

KOMBET E
BASHKUARA



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr. IT-05-87-T
Data: 26 shkurt 2009
Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE

Para: Gjykatësit Iain Bonomy, Kryegjykatës
Gjykatësit Ali Nawaz Chowhan
Gjykatëses Tsvetana Kamenova
Gjykatëses Janet Nosworthy, Gjykatëse Rezerve

Sekretari Z. John Hocking
i Përkohshëm:

Aktgjykim: 26 SHKURT 2009

PROKURORI

kundër

**MILLAN MILLUTINOVIQIT
NIKOLLA SHAINOVIQIT
DRAGOLUB OJDANIQIT
NEBOJSHA PAVKOVIQIT
VLADIMIR LLAZAREVIQIT
SRETEN LLUKIQIT**

PUBLIK

AKTGJYKIM

Vëllimi 3 nga 4

Zyrës së Prokurorit:

Z. Thomas Hannis
Z. Chester Stamp

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Eugene O'Sullivan dhe Z. Sillobodan Zeçeviq për Z. Millan Millutinoviq
Z. Toma Fila dhe Z. Vladimir Petrovich për Z. Nikolla Shainoviq
Z. Tomislav Vishnjiq dhe Z. Norman Sepenuk për Z. Dragolub Ojdaniq
Z. John Ackerman dhe Z. Aleksandar Aleksiq për Z. Nebojsa Pavkoviq
Z. Mihajlo Bakrač dhe Z. Gjuro Çepiq për Z. Vladimir Lazarevich
Z. Branko Llukiq dhe Z. Dragan Ivetic për Z. Sreten Llukiq

VIII. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE.....	7
A. FORMA TË PËRGJEGJËSISË SIPAS AKTAKUZËS	7
B. KRYERJA NËPËRMJET NJË NDËRMARRJEJE TË PËRBASHKËT KRIMINALE.....	7
1. Akuzat e Aktakuzës që lidhen me ndërmarrjen e përbashkët kriminale	7
2. Historia procedurale e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në këtë çështje	9
3. Elementë fizikë	12
a. Plani, projekti ose qëllimi i përbashkët - elementi i dytë	12
i. Praktika e krimeve në pranverë të vitit 1999.....	13
(A) Provat demografike.....	14
(B) Konfiskimi i dokumenteve të identitetit	17
(C) Praktikë e identifikueshme e shpërnguljes së dhunshme.....	22
ii. Konteksti i ngjarjeve më 1998 dhe 1999.....	23
iii. Armatosja e joshqiptarëve dhe çarmatosja e shqiptarëve kosovarë	24
(A) Procesi i armatosjes së popullatës joshqiptare.....	25
(B) Ligjshmëria e armatosjes së popullatës joshqiptare.....	26
(C) Armatosja dhe çarmatosja e popullatës në bazë të kombësisë.....	27
(D) Armatosja dhe çarmatosja diskriminuese	33
iv. Shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit dhe përpjekjet diplomatike.....	34
v. Emërimet e zyrtarëve të lartë.....	35
vi. Pengimi i drejtësisë	38
vii. Përfundime	39
b. Shumësi individësh – elementi i parë	42
c. Kontributi i konsiderueshëm—Elementi i tretë	42
C. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E MILLAN MILLUTINOVIQIT	42
1. Akuzat e Aktakuzës	42
2. Posti i Millutinoviqit si Presidenti i Serbisë	44
a. Pushteti i Millutinoviqit mbi forcat e armatosura.....	45
i. Kompetencat de jure të Millutinoviqit	45
ii. Millutinoviqi si anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes	45
iii. Millutinoviqi si anëtar i Komandës së Lartë në kohë luftime	54
iv. Millutinoviqi në mbledhje të ndryshme	55
b. Marrëdhëniet e Millutinoviqit me qeverinë serbe	60
i. Incidenti Jashari në mars 1998.....	61
ii. Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq	62
iii. Kompetenca e Millutinoviqit për gradimin e zyrtarëve të MPB-së.....	63
iv. Kontakte të tjera me qeverinë.....	63
v. Përfundim	65
c. Kompetenca dekretuese e Millutinoviqit.....	65
d. Millutinoviqi si negociator me shqiptarët kosovarë	71
e. Millutinoviqi si negociator me bashkësinë ndërkombëtare	78
f. Millutinoviqi në Rambuje dhe në Paris	83
g. Kontaktet e Millutinoviqit me Rugovën	87
3. Pozita e Millutinoviqit si anëtar i SPS-së	91
4. Marrëdhëniet dhe kontaktet e Millutinoviqit me Presidentin e RFJ-së, Millosheviqin.....	94
5. Synimi kriminal i Millutinoviqit për Kosovën dhe shqiptarët kosovarë	96
6. Dijenja e Millutinoviqit për ngjarjet në Kosovë	99
7. Konkluzione mbi përgjegjësinë e Millan Millutinoviqit sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit	108
a. Fajësia nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale	108
b. Planifikimi/Nxitja/Urdhërimi	111
c. Ndihmë dhe inkurajim.....	112

8. Përfundimet lidhur me përgjegjësinë e Millan Millutinoviçit sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit	113
9. Përfundim	113
D. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E NIKOLLA SHAINOVIÇIT	114
1. I Akuzuari	114
2. Akuzat e Aktakuzës	114
3. Kompetencat e Shainoviçit.....	115
a. Shainoviçi si përfaqësues i Millosheviçit në Kosovë.....	115
b. Pushteti i Shainoviçit mbi UJ-në dhe MPB-në.....	120
i. Pushteti i Shainoviçit mbi UJ-në dhe MPB-në në vitin 1998	121
(A) Mbledhjet e Komandës së Përbashkët	122
(B) Mbledhje të tjera	133
ii. Pushteti i Shainoviçit mbi UJ-në dhe MPB-në në vitin 1999	134
c. Kontaktet e Shainoviçit me KVM-në dhe pengimi i procesit të Marrëveshjeve të Tetorit	147
i. Pengimi i procesit të Marrëveshjeve të Tetorit	147
ii. Shainoviçi si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në	149
iii. Shembuj të pushtetit të Shainoviçit si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim	156
iv. Përfundim	160
d. Shainoviçi në Rambuje.....	161
e. Kontaktet e Shainoviçit me Rugovën.....	165
4. Marrëdhëniet e Shainoviçit me Millosheviçin	169
a. Pozita e Shainoviçit si anëtar i SPS-së	169
b. Takimet me Millosheviçin.....	171
c. Përfundim	172
5. Synimi kriminal i Shainoviçit në lidhje me Kosovën dhe shqiptarët kosovarë.....	172
6. Dijenia e Shainoviçit për krimet në Kosovë dhe përpjekjet për t'i proceduar penalisht.....	176
a. Dijenia për krimet.....	176
b. Përpjekjet për parandalimin dhe/ose ndëshkimin e krimeve	181
c. Përfundim	182
7. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Nikolla Shainoviçit.....	183
E. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E DRAGOLUB OJDANIÇIT.....	192
1. I akuzuari	192
2. Akuzat në Aktakuzë.....	192
3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ojdaniçit në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së	193
4. Sjellja e Ojdaniçit në vitin 1998 dhe 1999	198
a. Përdorimi i UJ-së në Kosovë në vitin 1998 dhe emërimi si shef i Shtabit të Përgjithshëm.....	198
b. Roli në Këshillin e Lartë të Mbrojtjes, Komandën e Lartë dhe Komandën e Përbashkët ..	201
c. Armatosja e popullatës joshqiptare.....	204
d. Qëndrimi në lidhje me Marrëveshjet e Tetorit	206
e. Zëvendësimi i ushtarakëve të lartë të UJ-së	212
f. Urdhrat ushtarakë për përdorimin e UJ-së.....	215
5. Dijenia dhe reagimi i Ojdaniçit për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe MPB-ja.....	218
a. Dijenia për krimet në Kosovë përpara fushatës ajrore të NATO-s.....	219
b. Dijenia për krimet në Kosovë pas datës 23 mars 1999.....	223
i. Krimet e anëtarëve të UJ-së	224
ii. Masat e marra në lidhje me vullnetarët	229
iii. Dijenia për implikimin e UJ-së dhe MPB-së në krizën humanitare.....	231
iv. Misionet e administratës së sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në Kosovë.....	234
v. Mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj.....	236
vi. Krimet e kryera nga paraushtarakët dhe anëtarët e MPB-së	239
vii. Raportet e datave 25 maj dhe 4 qershor	241
viii. Dalja e aktakuzës së parë	246
ix. Mosdisplinimi i Pavkoviçit	248
x. Masat përmes gjykatave ushtarake.....	250

xi. Përfundim në lidhje me dijeninë për krimet në Kosovë dhe reagimin ndaj tyre	253
6. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Dragolub Ojdaniqit.....	254
a. Kryerja e krimeve përmes pjesëmarrjes në ndërmarrje të përbashkët kriminale.....	254
b. Ndihma dhe inkurajimi.....	257
c. Përgjegjësia si epror.....	263
F. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E NEBOJSHA PAVKOVIQIT	264
1. I akuzuari	264
2. Akuzat në Aktakuzë.....	265
3. Roli i Pavkoviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës.....	266
a. Emërimi dhe kompetencat	266
b. Roli i Pavkoviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës.....	266
i. Kontaktet me Millosheviqin dhe pjesëmarrja në Komandën e Përbashkët në vitin 1998..	266
ii. Armatosja e popullatës joshqiptare në Kosovë	279
iii. Dijenia dhe veprimet si komandant i Korpusit të Prishtinës.....	280
4. Roli i Pavkoviqit si komandant i Armatës së Tretë	285
a. Emërimi dhe kompetencat	285
i. Emërimi.....	285
ii. Kompetencat dhe përgjegjësitë	287
b. Sjellja e Pavkoviqit si komandant i Armatës së Tretë	288
i. Shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit	288
ii. Urdhrat ushtarakë	290
iii. Deklarata në kazermën “Kosovski Junaci”	293
iv. Kontaktet me Millosheviqin dhe pjesëmarrja në Komandën e Përbashkët në vitin 1999	294
v. Përgjegjësia për operacionet e forcave të MPB-së.....	297
c. Dijenia për krimet në Kosovë dhe reagimi i Pavkoviqit.....	298
i. Prania në Kosovë.....	299
ii. Dijenia për krimet përmes raporteve dhe mbledhjeve	300
iii. Raportimi nga Armata e Tretë	315
iv. Informacioni i dhënë nga bashkësia ndërkombëtare	320
v. Pavkoviqi dhe sistemi i drejtësisë ushtarake	322
vi. Përfundim.....	325
5. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Nebojsa Pavkoviqit.....	326
G. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E VLADIMIR LLAZAREVIQIT.....	337
1. I akuzuari	337
2. Akuzat në Aktakuzë.....	337
3. Emërimi i Llazareviqit si shef i Shtabit dhe komandant i Korpusit të Prishtinës.....	338
4. Llazareviqi si shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës në vitin 1998.....	340
a. Llazareviqi dhe operacionet e përbashkëta.....	340
i. Pjesëmarrja e Llazareviqit në operacionet e përbashkëta.....	340
ii. Pjesëmarrja e Llazareviqit në mbledhjet e Komandës së Përbashkët	342
b. Dijenia e Llazareviqit për krimet e kryera më 1998 nga UJ-ja dhe MPB-ja	342
5. Llazareviqi si komandant i Korpusit të Prishtinës në vitin 1999.....	347
a. Detyrat dhe kompetencat e Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës.....	347
b. Llazareviqi dhe operacionet e përbashkëta në vitin 1999.....	348
c. Implikimi i Llazareviqit në inkuadrimitin e vullnetarëve në njësitë e Korpusit të Prishtinës.....	353
d. Dijenia dhe reagimi i Llazareviqit ndaj krimeve të kryera në vitin 1999	355
i. Prania e Llazareviqit në terren	355
ii. Dijenia për krimet e kryera nga anëtarët e njërive të Korpusit të Prishtinës	357
e. Reagimet ndaj krimeve të kryera nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës	366
i. Masat e marra lidhur me krimet e kryera nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës	367
ii. Llazareviqi dhe gjykata ushtarake e Komandës së Korpusit të Prishtinës	370
iii. Llazareviqi dhe ekzaminimet mjeko-ligjore në Kosovë	370
iv. Masat e marra lidhur me masakrën në Hallaç të Vogël	371
v. Masat e marra lidhur me masakrën e Izbicës	373

vi. Reagimi ndaj krimeve të kryera nga anëtarët e MPB-së.....	376
f. Masat parandaluese të marra brenda Korpusit të Prishtinës.....	376
i. Masat e përgjithshme parandaluese.....	376
ii. Shkarkimi nga detyra i komandantëve.....	378
iii. Masat e marra në lidhje me civilët.....	381
6. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Vladimir Llazareviqit.....	386
a. Kryerja e krimeve përmes pjesëmarrjes në ndërmarrje të përbashkët kriminale.....	387
b. Ndihma dhe inkurajimi.....	389
c. Përgjegjësia si epror.....	394
H. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E SRETEN LLUKIQIT.....	396
1. I Akuzuari.....	396
2. Akuzat e Aktakuzës.....	396
3. Grada e Llukiqit.....	397
4. Pozita e Llukiqit në kuadër të Shtabit të MPB-së.....	398
a. Funkcionet e Shtabit të MPB-së për Kosovën.....	399
i. Argumentet e palëve dhe dëshmitë e dëshmitarëve.....	399
(A) Kompetencat e Shtabit të MPB-së mbi njësitë e RJB-së.....	399
(B) Pushteti i Shtabit të MPB-së mbi njësitë e RDB-së.....	405
(C) Roli i Shtabit të MPB-së në planifikimin e operacioneve.....	407
(D) Raportimi në Shtabin e MPB-së.....	410
ii. Prova shkresore.....	412
(A) 1998.....	412
(B) 1999.....	417
b. Përfundime lidhur me rolin dhe funksionet e Shtabit të MPB-së.....	424
5. Kompetencat e Llukiqit si shef i Shtabit të MPB-së.....	425
a. Pjesëmarrja e Llukiqit në mbledhje të nivelit të lartë.....	426
b. Kontaktet e Llukiqit me vëzhguesit ndërkombëtarë.....	432
c. Kompetencat e Llukiqit për masa disiplinore.....	435
d. Përfundime.....	436
6. Roli i Llukiqit në raportimin për Ministrinë e Brendshme.....	437
7. Pjesëmarrja e Llukiqit në armatosjen e civilëve joshqiptarë.....	441
8. Implikimi i Llukiqit në shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit.....	443
9. Kontrolli i Llukiqit mbi stacionet e policisë kufitare.....	445
10. Dijenia e Llukiqit për krimet.....	446
a. Dijeni për krimet më 1998.....	447
b. Dijenia për krimet më 1999.....	449
c. Pjesëmarrja e Llukiqit në fshehjen e kufomave.....	454
11. Përfundime mbi përgjegjësinë e Sreten Llukiqit.....	460
IX. PËRCAKTIMI I DËNIMIT.....	471
A. LIGJI PËR PËRCAKTIMIN E DËNIMIT.....	471
1. Qëllimet e dënimit.....	472
2. Dhënia e dënimeve.....	472
a. Pesha e shkeljes.....	472
b. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese.....	473
i. Rrethanat rënduese.....	474
ii. Rrethanat lehtësuese.....	475
iii. Praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë.....	475
iv. Përfitimi i kohës së paraburgimit.....	478
B. LIGJI MBI FAJËSINË E SHUMËFISHTË DHE AKUZAT KONKRETE NË KËTË ÇËSHTJE.....	478
C. PËRCAKTIMI I DËNIMEVE NË KËTË ÇËSHTJE.....	480
1. Pesha e Shkeljeve.....	480
2. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese.....	481
a. Rrethanat e përgjithshme.....	481

b. Shainoviqi.....	482
c. Ojdaniqi.....	483
d. Pavkoviqi.....	485
e. Llazarevici.....	486
f. Llukiqi.....	488
X. VENDIM.....	491
MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT CHOWHAN.....	494

VIII. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

A. FORMA TË PËRGJEGJËSISË SIPAS AKTAKUZËS

1. Të Akuzuarit akuzohen në bazë të paragrafit 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit për rolin e tyre të pretenduar në krime që thuhet se u kryen në Kosovë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë midis marsit dhe qershorit 1999. Konkretisht të Akuzuarit akuzohen si përgjegjës për dëbim, krim kundër njerëzimit (pika 1); zhvendosje e dhunshme si “veprime të tjera çnjerëzore,” krim kundër njerëzimit (pika 2); vrasje, krim kundër njerëzimit dhe shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (pikat 3 dhe 4); dhe përndjekje, krim kundër njerëzimit (pika 5).

2. Sipas Aktakuzës, objektivi i këtyre krimeve të pretenduara ishte popullata shqiptare e Kosovës, dhe të Akuzuarit morën pjesë, bashkë me të tjerë, në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për të ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës, për garantimin e vazhdimësisë së kontrollit të krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë. Më tej Prokuroria pretendon se qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale do të arrihej me anë të një fushate gjerësisht të përhapur ose sistematike terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare të Kosovës, përfshirë krime të ndryshme konkrete të përmendura në çdo pikë të Aktakuzës. Prokuroria deklaron se secili i Akuzuar akuzohet për krimet e pretenduara në Aktakuzë duke planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer apo ndryshe duke ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve në fjalë. Nuk pretendohet se ndonjëri prej të akuzuarve kreu fizikisht ndonjë prej krimeve për të cilat akuzohet personalisht, por se “kryerja” lidhet me pjesëmarrjen e tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

3. Më tej Dhoma do të analizojë përgjegjësisë penale individuale të secilit prej të gjashtë të Akuzuarve, duke filluar me ekzistencën e pretenduar të një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët – elementi i dytë fizik i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, siç pretendon Prokuroria në Aktakuzë.

B. KRYERJA NËPËRMJET NJË NDËRMARRJEJE TË PËRBASHKËT KRIMINALE

1. Akuzat e Aktakuzës që lidhen me ndërmarrjen e përbashkët kriminale

4. Dhoma Gjyqësore e gjykon të rëndësishme të rikujtojë tekstualisht pjesë konkrete të Aktakuzës për ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale:

18. Me përdorimin e fjalës “kryen” në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk synon të sugjerojë se ndonjëri prej të akuzuarve kreu fizikisht ndonjë prej krimeve për të cilat akuzohet personalisht. “Kryerja” në këtë aktakuzë, e përdorur lidhur me të akuzuarit, do

të thotë pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale si bashkëkryes, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.

19. Synimi i kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale ndër të tjera ishte ndryshimi i ekuilibrit etnik në Kosovë me qëllim për të siguruar kontrollin e mëtejshëm serb mbi krahinën.¹ Ky qëllim do të realizohej me mjete kriminale që përbëheshin nga një fushatë e gjerë ose sistematike terrori dhe dhune duke përfshirë largimet, vrasjet, shpërnguljet e dhunshme dhe përndjekjet kundër popullatës shqiptare të Kosovës gjatë periudhës së aktakuzës. Për përmbylljen e këtij qëllimi, secili prej të akuzuarve, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kontribuoi në ndërmarrjen e përbashkët kriminale duke shfrytëzuar mundësitë *de jure* dhe *de facto* që kishte në dispozicion.

20. Kjo ndërmarrje e përbashkët kriminale filloi jo më vonë se në tetor të vitit 1998 dhe vazhdoi gjatë kohës së kryerjes së krimeve të përmendura në Pikat 1 – 5 të kësaj aktakuze: duke filluar më 1 janar 1999 ose rreth kësaj date dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999. Një numër individësh morën pjesë në këtë ndërmarrje të përbashkët kriminale gjatë tërë ekzistencës së saj, ose ndryshe, në kohë të ndryshme gjatë ekzistencës së saj, duke përfshirë MILLAN MILLUTINOVIQIN, NIKOLLA SHAINOVIQIN, DRAGOLUB OJDANIQIN, NEBOJSHA PAVKOVIQIN, VLLADIMIR LLAZAREVIQIN, Vllastimir Gjorgjeviqin, SRETEN LLUKIQIN, Sllobodan Millosheviqin dhe Vllajko Stojilkoviqin. Ndër anëtarë të tjerë ishin Radomir Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, Dragan Iliqi dhe persona të pidentifikuar të cilët ishin anëtarë të strukturave komanduese dhe bashkërenduese dhe anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë që kishin të njëjtin synim për jetësimin e qëllimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Gjithashtu, dhe/ose ndryshe, MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, Vllastimir Gjorgjeviqi, SRETEN LLUKIQI, Sllobodan Millosheviqi, Vllajko Stojilkoviqi, Radomir Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, Dragan Iliqi zbatuan objektivat e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nëpërmjet anëtarëve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë, nën kontrollin e tyre në kryerjen e krimeve për të cilat akuzohen në këtë aktakuzë.

21. Krimet e renditura në Pikat 1 – 5 të kësaj Aktakuze përfshiheshin në synimin e kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe të akuzuarit kishin të njëjtin synim me bashkëkryesit e tjerë që të kryeshin këto krime. Ndryshe, krimet e renditura në Pikat 3-5 ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të mundshme të jetësimit të ndërmarrjes. Megjithëse ishin të vetëdijshëm për pasojat e parashikueshme, MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLLADIMIR LLAZAREVIQI, Vllastimir Gjorgjeviqi dhe SRETEN LLUKIQI, vendosën të merrnin pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Secili prej të akuzuarve dhe pjesëmarrësve të tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale gjithashtu kishin të njëjtin synim dhe gjendjen e nevojshme mendore për kryerjen e secilit prej krimeve për të akuzohen në pikat 1 – 5. Mbi këtë bazë, në pajtim me Nenin 7 (1) të Statutit, secili prej të akuzuarve bart përgjegjësi penale individuale për krimet e pretenduara në Pikat 1 – 5.

5. Rrjedhimisht në paragrafin 21 të Aktakuzës pretendohet se të Akuzuarit “kryen” krime të akuzuara sipas formave 1 dhe 3² të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Akuzat e Pikave 1-5

¹ Shih Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 27, 249; Argumente përmbyllëse të Prokurorisë, T. 26770, 26776 (19 gusht 2008).

² Shih Vendim i Rregullën 98bis, T. 12787 (18 maj 2007) (“Dhoma është e mendimit se Prokuroria ka ngarkuar të akuzuarit me përgjegjësi për krimet e akuzuara sipas kategorisë së parë dhe të tretë të NPK-së, të shprehur në jurisprudencën e Tribunalit. Në veçanti, Dhoma pranon se të akuzuarit akuzohen se janë përgjegjës për shpërnguljen e

janë të formës 1 të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale; dhe, ndryshe, Prokuroria i ka përfshirë Pikat 3-5 (vrasje dhe përndjekje) si formën 3 të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.³

6. Në paragrafët 23-33, Aktakuza ofron një përmbledhje të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Paragrafi 23 pretendon ekzistencën e një hierarkie funksionuese komanduese midis “niveleve më të larta në Beograd dhe forcave të RFJ-se dhe të Serbisë në terren,” dhe se strukturat e zhvilluara komanduese dhe kontrolluese garantuan mbikëqyrjen e pandërprerë të gjendjes në terren. Për më tepër, Kushtetuta dhe ligjet e rregullat në fuqi në RFJ lejuan që Millosheviqi, Millutinoviqi dhe Ojdaniqi, nëpërmjet KLM-së dhe Komandës së Lartë, të ushtronin kontroll edhe mbi UJ-në edhe mbi MPB-në. Paragrafi 24 pretendon se Millosheviqi, Millutinoviqi, Shainoviqi, Pavkoviqi, Llazareviqi dhe Llukiqi ushtruan komandë dhe kontroll mbi forcat e RFJ-se dhe të Serbisë në Kosovë nëpërmjet Komandës së Përbashkët.⁴

7. Paragrafët 25-31 të Aktakuzës pretendojnë se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë zbatuan një fushatë të qëllimshme dhe të përhapur gjerësisht ose sistematike për dëbimin dhe shpërnguljen me dhunë të popullatën shqiptare kosovare brenda Kosovës nëpërmjet krijimi të një atmosfere frike dhe shtypjeje, shkatërrimit të pronës dhe veprimeve brutale dhe të dhunshme. Pasi shqiptarët kosovarë u dëbuan me dhunë nga shtëpitë dhe formuan kolona që shkonin në drejtim të kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë morën nën kontroll rrugët për në kalimet kufitare, i keqtrajtuuan shqiptarët kosovarë, dhe konfiskuan dhe shkatërruan sistematikisht dokumentet e tyre personale të identifikimit.

2. Historia procedurale e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në këtë çështje

8. Ndërmarrja e përbashkët kriminale në këtë çështje nuk shfaqet në një zbrazëti procedurale. Përkundrazi, prej *shumë* vitesh ajo ka qenë temë e argumenteve ligjore në sallën gjyqësore. Dhoma do të shtjellojë shkurtimisht disa aspekte të vendimeve të marra në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale në këtë çështje.

9. *Ekzistenca e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale si formë përgjegjësie.* Më 13 shkurt 2003, Dhoma hodhi poshtë mocionin e Ojdaniqit për mosnjohjen e juridiksionit të Tribunalit sipas Nenit 7 të Statutit mbi persona të akuzuar si anëtarë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Nëpërmjet atij vendimi, Dhoma e cilësoi ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale si

dhunshme të popullatës shqiptare të Kosovës, ose planin e përbashkët, dhe se vrasjet e kryera në lidhje me synimin kryesor të NPK-së ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme në kategorinë e tretë të NPK-së.”)

³ Aktakuza, para. 21.

⁴ *Shih gjithashtu* Aktakuzën, para. 97 (“Së paku midis fundit të korrikut dhe fundit të tetorit të vitit 1998, takime të Komandës së Përbashkët janë mbajtur në Prishtinë për situatën në Kosovë pothuaj përditë.”)

formë përgjegjësie, duke cituar jurisprudencën e Dhomës së Apelit, të drejtën zakonore ndërkombëtare, të drejtën penale ndërkombëtare të përgjithshme, legjislacionin e vendeve të ndryshme, dhe jurisprudencën e proceseve penale të pasluftës së dytë botërore.⁵ Dhoma e Apelit la në fuqi vendimin e Dhomës.⁶

10. *Anëtarësia në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.* Më 22 mars 2006, Dhoma hodhi poshtë mocionin e mëtejshëm të Ojdaniqit për mosnjohjen e juridiksionit në të cilin argumentoi se as në Statut, as në të drejtën zakonore ndërkombëtare nuk njihet koncepti se një i akuzuar mund të mbajë përgjegjësi për pjesëmarrjen e tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale ku një apo më shumë pjesëmarrës të ndërmarrjes së përbashkët kriminale përdorin persona jashtë ndërmarrjes së përbashkët kriminale për të kryer fizikisht krime të cilat përbëjnë synimin e përbashkët të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Dhoma përfundoi se çështja nëse anëtarë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale mund të kryenin krime me anë të njerëzve të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk lidhej me juridiksionin e Tribunalit, por me “kornizën e përgjegjësisë [së ndërmarrjes së përbashkët kriminale],” që mund të trajtohej në mënyrë të duhur vetëm në kuadrin e fakteve. Kjo çështje duhej trajtuar në gjyq dhe si pasojë Dhoma e hodhi poshtë mospranimin e juridiksionit prej Ojdaniqit.⁷ Mirëpo, jurisprudenca e mëvonshme e Dhomës së Apelit bëri që Prokuroria të tërhiqte pjesërisht paragrafin 20 të Aktakuzës, siç përshkruhet më poshtë, duke e zgjidhur këtë çështje para aktgjykimit përfundimtar të kësaj çështjeje.

11. Aktakuza pretendon se ndër pjesëmarrësit e ndërmarrjes së përbashkët kriminale përfshiheshin të gjithë të Akuzuarit si dhe Vllastimir Gjorgjeviqin, Sllobodan Millosheviqin, Vllajko Stojilkoviqin, Radomir Markoviqin, Obrad Stevanoviqin dhe Dragan Iliqin. Rrjedhimisht të gjithë individë e lartpërmendur janë anëtarë të identifikuar me emër të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Mirëpo, në paragrafin 20 Prokuroria pretendon gjithashtu se personat e mëposhtëm të paidentifikuar ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale: “persona të paidentifikuar të cilët ishin anëtarë të strukturave komanduese dhe bashkërenduese dhe anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë që kishin të njëjtin synim për jetësimin e qëllimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.”⁸ Më tej Aktakuza pretendon, se ndryshe anëtarët e identifikuar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale “zbatuan objektivat e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nëpërmjet anëtarëve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë, nën kontrollin e tyre në kryerjen e krimeve për të cilat

⁵ *Prokurori k. Millutinoviqit e të tjerëve*, Lënda Nr. IT-99-37-PT, Vendim mbi Mocionin Paraprak të Dragolub Ojdaniqit për Mospranim për Mungesë Juridiksioni: Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale, 13 shkurt 2003, f. 6–7.

⁶ *Prokurori k. Millutinoviqit e të tjerëve*, Lënda Nr. IT-99-37-AR72, Vendim mbi Mocionin e Dragolub Ojdaniqit për Mospranim Juridiksioni: *Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale*, 21 maj 2003, para. 30, 33, 44.

⁷ Vendim mbi Mocionin e Dragolub Ojdaniqit për Mospranim Juridiksioni: *Bashkëkryerja e tërthortë*, 22 mars 2006, para 23-24.

⁸ Aktakuza, para. 20.

akuzohen në këtë aktakuzë.”⁹ Megjithatë, gjatë parashtrimeve gojore në përgjigje të mocioneve të të Akuzuarve për lirim nga akuzat, Prokuroria tha se “duke marrë parasysh aktgjykimin e apelit në [çështjen] Bërgjanin... *ne do të vazhdojmë tani vetëm në bazë të këtij interpretimi alternativ*, se këta gjashtë anëtarë [të ndërmarrjes së përbashkët kriminale] shfrytëzuan anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë të cilët i kishin nën kontroll për të kryer dëbime, zhvendosje të dhunshme, vrasje dhe përndjekje.”¹⁰ Prokuroria përsërit këtë qëndrim në dosjen e saj gjyqësore përfundimtare.¹¹ Si rrjedhojë për nxjerrjen e përfundimeve lidhur me përgjegjësinë e të Akuzuarve, Dhoma do të bazohet në këtë formulim.

12. *Pretendimi për krime më 1998 në lidhje me synimin kriminal të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.* Gjithashtu, më 22 mars 2006, Dhoma miratoi kundërshtimin e Mbrojtjes në lidhje me krimet e vitit 1998 të përmendura në Aktakuzë, që Prokuroria donte të shfrytëzonte për të provuar se të Akuzuarit ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe kishin synimin e duhur kriminal për të kryer krimet a akuzuara. Dhoma konkludoi se këto krime ishin fakte materiale të cilat duheshin paraqitur në mënyrë të duhur dhe për këtë arsye urdhëroi që nëse donte të përdorte këto krime të pretenduara të vitit 1998 në gjyq, Prokuroria duhej të ndryshonte Aktakuzën për të identifikuar, të paktën, datat dhe vendet e krimeve dhe lidhjen e pretenduar me çdo të Akuzuar dhe të jepte emrat e viktimave, nëse Prokuroria mund të bënte një gjë të tillë.¹² Më 11 maj 2006, Dhoma miratoi ndryshimet e Prokurorisë në Aktakuzë (paragrafët 94-97), duke marrë parasysh se

informacioni i dhënë në Aktakuzën e Propozuar për krimet e pretenduara të vitit 1998 mjafton “që [të Akuzuarit] të mund të përgatisin mbrojtjen në mënyre efektive dhe efikase,” në veçanti duke qenë se nga pretendimet në fjalë nuk burojnë akuza të veçanta kundër ndonjërit prej të Akuzuarve, por shfrytëzohen për të vërtetuar elementë konkretë të krimeve dhe të formave të përgjegjësisë të pretenduara në aktakuzë.¹³

13. Krimet e vitit 1998 diskutohet në Pjesën VI.C dhe gjithashtu sa herë që është e përshtatshme, në pjesët e përgjegjësisë së të Akuzuarve.

14. *Ndërmarrja e përbashkët kriminale nëpërmjet mosveprimit.* Në vendimin e saj i cili hodhi poshtë mocionet e të Akuzuarit për pafajësi, konkluzioni i Dhomës në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale nëpërmjet mosveprimit ishte si më poshtë:

⁹ Aktakuza, para. 20.

¹⁰ Seanca e Rregullës 98 bis, T. 12577 (3 maj 2007) (theksi i shtuar). Gjatë dhënies së Vendimit të Rregullës 98 bis, Dhoma paralajmëroi se “Ky është një argument i rëndësishëm i Prokurorisë të cilën palët duhet të kenë parasysh.” Seanca e Rregullës 98 bis, T. 12787 (18 maj 2007).

¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 10.

¹² Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes të cilat Pretendojnë Mangësi në Formën e Aktakuzës së Propozuar të Përbashkët të Ndryshuar, 22 mars 2006, para. 11-17, 33(3)(b).

¹³ Vendim mbi Mocionin për Ndryshimin e Aktakuzës, 11 maj 2006, para. 11 (pa shënime në fund të faqes).

[n]ë këtë çështje, ku provat shpalosin një detyrim ligjor dhe mosveprim nga njëri apo disa të Akuzuarit, kjo mund të interpretohet si provë e mjaftueshme e pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale si përgjegjësi sipas nenit 7(1) nëse, me anë të një mosveprimi të tillë, i jepet ndihmesë e konsiderueshme ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁴

15. Më pas, disa të Akuzuar kërkuar leje për të apeluar këtë pjesë të vendimit. Më 14 qershor 2007, Dhoma hodhi poshtë kërkesën për apelim, duke konkluduar se (a) akuzat në Aktakuzë ishin të mjaftueshme për të informuar të Akuzuarit për format e përgjegjësisë nëpërmjet të cilave thuhet se ishin përgjegjës për shkeljet themelore të Aktakuzës; (b) vendimi nuk lidhej me një çështje që do të ndikonte qenësisht në kryerjen e një procesi të shpejtë dhe të drejtë ose në rezultatin e gjykimit; dhe (c) zgjidhja e çështjes nga Dhoma e Apelit në atë kohë nuk mund të përshpejtonte procesin nga pikëpamja ligjore.¹⁵

3. Elementë fizikë

a. Plani, projekti ose qëllimi i përbashkët - elementi i dytë

16. Thelbi i argumentit të Prokurorisë se secili i Akuzuar kreu krime të ndryshme duke marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale është pretendimi mbi ekzistencën e një ndërmarrjeje të tillë e cila përfshinte zyrtarë të ndryshëm të lartë dhe të pushtetshëm të qeverisë së RFJ-së dhe të Serbisë, dhe oficerë të lartë të UJ-së dhe të MPB-së të cilët drejtuan forcat e UJ-së dhe të MPB-së të Federatës dhe të Republikës në një fushatë terrori dhe dhune për shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare me synim ndryshimin e përbërjes etnike të popullatës në Kosovë për të siguruar kontrollin e krahinës për serbët etnikë. Para analizës mbi pjesëmarrjen e mundshme faktike të ndonjë të Akuzuari në një ndërmarrje të tillë, duhet vërtetuar ekzistenca e saj: me fjalë të tjera, nëse kishte veprim të bashkërenduar nga ana e zyrtarëve dhe të oficerëve të lartë për të përdorur pushtetin e shtetit kundër një pjese të qytetarëve të vetë për të arritur atë qëllim. Tani, Dhoma do të analizojë provat lidhur me këtë aspekt. Këtu, Dhoma dëshiron të theksojë se mori në shqyrtim të gjitha provat e rëndësishme në këtë çështje, përfshirë veprime dhe sjellje të të Akuzuarve, por duke përjashtuar intervista të katër të Akuzuarve të cilat, siç ka thënë më parë, do të përdoren vetëm në lidhje me të Akuzuarin i cili i dha intervistë Prokurorisë. Pasi jep përfundimin e saj për elementin e dytë fizik, Dhoma do të shqyrtojë elementë të tjerë fizikë dhe mendorë të

¹⁴ Seanca e Rregullës 98 bis, T. 12776-12777 (18 maj 2007).

¹⁵ Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Lejimin e Apelit të Ndërkohshëm të Vendimit të Rregullës 98 bis, 14 qershor 2007, para. 14-18 ("Shpesh është e vështirë të kategorizosh sjelljen si një veprim tërësisht aktiv ose mosveprim tërësisht pasiv. Të dy elementët mund të ekzistojnë në sjelljen në fjalë. Çështja nëse provat vërtetojnë se një i akuzuar 'kreu' një krim, nuk mund të zgjidhet me anë të një debati teorik i cili kërkon të caktojë rëndësinë e provave duke i klasifikuar në sjellje aktive ose mosveprim pasiv. Çështja nëse të Akuzuarit mund të fajësohen penalisht për pjesëmarrjen e tyre të pretenduar në NPK-në me anë të sjelljes e cila mund të interpretohet si "mosveprim" zgjidhet më mirë brenda kuadrit të provave konkrete të kësaj çështjeje, si provat e Prokurorisë, po ashtu edhe provat e Mbrojtjes.

ndërmarrjes së përbashkët kriminale në lidhje me secilin prej gjashtë të Akuzuarve në pjesët e tyre përkatëse.

17. Prokuroria ka ofruar shumë prova në përpjekjen e saj për të provuar ekzistencën e planit, projektit ose qëllimit të përbashkët. Sipas Dhomës, provat më bindëse të planit, projektit ose qëllimit të përbashkët lidhen me praktiken e krimeve në vitin 1999. Rrjedhimisht, në fillim të diskutimit Dhoma do të analizojë këto prova. Më pas, Dhoma do të shqyrtojë prova të tjera lidhur me elementin e dytë.

i. Praktika e krimeve në pranverë të vitit 1999

18. Prokuroria argumenton se provat për shkallën e shkatërrimit të fshatrave të shqiptarëve kosovarë, praktika e përgjithshme e dhunës, e vrasjeve, shpërnguljeve të konstatuara anembanë Kosovës, metodat e tipit ushtarak, mënyra e bashkërenduar dhe e organizuar e dërgimit të kolonave të refugjatëve nëpër dhe jashtë Kosovës, dhe konfiskimi sistematik i dokumenteve të identifikimit çojnë në përfundim se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vepruan në bazë të një plani të përbashkët, dhe se këto ngjarje nuk mund të kenë qenë rezultat i veprimeve individuale të dhunës të kryera kuturu nga individë në radhët e ushtrisë dhe policisë.¹⁶

19. Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se NATO-ja dhe mediat ndërkombëtare shtrembëruan ngjarjet në Kosovë për të shtuar mbështetjen publike për fushatën ajrore kundër RFJ-së. Ajo pretendon gjithashtu se asnjë organ i autorizuar i shtetit (qoftë publikisht, qoftë privatisht) nuk përmendi ndonjë plan për të dëbuar ose për të dëmtuar popullatën shqiptare kosovare para apo gjatë luftës.¹⁷ Mbrojtjet e Millutinoviçit dhe të Pavkoviçit argumentojnë se ka prova ku civilëve iu tha të ktheheshin në shtëpi dhe se gjatë bombardimit, midis forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, mbretëronte një atmosferë tejte kaotike.¹⁸

20. Së pari, Dhoma do të shqyrtojë dy aspekte të provave në këtë çështje: provat demografike të mbledhura në proces dhe konfiskimi i dokumenteve të identitetit.

¹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 268-269.

¹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 264-266.

¹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 303, f. 164-165; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 359; *shih* gjithashtu Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 629-630.

(A) Provat demografike

21. Duke shfrytëzuar analizën statistikore të Patrick Ball-it, Prokuroria deklaroi se ekzistonte një praktikë vrasjesh dhe të largimit të refugjatëve që tregon për një shkak të përbashkët.¹⁹ Sipas analizës së Ball-it, praktikat e konstatuara nuk përputheshin me hipotezat se rrjedha e migrimit dhe vrasjet u shkaktuan nga bombardimi i NATO-s apo nga veprimet e UÇK-së (përkatësisht “hipoteza e parë” dhe “hipoteza e dytë”), por përputheshin me hipotezën se shkak i ngjarjeve ishte veprimi i forcave jugosllave (“hipoteza e tretë”).²⁰

22. Eric Fruits u thirr bashkërisht nga Mbrojtja për të rishikuar raportet dhe dëshminë e Ball-it. Në bazë të aktekspertizës dhe të dëshmisë të Fruits-it, Mbrojtja e Ojdaniqit kundërshtoi saktësinë dhe plotësinë e të dhënave bazë të Ball-it, pretendoi mangësi në metodologjinë e tij dhe hodhi poshtë përfundimin e tij.²¹ Për më tepër, Mbrojtja e Ojdaniqit pretendoi se në vetvete Ball-i mund të kishte paragjykitje kundër Slllobodan Millosheviqit, duke u bazuar në komentet e bëra prej tij në një konferencë.²² Nga ana e saj, Prokuroria kundërshtoi kualifikimet e Fruits-it në fushën e demografisë statistikore.²³

23. Dhoma vëren se gjatë debatit të ekspertëve lidhur me praktikën e vrasjeve dhe të migrimit, u ngritën pesë probleme kyçe: pretendimi i anësisë së Ball-it; pretendimi i mungesës së kualifikimit të Fruits-it; integriteti dhe plotësia e të dhënave bazë; korrektësia e metodologjisë të zbatuar; dhe më e rëndësishmja, fuqia bindëse e përfundimit. Secila pikë do të shqyrtohet me radhë.

24. Së pari, lidhur me pretendimin e anësisë së Ball-it, Dhoma dëgjoi dëshmi se në një konferencë ku ishte i pranishëm më 14 korrik 2001, ai bëri thirrje për duartrokitje për të festuar ekstradimin e Slllobodan Millosheviqit në Hagë. Përveç kësaj, Ball-i pranoi se më vonë kishte thënë atje, “[u] fut në burg njëri prej njerëzve më të ligj në botë, të paktën gjatë jetës sime.” Kur gjatë pyetjeve nga Mbrojtja dëshmitari u ballafaqua me këtë citim, ai dëshmoi fillimisht se nuk i kujtohej nëse e kishte pasur fjalën për Millosheviqin dhe se mund të kishte folur për Pinoçetin.²⁴ I pyetur nga Kryegjykatësi se kur kishte qenë Pinoçeti në burg, Ball-i korrigjoi vetveten dhe pranoi

¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 314; Argumente përmblyllëse të Prokurorisë, T. 26805 (19 gusht 2008).

²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 314; Argumente përmblyllëse të Prokurorisë, T. 26809 (19 gusht 2008). *Shih* gjithashtu P1506 (aktekspertiza e Patrick Ball-it, 3 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 9.

²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 126-151.

²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 128; Argumente përmblyllëse të Ojdaniqit, T. 27146 (22 gusht 2008).

²³ Argumente përmblyllëse të Prokurorisë, T. 26806-26808 (19 gusht 2008).

²⁴ Patrick Ball, T. 10273-10277 (20 shkurt 2007).

zyrtarisht se e kishte pasur fjalën për Millosheviqin.²⁵ Dhoma është e mendimit se natyra dredhuese e përgjigjeve të dëshmitarit hedh dyshim mbi paanshmërinë e tij si dëshmitar ekspert. Mirëpo në dukje përgatitja dhe përmbajtja e aktekspertizave të Ball-it, nuk tregojnë anësi. Për më tepër, Ball-i nuk tregoi anësi gjatë dëshmisë gojore të tij para Dhomës. Rrjedhimisht, dëshmia e tij do të shqyrtohet më poshtë vetëm në lidhje me çështjen.

25. Së dyti, Prokuroria vë në pikëpyetje kualifikimet e Fruits-it në fushën e demografisë statistikore dhe pretendon se ai ka botuar vetëm një artikull në këtë fushë dhe nuk e njihte terminologjinë bazë në këtë fushë.²⁶ Gjithsesi, Dhoma është bindur se ekspertiza statistikore e Fruits-it është e mjaftueshme për t'i mundësuar atij kryerjen e një analize të vlefshme të aktekspertizës së Ball-it. Kjo vërtetohet nga dokumentet dhe jetëshkrimi i tij, përfshirë faktin se ka dhënë mësim në shkollë të mesme lëndën e analizës së regresionit linear, ka dhënë konsulencë në projekte të analizës statistikore të të dhënave demografike dhe është pranuar si ekspert statistikor në gjykata të Shteteve të Bashkuara.²⁷ Dhoma është e mendimit se përgjigjet e Fruits-it në gjyq ishin të mjaftueshme për një ekspert në fushën e tij dhe e gjykon të pabazë kundërshtimin ndaj kualifikimit të tij profesional.

26. Së treti, Fruits rendit një sërë parregullsish lidhur me të dhëna bazë të Ball-it.²⁸ Në veçanti, Fruits-i pretendon se gabimi kyç i Ball-it është fakti se, megjithëse studimi i tij kryesor shqyrtoi të dhëna mbi aktivitetet e UÇK-së dhe mbi bombardimet ajrore të NATO-s, aty nuk përfshiheshin të dhëna mbi forcat jugosllave apo mbi lëvizjet e tyre.²⁹ I pyetur për këtë nga Mbrojtja, Ball-i dëshmoi se ai dhe ekipi i tij kishin disa të dhëna në dispozicion për aktivitetet e forcave jugosllave, por tepër të pakta që të shfrytëzoheshin shkencërisht.³⁰ Fruits-i argumentoi se ky gabim, mospërfshirja e një ndryshori, jo vetëm tregon subjektivizëm kundër të dhënave që mungojnë, por bën që vlerësimet e ndikimit të veprimeve të UÇK-së dhe të NATO-s mbi situatën në terren të jenë jo të besueshme.³¹ Megjithëse Dhoma i kupton vështirësitë në mbledhjen e të dhënave mbi veprimet e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, ajo është e mendimit se dëshmia e Fruits-it në lidhje me këtë pikë, është e rëndësishme përkundërt përpjekjeve të Prokurorisë për të shfrytëzuar konstatimet e Ball-it si provë

²⁵ Patrick Ball, T. 10274-10275 (20 shkurt 2007).

²⁶ Argumente përmbyllëse të Prokurorisë, T. 26806-26807 (19 gusht 2008).

²⁷ Eric Fruits, T 25953-25955 (23 prill 2008).

²⁸ 3D 893 (Aktekspertiza e Eric Fruits-it, 3 shkurt 2008), f. 13-23.

²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 127, 150; *shih gjithashtu* 3D893 (Aktekspertiza e Eric Fruits-it, 3 shkurt 2008), f. 23-24.

³⁰ Patrick Ball, T. 10290 (20 shkurt 2007).

³¹ Eric Fruits, T. 25959 (23 prill 2008).

për vërtetimin e ekzistencës së një fushate të përhapur gjerësisht ose sistematike vrasjesh dhe dëbimesh të kryera nga forcat jugosllave.³²

27. Së katërti, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se metodologjia e Ball-it kishte mangësi.³³ Përfundimi i parë i Ball-it ishte se vrasjet dhe lëvizja e refugjatëve ndodhën sipas një modeli, dhe vlerat maksimale përkonin me njëra-tjetrën.³⁴ Mirëpo, Fruits-i theksoi se ekzistenca dhe ngjashmëria e praktikës së vrasjeve dhe të zhvendosjeve nuk u vërtetuan statistikisht dhe se një analizë më e kujdesshme zbulon se ka ndryshime thelbësore midis tyre.³⁵ Fruits-i i provoi Dhomës se grafikët e vrasjeve dhe të lëvizjes së refugjatëve nuk përkonin me njëri-tjetrin në të paktën tri pika kohore.³⁶ Dhoma gjykon se paralelizmi i argumentuar prej Ball-it midis këtyre dy praktikave dhe veprimeve të forcave jugosllave u rrëzua nga analiza e Fruits-it.³⁷

28. Së fundi, në bazë të shpjegimeve të mëparshme, Dhoma do të shqyrtojë përfundimin e Ball-it (dhe argumentin e Prokurorisë) se analiza e tij statistikore përputhet me hipotezën e tretë se forcat jugosllave zhvilluan një fushatë vrasjesh dhe dëbimesh masive.³⁸ Duhet theksuar që prej fillimit se Ball-i vetë pranoi se “statistikat e vëzhgimit nuk lejojnë konfirmimin e shkakut”³⁹ dhe rrjedhimisht ekspertiza e tij nuk shërben për gjë tjetër veçse për të hedhur poshtë hipoteza të tjera. Mirëpo, lidhur me ndërtimin e hipotezave, studimi kryesor i Ball-it pohon vetëm se “megjithëse mund të ketë shpjegime të tjera për praktikën e përsëritura të vrasjeve dhe të lëvizjeve të refugjatëve, ne konsiderojmë këto tri hipoteza si më të ngjashme.”⁴⁰ pa hyrë në hollësi për arsyet që motivuan këtë formulim. Mbrojtja e Ojdaniqit ofron katër shpjegime shtesë: lëvizja mund të ketë rezultuar nga urdhrat e UÇK-së që civilë shqiptarë kosovarë të braktisnin fshatrat e tyre; refugjatët mund të kenë ikur nga zonat e luftimit midis UÇK-së dhe forcave jugosllave; njerëzit mund të jenë larguar duke menduar se NATO-ja do të bombardonte; dhe praktikën mund të kenë qenë pasojë e bashkëpunimit midis NATO-s dhe UÇK-së në Kosovë.⁴¹ Dhoma vëren se përjashtimi i dy hipotezave të para nga Ball-i – edhe po të bazohet mbi të dhëna dhe metodologjinë e saktë – ka pak vlerë sepse mbeten disa hipoteza të mundshme të pashqyrtuara. Me fjalë të tjera, eliminimi i dy hipotezave nuk mjafton

³² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 314; Argumente përmblylëse të Prokurorisë, T. 26805 (19 gusht 2008).

³³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 134-136.

³⁴ P1506 (Aktekspertiza e Patrick Ball-it, 3 janar 2002), f. 15.

³⁵ Eric Fruits, T. 25964-25967 (23 prill 2008); 3D 893 (Aktekspertiza e Eric Fruits-it, 3 shkurt 2008), f. 24-26.

³⁶ Eric Fruits, T. 25966 (23 prill 2008); *shih gjithashtu* 3D1144 (Grafiku i Eric Fruits-it lidhur me “Eyeballing”, Prova materiale P1394, f. 3 me krahasim).

³⁷ P1506 (Aktekspertiza e Patrick Ball-it, 3 janar 2002), f. 4.

³⁸ P1506 (Aktekspertiza e Patrick Ball-it, 3 janar 2002), f. 4; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 314; Argumente përmblylëse të Prokurorisë, T. 26809 (19 gusht 2008).

³⁹ Patrick Ball, T. 10256 (20 shkurt 2007).

⁴⁰ P1506 (Aktekspertiza e Patrick Ball-it, 3 janar 2002), f. 3.

⁴¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 146.

sepse provat e paraqitura para Dhomës nuk tregojnë se ka vetëm tri *hipoteza* të mundshme. Gjithashtu, Dhoma kujton se mangësitë në të dhëna dhe metodologjinë bazë dhe të metat në modelin statistikor që mbështet ekzistencën e praktikave, d.m.th. fakti se ekzistojnë ndryshime thelbësore midis praktikave të vrasjeve dhe zhvendosje, hedhin më shumë dyshim mbi vlerën e përfundimeve të Ball-it.

29. Dhoma konstaton se synimi kryesor i Ball-it dhe bashkëpunëtorëve të tij – për të ofruar një mënyrë alternative dhe të re të konceptimit të dhunës politike⁴² - me gjasë është i lavdërueshëm. Po kështu, Dhoma nuk ka ndërmend të hedhë poshtë vlerën shkencore teorike të studimit dhe të metodologjisë së tij, gjë që i përket botës shkencore. Mirëpo Dhoma është e mendimit se mbi përfundimet e studimit është hedhur kaq shumë dyshim, se do të ishte e gabuar që ky studim të përdoret si provë.

(B) Konfiskimi i dokumenteve të identitetit

30. Prokuroria argumenton se konfiskimi i dokumenteve të identifikimit të shqiptarëve kosovarë provon se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vepronin sipas një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët.⁴³ Mbrojtja e Pavkoviçit e kundërshton këtë pohim, duke argumentuar se provat lidhur me dokumentet e identitetit nuk përputhen me teorinë e Prokurorisë të ekzistencës së një plani sepse jo të gjithë dëshmitarëve që dëshmuuan ua kishin konfiskuar letërnjoftimet dhe jo të gjithë kishin parë t'u konfiskoheshin të tjerëve.⁴⁴ Mbrojtja e Llukiqit deklaron se provat tregojnë se pretendimet e Prokurorisë lidhur me shkatërrimin e dokumenteve personale të identifikimit dhe targat e makinave janë të pavërteta. Ajo argumenton gjithashtu se jo vetëm pati dëshmitarë që pohuan se dokumentet e tyre personale nuk u konfiskuan, por dëshmitë nga anëtarët e MPB-së përgjegjës për kalimet e kufirit tregojnë se ata nuk kishin marrë kurrë urdhra për të shkatërruar dokumente identifikimi. Së fundi, Mbrojtja e Llukiqit argumenton se provat tregojnë se pasi letërnjoftimet u flakën nga pronarët e tyre, u bënë përpjekje për t'ua kthyer SPB-ve që i kishin lëshuar.⁴⁵

31. Dhoma i ka shqyrtuar tashmë provat në lidhje me konfiskimin e dokumenteve të identitetit të shqiptarëve kosovarë në pjesët e mëparshme, por më poshtë ajo do të nxjerrë dhe do t'i përmbledhë këto prova.

⁴² Patrick Ball, T. 10222-10223 (20 shkurt 2007).

⁴³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 268.

⁴⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 359.

⁴⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 195-204.

32. Shumë shqiptarë kosovarë të cilët dëshmuuan para Dhomës pohuan se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë konfiskonin dokumentet e identitetit, veçanërisht të shqiptarëve kosovarë. Edhe dëshmitarë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përshkruan konfiskimin dhe shkatërrimin e dokumenteve të identitetit të shqiptarëve kosovarë.⁴⁶ Shumica e konfiskimeve të letërnjoftimeve u krye në kufirin Kosovë-Shqipëri apo gjatë rrugës për në kufi, dhe jo vetëm në një pikë kalimi, por në komuna të ndryshme. Njëzet e gjashtë dëshmitarë shqiptarë kosovarë dëshmuuan për konfiskimin e dokumenteve të identifikimit në kufirin Kosovë-Shqipëri ose në një kolonë që po shkonte në kufi.⁴⁷ Një kolonë e cila po afrohej pikës kufitare të Vërbnicës (Morinë) më 3 prill 1999 thuhej se ishte 25 kilometër e gjatë;⁴⁸ dhe një kolonë tjetër nga Prizreni për në kufi më 3 prill 1999, kishte 20.000 njerëz.⁴⁹ Një grup tjetër i cili më 29 mars 1999 u transportua me tren për në Hanin e Elezit, në komunën e Kaçanikut, bartte mijëra refugjatë për në Maqedoni.⁵⁰ Disa dëshmitarëve nuk ua konfiskuan dokumentet e identifikimit,⁵¹ por shumica dëshmoi për konfiskimin e dokumenteve të identitetit në kufi nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.⁵²

33. Gjithashtu dëshmitarët thanë se panë kuti apo shporta të mëdha në të cilat forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hidhnin letërnjoftimet e shqiptarëve kosovarë. Në pikën kufitare të Vërbnicës (Morinë), katër dëshmitarë dëshmuuan se dokumentet e konfiskuara të identitetit u hodhën në një kuti apo shportë, dhe përshkruan sasinë e dokumenteve si “grumbull,” “mal” apo “pirg”⁵³ Dy dëshmitarë të cilët kaluan pikën kufitare të Qafës së Prushit më 2 prill 1999 së bashku me mijëra

⁴⁶ *Shih* p. sh. K89, T. 9124 (24 janar 2007); Nikë Peraj, P2248 (deklarata e dëshmitarit me datën 15 shkurt 2001), f. 9.

⁴⁷ *Shih* p. sh. Sabit Kadriu, P2377 (deklarata e dëshmitarit me datën 10 dhjetor 2000) (“Serbët e morën [letërnjoftimin tim] dhe na mallkuan dhe na thanë të shkonim në anën shqiptare të kufirit. U konfiskuan gjithashtu dokumentet e identifikimit të të gjithë bashkudhëtarëve të mi.”), f. 20; Rahim Latifi, P2831 (deklarata e dëshmitarit me datën 28 shkurt 1999), f. 3 (“Në pikën kufitare të Morinës na morën dokumentet personale.”); Martin Pnishi, P2236 (deklarata e dëshmitarit me datën 4 prill 2000), f. 4 (“Pashë se si civilët u detyruan të hidhnin letërnjoftimet e tyre përtokë.”); Mehmet Mazrekaj, T. 5813, 5838 (3 nëntor 2006) (“U morën dokumente njerëzve me mua në të njëjtën traktor. Dokumentet ia dhanë një polici.”).

⁴⁸ Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit me datën 5 tetor 2001), f. 5, P2523 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 903-904.

⁴⁹ Ali Hoti, T. 4156 (27 shtator 2006).

⁵⁰ Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitares me datën 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7-8.

⁵¹ *Shih* p. sh. Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitares me datën 9 qershor 2001), f. 5 (“Policët pyetën... nëse kishim letërnjoftime me vete.”).

⁵² *Shih* p. sh. Halit Berisha, P2326 (deklarata e dëshmitarit me datën 17 gusht 2001), f. 4 (“Kur erdhëm në Morinë në kufi, policët morën letërnjoftimet, patentat, targat e makinave. Kur erdhëm në Kukës, pamë se ishin rreth 5.000 njerëz në kolonë.”); Nazlie Bala, P2262 (deklarata e dëshmitares me datën 16 gusht 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 9.; Shyrete Berisha, T. 3910 (25 shtator 2006); Fuat Haxhibeqiri, T. 1103 (8 gusht 2006); K58, P2550 (deklarata e dëshmitarit me datën 2 shkurt 2000), versioni elektronik, f. 17; K81, P2526 (deklarata e dëshmitarit me datën 30 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 9.

⁵³ Mahmut Halimi, T. 4458-4459 (9 tetor 2006); Sadik Januzi, P2525 (deklarata e dëshmitarit me datën 23 prill 1999), versioni elektronik, f. 8; Ndrec Konaj, P2372 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 qershor 2001), f. 5; Halil Morina, P2522 (deklarata e dëshmitarit me datën 5 tetor 2001), f. 5; P2523 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 905.

persona të tjerë, thanë se kishte një kuti ku MPB-ja hodhi dokumentet e identifikimit;⁵⁴ një dëshmitar tha se, kur kaloi atje, kutia që pa kishte 300-400 dokumente.⁵⁵ Megjithëse Mbrojtja e Llukiqit pretendon se shqiptarët kosovarë u dorëzuan rojeve të kufirit dokumentet e tyre të identifikimit vullnetarisht që të ruheshin,⁵⁶ dhe paraqitën një dëshmitar për të dëshmuar për këtë,⁵⁷ Dhoma e hedh poshtë këtë argument dhe këtë dëshmi, përkundrejt dëshmimeve të shumë dëshmitarëve të cilët Dhoma i konsideron të besueshëm në këto pika.

34. Mbrojtja e Pavkoviçit pranoi se u konfiskuan dokumente identiteti, por argumenton se nuk ishte pjesë e një plani.⁵⁸ Ky pohim duket i pabesueshëm duke marrë parasysh dëshminë e K89-ës, ushtar i UJ-së në Gjakovë, dhe të Nikë Perajt, ish-oficer i UJ-së. K89-a dëshmoi se eprori i tij u tha: “të mos mbetet asnjë vesh shqiptari në Kosovë dhe të grisen dokumente të tyre të identifikimit që ata të mos kthehen më.” Më vonë, ai pa se si ushtarë të UJ-së konfiskuan dhe grisën dokumente të shqiptarëve kosovarë në Gjakovë.⁵⁹ Peraj dëshmoi se në Mejë u ngit një postbllok i MPB-së ku personeli i MPB-së konfiskoi dokumente të identifikimit.⁶⁰ Kur bëhet krahasimi me përshkrimet e konfiskimeve sistematike të dokumenteve të identifikimit, pretendimi i Mbrojtjes së Pavkoviçit se kjo ishte thjesht ideja e disa “njerëzve gjysmë të dehur në kufi.”, tingëllon jobindës⁶¹

35. Disa dëshmitarë shqiptarë thanë se dokumentet e tyre u grisën në Prishtinë, në Zveçan, në Dushanovë dhe në Xërxë.⁶² Rreth 10.000 njerëz u grumbulluan në një pyll afër Celinës për të ikur prej dhunës në fshatrat e tyre; policët kërkuan që ata të dorëzonin çfarëdo dokumentesh identiteti që kishin, duke i paralajmëruar se do të pushkatoheshin nëse u gjenin ndonjë dokument. Pastaj ata grumbulluan të tëra dokumentet dhe i dogjën.⁶³ Në pikën kufitare të Vërbnicës (Morinë),

⁵⁴ Hani Hoxha, T. 1546–1550 (11 gusht 2006), P2267 (deklarata e dëshmitarit me datën 22 prill 1999), f. 5, P2231 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7355; Lulzim Vejsa, P2350 (deklarata e dëshmitarit me datën 16 prill 1999), f. 3.

⁵⁵ Hani Hoxha, T. 1549 (11 gusht 2006).

⁵⁶ Argumente përmbyllëse të Llukiqit, T. 27344-27345 (26 gusht 2008).

⁵⁷ Nebojsa Ognjenović, T. 22885–22886 (20 shkurt 2008).

⁵⁸ Argumente përmbyllëse të Pavkoviçit, T. 27206 (22 gusht 2008).

⁵⁹ K89, T. 9124 (24 janar 2007), T. 9154, 9201 (25 janar 2007).

⁶⁰ Nikë Peraj, P2248 (deklarata e dëshmitarit me datën 15 shkurt 2001), f. 9.

⁶¹ Argumente përmbyllëse të Pavkoviçit, T. 27206 (22 gusht 2008).

⁶² Emin Kabashi, T. 2098 (22 gusht 2006), P2250 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 3; Shukri Gërxhaliu, P2275 (deklarata e dëshmitarit me datën 19 shkurt 2000), para. 35 (“Policët kontrolluan tërë letërnjoftimet dhe grisën ata në gjuhën shqipe”); Hysni Kryeziu, P2514 (deklarata e dëshmitarit me datën 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9 (“[Policët] na morën çdo gjë që kishim Ose grisnin dokumente, ose i hidhnin në plehra.”); Isuf Zhuniqi, P2331 (deklarata e dëshmitarit me datën 4 maj 1999), f. 4 ([Policë] ma grisi pasaportën dhe më mori gjithashtu letërnjoftimin dhe patentën, dhe veçoi kështu edhe me të tjerët.”).

⁶³ Reshit Salih, P2336 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 prill 1999), f. 4.

dëshmitarë folën për djegien e dokumenteve të identitetit të shqiptarëve kosovarë pas konfiskimit të tyre nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.⁶⁴

36. Dëshmitarë të tjerë folën për konfiskimin dhe shkatërrimin e dokumenteve në fshatra apo në vende ku ata ishin mbajtur. Në Bellacërkë, Sabri Popaj pa një polic duke u marrë dokumente burrave të kapur, të cilat i grumbulloi në një breg lumi dhe dogji disa prej tyre.⁶⁵ Në Dushanovë, policët i morën letërnjoftimin djalit të Rexhep Krasniqit, Afrimit, teksa e rrihnin.⁶⁶ Në Korenicë, Lizane Malaj pa kur i vëllai dhe i nipi u detyruan të shtriheshin përtokë, kur forcat serbe ua morën dokumentet e identifikimit dhe u thanë të shkonin në Shqipëri.⁶⁷ Në Krushën e Vogël, “forcat serbe” rrahën burra shqiptarë kosovarë dhe i detyruan të dorëzonin kuletat, paratë dhe dokumentet.⁶⁸ Në Përlepnice, ushtarë serbë u morën fshatarëve para, telefona celularë, stoli, letërnjoftime dhe çelësat e makinave.⁶⁹ Në Dushanovë, policët u morën çdo gjë fshatarëve: makinat, stoli, para, dhe çfarëdo dokumentesh, përfshirë letërnjoftime dhe dokumente të makinave; të cilat i grisën ose i hodhën në plehra.⁷⁰

37. Mbrojtja u përpoq t’u kundërviej këtyre provave të shumta. Nebojsja Ognjenoviqi pretendoi se nuk kishte parë ndonjë polic t’u merrte para njerëzve, t’u merrte makinat dhe dokumentet, apo t’u hiqte targat e makinave dhe tha se, po të kishte ndodhur një rast i tillë, ai do te kishte vepruar kundër keqbërësve. Mirëpo, askush nuk erdhi për t’u ankuar për sjelljen dhe qëndrimin e policisë në pikën kufitare.⁷¹ Ognjenoviqi kujtoi se disa njerëz që u larguan nga kolona ishin në këmbë dhe disa prej tyre kishin braktisur makinat e tyre pa ardhur në kufi sepse nuk donin të prisnin më në radhën e makinave.⁷² Ognjenoviqi pretendoi gjithashtu se shqiptarët kosovarë i hodhën dokumentet e tyre të identifikimit në pikën kufitare apo afër saj dhe se punonjësit kufitarë i mblodhën dhe i vendosën në një dhomë. Dokumentet e makinave, targat dhe patentat iu kaluan MPB-së së Prizrenit, kurse letërnjoftimet mbetën në ndërtesën kufitare edhe pas tërheqjes së forcave të RFJ-së/Serbisë nga Kosova.⁷³ Petar Dujkoviqi, shefi i Administratës së Policisë Kufitare

⁶⁴ Hamide Fondaj, P2283 (deklarata e dëshmitares me datën 9 qershor 2001), f. 5 (“Njerëzit në kolonë që kaluan dy orë më vonë u rrahën dhe atyre u morën të gjitha letërnjoftimet dhe i dogjën.”); Sabri Popaj, T. 5753 (2 nëntor 2006), P2446 (deklarata e dëshmitarit me datën 14 qershor 1999), p. 12 (“Na kërkuan dokumentet ... i hodhën dokumentet në zjarr disa metra larg.”); Sadije Sadiku, T. 1903 (18 gusht 2006) (“Na ndaluan në postbllok, na kërkuan para, letërnjoftimet dhe pasaportat. ... dokumentet ua dhamë rojeve dhe ata i grisën dhe i dogjën.”).

⁶⁵ Sabri Popaj, P2446 (deklarata e dëshmitarit me datën 14 qershor 1999), f. 4.

⁶⁶ Rexhep Krasniqi, P2378 (deklarata e dëshmitarit me datën 19 shtator 2004), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 13.

⁶⁷ Lizane Malaj, T. 1310 (9 gusht 2006).

⁶⁸ Lufti Ramadani, T. 4295 (28 shtator 2006).

⁶⁹ Abdullah Shaqiri, 4D4 (deklarata e dëshmitarit me datën 25 prill 1999), f. 4.

⁷⁰ Hysni Kryeziu, P2514 (deklarata e dëshmitarit me datën 14 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 9.

⁷¹ Nebojsja Ognjenoviqi, T. 22919 (21 shkurt 2008).

⁷² Nebojsja Ognjenoviqi, T. 22919 (21 shkurt 2008).

⁷³ Nebojsja Ognjenoviqi, T. 229882-22885, 22889-22891 (20 shkurt 2008).

në MPB, konfirmoi se, kur filluan bombardimet e NATO-s, shumë njerëz të Kosovës kërkonin të kalonin kufirin, dhe e përshkroi atë kohë si “krizë e madhe.”⁷⁴ Po ashtu si Ognjenoviq, ai mohoi se kishte marrë urdhër apo se kishte dhënë urdhër për të konfiskuar dokumente identiteti të shqiptarëve kosovarë që po kalonin kufirin.⁷⁵

38. Edhe pse në disa raste mund të ketë të ndodhur që njerëzit të kenë hedhur vullnetarisht dokumentet e tyre personale, duke marrë parasysh dëshmitë përputhëse prej një sërë dëshmitarësh të Prokurorisë të cilëve ua konfiskuan dokumentet e identifikimit, apo të cilët panë se si shqiptarëve të tjerë të kosovarë ua konfiskuan dokumente në kufi apo në disa raste gjatë dëbimit nga shtëpitë e tyre, Dhoma Gjyqësore është bindur se kjo ishte praktikë e zakonshme e zbatuar kryesisht nga efektiva të policisë.

39. Lidhur me këtë, Dhoma citon dëshminë e dorës së dytë të dëshmitarit K54, ushtar i UJ-së i cili tha se një koleg e kishte informuar se policët kishin urdhër të merrnin dokumentet nga shqiptarët kosovarë të cilët kalonin kufirin e Vërbnicës (Morinë) dhe se ata i dogjën dokumentet.⁷⁶ Dëshmitari K89, gjithashtu ushtar i UJ-së, tregoi se kishte parë një kolonë të gjatë grash, fëmijësh dhe pleqsh që lëvizte në drejtim të kufirit shqiptar dhe se ushtarë të një njësie të UJ-së kishin grisur dokumente e tyre të identitetit.⁷⁷ Ish-vëzhguesi i KVM-së Richard Ciaglinski, dëshmoi se më 13 qershor 1999, ai u kthye në Prishtinë dhe ndihmoi në marrjen në kontroll të zyrës së atjeshme të MPB-së. Atje ai pa një grumbull të madh dokumentesh, përfshirë pasaporta dhe letërnjoftime të shqiptarëve kosovarë, që po digjeshin. Ai i dha disa dokumente Karol John Drewienkiewicz-it,⁷⁸ i cili konfirmoi se Ciaglinski e kishte informuar për një flakadan dokumentesh në selinë e policisë, që ai e pa gjithashtu.⁷⁹

40. Duke marrë parasysh të gjitha provat, Dhoma konkludon se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u konfiskuan shqiptarëve kosovarë dokumentet e identitetit gjatë shpërnguljes së tyre dhe se shumë dokumente u shkatërruan. Dhoma Gjyqësore është bindur se konfiskimi dhe shkatërrimi i dokumenteve të identitetit është ndër provat më bindëse për pretendimin se ngjarjet e pranverës së vitit 1999 në Kosovë ishin pjesë e një qëllimi të përbashkët.

⁷⁴ Petar Dujković, T. 23327 (27 shkurt 2008).

⁷⁵ Petar Dujković, T. 23312 (27 shkurt 2008).

⁷⁶ K54, T. 10520 (26 shkurt 2007), P2677 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 8253 (e vulosur).

⁷⁷ K89, T. 9154–9156 (25 janar 2007).

⁷⁸ Richard Ciaglinski, T. 6848–6850 (17 nëntor 2006), T. 6983–6987 (21 nëntor 2006), P2489 (transkript nga *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3210–3211.

⁷⁹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7816–7817, 7822 (4 dhjetor 2006).

(C) Praktikë e identifikueshme e shpërnguljes së dhunshme

41. Në pjesët e mëparshme të këtij Aktgjykimi, Dhoma analizoi me kujdes provat për shkeljet bazë dhe arriti në përfundime të hollësishme për secilën komunë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kryen shumë krime dhe ekziston një praktikë e identifikueshme e këtyre krimeve; megjithëse nuk janë vërtetuar të gjitha krimet e pretenduara në Aktakuzë, del në pah një praktikë e qartë e krimeve të provuara. Më fillimin e bombardimit të NATO-s më 24 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën një fushatë gjerësisht të përhapur dhe sistematike, duke shfrytëzuar bombardimin për qëllimet e tyre. U krijua një atmosferë terrori, e cila bëri që njerëzit të iknin kur dëgjuan për sulmet e fshatrave fqinje.

42. Siç u diskutua më parë në pjesët mbi komunat, dëshmitë e drejtpërdrejta të shumë dëshmitarëve tregojnë se popullata shqiptare kosovare iku prej veprimeve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë, dhe jo prej bombardimit të NATO-s dhe prej UÇK-së.

43. Për shembull, dëshmitari K90 dëshmoi se gjatë prillit të vitit 1999, njësia e tij e UJ-së u përfshi në urdhërimin e largimit të fshatarëve shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre në komunën e Gjakovës, megjithëse kjo nuk ishte detyra e tyre kryesore.⁸⁰ K90-a mori pjesë në “zhvendosjen” e shqiptarëve kosovarë nga fshatrat dhe lagjet rreth Gjakovës, veçanërisht në dëbimin e banorëve nga nëntë apo dhjetë fshatra në mes të prillit 1999.⁸¹ Ai dëshmoi se, sipas urdhrave që kishte, ai fliste me fshatarët në serbisht, duke i urdhëruar të shkonin në drejtim të Gjakovës dhe të fshatrave përreth.⁸² Urdhrat që njësia e tij mori në lidhje me “zhvendosjen” nuk ishin kurrë në formë të shkruar, por transmetoheshin gojarisht,⁸³ dhe, sipas K90-ës, “po të spastrosh një fshat, i dëbon njerëzit.”⁸⁴

44. Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se dëshmia e Merita Dedës – që më 28 prill 1999, në Gradish ajo dhe kolona e saj u urdhëruan nga ushtarët e UJ-së të ktheheshin në fshatrat e tyre –

⁸⁰ Dëshmia e K90-ës përputhej me dëshminë e Fuat Haxhibeqirit, K73, Nikë Perajt, Merita Dedajt, Lizane Malajt. Përpjekje për të diskredituar besueshmërinë e K90-ës nëpërmjet Vllatko Vukoviqit ishin të pabaza. Kundërshtimet e ngritura lidhur me praninë e K90-ës në operacionin në luginën e Caragojit u bazuan mbi deklaratat e individëve që nuk u thirrën dëshmitarë apo mbi dokumente të papranuara të cilët ishin të shkurtra apo jo të hollësishme. Si pasojë, Dhoma përfundon se K90-a ishte përgjithësisht i besueshëm dhe i saktë për pikat në deklaratën e tij me shkrim si dëshmitar, të cilën ai e rikonfirmoi në dëshminë e tij gojore.

⁸¹ K90, T. 9271–9273 (seancë e mbyllur), T. 9297–9298 (29 janar 2007), P2652 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 dhjetor 2002), para. 41–45.

⁸² K90, T. 9302 (29 janar 2007).

⁸³ K90, T. 9303 (29 janar 2007), P2652 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 dhjetor 2002), para. 40–41.

⁸⁴ K90, T. 9331 (29 janar 2007). K90-a dëshmoi gjithashtu se majori i tij kurrë nuk urdhëroi dëbimin e fshatarëve dhe se, përkundrazi, mori urdhër që të drejtonte njerëzit në Gjakovë dhe fshatrat e para afër Gjakovës. Civilët u dërguan në drejtim të Shqipërisë vetëm pasi NATO-ja hodhi bomba thërrmuese. T. 9273 (29 janar 2007). Mirëpo, kur dëshmitari K90 iu tha se fshatarët u dëbuan për shkak të bombardimit të NATO-së dhe të rrezikut të një pushtimi tokësor, ai nuk u pajtua me këtë sugjerim. T. 9407–9408 (30 janar 2007).

përgënjeshtrojnë pretendimin e Prokurorisë se UJ-ja po përpikte të dëbonte shqiptarët kosovarë.⁸⁵ Mirëpo, Dhoma vëren se K90-a dëshmoi se disa shqiptarë kosovarë nuk u dëbuan nga zonat në të cilat vepronte UJ-ja për shkak se UJ-ja do të kishte mbetur pa mbrojtjen nga prania e civilëve përreth dhe rrjedhimisht e ekspozuar ndaj sulmeve të NATO-s. Ai pohoi se kjo u vendos në nivelin e komandës së UJ-së.⁸⁶ Momir Stojanoviç ishte pjesërisht dakord me këtë mendim, duke thënë se komandantët e Korpusit të Prishtinës nuk i dëbuan shqiptarët kosovarë sepse ishin të vetëdijshëm se popullata civile shërbente si mbrojtje kundër bombardimit të NATO-s.⁸⁷ Prova të tilla nuk e vënë në dyshim ekzistencën e praktikës së përgjithshme të shpërnguljes që del e qartë nga tërë provat e çështjes.

45. Siç u diskutua në Pjesën VII.N, megjithëse bombardimi i NATO-s dhe veprimtaria e UÇK-së ishin faktorë në gjendjen e ndërlikuar në terren, ato nuk ishin shkak i lëvizjes masive të më shumë se 700,000 njerëzve si brenda Kosovës, po ashtu edhe përtej kufirit.

46. Bazuar në të gjitha provat e shqyrtuara në këtë Aktgjykim, Dhoma është e mendimit se ekziston një praktikë e qartë krimesh të shumta të kryera në Kosovë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjatë periudhës që mbulohet nga Aktakuza. Këto krime nuk u kryen në mënyrë të rastësishme dhe të paorganizuar, por në përputhje me një qëllim të përbashkët.

ii. Konteksti i ngjarjeve më 1998 dhe 1999

47. Prokuroria argumenton se krimet e vitit 1999 nuk mund të kuptohen pa përmendur kontekstin e zhvillimeve në vitet '90, d.m.th. se kufizimi i aspiratave të shqiptarëve kosovarë për pavarësi apo autonomi u bë objektivi i përbashkët i tërë forcave politike kryesore në Serbi, për realizimin e të cilit Millosheviç ndoqi një strategji të dyfishtë: (a) "legjislacion për të vendosur Kosovën nën kontrollin e vet të drejtpërdrejtë" dhe (b) ndryshimin e "strukturës demografike të krahinës për të përforcuar sundimin serb atje."⁸⁸ Kundërshtimi kryesor ndaj këtij aspekti të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar vjen nga Mbrojtja e Millutinoviçit e cila argumenton se Millutinoviç bëri çmos për të gjetur një zgjidhje diplomatike këtyre çështjeve.⁸⁹

48. Dhoma ka përfunduar tashmë se, afërsisht rreth vitit 1989, ndryshimet midis aspiratave të shumicës së popullatës shqiptare të Kosovës dhe synimeve të autoriteteve shtetërore të RFJ-së dhe

⁸⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 384.

⁸⁶ K90, T. 9408 (30 janar 2007).

⁸⁷ Momir Stojanoviç, T. 19732 (6 dhjetor 2007).

⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 28-40.

⁸⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 13-14, 303.

të Serbisë krijuan një gjendje të tendosur dhe të paqëndrueshme. Përpjekjet e udhëheqjes së RFJ-së dhe të Serbisë për të ushtruar kontroll mbi krahinën duke i hequr autonominë dhe duke zvogëluar ndikimin e shqiptarëve kosovarë në qeverisjen krahinore, shërbimet publike dhe mbi jetën ekonomike e polarizuan shoqërinë. Megjithëse në mes të viteve '90 u ndërmorën disa hapa për zgjidhjen e problemeve, asnjë palë nuk bëri përpjekje serioze për zgjidhjen e krizës që po thellohej deri në ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare. Dëshmitë përkatëse dëshmojnë shpërdorim pushteti nga ana e autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë që çuan në çrregullimin e jetës ekonomike-shoqërore të shumicës shqiptare të Kosovës dhe që “përgatitën terrenin” për ngjarjet e vitit 1998 dhe 1999.

iii. Armatosja e joshqiptarëve dhe çarmatosja e shqiptarëve kosovarë

49. Prokuroria pretendon se gjatë viteve 1998 dhe 1999, UJ-ja, MPB-ja dhe Ministria Federale e Mbrojtjes bënë armatosjen e popullatës serbe dhe malazeze të Kosovës dhe njëkohësisht çarmatosjen e popullatës shqiptare të Kosovës. Prokuroria pretendon se, megjithëse në dukje ky proces u paraqit si masë për të luftuar “terrorizmin”, anësia e tij etnike bëri që popullata shqiptare në Kosovë të dëbohej gjerësisht në vitin 1999 dhe u mundësoi serbëve të armatosur në fshatrat e tyre që të merrnin pjesë në krime të vitit 1999.⁹⁰

50. Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se mbledhja e armëve nga fshatrat shqiptare të Kosovës u pa si masë e domosdoshme sigurie për të hequr armë nga duart e UÇK-së dhe jo si plan për të dëbuar shqiptarët etnikë të Kosovës.⁹¹ Mbrojtja e Pavkoviqit pretendon se, që prej Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia ka njohur konceptin e mbrojtjes civile të vendit dhe se armatimi i popullatës joshqiptare (“mbrojtja popullore e përgjithshme”) u bë në përputhje të plotë me ligjet përkatëse për të mbrojtur fshatra nga “terroristët”.⁹² Mbrojtja e Llazareviqit parashtron se popullata shqiptare e Kosovës nuk njihnte institucionet e Serbisë dhe të RFJ-së dhe nuk donte të merrte pjesë në mbrojtjen civile dhe në njësitë e mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile (dhe si rrjedhojë nuk kishte nevojë për armë); gjithsesi armatosja e popullatës civile ishte kompetencë e Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Korpusi i Prishtinës nuk armatosi civilë, veçanërisht joserbë.⁹³

51. Dhoma do t’a analizojë këtë problem në tri aspekte: (a) procesi i armatosjes së popullatës etnike serbe dhe malazeze; (b) ligjshmëria e armatosjes së popullatës etnike serbe dhe malazeze në fshatrat e tyre; dhe (c) natyra diskriminuese e armatosjes dhe çarmatosjes së popullatës mbi bazë

⁹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (versioni publik), 29 korrik 2008, para. 47-50.

⁹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 23-29, 43, 54

⁹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 156, 168, 175.

⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 516-518.

etnike. Fillimisht Dhoma vëren se në vitin 1998 shprehja “serbë të armatosur” u përdor për popullatën e armatosur joshqiptare e cila ishte armatosur nëpër fshatrat e veta dhe u krijuan detashmente policore rezervist (RPO), ku përfshiheshin rezervistë të UJ-së, rezervistë të MPB-së, anëtarët e mbrojtjes civile, dhe të ruajtjes civile dhe fshatarë jashtë këtyre strukturave. Provat lidhur me strukturën, komandimin dhe numrin e popullatës joshqiptare të armatosur dhe të njësive të mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile shqyrtohen në Nënpjesën VI.A.4.

(A) Procesi i armatosjes së popullatës joshqiptare

52. Gjatë viteve 1998 dhe 1999, UJ-ja dhe MPB-ja armatosën fshehurazi më shumë se 60.000 banorë të fshatrave dhe qyteteve të Kosovës.⁹⁴ Armët iu shpërndanë personave të kombësisë joshqiptare (të ashtuquajtur “serbë të armatosur”⁹⁵) të cilët u kthyen në fshatrat e tyre për të krijuar njësi të mbrojtjes vendore të njohura si Detashmente Policore Rezerviste (RPO).⁹⁶

53. Adnan Merovci dëshmoi se të gjithë meshkujt serbë në Kosovë u pajisën me armë dhe se i bartnin haptazi.⁹⁷ Disa dëshmitarë ishin të mendimit se armatosja e popullatës joshqiptare u bë prej Ministrisë së Mbrojtjes dhe u orvatën të distanconin UJ-në dhe MPB-në nga procesi. Kështu, Geza Farkash dëshmoi se UJ-ja mund t’u shpërndante armë njësive zyrtare në kompetencë të Ministrisë së Mbrojtjes, siç janë mbrojtja civile dhe ruajtja civile, me kusht që këto njësi të ishin të mobilizuara.⁹⁸ Llazareviqi dëshmoi se organi përgjegjës për organizimin, pajisjen, armatosjen, përdorimin dhe komandimin e forcave të mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile ishte Ministria Federale e Mbrojtjes.⁹⁹ Ai gjithashtu deklaroi se Korpusi i Prishtinës nuk e armatosi popullatën joshqiptare sepse nuk kishte “as kompetenca *de jure*, as *de facto*” për këtë;¹⁰⁰ sipas tij, vetëm Ministri i Mbrojtjes e kishte këtë kompetencë.¹⁰¹

⁹⁴ *Shih p.sh.*, P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7; P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 9; P2803 (Raporti i Shtabit të MPB-së lidhur me vizitën në RPO-të rajonale), f. 7; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26634 (8 korrik 2008).

⁹⁵ *Shih p.sh.*, P931 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së 2 shkurt 1999), f. 23; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26634 (8 korrik 2008).

⁹⁶ P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1999), f. 9; P2803 (Raporti i Shtabit të MPB-së lidhur me vizitën në RPO-të rajonale), f. 7; *shih gjithashtu* P931 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së 2 shkurt 1999), f. 23; Momçillo Stojanoviq, T. 20073 (12 dhjetor 2007); P1415 (Urdhër i PrK-së, 26 qershor 1998), f. 1–2.

⁹⁷ Adnan Merovci, T. 8439 (16 janar 2007); *shih gjithashtu* Lubinko Cvetiq, T. 8090 (7 dhjetor 2006) (pohohet se e tërë popullata serbe në rajonin e Kosovës ishte e armatosur).

⁹⁸ Geza Farkash, T. 16380 (25 shtator 2007); *shih gjithashtu* Branko Gajiq, T. 15463 (12 shtator 2007).

⁹⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17967 (9 nëntor 2007).

¹⁰⁰ Vladimir Llazareviq, T. 18727 (21 nëntor 2007).

¹⁰¹ Vladimir Llazareviq, T. 18728-18729 (21 nëntor 2007); *shih gjithashtu* Tomislav Mitiq, T. 20863–20864 (23 janar 2008).

54. Megjithëse këta dëshmitarë folën për armatosjen e strukturave të mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile, anëtarët e të cilave u armatosën nga Ministria Federale e Mbrojtjes në bashkëpunim me UJ-në,¹⁰² popullata joshqiptare e armatosur e inkuadruar në RPO-të, ishte numerikisht shumë më me madhe se efektivat e njërive të mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile, siç u diskutua më lart. Gjithashtu, dokumente të ndryshme zyrtare të RFJ-së tregojnë se UJ-ja dhe MPB-ja zbatuan armatosjen e popullatës joshqiptare.¹⁰³ Për më tepër, Dhoma dëgjoi dëshminë e Sllobodan Kosovacit i cili tha se, në përputhje me Rregulloren e Mobilizimit, ushtarët mund të nënshkruanin për një uniformë, një armë dhe pajisje të tjera, dhe mund t'i mbanin të gjitha këto në shtëpi; dhe faktikisht shumë njerëz i mbajtën pajisjet e dhëna në shtëpitë e tyre.¹⁰⁴ Bazuar në këto prova, armatosja nuk mund t'i atribuohet vetëm Ministrisë Federale të Mbrojtjes, dhe është e qartë se edhe UJ-ja dhe MPB-ja morën pjesë në armatosjen e popullatës joshqiptare të Kosovës.¹⁰⁵

(B) Ligjshmëria e armatosjes së popullatës joshqiptare

55. Në lidhje me praktikën e armatosjes së rezervistëve të MPB-së dhe të kthimit të tyre në shtëpi me armë, K25-a dëshmoi se kjo nuk u zbatua kudo në Serbi, por vetëm në Kosovë.¹⁰⁶ Lubinko Cvetiqi dëshmoi se rezervistëve të MPB-së u shpërndanë mitralozë të lehtë si individë dhe jo si njësi.¹⁰⁷ Mirëpo, K25-a pohoi se armatosja e rezervistëve në fshatrat e tyre nuk ishte dukuri jonormale dhe se ishte zbatuar edhe më parë.¹⁰⁸ Dhoma diskutoi më lart dëshminë e Kosovacit për anëtarë të UJ-së që morën armë dhe u dërguan në shtëpi në fshatrat e tyre. Për më tepër, përveç rezervistëve të UJ-së dhe të MPB-së, u armatosën edhe anëtarë të mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile dhe serbë jashtë këtyre strukturave formale.¹⁰⁹

56. Në lidhje me armatosjen e popullatës joshqiptare në përgjithësi, Ligji i Mbrojtjes i RFJ-së përcaktonte se mund të krijoheshin njësi për të mbrojtur popullatën civile nga sulmi “[n]ë gjendje

¹⁰² P1060 (Letër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 2 nëntor 1998).

¹⁰³ P3121 (Procesverbali i takimit të Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), p. 7; P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 9; P2803 (Raporti i Shtabit të MPB-së lidhur me vizitën RPO-ve rajonale), f. 7; P1415 (Urdhri i PrK-së, 26 qershor 1998), f. 1–2; Lubinko Cvetiq, T. 8055–8056, T. 8091 (7 dhjetor 2006). *Kr.* Tomislav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari me datën 19 janar 2008), para. 7 (i cili thotë lidhur me P1415, se u shpërndanë armë rezervistëve të UJ-së në përputhje me Rregulloren e Mobilizimit të Ushtrisë Jugosllave). *Shih gjithashtu* P1114 (Raport Shtabit të SPB-së nga SPB-ja e Mitrovicës, 1 korrik 1998); P1115 (Lista e armëve të shpërndarë nga UJ-ja njërive rezerviste të MPB-së sipas komunave, 30 korrik 1998); P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998), p. 1; Bozhidar Filiq, T. 24013 (10 mars 2008); P931 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 2 shkurt 1999), f. 23.

¹⁰⁴ Sllobodan Kosovac, T. 15829 (18 shtator 2007).

¹⁰⁵ *Shih* P2803 (Raporti i Shtabit të MPB-së lidhur me vizitën RPO-ve rajonale), p. 7; P1415 (Urdhri i PrK-së, 26 qershor 1998), f. 1–2; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26634 (8 korrik 2008).

¹⁰⁶ K25, T. 4683 (11 tetor 2006).

¹⁰⁷ Lubinko Cvetiq, T. 8061 (7 dhjetor 2006).

¹⁰⁸ K25, T. 4683–4685 (11 tetor 2006).

¹⁰⁹ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998).

lufte dhe, sipas nevojës, në rastin e një kërcënimi të menjëhershëm luftime.”¹¹⁰ Mirëpo, gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 kur u armatos popullata joshqiptare e Kosovës, nuk ishte shpallur një gjendje e tillë siç u përmend më herët në këtë Aktgjykim. Neni 6 përcaktonte se, përveç kompetencave të përmendura shprehimisht në Kushtetutë, të gjitha kompetencat e mbetura u përkisnin republikave anëtare.¹¹¹ Rrjedhimisht, duke u bazuar vetëm në tekstin e Kushtetutës, duket se, pa përfshirjen formale në UJ apo pa bazë ligjore shtesë, armatosja e popullatës joshqiptare nga UJ-ja dhe nga Ministria Federale e Mbrojtjes nuk lejohej me ligj. Gjithsesi, ka të ngjarë që Neni 61 të jetë shpërfillur nga autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë të cilët, në vend të kësaj dispozite, u bazuan në Nenin 54 – “qytetarë ... organizojnë, përgatisin dhe marrin pjesë në mbrojtjen e popullatës civile, objekteve civile dhe burimeve të tjera nga shkatërimi i luftës... në kohë paqeje ose luftime” për të armatosur civilë edhe para shpalljes së gjendjes së luftës apo gjendjes së kërcënimit të menjëhershëm të luftës, për t’i përgatitur për krijimin e njësisive të mbrojtjes civile sapo të shpallej një gjendje e tillë.¹¹² Si pasojë, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundim nëse një armatosje e tillë përgjithësisht ishte e paligjshme në vetvete, por gjykon se problemi kryesor në lidhje me procesin e armatosjes dhe të çarmatosjes është nëse u bë në bazë të kombësisë. Pikërisht ky është aspekti që tani do të analizohet tani nga Dhoma.

(C) Armatosja dhe çarmatosja e popullatës në bazë të kombësisë

57. *Natyra diskriminuese e armatosjes dhe çarmatosjes.* Një sërë dokumentesh të UJ-së, të MPB-së dhe të Ministrisë Federale të Mbrojtjes përmendnin faktorin etnik mbi bazën e të cilës u zbatua procesi i armatosjes së popullatës. Në një urdhër të muajt maj 1998, lëshuar pikërisht për të armatosur banorët serbë dhe malazezë të fshatrave ku ishin pakicë, Shefi i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës pohonte se Administrata e Mbrojtjes, në bashkëpunim me MPB-në dhe UJ-në, duhej të informonte drejtuesit e komunës për “planin e veçantë për të mbrojtur qytetarë serbë, malazezë dhe qytetarë të tjerë besnikë ndaj Serbisë.”¹¹³ Urdhri i Korpusit të Prishtinës me datën 26 qershor 1998 urdhëronte që komandat vartëse të hartonin lista të rekrutëve ushtarakë dhe të organizonin shpërndarjen e armëve në “fshatra serbe dhe malazeze.”¹¹⁴ Një ditë më vonë, një raport i komandës së qarkut ushtarak me datën 27 qershor 1998 theksonte re se po zbatohet organizimi i “serbëve dhe të malazezëve” për mbrojtjen e fshatrave.¹¹⁵ Nën titullin “përvoja pozitive,” një raport luftimi i Armatës së Tretë me datën 2 tetor 1998 informonte se shpërndarja e armëve për “qytetarët

¹¹⁰ *Shih* P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), nenet 61-63.

¹¹¹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 6.

¹¹² P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 54.

¹¹³ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998), f. 2; *shih gjithashtu* 3D1116 (Aktekspertiza e Radovan Radinoviqit), f. 37.

¹¹⁴ P1415 (Urdhër i PrK-së, 26 qershor 1998), f. 1

besnikë të RFJ-së (të kombësisë serbe dhe malazeze)” kishte mundësuar organizimin e rezistencës masive kundër “terroristëve;” në raport gjithashtu bëhej e ditur se çarmatosja e popullatës shqiptare në Kosovë kishte dobësuar moralin e UÇK-së.¹¹⁶ Dhoma konstaton se ky urdhër bën një dallim të qartë midis “terroristëve” dhe popullatës civile, dhe kjo *e dyta* po çarmatosej.

58. Urdhurat e Komandës së Përbashkët nga marsi 1999 përmendin gjithashtu popullatën joshqiptare të armatosur.¹¹⁷ Për më tepër, në një raport operativ të Komandës së Përbashkët bëhej e ditur se MPB-ja vazhdonte të mblidhte armë nga fshatrat shqiptare të cilat pranonin t’i dorëzonin vullnetarisht, dhe se kjo punë duhej të vazhdonte.¹¹⁸ Në raport gjithashtu informohej se UJ-ja po merrej me çarmatosjen e popullatës në brezin kufitar. Edhe raporti i Komandës së Përbashkët me datën 20 nëntor 1998 informonte për grumbullimin e armëve në fshatra shqiptare.¹¹⁹

59. Mbrojtja pretendon se u bënë përpjekje për të armatosur edhe popullatën shqiptare në ato raste ku nuk do të kishte si pasojë që armët t’i kalonin UÇK-së.¹²⁰ Dushan Llonçari dëshmoi se Shainoviqi u përpoq të formonte forcat policore shumetnike për të mbrojtur fshatra, veçanërisht në komunën e Mitrovicës, për të përmirësuar marrëdhëniet me shqiptarët.¹²¹ Gjithashtu, Llonçari dëshmoi se popullata vendase krijoi njësi vendase të sigurimit që nuk kishin kontakt me MPB-në apo me UJ-në.¹²² Dushan Matkoviqi dëshmoi se u bënë përpjekje për të krijuar këto njësi, por se “ekstremistët shqiptarë dhe nacionalistët serbë” i kundërshtuan përpjekjet, dhe, si pasojë brenda tetorit 1998 ishte hequr dorë nga këto përpjekje.¹²³

60. Për të vërtetuar pretendimin e përpjekjeve për krijimin e njësive vendore të sigurimit me shqiptarë kosovarë, u dorëzuan si provë materiale disa dokumente. Në një mbledhje të Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, Zoran Angjelkoviqi tha se sigurimi apo policia vendase duhej të

¹¹⁵ P1138 (Raport i Qarkut Ushtarak, 27 qershor 1998), f. 1.

¹¹⁶ 3D697 (Postëkomanda pararojë e Armatës së Tretë, analiza e realizimit të detyrave në Kosovë), f. 4, 6.

¹¹⁷ *Shih, për shembull.*, P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1998), f. 2; P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 2; P1970 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 9 prill 1999), f. 2; P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2; P1198 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998); P1203 (Raport i Komandës së Përbashkët, 15 tetor 1998), f. 5, 8; P1206 (Raport i Komandës së Përbashkët, 17 tetor 1998), f. 4; P1204 (Raport i Komandës së Përbashkët, 28 tetor 1998), f. 5; P1197 (Raport i Komandës së Përbashkët, 20 nëntor 1998), f. 3; P2623 (Raport i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998), f. 8; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26634 (8 korrik 2008).

¹¹⁸ P1203 (Raport i Komandës së Përbashkët, 15 tetor 1998), f. 5, 8.

¹¹⁹ P1197 (Raport i Komandës së Përbashkët, 20 nëntor), f. 5, 8; P2623 (Raport i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998), f. 8.

¹²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 494, 497; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para 112 e në vijim.

¹²¹ Dushan Llonçar, T. 7591 (30 nëntor 2006), P2521 (deklarata e dëshmitarit me datën 3 mars 2004), para. 76; *shih gjithashtu* Zoran Angjelkoviq, T. 14657–14659 (30 gusht 2007); Vladimir Llazareviq, T. 17899, 17945, 17962 (8 nëntor 2007), 17980 (9 nëntor 2007), 18425 (16 nëntor 2007).

¹²² Dushan Llonçar, T. 7660-7661 (1 dhjetor 2006).

¹²³ Dushko Matkoviq, T. 14659-14660 (30 gusht 2007).

organizohej në fshatra shqiptare dhe se “qytetarë besnikë” ishin të mirëpritur të merrnin pjesë;¹²⁴ ai deklaroi se kjo do të ndikonte që shqiptarët kosovarë të mos krijonin forcat e tyre policore. Në mbledhje, Stanojeviqi tha se në Gjakovë ishte krijuar një njësi vendase e sigurimit, se anëtarëve të saj u ishin dhënë uniforma, pranga, shkopinj policorë dhe revole; se ishin paguar; dhe se u kishin dhënë autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë, emrat e 2,000 anëtarëve të UÇK-së.¹²⁵

61. Sipas Llazareviqit, këto njësi u krijuan tërësisht me shqiptarë etnikë, por nuk ishin policë të rregullt sepse kishin uniforma dhe emblema të ndryshme. Ai tha se thujse çdo fshat kryesor kishte një njësi të tillë, synimi i të cilës ishte mbrojtja kundër sulmeve të reja “terroriste,”¹²⁶ por nuk dinte se kush i kishte krijuar këto njësi dhe madhësinë e tyre numerike. Nebojsa Bogunoviqi dëshmoi se në vitin 1998 u krijuan rreth 80 sish në komunën e Gjakovës, si dhe rreth dhjetë të tilla në komunën e Mitrovicës, se anëtarët e këtyre njësive vendore të sigurimit mbanin uniforma të hirta me fjalët “sigurimi vendor” mbi to; se u dhanë armë zjarri; dhe se merrnin rrogë nga autoritetet vendore komunale. megjithëse ishin zgjedhur nga populli.¹²⁷ Mirëpo kur u pyet për këto formacione, Martin Pnishi – dhe dëshmitarë të tjerë të thirrur nga Prokuroria – pohuan se nuk u zgjodhën nga banorët shqiptarë të Kosovës, por nga policia dhe autoritetet komunale.¹²⁸ Lidhur me këtë temë, Dhoma dëgjoi dëshmi se policë vendore të kombësisë shqiptare u hoqën nga puna gjatë debimeve në Deçan në mars 1999 dhe u futën në radhët e civilëve shqiptarë që po dëboheshin nga fshatrat e tyre.¹²⁹

62. Dhoma është e mendimit se në lidhje me këtë temë provat e paraqitura nga Prokuroria janë më bindëse sesa provat e Mbrojtjes. U bënë disa përpjekje për të krijuar njësi vendase të sigurimit të shqiptarëve kosovarë, dhe disa u krijuan. Mirëpo, sipas Llonçarit dhe Matkoviqit, deri në tetor 1998 përpjekja politike për projektin kishte marrë fund, dhe provat tregojnë se vetëm disa njësi me shqiptarë të zgjedhur dhe të paguar nga MPB-ja serbe, vazhduan të ekzistonin gjatë fushatës ajrore të NATO-s, kryesisht në Gjakovë. Dhoma nuk pranon dëshminë e Llazareviqit se këto njësi u krijuan thujse në çdo fshat kryesor: ai vetë pranoi vetë se nuk dinte se sa pjesëtarë kishin këto njësi dhe se kush i krijoi. Në bazë të të gjitha provave lidhur me këtë temë - disa të paqarta, për shembull dëshmia e Llazareviqit – Dhoma është e mendimit se këto njësi shqiptare vendase të sigurimit nuk

¹²⁴ P1193 (Shënime stenografike nga Angjelkoviqi), f. 3, 5, 7, 12.

¹²⁵ P1193 (Shënime stenografike nga Angjelkoviqi), f. 12; *shih gjithashtu* 6D972 (Komuna e Kaçanikut, Kontratë Pune për Sigurimin Vendas, 1 shtator 1998); 6D449 (Letërnjoftime të personelit të Sigurimit Vendas); 6D62 (Notë Zyrtare nga SPB-ja e Gjakovës, 14 maj 1999); 6D484 (Lista e personave të sigurimit vendas në Kaçanik, 2 nëntor 1998).

¹²⁶ P950 (Intervista e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 65-67.

¹²⁷ Nebojsa Bogunoviqi, 6D1614 (deklarata e dëshmitarit me datën 2 prill 2008), para. 18–20; Martin Pnishi, T. 1507 (11 gusht 2006); Nikë Peraj, T. 1760–1762 (16 gusht 2006).

¹²⁸ Martin Pnishi, T. 1507 (11 gusht 2006); *shih gjithashtu* Nikë Peraj, T. 1760–1762 (16 gusht 2006); Hani Hoxha, T. 1556 (11 gusht 2006).

¹²⁹ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata e dëshmitarit me datën 4 shkurt 2000), f. 3–10.

kishin ndonjë peshë brenda kuadrit të gjerë të armatosjes së popullatës joshqiptare dhe të çarmatosjes së popullatës shqiptare të Kosovës.

63. *Përligjja e diskriminimit në armatosje.* Siç u tha më sipër, Mbrojtjet e Ojdaniqit, Pavkoviqit dhe Llazareviqit argumentojnë se, nëse ka pasur diskriminim, ai përligjej nga natyra e kërcënimit të sigurisë në Kosovë. Rrjedhimisht Dhoma do të analizojë justifikimet e përmendura për praktikën e armatosjes së popullatës serbe dhe të çarmatosjes së popullatës shqiptare në Kosovë.

64. Kur i treguan urdhrin e Korpusit të Prishtinës me datën 26 qershor 1998 për shpërndarjen e armëve serbëve në Kosovë, Momir Stojanoviçi dëshmoi se ai u lëshua në përgjigje të kërkesave të përfaqësuesve të vendbanimeve serbe. Sipas atij, këta përfaqësues pohuan se enklavat serbe ishin djegur dhe plaçkitur; dhe, pasi Pavkoviçi takoi serbë të Prelluzhës dhe të Obiliqit, u organizua armatosja e popullatës serbe për të mundësuar vetëmbrojtjen e tyre në fshatrat e tyre.¹³⁰ Radovan Radinoviçi u pyet pse procesi u zhvillua fshehurazi, ndryshe nga mobilizimi i përgjithshëm i njësive të UJ-së, dhe pse u krye në bazë të kombësisë. Ai pranoi se procesi i armatosjes në bazë të kombësisë nuk ishte normal, por dëshmoi se ishte i domosdoshëm sepse ishte një konflikt etnik: UJ-ja kishte detyrë që të mbronte bashkësinë etnike të kërcënuar, dhe kjo ishte kombësia serbe në Kosovë. Ai pohoi se puna u krye fshehurazi për të shmangur një panik të përgjithshëm.¹³¹

65. Aleksandar Dimitrijeviçi dëshmoi se serbët, malazetët dhe “joshqiptarët në përgjithësi” u armatosën nga UJ-ja dhe MPB-ja. Sipas atij, këto masa synonin të mbronin popullatën serbe nga sulmet e UÇK-së, dhe në çdo njësi fshatare u vu në krye një komandant i UJ-së për të siguruar që armët të mos keqpërdreshin.¹³² Në një mbledhje të Shtabit të MPB-së për Kosovën në nëntor 1998, Llukiçi urdhëroi shefat e SPB-ve të merrnin masa mbrojtëse shtesë në fshatra me banorë serbë, dhe të siguronin që popullata serbe dhe anëtarë të Detashmenteve Policore Rezerviste të mos keqpërdornin armët e tyre, as t’i bartnin publikisht në praninë e verifikuesve të KVM-së. Serbët e armatosur u udhëzuan se në rast se pyeteshin nga verifikues të KVM-së, të mohonin se serbët në fshatra kishin armë dhe të thoshin se vetëm rojet e fshatit ishin të armatosur.¹³³

66. Mbrojtja e Pavkoviqit deklaroi se “Që prej Luftës së Dytë Botërore dhe aksioneve të partizanëve dhe daljes në krye të Marshall Titos, Jugosllavia ka zbatuar konceptin e ‘mbrojtjes

¹³⁰ Momir Stojanoviçi, T. 20072–20073 (12 dhjetor 2007); *shih gjithashtu* Zllatomir Peshiq, T. 7190 (23 nëntor 2006); P1011 (Ivan Markoviçi, red., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* (2001)), f. 58; P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998); 3D1116 (Aktekspertiza e Radovan Radinoviqit), f. 37.

¹³¹ Radovan Radinoviçi, T. 17308–17309 (19 tetor 2007); *shih gjithashtu* Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26634 (8 korrik 2008).

¹³² Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26634–26636 (8 korrik 2008).

¹³³ P3130 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 nëntor 1998), para. 8.

popullore.’ Çdo qytetar i aftë fizikisht, ishte pjesë e mbrojtjes së vendit. Rrjedhimisht kundrejt kërcënimeve të brendshme ose të jashtme ndaj vendit, u armatosën qytetarë, civilë.”¹³⁴ Megjithëse Mbrojtja e Pavkoviçit flet për detyrën e qytetarëve për të marrë pjesë në mbrojtjen dhe ruajtjen civile,¹³⁵ armatosja e serbëve dhe malazezëve në Kosovë përfshiu individë jashtë këtyre strukturave, siç u përmend më lart. Për më tepër, kjo deklaratë nuk shpjegon pse togfjalëshit “popullata e armatosur” iu shtua cilësimi etnik “joshqiptare,” që është përdorur në disa urdhra.

67. Kërsman Jeliqi u përpoq të shpjegonte bazën etnike të armatosjes duke theksuar se popullata joshqiptare iu përgjigj thirrjes për mobilizim në radhët e UJ-se dhe të MPB-se, ndërsa shqiptarët nuk u përgjigjën dhe si pasojë nuk morën armë.¹³⁶ Radinoviçi përmendi përpjekjen për të krijuar një detashment ushtarak territorial shqiptar brenda UJ-së dhe për mungesën e përgjigjes kësaj thirrjeje.¹³⁷ Mirëpo, të paktën disa shqiptarë iu përgjigjën thirrjes, siç vërtetohet nga raporti i Armatës së Tretë i 13 shkurtit 1999, ku pohohet se në degën ushtarake të Mitrovicës u paraqitën gjashtë nga 136 shqiptarë të thirrur.¹³⁸ Dhoma vëren se paraqitja për mobilizim në atë kohë ishte e ulët kudo në UJ, dhe Shtabi i Përgjithshëm ishte i shqetësuar.¹³⁹ Dhoma nuk pranon se mosbindja ndaj thirrjes së UJ-së për mobilizim nga shumë shqiptarë kosovarë për ligji lëshimin e udhëzimeve për të armatosur vetëm popullatën serbe.

68. Armatosja e popullatës joshqiptare në fshatrat e tyre përfshiu shpërndarjen e rreth 60.000 armëve në Kosovë.¹⁴⁰ Duke qenë se sipas Bozhidar Deliqit, popullata serbe e Kosovës në atë kohë numëronte 234.425 banorë bazuar në shifrat e regjistrimit të popullsisë të vitit 1991,¹⁴¹ këto armë duhet t’u jenë dhënë në radhë të parë meshkujve serbë të moshës ushtarake, me banim në Kosovë.¹⁴² Faktikisht njësitë luftarake jo vetëm u shpërndanë armë individëve jo në shërbim aktiv, me detyre luftarake në UJ, MPB dhe në njësitë e mbrojtjes civile dhe të ruajtjes civile para se të dërgoheshin në fshatrat e tyre, por nga maji 1998 Ministria e Mbrojtjes u shpërndau armë edhe

¹³⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para 156.

¹³⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 20.

¹³⁶ Kërsman Jeliq, T. 19074 (26 nëntor 2007); *shih gjithashtu* Slobodan Kosovac, T. 15795–15796 (17 shtator 2007); Tomislav Mitiq, 5D1390 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 dhjetor 2007), para. 5, f. 1.

¹³⁷ P1471 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 31 mars 1999); 3D1116 (Aktekspertiza e Radovan Radinoviçit), f. 37.

¹³⁸ 5D1183 (Raport i Armatës së Tretë, 13 shkurt 1999), f. 1; *shih gjithashtu* Nikë Peraj, T. 1760–1761 (16 gusht 2006).

¹³⁹ P937 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 shkurt 1999), f. 10 (gjatë të cilit Gjorgje Qurçini raportoi se nga 11,645 ushtarë të thirrur në Armatën e Tretë vetëm 12.4 për qind u paraqitën, dhe për Forcat Ajrore dhe Mbrojtjen Kundërajrore më pak se pesë për qind).

¹⁴⁰ *Shih*, për shembull, P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7; P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm i UJ-së, 30 dhjetor 1998), p. 9; P2803 (Raport i Shtabit të MPB-së për vizitën në RPO-të rajonale), f. 7.

¹⁴¹ P1893 (Teza akademike e Bozhidar Deliqit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave të Mbrojtjes së RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë”, 1997), pjesa 1.2.

¹⁴² *Shih gjithashtu* Halit Berisha, T. 3653 (20 shtator 2006).

qytetarëve pa detyrë luftarake në këto struktura.¹⁴³ Këto masa në tërësi garantuan se deri në mars 1999 thuhet se çdo mashkull i moshë ushtarake me prejardhja shqiptare dhe me banim në Kosovë kishte një armë.¹⁴⁴ Ky fakt konfirmon pretendimin e Prokurorisë se procesi i armatosjes dhe çarmatosjes së popullatës diskriminonte mbi bazën e kombësisë dhe nuk synonte mbrojtjen e popullsisë në tërësi.

69. *Justifikimi për diskriminim në çarmatosje.* Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se shumë armë hynë kontrabandë nga Shqipëria dhe kaluan në duart e UÇK-së, duke bërë të domosdoshëm çarmatimin e shqiptarëve kosovarë, për të parandaluar rënien e tyre në duart të UÇK-së.¹⁴⁵ Zyrapi dëshmoi se gjatë periudhës nëntor 1998 - mars 1999, UÇK-ja kishte rreth 17.000-18.000 luftëtarë, përfshirë edhe ata që nuk ishin luftëtarë të rregullt.¹⁴⁶ Po të krahasohet kjo shifër me popullatën shqiptare të Kosovës, e cila në tezën e Deliçit të vitit 1997 vlerësohej se numëronte 1.655.294 banorë,¹⁴⁷ mund të përfundohet se gjatë viteve 1998 dhe 1999 shumica dërrmuese e shqiptarëve kosovarë mbeti jashtë radhëve të UÇK-së.

70. Mbrojtja nënvizon raportet e ndryshme për armë që po silleshin në Kosovë nga Shqipëria si provë për nevojën e një projekti çarmatosjeje.¹⁴⁸ Për shembull, një raport mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë në shkurt 1999 theksonte se UÇK-ja sulmoi popullatën civile dhe përdori fshatra shqiptare për të mbështetur sulmet e tyre.¹⁴⁹ Velko Odaloviç, shefi i “Qarkut të Kosovës” në vitin 1998 dhe

¹⁴³ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998), f. 1–2; Bozhidar Filiq, T. 24013 (10 mars 2008).

¹⁴⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8090 (7 dhjetor 2006); Adnan Merovci, T. 8439 (16 janar 2007).

¹⁴⁵ Dosja Gjqësore Përfundimtare e Ojdaniqit (version publik), 29 korrik 2008, para. 25; 3D991 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK, 17 prill 1998); 3D738 (Letër e Perishiqit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 16 korrik 1998); 6D1637 (Radiogram diplomatik i SHBA-së, 15 prill 1999).

¹⁴⁶ Bislim Zyrapi, T. 5959 (6 nëntor 2006).

¹⁴⁷ P1893 (Teza akademike e Bozhidar Deliçit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave të Mbrojtjes së RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë”, 1997), pjesa 1.2. Dhoma vëren se figura në grafikun e përkthimit duket e përkthyer keq, por se versioni në BKS përputhet me grafikun dhe me tekstin e tezës. *Shih gjithashtu* Milivoje Mihajllloviq, T. 24091–24093 (11 mars 2008) (që konfirmon se shqiptarët përbënin 90 për qind të popullsisë të Kosovës në vitin 1999).

¹⁴⁸ 3D991 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 17 prill 1998); 3D994 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 10 korrik 1998); 3D999 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 17 korrik 1998); 3D1001 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 1 gusht 1998); 3D1012 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 27 tetor 1998); 3D1013 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 28 tetor 1998); 3D1037 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 28 dhjetor 1998); 3D1038 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 29 dhjetor 1998); 3D1039 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 9 janar 1999); 3D1040 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 13 janar 1999); 3D1041 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 19 janar 1999); 3D1042 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 20 janar 1999); 3D1043 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 21 janar 1999); 3D1044 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 26 janar 1999); 3D1045 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 22 shkurt 1999); 3D1046 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999); 3D1047 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 1 mars 1999); 3D1051 (Raport i Komandës të Armatës të Tretë, 6 mars 1999); 3D1052 (Raport i Komandës të Armatës të Tretë, 13 mars 1999). *Shih gjithashtu* 3D697 (Postëkomanda pararojë e Armatës të Tretë, Analiza e detyrave, 2 tetor 1998), f. 6.

¹⁴⁹ 3D685 (Vlerësimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së i informacionit të sigurisë dhe i kërcënimit ndaj sigurisë të RFJ-së), f. 15–16.

komandanti i Shtabit të Ruajtjes Civile të Qarkut të Kosovës, dëshmoi se ai mori pjesë në një fushatë publike që shqiptarët kosovarë të dorëzonin armë të paligjshme dhe të ktheheshin në shtëpi në vjeshtë të vitit 1998. Si rezultat i kësaj fushate, u dorëzuan disa mijëra armë.¹⁵⁰ Mirëpo, raportet e operacioneve të Komandës së Përbashkët nuk përmendin faktin se armët po grumbulloheshin për shkak se u përvetësuan dhe u mbajtën në mënyrë të paligjshme, gjë që, sipas dëshmisë së Odaloviqit ishte shkak i çarmatosjes.¹⁵¹

(D) Armatosja dhe çarmatosja diskriminuese

71. Procesi i armatosjes së popullatës serbe të Kosovës dhe të çarmatosjes së popullatës shqiptare të Kosovës ndodhi gjatë një periudhe konfliktesh të dukshme etnike në Kosovë. Në një kolegji të UJ-së më 21 janar 1999, Dimitrijeviqi shprehu shqetësimin e tij për popullatën joshqiptare të armatosur, duke thënë, “Duke marrë parasysh numrin e njerëzve që mbajnë dhe që kanë marrë armë, ekziston një mundësi reale nga ana e serbëve dhe të malazezëve që popullata serbe të organizohet për të rezistuar dhe që të shtohen forca radikale.”¹⁵² Në lidhje me një pjesë të raportit të UJ-së në shkurt 1999, ku thuhet se në përgjigje të sulmeve kundër tyre, serbët dhe malazezët e Kosovës mund të organizonin rezistencë. Gajiqi dëshmoi se Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së ishte e vetëdijshme për rrezikun që popullata mund të merrte armë, të cilat sipas tij ishin lirish në qarkullim, dhe se kjo mund të shkakonte përleshje ndëretnike. Ai tha se UJ-ja donte të shmangte një rrezik të tillë.¹⁵³

72. Si përfundim, Dhoma gjykon se strategjia e çarmatosjes së shqiptarëve kosovarë në fshatrat e tyre dhe njëkohësisht e armatosjes së shumicës dërrmuese të serbëve dhe të malazezëve në Kosovë, në rrethanat e një konflikti të njohur etnik, u krye në mënyrë diskriminuese dhe kishte për qëllim që popullata shqiptare e Kosovës të ishte e pambrojtur kundrejt forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe në të njëjtën kohë që popullata joshqiptare të fuqizohej më shumë. Ky përfundim vërtetohet qartë nga faktet vijuese: (a) urdhrat dhe raportet tregojnë se armatosja dhe çarmatosja u kryen mbi bazë etnike; (b) shumica dërrmuese e popullatës serbe në fjalë u pajis me armë; (c) armatosja u krye fshehurazi; (d) gjatë viteve 1998 dhe 1999 shumica dërrmuese e shqiptarëve kosovarë mbeti jashtë radhëve të UÇK-së; dhe (e) ekzistonte rrezik i dukshëm që armët e

¹⁵⁰ Velko Odaloviq, T. 14459–14460 (27 gusht 2007); *shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19588 (5 dhjetor 2007); P1198 (Raport i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998), f. 4; 3D1005 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 8 tetor 1998); P1203 (Raport i Komandës së Përbashkët, 15 tetor 1998), f. 4, 8.

¹⁵¹ Velko Odaloviq, T. 14459–14460 (27 gusht 2007).

¹⁵² P939 (Kolegji i UJ-së i Shtabit të Përgjithshëm, 21 janar 1999), f. 16.

¹⁵³ Branko Gajiqi, T. 15252–15253 (7 shtator 2007); *shih gjithashtu* 3D1034 (Raport i Administratës së Sigurimit të PrK-së, 22 dhjetor 1998).

shpërndara të përdoreshin nga popullata serbe kundër shqiptarëve, dhe autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë e njohën rrezikun e dhunës etnike në fshatra.

iv. Shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit dhe përpjekjet diplomatike

73. Prokuroria argumenton se autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë nuk kishin ndërmend të respektonin Marrëveshjet e Tetorit, siç vërtetohet nga mostërheqja e njësisve nga ana e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë përtej kufirit dhe nga qëndrimi i tyre në kazerma, si dhe nga ardhja e njësisve të tjera në Kosovë.¹⁵⁴ Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se kishte bashkëpunim dhe respektim të plotë të Marrëveshjeve të Tetorit;¹⁵⁵ Mbrojtja e Shainoviçit argumenton se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë ishin zvogëluar në masën e duhur;¹⁵⁶ dhe Mbrojtja e Ojdaniçit parashtron se RFJ-ja i respektoi fillimisht marrëveshjet, por pastaj u detyrua t'i shkelte sepse UÇK-ja përfitoi nga gjendja duke u riamatosur, duke rifituar terren, dhe duke kryer krime të mëtejshme terroriste.¹⁵⁷ Mbrojtja e Llazareviçit argumenton se “disa incidente dhe keqkuptime sporadike” nuk përbënin shkelje;¹⁵⁸ dhe Mbrojtja e Llukiqit argumenton se faktikisht forcat e MPB-së në Kosovë i respektuan plotësisht Marrëveshjet e Tetorit.¹⁵⁹

74. Në lidhje me negociatat diplomatike, Prokuroria argumenton se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale penguan negociatat e Rambujesë dhe të Parisit, ndërsa përgatisnin ofensivën e pranverës.¹⁶⁰ Mbrojtja e Millutinoviçit dhe e Shainoviçit e kundërshtojnë këtë interpretim dhe argumentojnë se delegacioni i RFJ-së/Serbisë negocioi ndershmërisht për të gjetur një zgjidhje politike të situatës.¹⁶¹ Mbrojtja e Ojdaniçit dhe e Pavkoviçit theksuan se përforcimi ushtarak në vitin 1999 ishte përgjigje legjitime kundrejt kërcënimeve të NATO-s dhe të UÇK-së dhe se u morën masa për mbrojtjen e popullatës civile.¹⁶² Mbrojtja e Llazareviçit dhe e Llukiqit vënë në dukje se UÇK-ja e shfrytëzuar fillimin e vitit 1999 për t'u rigrupuar dhe për të përgatitur luftime të mëtejshme.¹⁶³

¹⁵⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 70-89.

¹⁵⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 303, p. 161.

¹⁵⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 317

¹⁵⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 63, 73.

¹⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 590-595.

¹⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 46-47.

¹⁶⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 250-261, 267.

¹⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 303, f. 162-163; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 487, 491, 901-902.

¹⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 97; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 70-73, 75-77.

¹⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 606, 628; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 266-267.

75. Dhoma tashmë ka pohuar se pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq kishte një farë mundësie për një zgjidhje të negociuar dhe në atë kohë forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërprejnë përkohësisht operacionet e tyre në Kosovë dhe u tërhoqën të paktën *pjesërisht*. Gjendja filloi të qetësohej dhe të shpërngulurit filluan të ktheheshin në shtëpi. Mirëpo, pak kohë më pas, siç u vërtetua nga Dhoma në Pjesën VI.D, pasoi “incidenti i Podujevës” i cili ishte shkelje e qëllimshme të Marrëveshjeve të Tetorit. Kuptohet se udhëheqja e RFJ-së dhe të Serbisë nuk kishte shumë dëshirë për pakësimin e forcave në Kosovë për shkak të veprimeve të UÇK-së dhe të NATO-s; përkundrazi pati shtim të efektivit të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë, një shkelje tjetër e Marrëveshjeve të Tetorit. Forca të tjera të UJ-së dhe të MPB-së “u prunë” në Kosovë në mënyra të ndryshme: largimi i disa njësive u vonua, u urdhërua dislokimi i njësive të tjera, i arsyetuar në disa raste me nevojën e vetëmbrojtjes. Për më tepër, MPB-ja mbajti armë dhe pajisje të rënda që duhej t’ia kthente UJ-së.

76. Në Kapitullin V, Dhoma parashtron provat në hollësi dhe nxjerr përfundime mbi procesin e ndërlikuar të negociatave të Rambujesë dhe të Parisit në kuadrin e ngjarjeve në terren në Kosovë. Përfundimisht, Dhoma konkludoi se përgjegjësia për dështimin e përpjekjeve diplomatike lidhur me Kosovën nuk binte vetëm mbi autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë, por edhe mbi palën shqiptare kosovare dhe aktorë të bashkësisë ndërkombëtare. Megjithëse përgjegjësia për dështimin e negociatave ishte e të gjithë pjesëmarrësve, autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë shfrytëzuan kohën e negociatave dhe faktin se, gjatë zhvillimit të negociatave, u vonua ardhja e pranisë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, dhe dislokuan forca shtesë në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit, duke u mundësuar autoriteteve shtetërore që në pranverë të vitit 1999 të ndërmerren një sulm të gjerë kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës. Këto procese dinamike dhe të ndërthurura shërbejnë si provë për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët.

v. Emërimet e zyrtarëve të lartë

77. Prokuroria argumenton se Millosheviqi dhe Millutinoviqi hoqën anëtarë të UJ-së dhe të MPB-së të cilat u ankuan për mënyrën e punës dhe i zëvendësuan me njerëz të gatshëm që të zbatonin qëllimet e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶⁴ Për më tepër, Prokuroria argumenton se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk u ndëshkuan për sjelljen e tyre kriminale, përkundrazi, ata u shpërblyen: Millutinoviqi dhe Shainoviqi mbetën në post; Ojdaniqi u ngrit në postin e ministrit federal të Mbrojtjes; Pavkoviqi u ngrit në shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së; Llazareviqi u emërua komandant i Armatës së Tretë; Gjorgjeviqi dhe Stevanoviqi u lavdëruan për

¹⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 80-83.

rolin e tyre në Kosovë në vitin 1999; dhe Llukiqi u gradua gjenerallejtënant, u dekorua me Urdhrin e Flamurit Jugosllav, dhe u emërua zëvendësministër dhe shef i RJB-së.¹⁶⁵

78. Mbrojtja e Millutinoviqit argumenton se të gjitha ndryshimet në personelin të UJ-së bëheshin gjithmonë në përputhje të rreptë me ligjin.¹⁶⁶ Mbrojtja e Ojdaniqit kundërshton pohimin se ai u zgjodh personalisht nga Millosheviqi dhe argumenton se zëvendësimi i Perishiqit ishte brenda kompetencave të Millosheviqit dhe u krye sipas procedurave të rregullta.¹⁶⁷ Mbrojtja e Llazareviqit thekson se ishte Perishiqi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i UJ-së, i cili propozoi ngritjen e tij, gjë që u krye pa kundërshtim të Presidentit të Malit të Zi Gjukanoviqi pas propozimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.¹⁶⁸ Llukiqi argumenton se ecuria e karrierës se tij tregon se ai nuk mbështeti udhëheqjen dhe se emërimi i tij si *rukovodilac* i Shtabit të MPB-së për Kosovën në qershor 1998, duhet interpretuar vetëm si ulje apo ndëshkim.¹⁶⁹

79. Megjithëse pjesa më e madhe e provave për këtë aspekt janë rrethanore, faktikisht ka prova të drejtpërdrejta që Millosheviqi largoi njerëz me gjykim të pavarur nga poste kyçe dhe vendosi në këto poste puthadorët e tij para zbatimit të qëllimit të përbashkët. Kjo pikë trajtohet vetëm kalimthi këtu për shkak se provat lidhur me këtë temë shqyrtohen në hollësi më poshtë në pjesë të kushtuara secilit prej të Akuzuarve.

80. Në një letër me datën 23 korrik 1998, Perishiqi iu ankua Millosheviqit për “prirjen e vazhdueshme për të përdorur UJ-në jashtë institucioneve të sistemit;” për “përpjekjen e komandimit të njësive të UJ-së nga ana e personave të paautorizuar;” për “anashkalimin e hierarkisë komanduese në bisedime zyrtare me anëtarë të UJ-së;” për “zbatimin e një praktike të paligjshme dhe të pabazë emërimesh;” ose për “furnizimin me materiale jashtë kuadrit ligjor.”¹⁷⁰ Më 24 nëntor 1998, Ojdaniqi zëvendësoi Perishiqin si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së me dekret të Millosheviqit.¹⁷¹ Në një mbledhje të kolegjumit të UJ-së u raportua se pasi i dorëzoi detyrën Ojdaniqit më 27 nëntor 1998, Perishiqi bëri dhe nënshkroi një deklaratë publike ku thuhej si më poshtë:

¹⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 291-295. I Akuzuari kundërshton këtë argument, *shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 303, f. 166; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 904; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 700.

¹⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 78.

¹⁶⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 169.

¹⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 598-604.

¹⁶⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1440-1443.

¹⁷⁰ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, 23 korrik 1998), f. 1.

¹⁷¹ Urdhër mbi fakte të pranuar me marrëveshje, 11 korrik 2006, f. 12-13; P796 (Procesverbali i dorëzimit të detyrës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 27 nëntor 1998).

Regjimi i tanishëm nuk i ka qejf udhëheqës me integritet të lartë, as ata që kanë mendim të pavarur. Unë u hoqa nga posti i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave pa konsultime dhe në mënyrë të gabuar dhe joligjore. Nuk e pranoj postin e sajuar në qeverinë e tanishme federale që më është ofruar. Mbetem në dispozicion të ushtrisë, shtetit dhe popullit tim.¹⁷²

81. Disa dëshmitarë folën për heqjen nga detyra të Perishiqt. Momir Bullatoviçi dëshmoi se, sipas tij, letra e Perishiqt e datës 23 korrik ishte jashtë kuadrit të kompetencave të tij si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe se, si pasojë e kësaj letre, ai bëri thirrje për zëvendësimin e tij, me gjithë faktin se e njihte Perishiqtin prej vitesh dhe kishte mendim të mirë për të.¹⁷³ Miodrag Simiqi, shefi i Shtabit të gjeneralit Samarxhiq për Armatën e Tretë në verë të vitit 1998, dëshmoi se grindja midis Perishiqt dhe Millosheviqt në verë të vitit 1998 lidhej me mendimin e Perishiqt se ushtria nuk duhet të përdoret për shkatërrimin e UÇK-në pa shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të rrezikut të luftës së afërt.¹⁷⁴

82. John Crosland-i dëshmoi se më 5 nëntor 1998, ai takoi Aleksandar Dimitrijeviqtin i cili shprehu shqetësimin e tij se Pavkoviçi vepronte jashtë hierarkisë komanduese dhe i raportonte drejtpërsëdrejti Millosheviqt.¹⁷⁵ Aleksandar Vasileviçi dëshmoi se si Perishiçi, po ashtu edhe Dimitrijeviçi u zëvendësuan sepse nuk ishin dakord me vendimin e Millosheviqt për përdorimin e UJ-në në Kosovë pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme.¹⁷⁶ Më 25 mars 1999, Geza Farkashi zëvendësoi Dimitrijeviqtin si shef i Administratës së Sigurimit të UJ-së, me dekret të Millosheviqt.¹⁷⁷

83. Dhoma mori prova se në vitin 1998 kishte tension midis Pavkoviqt, komandanti i Korpusit të Prishtinës, dhe eprorit të tij, Samarxhiqt, i cili në atë kohë ishte komandanti i Armatës së Tretë, mbi zbatimin e Planit kundër Terrorizmit në Kosovë miratuar në korrik 1998.¹⁷⁸ Më 28 dhjetor 1998, Millosheviçi lëshoi një dekret nëpërmjet të cilit Samarxhiçi u zëvendësua me Pavkoviqtin, dhe Pavkoviçi filloi detyrën më 13 janar 1999.¹⁷⁹ Më 28 dhjetor 1998, Millosheviçi lëshoi një dekret duke emëruar Llazareviqtin si komandant të Korpusit të Prishtinës të Armatës së Tretë (postin

¹⁷² P935 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 11 mars 1999), f. 27; Miodrag Simiq, T. 15694-15698 (14 shtator 2007); P1576 (Procesverbali i mbledhjes së shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998) (ku diskutohet për zëvendësimin e Perishiqt me Ojdaniqtin), f. 3-5.

¹⁷³ Momir Bullatoviçi, T. 13919-13922 (17 gusht 2007).

¹⁷⁴ Miodrag Simiq, T. 15694-15696 (14 shtator 2007).

¹⁷⁵ John Crosland, T. 9818-9822 (7 shkurt 2007).

¹⁷⁶ Aleksandar Vasileviçi, T. 8631-8634 (18 janar 2007).

¹⁷⁷ P799 (Raport mbi marrjen e detyrës, 25 maj 1999).

¹⁷⁸ P1439 (Letër e Pavkoviqt për Samarxhiqtin, 5 tetor 1998); 4D100 (Raporti i PrK-së për Armatën e Tretë mbi angazhimin e njëjësive, 22 korrik 1998); 4D119 (Letër e Samarxhiqt për Pavkoviqtin, 22 korrik 1998).

¹⁷⁹ P800 (Raport i marrjes së detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsa Pavkoviçi, 13 janar 1999), pranuar gjithashtu si 4D36; P802 (Raport i dorëzimit të detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiçi, 13 janar 1999).

i sapoliruar nga Pavkoviqi), dhe Llazareviqi filloi detyrën më 8 apo 9 janar 1999.¹⁸⁰ Më parë, Llazareviqi kishte qenë shefi i Shtabit të Pavkoviqit në Korpusin e Prishtinës.¹⁸¹

84. I pyetur nga Prokuroria për heqjen e tij nga UJ-ja dhe nëse kjo përputhej me faktin se Samarxhiqi, Perishiqi dhe Jovica Stanishiqi të RDB-së ishin hequr të gjithë nga postet e tyre sepse u ankuan për mënyrën e përdorimit të UJ-së prej Pavkoviqit dhe Millosheviqit, Dimitrijeviqi tha: “ndoshta është kështu, por unë mendoj... se këtu në radhë të parë kemi të bëjmë me një ndryshim të politikës dhe se njerëzit që kundërshtuan disa gjëra thjesht nuk ishin më të pranueshëm.”¹⁸²

85. Rrjedhimisht ekzistojnë prova se me shkallëzimin e krizës në Kosovë, zyrtarë të lartë u emëruan qëllimisht në poste të caktuara, por Prokuroria arriti t’u vërtetonte këtë hipotezë vetëm në lidhje me Ojdaniqin dhe Pavkoviqin. Siç analizohet hollësisht më poshtë, ngritja e shpejtë e Pavkoviqit është një tregues i shpërblimit të Millosheviqit para, gjatë dhe pas fushatës: Pavkoviqi vetë tha se më parë ishte graduar më shumë herë se lejohej nga rregullat, dhe Dimitrijeviqi, Vasileviqi dhe Perishiqi thanë të gjithë se ngritja e tij në vitin 1998 ishte jo e rregullt. Për më tepër, Dhoma konkludon më poshtë se Millosheviqi e zëvendësoi Perishiqin me Ojdaniqin në një përpjekje për të pasur një shef të Shtabit të Përgjithshëm i cili mund të përpunohej më lehtë dhe se, me gjithë kundërshtimin e Presidentit malazez Gjukanoviç, Millosheviqi zëvendësoi Samarxhiqin me Pavkoviqin pas grindjes së Pavkoviqit dhe të Samarxhiqit për shkallëzimin e pranisë së UJ-së në Kosovë pa vepruar përpikmërisht sipas hierarkisë komanduese. Gjithsesi disa zëvendësime dhe ngritje në detyrë nuk përputhen me këtë praktikë, për shembull për Llazareviqin dhe Llukiqin, dhe Shainoviqi ishte zëvendëskryeministër për vite të tëra para konfliktit. Si rrjedhojë hipotezat e Prokurorisë në këtë pikë nuk u vërtetuan plotësisht, por provat në lidhje me Ojdaniqin dhe Pavkoviqin tregojnë se Millosheviqi, anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, i emëroi qëllimisht në ato poste për të lehtësuar zbatimin e qëllimit të përbashkët.

vi. Pengimi i drejtësisë

86. Siç diskutohet në Pjesën VII.P, Prokuroria argumenton se qëllimi i përbashkët i ndërmarrjes së përbashkët kriminale u realizua pjesërisht nëpërmjet fshehjes së kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë gjatë zbatimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. U zhvarrosën kufoma nga varre të përbashkëta dhe individuale në Kosovë, të cilat u transportuan për në pjesë të tjera të

¹⁸⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17740–17745 (6 nëntor 2007), T. 18544 (19 nëntor 2007); P801 (Raport i marrjes së detyrës së Komandantit të PrK-së nga Vladimir Llazareviqi, 13 janar 1999); P950 (Intervista e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 7–10.

¹⁸¹ Vladimir Llazareviq, T. 17740 (6 nëntor 2007); 5D1324 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm i UJ-së, 12 janar 1998).

¹⁸² Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26713 (9 korrik 2008).

Serbisë ku ato u fshehën në vende të ndryshme në mbikëqyrjen e MPB-së dhe të UJ-së.¹⁸³ Mbrojtja pranon se u fshehën kufoma, por kundërshton rolin e UJ-së në operacionin,¹⁸⁴ ose kundërshton akuzën e Prokurorisë se kufomat e gjetura ishin njerëz të vrarë si rezultat i zbatimit të një plani të përbashkët kriminal.¹⁸⁵

87. Dhoma tashmë ka konkluduar që nuk ka dyshim se gjatë bombardimit të NATO-s u krye një operacion i fshehur për zhvarrosjen e më shumë se 700 kufomave të varrosur fillimisht në Kosovë dhe zhvendosjen e tyre në Serbi. Sipas provave të diskutuara më lart, figurat kryesore që morën pjesë në organizimin e këtij operacioni të gjerë ishin shefi i RJB-së në atë kohë, Vllastimir Gjorgjeviqi; ministri i Brendshëm, Vllajko Stojilkoviqi; dhe Presidenti i RFJ-së, Slllobodan Millosheviqi, të gjithë të përmendur si anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Qëllimi i këtij operacioni ishte fshehja e qindra kufomave në Kosovë nga përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe/ose forcat tokësore të NATO-s, prania e të cilëve në terren ishte parashikuar pas bombardimit të NATO-s. Dhoma përfundoi se Gjorgjeviqi, Stojilkoviqi dhe Millosheviqi dinin se shumica dërrmuese e kufomave të zhvendosura ishin viktima të krimeve dhe civilë, përfshirë gra dhe fëmijë. Implikimi i Llukiqit dhe Shainoviqit shqyrtohet më vonë në këtë Aktgjykim.

88. Dhoma është e mendimit se provat për fshehjen e kufomave, të përshkruara më hollësisht në Pjesën VII.P, konfirmojnë tërthorazi përfundimin e ekzistencës së një qëllimi të përbashkët.

vii. Përfundime

89. Elementi i dytë fizik i formës së përgjegjësisë e njohur si kryerje nëpërmjet një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale përfshin aspekte të ndryshme të provave në këtë proces; dhe, për të shmangur përsëritje të panevojshme, shqyrtimi i provave në këtë pjesë shfrytëzon pjesë të tjera të Aktgjykimit ku provat shqyrtohen hollësisht. Pikërisht këto pjesë të tjera duhen cituar për një analizë më të gjerë të provave. Në nxjerrjen e përfundimeve të veta për këtë element, Dhoma ka marrë parasysh të gjitha provat përkatëse dhe i ka vlerësuar këto prova lidhur me besueshmërinë e tyre relative, edhe kur nuk përmend prova ose dëshmi konkrete.

90. Në vitet '90, autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë arritën një farë suksesi në përpjekjet e tyre për të kufizuar kërkesat e shqiptarëve kosovarë për më shumë autonomi, dhe gjatë luftërave të Bosnjës dhe të Kroacisë, Kosova mbeti pjesë e RFJ-së dhe e Serbisë. Mirëpo, gjatë viteve '90, kur

¹⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 278, 282-287.

¹⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 215-218; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 288-292; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 692-699.

¹⁸⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 597-602.

autoritetet morën masa më të rrepta për të kontrolluar krahinën duke ia hequr autonominë, UÇK-ja u fuqizua dhe ndërmori sulme më të vendosura kundër autoriteteve shtetërore dhe kundër personave që shiheshin si përkrahës të tyre. Në vitin 1998, autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë u përpoqën të shtypnin këtë element të ri të dhunshëm në Kosovë dhe popullata shqiptare e Kosovës vuajti nga përdorimi i tepruar i dhunës, kur më shumë se 200,000 njerëz u shpërngulën brenda Kosovës deri në fund të vitit. Vetëm ndërhyrja ndërkombëtare dhe Marrëveshjet e Tetorit lejuan që këta njerëz të ktheheshin në shtëpi para fillimit të dimrit, por edhe në atë kohë autoritetet e Serbisë dhe të RFJ-së shkelën marrëveshjet duke vazhduar luftën e ashpër kundër UÇK-së.

91. Megjithëse në vitet 1998 dhe 1999, gjendja në Kosovë u bë gjithnjë e më e dhunshme, autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë kishin gjithsesi përgjegjësi për krijimin e një klime besimi, për trajtimin e shqiptarëve kosovarë si qytetarë të barabartë të RFJ-së, dhe për t'iu përgjigjur kundërshtimit të tyre ndaj ndryshimeve kushtetuese të vitit 1989 nëpërmjet dialogut politik. Udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të RFJ-së dhe Serbisë nuk e përmbushën këtë përgjegjësi; përkundrazi, ata e trajtuan popullatën shqiptare të Kosovës në tërësi si armiq të shtetit, me gjithë faktin se UÇK-ja përbënte vetëm një pjesë të vogël të kësaj popullate.

92. Negociatat ndërkombëtare të vitit 1999 synonin të gjenin një zgjidhje të krisës. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë, si dhe bashkëbisedues të tjerë shkaktuan dështimin e negociatave, hyri në fuqi vendimi i Këshillit të NATO-s për të përdorur forcë, dhe NATO-ja filloi bombardimin. Përgjegjësia e pjesshme e delegacionit të RFJ-së në dështimin e bisedimeve, e marrë në kontekstin e dislokimit të forcave të tjera në Kosovë, mundëson interpretimin se kjo u bë për të fituar kohë. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, parimet e parashtruara nga Grupi i Kontaktit, dhe kërcënimet për përdorimin e forcës nga NATO-ja duhej të kishin hapur sytë e udhëheqjes së RFJ-së dhe të Serbisë dhe të kishin shërbyer si paralajmërim për nevojën e një zgjidhjeje të përgjegjshme dhe pa vonesë e konfliktit me shqiptarët kosovarë, të cilët në atë kohë ishin më shumë se 90 për qind e popullsisë. Në vend të zgjidhjes së problemit të UÇK-së nëpërmjet përdorimit efikas dhe demokratik të policisë dhe të sistemit gjyqësor, u përdor kryerja e krimeve. Bombardimi i NATO-s u dha anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale mundësinë që po prisnin dhe për të cilën ishin përgatitur, dërgimin e forcave shtesë në Kosovë dhe armatosjen e çarmatosjen përshkruar më lart, për t'i dhënë një goditje të fortë UÇK-së dhe për të shpërngulur brenda Kosovës dhe jashtë saj aq shqiptarë të Kosovës sa duhej për ndryshimin e përbërjes etnike në Kosovë dhe për mbajtjen e krahinën nën kontroll. Dhe në këto rrethana, synimi mund të realizohej, duke i mohuar veprimet përkatëse në mënyrë bindëse, sepse mund të fajësohej jo vetëm UÇK-ja, por edhe NATO-ja.¹⁸⁶

¹⁸⁶ *Krahaso* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka e të tjerë.*, para 117 (ku është konkluduar se jo domosdoshmërisht qëllimi i përbashkët duhet të jetë përcaktuar apo formuluar paraprakisht dhe mund të konkretizohet spontanisht).

Megjithëse mund të jenë lëshuar urdhra që policia të parandalonte largimin e civilëve nga Kosova pas fillimit të eksodit masiv, këto urdhra nuk krijojnë asnjë dyshim për ekzistencën e qëllimit të përbashkët dhe të zbatimit të tij nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së. Urdhra të tilla ishin të ngjashme me urdhrat e dhëna forcave të UJ-së për respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare, të cilat u shkelën sistematikisht.¹⁸⁷

93. Dhoma nuk u jep shumë vlerë dëshmime të atyre dëshmitarëve të cilët pretenduan se nuk ekzistonte plan, projekt apo qëllim i përbashkët për shpërnguljen e popullatës ose mospërmendjes së një qëllimi të tillë në mbledhje zyrtare të organeve, si për shembull Kolegjiumi i UJ-së.¹⁸⁸ Dhoma pranon pak a shumë argumentet e Prokurorisë në këtë pikë se dëshmitarët të cilët pretenduan se nuk ekzistonte asnjë plan (a) kishin motiv për të gënjyer në mbrojtje të vetvetes, të kolegëve, të miqve dhe të institucioneve ku bënë pjesë; (b) nuk u informuan apo nuk ishin në gjendje të dinin për planin; ose (c) thjesht hamendësonin në bazë të të dhënave të pamjaftueshme.¹⁸⁹

94. Krimet e kryera gjatë periudhës së Aktakuzës tregojnë një praktikë të dallueshme shpërnguljeje të popullatës shqiptare të Kosovës, por jo praktikë vrasjesh, të dhunës seksuale dhe të shkatërrimit të monumenteve të kulturës. Në pjesët kushtuar përgjegjësisë penale individuale analizohet problemi nëse këto krime të tjera ishin logjikisht të parashikueshme për anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale – elementi mendor i kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

95. Bazuar mbi provat e analizuara më lart dhe të provave përkatëse në pjesët e mëposhtme lidhur me përgjegjësinë e të Akuzuarit (me përjashtim të katër intervistave të të Akuzuarit me Prokurorinë cituar aty), Dhoma Gjyqësore përfundon se qëllimi i përbashkët i ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte garantimi i vazhdimësisë së kontrollit të Kosovës prej autoriteteve të RFJ-së dhe të Serbisë që do të arrihej me anë të metodave kriminale. Nëpërmjet një fushate gjerësisht të përhapur dhe sistematike terrori dhe dhune, popullata shqiptare e Kosovës do të shpërngulej me dhunë edhe brenda Kosovës, edhe jashtë saj. Anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishin të vetëdijshëm mbi pamundësinë e dëbimit të të gjithë shqiptarëve kosovarë nga Kosova, kështu që qëllimi i përbashkët ishte shpërngulja e një numri të mjaftueshëm të tyre për të

¹⁸⁷ *Shih* p.sh. 6D778 (Radiogram i Shtabit të MPB-së, 15 prill 1999).

¹⁸⁸ *Shih* p. sh. Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 13-21; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 53; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 502; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 379-390

¹⁸⁹ Argumente Përmbyllëse të Prokurorisë, T. 26900-26901 (20 gusht 2008).

ndryshuar përbërjen demografike me synim arritjen e barazisë numerike të grupeve etnike dhe për nënshtrimin e shqiptarëve kosovarë.

96. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore përfundon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që gjatë kohës së krimeve të pretenduara në Aktakuzë ekzistonte një qëllim i përbashkët, që synonte apo përfshinte kryerjen e atyre krimeve sipas Statutit dhe si rezultat është vërtetuar elementi fizik i dytë i ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

b. Shumësi individësh – elementi i parë

97. Bazuar mbi përfundimet më poshtë në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore përfundon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm elementi i parë fizik i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, d.m.th. se në ndërmarrjen e përbashkët kriminale ekzistonte një shumësi individësh.

c. Kontribut i konsiderueshëm—Element i tretë

98. Pasi ka konkluduar se elementi i parë dhe i dytë fizik të ndërmarrjes së përbashkët kriminale janë vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, Dhoma Gjyqësore do të trajtojë elementin *e tretë* fizik në lidhje me secilin të Akuzuar në pjesët e mëposhtme të Aktakuzës, d.m.th. nëse ndonjë anëtar i pretenduar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale – Millutinoviqi, Shainoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Lazareviqi, Llukiqi, Vllastimir Gjorgjeviqi, Slllobodan Millosheviqi, Vllajko Stojilkoviqi, Radomir Markoviqi, Obrad Stevanoviqi dhe Dragan Iliqi – dha kontribut të konsiderueshëm në qëllimin e përbashkët. Si rezultat, Dhoma do të trajtojë edhe elementët mendorë në lidhje me format 1 dhe 3 të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, për secilin të Akuzuar, si dhe elementët e formave të tjera të përgjegjësisë të pretenduar në Aktakuzë, ku të jetë e nevojshme dhe e përshtatshme.

C. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E MILLAN MILLUTINOVIQIT

1. Akuzat e Aktakuzës

99. Aktakuza e ngarkon Millan Millutinoviqin, lindur më 19 dhjetor 1942 në Beograd, Serbi, me përgjegjësi për krime kundër njerëzimit dhe për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Sipas Aktakuzës, Millutinoviqi ishte aktiv në SPS dhe mbajti postin e Presidentit të Republikës së Serbisë, ku u zgjodh më 21 dhjetor 1997. Duke qenë se gjatë kohës të Aktakuzës ai ishte Presidenti i Serbisë, pretendohet se (a) përfaqësoi Serbinë dhe zhvillonte marrëdhënie me shtete të tjera dhe me organizata ndërkombëtare; (b) ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes (“KLM”) të RFJ-së

dhe si rezultat mori pjesë në vendime lidhur me përdorimin e UJ-së dhe ushtri pushtet si epror mbi njësi të MPB-së të vëna nën vartësinë e UJ-së gjatë gjendjes së luftës; (c) kishte kompetencë të përbashkët me Kuvendin e Republikës së Serbisë (“Kuvendi Kombëtar”), për të kërkuar raporte nga qeveria serbe lidhur me çështje në juridiksionin e saj, dhe nga MPB-ja, lidhur me veprimtarinë e saj dhe me gjendjen e sigurisë në Serbi; (d) kishte kompetencë për shpërbërjen e Kuvendit Kombëtar dhe nëpërmjet tij të qeverisë së Serbisë; dhe (e) gjatë gjendjes së luftës, kishte kompetencë të shpallte masa të cilat normalisht ishin kompetencë e Kuvendit Kombëtar, përfshirë kalimin e ligjeve.¹⁹⁰

100. Aktakuza pretendon se Millutinoviçi është individualisht përgjegjës për krimet në lidhje me të cilat akuzohet sipas Nenit 3, 5 dhe 7 të Statutit. Sipas Aktakuzës, ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndryshe ndihmoi dhe inkurajoi planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtyre krimeve. Në kuadrin e “kryerjes”, pretendohet se ai mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të diskutuar më lart. Pretendohet se ai kontribuoi në ndërmarrjen e përbashkët kriminale nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të tij *de jure* dhe *de facto*. Pretendohet se në pozitën si epror Millutinoviçi mban përgjegjësi penale edhe për mosparandalimin apo mosndëshkimin e vartësve të tij, sipas Nenit 7(3) të Statutit, për krimet e pretenduara në Pikat 1-5 të Aktakuzës.¹⁹¹

101. Aktakuza pretendon se ekzistenca e synimit kriminal të Millutinoviçit që e ngarkon me përgjegjësi sipas Nenit 7(1) dhe 7(3) mund të deduktohet nga faktorë të ndryshëm, konkretisht nga fakti se ishte në dijeni të gjasës se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë do të kryenin krime në Kosovë si rezultat i raporteve të shumta të burimeve të ndryshme lidhur me pretendime për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998; takimet e planifikimit dhe konsultimit me Slllobodan Millosheviçin; prania e tij në mbledhje ku anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale bënë deklaratatë të cilat nënkuptonin se të gjithë shqiptarët kosovarë ishin kriminelë që meritonin të vriteshin; dijenia dhe miratimi prej tij i heqjes nga postet e tyre të zyrtarëve të lartë të MPB-së dhe të UJ-së të cilët kishin shprehur mospajtimin e tyre me qëllimet e Slllobodan Millosheviçit në Kosovë ndërsa persona të cilët kishin shprehur përkrahjen e tyre për këtë politikë morën poste më të larta; pretendimet për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, të cilat dihehin në mbarë botën, përfshirë edhe në RFJ, në bazë të së cilave NATO-ja shpalli ndërmarrjen e fushatës ajrore kundër RFJ-së; informacion që ai dispononte për shpërnguljen masive të shqiptarëve kosovarë dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta nëpërmjet sistemit të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së, mediave, dhe

¹⁹⁰ Aktakuza, para 1, 5.

¹⁹¹ Aktakuza, para. 16-22.

takimeve të tij me zyrtarë të lartë të UJ-së dhe të MPB-së; dijenia e tij për fshehjen e vrasjeve nga anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.¹⁹²

102. Në Kapitullin VII, Dhoma arriti në përfundimin se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kryen krime kundër popullatës civile shqiptare kosovare në shume komuna të Kosovës, nga marsi deri në qershor 1999. Rrjedhimisht në këtë pjesë do të përcaktohet nëse Millutinoviçi është përgjegjës për ndonjë prej këtyre krimeve, në kuadrin e formave të ndryshme të përgjegjësisë së pretenduar në Aktakuzë.

2. Posti i Millutinoviçit si Presidenti i Serbisë

103. Sipas Prokurorisë, pas zgjedhjes së tij nga populli si Presidenti i Serbisë dhe duke pasur sigurinë në atë post për kohëzgjatjen e mandatit përkatës, Millutinoviçi ishte një ndër figurat më të njohura dhe të fuqishme politike të RFJ-së dhe të Serbisë. Si rezultat, ai mori pjesë në procesin vendimmarrës në Këshillin e Lartë të Mbrojtjes dhe mund të shfrytëzonte kompetenca të caktuara mbi Ministrinë e Brendshme që i akordonte Kushtetuta serbe dhe Ligji për Punë të Brendshme.¹⁹³ Gjithashtu Prokuroria argumenton se, përveç kompetencave *de jure*, Millutinoviçi ushtronte edhe pushtet dhe ndikim të konsiderueshëm *de facto* mbi organe të ndryshme, duke qenë se ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Millosheviçit, dhe madje kishte njëfarë ndikimi mbi të.¹⁹⁴ Sipas Prokurorisë, Millutinoviçi i shfrytëzoi këto kompetenca për të ndryshuar përbërjen etnike në Kosovë nëpërmjet kryerjes së krimeve të pretenduar. Kontributi i tij drejt këtij synimi u konkretizua si nëpërmjet veprimeve, po ashtu dhe mosveprimeve.¹⁹⁵

104. Nga ana tjetër, Mbrojtja e Millutinoviçit i mohon akuzat dhe argumenton se Millutinoviçi mbronte vlerat e Kushtetutës serbe. Ai punoi për shmangien e konfliktit dhe për rivendosjen e paqes në rajon, dhe punoi për të ruajtur sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Serbisë dhe të RFJ-së.¹⁹⁶

105. Siç parashtrohet në Kapitullin IV, posti i Millutinoviçit si Presidenti i Serbisë i akordonte atij disa kompetenca dhe përgjegjësi të cilat i mundësuan të ushtronte një sërë funksionesh. Jovan Kojiçi, i cili ishte nëpunës në zyrën e Presidentit ("Presidenca"), dëshmoi për organizimin dhe punën e përditshme të Presidencës, dhe për punë të përditshme të Millutinoviçit kur ky ishte

¹⁹² Aktakuza, para 39.

¹⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 562, 567-568.

¹⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 563-564.

¹⁹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 560-561.

¹⁹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 278-280.

president.¹⁹⁷ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria doli se Millutinoviçi kalonte shumë kohë jashtë Presidencës dhe për Dhomën ishte e qartë se Kojiçi nuk kishte dijeni për të gjitha takimet e Millutinoviçit jashtë Presidencës.¹⁹⁸ Lidhur me pretendimet e Aktakuzës provat nuk tregojnë se në Zyrën e Millutinoviçit ndodhën ngjarje të rëndësishme.

a. Pushteti i Millutinoviçit mbi forcat e armatosura

i. *Kompetencat de jure të Millutinoviçit*

106. Siç shpjegohet në Kapitullin IV, neni 83(5) i Kushtetutës Serbe, sipas të cilës Presidenti serb “i udhëhiqte forcat e armatosura” në kohe lufte dhe paqeje, ishte kompetencë rezerve që hynte në fuqi në rast se Serbia do të bëhej shtet i pavarur, dhe më 1998 dhe 1999 nuk i akordonte Millutinoviçit pushtet si epror mbi UJ-në. Gjithashtu, Dhoma vëren gjithashtu se të gjitha figurat e larta ushtarake dhe politike që dolën dëshmitarë në këtë çështje, dëshmuan se Millosheviçi si Presidenti i RFJ-së ishte “kryekomandanti” i UJ-së.¹⁹⁹ Vetë Millutinoviçi, gjatë intervistës me Prokurorinë, tha se Millosheviçi ishte kryekomandanti i UJ-së, si në kohë paqeje, po ashtu edhe në kohë lufte. Millutinoviçi supozoi se Millosheviçi i kishte dhënë urdhra Shtabit të Përgjithshëm, por deklaroi se nuk kishte parë me sy asnjë urdhër të tillë.²⁰⁰

107. Si rrjedhojë, Dhoma është bindur se Millutinoviçi nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi UJ-në. dhe as nuk mund t’u jepte urdhra njërive ushtarake. Faktikisht, shumë dëshmitarë në këtë çështje konfirmuan se e vetmja lidhje e tij formale me UJ-në ishte anëtarësia e tij *ex officio* në KLM.

ii. *Millutinoviçi si anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes*

108. Prokuroria pretendon se Millosheviçi komandoi UJ-në, në përputhje me vendimet e marra prej tij dhe Millutinoviçit, si një prej tre anëtarëve me drejtë vote të KLM-së. Më tej argumentohet se, si anëtar i KLM-së, Millutinoviçi mund të bllokonte apo të pengonte propozime që u paraqitën për zbatimin e planit kriminal por, në të kundërt tregoi një “përafrim të ngushtë mendimesh” me

¹⁹⁷ Jovan Kojiçi, T. 13721–13727 (15 gusht 2007), T. 13762–13763 (16 gusht 2007), 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 1–21, Shtojca A; IC135 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Kojiçi shënuar nga Kojiçi); IC136 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Kojiçi shënuar nga Kojiçi).

¹⁹⁸ Jovan Kojiçi, T. 13755–13762 (16 gusht 2007).

¹⁹⁹ *Shih për shembull*, Aleksandar Vasileviçi, T. 8635 (18 janar 2007); Millorad Obradoviçi, T. 15042 (5 shtator 2007); Millovan Vllajkoviçi, T. 16089–16093 (20 shtator 2007); Branko Gajiçi, T. 15296–15297 (7 shtator 2007), T. 15434–15436 (12 shtator 2007); Miodrag Simiq, T. 15600–15603, 15610 (13 shtator 2007).

²⁰⁰ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 183–184.

Milloshëviqin.²⁰¹ Prokuroria pretendon gjithashtu se, nëpërmjet KLM-së, Millosheviqi dhe Millutinoviqi hoqën sistematikisht nga puna ata që kundërshtuan përdorimin e UJ-së jashtë hierarkisë së përcaktuar komanduese dhe në vend të tyre emëruan individë të gatshëm për zbatimin e planit kriminal. Sipas Prokurorisë, nëpërmjet këtij procesi u emëruan në poste kyçe Ojdaniqi, Pavkoviqi dhe Llazareviqi si dhe zyrtarë të tjerë përkrahës.²⁰² Megjithëse Prokuroria pranon se vetëm Presidenti i RFJ-së kishte kompetencë për emërimin apo heqjen nga puna të zyrtarëve të lartë të UJ-së, ajo pretendon se do të ishte qenë “shumë më e vështirë, praktikisht thuajse e pamundur, që Millosheviqi të zbatonte propozimin e tij kundër vullnetit të shumicës së KLM-së.”²⁰³

109. Mbrojtja e Millutinoviqit, në anën tjetër, argumenton se provat tregojnë që anëtarët e KLM-së takoheshin për të marrë të dhëna të caktuara mbi punonjësit e UJ-së dhe mbi çështje buxhetore, dhe se, në lidhje me diskutimet e tyre për kërcënimet nga UÇK-ja dhe NATO-ja, ata miratonin përfundime ose qëndrime politike, por jo vendime. Më tej, Mbrojtja flet për përfundimet dhe argumenton se këto përfundime ishin gjithmonë dhe pandryshueshmërisht në mbështetje të një zgjidhjeje paqësore të problemeve. Mbrojtja e vendit përmendë vetëm në rast se vendi do të sulmohej. Së fundi Mbrojtja argumenton se pas fillimit të fushatës së NATO-s, KLM-ja dhe Millutinoviqi nuk kishin asnjë rol në lidhje me përdorimin e UJ-së dhe të MPB-së.²⁰⁴

110. Siç u konkludua më herët, Dhoma është bindur se KLM-ja ishte më shumë se një organ thjesht këshillimor, qoftë në bazë të kushtetutës, qoftë në praktikë, dhe se faktikisht mori vendime. Gjithsesi pas 25 dhjetorit 1998 nuk ka prova të drejtpërdrejta për mbledhje të KLM-së në përbërjen e plotë. Nga ana tjetër, ka prova për një mbledhje të KLM-së më 23 mars, por në të nuk mori pjesë Presidenti malazez Gjukanoviq.²⁰⁵ Tani Dhoma do të analizojë llojet e vendimeve të marra nga KLM-ja dhe, konkretisht nëse këto vendime përmbanin diçka kriminale apo të dyshimtë, fakt që mund të çonte në përfundimin se, si anëtar, Millutinoviqi ishte përgjegjës për krimet e pretenduara në Aktakuzë. Dhoma analizoi me kujdes procesverbalet dhe shënimet stenografike e sesioneve të KLM-së që janë pranuar si prova. Procesverbalet janë nga nëntë sesione të KLM-së midis 28 tetorit 1997 dhe 23 marsit 1999.²⁰⁶ Shënimet stenografike përkrijnë me gjashtë nga këto nëntë sesione.²⁰⁷

²⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 26, 569–570, 613.

²⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 80, 137–141.

²⁰³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 574.

²⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 64–82.

²⁰⁵ Shih Ndarjen VI.A.1.d.

²⁰⁶ 1D691 (Procesverbali i sesionit të parë të KLM-së, 28 tetor 1997); 1D692 (Procesverbali i sesionit të dytë të KLM-së, 10 nëntor 1997); P1573 (Procesverbali i sesionit të tretë të KLM-së, 24 dhjetor 1997); 1D550 (Procesverbali i sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998); P1574 (Procesverbali i sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998); P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998); P1576 (Procesverbali i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998); P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998); P1577 (Procesverbali i sesionit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999).

111. Duke qenë se në atë kohë, Millutinoviçi nuk ishte Presidenti i Serbisë, ai nuk mori pjesë në tre sesionet e para të KLM-së, të cilat u zhvilluan më 28 tetor 1997,²⁰⁸ 10 nëntor 1997²⁰⁹ dhe 24 dhjetor 1997.²¹⁰ Ai mori pjesë për herë të parë në sesionin e KLM-së më 8 janar 1998.²¹¹ Përveç anëtarëve të rregullt të KLM-së, d.m.th. Presidenti i RFJ-së Millosheviç, Millutinoviçi, dhe Presidenti i atëhershëm i Malit të Zi, Momir Bullatoviç, të pranishëm në sesion ishin edhe Kryeministri i RFJ-së Radoje Kontiq, ministri federal i Mbrojtjes Pavle Bullatoviç, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Momçillo Perishiç, dhe sekretari i KLM-së, gjeneralletjënant Sllavolub Shushaqit. Tema kryesore e bisedës, në të cilën nuk mori pjesë Millutinoviçi, ishte shpërndarja e burimeve financiare për UJ-në dhe Ministrinë federale të Mbrojtjes. KLM-ja përmendi shkurtimisht gjithashtu çështjen e marrëdhënieve midis Kroacisë dhe RFJ-së. Pjesëmarrja e Millutinoviçit në këtë diskutim zbuloi përfshirjen e tij në negociatat me Kroacinë.²¹²

112. Sesioni i pestë u zhvillua më 9 qershor 1998 me pjesëmarrje të njëjtë si në sesionin e katërt, me përjashtim të Radoje Kontiqit. Gjithashtu, Presidenti i ri i Malit të Zi, Millo Gjukanoviçi, mori pjesë si anëtar me drejtë vote të KLM-së, kurse Momir Bullatoviçi mori pjesë në cilësinë e re si Kryeministër i RFJ-së. Dy temat e rendit të ditës ishin: (a) gjendja ushtarake dhe politike në RFJ, përfshirë gjendjen në kufirin shtetëror me Shqipërinë, dhe (b) çështje personeli. Në lidhje me pikën e parë, Perishiçi përshkroi rreziqet e mundshme për vendin nga territori i vendeve fqinjë, kryesisht nga Shqipëria, si dhe pozicionet e trupave të UJ-së në Kosovë. Ai përmendi gjithashtu periudhën nga 20 marsi deri më 9 qershor 1998, kur afër kufirit shqiptar kishin ndodhur 31 incidente me UÇK-në; foli edhe për humbjet e pësuar nga UJ-ja si rezultat i tyre. Pas këtij prezantimi, KLM-ja miratoi tri përfundime. Së pari, u pranua njëzëri prezantimi i Perishiçit. Së dyti, u konkludua se UJ-ja do të “ndërhynte në mënyrën e duhur” nëse shkallëzoheshin aktivitetet e terroristëve. Së treti, UJ-ja ishte e gatshme t’i kundërpërgjigjej çdo lloj ndërhyrjeje të jashtme që mund të prekte sovranitetin

²⁰⁷ 1D756 (Shënime stenografike të sesionit të parë të KLM-së, 28 tetor 1997); 1D757 (Shënime stenografike të sesionit të dytë të KLM-së, 10 nëntor 1997); 1D758 (Shënime stenografike të sesionit të tretë të KLM-së, 24 dhjetor 1997); 1D759 (Shënime stenografike të sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998); 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998); P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998); 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998).

²⁰⁸ 1D691 (Procesverbali i sesionit të parë të KLM-së, 28 tetor 1997); 1D756 (Shënime stenografike të sesionit të parë të KLM-së, 28 tetor 1997).

²⁰⁹ 1D692 (Procesverbali i sesionit të dytë të KLM-së, 10 nëntor 1997); 1D757 (Shënime stenografike të sesionit të dytë të KLM-së, 10 nëntor 1997).

²¹⁰ P1573 (Procesverbali i sesionit të tretë të KLM-së, 24 dhjetor 1997); 1D758 (Shënime stenografike të sesionit të tretë të KLM-së, 24 dhjetor 1997).

²¹¹ 1D550 (Procesverbali i sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998); 1D759 (Shënime stenografike të sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998).

²¹² 1D550 (Procesverbali i sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998); 1D759 (Shënime stenografike të sesionit të katërt të KLM-së, 8 janar 1998), f. 13-14.

e RFJ-së.²¹³ Gjatë prezantimit, Perishiqi shpjegoi se UJ-ja vepronte vetëm në brezin kufitar dhe kjo si “ushtri në kohë paqeje.” Ai shpjegoi se UJ-ja nuk do të vepronte brenda Kosovës nëse nuk sulmohej, se përndryshe bota do të kishte një pretekst për të ndërhyrë në konflikt.²¹⁴ Në lidhje me çështjet e personelit, KLM-ja shqyrtoi një listë propozimesh të përgatitura nga Shtabi i Përgjithshëm, e miratoi listën tërësisht dhe si rezultat emëroi apo ngriti në rang disa individë në listë, përfshirë Llazareviqin.²¹⁵ Sipas procesverbalit, këto emëtime u kryen nga KLM-ja dhe jo nga Millosheviqi vetë. Pas këtij sesioni të KLM-së, në verë të vitit 1998 forcat e RFJ-së/Serbisë në Kosovë ndërmorën operacionet e tyre kundër UÇK-së sipas Planit të lartpërmendur kundër Terrorizmit.²¹⁶

113. Më 4 tetor 1998 u zhvillua sesioni i gjashtë i KLM-së, pas përfundimit të Planit kundër Terrorizmit, me të njëjtën pjesëmarrje të sesionit të mëparshëm. E vetmja temë në rendin e ditës ishte gjendja ushtarake dhe politike në RFJ. Këtë herë u diskutua për një sulm të mundshëm të NATO-së. Perishiqi paraqiti skenarët e mundshëm të një sulmi të tillë dhe paralajmëroi se forcat e RFJ-së nuk do të mund të mbronin vendin pa aleatë. Ai argumentoi se (a) sulmet ajrore të NATO-së duheshin shmangur me çdo mjet diplomatik dhe politik; (b) duhej kërkuar nga Kuvendi Federal që të shpallte rrezikun e luftës së afërt dhe, pas hedhjes së raketës së parë, të shpallte menjëherë gjendjen e luftës për të krijuar kushte për mbrojtjen; dhe (c) KLM-ja duhej të miratonte masat e nevojshme në përgatitje për mbrojtjen e vendit, duke marrë parasysh se sulmet ajrore dukeshin të pashmangshme.²¹⁷

114. Në këtë pikë Millutinoviqi mori pjesë në diskutim dhe ra dakord me Perishiqin, por shprehu shpresën se nuk do të kishte sulme ajrore sepse RFJ-ja kishte plotësuar detyrimet e saj sipas Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ai pranoi se vendi duhet të ishte i përgatitur për një sulm të tillë.²¹⁸ Gjukanoviqi argumentoi se një sulm nga NATO-ja ishte më i mundshëm se kurrë, dhe se RFJ-ja duhet të bënte çmos për ta shmangur. Ai sugjeroi që Millosheviqi të lëshonte menjëherë një deklaratë se ishte gati të pranonte tërë detyrimet e imponuara nga Rezoluta e Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu ai sugjeroi që Millosheviqi të ftonte

²¹³ P1574 (Procesverbali i sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 1-4; 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 4-10.

²¹⁴ 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 9-10.

²¹⁵ P1574 (Procesverbali i sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 4-8; 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 10-15.

²¹⁶ *Shih* Seksionin VI.E.

²¹⁷ P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 1-4; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 4-10.

²¹⁸ P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 4; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 10-11. *Shih gjithashtu* P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29-33.

përfaqësuesit e Tribunalit për të hetuar akuzat për krime kundër shqiptarëve kosovarë dhe të paraqiste një plan të detajuar për kthimin e “refugjatëve” në Kosovë, gjithë kjo për të shmangur dyshimet mbi respektimin e Rezolutës 1199 prej RFJ-së. Gjukanoviqi e mbështeti plotësisht propozimin e parë të Perishiqit, por nuk ishte dakord me propozimin e dytë dhe të tretë.²¹⁹ Pas fjalës së Kryeministrit të RFJ-së, Momir Bullatoviqi, i cili, ashtu si Millutinoviqi, ishte kundër shpalljes së rrezikut të luftës,²²⁰ dhe të ministrit federal të Mbrojtjes, Pavle Bullatoviqi, dhe të Perishiqit,²²¹ Millosheviqi deklaroi se RFJ-ja i kishte plotësuar të gjithë kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare dhe u kujtoi të pranishmëve se veprime “kundërterroriste” kishin përfunduar gjashtë ditë më parë dhe se njësitë e UJ-së ishin kthyer në kazerma. Mirëpo, ai tha se kërcënimi duhej marrë seriozisht dhe se vendi duhej të përgatitej për t’u mbrojtur. Më tej ai sugjeroi se duhej miratuar dhe publikuar vetëm një përfundim, se vendi do të vetëmbrohej nëse sulmohej. Anëtarët e tjerë të KLM-së e pranuan njëzëri këtë propozim.²²² Sipas Mbrojtjes së Millutinoviqit, ky është përfundimi apo “qëndrimi politik” i cili u shfrytëzua më vonë nga Millosheviqi për të komanduar UJ-në vetë, pa mendimin e KLM-së, siç pasqyrohet në urdhrin e kalimit të MPB-së në varësi të UJ-së, i cili u lëshua më 18 prill 1999, dhe në të cilin shfrytëzohet konkretisht ky përfundim.²²³

115. Millosheviqi pranoi gjithashtu propozimin e Perishiqit që në sesionin vijues të Kuvendit Federal të shpallej rreziku i luftës së afërt për të mundësuar që vendi të fillonte përgatitjet e nevojshme për mbrojtje.²²⁴ Ditën e nesërme, më 5 tetor 1998, u mbledh Kuvendi Federal ku, midis të tjerave, shprehu mbështetjen për Republikës e Serbisë në luftën e saj kundër separatizmit shqiptar; lavdëroi UJ-në dhe MPB-në për mbrojtjen e tërësisë territoriale të RFJ-së; dënoi veprimet e Shqipërisë e cila ofronte vend stërvitjeje për UÇK-së; dënoi manipulimet e gjendjes në Kosovë nga ana e mediave; përmendi Marrëveshjen Millosheviq-Jelsin; dhe pranoi vëzhguesit e OSBE-së në Kosovë. Gjithsesi, nuk u shpall rreziku i luftës së afërt. Marrëveshja Millosheviq-Holbrooke u negociua më 13 tetor.²²⁵

²¹⁹ P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 4-5; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 11-16.

²²⁰ P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 17-19.

²²¹ P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 6-7; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 19-22.

²²² P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 7-10; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 22-33.

²²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 84-85; 3D670 (Urdhri i ndërrimit të varësisë i lëshuar nga Sllobodan Millosheviqi, 18 prill 1999).

²²⁴ P1575 (Procesverbali i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 7-10; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 22-33.

²²⁵ 1D234 (Përfundimet e Kuvendit të RFJ-së, botuar më 6 tetor 1998).

116. Është për t'u theksuar se sipas shënimeve stenografike të këtij sesioni të KLM-së Millosheviqi deklaroi se bashkësia ndërkombëtare zakonisht e fajësonte atë për të gjithë problemet. Më tej ai tha:²²⁶

Por ata marrin parasysh edhe çfarë bëjnë organet tona, d.m.th. kjo është e njëjtë. Sepse policia nuk është kompetenca ime—është Presidenti i Serbisë, Millutinoviqi, dhe për gjëra të tjera gjithashtu. Por unë i pranoj edhe këto. Nuk u shmangem këtyre përgjegjësive—për këtë nuk ka dyshim, por një gjë duhet të jetë e qartë: organet shtetërore bëjnë punën e tyre sepse është brenda kompetencave të tyre, dhe kjo është politika jonë shtetërore.

Në përgjigje të kësaj deklaratë, Gjukanoviqi tha se Millosheviqi nënvlerësonte faktin se bashkësia ndërkombëtare nuk u besonte deklaratat e disa organeve shtetërore, si dhe të vetë Millosheviqit. Ai përmendi incidentin në Abrinë e Epërme që ndodhi më 26 shtator 1998 dhe dyshimet e bashkësisë ndërkombëtare mbi ndërprerjen e veprimeve luftarake në atë zonë.²²⁷ Ai përmendi gjithashtu ambasadorin amerikan Chris Hill i cili raportoi se kishte parë personalisht që disa postblloqe policore nuk ishin hequr me gjithë sigurimet “e Beogradit” se nuk ishin më.²²⁸

117. Më 1 tetor 1998, Millutinoviqi mori një letër nga zëvendësministri i Informacionit ku shkruhej se pretendimet e mediave ndërkombëtare për Abrinë e Epërme ishin spekulime pa bazë.²²⁹ Në sesionin e datës 5 tetor 1998, Kuvendi Federal dënoi manipulimet e fundit të mediave, ku përfshiheshin “trillimi dhe botimi i raporteve për vende fiktive të ekzekutimit dhe për njëfarë ‘katastrofe njerëzore’ si dhe për përpjekje të turpshme për inskenim ‘masakrash’”²³⁰

118. Më 24 nëntor 1998, u zhvillua sesioni i shtatë i KLM-së në të cilin morën pjesë vetëm tre anëtarë të KLM-së me të drejtë vote: Millosheviqi, Millutinoviqi dhe Gjukanoviqi. Në rendin e ditës ishin dy pika: rishikimi i buxhetit ushtarak për 1999 dhe çështje personeli. Millutinoviqi diskutoi për të dy temat. Në lidhje me pikën e parë, ai argumentoi se Mali i Zi duhej të shtonte kontributin e tij për buxhetin ushtarak të paktën deri në dhjetë për qind. Më pas KLM-ja shprehu miratimin për buxhetin ushtarak dhe kontributin proporcional të republikave anëtare në financimin e UJ-së.²³¹

119. Lidhur me temën e dytë të rendit të ditës, Millosheviqi propozoi që Perishiqi të hiqej nga posti si shef i Shtabit të Përgjithshëm sepse e kishte pasur për një kohë tepër të gjatë. Ai sugjeroi që Perishiqi të zëvendësohej ose nga Ojdaniqi, ose nga gjenerali Lubisha Veliçkoviç. Gjukanoviqi nuk

²²⁶ P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 23.

²²⁷ Ky incident përshkruhet me hollësi në Pjesën VI.C.

²²⁸ P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 28-31.

²²⁹ P2827 (Letër e zëvendësministrit të Informacionit të Serbisë drejtuar Millan Millutinoviqit, 1 tetor 1998), p. 2-3.

²³⁰ 2D67 (Përfundimet e Kuvendit Federal të RFJ-së për gjendjen në Kosovë, 5 tetor 1998), f. 2.

²³¹ P1576 (Procesverbali i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998), f. 1-3.

ishte dakord me këtë propozim, duke argumentuar se Perishiqi kishte shumë përvojë, se kishte mbajtur bashkëpunim korrekt me udhëheqjen e Malit të Zi dhe se kishte përfaqësuar me sukses interesat dhe reputacionin e UJ-së në arenën ndërkombëtare.²³² Millutinoviqi kishte një mendim tjetër dhe argumentoi se, megjithëse i suksesshëm në arenën ndërkombëtare, Perishiqi duhej zëvendësuar sepse e kishte pasur postin për një kohë tepër të gjatë, sepse mendimi pozitiv i bashkësisë ndërkombëtare duhej marrë me rezerva, dhe se vendi nuk duhej të vendoste çështje të brendshme sipas interesave të jashtme. Përveç kësaj, Ojdaniqi ishte kandidat po aq i mirë sa Perishiqi.²³³ Kur Gjukanoviqi parashtrroi argumente në favor të mbajtjes së Perishiqit në post, Millosheviqi i pranoi por ritheksoi se sipas tij Ojdaniqi duhej të ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Gjukanoviqi protestoi fuqimisht dhe argumentoi se praktika e mëparshme e KLM-se, siç shihet në procesverbalin e sesionit të pestë, për emërimin apo heqjen e personelit të UJ-së nuk duhej anashkaluar. Millosheviqi u përgjigj duke u kujtuar anëtarëve të KLM-së se, sipas Kushtetutës së RFJ-së, vendimet për emërimet e gjeneralëve të UJ-së lëshoheshin nga Presidenti i RFJ-së. Millosheviqi shpjegoi gjithashtu se praktika e KLM-së ishte që të dëgjoreshin mendimet e anëtarëve edhe për çështje që ishin vetëm kompetenca e Presidentit të RFJ-së. Duke mbyllur debatin, Millosheviqi tha se do të vazhdonte të këshillohej me anëtarët e KLM-së për çështjet më të rëndësishme të UJ-së. Më pas ai lëshoi dekrete për emërimin e Ojdaniqit shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe për emërimin e Perishiqit këshilltar të qeverisë së RFJ-së për çështje të mbrojtjes.²³⁴

120. Më 25 dhjetor 1998 u zhvillua sesioni i tetë i KLM-së. Morën pjesë të tre anëtarët si dhe Shainoviqi (për Momir Bullatoviqin²³⁵), Pavle Bullatoviqi, Ojdaniqi si shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm, dhe sekretari i KLM-së. Në rendin e ditës ishin tri tema: gjendja në kufirin shtetëror me Shqipërinë, financimi i UJ-së dhe një “raport mbi emërimet e propozuara në Ushtrinë Jugosllave dorëzuar për vendim Presidentit të RF të Jugosllavisë.”²³⁶ Ojdaniqi prezantoi temën e parë, përshkroi masat e sigurisë të ndërmarra nga UJ-ja, në veçanti Korpusi i Prishtinës, në lidhje me kufijtë me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ai nënvizoi se nga 1 janari deri me 24 dhjetor 1998, kishte pasur më shumë se 100 shkelje të kufirit, dhe ishin arrestuar 676 persona të cilët ishin përpjekur të kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme.. Së fundi, ai përshkroi disa probleme dhe dobësi që ndërlikuan funksionimin e sistemit kufitar, përfshirë mungesën e organizimit të njësisive të

²³² P1576 (Procesverbali i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998), f. 3-4.

²³³ P1576 (Procesverbali i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998), f. 4.

²³⁴ P1576 (Procesverbali i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998), f. 4-5.

²³⁵ Bullatoviq, T. 13858–13859 (17 gusht 2007).

²³⁶ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3.

Korpusit të Prishtinës.²³⁷ Pas tij foli Shainoviçi i cili përmendi bashkëpunimin midis UJ-së dhe MPB-së, si dhe faktin se nuk ishte në dijeni për asnjë problem në kryerjen e detyrave në kufi. Mirëpo, Millosheviçi theksoi se, me gjithë mbylljen e kufirit shtetëror, UÇK-ja ende po armatosej. Ai argumentoi për një bashkëpunim më të ngushtë midis UJ-së dhe MPB-së.²³⁸

121. Lidhur me diskutimin e personelit të UJ-së, një propozim në listën e hartuar nga Shtabi i Përgjithshëm ishte që Pavkoviçi të emërohej komandant i Armatës së Tretë. Millosheviçi e shpjegoi kështu:

Për sa i përket rregullimit të statusit të shërbimit të gjeneralëve, kjo u bë për shkak të disa riemërimeve. Posti i zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm është i hapur duke qenë se ish-zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerali Ojdaniq, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm. Parashikohet që gjenerali Marjanoviçi të marrë postin. Si rezultat mbetet i lirë posti i Kryeinspektorit në të cilin parashikohet të emërohet gjenerali Samarxhiq. ...

Gjeneralkoloneli Nebojsa Pavkoviçi është propozuar komandant i Armatës së Tretë. Ai ka qenë i shkëlqyer në postin e tij të komandantit të Korpusit [të Prishtinës], në korpusin më të fortë të Armatës së Tretë, si dhe në një sërë detyrash të tjera ndihmëse dhe të shtabit.²³⁹

122. Gjukanoviçi vuri në dukje se kjo pikë e rendit të ditës ishte përfshirë nën titullin “Informacion”, që nënkuptonte se paraqitej sa për të informuar KLM-në dhe se KLM-ja nuk mund të merrte asnjë vendim lidhur me të. Ai tha gjithashtu se donte të kishte më shumë të dhëna mbi kandidatët e propozuar, dhe vërejtje se Mali i Zi ishte informuar se veprimet e Korpusit të Prishtinës nuk ishin gjithmonë në përputhje me rolin kushtetues të UJ-se dhe me vendimet e KLM-së. Për atë arsye, Gjukanoviçi kërkoi që të rishikohej vendimi për ngritjen në detyrë të Pavkoviçit.²⁴⁰ Millosheviçi iu përgjigj komenteve të Gjukanoviçit duke thënë se nuk kishte pasur ankesë për ndonjë veprim joligjor të Korpusit të Prishtinës dhe Millutinoviçi shtoi se raportet “mbi pretendime për mungesë disipline dhe veprime të Korpusit të Prishtinës në shkelje të kushtetutës ishin, si zakonisht, të tepruara.”²⁴¹

123. Në fund të mbledhjes Millosheviçi paraqiti, dhe anëtarët e KLM-së pranuan, një sërë përfundimesh, konkretisht se UJ-ja vepronte në përputhje me rregulloren e shërbimit në Kosovë dhe se Korpusi i Prishtinës po i kryente detyrat me sukses, se efektive u duheshin krijuar kushte

²³⁷ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1-3; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 4-7.

²³⁸ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3-4; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 7-11.

²³⁹ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 8-9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 13-21.

²⁴⁰ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 9-10; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 21-22.

²⁴¹ P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 10; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 21-23.

më të mira për të mbrojtur kufirin, se KLM-ja do të vazhdonte të informohej për të gjitha çështjen në lidhje me UJ-në, dhe se në procesin vendimmarrës duheshin marrë parasysh të gjitha vërejtjet e paraqitura. Millosheviqi përfundoi se nuk kishte kundërshtime përveç atij për ngritjen në detyrë të Pavkoviçit; ai shprehu shpresën e tij se kjo nuk do të botohej në media dhe Gjukanoviçi premtoi se nuk do të ndodhte.²⁴² Duke marrë parasysh diskutimin e Gjukanoviçit në mbledhje, është e habitshme që ai pranoi përfundimin e parë.

124. Sesioni i nëntë i KLM-së ishte tepër i shkurtër dhe u zhvillua më 23 mars 1999. Sesioni u kryesua nga Millosheviqi dhe në të morën pjesë Millutinoviçi, Momir Bullatoviçi, Pavle Bullatoviçi, Ojdaniçi, dhe sekretari i KLM-së. Gjukanoviçi nuk ishte.²⁴³ Në rendin e ditës ishin dy tema: mundësia e “agresionit të NATO-s” dhe shqyrtimi i Rregullores së Procedurës së KLM-së. Në lidhje me temën e parë, Ojdaniçi u shpjegoi pjesëmarrësve masat mbrojtëse të ndërmarra nga udhëheqja e lartë ushtarake. Më tej, Millutinoviçi theksoi se delegacioni i RFJ-së në Rambuje kishte bërë çmos për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për problemet në Kosovës por se “Perëndimi” siç duket, kishte vendosur të shënonte përvjetorin e 50-të të NATO-s me një spektakël. Millosheviqi u kujtoi të tjerëve përfundimet e KLM-së të tetorit 1998 për mbrojtjen e vendit me çdo kusht në rast se sulmohej. Në lidhje me temën e dytë të rendit të ditës, KLM-ja pranoi Rregulloren e re të Procedurës së KLM-së, e cila parashikonte miratimin e përfundimeve me konsensusin e të tre anëtarëve me drejtë vote dhe kërkonte pjesëmarrjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe të ministrit të Mbrojtjes së RFJ-së.²⁴⁴

125. Pasi ka analizuar të gjitha provat në lidhje me sesionet e KLM-së deri më 23 mars 1999, Dhoma konkludon se asnjë dokument i KLM-së nuk zbulon formulimin apo zbatimin e qëllimit të përbashkët të përmendur në Aktakuzë. Përfundimi i datës 9 qershor 1998 – se UJ-ja do të ndërhynte nëse veprimet e UÇK-së në Kosovë shtoheshin – duket se ishte rezultat i prezantimit të Perishiçit për gjendjen gjithnjë e më të nderë në Kosovë. Vendimi i datës 4 tetor që vendi do të vetëmbrohej në rast se sulmohej, duket se ishte rezultat i kërcënimit të NATO-s i cili ishte tepër real në atë kohë dhe i cili më së fundi u shmang më 13 tetor kur Millosheviqi arriti një marrëveshje me Holbrooke-un.

126. Lidhur me sjelljen e Millutinoviçit gjatë mbledhjeve të KLM-së, është e qartë se ai mbështeti Millosheviqin kur Gjukanoviçi shprehu dyshim për zëvendësimin e Perishiçit dhe për ngritjen e Pavkoviçit. Këto janë dy rastet e vetme të dokumentuara të një mosmarrëveshjeje të fortë

²⁴² P1000 (Procesverbali i takimit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 10-11; 1D761 (Shënime stenografike të takimit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 24-25.

²⁴³ P1577 (Procesverbali i takimit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1.

²⁴⁴ P1577 (Procesverbali i takimit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1-2.

ndërmjet tre anëtarëve me drejtë vote të KLM-së. Në të dy rastet, dhe me gjithë argumentet e mira, Gjukanoviçi ishte pakicë. Në mbështetjen e këtyre vendimeve, mund të thuhet se Millutinoviçi tregoi besnikëri ndaj Millosheviçit dhe nuk ushtroi mendimin e vet të pavarur, më shumë në lidhje me ngritjen e Pavkoviçit sesa me zëvendësimin e Perishiçit. Mirëpo, edhe nëse Millutinoviçi do të kishte marrë anën e Gjukanoviçit në këto dy çështje, rezultati nuk do të kishte qenë i ndryshëm meqenëse sipas nenit 136 të Kushtetutës së RFJ-së, emërimet dhe gradimet e gjeneralëve të UJ-së ishin kompetencë ekskluzive e Millosheviçit. Siç u tha më lart, KLM-ja ishte informuar për këtë gjatë diskutimit të zëvendësimit të Perishiçit.

127. Gjithashtu vlen të theksohet se Millutinoviçi vetë duket se nuk ngriti asnjë problem gjatë këtyre mbledhjeve megjithëse kishte mundësi për të bërë propozime.²⁴⁵

iii. Millutinoviçi si anëtar i Komandës së Lartë në kohë lufte

128. Prokuroria pretendon se, me shpalljen e gjendjes së luftës, KLM-ja u bë pjesë përbërëse e Komandës së Lartë. Rrjedhimisht, Millutinoviçi u bë anëtar i Komandës së Lartë dhe ishte i informuar për zhvillimet në Kosovë gjatë tërë konfliktit.²⁴⁶ Mirëpo, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se ai nuk ka qenë asnjëherë anëtar i Komandës së Lartë dhe se i vetmi civil i cili kishte pushtet mbi UJ-në, në kohë paqeje dhe lufte, ishte Presidenti i RFJ-së.²⁴⁷ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se KLM-ja nuk mbajti më mbledhjes pas datës 23 mars 1999 sepse nuk kishte asnjë rol në vendimet mbi luftën.²⁴⁸

129. Dhoma kujton përfundimin e saj se, megjithëse nuk ka prova të drejtpërdrejta të mbledhjeve të KLM-së pas datës 23 mars 1999, KLM-ja mbajti komandën *de jure* mbi UJ-ne në kohë lufte, në përputhje me Kushtetutën e RFJ-së. Siç u tha më lart, qoftë nën shkurtesën KLM, qoftë si organ që më vonë quhej “Komanda e Lartë,” Dhoma Gjyqësore është bindur se anëtarët e mbetur të KLM-së, pra Millosheviçi dhe Millutinoviçi, u takuan gjatë fushatës ajrore të NATO-s dhe ushtruan komandë formale mbi UJ-në.

130. Mirëpo, në të njëjtën kohë, nuk ka dyshim se Millosheviçi, si “Komandant i Lartë,” ishte në majë të strukturës komanduese të UJ-së gjatë tërë konfliktit. Për shembull, gjatë bombardimit të NATO-s, Millosheviçi, dhe jo Millutinoviçi, takohej me Ojdaniqin përditë, duke shfrytëzuar vendimin e KLM-së të 4 tetorit si bazën ligjore të pushtetit të tij. Gjithashtu Dhoma vëren se shumica e dëshmitarëve në gjyq nuk kishin dëgjuar që Millutinoviçi të merrte pjesë në mbledhjet e

²⁴⁵ *Shih* Ndarjen VI.A.1.d.

²⁴⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 640.

²⁴⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 88.

“Komandës së Lartë.” Përkundrazi, tre dëshmitarë dëshmuar se Millutinoviçi u pa në ndërtesën e shtabit të Komandës së Lartë një apo dy herë gjatë konfliktit.²⁴⁹

131. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se, megjithëse teorikisht Millutinoviçi kishte ende një rol formal në strukturën komanduese të UJ-së, komandimi i vërtetë në atë kohë u krye nga Kryekomandanti, Sllobodan Millosheviçi, i cili përdori vendimin e KLM-së të datës 4 tetor dhe e miratoi për mbrojtjen e vendit nëse sulmohej nga NATO-ja.

iv. Millutinoviçi në mbledhje të ndryshme

132. Prokuroria pretendon se si në vitin 1998, po ashtu edhe në vitin 1999, Millutinoviçi mori pjesë në mbledhje të shumta me udhëheqjen e lartë politike, ushtarake dhe policore ku shkëmbehej informacion për Kosovën, diskutoheshin plane për veprime në të ardhmen, dhe merreshin vendime. Sipas Prokurorisë, prania e tij si Presidenti i Serbisë u dha legjitimitet vendimeve të marra.²⁵⁰ Mbrojtja e Millutinoviçit e mohon këtë pretendim duke argumentuar se këto mbledhje nuk kishin lidhje me dislokimin e UJ-së dhe/ose të MPB-së, por se synonin të shpjegonin politikën e shtetit në lidhje me Kosovën dhe se kontributi i Millutinoviçit në ato mbledhje ishte i vogël.²⁵¹

133. Siç përshkruhet hollësisht më lart, Millutinoviçi mori pjesë në një mbledhje në Beograd me Millosheviçin dhe përfaqësuesit e UJ-së dhe të MPB-së. Përveç Millosheviçit, i cili kryesoi mbledhjen, ishin edhe Miniçi, Matkoviçi, Angjelkoviçi, Perishiçi, Samarxhiçi, Pavkoviçi, Dimitrijeviçi, Stojilkoviçi, Gjorgjeviçi dhe Llukiqi. Gjatë mbledhjes u miratua një Plan kundër Terrorizmit. Në lidhje me rolin e Millutinoviçit, Matkoviçi dëshmoi se nuk i kujtohej nëse Millutinoviçi kishte marrë pjesë në bisedë.²⁵²

134. Zllatomir Peshiqi, i cili në atë kohë ishte ndihmës për Logjistikën në Shtabin e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe më vonë u bë komandanti i Qarkut Ushtarak të Prishtinës, dëshmoi se mori pjesë në një mbledhje, mbase në maj apo qershor 1998, ku ishte Millutinoviçi si dhe përfaqësues të UJ-së, si Pavkoviçi, dhe të MPB-së, si Llukiqi. Ai u ftua në atë mbledhje nga Pavkoviçi për të përfaqësuar Komandën e Korpusit. Mbledhja u zhvillua në ndërtesën e MPB-së në Prishtinë. Qëllimi i saj ishte për të informuar Millutinoviçin mbi gjendjen në Kosovë, gjë që u bë

²⁴⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 93-96.

²⁴⁹ Spasoje Muçibabiç, T. 16578–16580 (28 shtator 2007); Miodrag Simiq, T. 15634–15635 (14 shtator 2007); Millovan Vllajkoviçi, T. 16093 (20 shtator 2007).

²⁵⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 578.

²⁵¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 167, 181.

²⁵² Dushko Matkoviçi, T. 14634–14638 (30 gusht 2007), P2913 (deklarata e dëshmitarit me datën 10 shkurt 2003), f. 9; Millan Gjakoviçi, T. 26410 (19 maj 2008); Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26622–26623 (8 korrik 2008). *Shih edhe* 4D100

nga Llukiqi.²⁵³ Sipas Peshiqit, duket se Millutinoviçi ishte i ftuar nga Llukiqi. Pavkoviçi dhe Peshiqi nuk folën gjatë mbledhjes. Pas informimit të Llukiqit, foli Millutinoviçi. Peshiqit nuk i kujtohej çfarë kishte thënë përveç faktit se çdo gjë kishte lidhje me gjendjen politike dhe të sigurisë në Serbi dhe ndikimin e saj në gjendjen në Kosovë.²⁵⁴ Mbrojtja e Millutinoviçit e pyeti Peshiqin për datën e mbledhjes dhe i sugjeroi se kishte ndodhur në fund të shtatorit 1998, pas vizitës së Millutinoviçit në Liqenin e Radoniqit. Peshiqi pranoi se mund të gabohej për datën.²⁵⁵ Duke marrë parasysh ngjashmëritë midis dëshmisë së Peshiqit të kësaj mbledhjeje dhe të Cvetiqit përmendur në paragrafin tjetër, Dhoma mendon se Peshiqi e kishte fjalën për mbledhjen e datës 23 shtator 1998.

135. Lubinko Cvetiqi, shefi i SPB-së së Mitrovicës në atë kohë, ishte i pranishëm në një mbledhje më 23 shtator 1998. Ai dëshmoi se në këtë mbledhje morën pjesë të gjithë shefet e SPB-ve dhe se Millutinoviçi tha se “terrorizmi në Kosovë është mposhtur, grupet terroriste janë shpartalluar dhe se në Kosovë janë krijuar rrethanat e domosdoshme për zgjidhjen e problemeve me mjete paqësore.” Ai tha gjithashtu se situata e sigurisë duhet të përmirësohet dhe se të gjithë duhet të përpiqen për të zgjidhur problemet në punën që bëjnë.²⁵⁶ Dhoma vëren se kjo mbledhje u mbajt në fund të operacioneve të ndërmarra nga UJ-ja dhe MPB-ja sipas Planit kundër Terrorizmit.

136. Millutinoviçi mori pjesë gjithashtu në një mbledhje të “Shtabit Operativ Ndërdikasterial për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë dhe në Metohi,” e cila u mbajt në Beli Dvor të Beogradit më 29 tetor 1998. Kjo mbledhje u kryesua nga Millosheviçi dhe në të morën pjesë Millutinoviçi, Shainoviçi, Pavkoviçi dhe Llukiqi, si dhe figura të tjera të rëndësishme si Perishiçi, Dimitrijeviçi, Samarxhiçi, Miniçi, Matkoviçi, Angjelkoviçi, Stojilkoviçi, Gjorgjeviçi, Markoviçi dhe Stevanoviçi.²⁵⁷ Megjithëse Dhoma nuk bindet se dokumenti i pranuar si provë materiale, që thuhet se është procesverbali i mbledhjes, është një pasqyrim i saktë i përmbajtjes së mbledhjes, nuk ka dyshim se mbledhja u zhvillua, se në atë morën pjesë figura të larta të qarqeve politike, të UJ-së dhe të MPB-së, dhe se gjatë mbledhjes u diskutua Plani kundër Terrorizmit.

137. Në fund të mbledhjes, Millosheviçi rekomandoi që Millutinoviçi të shkonte në Kosovë dhe të takohej me kryetarët e qarqeve dhe të komunave për t’u shpjeguar dispozitat e Marrëveshjes

(Raporti i PrK-së për Armatën e Tretë mbi angazhimin e njëjësive, 22 korrik 1998); 4D101 (Plani i PrK-së për angazhimin e njëjësive në Kosovë, 23 korrik 1998).

²⁵³ Zllatomir Peshiq, T. 7215–7216 (23 nëntor 2006), T. 7297–7298 (24 nëntor 2006), P2502 (deklarata e dëshmitarit me datën 30 janar 2004), para. 32. *Shih edhe* Zllatomir Peshiq, P2515 (fletinformacion plotësues), korrigjim paragrafit 32.

²⁵⁴ Zllatomir Peshiq, P2515 (fletinformacion plotësues), korrigjim paragrafit 32.

²⁵⁵ Zllatomir Peshiq, T. 7225–7227 (23 nëntor 2006); Dushko Dunjiq, T. 5286–5287 (25 tetor 2006), 6D99 (deklarata e dëshmitarit me datën 10 prill 2006), para. 37.

²⁵⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8189 (8 dhjetor 2006).

²⁵⁷ P2166 (Procesverbali i mbledhjes së Beli Dvorit, më 29 tetor 1998). *Shih edhe* Zoran Angjelkoviçi, T. 14712 (30 gusht 2007).

Holbrooke-Milloshëviq.²⁵⁸ Si pasojë, më 5 nëntor 1998, Millutinoviqi udhëtoi për në Kosovë me Ratko Markoviqin dhe u takua më figurat e politikës dhe të biznesit të atjeshëm, dhe më tej pati një mbledhje në ndërtesën e MPB-së në Prishtinë. Procesverbali i mbledhjes së dytë është pranuar si provë materiale dhe pasqyron çështje të trajtuara në mbledhjen e 29 tetorit. Sipas procesverbalit më 5 nëntor 1998, përveç Millutinoviqit, të pranishëm ishin edhe Shainoviqi, Llukiqi, Pavkoviqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi, Miroslav Mijatoviqi, Lubinko Cvetiqi, anëtarë të Grupit të Punës, shefat e SPB-ve dhe të Degëve të Brendshme (OUP), si dhe komandantet e njësive PJP.²⁵⁹ Llukiqi i informoi pjesëmarrësit për gjendjen në Kosovë në atë kohë dhe për gatishmërinë e forcave të MPB-së për të kryer detyrat e tyre të mëtejshme. Pas tij, Millutinoviqi foli për Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq dhe shpjegoi se ishte një fazë e vështirë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, megjithëse “forcat terroriste shqiptare” ishin “shpartalluar.”²⁶⁰ Millutinoviqi shpjegoi se kërcënimi i NATO-s nuk ishte më, se “lidhur me ushtrinë dhe policinë jugosllave, çdo gjë do të mbetet siç ka qenë deri tani (një komandë e përbashkët, njësitë e UJ-së nuk do të tërhiqen, forcat policore janë pakësuar vetëm në bazë të numrit të forcave tashmë të larguara). Nëse sulmohen, policia dhe ushtria kanë të drejtën të ndërhyjnë.”²⁶¹ Gjithashtu Millutinoviqi deklaroi:

Mendojmë se OSBE-ja do të dërgojë rreth 1.200 përfaqësues dhe se pas kësaj nuk do të ketë dyshim se çfarë po ndodh në Kosovë. Do të ketë provokime, por duhet të durojmë, edhe po të na duhen vite. Në këtë periudhë duhet të luajmë rolin e viktimës. Ka të dhëna se UÇK-ja po merr pozicionet e policisë dhe të ushtrisë jugosllave, dhe nëse ata kanë sukses atëherë kemi leje të veprojmë. ...

Të gjitha objektet dhe rrugët ushtarake duhen të mbrohen. Vazhdoni të planifikoni aktivitete me një angazhim dhe energji të pakursyer. Po të mos kishim bërë atë që bëmë, do të ishim në një gjendje politike shumë më të vështirë. Grupi i udhëhequr nga Clark-u tregoi mirëkuptim ndaj nesh dhe ka miratuar heshturazi operacionet tona kundër shqiptarëve, për aq kohë sa nuk bien në sy. Taktika dhe shkathësia jonë kanë lënë përshtypje në ta.”²⁶²

138. Gjatë intervistës me Prokurorinë në nëntor 2001, Millutinoviqi u pyet nëse kishte pasur takime me ministrin e Brendshëm. Ai u përgjigj se, përveç disa telefonatave të mundshme nuk e takoi, apo të paktën nuk i kujtohej ta kishte takuar. Për atë arsye, kërkoi që punonjësit e tij të nxirrin një pjesë nga ditari i punës ku ishin shënuar të gjitha takimet.²⁶³ Nga ditari dilte se ata të dy ishin takuar, por në mars 1998, siç duket, në lidhje me incidentin Jashari. Millutinoviqi mohoi se

²⁵⁸ P2166 (Procesverbali i mbledhjes së Beli Dvorit, më 29 tetor 1998), f. 14.

²⁵⁹ P2805 (Procesverbali i mbledhjes në Shtabin e MPB-së, 5 nëntor 1998). *Shih edhe* Ratko Markoviq, T. Lubinko Cvetiq, T. 8187–8189 (8 dhjetor 2006); Millomir Miniq, T. 14783–14785 (31 gusht 2007); Radovan Vuçureviq, T. 23187–23188 (25 shkurt 2008).

²⁶⁰ P2805 (Procesverbali i mbledhjes në Shtabin e MPB-së, 5 nëntor 1998), f. 3.

²⁶¹ P2805 (Procesverbali i mbledhjes në Shtabin e MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4.

²⁶² P2805 (Procesverbali i mbledhjes në Shtabin e MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4-5.

²⁶³ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 87–91.

kishte takuar ndonjë përfaqësues të Ministrisë së Brendshme gjatë bombardimit të NATO-s.²⁶⁴ Intervistuesit vunë në dukje një takim më 13 maj 1999. Millutinoviçi shpjegoi se ky takim ishte pjesë e një tradite 50-vjeçare të festimit në Presidencë të datës 13 maj si dita e sigurimit. Sipas Millutinoviçi, gjatë festimit nuk u diskutua për çështje të sigurisë.²⁶⁵ Millutinoviçi shpjegoi gjithashtu se, pas incidentit Jashari në vitin 1998, punonjësit e Ministrisë së Brendshme zakonisht e kishin shmangur.²⁶⁶

139. Më pas Millutinoviçi u pyet nëse kishte takuar ndonjëherë Radomir Markoviçin, shefin e RDB-së. Ai u përgjigj se e kishte takuar Markoviçin, por rrallë, dhe kurrë gjatë bombardimit të NATO-s. Mirëpo, ai pranoi se mund t'i kishin telefonuar njëri-tjetrit gjatë bombardimit.²⁶⁷ Përsa i përket takimeve me Sreten Llukiqin gjatë bombardimit të NATO-s, Millutinoviçi tha se ata takoheshin kur shkonte në Prishtinë. Kjo ndodhi edhe para bombardimit të NATO-s, edhe një herë gjatë bombardimit kur Millutinoviçi ishte atje për një takim me Ibrahim Rugovën.²⁶⁸ Së fundi, Millutinoviçi u pyet nëse i kujtohej të kishte takuar Llukiqin dhe Ojdaniqin në zyrën e tij më 4 maj 1999. Ai u përgjigj se nuk i kujtohej një takim i tillë.²⁶⁹

140. Mirëpo, më 4 maj 1999 u zhvillua një mbledhje, por në vilën e Millosheviçit ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në Kosovë.²⁷⁰ Raportet e mediave për takimin përcaktojnë se në mbledhje morën pjesë Millosheviçi, Millutinoviçi, Ojdaniçi, Pavkoviçi, Llukiqi dhe të tjerë. I pyetur për përmbajtjen e një lajmi në shtyp, Millovan Vllajkoviçi, shefi i kabinetit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë deklaroi se kishte dëgjuar për mbledhjen dhe mendonte se Ojdaniçi kishte marrë pjesë në të.²⁷¹ Lubisha Stojimiroviçi, shefi i Shtabit të Armatës së Tretë, dëshmoi se, në fillim të majit, Llukiqi dhe Pavkoviçi shkuan për të takuar Millosheviçin.²⁷² Për më tepër, Llukiqi lëshoi një urdhër që varësit e tij të lexonin një artikull në gazetën *Politika* dhe të zbatonin udhëzimet e atjeshme, gjë që tregon se përmbajtja e artikullit u pranua nga autoritetet

²⁶⁴ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 100-101.

²⁶⁵ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 178-181.

²⁶⁶ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 181-182.

²⁶⁷ Lidhur me takimet para bombardimit, në ato u trajtua çështja e sigurimit të Millutinoviçit që rezultoi në një mosmarrëveshje të madhe se kush do ta mbronte, policia e rregullt apo siguri i shtetit. Mosmarrëveshja ndodhi sepse ai refuzoi të mbrohej nga siguri i shtetit. *Shih* P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 158-160.

²⁶⁸ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 184-186.

²⁶⁹ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 186-187.

²⁷⁰ P1696 ("Krerët e ushtrisë dhe të policisë informojnë Millosheviçin për mbrojtjen e suksesshme," Raporti i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1. 4D406 ("Gjendja e Sigurisë në Kosovë", Artikull i gazetës *Politika*, 6 maj 1999). Dokumenti u kundërshtua. T. 16105–16106 (21 shtator 2007); T. 22547 (15 shkurt 2008). Mirëpo, u vërtetua nga 5D1289 (Raporti i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999). *Shih edhe* Dushan Gavranic, T. 22722 (19 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24188 (12 mars 2008).

²⁷¹ Millovan Vllajkoviçi, T. 16081–16082 (20 shtator 2007).

²⁷² Lubisha Stojimiroviçi, T. 17684 (26 tetor 2007).

serbe.²⁷³ Deklarata të Shainoviqit në mbledhjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën më 7 maj konfirmojnë saktësinë e lajmeve të shtypit. Shainoviqi deklaroi se Presidenti i RFJ-së dhe Presidenti serb kishin dëgjuar raporte nga Pavkoviqi dhe Llukiqi, dhe teksti i një deklaratë ishte bërë publik dhe u duhej shpërndarë të gjithë komandantëve të policisë.²⁷⁴

141. Dhoma bindet se gjatë mbledhjes së 4 majit u diskutua për gjendjen e sigurisë në Kosovë, u përmendën struktura të krijuara për të ndihmuar “të gjithë qytetarë të ktheheshin në shtëpi” pas mbarimit të luftimeve, dhe u raportua se gjatë luftimeve të ashpra me UÇK-në, forcat e sigurisë të UJ-së kishin trajtuar shumë raste të dhunës, vrasjeve, plaçkitjeve dhe të krimeve të tjera dhe kishin arrestuar disa qindra keqbërës, krimet e të cilëve përbënin një rrezik të madh për popullatën civile. Gjatë mbledhjes u konkludua se puna e gjykatave ushtarake kishte bërë që ngjarje të tilla të bëheshin “të pamundura” në të ardhmen duke qenë se ishin proceduar shumë raste të krimeve kundër popullatës civile dhe se për këto krime ishin dhënë “një numër i madh” dënimesh prej pesë deri 20 vjet burg.²⁷⁵ Mirëpo këto deklaratë të raportuara nga mbledhja nuk përputhen me raporte të ndryshme të punës së gjykatave ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Asnjë raport nuk tregon se gjykatat ushtarake dhanë vendime nga 5 deri në 20 vjet burgim për krime kundër civilëve deri më 4 maj 1999.²⁷⁶ Dhoma nuk mori asnjë provë që vërtetonte se Millutinoviqi dinte se ky informacion ishte i pasaktë.

142. Dhoma vë në dukje se provat tregojnë për pak mbledhje ku ishte i pranishëm Millutinoviqi. Lidhur me kontributin e Millutinoviqit në ato mbledhje, bie në sy se Matkoviçit nuk i kujtohej nëse Millutinoviqi kishte marrë pjesë në diskutimet e mbledhjes së datës 21 korrik. Gjithashtu, kur dëshmoi për mbledhjen e datës 23 shtator 1998, Peshiqit nuk i kujtohej asnjë hollësi për diskutimin e Millutinoviqit. Cvetiqi, i cili ishte i pranishëm në mbledhjen e datës 23 shtator, mbante mend vetëm se Millutinoviqi foli për fundin e “terrorizmit në Kosovë” dhe përmendi një zgjidhje paqësore të problemave. Duket se rasti i vetëm ku Millutinoviqi ofroi kontribut të konsiderueshëm ishte në mbledhjen e 5 nëntorit në ndërtesën e Shtabit të MPB-së. Kontributi i tij konsistoi në

²⁷³ 5D1289 (Raporti i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999), gjithashtu pranuar si P2159.

²⁷⁴ P1996 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 4; Miroslav Mijatoviq, T. 22286–22289 (13 shkurt 2008).

²⁷⁵ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe të policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme,” Raporti i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1-2.

²⁷⁶ P1912 (Raporti i Armatës së Tretë për çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raporti i ecurisë së punës nga Zyrat e Prokurorisë dhe gjykatat ushtarake, 30 prill 1999); P1182 (Informacion nga PrK-ja dërguar Brigadës 52 të Raketave Artilerike, 15 maj 1999); 3D986 (Raporti i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për çështje penale, 6 shtator 1999); P962 (Raporti i Brigadës së Motorizuar 549 për çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, maj 1998–korrik 1999); P830 (Raport mbi proceset penale të nisura nga organet e drejtësisë ushtarake, 9 prill 2002); P954 (Raport për çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001); P955 (Përmbledhja e Raportit për çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake); P845 (Raport për çështje penale në gjykata ushtarake mbi dhunën seksuale, 10 shtator 2002).

shpjegimin e dispozitave të Marrëveshjeve të Tetorit, duke theksuar raportet mbi fuqizimin e UÇK-së, iu përgjigj shqetësimeve të zyrtarëve vendas të MPB-së lidhur me këtë aspekt, duke nënvizuar vazhdimësinë e së drejtës së vetëmbrojtjes, dhe në fund, i inkurajoi të vazhdonin me planifikimin, dhe mbrojtjen e rrugëve dhe të objekteve të tjera.

143. Mirëpo, të gjitha këto dëshmi, më shumë se rolin e rëndësishëm të Millutinoviçi gjatë këtyre mbledhjeve, tregojnë se kontributi i tij u përqendrua ose në Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq ose fjalë të përgjithshme për ngritjen e moralit, për të davaritur shqetësimet e zyrtarëve përgjegjës për Kosovën.

b. Marrëdhëniet e Millutinoviçi me qeverinë serbe

144. Prokuroria pretendon se Millutinoviçi si Presidenti i Serbisë, kishte disa kompetenca që mund t'i kishte shfrytëzuar për ta bërë "shumë më të vështirë" kryerjen 'e krimeve të akuzuara'. Nëpërmjet këtij mosveprimi të qëllimshëm, me gjithë dijeninë e tij për krimet e kryera nga UJ-ja dhe nga MPB-ja, ai ndihmoi në planin e ndryshimit të përbërjes etnike të krahinës për të siguruar kontrollin mbi të.²⁷⁷ Në këtë kontekst, Prokuroria përmend betimin presidencial i cili, sipas nenit 86 të Kushtetutës serbe, e detyron Presidentin të mbrojë sovranitetin dhe territorin e Serbisë dhe të ruajë paqen dhe mirëqenien e tërë qytetarëve të Serbisë.²⁷⁸ Për më tepër, Prokuroria citon edhe kompetencën e Presidentit sipas nenit 85 të Kushtetutës serbe për të kërkuar raporte nga qeveria e Serbisë mbi çështje të ndryshme brenda kompetencës së saj, p.sh mbi punën e organeve të saj; dhe, sipas nenit 9 të Ligjit mbi Punët e Brendshme, një kompetencë tjetër të ngjashme që lidhet konkretisht me MPB-në.²⁷⁹ Prokuroria pretendon gjithashtu se në maj 1999 Millutinoviçi përdori kompetencat presidenciale për ngritjen në detyrë të Llukiqin duke e "fuqizuar" dhe inkurajuar.²⁸⁰

145. Nga ana e saj, Mbrojtja e Millutinoviçi argumenton se kompetenca kushtetuese e nenit 85 nuk kishte kuptim sepse Presidenti i Serbisë nuk mund të urdhëronte qeverinë që të hartonte një raport të tillë; ai vetëm mund të bënte kërkesë dhe, pas marrjes së raportit, ai nuk mund të detyronte qeverinë që të ndryshonte mendimin e saj. Lidhur me nenin 9 të Ligjit mbi Punët e Brendshme, Mbrojtja e Millutinoviçi argumenton se ai nuk përputhej me Kushtetutën sepse, sipas nenit 83(12) të Kushtetutës serbe, të gjitha kompetencat e Presidentit përcaktoheshin nga Kushtetuta dhe jo nga ligjet e zakonshme. Ajo argumenton gjithashtu se Presidenti nuk mund të vepronte në mënyrë të

²⁷⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 8, 599.

²⁷⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 608.

²⁷⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 610, shënim 1618.

²⁸⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 575-576.

pavarur, por i duhej të bënte kërkesa të tilla në bashkëveprim me Kuvendin Kombëtar.²⁸¹ Dhoma tashmë ka konkluduar se kjo është e vërtetë dhe se duhej një kërkesë e përbashkët.²⁸²

146. Mbrojtja e Millutinoviqi argumenton gjithashtu se ngritja në detyrë e Llukiqit u krye sipas nenit 6 të Ligjit mbi Gradat e Anëtarëve të MPB-së dhe ishte thjesht një formalitet në emër të Presidentit të Serbisë, i ngjashëm me detyrën e tij për shpalljen e ligjeve të miratuara nga Kuvendi Kombëtar. Për më tepër, Mbrojtja shpreh mendimin se personat e ngritur në detyrë nga Presidenti nuk varen prej tij në punë. Së fundi, theksohet se në vitin 2003, Gjykata Kushtetuese serbe shfuqizoi nenin 6 sepse ky nen kishte zgjeruar kompetencat kushtetuese të Presidentit.²⁸³

147. Dhoma kujton këtu përfundimin e saj se kompetencat dhe përgjegjësitë e Presidentit të Serbisë në lidhje me ministrinë dhe organet e qeverisë, përfshirë Ministrinë e Brendshme, ofronin mundësinë e një kontrolli të konsiderueshëm mbi këto organe. Mirëpo, siç u tha më herët, masa e përdorimit të plotë të tyre varej nga personi që mbante postin.²⁸⁴

i. Incidenti Jashari në mars 1998

148. Sipas Prokurorisë, Millutinoviqi ishte në dijeni të kompetencave që kishte sipas Kushtetutës dhe Ligjit mbi Punë të Brendshme, madje i shfrytëzoi në mars 1998 pas incidentit Jashari, kur kontaktoi Ministrinë e Brendshme dhe mori një informacion të shkurtër për incidentin nga punonjësit e tij.²⁸⁵ Kjo u konfirmua pjesërisht nga Jovan Kojiqi, i cili ishte nëpunës në Kabinetin e Presidentit gjatë periudhës në fjalë. Ai dëshmoi e informoi Millutinoviqin personalisht për incidentin Jashari pasi kishte parë lajmet në *Sky News*. Sipas Kojiqit, Millutinoviqi u habit dhe, siç duket, nuk ishte në dijeni për aksionin apo zhvillimet në terren.²⁸⁶ Më tej, Millutinoviqi e udhëzoi Kojiqin që t'i telefononte ministrin të Brendshëm, Stojilkoviq. Kojiqi telefoni, por nuk arriti të fliste me ministrin dhe i la një mesazh Stojilkoviqit që ai të telefononte Kabinetin e Presidentit. Me gjithë telefonatat e përsëritura gjatë dy ditëve që vijuan, Stojilkoviqi nuk u përgjigj kurrë, gjë që e mërziti Millutinoviqin. Atëherë Millutinoviqi i shkroi Stojilkoviqit, por nuk mori përgjigje.²⁸⁷ I pyetur nëse Millutinoviqi bëri diçka dhe se çfarë bëri për t'u ballafaquar me sjelljen e Stojilkoviqit, Kojiqi tha se nuk dinte gjë për ndonjë veprim të mëtejshëm në këtë punë.²⁸⁸ Atij iu tregua një

²⁸¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 28-38.

²⁸² *Shih* Kapitullin IV.

²⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 55-61.

²⁸⁴ *Shih* Kapitullin IV.

²⁸⁵ P604 (intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 54-55.

²⁸⁶ Jovan Kojiq, T. 13725-13726 (15 gusht 2007), 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 17.

²⁸⁷ Jovan Kojiq, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 18.

²⁸⁸ Jovan Kojiq, T. 13728-13729 (15 gusht 2007).

deklaratë e lëshuar nga Ministria e Informacionit pas incidentit dhe bëri të ditur se, duke parë shënimet e bëra nga Millutinoviçi dhe nga vetë Kojiçi, ajo mund të ishte e daktilografuar në Kabinetin e Presidentit. Në deklaratë përmendej raporti paraprak i Ministrisë së Brendshme, ku përshkruhej incidenti dhe vihej në dukje se po kryhej një hetim për pretendimet se forcat e RFJ-së/Serbisë kishin përdorur forcë të tepruar.²⁸⁹

149. Gjatë fazës së pyetjeve nga pala tjetër, Kojiçi u pyet për intervistën e Prokurorisë me Millutinoviçin gjatë të cilës ai tha se faktikisht e kishte takuar ministrin Stojilkoviçi për incidentin Jashari.²⁹⁰ Kojiçi u përgjigj se, pas dërgimit të letrës, Stojilkoviçi nuk erdhi në Presidencë për një kohë të gjatë. Kur më në fund erdhi, Kojiçi nuk dinte gjë për temën e bisedës midis të dyve. I pyetur nëse Stojilkoviçi e vizitonte Millutinoviçin rregullisht, Kojiçi u përgjigj se vizita të tilla ishin tepër të rralla.²⁹¹

150. Kjo dëshmi përputhet me dëshminë e Ratko Markoviçit, ekspert i së drejtës kushtetuese, i cili dëshmoi se oficerët e MPB-së me gradën e gjeneralit nuk i jepnin llogari Presidentit për punën e tyre, por se ishin përgjegjës vetëm para ministrit të Brendshëm apo qeverisë.²⁹²

ii. Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviçi

151. Qeveria serbe mbledhje çdo të enjten për diskutime, e më pas nxirrte vendime.²⁹³ Provat sugjerojnë se Millutinoviçi mori pjesë rrallë në këto mbledhje dhe vetëm kur diskutohej për çështje të rëndësishme. Disa dëshmitarë përmendën konkretisht një mbledhje kur u diskutua për Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviçi.²⁹⁴ Pas mbledhjes, Millutinoviçi lëshoi një deklaratë shtypi ku bëri të ditur se ai kishte informuar qeverinë për kushtet e Marrëveshjes dhe për atmosferën e përgjithshme të negociatave. Deklarata e shtypit përmendte gjithashtu 11 parimet e miratuar nga Milloshëviçi dhe Holbrooke-u. Gjithashtu publiku u informua se qeveria mbështeti Marrëveshjen në tërësi dhe se gjithashtu do t'i propozonte qeverisë së RFJ-së që t'a miratonte.²⁹⁵

²⁸⁹ Jovan Kojiçi, T. 13734–13736 (16 gusht 2007); 1D553 (Deklaratë Shtypi e MPB-së, 11 mars 1998); IC137 (1D553 shënuar nga Kojiçi për të treguar shkrimin e Millutinoviçit).

²⁹⁰ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), f. 54-55, 100-101.

²⁹¹ Jovan Kojiçi, T. 13751–13755 (16 gusht 2007).

²⁹² Ratko Markoviçi, T. 12942–12948 (6 gusht 2007), T. 12965–12967, 12996–12998 (7 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.40; 1D639 (vendimi i Gjykatës Kushtetuese).

²⁹³ Momir Bullatoviçi, T. 13838–13839 (16 gusht 2007); Andreja Millosavleviçi, T. 14310–14311 (23 gusht 2007).

²⁹⁴ Jovan Kojiçi, T. 13748–13750 (16 gusht 2007); Andreja Millosavleviçi, T. 14312–14313 (23 gusht 2007); Zhivota Qosiçi, T. 13698–13706 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 7, 41. *Shih gjithashtu* 1D204 (Miratimi prej qeverisë së Serbisë i Marrëveshjes midis Richard Holbrooke-ut dhe Slobodan Millosheviçit, 14 tetor 1998), f. 2.

²⁹⁵ 1D601 (Deklarata e shtypit e Millan Millutinoviçit, 13 tetor 1998), pranuar gjithashtu si 2D354.

iii. Kompetenca e Millutinoviçit për gradimin e zyrtarëve të MPB-së

152. Dhoma tashmë ka arritur në përfundimin se Presidenti mund të dekretonte gradimin e një zyrtari me gradë koloneli (apo me lart) në gradën e gjeneralit (apo më lart), por gjithashtu pranoi se ishte vetëm formalitet sepse kandidatët përkatës duhej të plotësonin kushtet e parashikuara në dispozitat e tjera të Ligjit mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme dhe duhej të rekomandoheshin nga ministri i Brendshëm.²⁹⁶

153. Dëshmia e Jovan Kojiçit konfirmon sa më sipër. Ai dëshmoi se procedura normale për gradimin në MPB konsistonte në rekomandime të ministrit të Brendshëm që thjesht kopjoheshin në një shkresë të nënshkruar nga Millutinoviçi.²⁹⁷ Millutinoviçi vetë e konfirmoi këtë fakt kur tha se, gjatë bombardimit, ai lëshoi një urdhëresë për gradimin e Llukiqit, por nguli këmbë se gradimi u bë me rekomandimin e ministrit të MPB-së.²⁹⁸ Dhoma disponon si provë një letër rekomandimi nga ministri i MPB-së dërguar Millutinoviçit më 11 maj 1999, në të cilën i pari rekomandon që Llukiqi të gradohej gjenerallejtënant.²⁹⁹ Prokuroria nuk ofroi asnjë provë për të kundërshtuar dëshminë se roli i Presidenti ishte thjesht formal.

iv. Kontakte të tjera me qeverinë

154. Zhivota Qosiqi, i cili ishte ministër i Minierave dhe Energjetikës dhe mik i ngushtë i Millutinoviçit gjatë periudhës së Aktakuzës,³⁰⁰ dëshmoi për kontaktet e Millutinoviçit me qeverinë serbe. Në vitin 1998, Qosiqi shkoi në Kosovë bashkë me Mirko Marjanoviçin, Kryeministri serb, për të vizituar fabrika në Kosovë dhe për të shqyrtuar ankesat e punëtorëve për rrëmbimet dhe vrasjet prej UÇK-së.³⁰¹ Ai nuk kishte ndonjë detyrim ndaj Millutinoviçit dhe i jepte llogari vetëm Marjanoviçit, i cili ishte i vetmi njeri që kishte të drejtën t'i jepte detyra.³⁰² Mirëpo, duke qenë se Millutinoviçi u interesua për çështje konkrete me interes publik, siç ishte për shembull furnizimi i pandërprerë i energjisë elektrike, Qosiqi e informoi Millutinoviçin për këto aspekte.³⁰³

155. Pas fillimit të fushatës së NATO-s, në prani të Shainoviçit, Marjanoviçi i ngarkoi Qosiqit detyrën e organizimit dhe të zhvendosjes së lëndëve të rrezikshme në Serbi. Nga ana e tij, Qosiqi

²⁹⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.32–3.36; P1015 (Ligji mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme), neni 6(1).

²⁹⁷ Jovan Kojiç, T. 13747–13748 (16 gusht 2007); 1D722 (Sugjerimi dhe urdhëresa e mëpasme e Stojilkoviçit për gradime)

²⁹⁸ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 184–186.

²⁹⁹ 1D680 (Rekomandimi për gradimin e Sreten Llukiqit gjenerallejtënant, 11 maj 1999).

³⁰⁰ Zhivota Qosiq, T. 13661 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 3.

³⁰¹ Zhivota Qosiq, 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 5–6.

³⁰² Zhivota Qosiq, T. 13669–13670, 13712–13714 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 8.

kërkoj ndihmë nga Shainoviçi, i cili në atë kohë ishte Kryetari i Komitetit për Lëndët Bërthamore dhe Lëndë të Tjera të Para.³⁰⁴ Sipas Qosiqit, Millutinoviçi pyeste vazhdimisht për zhvillimet në këtë operacion. Ai merrte kopje të raporteve të rëndësishme që i dërgoheshin përditë Kryeministrit. Përveç kësaj, çdo dy-tri ditë, Qosiqi i telefononte Millutinoviçit për ta informuar për aktivitetet e tij.³⁰⁵ Më 7 prill 1999, Qosiqi dhe zëvendëskryeministri Dragomir Tomiq u takuan me Millutinoviçin për të gjetur një zgjidhje për zhvendosjen e acidit klorhidrik nga një fabrikë afër Beogradit në një vend më të sigurt, dhe pastaj asgjësimin e tij. Sipas Qosiqit, ai kontaktoi Millutinoviçin sepse e dinte që “Presidenti Millutinoviç ka ndikim.”³⁰⁶ Kjo u arrit nga fundi i prillit 1999.³⁰⁷

156. Një problem tjetër që Millutinoviçi e ndoqi nga afër ishte shkatërrimi i sistemit dhe i impianteve të energjisë elektrike të goditura nga NATO-ja në fund të prillit 1999. Sipas Qosiqit, Millutinoviçi vazhdimisht u telefononte Tomiqit, Qosiqit dhe të tjerëve në industrinë elektrike, dhe pyeste për gjendjen e furnizimit të energjisë elektrike dhe të lidhjeve telefonike. Nga mesi i majit, furnizimi me energjisë elektrike ishte bërë problem i madh dhe më 24 maj 1999, Qosiqi dhe drejtori i Ndërmarrjes serbe të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike u takuan me Millutinoviçin për t’i shpjeguar për gjendjen e furnizimit.³⁰⁸ Sipas Qosiqit, qëllimi i takimit ishte për të informuar Presidentin për ndërprerjet e energjisë elektrike sepse ato krijojnë probleme për të gjithë qytetarët e Serbisë. Përveç kësaj, ata hartuan një listë përparësish të furnizimit me energji në të cilën u shënuan industritë të cilave do t’u jepej përparësi.³⁰⁹

157. Gjatë fazës së pyetjeve nga Prokuroria, Qosiqi u pyet për kompetencat e Millutinoviçit për të kërkuar një raport nga Qeveria, por mohoi njohuri për dispozitat ligjore të lidhura me atë. Mirëpo, pranoi se Presidenti i Serbisë duhet të ishte informuar për punën e Qeverisë nëpërmjet kontakteve të tij me Kryeministrin.³¹⁰ Gjithashtu ai konfirmoi se kishte takuar Millutinoviçin më shumë se dy herë gjatë fushatës së NATO-s.³¹¹ I pyetur se çfarë opsione mund të kishte pasur Millutinoviçi nëse Qosiqi nuk do të kishte kryer detyrat e tij në mënyrë të duhur, Qosiqi u përgjigj

³⁰³ Zhivota Qosiq, 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 9.

³⁰⁴ Zhivota Qosiq, T. 13664–13668, 13681 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 10-18.

³⁰⁵ Zhivota Qosiq, T. 13668-13669, 13690-13692 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 19; 1D706 (Raporti mbi Lëndët e Rrezikshëm, 11 maj 1999).

³⁰⁶ Zhivota Qosiq, T. 13665 (15 gusht 2007).

³⁰⁷ Zhivota Qosiq, 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para 21-22.

³⁰⁸ Zhivota Qosiq, T. 13671-13674 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para 23-27.

³⁰⁹ Zhivota Qosiq, T. 13672-13673 (15 gusht 2007).

³¹⁰ Zhivota Qosiq, T. 13686-13687 (15 gusht 2007).

³¹¹ Zhivota Qosiq, T. 13686-13687 (15 gusht 2007).

se Millutinoviqi mund të kërkonte nga Kryeministri që ai ta largonte, por edhe të tjerët mund të bënin këtë.³¹²

158. Nëpërmjet Qosiqit, Mbrojtja dorëzoi në gjyq një letër dërguar Millutinoviqit më 29 prill 1999 nga ministri i Brendshëm, ku pasqyrohej masa e shkatërrimit të shkaktuar nga NATO-ja.³¹³ I pyetur nga Prokuroria për këtë letër, Qosiqi tha se nuk dinte se sa shpesh merrte Millutinoviqi këtë lloj informacioni, por mendonte se qeveria merrte raporte thuajse të përditshme për masën e shkatërrimit të shkaktuar nga NATO-ja.³¹⁴

v. Përfundim

159. Provat e lartpërmendura tregojnë se, në disa çështje si çështja e lëndëve të rrezikshme apo çështja e Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq, Millutinoviqi kishte kompetencë për të bashkëpunuar me anëtarë të ndryshëm të qeverisë dhe në këtë aspekt luajti një rol aktiv. Mirëpo, provat tregojnë gjithashtu se në fillim të vitit 1998, pas incidentit Jashari, përpjekjet e Millutinoviqit për të ushtruar kontroll mbi Vllajko Stojilkoviqin dhe për të marrë informacion për incidentin dolën të pasuksesshme. Në fakt, deklarata e shtypit e lëshuar siç duket nga Kabineti i tij u bazua kryesisht mbi raportin e MPB-së për ngjarjen, si dhe mbi faktin se po zhvilloheshin hetime te mëtejshme. Kjo përputhet me provat e marra nga Dhoma se gjeneralët e MPB-së nuk ishin të detyruar t'i raportonin Presidentit të Serbisë si dhe me provat se, megjithëse ministri i Brendshëm formalisht ishte përgjegjës për RDB-në dhe RJB-në, praktikisht ishte Sllobodan Millosheviqi që i drejtoi dhe kontrolloi të dy organet.³¹⁵ Dhoma pranon gjithashtu se gradimi i Llukiqit ishte një formalitet që konkretizoi rekomandimin e ministrit të Brendshëm.

160. Rrjedhimisht, të marra në tërësi provat nuk vërtetojnë kontakte të shumta të Millutinoviqit me qeverinë serbe, dhe në veçanti me MPB-në. Si pasojë konfirmohet pjesërisht dëshmia e Ratko Markoviqit, e përshkruar në Kapitullin IV, se Presidenti i Serbisë nuk kishte kompetenca të gjera ekzekutive. Kompetencat *de jure* të Presidentit mbi MPB-në nuk ishin të gjera dhe provat e paraqitura nuk tregojnë se Millutinoviqi kishte kompetenca të konsiderueshme *de facto*.

c. Kompetenca dekretuese e Millutinoviqit

³¹² Zhivota Qosiq, T. 13708, 13714-13715 (15 gusht 2007).

³¹³ 1D705 (Letër nga Stojilkoviqi Millutinoviqit, 29 prill 1999).

³¹⁴ Zhivota Qosiq, T. 13692-13694 (15 gusht 2007), 1D738 (deklarata e dëshmitarit me datën 29 qershor 2007), para. 38.

³¹⁵ Ratimir Taniq, T. 6406-6407 (13 nëntor 2006); Aleksandar Vasileviq, T. 9001 (23 janar 2007).

161. Dhoma kujton përfundimin e saj të mëparshme se, përse i përket miratimit të ligjeve në kohë paqeje, roli i Presidentit ishte thjesht dekretimi i ligjeve të miratuara nga Kuvendi Kombëtar. Jovan Kojiqi dëshmoi për procedurën e Presidencës lidhur me dekretimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi Kombëtar. Ai tha se këto ligje merreshin nga Sekretari i Kuvendit Kombëtar dhe nënshkruheshin nga Millutinoviqi pa u ndryshuar asnjë fjalë.³¹⁶ Siç u diskutua më herët, në përputhje me nenin 83 (7) të Kushtetutës serbe, Presidenti i Serbisë, mund të miratonte dekrete për çështje brenda kompetencave të Kuvendit Kombëtar në gjendje të jashtëzakonshme. Ai mund të bënte këtë me iniciativën e vetë ose me propozimin e qeverisë serbe, por vetëm gjatë gjendjes së luftës ose të rrezikut të luftës së menjëhershme. Pas datës 23 mars 1999, Millutinoviqi miratoi 16 dekrete të tilla³¹⁷ të cilat me mbarimin e gjendjes së luftës, iu dorëzuan Kuvendit Kombëtar për ratifikim. Të gjitha dekretet u ratifikuan, por menjëherë pas kësaj u shfuqizuan nga Kuvendi duke qenë se u konsideruan të panevojshme në kohë paqeje.³¹⁸

162. Prokuroria pretendon se Millutinoviqi shfrytëzoi kompetencën e tij dekretuese në mbështetje të qëllimit kriminal për të ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës, në veçanti Dekretin mbi Letërnjoftime Gjatë Gjendjes së Luftës (“Dekreti i Letërnjoftimeve”) dhe Dekretin mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës (“Dekreti i Vendbanimit”).³¹⁹ Prokuroria argumenton si vijon:

Nga 16 dekretet e lëshuara nga Millutinoviqi gjatë gjendjes së luftës, dy në veçanti synonin të ndihmonin në realizimin e qëllimit [të ndërmarrjes së përbashkët kriminale]

³¹⁶ Jovan Kojiq, T. 13742–13743 (16 gusht 2007).

³¹⁷ Të 16 dekretet janë: P993 (Dekreti mbi Punët e Brendshme gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999; Dekret mbi Grumbullimin e Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999; Dekret mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999; Dekret mbi Letërnjoftime gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999); 1D158 (Dekreti mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 19 prill 1999); 1D161 (Dekret mbi Buxhetin e Shpenzimeve Publike të Republikës së Serbisë për prillin, majin dhe qershorin 1999 dhe Masa për Mostejkalimin e Buxhetit Gjatë Gjendjes së Luftës, 22 prill 1999); 1D163 (Dekret mbi Fondin e Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht të Papunë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 23 prill 1999); 1D166 (Dekret mbi Punësimin dhe Kompensimet Paguar Punonjësve në Firmat, Ndërtesat, Mjetet e Prodhimit dhe Pajisje të cilat u Shkatërruan gjatë Operacioneve Luftarake, 23 prill 1999); 1D169 (Dekret mbi Pagesën e Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Shoqëror për Punonjësit në Ndërmarrje të Caktuara, 15 maj 1999); 1D172 (Dekret mbi Tregtinë në Mallra, Shërbime dhe Inspektim gjatë Gjendjes së Luftës, 21 maj 1999); 1D175 (Dekret mbi Raportin e Buxhetit Vjetor për 1998 të Republikës së Serbisë, 21 maj 1999); 1D178 (Dekret mbi Raportin Përfundimtar të Buxhetit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë për Vitin 1998, 21 maj 1999); 1D181 (Dekret mbi Kushtet e Posaçme të Organizimit të Lojërave të Fatit në Kohë Luftë, 29 maj 1999); 1D187 (Dekret mbi Ndryshimet e Dekretit mbi Livrimin e Fondeve të Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht të Papunë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 9 qershor 1999); 1D189 (Dekret mbi Përbërjen e Qeverisë, 15 qershor 1999); dhe 1D478 (Dekreti që ndryshon Dekretin mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 4 qershor 1999).

³¹⁸ Ratko Markoviq, T. 12925–12931 (6 gusht 2007), T. 13243–13261 (9 gusht 2007); 1D682 (Ekspertiza e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Postin e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.29; 1D190 (Letër e Millutinoviqit drejtuar Kryetarit të Kuvendit Kombëtar Lidhur me Verifikimin e Dekreteve të Nënshkuara Gjatë Gjendjes së Luftës, 25 qershor 1999); 1D192 (Ligji i Cili Konfirmon Dekretet e Miratuara nga Presidenti i Republikës Gjatë Gjendjes së Luftës). *Shih gjithashtu* P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 93–100.

³¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 615.

për të ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës: Dekreti mbi Letërnjoftimet Gjatë Gjendjes së Luftës dhe Dekretin mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës. ... Dekretin mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës vendosi kushte të pamundshme për shqiptarët kosovarë që u dëbuan. Ai detyroi të gjithë personat mbi moshën 14 vjeç të regjistrinin ndryshimin e vendbanimit të përhershëm brenda 24 orësh dhe të vendbanimin aktual brenda 12 orësh, dhe regjistrimi i vendbanimit të përhershëm ose aktual duhej të bëhej menjëherë para largimit.³²⁰

Gjithashtu, Prokuroria pretendon se ai nuk shfrytëzoi nenin 83 (7) për të ndërhyrë në operacionet e MPB-së me qëllim që të parandalonte ose pengonte kryerjen e krimeve.³²¹

163. Nga ana e saj, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se Millutinoviçi nuk e përdori kompetencën e tij dekretuese në mbështetje të krimeve të akuzuara, dhe se nuk kishte asnjë qëllim të keq në 16 dekretet e lëshuara nga Millutinoviçi gjatë gjendjes së luftës.³²² Më tej Dhoma do të analizojë 16 dekretet në fjalë, duke filluar me dy dekretet që sipas Prokurorisë synonin të mbështesnin qëllimin e ndërmarrjes kriminale.

164. Neni 2 i Dekretit mbi Letërnjoftimet i detyronte të gjithë personat mbi moshën 13 vjeç që të pajiseshin me letërnjoftim. Sipas nenit 3, në rast të humbjes së letërnjoftimit, personi në fjalë duhej t'i raportonte MPB-së për humbjen e dokumentit brenda 24 orësh.³²³ Markoviçi shpjegoi se Dekreti i Letërnjoftimeve ndryshoi Ligjin e mëparshëm për Letërnjoftime, së pari duke ulur moshën e personave që duheshin pajisur me letërnjoftim nga 18 në 14 dhe se dyti duke shkurtuar afatin e raportimit të humbjes së letërnjoftimit nga 15 ditë në 24 orë.³²⁴ Rregullat e reja zbatoheshin njësoj për meshkuj dhe femra kudo në Republikën e Serbisë.³²⁵ Në lidhje me argumentin se Dekreti mbi Letërnjoftimet dhe ai mbi Vendbanimin nuk përmbanin asnjë qëllim të keq, Mbrojtja e Millutinoviçit i citoi Dhomës edhe Ligjin Federal mbi Shtetësinë i vitit 1996 i cili përcaktonte se gjatë gjendjes së luftës, gjatë rrezikut të luftës së afërt, apo gjatë gjendjes së jashtëzakonshme nuk miratohej asnjë heqje e shtetësisë.³²⁶ Rrjedhimisht, shqiptarët kosovarë të cilët u detyruan t'i dorëzonin dokumentet e identitetit, jo domosdoshmërisht humbën edhe shtetësinë.

165. Dhoma pyeti Petar Dujkoviçin, i cili ishte shefi i administratës së policisë kufitare në MPB në atë kohë, për shkaqet e ndryshimit të këtij ligji. Ai shpjegoi se udhëzimet që mori përcaktuan se

³²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 615-617.

³²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 612.

³²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para 41-54.

³²³ P993 (Dekret mbi Letërnjoftime gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999), neni 3.

³²⁴ Ratko Markoviç, T. 12926–12927 (6 gusht 2007), T. 13252–13255 (9 gusht 2007); P1832 (Ligji mbi Letërnjoftimet), nenet 3, 12.

³²⁵ Radovan Vuçureviç, T. 23225 (26 shkurt 2008); Petar Dujkoviç, T. 23354 (28 shkurt 2008).

³²⁶ 1D226 (Ligji mbi Shtetësinë Jugosllave, 19 korrik 1996), neni 34.

kjo do të lehtësonte punën e MBP-së për të “identifikuar persona në terren.”³²⁷ Dujkoviqi mohoi se ky ndryshim kishte të bënte me përpjekjen për të penguar të rinjtë shqiptarë kosovarë që të ngriheshin me armë kundër Serbisë; ai tha gjithashtu se kjo ishte e pamundur sepse ligji i ri vlente për tërë Republikën e Serbisë, si për meshkuj po ashtu edhe për femra.³²⁸

166. Branisllav Simonoviqi, dëshmitari ekspert i thirrur nga Mbrojtja e Llukiqit për dëshmuar për punën e MPB-së gjatë periudhës në fjalë, dëshmoi se shtetësia jugosllave kishte përparësi mbi mbajtjen e pasaportës jugosllave. Me fjalë të tjera, sipas Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1992, çdo qytetar jugosllav kishte të drejtën të kthehej në vend në çdo kohë, dhe vërtetimi i shtetësisë së tij nuk varej nga paraqitja e ndonjë dokumenti udhëtimi apo identifikimi.³²⁹ Lidhur me letërnjoftimin, Simonoviqi dëshmoi se ky ishte një dokument i përdorur për të vërtetuar identitetin e një personi vetëm në procedura të brendshme ligjore. Me fjalë të tjera, nuk vlente për kalimin e kufijve shtetërorë apo për udhëtime jashtë vendit. Nga pikëpamja teknike, letërnjoftimi, i cili kishte hyrë në fuqi rreth 30 vjet më parë, ishte i vjetërsuar dhe mund të falsifikohesh dhe të shfrytëzohej lehtësisht.³³⁰ Mirëpo, Simonoviqi pranoi se vërtetimi i identitetit dhe rrjedhimisht i shtetësisë ishte më i lehtë për individët që kishin një letërnjoftim jugosllav kur ktheheshin në vend.³³¹

167. Dekreti i Vendbanimit kërkonte që të gjithë personat mbi moshën 14 vjeç të regjistronin ndryshimin e vendbanimit të përkohshëm brenda 24 orësh dhe të vendbanimit të përhershëm brenda 12 orësh pas ardhjes në vendbanimin e ri, dhe që personat të njoftonin për largimin e tyre nga vendbanimi pikërisht para largimit të tyre.³³² Persona që nuk e bënin këtë mund të dënoheshin me 30 ditë burgim.³³³ Më 2 maj 1999, Sreten Llukiqi u dërgoi udhëzime SPB-ve në Kosovë, në përputhje me Dekretin e Vendbanimit dhe u kërkoi që (a) të organizonin regjistrimin e vendbanimit në çdo vend “ku do të ndihmoheshin refugjatët të cilët kishin braktisur vendbanimet e tyre të përhershme për shkak të bombardimit të forcave të NATO-s”, (b) të bënin të mundur që të gjithë persona të regjistronin vendbanimin e tyre në formularin e rregullt dhe të lëshonin vërtetime të regjistrimit të vendbanimit, (c) të mbronin persona me vendbanim të regjistruar, dhe (d) të siguronin që ata të dorëzonin armë (pa pasojë), që të mos strehonin “terroristë ose persona te

³²⁷ Petar Dujkoviq, T. 23340–23341 (27 shkurt 2008), T. 23354–23355 (28 shkurt 2008).

³²⁸ Petar Dujkoviq, T. 23341–23343 (27 shkurt 2008), T. 23354–23355, 23375–23384 (28 shkurt 2008); 1D776 (Mostra e Redaktuar e Letërnjoftimit).

³²⁹ Branisllav Simonoviq, T. 25635–25636, 25639–25642 (17 prill 2008); 6D668 (Aktekspertiza e Branisllav Simonoviqit), f. 44; P1833 (Ligji mbi Dokumente të Udhëtimit të Shtetasve Jugosllavë), neni 3.

³³⁰ 6D668 (Aktekspertiza e Branisllav Simonoviqit), f. 44.

³³¹ Branisllav Simonoviq, T. 25638–25639 (17 prill 2008).

³³² P993 (Dekret mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Aktual të Qytetarëve gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999), neni 3, 4, dhe 5.

³³³ P993 (Dekret mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Aktual të Qytetarëve gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999), neni 7.

armatosur në vendbanimet e tyre”, që të mos pengonin lëvizjet e policisë dhe ushtrisë, që të caktonin përfaqësues të cilët do të kryenin punën e policisë vendase dhe do të mbanin kontakt me organet e qeverisë për të zgjidhur çështje humanitare, dhe që të mbanin me vete vërtetimin e regjistrimit të vendbanimit i cili u jepte jep lirinë e lëvizjes veç zonave të “luftimit dhe të operacioneve antiterroriste.”³³⁴

168. Dhoma trajton gjithashtu çështjen e dy dekreteve të cilat nuk u cituan shumë nga Prokuroria por që u dorëzuan si provë materiale. Dekreti mbi Grumbullimin e Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës ndalonte tubime publike pa miratim paraprak nga organi i duhur,³³⁵ kurse Dekreti mbi Punë të Brendshme Gjatë Gjendjes së Luftës kufizoi disa të drejta gjatë gjendjes së luftës (“Dekreti mbi Punë të Brendshme”).³³⁶ Për shembull, për hir të mbrojtjes së shtetit, ministri i Brendshëm mund të largonte “në një vend të caktuar” një person i cili përbente rrezik për shtetin. Kjo masë nuk mund të zgjaste më shumë se 60 ditë, pas së cilave, personi në fjalë u duhej dorëzuar organeve gjyqësore.³³⁷ Gjithashtu, neni 4 i Dekretit të Punës së Brendshme, për arsye sigurie, lejonte që zyrtarët e autorizuar të MPB-së të kryenin kontrollin e personit gjatë burgimit apo arrestimit pa urdhër kontrolli dhe të kryenin kontrollin e çdo personi dhe pronës së tij pa urdhër kontrolli për të verifikuar nëse ky person mbante armë pa lejë. Neni 9 i këtij Dekreti përkufizonte shkelje të rënda të detyrave profesionale të punonjësve të MPB-së, një prej të cilave ishte "shfaqja e mungesës së tolerancës kombëtare, racore apo fetare," ndëshkimi i së cilës, përveç masave të zakonshme, ishte kufizimi i lëvizjes apo ulja në pozitë apo në gradë. Dymbëdhjetë dekretet e tjera trajtonin kryesisht aspekte që nuk kanë lidhje me këtë proces, siç janë buxheti, punësimi, tregtia, dhe tatimet, dhe rrjedhimisht pa ndonjë rëndësi të veçantë.³³⁸

³³⁴ 6D770 (Udhëzime të Sreten Llukiqit SPB-ve të Kosovës, 2 maj 1999). *Shih gjithashtu* Petar Dujković 6D1499 (deklarata e dëshmitarit me datën 22 shkurt 2008), para. 5.

³³⁵ P993 (Dekret mbi Grumbullimin e Qytetarëve gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999), neni 2.

³³⁶ P993 (Dekret mbi Punë të Brendshme gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999).

³³⁷ P993 (Dekret mbi Punë të Brendshme gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999), neni 3.

³³⁸ 1D158 (Dekreti mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 19 prill 1999); 1D161 (Dekret mbi Buxhetin e Shpenzimeve Publike të Republikës së Serbisë për prillin, majin dhe qershorin 1999 dhe Masa për Mostekalimin e Buxhetit Gjatë Gjendjes së Luftës, 22 prill 1999); 1D163 (Dekret mbi Fondin e Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht të Papunë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 23 prill 1999); 1D166 (Dekret mbi Punësimin dhe Kompensimet Pagaruar Punonjësve në Firmat, Ndërtesat, Mjetet e Prodhimit dhe Pajisje të cilat u Shkatërruan gjatë Operacioneve Luftarake, 23 prill 1999); 1D169 (Dekret mbi Pagesën e Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Shoqëror për Punonjësit në Ndërmarrje të Caktuara, 15 maj 1999); 1D172 ((Dekret mbi Tregtinë në Mallra, Shërbime dhe Inspektim gjatë Gjendjes së Luftës, 21 maj 1999); 1D175 (Dekret mbi Raportin e Buxhetit Vjetor për 1998 të Republikës së Serbisë, 21 maj 1999); 1D178 (Dekret mbi Raportin Përfundimtar të Buxhetit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë për Vitin 1998, 21 maj 1999); 1D181 (Dekret mbi Kushtet e Posaçme të Organizimit të Lojërave të Fatit në Kohë Lufte, 29 maj 1999); 1D187 (Dekret mbi Ndryshimet e Dekretit mbi Livrimin e Fondeve të Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht të Papunë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 9 qershor 1999); 1D189 (Dekret mbi Përbërjen e Qeverisë, 15 qershor 1999); dhe 1D478 (Dekreti që ndryshon Dekretin mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 4 qershor 1999).

169. Dhoma ka marrë letra të nënshkruara nga zëvendëskryeministri i Serbisë dhe adresuar Presidentit serb, të cilat rekomandojnë që ai të miratojë secilin prej 16 dekreteve në fjalë. Dhoma ka shqyrtuar projekt-dekretet dhe letrat përkatëse të katër dekreteve të përshkruara më lart, të nënshkruara nga zëvendëskryeministri i atëhershëm, Ratko Marković.³³⁹ Letrat përmendin mbledhjen qeveritare nr. 83, të mbajtur më 6 prill 1999, pas së cilës qeveria vendosi t'i paraqiste Presidentit katër dekretet për miratim. Mirëpo, këto projekt-dekrete kishin tashmë datën e nënshkrimit 31 mars apo 1 prill, dhe u nënshkruan më vonë nga Millutinoviçit pranë asaj date, gjë që lë të kuptohet se rekomandimi erdhi pas nënshkrimit. Në dëshminë e tij para Dhomës, Ratko Marković nuk mundi të shpjegonte ndryshimin e datave.³⁴⁰ Mirëpo, ai shpjegoi se çdo dekret u hartua nga ministria përkatëse. Për shembull Dekreti mbi Letërnjoftimet u hartua nga Ministria e Brendshme.³⁴¹

170. Markovići konfirmoi se kishte nënshkruar katër dekretet sepse kishin të bënin me çështje të specialitetit të tij, kurse 12 dekretet e tjera u nënshkruan nga zëvendëskryeministri tjetër, Vojislav Sheshel.³⁴² Markovići shpjegoi gjithashtu procedurën e ndjekur nga qeveria para lëshimit të dekreteve. Së pari, tema diskutohej nga Kabineti, i cili përfshinte Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat e të gjitha Ministrive, dhe ministrat e Shtetit. Pas diskutimit, vendimet merreshin me konsensus, dhe nënshkruheshin nga ministri përkatës. Mirëpo, Markovićit nuk i kujtohej diskutimi lidhur me Dekretin mbi Letërnjoftimet.³⁴³

171. Dhoma vëren se të 12 dekretet e mbetura nuk kanë ndryshime në datë si katër të parët. Mirëpo, ajo vëren gjithashtu se të 12 projekt-dekretet e bashkangjitura letrës së rekomandimit kanë një datë pranë vendit për nënshkrimin e Millutinoviçit, dhe zakonisht kjo datë përputhet me datën e mbledhjes qeveritare. Kjo lë të mendohet se dekretet u hartuan menjëherë para apo menjëherë pas mbledhjes qeveritare, me hapësirën për nënshkrimin e Millutinoviçit, përbri datës së mbledhjes. Në këtë formë, projekti i dërgohej Millutinoviçit për nënshkrim. Nuk dihet se për çfarë arsye të katër dekretet e para u hartuan me datën 31 mars dhe/ose 1 prill, megjithëse mbledhja qeveritare u zhvillua më 6 prill. Është e paqartë nëse ishte lëshim për qeverinë ose nëse qeveria rekomandoi miratimin e katër dekreteve pas iniciativës së Millutinoviçit për t'i nxjerrë.

³³⁹ ID144 (Projektligji i Dekretit mbi Letërnjoftime gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); ID147 (Projektligji i Dekretit mbi Grumbullimin e Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); ID150 (Projektligji i Dekretit mbi Vendbanimin e Përhershëm dhe Vendbanimin e Përkohshëm të Qytetarëve gjatë Kohës së Luftës, 6 prill 1999); ID153 (Projektligji i Dekretit mbi Punë të Brendshme Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999).

³⁴⁰ Ratko Marković, T. 13246-13250 (9 gusht 2007).

³⁴¹ Ratko Marković, T. 13250-13252 (9 gusht 2007).

³⁴² Ratko Marković, T. 13255-13256 (9 gusht 2007).

³⁴³ Ratko Marković, T. 13257-13261 (9 gusht 2007).

172. Gjithsesi, pasi ka shqyrtuar tërë provat e mësipërme, Dhoma është bindur se qytetarët shqiptarë kosovarë të RFJ-së, dokumentet e identitetit të të cilëve u konfiskuan, nuk humbën shtetësinë e tyre si pasojë e konfiskimit. Dhoma vëren, siç u pranua nga Simonoviqi, se identiteti dhe shtetësia vërtetohen më lehtë për persona që kishin dokumente jugosllave të identitetit. Mirëpo, ky fakt nuk ndryshon pavarësisht nëse Dekreti mbi Letërnjoftimet ishte në fuqi në atë kohë apo jo, veçanërisht nëse personi i cili përpiqte të vërtetonte shtetësinë e tij kishte qenë jashtë Kosovës për më shumë se 15 ditë. Për më tepër, Dhoma nuk ka marrë prova se shqiptarët kosovarë patën vështirësi gjatë kthimit të tyre në Kosovë për shkak të humbjes së dokumenteve të identitetit. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se Prokuroria nuk ka shpjeguar dhe provuar mënyrën praktike të zbatimit të Dekretit mbi Letërnjoftimet për të arritur qëllimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

173. Gjithashtu qëllimi i katër dekretëve të përshkruara hollësisht më lart, lejon një interpretim të ndryshëm nga ai i Prokurorisë, d.m.th. se, në vend të inkurajimit të dëbimeve, duket se qëllimi ishte që të mundësohej shtimi i kontrollit policor mbi vendndodhjen e popullatës në Kosovë, si dhe shtimi i kontrollit policor mbi të rinjtë e asaj popullate. Të katër dekretet u lëshuan për afërsisht në të njëjtën kohë kur Llukiqi i udhëzoi SPB-të që të ndalonin civilët që të largoheshin nga vendbanimet e tyre.³⁴⁴ Rrjedhimisht, për tërë këto arsye, bazuar në provat lidhur me dekretet Dhoma nuk është në gjendje të nxjerrë një përfundim kundër Millutinoviqit.

d. Millutinoviq si negociator me shqiptarët kosovarë

174. Siç është shpjeguar më herët në këtë Aktgjykim, gjatë vitit 1998 dhe gjatë pjesës së vitit 1999, Millutinoviqi mori pjesë në negociata të ndryshme me shqiptarët kosovarë dhe me bashkësinë ndërkombëtare, dhe shkoi disa herë në Kosovë.³⁴⁵ Prokuroria pretendon se këto mbledhje penguan çdo përpjekje serioze për të arritur një marrëveshje me përfaqësues të besueshëm të shqiptarëve kosovarë duke qenë se në to morën pjesë vetëm shqiptarë kosovarë të cilët nuk përfaqësonin askënd. Këto mbledhje u shfrytëzuan për të shmangur vëmendjen nga krimet e kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.³⁴⁶ Nga ana e saj, Mbrojtja argumenton se, gjatë negociatave Millutinoviqi u angazhua për të gjetur një zgjidhje paqësore nëpërmjet dialogut.³⁴⁷

175. Procesi i negociatave filloi më 11 mars 1998, kur qeveria serbe emëroi një ekip përfaqësuesish, përfshirë Ratko Markoviqin dhe Andreja Millosavleviqin, për të negociuar në emër

³⁴⁴ 6D778 (Telegram i Shtabit të MPB-së nënshkruar nga Llukiqi, 15 prill 1999).

³⁴⁵ *Shih* Kapitulli V. *Shih edhe* Jovan Kojic, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 39.

³⁴⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 586.

³⁴⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008 (versioni publik), para. 127-182.

të saj me përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë.³⁴⁸ Duke qenë se këta të fundit nuk iu përgjigjën disa ftesave për të marrë pjesë në bisedime, Millutinoviçi lëshoi një deklaratë në të cilën ai shprehu gatishmërinë e tij për të qenë garantues i këtyre bisedimeve mbi bazën e tërësisë territoriale dhe të vetëqeverisjes së Kosovës brenda Republikës së Serbisë.³⁴⁹ Që prej atij momenti, sipas Jovan Kojiqit, Millutinoviçi mori pjesë intensivisht në procesin e zgjidhjes politike të çështjeve të Kosovës. Si pasojë, Presidenca dhe Kojiqi personalisht ishin dërguesit e shumë letrave udhëheqësve të shqiptarëve kosovarë për t'i ftuar në bisedime. Me përjashtim të një rasti, përfaqësuesit e partive kryesore shqiptare kosovare nuk iu përgjigjën ftesave, kurse partitë e vogla të shqiptarëve kosovarë dhe pakicat e tjera etnike pranuan.³⁵⁰

176. Më 31 mars 1998, qeveria serbe ftoi përfaqësuesit e partive politike të shqiptarëve kosovarë për bisedime më 7 prill 1998. Delegacioni serb, përfshirë Millutinoviçin, udhëtoi për në Prishtinë. Mirëpo, udhëheqësit e partive politike më të mëdha të shqiptarëve në Kosovë nuk erdhën. Millutinoviçi lëshoi një deklaratë në të cilën shprehu pakënaqësinë e tij me faktin se udhëheqësit e shqiptarëve kosovarë e shpërfillën ftesën për dialog politik, por theksoi se, pavarësisht nga mungesa e tyre, pala serbe kishte durim dhe ishte e hapur për dialog konstruktiv. Gjithashtu, ai përsëriti se ishte personalisht i gatshëm për t'u takuar me përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë në çdo kohë që të dëshironin dhe theksoi faktin se e ardhmja e Kosovës dhe e Serbisë bazohej në “barazi dhe jetën e përbashkët” dhe jo në ndasitë etnike.³⁵¹

177. Wolfgang Petritsch-i, i cili në atë kohë ishte ambasador i Austrisë në RFJ, konfirmoi se Millutinoviçi u përpoq vazhdimisht që t'i bindte shqiptarët kosovarë të vinin në tryezën e bisedimeve. Megjithatë, ai tha gjithashtu se bashkësia ndërkombëtare u përpoq të bindte palën serbe se “lëshimi i ftesave në minutën e fundit, veprimet sa për sy e faqe, udhëtimet në Prishtinë etj.” nuk ndihmonin vërtet për të inkurajuar shqiptarët kosovarë që të merrnin pjesë në bisedime, dhe se duhej gjetur një mënyrë më efikase. Gjithsesi ai konfirmoi se bashkësia ndërkombëtare i mbështeti shumë këto përpjekje të qeverisë serbe.³⁵²

178. Gjatë tërë vitit 1998, Millutinoviçi dhe kabineti i tij u angazhuan në përpjekje për të negociuar. Ambasadori amerikan Hill, me ndihmën e konsulentit të tij ligjor, James O'Brien, shërbeu si ndërlidhës dhe ndërmjetësues midis të dy palave më 1998 dhe deri në vitin 1999 në një

³⁴⁸ Ratko Marković, T. 13125 (8 gusht 2007); 1D78 (Deklarata e Qeverisë Serbe, 11 mars 1998).

³⁴⁹ Ratko Marković, T. 13132-13133 (8 gusht 2007); 1D79 (Deklarata e Presidentit të Serbisë, Millan Millutinović, 18 mars 1998); P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56-65, 79-81.

³⁵⁰ Jovan Kojiq, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 34, 37.

³⁵¹ Ratko Marković, T. 13143-13144 (8 gusht 2007); 1D82 (Deklarata e Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi Kosovën dhe Metohinë, 31 mars 1998); 1D83 (Deklarata e Presidentit të Qeverisë së Serbisë, 7 prill 1998).

përpjekje për të hartuar një plan për vetëqeverisjen e Kosovës. Ratko Markoviqi dhe Millutinoviqi patën bisedime me Hill-in dhe O'Brien-in, të cilat u zhvilluan paralelisht me përpjekjet e dështuara të delegacionit serb për të zhvilluar negociata të drejtpërdrejta me shqiptarët kosovarë. Në këto bisedime, Hill-i dhe O'Brien-i sollën propozimet e tyre për një plan, apo një marrëveshje për vetëqeverisjen e Kosovës, për të cilat delegacioni serb dha komente. Pas kësaj, Hill-i dhe O'Brien-i ua përcollën komentet shqiptarëve kosovarë dhe më pas i bënë të ditur delegacionit serb mendimin e shqiptarëve kosovarë.³⁵³ Ky ndërmjetësim rezultoi në disa projekt-marrëveshje. Më vonë, disa propozime u inkuadruan në projekt-marrëveshjen përfundimtare të paraqitur në Rambuje.³⁵⁴ Kojiqi konfirmoi se kaloi orë dhe ditë të tëra duke daktilografuar versionet e ndryshme të këtyre marrëveshjeve, të cilat verifikoheshin nga Markoviqi. Më pas, Hill-i dhe O'Brien-i sillnin versionet e tyre dhe i shpjegonin, dhe pas kësaj, Markoviqi dhe bashkëbiseduesit e tjerë jepnin përgjigjet dhe kundërpropozimet e tyre.³⁵⁵ Petritsch-i, i cili në atë kohë ishte i Dërguari i Posaçëm i BE-së për Kosovën dhe punonte ngushtësisht me Hill-in, dëshmoi gjithashtu për procedurën. Ai tha se projektet u transmetoheshin të dy delegacioneve dhe pastaj ai dhe Hill-i shkolin në Prishtinë apo në Beograd për t'u takuar me përfaqësuesit e delegacioneve. Për palën serbe, përfaqësuesi ishte Millutinoviqi i cili, sipas Petritsch-it, bëri përpjekje të vazhdueshme për të inkurajuar shqiptarët kosovarë për të negociuar.³⁵⁶

179. Më 29 shtator 1998, Zyra e Millutinoviqit lëshoi një deklaratë që informonte publikun se së bashkë me Ratko Markoviqin dhe Millosheviqin, ai kishte pritur Hill-in për të diskutuar mbi

³⁵² Wolfgang Petritsch, T. 10771-10787 (1 mars 2007).

³⁵³ Ratko Markoviqi, T. 13165 (8 gusht 2007); Jovan Kojiqi, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para 34-35. *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviq, T. 13997 (20 gusht 2007).

³⁵⁴ Ratko Markoviqi, T. 13166 (8 gusht 2007), 13175 (9 gusht 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10711 (28 shkurt 2007).

³⁵⁵ Jovan Kojiqi, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 35, 58-77, 81; 1D625 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 7 korrik 1998); 1D610 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 11 korrik 1998); 1D611 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 13 korrik 1998); 1D612 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 14 korrik 1998); 1D626 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi i SHBA-së, 20 korrik 1998); 1D613 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 26 korrik 1998); 1D614 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 27 korrik 1998); 1D615 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 28 korrik 1998); 1D616 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 29 korrik 1998); 1D730 (Komentet e shqiptarëve kosovarë mbi projekt-dokumentin amerikan, 16 shtator 1998); 1D617 (Komentet e vërejtjet mbi projekt-dokumentin amerikan, 25 shtator 1998), pranuar gjithashtu si 1D728; 1D701 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 29 shtator 1998); 1D618 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 30 shtator 1998); 1D702 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 6 tetor 1998); 1D694 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 9 tetor 1998); 1D695 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 29 tetor 1998); 1D703 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 29 tetor 1998); 1D696 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi jugosllav, 1 nëntor 1998); 1D627 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 2 nëntor 1998); 1D628 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë - propozimi amerikan, 13 nëntor 1998).

³⁵⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10786-10787, 10809-10810 (1 mars 2007).

çështjet e paqes dhe të stabilitetit në Kosovë. Sipas deklaratës, në takim u tha se duhej rifillim dhe intensifikim urgjent i dialogut midis delegacionit shtetëror dhe përfaqësuesve të partive politike të shqiptarëve kosovarë për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura.³⁵⁷

180. Më 5 nëntor 1998, Millutinoviçi shkoi në Prishtinë ku u takua me kryetarët e komunave, deputetët e republikës dhe të federatës, dhe krerët e qarqeve të Kosovës. Ai u informua nga Zoran Angjelkoviçi, Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm dhe Vojislav Zhivkoviçi, shefi i komitetit krahinor të SPS-së. Zyra e Millutinoviçit lëshoi një deklaratë publike e cila përshkruante bisedimet dhe përmendte marrëveshjen me bashkësinë ndërkombëtare për hyrjen e vëzhguesve të OSBE-së në Kosovë. Në deklaratë, Millutinoviçi afirmoi angazhimin e Serbisë për një zgjidhje me mjete politike, si dhe përkrahjen e Serbisë për misionin e verifikuesve të udhëhequr nga OSBE-ja (“KVM”).³⁵⁸ Ai tha gjithashtu se KVM-ja duhej të zbulonte të vërtetën dhe të hidhte poshtë thashethemet, spekulimet dhe nxitjet mediatike të organizuara.³⁵⁹ Deklarata u shpreh kundër përdorimit të forcës dhe argumentoi për një zgjidhje paqësore të problemit, si dhe për eliminimin e “përrjashtimit, ekstremizmit dhe urrejtjes.”³⁶⁰ Së fundi, në deklaratë u bëhej thirrje përfaqësuesve të partive politike të shqiptarëve kosovarë që të angazhoheshin në bisedime për arritjen e paqes dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të të gjitha bashkësive etnike në Kosovë.³⁶¹

181. Më 14 nëntor 1998, Millutinoviçi dërgoi një sërë ftesash për udhëheqësin e LDK-së, Ibrahim Rugova, si dhe përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë dhe të pakicave të tjera në Kosovë, për një takim në Prishtinë, duke cituar Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq si platformë bisedimesh.³⁶² Ai lëshoi gjithashtu një deklaratë shtypi duke bërë të njohur se ftesat ishin dërguar dhe se, ndër të tjerë, ishin ftuar edhe Hill-i dhe Petritsch-i.³⁶³ Takimi u zhvillua më 18 nëntor 1998. Përfaqësuesit e pakicave të ndryshme etnike në Kosovë dhe përfaqësuesit e partive më të vogla të shqiptarëve kosovarë morën pjesë, kurse partitë politike kryesore të shqiptarëve kosovarë nuk erdhën.³⁶⁴ Prokuroria argumentoi se kjo mund të ketë ndodhur sepse në një letër me datën 14 nëntor 1998 u bë propozimi për një takim më 11 nëntor 1998, gjë që, siç pranoi Ratko Markoviçi, mund të

³⁵⁷ 1D86 (Deklaratë publike e Presidencës, 29 shtator 1998). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10800–10804 (1 mars 2007); P556 (Mesazh i Ambasadës Austriake, 30 shtator 1998).

³⁵⁸ Ratko Markoviçi, T. 13170–13172 (8 gusht 2007); 1D45 (Deklaratë e Millutinoviçit, 5 nëntor 1998). *Shih edhe* 1D690 (Njoftim shtypi i Tanjug-ut mbi vizitën e Millan Millutinoviçit në Prishtinë, 5 nëntor 1999).

³⁵⁹ Ratko Markoviçi, T. 13171 (8 gusht 2007); 1D45 (Deklaratë Shtypi e Millan Millutinoviçit, 5 nëntor 1998).

³⁶⁰ 1D45 (Deklaratë Shtypi e Millan Millutinoviçit, 5 nëntor 1998), f. 1.

³⁶¹ 1D45 (Deklaratë Shtypi e Millan Millutinoviçit, 5 nëntor 1998), f. 2.

³⁶² 1D62 (Letra të dërguara nga Millutinoviçi përfaqësuesve të shqiptarëve kosovarë, 14 nëntor 1998), pranuar gjithashtu si 1D621.

³⁶³ 1D88 (Deklaratë Shtypi e Millan Millutinoviçit, 14 nëntor 1998).

³⁶⁴ Ratko Markoviçi, T. 13172 (8 gusht 2007); 1D622 (Fjalë hapëse e Millutinoviçit në bisedimet me Përfaqësuesit e Grupeve Kombëtare në Kosovë); 1D623 (Fjalë Mbyllëse e Millutinoviçit në bisedimet me Përfaqësuesit e Grupeve Kombëtare në Kosovë).

ketë krijuar një ngatërresë lidhur me datën e takimit. Në anën tjetër, megjithëse në të gjitha letrat ishte i njëjti gabim, përfaqësuesit e pakicave morën pjesë në takim.³⁶⁵ Gjithashtu, Jovan Kojiqi, i cili kishte marrë pjesë në hartimin e letrave të dërguara në atë kohë nga Presidenca, shpjegoi se provat e paraqitura ishin dokumente të parafuara por jo të nënshkruara, d.m.th. kopje nga Presidenca, kurse letrat e dërguara ishin nënshkruar nga Millutinoviqi, me emër dhe mbiemër. Kojiqi mendonte se gabimet në data duhet të jenë zbuluar para dërgimit të letrave, duke qenë se askush nuk u ankua për data të gabuara.³⁶⁶ Gjithsesi, ndonëse Petritsch-i nuk mori pjesë në këtë takim, tha se ishte një hap i madh përpara duke qenë se, për herë të parë, autoritetet serbe i kishin përfshirë haptas në proces negociatorët ndërkombëtarë me përvojë në këtë çështje.³⁶⁷

182. Në takimin e Prishtinës më 18 nëntor 1998, Millutinoviqi bëri një deklaratë hapëse dhe gjithashtu dha konkluzione në fund të takimit. Në hapje të takimit, ai përmendi Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq si një arritje e madhe dhe si bazë për një zgjidhje paqësore të problemit të Kosovës. Ai theksoi gjithashtu barazinë e tërë qytetarëve të Serbisë dhe faktin se deri në atë kohë Serbia kishte plotësuar të gjitha detyrimet e saj dhe afatet e parashikuara në marrëveshjet me bashkësinë ndërkombëtare. Ai foli për vetëqeverisjen demokratike për Kosovën brenda Republikës së Serbisë, dhe përsëriti bindjen e tij se e ardhmja e Kosovës ishte "paqe, barazi, jetë e përbashkët, zhvillim, dhe jo konflikte dhe dasi." Pastaj i ftoi të gjithë të jepnin propozimet dhe idetë e tyre.³⁶⁸

183. Në fjalën e tij mbyllëse në fund të bisedimeve të asaj dite, Millutinoviqi vlerësoi bisedimet si pozitive, por shprehu keqardhjen se në takim nuk morën pjesë përfaqësuesit e partive politike kryesore të shqiptarëve kosovarë. Mirëpo, ai theksoi se pala serbe kishte durim dhe do të vazhdonte të ishte e hapur për një dialog konstruktiv si e vetmja mënyrë për të arritur një zgjidhje. Ai përsëriti faktin se ishte personalisht i gatshëm të takonte përfaqësuesit e të gjithë bashkësive të Kosovës në çdo kohë.³⁶⁹

184. Më 19 nëntor 1998, Millutinoviqi u takua përsëri, këtë herë në Beograd, me udhëheqësit e pakicave të Kosovës për të vazhduar bisedimet e filluara ditën e mëparshme. Një deklaratë publike e lëshuar nga kabineti i tij në lidhje me këtë takim përshkruante diskutimet dhe vinte në dukje marrëveshjen midis të pranishmëve se vetëm qytetarët e RFJ-së, të Serbisë dhe të vetë Kosovës mund të përkufizonin më mirë elementet e një zgjidhjeje politike për Kosovën. Gjithashtu në

³⁶⁵ Ratko Marković, T. 13525–13528 (14 gusht 2007).

³⁶⁶ Jovan Kojiq, T. 13737–13740 (16 gusht 2007).

³⁶⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10810–10811 (1 mars 2007); 1D68 (Notë e Petritsch-it për Millutinoviqin, dërguar më 17 nëntor 1998).

³⁶⁸ 1D622 (Fjalë hapëse e Millutinoviqit në bisedimet me Përfaqësuesit e Grupeve Kombëtare në Kosovë); Jovan Kojiq, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 79.

deklaratë përsëritej bindja se barazia e njëmendtë e të gjitha bashkësive kombëtare në Kosovë ishte e mundshme dhe do të respektohej tërësisht.³⁷⁰

185. Në të njëjtën ditë, Millutinoviçi u dërgoi përsëri letra tre shqiptarëve të njohur kosovarë: Rexhep Qosja, Adem Demaçi dhe Hydajet Hyseni, të cilët nuk kishin marrë pjesë më parë, duke kërkuar një takim më 20 nëntor, si mënyrë për të nxitur bisedime të mëtejshme.³⁷¹ Në këto letra, ai përmendi takimin e datës 18 nëntor dhe shprehu dëshirën e tij për të dëgjuar mendimet e marrësve të letrës për një “rrugë drejt një zgjidhjeje paqësore të problemit.”³⁷² Më 20 nëntor 1998, dy prej tyre, Rexhep Qosja dhe Hydajet Hyseni, i dërguan një përgjigje Millutinoviçit duke thënë se nuk besonin se diskutimet private të improvizuara ngutshëm do të ndihmonin në zgjidhjen e problemit në Kosovë dhe, për këtë arsye, nuk mund të merrnin pjesë në to. Sipas tyre, zgjidhja e drejtë afatgjatë e çështjes së Kosovës nënkuptonte nevojën e një procesit të mirëpërgatitur diskutimesh midis palëve të barabarta, me angazhimin e drejtpërdrejtë të ndërmjetësuesve ndërkombëtar të autorizuar.³⁷³ Adem Demaçi u përgjigj më 24 nëntor, duke lavdëruar Millutinoviçin për përpjekjet e tij, por refuzoi të takohej sepse donte bisedime në nivelin federativ. Ai refuzoi gjithashtu sepse ftesa nuk përcaktonte nëse statusi i tij në bisedimet do të ishte si qytetar privat ose si përfaqësues kryesor politik i UÇK-së.³⁷⁴

186. Më 20 nëntor, Millutinoviçi u dërgoi letra nëntë individëve, përfshirë Ibrahim Rugovën dhe përfaqësues të tjerë të partive kryesore të shqiptarëve kosovarë, si dhe udhëheqësve të pakicave në Kosovë.³⁷⁵ Kojiçi u përpoq të shpjegonte mospërputhjet e ndryshme në këto letra, edhe për datën, duke thënë se Millutinoviçi as nuk e kishte sigluar versionin e paraqitur të letrave dhe për këtë arsye ky sigurisht nuk ishte versioni përfundimtar.³⁷⁶ Në letrat, Millutinoviçi përmendte takimet e tij më 19 dhe 20 nëntor dhe i informonte marrësit për faktin se rezultati i tyre ishte “Projekt-Marrëveshja e Përbashkët mbi Kuadrin Politik të Vetëqeverisjes në Kosovë.” Më tej ai i ftonte

³⁶⁹ 1D623 (Fjalë mbyllëse e Millutinoviçit në Bisedimet me Përfaqësuesit e Grupeve Kombëtare në Kosovë); Jovan Kojiçi, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 80.

³⁷⁰ 1D89 (Deklaratë publike nga Presidenca, 19 nëntor 1998).

³⁷¹ Ratko Markoviçi, T. 13172–13173 (8 gusht 2007), T. 13528–13529 (14 gusht 2007); 1D66 (Letra e Millutinoviçit drejtuar Rexhep Qoses, Hydajet Hysenit, dhe Adem Demaçit me datën 19 nëntor 1998).

³⁷² 1D66 (Letra e Millutinoviçit drejtuar Rexhep Qoses, Hydajet Hysenit, dhe Adem Demaçit me datën 19 nëntor 1998).

³⁷³ 1D67 (Letra e Rexhep Qoses dhe të Hydajet Hysenit drejtuar Millutinoviçit, me datën 20 nëntor 1998). *Shih edhe* Ratko Markoviçi, T. 13529–13531 (14 gusht 2007).

³⁷⁴ 1D92 (Letra e Adem Demaçit drejtuar Millutinoviçit, 24 nëntor 1998).

³⁷⁵ Jovan Kojiçi, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 37, 82; 1D624 (Letra e Millutinoviçit më 20 nëntor 1998). Kojiçi dëshmoi se vetëm Adem Demaçi u përgjigj dhe sipas Kojiçit kjo tregonte se udhëheqësit shqiptar “nuk kishin dëshirë për një marrëveshje”. Jovan Kojiçi, T. 13744–13745 (16 gusht 2007).

³⁷⁶ Jovan Kojiçi, T. 13746–13747 (16 gusht 2007).

marrësit të merrnin pjesë në një takim tjetër në Prishtinë më 25 nëntor 1998 për të firmosur një deklaratë lidhur me projekt-marrëveshjen (“Deklarata e Prishtinës”).³⁷⁷

187. Kjo projekt-marrëveshje ishte kulmimi i procesit të negociatave të cilat filluan në mars 1998, por që u bojkotuan vazhdimisht nga shqiptarët kosovarë. Ky dokument u nënshkrua nga delegacioni i qeverisë serbe, nga përfaqësuesit e dy partive politike të shqiptarëve kosovarë dhe nga përfaqësuesit e bashkësive të tjera etnike të cilat morën pjesë në formulimin e dispozitave të marrëveshjes. Sipas Ratko Markoviqit, arsyeja e vetme e përfshirjes së Millutinoviqit në negociimin dhe hartimin e marrëveshjes ishte se ai personifikonte Republikën e Serbisë.³⁷⁸

188. Më 20 nëntor, para nënshkrimit të Deklaratës së Prishtinës, Millutinoviqi u takua gjithashtu me përfaqësuesit e partive të ndryshme politike në Serbi. Diskutimi kishte të bënte me mendimet dhe propozimet e këtyre partive dhe se si mund të arrihej një “platformë e pranueshme nga të gjithë” për një zgjidhje të problemit të Kosovës. U ra dakord se zgjidhje politike duhej të bazohej tërësisht në Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq. U theksua vetëqeverisja demokratike në kuadrin e Kushtetutave të RFJ-së dhe të Serbisë.³⁷⁹ Më 23 nëntor 1998, Millutinoviqi u takua me Christopher Hill-in. Gjithashtu të pranishëm ishin Ratko Markoviq dhe Vlladan Kutleshqi, i dërguari personal i Slobodan Milloshëviqit. Ata diskutuan për negociatat e 18 dhe 19 nëntorit dhe për marrëveshjen që rezultoi. Më tej u pranua që vetëqeverisja e gjerë, bazuar mbi barazinë e bashkësive etnike në Kosovë, të ishte “shtylla kryesore e zgjidhjes politike.”³⁸⁰

189. Pas nënshkrimit të Deklaratës së Prishtinës, Millutinoviqi u takua përsëri me nënshkruesit më 9 dhjetor 1998. Të pranishëm për palën serbe, përveç Millutinoviqit, ishin Ratko Markoviq, Shainoviqi dhe Vojislav Sheshel. Qëllimi i takimit ishte vazhdimi i negociatave në aspekte të mëtejshme për të arritur një zgjidhje politike në Kosovë. Pjesëmarrësit shqyrtuan “projektin e fundit të Hill-it” paraqitur më 2 dhjetor, dhe e hodhën poshtë, duke qenë se ndryshonte shumë nga projekt-marrëveshja e negociuar më 18 dhe 19 nëntor.³⁸¹ Adem Demaçi e kishte hedhur poshtë propozimin e Hill-it një ditë më parë, duke kritikuar Hill-in dhe Holbrooke-un në deklaratën e shtypit se kishin marrë anën e serbëve. Ai pranoi se delegacioni i shqiptarëve kosovarë nuk kishte ofruar asnjë propozim i cili përjashtonte qëllimin përfundimtar të një Kosove të pavarur, dhe tha se

³⁷⁷ 1D603 (Deklaratë shtypi e Millan Millutinoviqit, 20 nëntor 1998); 1D620 (Deklarata e Nënshkruesve të Marrëveshjes, 25 nëntor 1999); 1D624 (Letrat e Millutinoviqit, më 20 nëntor 1998); 1D577 (Lista e të ftuarve në negociatat e 25 nëntorit); 1D91 (Projekt-Marrëveshja e Përbashkët mbi Kuadrin Politik të Vetëqeverisjes në Kosovë, 20 nëntor 1998) pranuar gjithashtu si 1D619; 1D18 (Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989–1999*), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 372. *Shih gjithashtu* 1D754 (Fletinformacion plotësues i Kojiqit), para. 7.

³⁷⁸ Ratko Markoviq, T. 13522–13524 (14 gusht 2007).

³⁷⁹ 1D602 (Deklaratë shtypi e Millan Millutinoviqit, 20 nëntor 1998).

³⁸⁰ 1D604 (Deklaratë shtypi e Millan Millutinoviqit, 23 nëntor 1998).

³⁸¹ *Shih* 1D605 (Deklaratë shtypi e Millan Millutinoviqit, 9 dhjetor 1998).

misioni i tij ishte të “bashkonte shqiptarët që të ‘jemi të bashkuar në fuqi dhe në politikë dhe të krijojmë shtetin tonë.’”³⁸²

190. Dhoma kujton këtu përfundimin e saj në Kapitullin V se qëndrimet e të dy palëve ishin kaq të largëta nga njëri-tjetri sa ishte jashtëzakonisht e vështirë të përfytyrohej një marrëveshje. Provat e shumta për refuzimin e përfaqësuesve kryesorë të shqiptarëve kosovarë për të takuar negociatorët e RFJ-së dhe të Serbisë tregojnë qartë mungesën e vullnetit për të gjetur një zgjidhje e cila do të përfshinte një lidhje të mëtejshme midis Kosovës dhe Serbisë. Në anën tjetër, qëndrimi i autoriteteve serbe ishte vendosmërisht kundër pavarësisë së Kosovës. Në këtë kuadër, dhe në veçanti duke marrë parasysh refuzimin e shqiptarëve kosovarë për të negociuar dhe të dëshmisë të Petritsch-it nuk mund të thuhet se Millutinoviçi, i cili mori pjesë aktive në procesin e negociatave dhe dukej i gatshëm të takohej me përfaqësuesit kryesorë të shqiptarëve kosovarë, pengoi një përpjekje të sigurtë të një zgjidhjeje.

e. Millutinoviçi si negociator me bashkësinë ndërkombëtare

191. Po ashtu si në negociatat me shqiptarët kosovarë, Prokuroria pretendon se Millutinoviçi shfaqti një qëndrim pengues gjatë kontakteve të tij me përfaqësuesit ndërkombëtarë. Për më tepër, edhe kur u realizuan marrëveshjet, ai vazhdoi të pengonte zbatimin e tyre.³⁸³ Mbrojtja, në anën tjetër, argumenton se prania e Millutinoviçit në takimet me përfaqësuesit ndërkombëtarë përputhej me rolin e tij kushtetues si përfaqësues i unitetit shtetëror të Serbisë.³⁸⁴

192. Nuk kundërshtohet se Millutinoviçi mori pjesë në takime me përfaqësues të ndryshëm të bashkësisë ndërkombëtare. Gjenerali Klaus Naumann, kryetari i komitetit ushtarak të NATO-s në atë kohë, dëshmoi se, midis tetorit 1998 dhe janarit 1999, ai dhe Wesley Clark zhvilluan tri takime me Millosheviçin, gjatë të cilave ishte i pranishëm edhe Millutinoviçi. Takimi i parë u zhvillua më 15 tetor 1998 dhe përfshiu Perishiçin dhe Javier Solanën, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s. Qëllimi i takimit ishte të informohej Millosheviçi për shqetësimin e NATO-s lidhur me veprimet e RFJ-së në Kosovë dhe me mostërheqjen e forcave të RFJ-së, dhe kjo u bë. Millosheviçi u informua gjithashtu për përdorimin e forcës së tepruar, por ai i hodhi poshtë këto pretendime.³⁸⁵ Takimi zgjati rreth pesë orë, dhe në shumicën e kohës folën Solana dhe Millosheviçi. Sipas Naumann-it, Millosheviçi pyeti për numrin e forcave në Kosovë dhe Perishiçi e informoi se raportet e zbulimit të NATO-s ishin të sakta për sa i përket numrit të tepërt të trupave të UJ-së. Naumann-i dëshmoi

³⁸² ID18 (Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989–1999*), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 372–379.

³⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 595.

³⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 175.

gjithashtu se ai dhe kolegët e tij besonin se Millosheviqi ishte në krye të pushtetit në RFJ dhe për këtë arsye, në fund të takimit, Solana foli personalisht me Millosheviqin, duke e informuar se NATO-ja e merre çështjen me seriozitet dhe se nuk kishte më kohë për të luajtur.³⁸⁶

193. Millutinoviqi ishte i pranishëm në një takim të ngjashëm më 24 tetor 1998, bashkë me Perishiqin, Shainoviqin dhe një sërë zyrtarësh të MPB-së. Takimi zgjati 90 minuta dhe qëllimi i tij ishte të paralajmërohej Millosheviqi edhe një herë se duhej të pakësonte praninë e MPB-së dhe të UJ-së në Kosovë dhe se forcat e RFJ-së dhe të Serbisë duhej të mos përdorin forcë të tepruar kundër popullatës civile. Millosheviqi mohoi përdorimin e tepruar të forcës, si edhe akuzën se ishte përdorur kundër civilëve.³⁸⁷

194. Pas këtij takimi, u zhvilluan një sërë takimesh teknike me një delegacion më të madh, përfshirë edhe Shaun Byrnes të US-KDOM.³⁸⁸ RFJ-ja përfaqësohej nga Millutinoviqi, Shainoviqi dhe titullarët të policisë dhe ushtrisë si Llukiqi, Obrad Stevanoviqi dhe Vllastimir Gjorgjeviqi. Takimi u përqendrua mbi sasinë e forcave që duhej të ishin të pranishme në Kosovë.³⁸⁹ Sipas Naumann-it, Millutinoviqi nuk ishte shumë aktiv gjatë negociatave teknike.³⁹⁰ Mirëpo, gjatë dëshmisë së tij, Byrnes-i mendonte, megjithëse nuk ishte i sigurt, se Millutinoviqi kryesoi mbledhjen plenare të 30-40 personave, të cilët më pas u ndanë në dy grupe për të diskutuar dy çështje të ndryshme.³⁹¹ Më vonë atë ditë, sipas këshillës së Perishiqit, përfaqësuesit e NATO-s u takuan përsëri më Millosheviqin, në prani të “të njëjtit grup personash.” Ndaj Millosheviqit u ushtrua trysni për më shumë se dy orë. Pas një bisede me këshilltarët e tij, përfshirë Millutinoviqin dhe Perishiqin, ai pranoi të plotësonte kërkesat e NATO-s dhe kërkoi që hollësitë e marrëveshjes të shqyrtoheshin me Millutinoviqin, Perishiqin dhe Gjorgjeviqin. Negociatat zgjatën rreth gjashtë orë dhe, në orën 05:00 të datës 25 tetor, ishte gati një projekt-marrëveshje që Millutinoviqi pranoi t’ia paraqiste Millosheviqit.³⁹² Pas kësaj, në orën 10:00 të datës 25 tetor 1998, të gjitha palët u takuan

³⁸⁵ Klaus Naumann, T. 8247–8248 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 3–4; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6965–6973.

³⁸⁶ Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 5-7.

³⁸⁷ Klaus Naumann, T. 8249–8251 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 11-13; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6974–6980.

³⁸⁸ Shaun Byrnes, T. 12142, 12155–12157 (16 prill 2007).

³⁸⁹ Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 14-16; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6980–6981; Rade Çuçak, T. 14933-14934 (4 shtator 2007).

³⁹⁰ Klaus Naumann, P2561 (fletinformacion plotësues me datën 7 dhjetor 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1.

³⁹¹ Shaun Byrnes, T. 12155–12157 (16 prill 2007).

³⁹² Klaus Naumann, T. 8251–8252 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 17-21; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6981–6984; P395 Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998). Sipas Millorad Obradoviqit, gjeneral i UJ-së i cili mori pjesë gjithashtu në negociatat, Perishiqi e pranoi marrëveshjen, por u tha Naumann-it dhe Clark-it se duhej bindur edhe UÇK-ja, dhe nëse nuk ndodhte kështu, ai do të ishte i detyruar t’i kthente njësitë e UJ-se në territorin nga i cili ishin tërhequr. Clark-u dhe Naumann-i e pranuan këtë kërkesë dhe premtuan se do ta zgjidhnin. Millorad Obradoviq, T. 14933–14936 (4 shtator 2007), 15121–15122 (6

me Millosheviqin dhe, sipas Naumann-it, ai dhe Clark-u patën shumë vështirësi për t'a bindur Millosheviqin që të nënshkruante. Me në fund, pas një bisede me Millutinoviqin, Millosheviqi e nënshkroi.³⁹³ Disa ditë më vonë, më 5 nëntor 1998, kur raportonte dhe sqaronte dispozitat e Marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq, Millutinoviqi u tha të pranishmëve në një takim të Shtabit të MPB-së në Kosovë:

Lidhur me ushtrinë dhe policinë jugosllave, çdo gjë do të mbetet si ka qenë deri tani (një komandë e përbashkët, njësitë e UJ-së nuk do të tërhiqen, dhe forcat policore do të pakësohen vetëm me numrin e forcave tashmë të tërhequra). Policia dhe ushtria do të kenë të drejtën të vazhdojnë të ndërhyjnë, nëse sulmohen.³⁹⁴

Sipas Prokurorisë, fjalët e thëna në këtë takim tregojnë se ai në fakt synonte t'i pengonte Marrëveshjet e Tetorit.³⁹⁵

195. Më 19 janar 1999, pas incidentit të Reçakut, u zhvillua takimi i tretë midis Clark-ut, Naumann-it dhe Millosheviqit. Ndër pjesëmarrësit e tjerë ishin Millutinoviq dhe Shainoviq. Qëllimi ishte të paralajmërohej Millosheviqi se veprime të tilla nuk duheshin përsëritur, të bindej që zbatonte dispozitat e Marrëveshjeve të Tetorit, dhe të bindej që të lejonte Prokuroren e Tribunalit, Louise Arbour, të vinte në Kosovë dhe të hetonte për incidentin. Millosheviqi i dhanë një listë me pesë deri dhjetë incidente të konstatuara nga KVM-ja ku ishte përdorur forcë e tepruar. Në përgjigjen e tij, Millosheviqi mohoi akuzat për Reçakun dhe akuzoi bashkësinë ndërkombëtare dhe Walker-in se ishin “të njëanshëm.” Më tej ai beri kundërpropozime për ardhjen e Louise Arbour-it në Kosovë, por kur Clark-u e kontaktoi, ajo gjykoj se propozimet ishin të papranueshme sepse nuk lejohej të hetonte pa kufizime.³⁹⁶

196. Naumann-i dëshmoi se, gjatë të tre takimeve të lartpërmendura, vendimet merreshin prej Millosheviqit i cili ishte autoritet më i lartë i vendit.³⁹⁷ Millutinoviqi dhe Shainoviqi nuk ndërhyjnë as nuk e korrigjuan Millosheviqin asnjëherë dhe në takimin e janarit, dukej se Shainoviqi ishte këshilltari më i ngushtë i Millosheviqit.³⁹⁸

shtator 2007). *Shih gjithashtu* P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 17; Rade Çuçak, T. 14934–14936 (4 shtator 2007).

³⁹³ Klaus Naumann, T. 8252–8253 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 22-23; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6985–6989.

³⁹⁴ P2805 (Procesverbali i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4.

³⁹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 595.

³⁹⁶ Klaus Naumann, T. 8268–8271 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 30-38; P2512 (*transkript i Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6998-7009.

³⁹⁷ Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 42.

³⁹⁸ Klaus Naumann, P2561 (fletinformacion plotësues me datën 7 dhjetor 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1, 2.

197. Përveç këtyre takimeve me përfaqësuesit e NATO-s, Dhoma dëgjoi gjithashtu se Millutinoviqi mori pjesë edhe në një takim më 24 nëntor 1998 midis Michael Phillips-it të OSBE-së dhe Millosheviqit, President i RFJ-së. Sipas Phillips-it, qëllimi i takimit ishte të diskutohej mbi bashkëpunimin. Phillips-i dëshmoi se në takim morën pjesë Millosheviqi, Shainoviqi, Millutinoviqi, Ambasadori Miles dhe Walker.³⁹⁹ Përshtypja e tij gjatë takimit ishte se Millosheviqi ishte përgjegjës për vendimet mbi forcat e sigurisë, që Shainoviqi do të zbatonte në Kosovë.⁴⁰⁰ Për sa i përket Millutinoviqit, ai rrinte pranë Millosheviqit; të dy duke shkëmbyer fjalë serbisht, dhe më pas Millutinoviqi i drejtohej Shainoviqit dhe i thoshte diçka serbisht.⁴⁰¹

198. Mirëpo, Mbrojtja pyeti pse nuk kishte shënime për takimin e datës 24 nëntor 1998 në ditarin e Phillips-it. Gjithsesi Phillips-i nguli këmbë se takimi u zhvillua. Atëherë Mbrojtja u kundërpërgjigj se sipas ditarit të tij më 24 nëntor 1998 kishte qenë në një darkë në Prishtinë bashkë me Shainoviqin, Llonçarin, Drewienkiewicz-in dhe Walker-in. Phillips-i shpjegoi se ishte i sigurt që kishte pasur një takim me Millosheviqin në nëntor 1998 dhe se Millutinoviqi ishte i pranishëm.⁴⁰² Mirëpo pas pyetjeve të mëtejshme, Phillips-i pranoi se kishte të ngjarë që Millutinoviqi të mos ketë qenë i pranishëm në takim.⁴⁰³ Gjatë pyetjeve shtesë të Prokurorisë, Phillips-i shpjegoi se ishte ngatërruar me datat por se ishte i sigurt se kishte pasur një takim me Millosheviqin gjatë të cilit ishte i pranishëm Millutinoviqi, dhe se ky takim mund të ketë ndodhur më 4 dhjetor 1998. Ai tha se Millutinoviqi foli pak gjatë takimit.⁴⁰⁴ Pyetjet shtesë të Prokurorisë shkaktuan pyetje të mëtejshme të Mbrojtjes kur Phillips-i përsëri shprehu pasiguri lidhur me praninë e Millutinoviqit në takimet përkatëse.⁴⁰⁵ Duke marrë parasysh nivelin e pasigurisë së tij, Dhoma nuk mund të shfrytëzojë dëshminë e tij se Millutinoviqi kishte marrë pjesë në një takim me Phillips-in. Faktikisht, pasiguria e shfaqur nga Phillips-i sugjeron se ai nuk ishte i interesuar në veprimet e Millutinoviqit në atë kohë.

199. Dhoma dëgjoi gjithashtu dëshminë e Knut Vollebaek-ut, i cili në vitin 1999 ishte Kryetari i Radhës i OSBE-së.⁴⁰⁶ Në vitin 1999 ai u takua me Millosheviqin tri herë: më 11 janar 1999, rreth 21 janarit 1999 dhe më 1 mars 1999. Gjithashtu ata bënë një bisedë telefonike më 24 mars 1999.⁴⁰⁷ Ai tha se në këto takime morën pjesë edhe të tjerë, herë pas here edhe Millutinoviqi. I pyetur se sa

³⁹⁹ Michael Phillips, T. 11841–11842 (19 mars 2007).

⁴⁰⁰ Michael Phillips, T. 11843 (19 mars 2007).

⁴⁰¹ Michael Phillips, T. 11843–11844 (19 mars 2007).

⁴⁰² Michael Phillips, T. 11858–11861 (19 mars 2007); 2D17 (pjesë nga ditari i Phillips-it).

⁴⁰³ Michael Phillips, T. 11862 (19 mars 2007).

⁴⁰⁴ Michael Phillips, T. 12002–12004 (20 mars 2007).

⁴⁰⁵ Michael Phillips, T. 12010–12013 (20 mars 2007).

⁴⁰⁶ Knut Vollebaek, P2634 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 janar 2002), para. 5.

takime kishte pasur në praninë e Millutinoviçit, ai u përgjigj se nuk i kujtohej sepse vëmendja e tij ishte gjithmonë e përqendruar mbi Millosheviçin i cili ishte “aktori kryesor”.⁴⁰⁸ Sipas Vollebaek-ut, Millutinoviçi përgjithësisht mbështeste Millosheviçin në këto takime. Ai nuk fliste shpesh me Vollebaek-ut, por herë pas here i adresoi komente. Sipas Vollebaek-ut, shprehja në fytyrën e Millutinoviçit tregonte qartë se ai e përbuzte.⁴⁰⁹

200. Dëshmitë e përmbledhura më lart për takimet midis Millutinoviçit dhe përfaqësuesve të NATO-s dhe të OSBE-së tregojnë se ai nuk luajti rol aktiv gjatë tyre dhe se nuk dallohej kurrë si njeri me ndikim apo i angazhuar në bisedime. Të gjithë dëshmitarët të cilët dëshmuar për këto takime ishin të mendimit se Millosheviçi ishte plotësisht në komandë dhe se Shainoviçi ishte i dyti. Gjithashtu, disa dëshmitarë si Phillips-i dhe Vollebaek-u, nuk ishin as në gjendje të konfirmonin praninë e Millutinoviçit gjatë disa takimeve.

201. Për sa u përket pretendimeve të qëndrimit pengues kundër zbatimit të Marrëveshjeve të Tetorit, Dhoma kujton përfundimin e saj më të hershëm se udhëheqja e RFJ-së/Serbisë nuk kishte shumë dëshirë të pranonte trupa të huaja në territorin e vendit.⁴¹⁰ Mirëpo, edhe duke marrë parasysh këtë, deklarata e Millutinoviçit gjatë takimit të datës 5 nëntor nuk është automatikisht provë e mbështetjes së tij për shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit. Ky takim u zhvillua disa ditë pasi bashkësia ndërkombëtare kishte lavdëruar autoritetet e RFJ-së/Serbisë për tërheqjen e njësisve të tyre në përputhje me afatet e caktuara në Marrëveshjet e Tetorit.⁴¹¹ Rrjedhimisht deklarata e Millutinoviçit se çdo gjë do të mbetej si kishte qenë deri atëherë, përfshirë forcat tashmë të pakësuara të MPB-së dhe mostërheqjen e forcave të UJ-së, mund të nënkuptonte edhe zbatimin e marrëveshjeve deri në atë datë. Duhet pasur parasysh se Marrëveshjet e Tetorit lejonin praninë e vazhdueshme të UJ-së në brezin kufitar, me tri kompani të UJ-së për patrullimin e tri rrugëve kryesore në Kosovë dhe me disa trupa të tjera në Kosovë, por në kazerma. Së fundi, pohimi i Millutinoviçit se forcat kishin të drejtën e vetëmbrojtjes, ishte në përputhje me Marrëveshjet e Tetorit të cilat përfshinin një dispozitë vetëmbrojtjeje. Për këto arsye Dhoma nuk është bindur se qëllimi i vizitës së Millutinoviçit në Shtabin e MBP-së në Kosovë ishte që të nxiste zyrtarët e MPB-se për të shkelur Marrëveshjet e Tetorit, siç pretendon Prokuroria.

⁴⁰⁷ Knut Vollebaek, P2634 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 janar 2002), para. 18, P2632 (transkript i *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7644-7646.

⁴⁰⁸ Knut Vollebaek, T. 9505, 9512 (31 janar 2007), P2632 (transkript i *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7655-7656.

⁴⁰⁹ Knut Vollebaek, T. 9509 (31 janar 2007), P2634 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 janar 2002), para. 23. 39.

⁴¹⁰ *Shih* Seksionin VI.D.

⁴¹¹ 2D10 (pjesa nga Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989–1999*); Karol John Drewienkiewicz, T. 7885–7886 (5 dhjetor 2006). *Shih gjithashtu* John Crosland, T. 9869 (8 shkurt 2007); 6D1669 (Raport i ambasadës së SHBA-së në Beograd në lidhje me respektimin e Marrëveshjeve të tetorit nga ana e RFJ/Serbisë, 1 nëntor 1998).

f. Millutinoviqi në Rambuje dhe në Paris

202. Si në rastin e negociatave të tjera në të cilat mori pjesë, Prokuroria pretendon se Millutinoviqi tregoi qëndrim pengues gjatë bisedimeve në Rambuje dhe Paris.⁴¹² Në të kundërt, Mbrojtja e Millutinoviqit argumenton se provat tregojnë se pretendimet lidhur me qëndrimin e Millutinoviqit në Rambuje dhe Paris janë të pabaza dhe të pasakta. Ai ishte i pranishëm në negociata për shkak të përvojës së tij në politikë dhe në diplomaci, dhe bëri çmos për të gjetur një zgjidhje paqësore për problemet në Kosovë.⁴¹³

203. Siç është përmendur në Kapitullin V, Millutinoviqi erdhi në negociatat e Rambujesë rreth 10 apo 11 shkurtit 1999, disa ditë pas fillimit. Sipas Wolfgang Petritsch-it, një nga tre ndërmjetësuesit kryesorë ndërkombëtarë, dukej se Millutinoviqi ishte zëdhënësi faktik i delegacionit, i njëjti rol që kishte pasur gjatë negociatave të brendshme.⁴¹⁴ Ratko Markoviqi, i cili ishte kryetar i delegacionit serb, dëshmoi se Millutinoviqi mori pjesë në takime me dëshirën e vetë sepse, në cilësinë e tij si President, donte të përfaqësonte Republikën e Serbisë.⁴¹⁵ Veton Surroi, anëtar i delegacionit të shqiptarëve kosovarë, tha se Millutinoviqi vinte herë pas here nga Beogradi, por dukej se nuk ishte i përfshirë drejtpërsëdrejti në negociata.⁴¹⁶

204. U pranuan si provë materiale disa mesazhe nga ambasada austriake në Beograd, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme austriake në Vjenë, që informonin për ecurinë e bisedimeve të Rambujesë.⁴¹⁷ Sipas një mesazhi më 16 shkurt 1999, në mes të bisedimeve, Hill-i udhëtoi për në Beograd dhe pati një takim triorësh me Millosheviqin dhe Millutinoviqin. Aty u diskutua për çështje më të vështira për palën e RFJ-së/Serbisë, përfshirë kushtin që të mos prekeshin sovraniteti dhe tërësia territoriale e Serbisë/RFJ-së.⁴¹⁸ Më vonë, më 18 shkurt 1999, Millutinoviqi u takua me Hill-in në Paris. Petritsch-i shpjegoi se Hill-i dhe negociatorët e tjerë ndërkombëtarë e mirëpritën Millutinoviqin në Rambuje si një vendimmarrës politik, dhe donin të flisnin me të për të arritur një marrëveshje sa më shpejt. Mirëpo, shënohet se ky takim dështoi dhe ishte “absolutisht jorezultativ” sepse çështjet me të diskutueshme, siç ishin aspektet ushtarake të marrëveshjes, mbetën të pazgjidhura. Pas takimit, Millutinoviqi mbajti një qëndrim më aktiv gjatë pjesës tjetër të

⁴¹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 596-598.

⁴¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 183, 200, 225.

⁴¹⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10848 (1 mars 2007), P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 janar 2002), p. 3, P2793 (transkript i Prokurori k. Millosheviqit, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7221. *Shih gjithashtu* Ratko Markoviq, T. 13222 (9 gusht 2007).

⁴¹⁵ Ratko Markoviq, T. 13194 (9 gusht 2007); 13541 (14 gusht 2007).

⁴¹⁶ Veton Surroi, T. 4544, 4547-4548 (10 tetor 2006).

⁴¹⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10712 (28 shkurt 2007).

⁴¹⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10718 (28 shkurt 2007); P2661 (Mesazh i Ambasadës Austriake, 18 shkurt 1999), f. 1.

negociatave në Rambuje.⁴¹⁹ Gjithsesi, pa dëshminë e Hill-it mbi këtë çështje, është e vështirë që kjo të interpretohet si pengesë nga ana e Millutinoviqit, duke marrë parasysh dëshmitë mbi qëndrimin e tij.

205. Petritsch-i dëshmoi se, më 19 apo 20 shkurt 1999, Millutinoviqi u tha negociatorëve ndërkombëtare se aspektet politike të marrëveshjes së propozuar ishin të pranueshme për delegacionin e RFJ-së. Më 23 shkurt, Markoviqi nënshkroi një letër që pretendohet se ishte hartuar nga Millutinoviqi ku konfirmohej gatishmëria për të diskutuar “kuadrin dhe natyrën e pranisë ndërkombëtare” në Kosovë.⁴²⁰ Ky qëndrim përputhej me qëndrimin e shprehur në konferencën e shtypit të dhënë nga Millutinoviqi po atë ditë ku u përsërit gatishmëria e delegacionit për të pranuar marrëveshjen politike të Rambujesë Millutinoviqi tha ndër të tjera se “u bënë përpjekje të dukshme për të arritur rezultat në konferencë, që ka të ngjarë të jetë pikënisja e takimit tjetër.”⁴²¹ Në të njëjtën kohë, ai kritikoi gjerësisht mënyrën e organizimit të bisedimeve dhe përmendi “trysninë e fortë të jashtme” mbi delegacionin e RFJ-së dhe të Serbisë. Ai gjithashtu tha se delegacioni i shqiptarëve kosovarë kishte refuzuar të takohej me delegacionin e RFJ-së/Serbisë dhe se kishte “dëmtuar shumë gjëra.”⁴²² Mirëpo, Millutinoviqi e përfundoi deklaratën duke thënë se kishte qenë e dobishme që bisedimet të filloheshin dhe se pala serbe ishte për një zgjidhje paqësore dhe një “autonomi vërtet të zgjeruar” të Kosovës.⁴²³ Bisedimet do të rifillonin në Paris më 14 mars.

206. Pas përfundimit formal të bisedimeve të Rambujesë, më 2 mars 1999 u mbajt një takim midis Hill-it dhe Millutinoviqit, Shainoviqit dhe Vuk Drashkoviqit, pas së cilit Kabineti i Millutinoviqit lëshoi një deklaratë. E vetmja provë materiale që disponon Dhoma për këtë deklaratë është raporti i KVM-së për të cilin Vollebaek-u tha se nuk ishte i saktë dhe të cilin për këtë arsye Dhoma nuk do ta marrë parasysh.⁴²⁴

207. Ratko Markoviqi konfirmoi se disa ditë më vonë, më 5 mars 1999, ai dhe Millutinoviqi patën një takim me delegacionin e RFJ-së/Serbisë dhe se, pas takimit, delegacioni ishte i gatshëm të vazhdonte bisedimet.⁴²⁵ Nga ana e tij, Petritsch-i dëshmoi se më 5 mars, Millutinoviqi lëshoi një deklaratë publike e cila tregoi qartë ndryshimin e qëndrimit të delegacionit të RFJ-së/Serbisë lidhur

⁴¹⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10724 (28 shkurt 2007); P563 (Mesazh i Ambasadës Austriake, 19 shkurt 1999), f. 2.

⁴²⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10748 (1 mars 2007), T. 10874–10875 (2 mars 2007), P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 4; Ratko Markoviq, T. 13209 (9 gusht 2007), T. 13562–13563 (14 gusht 2007); P625 (Letra e Markoviqit drejtuar Petritsch-it, Hill-it, dhe Majorski-t, 23 shkurt 1999), pranuar gjithashtu si 1D582.

⁴²¹ Ratko Markoviq, T. 13215 (9 gusht 2007); 1D586 (Konferencë shtypi e Millutinoviqit ne Paris, 23 shkurt 1999), f. 1.

⁴²² 1D586 (Konferencë shtypi e Millutinoviqit ne Paris, 23 shkurt 1999), f. 1.

⁴²³ 1D586 (Konferencë shtypi e Millutinoviqit ne Paris, 23 shkurt 1999), f. 3.

⁴²⁴ P461 (Raporti ditor i OSBE-së, 2 mars 1999); Knut Vollebaek, T. 9519–9520 (31 janar 2007).

⁴²⁵ Ratko Markoviq, T. 13219–13220 (9 gusht 2007);

me procesin e Rambujesë.⁴²⁶ Në të njëjtën ditë, Markoviqi dhe Millutinoviqi u dërguan letra Madeleine Albright-it, Hubert Vedrine-it, Joschka Fischer-it, Robin Cook-it dhe të tjerëve, duke u ankuar për “fushatën e paparë për të bindur përfaqësuesit e partive politike të lëvizjes separatiste shqiptare të nënshkruanin tekstin e ‘Marrëveshjes’ së paqenë të 23 shkurtit (në orën 09:30), para 15 marsit dhe para vazhdimit të bisedimeve të miratuara.” Ata gjithashtu deklaruan se “fushata e tanishme për nënshkrimin e 'dokumentit' të paqenë [i] habit dhe shkaktonte indinjatë sepse është e qartë se po kërkojnë të imponojnë një politikë të faktit të kryer e cila mund të rrezikojë seriozisht vazhdimësinë e procesit të negociatave.”⁴²⁷ Sipas Petritsch-it, kjo tregon një ndryshim të plotë të qëndrimit të delegacionit të RFJ-së/Serbisë në periudhën e ndërkohshme para bisedimeve të Parisit duke qenë se parashikonte se aspektet politike të marrëveshjes nuk ishin miratuar.⁴²⁸

208. Gjithashtu Petritsch-i dëshmoi se më 8 mars 1999 u takua me Millosheviqin dhe Millutinoviqin në Beograd, në prani të përfaqësuesve të tjerë të huaj, përfshirë ministrin e Punëve të Jashtme të RFJ-së, Zhivadin Jovanović, dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Joschka Fischer. Ndërsa Millosheviqi dhe Fischer-i hynë në një dhomë tjetër për një takim privat, Petritsch-i u përpoq të fliste me Millutinoviqin, por ky i fundit nuk pranoi të diskutonte për hollësitë e pjesës politike të marrëveshjes për të cilat më parë, delegacioni serb ishte treguar i gatshëm të bënte kompromis. Sipas Petritsch-it, ky takim ishte një tregues tjetër se pala serbe nuk do të pranonte marrëveshjen.⁴²⁹ Në këtë kontekst, Petritsch-i shprehu mendimin se, pas Millosheviqit, fajin më të madh për ngjarjet në Kosovë e kishte Millutinoviqi sepse ishte përkrahësi më i madh i politikës së Millosheviqit dhe më i zëshmi në përkrahjen e kësaj politike.⁴³⁰

209. Millutinoviqi mori pjesë që në nisje të bisedimeve të Parisit që filluan më 14 mars 1999. Petritsch-i dëshmoi se Millutinoviqi ishte shumë më aktiv në këto bisedime se sa në bisedimet e Rambujesë dhe se ishte e qartë se kishte ardhur me udhëzime nga Millosheviqi. Sipas Petritsch-it, këto udhëzime ishin që delegacioni i RFJ-së/Serbisë të refuzonte çdo aspekt të marrëveshjes së paqes dhe të hiqte dorë nga kompromisi i arritur në shkurt.⁴³¹ Mirëpo, Dhoma vëren se, më 16 mars

⁴²⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10758 (1 mars 2007).

⁴²⁷ Ratko Markoviqi, T. 13218–13219 (9 gusht 2007); 1D99 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Madeleine Albright-it, 5 mars 1999); 1D595 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Hubert Vedrine-it, 5 mars 1999); 1D594 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Joschka Fischer-it, 5 mars 1999); 1D593 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Lamberto Dini-t, 5 mars 1999); 1D592 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Robin Cook-it, 5 mars 1999); 1D591 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Igor Ivanov-it, 5 mars 1999); 1D32 (Procesverbali i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 8.

⁴²⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10758 (1 mars 2007).

⁴²⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10758 (1 mars 2007). P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 5, P2793 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7234–7237.

⁴³⁰ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 5.

⁴³¹ Wolfgang Petritsch, T. 10929-10930(2 mars 2007). P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 5, P2793 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7237–7238. Veton Surroi dëshmoi gjithashtu

1999, Millutinoviçi lëshoi një deklaratë shtypi në Paris, në të cilën tha se delegacioni serb ishte i gatshëm të pranonte pjesën politike të marrëveshjes nëse do të pranoheshin kundërshtimet e përmendura një ditë më parë. Kundërshtimet kishin të bënin me një përpjekje të negociatorëve ndërkombëtarë për të përfshirë kapituj shtesë në marrëveshjen politike të miratuar në Rambuje. Ai tha gjithashtu se marrëveshja duhej nënshkruar para se të diskutohej për zbatimin e saj, dhe konkludoi se kuadri dhe natyra e zbatimit duheshin diskutuar më vonë.⁴³² Sipas Ratko Markoviçit, deklarata e shtypit përputhej me deklaratën e Millutinoviçit dhënë në Rambuje më 23 shkurt 1999.⁴³³

210. Pas dështimit të mëvonshëm të bisedimeve të Parisit, delegacioni i RFJ-së/Serbisë u kthye në Beograd dhe i paraqiti një raport Kuvendit Kombëtar serb gjatë sesionit të datës 23 mars 1999.⁴³⁴ Përveç raportit të delegacionit, Millutinoviçi mbajti një fjalim në Kuvendin Kombëtar dhe shprehu mendimin e vet për bisedimet e Rambujesë dhe të Parisit, i cili, sipas Markoviçit, ishte një pasqyrim objektiv i ecurisë së bisedimeve. Ai tha se, duke marrë parasysh rrethanat, delegacioni bëri aq sa mundi. Millutinoviçi e informoi Kuvendin Kombëtar se delegacioni i RFJ-së/Serbisë në bisedimet e Rambujesë dhe të Parisit kishte qenë nën trysni të madhe që të lejonte praninë e forcave ndërkombëtare në terren në Kosovë. Faktikisht ai pretendoi se ata ishin përballur me ultimatumin "ose trupa ose bombardim", dhe e karakterizoi tërë procesin e negociatave si farsë.⁴³⁵ Pas një debati për raportin e delegacionit të RFJ-së/ Serbisë mbi bisedimet e Rambujesë dhe të Parisit, Kuvendi Kombëtar miratoi njëzëri veprimtarinë e delegacionit dhe dënoi kërcënimet e NATO-s, nëpërmjet konkluzioneve të veta. Këto konkluzione u botuan në Fletoren Zyrtare.⁴³⁶

211. Petrîtsh-i dëshmoi se, gjatë bisedimeve të Rambujesë dhe të Parisit, kritikoi më i ashpër i procesit të bisedimeve ishte Millutinoviçi, i cili ishte tepër negativ dhe cinik gjatë bisedimeve.⁴³⁷ Veton Surroi dëshmoi se njëri nga negociatorët e informoi se Millutinoviçi u kishte thënë negociatorëve se "nuk mund të merrte asnjë vendim pa shefin."⁴³⁸

se njëri nga negociatorët e informoi se Millutinoviçi u kishte thënë negociatorëve se "nuk mund të merrte asnjë vendim pa shefin." *Shih* Veton Surroi, P2361 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 gusht 1999), f. 8.

⁴³² 1D587 (Deklaratë shtypi e Millan Millutinoviçit, 16 mars 1999); 1D32 (Procesverbali i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7-9.

⁴³³ Ratko Markoviç, T. 13222 (9 gusht 2007).

⁴³⁴ Ratko Markoviç, T. 13228–13229 (9 gusht 2007); 1D32 (Procesverbali i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999).

⁴³⁵ 1D32 (Procesverbali i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 29-30. *Shih gjithashtu* Ratko Markoviç, T. 13576 (14 gusht 2007).

⁴³⁶ Ratko Markoviç, T. 13231 (9 gusht 2007); 1D33 (Konkluzione të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë pas shqyrtimit të raportit të delegacionit në bisedimet e Rambujesë dhe Parisit, 23 mars 1999).

⁴³⁷ Wolfgang Petrîtsh, P2793 (transkript i *Prokurori k. Milloshëviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7228; *shih gjithashtu* Ratomir Taniç, T. 6479-6480 (14 nëntor 2006).

⁴³⁸ Veton Surroi, P2361 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 gusht 2001), f. 8.

212. Ratko Markoviçi e vlerësoi ndryshe rolin e Millutinoviçit në negociatë. Sipas tij, Millutinoviçi nuk i pengoi asnjëherë negociatat në Rambuje apo në Paris, përkundrazi u përpoq t'i kontribuonte procesit.⁴³⁹ Gjithashtu Millutinoviçi gjithmonë mbështeti zgjidhjen e krizës kosovare nëpërmjet dialogut politik midis të dy palëve.⁴⁴⁰ Markoviçi dëshmoi se, në çdo deklaratë, delegacioni i RFJ-së/Serbisë theksoi se çështja e Kosovës mund të zgjidhej vetëm me miratimin e të gjitha pakicave etnike.⁴⁴¹ I pyetur nëse Millutinoviçi e mashtroi Kuvendin Kombëtar më 23 mars 1999, Markoviçi u përgjigj se fjalimi i tij thjesht pasqyroi çfarë kishte ndodhur.⁴⁴²

213. Dhoma kujton këtu përfundimin e mëhershëm se, në fund te fundit, të gjitha palët mbanin përgjegjësi për dështimin e negociatave në Rambuje.⁴⁴³ Rrjedhimisht dëshmitë mbi kritikën e Millutinoviçit ndaj procesit të negociatave në fazën e fundit nuk çojnë detyrimisht në përfundimin se ai nuk donte realizimin e marrëveshjes për të shmangur rrezikun e NATO-s. Dëshmitë e lartpërmendura veçanërisht të shqyrtuara së bashku me dëshmitë e diskutuara më parë në Kapitullin V, tregojnë gjithashtu se vendimi për pranimin ose mospranimin e marrëveshjes në fund të fundit ishte në dorë të Millosheviçit dhe, për këtë arsye, as Millutinoviçi, as Shainoviçi nuk kishin kompetencë për marrjen e një vendimi të kundërt. Si rrjedhojë Dhoma nuk bindet se dëshmitë e paraqitura tregojnë se Millutinoviçi personalisht mbajti qëndrim pengues duke synuar dështimin e bisedimeve. Provat lejojnë gjithashtu interpretimin se ai u përpoq të siguronte një marrëveshje të pranueshme për autoritetet e RFJ-së/Serbisë.

g. Kontaktet e Millutinoviçit me Rugovën

214. Prokuroria pretendon se në vitin 1999, gjatë bombardimit të NATO-s, Millutinoviçi ishte në dijeni për krime të ndryshme që po kryheshin në Kosovë, pjesërisht nga kontaktet e tij me Ibrahim Rugovën, kryetarin e LDK-së.⁴⁴⁴ Për më tepër, Prokuroria pohon se takimet e Millutinoviçit me Rugovën ishin jo përpjekje e sinqertë për të arritur një marrëveshje, por "pjesë e një fushate propagandistike për të devijuar vëmendjen nga krimet që po kryheshin" dhe sinonin të diskreditonin Rugovën në sytë e popullatës shqiptare kosovare.⁴⁴⁵ Mbrojtja nga ana e saj

⁴³⁹ Ratko Marković, T. 13225 (9 gusht 2007).

⁴⁴⁰ Ratko Marković, T. 13225–13226 (9 gusht 2007).

⁴⁴¹ Ratko Marković, T. 13226–13227 (9 gusht 2007).

⁴⁴² Ratko Marković, T. 13229–13230 (9 gusht 2007).

⁴⁴³ *Shih* Kapitullin V.

⁴⁴⁴ Aktakuza, para. 39 (b).

⁴⁴⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 591.

argumenton se takimet e Millosheviqit me Rugovën ishin përpjekje të sinqerta për rivendosjen e paqes dhe për përtëritjen e hapave për një marrëveshje mbi vetëqeverisjen në Kosovë.⁴⁴⁶

215. Nuk kundërshtohet se Millutinoviqi dhe Rugova u takuan në Prishtinë më 28 prill 1999 ku ishte i pranishëm edhe Ratko Markoviqi. Markoviqi dëshmoi se takimi u zhvillua në një atmosferë konstruktive. Në fund të takimit, Millutinoviqi dhe Rugova firmosën një deklaratë të përbashkët me anë të së cilës theksuan nevojën për rifillimin dhe intensifikimin e menjëhershëm të bisedimeve të filluara midis qeverisë së Republikës së Serbisë dhe udhëheqësve të partive politike shqiptare në Kosovë. Ata ranë dakord gjithashtu për nevojën e krijimit, në kushte të ndryshuara, të një këshilli ekzekutiv të përkohshëm i cili do të kryente funksionin e një qeverie të përkohshme deri në themelimin e organeve.⁴⁴⁷

216. Provat për këtë takim ndodhen gjithashtu në një deklaratë dëshmitari të shkruar nga i ndjeri Rugova, e cila u përgatit për procesin *Milloseviq* si dhe në transkriptin e dëshmisë së tij në atë çështje.⁴⁴⁸ Gjithashtu, Dhoma dëgjoi dëshminë e sekretarit personal të Rugovës, Adnan Merovci.⁴⁴⁹ Dëshmitë e dy të lartpërmendurve mbi këtë takim ishin paksa të ndryshme nga dëshmia e Markoviqit.⁴⁵⁰

217. Edhe Rugova edhe Merovci dëshmuan se nga 31 mars 1999 ndodheshin në arrest shtëpiak, kur Rugova pak a shumë u shtrëngua të takohej fillimisht me Millosheviqin, më pas me Shainoviqin dhe me Ratko Markoviqin dhe Shainoviqin bashkë.⁴⁵¹ Sipas Merovcit, më 13 prill 1999, Shainoviqi erdhi në shtëpinë e Rugovës dhe sugjeroi që Rugova të takohej me Millutinoviqin. Merovci tha se Rugova e pranoi takimin duke qenë se në atë kohë ata kishin kuptuar se nuk kishte kuptim që të refuzonin takime të tilla. Rugova vetë tha se e pranoi takimin vetëm sepse ndërmjetësuesit ishin këmbëngulës dhe agresivë. Më 16 prill 1999, Rugova dhe Merovci u çuan në Beograd me makinë, te ndërtesa e Presidencës, ku u takuan me Millutinoviqin dhe Shainoviqin. Gazetarët dhe fotografët i prisnin.⁴⁵² Merovci dëshmoi se, gjatë takimit

⁴⁴⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 272-276.

⁴⁴⁷ Ratko Markoviq, T. 13234–13235 (9 gusht 2007); Jovan Kojiq, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 gusht 1999), para. 48; P416 (Deklaratë e përbashkët e nënshkruar nga Rugova dhe Millutinoviqi, 28 prill 1999).

⁴⁴⁸ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999); P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T).

⁴⁴⁹ Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000).

⁴⁵⁰ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999); Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 17.

⁴⁵¹ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 9; P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4225–4226; Adnan Merovci, P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 52–66.

⁴⁵² Adnan Merovci, T. 8464–8465 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 68; 1D60 (pamje filmike të takimit të 16 prillit 1999); Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill

Millutinoviqi foli për unitet të plotë të qeverisë dhe kundërshtoi emërtimin Presidenti i Kosovës për Rugovën duke qenë se sipas Kushtetutës së RFJ-së apo të Serbisë një post i tilli nuk ekzistonte.⁴⁵³ Sipas Rugovës, takimi u kryesua nga Millutinoviqi.⁴⁵⁴ Kur Rugova e informoi Millutinoviqin për shpërnguljet e dhunshme, dhunën dhe shtypjen në Kosovë, Millutinoviqi u përgjigj se faj për këtë kishte bashkësia ndërkombëtare. Gjatë këtij takimi, të tre lëshuan një deklaratë shtypi të panëshkruar. Në atë deklaratë, Rugova shkroi se Beogradi duhej të pranonte kushtet e bashkësisë ndërkombëtare.⁴⁵⁵

218. Takimi tjetër u zhvillua në Prishtinë më 28 prill 1999 dhe në të morën pjesë Rugova, Merovci, Millutinoviqi, Shainoviqi, Angjelkoviqi dhe Ratko Markoviqi. Gjatë takimit, Millutinoviqi tha se kishte parë dëmtime në Prishtinë të shkaktuara nga NATO-ja, por nuk kuptonte pse njerëzit po braktisnin qytetin. Merovci i tha Millutinoviqit se njerëzit po largoheshin sepse po i dëbonin nga shtëpitë e tyre dhe se faj për këtë kishin serbë me uniformë. Sipas Merovcit, Millutinoviqi iu drejtua Shainoviqit dhe e pyeti nëse ishte e vërtetë. Shainoviqi nuk dha përgjigje, por shprehu habi. Gjatë takimit për Merovcin u bë e qartë se pala e RFJ-së/Serbisë mendonte të lironte atë dhe Rugovën që ata të shkonin jashtë shteti. Merovci i kishte thënë Millosheviqit personalisht në një nga takimet e para se donin të largoheshin nga Kosova për t'u këshilluar me ndihmësit dhe kolegët e Rugovës të cilët gjendeshin jashtë. I pyetur drejtpërsëdrejti për këtë, Millutinoviqi tha se i duheshin 24 orë para se t'i jepte Merovcit një përgjigje. Tridhjetë orë më vonë, Merovci u informua me telefon se duhej të takoheshin sërish me Millosheviqin për të zgjidhur problemin.⁴⁵⁶ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Merovci u pyet për këtë takim me Millosheviqin dhe iu treguan pamje filmike të Millutinoviqit dhe të Rugovës pas takimit duke u dhënë deklarata gazetarëve. Në këtë filmim Rugova foli për mirëbesimin e ri të të dy palëve dhe për dëshirën për të krijuar organe të reja të vetëqeverisjes në Kosovë. Merovci nguli këmbë se këto takime u inskenuan si propagandë dhe se Rugova nuk kishte mundësi tjetër veçse të merrte pjesë në to.⁴⁵⁷

1999), f. 11; P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4234–4235. *Shih gjithashtu* Lubivoje Joksiq, T. 21993 (8 shkurt 2008).

⁴⁵³ Adnan Merovci, T. 8465–8467 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 68.

⁴⁵⁴ Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 11; P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4234–4235.

⁴⁵⁵ 1D607 (Deklarata e shtypit e Millan Millutinoviqit, 16 prill 1999); P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4235. Rugova mendonte se Shainoviqi ishte zyrtari me më shumë përgjegjësi për Kosovën dhe se kishte “pushtet të mirëfilltë”. Disa herë gjatë bombardimit të NATO-s, Shainoviqi i tha Rugovës se i duhej të takohej me dikë, përfshirë Millutinoviqin. *Shih* Ibrahim Rugova, P 2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 12; P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4236.

⁴⁵⁶ Adnan Merovci, T. 8468–8474 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 58–59, 72.

⁴⁵⁷ Adnan Merovci, T. 8502–8509 (17 janar 2007). *Shih gjithashtu* Lubivoje Joksiq, T. 21993–21995 (8 shkurt 2008).

219. Në deklaratën dhe dëshminë e tij në çështjen *Milloseviq*, Rugova konfirmoi se, në fund prilli 1999, Millutinoviçi erdhi në Prishtinë ku u takuan. Me “kërkesën e Beogradit”, palët lëshuan një dokument të nënshkruar ku thuhej se duhej të rifillonin dhe intensifikoheshin bisedimet e drejtpërdrejta midis qeverisë serbe dhe partive politike shqiptare të Kosovës që të arrihej një marrëveshje politike ku Kosovës t’i akordohej vetëqeverisje e gjerë, ku të gjithë qytetarët do të ishin të barabartë dhe të respektohej sovraniteti dhe tërësia territoriale e Jugosllavisë.⁴⁵⁸ Gjithashtu në deklaratë theksohej se ishte arritur një marrëveshje për të krijuar një këshill ekzekutiv të përkohshëm në Kosovë, i cili do të funksiononte si qeveri e përkohshme.⁴⁵⁹ Rugova tha se nuk donte të nënshkruante deklaratën dhe se nuk kishte marrë pjesë në hartimin e saj, por në fund ai u përkul.⁴⁶⁰ Ai theksoi gjithashtu se, në kohën e hartimit të deklaratave, e ndjente vetën si i burgosur.⁴⁶¹ Rugova konkludoi se ai mendonte se qëllimi i takimeve dhe të deklaratave të lëshuara ishte nxitja e konflikteve politike në bashkësinë shqiptare kosovare dhe për ta diskredituar në sytë e publikut shqiptar kosovar.⁴⁶²

220. Gjatë intervistës me Prokurorinë, vetë Millutinoviçi foli për takimin e fundit dhe konfirmoi se Rugova e kishte vizituar në Beograd. Gjithashtu Millutinoviçi pretendoi se Rugova i kishte kërkuar ndihmë që të largohej nga vendi sepse ishte i rrezikuar fizikisht nga shqiptarët e tjerë kosovarë.⁴⁶³ Millutinoviçit iu tha se vizita ishte kundër dëshirës së Rugovës. Millutinoviçi e kundërshtoi këtë sugjerim dhe përsëriti se opozita shqiptare kosovare ishte përprjekur të vriste Rugovën dhe për këtë arsye Rugova donte t’u bashkohej anëtarëve të tjerë të partisë së tij të cilët ishin larguar nga vendi. Millutinoviçi pretendoi se Rugova kurrë nuk kishte thënë se merrte pjesë në atë takim ishte kundër dëshirës së tij. Gjatë takimit, ai madje i dha Millutinoviçit një dhuratë.⁴⁶⁴ Millutinoviçi tha gjithashtu se, kur Rugova shprehu dëshirën e tij për të shkuar në Itali, Millutinoviçi personalisht i telefonoi ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë për këtë qëllim. Si rezultat, italianët e pranuan Rugovën dhe dërguan një avion për ta marrë.⁴⁶⁵

221. Më parë Dhoma ka konkluduar se në prill 1999, Rugova ndodhej në Prishtinë në arrest shtëpiak.⁴⁶⁶ Mirëpo, në krahasim me Shainoviçin dhe Joksiqin të cilët kishin kontakte më të shpeshta me Rugovën dhe i shkonin në shtëpi, kontaktet e Millutinoviçit me Rugovën konsistojnë

⁴⁵⁸ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4236-4237.

⁴⁵⁹ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4251.

⁴⁶⁰ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4251-4252.

⁴⁶¹ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4283.

⁴⁶² Ibrahim Rugova, P2613 (deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 12, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4256.

⁴⁶³ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 41-45.

⁴⁶⁴ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 212-216.

⁴⁶⁵ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 40-41.

vetëm në dy takime, një në Beograd dhe një në Prishtinë në ndërtesën krahinore. Takimi i Beogradit u zhvillua në një kohë kur Rugova dhe Merovci kuptuan se nuk kishte kuptim që ata të kundërshtonin njerëzit që po përgatisnin takimet. Takimi i Prishtinës trajtoi çështjen e organizimit të largimit të Rugovës për në Itali, gjë që në fund u rregullua nga Millutinoviçi. Rrjedhimisht megjithëse është e mundshme që Millutinoviçi të ishte në dijeni të arrestit shtëpiak të Rugovës dhe për situatën e tij, gjithsesi nuk është e sigurtë Përshtypja e Dhomës është se bisedimet me Rugovën ishin thjesht propagandë për të krijuar përshtypjen se po bëheshin përpjekje për të negociuar me shqiptarët kosovarë, për të arritur ndërprerjen e bombardimit të NATO-s.

3. Pozita e Millutinoviçit si anëtar i SPS-së

222. Prokuroria pretendon se Millutinoviçi, si anëtar i lartë i SPS-së, ushtroi ndikim mbi ngjarjet në Kosovë dhe se zbatoi politikën e Millosheviçit.⁴⁶⁷ Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se Millutinoviçi ishte thjesht anëtar i Këshillit Kryesor të partisë dhe jo anëtar i Komitetit Ekzekutiv, dhe se kurrë nuk kishte ndonjë post me rëndësi në parti gjatë kohës që mbulohej nga Aktakuza.⁴⁶⁸ Dhoma u referohet përfundimeve në lidhje me pozitën e Millutinoviçit brenda partisë dhe faktit se ishte vërtet anëtar i Këshillit Kryesor.⁴⁶⁹

223. Për të përcaktuar angazhimin e Millutinoviçit në parti, Dhoma ka shqyrtuar procesverbalin e disa mbledhjeve të ndryshme të mbajtura nga SPS-ja në të cilat mori pjesë Millutinoviçi. Për shembull, më 10 qershor 1998, ai ishte i pranishëm në sesionin e 16-të të Këshillit kryesor të SPS-së, bashkë me Millosheviçin, Shainoviçin, Angjelkoviçin, Miniçin dhe Kertesin, ndër të tjerë. Në këtë mbledhje SPS-ja vendosi të dërgonte Angjelkoviçin, Miniçin dhe Matkoviçin në Kosovë për të bashkërenduar veprimtarinë politike të SPS-së në Kosovë. Procesverbali nuk pasqyron çfarë tha Millutinoviçi në atë mbledhje.⁴⁷⁰

224. Dushan Matkoviçi, anëtar i Grupit të Punës për Kosovën, dëshmoi se më 25 qershor 1998, Grupi u kthye në Beograd për një takim me Millosheviçin, ku Millosheviçi, Millutinoviçi dhe Shainoviçi iu raportua për bisedimet e tyre me anëtarët e SPS-së në Kosovë. Sipas Markoviçit, Millutinoviçi nuk tha gjë në atë takim.⁴⁷¹

⁴⁶⁶ *Shih* Pjesën VII.J.

⁴⁶⁷ Aktakuza, para. 35(g).

⁴⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 126.

⁴⁶⁹ *Shih* Kapitullin IV.

⁴⁷⁰ P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 6-8.

⁴⁷¹ Dushko Matkoviçi, T. 14590–14591 (29 gusht 2007), T. 14633–14634 (30 gusht 2007), P2913 (deklarata e dëshmitarit me datën 10 shkurt 2003), f. 7–8. *Shih edhe* Millomir Miniç, T. 14744–14745 (31 gusht 2007).

225. Dhoma ka si provë materiale edhe procesverbalet e katër sesioneve të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së në të cilat mori pjesë Millutinoviqi, jo si anëtar por si Presidenti i Serbisë. Në sesionin e datës 22 shtator, u konkludua se gjendja në Kosovë po kthehej në normalitet.⁴⁷² Në këtë sesion u paraqit një raport dhe një përmbledhje e veprimtarisë së kryer në përputhje me konkluzionet e Këshillit Kryesor më 10 qershor 1998. Pas këtij sesioni, u pakësua veprimtaria e Grupit të Punës në Kosovë.⁴⁷³

226. Më 14 tetor 1998, Millutinoviqi mori pjesë në një sesion tjetër të Komitetit Ekzekutiv ku mbajti fjalën e hapjes dhe foli për rëndësinë e Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq, si dhe për detyrat e ardhshme. Për Komitetin Ekzekutiv, ardhja e KVM-së të OSBE-së nënkuptonte eliminimin e përhershëm të kërcënimit të përdorimit të forcës.⁴⁷⁴

227. Në sesionin e datës 27 tetor 1998, Millutinoviqi, bashkë me Shainoviqin, Angjelkoviqin, Miniqin dhe Zhivadin Jovanoviqin, diskutuan për zbatimin e Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq. Ata informuan të pranishmit për bisedimet e fundit të Milloshëviqit me bashkësinë ndërkombëtare në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes. Pastaj folën për hapat e ndërmarra deri në atë kohë për zbatimin e Marrëveshjes dhe për përgjegjësinë e tërë organeve shtetërore për të vepruar në mënyrë të organizuar. Folësit paralajmëruan për pasojat eventuale negative të një qëndrimi të shkujdesur ndaj zbatimit, duke theksuar nevojën që të gjitha organet dhe institucionet e ngarkuara me detyrën e zbatimit të Marrëveshjes të merrnin urgjentisht hapat e nevojshme dhe të bënin plane konkrete. Komiteti konkludoi se ishte e rëndësishme që të shtohet dhe të përforcohet “elementi kombëtar serb në Kosovë” dhe theksoi se ishte e nevojshme të bëhej përpjekje maksimale për të “depërtuar” në pakicën shqiptare kosovare që kjo popullatë të merrte pjesë në të gjitha aspektet e jetës dhe të punës në Kosovë, si dhe për të rikrijuar besim të ndërsjellë.⁴⁷⁵

228. Më 3 qershor 1999 u zhvillua një sesion tjetër i Komitetit Ekzekutiv në të cilin mori pjesë Millutinoviqi. Në këtë sesion, Millutinoviqi raportoi për projekt-planin e propozuar nga Çernomërdini dhe Ahtisaari për mbarimin e fushatës së NATO-s. Millutinoviqi dha shpjegime të hollësishme mbi planin dhe komente mbi dispozita të ndryshme të planit. Pas sesionit, Komiteti

⁴⁷² Millan Jovanoviq, T. 14163–14165 (22 gusht 2007); 2D56 (Procesverbal i sesionit të 88-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 22 shtator 1998).

⁴⁷³ Millan Jovanoviq, T. 14166–14167 (22 gusht 2007); 2D77 (Procesverbali i sesionit të 89-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 14 tetor 1998).

⁴⁷⁴ Millan Jovanoviq, T. 14167–14168 (22 gusht 2007); 2D77 (Procesverbali i sesionit të 89-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 14 tetor 1998).

⁴⁷⁵ Millan Jovanoviq, T. 14169–14171 (22 gusht 2007); 2D88 (Procesverbali i sesionit të 90-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 27 tetor 1998), f. 2, 3.

Ekzekutiv u dha udhëzime deputetëve të SPS-së në Kuvendin Kombëtar për të mbështetur planin.⁴⁷⁶

229. Gjatë intervistës me Prokurorinë, Millutinoviçi u pyet nëse kishte pasur ndonjë takim privat me Millosheviçin dhe të tjerë gjatë luftës. Ai pranoi se kishte pasur disa takime të pakta me anëtarë të SPS-së, zakonisht mbledhje të vogla të Komitetit Ekzekutiv dhe zakonisht në lidhje me furnizimet, funksionimin e industrisë, etj.⁴⁷⁷

230. Së fundi, Prokuroria i referohet gjerësisht letrës së dërguar Millutinoviçit më 19 qershor 1998 nga kryetari i Komitetit Krahinor të SPS-së në Kosovë, Vojisllav Zhivkoviçi.⁴⁷⁸ Zhivkoviçi përshkruante gjendjen e serbëve në Kosovë dhe sugjeronte se të gjithë meshkujt serbë të aftë për shërbim ushtarak në krahinë të organizoheshin në njësi, të armatoseshin dhe të përdroreshin për të mbrojtur Kosovën. Kur ia treguan letrën, Kojiçi tha se Millutinoviçi, pasi e lexoi, udhëzoi punonjësit e tij ta arkivonin, gjë që e bënë menjëherë. Sipas Kojiçit, kjo do të thoshte se nuk u morën masa të mëtejshme. Kojiçi shpjegoi se dihej gjerësisht se Millutinoviçi nuk kishte marrëdhënie të mira me gjithë udhëheqjen e SPS-së në Kosovë sepse e kishte kritikuar gjatë fushatës zgjedhore të vitit 1997.⁴⁷⁹ Millan Jovanoviçi, anëtar i lartë i partisë i cili ishte i pranishëm në mbledhjet e Këshillit Kryesor dhe të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, dëshmoi se gjatë atyre mbledhjeve nuk u diskutua kurrë për armatimin e popullatës serbe dhe se vija e partisë ishte e qartë: sovraniteti nuk mund të mbrohej individualisht dhe duhet t'i lihej policisë dhe ushtrisë.⁴⁸⁰ Dhoma kujton këtu përfundimin e saj lidhur me armatosjen e popullatës joshqiptare në Kosovë dhe vëren se urdhri i parë i armatosjes ishte lëshuar më 21 maj 1998, para letrës në fjalë.⁴⁸¹

231. Pasi ka shqyrtuar materialin e lartpërmendur, Dhoma vëren se Millutinoviçi ishte anëtar i Këshillit Kryesor të përbërë prej 250 anëtarësh të SPS-së.⁴⁸² Në vitin 1998, ai mori pjesë gjithashtu në katër mbledhje të Komitetit Ekzekutiv në cilësinë e Presidentit të Republikës dhe për të informuar për marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare të nënshkruara në emër të RFJ-së. Ai gjithashtu pranoi se kishte marrë pjesë në disa mbledhje të Komitetit Ekzekutiv gjatë luftës, por tha se ato kishin trajtuar aspektin e furnizimeve dhe funksionimin e industrisë gjatë bombardimit. Rrjedhimisht, Dhoma ka marrë shumë pak prova për ndikimin e Millutinoviçit brenda partisë dhe

⁴⁷⁶ 2D259 (Procesverbali i sesionit të 107-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 3 qershor 1999), f. 1–2.

⁴⁷⁷ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101-103.

⁴⁷⁸ P2828 (Letra e Vojisllav Zhivkoviçi Millan Millutinoviçit, 19 qershor 1998).

⁴⁷⁹ Jovan Kojiçi, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 98.

⁴⁸⁰ Millan Jovanoviçi, T. 14216–14218 (22 gusht 2007).

⁴⁸¹ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës, 21 maj 1998), f. 1; Bozhidar Filiçi, T. 24013 (10 mars 2008). *Shih edhe* Pjesën VIII.B.

⁴⁸² *Shih* Kapitullin IV.

jashtë saj, dhe ka marrë disa prova të pakundërshtueshme mbi faktin se ai nuk kishte marrëdhënie të mira me anëtarët e SPS-së në Kosovë.

4. Marrëdhëniet dhe kontaktet e Millutinoviçit me Presidentin e RFJ-së, Millosheviçin

232. Prokuroria pretendon se Millutinoviç ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Millosheviçit dhe, në mbështetje të këtij pretendimit, shfrytëzon kryesisht dëshminë e Petritsch-it lidhur me negociatat në Paris.⁴⁸³

233. Gjatë intervistës me Prokurorinë, Millutinoviç shpjegoi se nuk kishte marrëdhënie të ngushta me Millosheviçin dhe se konkurroi për President të Serbisë vetëm sepse SPS-ja kishte nevojë për një kandidat i cili do të përballej me Vojislav Sheshelin dhe partinë e tij. Ai tha gjithashtu se, gjatë fushatës së NATO-s kishte pasur grindje të shpeshta me Millosheviçin.⁴⁸⁴ Millutinoviç shpjegoi se në 99 për qind të kohës, Millosheviç komunikonte kokë më kokë me njerëzit, duke lënë të kuptohej se ai nuk kishte mundësi të dinte se çfarë diskutonte Millosheviç me zyrtarët e tjerë.⁴⁸⁵ Sipas Kojiçit, në vitin 1998 Millutinoviç takohej me Millosheviçin rreth një herë në muaj.⁴⁸⁶ Millosheviç e vizitoi Presidencën dy herë, një herë në vitin 1998 dhe një herë në vitin 2000, për të marrë pjesë në pritje të organizuara më 28 mars në festën e ditës kombëtare të Serbisë.⁴⁸⁷

234. Millutinoviç u pyet gjatë intervistës nëse, gjatë bombardimit të NATO-s, kishte pasur takime me Millosheviçin dhe Ojdaniçin bashkë. Ai u përgjigj se gjatë asaj kohe kishte pasur 1-3 takime me ta dhe la të kuptohej se kjo lidhej me punën e tij për largimin e lëndëve të rrezikshme nga fabrikat e goditura nga NATO-ja.⁴⁸⁸ Ai gjithashtu mohoi se kishte marrë pjesë në takime me Millosheviçin në të cilat i dyti diskutoi UJ-në dhe veprimet e saj në Kosovë sepse ai (Millutinoviç) ishte marrë me probleme civile të furnizimit.⁴⁸⁹

235. Gjithashtu, gjatë fushatës së NATO-s, Millosheviç thërriste shpesh mbledhje gjysmëorëshe me zyrtarë të tjerë, përfshirë Millutinoviçin, Kryeministrin e RFJ-së, dhe ministrin e Mbrojtjes, për t'i treguar popullsisë se ata ishin të gjithë në vend gjatë krizës. Këto ishin mbledhje publike në Beli Dvor, me njerëz rreth e rrotull, ku gazetarët bënin fotografi. Në ato mbledhje, Millutinoviç informohej për gjendjen, por vetëm në vija të përgjithshme, sepse “luftimet” komandoheshin nga

⁴⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 564-565.

⁴⁸⁴ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 1-5.

⁴⁸⁵ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7-8.

⁴⁸⁶ Jovan Kojiç, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 33.

⁴⁸⁷ Jovan Kojiç, 1D741 (deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 29.

⁴⁸⁸ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviçin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 69.

shefi i Shtabit të Komandës së Lartë i cili i raportonte vetëm Presidentit të RFJ-së. Të dhënat që mori Millutinoviqi në ato takime ishin, në shumicën e rasteve, për dëmet e shkaktuara nga bombardimi i NATO-s.⁴⁹⁰ Më vonë, gjatë intervistës, doli se kishte pasur 12 takime te tilla, duke filluar nga 25 marsi. Tri takime u zhvilluan në mars, pesë në prill dhe katër në maj. Fotografitë e takimeve u botuan në *Politika*.⁴⁹¹

236. I pyetur nëse ndonjë përfaqësues i Ministrisë së Brendshme mori pjesë në ato takime, Millutinoviqi tha se mendonte se jo, por se kjo mund të verifikohet duke shfletuar artikujt e gazetës *Politika* të botuar në atë kohë.⁴⁹² Ai tha gjithashtu se në ato takime nuk u diskutua për veprimet e UJ-së apo të MPB-së në Kosovë, sepse nuk kishte shumë kohë dhe askush nga organet përkatëse nuk ishte i pranishëm. U diskutua vetëm përgjithësisht për UJ-në, d.m.th. për mbrojtjen e vendit nga sulmet e NATO-s, përfshirë çështjet e mbrojtjes civile, dhe për këtë arsye ishte i pranishëm ministri i Mbrojtjes.⁴⁹³ I pyetur nëse kjo donte të thoshte se UÇK-ja nuk konsiderohej problem, ai tha se ajo konsiderohej problem i madh, por se kjo çështje nuk u diskutua gjatë këtyre takimeve sepse të pranishmit nuk merreshin me atë çështje.⁴⁹⁴

237. Millomir Miniq foli për të njëjtat takime. Ai konfirmoi se gjatë fushatës së NATO-s, figura të ndryshme të udhëheqjes së RFJ-së dhe të Serbisë u takuan më Millosheviqin. Ndër të pranishmit ishin Millutinoviqi, Momir Bullatoviqi (Kryeministri i RFJ-së), Pavle Bullatoviqi (ministri i Mbrojtjes së RFJ-së), Zhivadin Jovanoviqi (ministri i Punëve të Jashtme të RFJ-së), dhe Kryetari i Kuvendit të RFJ-së dhe ai i Serbisë, një prej të cilëve ishte Miniq. Sipas tij, qëllimi i takimeve ishte të informoheshin të gjithë të pranishmit për gjendjen në vend dhe takimet filmoheshin dhe transmetoheshin në televizion, për t'i treguar publikut se udhëheqja ishte ende në vend. Takimet u zhvilloheshin në Beli Dvor dhe zgjasnin rreth një gjysmë ore.⁴⁹⁵ Miniq dëshmoi gjithashtu se në takimin e parë ishte edhe Ojdaniqi, por nuk i kujtohej nëse ai ose ndonjë përfaqësues tjetër i UJ-së apo të MBP-së ishte i pranishëm në takimet e tjera. Edhe Miniq mohoi se ishte diskutuar ndonjë herë për çështje të mbrojtjes. Më shumë u diskutua për problemet e furnizimit, të energjisë elektrike dhe të rimëkëmbjes së vendit.⁴⁹⁶

⁴⁸⁹ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 122-128.

⁴⁹⁰ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 68-79.

⁴⁹¹ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 86-87, 98.

⁴⁹² P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 101.

⁴⁹³ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 128-131.

⁴⁹⁴ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 131-135.

⁴⁹⁵ Millomir Miniq, T. 14758-14761 (31 gusht 2007).

⁴⁹⁶ Millomir Miniq, T. 14758-14762 (31 gusht 2007).

238. Millutinoviqi u pyet për marrëdhëniet e tij personale me Millosheviqin. Ai shpjegoi se kishte një mosmarrëveshje personale me të “për shkak të mospajtimit të tij [të Millutinoviqit] personal gjatë luftës,” dhe se, për këtë arsye, gjatë luftës mori pjesë vetëm në takime të shkurtra të lartpërmendura. Ai tha se, megjithëse publiku kishte përshtypje se ai ishte afër Millosheviqit, realiteti ishte i ndryshëm sepse Millosheviqi e kishte të vështirë të pranonte shumë gjëra të papëlqyeshme që Millutinoviqi i thoshte. Për këtë arsye, ai u mënjanua pas Rambujesë edhe pse mbeti figurë popullore në publik.⁴⁹⁷ I pyetur nëse i kishte thënë dikujt për mosmarrëveshjen, Millutinoviqi u përgjigj se i kishte treguar gruas. Nuk donte të fliste për natyrën e mosmarrëveshjes (dhe të mospajtimit të tij), por tha se nuk ishte politike. Më shume, lidhej me çështje personale dhe diçka që bënte të ndihej shumë i fyer.⁴⁹⁸

239. Dëshmitë, ndër të cilat dëshmia e Petritsch-it, nuk i lanë Dhomës përshtypjen e qartë se Millutinoviqi kishte marrëdhënie të ngushtë personale apo profesionale me Millosheviqin. Në krahasim me Shainoviqin, i cili konsiderohej gjerësisht bashkëpunëtori më i ngushtë i Millosheviqit, Millutinoviqi kishte më pak kontakt me Millosheviqin. Gjithashtu në ndryshim me Shainoviqin, Dhoma nuk ka marrë prova që tregojnë se ata të dy kishin takime personale pa praninë e zyrtarëve të tjerë të lartë të autoriteteve të RFJ-së/Serbisë.

5. Synimi kriminal i Millutinoviqit për Kosovën dhe shqiptarët kosovarë

240. Prokuroria pretendon se Millutinoviqi kishte të njëjtin synim për realizmin e qëllimit të përbashkët të ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës me mjete kriminale dhe se kishte folur publikisht në lidhje me këtë.⁴⁹⁹ Mbrojtja e Millutinoviqit argumenton se Millutinoviqi ishte i përkushtuar në gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për problemet e Kosovës. Ai mbështeti qëndrimin e shprehur nga Kuvendi Kombëtar i Serbisë, dhe më vonë të qeverisë së RFJ-së, se thelbi i problemit ishte separatizmi shqiptar dhe terrorizmi si mjet për shpëputje, megjithëse gjithmonë bënte dallimin midis anëtarëve të UÇK-së dhe shqiptarëve kosovarë që donin të jetonin në paqe brenda RFJ-së.⁵⁰⁰

241. Në mbështetje të qëndrimit të saj, Prokuroria citon dëshminë e Petritsch-it se atij i kujtohej një takim me delegacionin e RFJ-së/Serbisë ku anëtarët e tij u shprehën se “bombardimi i Serbisë do të çojë në masakra.”⁵⁰¹ Në deklaratën e dëshmitarit dhe gjatë dëshmisë në procesin *Millosheviq*, Petritsch-i ia atribuoi shprehjen Shtambukut. Mirëpo, në sallën e gjyqit para Dhomës, Petritsch-i

⁴⁹⁷ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 148-149.

⁴⁹⁸ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 156.

⁴⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 618-629.

⁵⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 170-174.

⁵⁰¹ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), p. 3; P562 (Mesazhi i ambasadës së Austrisë, 20 shkurt 1999), f. 2.

dëshmoi se ishin fjalë të Millutinoviçit. Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Petritsch-i nguli këmbë se edhe Shtambuku, edhe Millutinoviçit folën kështu, por nuk i kujtohej saktësisht nëse e tha Millutinoviçit shprehimisht. Edhe kur iu kërkua të dëshmonte mbi komentet e Millutinoviçit ndaj mesazhit të tij, atij nuk i kujtohej nëse Millutinoviçit i kishte shprehur këto fjalë. Mirëpo ai ishte i bindur, për shkak të rrethanave të takimit dhe mënyrës së evidentimit të përmbajtjes së takimeve të tilla, se komentet ishin evidentuar me saktësi. I pyetur më tej për këtë, Petritsch-i tha se si Shtambuku, po ashtu edhe Millutinoviçit folën për një masakër të mundshme⁵⁰² Petritsch-i e interpretoi komentin në kuptimin se bombardimi i NATO-s do të kishte si pasojë masakrën e shqiptarëve kosovarë nga ana e forcave të RFJ-së/Serbisë dhe shpjegoi se ishte përfundim logjik, sepse pas fillimit të bombardimit në vend nuk do të kishte vëzhgues ndërkombëtarë.⁵⁰³

242. Duke marrë parasysh se deklarata e parë e Petritsch-it dhe dëshmia e tij në procesin *Milloseviç* ia atribuuan këto fjalë Shtambukut, dhe kur dëshmoi para Dhomës, Petritsch-i nuk ishte në gjendje të kujtohej nëse Millutinoviçit i kishte thënë këto fjalë, Dhoma nuk mund të mbështetet mbi këto prova. Për më tepër, Ratko Markoviçit dëshmoi se kishte marrë pjesë në të gjithë takimet ku ishte Millutinoviçit dhe se kurrë nuk dëgjoi Millutinoviçin të thoshte se bombardimi i Serbisë do të sillte masakra në Kosovë.⁵⁰⁴

243. Prokuroria citon gjithashtu dëshminë e Ibrahim Rugovës se, kur e informoi Millutinoviçin se Kosova po zbrazej, përgjigjja e Millutinoviçit ishte se fajin e kishte bashkësia ndërkombëtare. Mirëpo, kjo dëshmi u pranua sipas Rregullës 92 *quater* dhe nuk mbështetet nga prova të tjera, dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret për të vërtetuar veprimet dhe sjelljen e Millutinoviçit.

244. Së fundi Prokuroria argumenton se qëndrimi i Millutinoviçit shihet nga fakti se ai nuk u distanca nga deklaratat e bëra në praninë e tij nga Milloseviçit apo nga anëtarët e SPS-së. Në mbështetje të këtij argumenti përmendet incidenti i treguar nga Klaus Naumann-i që ndodhi pas finalizimit të marrëveshjes Clark-Naumann. Siç përshkruhet në Kapitullin V, pas nënshkrimit të Marrëveshjes, palët filluan bisedime të mëtejshme se si të përmirësonin marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve kosovarë. Sipas Naumann-it, gjatë mbledhjes plenare dhe në prani të Millutinoviçit u bënë komente për lindshmërinë e lartë të shqiptarëve kosovarë. Gjithashtu Milloseviçit tha më vonë në prani të Millutinoviçit se shqiptarët kosovarë ishin të gjithë kriminelë, vrasës dhe

⁵⁰² Petritsch, T. 10727–10730 (28 shkurt 2007), T. 10876–10888, T. 10958–10959 (2 mars 2007), P2793 (transkript i Prokurori k. *Milloseviçit*, Lënda IT-02-54-T), T. 7232–7233; P562 (Mesazhi i ambasadës së Austrisë, 20 shkurt 1999), f. 2; Jan Kickert, T. 11249–11251 (7 mars 2007).

⁵⁰³ Wolfgang Petritsch, T. 10728 (28 shkurt 2007), T. 10879 (2 mars 2007), P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 3. Ibrahim Rugova dëshmoi se kur i tregoi Millutinoviçit për situatën dhe dhunën në Kosovë, ky i fundit u përgjigj se ishte pasojë e veprimeve të bashkësisë ndërkombëtare. Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i Prokurori k. *Milloseviçit*, Lënda IT-02-54-T), T. 4235.

⁵⁰⁴ Ratko Markoviç, T. 13226–13227 (9 gusht 2007), T. 13565 (14 gusht 2007).

përdhunues, dhe se zgjidhja e problemit do të vinte në pranverë të vitit 1999. I pyetur për këtë zgjidhje, Millosheviqi u përgjigj se do t'i mblidhnin dhe do t'i pushkatonin si në Drenicë pas Luftës së Dytë Botërore.⁵⁰⁵ Sipas Naumann-it, dëgjuesit nuk reagojnë sepse “në shumicën e rasteve nuk flisnin kur fliste [Millosheviqi].”⁵⁰⁶ Gjatë dëshmisë për Dhomën, Naumann-it i kujtohej se Millosheviqi përdori shprehjen “zgjidhja përfundimtare” por nuk arriti t'i shpjegonte Dhomës pse nuk e kishte përmendur këtë më herët, qoftë gjatë dhënies së deklaratës, qoftë gjatë dëshmisë në procesin *Millosheviq*.⁵⁰⁷

245. Prokuroria citon edhe sesionin e 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së më 16 qershor 1998, kur Miniqi u shpreh si më poshtë:

Nëse shokët tanë thonë se populli ynë do të ballafaqohet me një sfidë psikologjike në verë, kur ata do të vendosin të qëndrojnë apo të largohen, atëherë duhet të zgjidhim problemin me sukses në mënyrë që populli ynë të qëndrojë. Numri i serbëve dhe i malazezëve në Kosovë dhe në Metohi duhet të mbetet siç është sot dhe duhet të rritet në të ardhmen. Kjo është e vetmja mbrojtje afatgjatë dhe e vërtetë e Kosovës dhe Metohisë, për sa u përket interesave shtetërore dhe kombëtare. Aktualisht njerëzit janë të shqetësuar, shumë të shqetësuar. Disa po largohen. Është detyra jonë t'i japim shpresë popullit tonë me masat e ndërmarra dhe me përpjekjet e tyre, dhe ti tregojmë se Kosova do të mbetet e jona dhe se ata e kanë vendin këtu.⁵⁰⁸

Mirëpo Dhoma vëren se ishte sesion i gjatë dhe se gjatë këtij sesioni Miniqi tha shumë gjëra, përfshirë qëllimin e partisë për integrimin e popullatës shqiptare kosovare në institucionet serbe, mbështetjen e gjithë atyre që jetonin në Kosovë, zbutjen e tensioneve dhe për të bërë gjithmonë dallimin midis “terroristëve dhe terrorizmit në një anë, dhe pakicës shqiptare në anën tjetër,” dhe theksoi se shqiptarë kosovarë ishin pjesë përbërëse dhe e patjetërsueshme e Serbisë.⁵⁰⁹

246. Prokuroria ka paraqitur si prova edhe tri letra të dërguara Millutinoviçit në të cilat bëhej fjalë për numrin e shqiptarëve kosovarë në Kosovë dhe sipas Prokurorisë, nga këto letra, mund të konkludohet se Millutinoviçit mbështeti masa për fshehjen e informacionit lidhur me numrat.⁵¹⁰ Sipas Dhomës, nxjerrja e këtij përfundimi nga letrat përbën interpretim tej mase, gjë që Prokuroria mbase e ka kuptuar sepse nuk i citoi në dosjen përfundimtare.

⁵⁰⁵ Klaus Naumann, T. 8259–8260 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 24, P2561 (faqja shtesë me datën 7 dhjetor 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 6989–6992.

⁵⁰⁶ Klaus Naumann, T. 8258–8263 (13 dhjetor 2006).

⁵⁰⁷ Klaus Naumann, T. 8259–8263 (13 dhjetor 2006).

⁵⁰⁸ P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 21.

⁵⁰⁹ P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 30.

⁵¹⁰ Kërkesa e Tretë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale në Sallën Gjyqësore, dorëzuar më 16 mars 2007, para. 17; P2842 (Letër e Vlladan Kutleshqiçit drejtuar Zoran Jovanoviçit, 6 tetor 1998); P2843 (Letër e Millovan Zhivkoviçit drejtuar Millutinoviçit, 12 janar 1999); P2844 (Letër e Mileva Zhizhiqiçit drejtuar Borisllav Mitroviçit, 17 shkurt 1999).

247. Gjithashtu Dhoma dëgjoi dëshmi se Millutinoviçi shprehu mendimin e kundërt. Për shembull, gjatë takimit të datës 5 nëntor 1998 të mbajtur në ndërtesën e Shtabit të MPB-së në Kosovë, Millutinoviçi u tha të pranishmëve se duhej se këmbëngulnin “për një bashkësi me shqiptarët.”⁵¹¹ Ky qëndrim përputhej me konkluzionin e Kuvendit Kombëtar të Serbisë, të mbështetur më vonë nga qeveria e RFJ-së, në të cilin Kuvendi theksoi faktin se kishte një dallim të qartë midis anëtarëve të UÇK-së dhe atyre shqiptarëve kosovarë të cilët ishin të gatshëm të jetonin në paqe me qytetarë të tjerë të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe i mëshoi gjetjes së një zgjidhjeje nëpërmjet dialogut paqësor.⁵¹² Për më tepër, lidhur me përpjekjet e Millutinoviçit për të negociuar me shqiptarët kosovarë dhe lidhur me deklaratat e tij në Rambuje, të gjithë theksuan mbështetjen e tij për një zgjidhje paqësore të problemit dhe për autonominë e zgjeruar të Kosovës.⁵¹³

248. Dhoma gjykon se shumë nga provat e përshkruara më lart dhe të shfrytëzuara nga Prokuroria për të provuar synimin kriminal të Millutinoviçit nuk janë të mjaftueshme. Pjesa tjetër janë provat të cilat sugjerojnë se Millutinoviçi nuk u distanca nga fjalët e Millosheviçit dhe të Miniçit. Në lidhje me deklaratën e Drenicës të bërë nga Millosheviçi, Dhoma ka konkluduar se nuk është përshtatshme t’i atribuohet ndonjë synim Millutinoviçit për shkak të pranisë së tij kur Millosheviçi bëri këtë deklaratë, ku ndoshta përmendi ose nuk përmendi "zgjidhje përfundimtare" duke qenë se, duke pasur parasysh rrethanat në tërësi, nuk mund të thuhet se mosveprimi i Millutinoviçit pas këtyre fjalëve vërteton miratimin e tij. Dhoma është akoma më pak e prirur të nxjerrë një interpretim për synimin kriminal të Millutinoviçit në bazë të fjalëve të Miniçit gjatë mbledhjes së SPS-së, veçanërisht duke marrë parasysh se deklarata e Miniçit e përdorur nga Prokuroria ishte vetëm pjesë e një fjalimi më të gjatë i cili përfshinte edhe retorikë pajtuese.

6. Dijenia e Millutinoviçit për ngjarjet në Kosovë

249. Prokuroria pretendon se Millutinoviçi kishte dijeni për krimet e kryera nga forcat e RFJ-së/Serbisë në Kosovë, si gjatë vitit 1998, po ashtu edhe gjatë periudhës e cila mbulohet nga Aktakuza, sepse provat e lartpërmendura tregojnë se ai mori pjesë në disa negociata dhe mbledhje ku mori informacionin në fjalë. Gjithashtu ai shkoi personalisht në Kosovë, ishte në dijeni të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, mori letra dhe raporte

⁵¹¹ P2805 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 5.

⁵¹² 1D202 (Konkluzione të Kuvendit Kombëtar, 28 shtator 1998); 2D268 (Deklaratë e qeverisë së RFJ-së, 28 shtator 1998); 2D70 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së mbi mbledhjen e 21-së të qeverisë së RFJ-së, 28 shtator 1998).

⁵¹³ *Shih* për shembull, 1D83 (Deklaratë e Kryeministrit të Serbisë, 7 prill 1998); 1D45 Deklaratë Shtypi e Millan Millutinoviçit, f. 2; 1D586 (Konferencë Shtypi e Millutinoviçit në Paris, 23 shkurt 1999), f. 3.

nga Human Rights Watch dhe Prokurorja e Tribunalit, Louise Arbour, dhe ndihmësit e tij përgatisnin përmbledhje shtypi dhe informacione ditore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.⁵¹⁴

250. Gjatë intervistës, Millutinoviqi u pyet për nivelin e dijenisë së tij mbi ngjarjet e ndryshme në Kosovë. Lidhur me periudhën para bombardimit të NATO-s, Millutinoviqi mohoi se kishte dijeni të mirë të ngjarjeve në terren megjithëse ishte anëtar i KLM-së. Gjatë vizitave të tij në Kosovë në vitin 1998, për negociata me shqiptarët kosovarë dhe me grupet e tjera etnike në Kosovë,⁵¹⁵ ai vinte vetëm për bisedime, priste një orë e gjysmë për shqiptarët kosovarë dhe largohej nga Kosova menjëherë pasi ata nuk vinin.⁵¹⁶ Sipas përgjigjeve të tij, menjëherë pas këtyre përpjekjeve për negociata filloi procesi i Rambujesë në të cilin ishte aq i zënë se nuk kishte dijeni të mjaftueshme për ngjarjet ekzistuese në terren në Kosovë.⁵¹⁷

251. Millutinoviqit iu parashtrua se ai mund të kuptonte çfarë po ndodhte në Kosovë nga gazetatat dhe me siguri ishte në dijeni të largimit të shumë njerëzve. Millutinoviqi u përgjigj se njerëzit u larguan nga Kosova vetëm gjatë bombardimit të NATO-s sepse shumica e bombave ranë mbi Kosovën. Rrjedhimisht, shumë njerëz u larguan përkohësisht nga Kosova dhe u kthyen pas mbarimit të bombardimit. Ai tha gjithashtu se të vdekurit në Kosovë ishin pasojë e bombardimit të NATO-s. Kur iu tha se, në atë kohë, ai takohej me përfaqësuesit e huaj të cilët ishin të mendimit se njerëzit në Kosovë po vriteshin nga forcat serbe, Millutinoviqi shpjegoi se nuk ishte i pranishëm në Kosovë dhe se nuk mund të dinte se çfarë ishte propagandë dhe çfarë ishte e vërtetë.⁵¹⁸ Lidhur me komentit e tij se njerëzit po largoheshin nga Kosova për shkak të bombardimit të NATO-s, Millutinoviqi u pyet se pse serbët nuk po largoheshin nga Serbia me gjithë se tërë vendi po bombardohej. Ai shpjegoi se Kosova ishte një shoqëri fisnore e cila kishte frikë nga UÇK-ja dhe se UÇK-ja kishte urdhëruar që njerëzit të largoheshin nga qytetet.⁵¹⁹

252. Mirëpo, Dhoma ka dëgjuar provat të cilat kundërshtojnë qëndrimin e Millosheviqit se i mungonte informacion. Për shembull, Frederick Abrahams dëshmoi se Human Rights Watch u dërgonte rregullisht zyrtarëve dhe institucioneve raporte për ngjarje të ndryshme në Kosovë, përfshirë edhe një raport për ngjarjet në Drenicë të botuar në shkurt 1999. Një ndër marrësit e rregullt të këtyre raporteve ishte Presidenca e Serbisë. Ai tha gjithashtu se Human Rights Watch u shpërndante material shumë kontakteve mediatike, përfshirë media të RFJ-së, dhe shprehu

⁵¹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 618-619, 630-644.

⁵¹⁵ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45-46.

⁵¹⁶ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 56-57. Kjo konfirmohet nga Kojiqi i cili dëshmoi se Millutinoviqi nuk qëndronte as edhe një natë të vetme në Kosovë. *Shih* Jovan Kojiq, 13771 (16 gusht 2007), 1D741 (Deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 39.

⁵¹⁷ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 45-46.

⁵¹⁸ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 81-85.

mendimin se përgjithësisht raporte të tilla nuk përfshinin aq informacion sa duhej normalisht.⁵²⁰ Më 20 korrik 1998, Human Rights Watch u dërgoi shtatë letra ministrive të ndryshme të qeverisë serbe dhe organeve të ndryshme ku kërkonte shpjegim për disa persona të arrestuar nga MPB-ja, si dhe informacion të mëtejshëm në lidhje me viktimat serbe.⁵²¹

253. Prokuroria dorëzoi gjithashtu disa dokumente në sallën gjyqësore për të provuar se Millutinoviqi ishte në dijeni për ngjarjet në Kosovë dhe kishte synim të zbatonte politikën e Millosheviqit në Kosovë.⁵²² Ndër dokumentet është një raport i UJ-së me datën 25 maj 1998, dërguar Millutinoviqit nga Perishiqi. Prokuroria argumentoi se ky raport tregon se Millutinoviqi merrte informacione të përditshme mbi veprimtarinë e UJ-së në Kosovë.⁵²³ Dokumenti përshkruan hollësisht veprimtarinë e UJ-së në Kosovë më 23 dhe 24 maj 1998. Dhoma vëren se vetë dokumenti tregon se u lexua nga Millutinoviqi, duke qenë se mban nënshkrimin e tij mbi ballinën origjinale.⁵²⁴

254. Jovan Kojiqi pranoi se Presidenca merrte buletinet e përditshme të MPB-së mbi ngjarje brenda juridiksionit të Ministrisë që kishin ndodhur në Serbi një ditë më parë, si dhe raporte të përditshme të UJ-së. Buletinet e MPB-së jepnin të dhëna të përgjithshme mbi incidente të ndryshme, përfshirë vrasje dhe vjedhje, por nuk përfshinin të dhëna të hollësishme për viktimat dhe/apo keqbërësit. Mirëpo, raportet e përditshme të UJ-së përmbanin pak informacion dhe bazoheshin mbi raportet e zbulimit të përpiluara nga atashetë ushtarakë jashtë shtetit mbi sigurinë e vendeve fqinjë dhe të rajonit. Të gjitha këto raporte, bashkë me lajmet e mediave dhe të televizionit të ndjekura imtësisht nga punonjësit e Presidencës, përmbledheshin në një raport të shkurtër që i jepej Millutinoviqit çdo ditë.⁵²⁵ Rrallëherë, mbase dy herë në vitin 1998, Presidenca merrte një pasqyrë të operacioneve të kryera nga UÇK-ja, si dhe listat e civilëve dhe të anëtarëve të MPB-së të

⁵¹⁹ P604 (Intervista e Prokurorisë me Millan Millutinoviqin), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 168–170.

⁵²⁰ Fred Abrahams, T. 811–812, 818 (13 korrik 2006), T. 894 (7 gusht 2006).

⁵²¹ P540 (Letër nga Human Rights Watch për ministrin serb të Drejtësisë, 20 korrik 1998), P541 (Letër nga Human Rights Watch për ministrin jugosllav të Drejtësisë, 20 korrik 1998), P542 (Letër nga Human Rights Watch për ministrin e Brendshëm serb, 20 korrik 1998), P543 (Letër nga Human Rights Watch për sekretarin jugosllav të Informacionit, 20 korrik 1998), P544 (Letër nga Human Rights Watch për UJ-në, 20 korrik 1998), P545 (Letër nga Human Rights Watch për sekretarin serb të Informacionit, 20 korrik 1998), P546 (Letër nga Holly Cartner për ministrin e Brendshëm serb, 20 korrik 1998); P545 (Letër nga Human Rights Watch për sekretarin serb të Informacionit, 20 korrik 1998).

⁵²² Kërkesa e Tretë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale në Sallën Gjyqësore, dorëzuar më 16 mars 2007, para. 13-18.

⁵²³ Kërkesa e Tretë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale në Sallën Gjyqësore, dorëzuar më 16 mars 2007, para. 14.

⁵²⁴ P2922 (Raporti i veprimtarive të UJ-së në Kosovë, 25 maj 1998).

⁵²⁵ Jovan Kojiq, T. 13727–13728 (15 gusht 2007), T. 13771–13775 (16 gusht 2007), 1D741 (Deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 25–26; P2827 (Letër e zëvendësministrit të Informacionit të Serbisë drejtuar Millutinoviqit, 1 tetor 1998).

vrarë dhe/apo të rrëmbyer gjatë operacioneve. Kojiqi dëshmoi se Presidenca nuk merrte raporte të krimeve të kryera nga forcat e RFJ-së/Serbisë gjatë konfliktit.⁵²⁶

255. Prokuroria paraqiti një letër nga Ministria e Informacionit për Millutinoviçin më 1 tetor 1998 në të cilën përmenden lajme të mediave perëndimore mbi masakrën e pretenduar në Abrinë e Epërme, duke e quajtur manipulim të qartë mediatik, “si granatimi dhe vrasja e civilëve në tregun Markale të Sarajevës në shkurt 1994 dhe gusht 1995, me synim për t’a shfrytëzuar si pretekst urgjent që Këshilli i Sigurimit të marrë një vendim për ndërhyrjen ushtarake të NATO-s.”⁵²⁷ Në letër gjithashtu lexohet se zyrtarët e MPB-së mohuan se efektivat e saj kishin ndërmarrë operacione kundër civilëve dhe se MPB-ja do të hetonte pretendimet për krime të cilat ishin pasqyruar nga mediat e huaja. Më tej Ministria rekomandonte që organet shtetërore të Serbisë t’i drejtoheshin publikut të brendshëm dhe të jashtëm sa më shpejt dhe nxirrte në pah faktet në lidhje me akuzat për krimet kundër shqiptarëve kosovarë. Ministria propozonte që Millutinoviçi të merrte kontakt me udhëheqësit shtetërorë serbë për një deklaratë të tillë publike.⁵²⁸ Kur i treguan letrën e Ministrisë së Informacionit, Kojiqi konfirmoi se punonjësit e Presidencës sigurisht ia kanë dorëzuar këtë letër Millutinoviçit.⁵²⁹

256. Gjatë mbledhjes së KLM-së më 4 tetor 1998, Gjukanoviçi sugjeroi që Millosheviçi të ftonte përfaqësuesit e Tribunalit të hetonin pretendimet për krime kundër shqiptarëve kosovarë dhe të nxirrte një plan të hollësishëm për kthimin e “refugjatëve” në Kosovë e gjithë kjo për të shmangur spekulimet mbi respektimin e Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara prej RFJ.⁵³⁰ Gjithashtu, gjatë takimeve të 15 dhe 24 tetorit 1998 midis Clark-ut, Naumann-it dhe Millosheviçit, Millosheviçi ishte i pranishëm kur u fol për përdorimin e forcës së tepruar kundër shqiptarëve kosovarë, gjë që Millosheviçi e mohoi.⁵³¹ Vollebaek-u dëshmoi gjithashtu se në takimet e tij me Millosheviçin shpeshherë kishte shprehur shqetësimin e tij për trajtimin e civilëve shqiptarë kosovarë. Atij i kujtohej se i kishte dhënë Millosheviçit informacion për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, informacion që e kishte marrë nga KVM-ja. Mirëpo, nuk i kujtohej

⁵²⁶ Jovan Kojiq, T. 13779–13800 (16 gusht 2007); 1D741 (Deklaratë dëshmitari e Kojiqit, 27 korrik 2007), para. 55–57; 1D725 (Lista e veprimtarive terroriste të separatistëve shqiptarë në Kosovë– pjesa 1, 1 janar –7 korrik 1998); 1D726 (Lista e veprimtarive terroriste të separatistëve shqiptarë në Kosovë– pjesa 2, 1 janar –7 korrik 1998); 1D707 (Lista e qytetarëve dhe të anëtarëve të MPB-se të rrëmbyer, 1 janar –7 korrik 1998); 1D721 (Lista e qytetarëve të vrarë, 1 janar –8 korrik 1998).

⁵²⁷ P2827 (Letër e zëvendësministrit të Informacionit të Serbisë drejtuar Millutinoviçit, 1 tetor 1998).

⁵²⁸ P2827 (Letër e zëvendësministrit të Informacionit të Serbisë drejtuar Millutinoviçit, 1 tetor 1998).

⁵²⁹ Jovan Kojiq, T. 13771–13775 (16 gusht 2007), 1D741 (Deklarata e dëshmitarit me datën 27 korrik 2007), para. 25 dhe 26; P2827 (Letër e zëvendësministrit të Informacionit të Serbisë drejtuar Millan Millutinoviçit, 1 tetor 1998).

⁵³⁰ P1575 (Procesverbal i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së), f. 11-16.

⁵³¹ Klaus Naumann, T. 8247–8251 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 3–4. 11–13; P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6964–6980.

saktësisht takimi përkatës, as nuk i kujtohej nëse Millutinoviçi kishte qenë i pranishëm në atë takim.⁵³²

257. Millutinoviçi mori informacion edhe nga popullata vendase serbe në Kosovë, e cila ankohej për gjendjen në krahinë. Në një letër me datën 11 dhjetor 1998, dërguar Millosheviçit, Millutinoviçit dhe disa të tjerëve, Kuvendi Komunal i Podujevës ankohej për gjendjen në Podujevë, duke dhënë një listë të hollësishme të incidenteve të keqtrajtimit të qytetarëve serbë. Letra kërkonte që qeveria të merrte masat përkatëse për të përmirësuar gjendjen në komunë. Për shembull, Kuvendi kërkoi që DPB-së së Podujevës t'i dërgoheshin përforcime dhe që pjesë të “forcave të posaçme kundër terroristëve” të dislokoreshin atje.⁵³³ Më 5 maj 1998, Millosheviçi dhe Millutinoviçi morën një letër të ngjashme, këtë herë nga kryetari i komunës së Gjakovës, në të cilën ai ankohej për gjendjen në komunë lidhur me sulmet më të shpeshta të UÇK-së; letra bënte thirrje për shpalljen e shtetrrëthimit dhe për vendosjen e pushtetit ushtarak në rajon. Më 12 maj, Millutinoviçi u informua nga një ndihmës i tij se kryetari i komunës së Pejës e kishte informuar Presidencën se Peja ishte bllokuar nga pjesa tjetër e krahinës dhe se i mungonte ushqim.⁵³⁴

258. Më 15 mars 1999, Millutinoviçi mori një notë që përmbante përmbledhjen e një bisede telefonike midis Wesley Clark-ut dhe Ojdaniqit, përgatitur nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së. Kjo notë e evidenton se Clark-u e paralajmëroi Ojdaniqin për një sulm të NATO-s. Ai i tha Ojdaniqit gjithashtu se UJ-ja po shkelte “premtimet e bëra nga Millosheviçi në tetor,” se UÇK-ja nuk mund të shkatërrohej me mjete ushtarake dhe se dislokimi i UJ-së në Kosovë vetëm po shkatërronte krahinën dhe popullin e saj. Clark-u theksoi më tej se bashkësia ndërkombëtare nuk kishte qëllim që të rrezikonte tërësinë territoriale dhe sovranitetin e RFJ-së.⁵³⁵ Anëtarët e KLM-së morën edhe një notë të dytë në të cilin pasqyrohet një bisedë midis dy të lartpërmendurve më 22 mars 1999, dhe ku flitet edhe një herë për shkeljen nga ana e UJ-së të marrëveshjes Holbrooke-Millosheviç, dhe për fushatën e mundshme të NATO-s.⁵³⁶

259. Gjatë pyetjeve të Prokurorisë për Zoran Angjelkoviçin, Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm në kohën e fushatës së NATO-së, Prokuroria nxori një raport të përpiluar nga Këshilli dhe të dërguar Millutinoviçit.⁵³⁷ Angjelkoviçi dëshmoi se Këshilli u dërgonte raporte të tilla

⁵³² Knut Vollebaek, T. 9513–9516 (31 janar 2007); P2634, para. 39–40, dhe 46.

⁵³³ P414 (Letër drejtuar Millutinoviçit lidhur me gjendjen në Podujevë, 11 dhjetor 1998).

⁵³⁴ 1D483 (Letër dërguar Millutinoviçit, 5, 6, dhe 12 maj).

⁵³⁵ Millovan Vllajkoviçi, T. 16022 (20 shtator 2007); 3D706 (Evidencë e një bisede telefonike midis Wesley Clark-ut dhe Dragolub Ojdaniqit, 15 mars 1999).

⁵³⁶ Millovan Vllajkoviçi, T. 16022–16023 (20 shtator 2007); 3D707 (Evidencë e një bisede telefonike midis Wesley Clark-ut dhe Dragolub Ojdaniqit, 22 mars 1999).

⁵³⁷ P2900 (Raport mbi angazhimin dhe veprimtaritë e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, 16 prill 1999, marrë më 23 prill 1999).

personave “me pushtet në republikë,” përfshirë edhe Presidentin e Serbisë, kur gjykohej e nevojshme.⁵³⁸ raporti trajton veprimtaritë e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm në periudhën nga 24 marsi deri më 13 prill 1999, dhe ndër të tjera, evidenton se (a) se Sekretariati i Shëndetësisë lëshoi udhëzime lidhur me “statusin e punonjësve të shëndetësisë të kombësisë shqiptare,” (b) se sekretariati i administratës dhe të rregullores mbikëqyrte punën e organeve civile dhe ushtarake të drejtësisë dhe mblidhte të dhëna për gjendjen dhe autorët e akteve kriminale në Kosovë (raport përmend 2 vrasje dhe 75 vjedhje në rrethana rënduese); (c) se sekretariati për çështjet humanitare punonte për kthimin e “refugjatëve” dhe për strehimin e qytetarëve të cilëve u janë shkatërruar shtëpitë gjatë bombardimit të NATO-s, si dhe për furnizimin me ushqime dhe barna: dhe (d) se policia financiare, në bashkëpunim me organet e MPB-së po merrte të gjitha hapat e nevojshme për parandalimin e plaçkitjeve dhe vjedhjeje në dyqanet, depot dhe magazinat e braktisura.⁵³⁹

260. Kojiqi dëshmoi gjithashtu se disa javë para fillimit të bombardimit të NATO-së, raportet e UJ-së të marra nga Presidenca ndryshuan disi. Ato dorëzoheshin në Presidencë nga një ushtar i UJ-së dhe ishin identike me raportet e MPB-së në kohë paqeje. Ato përfshinin të dhëna të përgjithshme mbi gjendjen e UJ-së, nevojat logjistike dhe, me kohë, një listë të hollësishme të sulmeve të NATO-s. Raportet e MPB-së mbetën njësoj përveç faktit se tani përfshinin të dhëna mbi sulmet e NATO-s.⁵⁴⁰

261. Fakti se Millutinoviqi merrte këto raporte u konfirmua edhe nga Radovan Radinoviqi, eksperti ushtarak i thirrur nga Mbrojtja e Ojdaniqit, i cili dëshmoi se, gjatë fushatës së NATO-s, raporte të përditshme luftarake për gjendjen në UJ-në, të bazuara në raportet luftarake të përgatitura nga komandat dhe njësitë varëse, i dërgoheshin edhe Millutinoviqit.⁵⁴¹ Dhoma ka pranuar gjithsej 77 raporte të tilla të hartuara në periudhën midis 25 marsit dhe 9 qershorit 1999. Sipas listës së marrësve në faqen e fundit të çdo raporti, Millutinoviqi mori shumicën e raporteve, por jo të gjithë. Informacioni në ato raporte kishte të bënte me veprimtaritë e armikut, me gjendjen dhe veprimtaritë e Armatave 1, 2 dhe 3, me gjendjen në kufi dhe me gjendjen e moralit në trupat e UJ-së.⁵⁴² Në katër

⁵³⁸ Zoran Angjelkoviq, T. 14725–14728 (31 gusht 2007).

⁵³⁹ P2900 (Raport mbi angazhimin dhe veprimtaritë e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, 16 prill 1999, marrë më 23 prill).

⁵⁴⁰ Jovan Kojiq, 1D741 (Deklarata e dëshmitari me datën 27 korrik 2007), para. 45, 1D754 (fletinformacion plotësues), para. 6.

⁵⁴¹ Radovan Radinoviq, T. 17258–17260 (18 tetor 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), para. 71, 112. *Shih gjithashtu* P1481 (Direktivë e Shtabit të Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtje kundër NATO-s, 9 prill 1999), f. 11.

⁵⁴² Raportet që evidentojnë Millutinoviqin si marrës janë: 3D808 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999); 3D810 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 5 prill 1999); 3D811 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 6 prill 1999); 3D812 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 7 prill 1999); 3D813 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 prill 1999); 3D814 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 9 prill 1999); 3D815 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 prill 1999); 3D816 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999); 3D817 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 12 prill 1999); 3D818 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 13 prill 1999); 3D819 (Raport i

raporte, Ojdaniqi flet shkurtimisht për akuzat e krimeve, duke thënë se ato ishin “propagandë armiqësore” për të përligjur sulmet e NATO-s.⁵⁴³

262. Prokuroria dorëzoi një letër me datën 26 mars 1999, dërguar Millutinoviçit nga Prokurorja e Tribunalit në atë kohë, Louise Arbour, në të cilën ajo përmendte shkallëzimin e dhunës në Kosovë dhe shprehte shqetësimin e saj se po kryheshin shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.⁵⁴⁴ Prokuroria citoi edhe dy Rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rezolutën 1160 të 31 marsit 1998 dhe Rezolutën 1199 të 23 shtatorit 1998, të cilat përmendin përdorimin e forcës së tepruar nga ana e forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë, si dhe shpërnguljen e shumë njerëzve.⁵⁴⁵ Mirëpo, Kojiqi dëshmoi se nuk i kujtohej nëse Millutinoviçi ishte në dijeni të rezolutave të ndryshme të Kombeve të Bashkuara të miratuara për Kosovën, dhe as nuk i kujtohej nëse kishte marrë raporte nga Human Rights Watch ose një letër nga Louise Arbour.⁵⁴⁶ Gjithsesi procesverbalet e KLM-së tregojnë se një ndër temat kryesore të bisedimeve gjatë sesionit të 6-të të KLM-së më 4 tetor 1998 ishte Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të

Shtabit të Komandës së Lartë, 14 prill 1999); 3D820 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999); 3D821 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999); 3D822 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 17 prill 1999); 3D823 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 18 prill 1999); 3D824 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 19 prill 1999); 3D825 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 20 prill 1999); 3D826 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 21 prill 1999); 3D827 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 22 prill 1999); 3D828 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 23 prill 1999); 3D829 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 24 prill 1999); 3D830 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 25 prill 1999); 3D831 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 26 prill 1999); 3D832 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 27 prill 1999); 3D833 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 28 prill 1999); 3D834 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 29 prill 1999); 3D835 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 30 prill 1999); 3D836 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 1 maj 1999); 3D837 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 maj 1999); 3D838 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 3 maj 1999); 3D839 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 4 maj 1999); 3D840 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 5 maj 1999); 3D841 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 6 maj 1999); 3D842 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 7 maj 1999); 3D843 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 maj 1999); 3D844 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 9 maj 1999); 3D846 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 maj 1999); 3D847 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 12 maj 1999); 3D848 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 13 maj 1999); 3D849 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 14 maj 1999); 3D850 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 maj 1999); 3D852 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 17 maj 1999); 3D853 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 18 maj 1999); 3D854 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 19 maj 1999); 3D855 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 20 maj 1999); 3D856 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 21 maj 1999); 3D857 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 22 maj 1999); 3D858 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 23 maj 1999); 3D859 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 24 maj 1999); 3D860 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 25 maj 1999); 3D861 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 26 maj 1999); 3D863 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 28 maj 1999); 3D864 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 29 maj 1999); 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 30 maj 1999); 3D866 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 31 maj 1999); 3D867 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 1 qershor 1999); 3D870 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999); 3D871 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 5 qershor 1999); 3D872 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 6 qershor 1999); 3D873 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 7 qershor 1999); 3D874 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 qershor 1999).

⁵⁴³ 3D820 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999); 3D821 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999); 3D825 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 20 prill 1999); 3D826 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 21 prill 1999).

⁵⁴⁴ P399 (Letër nga Louise Arbour drejtuar Millutinoviçit, 26 mars 1999).

⁵⁴⁵ P455 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të BE-së 1160, 31 mars 1998); P456 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të BE-së 1199, 23 shtator 1998); P433 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të BE-së 1244, 10 qershor 1999).

⁵⁴⁶ Jovan Kojiq, T. 13774–13778 (16 gusht 2007).

Kombeve të Bashkuara, e cila, sipas prezantimit të Millosheviqit gjatë mbledhjes, ishte respektuar.⁵⁴⁷

263. Më 16 prill 1999, gjatë takimit me Rugovën dhe Merovcin, Rugova i tregoi Millutinoviqit për shpërnguljet e dhunshme, dhunën dhe shtypjen në Kosovë. Sipas Rugovës, Millutinoviqi u përgjigj se fajin e kishte bashkësia ndërkombëtare.⁵⁴⁸ Mirëpo, kjo dëshmi nuk u konfirmua nga prova të tjera dhe, duke qenë së është pranuar sipas Rregullës 92 *quater*, Dhoma nuk mund ta përdorë për të vërtetuar veprimet dhe sjelljen e Millutinoviqit.

264. Gjatë vizitës në Prishtinë më 28 prill 1999, Millutinoviqi tha se atje kishte parë dëmtime të shkaktuara nga NATO-ja, por nuk kuptonte se pse njerëzit po braktisnin qytetin. Merovci i shpjegoi Millutinoviqit se njerëzit po largoheshin sepse detyroheshin të dilnin nga shtëpitë për shkak të serbëve me uniformë. Sipas Merovcit, Millutinoviqi iu drejtua Shainoviqit dhe e pyeti nëse ishte e vërtetë. Ky i fundit nuk u përgjigj, por dukej i habitur.⁵⁴⁹

265. Gjatë mbledhjes së datës 4 maj, në të cilën, sipas raporteve të mediave, morën pjesë Millutinoviqi, Millosheviqi, Pavkoviqi dhe Llukiqi, u paraqitën të dhëna se “forcat e sigurisë” ndërsa ishin angazhuar në luftime të ashpra me UÇK-së, gjithashtu kishin trajtuar raste të shumta të dhunës, vrasjes, plaçkitjeje dhe të krimeve të tjera, dhe se kishin arrestuar disa qindra keqbërës, krimet e të cilëve përbënin një rrezik të madh për popullatën civile.⁵⁵⁰ Në atë mbledhje u përfundua se puna e gjykatave ushtarake kishte bërë “të pamundur” kryerjen e krimeve të tilla në të ardhmen, duke qenë se gjykatat kishin proceduar shumë krime kundër popullatës civile dhe kishin shpallur “shumë” dënime prej pesë deri 20 vjet burg për këto krime.⁵⁵¹

266. Këtu duhet theksuar se, për çudi, Millutinoviqi nuk mori pjesë në mbledhjen e datës 17 maj 1999, në të cilën morën pjesë Millosheviqi, Shainoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Rade Markoviqi, Geza Farkashi dhe Branko Gajiqi.⁵⁵² Në atë mbledhje, Vasileviqi raportoi mbi krime të kryera nga UJ-ja, MPB-ja dhe nga vullnetarët në Kosovë, si përdhunime të civileve nga ushtarët dhe krimet e kryera nga Akrepat në Podujevë. Markoviqi pranoi se efektivat e grupeve paraushtarake

⁵⁴⁷ *Shih* Ndarjen VI.A.1.d.

⁵⁴⁸ Ibrahim Rugova, P2613 (Deklarata e dëshmitarit me datën 24 prill 1999), f. 12, P2612 (Transkript i *Prokurori k Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 4236.

⁵⁴⁹ Adnan Merovci, T. 8468–8474 (16 janar 2007), P2588 (deklarata e dëshmitarit me datën 12 prill 2000), para. 72.

⁵⁵⁰ P1696 (“Krerët e Ushtrisë, Policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, Reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

⁵⁵¹ P1696 (“Krerët e Ushtrisë, Policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, Reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1-2.

⁵⁵² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklarata e dëshmitarit me datën 14 janar 2007), para. 63–74, P2589 (Transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 15999–16000. *Shih edhe* P2592 (Pjesë e ditarit të Vasileviqit).

ndodheshin në Kosovë si vullnetarë dhe po kryenin krime.⁵⁵³ Vasileviqi dëshmoi se ishte e habitshme se Millutinoviqi, pjesëtar i qeverisë serbe, të cilës i përkiste Ministria serbe e Punëve të Brendshme, nuk mori pjesë në atë mbledhje ku u diskutua për krimet e kryera nga MPB-ja. Sipas Vasileviqit, kjo do të thotë se si RDB-ja, po ashtu dhe RJB-ja ishin nën kontrollin e Millosheviqit.⁵⁵⁴

267. Së fundi, Prokuroria i referohet aktakuzës origjinale kundër Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit dhe Stojilkoviqit, dorëzuar më 23 maj 1999 dhe publikuar më 27 maj 1999, e cila e paralajmëroi Millutinoviqin mbi incidentet konkrete të krimeve të pretenduara të kryera në rajon për të cilat ai vetë thuhej se ishte përgjegjës. Jovan Kojiqi konfirmoi se Millutinoviqi e kishte parë këtë aktakuzë.⁵⁵⁵

268. Dhoma është e mendimit se provat e lartpërmendura tregojnë se Millutinoviqi ishte relativisht i mirinformuar për gjendjen në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999. Ai u mbajt i informuar nëpërmjet raporteve të UJ-së dhe të MPB-së që e vunë në dijeni për gjendjen dhe gjithashtu ishte i informuar për disa ankesa të popullatës vendase serbe në Kosovë. Atëherë pyetja që shtrohet është nëse ai ishte në dijeni edhe të krimeve të pretenduara nga forcat e UJ-së/MPB-së në vitet 1998 dhe 1999.

269. Shumë dëshmi lidhur me dijeninë e lartpërmendur u dhanë nga përfaqësuesit ndërkombëtarë të cilët iu ankuan Millosheviqit për shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit dhe për përdorimin e forcës së tepruar. Dëshmi dha edhe Merovci për një prej dy takimeve që Millutinoviqi zhvilloi me të dhe me Rugovën. Nga ana tjetër, informacioni që ai mori nga burimet e RFJ-së/Serbisë, ose nuk përmendi krime (raportet e UJ-së dhe të MPB-së), ose, nëse po, pretendimet u raportuan si propagandë e bashkësisë ndërkombëtare (incidenti i Abrisë së Epërme), ose atij iu tha se problemet po trajtoheshin nga autoritetet kompetente (rezultati i mbledhjes së datës 4 maj). Për sa i përket rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mbledhjen e KLM-së të datës 4 tetor u diskutua për rezolutën e 23 shtatorit gjatë së cilës Millosheviqi tha se aktivitetet e forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë kishin mbaruar dhe se, rrjedhimisht ishin plotësuar kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare.

270. Me gjithë mungesën e informacionit konkret nga burimet e brendshme se po kryheshin krime, gjithsesi Dhoma është e mendimit se Millutinoviqi u informua se në vitin 1998 ishin kryer

⁵⁵³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklarata e redaktuar e dëshmitarit me datën 14 janar 2007), para. 65–67, P2589 (Transkript i Prokurori k. Millosheviqit, Lënda IT-02-54-T), T. 15999–16004.

⁵⁵⁴ Aleksandar Vasileviq, T. 9001 (21 janar 2007).

⁵⁵⁵ Jovan Kojiq, T. 13777 (16 gusht 2007).

krime dhe në fillim të vitit 1999 ishte përdorur forcë e tepruar, kryesisht nëpërmjet kontakteve të tij me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Provat nuk janë kaq të gjera lidhur me dijenitë e tij gjatë bombardimit të NATO-s, veçanërisht duke marrë parasysh faktet se më 4 maj, pas takimeve të tij me Rugovën dhe Merovcin, iu tha se krimet po procedoheshin. Megjithëse Kojiqit nuk i kujtohej që Presidenca t1 kishte marrë letrën e 26 marsit të Louise Arbour-it, Dhoma është e mendimit se Millutinoviçi duhet ta ketë marrë letrën apo duhet të ketë dëgjuar për të. Dy muaj më vonë, aktakuza e Tribunalit kundër tij pasqyroj akuza më konkrete për krimet dhe incidentet. rrjedhimisht Dhoma është e mendimit se Millutinoviçi u informua për lëvizjet e popullatës në Kosovë dhe për përdorimin e forcës së tepruar nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë.

7. Konkluzione mbi përgjegjësinë e Millan Millutinoviçit sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit

a. Fajësia nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

271. Sipas Prokurorisë, provat e lartpërmendura vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Millutinoviçi ishte anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar në Aktakuzë dhe se kontribuoi në një masë të konsiderueshme në zbatimin e saj, nëpërmjet (a) pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës në organe të ndryshme të nivelit të lartë; (b) përkrahjes në themelimin dhe punën e organeve të cilat zbatuan ndërmarrjen e përbashkët kriminale, si Komanda e Përbashkët; (c) rolit të tij pengues në disa takime dhe konferenca me udhëheqës të shqiptarëve kosovarë dhe me përfaqësuesit ndërkombëtar; (d) mosplotësimit të qëllimshëm të detyrave të tij dhe mospërdorimit të kompetencave të tij për mbrojtjen e popullatës civile nga krimet; dhe (e) nxjerrjes së dekretive të hartuara për realizimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁵⁵⁶ Prokuroria argumenton gjithashtu se mosveprimet e tij të lartpërmendura në pikën (d) dhe të diskutuara gjerësisht në këtë Kapitull, kontribuan dukshëm në krijimin e rrethanave që u hapën rrugën krimeve kundër popullatës shqiptare kosovare.⁵⁵⁷

272. Përveç mohimit të ekzistencës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se ai nuk mori pjesë asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në ndonjë plan të përbashkët kriminal, dhe as nuk ishte në dijeni të një plani të tillë.⁵⁵⁸

273. Për të vërtetuar se përgjegjësia penale e Millutinoviçit i përket kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të vërtetojnë se ai mori pjesë në të paktën një

⁵⁵⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 559.

⁵⁵⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 614.

⁵⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 304-306.

aspekt të qëllimit të përbashkët për të mundësuar kontroll të mëtejshëm të Kosovës nga ana e autoriteteve të RFJ-së/Serbisë nëpërmjet krimit të shpërnguljes së dhunshme, ekzistenca e të cilit tashmë është vërtetuar tashmë Dhoma.⁵⁵⁹ Për të plotësuar këtë kriter, nuk duhet që Millutinoviqi të ketë kryer fizikisht krime nëpërmjet të cilëve u arrit qëllimi, apo madje të ketë kryer ndonjë shkelje tjetër.⁵⁶⁰ Në fakt, nuk kërkohet as që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe në vendin e kryerjes fizike të krimeve.⁵⁶¹ Mirëpo, kontributi i tij për planin duhet të ketë qenë i rëndësishëm.⁵⁶² Edhe një mosveprim mund të mbartë përgjegjësi sipas Nenit 7(1), kur ekziston një detyrim ligjor për të vepruar.⁵⁶³ Për sa i përket elementit mendor të domosdoshëm, duhet të vërtetohet se Millutinoviqi mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte të njëjtin synim me anëtarë të tjerë në ndërmarrjes së përbashkët kriminale për të kryer krimin apo shkeljen bazë e cila ishte synimi i ndërmarrjes – në këtë rast, shpërngulja e dhunshme.

274. Duke shqyrtuar së pari kontributin e tij, Dhoma është e mendimit se disa shembuj të pjesëmarrjes së Millutinoviqit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të pretenduar nga Prokuroria nuk janë vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Për shembull, Dhoma konkludoi se, gjatë negociatave midis shqiptarëve kosovarë dhe autoriteteve të RFJ-së/Serbisë, të gjitha palët mbanin përgjegjësi për dështimin e tyre. Si rezultat, Dhoma nuk mund të konkludonte se Millutinoviqi pengoi procesin e bisedimeve. Për më tepër u konkludua se akuza se ai ndihmoi ndërmarrjen e përbashkët kriminale nëpërmjet lëshimit të dy dekreteve të cilët pretendohet se synonin të mbanin popullatën shqiptare kosovare jashtë Serbisë, nuk ishte vërtetuar. Provat për marrëdhëniet e tij me qeverinë serbe treguan se kompetencat e tij nuk ishin të gjera dhe vareshin nga popullariteti dhe forca tërheqëse e personit i cili mbante funksionin, veti që ai nuk i kishte. Gjithashtu, sipas Kushtetutës së Serbisë, ai nuk kishte pushtet komandues mbi UJ-në. Kontributi i tij për luftën konsistonte vetëm si anëtar *ex officio* i KLM-së. Pas një vendimi të njëzëshëm të të tre anëtarëve të KLM-së me drejtë vote, u morën dy vendime lidhur me përdorimin e UJ-së në Kosovë, njëri më 9 korrik 1998 për të përballuar kërcënimin e UÇK-së dhe tjetri më 4 tetor 1998 për të mbrojtur vendin nëse sulmohej nga NATO-ja. Lidhur me periudhën pas fillimit të fushatës së NATO-s, megjithëse mbajti disa kompetenca ligjore nëpërmjet anëtarësisë së tij në KLM apo në Komandën e Lartë, nuk u vërtetua se Millutinoviqi mori pjesë në vendimmarrjen e asaj kohe veçanërisht lidhur me UJ-në. Nuk u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm edhe pretendimi se Millutinoviqi e ndihmoi Millosheviqin për të vendosur figura kyçe në poste kyçe duke qenë se kjo kompetencë

⁵⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

⁵⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

⁵⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimin e Apelit *Simiq dhe të tjerë.*, para. 158.

⁵⁶² Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

⁵⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 175.

ishte vetëm në duart e Millosheviqit. Përsa i përket MPB-së, kompetencat e tij të kufizuara lidhur me atë organ u kufizuan edhe më shumë nga Millosheviqi i cili kishte lidhje të drejtpërdrejta me krerët e RDB-së dhe të RJB-së, siç dëshmoi Vasileviqi. Gjithashtu, provat tregojnë se Millosheviqi lëshonte urdhra për efektivat e MBP-së në Kosovë, shpesh nëpërmjet Shainoviqit i cili siç do të shihet në pjesën vijuese, ishte në kontakt të vazhdueshëm me Llukiqin. Së fundi, në ndryshim nga Shainoviqi, Millutinoviqi nuk shkoi shpesh në Kosovë dhe nuk ishte ne dijeni të diskutimeve lidhur me veprimtaritë konkrete të forcave të RFJ-së/MPB-së në krahinë. Në realitet, roli i tij konsistonte kryesisht në informimin e zyrtarëve krahinorë mbi dispozitat e Marrëveshjeve të Tetorit.

275. Mirëpo, Millutinoviqi mori pjesë në mbledhjen e datës 21 korrik 1998 me anëtarët tjerë të udhëheqjes kur u miratua Plani kundër Terrorizmit dhe u formua Komanda e Përbashkët. Ai gjithashtu mori pjesë në një mbledhje të ngjashme të datës 29 tetor në të cilin u diskutuan rezultatet e këtyre veprimtarive. Ai gjithashtu mbajti dhe dy fjalime për të ngritur moralin e MPB-së. Për më tepër, ai nuk ngriti disa çështje në mbledhjet e KLM-së dhe në përgjithësi tregoi besnikëri ndaj Millosheviqit. Megjithatë, Dhoma është e mendimit se këto fakte nuk përbëjnë kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, sidomos duke mbajtur parasysh jurisprudencën mbi të cilën mbështetet Prokuroria lidhur me përgjegjësinë e mosveprimit, sipas të cilës mosveprimet e tij jo vetëm që duhej të ishin lidhur me detyrimin e tij për të vepruar por edhe me pushtetin e tij mbi autorët fizikë të akteve kriminale në fjalë. Në mungesë të kompetencave të reale *de jure* dhe *de facto*, Dhoma nuk pranon që Millutinoviqi kishte detyrime ligjore imponuar nga betimi presidencial. Për më tepër, duke marrë parasysh se Millutinoviqi nuk kishte pushtet mbi forcat që po kryenin krimet në fjalë, Dhoma nuk është e gatshme të pranojë që kontributi përmes mosveprimit ishte i konsiderueshëm.

276. Le të supozojmë për një çast se Dhoma nuk e ka analizuar drejt kontributin e Millutinoviqit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, tani ajo do të shqyrtojë elementin mendor të nevojshëm për të përcaktuar këtë lloj përgjegjësie. Dhoma Gjyqësore gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjitha veprimet e Millutinoviqit të përshkruara më lart ishin me vullnet të lirë e jo të detyruara. Edhe pse e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Millutinoviqi kishte të njëjtin synim për mundësimin e kontrollit të mëtejshëm të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi Kosovën, Dhoma nuk mori prova të mjaftueshme që të vërtetonin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Millutinoviqi kishte synim realizimin e këtij kontrolli me anë të metodave dhe mjeteve kriminale, si për shembull krimi i shpërnguljes. Provat që tregojnë se Millutinoviqi nuk u distancua nga dy deklaratat që bëri Millosheviqi në tetor 1998 nuk mjaftojnë që të bindin Dhomën jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synimin e lartpërmendur. Për më tepër, provat e lartpërmendura lidhur me dijeninë e Millutinoviqit për krimet, në një kohë që personat me përgjegjësi zyrtare për

këtë gjë i kishin thënë atij se këto akuza ishin propagandë ose ishin në procedim e sipër, së bashku me të gjitha provat mbi sjelljen e tij që Dhoma ka bërë të ditur se i pranon, nuk mjaftojnë që të bindin Dhomën se ai me të vërtetë synonte shpërnguljen e shqiptarëve kosovarë nga Kosova. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludon se pjesëmarrja e Millutinoviçit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Për këtë arsye, Dhoma do të trajtojë kategoritë e tjera të përgjegjësive.

b. Planifikimi/Nxitja/Urdhërimi

277. Sipas Prokurorisë, tërësia e provave vërteton përgjegjësinë penale të Millutinoviçit mbi bazën e planifikimit. Në këtë kuadër, Prokuroria i referohet pjesëmarrjes së tij në disa takime dhe vendime thelbësore më 1998 dhe 1999 lidhur me dislokimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së. Sipas Prokurorisë, tërësia e provave gjithashtu vërteton përgjegjësinë penale të Millutinoviçit mbi bazën e nxitjes. Në këtë aspekt, Prokuroria i referohet pjesëmarrjes së tij në disa takime dhe vendime kryesore më 1998 dhe 1999 lidhur me dislokimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu, mosmarrja e masave të rëndësishme për ndalimin ose parandalimin e kryerjes së krimeve (nga Millutinoviçi), si dhe përgëzimet që ai u drejtoi publikisht forcave të RFJ-së dhe Serbisë, vërtetojnë përgjegjësinë e tij penale për nxitjen e kryerjes së tyre. Së fundi, Prokuroria është e mendimit se tërësia e provave vërteton përgjegjësinë penale të Millutinoviçit mbi bazën e urdhërimit. Në këtë aspekt, Prokuroria i referohet pjesëmarrjes së tij në disa takime dhe vendime kryesore më 1998 dhe 1999 lidhur me dislokimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së.⁵⁶⁴

278. Mbrojtja, nga ana tjetër, pretendon se nuk ka prova që vërtetojnë se Millutinoviçi kishte planifikuar ndonjë veprimtari, vetë ose bashkë me të tjerë, që ishte faktor i rëndësishëm në kryerjen e ndonjë krimi.⁵⁶⁵ Gjithashtu Mbrojtja argumenton se nuk ka asnjë provë që Millutinoviçi të ketë nxitur dikë për të kryer një krim.⁵⁶⁶ Së fundi, lidhur me urdhërimin, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se Millutinoviçi nuk kishte pushtet ose mundësi *de jure* dhe *de facto* që t'i jepte dikujt urdhra. Për më tepër, nuk ka prova që ai t'i ketë dhënë ndonjë urdhër dikujt ose të ketë pasur dijeni që dikush tjetër kishte urdhëruar kryerjen e ndonjë krimi.⁵⁶⁷

279. Duke qenë se Dhoma ka konkluduar se nuk ekzistojnë ka prova të mjaftueshme që Millutinoviçi kishte synim kryerjen e krimit të shpërnguljes, Dhoma gjithashtu nuk është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Millutinoviçi projektoi një veprim ose mosveprim me qëllim

⁵⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 647-648.

⁵⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 281-284.

⁵⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 285-288.

⁵⁶⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 289-292.

kryerjen e shkeljes bazë të shpërnguljes së dhunshme. Dhoma gjithashtu nuk është e bindur se nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, ai nxiti dikë të vepronte në një mënyrë të veçantë, me qëllim kryerjen e krimit të shpërnguljes së dhunshme. Së fundi, Dhoma konkludon se Millutinoviqi nuk kishte pushtet *de jure* ose *de facto* që t'u jepte urdhra forcave të MPB-së ose të UJ-së që u përfshinë në kryerjen e krimeve në Kosovë. Me përjashtim të dy vendimeve të KLM-së të përmendura më lart që Kryekomandanti i përdori si platformë për lëshimin e urdhrave, nuk ekzistojnë prova që Millutinoviqi të ketë dhënë një urdhër të tillë. Gjithashtu nuk ekzistojnë prova që ai kishte synimin e nevojshëm. Rrjedhimisht, Dhoma përfundon se Millutinoviqi nuk mund të cilësohet përgjegjës për planifikim, nxitje ose urdhërim.

c. Ndhimë dhe inkurajim

280. Aktakuza pretendon se Millutinoviqi është përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të pretenduara në Aktakuzë, si nëpërmjet kontributit qenësor në kryerjen e këtyre krimeve, po ashtu edhe nëpërmjet mosplotësimit të detyrës së tij për parandalimin e atyre krimeve.⁵⁶⁸ Mbrojtja e Millutinoviqit argumenton se nuk ka prova që Millutinoviqi të ketë ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e cilitdo prej krimeve të pretenduara në Aktakuzë.⁵⁶⁹

281. Dhoma vë në dukje se për vërtetimin e fajësisë së tij nëpërmjet kësaj forme përgjegjësie, provat duhet të provojnë se Millutinoviqi ofroi ndihmë ose inkurajim praktik ose mbështetje morale në kryerjen e një krimi nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, faktor me ndikim të qenësishëm në kryerjen e krimit. Dhoma citon përfundimet e saj se në shtator dhe nëntor të vitit 1998, Millutinoviqi mbajti disa fjalime për ngritjen e moralit përpara zyrtarëve në Kosovë, dhe me këtë u dha njëfarë legjitimiteti veprimeve të tyre. Ai gjithashtu nuk ngriti asnjë shqetësim gjatë mbledhjeve të KLM-së dhe nuk mbështeti Gjukanoviqin i cili në disa raste ngriti probleme. Mirëpo, në kuadër të një çështjeje kaq të gjerë në të cilën janë përfshirë shumë individë, nuk mund të thuhet se këta dy faktorë në vetvete kanë ushtruar ndikim thelbësor në kryerjen e krimeve të shpërnguljes që u kryen nga fundi i marsit 1999 e më tej. Për sa i përket elementit mendor të domosdoshëm, duhet provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që Millutinoviqi dinte se veprimet ose mosveprimet e tij praktikisht ndihmuan, inkurajuan ose mbështetën moralisht kryerjen e krimeve dhe se ai ishte në dijeni të synimit të autorit fizik ose të ndërmjetëm për të kryer krime. Duke qenë se provat nga mbledhjet dhe diskutimet në të cilat mori pjesë Millutinoviqi dëshmojnë se pjesa më e madhe e tyre kishte të bënte me çështje politike, si autonomia e Kosovës, ose diskutime lidhur me veprimtaritë e forcave të RFJ-së dhe Serbisë në kuadër të operacioneve kundër UÇK-së, Dhoma nuk është e

⁵⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 649-652.

⁵⁶⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 293-298.

bindur që i vetmi përfundim i arsyeshëm është se Millutinoviçi kishte dijeni për qëllimin e atyre që po kryenin krime. Për më tepër, edhe kur ai njoftohej lidhur me zhvendosjet dhe krimet e mundshme, kryesisht nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, në të njëjtën kohë autoritetet përgjegjëse zyrtare të RFJ-së/Serbisë i thoshin atij që çështja e këtyre krimeve po trajtohej ose që ato ishin shkaktuar nga UÇK-ja dhe NATO. Për këtë arsye, Dhoma nuk është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat lidhur me njoftimin është se Millutinoviçi kishte dijeni për qëllimin e kryesit fizik ose të ndërmjetëm për të kryer krime të zhvendosjes.

8. Përfundimet lidhur me përgjegjësinë e Millan Millutinoviçit sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit

282. Sipas Prokurorisë, si President i Serbisë, Millutinoviçi kishte pushtet lidhur me qeverinë e Serbisë dhe sidomos me Ministrinë e Brendshme. Për këtë arsye, brenda kuadrit të paragrafit 3 të Nenit 7 ai ushtronte kontroll efektiv mbi Ministrin e Brendshëm dhe midis tyre ekzistonte lidhje epror-vartës.⁵⁷⁰ Për më tepër, Prokuroria parashtron se si anëtar i KLM-së dhe Komandës së Lartë, Millutinoviçi mund të propozonte pika të rendit të ditës në punimet e këtyre organeve. Rrjedhimisht, ai mund të propozonte diskutime për krimet e kryera nga UJ në Kosovë dhe të thërriste ushtarakë të lartë të UJ-së për t'i raportuar mbi këtë çështje. Kjo kompetencë i jepte atij “mundësi materiale që t’u tërhiqte vërejtjen dhe disiplinonte anëtarë të UJ-së” dhe rrjedhimisht kontroll efektiv mbi anëtarë të lartë të UJ-së me të cilët ai kishte lidhje epror-vartës.⁵⁷¹ Mbrojtja e Millutinoviçit, nga ana e saj argumenton se Millutinoviçi nuk është përgjegjës për asnjë nga krimet e pretenduara në Aktakuzë sipas Nenit 7(3) për arsye se nuk kishte asnjë vartës ose njeri mbi të cilin ushtronte kontroll efektiv.⁵⁷²

283. Bazuar në provat e lartpërmendura, e veçanërisht provat e pakta lidhur me pushtetin e tij mbi MPB-në, Dhoma është e mendimit që Millutinoviçi nuk kishte kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe Serbisë dhe si pasojë nuk mund të cilësohet përgjegjës sipas Nenit 7(3) të Statutit.

9. Përfundim

284. Dhoma vë në dukje se në këtë pjesë ka theksuar rastet kur nuk mund të nxirrej përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo nuk do të thotë që Dhoma ka vlerësuar veç e veç provat lidhur me çdo çështje që lidhet me përgjegjësinë e Millan Millutinoviçit. Dhoma ka marrë parasysh

⁵⁷⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 653.

⁵⁷¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 654.

⁵⁷² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 314.

të gjitha provat përkatëse në nxjerrjen e përfundimit të saj se nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që Millan Millutinoviçi mban përgjegjësi për krimet në Aktakuzë, në varësi të paragrafit të fundit në Aktgjykim. Sikur detyrimi i provës të mbështetëj në tërësinë e gjasave dhe jo jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, përfundimet mbase do të ishin ndryshe. Gjithsesi, Dhoma nuk ka për detyrë të përcaktojë fajësinë morale të Millan Millutinoviçit, por thjesht të marrë vendim nëse Prokuroria ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm akuzat në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se Millan Millutinoviçi është i pafajshëm për krimet e pretenduara në Aktakuzë.⁵⁷³

D. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E NIKOLLA SHAINOVIÇIT

1. I Akuzuari

285. I Akuzuari Nikolla Shainoviçi u lind më 7 dhjetor 1948 ne Bor, Serbi, dhe ka marrë pjesë aktive në Partinë Socialiste të Serbisë ("SPS"). Ai ka mbajtur poste të ndryshme në qeveritë e Serbisë dhe RFJ-së, duke përfshirë postin e kryeministrit të Serbisë dhe zëvendëskryeministrit të RFJ-së. Ai ishte gjithashtu një nga zëvendëskryeministrat e RFJ-së nga shkurti 1994 deri më ose rreth datës 4 nëntor 2000, kur u formua një qeveri e re federale.⁵⁷⁴

2. Akuzat e Aktakuzës

286. Aktakuza pretendon se gjatë vitit 1998, si dhe gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës, Shainoviçi ishte përfaqësuesi i Presidentit të RFJ-së, Slllobodan Millosheviçi, në Kosovë. Më tej Aktakuza pretendon se në këtë cilësi ai ishte kreu i Komandës së Përbashkët, një organ që kishte pushtet ndaj forcave të UJ-ve dhe MPB-së. Thuhet se si kreu i Komandës së Përbashkët ai mori pjesë në planifikimin, nxitjen, dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimeve të forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë, të cilat, më pas, u përfshinë në kryerjen e krimeve të përmendura në Aktakuzë. Gjithashtu diplomatë dhe përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë që kërkonin të bisedonin me një zyrtar të qeverisë për ngjarjet në Kosovë përcilleshin tek ai. Thuhet se ai luajti rol aktiv në negociatat për vendosjen e misionit verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe mori pjesë në shumë takime të tjera për krizën e Kosovës. Gjatë gjithë kohës së mbuluar nga Aktakuza ai veproi si pikë kontakti midis Slllobodan Millosheviçit dhe udhëheqësve të ndryshëm të shqiptarëve kosovarë.⁵⁷⁵

⁵⁷³ Paragrafi i fundit i Aktgjykimit e kufizon këtë deklaratë.

⁵⁷⁴ Aktakuza, para. 2, 9.

⁵⁷⁵ Aktakuza, para 10.

287. Shainoviqi akuzohet se gjatë kryerjes së të gjitha këtyre funksioneve ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu, apo ndihmoi dhe inkurajoi në planifikimin, përgatitjen, apo kryerjen e këtyre krimeve. Brenda kuptimit të termit "kreu", pretendohet se Shainoviqi mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ishte të ndryshohej përbërja etnike në Kosovë me qëllim që të garantohej vazhdimësia e kontrollit të krahinës nga ana e autoriteteve të FRJ-së dhe të Serbisë. Ai ngarkohet gjithashtu me përgjegjësi eprore për mosparandalimin apo mosndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit e tij.⁵⁷⁶

288. Mbrojtja e Shainoviqit i kundërshton të gjitha këto pretendime, duke argumentuar se Shainoviqi nuk kishte as pushtet dhe as kontroll ndaj forcave të UJ-së dhe MPB-së, dhe se as nuk mori pjesë në ndonjë ndërmarrje të përbashkët kriminale.⁵⁷⁷

289. Në Kapitullin VII më sipër Dhoma Gjyqësore ka përfunduar se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen krime ndaj popullsisë civile shqiptare kosovare në shumë nga komunat e Kosovës gjatë periudhës nga marsi deri në qershor 1999. Ky kapitull do të trajtojë nëse Shainoviqi është përgjegjës për ndonjë nga këto krime, në çfarëdo formë përgjegjësie të pretenduar në Aktakuzë.

3. Kompetencat e Shainoviqit

290. Palët janë dakord që gjatë gjithë periudhës së mbuluar nga Aktakuza, Shainoviqi ka qenë zëvendëskryeministër i RFJ-së, përgjegjës për politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të RFJ-së, si dhe përgjegjës për bashkëpunimin e RFJ-së me KVM-në.⁵⁷⁸ Çështja për të cilën nuk bien dakord palët ka të bëjë me nivelin e kompetencave të tij *de jure* në Kosovë, nëse ka pasur kompetenca *de facto*, dhe, nëqoftëse po, deri në çfarë niveli arrinin këto kompetenca.

a. Shainoviqi si përfaqësues i Millosheviqit në Kosovë

291. Sipas Prokurorisë, Shainoviqi ishte përfaqësuesi personal i Millosheviqit në Kosovë. Roli i tij kryesor ishte të zbatonte objektivat e Millosheviqit atje si dhe të koordinonte veprimet e UJ-së, MPB-së, dhe strukturave të tjera të armatosura.⁵⁷⁹ Mbrojtja e Shainoviqit e mohon këtë dhe argumenton se ai ishte thjesht një nga personat e shumtë, si Andreja Millosavleviq, dhe anëtarët e tjerë e grupit të punës së SPS-së për Kosovën, që u dërguan për të zgjidhur situatën në krahinë.⁵⁸⁰ Mbrojtja argumenton gjithashtu se Shainoviqi u dërgua në Kosovë thjesht sepse ne funksionin e tij

⁵⁷⁶ Aktakuza, para 16-22.

⁵⁷⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik).

⁵⁷⁸ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 12. *Shihni gjithashtu* P606 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 8-11, 20-24; ID260 (Vendim mbi përbërjen e qeverisë federale).

⁵⁷⁹ Aktakuza, para. 48; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para 662-663.

⁵⁸⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para 43.

si zëvendëskryeministër i FRJ-së, ai ishte përgjegjës për çështjet e jashtme dhe kishte përvojë në kontaktet me diplomatët e huaj. Ajo u referohet gjithashtu librit të Momir Bullatoviçit dhe shpjegimeve në të se Millosheviqi, duke e ditur se të gjithë ata që do të implikoheshin në Kosovë do të përfundonin të proceduar në Hagë, u përpoq t'a ruante Bullatoviçin duke dërguar në vend të tij Shainoviçin në Kosovë.⁵⁸¹

292. Nuk ka kundërshtim për faktin se Shainoviçi u dërgua në Kosovë në verën e vitit 1998, pasi ai vetë pranoi se kishte qenë në Kosovë rreth 80 për qind të kohës në periudhën nga korriku deri në shtator 1998.⁵⁸² Pika kryesore e mosmarrëveshjes midis palëve ka të bëjë me aspektin nëse vendimi për t'i ngarkuar atij detyrën e Kosovës u mor nga Millosheviçi i cili konsiderohej si personi më i pushtetshëm në RFJ në atë kohë, apo, siç parashikohej nga Kushtetuta e RFJ-së, ishte një vendim që u mor nga Kryeministri i RFJ-së, Momir Bullatoviç. Bullatoviçi dëshmoi se këtë vendim e mori ai vetë, dhe se arsyeja ishte përvoja diplomatike që kishte krijuar Shainoviçi gjatë zbatimit të Marrëveshjeve të Dejtonit, përvojë që do t'a ndihmonte në kontaktet dhe komunikimin me përfaqësuesit ndërkombëtarë, si ambasadori Christopher Hill.⁵⁸³ Gjithsesi kur u pyet nga Prokuroria dhe u ballafaqua me një pjesë të librit të tij ku thuhet se ky vendim u mor me kërkesë të Millosheviçit si dhe me qëllim që të shmangej implikimi i Bullatoviçit në Kosovë, Bullatoviçi u detyrua të pranonte se vendimin e kishte marrë Millosheviçi dhe se ai kishte qenë plotësisht dakord me këtë vendim.⁵⁸⁴ Rrjedhimisht kjo detyrë iu caktua Shainoviçit nga Bullatoviçi në përputhje të plotë me Kushtetutën e RFJ-së dhe Rregulloren e Procedurës së qeverisë së RFJ-së, por me urdhër të Millosheviçit. Dhoma Gjyqësore nuk pranon se arsyeja e këtij emërimi është dëshira e Millosheviçit për të ruajtur Bullatoviçin. Ka më shumë të ngjarë që ky vendim të jetë marrë sepse disa muaj më parë Shainoviçi kishte bërë një vizitë në krahinë për të parë situatën atje dhe se, siç do të shikohet edhe më poshtë, ai gëzonte besimin e Millosheviçit.⁵⁸⁵

⁵⁸¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para 47, 55; argumentet përmblylëse të Shainoviçit, T 27085 (21 gusht 2008).

⁵⁸² P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 431-432.

⁵⁸³ Momir Bullatoviçi, T. 13817-13820 (16 gusht 2007), T. 13891-13898 (17 gusht 2007). *Shih gjithashtu* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 120-125, 130-131, 192-193, 288, 302; Zhivadin Jovanoviçi, T. 13997 (20 gusht 2007); Dushko Matkoviçi, T. 14589, 14597-14598 (29 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçi, T. 14652 (30 gusht 2007); Millomir Miniçi, T 14743-14744, 14756 (31 gusht 2007).

⁵⁸⁴ Momir Bullatoviçi, T. 13895-13897 (17 gusht 2007); P2895 (Pjesë nga libri i Momir Bullatoviçit me titull "Rregullat e Heshtjes"). *Shihni gjithashtu* Dushko Matkoviçi, T. 14588-14589 (29 gusht 2007); Branko Gajiq, T. 15412-15413 (11 shtator 2007), T. 15439 (12 shtator 2007); Andreja Millosavleviçi, T. 14305 (23 gusht 2007), Radomir Llukiq, T. 26298-26302 (15 maj 2008).

⁵⁸⁵ Takimi i parë publik i Shainoviçit me përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë u zhvillua në mars ose prill 1998, në selinë qendrore të LDK-së (partia e Rugovës), në Prishtinë. Qëllimi i atij takimi ishte të vendosej një kontakt i vazhdueshëm. Pas takimit Shainoviçi dhe Zoran Liliçi u dërguan nga Bullatoviçi në Kosovë në një mision faktmbledhës, për të cilin ishte në dijeni edhe Millosheviçi. Shainoviçi dhe Liliçi bënë dy vizita dikur në prill apo maj 1998, secila prej të cilave vazhdoi jo me tepër se një ditë. Pas kthimit Shainoviçi dhe Liliçi prezantuan konstatimet e tyre me gojë në takime ku ishin të pranishëm përfaqësues të qeverisë së RFJ-së dhe të qeverisë serbe. Më pas

293. Lidhur me këtë, Bullatoviçi pranoi se nuk i kishte caktuar asnjëherë detyra specifike Shainoviçit, ndonëse ishte formalisht epror i tij. Ai pranoi gjithashtu se Shainoviçi nuk i raportoi atij për incidentet në Abrinë e Epërme dhe Reçak, dhe se nuk i kishte thënë gjithashtu asgjë për vendosjen e Rugovës në arrest shtëpiak.⁵⁸⁶ Në këto aspekte veprimet e Shainoviçit binin ndesh me pozicionin formal kushtetues të përshkruar nga specialisti për Kushtetutën, Radomir Llukiçi, i cili dëshmoi se roli i kryeministrit ishte kaq dominues sa anëtarët e tjerë të kabinetit federal ishin thjesht këshilltarë pa fushë veprimi për aktivitetet dhe vendimmarrje autonome.⁵⁸⁷ E gjitha kjo tregon se Shainoviçi vepronte me autorizimin e dikujt tjetër dhe se i raportonte po këtij personi. Mbi bazën e dëshmive ky person mund të ketë qenë vetëm Millosheviçi. Dhoma Gjyqësore mendon se nëqoftëse Shainoviçi nuk i merrte urdhrat nga Bullatoviçi, i vetmi burim i pushtetit të Shainoviçit ishte Millosheviçi.

294. Duke përshkruar rolin e tij gjatë intervistës, Shainoviçi i tha Prokurorisë se detyra e tij kryesore ishte të komunikonte me diplomatët e huaj dhe të diskutonte me ta çështjet e Kosovës, duke përfshirë gjendjen politike dhe incidentet, si dhe t'i raportonte qeverisë së RFJ-së për këto bisedime. Ai komunikonte rregullisht me Bullatoviçin në mbledhjet javore të kabinetit.⁵⁸⁸ Ai ishte gjithashtu në kontakt me Andreja Millosavleviçi, i cili ishte në Kosovë nga korriku në shtator 1998 (i vendosur në të njëjtën ndërtesë me Pavkoviçin) dhe vepronte si person kontakti midis ministrive serbe, kryetarëve të pesë qarqeve të Kosovës, dhe kryetarëve të 29 komunave në Kosovë.⁵⁸⁹ Të dy këta persona shkëmbenin rregullisht informacione për punën e tyre.⁵⁹⁰

295. Shumë dëshmitarë, që e kishin takuar Shainoviçin në rrethana të ndryshme, dhanë dëshmi përputhëse për pushtetin e Shainoviçit në Kosovë dhe burimin e këtij pushteti. Klaus Naumann, i cili në atë kohë ishte kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, tha se në takimet e 24 dhe 25 shtatorit 1998 Millosheviçi ia prezantoi Shainoviçin si zëvendëskryeministër i RFJ-së dhe "personi përgjegjës për Kosovën."⁵⁹¹ Knut Vollebaek, ministri i Jashtëm norvegjez dhe në atë kohë kryetar i

Millosheviçi i thirri Shainoviçin dhe Liliqin në një takim në zyrën e tij për të mësuar detaje të tjera për ngjarjet në Kosovë për të cilat ata kishin raportuar. Në takim Shainoviçi shprehu pikëpamjen e tij për gjendjen si dhe për masat e gjithanshme që ishin parashikuar të merreshin, masat e sigurisë, masat politike për gjendjen e brendshme si dhe masat politike për gjendjen e jashtme. Megjithatë, Millosheviçi nuk i kërkoi që ai të bënte propozime apo ofronte zgjidhje specifike dhe kështu në takim nuk u mor asnjë vendim për hapat që duhet të ndërmerreshin. P605 (Intervista e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 24-34, 37, 44-55, 74-78, 84-88, 91.

⁵⁸⁶ Momir Bullatoviçi, T. 13901-13902, 13910-13913 (17 gusht 2007).

⁵⁸⁷ 2D393 (Aktekspertiza e Radomir Llukiçit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 84.

⁵⁸⁸ P605 (Intervista e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 20-24, 208, 384. *Shihni gjithashtu* Momir Bullatoviçi, T. 13820-13821 (16 gusht 2007), T. 13899-13900 (17 gusht 2007).

⁵⁸⁹ Andreja Millosavleviçi, T. 14262-14266, 14268-14272, 14311-14312 (23 gusht 2007), T. 14336-14338 (24 gusht 2007).

⁵⁹⁰ Andreja Millosavleviçi, T. 14304-14306, 14308 (23 gusht 2007), T. 14358 (24 gusht 2007).

⁵⁹¹ Klaus Naumann, T. 8251 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënimet e intervistave me Zyrën e Prokurorisë), para. 26, P2512 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6993.

OSBE-së, dëshmoi se përshtypja e tij në atë kohë ishte se Shainoviqi ishte personi përgjegjës për Kosovën në qeverinë e RFJ-së.⁵⁹² Richard Ciaglinski, i cili u angazhua në KVM në fund të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999, dëshmoi se Shainoviqi ishte përgjegjës për Kosovën dhe se, për sa i përket Kosovës, Millosheviqi ishte i vetmi person me pushtet më të madh se Shainoviqi.⁵⁹³ Michael Phillips, i cili punoi si shef i kabinetit të William Walker-it, dëshmoi se në takimin e tij të parë me Shainoviqin, Shainoviqi e prezantoi veten si përfaqësues personal i Millosheviqit në Kosovë.⁵⁹⁴ Joseph Maisonneuve, shefi i zyrës rajonale të KVM-së në Prizren, dëshmoi se asnjëherë nuk e kishte dëgjuar Shainoviqin t'i nënshtrohej dikujt tjetër në lidhje me veprimet në Kosovë. Sipas mendimit të tij, nuk kishte dyshim se Shainoviqi ishte i mirinformuar për çfarë po ndodhte në Kosovë dhe se kishte pushtet të konsiderueshëm për të vepruar.⁵⁹⁵ Ibrahim Rugova, i cili e takoi Shainoviqin disa herë gjatë arrestit të tij shtëpiak, tha se Shainoviqi ishte përgjegjës për Kosovën dhe se kishte më shumë pushtet se sa të gjithë serbët e atjeshëm.⁵⁹⁶ Dushan Llonçari, i cili punoi me Shainoviqin në Kosovë, dëshmoi se Shainoviqi kishte shumë pushtet, si formalisht në funksionin e tij si zëvendëskryeministër dhe kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në (komision që është shqyrtuar hollësisht më poshtë), po ashtu dhe joformalisht, duke marrë përsipër të bënte shumë më tepër gjëra se sa ishte i detyruar të bënte në bazë të funksioneve që kishte.⁵⁹⁷ Gjenerali Karol John Drewienkiewicz, i cili ishte gjithashtu pjesë e KVM-së, deklaroi se Shainoviqin ia prezantuan vazhdimisht si pikë kontakti apo si i vetmi person me kompetencë vendimmarrjeje në Kosovë. Sa here që çështjet i jepeshin atij mbi bazën e postit që kishte si zyrtar federal, askush nuk e kundërshtoi këtë gjë nga pikëpamja kushtetuese apo ligjore.⁵⁹⁸ Gazetari dhe negociatori shqiptar kosovar, Veton Surroi, dëshmoi se Shainoviqi ishte personi më i besuar i Millosheviqit në Kosovë dhe se ishte bashkëpunëtori më i ngushtë i tij lidhur me çështjet e Kosovës.⁵⁸⁵ E gjitha kjo përputhet me përshtypjen që kishte John Crosland, atashe i mbrojtjes i ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Beograd.⁶⁰⁰

296. Ambasadori austriak Wolfgang Petritsch dëshmoi se Shainoviqi ishte përgjegjës për çështjet lidhur me Kosovën, dhe se për këtë arsye ata patën shumë takime midis tyre. Ai deklaroi se Shainoviqi ishte "njeriu i besuar i Millosheviqit për Kosovën". Petritsch-i tha më tej se Shainoviqi gjithmonë ia përcillte çështjet Millosheviqit për vendim përfundimtar, ashtu siç veproi në rastin kur

⁵⁹² Knut Vollebaek, T. 9508 (31 janar 2007), P2634 (deklarata e dëshmitarit me datën 8 janar 2002), para. 19.

⁵⁹³ Richard Ciaglinski, T. 6825 (17 nëntor 2006).

⁵⁹⁴ Michael Phillips, T. 11831 (19 mars 2007).

⁵⁹⁵ Joseph Maisonneuve, T. 11033 (6 mars 2007).

⁵⁹⁶ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4235-4236.

⁵⁹⁷ Dushan Llonçar, T. 7590 (30 nëntor 2006).

⁵⁹⁸ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit me datën 23 qershor 2000), para. 201.

⁵⁸⁵ Veton Surroi, T. 4547 (10 tetor 2006).

⁶⁰⁰ John Crosland, P2645 (deklarata e dëshmitarit me datën 31 tetor 2006), para. 58.

negociuan për lirim e të burgosurve të UÇK-së në fund të janarit 1999, dhe se Shainoviqi kishte ndikim të konsiderueshëm për gjithçka që ndodhte në Kosovë.⁶⁰¹

297. Shefi i KDOM-it amerikan, Shaun Byrnes, dëshmoi se kishte përshtypjen se Shainoviqi ishte "pika e kontakteve politike për Kosovën."⁶⁰² Byrnes u takua me Shainoviqin disa herë dhe këto takime zhvilloheshin gjithmonë për të diskutuar situata të ndryshme krize, siç do të diskutohet më hollësisht më poshtë. Nga të gjitha këto takime Byrnes-it iu përforcua përshtypja për pushtetin që Shainoviqi gëzonte në Kosovë.⁶⁰³ Së fundi, siç u theksua më sipër, Momir Bullatoviqi pranoi, pasi u përpoq disa herë t'i shmangej pyetjes, se asnjëherë nuk i kishte caktuar detyra specifike Shainoviqit, ndonëse formalisht ai ishte epror i tij.⁶⁰⁴

298. Kur u pyet gjatë intervistës me Prokurorinë se çfarë mendonte për të gjitha këto konsiderata për rolin e tij, Shainoviqi deklaroi se ato ishin të vetëkuptueshme për faktin se përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë gjithmonë takoheshin me të si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-s dhe si personi që përcillte mesazhet tek Millosheviqi dhe organet e tjera shtetërore.⁶⁰⁵ Ai pranoi se në funksionin e tij si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në, ai shërbeu si ndërmjetës midis Millosheviqit dhe komunitetit ndërkombëtar, duke thënë se "njerëzit ... e dinin se duhej të vinin tek unë për çdo gjë që donin t'i transmetohej qeverisë jugosllave apo z. Millosheviq, sepse kjo ishte detyra ime."⁶⁰⁶

299. Dhoma Gjyqësore është e bindur se Shainoviqi ishte zyrtar i pushtetshëm, i cili jo vetëm që i përcillte informacione Millosheviqit dhe transmetonte urdhrat e tij në Kosovë, por që kishte gjithashtu ndikim të konsiderueshëm ndaj ngjarjeve në krahinë dhe kishte kompetenca për vendimmarrje. Pushteti i pozitës së tij nuk vinte thjesht nga funksioni i tij si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në. Në fakt, ai ishte vendosur në Kosovë shumë muaj para se të vinte KVM-ja dhe konsiderohej si person me pushtet të konsiderueshëm që përpara mbërritjes së këtij

⁶⁰¹ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklarata e dëshmitarit me datën 9 qershor 1999), f. 7-8, P2793 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7216-7217.

⁶⁰² Shaun Byrnes, T. 12138 (16 prill 2007).

⁶⁰³ Shaun Byrnes, T. 12138-12140 (16 prill 2007).

⁶⁰⁴ Momir Bullatoviq, T. 13901-13902 (17 gusht 2007).

⁶⁰⁵ P605 (Intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 843-851.

⁶⁰⁶ P605 (Intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 845.

misioni. Analiza e dëshmimeve të diskutuara në pjesët e mëposhtme të kësaj pjese të Aktgjykimit shërben për të përforcuar këtë mendim.

b. Pushteti i Shainoviqit mbi UJ-në dhe MPB-në

300. Dhoma ka konstatuar tashmë se, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1998 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 1999, ekzistonte një organ bashkërendues, i cili kishte ndikim të konsiderueshëm në veprimet e forcave të MPB-së dhe UJ-së.⁶⁰⁷ Prokuroria pretendon se në krye të këtij organi ishte fillimisht Miniqi, ndërsa më pas Shainoviqi. Sipas Prokurorisë, si kreu i Komandës së Përbashkët më 1998 dhe 1999, Shainoviqi mbikëqyrte veprimtaritë e UJ-së, MPB-së dhe strukturave civile në Kosovë, si edhe i drejtonte në përputhje me udhëzimet e Millosheviqit. Në këtë mënyrë, ai i përdori forcat e RFJ-së/Serbisë për të kryer krime, si edhe mori pjesë në vënien në zbatim të planit për stërvitjen dhe armatosjen e civilëve joshqiptarë të Kosovës.⁶⁰⁸ Mbrojtja e Shainoviqit, nga ana tjetër, përveçse e mohon ekzistencën e Komandës së Përbashkët, argumenton se Shainoviqi nuk ka qenë kreu i Komandës së Përbashkët më 1998 dhe 1999 dhe se nuk kishte pushtet komandues mbi UJ-në dhe/apo MPB-në.⁶⁰⁹ Përkundrazi, ai thjesht merrte pjesë në mbledhje me përfaqësues të UJ-së dhe MPB-së (të cilat nuk u zhvilluan më pas muajit tetor 1998, pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të Tetorit), në mënyrë që të informohej për situatën në terren dhe, kështu, t'i ushtronte në mënyrë efektive detyrat e tij në Kosovë.⁶¹⁰ Në vijim të argumentit të saj lidhur me mungesën e pushtetit të Shainoviqit në Komandën e Përbashkët, Mbrojtja e Shainoviqit parashtron se nuk kishte asnjë marrëdhënie vartësie apo asnjë marrëdhënie tjetër zyrtare midis anëtarëve të Grupit të Punës për Kosovën, Matkoviqit, Miniqit, Angjelkoviqit, nga njëra anë, dhe Shainoviqit, nga ana tjetër.⁶¹¹ Së fundi, Mbrojtja argumenton se “procesverbalet” e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët nuk ishin gjë tjetër veçse shënime të oficerit të UJ-së, Millan Gjakoviqit, të mbajtura gjatë këtyre mbledhjeve, në të cilat ai ka shënuar vetëm ato pjesë që i interesonin apo i përkisnin atij dhe, rrjedhimisht nuk përbëjnë një procesverbal të plotë apo tërësisht të saktë.⁶¹²

301. Dhoma vëren se, gjatë marrjes së vendimit lidhur me kuadrin e pushtetit të Shainoviqit mbi UJ-në dhe MPB-në, si edhe lidhur me shtrirjen e pushtetit të tij në Kosovë në përgjithësi, u është kushtuar vëmendje e veçantë mbledhjeve ku ka qenë i pranishëm Shainoviqi dhe zyrtarë të tjerë të lartë më 1998 dhe 1999, gjatë të cilave u diskutuan veprimtari të ndryshme të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Shumë prej këtyre mbledhjeve janë përmendur në pjesë të tjera të Aktgjykimit, sidomos

⁶⁰⁷ *Shih* Pjesën VI.E.

⁶⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 164, 673.

⁶⁰⁹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 68–93, 103–107.

⁶¹⁰ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 84–102.

⁶¹¹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 63–67.

në Pjesën VI.E, dhe si pasojë nuk do të përshkruhen me hollësi këtu. Ndërkohë, Dhoma do të përqendrohet te provat për kontributin që ka dhënë Shainoviqi në këto mbledhje dhe, krahas provave të tjera, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë intervistës së tij me Prokurorinë, në ato pjesë ku trajtohet kontributi në fjalë.

i. Pushteti i Shainoviqit mbi UJ-në dhe MPB-në në vitin 1998

302. Sikurse është thënë më parë, dikur nga fundi i muajit maj dhe fillimi i muajit qershor 1998, përpara se Shainoviqi të vendosej në Kosovë, Bullatoviqi dërgoi atë dhe Zoran Liliqin, edhe ky zëvendëskryeministër i RFJ-së asokohe, me një mision “faktmbledhës” në krahinë.⁶¹³ Ata bënë dy vizita, pa kaluar një javë nga njëra-tjetra, ku secila prej tyre nuk zgjati më shumë se një ditë.⁶¹⁴ Gjatë vizitës së dytë, të dy ata u takuan me një sërë zyrtarësh të MPB-së dhe UJ-së në kazemat e UJ-së në Pejë. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm Miodrag Simiqi, shef i Shtabit të Armatës së Tretë, së bashku me komandantin e Armatës së Tretë Dushan Samarxhiqin, Vllastimir Gjorgjeviqin, Obrad Stevanoviqin, të akuzuarin Llukiq, Franko Simatoviqin dhe Jovica Stanishiqin. Dukej se Stanishiqi ishte në krye të anës së MPB-së. Diskutimi kishte të bënte me situatën në zonën Gjakovë-Deçan dhe në kufi. Shainoviqi dhe Liliqi kryesisht dëgjonin, ndërsa oficerët e MPB-së dhe UJ-së i informonin për situatën.⁶¹⁵

303. Në qershor 1998, Këshilli Kryesor i SPS-së, anëtar i të cilit asokohe ishte edhe Shainoviqi, dërgoi në Kosovë një ekip të përbërë nga Miniq, Matkoviqi dhe Angjelkoviqi (i njohur si “Grupi i Punës”).⁶¹⁶ Ata bënë mbledhje me përfaqësues të ushtrisë dhe policisë si edhe me autoritete dhe politikanë vendorë, përfshirë anëtarë të SPS-së, për të cilat i raportuan Millosheviqit, Millutinoviqit dhe Shainoviqit më 25 qershor 1998.⁶¹⁷

304. Pastaj, Shainoviqi mori pjesë në një mbledhje të zhvilluar më 21 korrik 1998, në Beli Dvor në Beograd, e cila është përmendur edhe më parë në Aktgjykim,⁶¹⁸ dhe gjatë së cilës u miratua zyrtarisht një plan që përfshinte masa ushtarake dhe politike për shtypjen dhe luftën kundër terrorizmit në Kosovë (“Plani kundër Terrorizmit”). Persona të tjerë të pranishëm ishin

⁶¹² Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 189–204.

⁶¹³ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 29–33, 37, 55.

⁶¹⁴ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 33–34, 45, 53.

⁶¹⁵ Miodrag Simiq, T. 15619–15622 (14 shtator 2007); P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 91–95.

⁶¹⁶ P1012 (Procesverbali i Sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 6-8. *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 118, 125–129, 288.

⁶¹⁷ Dushko Matkoviq, T. 14590–14592 (29 gusht 2007), T. 14633–14634 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14744–14751 (31 gusht 2007); Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26619–26620 (8 korrik 2008). *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë, 11 dhjetor 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 201–202, 310–311, 345.

⁶¹⁸ *Shih* Pjesën VI.E.

Millutinoviqi, Miniqi, Perishiqi, Pavkoviqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi dhe Llukiqi.⁶¹⁹ Nga kjo mbledhje, Shainoviqi kuptoi se detyra e tij në lidhje me këtë Plan ishte t'u shpjegonte përfaqësuesve të huaj se veprimet e ndërmarra bënë pjesë në luftën kundër terrorizmit dhe nuk kishin në shënjestër popullatën shqiptare kosovare.⁶²⁰

305. Në intervistën e tij, Shainoviqi i tha Prokurorisë se nga qershori deri në fillim të tetorit 1998, ai mori pjesë në katër-pesë mbledhje të tilla, në të cilat foli vetëm për çështjet që ishin brenda kompetencës së tij, domethënë për situatën e përgjithshme lidhur me Kosovën, dhe se nuk u dha asnjëherë asnjë urdhër UJ-së ose/dhe MPB-së.⁶²¹ Ai shpjegoi edhe se pjesëmarrësit në këto mbledhje paraqitën pikëpamjen e tyre për situatën në Kosovë dhe, ndonjëherë, rekomanduan një plan veprimi. Pas diskutimit, Millosheviqi formulonte ose arrinte në përfundime se çfarë masash duhej të merreshin dhe kjo përbënte bazën e veprimit për UJ-në dhe MPB-në. Pas mbledhjeve, përfaqësuesit e UJ-së dhe MPB-së ktheheshin në komandat apo zyrat përkatëse të tyre dhe i vinin këto përfundime në zbatim.⁶²² Faktin që këto mbledhje janë zhvilluar e konfirmon Dushko Matkoviqi, i cili ishte një ndër pjesëmarrësit. Sipas Matkoviqit, më 5 gusht 1998, ai, së bashku me Millosheviqin, Miniqin, Angjelkoviqin, Shainoviqin, Perishiqin, Pavkoviqin, Dimitrijeviqin, Samarxhiqin, Llukiqin, Gjorgjeviqin dhe Stevanoviqin, morën pjesë në një mbledhje ku u paraqitën raporte për ngjarjet në Kosovë.⁶²³ Një mbledhje tjetër, me të njëjtët persona, u zhvillua në fund të muajit gusht 1998, ku pjesëmarrësit raportuan për “realizimin e planit origjinal”.⁶²⁴

(A) Mbledhjet e Komandës së Përbashkët

306. Pas mbledhjes së datës 21 korrik 1998, Shainoviqi dhe anëtarët e Grupit të Punës u kthyen në Kosovë dhe filluan të takoheshin thujtë përditë në Prishtinë me përfaqësues të UJ-së dhe MPB-së, si për shembull me Pavkoviqin, Llukiqin, Gjorgjeviqin, Stevanoviqin dhe Gjakoviqin.⁶²⁵ Me intensifikimin e bashkërendimit, u mor vendimi për të mbajtur përditë “mbledhje bashkërendimi”

⁶¹⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 197–198, 203, 245, 345, 418–419, 436–440; Dushko Matkoviq, T. 14634–14637 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9; Millan Gjakoviq, T. 26410 (19 maj 2008); Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26589–26590 (8 korrik 2008). *Shih edhe* 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njëjësive, 22 korrik 1998; 4D101 (Plani i Korpusit të Prishtinës për angazhimin e njëjësive në Kosovë, 23 korrik 1998).

⁶²⁰ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 446.

⁶²¹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 199–203, 245–248, 290; *Shih edhe* Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26587–26591 (8 korrik 2008), T. 26710–26712 (9 korrik 2008).

⁶²² P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 233–235, 240.

⁶²³ Dushko Matkoviq, P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 13.

⁶²⁴ Dushko Matkoviq, P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 13; P1435 (Raport për realizimin e fazës së 5-të të planit të luftës kundër terrorizmit, 22 shtator 1998).

⁶²⁵ Dushko Matkoviq, T. 14644–14645 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003) f. 9. *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 201–203, 208, 414, 419–421, 440–442.

me UJ-në dhe MPB-në.⁶²⁶ Këto mbledhje të përditshme në Prishtinë që filluan në verën e vitit 1998, njiheshin si mbledhjet e “Komandës së Përbashkët”.⁶²⁷

307. Shainoviqi pretendoi se qëllimi i këtyre mbledhjeve ishte diskutimi i çështjeve të lidhura me autoritetet civile, informimi i UJ-së dhe MPB-së për problemet që kishin autoritetet civile dhe shkëmbimi i informacionit çka do të ndihmonte në shmangien e gabimeve. Sipas Shainoviqit, në këto mbledhje nuk u mor asnjë vendim dhe qëllimi kryesor i tyre ishte dhënia dhe shkëmbimi i informacionit midis autoriteteve civile dhe forcave të sigurisë.⁶²⁸ Mirëpo, Dhoma kujton këtu konstatimin e saj se Komanda e Përbashkët kishte një ndikim të ndjeshëm mbi veprimet e MPB-së dhe UJ-së lidhur me vënien në zbatim të fazave të ndryshme të Planit kundër Terrorizmit.

308. Shainoviqi shpjegoi se, pas diskutimeve në këto mbledhje, ai i raportonte Millosheviqit, Bullatoviqit dhe Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme. Ai merrte informacion edhe nga Bullatoviqi dhe ministri i Punëve të Jashtme, informacion të cilin, më pas, e transmetonte në mbledhjet e Prishtinës.⁶²⁹ Megjithatë, Shainoviqi mohoi që roli i tij konsistonte në përcjelljen e udhëzimeve të Millosheviqit.⁶³⁰ Gjithashtu ai deklaroi se nuk ishte në gjendje të vinte në dyshim Pavkoviqin dhe Llukiqin lidhur me çështjet që ishin brenda kompetencave të tyre, mirëpo shpjegoi se atmosfera në këto mbledhje ishte e tillë që çdokush mund të shprehte çfarë mendonte dhe mund të shkëmbente informacion për çështjet lidhur me fushat e tyre.⁶³¹

309. Gjatë këtyre mbledhjeve, në shumicën e të cilave mori pjesë Shainoviqi, personat e pranishëm në përgjithësi raportnin për statusin e veprimeve të përbashkëta dhe komentnin për situatën e atëhershme në Kosovë. Dhoma kujton këtu konstatimin e mëhershëm të saj se nuk ka dyshim që politikanët e pranishëm në mbledhjet e Komandës së Përbashkët i shprehnin mendimet e tyre se çfarë duhej të bënin UJ-ja dhe MPB-ja dhe se Miniqi dhe Shainoviqi luanin një rol udhëheqës, duke i mbikëqyrur mbledhjet dhe, shpesh, duke e drejtuar grupin.⁶³² Kjo konfirmohet nga Shënime të Komandës së Përbashkët, të mbajtura nga Millan Gjakoviqi. Dhoma pranon se këto Shënime nuk i identifikojnë shprehimisht rolet e luajtura nga pjesëmarrësit, por vetëm evidentojnë disa deklarata të të pranishmëve. Megjithatë, Dhoma gjykon se, marrë në tërësi për

⁶²⁶ Dushko Matkoviq, T. 14644–14645 (30 gusht 2007); Zoran Angjelkoviq, T. 14656 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14748 (31 gusht 2007).

⁶²⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët). *Shih në përgjithësi* Urdhri e Dytë lidhur me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008 (ku pranohet prova materiale IC199 si plotësues i pjesëve të palexueshme të provës materiale P1468).

⁶²⁸ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 203–204.

⁶²⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 208. *Shih edhe* Momir Bullatoviq, T. 13820–13821 (16 gusht 2007), T. 13899–13900 (17 gusht 2007).

⁶³⁰ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 307.

⁶³¹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 405–408.

⁶³² *Shih* Pjesën VI.E.

numrin e madh të mbledhjeve me të cilat lidhen, Shënimet ilustrojnë me qartësi rolet e të pranishmëve. Ato pasqyrojnë faktin që Shainoviçi, së bashku me Miniçin, luajtën një rol udhëheqës gjatë këtyre mbledhjeve dhe tregojnë se Shainoviçi ushtroi pushtet *de facto* në drejtimin e veprimeve të UJ-së dhe/ose MPB-së në vitin 1998.

310. Për shembull, në mbledhjen e zhvilluar më 23 korrik 1998, Shainoviçi tha se nuk përbënte më asnjë të fshehtë se “operacioni” ishte në zhvillim e sipër; ai bëri të ditur nevojën për diskutuar se çfarë masash të tjera duhej të merreshin për vëzhgimin e kufirit; dhe tha se Sigurimi i Shtetit (RDB) duhej ta intensifikonte punën dhe të kryente një zbulim ofensiv dhe, madje, të fortë.⁶³³ Shainoviçi tha edhe se synimi i këtyre forcave ishte ruajtja e komunikimit dhe se lipsej që ato të nisnin veprimet me pjesëmarrjen e ushtrisë në mënyrë që ta arrinin këtë synim.⁶³⁴

311. Në mbledhjen e zhvilluar më 25 korrik, Shainoviçi i vlerësoi pozitivisht veprimtaritë e asaj dite dhe tha se duhej të stabilizoheshin “njësitë” dhe të ndërmerreshin masa sigurie.⁶³⁵ Në mbledhjen e zhvilluar më 26 korrik, pas raporteve të gjata që dhanë disa pjesëmarrës, Shainoviçi e mbylli mbledhjen duke thënë se ai do të merrte përgjegjësinë për dështimet, megjithëse është e paqartë nëse e kishte fjalën për dështimet e Komandës së Përbashkët apo të aksioneve specifike të UJ-së/MPB-së.⁶³⁶ Më 29 korrik, Shainoviçi tha se dy “detashmente në malin Rudnik do të sulmojnë Llaushën” dhe se “duhet të jetë aktiv edhe një grup luftimi, për ta izoluar Llaushën”.⁶³⁷ Më 31 korrik, ai shprehu mendimin se problemi kryesor ishte “çështja e refugjatëve” dhe “ekipeve televizive për të pasqyruar kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre, nëse ishte e mundur”.⁶³⁸ Në mbledhjen e datës 8 gusht 1998 ai udhëzoi që “të përgatitej faza tjetër për të martën [dhe] të ‘mbaronin punë’ me fshatin Josiq”, ndërsa Pavkoviçi vërejti se “duhej të ‘mbaronin punë’ edhe me fshatin Voushtë”.⁶³⁹ Më 12 gusht, Shainoviçi tha se ushtria duhet t’i përmbushte detyrimet e veta në brezin kufitar; policia duhej të mbulonte të gjithë territorin dhe të konsolidohej, ndërsa Sigurimi i Shtetit (RDB) duhej “të merrte zonën e tretë”; RDB-ja dhe ushtria duhej të bënin një propozim të përbashkët për plane të mëtejshme; dhe duhej të vazhdonte konfiskimi i armëve.⁶⁴⁰ Në mbledhjen e datës 16 gusht, ai bëri disa deklaratë në formë urdhri: “të rritet kontrolli në fshatra nesër”, “të

⁶³³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 7.

⁶³⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 8.

⁶³⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 11.

⁶³⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 16.

⁶³⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 27.

⁶³⁸ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 34.

⁶³⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 47.

⁶⁴⁰ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 50. *Shih edhe* Zoran Angjelkoviç, T. 14698–14701 (30 gusht 2007), T. 14731–14734 (31 gusht 2007).

dërgohet një grup luftimi rreth Junikut”, “të organizohen pozicionet” dhe “të përgatitet pastrimi i rrugës (UJ)”.⁶⁴¹ Në mbledhjen e zhvilluar më 27 gusht, ai tha se duhej përgatitur një raport se ku mund të ndërtoheshin dhe të zgjeroheshin vendbanimet serbe.⁶⁴²

312. Ai vijoi pjesëmarrjen në këto mbledhje me të njëjtën atmosferë gjatë gjithë shtatorit dhe tetorit. Në mbledhjen e zhvilluar më 2 shtator, Shainoviqi përmendi marrjen e masave nga policia në Rugovë dhe, sidomos, në Qiqavicë.⁶⁴³ Më 15 shtator ai tha se duhej të vazhdonin aksionet; konkretisht, se duhej të vazhdonin veprimtaritë civile.⁶⁴⁴ Më 20 shtator, Shainoviqi tha, ndër të tjera, se duhej të organizohej puna e policisë vendore në zonat e Gjakovës, Pejës dhe Deçanit.⁶⁴⁵ Sipas Shënimeve të datës 21 shtator, Shainoviqi tha se Komanda e Përbashkët nuk duhej të vinte në zbatim “çështjet e përmendura nga Millosheviqi dhe Jelsini në deklaratë” dhe se nuk duhej ta zvogëlonin numrin e forcave në Kosovë.⁶⁴⁶ Ai tha më tej se askush nuk e vë në dyshim “të drejtën tonë legjitime për ta mbrojtur vendin”, por se veprimet duhej të kryheshin në mënyrë të disiplinuar, “për të shmangur zjarrvënien”. Ai tha edhe se duhet të kishte një numër të forcave të policisë për të organizuar kthimin e civilëve.⁶⁴⁷ Më 22 shtator, ai raportoi se kishte pasur përleshje shumë të ashpra dhe se ata kishin pësuar humbje. Ai sugjeroi rigrupimin e dy kompanive të forcave të PJP-së dhe tha se operacionet duhej të vijonin të nesërmen. Ai tha edhe se “pas mbarimit të operacionit [ata] do të duhej të angazhonin një togë ndërhyrjeje për të rrethuar fshatin ku ndodhen terroristët ... Një oficer ndërlihdës, së bashku me Llukiqin ngarkohen me detyrën e angazhimit të togës së ndërhyrjes”.⁶⁴⁸ Në mbledhjen e zhvilluar më 26 shtator, pas raportit të Pavkoviqit dhe Llukiqit se kishte përfunduar aksioni në Abrinë e Epërme dhe Abrinë e Poshtme, Shainoviqi tha se operacioni “Jezerca” duhej të vijonte të nesërmen.⁶⁴⁹ Më 29 shtator, ai tha se u duhej t’i “demoralizojnë” shqiptarët kosovarë dhe t’i “bindnin ta braktisnin ringjalljen e separatizmit”. Ai tha, gjithashtu, se u duhej të pajisnin “të paktën një kompani nga çdo detashment”.⁶⁵⁰

313. Më 4 tetor, Shainoviqi tha se duheshin marrë të gjitha masat në kufi, sepse ishin të mundshme të gjitha llojet e sulmeve, përfshirë edhe bombardimin, dhe se duheshin siguruar selia dhe objektet që mund të ishin një vend për këto grupe.⁶⁵¹ Më 7 tetor, ai shtoi, më tej, se duhej

⁶⁴¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 55–56.

⁶⁴² P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 78.

⁶⁴³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 85.

⁶⁴⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 115.

⁶⁴⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 123.

⁶⁴⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124.

⁶⁴⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124–125.

⁶⁴⁸ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 126–128.

⁶⁴⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 129.

⁶⁵⁰ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 132.

⁶⁵¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 135–136.

ngritur niveli i “veprimtarive operative” dhe se aksionet duheshin kryer në fshehtësi.⁶⁵² Më 8 tetor, ai tha se Trajkoviqi, kreu i SAJ-së, dhe një person tjetër nga kjo njësi duhej të hynin në zonën në fjalë dhe të shpërndaheshin detyrat.⁶⁵³ Më 11 tetor, ai raportoi se “4-5 zona kanë bërë planet e tyre” dhe të nesërmen duhej të paraqiteshin propozime të tjera për Komandën e Përbashkët (katër deri në pesë aksione). Ai sugjeroi edhe “ndarjen e detyrave të gjitha sekretariateve të tjera për të likuiduar objektivat individualë.”⁶⁵⁴ Më 13 tetor, ai udhëzoi që të shkaktoheshin humbje të vogla për të krijuar ndjesinë e pasigurisë dhe se duheshin përgatitur planet e veprimit për Gjakovën dhe Pejën.⁶⁵⁵

314. Më 21 tetor, pas Marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq dhe takimit të tij me Wesley Clark-un, Shainoviqi solli planin e tërheqjes të forcave të RFJ-së/Serbisë nga disa zona të caktuara. Pjesa e parë e planit ishte nxjerrja e policisë nga fshati Pagarushë, pas së cilës UJ-ja duhej të dilte nga Podujeva. Shainoviqi e karakterizoi tërheqjen e njësisve të policisë dhe të UJ-së si kalimin e njësisve në gjendje paqeje dhe jo si largim nga territori. Ai bëri të ditur se në Malishevë duhej të kishte një stacion policor dhe se niveli i gatishmërisë duhej të ulej “kur shqiptarët të plotësojnë disa kushte të caktuara që u janë vendosur”.⁶⁵⁶ Në mbledhjen e zhvilluar më 22 tetor, ai tha se ishte e nevojshme të rritej puna për të mbledhur informata lidhur me gjendjen, madhësinë e efektivit dhe vendosjen e “DTS”-ve (forcat terroriste-diversante) dhe bëri të ditur se nuk duhej përdorur artileria e rëndë gjatë operacioneve të MPB-së dhe se duheshin përgatitur të dhënat për pozicionin e minave në terren.⁶⁵⁷ Më 26 tetor, kur Pavkoviqi raportoi për mendimin e Komandës së Armatës së Tretë se Komanda e Përbashkët duhej të pushonte së ekzistuari, Shainoviqi u përgjigj se duhej mbyllur kjo fazë e operacioneve dhe se duheshin dhënë vendimet dhe detyrat. Ai shtoi, më tej, se vartësia ishte publike dhe se “me presionin e OSBE-së, duhet të ketë më shumë bashkërendim midis të gjitha organeve”. Angjelkoviqi tha se askush nuk ishte i autorizuar të largonte dokumentet e Komandës së Përbashkët, të cilat duhet të mbaheshin në mjediset e Komandës së Përbashkët. Shainoviqi u përgjigj se kushtet për ligjnin mbajtjen e dokumenteve në një ndërtesë të MPB-së. Ai tha edhe se “Kur të tërhiqemi, duhet të jemi të kujdesshëm, duhet të kujdesemi që askush të mos gjejë pjesë të disa detashmenteve të caktuara që nuk janë tërhequr. Nuk duhet të ketë mospërputhje me

⁶⁵² P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 141.

⁶⁵³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 142; IC199 (Sqarimet e Millan Gjakoviqit për Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 8 (lidhur me shënimin numër KO2228540).

⁶⁵⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 145.

⁶⁵⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 148.

⁶⁵⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 152–153.

⁶⁵⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 156.

informacionin e bërë publik”.⁶⁵⁸ Në mbledhjen e datës 30 tetor, Shainoviqi udhëzoi që një automjet luftarak i blinduar “të patrullojë sonte midis Emilevës dhe Dulës”.⁶⁵⁹

315. Disa dëshmitarë bënë të ditur gjithashtu se Shainoviqi jo vetëm që ishte anëtar i Komandës së Përbashkët, por edhe e kryesonte atë. Lubinko Cvetiqi, ish-shef i SPB-së së Mitrovicës, dëshmoi se në mbledhjen në ndërtesën e Shtabit të MPB-së në Prishtinë më 10 korrik 1998 ku morën pjesë të gjithë krerët e sekretariateve nga Kosova, Vllastimir Gjorgjeviqi ose Obrad Stevanoviqi u tha atyre se ishte rënë dakord në nivelin më të lartë për të ngritur një Komandë të Përbashkët për të gjitha formacionet e ushtrisë dhe policisë në vënien në zbatim të operacioneve antiterroriste. Në një mbledhje të dytë të Shtabit të MPB-së, të zhvilluar më 22 korrik 1998, Vllastimir Gjorgjeviqi ritheksoi krijimin e Komandës së Përbashkët, e cila përbëhej nga Shainoviqi, Dushko Matkoviqi, Millomir Miniqi, Llukiqi, Pavkoviqi, Zoran Angjelkoviqi dhe David Gajiqi. Cvetiqi dëshmoi se gjatë këtyre mbledhjeve të Shtabit të MPB-së, atij dhe shefave të tjerë të MPB-së u bënë të ditur se Shainoviqi ishte kreu i Komandës së Përbashkët dhe se atij i ishte besuar bashkërendimi i ushtrisë dhe policisë.⁶⁶⁰

316. Dhoma ka administruar si prova procesverbalin e mbledhjes së Shtabit të MPB-së të datës 22 korrik ku nuk përmendet asnjëherë Komanda e Përbashkët apo Shainoviqi.⁶⁶¹ Mirëpo, ky dokument nuk është i plotë dhe, rrjedhimisht, nuk përbën asnjë bazë që Dhoma të përcaktojë nëse Shainoviqi përmendej si kreu i Komandës së Përbashkët.

317. Miroslav Mijatoviqi, i cili ishte zëvendës i Sreten Llukiqit në Shtabin e MPB-së, e hodhi poshtë dëshminë e Cvetiqit, duke thënë se, ndryshe nga Cvetiqi, atij nuk i ishte thënë gjatë mbledhjeve të Shtabit të MPB-së të muajit korrik 1998 se Shainoviqi ishte komandant i Komandës së Përbashkët.⁶⁶² Radovan Vuçureviqi, i cili gjithashtu punonte në Shtabin e MPB-së në Prishtinë dhe ishte i pranishëm në mbledhjen e datës 22 korrik, dëshmoi se as Gjorgjeviqi, as Stevanoviqi, nuk i informuan të pranishmit në mbledhje se Shainoviqi ishte komandant i Komandës së Përbashkët.⁶⁶³ Krahas këtyre, besueshmëria e Cvetiqit u kundërshtua edhe nga zëvendësi i tij, Nebojsa Bogunoviqi, si edhe nga disa dëshmitarë të tjerë të thirrur nga Mbrojtja.⁶⁶⁴ Dhoma vëren se, në përgjithësi, ajo nuk është bindur nga sulmet kundër besueshmërisë së Cvetiqit. Dëshmitarët

⁶⁵⁸ Argumentet përmblylëse të Shainoviqit, T. 27069 (21 gusht 2008).

⁶⁵⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 164.

⁶⁶⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8051–8052, 8077–8078 (7 dhjetor 2006), T. 8123–8124 (8 dhjetor 2006).

⁶⁶¹ 6D798 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998).

⁶⁶² Miroslav Mijatoviq, T. 22284–22285 (13 shkurt 2008).

⁶⁶³ Radovan Vuçureviq, T. 23130–23131 (25 shkurt 2008).

⁶⁶⁴ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 15 korrik 2008 (version publik), para. 725; Argumentet përmblylëse të Shainoviqit, T. 27064 (21 gusht 2008); *shih edhe* argumentet përmblylëse të Llukiqit, T. 27363 (26 gusht 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24157 (12 mars 2008).

e ftuar për ta vënë në dyshim besueshmërinë e tij, thjesht iu përgjigjën pyetjeve sugjestionuese që u drejtonte Mbrojtja e Shainoviqit.⁶⁶⁵ Nga ana tjetër, Dhomës i bëri përshtypje mënyra e drejtpërdrejtë me të cilën iu përgjigj pyetjeve Cvetiqi në sallën e gjyqit dhe Dhoma e konsideron dëshmitarin të mirinformuar. Dhoma e konsideron Cvetiqin të besueshëm lidhur me këtë argument dhe e pranon dëshminë e tij lidhur me mbledhjet në Shtabin e MPB-së gjatë muajit korrik.

318. Dhoma dëgjoi edhe nga gjeneral Branko Gajiqi i UJ-së, i cili dëshmoi se Shainoviqi dhe Miniqi ishin dërguar enkas në Kosovë për të bashkërenduar veprimtari të caktuara politike dhe ekonomike dhe për bashkërenduar veprimtaritë midis UJ-së dhe MPB-së, në luftën kundër terrorizmit.⁶⁶⁶ Gjatë pyetjeve të bëra nga Mbrojtja e Shainoviqit, Gajiqi pranoi se nuk kishte asnjë ndërhyrje midis komandës së MPB-së apo të UJ-së në mbledhjet në fjalë.⁶⁶⁷ Gjithsesi, Dhoma vëren se dëshmia e tij përputhet me Shënimet e Komandës së Përbashkët, të cilat tregojnë se një rol drejtues, me bërje propozimesh dhe me dhënie sugjerimesh dhe udhëzimesh, ka luajtur, si Miniqi, ashtu edhe Shainoviqi, dhe se ky rol konsistonte në bashkërendimin e veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së, e jo në ndërhyrjen në proceset e brendshme komanduese të tyre.

319. Fakti se Shainoviqi dhe Miniqi ishin anëtarë drejtues të Komandës së Përbashkët përputhet edhe me ankesën që ka bërë në korrik 1998 Momçillo Perishiçi, shefi i Shtabit të UJ-së në vitin 1998, lidhur me një hierarki komanduese alternative, sipas së cilës Shainoviqi dhe Miniqi ishin të përfshirë në drejtimin e njësisive të UJ-së. Në letrën që i drejton Millosheviqit, ai shprehej si më poshtë:

Orvatja e anëtarëve civilë të Shtabit për të komanduar Korpusin. Komandanti i Korpusit është përgjegjës për vlerësimin e situatës dhe për planifikimin e operacioneve të UJ-së dhe MPB-së, në bashkëpunim me anën civile të shtabit dhe të MPB-së, për t'ia përcjellë ato Shainoviqit dhe Miniqit, në mënyrë që këta t'u shpërndajnë detyra të gjithëve përveç Korpusit të Prishtinës. Në praktikë, komandanti i Korpusit të Prishtinës planifikon për çfarë është urdhëruar dhe kjo bëhet me kërkesën e Shainoviqit dhe Miniqit dhe të MPB-së dhe, kështu, shndërrohet në njëfarë shërbimi të tyre, për planifikim dhe ekzekutim. Duke qenë se, edhe ai, edhe të gjithë ne, dëshirojmë realizimin e planit, nëse të tjerët nuk e realizojnë ose nuk mund ta realizojnë, ai e realizon me njësitë e Korpusit të Prishtinës, çka çon në një shfrytëzim jo të rregullt dhe joadekuat të njësisive të UJ-së, duke e shkatërruar, kështu, sistemin. Ata i ndajnë njësitë, i zgjerojnë ato, i lidhin ato, dhe, kështu, nëse do të dalë vërtetë nevoja për ta përdorur Korpusin sipas rregulloreve për përdorimin e tij në luftim, ka të ngjarë të mos jetë i mundshëm përdorimi i tij.⁶⁶⁸

⁶⁶⁵ Nebojsa Bogunoviç, T. 25119–25120 (10 prill 2008). Kur Bogunoviçit iu bë pyetja nëse pajtohej se Cvetiqi “ishte epror i keq dhe se, si njeri, ishte edhe më i keq”, ai u përgjigj “Po”.

⁶⁶⁶ Branko Gajiq, T. 15412 (11 shtator 2007).

⁶⁶⁷ Branko Gajiq, T. 15439–15446 (12 shtator 2007).

⁶⁶⁸ P717 (Letër e Momçillo Perishiçit, drejtuar Sllobodan Millosheviqit, datë 23 korrik 1998), f. 2–3.

Në fund të letrës, Perishiqi propozonte që Millosheviqi të mos lejonte komandimin e UJ-së jashtë sistemit të varësisë ushtarake dhe komandës së vetme.⁶⁶⁹

320. John Crosland-i dëshmoi se mes atashëve të huaj ishte gjë e ditur se Shainoviqi ishte njeriu drejtpërsëdrejti përgjegjës për ngjarjet në Kosovë, se urdhrat e Millosheviqit i kalonin Pavkoviqit përmes Shainoviqit dhe se Shainoviqi ishte “njeriu operativ i punëve të përditshme” i Millosheviqit.⁶⁷⁰ Dhoma ka në provat gjyqësore një telegram të përgatitur nga ambasada e Mbretërisë së Bashkuar që flet për një mbledhje të datës 3 tetor 1998, midis Crosland-it, ambasadorit britanik dhe Aleksandar Dimitrijeviqit, shefit të Administratës së Sigurimit të UJ-së.⁶⁷¹ Në telegram evidentohet pakënaqësia e Dimitrijeviqit kundrejt veprimeve të Shainoviqit në Kosovë:

Ai, personalisht, [Dimitrijeviqi] dhe personeli i Shtabit të Përgjithshëm [konkretisht shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Perishiqi] nuk pajtoheshin me veprimet që ishin kryer gjatë muajve të fundit, qysh prej momentit kur Shainoviqi kishte marrë në dorë punët në Kosovë.⁶⁷² ...

E pyeta, po të mbajmë parasysh se, siç kishte thënë ai, Shainoviqi kishte anashkaluar dëshirat e Shtabit të Përgjithshëm, se si mund të kishim besim te kjo garanci [që të mos përdoshin më njësitë e UJ-së]. Ai tha se ai dhe Perishiqi do të bënin maksimumin që të mos e lejonin më një gjë të tillë. Ata ia kishin bërë të qartë udhëheqjes shtetërore rëndësinë e situatës dhe nevojën për të respektuar [Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së] 1199. Mirëpo, fatkeqësisht, ai nuk jepte dot asnjë garanci.⁶⁷³

I thashë se shpresoja se ishte e vërtetë çfarë thoshte ai, duke qenë se ne do të ishim në gjendje të pikasim shumë shpejt çdo gjë që nuk përputhej me të. A e kuptonte MPB-ja se ne po i ndiqnim nga shumë afër veprimtaritë e tyre dhe se shikonim gjurmë të vijimit të veprimtarisë. Ai tha se, kësaj pyetjeje mund t’i përgjigjej vetëm Shainoviqi. Ai kishte qenë përgjegjës për politikën dhe përdorimin e forcave. Por, ai m’u lut të mos i tregoja Shainoviqit që kishte thënë kështu.⁶⁷⁴

Dimitrijeviqi tregoi maksimumin e mosbesnikërisë që mund të tregonte, në fjalët e tij për Millosheviqin dhe Shainoviqin. Ai mund t’i druhet një hetimi të mundshëm nga TPNJ-ja lidhur me ngjarjet e kohëve të fundit dhe ishte shumë i gatshëm t’ia kalonte përgjegjësinë MPB-së.⁶⁷⁵

⁶⁶⁹ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit, drejtuar Sllobodan Millosheviqit, datë 23 korrik 1998), f. 2–3.

⁶⁷⁰ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 54, 56, 58.

⁶⁷¹ P683 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998); *shih* John Crosland, T. 9874 (8 shkurt 2007).

⁶⁷² P683 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998), para. 6.

⁶⁷³ P683 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998), para. 8.

⁶⁷⁴ P683 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998), para. 9. *Shih edhe* John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 52.

⁶⁷⁵ P683 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998), para. 12.

321. Sipas Crosland-it, më 5 tetor 1998, u zhvillua një takim tjetër me Dimitrijeviqin ku ky i fundit përsëri u ankua se Pavkoviqi punonte jashtë hierarkisë komanduese dhe komunikonte drejtpërdrejtë me Millosheviqin dhe Shainoviqin.⁶⁷⁶

322. Dimitrijeviqi përmendi edhe se në një prej mbledhjeve të kolegjiut të UJ-së Shainoviqi kishte thënë: “Mendoj se më e rëndësishme është të garantojmë që madje as Shainoviqi, apo ndonjë Shainoviq tjetër, të mos i zgjidhë këto probleme duke vendosur t’i përdorë njësitë si të dojë.”⁶⁷⁷

323. I thirrur nga Dhoma për të dëshmuar në gjyq, Dimitrijeviqit iu kërkua të komentojë për përmbajtjen e telegramit të përmendur më lart. Ai shprehu habi për përmbajtjen e telegramit dhe tha se dukej qartë se hartuesi i telegramit interpretonte çfarë kishte thënë ai. Në lidhje me komentin e shënuar se ai nuk pajtohej me çfarë po ndodhte pas mbërritjes së Shainoviqit në Kosovë, Dimitrijeviqi tha se nuk mund ta kishte thënë një gjë të tillë sepse “Shainoviqi nuk kishte absolutisht asnjë pushtet në Kosovë dhe se kjo do të ishte qenë gënjeshtër”.⁶⁷⁸ I pyetur nga Dhoma se përse Crosland-i dhe Donnelly do t’a pasqyronin takimin pasaktësisht, Dimitrijeviqi tha se ai nuk kishte thënë asnjëherë një gjë të tillë atëherë dhe as tani nuk mund ta thoshte një gjë të tillë, sepse Shainoviqi, “si gjithë të tjerët, shkonte në komandën e Korpusit të Prishtinës”.⁶⁷⁹ Më tej Dimitrijeviqi shpjegoi se, gjatë disa prej mbledhjeve të Kolegjiut të UJ-së, ai kishte ndërhyrë dhe kishte argumentuar se nuk duhej lejuar asnjë civil ta përdorte UJ-në jashtë hierarkisë komanduese dhe pranoi se e kishte përmendur Shainoviqin në këtë kontest. Mirëpo, ai shpjegoi se këtë e kishte bërë thjesht ngaqë Shainoviqi ishte një person që përfaqësonte qeverinë e RFJ-së për çështjet e lidhura me Kosovën.⁶⁸⁰ Më tej, ai shpjegoi se nuk nënkuptonte që ushtria po përdorej në të vërtetë, në atë mënyrë, por thjesht po përpiquej të thoshte se nuk duhej të përdorej ashtu.⁶⁸¹ Së fundi, Dimitrijeviqi dëshmoi se hierarkia komanduese mbeti e pacenuar dhe se nuk ishte nevoja që Millosheviqi të kishte një ndërmjetës midis tij dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe/ose Pavkoviqit.⁶⁸²

324. Edhe gjatë pyetjeve nga pala kundërshtarë, Dimitrijeviqi u pyet lidhur me letrën e Perishiqit dhe përmendjen e “anëtarëve civilë të shtabit” në letër. Ai dëshmoi se nuk e dinte kuptimin e kësaj fraze dhe se komentet e Perishiqit ishin çorientuese. Mirëpo, Dimitrijeviqi nuk pajtohej se

⁶⁷⁶ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 54.

⁶⁷⁷ P928 (Procesverbal i Kolegjiut të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14.

⁶⁷⁸ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26666–26669 (9 korrik 2008).

⁶⁷⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26669 (9 korrik 2008).

⁶⁸⁰ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26669–26670 (9 korrik 2008).

⁶⁸¹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26701–26704 (9 korrik 2008).

⁶⁸² Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26714–26718 (9 korrik 2008).

Perishiqi mendonte se kishte një problem me hierarkinë komanduese dhe varësinë.⁶⁸³ Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, ai parashtroi edhe argumentin se Perishiqi përmendte një “orvatje” të civilëve për të vënë nën kontroll ushtrinë dhe se letra nuk bën të ditur që kjo orvatje kishte rezultuar e suksesshme.⁶⁸⁴

325. Dhoma nuk bindet nga mohimi prej Dimitrijeviqit i rolit të rëndësishëm që luajti Shainoviqi në Komandën e Përbashkët apo i ushtrimit të pushtetit mbi forcat e policisë dhe UJ-së në Kosovë dhe i hedh poshtë kundërthëniet e tij ndaj deklaratave të veta të mëhershme. Dhoma është e mendimit se dokumentet e administruara si prova që evidentojnë ankesat e shprehura nga disa anëtarë të UJ-së lidhur me rolin e Shainoviqit nuk kanë nevojë për koment dhe tregojnë se roli i tij brenda Komandës së Përbashkët ishte tejet i rëndësishëm.

326. Kjo u konfirmua edhe nga Wolfgang Petritsch-i, ambasadori austriak në RFJ, i cili dëshmoi se në rrethin e diplomatëve në Beograd dihej se Shainoviqi ishte i ngarkuar me bashkërendimin e forcave në Kosovë që nga vera e vitit 1998. Shainoviqi ishte i mirinformuar për çështjet e lidhura me Kosovën dhe Petritsch-i kishte bërë gjithmonë biseda shumë të këndshme dhe faktike me të, përkundër situatës së nderë dhe konfliktit që ishte në zhvillim e sipër.⁶⁸⁵ Edhe diplomati austriak, Jan Kickert, tha se gjatë verës së vitit 1998, Shainoviqi ishte bashkëpunëtor i afërt i Millosheviqit dhe ishte “përgjegjës për bashkërendimin e forcave të sigurisë në Kosovë”. Shainoviqi ndodhej shpesh në ndërtesën qeveritare në Prishtinë dhe “ai përmendej ... si personi me të cilin amerikanët diskutonin çështjet e sigurisë”.⁶⁸⁶

327. Dëshmitë e kundërta pohojnë se Shainoviqi, në të vërtetë, nuk ishte kreu i Komandës së Përbashkët dhe nuk kishte asnjë pushtet apo ndikim mbi UJ-në dhe/ose MPB-në. Për shembull, Momir Bullatoviqi mohoi që Shainoviqi të kishte komanduar ndonjëherë UJ-në dhe/ose MPB-në dhe tha se ai (Bullatoviqi) nuk kishte dëgjuar, madje as për Komandën e Përbashkët deri në procesin gjyqësor të Millosheviqit.⁶⁸⁷ Llazareviqi, i cili kishte marrë pjesë në pesë prej këtyre mbledhjeve dëshmoi se Shainoviqi ishte i pranishëm të paktën në njërin prej tyre, por tha, se as Shainoviqi dhe askush tjetër nga strukturat politike nuk i dhanë urdhra atij apo Pavkoviqit.⁶⁸⁸ Kurse Mbrojtja e Shainoviqit thekson me të drejtë se nuk ka asnjë dokument i cili ta përmendë

⁶⁸³ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26687–26690 (9 korrik 2008).

⁶⁸⁴ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26723, 26760–26761 (9 korrik 2008).

⁶⁸⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10766–10767 (1 mars 2007).

⁶⁸⁶ Jan Kickert, T. 11235 (7 mars 2007); P560 (Mesazh i ambasadës austriake, 7 tetor 1998), f. 1.

⁶⁸⁷ Momir Bullatoviq, T. 13855–13857, 13907–13910 (17 gusht 2007).

⁶⁸⁸ Vladimir Llazareviq, T. 17815–17822 (7 nëntor 2007), T. 18138–18139 (12 nëntor 2007), T. 18155–18156 (13 nëntor 2007), T. 18404 (15 nëntor 2007), T. 18462–18467 (16 nëntor 2007); P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 117–123.

Shainoviqin si Kryetar të Komandës së Përbashkët. Përkundrazi, ai përmendet gjithmonë si zëvendëskryeministër i RFJ-së.⁶⁸⁹

328. Duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë dhe provat lidhur me Komandën e Përbashkët, të përmendura me hollësi më lart, Dhoma gjykon se dëshmia e Bullatoviqit është e pambështetur në informacion dhe nuk ka aspak besueshmëri dhe, për pasojë, nuk e pranon mohimin që ai i bën rolit të Shainoviqit. Dëshmia e Llazareviciqit përfshin një numër të vogël mbledhjesh dhe është përgjithësisht e saktë mbi mënyrën e funksionimit të këtij organi dhe si pasojë nuk ndryshon nga dëshmitë që konfirmojnë rolin drejtues të Shainoviqit. Edhe pse Dhoma pranon se, as Shënimet, as dokumentet e tjera që përfshihen në provat e kësaj çështjeje nuk e përmendin Shainoviqin përveçse si zëvendëskryeministër të RFJ-së, kjo nuk është në mospërputhje me mënyrën e funksionimit të Komandës së Përbashkët në vitin 1998, domethënë se vendimet e saj viheshin në zbatim përmes hierarkive komanduese përkatëse.

329. Dhoma citon edhe dëshminë e Millan Gjakoviqit se Miniqi kishte postin më të lartë nga të gjithë politikanët atje dhe se dukej se ai merrte pjesë më shumë në këto mbledhje.⁶⁹⁰ Gjakoviqi dëshmoi, më tej, se Shainoviqi nuk ishte në krye të këtyre mbledhjeve, se ai nuk u jepte urdhra Pavkoviqit apo Llukiqit dhe se, zakonisht, e merrte fjalën për të folur për çështjet e politikës së jashtme sepse kishte nevojë të informohej për situatën në terren në mënyrë që të ishte në gjendje të merrte pjesë në mbledhjet me përfaqësuesit e huaj.⁶⁹¹ Sikurse vërehet më lart, kur u përpoq të shpjegonte Shënimet, Gjakoviqi tha se ato përbënin një evidencë të çështjeve që ishin të rëndësishme për të si ushtarak dhe rrjedhimisht nuk pasqyronin gjithçka që është thënë në këto mbledhje. Si pasojë nuk u pasqyrua pjesa më e madhe e komenteve të Shainoviqit që kishin të bënin me politikën në përgjithësi dhe me politikën e jashtme dhe se ato pjesë që ishin shënuar ishin “zhargon ushtarak”.⁶⁹² Gjakoviqi tha gjithashtu se asnjëri prej katër politikanëve të pranishëm në këto mbledhje nuk kishte ndikim të rëndësishëm në vendimet e marra nga UJ-ja.⁶⁹³

330. Dëshmia e Gjakoviqit lidhur me pjesëmarrjen e Miniqit nuk është në mospërputhje me pikëpamjen e Dhomës se Miniqi, ashtu si Shainoviqi, luajti një rol aktiv gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët. Mirëpo, Dhoma nuk bindet shumë nga përshkrimi që i bën Gjakoviqi rolit të Shainoviqit, po të kihen parasysh se Shënimet që i ka mbajtur vetë Gjakoviqi bëjnë të ditur se Shainoviqi diskutonte shpesh për çështje të ndryshme të lidhura me UJ-në dhe MPB-në të cilat

⁶⁸⁹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 709. *Shih, për shembull*, P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999).

⁶⁹⁰ Millan Gjakoviq, T. 26481 (20 maj 2008).

⁶⁹¹ Millan Gjakoviq, T. 26380, 26412–26414 (19 maj 2008), T. 26443–26444, 26478–26483 (20 maj 2008).

⁶⁹² Millan Gjakoviq, T. 26375 (19 maj 2008), T. 26484 (20 maj 2008).

shkonin përtej politikës së jashtme. Pasi i analizoi me kujdes Shënimet, Dhoma është e mendimit se, faktikisht, ato nuk përmbajnë vetëm “zhargon ushtarak”, por përmendin edhe çështje të tilla si shpërndarja e ndihmës humanitare, krimet që po kryheshin në Kosovë e kështu me radhë. Edhe pse është e kuptueshme që Gjakoviçi do të mbante shënim ato gjëra që i interesonin për punën e tij, nuk ka arsye që ai të ketë mbajtur shënim thënie të politikanëve që nuk ishin propozime, sugjerime apo udhëzime, duke përdorur një gjuhë që tregon se ishin propozime, sugjerim ose udhëzime. Si pasojë, Dhoma është e mendimit se, megjithëse duket se përgjithësisht Gjakoviçi është dëshmitar i sinqertë, ai dha një dëshmi të cilën Dhoma e hedh poshtë sepse nuk përputhet me përmbajtjen e Shënimeve.

331. Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se Shainoviçi, së bashku me Miniçin, ishte pjesëmarrës aktivë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, në të cilat ai luajti një rol drejtues. Krahas kësaj, siç e thotë ai vetë, ai i raportonte Millosheviçit, Bullatoviçit dhe Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme. Po të kihet parasysh se, asokohe, me UJ-në dhe MPB-në lidhjet i mbanin politikanët dhe po të kihet parasysh se të dy këto organe duhej të merrnin miratimin e Millosheviçit, roli i Shainoviçit ishte kyç si në dhënien e miratimit, po ashtu edhe në nxjerrjen e udhëzimeve. Udhëzimet e ndryshme të nxjerra nga ai, sikurse përshkruhet më lart, tregojnë se, në të vërtetë, ai ishte një bashkërendues politik i veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në vitin 1998.

(B) Mbledhje të tjera

332. Më 29 tetor 1998, Shainoviçi mori pjesë në një mbledhje ku ishin të pranishëm Millosheviçi dhe figura të tjera me influencë, përfshirë Pavkoviçin, Llukiqin dhe Millutinoviçin, e diskutuar me hollësi më lart.⁶⁹⁴ Megjithëse Dhoma pranon se prova që supozohet se është procesverbal i kësaj mbledhjeje nuk është pasqyrim tekstual i përmbajtjes së mbledhjes, nuk ka dyshim që kjo mbledhje u mbajt, që në të morën pjesë individët më të pushtetshëm të qarqeve të politikës, UJ-së dhe MPB-së dhe që gjatë saj u diskutua Plani kundër Terrorizmit.⁶⁹⁵ Kjo është njëra prej katër-pesë mbledhjeve të këtij lloji në të cilat Shainoviçi thotë se mori pjesë gjatë periudhës korrik-shtator 1998.

333. Më 5 nëntor 1998, Shainoviçi mori pjesë në një mbledhje të Shtabit të MPB-së në Prishtinë, me pjesëmarrjen e Millutinoviçit, Llukiqit, Pavkoviçit, Stojilkoviçit, Gjorgjeviçit, Rade Markoviçit, Miroslav Mijatoviçit, anëtarëve të Grupit të Punës, shefave të SPB-ve dhe DPB-ve, si

⁶⁹³ Millan Gjakoviçi, T. 26486 (20 maj 2008).

⁶⁹⁴ P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Beli Dvor më 29 tetor 1998), f. 1.

⁶⁹⁵ *Shih* Pjesën VI.E.

edhe të komandantëve të PJP-së. Në këtë mbledhje, Llukiqi i informoi pjesëmarrësit për situatën e atëhershme në Kosovë dhe për gatishmërinë e forcave të MPB-së për të vijuar zbatimin e detyrave të tyre. Pastaj, foli Millutinoviqi për Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq dhe tha se e vështirë ishte kjo fazë e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, edhe pse “forcat terroriste shqiptare” në më të shumtën ishin “neutralizuar”.⁶⁹⁶ Millutinoviqi shpjegoi se kërcënimi i NATO-s ishte zhdukur dhe se në lidhje me UJ-në, “çdo gjë do të mbetet siç ka qenë deri tani (një komandë e përbashkët, njësitë e UJ-së nuk do të tërhiqen, ndërsa forcat policore vetëm sa janë zvogëluar me atë sasi e cila tashmë është tërhequr)”.⁶⁹⁷ Krahas këtyre, sipas Millutinoviqit, forcat e UJ-së dhe MPB-së kishin të drejtë të mbroheshin nëse dikush i sulmonte dhe, rrjedhimisht udhëzoheshin të vijonin planifikimin e “veprimtarive me angazhim dhe energji të pashterur”.⁶⁹⁸ Në procesverbalin e kësaj mbledhjeje nuk evidentohet pjesëmarrja e Shainoviqit.

334. Dhoma disponon si provë edhe procesverbalin e mbledhjes së MPB-së, datë 2 dhjetor 1998, gjatë së cilës Llukiqi përmend një mbledhje tjetër të zhvilluar në Beograd më 27 nëntor 1998. Ai tha se në këtë mbledhje, të zhvilluar në Ministrinë e Brendshme, kishte marrë pjesë ai vetë, ministri Vllajko Stojilkoviqi, ndihmësministrat, shefat e RDB-së dhe RJB-së dhe Shainoviqi. Fillimisht u bë një vlerësim i situatës në Kosovë e më tej u përcaktuan detyrat dhe angazhimet e mëtejshme të forcave policore në Kosovë. Thelbi i mbledhjes ishte vijimi i realizimit të aksioneve antiterroriste. Krahas kësaj, policia ngarkohej me kryerjen e një roli më sulmues në rrethanat e krijuara.⁶⁹⁹

335. Rrjedhimisht është e qartë se, krahas mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, Shainoviqi mori pjesë edhe në mbledhje të tjera në Kosovë gjatë vënies në zbatim të Planit kundër Terrorizmit dhe pas vënies në zbatim të këtij plani. Në këto mbledhje morën pjesë zyrtarët më lartë të Beogradit, si edhe zyrtarët më të lartë të ngarkuar për Kosovën. Ky konstatim përputhet me provat e shumta, të ravijëzuara më lart, mbi ndikimin që ushtronte Shainoviqi lidhur me Kosovën. Ai përputhet edhe me përfundimin e mëparshëm se në atë periudhë Shainoviqi ishte koordinator politik i UJ-së dhe MPB-së.

ii. Pushteti i Shainoviqit mbi UJ-në dhe MPB-në në vitin 1999

336. Prokuroria pretendon se, edhe pse përbërja e Komandës së Përbashkët ndryshoi në vitin 1999 me largimin e Miniqit dhe të Matkoviqit nga Kosova, Shainoviqi vijoi të ishte kreu i saj.⁷⁰⁰

⁶⁹⁶ P2805 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 3.

⁶⁹⁷ P2805 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4.

⁶⁹⁸ P2805 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4–5. *Shih edhe* Lubinko Cvetiq, T. 8187–8189 (8 dhjetor 2006); Millomir Miniq, T. 14783–14785 (31 gusht 2007).

⁶⁹⁹ P3122 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 2.

⁷⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 201–202.

Nga ana tjetër, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se nuk ka prova se “mënyra e punës” që ishte ndjekur gjatë një pjese të vitit 1998 të ketë vazhduar edhe gjatë vitit 1999. Në fakt, sipas Mbrojtjes së Shainoviqit, me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Tetorit, pushoi së ekzistuari nevoja e mbledhjeve të politikanëve me përfaqësuesit e UJ-së dhe të MPB-së. Më tej, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se, pas Marrëveshjeve të Tetorit dhe, sidomos, pas datës 24 mars 1999, Shainoviqi nuk ishte i përfshirë “në asnjë mënyrë” në veprimtaritë e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë.⁷⁰¹ Mirëpo, Dhoma nuk mund ta pranojë sugjerimin e Mbrojtjes së Shainoviqit se Shainoviqi nuk ishte aspak i përfshirë në veprimtaritë e UJ-së dhe të MPB-së pas Marrëveshjeve të Tetorit, po të kihet parasysh angazhimi me Komisionin për Bashkëpunim me KVM-në, i cili diskutohet më poshtë.

337. Në intervistën e tij me Prokurorinë, Shainoviqi tha se mbledhjet që u zhvilluan në Prishtinë në vitin 1998 ishin të pamundura të realizoheshin dhe nuk u zhvilluan gjatë bombardimeve të NATO-s.⁷⁰² Faktikisht, me përjashtim të një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët më 1 qershor 1999, në të cilin Shainoviqi mori pjesë, nuk ka prova që ky organ të jetë mbledhur në të njëjtën mënyrë si në vitin 1998. Mirëpo, mbështetur në provat dokumentare dhe gojore, Dhoma ka konkluduar se, edhe pse del më pak qartë, Komanda e Përbashkët ekzistonte edhe në vitin 1999 dhe bashkërendoi një sërë veprimesh në Kosovë. Krahas kësaj, megjithëse nuk ka prova për pjesëmarrjen e Shainoviqit në mbledhje të ngjashme me mbledhjet në të cilat mori pjesë në vitin 1998, roli i tij si politikan detyra e të cilit ishte ndërlidhja midis UJ-së dhe MPB-s, nga njëra anë, dhe Millosheviqit, nga ana tjetër, vazhdoi si i tillë duke qenë se ai mori pjesë në një sërë mbledhjesh me zyrtarë të UJ-së dhe MPB-së në Beograd dhe Kosovë.

338. Për shembull, më 5 janar 1999, ai mori pjesë në një tjetër mbledhje “bashkërenduese”, me pjesëmarrjen e Millosheviqit, Millutinoviqit, Ojdaniqit, Stojilkoviqit, Pavkoviqit, Llukiqit dhe Gjorgjeviqit në Beli Dvor në Beograd. Shainoviqi tha se kjo mbledhje ndryshonte nga mbledhjet e mbajtura në Beli Dvor në vitin 1998, sepse në të nuk u diskutua për operacionin antiterrorist, meqë ky operacion kishte përfunduar.⁷⁰³ Shainoviqi mësoi se ai ishte ftuar në këtë mbledhje si Kryetari i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në, për të cilin raportonte gjatë funksionimit të tij. Në veçanti, ai raportoi për problemet e riaktivizimit të UÇK-së në disa pjesë të Kosovës dhe për vështirësitë që haste kur donte t’ia shpjegonte këtë problem KVM-së. Edhe pjesëmarrësit e tjerë folën në mbledhje për rigrupimin e UÇK-së dhe fuqizimin e veprimtarive të tyre dhe për mënyrën

⁷⁰¹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 648–654, 766–768.

⁷⁰² P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 865.

⁷⁰³ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 828–830.

se si ta trajtonin këtë çështje brenda kuadrit të Marrëveshjeve të Tetorit. Në atë kohë, një ilustrim i riaktivizimit të UÇK-së dhe qëndrimit të KVM-së ishte problemi i Podujevës.⁷⁰⁴

339. Sa i takon periudhës së bombardimeve të NATO-s, kur po jepte dëshmi gjatë procesit të Millosheviqit lidhur me problemet e varësisë së MPB-së ndaj UJ-së në maj 1999, Vasileviqi tha se “komanda ekzekutive ishte në duart e zotit Shainoviç, i cili ishte atje për këtë qëllim, për të bashkërenduar veprimtaritë e ushtrisë dhe të MPB-së”.⁷⁰⁵

340. Më 29 mars 1999, Lubinko Cvetiqi e pa Shainoviçin në bodrumin e Hotelit “Grand”. Cvetiqi po merrte pjesë në një mbledhje të zhvilluar atje, por dëshmoi se Shainoviç nuk mori pjesë fare në atë mbledhje. Përkundrazi, ai ndodhej në një pjesë tjetër të bodrumit, ku po shihte televizion dhe po dëgjonte lajmet për sulmet e NATO-s kundër RFJ-së.⁷⁰⁶

341. Më 4 prill 1999, Shainoviç mori pjesë në një mbledhje në zyrat e Shtabit të MPB-së.⁷⁰⁷ Në këtë mbledhje, të cilën e kryesuan Stevanoviç dhe Llukiç, merrnin pjesë shefat e të gjithave SPB-ve të Kosovës, komandantët e detashmenteve të PJP-së, komandanti i SAJ-së dhe komandanti i JSO-së. Sipas procesverbalit të mbledhjes Shainoviç u dha direktiva zyrtarëve të lartë të MPB-së, pasi zyrtarë të ndryshëm të lartë të policisë kishin raportuar për veprimtaritë e tyre. Në procesverbal shënohet se ai u shpreh se “është e nevojshme që faza e parë e operacioneve antiterroriste të përfundojë sot, me qëllim mbrojtjen aktive dhe mbrojtjen e territorit dhe të kufirit në rast të një depërtimi nga agresori në thellësi të territorit të RFJ-së”. Ai shtoi se personat e arrestuar për kryerje krimesh duhej të mbaheshin në paraburgim derisa t’u kaloheshin organeve të gjyqësorit.⁷⁰⁸ Dushan Gavraniç, i cili ishte shefi i atëhershëm i SPB-së së Gjilanit, dëshmoi se ai kishte marrë pjesë në këtë mbledhje dhe se Shainoviç nuk ishte i pranishëm në fillim, por kishte ardhur më vonë.⁷⁰⁹ Kjo ardhje e mëpasshme u konfirmua edhe nga Millosh Vojnoviç, shef i SPB-së së Prizrenit në atë kohë, i cili gjithashtu dëshmoi se ishte tipike që një zyrtar politik i rangut të lartë të vinte për t’i ofruar inkurajim policisë.⁷¹⁰ Lubinko Cvetiqi, i cili ishte gjithashtu i pranishëm në këtë mbledhje, konfirmoi se Shainoviç i kërkoi policisë të silleshin me profesionalizëm gjatë realizimit të detyrave dhe të ishin të rreptë me çdokënd që kishte kryer shkelje penale apo krim, duke thënë se persona të tillë duhet të mbaheshin në paraburgim gjersa të ngriheshin gjykatat ushtarake të kohës

⁷⁰⁴ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 830–834, 840.

⁷⁰⁵ Aleksandar Vasileviç, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15993.

⁷⁰⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8086 (7 dhjetor 2006), T. 8135 (8 dhjetor 2006).

⁷⁰⁷ P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999).

⁷⁰⁸ P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4.

⁷⁰⁹ Dushan Gavraniç, T. 22719–22720 (19 shkurt 2008).

⁷¹⁰ Millosh Vojnoviç, T. 24185–24186 (12 mars 2008). Dragan Zhivaleviç, i cili ishte gjithashtu i pranishëm në këtë mbledhje, dëshmoi se Shainoviç mbërriti afër mbylljes së mbledhjes. Dragan Zhivaleviç, T. 24841–24842 (3 prill 2008).

së luftës. Duke konfirmuar përmbajtjen e procesverbalit, Cvetiqi dëshmoi se Shainoviqi kërkoi që aksionet të mbylleshin brenda fundit të asaj dite dhe se duhej të kalonin në realizimin e dy detyrave të tjera: së pari, të mbroheshin të gjitha njësitë në pozicionin e zënë të fundit dhe të kamufloheshin kundër çdo sulmi të NATO-s; dhe, së dyti, të sigurohej dhe të mbrohej kufiri në mënyrë që të pengohej hyrja e forcave tokësore të NATO-s. Të gjitha këto detyra duhej të planifikoheshin dhe të realizoheshin në bashkëpunim me UJ-në.⁷¹¹ Dhoma nuk e pranon dëshminë e Vojnoviqit se Shainoviqi thjesht ofroi inkurajim në këtë mbledhje, dhe është e mendimit se ai dha direktiva, sikurse mund të shihet nga procesverbali, të cilin e konfirmon edhe Peshiqi. Edhe këtu, nga këto direktiva është e qartë se Shainoviqi luajti një rol udhëheqës lidhur me përdorimin e forcave të MPB-së në Kosovë, shumë të ngjashëm me rolin që kishte pasur gjatë verës së vitit 1998 dhe përkundër faktit se ai ishte një politikan federativ dhe nuk bënte pjesë në hierarkinë komanduese zyrtare të MPB-së në rang republike.

342. Dëshmia e Zllatomir Peshiqit konfirmon se Shainoviqi mundi të ushtronte ndikim mbi UJ-në dhe oficerët e lartë të saj gjatë bombardimeve të NATO-s. Ai dëshmoi se e kishin thirrur në një ndërtesë pranë Hotelit “Grand” në Prishtinë, më 13 prill 1999. Atje qenë të pranishëm Shainoviqi, Angjelkoviqi, Pavkoviqi, Llazareviqi dhe Stojanoviqi, si edhe disa kolonelë të MPB-së. Ata donin të dinin për një “detachment në Istog, i cili thuhej se përbënte një kamp burgimi” për shqiptarët kosovarë.⁷¹² Peshiqi dëshmoi se Pavkoviqi ia vuri fajin atij dhe e pyeti përse një detachment territorial bënte një gjë të tillë, së cilës Peshiqi iu përgjigj duke mohuar ekzistencën e një kampi të tillë. Peshiqit i thanë se “duhej nxjerrë një urdhër për një komision me përbërje të një prokurori dhe hetuesish ushtarakë”, i cili të hetonte këtë çështje, gjë që u realizua.⁷¹³ Më në fund, komisioni i ngrit dhe nxori një raport, ku konstatonte se nuk ekzistonte një kamp i tillë burgimi.⁷¹⁴

343. Më 4 maj 1999, Shainoviqi ose mori pjesë, ose, të paktën, u informua plotësisht për përmbajtjen e një mbledhjeje ku u diskutuan ngjarjet në Kosovë, përfshirë edhe krimet e kryera atje dhe reagimin e gjykatave ushtarake.⁷¹⁵ Kjo mbledhje u zhvillua pas marrjes së mesazheve nga Prokurorja e atëhershme Tribunalit, Louise Arbour, në të cilat ajo shprehte shqetësimin e saj të

⁷¹¹ Lubinko Cvetiq, T. 8085 (7 dhjetor 2006).

⁷¹² Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 janar 2004), para. 34.

⁷¹³ Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 janar 2004), para. 34–35.

⁷¹⁴ P1721 (Raport i Komisionit të UJ-së/MPB-së, 14 prill 1999). *Shih edhe* 5D190 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, për krijimin e Komisionit të UJ-së/MPB-së, 13 prill 1999).

⁷¹⁵ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1. 4D406 (“Situata e sigurisë në Kosovë”, reportazh në *Politika*, 6 maj 1999). Ky dokument është kundërshtuar nga mbrojtja e Ojdaniqit, T. 16105–16106 (21 shtator 2007), T. 22547–22548 (15 shkurt 2008). Megjithatë, ai mbështetet nga 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999). *Shih edhe* Dushan Gavranic, T. 22722 (19 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24188 (12 mars 2008).

thellë lidhur me shkeljet e vazhdueshme të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë.⁷¹⁶

344. Sipas lajmeve në media lidhur me mbledhjen e datës 4 maj të pranishëm ishin Millosheviqi, Millutinoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Llukiqi dhe persona të tjerë. I pyetur për përmbajtjen e një prej këtyre artikujve në shtyp, Millovan Vllajkoviqi, shefi i Kabinetit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, tha se ai kishte dëgjuar për këtë mbledhje dhe se mendonte që Ojdaniqi kishte marrë pjesë në të.⁷¹⁷ Krahas kësaj, Lubisha Stojimiroviqi, i cili ishte shefi i Shtabit të Armatës së Tretë, dëshmoi se, në fillim të muajit maj, Llukiqi dhe Pavkoviqi shkuan të takoheshin me Millosheviqin.⁷¹⁸ Për më tepër, Llukiqi nxori një urdhër, me të cilin i nxiste vartësit të lexonin përmbajtjen e artikullit në gazetën “Politika” dhe të ndiqnin direktivat e tij, çka tregonte se përmbajtja e këtij artikulli ishte e pranuar zyrtarisht.⁷¹⁹ Deklaratat e mëpasshme të Shainoviqit, të cilat i bëri në mbledhjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën më 7 maj, i mbështesin këto dëshmi për mbledhjen e 4 majit. Në këtë mbledhje të mëpasshme, Shainoviqi tha se Presidenti i RFJ-së dhe Presidenti serb kishin dëgjuar raportet e Pavkoviqit dhe të Llukiqit dhe ishte bërë publik teksti i një deklaratë, që duhej t’u shpërndahej të gjithë komandantëve të policisë.⁷²⁰ Miroslav Mijatoviqi dëshmoi se Shainoviqi e kishte fjalën për mbledhjen e datës 4 maj 1999 dhe se Shainoviqi ishte në dijeni të deklaratës së publikuar në gazetën “Politika”.⁷²¹

345. Sipas një raporti për përmbajtjen e mbledhjes së datës 4 maj, gjatë mbledhjes u dha informacion se “forcat e sigurimit” kishin trajtuar raste të shumta dhune, vrasjesh, plaçkitjeje dhe krimesh të tjera, kishin arrestuar disa qindra kriminelë krimet e të cilëve përbënin një rrezik të madh për popullatën civile dhe kishin proceduar shumë çështje të krimeve kundër popullatës civile, duke dhënë një “numër të madh” dënimesh nga pesë deri në 20 vjet burg për këto krime.⁷²² Siç është konstatuar më parë, ky informacion nuk përputhet me raporte të ndryshme që ka nxjerrë UJ-ja për punën e gjykatave ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s, ku në asnjë vend nuk bëhet e

⁷¹⁶ P401 (Letër e Louise Arbour drejtuar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999); 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); Millovan Vllajkoviqi, T. 16046–16047 (20 shtator 2007); 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

⁷¹⁷ Millovan Vllajkoviqi, T. 16081–16082 (20 shtator 2007).

⁷¹⁸ Lubisha Stojimiroviqi, T. 17684 (26 tetor 2007).

⁷¹⁹ 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit për artikullin në Politika, 6 maj 1999), pranuar edhe si P2159.

⁷²⁰ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 4.

⁷²¹ Miroslav Mijatoviqi, T. 22286–22289 (13 shkurt 2008).

⁷²² P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999).

ditur që gjykatat ushtarake të kenë dhënë dënime nga pesë deri në 20 vjet burg për krimet e kryera kundër civilëve gjatë fushatës së NATO-s deri më datë 4 maj 1999.⁷²³

346. Procesverbali i mbledhjes së datës 7 maj, e cila përmendet më lart, tregon se Shainoviqi ishte ai që hapi mbledhjen. Së pari, ai vlerësoi situatën dhe raportoi për disa prej veprimtarive që kishin për synim shkatërrimin e forcave të UÇK-së. Pastaj, ai parashtrroi objektivat dhe detyrat kryesore për arritjen e synimit parësor, i cili ishte “mbrojtja e vendit nga agresori” dhe “lufta kundër terrorizmit” dhe tha se “pas Operacionit “Jezerce”, të gjitha detashmentet e PJP-së do të kthehen në sekretariatet e tyre dhe, në bashkëpunim me UJ-në, do të punojnë për shkatërrimin e grupeve terroriste të mbetura”.⁷²⁴ Ai tha se “detyra nr 1 e shtetit” ishte spastrimi i terrenit dhe se kjo duhej bërë pa vonesë. Ai vërejti edhe se bashkëpunimi midis UJ-së dhe policisë ishte përkufizuar, zgjidhur dhe po funksiononte mirë.⁷²⁵ Duke folur për një urdhër të Millosheviqit, Shainoviqi tha se ky urdhër u duhej kaluar “të gjithë komandantëve të policisë, si detyrë e ngarkuar nga Komanda e Lartë”. Ai i falënderoi të gjithë efektivat e policisë për arritjen e rezultateve të shkëlqyera, por shtoi se ata të cilët nuk e tregonin veten dhe sjellja e të cilëve ishte e dobët do të ndëshkoheshin dhe ndiqeshin ligjërisht. Ai theksoi nevojën për të rregulluar më vete sjelljen e rezervistëve të UJ-së përmes marrjes së masave ligjore të burgimit dhe punës për të rimarrë terrenin.⁷²⁶ Shainoviqi u largua nga mbledhja përpara mbylljes së saj.⁷²⁷

347. Miroslav Mijatoviqi, i cili ishte zëvendësi i Llukiqit në Shtabin e MPB-së, dëshmoi se Shainoviqi nuk ishte anëtar i Shtabit dhe se roli i tij ishte mbajtja e fjalimeve politike dhe jo dhënia e urdhrave apo direktivave për MPB-në.⁷²⁸ Mijatoviqit i treguan procesverbalin e mbledhjes së 7 majit dhe ai tha se Shainoviqi thjesht ritheksoi çfarë kishte thënë Millosheviqi para disa ditësh, pas një mbledhjeje të 4 majit me zyrtarë të lartë të UJ-së dhe MPB-së, siç ishte publikuar në “Politika”

⁷²³ P1912 (Raport i Armatës së Tretë mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raport mbi Ecurinë e Punës për Prokuroritë dhe Gjykatat Ushtarake në Kohë Luftë, 30 prill 1999); P1182 (Informacion dërguar Brigadës 52 Artilerike të Raketave nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999); 3D986 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbi çështjet penale, 6 shtator 1999); P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002); P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001); P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake); P845 (Raport mbi çështjet penale në gjykatat ushtarake për dhunë seksuale, 10 shtator 2002). Dhoma vëren se P962 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, maj 1998–korrik 1999) nuk përfshin disa dënime të rënda të dhëna, por vëren se këto dënime lidhen me krime të vitit 1998 dhe u dhanë kundër shqiptarëve kosovarë të përmendur si civilë dhe se Radomir Gojoviqi, i cili ishte kreu i Administratës Juridike të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së gjatë fushatës ajrore të NATO-s në vitin 1999, dëshmoi se ai nuk ishte në dijeni të ndonjë ndjekjeje penale të anëtarëve të UÇK-së në gjykatat ushtarake. Radomir Gojoviqi, T. 16704 (2 tetor 2007).

⁷²⁴ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 2.

⁷²⁵ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 3.

⁷²⁶ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 4.

⁷²⁷ Dushan Gavranic, T. 22720–22721 (19 shkurt 2008). *Shih edhe* Miroslav Mijatoviqi, T. 22286–22287 (13 shkurt 2008); Bozhidar Filiq, T. 23974 (10 mars 2008).

⁷²⁸ Miroslav Mijatoviqi, T. 22289–22290 (13 shkurt 2008).

dhe në gazeta të tjera serbe.⁷²⁹ Edhe Gavraniqi konfirmoi se fjalimi që mbajti Shainoviqi asokohe ishte një fjalim politik, se ai vetëm sa kishte përsëritur ato që mund t'i lexoje në gazeta, se ai nuk po jepte urdhra apo udhëzime dhe se, si zëvendëskryeministër i RFJ-së, nuk kishte pushtet mbi MPB-në.⁷³⁰

348. Mirëpo, është e qartë se ai bëri shumë më tepër se thjesht kalimin e një kumti nxitës nga Presidenti. Krahas faktit se procesverbali pasqyron sërish se Shainoviqi luajti rol udhëheqës gjatë kësaj mbledhjeje, Dhoma vëren se përmbajtja e artikullit në “Politika” ishte më e përgjithshme se përmbajtja e fjalimit të Shainoviqit në mbledhjen e datës 7 maj. Për shembull, në prezantimin e tij, Shainoviqi përmend “Operacionin Jezerca”, i cili nuk përmendet fare, të paktën jo me emër, në artikullin në “Politika”. Gjithashtu, fjalimi i Shainoviqit ishte më i gjatë dhe më i hollësishëm se shkrimi në gazetë. Madje, gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, Gavraniqit iu tha kjo gjë dhe iu bë pyetja se kush ia dha Shainoviqit informacionet e hollësishme të operacionit. Ai nuk mundi t'i jepte përgjigje kësaj pyetjeje.⁷³¹ Rrjedhimisht Dhoma nuk e pranon shpjegimin e Mijatoviqit lidhur me rolin e Shainoviqit gjatë kësaj mbledhjeje. Sikurse edhe në shumë prej mbledhjeve të tjera me zyrtarë të UJ-së dhe/ose MPB-së në të cilat mori pjesë, Shainoviqi dha miratimin për veprimet e tyre dhe gjithashtu dha udhëzime dhe përcolli urdhrat e Millosheviqit. Ai veproi kështu edhe pse, edhe pse Shtabi i MPB-së bënte pjesë në MPB-në e republikës dhe jo MPB-në Federale, mbi të cilën, teorikisht, as ai, dhe as Millosheviqi nuk kishin pushtet të drejtpërdrejtë.

349. Vasileviqi dëshmoi se, më 16 maj 1999, ai mori pjesë në një mbledhje me Ojdaniqin, Pavkoviqin, Geza Farkashin dhe Branko Gajiqin. Pavkoviqi e informoi Ojdaniqin se MPB-ja e akuzonte UJ-në për krime, që kishin të bënin me rreth 800 kufoma. Në këtë numër nuk bëhej dallimi midis atyre që kishin vdekur si pasojë e krimeve dhe atyre që kishin vdekur nga shkaqe të tjera dhe ky numër nuk ishte numri i gjithsejtë i personave të vrarë në Kosovë. Pavkoviqi raportoi edhe se i kishte kërkuar Llukiqit të formonin një komision të përbashkët për të zbuluar se kush ishte përgjegjës për këto krime, mirëpo Llukiqi nuk kishte pranuar. Atëherë Pavkoviqi kishte urdhëruar që këtë gjë ta bënin organet ushtarake dhe për këtë e kishte informuar Shainoviqin. Ky hetim tregoi se në zonat e mbuluara nga UJ-ja kishin ndodhur 271 vdekje. Pastaj, MPB-ja nxori shifrat e veta, sipas së cilave në zonat e mbuluara nga forcat e MPB-së kishin ndodhur 376 vdekje. Vasileviqi dëshmoi se në mbledhje u diskutua fakti se këto shifra nuk nxirrnin shumë më 800 dhe se u shpjegua

⁷²⁹ Miroslav Mijatoviq, T. 22287–22289 (13 shkurt 2008); 5D1289 (Raport i Llukiqit për artikullin në *Politika*, të datës 4 maj 1999, 6 maj 1999).

⁷³⁰ Dushan Gavraniq, T. 22721–22723 (19 shkurt 2008). Të njëjtën dëshmi dha edhe Bozhidar Filiqi, T. 23974–23975 (10 mars 2008) dhe Millosh Vojnoviqi, T. 24187–24189 (12 mars 2008).

⁷³¹ Dushan Gavraniq, T. 22774 (19 shkurt 2008).

se disa prej vdekjeve mund të ishin shkaktuar nga sulmet e NATO-s.⁷³² Gjithashtu, Pavkoviqi i informoi personat e pranishëm se ai kishte parë anëtarë të Akrepave në Kosovë dhe se e kishte informuar për këtë Shainoviqin, por nuk dha asnjë hollësi se kur ia kishte përmendur këtë të dhënë Shainoviqit.⁷³³

350. Të nesërmen, më 17 maj, i njëjti grup mori pjesë në një mbledhje me Millosheviqin, Shainoviqin dhe Rade Markoviqin. Sikurse është thënë më parë, asnjë gjeneral i MPB-së nuk mori pjesë në mbledhje, ku nuk ishte i pranishëm as ministri i Brendshëm, Stojilkoviqi. Sipas Vasileviqit, mungesa e Stojilkoviqit do të thoshte se si RDB-ja po ashtu dhe RJB-ja ishin nën kontrollin e Millosheviqit.⁷³⁴

351. Gjatë mbledhjes, Vasileviqi paraqiti informacionin për krimet e kryera nga UJ-ja, MPB-ja dhe forcat vullnetare në Kosovë, ku përfshiheshin përdhunime të civilëve nga ushtarët dhe krime të kryera nga Akrepat në Podujevë. Markoviqi iu përgjigj këtij informacioni dhe tha se kishte dhënë urdhrin që Akrepat të tërhiqeshin nga Kosova. Megjithatë, ai pranoi se kishte rreth 30 anëtarë të “grupit të Arkanit” në Kosovë, duke i quajtur të gjithë vullnetarët një “të keqe të domosdoshme”. Pas kësaj, Pavkoviqi raportoi për kufomat e gjetura në Jezercë, krahas vendeve të tjera, dhe e mohoi implikimin e UJ-së. Edhe këtu, Markoviqi pranoi se në zonën e Jezercës ishte JSO-ja dhe UJ-ja dhe se, në fakt atje kishte qenë komandanti i JSO-së, Legija. Kur Pavkoviqi përmendi akuzat e MPB-së lidhur me 800 kufomat, Millosheviqi i këshilloi UJ-në dhe MPB-në t’i zgjidhnin mes tyre çështjet e mbivendosjes apo konfliktuale, përfshirë edhe problemin e vullnetarëve. Ai tha edhe se donte që me autorët e krimeve të mbarohej punë shpejt dhe se këta “të ashtuquajtur serbë të mëdhenj që vepronin në këtë mënyrë po i bënë një dëm shumë të madh çdo gjëje që kishte arritur deri tani në këtë luftë Jugosllavia”.⁷³⁵ Pastaj, Shainoviqi tha se ai nuk ishte në dijeni të grupeve të vullnetarëve në “qendrën e Fushë-Kosovës”, mirëpo tha se do të interesohej për këtë. Ai tha edhe se kishte njerëz që kishin paguar shuma të mëdha parash për uniforma të ushtrisë dhe MPB-së dhe kishin hyrë në Kosovë në mënyrë të paligjshme, për të plaçkitur. Ai ishte dakord me Pavkoviqin se do të ishte ide e mirë të dërgohej një “organ i paanshëm” ose një “komision i përbashkët shtetëror” nga Beogradi në Kosovë për të hetuar të gjitha akuzat e ngritura në mbledhje. Mirëpo, Millosheviqi

⁷³² Aleksandar Vasileviq, T. 8763, 8783 (19 janar 2007), T. 9041 (24 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15999.

⁷³³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 60–62, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15998–16004.

⁷³⁴ Aleksandar Vasileviq, T. 9001 (23 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 63–64.

⁷³⁵ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65–68, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15999–16004; P2592 (pjesë nga ditari i Vasileviqit).

i shpërfilli këto rekomandime dhe tha se nuk duhej të kishte më grupe paraushtarake në Kosovë.⁷³⁶ Në fund të mbledhjes, Millosheviqi i tha Markoviqi të qëndronte. Qëndroi edhe Shainoviqi. Vasileviqi mendoi se kjo ishte e papërshtatshme. Ai pati përshtypjen se ata ndenjën të diskutonin diçka pa i dëgjuar të pranishmit e tjerë në mbledhje. Farkashi dhe Gajiqi nuk e vunë re këtë gjë, sepse Ojdaniqi kishte filluar t'u ngarkonte detyra ndërkohë që po largoheshin.⁷³⁷

352. Në intervistën me Prokurorinë, Shainoviqi e konfirmoi pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e datës 17 maj, si i ftuar nga Millosheviqi. Ai tha se, gjatë mbledhjes, Markoviqi dhe Pavkoviqi ngritën çështjen e humbjeve në civilë në Kosovë dhe Markoviqi përmendi se grupe të caktuara kishin bërë krime. Markoviqi tha se ekzistonte një dyshim se në Kosovë ndodhej Arkani dhe se ekzistonte një akuzë se një grup policësh kishte kryer një krim pranë Mitrovicës. Pastaj, Ojdaniqi kërkoi të hetoheshin të gjitha këto çështje dhe e ngarkoi Vasileviqin me detyrën që të shkonte menjëherë në Kosovë dhe të zbulonte se çfarë kishte ndodhur. Edhe Millosheviqi tha se nuk duhej lejuar të ndodhte një gjë e tillë dhe se duhej bërë një hetim.⁷³⁸ Shefi i Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, Geza Farkashi dëshmoi se, pas mbledhjes së datës 17 maj, Ojdaniqi i kishte kërkuar të ngrinte një ekip për të kontrolluar njësitë bazë të UJ-së dhe organet e sigurimit brenda Kosovës, gjë të cilën e bëri. Ky ekip u dërgua në Kosovë më 1 qershor 1999, për të kontrolluar 16 organe të sigurimit dhe njësi bazë në terren.⁷³⁹ Pasi u kthyen në Beograd më 7 qershor 1999, Gajiqi dhe Vasileviqi u raportuan me gojë anëtarëve madhorë të shtabit, të cilëve u thanë se organet e sigurimit po bënin një punë të mirë në pikasjen e krimeve dhe përgatitjen e dosjeve për ndjekje penale.⁷⁴⁰ Vasileviqi dhe Gajiqi dokumentuan 42 raste krimesh, disa prej të cilave të kryera nga MPB-ja dhe disa nga UJ-ja. Sipas raporteve që mori Vasileviqi nga organet e sigurimit, në të gjitha syresh, me përjashtim të njërit, autorët qenë çuar për ndjekje penale, edhe pse ai nuk ishte në dijeni të rezultateve përfundimtare të këtyre procedimeve. Vasileviqi vërejti se një prej incidenteve të hetuara ishte zbulimi i varreve në Izbicë, por nuk tha se sa njerëz kishin vdekur në atë incident.⁷⁴¹

353. Dy versionet që kanë dhënë për këtë mbledhje Vasileviqi, Farkashi dhe Gajiqi, nga njëra anë, dhe Shainoviqi, nga ana tjetër, në më të shumtën përputhen me njëri-tjetrin. Si përfundim, ajo

⁷³⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 69–70. Çfarë thonë Farkashi dhe Gajiqi për këtë mbledhje përputhen tërësisht me çfarë thotë Vasileviqi. Geza Farkash, T. 16294–16298, 16329–16330 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15283–15284, 15289–15292 (7 shtator 2007).

⁷³⁷ Aleksandar Vasileviq, T. 8783 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 71. *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16298–16299, 16368 (25 shtator 2007).

⁷³⁸ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 866–871.

⁷³⁹ Geza Farkash, T. 16300 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8707 (19 janar 2007).

⁷⁴⁰ Geza Farkash, T. 16303 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

⁷⁴¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8789–8791 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 86–89.

që ndodhi ishte se pati një hetim të UJ-së por jo të MPB-së, sipas dëshmisë së Vasileviqit se Lluqi nuk ishte pro një komisioni të përbashkët. As Millosheviqi, as Shainoviqi, nuk morën masat për realizimin e një hetimi të tillë.

354. Siç është thënë edhe më parë,⁷⁴² në deklaratën e tij si dëshmitar Vasileviqi shtoi se pak kohë pas mbledhjes së 17 majit pati një mbledhje tjetër të zyrtarëve të UJ-së dhe MPB-së, në të cilin ishin të pranishëm dhe Millosheviqi dhe “Shaja” (Shainoviqi) dhe në të cilën zyrtarët e UJ-së ngritën çështjen e përgjegjësisë për krimet që po kryheshin në Kosovë. Mirëpo, doli që Vasileviqi nuk po bënte gjë tjetër në këtë dëshmi përveçse po përpiqej ta interpretonte rolin e Shainoviqit nga një ditarr që i përkiste Obrad Stevanoviqit, i cili ishte i vështirë për t’u lexuar. Edhe pse Stevanoviqi dha dëshmi në procesin gjyqësor të Millosheviqit, ai nuk u thirr si dëshmitar në këtë proces gjyqësor.⁷⁴³ Krahas kësaj, Vasileviqi dëshmoi përpara kësaj Dhome se, duke qenë se ai nuk mori pjesë në mbledhjen në fjalë, nuk mund të ishte i sigurt nëse ishte i pranishëm Shainoviqi apo nëse Millosheviqi kishte shqiptuar fjalët të cilat ia atribuoi Stevanoviqi.⁷⁴⁴ Rrjedhimisht Dhoma nuk mund t’i japë asnjë peshë kësaj prove materiale për vërtetimin e pranisë së Shainoviqit në këtë mbledhje apo të komenteve gjatë mbledhjes.

355. Sikurse është përmendur më herët në këtë Aktgjykim,⁷⁴⁵ më 1 qershor 1999 u zhvillua një mbledhje tjetër e Komandës së Përbashkët, në bodrumin e Hotelit “Grand” në Prishtinë.⁷⁴⁶ Pavkoviqi dhe Llazareviqi ndodheshin qysh më parë atje kur mbërritën Vasileviqi me Momir Stojanoviqin, shefin e Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës. Më vonë mbërritën një grup gjeneralësh të MPB-së. Pavkoviqi i përmendi Vasileviqit se do të vinte edhe “Shaja” (Shainoviqi). Gjeneralët e MPB-së, me përjashtim të Lluqi, qenë ulur në një anë të tryezës, ndërsa gjeneralët e UJ-së qenë ulur në anën tjetër. Dukej qartë se po prisnin dy njerëzit e rëndësishëm. Kur hynë Shainoviqi me Zoran Angjelkoviqin, të gjithë u ngritën më këmbë, pushuan bisedat e parëndësishme dhe atmosfera u bë më formale. Shainoviqi u ul në krye të tryezës, ndërsa Angjelkoviqi u ul në anën ku qenë ulur gjeneralët e MPB-së. Lluqi u ul në fund të tryezës, përballë Shainoviqit.⁷⁴⁷ Stojanoviqi dhe Llazareviqi konfirmuan se edhe ata kishin marrë pjesë në këtë mbledhje.⁷⁴⁸

⁷⁴² *Shih* Pjesën VII.P.

⁷⁴³ Aleksandar Vasileviq, T. 8778 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 72. *Shih edhe* P1898 (fletorja e Obrad Stevanoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 106.

⁷⁴⁴ Aleksandar Vasileviq, T. 8829–8830 (22 janar 2007).

⁷⁴⁵ *Shih* Pjesën VI.E.

⁷⁴⁶ Aleksandar Vasileviq, T. 14504–14505 (29 gusht 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 78–80, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15967–15969.

⁷⁴⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 80. Momir Stojanoviqi konfirmoi se të gjithë u ngritën më këmbë por shpjegoi se kjo ishte një sjellje e zakonshme në UJ “kur një epror hyn në dhomë”.

356. Vasileviqi dëshmoi se, pasi Llukiqi, Llazareviqi dhe Pavkoviqi folën për veprimtaritë e UJ-së dhe MPB-së e zhvilluara atë ditë, çka e shtyu Vasileviqin të mendonte se kjo ishte një mbledhje e përditshme, të pranishmëve iu drejtua Shainoviqi, i cili dha miratimin që të veprohej sipas planeve të gjeneralëve të UJ-së dhe MPB-së, me fjalët “Në rregull, veproni siç e keni planifikuar”. Çfarë ishte planifikuar ishte një operacion në Drenicë, ku, sipas planit, duheshin angazhuar 300 policë. Pastaj, Shainoviqi tha se “grupet terroriste” të mbetura duheshin shkatërruar në tri-katër ditët në vijim dhe se duhej përmirësuar organizimi i veprimtarive në terren dhe bashkëndimi midis MPB-së dhe UJ-së. Vasileviqi shpjegoi se nuk ishte nga ato mbledhje ku jepeshin urdhra, duke qenë se Shainoviqi i dërgoi të gjitha raportet dhe, pastaj, u pajtua shkurtimisht se gjërat duheshin bërë siç qenë planifikuar nga MPB-ja dhe UJ-ja.⁷⁴⁹ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Vasileviqi nuk dinte të thoshte nëse Shainoviqi merrte pjesë përditë në këto mbledhje, mirëpo tha vetëm se dukej sikur këto mbledhje bëheshin përditë.⁷⁵⁰ Çfarë mbante mend Stojanoviqi nga diskutimet në mbledhjen e datës 1 qershor ngjante me atë që mbante mend Vasileviqi. Shainoviqi i informoi të pranishmit se së shpejti do të nënshkruhej një marrëveshje midis RFJ-së dhe bashkësisë ndërkombëtare; se kjo marrëveshje parashikonte tërheqjen e UJ-së dhe MPB-së nga Kosova; dhe se kjo tërheqje do të duhej të fillonte shpejt. Llazareviqi dhe Llukiqi shprehën pakënaqësi lidhur me këtë, duke qenë se njësitë e tyre qenë të angazhuara në luftime. Sipas Stojanoviqit, çka përputhet edhe me dëshminë e Vasileviqit, Shainoviqi u përgjigj se operacionet duheshin finalizuar sa më shpejt dhe se Llazareviqi dhe Llukiqi duhej të mendonin për të gjetur mënyrën më të mirë për ta bërë një gjë të tillë.⁷⁵¹

357. Sipas Vasileviqit, gjatë gjithë kësaj mbledhjeje, të gjithë të pranishmit e trajtonin Shainoviqin me respekt. Ai drejtonte punimet e mbledhjes, nuk mbante asnjë shënim dhe jepte përshtypjen e qartë se ishte kryetari i saj. Sipas mendimit të Vasileviqit, Shainoviqin duhej ta kishte emëruar Millosheviqi dhe me siguri duhej t’i raportonte këtij të fundit.⁷⁵² Në dëshminë me gojë, Vasileviqi e ceku shkurtimisht Shainoviqin si “kryesuesin e mbledhjes”.⁷⁵³ Mirëpo, më vonë ai sqaroi se nuk e dinte se çfarë statusi zyrtar kishte Shainoviqi në mbledhje. Më tej, ai shpjegoi se

Momir Stojanoviç, T. 19803–19804 (7 dhjetor 2007). *Shih edhe* Vladimir Llazareviç, T. 18122–18124 (12 nëntor 2007).

⁷⁴⁸ Momir Stojanoviç, T. 19772–19774, 19801–19802 (7 dhjetor 2007); Vladimir Llazareviç, T. 18122–18124 (12 nëntor 2007).

⁷⁴⁹ Aleksandar Vasileviç, T. 8954–8955 (23 janar 2007), T. 14505–14506 (29 gusht 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 81–82, 2D387 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2007), para. 1–4; P2862 (pjesë nga ditari i Vasileviqit).

⁷⁵⁰ Aleksandar Vasileviç, T. 8838 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 77–84.

⁷⁵¹ Momir Stojanoviç, T. 19772–19776, 19802–19803 (7 dhjetor 2007). *Shih edhe* Vladimir Llazareviç, T. 18122–18124 (12 nëntor 2007).

⁷⁵² Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 80.

⁷⁵³ Aleksandar Vasileviç, T. 9042 (24 janar 2007).

“nuk mund të them në ishte apo nuk ishte komandanti i një Shtabi të Përbashkët apo Komande të Përbashkët. Mund të them vetëm se ai ishte personi më i lartë, bazuar në postet që kishte në qeveri, dhe ishte një person me pushtet politik të padiskutueshëm”. Vasileviqi kishte përshtypjen se Shainoviqi kishte detyrën “të informohej dhe të bashkërendonte problemet eventuale midis UJ-së dhe MPB-së dhe të ndiqte situatën e përgjithshme në Kosovë, për të cilën duhej të informonte Beogradin”.⁷⁵⁴ Stojanoviqi konfirmoi se gjatë mbledhjes nuk u dha asnjë urdhër dhe se askush nuk e kryesoi atë; Pavkoviqi vetëm sa e prezantoi Shainoviqin, i cili, më pas i informoi të pranishmit për marrëveshjen e ardhshme.⁷⁵⁵

358. Zoran Angjelkoviqi dëshmoi se ai ishte në të njëjtën mbledhje më 1 qershor 1999, mirëpo e përshkroi disi ndryshe. Ai tha se Shainoviqi e takoi në ndërtesën e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm dhe i tha se përfaqësuesit e UJ-së i kishin ftuar për darkë në Hotel “Grand”.⁷⁵⁶ Përpara darkës u bë një mbledhje.⁷⁵⁷ Përfaqësuesit e UJ-së, përfshirë edhe Llazareviqin, përshkruan ato që po ndodhnin në terren dhe Shainoviqi foli për bisedimet në Beograd midis Ahtisaari-t, Çernomërdinit dhe Millosheviqit.⁷⁵⁸

359. Dhoma vëren se versionet e ndryshme të dëshmive për këtë mbledhje, që jepen më lart, në përgjithësi përputhen me njëra-tjetrën. Ato gjithashtu përputhen në lidhje me rolin udhëheqës që tregoi Shainoviqi në mbledhjet e Komandës së Përbashkët më 1998, si edhe në lidhje me faktin se ai ishte personi përgjegjës për kalimin e urdhrave të Millosheviqit zyrtarëve në Kosovë. Ai u konsiderua nga personat e tjerë në mbledhje si zyrtari më i lartë dhe si personi që mund të urdhëronte ndalimin e veprimtarive të forcave të përbashkëta për shkak të marrëveshjes së arritur midis Millosheviqit dhe Martti Ahtisaari-t. Çka është më e rëndësishme, ai kishte kompetencën për të vendosur vetë për të urdhëruar *përfundimin* e këtyre veprimtarive në ditët në vijim. Si rrjedhojë mbledhja e 1 qershorit kishte elementet karakterizuese të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët të vitit 1998. Rrjedhimisht është e qartë se edhe në vitin 1999 ai ishte në gjendje të përçonte urdhra dhe të jepte miratimin për veprimtari të caktuara të UJ-së dhe MPB-së. Madje, Dhoma e gjykon veçanërisht me vend dëshminë e Vasileviqit lidhur me rolin e Shainoviqit në këtë fazë.⁷⁵⁹

⁷⁵⁴ Aleksandar Vasileviq, 2D387 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2007), para. 3–4. *Shih edhe* Aleksandar Vasileviq, T. 14505–14507 (29 gusht 2007).

⁷⁵⁵ Momir Stojanoviq, T. 19804 (7 dhjetor 2007).

⁷⁵⁶ Zoran Angjelkoviq, T. 14663–14664 (30 gusht 2007). Është me interes të theksohet se Vasileviqi vërejtë se dukej sikur Angjelkoviqi shkonte mirë me Shainoviqin. Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 80.

⁷⁵⁷ Zoran Angjelkoviq, T. 14663–14664, 14717 (30 gusht 2007). Mirëpo, Stojanoviqi dëshmoi se nuk hëngrën darkë gjatë kësaj mbledhjeje. Momir Stojanoviq, T. 19775, 19804 (7 dhjetor 2007).

⁷⁵⁸ Zoran Angjelkoviq, T. 14663–14664, 14716 (30 gusht 2007).

⁷⁵⁹ *Shih* Pikën VI.E.2.b.ii.(B).

360. Është e rëndësishme të theksohet se Aktakuza kundër Shainoviqit pretendon edhe se ai ushtronte pushtet *de facto* mbi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Ojdaniqin.⁷⁶⁰ Mbrojtja e Shainoviqit e kundërshton këtë pretendim, duke thënë se Ojdaniqi i merrte urdhrat drejtpërsëdrejti nga Millosheviqi.⁷⁶¹ Në mbështetje të argumentit të Mbrojtjes janë dëshmia që dhanë Gjorgje Qurçini, Shef i Administratës së Parë të Sektorit për Çështje Operative dhe të Shtabit të UJ-së, dhe Millorad Obradoviqi, Ndhimësshëf i Shtabit të Përgjithshëm për Sektorin për Çështje Operative dhe të Shtabit. Ata dëshmuuan të dy se ky pretendim nuk ishte as i logjikshëm dhe as i vërtetë.⁷⁶² Obradoviqi tha gjithashtu se as Shainoviqi, dhe asnjë autoritet tjetër shtetëror, nuk mund të vendosnin për përdorimin e njësive të UJ-së dhe se Ojdaniqi nuk merrte asnjëherë udhëzime nga një civil, me përjashtim të “Kryekomandantit” të UJ-së, Millosheviqit. Obradoviqi e mohoi sugjerimin se Shainoviqi thjesht përcillte urdhrat e Millosheviqit, duke qenë se nuk ishte e nevojshme sepse Millosheviqi mund të lidhej drejtpërsëdrejti me Ojdaniqin.⁷⁶³ Dhoma pranon se nuk ka dëshmi që Shainoviqi të ketë ushtruar pushtet mbi Ojdaniqin, i cili, gjatë luftës takohej përditë me Millosheviqin. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Shainoviqi nuk kishte ndikim mbi veprimtaritë e UJ-së dhe MPB-së, po të kihet parasysh marrëdhënia e tij e ngushtë me Millosheviqin, nga njëra anë, dhe marrëdhëniet e tij me Pavkoviqin dhe Llukiqin, nga ana tjetër, sikurse përshkruhen në këtë pjesë të Aktgjykimit.

361. Kjo konfirmohet nga Aleksandar Vasileviqi, i cili dëshmoi se në vitin 1999 Pavkoviqi shpesh e anashkalonte hierarkinë komanduese, duke shkuar drejtpërdrejtë te Millosheviqi dhe Shainoviqi, pa dijeninë apo lejen e Ojdaniqit.⁷⁶⁴ Kur Vasileviqi dhe Ojdaniqi shkuan të takoheshin me Millosheviqin në mes të muajit qershor 1999, ata panë Pavkoviqin tek largohej nga vila e Millosheviqit. Sipas Vasileviqit, Ojdaniqi i tha se Pavkoviqi takohej privatisht me Millosheviqin pa dijeninë e Ojdaniqit dhe i jepte më shumë rëndësi informimit të Shainoviqit sesa informimit të Ojdaniqit.⁷⁶⁵

⁷⁶⁰ Aktakuza, para. 48.

⁷⁶¹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 666–668.

⁷⁶² Gjorgje Qurçin, T. 16978–16980 (5 tetor 2007); Millorad Obradoviq, T. 15040–15043 (5 shtator 2007).

⁷⁶³ Millorad Obradoviq, T. 15039–15043 (5 shtator 2007). *Shih edhe* P928 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, 30 dhjetor 1998), f. 13–14, ku Aleksandar Dimitrijeviqi e përmendi Shainoviqin si dikush i cili mund të vendosë “me mendjelehtësi” për përdorimin e “njësive”.

⁷⁶⁴ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 19, T. 8669 (18 janar 2007).

⁷⁶⁵ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 20, T. 8670 (18 janar 2007), T. 8811 (22 janar 2007), T. 8932 (23 janar 2007).

c. Kontaktet e Shainoviçit me KVM-në dhe pengimi i procesit të Marrëveshjeve të Tetorit

i. Pengimi i procesit të Marrëveshjeve të Tetorit

362. Prokuroria argumenton se Shainoviçi nuk pati asnjëherë si synim respektimin e Marrëveshjeve të Tetorit midis NATO-s, KVM-së dhe RFJ-së/Serbisë dhe se ai pengoi vënien e tyre në zbatim.⁷⁶⁶ Nga ana e saj, Mbrojtja e Shainoviçit argumenton se RFJ-ja dhe Serbia kishin interes të madh për suksesin e KVM-së, çka duket edhe nga krijimi i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në.⁷⁶⁷ Në përgjigje të argumentit se Shainoviçi e pengonte procesin në lidhje me zbatimin e Marrëveshjeve të Tetorit, Mbrojtja argumenton se autoritetet e RFJ-së/Serbisë i kishin zbatuar tërësisht brenda datës 27 tetor 1998 kushtet e tyre.⁷⁶⁸

363. Në mbështetje të pretendimit të saj, Prokuroria përmend mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 21 shtator 1998, e cila u mbajt madje përpara lidhjes së Marrëveshjeve të Tetorit, ku Shainoviçi kishte shprehur pikëpamjen se: “Nuk duhet t’i zbatojmë pikat e Millosheviçit dhe Jelsinit që janë në deklaratë dhe nuk duhet ta zvogëlojmë numrin e efektivave”.⁷⁶⁹ Ky qëndrim konfirmohet pjesërisht nga ambasadori austriak, Wolfgang Petritsch, i cili u takua me Shainoviçin më 7 tetor 1998, përpara Marrëveshjeve. Gjatë kësaj mbledhjeje, Petritsch-i theksoi “problemin humanitar”, lidhur me mijëra persona të shpërngulur që qenë fshehur në luginën e Rugovës dhe nguli këmbë për tërheqjen e forcave policore. Mirëpo Shainoviçi iu përgjigj se numri i forcave policore ishte tashmë në nivel minimal dhe tha se duhej lënë një numër i mjaftueshëm për të qenë në gjendje të ruanin ligjin dhe rendin, sidomos përgjatë akteve kryesore të udhëtimit.⁷⁷⁰

364. Më pas Shainoviçi mori pjesë në mbledhjet e lidhura me Marrëveshjen “Clark-Naumann”, negociatat e së cilës janë përshkruar me hollësi në Kapitullin V, e në bazë të së cilës UJ-ja kishte detyrim të mos e rriste numrin e trupave në Kosovë.⁷⁷¹ Sikurse është thënë më herët, të nesërmen, më 26 tetor 1998, në një mbledhje të Komandës së Përbashkët, Shainoviçi u tha pjesëmarrësve të tjerë:

⁷⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 683–684.

⁷⁶⁷ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 254–364.

⁷⁶⁸ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 311–364.

⁷⁶⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124.

⁷⁷⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10944–10945 (2 mars 2007); 2D16 (Procesverbal i bisedimeve midis Wolfgang Petritsch-it dhe Shainoviçit, 7 tetor 1998).

⁷⁷¹ Klaus Naumann-i dëshmoi se materiali i bashkëngjitur u quajt “Deklaratë” sepse Clark-u dhe Naumann-i, si ushtarakë, nuk kishin kompetencë të nënshkruanin marrëveshje politike. Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervista me Prokurorinë), para. 21. P395 (Marrëveshja “Clark-Naumann”, 25 tetor 1998).

Kur të tërhiqemi, duhet të jemi të kujdesshëm, duhet të kujdesemi që askush të mos gjejë pjesë të disa detashmenteve të caktuara që nuk janë tërhequr. Nuk duhet të ketë mospërputhje me informacionin e dhënë më parë.⁷⁷²

Ky është interpretimi i komentit të Shainoviçit në anglisht i dhënë në sallën e gjyqit gjatë argumenteve përmbyllëse, të cilin Dhoma e pranon si të saktë.⁷⁷³

365. Në përgjigje, Mbrojtja e Shainoviçit argumenton se në këtë mbledhje Shainoviçi nuk shfaqi qëndrim pengues ndaj procesit, por, faktikisht i udhëzoi të pranishmit në mbledhje që të mundësonin respektimin e Marrëveshjeve të Tetorit.⁷⁷⁴ Në mbështetje të këtij argumenti, Mbrojtja thekson faktin se më 27 tetor Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe Sekretarja e Shtetit e SHBA-ve, Madeleine Albright, shprehën kënaqësinë e tyre për mënyrën me të cilën po bëhej tërheqja e njësisive.⁷⁷⁵ Krahas kësaj, një sërë dëshmitarësh dëshmuar se njësitë e UJ-së dhe të policisë që qenë sjellë në Kosovë nga jashtë saj u tërhoqën nga kjo krahinë.⁷⁷⁶ Për më tepër, Zoran Angjelkoviçi dëshmoi se gjatë kësaj mbledhjeje Shainoviçi veçoi në përputhje me postin e tij si Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në dhe se, në fund të fundit ai i paralajmëroi të gjithë se nuk duhej të kishte shkelje të marrëveshjes për tërheqjen e trupave.⁷⁷⁷

366. Mbrojtja e Shainoviçit citon edhe provat se, gjatë periudhës nëntor-dhjetor 1998, Shainoviçi bëri një varg takimesh me zyrtarë të huaj dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, në të cilat raportoi për respektimin e Marrëveshjeve të Tetorit. Kështu, më 3 nëntor 1998, Shainoviçi u takua me Petritsch-in dhe e informoi se procesi i stabilizimit po ecte përpara, se me mijëra refugjatë po ktheheshin dhe se jeta po i kthehej normalitetit.⁷⁷⁸ Diku mes datave 20 dhe 22 dhjetor 1998, ai u takua me Sadako Ogatan, Komisioneren e Lartë për Refugjatët e OKB-së, dhe diskutoi për çështjet e të shpërngulurve në Kosovë. Gjatë vizitës së saj, Ogata tha se numri i të shpërngulurve në Kosovë kishte rënë ndjeshëm dhe se nuk kishte asnjë katastrofë humanitare.⁷⁷⁹ Më 29 dhjetor 1998, u zhvillua edhe një takim tjetër midis Petritsch-it dhe Shainoviçit dhe një sërë ambasadorësh të

⁷⁷² Argumentet përmbyllëse të Shainoviçit, T. 27069 (21 gusht 2008).

⁷⁷³ Dhoma vëren se përkthimi i Shënimeve lidhur me këtë mbledhje ndryshon nga përkthimi brenda gjykatës që u bë gjatë argumenteve përmbyllëse. Dhoma do të përdorë përkthimin e dytë, sepse e konsideron më të saktë. *Krahaso* Argumentet përmbyllëse të Shainoviçit, T. 27069 (21 gusht 2008), me P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 160.

⁷⁷⁴ Argumentet përmbyllëse të Shainoviçit, T. 27069–27070 (21 gusht 2008).

⁷⁷⁵ 2D10 (Pjesë e nxjerrë nga libri i Marc Weller-it, “The Crisis in Kosovo 1989–1999” (Kriza në Kosovë 1989–1999)).

⁷⁷⁶ *Shih, p.sh.*, Karol John Drewienkiewicz, T. 7885–7886 (5 dhjetor 2006). *Shih edhe* John Crosland, T. 9868–9869 (8 shkurt 2007); 6D1669 (Raport i ambasadës amerikane në Beograd lidhur me respektimin e Marrëveshjeve të Tetorit nga RFJ-ja/Serbia, 1 nëntor 1998), f. 1–2.

⁷⁷⁷ Zoran Angjelkoviçi, T. 14703–14706 (30 gusht 2007).

⁷⁷⁸ 2D321 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Wolfgang Petritsch-it dhe Shainoviçit, 3 nëntor 1998).

⁷⁷⁹ 2D169 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për vizitën e Sadako Ogatës, 5 janar 1999), f. 2.

tjerë.⁷⁸⁰ Në fillim të muajit janar 1999, Shainoviçi udhëtoi për në Austri ku u takua me zyrtarë austriakë dhe me Petritsch-in dhe theksoi se ekzistonte nevoja për të gjetur një zgjidhje politike paqësore ku të kishte barazi për të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë.⁷⁸¹

367. Dhoma vëren shumëkuptimësinë e mundshme të përkthimit të deklaratës së Shainoviçit lidhur me tërheqjen e trupave në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 26 tetor. Përkthimi i brendshëm që është pranuar nga Dhoma mund ta mbështesë interpretimin e propozuar nga Mbrojtja e Shainoviçit, sidomos duke marrë parasysh provat e analizuara në paragrafët e mësipërm. Rrjedhimisht, Dhoma nuk mund ta pranojë këtë provë në dëm të Shainoviçit.

ii. Shainoviçi si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në

368. Në mbështetje të argumentit se Shainoviçi kishte pushtet të madh në Kosovë, Prokuroria sjell në vëmendje postin e tij si Kryetar i Komisionit të Qeverisë Federale për Bashkëpunim me Misionin e OSBE-së për Verifikimin në Kosovë (“Komisioni”), të cilin ai e shfrytëzoi si për të ushtruar kontroll mbi krahinë, po ashtu dhe për të penguar procesin e KVM-së.⁷⁸² Nga ana tjetër, Mbrojtja e Shainoviçit thekson se ky post është prova se Shainoviçi nuk ishte përfaqësues i Millosheviçit në Kosovë, por thjesht shihej si i tillë nga përfaqësuesit dhe diplomatët e huaj, të cilët komunikonin me të për shkak të rolit që kishte në këtë Komision.⁷⁸³ Sipas Mbrojtjes, ky emërim, së bashku me faktin se ai ishte zyrtari më i lartë nga RFJ-ja në Kosovë, shpjegojnë tërësisht pozitën, kompetencat dhe përgjegjësitë e Shainoviçit në krahinë.⁷⁸⁴ Mirëpo, duke u mbështetur në provat e mësipërme, Dhoma vëren se përgjegjësitë dhe pushteti i Shainoviçit në Kosovë ishin të gjera edhe përpara krijimit të Komisionit për Bashkëpunim.

369. Dhoma ka nxjerrë tashmë përfundime lidhur me Komisionin, në Pjesën VI.D, më lart, përfshirë edhe përfundimin se Komisioni nuk kishte pushtet komandues mbi UJ-në dhe MPB-në. Dhoma do të analizojë veprimet dhe sjelljen e Shainoviçit si Kryetar i Komisionit.

⁷⁸⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10945–10946 (2 mars 2007).

⁷⁸¹ Wolfgang Petritsch, T. 10947 (2 mars 2007); 2D15 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Shainoviçit dhe zyrtarëve austriakë, 6 janar 1999). Dhoma Gjyqësore ka marrë si prova edhe procesverbale nga një sërë takimesh të ngjashme midis Shainoviçit dhe diplomatëve të huaj, si përpara bombardimeve të NATO-s, po ashtu edhe gjatë tyre. *Shih, p.sh.*, 2D196 (Raport i qeverisë së RFJ-së për vizitën e delegacionit të RFJ-së në Komisionin e BE-së, 25 janar 1999); 2D183 (Udhëzime të qeverisë së RFJ-së lidhur me vizitën e delegacionit të RFJ-së në Danimarkë dhe Suedi, 14 janar 1999); 2D330 (Vendim i qeverisë së RFJ-së për vizitën e Shainoviçit në Danimarkë dhe Suedi, 21 janar 1999); 2D332 (letër e Shainoviçit drejtues Sekretarit të UNECE-së, Yves Berthelot, 27 maj 1999).

⁷⁸² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 660, 686.

⁷⁸³ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 410–416.

⁷⁸⁴ *Shih, p.sh.*, Joseph Maisonneuve, T. 11162–11164 (7 mars 2007); Michael Phillips, T. 11863–11866 (19 mars 2007).

370. Sikundër përmendet në Pjesën VI.D, anëtarët e tjerë të Komisionit ishin Zhivadin Jovanoviqi, Pavel Bullatoviqi, Momçillo Perishiqi, Mihal Kertesi, Zoran Angjelkoviqi, Vllajko Stojilkoviqi dhe Dushan Llonçari.⁷⁸⁵ Detyra kryesore e tij ishte të ndihmoheshin ministritë e ndryshme në marrëdhëniet e tyre me KVM-në.⁷⁸⁶ Megjithëse, zyrtarisht, u ngrit në tetor 1998 në Beograd, ku do të mblidhej një herë në javë, Komisioni kishte edhe një zyrë në Prishtinë. Kjo zyrë drejtohej nga Dushan Llonçari, gjeneral në lirim i UJ-së. Ndryshe nga situata në verën dhe vjeshtën e vitit 1998, Shainoviqi kaloi vetëm një të tretën e kohës në Kosovë gjatë kësaj periudhe.⁷⁸⁷

371. Llonçari dëshmoi se, që në fund të muajit korrik 1998, Millosheviqi i kishte kërkuar personalisht të drejtonte kontaktet midis kreut të KVM-së, William Walker-in dhe bashkëpunëtorët e tij më të afërt, nga njëra anë, dhe autoriteteve të RFJ-së/Serbisë, nga ana tjetër.⁷⁸⁸ Pas një pune të suksesshme me Walker-in në Kroaci në mesin e viteve '90, Llonçari konsiderohej si personi i përshtatshëm për këtë detyrë, paçka se nuk shkonte mirë me Millosheviqin.⁷⁸⁹ Llonçari e pranoi ofertën dhe u informua se do të punonte drejtpërdrejtë me Shainoviqin. Pas disa muajsh, më 30 tetor 1998, Shainoviqi i telefonoi Llonçarit dhe të dy u takuan në zyrën e Shainoviqit, ku Llonçari u informua se ishte bërë zyrtarisht anëtar i Komisionit.⁷⁹⁰ Përpara mbërritjes së KVM-së dhe gjatë kohës kur KDOM-i ishte ende në Kosovë, Shainoviqi takohej rregullisht me Shaun Byrnes-in e US-KDOM-së çdo dy-tri ditë.⁷⁹¹ Pas ngritjes së Komisionit dhe zyrës së tij në Prishtinë, Llonçari kishte detyrë të organizonte takimet e Shainoviqit me KVM-në.⁷⁹²

372. Ndryshe nga anëtarët e tjerë të Komisionit, të cilët vijuan realizimin e detyrave normale të tyre, Llonçari punonte vetëm për Komisionin. Detyra e tij ishte të mundësonte që verifikuesit e KVM-së të kishin lirinë e lëvizjes dhe siguri në Kosovë; t'i ndihmonte ata të gjenin strehim të përshtatshëm; të siguronte marrëdhënie të mira midis Walker-it dhe Komisionit, në mënyrë të tillë që të hetoheshin dhe sqaroheshin të gjitha incidentet; të siguronte lëvizshmërinë e misionit 24 orë në ditë, 7 ditë të javës; të mbante shënime kërkesat e misionit, të cilat, pastaj, duhej t'ia përcillte Shainoviqit, i cili u përgjigjej drejtpërsëdrejti ose përmes Llonçarit; dhe të sigurohej që KVM-ja ta

⁷⁸⁵ 2D8 (Vendim i qeverisë së RFJ-së mbi Krijimin e Komisionit Qeveritar Federal për Bashkëpunim me Misionin e OSBE-së për Verifikim në Kosovë, 19 tetor 1998), para. 3; 2D9 (Shtesë e Vendimit të qeverisë së RFJ-së mbi Krijimin e Komisionit Qeveritar Federal për Bashkëpunim me Misionin e OSBE-së për Verifikim në Kosovë), para. 1.

⁷⁸⁶ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 532–543.

⁷⁸⁷ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 543–549.

⁷⁸⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 13–15.

⁷⁸⁹ Dushan Llonçar, T. 7584 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 12–15, 48. *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 544–545.

⁷⁹⁰ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 17–20. Sipas Shainoviqit, Llonçari ishte i punësuar si civil dhe paguhej nga qeveria e RFJ-së, çka do të thoshte se nuk kishte lidhje me UJ-në; P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë, 11 dhjetor 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 528–530.

⁷⁹¹ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 25, P2530 (fletinformacion plotësues, datë 28 nëntor 2006), para. 6.

quante UÇK-në “terroriste”.⁷⁹³ Gjithashtu ai duhej të mbante komunikim 24-orësh me KVM-në dhe Komisionin, UJ-në dhe MPB-në. Nëse një incident ose një çështje ishte vërtetë e rëndësishme, ai organizonte një takim midis Shainoviqit dhe personelit të KVM-së.⁷⁹⁴

373. Llonçari shkoi për herë të parë në Kosovë më 12 nëntor 1998, i shoqëruar nga Shainoviqi. Me të mbërritur në Prishtinë, të dy shkuan në ndërtesën e Shtabit të MPB-së, ku u takuan me Llukiqin dhe Pavkoviqin dhe një person nga RDB-ja. Shainoviqi ua prezantoi Llonçarit të tjerëve dhe u tregoi për mandatin e Llonçarit. Shainoviqi nguli këmbë që të gjitha informacionet dhe kërkesat e UJ-së dhe MPB-së për KVM-në t'i përcilleshin Llonçarit. Po kështu, kur Llonçari të merrte kërkesa nga KVM-ja, ai do t'ua përcillte ato ose MPB-së, ose UJ-së. Shainoviqi organizoi edhe një ekip për Llonçarit, në të cilin përfshiheshin përfaqësues me grada të larta, nga MPB-ja (Miroslav Mijatoviqi, zëvendësi i Sreten Llukiqit), nga UJ-ja (kolonel Millan Koturi i Korpusit të Prishtinës) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme (Velo Sllana).⁷⁹⁵ Sipas Llonçarit, Shainoviqi i udhëzoi Llukiqin dhe Pavkoviqin të vazhdonin me praktikën e kthyer në rutinë tashmë, domethënë të informonin të parin (Shainoviqin) për incidentet e rëndësishme dhe vetëm pas kësaj të informonin eprorët e tyre.⁷⁹⁶

374. Pas çdo mbledhjeje midis anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të KVM-së, Velo Sllana bënte pesë kopje të procesverbalit, të cilin e kishin nënshkruar të pranishmit. Këto i dërgoheshin qeverisë së RFJ-së, qeverisë së Serbisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, arkivit dhe Shainoviqit.⁷⁹⁷

375. Llonçari dëshmoi edhe se, në kuadër të punës së përditshme të kontakteve me KVM-në, kishte një shkëmbim të rregullt raportesh.⁷⁹⁸ Çdo mëngjes, UJ-ja dhe MPB-së, përkatësisht përmes Koturit dhe Mijatoviqit, dërgonin raporte në zyrën e Llonçarit lidhur me incidentet që kishin ndodhur gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë. Llonçari i vinte në një vend këto raporte, i vuloste dhe i mbyllte, pa i ndryshuar dhe, pastaj, ia dërgonte Walker-it. Gjithashtu, Mijatoviqi dhe Koturi u dërgonin raportet e tyre individuale përfaqësuesve të KVM-së brenda orës 7 çdo mëngjes.⁷⁹⁹ Kur Drewienkiewicz-i raportonte një incident, siç bëri me rastin e Reçakut, Llonçari kontaktonte

⁷⁹² Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 25.

⁷⁹³ Dushan Llonçar, T. 7582–7585 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 18.

⁷⁹⁴ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 24.

⁷⁹⁵ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 21. *Shih edhe* Richard Ciaglinski, T. 6860 (17 nëntor 2006).

⁷⁹⁶ Dushan Llonçar, T. 7652–7654 (1 dhjetor 2006).

⁷⁹⁷ Dushan Llonçar, T. 7593–7596 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 26, P2530 (fletinformacion plotësues, datë 28 nëntor 2006), para. 7.

⁷⁹⁸ Dushan Llonçar, T. 7577 (30 nëntor 2006).

⁷⁹⁹ Dushan Llonçar, T. 7594, 7596 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 28.

menjëherë Koturin që ky i fundit të shkonte me Drewienkiewicz-in dhe të përgatiste një raport të qartë dhe të hollësishëm për incidentin. Krahas kësaj, nëse kishte ndonjë rast urgjent, Llonçari i telefononte menjëherë Shainoviçit. Drewienkiewicz-i caktoi edhe dikë nga KVM-ja për t'u takuar me Mijatoviçin çdo mëngjes, për të analizuar situatën nga këndvështrimi i MPB-së. Pas diskutimit raportet i shkonin Llonçarit dhe të nesërmen në mëngjes ai ia përcillte ato edhe Walker-it.⁸⁰⁰ Llonçari mendonte se ai kishte dëgjuar për të gjitha incidentet në Kosovë sepse Koturi dhe Mijatoviçi ishin shumë të përpiktë në punën e tyre. Sipas mendimit të tij, edhe KVM-ja ishte e mirinformuar për të gjitha incidentet.⁸⁰¹

376. Llonçari dëshmoi më tej se ai i telefononte Shainoviçit çdo mëngjes dhe e informonte se çfarë kishte ndodhur gjatë natës, edhe pse, shpesh, Shainoviçi ishte informuar më parë nga Llukiqi dhe Pavkoviçi.⁸⁰² Duke qenë se Shainoviçi ngulte këmbë që të informohej në kohë për incidentet në terren, sidomos për incidentet e rëndësishme dhe incidentet me shumë viktima, Pavkoviçi dhe Llukiqi qenë të detyruar ta informonin me telefon nëse ndodhte ndonjë incident i rëndësishëm. Ndonjëherë ishte nevoja ta kontaktonin Shainoviçin dy apo, madje, tri herë në ditë, por më të shumtën e kohës Pavkoviçi dhe Llukiqi i raportonin Shainoviçit dy, tri ose katër herë në javë.⁸⁰³

377. Çdo të martë, në orën 9 të mëngjesit, i gjithë Komisioni mbledhej në zyrën e Shainoviçit në Beograd, për të analizuar punën e KVM-së dhe të Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm. Aty jepeshin edhe detyrat për shtatë ditët në vijim. Llonçari mori pjesë në pesë syresh, ndonjëherë për të raportuar për anëtarët e rinj të KVM-së dhe problemet që kishin zyrtarët e KVM-së në kuadër të misionit.⁸⁰⁴ Perishiçi nuk mori pjesë asnjëherë. As Ojdaniçi nuk mori pjesë kur mori detyrën si Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Ata dërgonin një përfaqësues, Millorad Obradoviçin.⁸⁰⁵ Zhivadin Jovanoviçi, ministri i Punëve të Jashtme, dërgonte gjithmonë zëvendësin e tij, Sllanën.⁸⁰⁶ Angjelkoviçi mori pjesë në disa prej këtyre mbledhjeve.⁸⁰⁷

378. Mbledhjet e Komisionit në Beograd i drejtonte Shainoviçi. Një herë, mbledhjen e drejtoi Millomir Miniçi, i cili nuk ishte anëtar i Komisionit. Shainoviçi i hapte mbledhjet duke folur për situatën politike në Kosovë. Ai raportonte edhe për çështjet që kishin të bënin me rolin e KVM-së. Stojilkoviçi raportonte për incidentet e MPB-së, Obradoviçi raportonte për çështjet e UJ-së, ndërsa

⁸⁰⁰ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 32.

⁸⁰¹ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 35.

⁸⁰² Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 28, 53.

⁸⁰³ Dushan Llonçar, T. 7576–7577 (30 nëntor 2006), T. 7649, 7653–7654 (1 dhjetor 2006).

⁸⁰⁴ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 29, 31.

⁸⁰⁵ Millorad Obradoviçi, T. 15031 (5 shtator 2007); Dushan Llonçar, T. 7691 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 30.

⁸⁰⁶ Dushan Llonçar, T. 7592 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 30.

⁸⁰⁷ Dushan Llonçar, T. 7580 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 14.

Angjelkoviqi raportonte për masat ekonomike dhe civile. Me të gjitha marrëdhëniet politike merreshin Angjelkoviqi dhe Shainoviqi. Pas këtyre diskutimeve, Shainoviqi jepte detyra konkrete. Për shembull, një herë ai i tha Stojilkoviqit se një farë rruge ishte e rrezikshme dhe duhej rritur numri i patrullave. Këtë udhëzim Stojilkoviqi e zbatoi.⁸⁰⁸ Sipas Llonçari, detyrat e UJ-së dhe MPB-së diskutoheshin vetëm për aq sa kishin të bënin me punën e Komisionit.⁸⁰⁹ Mirëpo, kur Millorad Obradoviqit iu bë pyetja nëse këto mbledhje kishin ndonjë strukturë komandimi, ai i përshkroi këto mbledhje si mbledhje analizuese, ku “njerëzit jepnin mendimet e tyre” dhe “bisedonin për probleme të caktuara nga zonat e tyre”.⁸¹⁰

379. Krahas informimit me telefon dhe përmes mbledhjeve javore të Komisionit në Beograd, Shainoviqi shkante në Kosovë të paktën një apo dy herë në javë. Nëse kishte ndonjë incident të rëndë, siç ishte ai në Reçak në janar 1999, Shainoviqi qëndronte dy-tri ditë atje.⁸¹¹ Llonçari nuk takohej me Shainoviqin sa herë që vinte ky i fundit në Kosovë, por Llukiqi, Pavkoviqi dhe Angjelkoviqi takoheshin gjithmonë me të. Llonçari nuk ishte në dijeni të natyrës së këtyre takimeve, por supozoi se kishin të bënin me faktin që Shainoviqi kishte pushtet *de facto* në Kosovë.⁸¹² Kut ishte në Prishtinë, Shainoviqi kryesonte mbledhjet me KVM-në.⁸¹³

380. Duke bërë një përmbledhje të rolit të Shainoviqit në Kosovë, Llonçari mendonte se puna e tij me Komisionin bënte pjesë në detyrat e zëvendëskryeministrit të RFJ-së dhe, për rrjedhojë, bazohej te detyrat që merrte nga qeveria e RFJ-së.⁸¹⁴ Në deklaratën e tij si dëshmitar, Llonçari u shpreh se ai e merrte si të mirëqenë se e gjitha kjo bëhej në bazë të udhëzimeve të Millosheviqit.⁸¹⁵ Në gjyq, në bazë të dokumenteve të arkivave federale, Llonçari dëshmoi se Shainoviqi i merrte udhëzimet nga qeveria e RFJ-së dhe Momir Bullatoviqi.⁸¹⁶ Megjithatë, ai pranoi se edhe Millosheviqi, si President i RFJ-së asokohe, ushtronte ndikim në vendimet e qeverisë së RFJ-së.⁸¹⁷ Madje, lidhur me emërimin e vetë Llonçarit, Bullatoviqin e kontaktoi Millosheviqi, i cili propozoi përfshirjen e tij në Komision.⁸¹⁸ Dhoma nuk ka asnjë dyshim se Millosheviqi ushtroi ndikimin e tij

⁸⁰⁸ Dushan Llonçar, T. 7691–7692 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 30, 67.

⁸⁰⁹ Dushan Llonçar, T. 7601 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 30.

⁸¹⁰ Millorad Obradoviq, T. 15031 (5 shtator 2007).

⁸¹¹ Dushan Llonçar, T. 7577–7578 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 38.

⁸¹² Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 38; *shih edhe* P2530 (fletinformacion plotësues, datë 28 nëntor 2006), para. 8.

⁸¹³ Dushan Llonçar, T. 7691–7692 (1 dhjetor 2006). *Shih edhe* Richard Ciaglinski, T. 7002–7003 (21 nëntor 2006).

⁸¹⁴ Dushan Llonçar, T. 7585 (30 nëntor 2006).

⁸¹⁵ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 38, 65.

⁸¹⁶ Dushan Llonçar, T. 7604 (30 nëntor 2006), T. 7688–7689 (1 dhjetor 2006), P2530 (fletinformacion plotësues, datë 28 nëntor 2006), para. 8, 11.

⁸¹⁷ Dushan Llonçar, T. 7688–7690 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 14.

⁸¹⁸ Dushan Llonçar, T. 7690 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 14.

edhe në emërimin e Shainoviqit si kryetar i Komisionit. Kjo i dha mundësi Shainoviqit ta zgjeronte rolin e tij si përfaqësuesi politik i Millosheviqit në Kosovë.

381. Shtrirja e pushtetit të Shainoviqit ishte e tillë sa që Llonçari tha se ai e kishte këtë pushtet “mbi të gjitha strukturat” në Kosovë.⁸¹⁹ Sipas Llonçarit, përkushtimi i ndërgjegjshëm i Shainoviqit për punën e tij bëri që ai ta zgjeronte në mënyrë jozyrtare ndikimin e tij në sfera që dilnin jashtë kufijve zyrtarë të kompetencave të tij. Për shembull, ai punoi me Angjelkoviqin për ngritjen e organeve vendore dhe të forcave policore vendore të përziera.⁸²⁰

382. Llonçari shpjegoi edhe se ai rrallë merrte vendime të menjëhershme nga Shainoviqi kur i kërkonte udhëzime se çfarë të bënte më tej. Në përgjigje të kërkesave të KVM-së, Shainoviqi thoshte “le të presin, do të flas unë me Walker-in kur të takohemi”.⁸²¹ Mirëpo, Llonçari shtoi se kërkesat e Walker-it nga ana e tij, ose nga ana e KVM-së zakonisht shkonin përtej kushteve specifike të Marrëveshjeve të Tetorit dhe, nëse një çështje nuk ishte brenda kompetencës ekskluzive të Shainoviqit, atëherë Shainoviqit i duhej të këshillohej me qeverinë e RFJ-së, duke qenë se ai nuk “sundimtar absolut” dhe nuk mund të jepte përgjigje aty për aty.⁸²²

383. Llonçari mendonte se RFJ-ja kishte dëshirën e sinqertë që misioni i OSBE-së të dilte me sukses. Si rezultat, Shainoviqi ngulte këmbë gjithmonë për një punë të plotë të Komisionit dhe për pasjen e një marrëdhënieje të drejtë dhe të ndershme me KVM-në. Angazhimi i tij ishte për të siguruar suksesin e misionit.⁸²³ Shainoviqi gjithmonë i udhëzonte njerëzit e tij të bashkëpunonin me KVM-në dhe t’i plotësonin të gjitha kërkesat e misionit dhe asnjëherë nuk udhëzoi askënd që ta pengonte këtë bashkëpunim.⁸²⁴

384. Edhe ata që nuk qenë në dijeni të rolit zyrtar të Shainoviqit si Kryetar i Komisionit e konsideronin atë si person me pushtet në Kosovë për shkak të mënyrës si sillej. Michael Phillips-i, si shef i kabinetit të Walker-it, takoi rregullisht me Shainoviqin. Sikurse thuhet më lart, në takimin e tyre të parë, Shainoviqi e prezantoi veten si përfaqësues personal i Millosheviqit në

⁸¹⁹ Dushan Llonçar, T. 7603–7604 (30 nëntor 2006), P2530 (fletinformacion plotësues, datë 28 nëntor 2006), para. 8.

⁸²⁰ Dushan Llonçar, T. 7590 (30 nëntor 2006).

⁸²¹ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 65.

⁸²² Dushan Llonçar, T. 7586–7588 (30 nëntor 2006).

⁸²³ Dushan Llonçar, T. 7584, 7586 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 59. *Shih edhe* 2D119 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për mbërritjen e KVM-së, 18 nëntor 1998); 2D112 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për vizitën e pjesës franceze të KVM-së, 16 nëntor 1998).

⁸²⁴ Dushan Llonçar, T. 7590–7591 (30 nëntor 2006). *Shih, p.sh.*, 2D321 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Wolfgang Petritsch-it dhe Shainoviqit), f. 1. Në këtë dokument thuhet se Shainoviqi e nxit vijueshmërinë e monitorimit dhe praninë e përhershme të monitoruesve të KDOM-it dhe KVM-së. *Shih edhe* 2D318 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Staffan de Mistura-s dhe Shainoviqit).

Kosovë.⁸²⁵ Sa i takon rolit të tij specifik, ai shpjegoi se ai do të përfshihej në të gjitha aspektet politike dhe do të ndihmonte KVM-në për ngritjen e misionit.⁸²⁶ Phillips-i kishte përshtypjen se Shainoviqi ishte personi që e kryesonte mbledhjen, duke qenë se ai fliste më shumë nga të gjithë, qëndronte në tryezë i ulur drejtpërdrejtë përballë Walker-it dhe orientonte pjesëmarrësit e tjerë të ulur në anën e tij të tryezës, përfshirë edhe Llukiqin, i cili mori pjesë në disa prej këtyre mbledhjeve. Askush prej ekipit të Shainoviqit nuk ulej pa u ulur në fillim ai.⁸²⁷ Sa herë ngrihej një shqetësim lidhur me trupa të caktuara, Shainoviqi i drejtohej Llonçarit ose Llukiqit dhe bënte një pyetje. Phillips-i arriti në përfundimin se Shainoviqi kishte “njëfarë pushteti” mbi veprimtaritë e UJ-së dhe MPB-së.⁸²⁸ Edhe pse përshtypja e Phillips-it përputhej me mendimet e të tjerëve, për çudi ai nuk ishte i njohur me Komisionin dhe postin e Shainoviqit si Kryetar. Megjithatë, pasi pa vendimin e qeverisë së RFJ-së për ngritjen e Komisionit, ai konfirmoi se konstatimi i tij lidhur me detyrat e Shainoviqit për KVM-në përkonte me mandatin që Shainoviqi kishte marrë prej qeverisë së RFJ-së. Ai vijoi të ngulte këmbë se Shainoviqi e prezantoi veten si përfaqësues personal i Millosheviqit për Kosovën, mirëpo tha se besonte se Shainoviqi përfaqësonte edhe qeverinë.⁸²⁹

385. Phillips-i u përmendte Millosheviqit dhe Shainoviqit ankesat lidhur me ashpërsinë e forcës së ushtruar nga trupat e armatosura të RFJ-së/Serbisë në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999. Shainoviqin e informuan për këto shqetësime gjatë mbledhjeve javore, në prani të Llukiqit. Ndaj këtyre ankesave, të dy ata reagues duke u vënë në pozita mbrojtëse, gjithmonë duke thënë se u duhej të mbronin serbët (meqenëse këtë nuk e kishte bërë KVM-ja) dhe se po bënin diçka që ishte tërësisht e logjikshme, në kundërpërgjigje të aksioneve të UÇK-së.⁸³⁰

386. Phillips-i dëshmoi edhe për një takim me Millosheviqin, i cili u mbajt rreth datës 24 nëntor 1998, për të diskutuar problemet e bashkëpunimit midis KVM-së dhe autoriteteve të RFJ-së/Serbisë. Mes të tjerësh, në këtë mbledhje mori pjesë edhe Shainoviqi. Sipas Phillips-it, Walker-i mendoi se ishte e nevojshme t'i jepte me atë rast Millosheviqit një letër ku skicohej bashkëpunimi që priste misioni nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë dhe ku renditeshin problemet e ndryshme që kishin në Kosovë.⁸³¹ Phillips-i shpjegoi se e bënë këtë gjë sepse nuk po merrnin asnjë rezultat nga Shainoviqi.⁸³² Kur Millosheviqi dëgjoi për problemet, ai u pezmatua, sepse mendonte se po

⁸²⁵ Michael Phillips, T. 11831 (19 mars 2007).

⁸²⁶ Michael Phillips, T. 11832 (19 mars 2007).

⁸²⁷ Michael Phillips, T. 11832 (19 mars 2007).

⁸²⁸ Michael Phillips, T. 11855–11857 (19 mars 2007).

⁸²⁹ Michael Phillips, T. 11863–11866 (19 mars 2007).

⁸³⁰ Michael Phillips, T. 11845–11846 (19 mars 2007).

⁸³¹ Michael Phillips, T. 11841–11842, 11944–11945 (19 mars 2007); P396 (Letër e William Walker-it drejtuar Slobodan Millosheviqit).

⁸³² Michael Phillips, T. 11872–11873 (19 mars 2007).

siguronte një shkallë të lartë bashkëpunimi. Problemi ishte kryesisht siguria që kërkonte KVM-ja dhe fakti se Millosheviqi mendonte se shqetësime të tilla të sigurisë duhej t'i trajtonte MPB-ja. Gjatë këtij takimi, Phillips-i pati përshtypjen se Millosheviqi ishte përgjegjës për vendimet e sigurisë, të cilat i vinte në zbatim Shainoviqi në Kosovë. Këtë ai e mbështeste te fakti se Millosheviqi i kërkonte Shainoviqit të hetonte një problem, duke sugjeruar, për shembull, heqjen e një postblloku.⁸³³

387. Joseph Maisonneuve-i, shefi i Qendrës Rajonale të KVM-së në Prizren, dëshmoi se kur u takua disa herë me Shainoviqin, ai iu duk si “një zotëri i rafinuar me besim te vetja, i cili ishte në dijeni të veprimtarive që po zhvilloheshin në Kosovë asokohe.”⁸³⁴ Ai nuk e dëgjoi asnjëherë Shainoviqin t'ia kalonte kompetencën një personi tjetër kur bëhej fjalë për Kosovën. Sipas mendimit të tij, nuk kishte dyshim që Shainoviqi ishte i informuar mirë për çfarë ndodhte në Kosovë dhe gëzonte pushtet të madh për të vepruar.⁸³⁵ Gjatë pyetjeve të saj, Mbrojtja e Shainoviqit e pyeti nëse ishte në dijeni të faktit se Shainoviqi ishte Kryetari i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në. Maisonneuve-i u përgjigj se nuk ishte në dijeni në mënyrë të hollësishme, por dinte se Shainoviqit i ishte deleguar përgjegjësia për të bashkërenduar zonën operative të Kosovës. Ai pranoi se ky post shpjegonte edhe përshtypjen e tij lidhur me kompetencat e Shainoviqit në Kosovë.⁸³⁶

388. Ekzistojnë prova se nga data 1 janar deri më 24 mars 1999 Shainoviqi shkoi në Prishtinë vetëm disa herë. Ai vazhdoi të ishte Kryetari i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në deri në largimin e KVM-së nga Kosova.⁸³⁷

iii. Shembuj të pushtetit të Shainoviqit si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim

389. Dhoma ka dëgjuar dëshmi për angazhimin e Shainoviqit, në kuadër të punës me Komisionin, në incidente të ndryshme përreth Kosovës gjatë 1998 dhe 1999. Njëri prej këtyre incidenteve kishte lidhje me zonën problematike të Podujevës, për të cilën është folur tashmë në përgjithësi në Pjesën VI.D.

390. Si Llonçari, po ashtu edhe Drewienkiewicz-i, dëshmuar për një incident në fshatin e Obrancës në komunën e Podujevës, ku në fund të muajit dhjetor 1998, UÇK-ja vrau një fshatar të

⁸³³ Michael Phillips, T. 11842–11844 (19 mars 2007).

⁸³⁴ Joseph Maisonneuve, T. 11033 (6 mars 2007).

⁸³⁵ Joseph Maisonneuve, T. 11033 (6 mars 2007), P2772 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 mars 2000), para. 9.

⁸³⁶ Joseph Maisonneuve, T. 11162–11164 (7 mars 2007).

⁸³⁷ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 550, 842.

moshuar serb.⁸³⁸ Kur shkoi policia në fshat, ata ranë në një pritë të UÇK-së. Luftimet midis dy palëve vazhduan për disa ditë. Sipas Llonçarit, për këtë incident fillimisht u ngarkuan Llukiqi dhe MPB-ja. Pas disa ditësh, në vend erdhën forcat e UJ-së që po stërviteshin aty pranë.⁸³⁹ Ky incident ishte kaq i fortë sa që, edhe Walker-i, edhe Shainoviqi, u interesuan personalisht për të.⁸⁴⁰

391. Ciaglinski tregoi për një incident tjetër në Podujevë, rreth thujse të njëjtës kohë, i cili kishte të bënte me rrëmbimin e një bujku serb dhe me përpjekjet e autoriteteve të RFJ-së/Serbisë për të siguruar lirin e tij.⁸⁴¹ Ai mësoi për këtë incident gjatë një mbledhjeje me Llonçarin dhe Komisionin, ku Llonçari e informoi KVM-në se ata do të nisnin një sulm për të çliruar bujkun e rrëmbyer, me forca të MPB-së dhe UJ-së. Ciaglinski e dinte se edhe UÇK-ja po përgatitej për të sjellë forca, pajisje dhe municione shtesë dhe se një sulm i forcave të RFJ-së/Serbisë kishte shumë të ngjarë të çonte në humbjen e në numri të madh jetësh për të dyja palët. Atëherë, Ciaglinski dhe Drewienkiewicz propozuan që KVM-ja të bisedonte me UÇK-në për të liruar bujkun. Llonçari u përgjigj se nuk ishte në gjendje të merrte një vendim të tillë. Ai bëri një telefonatë, nga një dhomë aty ngjitur. Në fillim Ciaglinski dyshoi se Llonçari i telefonoi Shainoviqit, për t'i marrë leje. Mirëpo, më vonë, Koturi i tha se bëhej fjalë për një njeri me nivel më të lartë pushteti, dhe Ciaglinski mendoi se bëhej fjalë për Millosheviqin.⁸⁴² Si rezultat i kësaj telefonate, u pezullua sulmi në mënyrë që personeli i KVM-së të hynte në fshat dhe të merrte bujkun.⁸⁴³ Sipas Ciaglinski-t, ky ishte rasti kur ai dhe Drewienkiewicz-i e kuptuan për herë të parë se Llonçari nuk kishte pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime të caktuara në lidhje me KVM-në dhe se i duhej të këshillohej rregullisht me Beogradin, ku përfaqësuesi kryesor i Komisionit ishte Shainoviqi.⁸⁴⁴ Nuk ka rëndësi nëse ishte Shainoviqi apo Millosheviqi personi të cilin kontaktoi Llonçari, duke qenë se ata mbanin lidhje të rregullta me njëri-tjetrin.

392. Ciaglinski dha një shembull tjetër të pushtetit të Shainoviqit mbi ngjarjet në Kosovë, sikurse tregohet gjatë dy takimeve që pati me Llonçarin më 24 dhjetor 1998. Në takimin e parë, Ciaglinski u ankua për mungesën e informacionit që i kalohej KVM-së lidhur me lëvizjet e trupave. Në takimin e dytë, i cili u zhvillua pas rreth dy orësh, Llonçari tha se kishte folur me Pavkoviqin dhe se

⁸³⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 49; Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 qershor 2000), para. 109–111.

⁸³⁹ Dushan Llonçar, T. 7622–7623 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 49.

⁸⁴⁰ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 49; Karol John Drewienkiewicz, T. 7786–7790 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 qershor 2000), para. 111.

⁸⁴¹ Sipas Ciaglinski-t, Podujeva ishte një zonë e nxehtë me prani të konsiderueshme të UÇK-së dhe me shumë përplasje; Richard Ciaglinski, T. 6823 (17 nëntor 2006).

⁸⁴² Richard Ciaglinski, T. 6822–6826 (17 nëntor 2006), P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 4.

⁸⁴³ IC109 (Hartë e zonës, e shënuar nga Ciaglinski dhe që tregon vendndodhjen e forcave të ndryshme gjatë operacionit).

⁸⁴⁴ Richard Ciaglinski, T. 6825–6828 (17 nëntor 2006), P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 4–5.

tani do të rregullohej kalimi i informacionit. Mirëpo, Llonçari tha se kjo mbetej ende për t'u konfirmuar në një takim tjetër po atë mbrëmje, me Walker-in dhe Shainoviqin dhe komandantin e MPB-së. Sipas Ciaglinski-t, kjo tregonte se Llonçari mund të ndikonte vetëm në “çështjet lokale” dhe se çdo gjë që kishte të bënte me politikën duhej të kalonte në Beograd përmes Shainoviqit.⁸⁴⁵

393. Wolfgang Petritsch-i dëshmoi për një incident tjetër në fillim të muajit janar 1999, kur nëntë ushtarë të UJ-së i mori peng UÇK-ja dhe, si kundërpërgjigje, UJ-ja arrestoi një grup luftëtarësh të UÇK-së. Petritsch-it i kërkuan të ndërmjetësonte për të mundësuar lirin e të dy grupeve, gjë të cilën ai e bëri duke negociuar me Shainoviqin.⁸⁴⁶ Mirëpo, Petritsch-i konfirmoi se, edhe pse negociatori me të cilin kishte të bënte ishte Shainoviqi, ka shumë të ngjarë që vendimin përkatës për lirin e luftëtarëve të UÇK-së ta ketë marrë vetëm Millosheviqi. Në fakt, Shainoviqi e bëri të ditur qartë se kishte ndodhur kështu.⁸⁴⁷ Petritsch-i shtoi se Shainoviqi duhet t'a ketë bindur Millosheviqin, që të merrte vendim pozitiv, çka ishte një lëvizje konstruktive.⁸⁴⁸ Këtë incident e përmendi edhe Drewienkiewicz-i. Ai tha se u dërguan disa verifikues në kampin e UÇK-së për t'u siguruar që ushtarët e UJ-së ishin shëndoshë e mirë. Gjatë kohës që verifikuesit ndodheshin pranë UÇK-së, KVM-ja u informua se forcat speciale të RFJ-së/Serbisë po kalonin në një pozicion nga i cili mund të përpiqeshin t'i shpëtonin ushtarët. I shqetësuar për sigurinë e ekipit të tij, Drewienkiewicz-i dha urdhër menjëherë që ata të ktheheshin dhe kontaktoi ambasadorin francez, i cili, nga ana e tij, foli me Shainoviqin. Sipas Drewienkiewicz-it, Shainoviqi e siguroi ambasadorin se “çfarëdo që po mendohej do të mbahej pezull” dhe se ishte i kënaqur me vazhdimin e negociatave.⁸⁴⁹ Në këtë incident u angazhua edhe Llonçari, i cili dëshmoi se ndenji në zyrë dy net dhe një ditë në kontakt të vazhdueshëm me Drewienkiewicz-in. Në fund, u bë shkëmbimi i nëntë ushtarëve të UJ-së kundrejt 28 ushtarëve të UÇK-së.⁸⁵⁰

394. Edhe Ciaglinski e përmendi incidentin e mësipërm dhe dëshmoi për një takim të datës 6 janar 1999 ku KVM-ja kërkoi t'i jepej leja të vizitonte pjesëtarët e burgosur e UÇK-së, të cilët po mbaheshin në një burg ushtarak në Nish. Shainoviqi tha se kjo gjë mund të rregullohej, por se duheshin ndjekur disa procedura të caktuara. Pas rreth 10 ditësh Ciaglinski mori një telefonatë nga

⁸⁴⁵ Richard Ciaglinski, P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 5–6.

⁸⁴⁶ Wolfgang Petritsch, P2793 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 7240–7241, P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 7.

⁸⁴⁷ Wolfgang Petritsch, P2793 ((transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 7241, 7296.

⁸⁴⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10946 (2 mars 2007).

⁸⁴⁹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7742–7745 (4 dhjetor 2006). *Shih edhe* 2D181 (korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së lidhur me bisedimet midis Zhivadin Jovanoviqit dhe Knut Vollebaek-ut, 13 janar 1999), f. 4.

⁸⁵⁰ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 82. *Shih edhe* Shaun Byrnes, T. 12138–12140 (16 prill 2007); Richard Ciaglinski, T. 6891 (20 nëntor 2006); Michael Phillips, T. 11884–11886 (19 mars 2007); 2D20 (pjesë nga fletoret e Phillips-it).

Llonçari, i cili e informoi se vetëm atij i jepej leja për t'i vizituar të burgosurit. Sikurse thuhet më lart, Shainoviqi u angazhua nga afër në organizimin e lirim të po atyre të burgosurve.⁸⁵¹ Kjo i tregoi Ciaglinski-t se Shainoviqi “gëzonte shumë respekt mes serbëve të tjerë dhe se ishte një njeri mbresëlënës që mbante në duar frerët e mbledhjeve, një udhëheqës shumë i efektshëm”.⁸⁵² Sipas mendimit të Ciaglinski-t, nuk kishte dyshim që Shainoviqi fliste në emër të qeverisë së RFJ-së në Beograd.⁸⁵³ Dhoma vëren se, në dosjen gjyqësore përfundimtare, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se ky nuk është një shembull i influencës së Shainoviqit, por thjesht ilustron se ai ishte një “subjekt i ekspozuar i shtetit të RFJ-së kundrejt të gjithë përfaqësuesve të huaj, në lidhje me KVM-në”.⁸⁵⁴

395. Një incident tjetër, pasojat e të cilit Shainoviqi i administroi nga afër, ishte ai i Reçakut, më 15 janar 1999. Sipas Llonçarit, i cili nuk u angazhua personalisht për shkak të ndjeshmërisë së skajshme politike të këtij incidenti, Shainoviqin e informuan për incidentin Pavkoviqi dhe Llukiqi.⁸⁵⁵ Llonçari mësoi për herë të parë për këtë incident nga Drewienkiewicz-i, një ditë pasi ndodhi. Llonçari i telefonoi menjëherë Llukiqit, i cili i tha se në të vërtetë kishte pasur një operacion, se kishte pasur të vrarë në të dy krahët dhe se operacioni ishte në zhvillim e sipër. Llonçari pyeti nëse ishte informuar Shainoviqi dhe përgjigja ishte pohuese.⁸⁵⁶ Megjithatë, ai i telefonoi Shainoviqit për ta informuar për incidentin dhe për t'i thënë se ishte i zemëruar që kishte marrë vesh për të nga KVM-ja dhe jo nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë. Shainoviqi i tha se ai ishte vënë në dijeni për situatën qysh më parë, por nuk tha asgjë lidhur me ankesën e Llonçarit.⁸⁵⁷

396. Phillips-i dëshmoi se natyra dhe shpeshësia e takimeve të tij javore me Shainoviqin ndryshuan pas incidenteve të Podujevës. Përpara incidentit të Reçakut, këto mbledhje kishin një natyrë armiqësore dhe, pas këtij incidenti, ato u ndërprejnë fare. Shainoviqi ishte i pranishëm në secilën prej mbledhjeve javore, me përjashtim të mbledhjes së fundit përpara incidentit të Reçakut. U bënë përpjekje për ta ftuar në mbledhje, mirëpo nuk arritën ta kontaktonin. Në vend të tij, mori pjesë Llonçari.⁸⁵⁸

397. Gjatë intervistës me Prokurorinë, Shainoviqit iu bënë pyetje lidhur me trajtimin që i kishte bërë Reçakut. Ai tha se më 15 janar 1999, ndërkohë që ndodhej në Beograd, një gazetar vendas e

⁸⁵¹ Richard Ciaglinski, T. 6878–6879 (20 nëntor 2006), P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 5.

⁸⁵² Richard Ciaglinski, P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 5.

⁸⁵³ Richard Ciaglinski, P2488 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 mars 2000), f. 5.

⁸⁵⁴ Dosje Gjyqësore e Shainoviqit Përfundimtare, 29 korrik 2008 (version publik), para. 424–427.

⁸⁵⁵ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 51.

⁸⁵⁶ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 50.

⁸⁵⁷ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 55.

⁸⁵⁸ Michael Phillips, T. 11830–11831 (19 mars 2007).

kishte informuar përmes telefonit se MPB-ja kishte shkatërruar një njësi shumë të madhe terroriste në Reçak dhe se qenë vrarë rreth 100 persona.⁸⁵⁹ Shainoviqi pastaj i telefonoi Llukiqit, i cili i tha se ai kishte qenë në një betejë me terroristë dhe se për pasojë qenë vrarë 15 terroristë. Llukiqi i tha edhe se Gjorgjeviqi ndodhej në stacionin e policisë në Shtime. Atëherë, Shainoviqi i telefonoi Gjorgjeviqit për të mësuar se çfarë kishte ndodhur. Gjorgjeviqi i tha Shainoviqit të njëjtën gjë si Llukiqi, domethënë që ishte shkatërruar një grup i madh i UÇK-së.⁸⁶⁰

398. Gjithashtu Shainoviqi i shpjegoi Prokurorisë, gjithashtu, se ai nuk u përfshi në planifikimin e këtij aksioni nga MPB-ja. Gjithsesi ai ishte në dijeni se MPB-ja po përgatitej për ta “asgjësuar” atë grup të UÇK-së.⁸⁶¹ Ai vendosi të angazhohej për shkak të ndërlikimeve ndërkombëtare prej këtij incidenti. Ai nguli këmbë që një gjykatës hetues të shkonte në vendin e ngjarjes dhe të bënte një hetim.⁸⁶² Më tej, Shainoviqit iu bë pyetja se përse i shmangu lidhjet me përfaqësuesit e huaj dhe përse nuk ishte i kapshëm pas incidentit. Ai u përgjigj se Llonçari ishte në kontakt me ta sepse ai (Shainoviqi) nuk ndodhej në Prishtinë dhe se ai ishte në kontakt me Llonçarin. Shainoviqi tha, gjithashtu, se nuk e dinte që përfaqësuesit ndërkombëtarë nuk e kontaktonin dot. Llonçari duhej të shkonte në Reçak dhe të konstatonte se çfarë kishte ndodhur sepse ai ndodhej në atë kohë në Kosovë dhe sepse në çdo ngjarje të tillë ai ishte personi që shkonte në terren. Mirëpo, Llonçari nuk shkoi në terren. Në vend të kësaj, ai bëri diskutime me Drewienkiewicz-in dhe të tjerët.⁸⁶³

399. Në kontaktet e tij me Stojilkoviqin, Shainoviqi pyeti lidhur me hetimin e incidentit të Reçakut, mirëpo nuk mori asnjëherë një përgjigje. Në njërën prej mbledhjeve me Millosheviqin, disa ditë pas incidentit, Millosheviqi e kritikoi Stojilkoviqin për mënyrën se si e kishte trajtuar këtë çështje ai dhe MPB-ja. Stojilkoviqi ishte ministër në qeverinë e Serbisë dhe, si i tillë, varej zyrtarisht nga kryeministri serb, mirëpo në praktikë, ai i raportonte drejtpërdrejtë Millosheviqit.⁸⁶⁴

iv. Përfundim

400. Sikurse është thënë edhe më herët, Dhoma pranon se numri i forcave të RFJ-së/Serbisë u pakësua menjëherë pas Marrëveshjeve të Tetorit. Mirëpo, pas këtij respektimi fillestar, më vonë, rezultoi se pati shkelje siç ishte rritja e numrit të personelit dhe moskthimi i pajisjeve UJ-së nga MPB-ja. Dëshmitë nga mbledhjet e ndryshme ku mori pjesë Shainoviqi në shtator dhe tetor 1998

⁸⁵⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 722–723, 795–796, 825.

⁸⁶⁰ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 723, 725–726, 748. *Shih edhe* K86, T. 7377–7382 (27 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

⁸⁶¹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 731, 763–768.

⁸⁶² P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 735, 760, 804.

⁸⁶³ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 735–737.

⁸⁶⁴ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 807–811.

tregojnë se, ashtu sikurse udhëheqja e RFJ-së/Serbisë në përgjithësi, gjithmonë kishte një mungesë dëshire nga ana e tij për të pranuar një prani ushtarake ndërkombëtare në Kosovë dhe për t'i respektuar plotësisht kushtet e Marrëveshjeve, të cilat kërkonin pakësimin e forcave të RFJ-së/Serbisë dhe lejimin e një pranie ushtarake ndërkombëtare në krahinë. Ky qëndrim do të shihej më vonë në marrëdhëniet e tij me KVM-në, sidomos pas incidentit në Reçak.

401. Sa i takon pushtetit të Shainoviqit si Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në, Dhoma ka theksuar më parë se Millosheviqi luajti rolin kryesor në këtë emërim, faktor që i dha mundësi Shainoviqit ta zgjeronte rolin e tij si përfaqësues politik i Millosheviqit në Kosovë dhe të vazhdonte kontaktet jo vetëm me përfaqësuesit e UJ-së dhe MPB-së, por edhe me personelin e KVM-së. Si rrjedhojë Dhoma konkludon se, në cilësinë zyrtare të Kryetarit të Komisionit, Shainoviqi pati mundësi t'i vijonte marrëdhëniet e tij me zyrtarët e nivelit të lartë të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, sipas një mënyre të ngjashme me atë të vitit 1998. Me fjalë të tjera, marrëdhëniet e tij me Pavkoviqin dhe Llukiqin dhe ndikimi i tij te këta të fundit vijoi pa ndërprerje. Provat e mësipërme tregojnë, gjithashtu, se ai ishte më shumë se thjesht “një subjekt i ekspozuar i RFJ-së”, sikurse argumenton Mbrojtja e Shainoviqit, duke qenë se ai vijoi të demonstronte pushtet mbi të gjithë përfaqësuesit e UJ-së dhe MPB-së me të cilët pati lidhje. Në veçanti, ngjarjet e lidhura me incidentet në Podujevë dhe Reçak tregojnë se ai ishte në kontakt të rregullt me Llukiqin dhe Pavkoviqin, se ai ishte në gjendje të ushtronte ndikim mbi ta dhe se ishte në dijeni të operacioneve të afërta të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së. Dhoma vëren se ky përfundim nuk komprometohet nga fakti se të gjitha veprimtaritë e Shainoviqit gjatë kësaj periudhe mund të shihen si pjesë e rolit të tij zyrtar pranë Komisionit. Kjo, sepse këtu është natyra, dhe jo burimi i pushtetit të tij që ka rëndësi. Ky përfundim i Dhomës nuk komprometohet as nga fakti se, në këtë rol, Shainoviqi ndonjëherë ndihmoi edhe KVM-në.

d. Shainoviqi në Rambuje

402. Prokuroria pretendon se sjellja negative e delegacionit të RFJ-së/Serbisë gjatë bisedimeve të Rambuje dhe Paris dukej “qartë se ishte rezultati i udhëzimeve të Millosheviqit”, dhe se, përmes transmetimit të këtyre udhëzimeve, Shainoviqi ndihmoi në mosarritjen e një marrëveshjeje.⁸⁶⁵ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se Shainoviqi ishte thjesht një anëtar i delegacionit të RFJ-së/Serbisë në Rambuje, i cili drejtohej nga Ratko Markoviqi dhe të cilit Kuvendi Kombëtar

⁸⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 688.

serb i kishte dhënë një mandat të qartë dhe të kufizuar. Krahas kësaj, puna e delegacionit mbikëqyrej nga qeveria e RFJ-së.⁸⁶⁶

403. Është i pakundërshtueshëm fakti që Shainoviqi mori pjesë në bisedimet e Rambujesë si anëtar i delegacionit të RFJ-së/Serbisë, i cili zyrtarisht kryesohej nga Ratko Markoviqi.⁸⁶⁷ Mirëpo, sipas Wolfgang Petritsch-it dhe Jan Kickert-it, Shainoviqi konsiderohej nga negociatorët ndërkombëtarë si kreu politik i delegacionit, edhe pse titullin e kreut të delegacionit e mbante Markoviqi.⁸⁶⁸ Veton Surroi e konsideroi Shainoviqin si udhëheqësin politik të delegacionit, edhe pse, nga këndvështrimi juridik, personi i ngarkuar me drejtimin e negociatave të drejtpërdrejta qe Markoviqi.⁸⁶⁹ Madje, kur Surroi e vuri në dyshim rëndësinë e ekipit negociues jugosllav/serb, Hill-i i tha se Shainoviqi ishte njeriu më i besuar i Millosheviqit.⁸⁷⁰ Surroi e interpretoi rolin e Markoviqin si atë të një eksperti juridik të çështjeve kushtetuese, ndërsa Shainoviqi ishte përgjegjës për përfaqësimin e interesave politike dhe për kontaktet me Beogradin dhe me vetë Millosheviqin.⁸⁷¹ Surroi tha se “në çdo situatë të krijuar gjatë negociatave”, as Shainoviqi, as Markoviqi, nuk kishin kompetenca vendimmarrëse, por kishin vetëm të drejtën të këshilloheshin me Millosheviqin.⁸⁷²

404. Nga ana tjetër, dëshmitarët e thirrur nga Mbrojtja dëshmuan se Shainoviqi ishte përfshirë në delegacion për shkak të postit të tij si zëvendëskryeministër dhe të përgjegjësive të tij lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar. Zoran Angjelkoviqi dëshmoi se ata mendonin se duhej fuqizuar delegacioni dhe, për këtë arsye, ai vetë e propozoi përfshirjen e Shainoviqit.⁸⁷³ Zhivadin Jovanoviqi dëshmoi se Shainoviqi mori pjesë në bisedime sepse ai ishte personi me më shumë njohuri për diplomacinë dhe veprimtaritë e ndryshme ndërkombëtare të lidhura me problemin e Kosovës, sepse ai kishte më shumë lidhje me të huajt se të tjerët dhe sepse ai ishte Kryetari i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në.⁸⁷⁴

⁸⁶⁶ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 440–454.

⁸⁶⁷ P967 (Vendim i qeverisë serbe për emërimin e delegacionit të Rambujesë, 4 shkurt 1999). *Shih edhe* Momir Bullatoviç, T. 13845–13846 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviç, T. 14053 (20 gusht 2007).

⁸⁶⁸ Jan Kickert, T. 11259 (7 mars 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10717 (28 shkurt 2007), T. 10746 (1 mars 2007). *Shih* 1D97 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar ambasadorëve Hill, Petritsch, Mayorski, Ankesë për dokumentet jo të miratuara nga Grupi i Kontaktit, 22 shkurt 1999); P967 (Vendim i qeverisë serbe për emërimin e delegacionit të Rambujesë, 4 shkurt 1999).

⁸⁶⁹ Veton Surroi, T. 4544 (10 tetor 2006).

⁸⁷⁰ Veton Surroi, T. 4547 (10 tetor 2006), P2361 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 gusht 2001), f. 8.

⁸⁷¹ Veton Surroi, T. 4585 (10 tetor 2006).

⁸⁷² Veton Surroi, P2362 (transkripti i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 3399–3400.

⁸⁷³ Zoran Angjelkoviç, T. 14661 (30 gusht 2007).

⁸⁷⁴ Zhivadin Jovanoviç, T. 14053 (20 gusht 2007).

405. Prej dëshmime del se Shainoviçi komunikonte me Millosheviçin gjatë bisedimeve të Rambujesë dhe se kërkonte udhëzime prej tij. Sipas Petrirtsch-it, ecuria e negociatave të Rambujesë varej nga Millosheviçi dhe, sa herë që kishte një problem, delegacionit të RFJ-së/Serbisë i kërkohet që t'i telefononte Millosheviçit për të marrë miratim dhe direktiva të mëtejshme.⁸⁷⁵ Kur negociatat arritën një pikë kritike, Shainoviçi mori leje për t'u larguar nga kështjella ku po mbaheshin bisedimet, ku qenë ngujuar pjesëmarrësit, për të shkuar në Beograd që të këshillohej me Millosheviçin.⁸⁷⁶ Sipas mendimit të Petrirtsch-it, Shainoviçit iu dha leja të largohej sepse "nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për t'i realizuar negociatat pa miratimin e Millosheviçit".⁸⁷⁷ Surroi dëshmoi se Hill-i u shpjegoi se bëhej fjalë për një këshillim të ngutshëm i cili lipsej të bëhej kokë më kokë midis Shainoviçit dhe Millosheviçit.⁸⁷⁸ Një anëtar tjetër i delegacionit, Zhivadin Jovanoviçi, shpjegoi se udhëtimi i Shainoviçit në Beograd u nxit nga fakti se delegacionit iu kërkua të deklaronte qëndrimin e vet dhe të pranonte disa zgjidhje të caktuara të cilat nuk u përmbaheshin dhjetë parimeve të Grupit të Kontaktit. Jovanoviçi i tha Dhomës, gjithashtu, se ai foli me Shainoviçin kur ky i fundit ndodhej në Beograd, sikurse edhe Millosheviçi dhe Bullatoviçi. Sipas Jovanoviçit, gjatë këtyre diskutimeve u arritën dy përfundime, konkretisht se bisedimet në Rambuje duhej të vazhdonin dhe se diplomatët e RFJ-së duhej të fillonin të siguronin mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me dhjetë parimet.⁸⁷⁹

406. Ratko Markoviçi dëshmoi se, si kryetari zyrtar i delegacionit në Rambuje, ai nuk kishte asnjë kompetencë lidhur me anëtarët e delegacionit. Secili anëtar i delegacionit qe një figurë autonome. Kur Shainoviçi shkoi në Beograd për të folur me Millosheviçin, ai nuk ishte i detyruar t'i raportonte Markoviçit dhe as Markoviçi nuk kishte të drejtën t'i kërkonte të raportonte. Sipas Markoviçit, si zëvendëskryeministër i Qeverisë Serbe, ishte e papërshtatshme që ai t'i bënte pyetje zëvendëskryeministrit të Qeverisë Federale.⁸⁸⁰ Duke u mbështetur te dëshmia e Jovanoviçit dhe Markoviçit, Mbrojtja e Shainoviçit, në dosjen e saj gjyqësore përfundimtare, argumenton se, në vend që të theksohet fakti se Shainoviçi shkoi të takohej me Millosheviçin, fakti i rëndësishëm në

⁸⁷⁵ Wolfgang Petrirtsch, P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 4.

⁸⁷⁶ Veton Surroi, T. 4544–4545, 4586 (10 tetor 2006); Wolfgang Petrirtsch, P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 4.

⁸⁷⁷ Wolfgang Petrirtsch, P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 4.

⁸⁷⁸ Veton Surroi, T. 4596 (10 tetor 2006), P2362 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 3406–3407.

⁸⁷⁹ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14055–14056 (20 gusht 2007), T. 14120–14121 (21 gusht 2007); *Shih edhe* Ratko Markoviçi, T. 13542–13546 (14 gusht 2007).

⁸⁸⁰ Ratko Markoviçi, T. 13543–13545, 13553–13554 (14 gusht 2007); *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviçin, T. 14055 (20 gusht 2007).

lidhje me këto ngjarje ishte se bisedimet midis Shainoviqit dhe Millosheviqit ndihmuan në vijimin e negociatave.⁸⁸¹

407. Kjo konfirmohet nga Petritsch-i, i cili e përshkroi Shainoviqin si anëtarin “më të arsyeshëm” të delegacionit serb në Rambuje dhe si një person me të cilin kishte vendosur një marrëdhënie të mirë pune. Gjatë mbledhjeve në Rambuje, Shainoviqi “i hyri në punë”. Petritsch-i kishte përshtypjen se Shainoviqi mbante vesh dhe përpiqej t’u jepte përgjigje kërkesave që bënte bashkësia ndërkombëtare. Petritsch-i deklaroi se takimet e tyre zhvilloheshin në një atmosferë shumë të këndshme.⁸⁸² Si shembull për këtë, ai solli ngjarjet e datës 23 shkurt 1999, kur Ratko Markoviqi nisi një letër ku bënte të ditur se negociatat kishin dështuar. Atëherë, Petritsch-i u takua me Shainoviqin dhe i tha se letra do të konsiderohej si fundi i bisedimeve të Rambujesë. Pas disa orësh, mbërriti një letër tjetër, ku bëhej e ditur se delegacioni jugosllav/serb do të ishte i gatshëm të vijonte negociatat dhe ku bihej dakord për të diskutuar për kuadrin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, pa e kufizuar atë vetëm me prani civile. Pas dy orësh të tjera, mbërriti një letër e tretë, ku bihej dakord për të njëjtën gjë, por ku theksohej gjithashtu tërësia territoriale dhe sovraniteti i RFJ-së.⁸⁸³

408. Shaun Byrnes, i cili mori pjesë në negociatat e mëpasshme në Paris, i tha Dhomës se kishte bërë disa biseda me Shainoviqin atje. Byrnes-i kujtoi një bisedë, në të cilën i tha Shainoviqit se NATO nuk po bënte bluf, se nuk kishte gjasa që RFJ-ja të arrinte një marrëveshje më të mirë se ajo e ofruar në Rambuje dhe se lipsej që delegacioni jugosllav/serb të ishte më elastik. Më tej Byrnes-i tha:

Dhe më kujtohet qartë se si zoti Shainoviq qëndronte ulur, i menduar, dhe kur, më në fund, iu përgjigj pyetjes sime, duke thënë pak a shumë se nuk kishte kompetencë për të qenë aq elastik, se Beogradi i kishte vënë shumë kufizime dhe se, tekefundit, në këtë drejtim nuk mund të bënte asgjë, donte apo nuk donte ai. Pyetje: Me fjalë të tjera, pajtoheni me mua nëse them se Shainoviqi bëri maksimumin për të qenë elastik, domethënë ai vetë, por se, mesa duket qartë, ishte i kufizuar prej pushtetit aktual në Beograd. Mos po përpiqeni të thoni këtë? Përgjigje: Ajo që do të thosha është, së pari, se unë nuk ndodhesha në pozitat e zotit Shainoviq. Rrjedhimisht, nuk e di nëse bëri apo jo maksimumin. Ai më tha që po. Në themel të saj, unë këtë e besoj. Unë u besova fjalëve të tij.⁸⁸⁴

⁸⁸¹ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 529–534.

⁸⁸² Wolfgang Petritsch, T. 10945 (2 mars 2007).

⁸⁸³ Wolfgang Petritsch, T. 10747–10748 (1 mars 2007), T. 10930–10934 (2 mars 1999), P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 4; P625 (Letër drejtuar Hill-it, Petritsch-it dhe Mayorski-t, nënshkruar nga Ratko Markoviqi, 23 shkurt 1999). *Shih edhe* 1D18 (Marc Weller: “Crisis in Kosovo” (Kriza në Kosovë)), version elektronik, f. 466.

⁸⁸⁴ Shaun Byrnes, T. 12191 (16 prill 2007).

Përshtypja vetjake e Byrnes-it ishte se, kur Shainoviçi përmendi pushtetin e lartë, faktikisht e kishte fjalën për Millosheviçin.⁸⁸⁵

409. Dhoma kujton këtu përfundimet e saj në lidhje me negociatat e Rambujesë, sipas të cilave të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë edhe negociatorët ndërkombëtarë, ishin përgjegjës për dështimin e negociatave. Dhoma kujton edhe dëshmitë e Petrutsch-it dhe Byrnes-it se Shainoviçi ishte një negociator i arsyeshëm, por se ai ishte i kufizuar nga Beogradi. Pra, dëshmitë nuk tregojnë që Shainoviçi ta ketë penguar procesin e Rambujesë. Megjithatë, dëshmitarët konfirmojnë edhe një herë faktin se në atë kohë Shainoviçi ishte njëri prej bashkëpunëtorëve më të afërt të Sllobodan Millosheviçit dhe, faktikisht ishte anëtari më i lartë dhe me më shumë influencë në delegacionin e Rambujesë.

e. Kontaktet e Shainoviçit me Rugovën

410. Dhoma ka dëgjuar dëshmi se gjatë fushatës së NATO-s, njëra prej detyrave të Shainoviçit ishte vendosja e lidhjeve dhe dialogut politik me udhëheqësin e LDK-së, Ibrahim Rugovën. Sikurse është thënë më herët, Dhoma konstaton se Rugova ishte në arrest shtëpie gjatë këtyre kontakteve.⁸⁸⁶ Mendimi i Prokurorisë është se, përmes realizimit të këtyre takimeve me Rugovën, Shainoviçi u angazhua në një fushatë propagandistike për të krijuar përshtypjen se autoritetet e RFJ-së/Serbisë qenë të gatshme të takoheshin me shqiptarët kosovarë, kur, në të vërtetë, shqiptarët kosovarë po dëboheshin në kuadër të planit kriminal që pretendon Prokuroria.⁸⁸⁷ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Shainoviçit e mohon këtë akuzë dhe argumenton se Shainoviçi thjesht po përpiqej të ringjallte procesin politik.⁸⁸⁸

411. Sipas vetë Shainoviçit dhe dëshmitarëve të paraqitur nga Mbrojtja e Shainoviçit, këto marrëdhënie filluan në muajin prill 1999, kur u mbajtën disa takime në të cilat Rugova dhe Shainoviçi ranë dakord të punonin së bashku për një proces politik për të zgjidhur çështjet e Kosovës dhe për t'i rikthyer të shpërngulurit në shtëpitë e tyre.⁸⁸⁹ Këto angazhime u mbështetën më 6 prill si nga qeveria e RFJ-së, po ashtu edhe nga ajo serbe.⁸⁹⁰ Momir Bullatoviçi dëshmoi se, disa ditë pasi qeveria federale dhe ajo serbe e kishin informuar publikun ndërkombëtar për

⁸⁸⁵ Shaun Byrnes, T. 12231 (17 prill 2007).

⁸⁸⁶ *Shih* Kapitullin V.

⁸⁸⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 668.

⁸⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 810–826.

⁸⁸⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 842, 871; Momir Bullatoviçi, T. 13849–13850 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviçi, T. 14066–14069 (20 gusht 2007); Velko Odaloviçi, T. 14425–14426 (27 gusht 2007); Millomir Miniçi, T. 14757 (31 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçi, T. 14661–14662 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviçi, T. 14599–14600 (29 gusht 2007).

⁸⁹⁰ 1D36 (Deklaratë e Përbashkët e Qeverisë Federale dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, 6 prill 1999); Momir Bullatoviçi, T. 13851–13852 (17 gusht 2007).

mundësinë e nisjes së një dialogu të qenësishëm me Rugovën dhe për zgjidhjen e çështjes më të rëndësishme në Kosovë, e cila ishte kthimi i të shpërngulurve, ndodhën sulmet ajrore më të ashpra të NATO-s kundër objektivave civile në Kosovë. Sipas Bullatoviqit, bisedimet u penguan nga sulmet e NATO-s. Shainoviqi u kthye në Beograd dhe rinisi detyrat e tij si zëvendëskryeministër.⁸⁹¹ Adnan Merovci e konfirmoi pjesëmarrjen e Shainoviqit në këto diskutime. Mirëpo, ai dëshmoi se mbërritja e forcave të MPB-së dhe UJ-së në banesën e Rugovës më 31 mars 1999 qenë fillimi i një periudhe arresti shtëpiak pesëjavësh për atë dhe për Rugovën, periudhë gjatë së cilës erdhi për t'i takuar Shainoviqi.⁸⁹²

412. Shainoviqi u prezantua për herë të parë me Rugovën më 1 prill, gjatë një takimi midis Millosheviqit dhe Rugovës. Transmetimi i një kronike në televizion për këtë takim shkaktoi një valë reagimi në publik, sepse shumë njerëz kujtonin se Rugova kishte vdekur. Merovci kërkoi që atij dhe Rugovës t'u lejohej të largoheshin nga Kosova, në mënyrë që të konsultoheshin me ndihmësit e Rugovës dhe që të "vendoseshin në kontakt me persona kyç". Kur u kthye në Prishtinë, Merovci i shkroi edhe një herë Millosheviqit, duke ngulur këmbë që t'u jepej leja të shkonin jashtë vendit.⁸⁹³ Më 4 prill 1999, Shainoviqi shkoi për herë të parë në shtëpinë e Rugovës, në përpjekje për ta bindur që të takohej me Ratko Markoviqin. Sipas asaj që dinte Merovci, Markoviqi nuk ishte një person i cili mund t'i ndihmonte në situatën e tyre. Përkundrazi, ai mendonte se udhëheqja e shtetit po përpiqej t'i tregonte bashkësisë ndërkombëtare se kishte një proces negociatash në zhvillim e sipër, ekzistenca e të cilit mund të ndihmonte në ndalimin e bombardimeve të NATO-s.⁸⁹⁴ Lubivoje Joksiqi, i cili ishte ndihmëskoordinator i RDB-së në kohën në fjalë, dëshmoi se shefi i RDB-së i kërkoi të organizonte masat e sigurisë për këtë takim midis Shainoviqit dhe Rugovës, si edhe për takimet e mëpasshme midis tyre. Joksiqi që i pranishëm në shumicën e këtyre bisedimeve dhe dëshmoi se Shainoviqi transmetonte "mesazhe të një natyre të përgjithshme politike", që thoshin se "duhet bërë gjithçka për t'i ndaluar sulmet ajrore", se duhej diskutuar për organizimin e qeverisë në Kosovë dhe se "duhej të ktheheshin të gjithë të shpërngulurit dhe refugjatët e të gjitha përkatësive etnike që kishin jetuar në Kosovë më parë".⁸⁹⁵ Sipas Joksiqit, atmosfera e këtyre takimeve ishte "një atmosferë besimi reciprok".⁸⁹⁶ Mirëpo,

⁸⁹¹ Momir Bullatoviq, T. 13852–13853 (17 gusht 2007).

⁸⁹² Adnan Merovci, T. 8438–8450 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 54–62.

⁸⁹³ Momir Bullatoviq, T. 13850 (17 gusht 2007); Ibrahim Rugova, P2613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 nëntor 2001), f. 11–12; Adnan Merovci, P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 58–59. *Shih edhe* 2D300 (Njoftim nga mbledhja e Qeverisë së RFJ-së, 2 prill 1999).

⁸⁹⁴ Adnan Merovci, T. 8462–8464 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 62.

⁸⁹⁵ Lubivoje Joksiq, T. 21989–21991 (8 shkurt 2008), T. 22064–22065 (11 shkurt 2008).

⁸⁹⁶ Lubivoje Joksiq, T. 21991 (8 shkurt 2008). Joksiqi dëshmoi, gjithashtu, se Shainoviqi u takua dy herë me Merovcin, pa praninë e Rugovës, por nuk i kujtohej nëse kishte qenë i pranishëm gjatë bisedimeve. Lubivoje Joksiq, T. 21998 (8 shkurt 2008).

Dhoma vëren se e gjykon Joksiqin të pabesueshëm për shkak të versionit të tij në lidhje me arrestin në shtëpi të Rugovës.⁸⁹⁷

413. Më 5 prill 1999, Shainoviqi shkoi përsëri për vizitë në banesën e Rugovës, sipas Merovcit, për të diskutuar për çështjen e gjetjes së ndihmësve të Rugovës dhe për largimin e Rugovës dhe Merovcit nga Kosova. Gjatë takimit, Shainoviqi tha se Merovci ishte i lirë të shkonte në Maqedoni, por tha se “nuk mund t’i garantojnë sigurinë”.⁸⁹⁸ Merovci e mori këtë paralajmërim më shumë si një kërcënim për sigurinë e tij, nëse vendoste të largohej.⁸⁹⁹ Pas këtij takimi, doli një deklaratë e përbashkët, ku deklarohet gatishmëria e Shainoviqit dhe Rugovës për të punuar së bashku për procesin politik dhe për kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre.⁹⁰⁰ Gjatë kontakteve të Merovcit me Shainoviqin, Shainoviqi i thoshte vazhdimisht se i duhej të fliste me Beogradin, sa herë që i bënin ndonjë kërkesë. Kur Merovci e pyeti Shainoviqin se me cilin i duhej të fliste në Beograd dhe kur e pyeti se mos ky person ishte Millosheviqi, Shainoviqi i ishte përgjigjur me një lëvizje pohuese të kokës.⁹⁰¹ Joksiqi e konfirmoi pjesërisht këtë provë, kur dëshmoi se Shainoviqi gjithmonë mezi priste të kthehej në Beograd, sapo mbaronte bisedën me Rugovën, edhe sikur të ishte natë dhe situatë e pasigurtë.⁹⁰²

414. Më 9 prill 1999 u zhvillua një takim tjetër me Rugovën, në të cilin krahas Shainoviqit, mori pjesë edhe Ratko Markoviqi. Rugova ritheksoi kërkesën e tij që të plotësoheshin kushtet e NATO-s dhe që ai dhe stafi i tij të lejoheshin të shkonin jashtë vendit. Vizitorët ngulën këmbë që Rugova t’i kërkonte NATO-s të ndalonte fushatën e bombardimit.⁹⁰³ Në një takim tjetër, më 13 prill 1999, Shainoviqi i propozoi Rugovës të takohej me Millutinoviqin. Sipas Merovcit, Rugova nuk kishte zgjedhje tjetër përveçse të binte dakord për këtë takim.⁹⁰⁴ Takimi u zhvillua më 16 prill 1999, në ndërtesën e Presidencës Serbe në Beograd, me pjesëmarrjen e Millutinoviqit, Shainoviqit, Rugovës dhe Merovcit. Rugova dhe Merovci u informuan se Merovcit do t’i lejohej të shkonte në Shkup të takohej me ndihmësit e Rugovës. Në përfundim të takimit, Shainoviqi i dha udhëzime se çfarë të thoshte në Shkup dhe se nuk duhej të thoshte se Rugova dhe Merovci qenë në arrest. Gjithashtu Merovci u udhëzua të mos e përmendte shumë emrin e Shainoviqit dhe të ruhej nga UÇK-ja sepse ajo do të përpiqej ta vriste Merovcin. Shainoviqi tha se ishte i sigurt që Merovci do të kthehej për

⁸⁹⁷ *Shih* Pjesën VII.J.

⁸⁹⁸ Adnan Merovci, T. 8490–8491 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 64.

⁸⁹⁹ Adnan Merovci, T. 8532–8533, 8584–8585 (17 janar 2007).

⁹⁰⁰ Momir Bullatoviq, T. 13849–13851 (17 gusht 2007); 2D365 (Deklaratë e Përbashkët, 5 prill 1999). *Shih edhe* 2D303 (Deklaratë nga mbledhja e Qeverisë së RFJ-së, 8 prill 1999), e cila mbështet negociatat midis dy palëve.

⁹⁰¹ Adnan Merovci, P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 64.

⁹⁰² Lubivoje Joksiq, T. 21997 (8 shkurt 2008).

⁹⁰³ Adnan Merovci, P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 65.

⁹⁰⁴ Adnan Merovci, T. 8464–8465 (16 janar 2007).

shkak se ishte besnik i Rugovës dhe se, rrjedhimisht, ai i kishte garantuar eprorët e tij për kthimin e Merovcit.⁹⁰⁵

415. Më 28 prill 1999, në Prishtinë u zhvillua një takim tjetër midis Rugovës dhe Merovcit, nga njëra anë, dhe Millutinoviçit, Shainoviçit, Markoviçit dhe Angjelkoviçit, nga ana tjetër. Gjatë këtij takimi, Millutinoviçi tha se ai nuk e kuptonte përse po largoheshin njerëzit nga qyteti. Merovci iu përgjigj se njerëzit po i detyronin t'i linin shtëpitë e tyre dhe se apartamentin e atij vetë e kishte shkatërruar MPB-ja. Kur Millutinoviçi e pyeti Shainoviçin nëse ishte e vërtetë kjo, ai pohoi me kokë. Dikur, Merovci e përsëriti edhe një herë kërkesën e tij që atë dhe Rugovën t'i lejonin të largoheshin nga vendi. Mirëpo, Millutinoviçi u përgjigj se nuk mund ta merrnin vendimin për këtë menjëherë dhe se do t'u duheshin 24 orë.⁹⁰⁶ Në fund të këtij takimi u nënshkrua një deklaratë e përbashkët.⁹⁰⁷

416. Më në fund, Merovci, Rugovës dhe ndihmësve të tjerë të Rugovës u thanë se mund të largoheshin nga vendi. Më 4 maj 1999, Merovci shkoi së bashku me Rugovën në Beograd për një takim shumë të shkurtër me Millosheviçin, për t'u marrë me aspekte teknike dhe me organizimin e udhëtimit. Përsëri u takuan me Shainoviçin, i cili ishte i përfshirë në organizimin e nisjes së tyre. Të nesërmen, ata udhëtuan për në Itali.⁹⁰⁸ Merovci shpjegoi se, kur Rugovën e vizitonte Shainoviçi, ai trajtohej si kreu i misionit nga të gjithë personat përreth tij.⁹⁰⁹ Merovci dëshmoi edhe se, gjatë gjithë kontakteve të tij me Shainoviçin, ai bisedoi më vete me të lidhur me shkeljet në Kosovë dhe mbi përgjegjësinë e Shainoviçit për këto akte. Gjatë njëres prej këtyre bisedave, ai pyeti lidhur me Reçakun dhe Shainoviçi iu përgjigj se ishte gjithçka e sajuar nga Walker-i dhe e akuzoi KVM-në se mblidhte informata për NATO-n.⁹¹⁰

417. Duke pasur parasysh konkluzionin e Dhomës se këto kontakte me Rugovën, në të vërtetë, nuk qenë negociata të lira dhe se praktikisht u kryen në kushtet e arrestit në shtëpi, dhe duke pasur parasysh shkallën e përfshirjes së Shainoviçit në këtë veprimtari, përfshirë edhe vizitat e tij në banesën e Rugovës, Dhoma bindet se Shainoviçi u angazhua në to duke qenë në dijeni të plotë të situatës në të cilën ndodhej Rugova asokohe. Kjo, sipas mendimit të Dhomës, nuk përbënte një përpjekje për të negociuar një zgjidhje, por përkundrazi ishte një fushatë kërcënimesh kundër

⁹⁰⁵ Adnan Merovci, T. 8465–8468 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 68; Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 4234–4236. *Shih edhe* Lubivoje Joksiq, T. 21993 (8 shkurt 2008).

⁹⁰⁶ Adnan Merovci, T. 8469–8472 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 72.

⁹⁰⁷ P416 (Deklarata e Përbashkët e nënshkruar nga Rugova dhe Millutinoviçi, 28 prill 1999); Adnan Merovci, T. 8472–8474 (16 janar 2007). *Shih edhe* Lubivoje Joksiq, T. 21993 (8 shkurt 2008).

⁹⁰⁸ Adnan Merovci, T. 8475, 8479 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2000), para. 73.

⁹⁰⁹ Adnan Merovci, T. 8585–8586 (17 janar 2007).

⁹¹⁰ Adnan Merovci, T. 8475–8476 (16 janar 2007).

sigurisë vetjake të Rugovës dhe bashkëpunëtorëve të tij, e ndërmarrë për të treguar se autoritetet e RFJ-së/Serbisë po takoheshin me shqiptarët kosovarë, me shpresën se kjo do të çonte në ndalimin e fushatës së NATO-s. Shainoviqi mori pjesë në këtë fushatë me dijeni dhe vullnet të plotë.

4. Marrëdhëniet e Shainoviqit me Millosheviqin

418. Prokuroria pretendon se pushteti i Shainoviqit bazohej më së shumti në marrëdhënien e ngushtë që kishte me Millosheviqin. Krahas kësaj, pretendohet se së bashku me Miniqin ai bënte pjesë në “rrethin e brendshëm” të Millosheviqit në SPS, ku formulohej edhe politika.⁹¹¹ Nga ana tjetër, Mbrojtja argumenton se, jo vetëm që Shainoviqi nuk bënte pjesë në rrethin e brendshëm të Millosheviqit, por ai nuk luante asnjë rol të rëndësishëm brenda SPS-së në periudhën në fjalë, duke qenë se Millosheviqi e kishte liruar nga posti i nënkryetarit të partisë. Sipas Mbrojtjes së Shainoviqit, roli i tij në lidhje me partinë kryesore politike në Serbi ishte i kufizuar.⁹¹²

a. Pozita e Shainoviqit si anëtar i SPS-së

419. Siç është thënë edhe më herët,⁹¹³ në mars 1996 u mbaj Kongresi i SPS-së, në të cilin Shainoviqi u zgjodh nënkryetar i SPS-së.⁹¹⁴ Sipas Millan Jovanoviqit, i cili nga viti 1993 deri në vitin 2000 punoi si sekretar i sektorit të shërbimeve teknike të Këshillit Kryesor të SPS-së,⁹¹⁵ mendohej se gjatë Kongresit u zgjodh “një linjë e ashtuquajtur më e butë politikanësh”.⁹¹⁶ Më 24 prill 1997, Shainoviqin e larguan nga posti i nënkryetarit, me propozim të Sllobodan Millosheviqit dhe me vendim të Këshillit Kryesor. Jovanoviqi dëshmoi se Shainoviqin e larguan sepse “ai nuk i kishte përmbushur ato që priteshin prej tij në realizmin e detyrave që i kishte caktuar Kryetari i SPS-së”, por nuk i dinte hollësitë lidhur me largimin nga posti.⁹¹⁷ Mirëpo, gjatë së njëjtës seancë, kryesisht për shkak të rezultateve të mira gjatë zgjedhjeve, Shainoviqin e emëruan anëtar të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së.⁹¹⁸

420. Siç është thënë edhe më herët,⁹¹⁹ në vitin 1998 njëra prej çështjeve madhore të rendit të punës së SPS-së ishte situata e nderë në Kosovë. Për këtë arsye, në sesionin e 16-të të Këshillit

⁹¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 661–662.

⁹¹² Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 837–842.

⁹¹³ *Shih* Kapitullin IV.

⁹¹⁴ Millan Jovanoviç, T. 14197 (22 gusht 2007); P2875 (hapësira në internet e SPS-së, raport për kongresin e III të SPS-së, 3 mars 1996).

⁹¹⁵ Millan Jovanoviç, T. 14139 (21 gusht 2007);

⁹¹⁶ Millan Jovanoviç, T. 14200 (22 gusht 2007).

⁹¹⁷ Millan Jovanoviç, T. 14198 (22 gusht 2007).

⁹¹⁸ Millan Jovanoviç, T. 14198–14199 (22 gusht 2007). 2D25 (Procesverbali i sesionit të 10-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 24 prill 1997), f. 2–3.

⁹¹⁹ *Shih* Kapitullin IV.

Kryesor të SPS-së, të zhvilluar më 10 qershor 1998, u bë një diskutim i hollësishëm për situatën. Millosheviqi propozoi krijimin e një grupi pune për Kosovën, me detyrën për të bashkërenduar veprimtaritë politike të SPS-së në Kosovë.⁹²⁰ Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Kryesor dhe Shainoviqi.⁹²¹ Sipas anëtarëve të Grupit të Punës (Angjelkoviqi, Matkoviqi dhe Miniqi) veprimtaritë e Grupit të Punës ishin marrja e informacionit, zhvillimi i mbledhjeve me përfaqësues politikë dhe bisedat me njerëzit,⁹²² dhe Shainoviqi nuk ishte as epror, e as vartës i Grupit të Punës.⁹²³

421. Më 14 tetor 1998, Shainoviqi mori pjesë në një mbledhje të Komitetit Ekzekutiv, në të cilin Komiteti shprehu mbështetjen për Marrëveshjen Holbrooke-Millosheviq, pas fjalës hapëse të Millutinoviqit, në të cilën theksohej rëndësia e saj. Për Komitetin Ekzekutiv, ardhja e KVM-së do të thoshte se kërcënimi i përdorimit të forcës ishte larguar një herë e mirë.⁹²⁴ Në mbledhjen e datës 27 tetor 1998, Shainoviqi, së bashku me Millutinoviqin, Angjelkoviqin, Miniqin dhe Zhivadin Jovanoviqin, diskutuan për vënien në zbatim të Marrëveshjeve të Tetorit. Në fillim, ata i informuan të pranishmit e tjerë për bisedimet e fundit midis Millosheviqit dhe bashkësisë ndërkombëtare lidhur me vënien në zbatim. Pastaj, ata folën për hapat e marrë për të vënë në zbatim Marrëveshjet dhe për përgjegjësinë e të gjitha organeve shtetërore për vijimin e vënies në zbatim në mënyrë të organizuar. Në fund, folësit paralajmëruan lidhur me pasojat negative që mund të kishte mbajtja e një qëndrimi të shkujdesur sa i takonte vënies në zbatim, duke theksuar nevojën që të gjitha organet dhe institucionet, detyra e të cilave ishte zbatimi i marrëveshjes, të fillonin urgjentisht marrjen e hapave të nevojshëm dhe krijimin e planeve konkrete. Më tej Komiteti arriti në përfundimin se ishte e rëndësishme rritja dhe fuqizimi i “pranisë kombëtare serbe në Kosovë”, dhe theksoi nevojën për të punuar deri në maksimum për të “hyrë” në radhët e “pakicës etnike shqiptare” në mënyrë që kjo të angazhohej në të gjitha aspektet e jetës dhe punës në Kosovë si edhe për të rivendosur besimin e ndërsjellë.⁹²⁵

⁹²⁰ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 300–301.

⁹²¹ Zoran Angjelkoviq, T. 14651, 14713 (30 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviq, T. 14078–14079 (21 gusht 2007); Dushko Matkoviq, T. 14586–14587 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14742–14743 (31 gusht 2007); P1012 (Procesverbali i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998). *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 118, 125–128.

⁹²² Zoran Angjelkoviq, T. 14654–14656 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviq, T. 14591–14595 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14747–14751 (31 gusht 2007); Millan Jovanoviq, T. 14150–14151 (21 gusht 2007). *Shih edhe* P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 301, 373–374.

⁹²³ Zoran Angjelkoviq, T. 14654 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviq, T. 14588 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14752 (31 gusht 2007).

⁹²⁴ Millan Jovanoviq, T. 14167–14168 (22 gusht 2007). 2D77 (Procesverbali i sesionit të 89-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 14 tetor 1998).

⁹²⁵ Millan Jovanoviq, T. 14169–14171 (22 gusht 2007). 2D88 (Procesverbali i sesionit të 90-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 27 tetor 1998), f. 3.

b. Takimet me Millosheviqin

422. Krahas takimeve me Millosheviqin, të shtjelluara më lart, Shainoviçi pati konsultime politike javore të rregullta me të dhe me përfaqësues të tjerë nga qeveria e RFJ-së dhe qeveria e Serbisë, të cilat zhvilloheshin në zyrën e Millosheviçit.⁹²⁶ Gjatë krizës në Kosovë në vitin 1998, Shainoviçi mori pjesë në këto konsultime vetëm kur ndodhej në Beograd,⁹²⁷ dhe gjatë tyre raportonte për ecurinë e tij dhe të Grupit të Punës të SPS-së në Kosovë. Ndonjëherë, në vend të tij shkonte Miniçi, dhe, me raste, merrnin pjesë të dy.⁹²⁸

423. Sipas Shainoviçit, takimet kokë më kokë me Millosheviqin nuk qenë të zakonshme dhe bëheshin vetëm nëse këtë e kërkonte Millosheviçi kur ky donte të dëgjonte mendimin e Shainoviçit për diçka që përbënte temë të ditës.⁹²⁹ Krahas kësaj, Shainoviçi fliste me Millosheviqin në telefon kur ekzistonte ndonjë çështje e veçantë apo ndonjë arsye tjetër e veçantë. Sipas mendimit të tij, kjo nuk ishte procedurë raportimi e rregullt, por ata flisnin rreth një herë në javë. Më së shumti ishte Millosheviçi ai që i telefononte.⁹³⁰ Millosheviçi e kontaktonte për arsye të ndryshme. Për shembull, nëse gjatë një periudhe të caktuar, Shainoviçi dhe Millosheviçi duhej të takoheshin me përfaqësues të huaj, atëherë Millosheviçi i telefononte Shainoviçit për ta bashkërenduar qëndrimin e tyre dhe për ta udhëzuar në lidhje me këta përfaqësues. Ndonjëherë, Millosheviçi i telefononte për ta pyetur se çfarë mendonte për ngjarjet në Kosovë të cilat kishin rëndësi politike.⁹³¹

424. Më 24 mars 1999 u zhvillua një mbledhje konsultative politike “tek Millosheviçi” pa “njerëzit e sigurimit”.⁹³² Në fund të takimit, Shainoviçi tha se dëshironte të takohej me Angjelkoviçin për shkak të situatës së re. Po atë ditë, ai u nis për në Prishtinë dhe mbërriti në Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm pak përpara se të fillonte bombardimi nga NATO.⁹³³ Gjithashtu, gjatë fushatës së NATO-s, Shainoviçi mori pjesë në dy-tre takime me Millosheviqin dhe përfaqësuesit e republikës dhe organeve të RFJ-së, të cilët u zhvilluan kryesisht për t’i treguar publikut se udhëheqja e shtetit po punonte e bashkuar. Këto takime zgjasnin vetëm rreth dhjetë minuta.⁹³⁴

⁹²⁶ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 50, 206–207, 218–220.

⁹²⁷ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 220.

⁹²⁸ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 225–227.

⁹²⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 227, 348.

⁹³⁰ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 223–224.

⁹³¹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 377–381.

⁹³² P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 874.

⁹³³ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 873–876.

⁹³⁴ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 865.

425. Sa i takon marrëdhënies private me Millosheviqin, Shainoviqi tha se ata punuan shumë vjet bashkë, por ai nuk pati asnjë marrëdhënie private të veçantë me Millosheviqin dhe nuk bënte pjesë në rrethin e miqve të tij të ngushtë.⁹³⁵

426. Gjatë intervistës së tij, Shainoviqi nuk pranoi se kishte diskutuar për veprimtarinë e UJ-së apo të MPB-së me Millosheviqin.⁹³⁶ Duke pasur parasysh provat voluminoze për rolin e Shainoviqit si koordinator politik i veprimeve të UJ-së dhe MPB-së dhe faktin se atij iu lejua të largohej nga Rambujeja për t'u takuar me Millosheviqin, Dhoma nuk e pranon këtë pretendim. Është e paimagjinueshme që ata të mos kenë biseduar për veprimtari të tilla.

c. Përfundim

427. Duke marrë parasysh provat e shumta për takimet e ndryshme midis Shainoviqit dhe Millosheviqit, si edhe dëshmitë e dëshmitarëve të shumtë të thirrur nga Prokuroria dhe Mbrojtja lidhur me marrëdhënien midis Millosheviqit dhe Shainoviqit, Dhoma është e mendimit se Shainoviqi ishte, në të vërtetë, njëri prej bashkëpunëtorëve më të afërt dhe më të besuar të Sllobodan Millosheviqit si në vitin 1998, po ashtu edhe në vitin 1999. Kjo marrëdhënie bëri që ai të merrte një rol kryesues në mbledhjet e Komandës së Përbashkët dhe në mbledhjet e tjera të ndryshme me pjesëmarrjen e zyrtarëve të UJ-së dhe MPB-së. Kjo marrëdhënie, gjithashtu, bëri që ai të zgjidhej kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në. Këto role të ndryshme, nga ana e tyre, i mundësuan atij të funksiononte si koordinator politik i veprimtarive civile dhe ushtarake në Kosovë dhe të kishte një rol vendimmarrës lidhur me këtë krahinë.

5. Synimi kriminal i Shainoviqit në lidhje me Kosovën dhe shqiptarët kosovarë

428. Prokuroria pretendon se Shainoviqi kishte synim për ta spastruar etnikisht Kosovën në mënyrë që të mundësohej vijimësia e kontrollit të krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë dhe se ai ishte në dijeni të sjelljes përndjekëse të forcave të RFJ-së dhe Serbisë kundër shqiptarëve kosovarë përpara datës 23 mars 1999 dhe pas kësaj date.⁹³⁷

429. Në mbështetje të këtyre akuzave, Prokuroria u referohet dëshmive të Ratomir Taniqit dhe Klaus Naumann-it. Taniqi dëshmoi se ai kishte informacion nga burime të tij në RDB se

⁹³⁵ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 382–384.

⁹³⁶ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 377–381.

⁹³⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 691–694.

Shainoviqi nuk ishte i përkushtuar për një zgjidhje paqësore të problemeve në Kosovë.⁹³⁸ Duke pasur parasysh natyrën e kësaj dëshmie, Dhoma nuk e merr parasysh.

430. Naumann-i dëshmoi se ai kishte përshtypjen se Shainoviqi kishte një mospëlqim të thellë për shqiptarët kosovarë.⁹³⁹ Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Clark-Naumann më 25 tetor 1998, personat e përfshirë në të bënë një diskutim të mëtejshëm se si të arriheshin marrëdhënie më të mira midis serbëve dhe shqiptarëve kosovarë. Sipas deklaratës së parë të Naumann-it, të përgatitur në kuadër të çështjes gjyqësore të Millosheviqit, në atë kohë Millosheviqi ose Shainoviqi tha se “nëse nuk e zgjidhnin tani problemin shqiptar, jugosllavët do të kishin të njëjtin problem pas 20 vjetësh sepse shqiptarët shumoheshin me një ritëm shumë më të lartë.”⁹⁴⁰ Mirëpo, në fletinformacionin plotësues të përgatitur në kuadër të kësaj çështjeje, Naumann-i tha se ishte Shainoviqi ai që fliste për shkallën e lartë të lindshmërisë të shqiptarëve kosovarë.⁹⁴¹ Gjatë pyetjeve që i bëri Mbrojtja e Shainoviqit lidhur me këtë, ai tha se ende nuk ishte i sigurt se kush e kishte bërë këtë koment dhe tha se ky koment ishte bërë gjatë një seance plenare të plotë.⁹⁴²

431. Gjatë të njëjtit varg takimesh, Naumann-it iu kujtuan fjalët e Millosheviqit, se shqiptarët kosovarë ishin të gjithë kriminelë, vrasës dhe përdhunues dhe se një zgjidhje e këtij problemi do të gjendej gjatë pranverës së vitit 1999, domethënë që do t’i grumbullonin dhe do t’i vrisnin, siç kishin vepruar në Drenicë pas Luftës së Dytë Botërore.⁹⁴³ Kjo deklaratë nuk shkaktoi asnjë reagim tek ata që e dëgjuan dhe “ky ishte, në shumicën e rasteve, qëndrimi i zakonshëm i tyre, pra që nuk thoshin asgjë kur fliste [Millosheviqi]”.⁹⁴⁴ Shainoviqi nuk ishte i pranishëm kur u bë kjo deklaratë.⁹⁴⁵ Në intervistën e tij me Prokurorinë, Shainoviqi e konfirmoi pjesëmarrjen e tij në këtë mbledhje, por as i përmendi dhe as e pyetën për deklaratat për të cilat dëshmoi Naumann-i.⁹⁴⁶

432. Mbrojtja e Shainoviqit e kundërshton dëshminë për deklaratën lidhur me shkallën e lartë të lindshmërisë, mbështetur në faktin se Naumann-it nuk i kujtohet se kush e bëri këtë deklaratë dhe duke argumentuar se nuk e bëri Shainoviqi. Gjithashtu, edhe nëse kjo është thënë në prani të Shainoviqit, Naumann-i dëshmoi se të pranishëm qenë shumë persona. Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes së Shainoviqit, nuk ka prova që Shainoviqi të ketë marrë pjesë në këtë diskutim apo të

⁹³⁸ Ratomir Taniq, T. 6325–6326, 6335 (10 nëntor 2006).

⁹³⁹ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervista me Prokurorinë), para. 26.

⁹⁴⁰ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervista me Prokurorinë), para. 29.

⁹⁴¹ Klaus Naumann, P2561 (fletinformacion plotësues, datë 7 dhjetor 2006), f. 2.

⁹⁴² Klaus Naumann, T. 8374–8375 (14 dhjetor 2006), P1767 (shënimet nga intervista me Prokurorinë), para. 29.

⁹⁴³ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervista me Prokurorinë), para. 24, P2561 (fletinformacion plotësues, datë 7 dhjetor 2006), f. 2. P2512 (transkript i *Prokuroria kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 6989–6992.

⁹⁴⁴ Klaus Naumann, T. 8258–8263 (13 dhjetor 2006).

⁹⁴⁵ Klaus Naumann, P2561 (fletinformacion plotësues, datë 7 dhjetor 2006), f. 2.

ketë dëgjuar se çfarë është thënë në të. Edhe sikur të kishte marrë pjesë në diskutim apo të kishte dëgjuar se çfarë është thënë në të, kjo nuk tregon asgjë lidhur me qëndrimin e tij personal për këtë çështje. Mbrojtja e Shainoviçit e kundërshtoi edhe atë pjesë të dëshmisë së Naumann-it lidhur me Drenicën, duke theksuar faktin se ai nuk mund ta konfirmonte praninë e Shainoviçit kur është thënë kjo deklaratë.⁹⁴⁷

433. Michael Phillips dëshmoi se, gjatë një prej takimeve të tyre në muajin nëntor 1998, Shainoviçit shprehu mendimin se shqiptarët etnikë nuk e kishin vendin në Kosovë, duke thënë se Kosova ishte atdheu i serbëve dhe djepi i qytetërimit serb dhe se ai mendonte se popullsia shqiptare e Kosovës nuk dëshironte të bashkëjetonte me serbët.⁹⁴⁸ Mbrojtja e Shainoviçit thekson se Phillips-i dëshmoi edhe se Shainoviçit ishte i sigurtë në përpjekjet e tij për të gjetur një strategji për bashkëjetesën e popullatës serbe dhe shqiptare kosovare në Kosovë, kur, në një darkë më 24 nëntor 1998, tha se shumica e njerëzve në Kosovë besonin se nuk mund të arrinin një zgjidhje politike. Phillips-i komentoi se nga kjo ai deduktoi se Shainoviçit shpresonte se mund të kishte njëfarë zgjidhje politike.⁹⁴⁹

434. Shaun Byrnes dëshmoi se Shainoviçit, duke qenë politikan praktik, mendonte se situata në Kosovë duhej të zgjidhej me mjete politike: ai kërkonte të gjente një zgjidhje politike të pranueshme reciprokisht për këtë problem dhe po punonte në këtë drejtim. Byrnes-i konfirmoi edhe se gjatë takimeve të tij me Shainoviçin, ai ishte gjithmonë bashkëpunues dhe nuk bënte propagandë.⁹⁵⁰ Sikurse është përmendur më parë, në janar 1999 Shainoviçit bëri fushatë edhe për lirim të një numri ushtarësh të UJ-së dhe për shkëmbimin e tyre me luftëtarët e zënë rob të UÇK-së.⁹⁵¹ Byrnes-i pranoi se, pas suksesit të kësaj përpjekjeje, Shainoviçit u përpoq të negocionte me UÇK-në dhe “t’ia shtrinte dorën udhëheqjes së UÇK-së, në shenjë përpjekjeje për të gjetur njëfarë zgjidhjeje” me shpresën që shkëmbimet e të burgosurve të mund të shndërroheshin “në diçka me pasoja politike më të gjera”.⁹⁵²

435. Edhe Petritsch-i konfirmoi gatishmërinë e Shainoviçit për të arritur një marrëveshje përmes mjeteve paqësore në bazë të Marrëveshjeve të Tetorit, të paktën deri në ndodhinë e incidentit të Reçakut.⁹⁵³ Takimet me Shainoviçin qenë gjithmonë takime miqësore “të mbështetura në respektin

⁹⁴⁶ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviçit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 450–454, 556–557, 576–581, 604–615, 626–633, 642–650.

⁹⁴⁷ Dosje Përfundimtare Gjyqësore e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 875–879.

⁹⁴⁸ Michael Phillips, T. 11840 (19 mars 2007).

⁹⁴⁹ Michael Phillips, T. 11877–11879, 11886–11887 (19 mars 2007); 2D17 (pjesë nga fletoret e Michael Phillips-it).

⁹⁵⁰ Shaun Byrnes, T. 12188 (16 prill 2007).

⁹⁵¹ Shaun Byrnes, T. 12189 (16 prill 2007). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10946 (2 mars 2007).

⁹⁵² Shaun Byrnes, T. 12189–12189 (16 prill 2007).

⁹⁵³ Wolfgang Petritsch, T. 10947 (2 mars 2007).

reciprok”.⁹⁵⁴ Siç është thënë më herët, gjatë takimeve në Rambuje, Petritsch-i pati përshtypjen se Shainoviqi “mbante vesh dhe përpiquej t’u jepte përgjigje kërkesave që bënte bashkësia ndërkombëtare” dhe ai konkludoi se këto takime u zhvilluan në një atmosferë shumë të këndshme.⁹⁵⁵

436. Dushan Llonçari dëshmoi se Shainoviqi u përpoq të formojë forca policore shumetnike për të mbrojtur fshatrat dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me shqiptarët kosovarë, por në fund kjo nuk u realizua me sukses, për shkak se tre anëtarë të këtyre forcave i vrau UÇK-ja.⁹⁵⁶ Gjatë mbledhjes së Shtabit të MPB-së më 7 maj 1999, Shainoviqi e përmendi kthimin e të shpërngulurve dhe marrëdhëniet me shqiptarët kosovarë për të siguruar besnikërinë e tyre.⁹⁵⁷ Kjo, sipas Mbrojtjes së Shainoviqit, është provë se ai nuk kishte asnjëherë objektivin për t’i dëbuar shqiptarët kosovarë nga Kosova.⁹⁵⁸

437. Mbrojtja e Shainoviqit vë në dukje edhe një sërë takimesh që pati Shainoviqi me zyrtarë të huaj, në të cilat ai gjithmonë shprehu dëshirën për të arritur një zgjidhje paqësore për Kosovën. Për shembull, në fillim të muajit janar 1999, Shainoviqi udhëtoi për në Austri ku u takua me zyrtarë austriakë dhe me Petritsch-in dhe theksoi se lipse gjetja e një zgjidhjeje politike paqësore dhe nguli këmbë për barazi të të gjitha bashkësive etnike në Kosovë.⁹⁵⁹

438. Dhoma bindet që deklarata për shkallën e lartë të lindshmërisë së shqiptarëve kosovarë u bë në prani të Klaus Naumann-it. Mirëpo, duke pasur parasysh se ai nuk mundi të thoshte me siguri se kush e kishte bërë këtë koment dhe duke pasur parasysh se ky koment u bë në një mbledhje ku ishin të pranishëm disa persona, Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë se ky koment erdhi nga Shainoviqi, apo që ai dëgjoi Millosheviqin të bënte komentin në fjalë. Për më tepër, Naumann-i tha se Shainoviqi nuk ishte i pranishëm kur u bë komenti për Drenicën. Megjithëse nga dëshmitë del se Shainoviqi mund të dukej si njëri prej politikanëve më të arsyeshëm në udhëheqjen e RFJ-së/Serbisë dhe, përveç disa mosmarrëveshjeve me KVM-në lidhur me kushtet e Marrëveshjeve të Tetorit, ai ishte, në përgjithësi, bashkëpunues me përfaqësuesit ndërkombëtarë, të paktën deri në incidentet e Podujevës dhe Reçakut, si edhe gjatë negociatave të Rambujesë, dëshmia e dhënë nga Phillips-i tregon gjithashtu se Shainoviqi mendonte se popullata shqiptare kosovare nuk kishte vend në Kosovë. Dhoma e pranon këtë dëshmi.

⁹⁵⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10945 (2 mars 2007).

⁹⁵⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10945 (2 mars 2007), P2792 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 qershor 1999), f. 3.

⁹⁵⁶ Dushan Llonçar, T. 7591 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 76.

⁹⁵⁷ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 3.

⁹⁵⁸ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 692.

⁹⁵⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10947 (2 mars 2007); 2D15 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Shainoviqit dhe zyrtarëve austriakë, 6 janar 1999).

6. Dijenia e Shainoviqit për krimet në Kosovë dhe përpjekjet për t'i proceduar penalisht

439. Prokuroria parashtron se Shainoviqi kishte dijani për forcë të tepruar dhe joproportionale të përdorur nga forcat e RFJ-së/Serbisë në vitin 1998 dhe se ishte i vetëdijshëm se nëse këto forca do të përdreshin përsëri në vitin 1999, ato do të vijonin me të njëjtën mënyrë. Këtë dijani ai e kishte nga mbledhjet e shumta në të cilat mori pjesë në vitin 1998 dhe 1999, gjatë të cilave u raportua për situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë.⁹⁶⁰ Prokuroria pretendon edhe se Shainoviqi, si zëvendëskryeministër i RFJ-së, shef *de facto* i Komandës së Përbashkët dhe përfaqësues i Millosheviqit për Kosovën, kishte kompetencë për marrjen e masave efektive për parandalimin apo ndëshkimin e krimeve, përfshirë edhe urdhërimin e hetimeve dhe kalimin e dosjeve në gjykatat ushtarake ose civile. Sipas Prokurorisë, ai ishte në gjendje t'u raportonte në mënyrë të efektshme autoriteteve kompetente. Ai kishte mundësi t'i paraqiste raporte Këshillit të Lartë të Mbrojtjes dhe autoriteteve të tjera kompetente lidhur me krimet e dyshuara në Kosovë dhe kishte mundësi të bënte rekomandime për parandalimin e tyre dhe për ndëshkimin e autorëve të krimeve.⁹⁶¹

440. Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se Shainoviqi nuk kishte mundësi të ishte në dijani për krimet që pretendohet se u kryen nga efektivat e UJ-së, sepse raportet për këto krime nuk i dërgoheshin atij. Sipas Mbrojtjes, Shainoviqi dëgjoi për herë të parë për këto krime gjatë mbledhjes së datës 17 maj 1999.⁹⁶² Lidhur me përpjekjet për t'i parandaluar dhe ndëshkuar krimet, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se, në mbledhjet e ndryshme të përmendura më lart, Shainoviqi gjithmonë mbrojti idenë e procedimit dhe ndëshkimit të krimeve dhe, si politikan, kaq mund të bënte.⁹⁶³

a. Dijenia për krimet

441. Sikurse përshkruhet në pjesën për mbledhjet e Komandës së Përbashkët në vitin 1998, nuk ka dyshim se Shainoviqi ishte në dijani të raporteve të UJ-së dhe MPB-së lidhur me Planin kundër Terrorizmit dhe të operacioneve e kryera sipas këtij Plani në verën e vitit 1998. Për më tepër, Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët në vitin 1998 tregojnë se Shainoviqi ishte i mirinformuar për krimet që po bëheshin në Kosovë. Për shembull, në mbledhjen e datës 24 korrik 1998, Gajiqi raportoi se “pas Rahovecit, filloi plaçkitja e pakontrolluar e shtëpive shqiptare”.⁹⁶⁴ Gjatë mbledhjes së datës 7 gusht, Shainoviqi tha se “dëmi më i madh na ka ardhur nga djegia e

⁹⁶⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 696–717.

⁹⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 724.

⁹⁶² Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 15 korrik 2008 (version konfidencial), para. 598, 739–742.

⁹⁶³ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 690.

⁹⁶⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 9.

panevojshme e shtëpive”.⁹⁶⁵ Sipas të dhënave, më 12 gusht ai ishte pranishëm kur Miniqi tha se “i duhet dhënë fund zjarrvënies së shtëpive”.⁹⁶⁶ Në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të zhvilluar më 1 tetor në të cilën mori pjesë Shainoviqi, Radoviqi solli në vëmendjen e Komandës së Përbashkët një artikull gazete për ngjarjet në Abrinë e Epërme. Në përgjigje, Miniqi tha se hetimi i krimeve duhej të përbënte përparësi. Pastaj, Llukiqi tha se “dysohet se ka një varr të përbashkët në zonën e Jabllanicës”.⁹⁶⁷ Gjatë mbledhjes së datës 1 tetor 1998, Gajiqi tha “ka disa të dhëna ata se do të dalin me disa raste të tjera si ato të Abrisë së Poshtme dhe të Epërme” dhe më vonë përmendi “krimet masive”, “3-4 vende të tjera ... pranë Jabllanicës” dhe “50 viktima të tjera”. Në përgjigje, Shainoviqi tha se duhej të formohej një komision në nivel shtetëror, për hetimin e krimeve.⁹⁶⁸ Më pas, më 26 tetor 1998, Shainoviqi përmendi plagosjen e një të riu dhe vrasjen e një fëmije në një fshat dhe tha se kjo kishte shkaktuar një “dëm” të madh.⁹⁶⁹

442. Shënimet e Komandës së Përbashkët gjithashtu tregojnë se pjesëmarrësit diskutuan me hollësi për çështjen e shpërnguljeve. Për shembull, më 2 gusht 1998, Pavkoviqi raportoi se “ishin vënë re shumë refugjatë në rrugën në drejtim të fshatit Llaushë”.⁹⁷⁰ Në mbledhjen e zhvilluar më 26 gusht, Shainoviqi ishte i pranishëm kur u raportua se 16.000 deri në 17.000 persona ishin strehuar në Shqipëri, ndërsa 40.000 persona ishin strehuar në Mal të Zi.⁹⁷¹ Në mbledhjen e zhvilluar më 1 shtator 1998, Shainoviqi tha se “njëri prej problemeve është katastrofa humanitare”.⁹⁷²

443. E gjitha kjo konfirmon se Shainoviqi ishte një politikan i mirinformuar për sjelljen kriminale dhe aktet kriminale të UJ-së dhe MPB-së në verën e vitit 1998. Në të njëjtën kohë, ai ishte gjithashtu në dijeni të akuzave të ndryshme që u vinin autoriteteve të RFJ-së/Serbisë nga bashkësia ndërkombëtare. Për shembull, më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së vërente se ishte “tejet i shqetësuar” për “përdorimin e tepërt dhe të verbër të forcës nga forcat serbe të sigurisë dhe ushtria jugosllave”, që sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, kishte çuar në

⁹⁶⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 46.

⁹⁶⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 52.

⁹⁶⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 134. I pyetur për detyrimin e Shainoviqit për t'i raportuar, Bullatoviqi tha se nuk i kujtohej nëse i kishte treguar Shainoviqi për masakrën në Abri të Epërme. Momir Bullatoviqi, T. 13912 (17 gusht 2007).

⁹⁶⁸ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 135–136.

⁹⁶⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 159.

⁹⁷⁰ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 36.

⁹⁷¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 74.

⁹⁷² P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124.

“shpërnguljen e mbi 230.000 personave nga shtëpitë e tyre”.⁹⁷³ Si zëvendëskryeministër i RFJ-së, Shainoviqi duhet të ketë qenë në dijeni të kësaj rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

444. Shainoviqi pranoi se ishte i pranishëm në njërën prej mbledhjeve “bashkërenduese” kur Perishiqi u ankua për dëmin e panevojshëm që po i shkaktohej pronës private në Kosovë. Shainoviqi shpjegoi se ai e dinte se gjatë operacioneve antiterroriste po dëmtohej prona private, por shpjegoi se kishte marrë informacion se kjo ishte pasojë e operacioneve legjitime të luftimit. Duke qenë se ai nuk kishte kompetencë për kryerjen e hetimeve në lidhje me UJ-në dhe MPB-në, ai u përqendrua të hapja e qendrave në mbarë Kosovën, për të shpërndarë lëndë ndërtimi.⁹⁷⁴ Kjo dijeni për dëmin që iu shkaktua pronës private përputhet me shënimet e mbledhjes së Komandës së Përbashkët të datës 7 gusht 1998, të përshkruar më lart.⁹⁷⁵

445. Pas Marrëveshjeve të Tetorit, kur u tërhoqën forcat dhe kur në Kosovë mbërriti KVM-ja, Shainoviqi ishte përsëri në gjendje të informohej gjerësisht nga burime të ndryshme për situatën në terren. Dëshmia e Dushan Llonçarit tregon se ka pasur një sistem raportimi përmes të cilit zyrtarët e lartë të forcave të RFJ-së dhe Serbisë i raportonin Shainoviqit për ngjarjet në Kosovë, te të cilët bënë pjesë edhe Pavkoviqi, Llazareviqi dhe Llukiqi. Llonçari dëshmoi se Shainoviqi organizonte dhe planifikonte punën e të gjitha strukturave të përfshira në Kosovë. Si anëtar i kabinetit federal dhe si Kryetar i Komisionit Federal për Bashkëpunimin me KVM-në, ai ishte i mendimit se duhej të informohej për gjithçka, sidomos për incidentet. Madje, ngaqë Shainoviqi ngulte këmbë që të informohej për veprimtaritë në Kosovë, ai e organizoi punën në mënyrë të atillë që të ishte në gjendje të mblidhte sa më shumë informacion. Ideja ishte që personat më përgjegjës për fushat e ndryshme në Kosovë të informonin Llukiqin, Pavkoviqin dhe Llazareviqin për ngjarjet atje. Më pas ata ia përcillnin këtë informacion Shainoviqit.⁹⁷⁶ Llonçari dëshmoi gjithashtu se, në kuadër të kontakteve që mbante me KVM-në, kishte një shkëmbim të rregullt raportesh dhe se ai i telefononte Shainoviqit për ta informuar për incidentet, nëse kishte të tillë.⁹⁷⁷ Trajtimi që i bëri Shainoviqi incidentit të Reçakut përbën shembullin më të qartë të bashkëpunimit midis Shainoviqit, nga njëra anë, dhe Llukiqit, Pavkoviqit dhe Llonçarit, nga ana tjetër.

446. Raporti i Shainoviqit për KLM-në lidhur me veprimtaritë e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, në kufirin me Shqipërinë, në mbledhjen e tetë të KLM-së, të zhvilluar në Beograd më 25 dhjetor

⁹⁷³ P456 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1199, 23 shtator 1998), f. 1.

⁹⁷⁴ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 653, 664–665, 673–674, 692, 695–702, 706–709.

⁹⁷⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 46.

⁹⁷⁶ Dushan Llonçar, T. 7649–7650 (1 dhjetor 2006), T. 7654 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 28.

⁹⁷⁷ *Shih* para. 376.

1998, është një tjetër provë se ai ishte i mirinformuar për ngjarjet në terren. Gjatë kësaj mbledhjeje ai mësoi edhe për shqetësimin e Gjukanoviqit lidhur me faktin që operacionet e Korpusit të Prishtinës nuk ishin gjithmonë në përputhje me rolin kushtetues të ushtrisë dhe me vendimet e KLM-së.⁹⁷⁸ Kjo pjesëmarrje në një mbledhje të KLM-së i lë Dhomes të kuptojë se Shainoviqi konsiderohej si një person kaq shumë i mirinformuar për Kosovën sa që i jepej mundësia të merrte pjesë plotësisht në një mbledhje të organit më të lartë shtetëror që ushtronte kontroll mbi UJ-në në krahinë. Kjo tregon edhe se ai ishte në dijeni të akuzave kundër Korpusit të Prishtinës.

447. Shainoviqi ishte në dijeni edhe të shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, përmes kontakteve që kishte me bashkëbiseduesit ndërkombëtarë, siç qenë Michael Phillips, Karol John Drewienkiewicz dhe Klaus Naumann. Phillips-i dëshmoi se në nëntor 1998 ai informoi Shainoviqin dhe Millosheviqin për të shpërngulurit nga Malisheva, e cila ishte “djegur gjer në themel”. Të dy ata u shqetësuan për personat e shpërngulur, mirëpo i konsideronin këta persona edhe si “terroristë”. Shainoviqi mendonte se tërheqja e trupave do të ishte e rrezikshme, përkundër faktit se fshati ishte i zbrazur, ngaqë ndodhej pranë Prishtinës.⁹⁷⁹ Phillips-i e vlerësoi Shainoviqin shumë të dobishëm në zgjidhjen e problemit të Malishevës. Sipas mendimit të tij, Shainoviqi ishte me siguri në dijeni të ngjarjeve që po zhvilloheshin në Kosovë.⁹⁸⁰ Drewienkiewicz-i dëshmoi se, gjatë një mbledhjeje më 4 dhjetor 1998, të cilën e pati me Llazareviqin, Mijatoviqin, Koturin dhe Llonçarin, Shainoviqi u informua për keqtrajtimin e popullsisë shqiptare kosovare nga ana e MPB-së në Malishevë.⁹⁸¹ Naumann-i dëshmoi se, në një mbledhje më 19 janar 1999 ku morën pjesë Millosheviqi, Millutinoviqi dhe Shainoviqi, Clark-u dhe Naumann-i i dorëzuan Millosheviqit një listë me shkelje të Marrëveshjes “Clark-Naumann”, ku përfshihej edhe përdorimi i tepërt dhe jo proporcional i forcës nga forcat policore dhe ushtarake. Në praninë e Shainoviqit, Clark-u dhe Naumann-i i shpjeguan qartë Millosheviqit çfarë dinin për këto incidente.⁹⁸² Lista në fjalë nuk i është paraqitur Dhomes, por Naumann-it i kujtohej se në të përfshiheshin edhe incidentet e Reçakut dhe Podujevës, të cilët janë diskutuar më lart.⁹⁸³

448. Sikurse është përmendur më lart, me t’u larguar KVM-ja nga Kosova dhe pasi UJ dhe MPB nisën një sërë operacionesh, më 26 mars 1999, Prokurorja e atëhershme e Tribunalit, Louise

⁹⁷⁸ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3, 9–10; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 8, 21–22.

⁹⁷⁹ Michael Phillips, T. 11838–11839 (19 mars 2007).

⁹⁸⁰ Michael Phillips, T. 11875–11877 (19 mars 2007).

⁹⁸¹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7777–7782 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklarate e dëshmitarit, datë 23 qershor 2000), para. 72–79.

⁹⁸² Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervista me Prokurorinë), para. 36–37, P2512 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 7007–7009.

Arbour, u drejtoi një letër Shainoviqit dhe të tjerëve, në të cilën shprehte shqetësimin për shkeljen e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe në të cilën deklaronte synimin e saj për t'i hetuar të gjitha shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, sidomos ato shkelje që kishin të bënin me sulmet kundër popullsisë civile.⁹⁸⁴ Frederick Abrahams, hulumtues i organizatës “Human Rights Watch” /Mbikëqyrja e të Drejtave të Njeriut/ dëshmoi gjithashtu se raportet për incidentet në Kosovë iu dërguan zyrtarëve të ndryshëm të qeverisë së RFJ-së, si edhe medias.⁹⁸⁵

449. Përkundër përpjekjeve të Mbrojtjes për ta minimizuar lidhjen e Shainoviqit me Kosovën gjatë fushatës së NATO-s, provat e administruara tregojnë se Shainoviqi ishte në krahinë më 24 mars, 29 mars, 4 prill, 5 prill, 9 prill, 13 prill, 28 prill, 7 maj dhe 1 qershor. Me fjalë të tjera, provat tregojnë se ai shkante rregullisht në Kosovë dhe se pjesa më e madhe e udhëtimeve të tij u bënë në fund të marsit dhe fillim të prillit, periudha kur ndodhën pjesa më e madhe e krimeve në krahinë, sikurse është theksuar, më lart, në Kapitullin VII. Faktikisht ai ishte Prishtinë më 29 mars dhe 4 prill, kohë kur atje po kryhej dëbim masiv.

450. Më 28 prill 1999, në takimin me Millutinoviqin, Shainoviqin, Markoviqin dhe Angjelkoviqin, udhëheqësi i LDK-së, Ibrahim Rugova, dhe sekretari i tij, Adnan Merovci, u ankuan për faktin se MPB-ja po e shtrëngonte popullsinë shqiptare kosovare të largoheshin nga shtëpitë e tyre.⁹⁸⁶ Merovci u tha edhe se kishte mësuar nga fqinji i tij se apartamentin ia kishin shkatërruar policë me uniformë.⁹⁸⁷

451. Provat e analizuara më lart tregojnë se Shainoviqi i përmendi krimet në Kosovë në një sërë takimesh me zyrtarë të lartë të MPB-së.⁹⁸⁸ Krahas kësaj, vetë Shainoviqi tha se, për shkak të postit që kishte, ai merrte informacione nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe nga MPB-ja, përkatësisht nga RDB-ja dhe RJB-ja. Mirëpo, ai shpjegoi se ata e kishin vetë në dorë se çfarë informacioni t'i përcillnin dhe se ai nuk ishte në gjendje të pyeste apo ta ndryshonte një gjë të tillë. Pra, ai nuk kishte asnjëherë një tablo të plotë të ngjarjeve, ndërsa Millosheviqi e kishte.⁹⁸⁹

⁹⁸³ Klaus Naumann, T. 8270 (13 dhjetor 2006).

⁹⁸⁴ P400 (Letër e Louise Arbour drejtuar Nikolla Shainoviqit, 26 mars 1999);

⁹⁸⁵ Frederick Abrahams-i shprehu gjithashtu mendimin se, në përgjithësi, raportet e organizatës “Human Rights Watch” nuk mbështeteshin në aq shumë informacion sa do të mbështeteshin në një situatë ideale. Frederick Abrahams, T. 811–812, 818 (13 korrik 2006), T. 984 (7 gusht 2006).

⁹⁸⁶ Adnan Merovci, P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 prill 2000), para. 72; Ibrahim Rugova, P2613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 nëntor 2001), f. 12.

⁹⁸⁷ Adnan Merovci, T. 8469–8471 (16 janar 2007), P2588 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 prill 2000), para. 72.

⁹⁸⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8052, 8077–8080, 8085–8086 (7 dhjetor 2006), T. 8123–8124 (8 dhjetor 2006). Krahas kësaj, Zhivadin Jovanoviqi dëshmoi se zyrat në terren të Ministrisë së Punëve të Jashtme merrnin informacione për incidentet nga përfaqësues të ndryshëm ndërkombëtarë në Kosovë dhe ia përcillnin ato po kësaj Ministrie në Beograd. Zhivadin Jovanoviq, T. 14103 (21 gusht 2007);

⁹⁸⁹ P605 (intervistë e Nikolla Shainoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 811–812.

452. Hera tjetër kur Shainoviçi mori pjesë në diskutimin për krimet në Kosovë ishte mbledhja e datës 17 maj, ku u diskutua për krimet e kryera nga UJ-ja, MPB-ja dhe grupet parashtarake dhe vullnetare, përfshirë edhe Akrepat. Sipas Vasileviçit, Shainoviçi ishte informuar qysh më parë, përpara mbledhjes së datës 17 maj, nga Pavkoviçi, lidhur me praninë e Akrepave në Kosovë. Për rrjedhojë, nuk ka dyshim se Shainoviçi ishte informuar për krimet që po kryheshin në Kosovë gjatë konfliktit. Pasi pranon se Shainoviçi ishte informuar për krimet e bëra në këtë kohë, Mbrojtja e Shainoviçit thekson, në të njëjtën kohë, dëshminë e Farkashit se, pas inspektimit të njësisë të Korpusit të Prishtinës, ekipi nuk vuri re asnjë mosveprim në funksionimin e njësisë të policisë ushtarake të Korpusit të Prishtinës.⁹⁹⁰ Mirëpo, Dhoma vëren se mbledhja e datës 17 maj nuk kishte të bënte vetëm me krimet e kryera nga UJ-ja, por edhe me diskutimin për krimet e kryera nga njësi të ndryshme të MPB-së dhe grupe parashtarake. Dhoma pranon se Shainoviçi e mbështeti Pavkoviçin në sugjerimin e tij se si MPB-ja, po ashtu edhe UJ-ja, duheshin hetuar nga një komision shtetëror i përbashkët, dhe pranon gjithashtu se Millosheviçi e hodhi poshtë këtë sugjerim. Ndërkohë që me nismën e Ojdaniçit u bë një kontroll në Korpusin e Prishtinës, duket se nga ana e MPB-së nuk u bë asgjë. rrjedhimisht Shainoviçi ishte në dijeni, jo vetëm të krimeve të kryera, por edhe të mosveprimit, të paktën nga ana e MPB-së, lidhur me këto krime.

453. Më 27 maj u bë publike aktakuza e parë kundër Millosheviçit, Millutinoviçit, Shainoviçit, Ojdaniçit dhe Stojilkoviçit, e cila ishte paraqitur më 23 maj 1999.⁹⁹¹ Duke pasur parasysh publicitetin e gjerë që i kushtuan mediat aktakuzës, Shainoviçi duhet të jetë vënë në dijeni të saj pak kohë pas datës 27 maj.

b. Përpjekjet për parandalimin dhe/ose ndëshkimin e krimeve

454. Është e rëndësishme të theksohet se, krahas mbështetjes së tij për Pavkoviçin gjatë mbledhjes së datës 17 maj, ka prova të tjera që dëshmojnë se Shainoviçi mbronte idenë se autorët e çdo krimi të kryer duheshin ndjekur penalisht dhe duheshin ndëshkuar. Për shembull, në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 4 gusht 1998, ai tha: “Duhet t’i bëjmë thirrje Prokurorisë së Republikës së Serbisë. Autorët e krimeve duhen vendosur në listën e personave të kërkuar.”⁹⁹² Gjatë mbledhjes së Komandës së Përbashkët të datës 7 gusht 1998, Shainoviçi dha urdhër që “të zgjidheshin vendndodhje të cilat nuk do të shkaktonin lëvizjen e popullatës civile”.⁹⁹³

⁹⁹⁰ Geza Farkash, T. 16303 (25 shtator 2007).

⁹⁹¹ Aktakuza e parë ishte kundër Millosheviçit, Millutinoviçit, Shainoviçit, Ojdaniçit dhe Stojilkoviçit. P968 (*Prokurori kundër Millosheviçit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IC-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999).

⁹⁹² P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 42.

⁹⁹³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 46.

455. Në mbledhjen me zyrtarë të lartë të policisë në Kosovë, më 4 prill 1999, Shainoviqi tha se “personat që janë ndaluar si autorë të krimeve duhen mbajtur në paraburgim derisa t’u kalohen organeve të drejtësisë”.⁹⁹⁴ Në mbledhjen e zhvilluar në ndërtesën e Shtabit të MPB-së, më 7 maj 1999, Shainoviqi tha se “MPB-ja duhet të sigurojë rendin publik dhe sigurinë dhe pronat e qytetarëve” dhe “t’i arrestojnë të gjithë ata që kapen duke vjedhur”. Më tej, ai tha se nuk duhet të kishte asnjë luftë private dhe se duheshin parandaluar vrasjet private. Çdo veprim i tillë duhej ndëshkuar në vend sepse “nuk mund të lejojmë që serbët të njollosen si njerëz që djegin, vjedhin dhe kapardisen në fshatra të braktisur dhe të shkretuar”.⁹⁹⁵ Ai dha urdhër që të informonin Llukiqin për çdo incident. Ai tha edhe se “çdo person me uniformë duhet të japë llogari për vjedhjet, sepse me uniformën e tij ai turpëron jo vetëm veten, por edhe shtetin”.⁹⁹⁶

c. Përfundim

456. Provat e shumta për rolin dhe angazhimin e Shainoviqit në Kosovë vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte dijeni për krimet që u kryen atje në vitin 1998 dhe në vitin 1999. Kjo dijeni vinte nga vizitat e tij në Kosovë, nga burimet e RFJ-së/Serbisë dhe nga akuzat e ngritura nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe bashkësia ndërkombëtare. Dhoma pranon se Shainoviqi dha një sërë deklaratash si në vitin 1998, po ashtu edhe në vitin 1999, ku këmbënguli për ndjekje penale dhe ndëshkim të autorëve të krimeve, çka shërben edhe një herë në përforcim të argumentit se kishte dijeni për krimet gjatë kësaj periudhe. Për më tepër, duke marrë parasysh angazhimin e tij për Kosovën në vitin 1998, kur forca e tepruar dhe joproporcionale e përdorur nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë çoi në shpërnguljen e mbi 200.000 civilëve, Shainoviqi duhej të kishte qenë në gjendje të parashikonte përsëritjen e kësaj situatë.

457. Mirëpo, edhe pse Shainoviqi dha deklarata ku i nxiste zyrtarët e UJ-së dhe MPB-së për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve, kryerja e krimeve vijoi gjerësisht dhe Shainoviqi vijoi të informohej për to, edhe përmes aktakuzës të ngritur kundër tij. Pushteti i gjerë i Shainoviqit te zyrtarët e Kosovës, shoqëruar edhe me faktin se nuk u bë shumë lidhur me krimet e përhapura dhe se Shainoviqi bëri shumë pak ose aspak përpjekje për të mundësuar parandalimin ose procedimin e këtyre krimeve, tregojnë se deklaratat e Shainoviqit në këto mbledhje kanë qenë vetëm sa për sy e faqe. Pas mbledhjes së 17 majit Shainoviqi e kishte të qartë se Millosheviqi nuk kishte interes të hetonte veprimet e forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë dhe vetë Shainoviqi nuk bëri asgjë për t’i nxitur këto forca, sidomos MPB-në, të bënin një gjë të tillë, edhe pse në raste të tjera ai nuk ngurroi t’u inkurajonte MPB-së. Shainoviqi nuk e përdori pushtetin e tij të gjerë në Kosovë dhe nuk

⁹⁹⁴ P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4.

⁹⁹⁵ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 3.

ndërmori asnjë nismë për t'i bindur eprorët e autorëve të krimeve që të vepronin me ngut për ta eliminuar një sjellje të tillë.

7. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Nikolla Shainoviqit

458. Prokuroria pretendon se Shainoviqi është përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) apo për ndihmë dhe inkurajim të krimeve në Aktakuzë.⁹⁹⁷ Ai akuzohet me përgjegjësinë si epror për mosparandalimin apo mosndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.⁹⁹⁸

459. Sipas Prokurorisë, Shainoviqi mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale që synonte ndryshimin e përbërjes etnike të popullsisë së Kosovës, në mënyrë që të mundësohej vijimësia e kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi krahinën. Prokuroria pretendon se Shainoviqi kishte të njëjtin synim si të tjerët synimin për realizimin e planit të përbashkët dhe veprimet e tij—përfshirë edhe pjesëmarrjen e tij në organet komanduese (siç ishte, për shembull, Komanda e Përbashkët)—tregojnë se ai synonte ta realizonte këtë plan përmes mjeteve dhe metodave kriminale.⁹⁹⁹ Nga ana e saj, Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se Shainoviqi nuk mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.¹⁰⁰⁰

460. Për ngarkimin me përgjegjësi të Shainoviqit në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të dëshmojnë se ai mori pjesë të paktën në një aspekt të qëllimit të përbashkët për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi krahinën, përmes krimeve të shpërnguljes me dhunë, ekzistencën e të cilit Dhoma tashmë e ka vërtetuar.¹⁰⁰¹ Për ta përmbushur këtë element, nuk është e domosdoshme që Shainoviqi t'i ketë kryer fizikisht krimet përmes të cilave është arritur qëllimi apo edhe krime të tjera.¹⁰⁰² Madje, nuk është e domosdoshme që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të këtyre krimeve.¹⁰⁰³ Mirëpo, duhet që kontributi i tij në këtë plan të ketë qenë i konsiderueshëm.¹⁰⁰⁴ Sa i përket elementit të nevojshëm mendor, duhet vërtetuar që Shainoviqi mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte të njëjtin synim me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes

⁹⁹⁶ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 3.

⁹⁹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 658, 720.

⁹⁹⁸ Aktakuza, para. 16–22.

⁹⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 8, 658–659, 691.

¹⁰⁰⁰ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1.

¹⁰⁰¹ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁰⁰² Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁰⁰³ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

¹⁰⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë që ishte objektiv i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, e cila në këtë rast është shpërngulja me dhunë.

461. Çështjet e trajtuara janë ilustruar me shembuj konkretë, mirëpo Dhoma vëren se këto përfundime mbështeten në të gjitha provat përkatëse.

462. Fillimisht lidhur me elementin mendor, Dhoma gjykon se është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjitha veprimet e Shainoviçit, të përshkruara më lart, janë kryer me vullnet të lirë dhe jo me detyrim. Lidhur me synimin e tij, Dhoma është e mendimit se, si njëri prej anëtarëve kryesues të Komandës së Përbashkët, Shainoviçi zotëronte kompetenca të gjera *de facto* mbi forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Si i tillë, ai ishte në gjendje t'u jepte propozime, sugjerime dhe urdhra si Pavkoviçit, po ashtu edhe Llukiçit dhe, përmes tyre, përkatësisht UJ-së dhe MPB-së. Ai ishte hallka kyçe midis Millosheviçit, i cili ndodhej në Beograd, dhe njësive të UJ-së dhe MPB-së që vepronin në Kosovë. Rrjedhimisht, roli i tij ishte roli i një koordinatori politik të forcave në Kosovë. Ai vijoi në këtë rol pas përfundimit të Planit të Luftës kundër Terrorizmit në tetor 1998, në fillim si Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me KVM-në dhe, më pas gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, si anëtar i Komandës së Përbashkët dhe si politikani më i lartë i cili vazhdoi takimet me Pavkoviçin dhe Llukiçin, udhëtoi shpesh në Kosovë dhe pati kontakte të shumta me Ibrahim Rugovën. Krahas këtyre, sikurse shihet nga mbledhja e datës 7 maj 1999 në ndërtesën e Shtabit të MPB-së, ai i përcillte MPB-së serbe, urdhrat e Millosheviçit.

463. Informacionin që mori Shainoviçi përpara dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s është provë e rëndësishme e përcaktimit të përgjegjësisë së tij, sepse dijenia për kryerjen e krimeve nga individët e lidhur me të akuzuarin, ndërthurur me pjesëmarrjen e vazhduar në operacionet e përbashkëta me këta individë, mund të tregojë synimin e një të akuzuari. Provat e përshkruara më lart mbi dijeninë e Shainoviçit tregojnë se në vitin 1998 ai ishte i mirinformuar për shpërnguljet dhe krimet e kryera në Kosovë, sikurse i raportuan gjatë një numri mbledhjesh të Komandës së Përbashkët. Për shembull, në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 31 korrik 1998, Shainoviçi shprehu mendimin se problemi kryesor ishte “çështja e refugjatëve” dhe ai donte që “ekipet televizive të pasqyronin kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre”.¹⁰⁰⁵ Ai ishte i pranishëm më 2 gusht 1998 kur Pavkoviçi raportoi se “ishin vënë re shumë refugjatë në rrugën në drejtim të fshatit Llaushë”¹⁰⁰⁶ dhe ishte gjithashtu i pranishëm në mbledhjen e zhvilluar më 26 gusht, kur u raportua se 16.000 deri në 17.000 persona ishin strehuar në Shqipëri, ndërsa 40.000 persona ishin

¹⁰⁰⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 34.

¹⁰⁰⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 36.

strehuar në Mal të Zi.¹⁰⁰⁷ Duke treguar dijeninë për shkallën e këtij problemi, në mbledhjen e zhvilluar më 21 shtator 1998, Shainoviqi tha se “një prej problemeve është katastrofa humanitare”.¹⁰⁰⁸ Krahas kësaj, ai ishte në dijeni të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së Nr 1199, datë 23 shtator 1998, e cila përmendte shpërnguljen e mbi 200.000 shqiptarëve kosovarë. E megjithatë, gjatë mbledhjes së Komandës së Përbashkët të datës 29 shtator, ai tha se autoritetet e RFJ-së/Serbisë duhej t’i “demoralizonin” shqiptarët kosovarë dhe t’i “bindnin të hiqnin dorë nga ringjallja e separatizmit”.¹⁰⁰⁹ Gjithashtu Shainoviqi mori informacion të ngjashëm gjatë takimeve të tij me përfaqësues ndërkombëtarë. Për shembull, në takimin e datës 7 tetor 1998, Petritsch-i i foli Shainoviqit për “problemin humanitar”, lidhur me mijëra persona të shpërngulur që qenë fshehur në luginën e Rugovës dhe nguli këmbë për tërheqjen e forcave policore. Shainoviqi iu përgjigj se numri i forcave policore ishte tashmë në nivel minimal dhe tha se duhej lënë një numër i mjaftueshëm për të qenë në gjendje të ruanin ligjin dhe rendin, sidomos përgjatë akseve kryesore të udhëtimit.¹⁰¹⁰ Po atë mbrëmje, ai mori pjesë në mbledhjen e Komandës së Përbashkët dhe tha se duhej ngritur niveli i operacioneve dhe se aksionet duheshin kryer në fshehtësi.¹⁰¹¹ Këto prova, të përshkruara me hollësi më lart, nuk i lënë asnjë dyshim Dhomës se Shainoviqi ishte në dijeni se qasja me dorë të fortë e forcave të RFJ-së/Serbisë gjatë bashkërendimit prej tij të këtyre forcave në vitin 1998 çoi në shpërnguljen e mbi 200.000 njerëzve, mirëpo, gjithsesi ai e mbështeti këtë qasje dhe bëri shumë pak për ta ndryshuar.

464. Nga sa shihet më lart, në vitin 1999 Shainoviqi vijoi të merrte informacion dhe të merrte pjesë në bashkërendimin e forcave në mënyrë të ngjashme me atë të ndjekur në vitin 1998 dhe me ndihmën e të njëjtëve personave, gjithçka me miratimin apo nxitjen e Millosheviqit. Si rrjedhojë, Dhoma është e mendimit se gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Shainoviqi ishte sërish një politikan i mirinformuar kur bëhej fjalë për ngjarjet në Kosovë dhe vijoi të merrte informacion se po kryheshin krime nga forcat e UJ-së dhe MPB-së. Ai e tregoi këtë dijeni në mbledhjen e datës 4 prill 1999 në ndërtesën e Shtabit të MPB-së, ku deklaroi se personat e ndaluar për krimet duhet të mbaheshin në paraburgim derisa të merreshin në dorëzim nga organet gjyqësore. Më 13 prill, ai ishte i pranishëm kur thirrën Peshiqin, të cilin e pyetën në lidhje me një pretendim për ekzistencën e një kampi burgimi. Në mbledhjen e Shtabit të MPB-së, të datës 7 maj, ai theksoi nevojën për ta rregulluar më vete sjelljen e rezervistëve të UJ-së të cilët diheshin se kishin kryer krime në krahinë. Çka është më e rëndësishme, në mbledhjen e datës 17 maj me Millosheviqin, Ojdaniqin dhe punonjës të tjerë të

¹⁰⁰⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 74.

¹⁰⁰⁸ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124.

¹⁰⁰⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 132.

¹⁰¹⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10944–10945 (2 mars 2007); 2D16 (Shënime të bisedimeve midis Wolfgang Petritsch-it dhe Shainoviqit, 7 tetor 1998).

¹⁰¹¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 141.

UJ-së dhe MPB-së, ai u informua për sjelljen e njësive të MPB-së dhe njësive paraushtarake në Kosovë, ku përfshihej edhe vrasja e shqiptarëve kosovarë dhe ku u përmendën 800 kufoma. Dhe megjithëse ai ishte në dijeni se Ojdaniqi kishte dërguar njerëzit e tij të hetonin njësitë e Korpusit të Prishtinës, ai ishte gjithashtu në dijeni se nuk ishte bërë asgjë për të hetuar MPB-në. Dhoma ka marrë dëshmi se Shainoviqi ishte i informuar për praninë e Akrepave në Kosovë, edhe përpara se të zhvillohej kjo mbledhje. Gjatë kontakteve të tij me Ibrahim Rugovën në Kosovë, Shainoviqi mësoi për krimet e përhapura kundër popullsisë shqiptare kosovare, përfshirë edhe shpërnguljen e një numri të madh syresh. Më 26 mars 1999, Prokurorja e Tribunalit i nisi një letër Shainoviqit, në të cilën ajo shprehte shqetësim për shkeljet e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe deklaronte synimin e saj për t'i hetuar të gjitha këto shkelje. Në fund, më 27 maj, u bë publike aktakuza e parë e nxjerrë kundër Shainoviqit dhe të tjerëve, në të cilën kishte informacion konkret për krimet e ndryshme të kryera në Kosovë gjatë periudhës përkatëse.

465. Përkundër dijenisë së gjerë që kishte për krimet në Kosovë, Shainoviqi tregoi shumë pak nismë për t'i trajtuar akuzat, me përjashtëm të disa deklaratave me gjithë pushtetin e madh *de facto* dhe *de jure* që gëzonte në krahinë dhe me gjithë lidhjen e ngushtë që kishte me Millosheviqin.

466. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat përkatëse, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim i arsyeshëm në të cilin mund të arrihet është se Shainoviqi kishte synim për të shpërngulur me dhunë një pjesë të popullsisë shqiptare kosovare, si brenda Kosovës, po ashtu edhe jashtë saj, për të ndryshuar përbërjen etnike të krahinës dhe për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të krahinës nga autoritetet e RFJ-së dhe autoritetet serbe. Siç do të tregohet më vonë, Dhoma është gjithashtu e bindur se këtë synim e kishin edhe personat e tjerë të cilët janë identifikuar si anëtarë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, të cilët janë Pavkoviqi dhe Llukiqi, madje edhe Millosheviqi. Dhoma arrin në këtë përfundim, pavarësisht konkluzionit lidhur me pjesëmarrjen e Shainoviqit në negociatat e Rambujesë.

467. Sa i takon aspektit të kontributit të Shainoviqit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, Dhoma është e mendimit se nga paragrafët e mësipërm del qartë se ai ka kontribuar dhe se ky kontribut ka qenë i ndjeshëm. Sikurse thuhet më lart, ai ishte personi të cilin Millosheviqi e përdori për të orkestruar ngjarjet në Kosovë. Qëllimi i tij ishte të bashkërendonte forcat në Kosovë, të transmetonte udhëzimet e Millosheviqit për veprimtaritë e aktorëve të ndryshëm atje dhe t'u jepte këtyre aktorëve sugjerimet dhe udhëzimet e veta, të gjitha këto në kuadër të arritjes së qëllimit të fundmë për ruajtjen e kontrollit në Kosovë. Si pasojë, Shainoviqi ishte njëri prej anëtarëve më me rëndësi të kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Megjithëse Dhoma vëren se dëshmitë e drejtpërdrejta për veprimtarinë e tij në ndikimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të forcave të

RFJ-së dhe Serbisë në vitin 1999 nuk janë aq të shumta sa ato që lidhen me vitin 1998, këto dëshmi, sidoqoftë, tregojnë qartë se pushteti dhe ndikimi i tij nuk u zvogëluan dhe se prania e tij në një sërë mbledhjesh në Kosovë gjatë fushatës së NATO-s ishte në kuadër të angazhimit të tij të mëparshëm në krahinë.

468. Siç mund të shihet nga konstatimet e lidhura me komuna të ndryshme të diskutuara më lart, anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale i përdorën forcat e UJ-së dhe MPB-së që kishin në kontroll për kryerjen e krimeve të pasqyruara në këtë Aktakuzë. Dhoma është e ndërgjegjshme se nuk është e nevojshme që të gjithë efektivat e këtyre forcave të jenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Sidoqoftë, veprimet e efektivave të UJ-së dhe MPB-së janë përgjegjësi e anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren përfundimet e mëvonshme të saj se Pavkoviqi dhe Llukiqi qenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Pavkoviqi, si komandant i Armatës së Tretë të UJ-së, kishte nën urdhrat dhe kontrollin e vet të gjitha forcat e UJ-së në Kosovë gjatë gjithë periudhës kur u kryen krimet dhe gjatë asaj kohe dha urdhra për operacionet e UJ-së në Kosovë. Homologu i Pavkoviqit në MPB ishte Llukiqi i cili, gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s, kishte përgjegjësinë *de jure* dhe *de facto* për forcat e MPB-së që kryen krime në masë. Vetë Shainoviqi ishte koordinator politik i forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Të tre ata u angazhuan në bashkërendimin e veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së. Sllobodan Millosheviqi, një tjetër anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ishte “Kryekomandanti” i UJ-së dhe kishte kompetenca të rëndësishme *de facto* mbi MPB-në. Për të gjitha këto arsye, krimet e UJ-së dhe të MPB-së i ngarkohen Shainoviqit.

469. Duke qenë se Dhoma ka konkluduar se qëllimi i përbashkët do të arrihej vetëm përmes shpërnguljes me dhunë, kjo çon në përfundimin se krimet e tjera për të cilat akuzohet Shainoviqi, të cilat janë vrasje dhe përndjekje, përmes, ndër të tjera, vrasjes, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve kulturore, duhet të këqyren në kuadër të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Duhet provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këto krime, edhe pse dalin jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët, ishin logjikisht të parashikueshme nga Shainoviqi dhe se ai mori me vullnet të plotë rrezikun se mund të kryheshin këto krime.

470. *Vrasjet.* Sikurse u përmend më lart, Shainoviqi synonte të shpërngulte me dhunë një pjesë të popullsisë shqiptare kosovare dhe këtë synim e kishte të përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, objektivi i së cilës ishte shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë brenda Kosovës dhe dëbimi i tyre jashtë Kosovës në mënyrë që të ruhej kontrolli mbi këtë krahinë. Shainoviqi ishte në dijeni të armiqësisë së fortë midis serbëve etnikë dhe shqiptarëve kosovarë në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe vitit 1999. Ai ishte në dijeni të kontekstit në të cilin po

zhvillohej shpërngulja me dhunë e popullsisë. Si rrjedhojë ishte logjikisht e parashikueshme se do të kryheshin edhe krime të tjera, përfshirë vrasjet, nga autorët fizikë dhe të ndërmjetëm me synimin për të diskriminuar shqiptarët kosovarë. Dhoma është e mendimit se dijenia e hollësishme e Shainoviçit për ngjarjet në terren në Kosovë në vitin 1998 dhe vitin 1999 e bëri të kuptonte se UJ-ja dhe MPB-ja do të kryenin vrasje të paligjshme si rezultat i shpërnguljeve që po ndodhnin në vitin 1999. Krahas kësaj, ka dëshmi konkrete në mbështetje të këtij përfundimi. Për shembull, gjatë mbledhjeve të datave 1 dhe 4 tetor 1998, u diskutuan ngjarjet në Abri të Epërme.¹⁰¹² Gajiçi përmendi “krimet në masë” dhe “50 viktima të tjera”, ndërsa Pavkoviçi foli për një tjetër varr të përbashkët që pretendohet se ishte në Jabllanicë. Në përgjigje, Shainoviçi tha se duhej të formohej një komision shtetëror, për hetimin e krimeve.¹⁰¹³ Më 26 tetor 1998, Shainoviçi përmendi plagosjen e një të riu dhe vrasjen e një fëmije në një fshat dhe tha se kjo kishte shkaktuar një “dëm” të madh.¹⁰¹⁴ Phillips-i dhe dëshmitarë të tjerë dëshmuuan se e informuan Shainoviçin për keqtrajtimin e popullsisë shqiptare kosovare në Malishevë dhe për një numër të madh meshkujsh shqiptarë kosovarë të vrarë në Reçak. Rrjedhimisht, nga përvoja ai e dinte se cilat do të ishin pasojat e taktikës së dorës së fortë të forcave të RFJ-së/Serbisë. Sidoqoftë, sikurse thuhet më lart, edhe në vitin 1999 u përdor e njëjta strategji.

471. Që në fillim të fushatës së NATO-s, Shainoviçi ishte gjithashtu në dijeni se gjatë operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së po kryheshin krime të tilla si vrasje dhe plaçkitje dhe se këto krime kishin motiv etnik. Sikurse përshkruhet më lart, në mbledhjen e Shtabit të MPB-së, të datës 4 prill ai i përmendi krimet dhe në mbledhjen e datës 7 maj, ai theksoi nevojën për ta rregulluar më vete sjelljen e rezervistëve të UJ-së të cilët dihej se kishin kryer krime në krahinë. Çka është më e rëndësishme, në mbledhjen e datës 17 maj me Millosheviçin, Ojdaniçin dhe punonjës të tjerë të UJ-së dhe MPB-së, ai u informua për sjelljen e njësisë të MPB-së, të njësisë të UJ-së dhe njësisë paraushtarake në Kosovë, ku përfshihej edhe vrasja e shqiptarëve kosovarë dhe ku u përmendën 800 kufoma. Sikurse thuhet më lart, ai u informua edhe për fushatën e përhapur të krimeve kundër popullsisë shqiptare kosovare gjatë kontakteve të tij me Ibrahim Rugovën. Rrjedhimisht, Dhoma është e bindur se vrasja e shqiptarëve kosovarë, edhe pse del jashtë kuadrin objektivit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ishte në fakt logjikisht e parashikueshme nga Shainoviçi.

¹⁰¹² *Shih* Pjesën VI.C.

¹⁰¹³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 134, 136.

¹⁰¹⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 159.

472. *Dhuna seksuale.* Lidhur me akuzat për dhunë seksuale që janë vërtetuar (në Beleg dhe Qirez),¹⁰¹⁵ Prokuroria nuk ka arritur të paraqesë prova që ta bindin Dhomën që dhuna seksuale ishte logjikisht e parashikueshme për Shainoviqin. Ndërkohë që krimet seksuale u diskutuan në mbledhjen e datës 17 maj në praninë e Shainoviqit, ky diskutim u zhvillua pas dhunës seksuale në Beleg dhe Qirez. Dhoma ka analizuar përfundimet e Dhomave Gjyqësore të proceseve *Kërstiq* dhe *Kvoçka*, në lidhje me parashikueshmërinë e përdhunimeve në rastet në fjalë. Mirëpo, faktet konkrete të atyre çështjeve lidhur me parashikueshmërinë ishin shumë më bindës se faktet e lidhura me këtë proces dhe, më konkretisht, me Shainoviqin.¹⁰¹⁶ Mungesa e dijenisë, nga ana e Shainoviqit, lidhur me dhunën seksuale gjithashtu çon në përfundimin se ai nuk planifikoi, nxiti, urdhëroi, apo ndihmoi dhe inkurajoi këto krime. Po ashtu, ai nuk është përgjegjës për to në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7, sepse nuk kishte arsye të dinte për to.

473. *Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve fetare.* Dhoma tashmë ka konkluduar se forcat e RFJ-së dhe Serbisë shkatërruan katër xhami dhe se këto vepra penale përfshihen në kategorinë e përndjekjes. Dhoma gjykon se për Shainoviqin ishte logjikisht e parashikueshme që forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin shkatërrim ose dëmtim pa shkak të objekteve fetare shqiptare kosovare, të monumenteve të kulturës dhe të vendeve të shenjta myslimane gjatë shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare kosovare. Konflikti kishte në thelb dasinë etnike. Për më tepër, qëllimi i përbashkët do të arrihej përmes një fushate terrori dhe dhune kundër popullsisë civile shqiptare kosovare. Në këto kushte, dhe duke mbajtur parasysh dijeninë e hollësishme të Shainoviqit për ngjarjet në terren në Kosovë gjatë konfliktit, konkluzioni i pashmangshëm është se për Shainoviqin ishte logjikisht e parashikueshme që ndërsa forcat e RFJ-së dhe Serbisë po zhvendosnin dhe dëbonin me dhunë popullsinë shqiptare kosovare, në të njëjtën kohë ato po shkatërronin apo dëmtonin pa shkak edhe objektet fetare, monumentet e kulturës dhe vendet e shenjta të kësaj popullsie.

474. Pas nxjerrjes së konkluzioneve të mësipërme, nuk është e nevojshme që Dhoma Gjyqësore të nxjerrë konkluzione për format e tjera të përgjegjësisë të pretenduara në Aktakuzë.

475. Për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Nikolla Shainoviqi është përgjegjës për kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e krimeve të mëposhtme në vendndodhjet e mëposhtme:

¹⁰¹⁵ Megjithëse më par Dhoma ka konkluduar se K14, K31 dhe K62 u përdhunan në Prishtinë, Prokuroria nuk arriti të paraqiste provat e nevojshme për synimin diskriminues dhe, për rrjedhojë, akuza për përndjekje përmes dhunës seksuale në Prishtinë nuk është vërtetuar. *Shih* Nënnpjesën VII.O.10.

¹⁰¹⁶ Aktgjykim *Kërstiq*, para. 616–618; Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 326–327. *Shih edhe* Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq*, para. 149, 151; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 330, 334.

- Pejë
 - Qyteti i Pejës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Deçan
 - Beleg— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjakovë
 - Qyteti i Gjakovës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Korenicë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Dobrosh—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Ramoc— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mejë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Fshatra të tjerë në zonën e Caragojit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Piranë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Dushanovë, pjesë e qytetit të Prizrenit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Rahovec
 - Celinë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekja (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Bellacërkë—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Krushë e Vogël—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Suharekë
 - Qyteti i Suharekës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;

- Skënderaj
 - Turiçec—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Izbicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Tushilë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Qirez— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit.
- Mitrovicë
 - Qyteti i Mitrovicës— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Zhabar— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Vushtri
 - Qyteti i Vushtrrisë—veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Kolonë pranë Studimes së Epërme—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Prishtinë
 - Qyteti i Prishtinës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjilan
 - Zhegër— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lladovë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Llashticë—përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Përlepnicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Ferizaj
 - Sojevë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mirosalë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Staro Sello— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

- Kaçanik
 - Kotlinë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Kaçanik— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lisnajë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit.

476. Shainoviçi nuk është përgjegjës për të gjitha akuzat e tjera të ngritura në Aktakuzë, përfshirë akuzat për dhunë seksuale të parashtruara në pikën 5 të Aktakuzës (përndjekje), në varësi të paragrafit të fundit të Aktgjykimit.

477. Rrjedhimisht, Nikolla Shainoviçi është fajtor për pikat 1 deri në 5 të Aktakuzës për aq sa përcaktohet më lart.

E. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E DRAGOLUB OJDANIQIT

1. I akuzuari

478. Dragolub Ojdaniqi u lind më 1 qershor 1941, në fshatin Ravni, i cili ndodhet pranë Uzhices në Serbi.¹⁰¹⁷ Është fakt i pakundërshtuar se Ojdaniqi u inkuadrua për herë të parë në Ushtrinë Jugosllave kur ishte adoleshent, pasi u regjistrua në shkollën e nënoficerëve të Armës së Këmbëorisë të Forcave Tokësore të UJ-së, ku shërbeu thujse në të gjitha nivelet e radhëve të ushtrisë, përfshirë edhe pozita komanduese luftimi dhe ku më 1 korrik 1996 arriti në pozitën e zëvendës-shefit të Shtabit të Përgjithshëm, post të cilin e mbajti më 24 nëntor 1998 kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm. Më pas, në shkurt 2000, u emëruar ministër i Mbrojtjes së RFJ-së.¹⁰¹⁸ Paralelisht me shërbimin në UJ, ai vijoi arsimimin duke u magjistruar në shkencat ushtarake, por studimet e doktoraturës i braktisi para marrjes së diplomën.¹⁰¹⁹

2. Akuzat në Aktakuzë

479. Sipas Aktakuzës, si zëvendës-shef dhe më pas shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Ojdaniqi kishte pushtet komandues mbi tërësinë e forcave të UJ-së dhe të forcave të tjera në varësi të UJ-së. Konkretisht, pretendohet se ai komandoi, urdhëroi, udhëzoi, rregulloi, plotësoi me efektiv dhe përndryshe drejtoi UJ-në, e cila u shfrytëzua për zbatimin e fushatës së dhunës që synonte

¹⁰¹⁷ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 12.

¹⁰¹⁸ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 12–13.

¹⁰¹⁹ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 70.

largimin e popullsisë shqiptare kosovare.¹⁰²⁰ Më tej pretendohet, se ai bashkëpunoi me MPB-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes të RFJ-së për mobilizimin e organeve dhe njërive të MPB-së dhe se ushtri pushtet komandues mbi njësitë e MPB-së.¹⁰²¹ Mbi këtë bazë, ai akuzohet për planifikimin, nxitjen, urdhërimin ose, përndryshe, ndihmë dhe inkurajim për planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e krimeve të pretenduara në Aktakuzë dhe për pjesëmarrjen në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të diskutuar më lart.¹⁰²² Më tej, Ojdaniqi akuzohet për përgjegjësinë si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.¹⁰²³

480. Mbrojtja e Ojdaniqit bën të ditur se Ojdaniqi hedh poshtë çdo element të secilës shkelje për të cilën akuzohet dhe parashtron se Prokuroria nuk ka arritur të provojë se ai mban përgjegjësi për planifikimin, urdhërimin, nxitjen, kryerjen apo, përndryshe, ndihmë dhe inkurajim për krimet e pretenduara në Aktakuzë.¹⁰²⁴ Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se veprimet e tij, për aq sa janë vërtetuar se janë kryer, kanë qenë të gjitha reagime legjitime ndaj kërcënimit që vinte nga UÇK-ja dhe NATO-ja.¹⁰²⁵

481. Në Kapitullin e mëparshëm VII, Dhoma ka arritur në përfundimin se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen krime kundër popullsisë civile shqiptare kosovare në shumë prej komunave të Kosovës, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999. Si rrjedhojë në këtë pjesë do të analizohet përgjegjësia e Ojdaniqit për këto krime, në bazë të kategorive të ndryshme të përgjegjësisë së pretenduar në Aktakuzë.

3. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ojdaniqit në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së

482. Prokuroria argumenton se Ojdaniqi kishte kompetenca të gjera si zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm në vitin 1998,¹⁰²⁶ dhe se, me t'u bërë shef i Shtabit të Përgjithshëm, ai kishte nën komandën dhe kontrollin e tij, *de jure* dhe *de facto*, të gjitha forcat e UJ-së.¹⁰²⁷ Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se kompetencat zyrtare të tij si zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm qenë minimale dhe se ndikimi i tij në realitet qe edhe më i kufizuar.¹⁰²⁸ Mbrojtja shton se, si shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi ishte kreu i efektivit profesional të Komandës së Lartë dhe

¹⁰²⁰ Aktakuza, para. 3, 11.

¹⁰²¹ Aktakuza, para. 11.

¹⁰²² Aktakuza, para. 16–22.

¹⁰²³ Aktakuza, para. 11, 40–44.

¹⁰²⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 5.

¹⁰²⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 29.

¹⁰²⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 727.

¹⁰²⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 820.

¹⁰²⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 150.

përmbushte urdhrat e Kryekomandantit, por argumenton se ai nuk kishte kontroll efektiv mbi autorët e krimeve në Kosovë.¹⁰²⁹

483. Gjatë kohës kur ishte zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi kishte përgjegjësinë zyrtare për Administratën e UJ-së për Marrëdhëniet me Përfaqësuesit Ushtarakë të Huaj dhe me Organizatat Ndërkombëtare.¹⁰³⁰ Krahas kësaj, në mungesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm ai drejtonte mbledhjet e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm, dhe me raste, nxirrte urdhra.¹⁰³¹ Radovan Radinoviqi dëshmoi se mundësia e Ojdaniqit për të ndikuar në ngjarjet në Kosovë ishte e kufizuar gjatë kohës që ishte zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm, për shkak të marrëdhënies së ftohtë që kishte me Perishiqin, shefin e Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰³² Mirëpo, ky vlerësim bazohej kryesisht në faktin se, sipas Radinoviqit, Perishiqi nuk kishte pranuar të jepte miratimin për tezën e propozuar të doktoraturës së Ojdaniqit.¹⁰³³ Përtej këtij fakti, Dhoma nuk ka dëgjuar asnjë dëshmi tjetër e cila do të sugjeronte një marrëdhënie të tillë midis dy oficerëve. Procesverbalet e mbledhjeve të kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm që janë pranuar si prova nuk japin asgjë të qartë të qartë në lidhje me këtë aspekt, edhe pse mund të vihet re se ka pasur raste kur Perishiqi është pajtuar me sugjerimet e bëra nga Ojdaniqi.¹⁰³⁴

484. Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se, gjatë kohës që ishte zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi nuk merrte përditë raporte operative lidhur me operacionet e UJ-së në Kosovë.¹⁰³⁵ Në mbështetje të kësaj, Mbrojtja e Ojdaniqit i referohet procesverbalit të mbledhjes së kolegjiut të UJ-së të zhvilluar më 22 qershor 1998, ku Perishiqi, shef i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm, përmendi një projektvendim të komandantit të Armatës së Tretë. Ojdaniqi u përgjigj, “si zëvendësi juaj, kërkoj që edhe unë të marr raportin e komandantit të Armatës së Tretë”.¹⁰³⁶ I pyetur lidhur me këtë koment, Radovan Radinoviqi nguli këmbë se Ojdaniqi e kishte fjalën për të gjitha raportet operative ditore, çka nënkupton se ai nuk i merrte këto raporte.¹⁰³⁷ Dhoma vëren se Ojdaniqi kërkoi “raportin e komandantit të Armatës së Tretë” por nuk përmendi shprehimisht raportet operative ditore që përgatiteshin në Shtabin e Përgjithshëm, sikurse është përmendur më

¹⁰²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 221–223, 479 *e në vijim*.

¹⁰³⁰ Rade Çuçak, T. 14895 (4 shtator 2007).

¹⁰³¹ *Shih, p.sh.*, 3D664 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 6 nëntor 1998); 3D586 (Informim i Shefit të Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999); 4D503 (Urdhër për Shtabin e Përgjithshëm, 19 tetor 1999).

¹⁰³² 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 79.

¹⁰³³ Radovan Radinoviq, T. 17197–17198 (18 tetor 2007).

¹⁰³⁴ *Shih, p.sh.*, P926 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 tetor 1998), f. 17.

¹⁰³⁵ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 152; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 79.

¹⁰³⁶ P923 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 22 qershor 1998), f. 15. Këto kolegjiute përshkruhen në Pjesën VI.A.

¹⁰³⁷ Radovan Radinoviq, T. 17203–17205 (18 tetor 2007).

parë në Pjesën VI.A. Në muajin tetor 1998, Ojdaniqi i merrte këto raporte operative ditore. Në mbledhjen e kolegjiut të datës 28 tetor 1998, ai tërhoqi vëmendjen te dy çështje nga raportet e rregullta të operacioneve.¹⁰³⁸ Pasi vë re se asnjë prej pretendimeve të përgjegjësive penale individuale të përmendura në Aktakuzë nuk rezultojnë nga kompetencat e Ojdaniqit si zëvendësues i Shtabit të Përgjithshëm, Dhoma kalon menjëherë në analizimin e kompetencave të tij si shef i Shtabit të Përgjithshëm.

485. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ishte oficeri ushtarak më i lartë në UJ dhe, sipas Ligjit të Mbrojtjes të RFJ-së, ishte në varësi vetëm të organeve civile që zotëronin komandën e përgjithshme të UJ-së.¹⁰³⁹ Ai kishte pushtet mbi të gjitha forcat e UJ-së, përfshirë edhe forcat në Kosovë.¹⁰⁴⁰ Funkzioni parësor i shefit të Shtabit të Përgjithshëm ishte komandimi i UJ-së përmes nxjerrjes së urdhrave.¹⁰⁴¹ Ndër detyra e tij ishin përcaktimi i planit për plotësimin dhe stërvitjen e efektivit të UJ-së, gradimin e oficerëve deri në gradën e kolonelit dhe propozimin e kandidatëve për kryetarë, gjykatës, prokurorë dhe punonjës të gjykatave disiplinore ushtarake.¹⁰⁴² Shefi i Shtabit të Përgjithshëm mund t'i propozonte Presidentit të RFJ-së kandidatët për emërim në postet që kërkonin gradën e gjeneralit ose admiralit.¹⁰⁴³

486. Sipas Ligjit për UJ-në të RFJ-së, Ojdaniqi mund të niste procedimin penal kundër çdo efektivit të UJ-së dhe, sipas Nenit 159, ekzistonte detyrimi për të mundësuar që anëtarët e UJ-së që kryenin vepra dhe shkelje kundër disiplinës ushtarake të UJ-së të mbanin përgjegjësi.¹⁰⁴⁴ Kjo përfshinte marrjen e masave kundër çdo vartësi që nuk zbatonte një urdhër për shkak të mungesës së disiplinës.¹⁰⁴⁵ Edhe mosbindja ndaj një urdhri në UJ ishte vepër penale, e cila dënohej deri në pesë vjet burgim.¹⁰⁴⁶ Në gjendje lufte, ekzistonte detyrimi për marrjen sa më të shpejtë të masave disiplinore.¹⁰⁴⁷ Ojdaniqi kishte mundësinë për t'i urdhëruar komandantët e njëjësive të UJ-së që të

¹⁰³⁸ P926 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 tetor 1998), f. 17.

¹⁰³⁹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 5; Spasoje Muçibabiq, T. 16579 (28 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 9, 15, T. 8639–8643 (18 janar 2007).

¹⁰⁴⁰ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 5; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 9, 15.

¹⁰⁴¹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 6; P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen); P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll), f. 97.

¹⁰⁴² Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 13.

¹⁰⁴³ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 46; 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 136; Ratko Markoviq, T. 13057 (7 gusht 2007); P1738 (Rregullore e KLM-së, 23 mars 1999), neni 4; *shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 17744 (6 nëntor 2007).

¹⁰⁴⁴ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 159, 180, 181, 185; 4D532 (Rregullore e Shërbimit e UJ-së, 1 janar 1996), neni 291. *Shih edhe* P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 8; P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 5, 46 dhe 168; P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll), f. 97.

¹⁰⁴⁵ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit e UJ-së, 1 janar 1996), f. 11, rregulla 36. *Shih edhe* P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll), f. 61–63.

¹⁰⁴⁶ P1736 (Kodi Penal i RFSJ-së), neni 203.

¹⁰⁴⁷ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 180 dhe 181.

hetonin anëtarët e UJ-së që kryenin krime në Kosovë dhe t'ua kalonin për procedim penal gjykatave ushtarake, dhe ai e ushtroi këtë kompetencë në disa raste gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹⁰⁴⁸ Rregullorja e Shërbimit e UJ-së parashtronte se, në rast të incidenteve të pazakonta që cenonin gatishmërinë luftarake apo reputacionin e UJ-së, shefi i Shtabit të Përgjithshëm kishte detyrimin për të formuar një komision hetimor për incidentin.¹⁰⁴⁹ Ai mund të kërkonte edhe raporte të posaçme jashtë linjave të zakonshme të raportimit, drejtpërsëdrejti nga nivelet dytësore të vartësisë.¹⁰⁵⁰ Këto mundësi përbënin një burim të konsiderueshëm pushteti të drejtpërdrejt në lidhje me ndëshkimet e mundshme, dhe të tërthortë në lidhje me pasojat në karrierën e një ushtaraku të UJ-së. Në ato raste kur masa të tilla çonin në ndjekje penale ose disiplinore, ky faktor bëhej pengesë për gradimin e anëtarit të ndëshkuar të UJ-së, me përjashtim të rastit kur ndjekja penale ndalohej për shkaqe që nuk kishin lidhje me kompetencat.¹⁰⁵¹

487. Radinoviqi dëshmoi se, edhe pse këto kompetenca i jepnin Ojdaniqit një farë “përgjegjësie kontrolli”, ato nuk i jepnin “përgjegjësi komande” (as *de jure*, as *de facto*) mbi UJ-në, dhe deklaroi se shefi i Shtabit të Përgjithshëm nuk funksiononte si një organ i veçuar komandues, por thjesht si një organ i specializuar për përgatitjen dhe përmbushjen e urdhrave të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes dhe, në kohë konflikti, të Komandës së Lartë.¹⁰⁵² Mirëpo, dispozitat që rregullojnë UJ-në, sikurse parashtrohet në Pjesën VI.A, janë të qarta në dhënien e kompetencave të gjera *de jure* shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ojdaniqi kishte edhe kompetencat përkatëse *de facto*, sikur duket, ndër të tjera, nga nxjerrja, nga ana e tij, e direktivave *Grom 3* dhe *Grom 4*, të cilat u zbatuan më pas në nivel të Armatës së Tretë dhe, më pas, të Korpusit të Prishtinës.¹⁰⁵³ Një raport që Ojdaniqi hartoi për Millosheviqin më 12 shkurt 1999, për planet *Grom*, lë të kuptosh se ai kishte autonomi të konsiderueshme për planifikimin e këtyre operacioneve të UJ-së.¹⁰⁵⁴ Për më tepër, gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi punoi nga afër me Presidentin e RFJ-së, Millosheviqin. Ata takoheshin

¹⁰⁴⁸ *Shih, p.sh.*, P1476 (Urdhër mbi Mbledhjen e të Dhënave për Krimet e NATO-s kundër Njerëzimit, 3 prill 1999); P1477 (Urdhër për Disiplinën Ushtarake, 3 prill 1999), f. 2.

¹⁰⁴⁹ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit e UJ-së, 1 janar 1996), nenet 313, 314. Incidentet e pazakonta përfshinin “komprometimin e gatishmërisë luftarake, vënien në rrezik të jetës dhe shëndetit të personelit, shkeljen e urdhrat dhe disiplinës, komprometimin e moralit ..., mosmarrjen e masave të duhura, ose forca madhore”. *Shih* 4D532 (Rregullore e Shërbimit e UJ-së, 1 janar 1996), neni 310.

¹⁰⁵⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17939 (8 nëntor 2007).

¹⁰⁵¹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 41, 42, 44 dhe 45.

¹⁰⁵² 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 100–105.

¹⁰⁵³ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva “Grom 3”, 16 janar 1999); 3D676 (Urdhër “Grom 3” i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), pranuar edhe me numrin 5D245; 5D249 (Urdhër i Armatës së Tretë, 1 shkurt 1999), f. 2; P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999); P1481 (Direktivë e Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999); 4D308 (Urdhër i Armatës së Tretë për mbrojtjen nga NATO-ja, 10 prill 1999); 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1999); Vladimir Llazareviq, T. 17957 (8 nëntor 2007); Gjorgje Qurçin, T. 16929 (5 tetor 2007). *Shih, p.sh.*, 3D696 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 mars 1999); P1495 (përgjigje e Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 24 maj 1999).

¹⁰⁵⁴ 3D704 (Raport për Millosheviqin, lidhur me Planet për Përdorimin e UJ-së, 12 shkurt 1999), f. 1–2.

çdo ditë, për të sqaruar çështjet që dilnin nga raportet e luftimit të cilat i vinin Millosheviqit në formë të përmbledhur.¹⁰⁵⁵ Millosheviqi i jepte udhëzime Ojdaniqit, i cili, më pas, i kthente në urdhra ushtarakë.¹⁰⁵⁶ Sistemi i komandimit të UJ-së vijoi funksionimin gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s.¹⁰⁵⁷ Është vërtetuar se Ojdaniqi kishte pushtet *de jure* dhe *de facto* mbi të gjitha forcat e UJ-së, që nga momenti i emërimit si shef i Shtabit të Përgjithshëm më 24 nëntor 1998 deri kur u bë ministër i Mbrojtjes i RFJ-së në shkurt 2000.

488. Prokuroria parashtron se kompetenca e Ojdaniqit mbulonin edhe forcat e MPB-së.¹⁰⁵⁸ Në përgjigje të kësaj, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se kalimi i MPB-së në vartësi të UJ-së, faktikisht nuk ndodhi asnjëherë, dhe se Ojdaniqi nuk kishte as kompetencë, as pushtet mbi forcat e MPB-së që vepronin në Kosovë.¹⁰⁵⁹

489. Gjatë vitit 1998, UJ-ja dhe MPB-ja bashkëpunuan në operacionet luftarake në Kosovë. Këto operacione të përbashkëta vazhduan në vitin 1999, sikurse përshkruhet në Pjesën VI.E. Për shembull, më 29 maj 1999, një urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë e urdhëronte Armatën e Tretë t'i mbështeste me zjarr artilerie forcat e MPB-së brenda zonave të përgjegjësisë së MPB-së kur t'i kërkohej një gjë e tillë.¹⁰⁶⁰ Mirëpo, edhe pse UJ-ja vijoi bashkërendimin dhe bashkëpunimin me forcat e MPB-së dhe madje mori në vartësi disa njësi të MPB-së në disa operacioni,¹⁰⁶¹ MPB si e tërë nuk u integrua asnjëherë në hierarkinë komanduese të UJ-së.¹⁰⁶²

490. Gjithashtu, Prokuroria ka argumentuar se Ojdaniqi kishte kompetenca komanduese mbi popullatën e armatosur joshqiptare në Kosovë gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹⁰⁶³ Roli i UJ-së në komandimin dhe drejtimin e popullatës së armatosur joshqiptare, përfshirë edhe ata të cilët u organizuan në njësi policore rezerviste, është diskutuar më lart në Pjesën VI.A. Atje, u konkludua se, edhe pse popullata e armatosur joshqiptare nuk bënte pjesë në UJ, gjithsesi UJ-ja u përfshi në

¹⁰⁵⁵ Gjorgje Qurçin, T. 16979 (5 tetor 2007); Branko Gajiq, T. 15417 (11 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 tetor 2006), para. 15; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 106.

¹⁰⁵⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 15; Gjorgje Qurçin, T. 16979–16980 (5 tetor 2007).

¹⁰⁵⁷ 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 8, 11; Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 tetor 2007), para. 8, 12–13; P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit drejtuar pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17.

¹⁰⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 748.

¹⁰⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 454.

¹⁰⁶⁰ P1465 (Paralajmërim i Shtabit të Komandës së Lartë drejtuar Armatës së Tretë për një operacion të mundshëm të NATO-s, 29 maj 1999), gjithashtu pranuar si P1920.

¹⁰⁶¹ *Shih* Dragan Zhivaleviq, T. 24921 (8 prill 2008); P1269 (Urdhër i Armatës së Tretë, 8 maj 1999); Nebojsa Bogunoviq 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 prill 2008), para. 92; Vladimir Iliq, T. 24350 (17 mars 2008).

¹⁰⁶² *Shih* Pjesën VI.E.

¹⁰⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 126.

armatosjen dhe organizimin e këtij grupimi dhe urdhëroi angazhimin e tij gjatë operacioneve të përbashkëta me MPB-në në vitin 1999.¹⁰⁶⁴

4. Sjellja e Ojdaniqit në vitin 1998 dhe 1999

a. Përdorimi i UJ-së në Kosovë në vitin 1998 dhe emërimi si shef i Shtabit të Përgjithshëm

491. Prokuroria argumenton se Ojdaniqi ishte më i hapur ndaj idesë së angazhimit të UJ-së në operacionet luftarake në Kosovë, çka binte ndesh me paraardhësin e tij, Perishiqin, i cili e vuri në dyshim ligjshmërinë dhe mençurinë e një angazhimi të tillë.¹⁰⁶⁵ Mbrojtja e Ojdaniqit kundërpërgjigjet se përdorimi i UJ-së kundër UÇK-së në Kosovë në vitin 1998 ishte në përputhje me rolin e saj kushtetues.¹⁰⁶⁶ Më tej, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se përdorimi i UJ-së në Kosovë u urdhërua së pari nga Perishiqi, kur ky ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm, dhe se Ojdaniqi nuk bëri gjë tjetër veçse e vijoi këtë politikë.¹⁰⁶⁷

492. Në Pjesën VI.C, më lart Dhoma ka konstatuar se në vitin 1998 UJ u angazhua gjerësisht në operacione mësimëse kundër UÇK-së, herë në mbështetje të forcave të MPB-së, dhe herë duke vepruar në mënyrë të pavarur, me gjithë protestat, ndër të tjera, të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Perishiqit, se kjo ishte shkelje e regjimit kushtetues për përdorimin e UJ-së. Tani, Dhoma do të analizojë pretendimin mbi dallimin midis qëndrimeve të Ojdaniqit dhe të Perishiqit kundrejt përdorimit të UJ-së në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999.

493. Në disa mbledhje të kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm në vitin 1997 dhe 1998, Ojdaniqi bëri komente lidhur me dëshirueshmërinë e shmangies së një “luftë” të përgjithshme në Kosovë, e cila do të shtonte vëmendjen ndërkombëtare dhe do të nxiste një ndërhyrje të mundshme të NATO-s.¹⁰⁶⁸ Për shembull, në mbledhjet e kolegjiut të datave 10 prill dhe 29 qershor 1998, ai tha se për

¹⁰⁶⁴ P2086 (Udhëzime për Mbrojtjen e Zonave të Populluara (të përkohshme), nxjerrë nga Komanda e Përbashkët për Kosovën, 1 korrik 1998), f. 7; P1114 (Raport nga SPB-ja e Mitrovicës për Shtabin e MPB-së, 1 korrik 1998), f. 1–8; Zllatomir Peshiq, T. 7316 (24 nëntor 2006); Nikë Peraj, P2253 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 gusht 2006), para. 15. *Shih edhe* 3D1087 (Interpretim i Ligjit të Mbrojtjes nga Ministria Federale e Drejtësisë, 8 prill 1999), f. 3.

¹⁰⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 80, 771.

¹⁰⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 164.

¹⁰⁶⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 167.

¹⁰⁶⁸ 3D1075 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 12 dhjetor 1997), f. 4; 3D1076 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 15 dhjetor 1997), f. 1; *shih edhe* 3D1074 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 26 shtator 1997), f. 3; 3D659 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 4 maj 1998); P923 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 22 qershor 1998), f. 11–12.

problemin në Kosovë duheshin kërkuar zgjidhje politike dhe diplomatike.¹⁰⁶⁹ Në mbledhjen e datës 10 prill ai vërejtë se UÇK-ja synonte të bëhej aq e fortë sa të mos i bënte dot ballë MPB-ja, e cila ishte “e vetmja forcë kompetente dhe e njohur botërisht për luftën kundër grupeve terroriste”.¹⁰⁷⁰ Më 23 tetor 1998, ai sugjeroi kthimin e të gjitha njësive të UJ-së në kazerma apo largimin e tyre nga Kosova për të mos lejuar asnjë palë që ta akuzonte UJ-në për shkelje të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199.¹⁰⁷¹

494. Perishiqi ishte kundër përdorimit të UJ-së në brendësi të Kosovës, pa një deklaratë përkatëse nga Kuvendi Federal apo nga KLM-ja.¹⁰⁷² Megjithatë, Perishiqi mori urdhër të përgatiste një plan për përdorimin e UJ-së në Kosovë, urdhër të cilin e përmbushi, duke nxjerrë planin “Grom 98” më 28 korrik 1998.¹⁰⁷³ Nikë Peraj dëshmoi se, edhe pse UJ-ja u angazhua në operacionet ushtarake në Kosovë gjatë kohës kur Perishiqi ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm, kishte një dallim të dukshëm midis këtyre operacioneve dhe operacioneve gjatë periudhës kur në këtë post ishte Ojdaniqi. Nën komandën e Ojdaniqit, ushtria i përdori gjithnjë e më shumë tanket dhe i granatoi fshatrat.¹⁰⁷⁴ Mirëpo, Millovan Vllajkoviqi, i cili ishte shef kabineti i shefit të Shtabit të Përgjithshëm, si me Perishiqin, po ashtu edhe me Ojdaniqin, dëshmoi se të dy shefat e Shtabit kishin qëndrime të ngjashme lidhur me përdorimin e UJ-së në Kosovë.¹⁰⁷⁵ Dhoma vëren se versioni i Perajt lidhur me ndryshimin e qëndrimit mes tyre ishte i paqartë dhe nuk kishte shembuj konkretë mbështetës.¹⁰⁷⁶ Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma nuk mbështetet në dëshminë e tij.

495. Në mbledhjen e KLM-së të datës 4 tetor 1998, Perishiqi sugjeroi, ndër të tjera që Kuvendi Federal të shpallte rrezikun e luftës së afërt dhe, nëse fillonte sulmi me raketa, gjendjen e luftës.¹⁰⁷⁷ Në këtë mbledhje, Millosheviqi propozoi një vendim që vendi të vetëmbrohej nëse sulmohej dhe ky

¹⁰⁶⁹ 3D657 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (UJ) për 10 prill 1998), f. 2; P927 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (UJ) për 29 qershor 1998), f. 12; Vllade Nonkoviq, T. 16198 (24 shtator 2007).

¹⁰⁷⁰ 3D657 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 10 prill 1998), f. 2.

¹⁰⁷¹ 3D645 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 23 tetor 1998), f. 4; Millorad Obradoviq, T. 14938 (4 shtator 2007).

¹⁰⁷² P717 (Letër nga Momçillo Perishiq drejtuar Slobodan Millosheviqit, datë 23 korrik 1998); 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 10; P922 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 3.

¹⁰⁷³ 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për përdorimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998); Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

¹⁰⁷⁴ Nikë Peraj, T. 1717 (15 gusht 2006), P2253 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 gusht 2006), para. 100.

¹⁰⁷⁵ Millovan Vllajkoviq, 3D1112 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 gusht 2007), para. 27; *Shih edhe* Gjorgje Qurçin, 3D1121 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 gusht 2007), para. 8.

¹⁰⁷⁶ Nikë Peraj, T. 1717 (15 gusht 2006).

¹⁰⁷⁷ P1575 (Procesverbal i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 1–4; P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 4–10.

propozim u miratua njëzëri.¹⁰⁷⁸ Millosheviqi e pranoi propozimin e Perishiqit për shpalljen e rrezikut të luftës së afërt në seancën e radhës të Kuvendit Federal, çka do t'i jepte mundësi vendit të fillonte përgatitjen e nevojshme për mbrojtjen.¹⁰⁷⁹ Mirëpo, në mbledhjen e ardhshme të KLM-së, më 24 nëntor 1998, me vendim të Millosheviqit, Perishiqi u zëvendësua nga Ojdaniqi.¹⁰⁸⁰ në atë kohë nuk u shpall as rrezik i një lufte të afërt dhe as gjendje lufte dhe, faktikisht gjendja e luftës u shpall vetëm në mars 1999, kur NATO-ja filloi fushatën ajrore.

496. Vasileviqi dëshmoi se transferimi i Perishiqit në një post jashtë organizatës së UJ-së u bë për ta shmangur atë.¹⁰⁸¹ Shefi i Administratës së Personelit të Shtabit të Përgjithshëm, Branko Fezeri, pranoi se roli i këshilltarit kishte më pak prestigj se ai i shefit të Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰⁸² John Crosland-i, i cili u takua disa herë me Ojdaniqin gjatë vitit 1998, në cilësinë e atashut ushtarak britanik, për të diskutuar për operacionet e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, deklaroi se, sipas mendimit të tij, personi që e zëvendësoi Perishiqin, Ojdaniqi, ishte një “kukull” e Millosheviqit.¹⁰⁸³

497. Mbrojtja e Ojdaniqit thekson se Ojdaniqi kishte bërë të ditur se nuk i pëlqente përdorimi i UJ-së në Kosovë, sikurse përshkruhet më poshtë, dhe se ishte më se normale që Ojdaniqi ta zëvendësonte Perishiqin sepse ai ishte zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰⁸⁴ Duke vënë re se nuk ka më dëshmi të tjera lidhur me mbështetjen e Ojdaniqit për planin “Grom 98” për përdorimin e UJ-së në Kosovë, Dhoma nxjerr përfundimin se ai nuk u përfshi në krijimin e këtij plani dhe nuk ka ishte entuziast për zbatimin e tij në vitin 1998. Dhoma konstaton se Millosheviqi e largoi Perishiqin nga posti dhe e zëvendësoi me Ojdaniqin për arsye të kundërshtimit të hapët prej Perishiqit ndaj përdorimit të UJ-së në 1998, si edhe për të pasur një shef Shtabi të Përgjithshëm më të bindur. Gjithsesi, Dhoma vëren se ky fakt nuk e ngarkon drejtpërsëdrejti Ojdaniqin me përgjegjësi penale individuale për krimet e pretenduara në Aktakuzë. Më tej do të analizohen veprimet e Ojdaniqit pas marrjes së postit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

¹⁰⁷⁸ P1575 (Procesverbal i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 7–10. P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 22–33.

¹⁰⁷⁹ P1575 (Procesverbal i sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 7–10. P2831 (Shënime stenografike të sesionit të gjashtë të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 22–33.

¹⁰⁸⁰ P1576 (Procesverbal i sesionit të shtatë të KLM-së, 24 nëntor 1998).

¹⁰⁸¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8928 (23 janar 2007).

¹⁰⁸² Branko Fezer, T. 16501–16502 (27 shtator 2007).

¹⁰⁸³ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 57.

¹⁰⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 167(b).

b. Roli në Këshillin e Lartë të Mbrojtjes, Komandën e Lartë dhe Komandën e Përbashkët

498. Prokuroria argumenton se Ojdaniqi ishte një anëtar pa të drejtë vote i KLM-së, çka i jepte një mundësi të madhe të ndikonte në vendimet e marra nga KLM-ja, dhe se gjatë fushatës ajrore të NATO-s ai mori pjesë në punën e Komandës së Lartë.¹⁰⁸⁵ Prokuroria pretendon se, përmes këtyre organeve, ai mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të Kosovës nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë dhe se, ndonëse nuk ishte anëtar i Komandës së Përbashkët, i zbatoi udhëzimet kësaj ndërmarrjeje dhe ua bëri të njohura vartësve të tij.¹⁰⁸⁶ Mbrojtja e Ojdaniqit kundërpërgjigjet se Ojdaniqi nuk ishte anëtar i KLM-së dhe se thjesht merrte pjesë në mbledhjet e këtij organi.¹⁰⁸⁷ Mbrojtja e Ojdaniqit shton se ai veprroi vetëm përmes hierarkisë së rregullt komanduese të UJ-së gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.¹⁰⁸⁸

499. Procesverbalet e mbledhjeve të KLM-së tregojnë se prania e shefit të Shtabit të Përgjithshëm ishte rutinë dhe, në periudhën pas emërimit të tij, por përpara fillimit të fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi mori pjesë në të dy mbledhjet e zhvilluara të KLM-së.¹⁰⁸⁹ Në këto mbledhje, ai u raportoi të pranishmëve dhe ofroi mendimet e veta. Gjithsesi nuk ka prova që ai të ketë pasur të drejtë vote në KLM. Ojdaniqi mori pjesë për herë të parë në mbledhje të KLM-së më 25 dhjetor 1998, pasi u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰⁹⁰ Atje ai bëri një prezantim të situatës në Kosovë, ku shpjegoi masat e sigurisë që kishte ndërmarrë UJ-ja.¹⁰⁹¹ Ai propozoi dhe mbështeti aktivisht zëvendësimin e Dushan Samarxhiqit si komandant të Armatës së Tretë, me Pavkoviqin, dhe emërimin e Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës.¹⁰⁹²

500. Ojdaniqi mori pjesë në mbledhjen e radhës së KLM-së më 23 mars 1999 dhe dha një informacion të aktualizuar të masave të marra në përgatitje të mbrojtjes së vendit nga një aksion i mundshëm ushtarak i NATO-s.¹⁰⁹³ Duke mbyllur diskutimin, Millosheviqi u kujtoi të pranishmëve një prej përfundimeve të mëparshme të KLM-së, të muajit tetor 1998, se nëse sulmohej vendi duhej të vetëmbrohej me të gjitha mjetet. Në të njëjtën mbledhje, KLM-ja miratoi rregulloren e re të

¹⁰⁸⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 754, 767–768.

¹⁰⁸⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 756; Aktakuza, para. 24.

¹⁰⁸⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 223.

¹⁰⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 56.

¹⁰⁸⁹ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3; P1577 (Procesverbal i sesionit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999), f. 1.

¹⁰⁹⁰ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3.

¹⁰⁹¹ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1–3; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 4–7.

¹⁰⁹² P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 13–21.

¹⁰⁹³ P1577 (Procesverbal i sesionit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999), f. 1.

brendshme për funksionimin në të ardhmen.¹⁰⁹⁴ Sipas kësaj rregulloreje të brendshme, shefi i Shtabit të Përgjithshëm ose zëvendësi i tij kishte për detyrë të ishte i pranishëm gjatë mbledhjeve, të cilat nuk mund të zhvilloheshin në mungesë të tij dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm mund të kërkonte mbajtjen e mbledhjes, dhe mund t'i bënte propozime KLM-së lidhur me emërimet, gradimet dhe lirin e admiralëve dhe gjeneralëve të UJ-së.¹⁰⁹⁵ Si rrjedhojë, teorikisht, roli i Ojdaniqit në këtë organ, pas datës 23 mars 1999, ishte më i gjerë se më parë, megjithëse nuk ishte i barabartë me statusin e anëtarit me të drejtë vote. Sidoqoftë ndër provat mungojnë procesverbale të mbledhjeve të KLM-së të mbajtura gjatë fushatës së NATO-s dhe Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi nëse e ka ushtruar dhe si e ka ushtruar Ojdaniqi këtë rol të fuqizuar. Rrjedhimisht Dhoma arrin në përfundimin se roli i shefit të Shtabit të Përgjithshëm konsistonte në angazhimin e tij të konsiderueshëm në punën e KLM-së, organi përgjegjës i praktikës së përdorimit të UJ-së. Krahas kësaj, shefi i Shtabit të Përgjithshëm kishte kompetencë për të vënë në zbatim vendimet e KLM-së, përmes nxjerrjes së urdhrave për përdorimin e forcave të UJ-së.

501. Dhoma kujton përfundimin e saj se, edhe pse nuk ka prova të drejtpërdrejta për mbledhjet e KLM-së pas datës 23 mars 1999, KLM-ja e mbajti komandën *de jure* të UJ-së në kohë lufte. Pavarësisht nëse anëtarët e mbetur të KLM-së funksionuan ose nuk funksionuan gjatë fushatës ajrore të NATO-s nën emërtesën “Këshilli i Lartë i Mbrojtjes” apo u bënë pjesë e një organi të quajtur “Komanda e Lartë”, është e qartë se ata i mbajtën rolet e tyre *de jure* në komandë të UJ-së, sikurse parashikohet në rregulloren e ndryshuar të brendshme të KLM-së. Nuk ka dyshim se Millosheviqi, si “Kryekomandanti”, ishte maja e strukturës së komandës së UJ-së gjatë gjithë konfliktit.

502. Në një raportim përpara Shtabit të Komandës së Lartë, më 11 prill 1999, Ojdaniqi u tha të pranishmëve se do të bëhej një mbledhje për projektplanin, në orën 9 të nesërmen në mëngjes, me “Komandën e Lartë” dhe përmendi se të pranishëm do të ishin Millosheviqi, Millutinoviqi, Sreten Llukiqi,¹⁰⁹⁶ Shainoviqi dhe Pavkoviqi, së bashku me Smilaniqin, Kërgën dhe vetë atë nga Shtabi i Përgjithshëm.¹⁰⁹⁷ Ky plan përmendet edhe në një dokument tjetër, në një urdhër të Ojdaniqit për komandantin e Armatës së Tretë për përgatitjen e një projektvendimi, i cili do t'i paraqitej “Kryekomandantit” dhe Shtabit të Komandës së Lartë më 11 prill 1999.¹⁰⁹⁸ Më pas, më 12 prill, Millosheviqi ishte i pranishëm në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së

¹⁰⁹⁴ P1577 (Procesverbal i sesionit të nëntë të KLM-së, 23 mars 1999), f. 1–2.

¹⁰⁹⁵ P1738 (Rregullore e KLM-së, 23 mars 1999), nenet 3–5; Ratko Marković, T. 13353 (10 gusht 2007).

¹⁰⁹⁶ Ai përshkruhet si “Sreteni, adjutanti i njësisë së MPB-së nga Kosova”. Branko Gajiqi ishte dakord se bëhej fjalë për Sreten Llukiqin. T. 15416 (11 shtator 2007).

¹⁰⁹⁷ 3D728 (Informim i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3.

¹⁰⁹⁸ P1480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për përgatitjen e planeve për mbrojtje, 9 prill 1999).

Lart dhe dha një urdhër për shpartallimin e forcave të UÇK-së, në bazë të projektplanit të përpiluar një ditë më parë.¹⁰⁹⁹ Dhoma është e mendimit se kjo tregon pjesëmarrjen e Ojdaniqit në organin më të lartë komandues të UJ-së gjatë fushatës ajrore të NATO-s.

503. Më parë Dhoma ka konkluduar se gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, dhe më herët, ekzistonte një organ i njohur si Komanda e Përbashkët, që kishte rol të drejtpërdrejtë në bashkërendimin e forcave ushtarake dhe të sigurisë që vepronin në Kosovë. Ojdaniqi e përmendi Komandën e Përbashkët disa herë, gjatë periudhës që mbulon Aktakuza. Më 17 prill 1999, Ojdaniqi iu drejtua Komandës së Armatës së Tretë, duke i lidhur shprehimisht një varg “sugjerimesh” lidhur me përgatitjen dhe dislokimin e gjerë të forcave, me një urdhër konkret të Komandës së Përbashkët.¹¹⁰⁰ Sipas Gjorgje Qurçinit, i cili ishte shef i Administratës së Parë të Sektorit të Operacioneve dhe Çështjeve të Personelit të Shtabit të Përgjithshëm, Pavkoviqi erdhi të takohej me Ojdaniqin pas një mbledhjeje me Millosheviqin, duke e anashkaluar kështu eprorin e tij.¹¹⁰¹ Ojdaniqi i shkroi sugjerimet në bazë të një harte të cilën ia tregoi Pavkoviqi, e cila paraqiste situatën në zonën e madhe të Grykës së Rugovës.¹¹⁰² Llazareviqi dëshmoi se arsyeja që Ojdaniqi bëri vetëm sugjerime në vend që të lëshonte urdhra lidhur me këtë dokument, ishte sepse dokumenti ishte përgatitur dhe miratuar në një nivel më të ulët të hierarkisë së UJ-së dhe, si i tillë nuk ishte brenda sferës së komandës së Ojdaniqit.¹¹⁰³ Mirëpo, shefi i Forcave Tokësore në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, Miodrag Simiqi, dëshmoi se sugjerimet, normalisht, vijnë nga poshtë-lart, dhe jo e kundërta.¹¹⁰⁴ Radinoviqi vërejti se, megjithëse “sugjerimet” nuk përbënin një formë të zakonshme të dokumentit ushtarak, prapëseprapë ishin diçka e njohur, dhe ishte i mendimit se, mbase, sugjerimet iu bënë ndonjë organi bashkërendues, të cilin ai e përshkroi si organ që bashkërendonte veprimtaritë e MPB-së dhe UJ-së me anë të një marrëveshjeje.¹¹⁰⁵ Ai pranoi se një komandant që nxirrte sugjerime të tilla duhej ta shihte me vëmendje dokumentin e bashkëlidhur, për t’u siguruar për përmbajtjen e tij.¹¹⁰⁶

504. Përpara kësaj, në një mbledhje të kolegjiut të UJ-së, të mbajtur më 21 janar 1999, u ngrit shqetësimi, kryesisht nga Dimitrijeviqi, mbi angazhimin e ushtrisë në aksionin në fshatin Reçak,

¹⁰⁹⁹ 4D420 (Mesazh i Armatës së Tretë për Komandën e Lartë, 20 prill 1999).

¹¹⁰⁰ 4D420 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999). *Shih edhe* Spasoje Smilaniq, T. 15781 (17 shtator 2007); P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

¹¹⁰¹ Gjorgje Qurçin, T. 17025–17027 (16 tetor 2007).

¹¹⁰² Gjorgje Qurçin, T. 16966–16968 (5 tetor 2007).

¹¹⁰³ Vladimir Llazareviq, T. 18367–18368 (15 nëntor 2007).

¹¹⁰⁴ Miodrag Simiq, T. 15691 (14 shtator 2007).

¹¹⁰⁵ Radovan Radinoviq, T. 17328–17336 (19 tetor 2007); *shih edhe* Gjorgje Qurçin, T. 16970–16974 (5 tetor 2007); 6D1130 (Përmbledhje e Arkivave të UJ-së për 1998 dhe 1999), f. 40.

¹¹⁰⁶ Radovan Radinoviq, T. 17333 (19 tetor 2007).

për të cilin nuk i ishte raportuar Shtabit të Përgjithshëm.¹¹⁰⁷ Ojdaniqi e zbuti këtë shqetësim në mbledhje duke i kujtuar shtabit “metodikën e bashkërenduar mirë për përdorimin e forcave dhe vendimmarrjen”.¹¹⁰⁸ Bie në sy fakti se ai e karakterizoi metodikën si “mjaf të rrezikshme dhe jo aq të justifikueshme nga këndvështrimi ushtarak”.¹¹⁰⁹ Ojdaniqi përmendi kalimthi se “*nëse shtabi a komanda e përbashkët apo gfarëdo që të quhet*” vendoste që një operacion në fshatin Reçak nuk mund të realizohej pa ndihmën e UJ-së, do të duhej të kërkohej miratimi i Presidentit të RFJ-së.¹¹¹⁰ Në fund, Ojdaniqi përmendi përdorimin e forcave të UJ-së në Kosovë, duke përfshirë “*komandën e përbashkët* atje, përmes së cilës Presidenti më urdhëron mua”.¹¹¹¹

505. Është vërtetuar se në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, shefi i Shtabit të Përgjithshëm morri pjesë rregullisht në mbledhjet e KLM-së. Megjithatë nuk ka prova që të ketë pasur ndonjëherë të drejtë vote apo kompetenca vendimtarëve pranë këtij organi,¹¹¹² procesverbalet e mbledhjeve të KLM-së tregojnë se ai mori pjesë në diskutimet për çështjet strategjike, përfshirë edhe nevojën për bashkëpunim më të ngushtë midis UJ-së dhe MPB-së,¹¹¹³ dhe për çështje të rëndësishme të personelit, siç ishte emërimi i Pavkoviçit si komandant i Armatës së Tretë.¹¹¹⁴ Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi vijoi pjesëmarrjen në organin kryekomandues të UJ-së. Megjithatë Ojdaniqi nuk ishte anëtar i Komandës së Përbashkët, ai qe në dijeni të saj dhe e pranoi funksionimin e saj.

c. Armatosja e popullatës joshqiptare

506. Prokuroria pretendon se Ojdaniqi mori pjesë në armatosjen e popullatës joshqiptare në Kosovë, e cila më vonë u përdor për të ndihmuar në dëbimin e shqiptarëve kosovarë.¹¹¹⁵ Sipas Prokurorisë, Ojdaniqi ishte në dijeni dhe u përfshi në armatosjen e civilëve joshqiptarë në Kosovë, të paktën që nga në muaji dhjetor 1998.¹¹¹⁶ Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se këto masa u morën

¹¹⁰⁷ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 9.

¹¹⁰⁸ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999).

¹¹⁰⁹ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999).

¹¹¹⁰ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 11 (theksi është shtuar).

¹¹¹¹ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 12 (theksi është shtuar). *Shih edhe* Radomir Çuçak, T. 14867 (4 shtator 2007); Branko Kërگا, T. 16870 (4 tetor 2007); Lubomir Angjelkoviç, T. 16440 (26 shtator 2007).

¹¹¹² Ratko Markoviç, T. 13352–13354 (10 gusht 2007); 3D1116 (Aktespertizë e Radovan Radinoviçit), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 86–87.

¹¹¹³ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3–4; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 7–11.

¹¹¹⁴ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 13–21.

¹¹¹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 47.

¹¹¹⁶ 3D438 (Shënime lidhur me takimin midis Drewienkiewicz-it dhe Ojdaniqit, 15 dhjetor 1998), f. 3; P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 9; P931 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23.

para emërimit të Ojdaniqit si shef i Shtabit të Përgjithshëm, se armatosja e civilëve ishte një kundërpërgjigje legjitime dhe proporcionale ndaj rrezikut të paraqitur nga UÇK-ja dhe se të gjithë civilët të cilët u pajisën me armë kishin role legjitime brenda strukturave shtetërore në kohë lufte.¹¹¹⁷

507. Natyra e popullatës së armatosur joshqiptare dhe procesi i armatosjes së këtij grupi janë analizuar në Pjesët VI.A dhe VIII.B, ku arrihet në përfundimin se në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999 rreth 60 mijë joshqiptarë u pajisën me armë për t'i përdorur në fshatrat e tyre, ndërsa shqiptarët kosovarë po çarmatoseshin. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi ishte i pranishëm në mbledhjet ku u diskutua për procesin e armatosjes dhe për rrezikun mundshëm të keqpërdorimit të këtyre armëve nga joshqiptarët.¹¹¹⁸ Në mbledhjen e kolegjiut, të datës 2 shkurt 1999, Ojdaniqi përmendi se kishte dëgjuar se kishte “50 mijë serbë të armatosur”.¹¹¹⁹ Samarxhiqi, i cili në atë kohë ishte Shef i Inspektoratit të UJ-së, u përgjigj se, duke gjykuar nga sasia e armëve të shpërndara, ishin 47 mijë dhe se disa mijë syresh ishin “nisur që më parë me armët e tyre”. Ojdaniqi e pyeti Samarxhiqin, “cilat janë detyrat e këtyre serbëve të armatosur dhe cili është plani për t'i inkuadruar ata në njësi”.¹¹²⁰ Samarxhiqi i informoi të pranishmit në kolegjiut se roli i serbëve të armatosur ishte “të mbronin fshatrat e tyre dhe të merrnin pjesë së bashku me njësitë e ushtrisë në operacione në afërsi të tyre”.¹¹²¹ Informacioni që dha Samarxhiqi tregon se Ojdaniqi kishte dijeni për armatosjen e popullatës joshqiptare nga UJ-ja dhe për faktin se këta persona mendohej të përdroreshin për të ndihmuar në operacionet e UJ-së.

508. Një vlerësim i bërë nga Sektori për Çështje Operative të Personelit i Shtabit të Përgjithshëm, lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë, në shkurt 1999, përmendte “rrezikun” se popullata e armatosur joshqiptare mund të organizohej më vete dhe ta “ndërlikonte” situatën.¹¹²² Lidhur me këtë vlerësim, Brano Gajiqi, zëvendës shef i Administratës së Sigurimit të UJ-së në vitin 1998 dhe 1999, dëshmoi se ekzistonte shqetësimi se popullata e armatosur joshqiptare do të angazhohej në konflikte ndëretnike kundër shqiptarëve kosovarë të cilët, sipas atij, qenë armatosur nga UÇK-ja.¹¹²³

509. Në kundërshtim të pretendimit se UJ-ja, MPB-ja apo Ministria Federale e Mbrojtjes kishin armatosur vetëm civilë joshqiptarë, Mbrojtja e Ojdaniqit vë në dukje përpjekjen për të krijuar një

¹¹¹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 23, 42.

¹¹¹⁸ P928 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 9; P939 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 21 janar 1999), f. 16–17.

¹¹¹⁹ P931 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23.

¹¹²⁰ P931 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23.

¹¹²¹ P931 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23.

¹¹²² 3D685 (Vlerësim i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për informacionin mbi sigurinë, shkurt 1999).

Detachment Territorial Ushtarak Shqiptar, si shembull i armatosjes së popullatës shqiptare kosovare.¹¹²⁴ Megjithëse, ishte ideja që një kolonel, Vladimir Ristiçi, do ta organizonte dhe bashkërendonte këtë repart dhe se ai do të vepronte në kuadër të UJ-së,¹¹²⁵ kjo përpjekje nuk pati sukses, duke qenë se shumica e shqiptarëve kosovarë nuk dëshironin të hynin në të.¹¹²⁶

510. Ojdaniqi ishte në dijeni dhe nuk e kundërshtoi përdorimin e popullatës së armatosur joshqiptare gjatë konfliktit në 1999. Në “sugjerimet” e tij, të datës 17 prill, të cilat lidheshin me një urdhër të Komandës së Përbashkët të datës 15 prill, ai e orientonte Korpusin e Prishtinës, së bashku me “popullatën e armatosur joshqiptare”, që t’i jepnin mbështetje MPB-së për shpartallimin dhe shkatërrimin e “FTSH-së” në sektorin e Grykës së Rugovës.¹¹²⁷

511. Dhoma bindet se Ojdaniqi kishte dijeni për përfshirjen e UJ-së në armatosjen e popullatës joshqiptare në Kosovë. Përpjekja e pasuksesshme për të formuar një njësi brenda UJ-së, me përbërje shqiptare kosovare, nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë çështje, duke qenë se pretendimi i Prokurorisë lidhet me përpjekjet për të krijuar një atmosferë në të cilën do të kryheshin krime nga civilët serbë kundër shqiptarëve kosovarë, çka nuk do të ndikohej nga krijimi i një njësie me shqiptarë kosovarë brenda radhëve të UJ-së.

d. Qëndrimi në lidhje me Marrëveshjet e Tetorit

512. Lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare të arritura në tetor 1998, Prokuroria pretendon se pasi i u bë shëf i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi nuk i përmbushi detyrimet e tij në kuadër të Marrëveshjeve të Tetorit, duke qenë se nuk bashkëpunoi tërësisht me KVM-në, e rriti numrin e forcave të UJ-së në Kosovë dhe forcat e UJ-së të vendosura atje u përdorën në operacione që i shkelnin këto marrëveshje.¹¹²⁸ Në përgjigje të këtij pretendimi, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se ai mori masa për të mundësuar bashkëpunimin e UJ-së me KVM-në dhe se dislokimi i trupave të tjera shtesë në Kosovë përputhej me marrëveshjen Clark-Naumann, duke qenë se ishte reagim mbrojtës legjitim ndaj veprimtarisë së UÇK-së dhe, më vonë, ndaj rrezikut të pushtimit tokësor nga NATO-ja.¹¹²⁹ Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se, pavarësisht nga fakti nëse interpretimi i RFJ-së

¹¹²³ Branko Gajiq, T. 15252–15253 (7 shtator 2007).

¹¹²⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 28; P1471 (Urdhër për Krijimin e “Njësisë Territoriale Ushtarake në Kohë Luftë”, 31 mars 1999).

¹¹²⁵ Zllatomir Peshiq, T. 7250 (23 nëntor 2006).

¹¹²⁶ Zllatomir Peshiq, T. 7250 (23 nëntor 2006).

¹¹²⁷ 4D420 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999), f. 1, ku përmendet P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

¹¹²⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 776.

¹¹²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 7, 63, 75, 85, 97, 194.

për Marrëveshjet e Tetorit ishte i saktë, Ojdaniqi ishte i detyruar ta pranonte këtë interpretim dhe ta zbatonte atë.¹¹³⁰

513. Çështja e respektimit të Marrëveshjeve të Tetorit është diskutuar më lart në Pjesën VI.D, ku konstatohet se UJ i shkeli qëllimisht këto Marrëveshje përmes angazhimit të forcave në incidentin e Podujevës, se shtimi i efektivit të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 binte ndesh me Marrëveshjet e Tetorit, siç binte ndesh edhe mbajtja e armëve dhe pajisjeve të rënda nga MPB-së, të cilat ishte e detyruar t'ia kthente UJ-së. Këtu do të analizohet qëndrimi i Ojdaniqit në lidhje me këto shkelje.

514. Në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Ojdaniqi nxori urdhra ku thuhej se UJ duhej ta rriste bashkëpunimin me KVM-në.¹¹³¹ Kur u takua me Drewienkiewicz-in, Ojdaniqi tha se UJ do të bënte manovra stërvitore jashtë kazermave, por pyetjeve për hollësi lidhur me vendndodhjen e stërvitjeve ai nuk iu përgjigj.¹¹³² Duke folur për këto manovra të UJ-së në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, në mbledhjet e kolegjiut të UJ-së Dimitrijeviqi shprehu shqetësimin e tij se në raportet e Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, operacionet e planifikuara të Korpusit të Prishtinës në Kosovë po raportoheshin si reagime mbrojtëse ndaj sulmeve të UÇK-së.¹¹³³ Lidhur me incidentet rreth Podujevës, një raport bën të ditur se Ojdaniqi e miratoi vendimin për t'i mbajtur forcat në aerodromin e Batllavës në atë zonë, përkundër presionit të ushtruar nga KVM-ja për t'i larguar.¹¹³⁴ Në një mbledhje të kolegjiut, të datës 30 dhjetor, Dimitrijeviqi e informoi Ojdaniqin, se përdorimi i efektivit të UJ-së nuk ishte një aksion mbrojtës, duke thënë:

Pas të ashtuquajturave manovra të planifikuara, të pretenduara apo të vërteta, në të cilat kjo kompani u angazhua në terren... Gjeneral këto lloj lëvizjesh do të na çojnë në katastrofë; shpjegimi se ishte manovër e planifikuar, nuk është i vërtetë. Ishte planifikuar

¹¹³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 183.

¹¹³¹ 3D408 (Urdhër Shtesë i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për vënien në zbatim të detyrimeve të UJ-së, 23 dhjetor 1998); Dushan Llonçar, T. 7676–7677 (1 dhjetor 2006). 3D409 (Urdhër i Ekipit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Kontaktet me Misionet e OSBE-së dhe NATO-s, 22 tetor 1998); 3D405 (Përmbledhje e detyrimeve dhe metodikës së punës me OSBE-në, 16 tetor 1998); 3D411 (Udhëzime për marrëdhëniet e UJ-së me OSBE-në, tetor 1998). 3D407 (Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së – Urdhër për organizimin e punës dhe marrëdhëniet me OSBE-në, 8 mars 1999); *Shih edhe* Dushan Llonçar, T. 7677–7680 (1 dhjetor 2006).

¹¹³² Karol John Drewienkiewicz, T. 7918 (5 dhjetor 2006), P2508 (deklaratë e dëshmitarit, datë qershor 2000), para. 64–66; P2535 (Shënime të takimit me Ojdaniqin, 27 nëntor 1998).

¹¹³³ P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14; P933 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15; P938 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627, T. 26653–26654 (8 korrik 2008).

¹¹³⁴ P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 3–4; Millorad Obradoviq, T. 14948 (4 shtator 2007); 3D785 (Ekipi i Armatës së Tretë për marrëdhënien me OSBE-në dhe NATO-n, Raport i Misionit, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; 4D423 (Raport: Armata e Tretë për Qendrën Operative të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 dhjetor 1998), f. 3; P924 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 14.

që njësia t'i provokonte terroristët në mënyrë që, pastaj, MPB-ja të bënte atë që duhej të bënte.¹¹³⁵

Përgjigjja e Ojdaniqit ishte se përdorimi i trupave të UJ-së në Podujevë ishte pjesë e një manovre stërvitore të vërtetë dhe se për këtë e kishte siguruar komandanti i Armatës së Tretë, i cili, asokohe, ishte Samarxhiqi.¹¹³⁶ Mirëpo, Millorad Obradoviqi, shef i Sektorit për Çështje Operative dhe të Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, tha në mbledhje se UJ-ja kishte “mundur ta evitonte regjistrimin e tij si një grup luftimi” duke e quajtur manovër stërvitore, duke lënë të kuptohej se dihej që bëhej fjalë për një operacion luftimi.¹¹³⁷ Më pas, në një mbledhje të kolegjiut të UJ-së, më 2 shkurt 1999, Ojdaniqi theksoi se “një grup” i forcave të UJ-së në Kosovë kishte shkelur Marrëveshjen Clark-Naumann, por nuk dha asnjë informacion për aktivitetet.¹¹³⁸

515. Gjatë javës 26 shkurt-4 mars 1999, vëzhguesit e OSBE/KVM-së në zonën e Kaçanikut raportuan se “autoritetet serbe” kishin kryer manovra në vende të cilat mund të kishin ndezur konflikte, kishin shtuar patrullat në zonat me ndikim të fortë të UÇK-së dhe kishin imponuar pushtetin e tyre ndaj anëtarëve të KVM-së.¹¹³⁹ Dimitrijeviqi i përmendi këto provokime në kolegjiut më 4 mars 1999. Ai tha se Armata e Tretë po e gënjente Shtabin e Përgjithshëm lidhur me veprimet e veta në Kosovë, duke qenë se ato qenë të planifikuara dhe jo reagime mbrojtëse ndaj sulmeve dhe se Shtabi i Përgjithshëm nuk duhej ta pranonte këtë praktikë duke qenë se kjo kishte të bënte me informacion për të cilin ata “duhej të viheshin në dijeni”.¹¹⁴⁰ Ai vijoi se “historitë se një kolonë ushtrie ishte sulmuar këtu apo atje mund t’ua mbushin mendjen tanëve, por nuk kanë asnjë kuptim për ata që janë jashtë sepse faktet janë të dukshme”.¹¹⁴¹ Ai tha se ky ishte shtrembërim faktesh dhe se gënjeshttrat dhe cilësimi i operacioneve si veprime mbrojtëse do të krijonte problem për Shtabin e Përgjithshëm. Ai i përsëriti këto deklarata në mbledhjen e kolegjiut të datës 18 mars 1999, duke thënë:

Ka pasur 16 sulme kundër njërive të ushtrisë sonë brenda një jave. A ndodhi ndonjë prej këtyre operacioneve kur ne po bënim një operacion të planifikuar paraprakisht dhe nuk ishte sulm? ... Unë mendoj se dy të djeshmit janë kryer prej nesh dhe ne nuk u sulmuam. Me fjalë të tjera, ne nuk nisëm një operacion pas një sulmi kundër njërive tona nga

¹¹³⁵ P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 14; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26631 (8 korrik 2008).

¹¹³⁶ P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 17.

¹¹³⁷ P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14–15.

¹¹³⁸ P931 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (UJ), 2 shkurt 1999), f. 20–21.

¹¹³⁹ P680 (Dokumentet Operative të Bashkimit OSBE/KVM), f. 1, 5. *Shih edhe* Karol Drewienkiewicz, T. 7932–7933 (5 dhjetor 2006).

¹¹⁴⁰ P933 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15.

¹¹⁴¹ P933 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 4 mars 1999), f. 9, 15; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627, T. 26653 (8 korrik 2008).

terroristët, por, përkundrazi, siç thonë ata, një spastrim i terrenit, /operacion/ ishte nisur më parë. Pra, kjo po bëhej për t'i dhënë mbështetje MPB-së.¹¹⁴²

Dimitrijeviqi vijoi, “duhet të dini se çfarë po ndodh në të vërtetë, sepse raportet nga Komanda e Korpusit të Prishtinës janë vetëm libra shkolle, kundërsulm, kundërsulm, etj. Unë mendoj se, e pakta që mund të themi është se ka një sjellje jokorrekte kundrejt jush si shef i Shtabit të Përgjithshëm”.¹¹⁴³ Ojdaniqi e shpërfilli këtë vërejtje, duke thënë “a keni ndonjë sugjerim si ta zgjidhim? Nëse jo, atëherë vazhdojmë me të tjerat”.¹¹⁴⁴ Më vonë, atë mbrëmje, Ojdaniqi iu kthye kësaj teme dhe i informoi të pranishmit se do të fliste me komandantin e Armatës së Tretë, i cili asokohe ishte Pavkoviqi, për këtë problem.¹¹⁴⁵ Sektorit të Çështjeve Operative dhe të Personelit i ngarkoi detyrën e përgatitjes së një urdhri lidhur me përdorimin e “oficerëve tanë në Korpusin e Prishtinës dhe komandën e ushtrisë”, duke thënë se kjo ishte e nevojshme për të parandaluar “çdo veprim të papërmbytur pa dijeninë e ushtrisë dhe të komandantëve të korpusit” dhe për të pasur “ndërgjegjen e pastër se, pak a shumë, kanë bërë gjithçka për të evituar ato që po ndodhnin”.¹¹⁴⁶

516. Kur u pyet lidhur me këto gjëra të përmendura në mbledhje, Dimitrijeviqi shpjegoi se ai ishte i shqetësuar se, ndërkohë që në perëndim po përhapeshin akuza për masakra në Kosovë, raportet nga njësitë në varësi të UJ-së çdo herë thoshin se po vepronin në përgjigje të provokimeve të UÇK-së.¹¹⁴⁷ Ai tha se ai dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm ishin në dijeni se akuzat në perëndim përqendroheshin te këto operacione “spastruese” dhe se ai ishte i shqetësuar për mungesën e përmendjes së këtyre operacioneve në raportet e luftimeve. Ai e paralajmëroi Ojdaniqin se do të ishte “keq nëse do të konstatohej se ai nuk ishte në dijeni të kësaj”, dhe këtu e kishte fjalën për operacione të tilla.¹¹⁴⁸ Dimitrijeviqi dëshmoi se gjatë muajve të tij të fundit në UJ, përpara se ta largonte Millosheviqi më 23 mars 1999, ai e konsideronte problemin e raportimit të Armatës së Tretë ende ekzistues.¹¹⁴⁹ Në përgjigje të pyetjeve për të njëjtat fakte të përmendura, Millorad Obradoviqi tha se pikëpamjet e Dimitrijeviqit nuk ishin ndonjë gjë e re dhe se Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë duhej të mbështetej në informacionin që merrte nga komandat në vartësi.¹¹⁵⁰

¹¹⁴² P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26654 (8 korrik 2008).

¹¹⁴³ P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21.

¹¹⁴⁴ P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 22.

¹¹⁴⁵ P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 25.

¹¹⁴⁶ P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 25; 3D1073 (Detyra nga Mbledhja e Kolegjiumit, 18 mars 1999).

¹¹⁴⁷ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26656 (8 korrik 2008).

¹¹⁴⁸ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26657 (8 korrik 2008).

¹¹⁴⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26654 (8 korrik 2008).

¹¹⁵⁰ Millorad Obradoviq, T. 15107–15108 (6 shtator 2007); *shih edhe* Gjorgje Qurçin, T. 16948 (5 tetor 2007).

517. Dimitrijeviqi kishte ngritur edhe më parë dyshime lidhur me aspektet ligjore, si për shembull në lidhje me praktikën e dhënies hua të pajisjeve të UJ-së, përfshirë edhe helikopterë, MPB-së.¹¹⁵¹ Në mbledhjen e kolegjiut, të datës 24 dhjetor 1998, Ojdaniqi e pranoi se këtë shqetësim ia kishte ngritur Kryekomandanti i Aleancës, Wesley Clark, dhe se vetë Ojdaniqi nuk i kishte kthyer përgjigje pyetjes së tij.¹¹⁵² Në atë mbledhje, Ojdaniqi tha se duheshin respektuar rezolutat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur ishte nevoja për t'i shkelur ato, dhe më pas organet më të larta ushtarake dhe politike të shtetit duhej të merrnin vendimin e duhur.¹¹⁵³

518. Në një përpjekje për ta zbutur konfliktin midis UJ-së dhe MPB-së nga njëra anë dhe UÇK-së, nga ana tjetër, Marrëveshjet e Tetorit i ndalonin UJ-së të sillte njësi të tjera shtesë në Kosovë. Megjithatë, në fillim të vitit 1999, UJ-ja solli një sërë njësisish në Kosovë, për të shtuar efektivat e veta. Në to përfshiheshin Brigada e 37-të e Këmbëorisë,¹¹⁵⁴ Brigada e 72-të Speciale,¹¹⁵⁵ Brigada e 211-të e Blinduar,¹¹⁵⁶ Brigada e 252-të e Blinduar¹¹⁵⁷ dhe kalimi i Korpusit të 21-të të Nishit në varësinë e Brigadës së Tretë të Korpusit të Prishtinës.¹¹⁵⁸ Lidhur me Brigadën e 72-të Speciale, përkundër një udhëzimi të Ojdaniqit për ta mbajtur në brezin kufitar midis Kosovës dhe Shqipërisë, Pavkoviqi e dislokoj këtë njësi në brendësi të Kosovës përpara datës 25 shkurt 1999.¹¹⁵⁹ Ojdaniqi i raportoi Shtabit të Përgjithshëm se, megjithëse nuk kishte qenë dakord për ta dislokuar këtë njësi në brendësi të Kosovës, prapëseprap Pavkoviqi e kishte bërë një gjë të tillë.¹¹⁶⁰ Ojdaniqi u tha të

¹¹⁵¹ 3D557 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 3 dhjetor 1998), f. 19–20.

¹¹⁵² P924 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 26.

¹¹⁵³ P924 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 28.

¹¹⁵⁴ Kjo ndodhi më 10 mars, P1615 (Ditari i Armatës së Tretë), f. 22; P2039 (Raport operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 20 mars 1999); P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 24.

¹¹⁵⁵ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 24; P1947 (Kërkesë e Pavkoviqit për ndërrim varësie, 2 shkurt 1999); P1948 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për ndërrim varësie, 19 shkurt 1999).

¹¹⁵⁶ 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 13 mars 1999); P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 24.

¹¹⁵⁷ 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 13 mars 1999), f. 2; P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 24.

¹¹⁵⁸ 3D680 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për ndërrim varësie të Brigadës së 37-të të Motorizuar të Armatës së Dytë, 6 mars 1999).

¹¹⁵⁹ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 16, 24; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26708 (9 korrik 2008); P1948 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për ndërrim varësie, 19 shkurt 1999); Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklarate e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 54, 65, T. 17656–17657 (26 tetor 2007);

¹¹⁶⁰ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 24; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26648–26649 (8 korrik 2008).

pranishmëve se do të fliste me Pavkoviçin për këtë çështje.¹¹⁶¹ Mirëpo, Ojdaniqi nuk u përpoq ta disiplinonin Pavkoviçin.¹¹⁶²

519. Më pas, në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm të datës 11 mars, Ojdaniqi bëri të ditur se futja e trupave shtesë përbënte shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit, duke u thënë të pranishmëve në mbledhje se ata e dinin “mjaft mirë përse na është dashur t’i shkelim”, arsyeja ishte shtimi i numrit të forcave të NATO-s në kufi dhe rreziku i UÇK-së. Ojdaniqi foli për bisedën e tij me Clark-un, gjatë së cilës pranoi se përforcimet qenë shkelje e marrëveshjes. Ku Clark-u e pyeti përse kishte 25 mijë trupa në kufirin me Shqipërinë, ai nuk e vuri në diskutim numrin, por tha se kjo ishte një kundërpërgjigje e nevojshme ndaj rritjes së numrit të forcave të NATO-s dhe aksioneve të UÇK-së.¹¹⁶³

520. Forcat e UJ-së në Kosovë u shtuan edhe përmes vonesës në largimin e disa njësive. Në mbledhjen e kolegjiut të datës 27 nëntor 1998, Ojdaniqi tha se qarkullimi i trupave duhej t’u raportohet verifikuesve.¹¹⁶⁴ Mirëpo më 15 mars 1999, koha e shërbimit ushtarak të ushtarëve u zgjat pas një vendimi të Presidentit të RFJ-së, çka çoi në mbajtjen e 2.500 - 2.800 ushtarëve në radhët e Korpusit të Prishtinës, deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s dhe pas fillimit të kësaj fushate.¹¹⁶⁵ Ojdaniqi nxori një urdhër për vënien në zbatim të kësaj mase, duke thënë se ishte e nevojshme si masë mbrojtëse që duhej marrë për shkak të “rritjes së presionit të jashtëm mbi vendin tonë dhe rritjes së numrit të trupave të huaja në kufijtë tanë”.¹¹⁶⁶ Mbajtja e ushtarëve rekrutë ekzistues për periudha më të gjata, ndërkohë që vazhdonte ardhja e rekrutëve të rinj, pati si efekt rritjen e numrit të trupave të UJ-së brenda Kosovës.¹¹⁶⁷

521. Duke u bazuar në sa më sipër, Dhoma gjykon se Ojdaniqi ishte në dijeni dhe i miratoi këto shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit. Veprimet e Ojdaniqit lidhur me rritjen e numrit të trupave të UJ-së në Kosovë dhe duke lejuar kryerjen e manovrave provokuese pa u konsultuar me përfaqësuesit e KVM-së, tregojnë se ai ishte i gatshëm t’i shpërfillte detyrimet që rridhnin nga marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi asokohe, për të arritur qëllimin e përdorimit të UJ-së në Kosovë. Mirëpo, fakti se ai dëshironte t’i mbante trupat shtesë të UJ-së në kufirin me Shqipërisë

¹¹⁶¹ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 16, 24.

¹¹⁶² Radovan Radinoviç, T. 17323–17325 (19 tetor 2007).

¹¹⁶³ P935 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 11 mars 1999), f. 21; *shih edhe* Gjorgje Qurçin, T. 17009–17013 (5 tetor 2007).

¹¹⁶⁴ P925 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 27 nëntor 1998), f. 8–9, 16. *Shih edhe* Millorad Obradoviç, T. 14973 (5 shtator 2007).

¹¹⁶⁵ Vladimir Llazareviç, T. 17877–17878 (7 nëntor 2007); 3D750 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 15 mars 1999).

¹¹⁶⁶ 3D750 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 15 mars 1999).

¹¹⁶⁷ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë e dëshmitarit, datë qershor 2000), para. 66. *Por shih* Dushan Llonçar, T. 7645 (1 dhjetor 2006).

dhe se nuk u informua si duhej nga Pavkoviqi për manovrat provokuese që po kryente UJ-ja në atë kohë në Kosovë, tregojnë se motivi i Ojdaniqit për t'i shkelur Marrëveshjet e Tetorit ishte frika që kishte nga një rrezik i njëmendtë nga NATO-ja dhe UÇK-ja, dhe jo dëshira për përgatitjen e një fushate të gjerë shpërnguljeje me dhunë në brendësi të Kosovës.

e. Zëvendësimi i ushtarakëve të lartë të UJ-së

522. Prokuroria pretendon se pasi u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi ndihmoi në zëvendësimin e oficerëve të UJ-së të cilit qenë kundër përdorimit të UJ-së në Kosovë, në mënyrë që të realizoheshin synimet e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹¹⁶⁸ Mbrojtja e Ojdaniqit nuk e trajton konkretisht këtë argument, por argumenton përgjithësisht se asnjë prej veprimeve të Ojdaniqit gjatë periudhës në fjalë nuk kishte asnjë synim tjetër veç qëllimeve ushtarake dhe parashtron se emërimet e bëra prej tij përlligjen nga kualifikimi i personave të emëruar dhe rrethanat e atëhershme në UJ.¹¹⁶⁹

523. Procesverbalet e mbledhjeve të KLM-së tregojnë se, pas emërimit të tij në muajin nëntor 1998, Ojdaniqi e mbështeti vendimin e KLM-së për zëvendësimin e komandantit të Armatës së Tretë, Dushan Samarxhiqit, me Pavkoviqin.¹¹⁷⁰ Emërimi i Pavkoviqit, si komandant i Armatës së Tretë, dhe i Llazareviqit, si komandant i Korpusit të Prishtinës, iu propozuan me shkrim Këshillit të Lartë të Mbrojtjes nga Ojdaniqi në mbledhjen e datës 25 dhjetor 1998.¹¹⁷¹ Kjo erdhi pas një vargu mosmarrëveshjesh midis Samarxhiqit dhe Pavkoviqit lidhur me përdorimin e UJ-së në Kosovë, sikurse u shpjegua më lart.¹¹⁷² Para propozimit të tij për emërimin e Pavkoviqit, Ojdaniqi kishte marrë ankesa për sjelljen e Pavkoviqit nga vetë punonjësit e tij. Në një mbledhje të kolegjiut, më 10 dhjetor 1998, Dimitrijeviqi u ankua për “kaq shumë incidente të pazakonta dhe shumë prej atyre që po ndodhin në Korpusin e Prishtinës janë pikërisht pasojë e ... distancimit të Komandantit të Korpusit dhe, bashkë me të, të gjithë komandës nga UJ-ja”.¹¹⁷³ Ai dëshmoi se këto “incidente të pazakonta” konsistonin në dezertime, plagosje dhe vetëvrasje, dhe jo akte të Pavkoviqit, por shtoi se këto akte qenë ndihmuar nga mungesa e Pavkoviqit nga vendkomanda e tij ndërkohë që

¹¹⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 80.

¹¹⁶⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 148.

¹¹⁷⁰ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 13–21.

¹¹⁷¹ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–7; 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojshta Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998); P800 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojshta Pavkoviqi, 13 janar 1999); P800 (Raport për dorëzimin e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiqi, 13 janar 1999); P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviqi, 9 janar 1999).

¹¹⁷² *Shih, për shembull*, P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura”* (2001)), f. 57; P1439 (Përgjigje e Korpusit të Prishtinës drejtuar Armatës së Tretë, 5 tetor 1998).

¹¹⁷³ 3D484 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14.

qëndronte në Beograd për periudha të gjata.¹¹⁷⁴ Ojdaniqi kishte marrë edhe ankesa të drejtpërdrejta nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, si për shembull nga John Crosland-i, i cili e paralajmëroi Ojdaniqin se Korpusi i Prishtinës, nën komandën e Pavkoviqit, po përdorte forcë të tepruar dhe të padallimtë në Kosovë në vitin 1998.¹¹⁷⁵

524. Megjithatë, në mbledhjen e KLM-së të datës 25 dhjetor 1998, pasi Millosheviqi vërejti se Pavkoviqi ishte treguar “i jashtëzakonshëm” në postin e tij si komandant i Korpusit të Prishtinës, sikurse edhe në postet e mëparshme, Ojdaniqi dha komente më të hollësishme për Pavkoviqin, duke e lëvdur së tepërmi për shërbimin që po i bënte UJ-së dhe e mbështeti emërimin e tij si komandant i Armatës së Tretë.¹¹⁷⁶ Përkundër shqetësimeve të ngritura nga Presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanoviqi, se Korpusi i Prishtinës nuk vepronte gjithmonë në përputhje me rolin kushtetues të UJ-së dhe me vendimet e KLM-së, Millosheviqi e emëroi Pavkoviqin komandant të Armatës së Tretë.¹¹⁷⁷

525. Më 25 mars 1999, Ojdaniqi diskutoi për zëvendësimin e Aleksandar Dimitrijeviqit, shef i Administratës së Sigurimit, nga Geza Farkashi.¹¹⁷⁸ Ojdaniqi tha se kjo çështje ishte në kompetencën e Presidentit të RFJ-së.¹¹⁷⁹ Kjo ndodhi një javë pas mbledhjes së kolegjiut në të cilën Dimitrijeviqi kishte shprehur dyshime se informacioni po shtrembërohej me kast dhe nuk po transmetohej nga forcat e UJ-së në terren.¹¹⁸⁰ Dimitrijeviqi ishte ankuar edhe më parë për dhënien hua të pajisjeve të UJ-së, përfshirë edhe helikopterë, MPB-së.¹¹⁸¹ Ai dëshmoi se Millosheviqi i kishte thënë se ai do të nxirrej në lirim pas viteve të gjata të shërbimit dhe se kishte nevojë të pushonte, mirëpo ai dëshmoi se kjo nuk ishte e vërtetë dhe se Millosheviqi ishte nën presionin e Pavkoviqi dhe njerëzve të MPB-së për ta larguar, sepse ai ishte ankuar për përdorimin e njësisë të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Ai shtoi se këta persona dëshironin që në atë post të ishte dikush “më bashkëpunues”.¹¹⁸²

¹¹⁷⁴ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26624–26628 (8 korrik 2008).

¹¹⁷⁵ P2554 (Raport konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 28 gusht 1998), f. 1; John Crosland, T. 9750–9751, 9787–9790 (7 shkurt 2007)

¹¹⁷⁶ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5, 9–10; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 24–25.

¹¹⁷⁷ 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998).

¹¹⁷⁸ P932 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 shkurt 1999), f. 7, 11–12; P799 (Raport për marrjen e detyrës së Shefit të Administratës së Sigurimit nga Geza Farkash, 25 mars 1999); P803 (Raport për dorëzimin e detyrës së Shefit të Administratës së Sigurimit nga Aleksandar Dimitrijeviq, 25 mars 1999). Dimitrijeviqi dëshmoi se e larguan më 23 mars 1999, T. 26580 (8 korrik 2008).

¹¹⁷⁹ P932 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 shkurt 1999), f. 7, 11–12.

¹¹⁸⁰ P938 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21–22.

¹¹⁸¹ 3D557 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 3 dhjetor 1998), f. 19–20.

¹¹⁸² Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26675 (9 korrik 2008).

526. Në prill 1999, gjeneralin Grahovac e hoqën nga posti i ndihmës-shefit të Shtabit të Përgjithshëm për Forcat Ajrore dhe Mbrojtjen Kundërajrore, pas deklaratave të tij kundër përdorimit të UJ-së në Kosovë, në fund të vitit 1998.¹¹⁸³ Në fund të 1998 dhe fillim të vitit 1999, Grahovaci kishte shfaqur shqetësim për përdorimin që po i bëhej UJ-së në Kosovë, sidomos duke komentuar se UJ-ja kishte blerë helikopterë në shkelje të embargos së vendosur për blerjen e armëve nga burime të huaja, e cila qe vendosur në mars 1998 me Rezolutën nr 1160 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.¹¹⁸⁴ Pyetjes lidhur me këtë, Shefi i Administratës së Personelit të Shtabit të Përgjithshëm, Branko Fezeri, iu përgjigj duke ngulur këmbë se ky nuk ishte lirim nga detyra. Fezeri nguli këmbë se çdo aludim nga Grahovaci se ishte larguar ngaqë nuk i pëlqente metodat e Millosheviqit bëheshin vetëm sepse Grahovaci “nuk ishte i kënaqur me statusin e tij”.¹¹⁸⁵

527. Në prill 1999, Millorad Obradoviqi u emërua komandant i Armatës së Dytë, ndërsa Jagosh Stevanoviqi u emërua shef i Shtabit të tij në bazë të vendimit të Millosheviqit.¹¹⁸⁶ Prokuroria i tha Fezerit se bëhej fjalë për një rast në të cilin një besnik i Millosheviqit vendosej në “një post komandues gjatë luftës”.¹¹⁸⁷ Mirëpo, Fezeri e hodhi poshtë një arsyetim të tillë.¹¹⁸⁸ Komandantit të mëparshëm të Armatës së Dytë, Martinoviqit, i dhanë një rol si “këshilltar” në Ministrinë Federale të Mbrojtjes, i cili u deklarua si “ulje në detyrë”.¹¹⁸⁹ Ojdaniqi ishte në dijeni të emërimit dhe gjatë mbledhjes së Shtabit të Komandës së Lartë të datës 3 prill 1999 tha se nuk duhej të flitej për këtë zëvendësim.¹¹⁹⁰ Fezeri pranoi se roli i këshilltarit kishte më pak prestigj se ai i një gjenerali me përgjegjësi komanduese, diçka që e pohoi edhe Aleksandar Vasileviqi.¹¹⁹¹

528. Megjithëse Ojdaniqi nuk kishte kompetencë vendimmarrëse për emërimet dhe largimet e ushtarakëve të UJ-së me gradën e gjeneralit dhe për postet për të cilat kërkohet grada e gjeneralit, ai kishte kompetencë për t’ia paraqitur këto propozime KLM-së për shqyrtim dhe Presidentit të RFJ-së për vendim. Lidhur me emërimin e Pavkoviqit si komandant i Armatës së Tretë, Ojdaniqi u vu në dijeni të shqetësimeve të shprehura nga Gjukanoviqi, për shkak të shpërdorimit të pretenduar të UJ-së në Kosovë. Megjithatë, Ojdaniqi e mbështeti aktivisht këtë emërim. Megjithëse nuk kishte ankese të ngjashme për Llazareviqin dhe Obradoviqin përpara se të emëroheshin, ngritja e tyre në

¹¹⁸³ P1739 (Listë e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së); Branko Kërka, T. 16914 (4 tetor 2007); P797 (Procesverbal i marrjes së detyrës, mbajtur nga Veliçkoviqi dhe Grahovaci, 16 prill 1999).

¹¹⁸⁴ 3D557 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm, 3 dhjetor 1998), f. 19–20; P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998).

¹¹⁸⁵ Branko Fezer, T. 16508–16509 (27 shtator 2007).

¹¹⁸⁶ P1352 (Njoftim i Ministrisë së Informacionit të Malit të Zi, 2 prill 1999).

¹¹⁸⁷ Branko Fezer, T. 16495 (27 shtator 2007).

¹¹⁸⁸ Branko Fezer, T. 16511 (27 shtator 2007).

¹¹⁸⁹ P1352 (Njoftim i Ministrisë së Informacionit të Malit të Zi, 2 prill 1999).

¹¹⁹⁰ 3D721 (Raportim para Shefit të Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 5; Branko Fezer, T. 16510 (27 shtator 2007).

detyrë përputhet me praktikën e shpërblimit të atyre që nuk shprehin dyshime mbi ligjshmërinë e përdorimit të UJ-së në Kosovë. Shkarkimet nga posti të Dimitrijeviqit dhe Grahovacit u bënë për shkak të mosmiratimit të shprehur të atyre që vinin në dyshim ligjshmërinë e aktiviteteve të UJ-së në Kosovë, megjithëse këto largime duket se janë bërë me urdhër të Millosheviqit dhe nuk ka prova që t'i ketë nxitur Ojdaniqi. Për pasojë, është vërtetuar se Ojdaniqi mbështeti emërimin në poste të larta të personave të cilët, ose e mbështesnin angazhimin e UJ-së në Kosovë, ose nuk ngrinin kundërshtime ndaj këtij angazhimi, siç ishte rasti i Pavkoviqit, dhe ishte në dijeni të heqjes nga postet të zyrtarëve të lartë në UJ të cilët ishin kundër përdorimit të UJ-së në Kosovë.

f. Urdhrat ushtarakë për përdorimin e UJ-së

529. Prokuroria pretendon se Ojdaniqi e shfrytëzoi Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së për të planifikuar, drejtuar dhe bashkërenduar operacionet, aktivitetet dhe përdorimin e forcave të UJ-së në Kosovë, për realizimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, që do të arrihej përmes metodave dhe mjeteve kriminale që konsistojnë në një fushatë të gjerësisht të përhapur ose sistematike terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare kosovare.¹¹⁹² Mbrojtja e Ojdaniqit parashton se nuk ka prova, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, që Shtabi i Komandës së Lartë të ketë urdhëruar apo nxitur forcat për të dëbuar popullatën shqiptare kosovare në anën tjetër të kufirit apo për të ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës dhe se të gjitha direktivat dhe urdhrat e lëshuar nga Ojdaniqi orientoheshin nga rreziqet e dala nga UÇK-ja dhe NATO-ja.¹¹⁹³

530. Sikurse u shpjegua më lart, gjatë fushatës ajrore të NATO-s Ojdaniqi takohej me Millosheviqin përditë dhe diskutonte me të për raportet e luftimit dhe propozimet e përgatitura një natë më parë.¹¹⁹⁴ Të dy ata ndodheshin në të njëjtën ndërtesë në Beograd, asokohe.¹¹⁹⁵ Në këto takime, Millosheviqi i jepte Ojdaniqit udhëzime të përgjithshme mbi përdorimin e UJ-së në Kosovë dhe më pas, Ojdaniqi përpilonte urdhrat për përdorimin e UJ-së, me ndihmën e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹⁹⁶

531. Gjatë periudhës përpara fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë ditëve të para të saj, Ojdaniqi lëshoi një sërë urdhrash për mobilizimin e forcave të UJ-së dhe që përbënin bazën për përdorimin e

¹¹⁹¹ Branko Fezer, T. 16501–16502 (27 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8928 (23 janar 2007).

¹¹⁹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 302.

¹¹⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 195.

¹¹⁹⁴ Gjorgje Qurçin, T. 16979 (5 tetor 2007); Branko Gajiq, T. 15417 (11 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (përmbledhje e dëshmitarit, datë 26 tetor 2006), para. 15; Radovan Radinoviq, T. 17253 (18 tetor 2007).

¹¹⁹⁵ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26717 (9 korrik 2008).

¹¹⁹⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 15; Radovan Radinoviq, T. 17248 (18 tetor 2007); Radovan Radinoviq, T. 17238–17239 (18 tetor 2007); Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë e dëshmitarit, datë 15 gusht 2007), para. 29.

tyre në Kosovë. Më 16 janar 1999, Ojdaniqi nxori një plan për mbrojtjen e vendit në rast të një sulmi nga jashtë, i njohur si plani “Grom 3”.¹¹⁹⁷ Ky urdhër ofronte bazën për operacionet e UJ-së kundër rrezikut të NATO-s dhe kundër UÇK-së në brendësi të Kosovës. Kjo direktivë cilësohej si forca armike UÇK-në brenda Kosovës, UÇK-në në Shqipëri dhe forcat e NATO-s në rajon. Faza e parë e operacionit ishte marrja e masave për të penguar hyrjen e NATO-s në Kosovë dhe, në bashkërendim me MPB-në, për të “bllokuar” UÇK-në në Kosovë. Objektivi i fazës së dytë ishte “dërrmimi dhe shkatërrimi” i forcave të NATO-së dhe UÇK-së, në bashkërendim me MPB-në.¹¹⁹⁸ Më 10 mars, Ojdaniqi u dha urdhër Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Dytë të vepronin së bashku në bllokimin e rrugëve për të parandaluar lëvizjen e forcave të UÇK-së.¹¹⁹⁹ Llazareviqi dëshmoi se ky urdhër ishte “konkretizim” i planit “Grom 3” dhe se kërkonte që Armata e Dytë dhe Armata e Tretë t’i bashkërendonin veprimtaritë e tyre për bllokimin e të gjitha rrugëve midis Kosovës dhe Malit të Zi në zonën e Grykës së Rugovës.¹²⁰⁰ Krahas urdhrave për vënien e njërive të ndryshme në varësi të njërive të UJ-së në Kosovë, sikurse është përshkruar më lart, Ojdaniqi mobilizoi edhe Detashmentet Territoriale Ushtarake në Prishtinë,¹²⁰¹ Mitrovicë, Pejë dhe Prizren.¹²⁰²

532. Në bazë të urdhrat “Grom 3” të Ojdaniqit, njësitë e UJ-së u angazhuan në operacione krahas MPB-së në Kosovë. Më 28 mars 1999, njësitë e Korpusit të Prishtinës morën urdhër të mbështesnin operacionet e MPB-së për shkatërrimin e UÇK-së në zonën e Malishevës.¹²⁰³ Më 30 mars, Komanda e Armatës së Tretë i dërgoi një telegram Shtabit të Komandës së Lartë, drejtuar personalisht Ojdaniqit, ku thuhet se kishte nisur operacionet në zonën e Malishevës, Rahovecit, Suharekës, fshatit Duhël dhe fshatit Guncat.¹²⁰⁴ Ndër këto vendndodhje përfshihen disa të përmendura në Aktakuzë si vende krimesh dhe në lidhje me të cilat Dhoma ka dëgjuar dëshmi për kryerjen e akteve kriminale më 25 mars 1999 dhe gjatë ditëve në vijim.¹²⁰⁵ Lidhur me këto urdhra, Mbrojtja e Ojdaniqit citon dëshminë e Radojko Stefanoviçit se zonat e Kosovës së Vogël, Drenicës

¹¹⁹⁷ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva “Grom 3”, 16 janar 1999).

¹¹⁹⁸ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva “Grom 3”, 16 janar 1999); Vladimir Lazareviq, T. 17894 (8 nëntor 2007).

¹¹⁹⁹ 3D696 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 mars 1999).

¹²⁰⁰ Vladimir Lazareviq, T. 17895–17896 (8 nëntor 2007).

¹²⁰¹ 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 13 mars 1999).

¹²⁰² P1925 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 mars 1999); *Shih edhe* P1924 (Kërkesë nga Pavkoviçi për mobilizim, 23 mars 1999).

¹²⁰³ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999). *Shih edhe* P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999); P2035 (Raport Luftimi i Komandës së Brigadës së 125-të të Motorizuar, 30 mars 1999); P2802 (Ditar lufte i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar); P2047 (Raport operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 29 mars 1999).

¹²⁰⁴ P1446 (Dokument i Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999). *Shih edhe* 4D307 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë të dërguar nga Pavkoviçi Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999).

¹²⁰⁵ Aktakuza, para. 72 dhe 75.

dhe Malishevës ishin zona delikate ku ekzistonte frika se mund të zbarkonte një forcë shumëkombëshe e NATO-s.¹²⁰⁶

533. Më 9 prill 1999, Ojdaniqi u nisi një direktivë të përgjithshme komandave të grupeve strategjike të UJ-së, për mobilizim dhe përgatitje për luftim, për sigurimin e kufijve dhe për shkatërrimin e UÇK-në. Armatës së Tretë iu ngarkua, ndër të tjera, detyra konkrete për të “dërrmuar dhe shkatërruar” UÇK-në dhe për të organizuar pritjen e “refugjatëve” në kufi, edhe përmes orientimit për “t’u ofruar ndihmë organeve shtetërore për kujdesin e tyre të ardhshëm [për refugjatët]”.¹²⁰⁷

534. Më 17 prill 1999, Ojdaniqi i nisi një dokument komandës së Armatës së Tretë ku kishte një numër “sugjerimesh” lidhur me një urdhër të Komandës së Përbashkët të datës 15 prill, ku Korpusi i Prishtinës dhe “popullata e armatosur joshqiptare” udhëzoheshin t’i jepnin mbështetje MPB-së për shpartallimin dhe shkatërrimin e “FTSH-së” në sektorin e Grykës së Rugovës.¹²⁰⁸ Ojdaniqi sugjeronte se objektivi i shkatërrimit të UÇK-së do të ishte i vështirë për t’u arritur nëse njësitë e Armatës së Tretë ishin nën bllokadë, se duhej të vonoheshin detyrat dhe se duhej ndërmarrë veprim i përbashkët me Armatën e Dytë.¹²⁰⁹

535. Megjithëse nuk ka urdhër me shkrim për operacionin e kryer në luginën e Caragojt në fund të muajit prill 1999, anëtarët e UJ-së thanë se shpërnguljet me dhunë të fshatrave të kësaj lugine u bënë me urdhër që erdhi nga hierarkia komanduese e UJ-së.¹²¹⁰ Kjo përputhet me faktin se ky ishte një operacion i madh që përfshinte një numër njësisish të UJ-së të cilat vepronin së bashku me MPB-në dhe me faktin se për këtë iu raportua Shtabit të Komandës së Lartë.¹²¹¹ Mirëpo, Dhoma vëren se nuk ka prova konkrete që tregojnë saktësisht se në cilin nivel të hierarkisë në UJ u dha urdhri për këtë operacion dhe se nuk ka prova konkrete që tregojnë se Ojdaniqi urdhëroi krimet e kryera gjatë këtij operacioni.

536. Ojdaniqi vijoi t’i jepte urdhra UJ-së për mbështetjen e MPB-në në Kosovë. Më 12 maj ai dha urdhër që një sasi e konsiderueshme armësh, ku përfshiheshin pushkë, municione dhe armë të rënda kundërajrore, t’i vihej në dispozicion MPB-së, në varësi të miratimit nga Ministria Federale e

¹²⁰⁶ Radojko Stefanoviq, T. 21817 (7 shkurt 2008).

¹²⁰⁷ P1481 (Direktivë e Shtabit të Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999); *Shih edhe* Branko Kërگا, T. 16803, T. 16814 (3 tetor 2007), T. 16840 (4 tetor 2007); P1483 (Plotësues i Direktivës DT Numër 22-1 i datës 9 prill 1999, 12 prill 1999).

¹²⁰⁸ P1487 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999), f. 1, ku përmendet P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

¹²⁰⁹ P1487 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999), f. 1–2.

¹²¹⁰ K90, P2652 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 8 dhjetor 2002), para. 40, 41; K73, T. 3382–3383 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

¹²¹¹ 6D1468 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 30 prill 1999), f. 1.

Mbrojtjes.¹²¹² Më 14 maj 1999, ai nxori një urdhër përmes të cilit kërkonte që njësitë policore ushtarake të përdreshin vetëm për detyrat bazë të policisë ushtarake, ku përfshiheshin, ndër të tjera, kontrollet dhe arrestimet, parandalimi i krimeve, dhe në luftime për detyra të tilla si “spastrimi” i terrenit, mbajtja në kontroll e territorit përmes organizimit të postbloqeve dhe patrullave dhe angazhimi në operacionet sulmuese dhe mbrojtëse kundër UÇK-së.¹²¹³

537. Më 25 maj 1999, forcat e UJ-së dhe MPB-së sulmuan qytetin e Lisnajës në komunën e Kaçanikut.¹²¹⁴ Ky ishte një operacion i organizuar, i cili iu raportua hierarkisë komanduese të UJ-së.¹²¹⁵ Ojdaniqi u informua se UJ ishte angazhuar në operacionin në Lisnajë një ditë më parë dhe ditën pas zhvillimit të tij.¹²¹⁶ Pas këtij operacioni, më 29 maj 1999, Ojdaniqi nxori një urdhër të përgjithshëm për përgatitjen për një pushtim të mundshëm tokësor nga ana e NATO-s. Në këtë urdhër ai e udhëzonte Korpusin e Prishtinës të jepte mbështetje me artileri për njësitë e MPB-së që qenë mbërthyer në luftim me UÇK-në jashtë zonës së përgjegjësisë së Korpusit të Prishtinës.¹²¹⁷

538. Pak kohë përpara fillimit të fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë kësaj fushate, Ojdaniqi nxori urdhra që UJ-ja të kryente operacione në mbarë Kosovën, përfshirë edhe mbështetjen për MPB-në. Krahas kësaj, gjatë ditëve të fundit të muajit mars 1999, kur është vërtetuar se kanë ndodhur shumica e krimeve që u kryen në komunat e mbuluara nga Aktakuza, Ojdaniqi mobilizoi njësi shtesë nga detashmentet Territoriale Ushtarake në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren. Rrjedhimisht, Ojdaniqi ishte në dijeni se forcat e UJ-së që kishte nën kontroll po vepronin në këto komuna dhe komuna të tjera në të gjithë Kosovën, gjatë fushatës ajrore të NATO-s.

5. Dijenia dhe reagimi i Ojdaniqit për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe MPB-ja

539. Prokuroria parashtron se Ojdaniqi ishte vënë në dijeni të sjelljes kriminale të forcave që kishte nën kontroll në Kosovë dhe nuk mori masat e nevojshme për t'i dhënë zgjidhje kësaj sjelljeje kriminale.¹²¹⁸ Prokuroria argumenton se, megjithëse efektivë të UJ-së u hetuan dhe ndëshkuan shpesh dhe rregullisht nga gjykatat ushtarake për çështje disiplinore si dezertimi dhe mosbindja,

¹²¹² 3D744 (miratim i Shtabit të Komandës së Lartës, 12 maj 1999). *Shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 18817 (22 nëntor 2007); Vidoje Panteliq 3D1113 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 16 shtator 2007).

¹²¹³ P1493 (Udhëzime të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbi përdorimin e policisë ushtarake në luftime, 14 maj 1999), f. 2.

¹²¹⁴ Fadil Vishi, T. 3555–3557 (19 shtator 2006); P2284 (deklaratë e dëshmitarit, datë 18 tetor 1999), f. 3–4; P2285, *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54, T. 4461 (7 maj 2002).

¹²¹⁵ Kërsman Jeliq, T. 19015–19016 (26 nëntor 2007); 5D666 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 4 maj 1999).

¹²¹⁶ 4D309 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 24 maj 1999), f. 2; 4D335 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 26 maj 1999).

¹²¹⁷ P1465 (Paralajmërim i Shtabit të Komandës së Lartë drejtuar Armatës së Tretë për një operacion të mundshëm të NATO-s, 29 maj 1999), gjithashtu pranuar si P1920.

¹²¹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 823.

thuajse nuk pati procedime penale për krime si dëbimi, vrasjet, përdhunimet, plaçkitjet apo shkatërrimet dhe dëmtime të kryera kundër shqiptarëve kosovarë dhe pasurisë së tyre.¹²¹⁹

540. Mbrojtja e Ojdaniqit përgjigjet se, brenda kompetencave të tij, Ojdaniqi mori masat që kishte në dispozicion. Mbrojtja e Ojdaniqit, më tej, argumenton se, gjatë rrjedhës së luftës, Ojdaniqi merrte informacion të përgjithshëm se po kryheshin krime nga anëtarët e UJ-së, por ai merrte garanci nga raportet të cilat vazhdimisht pohonin se këto krime po merrnin përgjigje nga organet e drejtësisë ushtarake, të cilat qenë autoritetet kompetente për t'i trajtuar këto çështje.¹²²⁰

a. Dijenia për krimet në Kosovë përpara fushatës ajrore të NATO-s

541. Në vitin 1998 dhe 1999, brenda UJ-së ekzistonte një sistem për raportimin e ngjarjeve në Kosovë, sikurse është përshkruar në Pjesën VI.A. Përmes raporteve të luftimit dhe informacionit të dhënë gojarisht në mbledhjet e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm dhe, më vonë, gjatë mbledhjeve informuese të Shtabit të Komandës së Lartë, Ojdaniqi informohej për të rejtat më të fundit lidhur me ngjarjet në Kosovë. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi takohej përditë me Millosheviqin për të diskutuar ngjarjet në Kosovë. Krahas këtyre, UJ-ja kishte postblloqe në vendndodhje të ndryshme në Kosovë, të cilat qenë burim informacioni për lëvizjen e popullsisë.¹²²¹ Miodrag Simiqi dëshmoi se në Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë ndodhej një hartë në mur ku tregoheshin dislokimi i Korpusit të Prishtinës, duke pasqyruar operacionet e tyre gjatë 24 orëve të fundit.¹²²² Rrjedhimisht, Dhoma është bindet se Ojdaniqi kishte një njohuri të hollësishme për ngjarjet e përgjithshme që ndodhën në Kosovë gjatë gjithë vitit 1998 dhe vitit 1999 kur ishte zëvendësues dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.

542. Gjithashtu Dhoma është bindur se në vitin 1998, forcat e MPB-së dhe UJ-së përdorën forcë të tepruar dhe joproporcionale në disa raste në Kosovë.¹²²³ Megjithëse Ojdaniqi u informua se UÇK-ja ishte përgjegjëse për një pjesë të lëvizjes së popullsisë,¹²²⁴ shpërngulja e dhjetëra mijëra shqiptarëve kosovarë u shkaktua, të paktën pjesërisht, nga përdorimi i tepruar i forcës nga UJ-ja dhe MPB-ja në vitin 1998. Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezoluta lidhur me situatën në Kosovë dhe operacionet e UJ-së dhe MPB-së. Më 31 mars 1998, u miratua Rezoluta nr 1160, ku dënohej

¹²¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 832.

¹²²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 265.

¹²²¹ 5D1031 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar për ngritjen e postblloqeve, 18 prill 1999); Hamide Fondaj, T. 3838–3839 (25 shtator 2006); Dragan Zlatković, T. 25292–25294 (15 prill 2008); Nebojsa Bogunović 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 prill 2008), para. 89; Agim Jemini, T. 4278 (28 shtator 2006).

¹²²² Miodrag Simiq, T. 15474 (12 shtator 2007).

¹²²³ *Shih* Pjesën VI.C.

¹²²⁴ *Shih, për shembull*, 3D993 (Raport i Korpusit të Prishtinës, 31 maj 1998); Branko Gajić, T. 15187 (7 shtator 2007); P933 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 4; 3D1050 (Raport për Sigurinë i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, 5 mars 1999).

“përdorimi i forcës së tepruar nga forcat policore serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë në Kosovë”.¹²²⁵ Gjithashtu dënoheshin edhe aktet e dhunshme të UÇK-së.¹²²⁶ Më pas, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën nr 1199, datë 23 shtator 1998, në të cilën shprehej “shqetësimi i madh” për konfliktin në Kosovë dhe “në veçanti lidhur me përdorimin në mënyrë të tepruar dhe pa dallim të forcës” nga MPB-ja dhe UJ-ja, që, sipas rezolutës, kishte rezultuar në “humbje të shumta në njerëz dhe ... në shpërnguljen e mbi 230.000 njerëzve nga shtëpive”.¹²²⁷ Rezoluta nr 1199 dhe kërkesat e saj u përmendën shprehimisht dhe u diskutuan me hollësi në prani të Ojdaniqit në kolegjiunin e datës 23 tetor 1998 të UJ-së.¹²²⁸

543. Ojdaniqi mori informacion konkret në lidhje me vrasjen e një numri civilësh në Abrinë e Epërme në fund të muajit shtator 1998, sikurse përshkruhet në Pjesën VI.C. Më 2 tetor 1998, Sektori për Çështje Operative dhe të Shtabit në Shtabin e Përgjithshëm kërkoi informacion për masakrën e pretenduar në Abrinë e Epërme, duke thënë se, sipas raporteve të ardhura nga Armata e Tretë, më 26 dhe 27 shtator njësitë e Korpusit të Prishtinës dhanë mbështetje me zjarr për njësitë e MPB-së të cilat po kryenin operacione luftarake në fshatrat Abri e Epërme, Abri e Poshtme, Baicë dhe Basilenë. Duke vënë re se mediat e huaja, organizatat humanitare dhe përfaqësuesit e shteteve të huaja kishin raportuar një masakër civilësh, kërkesa kërkonte informacione për masakrën dhe, nëse kishte ndodhur, identitetin e autorëve të krimit.¹²²⁹ Hulumtuesi i organizatës “Human Rights Watch”, Frederick Abrahams, dëshmoi se raporti i organizatës “Human Rights Watch” për këtë incident iu dha Presidencës së RFJ-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme të RFJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë, UJ-së dhe u shpërnda edhe në media.¹²³⁰ Përkundër këtij informacioni, Pavkoviqi e informoi Shtabin e Përgjithshëm se njësitë e UJ-së nuk kishin kryer masakër, por se nuk kishte asnjë informacion të besueshëm për MPB-në.¹²³¹

544. Edhe në vitin 1998, Ojdaniqi i ishte dhënë personalisht informacion lidhur me forcën e tepruar nga UJ-ja në Kosovë. Crosland-i dëshmoi se ai mendonte se Ojdaniqi ishte në brendësi të

¹²²⁵ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998).

¹²²⁶ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998). Në mbledhjen e radhës të kolegjiunin pas miratimit të kësaj Rezolute, ajo nuk u përmend konkretisht, por mendimet e bashkësisë ndërkombëtare u përmendën si nga Ojdaniqi, po ashtu edhe nga Perishiqi. 3D657 (Procesverbal i Kolegjiunin të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 10 prill 1998).

¹²²⁷ P456 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1199, 23 shtator 1998).

¹²²⁸ 3D645 (Procesverbal i Kolegjiunin të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së 23 tetor 1998).

¹²²⁹ 4D403 (Kërkesë e Shtabit të Përgjithshëm për deklaratë me shkrim, 2 tetor 1998). Frederick Abrahams, T. 806 (13 korrik 2006); P441 (Raport i organizatës “Human Rights Watch” me titull *A Week of Terror in Drenica - Humanitarian Law Violations in Kosovo* “Një javë terrori në Drenicë, shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë”, 1 shkurt 1999); Frederick Abrahams, P2227 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 maj 2002), para. 19.

¹²³⁰ Frederick Abrahams, T. 818 (13 korrik 2006), P2228 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 maj 2002), f. 12.

¹²³¹ P1440 (Përgjigje 880 - 290 lidhur me incidentin në zonën e kullës kufitare “Kosara”, 5 tetor 1998).

ngjarjeve për shkak të “informacionit shumë të saktë që i kalonim gjeneralit Ojdaniq dhe shtabit të UJ-së, se UJ-ja ishte e angazhuar aktivisht në operacionet e MPB-së dhe se ata po jepnin ... mbështetje me zjarr si të drejtpërdrejtë me tanke, po ashtu edhe të tërthortë me artileri dhe mortaja”.¹²³² Crosland-i foli për vizitën e tij në komunën e Deçanit me Ojdaniqin në takimin informues të Shoqatës së Atasheve Ushtarakë të Beogradit, më 27 gusht 1998.¹²³³ Ai i tregoi Ojdaniqit se kishte vëzhguar për katër orë zjarrin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi fshatrat Prejlep, Junik, Irzniq dhe Gllogjan, në zonat e Shtimës dhe në Malishevë.¹²³⁴ Crosland-i i tha Ojdaniqit se e kuptonte se roli i UJ-së kishte ndryshuar, por i tha se ky shkatërrim masiv ishte i papranueshëm.¹²³⁵ Ai pohoi se Ojdaniqi nuk i kundërshtoi faktet, por u përpoq të shpjegonte çfarë kishte parë Crosland-i dhe kolegët e tij, duke thënë se UJ-ja vepronte në Kosovë për të mbrojtur linjat e komunikimit.¹²³⁶ Ojdaniqi iu përgjigj informacionit se UJ kishte përdorur forcë joproporcionale në Kosovë, duke thënë se “forcës do t’i përgjigjemi me forcën [e duhur]”.¹²³⁷

545. Crosland-i dëshmoi se në vitin 1998 filmoi granatimin e fshatrave nga ana e UJ-së, e cila përdorte raketalëshuese shumëtytëshe, artileri dhe tanke në mbështetje të drejtpërdrejtë të forcave të MPB-së në Kosovë.¹²³⁸ Ky filmim tregonte predhat që binin brenda fshatrave dhe midis fshatrave. Në deklaratën e tij me shkrim dhe dëshminë me gojë, Crosland-i dëshmoi se ia kishte dhënë videofilmin Ojdaniqit dhe ishte përballur me të për filmimin.¹²³⁹ Mirëpo, më pas, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja e Ojdaniqit, ai tha se ia kishte dhënë Shërbimit të Ndërlidhjes së Huaj, i cili drejtohej nga Negovan Jovanoviqi, dhe se nuk e dinte nëse Ojdaniqi e kishte parë filmimin.¹²⁴⁰ Negovan Jovanoviqi dëshmoi se nuk kishte marrë asnjë video të tillë, as ai, as punonjësit e tij.¹²⁴¹ Edhe Dimitrijeviqi dëshmoi se Crosland-i i tha se kishte një video që tregonte përdorimin e tepruar të forcës nga UJ-ja, por se nuk ia kishte dhënë asnjëherë këtë video.¹²⁴² Dhoma nuk mbështetet në

¹²³² John Crosland, T. 9892–9893 (8 shkurt 2007).

¹²³³ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 42, T. 9750–9751, T. 9792–9794 (7 shkurt 2007).

¹²³⁴ Crosland-i pranoi se në deklaratën e tij si dëshmitar ka dhënë një datë tjetër për këtë takim dhe shpjegoi se ishte gabuar lidhur me datën e saktë në atë kohë të mëparshme. John Crosland, T. 9881–9884 (8 shkurt 2007); 3D512 (Shënime të Crosland-it mbi informimin për situatën në Kosovë nga Ojdaniqi, 28 gusht 1998); *shih edhe* P684 (Raport konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 6 nëntor 1999), f. 2.

¹²³⁵ John Crosland, T. 9804–9805 (7 shkurt 2007). Dimitrijeviqi deklaroi se Crosland-i i tha se UJ-ja po përdorte forcë të tepruar në Kosovë. Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627 (8 korrik 2008).

¹²³⁶ John Crosland, T. 9789–9790, T. 9803–9804 (7 shkurt 2007); John Crosland, 3D507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 maj 1999), para. 26

¹²³⁷ P2554 (Raport konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 28 gusht 1998), f. 1; John Crosland, T. 9750–9751, T. 9787–9790 (7 shkurt 2007).

¹²³⁸ John Crosland, T. 9798 (7 shkurt 2007).

¹²³⁹ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006); John Crosland, T. 9785, 9798 (7 shkurt 2007).

¹²⁴⁰ John Crosland, T. 9785 (7 shkurt 2007), T. 9889–9893 (8 shkurt 2007).

¹²⁴¹ Negovan Jovanoviq, T. 14911–14914 (4 shtator 2007).

¹²⁴² Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26628 (8 korrik 2008).

versionin e Crosland-it lidhur me dorëzimin e një videoje por bindet se Crosland-i ia bëri të ditur gojarisht Ojdaniqit informacionin lidhur me përdorimin e tepruar të forcës nga UJ-ja në vitin 1998.

546. Pasi Ojdaniqi u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm, ai drejtonte mbledhjet e kolegjiut, në të cilat jepeshin raportimet nga grupet strategjike dhe sektorët e administratave të ndryshme. Mbledhja e parë e kolegjiut për Ojdaniqin si shef i Shtabit të Përgjithshëm ishte më 27 nëntor 1998.¹²⁴³ Në këtë mbledhje, pas një raporti për disa incidente jo të zakonshme që kishin të bënin me vdekje jashtë luftimeve të anëtarëve të UJ-së dhe të civilëve, ai i dha detyrën e parë Sektorit për Çështje Operative dhe të Shtabit që t'i kalonin atij personalisht të gjitha raportet nga komandat dhe njësitë për “ngjarjet jo të zakonshme që kishin pasoja fatale”.¹²⁴⁴ Megjithatë, problemet sa i takon raportimin nga Armata e Tretë dhe Korpusi i Prishtinës për veprimet e UJ-së në Kosovë vazhduan edhe gjatë muajit dhjetor 1998 dhe gjatë vitit 1999, sikurse është përmendur më lart. Më pas, pasi Dimitrijeviqi shprehu mosmiratimin e tij për raportimin e operacioneve të Korpusit të Prishtinës në Kosovë si reagime mbrojtëse, më 4 mars 1999, Ojdaniqi i dha detyrë Sektorit për Çështje Operative dhe të Shtabit të përgatiste një urdhër paralajmërues, me arsyetimin se kjo ishte e nevojshme të evitohet çdo rast kur komanda përkatëse nuk është në dijeni të “sjelljeve të tërbuara”, duke garantuar në këtë mënyrë se kishin bërë sa mundën për evituar veprimet e ardhshme.¹²⁴⁵ Gjorgje Qurçini tha se, pas mbledhjes, ai përpiloi një urdhër për ta nënshkruar Ojdaniqi, por nuk tha se çfarë përmbajtje kishte ky urdhër apo nëse u nënshkrua dhe u shpërnda.¹²⁴⁶

547. Ojdaniqi mori masa edhe lidhur me raportimet për aktivitetin kriminal të efektivave të UJ-së. Pasi u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm, ai e pranoi ofertën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (“KNKK”) për të zhvilluar një seminar me oficerë të lartë të UJ-së lidhur me normat e të drejtës humanitare ndërkombëtare, i cili u zhvilluar në ditën e parë të detyrës së Ojdaniqit.¹²⁴⁷ Vetë Ojdaniqi mbajti fjalën hapëse të këtij seminari, i cili u zhvillua më datat 25 dhe 26 nëntor 1998, e cila ishte dita e tij e parë në detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.¹²⁴⁸ Në fjalim ai theksoi se ishin zhvilluar seminare në të gjitha komandat strategjike të UJ-së, me ndihmën e përfaqësuesve të KNKK-së. Në mbyllje të fjalës së tij, ai tha se operacionet ushtarake të RFJ-së në mbrojtje të tërësisë së saj territoriale po kryheshin në përputhje me parimet e të drejtës ndërkombëtare.

¹²⁴³ P925 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 27 nëntor 1998).

¹²⁴⁴ P925 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 27 nëntor 1998), f. 8.

¹²⁴⁵ P938 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 15, 26.

¹²⁴⁶ Gjorgje Qurçin, T. 16948 (5 tetor 2007).

¹²⁴⁷ Zllatoje Terziq, T. 15888–15894 (18 shtator 2007); 3D712 (Urdhër i Ojdaniqit për Përgatitjen e Seminarit, 3 shkurt 1998); 3D713 (Lista e Pjesëmarrësve në Seminar); 3D714 (Raport i Profesor Boroviqit për Seminarin).

¹²⁴⁸ 3D711 (Fjalimi Përshëndetës i Ojdaniqit në Seminarin për Oficerët e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 nëntor 1998).

b. Dijenia për krimet në Kosovë pas datës 23 mars 1999

548. Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s, Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së u shndërrua në Shtabin e Komandës së Lartë, ndërsa mbledhjet e kolegjiut u zëvendësuan nga mbledhjet informative të Shtabit të Komandës së Lartë. Gjatë gjithë konfliktit, sistemi i komandës së UJ-së vijoi funksionimin dhe raportet e luftimit vinin rregullisht nga komandat vartëse në komandat eprore.¹²⁴⁹

549. Më 20 mars 1999, sistemi i raportimit i UJ-së u ndryshua, duke i dhënë fund praktikës së dërgimit të raporteve të veçanta të sigurisë nga organet e sigurimit në njësitë vartëse që i dërgoheshin drejtpërsëdrejti Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë. Praktika e re kërkonte përfshirjen e informacionit që më parë jepej në raporte të veçante në raportet e rregullta të luftimit, të cilat i dërgoheshin Armatës së Tretë dhe prej aty në Shtabin e Komandës së Lartë.¹²⁵⁰ Geza Farkashi dëshmoi se arsyeja e këtij ndryshimi ishte situata e re e luftës dhe përshpejtimi i komunikimeve me njësitë vartëse.¹²⁵¹ Mirëpo, për afërsisht nga data 10 prill e më pas, raportet e luftimit nga Korpusi i Prishtinës i dërgoheshin edhe Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, edhe Komandës së Armatës së Tretë. Radojko Stefanoviqi, i cili ishte komandant i Brigadës së 52-të të Artilerisë së Përzierë të Korpusit të Prishtinës, tha se arsyeja e këtij ndryshimi ishte mundësimi i flukseve të shpejta të informacionit me ndërlikimin e situatës.¹²⁵² Dhoma vëren se ky arsyetim nuk përputhet me arsyetimin e dhënë për ndryshimin e datës 20 mars të sistemit të raportimit, që ndaloi transmetimin e drejtpërdrejtë të raporteve të veçanta të sigurisë Administratës së Sigurimit, sipas të cilit do të përshpejtohej raportimi duke përfshirë raportet e sigurisë në raportet e rregullta të luftimit dhe jo drejtpërsëdrejti komandave eprore. Lidhur me këtë mospërputhje, Dhoma nuk arrin në asnjë konkluzion, por vëren se krimet e kryera brenda zonës së përgjegjësisë së UJ-së duhej të ishin pasqyruar në raportet e rregullta të luftimit.¹²⁵³

550. Gjatë konfliktit, në përgjigje të shqetësimeve për informacionet në raportet e luftimit, Ojdaniqi dha urdhra të përgjithshëm për përmirësimin e organizimit të informacionit që përmbanin

¹²⁴⁹ 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 8, 11; Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 tetor 2007), para. 8, 12–13; P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit drejtuar pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 17; 3D801 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 27 mars 1999), f. 5; Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë e dëshmitarit, datë 15 gusht 2007), para. 11; Brano Gajiq, 3D1084 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 gusht 2007), para. 139–140.

¹²⁵⁰ Branko Gajiq, T. 15188–15189 (7 shtator 2007); Geza Farkash, T. 16292 (25 shtator 2007).

¹²⁵¹ Geza Farkash, T. 16291 (25 shtator 2007).

¹²⁵² Radojko Stefanoviq, T. 21710 (5 shkurt 2008).

¹²⁵³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 55.

këto raporte drejtuar Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁵⁴ Organet e sigurimit i jepnin gjithashtu Ojdaniqit informacion për kryerjen e krimeve në Kosovë, informacion i cili nuk pasqyrohej në raportet e rregullta të luftimit.¹²⁵⁵ Edhe organet e drejtësisë ushtarake i dërgonin informacion Administratës Juridike të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁵⁶

i. Krimet e anëtarëve të UJ-së

551. Me vazhdimin e fushatës ajrore të NATO-së, Ojdaniqi u informua konkretisht për krimet e kryera nga anëtarë të UJ-së. Raportet e luftimit të Armatës së Tretë, të datave 26 dhe 31 mars, përmendnin “incidente të izoluar sjelljeje të papranueshme” dhe “raste individuale grabitjesh”, por shtonin se këto po zgjidheshin nga komandat përkatëse dhe përmendnin edhe nisjen e disa ndjekjeve penale.¹²⁵⁷ Raporti i luftimit i Armatës së Tretë i datës 3 prill përmendte 32 kallëzime penale të cilat i qenë kaluar Prokurorisë Ushtarake për shkelje të disiplinës dhe vepra penale.¹²⁵⁸ Në mbledhjen informative të Komandës së Lartë, po atë ditë, Branko Gajiqi, zëvendës shefi i Administratës së Sigurimit, raportoi se ushtarë të UJ-së kishin kryer vepra penale në Kosovë dhe se 32 vullnetarë ishin çmobilizuar nga radhët e ushtrisë.¹²⁵⁹ Ai dëshmoi se këta vullnetarë ishin përfshirë në vrasjen e tetë civilëve si edhe në grabitje të civilëve dhe në djegien e shtëpive të tyre në Zhegër të komunës së Gjilanit.¹²⁶⁰ Gjatë mbledhjes informative, Ojdaniqi tha se Komanda e Armatës së Tretë do të duhej të jepte shpjegime përse këta 32 vullnetarë ishin të gjithë tok dhe nuk ishin shpërndarë në njësi të ndryshme.¹²⁶¹

552. Më 7 prill 1999, Ojdaniqi përmendi “përvoja negative të mëparshme” ku përfshiheshin zjarrvënia, vjedhjet dhe plaçkitjet e kryera nga anëtarët e UJ-së dhe tha se këto akte së bashku me kryerjen e përdhunimeve, nuk do të toleroheshin.¹²⁶² Përsëri, në mbledhjen informative të datës 18 prill 1999, u dha informacion konkret lidhur me akte kriminale të efektivit të UJ-së. Me këtë rast, Ojdaniqi u informua për një rast në Gjakovë, që kishte të bënte me përdhunimin e një vajze 16-

¹²⁵⁴ 3D678 (Urdhër për Raportet e Luftimit, 30 maj 1999); 3D688 (Udhëzues i UJ-së për Raportet e Luftimit, 30 maj 1999).

¹²⁵⁵ Geza Farkash, T. 16292–16293 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 56; *shih edhe* Momir Stojanoviq, T. 19778–19779, 19818 (7 dhjetor 2007).

¹²⁵⁶ Aleksandar Vasileviq, T. 8964 (23 janar 2007).

¹²⁵⁷ 4D272 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 26 maj 1999), f. 2; 4D273 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 31 mars 1999), f. 2–3.

¹²⁵⁸ 4D276 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 3 prill 1999).

¹²⁵⁹ 3D721 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 2; *shih edhe* P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 2.

¹²⁶⁰ Branko Gajiq, T. 15333 (11 shtator 2007).

¹²⁶¹ 3D721 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 2.

¹²⁶² P1479 (Urdhër lidhur me vullnetarët, 7 prill 1999).

vjeçare shqiptare kosovare nga tre ushtarë të UJ-së.¹²⁶³ Gajiqi dëshmoi se këta ushtarë u arrestuan dhe u proceduan penalisht dhe se, mesa dinte ai, ishin dënuar me burgim.¹²⁶⁴ Raporti i datës 17 prill i Degës së Çështjeve Juridike të Armatës së Tretë e informonte Shtabin e Komandës së Lartë se një anëtar i UJ-së po ndiqej penalisht për vrasje, por se ndjekjet e tjera penale ishin për krime më pak të rënda, si, për shembull, braktisja e pozicionit apo krime kundër pronës.¹²⁶⁵

553. Në të njëjtën kohë, Shtabi i Komandës të Lartë merrte raporte të rregullta në të cilat thuhej se një pjesë e akteve kriminale të efektivave të UJ-së po shqyrtohej nga sistemi i drejtësisë ushtarake.¹²⁶⁶ Në mbledhjen informative të datës 16 prill, ndihmësshefi i Shtabit të Përgjithshëm për Rekrutimin, Mobilizimin dhe Çështjet e Sistemit, Risto Matoviqi, raportoi se organet gjyqësore ushtarake kishin dhënë dënime me burg nga një muaj deri në dhjetë vjet.¹²⁶⁷ Mirëpo, në këto raporte nuk përmendeshin krimet e rënda të dhunshme të kryera nga anëtarët e UJ-së kundër shqiptarëve kosovarë. Dëshmitarët nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë dëshmuar se, megjithëse kishte raporte për krimet individuale të personelit të UJ-së, në raportet që merrte Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë nuk përmendeshin fare shkeljet masive të së drejtës humanitare ndërkombëtare.¹²⁶⁸ Në raportimet për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë gjatë fushatës ajrore të NATO-s, krimet e kryera nga forcat e UJ-së në Kosovë u përmendën vetëm kalimthi.¹²⁶⁹ Kjo përputhet me Ndarjen VI.A.1.e, ku Dhoma arrin në përfundimin se sistemi i drejtësisë ushtarake funksionoi gjatë gjithë fushatës së NATO-s, mirëpo funksionoi në një mënyrë të tillë që vetëm një përqindje e vogël e krimeve të dhunshme kundër shqiptarëve kosovarë u çuan

¹²⁶³ 3D589 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 18 prill 1999), f. 1; *shih edhe* 4D513 (Raport Sigurie i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 18 prill 1999), f. 1.

¹²⁶⁴ Branko Gajiq, T. 15317 (10 shtator 2007).

¹²⁶⁵ 5D1350 (Raport i Degës Juridike të Armatës së Tretë, 17 prill 1999).

¹²⁶⁶ *Shih* 4D273 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 31 maj 1999), f. 2; 4D274 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 1 maj 1999), f. 2; P1937 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 5 maj 1999), f. 3; P1945 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 20 maj 1999), f. 3; 4D281 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 24 prill 1999), f. 2; P1912 (Raport i Armatës së Tretë mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999), f. 1; P1939 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 23 prill 1999); P1940 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 30 prill 1999); P1941 (Raport mbi Punën e Organeve Gjyqësore Ushtarake, 30 maj 1999); 4D260 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 28 maj 1999), f. 2–3.

¹²⁶⁷ 3D587 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999), f. 2.

¹²⁶⁸ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë e dëshmitarit, datë 15 gusht 2007), para. 21. Stanisha Ivkoviq, 3D1117 (deklaratë e dëshmitarit, datë 20 gusht 2007), para. 13, 27; Gjorgje Qurçin, 3D1121 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 gusht 2007), para. 41.

¹²⁶⁹ 3D598 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 28 prill 1999), f. 1 (“Po procedohen 24 individë që kanë shfaqur një formë aktiviteti negativ.”); 3D599 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 29 prill 1999), f. 1 (“Situata e sigurisë është e qëndrueshme, përkundër një incidenti krimi në bazën logjistike të 608-të.”); 3D600 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 30 prill 1999), f. 5 (“Puna e gjykatave është mjaft e ngadaltë.”); 3D601 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 1 maj 1999), f. 1 (“Janë evidentuar 12 raste sjelljeje negative.”); 3D612 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 12 maj 1999), f. 2 (“Është shtuar puna e prokurorëve ushtarakë. Është rritur numri i dënimeve.”); 3D613 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 13 maj 1999), f. 2 (“Është përgatitur urdhri për studimin dhe zbatimin e kodit penal.”).

për ndjekje penale, ndërsa krimet kundër UJ-së apo viktimave serbe u proceduan penalisht në mënyrë më efikase.

554. Gjatë fushatës së NATO-s, Shtabi i Komandës së Lartë mori gjithashtu informacion se “Perëndimi” vazhdonte të ishte i shqetësuar për krimet e përhapura dhe të rënda që po kryheshin në Kosovë. Në mbledhjen e datës 15 prill 1999, Gajiqi raportoi se po veprohej në lidhje me akuzat për varre të përbashkëta.¹²⁷⁰ Ai dëshmoi se Administrata e Sigurimit ishte “përpjekur t’i verifikonte gjërat” por se nuk kishte mundur të merrte hollësi dhe, për pasojë kishte konkluduar se kjo çështje ishte manipulim i mjeteve mediatike.¹²⁷¹ Masat e marra nga Korpusi i Prishtinës në lidhje me këto zbulime jepen me hollësi më poshtë. Më 15 prill, Ojdaniqi i raportoi Kryekomandantit, si edhe Ministrit Federal të Mbrojtjes dhe Presidentit Serb, Millutinoviçit, se burimet e huaja vazhdonin të mblidhnin të dhëna për krimet që pretendoheshin se po kryheshin kundër popullsisë shqiptare kosovare.¹²⁷² Më 16 prill, Ojdaniqi u raportoi po këtyre personave për vijimësinë e këtyre “aktiviteteve psikologjike dhe propagandistike” të huaja, ku “armiku” e vinte theksin te katastrofa humanitare, spastrimi etnik, dokumentimi i varreve të përbashkëta përmes fotografike satelitore dhe përdhunimet masive që po kryheshin në Kosovë.¹²⁷³ Në ditët në vijim, ai përsëri dha raportime të së njëjtës natyrë.¹²⁷⁴ Për më tepër, raportimin e datës 4 maj, Ojdaniqit i thanë se shtypi i huaj po raportonte për vrasjet në masë në RFJ, megjithëse nuk u dhanë hollësi të mëtejshme.¹²⁷⁵

555. Ojdaniqi lëshoi një sërë urdhrash, ku kërkonte respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe ndjekjen penale të anëtarëve të UJ-së të cilët i shkelnin këto norma gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s.¹²⁷⁶ Më 18 prill 1999, Ojdaniqi urdhëroi shpërndarjen, brenda Armatës së Tretë, të 350 kopjeve të një fletëpalosjeje të KNKK-së për ligjet e së drejtës humanitare ndërkombëtare.¹²⁷⁷ Efektivave të UJ-së u jepej zakonisht një fletëpalosje që përmbante udhëzime të përgjithshme lidhur me të drejtën humanitare ndërkombëtare, në momentin e hyrjes në UJ.¹²⁷⁸

¹²⁷⁰ 3D586 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999), f. 1; *shih edhe* 3D821 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 16 prill 1999), f. 6.

¹²⁷¹ Branko Gajiq, T. 15268–15269 (7 shtator 2007).

¹²⁷² 3D820 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999), f. 5.

¹²⁷³ 3D821 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999), f. 6.

¹²⁷⁴ 3D825 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 20 prill 1999), f. 5; 3D826 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 21 prill 1999), f. 6.

¹²⁷⁵ 3D604 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 maj 1999), f. 1.

¹²⁷⁶ 3D1121 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 gusht 2007), para. 32; *shih, p.sh.*, 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999); Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë e dëshmitarit, datë 15 gusht 2007), para. 12; P1477 (Urdhër për Disiplinën Ushtarake, 3 prill 1999); P1486 (paralajmërim për respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare, 16 prill 1999), pranuar edhe si 3D482, 4D216; *Shih edhe* Branko Gajiq, T. 15262 (7 shtator 2007). *Por shih* P1476 (Urdhër për Mbledhjen e të Dhënave për Krimet e NATO-s kundër Njerëzimit, 3 prill 1999).

¹²⁷⁷ Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë e dëshmitarit, datë 8 gusht 2007), para. 145; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 149; 3D1110 (Rregullore për zbatimin e ligjeve ndërkombëtare të luftës në RFSJ), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 89.

¹²⁷⁸ Radomir Gojoviq, T. 16647–16648 (2 tetor 2007); Geza Farkash, T. 16315 (25 shtator 2007).

Më 23 prill 1999, Ojdaniqi nxori edhe një urdhër ku kërkonte që të gjithë oficerëve dhe ushtarëve të UJ-së t' u shpërndareshin dokumente që përmbanin ligjet ndërkombëtare të luftës.¹²⁷⁹

556. Më 26 mars 1999, Prokurorja e atëhershme Tribunalit, Louise Arbour, i shkroi Ojdaniqit, ku e informonte për shqetësimin e saj të thellë lidhur me shkeljet e vazhdueshme të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë. Ajo i sillte në vëmendje dispozita penale të Statutit të Tribunalit për përgjegjësinë penale individuale dhe e nxiste të merrte masa për parandalimin dhe ndëshkimin e kryerjes së krimeve të tilla nga vartësit e tij. Megjithëse duket se, Ministria Federale e Punëve të Jashtme dhe Ministria Federale e Drejtësisë e mbajtën këtë letër për njëfarë kohe përpara se t'ia kalonin Ojdaniqit, është e qartë se ai e mori këtë letër përpara datës 2 maj 1999.¹²⁸⁰

557. Pas marrjes së letrës, më 4 maj 1999 u zhvillua një mbledhje për të diskutuar për ngjarjet në Kosovë gjatë fushatës ajrore të NATO-s, përfshirë krimet që pretendohet se po kryheshin atje dhe reagimin e gjykatave ushtarake.¹²⁸¹ Njoftimet për shtyp të nxjerra pas kësaj mbledhjeje bëjnë të ditura se krahas Ojdaniqit, në të morën pjesë Millosheviqi, Millutinoviqi, Pavkoviqi, Llukiqi dhe të tjerë. Këto raporte, të cilat janë identike në përmbajtje, me përjashtim të disa ndryshimeve gjuhësore, janë kundërshtuar nga Mbrojtja e Ojdaniqit.¹²⁸² Mirëpo, zhvillimi i mbledhjes së datës 4 maj për të trajtuar aktivitetin kriminal që implikonte UJ-në dhe MPB-në në Kosovë mbështetet nga një sërë burimesh dhe njoftimi për shtyp i nxjerrë pas mbledhjes është nxjerrë nga MPB-ja si një urdhër zyrtar për ta lexuar personeli i MPB-së.¹²⁸³ Për më tepër, i pyetur për përmbajtjen e njërit prej këtyre artikujve në shtyp, Millovan Vllajkoviqi, shefi i kabinetit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, tha se ai kishte dëgjuar për këtë mbledhje dhe se mendonte se Ojdaniqi kishte marrë pjesë në të.¹²⁸⁴ Dhoma bindet për besueshmërinë e dokumenteve sa i takon faktit se ato bëjnë të ditur se është zhvilluar një mbledhje, se çështjet e përmendura në to janë diskutuar dhe se u nxor një njoftim për shtyp.

558. Sipas raporteve të mbledhjes, u paraqit informacion se “forcat e sigurisë” ishin marrë me raste të shumta dhune, vrasjesh, plaçkitjesh dhe krimesh të tjera dhe se kishin arrestuar disa qindra

¹²⁷⁹ P1944 (Letër e Bllagoje Kovaçeviqit lidhur me shpërndarjen e dokumenteve të ligjeve ndërkombëtare të luftës), f. 1.

¹²⁸⁰ Millovan Vllajkoviq, T. 16024–16025 (20 shtator 2007); P401 (Letër e Louise Arbour-it drejtuar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999); *shih edhe* 3D1090 (Letër e Louise Arbour-it drejtuar Dragolub Ojdaniqit, me letër shoqëruese nga Ministria e Drejtësisë).

¹²⁸¹ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1; 4D406 (Situata e sigurisë në Kosovë, reportazh në *Politika*, 5 maj 1999).

¹²⁸² T. 16105–16106 (21 shtator 2007), T. 22547 (15 shkurt 2008).

¹²⁸³ *Shih* 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999), pranuar edhe si P2159. Dushan Gavranic, T. 22722 (19 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24188 (12 mars 2008); *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviq, T. 17684 (26 tetor 2007); P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 4; Miroslav Mijatoviq, T. 22286–22289 (13 shkurt 2008).

kriminelë, krimet e të cilëve e kishin vënë në rrezik popullsinë civile.¹²⁸⁵ Të pranishmit në mbledhje arritën në përfundimin se puna e gjykatave ushtarake e kishte bërë “të pamundur” kryerjen e këtyre krimeve në të ardhmen, duke qenë se këto gjykata kishin proceduar shumë çështje për krimet kundër popullsisë civile dhe kishin dhënë një “numër të madh” dënimesh nga pesë deri në 20 vjet burgim për këto krime.¹²⁸⁶ Dhoma vëren se deklarata e dalë nga mbledhja për një “numër të madh” dënimesh nuk përputhet me raporte të ndryshme të nxjerra nga UJ-ja për punën e gjykatave ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s, ku në asnjë vend nuk bëhet e ditur që gjykatat ushtarake të kenë dhënë dënime nga pesë deri në 20 vjet burg për krimet e kryera kundër civilëve gjatë fushatës së NATO-s deri më datë 4 maj 1999.¹²⁸⁷ Duke pasur parasysh këtë mospërputhje me raporte të tjera zyrtare të UJ-së, Dhoma nuk mbështetet në njoftimet për shtyp si prova se gjykatat ushtarake në fakt kishin dhënë dënime të rënda për krimet kundër civilëve të kryera gjatë fushatës së NATO-s.

559. Në një mbledhje të Shtabit të MPB-së për Kosovën më 7 maj 1999 u fol gjithashtu se si krimet e kryera nga anëtarët e UJ-së, përfshirë vrasje, plaçkitje dhe djegie e shtëpive, nuk po procedoheshin sa duhej nga sistemi i drejtësisë ushtarake.¹²⁸⁸ Bozhidar Filiqi dëshmoi se, pas mbledhjes, ai hetoi më tej dhe zbuloi se ata anëtarë të UJ-së për të cilët ishte vërtetuar se kishin kryer krime qenë hetuar por ishin kthyer në njësitë e tyre brenda UJ-së në pritje të fundit të fushatës së NATO-s.¹²⁸⁹ Ky informacion përputhet me versionet për mbledhjen e datës 4 maj, të cilat bëjnë të ditur se gjatë javëve të fundit kundër civilëve në Kosovë ishin kryer krime të shumta, ndër të cilat edhe krime të kryera nga anëtarët e UJ-së, dhe se Ojdaniqi ishte vënë në dijeni të kësaj.

¹²⁸⁴ Millovan Villajković, T. 16081–16082 (20 shtator 2007).

¹²⁸⁵ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

¹²⁸⁶ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1–2.

¹²⁸⁷ P1912 (Raport i Armatës së Tretë mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 30 prill 1999); *shih* P1182 (Informacion i Korpusit të Prishtinës dërguar Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike, 15 maj 1999); 3D986 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbi çështjet penale, 6 shtator 1999); P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002); P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 20 gusht 2001); P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake); P845 (Raport mbi çështjet penale në gjykatat ushtarake për dhunë seksuale, 11 shtator 2002). Dhoma vëren se P962 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, maj 1998–korrik 1999) rendit disa dënime të rënda që janë dhënë, por vëren se këto lidhen me krime të vitit 1998 dhe janë dhënë kundër shqiptarëve kosovarë të përmendur si civilë dhe se Radomir Gojoviqi, i cili ishte kreu i Administratës Juridike të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së gjatë fushatës ajrore të NATO-s në vitin 1999, dëshmoi se ai nuk ishte në dijeni të ndonjë ndjekjeje penale të anëtarëve të UÇK-së në gjykatat ushtarake. Radomir Gojoviqi, T. 16704 (2 tetor 2007). Kjo bën të ditur se përmendja në mbledhjen e datës 4 maj e dënimeve të shumta të rënda për krimet e kryera gjatë fushatës së NATO-s, të dhëna nga gjykatat ushtarake, nuk ishin dënime kundër anëtarëve të UÇK-së për krimet gjatë fushatës së NATO-s.

¹²⁸⁸ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 5–9.

¹²⁸⁹ Bozhidar Filiqi, T. 23976 (10 mars 2008).

560. Pas mbledhjes së datës 4 maj, Ojdaniqi nxori një urdhër ku theksohej fuqimisht nevoja për parandalimin e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare, sikurse përshkruhet më poshtë.¹²⁹⁰ Ai paralajmëroi se përgjegjës do të mbaheshin edhe oficerët nëse ishin në dijeni se qenë kryer shkelje dhe nuk kishin marrë masat e duhura kundër autorëve të shkeljeve.¹²⁹¹ Urdhrit i ishte bashkëngjitur një shtojcë, ku përshkruhej përgjegjësia penale për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të ligjeve ndërkombëtare të luftës, të cilën komandantët e njësisve urdhëroheshin ta studionin me njësitë e tyre.¹²⁹²

561. Në fazat e fundit të fushatës ajrore të NATO-s, Shtabit të Komandës së Lartë iu raportuan akuza për krime të tjera të kryera nga anëtarët e UJ-së. Në mbledhjen e datës 2 qershor të Shtabit të Komandës së Lartë, Farkashi tha se në Kosovë po ndodhnin krime por se kallëzimi i krimeve të kryera nga efektivi i UJ-së në Kosovë nuk po kalonin përmes kanaleve të rregullta dhe se raportet nuk jepnin informacion lidhur me veprimtarinë kriminale të anëtarëve të UJ-së në Kosovë.¹²⁹³ Më tej, Farkashi tha se kufomat e 15 vetëve, mes tyre gra dhe fëmijë, qenë gjetur në zonën e Brigadës së 15-të të Blinduar e cila, sipas Vladimir Marinkoviqit, ishte dislokuar në zonën e përgjithshme të Vushtrrisë.¹²⁹⁴ Kur u pyet për këto komente, Farkashi shpjegoi se, në rrëmujën e tërheqjes së trupave nga Kosova, disa rezervistë kishin përfituar nga rasti për të kryer krime.¹²⁹⁵ Në mbledhjen e datës 4 qershor, Farkashi raportoi se po ngriheshin pretendime se në UJ punonin kriminelë dhe se organet gjyqësore “të mobilizuara” ishin implikuar në veprimtarinë kriminale.¹²⁹⁶ Megjithatë, në mbledhjen e radhës, më 8 qershor 1999, Farkashi raportoi se ishte bërë një analizë dhe se shumica e masakrave dhe krimeve të rënda, që nga plaçkitja e deri te përdhunimet, qenë dokumentuar dhe u ishin kaluar gjykatave ushtarake. Ai raportoi se rreth 95 për qind e autorëve të shkeljeve qenë arrestuar ose po hetoheshin.¹²⁹⁷

ii. Masat e marra në lidhje me vullnetarët

562. Në vitin 1999, UJ-ja pranoi vullnetarë në radhët e saj, sikurse përshkruhet në Pjesën VI.A. Administrata e Rekrutimit, Mobilizimit dhe Çështjeve të Sistemit në Shtabin e

¹²⁹⁰ Radomir Gojoviq, T. 16672–16673 (2 tetor 2007); Millovan Vllajkoviq, 3D1112 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 gusht 2007), para. 15; 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

¹²⁹¹ Radomir Gojoviq, T. 16674 (2 tetor 2007).

¹²⁹² Radomir Gojoviq, T. 16675 (2 tetor 2007); 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

¹²⁹³ 3D633 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 1–3; Geza Farkash, T. 16365 (25 shtator 2007).

¹²⁹⁴ 3D633 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 1.

¹²⁹⁵ Geza Farkash, T. 16301–16302, 16366–16367 (25 shtator 2007).

¹²⁹⁶ 3D635 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 qershor maj 1999), f. 2. Ojdaniqi nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje, por Matoviqi tha se ai do t’ia raportonte përmbajtjen e saj shefit të Shtabit. 3D635 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 qershor maj 1999), f. 4.

Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë ishte zyra e ngarkuar me organizimin dhe mobilizimin e vullnetarëve në UJ.¹²⁹⁸ Zharko Kostiqi, shefi i Zyrës së Pranimi, Përzgjedhjes dhe Stërvitjes së Vullnetarëve, në Armatën e Tretë, dëshmoi se, pas stërvitjes, vullnetarët u kaloheshin njësisive të UJ-së dhe se ky kalim administrohej nga një komision i posaçëm i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së përmes sistemeve kompjuterike, për të shmangur çdo lloj kërkesash personale apo favorizimi.¹²⁹⁹ Slllobodan Kosovaci dëshmoi se në fillim të fushatës së NATO-s, Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë mori masa,¹³⁰⁰ të cilat synonin pengimin e hyrjes së kriminelëve në UJ si vullnetarë.¹³⁰¹

563. Pas marrjes së informacionit se vullnetarët në UJ po kryenin krime të rënda në Kosovë, në fillim të muajit prill 1999 Ojdaniqi nxori një urdhër lidhur me vullnetarët.¹³⁰² Duhej treguar vëmendje e veçantë ndaj rezultateve të ekzaminimeve psikiatrike që duhej të kalonin vullnetarët dhe duhej konsultuar MPB-ja për të parë se ata nuk do të përbënin rrezik për sigurinë. Urdhri ndalonte grupimin e vullnetarëve në një njësi dhe ndalonte rreptësisht aktivitetin e grupeve paraushtarake. Mirëpo, ai lejonte që paraushtarakë të bëheshin vullnetarë nëse i përmbushnin kërkesat e kontrollit fillestar.¹³⁰³ Më pas, më 14 prill 1999 Ojdaniqi nxori një urdhër të dytë për stërvitjen e vullnetarëve ku udhëzonte që t'u thuhej vullnetarëve se nuk do të tolerohej sjellja e paligjshme.¹³⁰⁴ Në këtë urdhër, i cili iu dërgua armatave dhe degëve të ndryshme të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, ai kërkonte që paraushtarakët që pranoheshin si vullnetarë të kalonin procedurat e duhura të përcaktuara në urdhër.¹³⁰⁵ Vetë urdhri përmendte një kontroll sigurie dhe faktin se vullnetarët duhej t'i nënshtroheshin një stërvitjeje shtatëditore, gjatë së cilës do t'u thuhej të zbatonin ligjet dhe zakonet e luftës dhe se çdo shkelje e këtyre normave do të ndiqej ligjërisht.¹³⁰⁶ Mirëpo, edhe ky urdhër lejonte që paraushtarakët të bëheshin vullnetarë nëse i përmbushnin kërkesat e kontrollit fillestar.¹³⁰⁷

¹²⁹⁷ 3D479 (Raportim për shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 8 qershor 1999); Versioni në formë dorëshkrimi i këtyre shënimeve jepet në dokumentin 3D493.

¹²⁹⁸ Slllobodan Kosovaci, T. 15802–15803 (17 shtator 2007); 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 14 prill 1999).

¹²⁹⁹ Zharko Kostiq, T. 17506 (23 tetor 2007).

¹³⁰⁰ *Shih, p.sh.*, P1678 (Urdhër për rekrutimin e shtetasve të huaj, 5 prill 1999).

¹³⁰¹ Slllobodan Kosovaci, T. 15857 (18 shtator 2007); *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16314 (25 shtator 2007).

¹³⁰² P1479 (Urdhër lidhur me vullnetarët, 7 prill 1999).

¹³⁰³ P1479 (Urdhër lidhur me vullnetarët, 7 prill 1999); *Shih edhe* Slllobodan Kosovaci, T. 15860 (18 shtator 2007).

¹³⁰⁴ 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për Pranimin e Vullnetarëve, 14 prill 1999), f. 3.

¹³⁰⁵ 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për Pranimin e Vullnetarëve, 14 prill 1999), f. 2.

¹³⁰⁶ 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për Pranimin e Vullnetarëve, 14 prill 1999), f. 2–4.

¹³⁰⁷ 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për Pranimin e Vullnetarëve, 14 prill 1999), f. 2.

564. Më 20 prill 1999, Ojdaniqi nxori një urdhër të ngjashëm.¹³⁰⁸ Lidhur me përmendjen që bëhej në të se vullnetarët në shumicën e rasteve qenë “grupe paraushtarake të formuara më parë”, Sllobodan Kosovaci dëshmoi se vullnetarët shqyrtoheshin individualisht dhe kështu raportet e anëtarësisë në grupet paraushtarake qenë thjesht hipoteza.¹³⁰⁹ Mirëpo, Dragisha Marinkoviqi i cili në mes të muajit prill 1999 inspektoi Brigadën e 175-të të Këmbëtorisë, tha se ushtarët ishin të padisiplinuar dhe se ai kishte parë një njësi me përafërsisht 30 vetë në Brigadën e 175-të të Këmbëtorisë që përbëhej tërësisht nga vullnetarë.¹³¹⁰ Branko Gajiqi dëshmoi se dihej se njëfarë kolonel Shtupari i ndihmonte vullnetarët t’i anashkallonin procedurat e pranimit të UJ-së, por nuk ishte i sigurt se çfarë mase ishte marrë kundër tij.¹³¹¹ Më pas, Ojdaniqi nxori urdhra të tjerë që rregullonin inkuadrimin e vullnetarëve në UJ.¹³¹²

iii. Dijenja për implikimin e UJ-së dhe MPB-së në krizën humanitare

565. Ojdaniqi mori informacion për situatën e gjerë humanitare në Kosovë gjatë fazës së fillimit të fushatës ajrore të NATO-s. Për shembull, në mbledhjen e datës 28 mars 1999, Administrata e Zbulimit e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë tha se NATO-ja po mblidhej për të diskutuar për çështjen e Kosovës dhe për numrin e 500 mijë refugjatëve “për të cilin ka shumë hamendësime”.¹³¹³ Ojdaniqit iu dha informacion konkret më 28 mars, në raportin e luftimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, sipas të cilit MPB-ja dhe UJ-ja qenë të përfshira në kontrollimin e lëvizjes së popullsisë civile. Në raport vërehej se për të siguruar situatën në Kosovë ishte e nevojshme të forcohej kontrolli mbi lëvizjen e popullsisë, në bashkërendim me MPB-në.¹³¹⁴

566. Velimir Obradoviqi dëshmoi se lëvizjet e popullsisë civile nuk ishin në kompetencën e UJ-së, me përjashtim të rasteve kur këto lëvizje ndikonin në lëvizjen e trupave ose nëse në to ishte e përfshirë UÇK-ja.¹³¹⁵ Mirëpo, më 31 mars 1999, një raport nga Korpusi i Prishtinës bënte të ditur se MPB-ja dhe njësitë territoriale ushtarake po mbanin në kontroll lëvizjen e popullsisë shqiptare

¹³⁰⁸ P1943 (Dokument i Shtabit të Komandës së Lartë për problemet lidhur me vullnetarët, 20 prill 1999).

¹³⁰⁹ Sllobodan Kosovaci, T. 15808 (17 shtator 2007). *Shih, në përgjithësi*, P1943 (Dokument i Shtabit të Komandës së Lartë për problemet lidhur me vullnetarët, 20 prill 1999), f. 1.

¹³¹⁰ Dragisha Marinkoviqi, T. 20148–20149 (12 dhjetor 2007).

¹³¹¹ Branko Gajiq, T. 15311–15313 (10 shtator 2007).

¹³¹² P1688 (Telegram mbi rastet e shkeljeve, personat me probleme psikologjike, 4 maj 1999); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 151–152; 3D490 (Telegram i Shtabit të Komandës së Lartë, 4 maj 1990), f. 1; *shih edhe* Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 25–27.

¹³¹³ 3D898 (Raportim i Administratës së Zbulimit për Shtabin e Komandës së Lartë, 28 mars 1999), f. 1; *shih edhe* 3D803 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 29 mars 1999), f. 5; 3D584 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 31 mars 1999), f. 2; 3D805 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 31 mars 1999), f. 5.

¹³¹⁴ 3D802 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 28 mars 1999), f. 4.

¹³¹⁵ Velimir Obradoviqi, T. 17377 (22 tetor 2007).

kosovare “duke i kanalizuar” ata drejt kufirit.¹³¹⁶ Një raport tjetër luftimi i UJ-së në këtë kohë bënte të ditur se personat e shpërngulur në Kosovë po udhëzoheshin nga UJ-ja të qëndronin në Kosovë.¹³¹⁷ Dhoma bindet se UJ-ja u angazhua në lëvizjen e popullsisë civile dhe se Ojdaniqi ishte në dijeni të këtij angazhimi.

567. Lidhur me personat e shpërngulur dhe krimet e kryera në Kosovë, Drewienkiewicz-i dha një deklaratë për shtyp jo më vonë se 2 prill 1999. Ai përmendi një numër të madh shqiptarësh kosovarë të shpërngulur që mbërrinin në kufij dhe transmetoi raportet për krimet gjerësisht të përhapura, të kryera nga UJ-ja dhe MPB-ja, përfshirë edhe dëbimin nga Kosova. Ai tha se 6.000 deri në 8.000 shqiptarë kosovarë të shpërngulur ishin larguar për në Maqedoni një ditë më parë, ndërsa 7.000 ishin parë të largoheshin me tren atë ditë, krahas 50.000 të tjerëve që kishin kaluar kufirin. Ai përmendi veçanërisht krimet e kryera nga forcat e RFJ-së/Serbisë kundër shqiptarëve kosovarë dhe pronave të tyre në Pejë dhe Prizren dhe “plaçkitjen sistematike” dhe largimin me forcë të shqiptarëve kosovarë nga Prishtina.¹³¹⁸ Administrata e Zbulimit ishte ngarkuar me detyrën për ta informuar Ojdaniqin për këto fakte, sikurse është përshkruar në Pjesën VI.A. Duke pasur parasysh aktualitetin e temës dhe angazhimin e Drewienkiewicz-it në Kosovë përpara fushatës ajrore të NATO-s, Dhoma bindet se Ojdaniqit iu dha kjo deklaratë për shtyp.

568. Për çështjen e shqiptarëve kosovarë të shpërngulur u diskutua të nesërmen në mbledhjen e datës 3 prill 1999 të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë. Branko Kërگا, shefi i Administratës së Zbulimit e informoi Ojdaniqin lidhur me pretendimet se kishte 500.000 “refugjatë” në Kosovë.¹³¹⁹ Kërگا sugjeroi ngritjen e postblloqeve për “refugjatë”. Në reagim ndaj këtij informacioni, Ojdaniqi urdhëroi që Administrata e Zbulimit të përgatiste një përgënjeshtim të problemit të refugjatëve.¹³²⁰ Millivoje Novkoviqi shpjegoi se kjo do të thoshte përgënjeshtim i numrit të refugjatëve, por jo i problemit në tërësi.¹³²¹ Ky informacion u paraqit sërish, një javë më vonë, në mbledhjen e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, të zhvilluar më 9 prill. Në të, Gajiqi informoi Ojdaniqin se UÇK-ja ishte shkaktare e lëvizjes së popullsisë.¹³²² Gajiqi tha “armiku do të kryejë aktivitetin e planifikuar për t’i nxjerrë shqiptarët jashtë në mënyrë që shteti dhe ushtria jugosllave të akuzohen për spastrim etnik dhe gjenocid

¹³¹⁶ P2930 (Raport Luftimi i Grupit të Komandës së Korpusit të Prishtinës për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 2.

¹³¹⁷ *Shih* 4D510 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 24 mars 1999), f. 1–2.

¹³¹⁸ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999); Karol John Drewienkiewicz, T. 7815 (4 dhjetor 2006).

¹³¹⁹ 3D721 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 1; *shih edhe* 3D911 (Raportim i Administratës së Zbulimit, 3 prill 1999), f. 1.

¹³²⁰ 3D721 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 1, 5.

¹³²¹ Millivoje Novkoviq, T. 16269–16270 (24 shtator 2007).

¹³²² P929 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 9 prill 1999), f. 8–9.

kundër shqiptarëve, duke krijuar kështu kushte edhe më të favorshme ... për operacionet e NATO-s ... kundër ... forcave tona”.¹³²³ Rekomandimi i tij ishte që duhej “fuqizuar” regjimi i sigurisë në Kosovë dhe duhej “përqendruar te mbajtja në kontroll e lëvizjeve të popullsisë dhe të personave të huaj në zonat e operacioneve të luftimit dhe, sidomos, në zonat ku vepronin njësitë” dhe duhej “përqendruar te mbrojtja e fshehtësisë së vendimeve dhe aktiviteteve të forcave”.¹³²⁴ Gjithashtu, në raportin e luftimit të Shtabit të Komandës së Lartë, të datës 21 prill 1999, thuhet se 3 mijë persona kishin kaluar nga Kosova në Maqedoni përmes zonës së përgjegjësisë së Korpusit të Prishtinës, të shoqëruar nga forcat e MPB-së.¹³²⁵

569. Në udhëzimin e tij, të datës 9 prill 1999, Ojdaniqi bënte fjalë për çështjen e “refugjatëve”.¹³²⁶ Pasi i jepte Armatës së Tretë detyrën që, ndër të tjera, “të dërrmonte dhe shkatërronte” UÇK-në, ai jepte urdhrin konkret për organizimin e pritjes së “refugjatëve” në kufi, përfshirë edhe përmes urdhrin për t’u “ofruar ndihmë organeve shtetërore për kujdesin e mëtejshëm për ta”.¹³²⁷ Branko Kërگا tha se UJ-ja nuk kishte për objektiv dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga Kosova dhe, gjithashtu se UJ-ja nuk bëri asgjë për t’i penguar “refugjatët” të ktheheshin në Kosovë.¹³²⁸ Ai pranoi se një prej objektivave të ngritjes së postblloqeve për trajtimin e këtyre “refugjatëve” ishte ndryshimi i perceptimit të mediave duke u ofruar “refugjatëve” ndihmë në mënyrë të organizuar dhe që të tjerët të shihnin se po bëhej një gjë e tillë.¹³²⁹ Novkoviqi dëshmoi se, megjithëse Shtabi i Komandës së Lartë mendonte se problemi i “refugjatëve” ishte jashtë kompetencës së tij, faktikisht shtabi ushtroi presion mbi organet federale për ta trajtuar këtë çështje dhe për këtë qëllim më 10 maj 1999 u mbajt një konferencë për shtyp.¹³³⁰

570. Më 11 maj 1999, Ojdaniqi i raportoi Millosheviqit dhe, ndër të tjerë, Presidentit serb, Millutinoviqit, se UJ-ja kishte kapur rreth 600 meshkuj shqiptarë kosovarë nga fshatrat Dvoran, Ruhot dhe Nabërgjan dhe kishte “orientuar” rreth dhjetë mijë civilë të shkonin në qytetet Pejë dhe Klinë.¹³³¹ Në ndryshim nga cilësimi “terroristë”, sikurse figuronte gjetiu në raport lidhur me incidente të tjera, në të thuhej vetëm se ata qenë 600 meshkuj shqiptarë të aftë për shërbim

¹³²³ P929 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 9 prill 1999), f. 10.

¹³²⁴ P929 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 9 prill 1999), f. 10–11.

¹³²⁵ 3D826 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, 21 prill 1999), f. 3.

¹³²⁶ P1481 (Direktivë e Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999), f. 5; Miodrag Simiq, T. 15627–15629 (14 shtator 2007).

¹³²⁷ P1481 (Direktivë e Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999), f. 5; *Shih edhe* Miodrag Simiq, T. 15489–15491 (12 shtator 2007).

¹³²⁸ Branko Kërگا, T. 16803, 16814 (3 tetor 2007), T. 16840 (4 tetor 2007).

¹³²⁹ Branko Kërگا, T. 16803 (3 tetor 2007), T. 16899–16900 (4 tetor 2007); *shih edhe* 3D938 (Raport i Administratës së Zbulimit, 25 prill 1999).

¹³³⁰ Millivoje Novkoviq, T. 16236–16237 (24 shtator 2007).

¹³³¹ 3D846 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 maj 1999), f. 5; *shih edhe* 4D315 (Raport Luftimi i Komandës së Tretë, 10 maj 1999), f. 1.

ushtarak. Nuk thuhej nëse këta 600 individë qenë të armatosur, sikurse thuhej në vende të tjera në raport lidhur me “terroristët shqiptarë”.¹³³² Dhoma mendon se kjo është dëshmi e metodës së ndjekur nga UJ-ja dhe MPB-ja për të vënë në shënjestër meshkuj shqiptarë kosovarë, pavarësisht nëse qenë apo jo anëtarë të UÇK-së.

iv. Misionet e administratës së sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në Kosovë

571. Përkundër marrjes së raporteve në të cilët bëhej e ditur kryerja e krimeve në Kosovë, sikurse u shpjegua me hollësi më lart, në muajin maj 1999 u pa se Shtabi i Komandës së Lartë nuk po merrte të gjithë informacionin që duhet të merrte. Shefi i Administratës së Sigurimit, Geza Farkash, dëshmoi se gjatë fushatës ajrore të NATO-s ai merrte informacion nga organet e sigurisë në Kosovë se po kryheshin krime nga anëtarët e UJ-së por se ky informacion nuk dilte në raporte e luftimit.¹³³³ Këtë mosraportim e konfirmoi edhe Aleksandar Vasileviqi, i cili dëshmoi se ky problem shkaktohej nga një pengesë që i bëhej kalimit të informacionit, nga Armata e Tretë në Shtabin e Komandës së Lartë.¹³³⁴ Më 27 prill 1999, Ojdaniqi i dha urdhër Vasileviqit të rikthehej në radhët e ushtrisë nga lirimi dhe e emëroi zëvendësshef të Administratës së Sigurimit dhe i ngarkoi detyrën e hetimit dhe raportimit Shtabit të Komandës së Lartë të krimeve që po kryheshin në Kosovë.¹³³⁵

572. Farkashi dëshmoi se, edhe si pasojë e zbulimit të raportimit të pamjaftueshëm të krimeve, më 5 dhe 6 maj 1999 Ojdaniqi e dërgoi me mision, si shef të Administratës së Sigurimit për të kontrolluar organet e sigurimit të Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës.¹³³⁶ Farkash konstatoi se kishte probleme të rënda të shkaktuara nga aktiviteti kriminal i paraushtarakëve, ku përfshiheshin përdhunime, plaçkitje dhe vjedhje, krahas angazhimit jo të duhur të njëjstëve të Policisë Ushtarake të UJ-së në Kosovë.¹³³⁷ Farkash i raportoi për këto probleme Ojdaniqit më 7 maj dhe reagimi i Ojdaniqit ishte “i fortë”.¹³³⁸ Vasileviqi dëshmoi se më 8 maj 1999 u takua me shefin e Degës të Sigurimit të Korpusit të Prishtinës, i cili e informoi për krimet e kryera nga anëtarët e UJ-së kundër civilëve në Kosovë. Ndër të tjera, në këto krime kishte një përdhunim në të

¹³³² 3D846 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 maj 1999), f. 5; *shih edhe* 4D315 (Raport Luftimi i Komandës së Tretë, 10 maj 1999), f. 1.

¹³³³ Geza Farkash, T. 16292–16293, 16899–16900 (25 shtator 2007).

¹³³⁴ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 56; Aleksandar Vasileviq, T. 8750 (19 janar 2007); *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16359, 16363–16364 (25 shtator 2007).

¹³³⁵ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 53.

¹³³⁶ Geza Farkash, T. 16292 (25 shtator 2007).

¹³³⁷ Geza Farkash, T. 16293–16294, 16310, 16370 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15280–15282 (7 shtator 2007). Një shembull shkeljeje nga një formacion paraushtarak ishte masakra e kryer në Podujevë nga Akrepat. 3D1055 (Raport i Degës të Sigurimit të Shtabit të Komandës së Lartë për aktivitetet e paraushtarakëve, 13 maj 1999).

¹³³⁸ Geza Farkash, T. 16294 (25 shtator 2007).

cilin që përfshirë një rezervist, një vrasje e një shqiptari kosovar në një fshat të Skënderajt dhe vrasja e një burri në Shipovë. Vasileviqi reagoi duke kërkuar që shefi i Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës të shkruante një raport me informacion të hollësishëm për këto incidente të shkuara, i cili t'i përcillej Farkashit.¹³³⁹ Sa i takon raportimit të pamjaftueshëm, Vasileviqi dëshmoi se, më vonë, zbuloi se Komanda e Armatës së Tretë kishte marrë një vendim për të mos raportuar kryerjen e disa krimeve të caktuara në raportet e rregullta të luftimit, duke qenë se me to po merreshin organet gjyqësore ushtarake.¹³⁴⁰ Atij i thanë se të gjitha krimet po procedoheshin nga sistemi i drejtësisë ushtarake.¹³⁴¹ Dhoma vëren se, edhe pse në përgjithësi Vasileviqi ishte dëshmitar i besueshëm, ai u rikthye në Administratën e Sigurimit jo më herët se data 27 prill 1999 dhe ai raportoi vetëm për ato gjëra që mësoi nga anëtarët e UJ-së në Kosovë gjatë misionit të tij.

573. Më 13 maj 1999 Ojdaniqin e informuan për hollësitë e këtyre krimeve.¹³⁴² Vasileviqi tha se Ojdaniqi u duk “shumë i befasuar” nga ky informacion dhe se menjëherë mori në telefon Millosheviqin për ta informuar se sapo kishte marrë informacion lidhur me përdhunime dhe vrasje të kryera nga anëtarët e UJ-së dhe organizoi një takim me Millosheviqin.¹³⁴³ Dhoma vëren se Ojdaniqi ishte informuar më parë për krimet “e shumta”, përfshirë edhe vrasjet, që po i kryenin anëtarët e UJ-së, ndër të tjera në mbledhjen e datës 4 maj, dhe se Farkashi e kishte informuar më 7 maj se anëtarët e UJ-së në Kosovë po kryenin krime. Rrjedhimisht, Dhoma nuk mendon se reagimi i Ojdaniqit ndaj këtij lajmi përbën dëshmi se ishte hera e parë që dëgjonte për një aktivitet të tillë kriminal.

574. Gjithashtu, Ojdaniqi dërgoi ekipe inspektimi nga Shtabi i Komandës së Lartë, të drejtuara nga Miodrag Simiqi, për të kontrolluar një numër njësisish, përfshirë Brigadën e 37-të, 125-të dhe 549-të të Motorizuara dhe Brigadën e 52-të të Raketave Artilerike gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹³⁴⁴ Miodrag Simiqi dëshmoi se asnjë prej ekipeve të ndryshme të inspektimit nuk raportoi asgjë që tregonte kryerjen e krimeve nga anëtarët e UJ-së lidhur me incidentet e pretenduara në Aktakuzë.¹³⁴⁵ Po të kihet parasysh implikimi i UJ-së në shumë prej krimeve të pretenduara në Aktakuzë, sikurse është diskutuar më lart në Kapitullin VII, Dhoma arrin në përfundimin e dëshmia e Simiqit për këtë çështje nuk është e besueshme dhe nuk mendon se ajo hedh dyshime lidhur me

¹³³⁹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 59.

¹³⁴⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8749–8751 (19 janar 2007); *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16359, 16364 (25 shtator 2007).

¹³⁴¹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 56.

¹³⁴² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 59; Geza Farkash, T. 16294–16295 (25 shtator 2007).

¹³⁴³ Aleksandar Vasileviq, T. 8747–8748 (19 janar 2007).

¹³⁴⁴ 3D489 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për turneun e kontrollit, 20 prill 1999); 3D491 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për turneun e kontrollit, 8 maj 1999).

¹³⁴⁵ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë e dëshmitarit, datë 15 gusht 2007), para. 12.

dijeninë e Ojdaniqit për kryerjen në masë të krimeve nga anëtarët e UJ-së, sikurse u diskutua më lart.

v. Mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj

575. Pas marrjes së këtij informacioni nga anëtarët e Administratës së Sigurimit, Ojdaniqi ftoi Pavkoviçin dhe anëtarët e tjerë të Shtabit të Komandës së Lartë në një mbledhje më datë 16 maj 1999.¹³⁴⁶ Në këtë mbledhje, Pavkoviçi e informoi Ojdaniqin për hollësitë e krimeve që po kryheshin në Kosovë nga anëtarët e UJ-së,¹³⁴⁷ përfshirë edhe pretendimet për implikimin e UJ-së në vdekjet e 800 civilëve.¹³⁴⁸ Pavkoviçi tha se hetimet e tij kishin zbuluar se 271 prej këtyre vdekjeve kishin ndodhur në zonat e mbuluara nga UJ-ja, ndërsa 376 në zonat e mbuluara nga forcat e MPB-së.¹³⁴⁹ Vasileviçi tha se në mbledhje u diskutua fakti se këto shifra nuk rezultonin në shumën 800 dhe se u tha se disa prej vdekjeve mund të ishin shkaktuar nga sulmet e NATO-s.¹³⁵⁰ U fol edhe për krimet e kryera nga grupet paraushtarake.¹³⁵¹ Pavkoviçi tha se ai kishte qenë në kontakt me Sllobodan Mediqin (i njohur edhe si Boca), udhëheqësin e grupit të armatosur që njihej si “Akrepit”, të angazhuar nën mbikëqyrjen e MPB-së, të cilët ndodheshin në Kosovë dhe mbanin emblemën e SAJ-së.¹³⁵² Mirëpo, Gajiqi dëshmoi se tema kryesore e mbledhjes nuk ishte zbulimi i faktit se grupi “Pauk” apo Merimanga vepronte brenda UJ-së, por krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare që po bëheshin në Kosovë.¹³⁵³ Ojdaniqi u tha të pranishmëve se krimet e luftës duheshin hetuar dhe dokumentuar me urgjencë dhe, nëse konstatohej se këto krime i kishte kryer dikush, ky person duhej arrestuar menjëherë dhe çështja t’i raportojë Shtabit të Komandës së Lartë. Nëse çështja nuk ishte brenda juridiksionit të gjykatave ushtarake, por të gjykatave civile, atëherë këtë duhej ta zgjidhte gjyqësori civil.¹³⁵⁴

576. Pas kësaj mbledhjeje paraprake, më 17 maj 1999 u bë një mbledhje e dytë me Millosheviçin.¹³⁵⁵ Të pranishëm qenë Ojdaniqi, Radomir Markoviçi, Farkashi, Shainoviçi,

¹³⁴⁶ Geza Farkash, T. 16296–16298 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15284–15285 (7 shtator 2007).

¹³⁴⁷ Geza Farkash, T. 16295 (25 shtator 2007).

¹³⁴⁸ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62.

¹³⁴⁹ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62.

¹³⁵⁰ Aleksandar Vasileviçi, T. 8763 (19 janar 2007), T. 9041 (24 janar 2007), P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 15999–16000.

¹³⁵¹ Branko Gajiq, T. 15290 (7 shtator 2007).

¹³⁵² Branko Gajiq, T. 15286 (7 shtator 2007); Aleksandar Vasileviçi, T. 8756 (19 janar 2007).

¹³⁵³ Branko Gajiq, T. 15360 (11 shtator 2007).

¹³⁵⁴ Branko Gajiq, T. 15285 (7 shtator 2007).

¹³⁵⁵ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62; Branko Gajiq, T. 15290 (7 shtator 2007).

Pavkoviqi, Vasileviqi dhe Branko Gajiqi.¹³⁵⁶ Pavkoviqi përsëriti informacionin lidhur me krimet që po kryenin anëtarët e UJ-së në zonën e përgjegjesisë së Armatës së Tretë brenda Kosovës.¹³⁵⁷ Vasileviqi paraqiti edhe një raport për krimet e rënda të kryera nga forcat dhe vullnetarët e UJ-së kundër civilëve, përfshirë edhe vrasjet dhe përdhunimet.¹³⁵⁸ Ai pastaj i informoi të pranishmit për krimet e kryera nga “Akrepat” dhe nga figura paraushtarake si Sllobodan Mediqi (i njohur gjithashtu si Boca) si edhe nga njerëzit e Arkanit.¹³⁵⁹ Pavkoviqi raportoi përsëri për 800 kufomat e gjetura në Kosovë dhe shtoi se ky problem kishte lindur ngaqë MPB-ja dhe UJ-ja po përipiqeshin t’ia hidhnin fajin njëra-tjetrës.¹³⁶⁰ Vasileviqi dëshmoi se Ojdaniqi dhe Pavkoviqi propozuan ngritjen e një komisioni shtetëror të përbashkët për të gjetur çfarë po ndodhte në Kosovë, por se Pavkoviqi raportoi se Llukiqi nuk kishte interes në krijimin e këtij komisioni.¹³⁶¹ Përgjigja e Millosheviqit ndaj këtyre problemeve ishte shmangia nga tema e krimeve të UJ-së dhe MPB-së. Ai përmendi vetëm nevojën për të konstatuar se cilat grupe paraushtarake vepronin në Kosovë.¹³⁶²

577. Në mbledhjen e nesërme të Shtabit të Komandës së Lartë, Ojdaniqi trajtoi çështjet e mbledhjes me Millosheviqin. Në të ai i udhëzoi organet e sigurimit të Armatës së Tretë të zbulonin dhe dokumentonin krimet që mund të qenë kryer në Kosovë, duke thënë se “duhej identifikuar autori i krimit dhe duhej marrë përsipër përgjegjësia”.¹³⁶³ Farkashi dëshmoi se, pas mbledhjes së datës 17 maj, Ojdaniqi i kërkoi edhe ngritjen e një ekipi për të shkuar për kontroll në njësitë bazë të UJ-së dhe organet e sigurimit brenda Kosovës.¹³⁶⁴ Si rezultat, Farkashi ngriti një ekip kontrolli të kryesuar nga Gajiqi dhe Vasileviqi, i cili u dërgua në Kosovë më 1 qershor 1999, për të kontrolluar 16 organe të sigurimit dhe njësi bazë në terren.¹³⁶⁵ Gajiqi dëshmoi se ekipi pati përshtypjen se kishte probleme me krime lufte, por se organet e sigurimit në Korpusin e Prishtinës qenë aktive në

¹³⁵⁶ Geza Farkash, T. 16296 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8772–8773 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 63.

¹³⁵⁷ Geza Farkash, T. 16296–16297 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 67.

¹³⁵⁸ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65. Vasileviqit dhe Farkashit u kujtohet ndryshe renditja e prezantimeve në këtë mbledhje. Vasileviqi tha se ai dha raportin e parë. Farkashi tha se raportin e parë e dha Pavkoviqi. Sidoqoftë, të dy pajtohen lidhur me faktin se u dhanë të dy raportet.

¹³⁵⁹ P2592 (pjesë e nxjerrë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999), f. 1; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65; Branko Gajiq, T. 15290 (7 shtator 2007).

¹³⁶⁰ Aleksandar Vasileviq, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 16000, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65–71; P2592 (pjesë e nxjerrë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999), f. 1.

¹³⁶¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8783 (22 janar 2007).

¹³⁶² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 70, T. 8783 (22 janar 1999).

¹³⁶³ 3D618 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 18 maj 1999), f. 3; Geza Farkash, T. 16369 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 75.

¹³⁶⁴ Geza Farkash, T. 16300 (25 shtator 2007).

¹³⁶⁵ Geza Farkash, T. 16300 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8707 (19 janar 2007); Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

hetimin e këtyre incidenteve.¹³⁶⁶ Ai tha se çështja kryesore ishte se për këto krime nuk i raportohej Shtabit të Komandës së Lartë.¹³⁶⁷ Vasileviqi dëshmoi se ky mision nuk ishte komision mbikëqyrës, por ishte inspektim i zakonshëm që i bëhej punës së organeve të sigurimit. Ata nuk biseduan me personelin e sistemit të drejtësisë ushtarake dhe nuk bënë një krahasim midis asaj që kishin mësuar nga organet e sigurimit në Korpusin e Prishtinës dhe Armatën e Tretë, nga njëra anë, dhe të dhënave që kishin marrë nga prokuroritë dhe gjykatat ushtarake, nga ana tjetër.¹³⁶⁸

578. Vasileviqi përgatiti një raport të mbështetur në misionin e tij faktmbledhës, të cilin ia paraqiti Farkashit.¹³⁶⁹ Në raport dokumentoheshin 42 krime, disa të kryera nga forcat e UJ-së dhe disa nga forcat e MPB-së, megjithëse Vasileviqi dëshmoi se shumica e rasteve me të cilat u mor ai kishin të bënin me ushtarakë.¹³⁷⁰ Në këto 42 raste kishte vrasje, përdhunime, plaçkitje dhe shkelje penale.¹³⁷¹ Sipas Vasileviqit, rastet në të cilat qenë përfshirë anëtarët e UJ-së përfshinin, ndër të tjera, vrasjen e një shqiptari në Bresje nga tre rezervistë të UJ-së, vrasjen e katër shqiptarëve kosovarë dhe përdhunimin e një vajze nga njëfarë kapiten Stekoviqi, dhe kryerjen e krimeve nga anëtarët e Brigadës së 52-të të Blinduar.¹³⁷² Pasi u kthyen në Beograd më 7 qershor 1999, Gajiqi dhe Vasileviqi u raportuan me gojë anëtarëve madhorë të shtabit, të cilëve u thanë se organet e sigurimit ishin aktive në pikasjen e krimeve dhe përgatitjen e dosjeve për ndjekje penale.¹³⁷³ Gajiqi shtoi se organet e sigurimit “kishin mbështetjen e plotë të komandës”.¹³⁷⁴ Organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë i thanë Vasileviqit se të gjitha krimet po ndiqeshin penalisht.¹³⁷⁵ Mirëpo, Dhoma nuk mbështetet në këtë informacion që i kanë dhënë Gajiqit dhe Vasileviqit, si provë se në të vërtetë po ndiqeshin penalisht të gjitha krimet. Është krejt e kundërta, sepse është vërtetuar se shumë krime të kryera nga anëtarët e UJ-së nuk po ndiqeshin penalisht për shkak të ndërhyrjeve në sistem, sikurse u konkludua në Ndarjen VI.A.1.e.

¹³⁶⁶ Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

¹³⁶⁷ Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

¹³⁶⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8790 (22 janar 2007).

¹³⁶⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8700 (19 janar 2007) (seancë e mbyllur), T. 8786 (22 janar 2007).

¹³⁷⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8786–8787 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 87; Branko Gajiq, T. 15293 (7 shtator 2007).

¹³⁷¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8786–8788, 8791 (22 janar 2007).

¹³⁷² Aleksandar Vasileviq, T. 8786–8788 (22 janar 2007). Kur Dhoma pyeti për rëndësinë e këtyre incidenteve, nëse nuk ishin përmendur konkretisht në Aktakuzë, Prokuroria tha se ky informacion tregonte se disa raste të sjelljeve kriminale nuk qenë raportuar në mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm. T. 8788–8789 (22 janar 2007).

¹³⁷³ Geza Farkash, T. 16303 (25 shtator 2007); *Shih edhe* Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

¹³⁷⁴ Branko Gajiq, T. 15292 (7 shtator 2007).

¹³⁷⁵ Aleksandar Vasileviq, T. 8790 (22 janar 2007).

vi. *Krimet e kryera nga paraushtarakët dhe anëtarët e MPB-së*

579. Sikurse u përmend më lart, Ojdaniqi mori informacion lidhur me veprimtaritë kriminale të forcave të MPB-së në Kosovë në vitin 1999. Më 3 dhe 16 prill, Gajiqi i raportoi Shtabit të Komandës së Lartë se kishte pasur probleme me grupet paraushtarake që vepronin me MPB-në në Kosovë.¹³⁷⁶ Kur mësoi për këto veprimtari, Ojdaniqi nxori një udhëzim të përgjithshëm për Administratën e Sigurimit për të hetuar veprimtaritë paraushtarake, përfshirë edhe se ku vepronin, cilat qenë qëllimet e tyre dhe nën komandën e kujt vepronin.¹³⁷⁷

580. Gjashtë ditë pas raportit të parë të Gajiqit, problemi i paraushtarakëve u ngrit përsëri në mbledhjen e datës 22 prill 1999, ku ai tha se po mblidheshin të dhëna lidhur me respektimin e ligjeve të luftës nga anëtarët e UJ-së dhe se grupet paraushtarake po bëheshin më aktive në Kosovë.¹³⁷⁸ Atëherë, Ojdaniqi urdhëroi që organet gjyqësore të bëheshin më efikase, që të kontaktohej MPB-ja lidhur me vullnetarët dhe që kjo të bëhej përmes Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme.¹³⁷⁹

581. Pas marrjes së raporteve të mëtejshme për veprimtarinë kriminale të paraushtarakëve në Kosovë në mbledhjet e datave 22 prill,¹³⁸⁰ 23 prill,¹³⁸¹ dhe përmes raportit ditor të luftimeve të Korpusit të Prishtinës të datës 25 prill,¹³⁸² Ojdaniqi nxori një urdhër tjetër, ku u kërkonte komandantëve të armatave të mundësonin çarmatosjen e paraushtarakëve që vepronin në Kosovë dhe që kundër tyre të merreshin masa ligjore.¹³⁸³ Ky urdhër kërkonte respektimin e rreptë të Konventave të Gjenezës dhe të ligjeve të luftës, që personat që e shkelnin të drejtën humanitare ndërkombëtare të ndaloheshin, të ndiqeshin penalisht dhe që oficerët eprorë të mbanin përgjegjësi për realizimin e këtyre pikave.¹³⁸⁴ Mirëpo, Gajiqi dëshmoi se nuk u mor asnjë masë tjetër kundër

¹³⁷⁶ 3D721 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 2; 3D587 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999), f. 1.

¹³⁷⁷ 3D587 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 16 prill 1999), f. 4.

¹³⁷⁸ 3D592 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 22 prill 1999), f. 1.

¹³⁷⁹ 3D592 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 22 prill 1999), f. 4.

¹³⁸⁰ 3D592 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 22 prill 1999), f. 1.

¹³⁸¹ 3D593 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 23 prill 1999), f. 1; Branko Gajiq, T. 15278–15279 (7 shtator 2007).

¹³⁸² *Shih* P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999), f. 2.

¹³⁸³ P1490 (Urdhër lidhur me formacionet paraushtarake, hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të ligjeve të luftës, 26 prill 1999).

¹³⁸⁴ Ky urdhër i udhëzon komandat dhe organet e sigurimit të monitorojnë sjelljen e personelit të UJ-së dhe të MPB-së dhe udhëzon nisjen e procedimit penal kundër personave që shkelin të drejtën humanitare ndërkombëtare por nuk përcakton nëse ndjekja penale duhet nisur kundër personelit të UJ-së dhe MPB-së. Për informacion më të hollësishëm për normat juridiksionale që zbatohen për personelin e UJ-së dhe MPB-së. *Shih* Ndarjen VI.A.1.e.

paraushtarakëve, sepse forcat e MPB-së nuk e respektuan urdhrin e Ojdaniqit që të gjithë paraushtarakët të largoheshin nga Kosova.¹³⁸⁵

582. Kur Ojdaniqi i dërgoi Vasileviqin dhe Gajiqin në Kosovë, në fillim të muajit maj 1999, ai kërkoi edhe informacione të mëtejshme për problemet e hasura me organizatat paraushtarake. Në një mbledhje të Shtabit të Komandës së Lartë, të zhvilluar më 6 maj, Ojdaniqi e pyeti Gajiqin nëse po vepronin në Kosovë grupe të tilla.¹³⁸⁶ Gajiqi dha përgjigje pohuese dhe Ojdaniqi tha se informacioni i përgjithshëm nuk ishte i mjaftueshëm dhe se ai kishte nevojë për hollësi konkrete për krimet që pretendoheshin se qenë kryer në Kosovë. Gajiqi dëshmoi se Ojdaniqi dëshironte sqarimin e kësaj çështjeje dhe Ojdaniqi tha se, po të kishte persona të tillë në Kosovë, ata duheshin dëbuar dhe kundër tyre duheshin marrë masa ligjore.¹³⁸⁷ Më 13 maj, Farkashi i tregoi Ojdaniqit, ndër të tjera, për krimet e kryera nga një grup paraushtarak të drejtuar nga Sllobodan Mediqi (ndryshe i njohur si Boca) dhe nga grupe paraushtarake të tjera, sikurse u përshkrua më lart.¹³⁸⁸ Administrata e Sigurimit kishte mësuar se kishte prova konkrete për një krim të kryer nga Akrepat e Mediqit në Podujevë, ku qenë vrarë dhjetë fëmijë dhe dy të rritur.¹³⁸⁹ Vasileviqi dëshmoi edhe se kishte mësuar për një grup prej rreth 15 vetësh të quajtur “Legija”, të cilët kishin vrarë dhe plaçkitur shqiptarë kosovarë në Gjakovë, dhe për veprimtari të tjera të ngjashme në Mitrovicë.¹³⁹⁰ Gajiqi tha se të gjitha këto grupe vepronin të veshur me uniforma të SAJ/MPB-së.¹³⁹¹ Autorët e këtyre krimeve u hoqën nga Kosova, mirëpo ata u rikthyen në Kosovë pas një kohë të shkurtër.¹³⁹² Gajiqi që në dijëni se vetëm një person po ndiqej penalisht për këto krime.¹³⁹³

583. Në një raport të Administratës së Sigurimit jepej informacion i hollësishëm për këto incidente. Në raport bëhej e ditur se një grup me rreth 100 vullnetarë u organizua nga MPB-ja dhe u dërgua në Kosovë për të kryer operatione gjatë periudhës 27-31 mars 1999.¹³⁹⁴ Sipas raportit, përpara nisjes, vullnetarëve u foli një inspektor i MPB-së, i cili u tha se ata do të shërbenin si

¹³⁸⁵ Branko Gajiq, T. 15378 (11 shtator 2007).

¹³⁸⁶ Branko Gajiq, T. 15281 (7 shtator 2007); 3D606 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 6 maj 1999), f. 3.

¹³⁸⁷ Branko Gajiq, T. 15281 (7 shtator 2007).

¹³⁸⁸ Geza Farkash, T. 16294 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 59. *Shih, në përgjithësi*, 3D1055 (Raport i Degës të Sigurimit të Shtabit të Komandës së Lartë për aktivitetet e paraushtarakëve, 13 maj 1999); Goran Stopariq, P2224 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 korrik 2006), para. 38–64.

¹³⁸⁹ Branko Gajiq, T. 15273–15274 (7 shtator 2007).

¹³⁹⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8698 (19 janar 2007).

¹³⁹¹ Branko Gajiq, T. 15275 (7 shtator 2007).

¹³⁹² Branko Gajiq, T. 15347 (11 shtator 2007); Goran Stopariq, P2224 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 korrik 2006), para. 59–64, T. 724–725 (12 korrik 2006), 749–750 (13 korrik 2006).

¹³⁹³ Branko Gajiq, T. 15351 (11 shtator 2007).

¹³⁹⁴ 3D1055 (Raport i Degës të Sigurimit të Shtabit të Komandës së Lartë për aktivitetet e paraushtarakëve, 13 maj 1999), f. 1.

përforcime për forcat e MPB-së. Ata kryen krime kundër shqiptarëve kosovarë në Podujevë, përfshirë edhe vrasjen e dy të moshuarve dhe dhjetë të miturve. Kur mësoi për këtë, komandanti i Brigadës së 354-të të UJ-së e dëboi grupin nga zona e operacioneve. Në raport thuhej se ishte marrë informacion i pakonfirmuar se, pas dëbimit, Slobodan Mediqi dhe një grup me 100 vullnetarë hynë përsëri në Kosovë dhe u larguan më 10 maj 1999.¹³⁹⁵ Ojdaniqi mori informacion të mëtejshëm për krimet e kryera nga MPB-ja dhe paraushtarakët që vepronin në Kosovë, në mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj 1999, sikurse u përmend më lart.

vii. Raportet e datave 25 maj dhe 4 qershor

584. Mbrojtja e Ojdaniqit ngriti kundërshtime konkrete lidhur me dy raportet që Armata e Tretë i dërgoi Shtabit të Komandës së Lartë gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹³⁹⁶ Këto raporte mbajnë, përkatësisht, datat 25 maj dhe 4 qershor, dhe kanë të bëjnë me veprimtaritë kriminale të anëtarëve të MPB-së në Kosovë.¹³⁹⁷

585. Në raportin e datës 25 maj 1999, të cilin Pavkoviqi ia dërgoi Shtabit të Komandës së Lartë (adresuar personalisht Ojdaniqit), thuhet se situata e sigurisë në Kosovë ishte e paqëndrueshme për shkak të krimeve të shpeshta.¹³⁹⁸ Pavkoviqi pohonte se kjo ishte më e dukshme në postbllloqet të UJ-së/MPB-së, ku anëtarët e MPB-së e toleronin veprimtarinë kriminale dhe e kryenin vetë atë, kryesisht duke përvetësuar automjete dhe mallra. Në të thuhej gjithashtu se anëtarët dhe njësitë e MPB-së po kryenin krime të rënda kundër popullsisë shqiptare kosovare në qendra banimi dhe strehimore të “refugjatëve” në Kosovë, ku përfshiheshin “vrasja, përdhunimi, plaçkitja, vjedhja në rrethana rënduese, etj.”.¹³⁹⁹ Vlen të theksohet se Pavkoviqi deklaronte se ata punonjës të MPB-së të cilët i kryenin këto krime më pas “ua ngarkonin qëllimisht këto krime njëjive dhe anëtarëve të UJ-së”.¹⁴⁰⁰ Në fund, ai raportonte se marrja e informacionit të sigurimit nga RDB-ja nuk kishte qenë e kënaqshme dhe se i vetmi aspekt pozitiv i veprimeve të përbashkëta me MPB-në kishte qenë

¹³⁹⁵ 3D1055 (Raport i Degës të Sigurimit të Shtabit të Komandës së Lartë për aktivitetet e paraushtarakëve, 13 maj 1999). f. 1–2.

¹³⁹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 245–246; *shih edhe* 3D1078 (Letër drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, 1 mars 2002); 3D1077 (Letër e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar Ojdaniqit, 13 mars 2002).

¹³⁹⁷ P1459 (Raport i Armatës së 3-të për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), pranuar edhe me numrin 3D1106; P1725 (Kërkesë e Armatës së Tretë drejtuar Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999).

¹³⁹⁸ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), pranuar edhe me numrin 3D1106.

¹³⁹⁹ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), para. 3–4, pranuar edhe me numrin 3D1106.

¹⁴⁰⁰ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), para. 4, pranuar edhe me numrin 3D1106.

lokalizimi dhe ndalimi i rekrutëve ushtarakë të cilët nuk paraqiteshin në detyrë.¹⁴⁰¹ Raporti i datës 4 qershor 1999, të cilin gjithashtu Pavkoviqi ia drejtonte Shtabit të Komandës së Lartë, ishte një telegram, në të cilin, gjithashtu, jepeshin ankesa, ndër të tjera, lidhur me mosvënien në varësi të forcave të MPB-së, sjelljen e pahijshme të forcave të MPB-së dhe mungesën e mbështetjes financiare për rekrutët e UJ-së. Në të thuhej se forcat e MPB-së po shkelnin marrëveshjet dhe po bënë “plaçkitje, etj.”¹⁴⁰²

586. Mbrojtja e Ojdaniqit dhe Llukiqit thirrën arkivistin e UJ-së, Dushan Mladenovksin dhe një dëshmitar ekspert, Zhivojin Aleksi, për të kundërshtuar vërtetësinë e këtyre raporteve. Së pari, duhet theksuar se ka dy versione të ndryshme të raportit të datës 25 maj, njërit prej të cilëve i mungon vula e protokollit e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, ndërsa tjetri e ka vulën në fjalë. Dokumenti i dytë është vulosur sikur të jetë marrë më 26 maj 1999.¹⁴⁰³ Lidhur me këto raporte janë ekzaminuar dy regjistra të UJ-së, një listë e Arkivit të UJ-së, e cila ishte listë e materialeve të UJ-së të përfshira në arkivat ushtarake, dhe regjistri i kabinetit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, në të cilin regjistroheshin dokumentet që merrte zyra e shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁴⁰⁴

587. Në lidhje me listën e Arkivit të UJ-së e cila e përfshinte edhe raportin e datës 25 maj Mlladenovski tha se ai i kishte bërë të gjitha ndryshimet dhe shtesat me përjashtim të ndryshimit në kuadratin 82, ku ishte evidentuar marrja e raportit të datës 25 maj.¹⁴⁰⁵ Ai dëshmoi gjithashtu se numri i gjithsejtë i dokumenteve në listën e Arkivit të UJ-së ishte 278 dhe jo 277, sikurse tregohet në faqen e parë të listës, e cila aktualizohej për të pasqyruar numrin e gjithsejtë të dokumenteve. Ai tha se kjo tregonte se personi që kishte bërë ndryshimet në listën e Arkivit të UJ-së nuk ishte profesionist, duke qenë se do të duhet të kishte aktualizuar edhe listën në faqen e parë.¹⁴⁰⁶ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Mlladenovski tha se kjo listë konkrete e arkivit kishte ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm dhe ishte hartuar fillimisht nga Miodrag Jankoviqi, i cili kishte bërë 68 gabime të cilat

¹⁴⁰¹ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), para. 6–7, pranuar edhe me numrin 3D1106.

¹⁴⁰² P1725 (Kërkesë e Armatës së Tretë drejtuar Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999).

¹⁴⁰³ Zhivojin Aleksi, 3D1140 (aktekspertizë e datës 26 shkurt 2008), para. 15; *krahaso* P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999) (jo i vulosur), *me* 3D1106 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999) (i vulosur); *shih edhe* 3D1133 (versioni me ngjyra i P1459); 3D1132 (versioni me ngjyra i 3D1106).

¹⁴⁰⁴ 3D1130 (Kabineti i Shefit të Komandës së Lartë – listë r arkivit, 24 shtator 1999); 3D1131 (Kabineti i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm – regjistër, ekstrakt).

¹⁴⁰⁵ Dushan Mlladenovski, 3D1135 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2008), para. 8–14. Dokumentet e marra nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë të UJ-së evidentoheshin në lista dhe më pas çoheshin në Arkivin e UJ-së, ku arkivoheshin. Dushan Mlladenovski, 3D1135 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2008), para. 3–6.

¹⁴⁰⁶ Dushan Mlladenovski, T. 25770–25771 (21 prill 2008), T. 25795 (22 prill 2008).

i ndreqi vetë Mlladenovski.¹⁴⁰⁷ Mirëpo, ai shtoi se, po t'i kishte parë korrigjimet në listën e arkivit përpara se t'i kishte ardhur, ai do të kishte ngulur këmbë që ndryshimet të ishin sigluar.¹⁴⁰⁸

588. Aleksiqi pretendoi se shkrimi i dorës në listën e Arkivit të UJ-së, në të cilën evidentohet marrja e raportit të datës 25 maj, ndryshonte nga shkrimi i dorës i listës.¹⁴⁰⁹ Kjo përputhet me pretendimin e Mlladenovskit sipas të cilit i kishte bërë ai të gjitha korrigjimet me përjashtim të korrigjimit në kuadratin 82. Mirëpo, pasi identifikoi se disa të dhëna qenë shkruar me një “bisht si qafa e mjellmës”, Aleksiqi pranoi se ky tip shkrimi ishte në protokollime që nuk kishin të bënin me raportin e datës 25 maj, siç është edhe në faqen e parë të listës, sikurse duket qartë po ta shikohet vetë lista.¹⁴¹⁰ Kjo e dobëson ndjeshëm argumentin e Mbrojtjes së Ojdaniqit se shënimi në rreshtin 82 është falsifikim dhe se raporti i datës 25 maj është marrë shumë më vonë se data 25 maj 1999, duke qenë se falsifikuesi do të kishte qenë përgjegjës edhe për një sërë regjistrimesh të tjera edhe në vetë listën e arkivit.

589. Lidhur me vulën e datës që shoqëron shënimin që mbi raportin e datës 25 maj në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Aleksiqi dëshmoi se ajo u shtua në një moment tjetër në krahasim me shënimet e tjera të kësaj liste.¹⁴¹¹ Mirëpo, në dëshminë e tij Aleksiqi la të kuptohet se ai i mbështeste përfundimet e veta nga një shikim që u kishte hedhur shifrave, pa pasur ndonjë mbështetje shkencore për këto përfundime. Edhe sikur të pranohet mendimi i tij lidhur me përdorimin e një numëruesi të ndryshëm apo të përshtatur, dhe jo se është përdorur presion i ndryshëm kur është vënë vula, ai nuk ishte në gjendje ta eliminonte mundësinë që ndryshime të tilla të qenë bërë për arsye të padëmshme, si për shembull përdorimi i dy numëruesve për këtë punë. Aleksiqi tha se dy versionet e këtij raporti nuk qenë në përputhje me procedurën e zakonshme të UJ-së për dokumente të tilla.¹⁴¹² Mirëpo ai tha edhe se nuk i kishin kërkuar të kontrollonte nëse shkrimi i dorës i shënimeve për raportin e datës 25 maj në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së përputhej me shënimet e tjera të bëra në atë regjistër.¹⁴¹³ Nëse raporti do të kishte qenë jo origjinal apo nëse Shtabi i Përgjithshëm nuk do ta kishte marrë më 25 apo 26 maj, atëherë do të pritej që edhe shkrimi i dorës i shënimit në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm do të kishte qenë jo

¹⁴⁰⁷ Dushan Mlladenovski, T. 25789–25790 (22 prill 2008).

¹⁴⁰⁸ Dushan Mlladenovski, T. 25795 (22 prill 2008).

¹⁴⁰⁹ Zhivojin Aleksiq, T. 26063 (13 maj 2008).

¹⁴¹⁰ Zhivojin Aleksiq, T. 26065 (13 maj 2008). Ai tha se në këtë dokument ka disa shembuj, si për shembull Njësia e Arkivit nr 29. Si rrjedhojë, ai dëshmoi se personi që kishte bërë numrin 2 në rreshtin 29 është i njëjti person që ka bërë ndryshimet në rreshtin 82, duke qenë se në të dy rastet shkrimi ka “bishta në formën e qafës së mjellmës”. *Shih edhe* 3D1130 (Kabineti i Shefit të Komandës së Lartë – listë e arkivit, 24 shtator 1999).

¹⁴¹¹ Zhivojin Aleksiq, T. 26085–26089 (13 maj 2008); 3D1140 (aktekspertizë e Zhivojin Aleksiqit, 26 shkurt 2008), para. 14.

¹⁴¹² 3D1140 (aktekspertizë e Zhivojin Aleksiqit, 26 shkurt 2008), para. 15.

¹⁴¹³ Zhivojin Aleksiq, T. 26057–26058 (13 maj 2008).

i rregullt apo i ndryshëm nga shënimet e tjera. Mirëpo, shkrimi i dorës në shënimin në një rresht më lart në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm është i njëjtë me atë të shënimit të raportit të datës 25 maj.¹⁴¹⁴

590. Përveç dëshmisë së Mladenovksit dhe Aleksiqit, një sërë dëshmitarësh të tjerë dëshmuan se Ojdaniqi nuk e mori dokument. Aleksandar Vasileviqi dëshmoi se në kopjen e raportit të datës 25 maj që është pranuar si prova me numër P1459, nuk ishte vula e pranimit nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë.¹⁴¹⁵ Mirëpo, versioni tjetër i raportit të datës 25 maj, prova me numër 3D1106, mbart një vulë që tregon se është marrë nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë më 26 maj 1999.¹⁴¹⁶

591. Në vitin 2002, Ojdaniqi i dërgoi letër Millan Radoiçiqit, shefit të kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes, lidhur me raportet e datave 25 maj dhe 4 qershor, duke qenë se kishte lexuar për to në një artikull në publikimin *Vojska* të UJ-së, por pretendonte se vetë nuk i kishte parë asnjëherë.¹⁴¹⁷ Radoiçiqi iu përgjigj se nuk kishte dijeni për to dhe se ato nuk qenë protokolluar në regjistrin e kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁴¹⁸ Dëshmitarët e tjerë që kishin punuar në Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë asokohe dëshmuan se nuk u kujtohej ta kishin parë këtë dokument dhe se do të kishte qenë përfshirë në analizat e tyre përkatëse po ta kishin marrë.¹⁴¹⁹ Momir Stojanoviqi, shefi i Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës, dëshmoi se ai nuk kishte shkruar asnjë raport ku të thuhej se MPB-ja po kryente krime në Kosovë.¹⁴²⁰ Për më tepër, Millovan Vllajkoviqi dëshmoi se raporti ishte regjistruar gabimisht në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, duke qenë se i ishte dhënë numri vartës i një dokumenti që nuk kishte lidhje me të, ndërsa procedura normale do të ishte të jepeshin numra vartës të dokumenteve që kishin lidhje.¹⁴²¹ Dhoma vëren në këtë aspekt se, megjithëse përmbajtja e këtyre dokumenteve është e ndryshme, të dy ata bëjnë fjalë për marrëdhëniet e UJ-së me forcat e tjera të cilat UJ-ja përpiqej t'i vinte në varësi, Ministria Federale e Mbrojtjes dhe MPB-ja.

592. Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton më tej se përmbajtja e raportit të datës 25 maj nuk është në përputhje me raportet e tjera të luftimit, duke qenë se aty përmendet se në raportet e rregullta të

¹⁴¹⁴ 3D1109 (Regjistri i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2; 3D1131 (ekstrakt nga Regjistri i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2.

¹⁴¹⁵ Aleksandar Vasileviq, T. 8720–8721 (19 janar 2007).

¹⁴¹⁶ 3D1106 (Raport për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999).

¹⁴¹⁷ 3D1078 (Letër e gjeneralit të ushtrisë Dragolub Ojdaniqit drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, 1 mars 2002).

¹⁴¹⁸ 3D1077 (Letër e Ministrisë së Mbrojtjes për gjeneralin e ushtrisë Dragolub Ojdaniqit, 13 mars 2002); Millan Radoiçiq, T. 16129–16130 (21 shtator 2007).

¹⁴¹⁹ Branko Gajiq, T. 15428–15429 (12 shtator 2007); Gjorgje Qurçin, T. 17020–17021 (16 tetor 2007); Millovan Vllajkoviq, T. 16058 (20 shtator 2007).

¹⁴²⁰ Momir Stojanoviq, T. 19815 (7 dhjetor 2007), T. 20027–20028 (11 dhjetor 2007).

luftimit përmendëj që anëtarë të MPB-së kryenin krime, por kjo gjë nuk përmendet në raportet e tjera. Dhoma vëren se Pavkoviqi kishte marrë informacion në një raport për mosvënien në vartësi të MPB-së më 24 maj 1999 nga Llazareviqi, si komandant i Korpusit të Prishtinës.¹⁴²² Në këtë raport, Llazareviqi përshkruante me hollësi krimet që po kryenin anëtarët e MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë.¹⁴²³ Për më tepër, numri i identifikimit i raportit të datës 25 maj përputhet me atë të një raporti të mëparshëm për të njëjtën temë: problemet e vënies në varësi të MPB-së.¹⁴²⁴ Ojdaniqi mori gjithashtu informacion që përputhet me atë të raportit të datës 25 maj, më 27 maj në një raport nga Veličkoviqi, i cili kishte filluar një vizitë në Korpusin e Prishtinës dhe njësitë në vartësi të tij në emër të Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁴²⁵ Raporti i datës 27 maj bënte të ditur se MPB-ja po vepronte në mënyrë jo të duhur gjatë operacioneve të përbashkëta dhe se anëtarët e PJP-së po kryenin plaçkitje. Më 29 maj 1999, Ojdaniqi mori një raport të mbështetur në informacionin e siguruar gjatë vizitës së Shtabit të Komandës së Lartë në Korpusin e Prishtinës midis datave 23 dhe 26 maj. Raporti identifikonte një sërë mangësish mes trupave, përfshirë edhe një mungesë disipline dhe pamundësinë për t'i mbajtur nën kontroll krimet që po kryente personeli i MPB-së.¹⁴²⁶ Në një raport të datës 2 qershor përsëriteshin ankesa të ngjashme për sjelljen e personelit të MPB-së.¹⁴²⁷ Krahas kësaj, Ojdaniqi mori informacion gjatë mbledhjeve të datave 16 dhe 17 maj që i bëri të qartë se anëtarët e MPB-së po kryenin krime të rënda në Kosovë.

593. Në lidhje me raportin e datës 4 qershor, Mbrojtja e Ojdaniqit e vë theksin te një notë e qeverisë së Serbisë ku thuhet se ky raport nuk është regjistruar në Regjistrin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për vitin 1999.¹⁴²⁸ Mirëpo, kopjet e faqeve përkatëse të Regjistrit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së nuk janë paraqitur si provë në mbështetje të këtij pretendimi. Për më tepër, Gjorgje Qurçini dëshmoi se raporti kishte një vulë e cila tregonte se kishte hyrë në Arkivin e UJ-së.¹⁴²⁹ Dhoma vëren se Mladenovski nuk u pyet për këtë raport. Kur i treguan raportin e datës 4 qershor, Gjorgje Qurçini dëshmoi se ishte zhvilluar një takim midis Ojdaniqit dhe Millosheviqit

¹⁴²¹ Millovan Vllajkoviqi, 3D1114 (deklaratë e dëshmitarit, datë 17 shtator 2007), f. 2–3.

¹⁴²² P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999), pranuar edhe me numrat 4D192 dhe P1723.

¹⁴²³ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999), pranuar edhe me numrat 4D192 dhe P1723.

¹⁴²⁴ *Krahaso* P1457 (Urdhër për vartësim të MPB-së, 20 prill 1999), f. 1 (“Rreptësisht i fshehtë Nr. 872-94/1”), *me* P1459 (Raport i Armatës së Tretë për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999) (“Rreptësisht i fshehtë Nr. 872-94/1-2”).

¹⁴²⁵ 5D436 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së lidhur me vizitën e inspektimit në Brigadën e 354-t, 27 maj 1999), f. 5; *shih edhe* 5D434 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, nënshkruar nga gjeneralkolonel Veličkoviqi, 2 qershor 1999), f. 4.

¹⁴²⁶ 3D692 (Raport i Lubisha Veličkoviqit për vizitën dhe detyrat e përmbushura, 29 maj 1999), f. 4.

¹⁴²⁷ 5D434 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, nënshkruar nga gjeneralkolonel Veličkoviqi, 2 qershor 1999), f. 4.

¹⁴²⁸ 3D1136 (Konkluzion i Qeverisë së Serbisë, 27 dhjetor 2007).

¹⁴²⁹ Gjorgje Qurçin, T. 16988–16989 (5 tetor 2007).

për të folur për problemin e mosvartësimin të MPB-së.¹⁴³⁰ Për më tepër, një raport i përgatitur nga anëtarët e misionit të Veliçkoviçit në Kosovë konfirmon se tema e raportit të datës 4 qershor është origjinale duke qenë se në të raportohet edhe për krimet që po kryenin anëtarët e MPB-së dhe për mosrespektimin e vartësisë.¹⁴³¹ Ky raport përputhet me raportet e tjera dhe diskutimet e zhvilluara asokohe mes zyrtarëve të lartë të UJ-së.

594. Sikurse u theksua më lart, në letrën e tij të vitit 2002, Ojdaniqi ankohej se nuk kishte parë asnjë prej këtyre dy raporteve të datave 25 maj dhe 4 qershor dhe Mbrojtja e Ojdaniqit e ka mohuar marrjen dhe vërtetësinë e këtyre dy dokumenteve. Dhoma nuk e konsideron të besueshme dëshminë e Aleksiqit. Mlladenovskin Dhoma e gjykon dëshmitar të besueshëm, por thekson se dijenia e tij kufizohej vetëm brenda Arkivit të UJ-së dhe se dëshmia e tij për shënimin me shkrim dore për raportin e datës 25 maj komprometohej nga fakti që ishte i njëjti shkrim dore në shënimet e tjera në arkivin e UJ-së. Atij nuk iu bënë pyetje për raportin e datës 4 qershor. Dhoma vë në dukje raportet dhe komunikimet e ndryshme të tjera të marra nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë për çështjen e krimeve të kryera nga anëtarët e MPB-së në Kosovë, çka tregon se nuk bëhet fjalë për një dokument të izoluar me rëndësi të veçantë. Asnjë prej kundërshtimeve për vërtetësinë dhe marrjen e këtyre raporteve nuk u provua mjaftueshëm dhe raportet përputhen me informacionet e tjera të marra në atë kohë nga Ojdaniqi. Nuk ka dyshim lidhur me vërtetësinë e tyre dhe marrjen e tyre nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë i UJ-së.

viii. Dalja e aktakuzës së parë

595. Krahas gjithë këtyre raporteve të ardhura nga njësitë dhe organet e UJ-së, Ojdaniqi u vu në dijeni për pretendimet mbi kryerjen në masë të krimeve prej efektivit të UJ-së, përmes publikimit të aktakuzës së parë më 27 maj 1999, e cila u depozitua në Tribunal më 23 maj 1999.¹⁴³² Aktakuza e parë përmbante akuza konkrete për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që po kryheshin nga forcat që ndodheshin nën kontrollin e Ojdaniqit në të gjithë Kosovën. Aktakuza u diskutua në mbledhjen e Shtabit të Komandës së Lartë të datës 28 maj, ku Branko Kërگا tha se një prej qëllimeve të ngritjes së aktakuzës kundër zyrtarëve të lartë të RFJ-së/Serbisë ishte pengimi i nismave për paqen.¹⁴³³ Mbi këtë bazë dhe duke pasur parasysh se aktakuza u ngrit kundër tij, Dhoma bindet se Ojdaniqi u njoftua për aktakuzën më 27 maj ose rreth kësaj date. Po atë ditë, më 27 maj, Ojdaniqi mori një letër nga Pavkoviçi, e cila u përgjigjej akuzave të bëra nga Prokurorja e

¹⁴³⁰ Gjorgje Qurçin, T. 16990 (5 tetor 2007).

¹⁴³¹ 3D692 (Raport i Lubisha Veliçkoviçit për vizitën dhe detyrat e përmbushura, 29 maj 1999).

¹⁴³² P968 (*Prokurori kundër Millosheviçit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IT-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999).

¹⁴³³ 3D628 (Raportim për Shefin e Shtabit, 28 maj 1999), f. 1.

Tribunalit, Louise Arbour, në mars 1999.¹⁴³⁴ Në letër Pavkoviqi thoshte se të gjitha veprimet e tij në cilësinë e komandantit të Korpusit të Prishtinës dhe, më vonë, në cilësinë e komandantit të Armatës së Tretë, kishin qenë në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për UJ-në. Ai shtonte se i kishte informuar gjithmonë eprorët e tij për veprimtaritë e njërive të tij dhe se kishte shpërndarë informacion lidhur me detyrimet e vartësve të tij për të zbatuar të drejtën humanitare ndërkombëtare. Në mbyllje, ai thoshte se nuk ishte autorizuar për të lejuar kryerjen e hetimeve për krimet e luftës dhe se kjo kompetencë i takonte qeverisë federale.¹⁴³⁵ Në përgjigje të nxjerrjes së aktakuzës së parë, Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë raportoi se propaganda perëndimore po vazhdonte të përhapej, por nuk përmendi ndonjë hetim konkret të posaçëm apo komision të ngritur për të sqaruar vërtetësinë e akuzave të parashtruara në aktakuzë.¹⁴³⁶

596. Fakti se Ojdaniqi u informua mbi akuzat për përfshirjen e UJ-së në shpërnguljet e dhunshme dhe krimet e tjera, në aktakuzën e parë kundër tij, dhe nuk mori asnjë masë konkrete në lidhje me këto akuza, e mbështet pretendimin se ai ishte edhe më parë në dijeni të tyre. Ndër shpërnguljet e dhunshme përfshijnë edhe disa nga ato që u diskutuan më lart në Kapitullin VII, për të cilat Dhoma konkludoi se u kryen nga forcat e UJ-së dhe/ose të MPB-së, nga qyteti i Pejës dhe jashtë Kosovës më 27 dhe 28 mars, nga Pirana në Prizren në fund të muajit mars, nga qyteti i Gjakovës duke filluar në muajin prill dhe duke vazhduar në muajin maj, nga Përlepnica në Gjilan më 13 prill, nga Sojeva në Ferizaj në muajin prill, nga Celina në Rahovec më 25 mars dhe granatimi i Turiçecit në fund të muajit mars dhe në muajin prill.¹⁴³⁷

597. Fakti se Ojdaniqi u informua mbi akuzat për përfshirjen e UJ-së në shpërnguljen e dhunshme të civilëve nga Prishtina duke filluar në muajin prill, dhe nuk mori asnjë masë konkrete lidhur me këtë krim, e mbështet pretendimin se ai ishte që më parë në dijeni të tij, sidomos duke qenë se ai e dinte se Postëkomanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në këtë qytet dhe ai kishte mobilizuar detashmentin ushtarak territorial për t'u angazhuar në operacione atje.¹⁴³⁸

¹⁴³⁴ 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046 (20 shtator 2007). Kjo letër bënte të ditur se ishte përgjigje ndaj urdhrin të Drejtorisë Juridike të Shtabit të Komandës së Lartë të datës 10 maj 1999 drejtuar të gjithë komandantëve të UJ-së për respektimin e ligjeve të luftës. *Shih* 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

¹⁴³⁵ 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999).

¹⁴³⁶ 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 8, 11.

¹⁴³⁷ P968 (*Prokurori kundër Millosheviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IT-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999), f. 21–28.

¹⁴³⁸ Ojdaniqi u informua për “plaçkitjet sistematike” dhe eksodin e shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, për të cilin Dhoma ka konkluduar se ka qenë një proces i organizuar, i kryer nga forcat e UJ-së dhe MPB-së, mbi mijëra shqiptarë kosovarë. P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999). Ai e dinte se Postëkomanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në këtë qytet dhe mobilizoi detashmentin ushtarak territorial për t'u angazhuar në operacionet atje. 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 13 mars 1999). Ojdaniqi u informua edhe për përfshirjen e UJ-së në shpërnguljen e dhunshme nga Prishtina duke filluar nga muaji prill, nga aktakuza e parë kundër tij. P968 (*Prokurori kundër Millosheviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IT-99-37, Aktakuza, 23 maj 1999), f. 24.

ix. *Mosdisplinimi i Pavkoviçit*

598. Në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Dimitrijeviçi shprehu shqetësimin e tij se në raportet që Armata e Tretë i dërgonte Shtabit të Përgjithshëm, operacionet e planifikuara të Korpusit të Prishtinës në Kosovë po raportoheshin si reagime mbrojtëse ndaj sulmeve të UÇK-së.¹⁴³⁹ Në një mbledhje të kolegjiut të UJ-së më 10 dhjetor 1998, Dimitrijeviçi u ankua për incidentet e pazakonta për shkak të mungesës së Pavkoviçit në postin e tij.¹⁴⁴⁰ Ai dëshmoi se këto “incidente të pazakonta” konsistonin në dezertim, plagosje dhe vetëvrasje, dhe jo akte të Pavkoviçit, por shtoi se këto akte qenë ndihmuar nga mungesa e Pavkoviçit nga vendkomanda e tij, i cili ndërkaq qëndronte në Beograd për periudha të gjata.¹⁴⁴¹ Gjithsesi, dy javë më pas Ojdaniçi i propozoi KLM-së ngritjen në detyrë të Pavkoviçit në postin e komandantit të Armatës së Tretë, në vend të komandantit të atëhershëm, Dushan Samarxhiçit.¹⁴⁴²

599. Në janar 1999, pas emërimit të Pavkoviçit si komandant i Armatës së Tretë, Dimitrijeviçi u ankua se raportet nga Pavkoviçi nuk përmbanin të dhëna për incidentet e pazakonta në Kosovë dhe se nuk bëhej e ditur se çfarë masash kishin marrë komandanti i Korpusit të Prishtinës dhe ai i Armatës së Tretë për t’i trajtuar këto ndodhi.¹⁴⁴³ Në kolegjiut e datës 3 mars 1999 ai tha se Armata e Tretë po gënjente Shtabin e Përgjithshëm lidhur me operacionet e veta në Kosovë, duke qenë se ato qenë operacione të planifikuara dhe jo reagime mbrojtëse ndaj sulmeve dhe se Shtabi i Përgjithshëm nuk duhej ta pranonte këtë praktikë duke qenë se kjo kishte të bënte me informacion për të cilin ata “duhej të viheshin në dijeni”.¹⁴⁴⁴ Në muajin shkurt 1999, Pavkoviçi dislokoj njësinë e Brigadës së Posaçme të 72-të në brendësi të Kosovës, në kundërshtim me urdhrat e Ojdaniçit për ta mbajtur në kufirin me Shqipërinë dhe në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit.¹⁴⁴⁵ Megjithëse Ojdaniçi pranoi ekzistencën e këtij problemi dhe i siguroi anëtarët e kolegjiut se do të bënte diçka për këtë,¹⁴⁴⁶ nuk ka asnjë provë që ai të ketë marrë masa në lidhje me këtë, apo në lidhje me ankesat e mëparshme për raportet dhe veprimet e Armatës së Tretë, dhe, faktikisht më 31 mars 1999, Pavkoviçi u gradua gjeneralkolonel.¹⁴⁴⁷

¹⁴³⁹ 3D484 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 13–14; P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14; P933 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15; P938 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21; Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26627, 26653–26654 (8 korrik 2008).

¹⁴⁴⁰ 3D484 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14.

¹⁴⁴¹ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26624 (8 korrik 2008).

¹⁴⁴² P1000 (Procesverbali i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 13–21.

¹⁴⁴³ 3D559 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 janar 1999), f. 20.

¹⁴⁴⁴ P933 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15–16.

¹⁴⁴⁵ P941 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 16, 24.

¹⁴⁴⁶ P938 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 25.

¹⁴⁴⁷ Radovan Radinoviçi, T. 17323–17325 (19 tetor 2007); 4D163 (Kartelë Ushtarake e Nebojsha Pavkoviçit), f. 6.

600. Më 25 mars 1999, Ojdaniqi nxori një paralajmërim për komandat e armatave, përfshirë edhe Armatën e Tretë, për të qarkulluar në mënyrë të vazhdueshme informacion të saktë dhe të konfirmuar midis komandave dhe MPB-së.¹⁴⁴⁸ Armata e Tretë ishte e detyruar t'i raportonte Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë për krimet dhe incidentet e paligjshme.¹⁴⁴⁹ Ojdaniqi e konfirmoi këtë detyrim në urdhrin e tij të datës 2 prill 1999.¹⁴⁵⁰ E megjithatë, raportet e luftimit nga Armata e Tretë të dy ditëve në vijim nuk përfshinin informacione të rëndësishme në lidhje me krimet e rënda të dhunshme, përfshirë edhe vrasjet.¹⁴⁵¹ Problemet me raportimin vijuan, sikurse bëhet e ditur nga urdhri i Ojdaniqit, i datës 15 prill 1999.¹⁴⁵² Megjithëse Ojdaniqi lejonte fleksibilitet për vartësit e tij në njësitë komanduese të UJ-së, ai thoshte edhe se komandantët duhej të përgjigjeshin për veprimet dhe vendimet e tyre.¹⁴⁵³

601. Pasi Shtabi i Komandës së Lartë u informua se krimet e kryera nga anëtarët e UJ-së nuk po raportoheshin nga Armata e Tretë, Vasileviqi zbuloi se Komanda e Armatës së Tretë kishte marrë një vendim për të mos raportuar kryerjen e disa krimeve të caktuara në raportet e rregullta të luftimit, duke qenë se me to po merreshin organet gjyqësore ushtarake.¹⁴⁵⁴ Kjo binte ndesh me detyrimin për t'i raportuar ngjarje të tilla në UJ, si edhe me urdhrin e dhënë shprehimisht nga Ojdaniqi më 2 prill. Kjo nuk përputhej as me përmendjen e ndjekjeve të tjera penale që lidheshin me shkelje më pak të rënda të cilat i raportoheshin Shtabit të Komandës së Lartë në raportet në të cilat nuk përmendeshin krimet e rënda të dhunshme, siç ishte raporti i datës 3 prill, në të cilin përmendeshin “incidente të izoluara të tentativave për grabitje”.¹⁴⁵⁵

602. Më 2 maj, Ojdaniqi përsëri shprehu pakënaqësinë e tij në lidhje me ngjarjet në Armatën e Tretë, sepse kishte pasur një numër të madh të plagosurish brenda një dite. Ai tha se “dikush ka bërë një gabim këtu” dhe e udhëzoi personelin e tij t'i kërkonin shpjegim Komandës së Armatës së Tretë.¹⁴⁵⁶ Gjithashtu, në fazat e mëvonshme të fushatës ajrore të NATO-s, në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë u raportua se anëtarët e UJ-së po kryenin

¹⁴⁴⁸ P1469 (paralajmërim për dorëzimin e raporteve të sakta dhe të konfirmuara, 25 mars 1999), f. 1.

¹⁴⁴⁹ Lubisha Stojimiroviq, T. 17681 (26 tetor 2007); Radojko Stefanoviç, T. 21728 (6 shkurt 2008); Millosh Mandiq, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviq, T. 8666 (18 janar 2007). *shih* Radomir Gojoviç, T. 16706 (2 tetor 2007).

¹⁴⁵⁰ 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999), f. 1–2.

¹⁴⁵¹ *Për shembull*, 4D276 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 3 prill 1999).

¹⁴⁵² P1744 (Urdhër për raportimin e ngjarjeve me rëndësi, 15 prill 1999); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 115; Aleksandar Vasileviq, T. 8845 (22 janar 2007).

¹⁴⁵³ 3D669 (Monitorimi i Situatës në Kosovë, 23 shkurt 1999), f. 2.

¹⁴⁵⁴ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 56, T. 8750 (19 janar 2007); *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16359, 16363–16364 (25 shtator 2007).

¹⁴⁵⁵ 4D276 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 3 prill 1999), f. 2.

¹⁴⁵⁶ 3D602 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 maj 1999), f. 4.

krime por se këto krime ende nuk po raportoheshin përmes kanaleve të rregullta të UJ-së.¹⁴⁵⁷ Përsëri, Ojdaniqi nuk mori masa disiplinore kundër Pavkoviçit, të cilin, më vonë, e ngritën në detyrë si shef i Shtabit të Përgjithshëm.¹⁴⁵⁸

x. Masat përmes gjykatave ushtarake

603. Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi nxori një urdhër për të gjitha komandat e UJ-së për mobilizimin e gjykatave dhe prokurorëve ushtarakë në kohë lufte.¹⁴⁵⁹ Urdhri kërkonte shtimin e personelit të gjykatave ushtarake për procedimin e aktivitetit të pritur kriminal gjatë konfliktit.¹⁴⁶⁰ Megjithëse ky mobilizim filloi të nesërmen,¹⁴⁶¹ në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, të datës 29 mars 1999, Ojdaniqi tha se gjykatat ushtarake nuk po punonin si duhej dhe se proceset gjyqësore po kryheshin si procedura të “shkurtra”. Ai kërkoi raporte për punën e gjykatave ushtarake.¹⁴⁶² Gojoviç dëshmoi se problemet me funksionimin e gjykatave ushtarake kishin të bënin me personelin dhe se, në këtë kuadër, brenda një periudhe të shkurtër kohore u emëruan 125 gjykatës dhe prokurorë të rinj.¹⁴⁶³ Një raport i Shtabit të Përgjithshëm, i përpiluar pas konfliktit, fliste dhe për problemet e hasura nga gjykatat ushtarake në fillim të konfliktit.¹⁴⁶⁴

604. Lidhur me punën e gjykatave ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s, më 7 maj 1999 Ojdaniqi mori një raport në të cilin thuhej se, pas vështirësive të para, organet e sistemit të drejtësisë ushtarake po punonin sipas kushteve të kohës së luftës dhe se prokurorët dhe gjykatat ushtarake po shtoheshin në numër.¹⁴⁶⁵ Shumë shpejt pas këtij raporti, më 14 maj, Ojdaniqi mori një raport nga Risto Matoviç, në të cilin thuhej se sistemi i drejtësisë ushtarake ishte vënë në punë me t’u shpallur gjendja e luftës, por se numri i madh i kallëzimeve penale kërkonte përforcimin e këtyre organeve me profesionistë të sprovuar. Po ashtu si në raportin e datës 7 maj, në të thuhej se qenë kapërcyer vështirësitë e fillimit. Më tej raporti bënte të ditur se organet e drejtësisë ushtarake

¹⁴⁵⁷ 3D633 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 1–3; Geza Farkash, T. 16365 (25 shtator 2007).

¹⁴⁵⁸ 4D163 (Kartelë Ushtarake e Nebojsa Pavkoviçit), f. 6; Radovan Radinoviç, T. 17323–17325 (19 tetor 2007).

¹⁴⁵⁹ P1470 (Urdhër në lidhje me Mobilizimin e Gjykatave Ushtarake, 25 mars 1999), i pranuar edhe me numrin 4D217; 3D800 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 26 mars 1999), f. 3; *shih edhe* 3D582 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 29 mars 1999), f. 3;

¹⁴⁶⁰ P1470 (Urdhër në lidhje me Mobilizimin e Gjykatave Ushtarake, 25 mars 1999), i pranuar edhe me numrin 4D217.

¹⁴⁶¹ P1470 (Urdhër në lidhje me Mobilizimin e Gjykatave Ushtarake, 25 mars 1999), i pranuar edhe me numrin 4D217; *Shih edhe* P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 79.

¹⁴⁶² 3D582 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 29 mars 1999), f. 6; *shih edhe* 3D804 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999).

¹⁴⁶³ Radomir Gojoviç, T. 16658–16659 (2 tetor 2007).

¹⁴⁶⁴ P2826 (Raport mbi punën e gjykatave ushtarake, 12 shtator 1999), f. 2.

¹⁴⁶⁵ P1917 (Informacion nga Matoviç për punën e organeve gjyqësore ushtarake në kohë lufte, 7 maj 1999).

në komandën e Korpusit të Prishtinës po merreshin me dosje penale komplekse për krime të rënda, çka bënte të domosdoshme përfshirjen e informacionit mbështetës të akuzave në kallëzimet penale. Raporti përmbante rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të organeve të drejtësisë ushtarake, duke përfshirë rekomandimin që prokurorët dhe kryetarët e gjykatave të kontaktonin me komandantët e njësisë pranë të cilave funksiononin për shkëmbimin e informacionit në lidhje me sjelljen kriminale të personelit të UJ-së dhe përmirësimin e masave për parandalimin e këtyre krimeve, që të vendosej bashkëpunimi me gjykatat civile dhe që komandat e ndryshme ushtarake të monitoronin punën e organeve gjyqësore.¹⁴⁶⁶

605. Më 15 maj, Ojdaniqi kërkoi një analizë të mëtejshme të punës së organeve gjyqësore ushtarake,¹⁴⁶⁷ dhe pas një jave Shtabi i Komandës së Lartë mori një kërkesë nga Armata e Tretë për rritjen e punës së organeve gjyqësore ushtarake.¹⁴⁶⁸ Në përgjigje të kësaj, Ojdaniqi i kërkoi Shtabit të Komandës së Lartë të kryente një analizë tjetër për të parë nëse gjykatat ushtarake dispononin burimet e nevojshme, parë nga këndvështrimi i numrit të kallëzimeve penale.¹⁴⁶⁹ Në atë kohë, Ojdaniqi vazhdoi të informohej se gjykatat ushtarake po funksiononin me informacionet që mori në mbledhjen e datës 26 maj, nga Kryetari dhe Prokurori i Gjykatës së Lartë Ushtarake në mbledhjen e datës 28 maj, dhe nga Matoviqi në mbledhjen e datës 2 qershor.¹⁴⁷⁰ Pas marrjes së raportit për gjykatat ushtarake dhe si pasojë e mbledhjes me Millosheviqin më 17 maj 1999, Ojdaniqi urdhëroi përpilimin e udhëzimeve, ku shpjegoheshin funksionimi dhe kompetencat e sistemit të drejtësisë ushtarake, së bashku me organet e tjera përgjegjëse për zbulimin e krimeve dhe të autorëve të krimeve për nisjen dhe procedimin e çështjeve penale.¹⁴⁷¹

606. Një version i ndryshëm i marrëdhënies midis gjykatave ushtarake dhe UJ-së del në një raport të përgatitur nga Llakiq Gjoroviqi, dëshmia e të cilit është diskutuar me hollësi në Ndarjen VI.A.1.e. Gjoroviqi dëshmoi se organet e sigurimit ushtarak, nën udhëzimin e udhëheqjes shtetërore dhe ushtarake, ushtronin kontroll të plotë mbi të gjithë organizimin dhe rekrutimin e personelit brenda organeve të drejtësisë ushtarake, përfshirë këtu përzgjedhjen, zëvendësimin, largimin dhe lirimin e gjykatësve dhe prokurorëve ushtarakë, sidomos në postet administruese dhe drejtuese.¹⁴⁷² Ai dëshmoi edhe se ndjekja penale e personelit të UJ-së për krimet e kryera gjatë

¹⁴⁶⁶ P1918 (Informacion nga Matoviqi për punën e organeve gjyqësore ushtarake në kohë lufte, 14 maj 1999), f. 3, 7, 7.

¹⁴⁶⁷ 3D615 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 15 maj 1999), f. 3.

¹⁴⁶⁸ 3D621 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 21 maj 1999), f. 3.

¹⁴⁶⁹ 3D621 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 21 maj 1999), f. 5.

¹⁴⁷⁰ 3D626 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 26 maj 1999), f. 2; 3D628 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 28 maj 1999), f. 2; 3D633 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 2; *shih edhe* 3D862 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 27 maj 1999), f. 9.

¹⁴⁷¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8878 (22 janar 2007); 3D492 (Shtabi i Komandës së Lartë-Udhëzime, 22 maj 1999).

¹⁴⁷² P2672 (Llakiq Gjoroviq, raport për procedurat e gjykatës ushtarake në kohë lufte dhe kohë paqeje, 14 gusht 2006), f. 2.

konfliktit ishte jo e plotë përgjithësisht për shkak të moskallëzimit dhe mbulimit të provave nga administratat e sigurimit të UJ-së.¹⁴⁷³ Gjoroviqi e implikoi Ojdaniqin në një skemë ku përfshihej konfiskimi i paligjshëm i pronave të shqiptarëve kosovarë. Mirëpo, më herët ai kishte përmendur Llazareviqin, dhe jo Ojdaniqin.¹⁴⁷⁴ Dhoma nuk mbështetet në versionin e tij sa i takon implikimit të Ojdaniqit në këtë skemë të paligjshme.

607. Në mbledhjen e datës 8 qershor, Farkashi raportoi se ishte bërë një analizë e plotë e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë, që nxirrte përfundimin se qenë kryer krime të rënda, përfshirë edhe përdhunime dhe plaçkitje, por se 95 për qind e autorëve të krimeve qenë arrestuar dhe po hetoheshin.¹⁴⁷⁵ Në këtë mbledhje, Ojdaniqi nxori një dokument përmes të cilit urdhëronte që organet gjyqësore ushtarake të vendosnin prioritetet për ndjekjen penale të krimeve dhe se prioritetin më të lartë duhet t'ua kushtonin shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare.¹⁴⁷⁶

608. Radomir Gojoviqi, shefi i Administratës Juridike të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë gjatë fushatës së NATO-s, dëshmoi se, pas fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi e pyeti lidhur me një raport që kishte hartuar që përmendte një numër të madh ndjekjesh penale në gjykatat ushtarake gjatë konfliktit, por shumë pak qenë për krime lufte. Ai deklaroi se Ojdaniqi theksoi mospërputhjen e madhe midis numrit të viktimave që ankoheshin për krime të rënda dhe numrit shumë të vogël të procedimit penal të krimeve të tilla.¹⁴⁷⁷ Ai e informoi Ojdaniqin se kjo shpjegohej pjesërisht për shkak të vështirësisë për identifikimin e autorëve të krimeve në kohë lufte, ku shokët e tyre ushtarë i ndihmonin në fshehjen e fajësisë.¹⁴⁷⁸ Më pas, Ojdaniqi organizoi një takim midis Farkashit dhe shefit të RDB-së, Radomir Markoviqit, për të diskutuar një qasje të përbashkët për hetimin e krimeve, takim i cili u zhvillua më 9 korrik 1999.¹⁴⁷⁹ Të pranishëm në mbledhje, si përfaqësues të UJ-së, qenë Vasileviqi, Ojdaniqi, Farkashi, Kërگا dhe Gajiqi, dhe si përfaqësues të MPB-së qenë Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, Stevanoviqi dhe Markoviqi.¹⁴⁸⁰ Sipas

¹⁴⁷³ Llakiq Gjoroviqi, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 6, 9.

¹⁴⁷⁴ Llakiq Gjoroviqi, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 17, T. 11625–11627 (13 mars 2007).

¹⁴⁷⁵ 3D493 (Raporte për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 8 qershor 1999), f. 2; Geza Farkash, T. 16304 (25 shtator 2007).

¹⁴⁷⁶ 3D487 (Detyra të vendosura nga Shefi i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 qershor 1999), f. 1; Geza Farkash, T. 16306 (25 shtator 2007); 3D493 (Raporte për Komandën e Lartë dhe Shefin e Shtabit, 8 qershor 1999), f. 5.

¹⁴⁷⁷ Radomir Gojoviqi, T. 16684–16685 (2 tetor 2007).

¹⁴⁷⁸ Radomir Gojoviqi, T. 16685 (2 tetor 2007).

¹⁴⁷⁹ Aleksandar Vasileviqi, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 74, 90.

¹⁴⁸⁰ Aleksandar Vasileviqi, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 90.

Vasileviqit, pjesëmarrësit diskutuan për procedimin e çështjeve penale dhe Stojilkoviqi tha se po procedoheshin vetëm 16 çështje penale kundër anëtarëve të MPB-së.¹⁴⁸¹

xi. Përfundim në lidhje me dijeninë për krimet në Kosovë dhe reagimin ndaj tyre

609. Është se Ojdaniqi kishte dijeni për kryerjen e krimeve nga vartësit e tij brenda UJ-së në Kosovë, krahas krimeve të kryera nga anëtarët e MPB-së. Mbrojtja e Ojdaniqit thekson faktin se raportet e luftimit nuk raportojnë për pjesëmarrje të UJ-së në shpërnguljen e dhunshme dhe argumenton se, për rrjedhojë, Ojdaniqi nuk mund të ketë qenë në dijeni të krimeve të tilla.¹⁴⁸² Dhoma Gjyqësore vëren se dijenia e Ojdaniqit vinte nga disa burime të ndryshme, sikurse shpjegohet me hollësi më lart, dhe si rrjedhojë nuk është e mendimit se mungesa e raportimit të shpërnguljes së dhunshme në raportet e luftimit krijon ndonjë dyshim lidhur me dijeninë e Ojdaniqit për kryerjen e shpërnguljes së dhunshme në Kosovë.

610. Reagimi i Ojdaniqit ndaj këtij informacioni konsistoi kryesisht në dhënie urdhrash për respektimin e së drejtën humanitare ndërkombëtare, mbështetje në funksionimin e vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë ushtarake, dhe në dërgimin e misionëve faktmbledhëse me anëtarë të Administratës së Sigurisë së kishte në vartësi. Megjithatë, ai vijoi të urdhëronte pjesëmarrjen e UJ-së në operacione ushtarake me MPB-në në Kosovë, sikurse është diskutuar më lart.

611. Mirëpo, ai u vu në dijeni edhe të shqetësimeve serioze për paanshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë ushtarake.¹⁴⁸³ I ndërthurur me dijeninë e tij për veprimtarinë e përhapur kriminale dhe mungesën e ndjekjeve penale të efektshme, informacioni lartpërmendur e ndërjegjësoi Ojdaniqin për faktin se mbështetja te sistemi i drejtësisë ushtarake nuk do të përbënte një masë të efektshme për ndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit e tij. Në mbyllje të fushatës ajrore të NATO-s, ai mori raporte në të cilat bëhej e ditur se një numër i madh i efektivave të UJ-së qenë ndjekur penalisht për krime më pak të rënda kundër UJ-së, si dezertimi, por shumë pak qenë ndjekur penalisht për krime të rënda apo shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Ai ishte në dijeni të kryerjes së përhapur të krimeve, përfshirë edhe ato krime që qenë përfshirë në aktakuzën e parë. Megjithëse ai vijoi si shef i Shtabit të Përgjithshëm deri në muajin shkurt 2000, raportet nga sistemi i drejtësisë ushtarake tregojnë se nuk nisi asnjë procedim penal i komandantëve të UJ-së në lidhje me incidentet e pretenduara në aktakuzë dhe ai nuk ngriti asnjë komision për të hetuar vërtetësinë e akuzave në aktakuzën në fjalë, në të cilat përfshihej pjesëmarrja e UJ-së në

¹⁴⁸¹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 90.

¹⁴⁸² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 264.

¹⁴⁸³ *Shih, për shembull*, 3D635 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 qershor 1999), f. 2.

shpërnguljen e gjerë dhe sistematike të dhunshme të shqiptarëve kosovarë. Këto prova lidhem me aspektin nëse vërtetohet synimi kriminal për çdo formë përgjegjësie.

6. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Dragolub Ojdaniqit

612. Prokuroria pretendon se Ojdaniqi është përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) apo për ndihmë dhe inkurajim të krimeve në Aktakuzë.¹⁴⁸⁴ Ojdaniqi akuzohet edhe me përgjegjësinë si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.¹⁴⁸⁵ Mbrojtja e Ojdaniqit përgjigjet se Prokuroria nuk ka vërtetuar se ai ka marrë pjesë në krimet e pretenduara në Aktakuzë, dhe as se ka pasur dijeni se këto krime kishin ndodhur apo do të ndodhnin.¹⁴⁸⁶

613. Sipas Prokurorisë, Ojdaniqi ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe kontribuoi në masë të konsiderueshme në zbatimin e kësaj ndërmarrjeje. Prokuroria parashton se Ojdaniqi kishte synimin për ta realizuar këtë plan të përbashkët dhe veprimet e tij—përfshirë edhe komandimin, urdhërimin dhe udhëzimin nga ana e tij e operacioneve të UJ-së në Kosovë, përfshirë edhe operacionet e përbashkëta me MPB-në—tregojnë se ai synonte ta realizonte këtë plan përmes mjeteve dhe metodave kriminale.¹⁴⁸⁷ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se ai nuk mori pjesë në ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe se nuk është vërtetuar që ai të ketë pasur synim të përbashkët me të tjerë për të marrë pjesë në një ndërmarrje të tillë.¹⁴⁸⁸

614. Dhoma vëren se nuk është e detyruar të bëjë përfundimet faktike të plota për çdo formë të përgjegjësisë së pretenduar, por mund të analizojë vetëm ato që përshkruajnë më me saktësi sjelljen e të akuzuarit.¹⁴⁸⁹ Në përgjigje të pretendimit të Prokurorisë se Ojdaniqi ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale që kishte për synim kryerjen e krimeve në Kosovë, Dhoma fillimisht analizon përgjegjësinë e tij ligjore në kuadër të kësaj forme përgjegjësie. Çështjet e trajtuara janë ilustruar me shembuj konkretë, mirëpo Dhoma vëren se përfundimet bazohen në të gjitha provat përkatëse.

a. Kryerja e krimeve përmes pjesëmarrjes në ndërmarrje të përbashkët kriminale

¹⁴⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 725, 808.

¹⁴⁸⁵ Aktakuza, para. 11, 40–44.

¹⁴⁸⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 5.

¹⁴⁸⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 8, 725–729, 783.

¹⁴⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 4–5.

¹⁴⁸⁹ *Shih* Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 602; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 388–389.

615. Që përgjegjësia e Ojdaniqit të lindë në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të vërtetojnë se ai ka marrë pjesë të paktën në një aspekt të qëllimit të përbashkët për mundësimin e vijimësisë së kontrollit të Kosovës nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë, përmes krimeve të shpërnguljes me dhunë, për të cilin Dhoma tashmë ka konkluduar se ka ekzistuar.¹⁴⁹⁰ Për vërtetimin e këtij elementi, nuk është e domosdoshme që Ojdaniqi t'i ketë kryer fizikisht krimet përmes të cilave u realizua qëllimi, apo edhe krime të tjera.¹⁴⁹¹ Madje, nuk është e domosdoshme edhe që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të këtyre krimeve.¹⁴⁹² Mirëpo, duhet që kontributi i tij në këtë plan të ketë qenë i konsiderueshëm.¹⁴⁹³ Sa i përket elementit të nevojshëm mendor, duhet vërtetuar që Ojdaniqi mori vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte synimin e përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë që ishte objektiv i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, e cila në këtë rast është shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë.

616. Dhoma konstaton se, megjithëse ka prova të konsiderueshme në mbështetje të pretendimit të Prokurorisë se Ojdaniqi mbështeti kryerjen e krimeve në gjithë Kosovën nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në një fushatë të përhapur gjerësisht dhe sistematike kundër shqiptarëve kosovarë duke vijuar me autorizimin e veprimeve dhe operacioneve të UJ-së, përfshirë edhe përdorimin e popullsisë së armatosur joshqiptare, përmes ushtrimit të kompetencave të tij, nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synim të përbashkët me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në provat në mbështetje të këtij pretendimi të Prokurorisë përfshihen raportimet konkrete të vartësve të Ojdaniqit për aktivitetin kriminal, së bashku me dijeninë e Ojdaniqit për situatën e përgjithshme në Kosovë bazuar në postin e tij si oficeri më i lartë në UJ, takimet e përditshme me Millosheviqin gjatë fushatës ajrore të NATO-s, prania në mbledhjet e datave 4, 16 dhe 17 maj në Beograd për të diskutuar për aktivitetin kriminal në Kosovë dhe nxjerrja e vazhdueshme e urdhrave nga ana e tij për përdorimin e UJ-së në Kosovë në vitin 1999, përkundër faktit që ishte në dijeni se atje po kryheshin krime nga forcat e UJ-së dhe MPB-së.¹⁴⁹⁴

617. Mirëpo, provat tregojnë edhe se Pavkoviqi, që ishte anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, i minimizoi disa raporte mbi krimeve të efektiveve UJ-së të cilat iu dërguan Ojdaniqit dhe vazhdoi të takohej me Millosheviqin në vitin 1999 pa e njoftuar Ojdaniqin. Përpara fushatës

¹⁴⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227.

¹⁴⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 99.

¹⁴⁹² Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

¹⁴⁹³ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

¹⁴⁹⁴ Provat e tjera që lidhen me dijeninë e Ojdaniqit për fushatën diskutohen më poshtë.

ajrore të NATO-s, Ojdaniqi i shkeli Marrëveshjet e Tetorit duke dislokuar trupa shtesë në Kosovë. Mirëpo ai urdhëroi që njësitë shtesë të mbeteshin në kufirin me Shqipërinë, çka lë të kuptohet se motivi i Ojdaniqit për shkeljen e Marrëveshjeve të Tetorit ishte që t'i bënte ballë kërcënimit të që mendonte se paraqiste NATO-ja dhe UÇK-ja, dhe jo përgatitja për një fushatë të gjerë shpërnguljeje të dhunshme në Kosovë. Me gjithë urdhrin e Ojdaniqit, Pavkoviqi dislokoji Brigadën e 72-të të Posaçme në brendësi të Kosovës dhe e keqinformoi Ojdaniqin në lidhje me veprimet provokuese të UJ-së në Kosovë, në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit, në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999. Këto prova tregojnë se Ojdaniqi nuk ishte anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Gjithashtu, ai mori një sërë masash në lidhje me aktivitetet kriminale të anëtarëve të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, ku përfshihet edhe organizimi i një seminari për oficerët e UJ-së në lidhje me zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në vitin 1998, dërgimi i anëtarëve të Administratës së Sigurimit në Komandën e Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës për të mbledhur informacione të mëtejshme për krimet e anëtarëve të UJ-së, kërkimi i raporteve për funksionimin e sistemit të drejtësisë ushtarake dhe organizimi i një mbledhjeje më 9 korrik 1999 midis Farkashit dhe Radomir Markoviqit nga MPB-ja për të diskutuar për një qasje të përbashkët për hetimin e krimeve. Këto prova rrëzojnë pretendimin se ai kishte synimin e përbashkët për të kryer krime që përfshiheshin në qëllimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

618. Bazuar në këto prova, Dhoma konkludon se Prokuroria nuk ka vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Ojdaniqi kishte synimin e përbashkët me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale për ruajtjen e kontrollit në Kosovë përmes shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve kosovarë. Për shkak të këtij konkluzioni, Dhoma nuk do të analizojë aspektin nëse Ojdaniqi kontribuoi në masë të konsiderueshme në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

619. Duke kujtuar se Dhomës i duhet të analizojë vetëm ato forma përgjegjësie në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të cilat përshkruajnë më me saktësi sjelljen e të pandehurit, Dhoma bën një konstatim të përgjithshëm të elementëve fizikë të formave të tjera të përgjegjesisë në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 se planifikimi kryesisht ka të bëjë me planifikuesit e krimeve, se nxitja kryesisht ka të bëjë me nxitësit e krimeve dhe se urdhërimi kryesisht ka të bëjë me urdhëruesit e krimeve; ndërsa ndihma dhe inkurajimi kanë të bëjnë me ata të cilët ofrojnë praktikisht ndihmë, inkurajim ose mbështetje morale për kryerjen e krimeve.¹⁴⁹⁵ Bazuar në sa më sipër, Dhoma nuk gjykon se planifikimi, nxitja ose urdhërimi karakterizojnë sjelljen e Ojdaniqit dhe nuk pranon që këto forma përgjegjësie përkojnë me përgjegjësinë e tij individuale penale. Rrjedhimisht, Dhoma

¹⁴⁹⁵ Për përshkrimet e plota të elementëve të këtyre formave të përgjegjesisë, shih Kapitullin II.

tani do të analizojë përgjegjësinë e tij për ndihmën dhe inkurajimin e dhënë për kryerjen e krimeve të cilët janë vërtetuar se kanë ndodhur.

b. Ndhma dhe inkurajimi

620. Që Ojdaniqi të ngarkohet me përgjegjësi për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit për krimet që janë vërtetuar, duhet provuar se ai dha praktikisht ndihmë, inkurajim ose mbështetje morale për autorin e krimit apo shkeljes bazë, si edhe se ndihma, inkurajimi ose mbështetja morale praktike pati ndikim thelbësor në kryerjen e krimit apo shkeljes bazë.¹⁴⁹⁶ Gjithashtu duhet provuar se ai e dha qëllimisht ndihmën dhe se ishte i vetëdijshëm për elementët thelbësorë të krimit apo shkeljeje bazë, përfshirë edhe synimin kriminal të autorit fizik apo të ndërmjetëm.¹⁴⁹⁷ Dhënia e ndihmës, inkurajimit apo mbështetjes morale mund të ndodhë përpara, gjatë ose pas kryerjes së krimit.¹⁴⁹⁸ I akuzuari mund të ndihmojë dhe inkurajojë përmes mosveprimit, kur (a) ka detyrimin ligjor për të vepruar, (b) i akuzuari ka mundësinë për të vepruar, (c) nuk vepron me synimin e shkaktimit të pasojave kriminale ose me dijeninë dhe pëlqimin e ndodhjes së këtyre pasojave, dhe (d) mosveprimi shkakton kryerjen e krimit.

621. Në lidhje me përgjegjësinë në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit për mosveprimin, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë asnjë detyrim ligjor nën të cilin ndodhej Ojdaniqi gjatë periudhës përkatëse të cilin ai nuk e ka përmbushur.¹⁴⁹⁹ Më tej, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se mosparandalimi apo mosndëshkimi nga Ojdaniqi i kryerjes së krimeve nga vartësit e tij, nëse do të vërtetohej mund të përbënte bazë për përgjegjësi sipas paragrafit 1 të Nenit 7, duke sjellë si shembull Aktgjykimin *Prokurori kundër Mpambara-s*, në të cilën Dhoma Gjyqësore e hodhi poshtë teorinë e Prokurorisë se mosparandalimi apo mosndëshkimi mund të përbënte përgjegjësi në bazë të paragrafit 1 të Nenit 6 (që është ekuivalenti i TPNR-së për paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit).¹⁵⁰⁰ Sipas Mbrojtjes së Ojdaniqit, paragrafi 1 i Nenit 7 dhe paragrafi 3 i Nenit 7 i Statutit të Tribunalit përcaktojnë forma të dallueshme përgjegjësie dhe mbivendosja e këtyre dy paragrafëve për të mundësuar që mosparandalimi apo mosndëshkimi të

¹⁴⁹⁶ Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 45, 46; Aktgjykim i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

¹⁴⁹⁷ Aktgjykim i Apelit *Simiq dhe të tjerë*, para. 86; Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 49; Aktgjykim i Apelit *Vasileviq*, para. 102; Aktgjykim i Apelit *Aleksovski*, para. 162.

¹⁴⁹⁸ Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 48.

¹⁴⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 443.

¹⁵⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 446–447; Aktgjykim i *Mpambara*, para. 39.

përbëjë një mosveprim të fajshëm në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 do ta bënte të panevojshëm paragrafin 3 të Nenit 7.¹⁵⁰¹

622. Dhoma vëren se, edhe pse paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 7 nuk i përcaktojnë shprehimisht format e dallueshme të përgjegjesisë penale, kjo nuk do të thotë se nuk ka mbivendosje midis dy paragrafëve në lidhje me sjelljen faktike që mund të çojë në përgjegjësi. Mbivendosja është pranuar dhe një normë e sanksionuar e jurisprudencës së Tribunalit përcakton se, në përgjithësi, aty ku është i mundshëm dënimi sipas të dyja formave të përgjegjesisë, dhoma duhet të dënojë në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7. Në lidhje me fajësinë në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 për mosveprim, Dhoma ka arritur në përfundimin se kjo mund të sjellë përgjegjësi penale kur ka ekzistuar detyrimi ligjor për të vepruar dhe ku i akuzuari nuk ka vepruar. Përkufizimi i një detyrimi të tillë ligjor është i pavarur dhe jo i kufizuar nga kushtet e paragrafit 3 të Nenit 7, i cili përcakton një formë të dallueshme të përgjegjesisë penale, i cili zbatohet për eprorët. Rrjedhimisht në lidhje me pretendimin për ndihmë dhe inkurajim nga Ojdaniqi të krimeve të kryera në Kosovë më 1999, Dhoma do të analizojë veprimet dhe mosveprimet e tij.

623. Në vitin 1998 dhe gjatë periudhës deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s, Ojdaniqi i vinte informacion që bënte të ditur se anëtarë të UJ-së dhe MPB-së ishte përgjegjës për vepra të rënda penale të kryera kundër shqiptarëve etnikë në Kosovë. Ndër të tjera, në këtë informacion përfshiheshin edhe paralajmërimet nga John Crosland-i se trupat e UJ-së po përdornin forcë të tepruar në Kosovë në vitin 1998 dhe prova të pjesëmarrjes së UJ-së dhe MPB-së në dhunën kundër civilëve në Abrinë e Epërme, Gllogoc, në vitin 1998. Gërshetuar me informacionin e përcjellë nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me numër 1160 dhe 1199, gjithë këto të dhëna e bënë të ndërgjegjshëm Ojdaniqin se nëse urdhëronte hyrjen e UJ-së në Kosovë në vitin 1999 kishte të ngjarë të ndodhte përdorimi i tepruar i forcës dhe shpërnguljet e dhunshme.

624. Dhoma ka konkluduar se, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së ndërmorën një sulm të gjerë dhe sistematik kundër shumë fshatrave në 13 komuna të Kosovës, që rezultoi në kryerjen e krimeve kundër qindra mijërave shqiptarëve kosovarë.

625. Ojdaniqi ishte në dijeni të fushatës së përgjithshme të shpërnguljeve të dhunshme që u krye nga UJ-ja dhe MPB-ja në mbarë Kosovën gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm, me pushtet *de jure* dhe *de facto* mbi forcat e UJ-së në Kosovë, ai takohej përditë me Millosheviqin për të diskutuar për aksionet e UJ-së dhe për situatën në Kosovë, dhe mori pjesë në mbledhjet me drejtuesit e MPB-së, UJ-së dhe drejtues të tjerë të RFJ-së, siç qenë ato të datave 4, 16

¹⁵⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 453.

dhe 17 maj 1999, ku u diskutua për kryerjen e krimeve nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Sistemi i komandimit dhe i komunikimit i UJ-së vijoi funksionimin gjatë gjithë fushatës së NATO-s dhe megjithëse Pavkoviqi përpiqej t'i minimizonte raportimet e aktivitetit kriminal të anëtarëve të UJ-së, Ojdaniqi mori informacion edhe nga burime të tjera, përfshirë edhe drejtpërsëdrejti nga organet e sigurimit të UJ-së dhe nga raportet e degës së zbulimit të tij lidhur me informacione që vinin nga bashkësia ndërkombëtare. Që në ditët e para të konfliktit në vitin 1999, Ojdaniqi ishte në dijeni të pjesëmarrjes së MPB-së dhe UJ-së në zhvendosjen e shqiptarëve kosovarë,¹⁵⁰² dhe se kjo përfshinte në vetvete edhe akte kriminale të kryera nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së, ndër të cilat edhe shpërngulja e dhunshme.¹⁵⁰³ Më 7 prill 1999 Ojdaniqi pranoi se ishte në dijeni të kryerjes së mëparshme të krimeve, ndër të cilat zjarrvënia, vjedhja dhe plaçkitja e shqiptarëve kosovarë nga anëtarët e UJ-së.¹⁵⁰⁴ Ojdaniqi ishte gjithashtu në dijeni të kontekstit të gjerë diskriminues të konfliktit.¹⁵⁰⁵ Ai qe vënë në dijeni të akuzave për gjerësinë dhe përhapjen e këtij aktiviteti kriminal, ku përfshiheshin edhe shpërnguljet e dhunshme, përmes burimeve të brendshme të informimit, siç ishin raportimet në Shtabin të Komandës së Lartë, dhe përmes burimeve të jashtme, si për shembull përmes publikimit të aktakuzës së parë kundër tij, ku përmendej konkretisht fushata gjerësisht e përhapur e shpërnguljeve të dhunshme e ndërmarrë nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe disa vendndodhje konkrete ku qenë bërë këto shpërngulje të dhunshme.¹⁵⁰⁶ Ndërthurja e dijenisë së përgjithshme të Ojdaniqit për shpërnguljen e gjerësisht të përhapur të shqiptarëve kosovarë gjatë operacioneve të UJ-së me dijeninë e tij konkrete të vendndodhjeve të këtyre operacioneve, përfshirë edhe shumicën e vendndodhjeve të përmendura në Aktakuzë, bën që Dhoma të arrijë në përfundimin se i vetmi deduksion logjik që mund të nxirret është se ai ishte në dijeni të fushatës së terrorit, dhunës dhe shpërnguljes së dhunshme që po kryenin forcat e UJ-së dhe të MPB-së kundër shqiptarëve kosovarë.

626. Ojdaniqi u dha ndihmë, inkurajim dhe mbështetje morale praktike forcave të UJ-së që u angazhuan në shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë, në bashkërendim me MPB-në. Ai kontribuoi përmes nxjerrjes së urdhrave për pjesëmarrjen e UJ-së në operacione të përbashkëta me MPB-në në Kosovë gjatë fushatës ajrore të NATO-s, përmes mobilizimit të forcave të UJ-së për pjesëmarrje në këto operacione dhe përmes furnizimit të tyre me pajisjet ushtarake të UJ-së.¹⁵⁰⁷

¹⁵⁰² 3D802 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm, 28 mars 1999), f. 4.

¹⁵⁰³ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999); Karol John Drewienkiewicz, T. 7815 (4 dhjetor 2006).

¹⁵⁰⁴ P1479 (Urdhër lidhur me vullnetarët, 7 prill 1999), f. 3.

¹⁵⁰⁵ 3D685 (Vlerësim i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për informacionin mbi sigurinë, shkurt 1999).

¹⁵⁰⁶ P968 (*Prokurori kundër Millosheviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IC-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999).

¹⁵⁰⁷ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva "Grom 3", 16 janar 1999); Vladimir Lazareviq, T. 17894–17895 (8 nëntor 2007); P1487 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999), f. 1; P1925 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 mars 1999).

Krahas nxjerrjes së urdhrave përmes të cilave autorizoi praninë e UJ-në në vendndodhjet ku po kryheshin krimet, ai nuk mori masa të efektshme që mund t'i merrte si hetime konkrete për shpërnguljet e dhunshme, me gjithë dijeninë që kishte për këto incidente. Gjithashtu, Ojdaniqi kontribuoi për kryerjen e krimeve në Kosovë nga UJ-ja përmes rolit të tij në armatosjen e popullatës joshqiptare dhe përmes urdhërimit të angazhimit të kësaj popullate në vitin 1999.¹⁵⁰⁸ Këto kontribute patën ndikim thelbësor në kryerjen e krimeve, sepse rezultuan në ndihmë nëpërmjet dërgimit të ushtarëve në terren për kryerjen e këtyre akteve, ndihmuan në arsenalin e armëve të UJ-së në kryerjen e këtyre akteve dhe në inkurajim dhe mbështetje morale përmes autorizimit brenda hierarkisë komanduese të UJ-së për vijimësinë e funksionimit të UJ-së në Kosovë me gjithë kryerjen e këtyre krimeve.

627. Për më tepër, Ojdaniqi kishte kompetenca të gjera për nisjen e procedimit disiplinor kundër çdo efektivit tjetër të UJ-së dhe kishte detyrë të garantonte nxjerrjen sa më shpejt para përgjegjësisë në kohë lufte të anëtarëve të UJ-së që kryenin vepra dhe shkelje kundër disiplinës ushtarake të UJ-së.¹⁵⁰⁹ Megjithëse në fillim të muajit prill 1999 ai nxori një urdhër që aktivitetet kriminale t'i raportoheshin Shtabit të Komandës së Lartë, Pavkoviqi nuk e respektoi këtë urdhër.¹⁵¹⁰ Ky mosraportim vazhdoi gjatë gjithë vitit 1998 dhe 1999, dhe Ojdaniqi u informua shprehimisht nga Dimitrijeviqi për këtë mosraportim të Pavkoviqit, disa herë.¹⁵¹¹ Ojdaniqi mori disa masa konkrete në kundërpërgjigje të veprimeve të Pavkoviqit, përfshirë edhe dërgimin e anëtarëve të Administratës së Sigurimit në vartësi të tij për mbledhjen e më shumë të dhënave dhe ishte nismëtar i takimit me Millosheviqin më 17 maj 1999. Mirëpo, këto masa ishin të pamjaftueshme për zgjidhjen e problemit, sikurse u diskutua edhe më lart. Duke marrë parasysh dijeninë që kishte për aktivitetin kriminal gjerësisht të përhapur mes anëtarëve të UJ-së nga mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj, nga letra e Arbour-it, nga publikimi i aktakuzës së parë dhe nga disa kallzime të mëhershme të veprave penale të kryera nga anëtarët e UJ-së, kërkesa e Ojdaniqit për të marrë një përgjigje nga Pavkoviqi ishte e pamjaftueshme.¹⁵¹² Më pas, kur Shtabit të Komandës së Lartë përsëri iu paraqit informacion se po vazhdonin të kryheshin krime nga efektivitë i UJ-së në Kosovë në muajin qershor 1999, Ojdaniqi nuk lëvizi nga metoda e tij dhe vazhdoi të kërkonte raporte dhe të

¹⁵⁰⁸ P931 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23; P1487 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999), f. 1.

¹⁵⁰⁹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 159, 180, 181; 4D532 (Rregullore e Shërbimit të UJ-së, 1 janar 1996), nenet 291, 313, 314.

¹⁵¹⁰ 4D276 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 3 prill 1999).

¹⁵¹¹ P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14; P933 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15; P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21.

¹⁵¹² 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046–16047 (20 shtator 2007).

lëshonte urdhra për fuqizimin e funksionimit të gjykatave ushtarake.¹⁵¹³ Sërish, ai nuk mori masa disiplinore kundër komandantit të Armatës së Tretë, me gjithë faktin se krimet ende nuk pasqyroheshin në raportet me shkrim që Armata e Tretë i dorëzonte Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁵¹⁴ Mosmarrja e masave të efektshme kundër Pavkoviqit nga ana e Ojdaniqit praktikisht përbënte ndihmë, inkurajim dhe mbështetje morale anëtarëve të UJ-së të cilët kryen krime në Kosovë, duke kultivuar mendësinë e mosndëshkimit lidhur me shpërnguljen e dhunshme të popullatës shqiptare kosovare dhe duke e lejuar komandantin e Armatës së Tretë të vijonte të jepte urdhra për kryerjen e operacioneve në Kosovë gjatë të cilëve u realizua shpërngulja e dhunshme.

628. Dhoma konkludon se është vërtetuar se të gjitha veprimet e Ojdaniqit të përshkruara më lart kanë qenë të vullnetshme. Dhoma gjykon se, përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tij, Ojdaniqi dha praktikisht ndihmë, inkurajim dhe mbështetje morale për anëtarët e UJ-së të përfshirë në kryerjen e zhvendosjes dhe dëbimit të dhunshëm në vendndodhjet konkrete të krimeve ku është vërtetuar se ka marrë pjesë UJ-ja, se sjellja e tij pati ndikim thelbësor në kryerjen e këtyre krimeve, se ai ishte në dijeni të kryerjes së qëllimshme të këtyre krimeve nga UJ-ja në bashkërendim me MPB-në dhe se ai ishte në dijeni se sjellja e tij ndihmoi në kryerjen e këtyre krimeve.

629. Edhe pse shpërnguljet e dhunshme qenë pjesë e fushatës së organizuar të UJ-së dhe MPB-së, Dhoma nuk bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasjet, dhuna seksuale apo shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore ishin synime të paramenduara të kësaj fushate. Si pasojë, megjithëse ai ishte në dijeni që anëtarët e UJ-së kishin vrarë shqiptarë kosovarë në disa raste, nuk është vërtetuar që Ojdaniqi të ketë qenë në dijeni se forcat e UJ-së dhe MPB-së po hynin në vendet e krimeve të përmendura më lart për të kryer vrasje, dhunë seksuale apo shkatërrim të objekteve fetare dhe kulturore. Rrjedhimisht, në rastin e Ojdaniqit, synimi kriminal i ndihmës dhe inkurajimit nuk është vërtetuar në lidhje me pikat 3, 4 dhe 5 të aktakuzës.

630. Për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se është vërtetuar përgjegjësia e Dragolub Ojdaniqit për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit, në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit, për krimet në vendndodhjet e mëposhtme:

- Pejë
 - Qyteti i Pejës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjakovë

¹⁵¹³ 3D633 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 2; 3D487 (Detyra të vendosura nga Shefi i Shtabit të Komandës së Lartë, 8 qershor 1999), f. 1.

¹⁵¹⁴ Radovan Radinoviç, T. 17323–17325 (19 tetor 2007).

- Qyteti i Gjakovës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Korenicë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Dobrosh—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Ramoc— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mejë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Fshatra të tjerë në zonën e Caragojit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Piranë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Rahovec
 - Celinë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Skënderaj
 - Turiçec—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Izbicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Tushilë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Qirez— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit.
- Prishtinë
 - Qyteti i Prishtinës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjilan
 - Zhegër— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lladovë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Përlepnice— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Ferizaj
 - Sojevë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mirosalë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

- Staro Sello— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Kaçanik
 - Kotlinë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Kaçanik— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lisnajë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit.

631. Në lidhje me krimet që është vërtetuar se janë kryer dhe për të cilat Ojdaniqi nuk është konsideruar përgjegjës për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit, Dhoma gjithashtu konkludon se ai nuk i planifikoi, nxiti apo urdhëroi këto krime.

c. Përgjegjësia si epror

632. Duke analizuar përgjegjësinë e Ojdaniqit në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, Dhoma konstaton se për krime konkrete të shpërnguljes së dhunshme ai nuk u gjykua përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim të këtyre krimeve. Krimet konkrete në fjalë konsistojnë në shpërngulje të dhunshme të kryer nga MPB-ja, pa pjesëmarrjen e UJ-së. Sikurse u konkluduar më parë, nuk është vërtetuar që Ojdaniqi të ketë pasur kontroll të efektshëm mbi forcat e MPB-së të cilat vepronin në Kosovë. Rrjedhimisht, ai nuk është përgjegjës sipas paragrafit 3 të Nenit 7 për krimet e tjera në pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës të cilat janë vërtetuar, dhe të cilat janë:

- Deçan
 - Beleg— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Dushanovë, pjesë e qytetit të Prizrenit— dëbim si krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme, veprime të tjera çnjerëzore si krim kundër njerëzimit;
- Suharekë
 - Qyteti i Suharekës— dëbim si krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme, veprime të tjera çnjerëzore si krim kundër njerëzimit;
- Mitrovicë
 - Qyteti i Mitrovicës— dëbim si krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme, veprime të tjera çnjerëzore si krim kundër njerëzimit;
 - Zhabar— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

- Vushtrri
 - Qyteti i Vushtrrisë—veprime të tjera çnjerëzore, zhvendosje e dhunshme si krim kundër njerëzimit;
 - Kolonë pranë Studimes së Epërme—dëbim si krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme si krim kundër njerëzimit.

633. Gjithashtu Ojdaniqi akuzohet për përgjegjësi sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit për pikat 3, 4 dhe 5 të Aktakuzës. Dhoma konstaton se nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasjet, dhuna seksuale apo shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore të kenë qenë synime të paramenduara të fushatës së shpërnguljes së dhunshme. Rrjedhimisht, Ojdaniqi do të ishte në dijeni se forcat e tij po kryenin këto krime vetëm në rast se do të ekzistonte informacion i disponueshëm për të në lidhje me krimet konkrete të vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve fetare dhe kulturore të kryera nga forcat e UJ-së. Dhoma nuk është e mendimit se ekzistonte informacion i disponueshëm për të në lidhje me krimet konkrete të vrasjeve, dhunës seksuale ose shkatërrimit të objekteve fetare dhe kulturore, për të cilat është vërtetuar përgjegjësia e UJ-ja, apo se ai kishte arsye të dinte për to.

634. Ojdaniqi nuk është përgjegjës për asnjë prej akuzave të tjera të ngritura në Aktakuzë, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

635. Rrjedhimisht, Dragolub Ojdaniqi është fajtor për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës. Mirëpo ai nuk është fajtor për pikat 3, 4 dhe 5 të Aktakuzës, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

F. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E NEBOJSHA PAVKOVIQIT

1. I akuzuari

636. Nebojsa Pavkoviqi u lind më 10 prill 1946, në Senjski Rudnik të Serbisë, dhe ka mbajtur një sërë postesh në APJ dhe UJ.¹⁵¹⁵ Në vitin 1994, Pavkoviqin u caktua në Korpusin e Prishtinës, ku shërbeu në poste të ndryshme në shtabin komandues, deri kur u emërua komandant i këtij Korpusi më 9 janar 1998.¹⁵¹⁶ Më 28 dhjetor 1998, ai u emërua komandant të Armatës së Tretë, detyrë të cilën e mori më 13 janar 1999 dhe e ushtroi deri në fillim të vitit 2000.¹⁵¹⁷ Gjatë kohës së

¹⁵¹⁵ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 13–14.

¹⁵¹⁶ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 13.

¹⁵¹⁷ P800 (Raport mbi dorëzimin e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiqi, 13 janar 1999); 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998); 4D36 (Raport mbi marrjen e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsa Pavkoviqi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin P800.

emërimet në këto poste, më 21 korrik 1998 Pavkoviqi u gradua gjenerallejtënant dhe më 31 mars 1999, gjeneralkolonel.¹⁵¹⁸ Në shkurt 2000, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.¹⁵¹⁹

2. Akuzat në Aktakuzë

637. Sipas Aktakuzës, si komandant i Armatës së Tretë, gjatë kohës kur pretendohet se janë kryer krimet e ngritura në Aktakuzë, Pavkoviqi ushtronte pushtet komandues mbi forcat e UJ-së të Armatës së Tretë dhe mbi forcat e tjera në varësi të UJ-së. Në veçanti, pretendohet se ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e këtyre krimeve. Brenda kuadrit të “kryerjes”, pretendohet se Pavkoviqi mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ishte, ndër të tjera, ndryshimi i përbërjes etnike të popullsisë së Kosovës, në mënyrë që të mundësohej vijimësia kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi këtë krahinë. Kjo do të arrihej përmes mjeteve kriminale të cilat konsistonin në një fushatë të gjerësisht të përhapur ose sistematike terrori dhe dhune e cila përfshinte dëbimin, vrasjen, zhvendosjen e dhunshme dhe përndjekjen e popullsisë shqiptare kosovare gjatë periudhës që mbulon Aktakuza. Pretendohet se Pavkoviqi kontribuoi në ndërmarrjen e përbashkët kriminale nëpërmjet ushtrimit të kompetencat *de jure* dhe *de facto* që kishte në dispozicion. Si një person në pozitë eprore, pretendohet që Pavkoviqi mban përgjegjësi penale edhe për “veprimet ose mosveprimet e vartësve të tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit të Tribunalit për krimet e pretenduara në Pikat nga 1 deri në 5 të Aktakuzës”.¹⁵²⁰

638. Mirëpo, Pavkoviqi parashtron se Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë përgjegjësinë e tij për planifikimin, urdhërimin, nxitjen, kryerjen apo për ndihmë dhe inkurajim të krimeve në Aktakuzë.¹⁵²¹ Pavkoviqi argumenton edhe se Prokuroria nuk ka arritur të provojë se ai është përgjegjës sipas paragrafit 3 të Nenit 7 për krimet në Aktakuzë.¹⁵²²

639. Në Kapitullin VII, Dhoma ka arritur në përfundimin se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen krime kundër popullsisë civile shqiptare kosovare në shumë prej komunave të Kosovës, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999. Rrjedhimisht më poshtë do të analizohet aspekti i përgjegjësisë së Pavkoviqit për këto krime, në bazë të kategorive të ndryshme të përgjegjësisë ligjore të pretenduar në Aktakuzë.

¹⁵¹⁸ Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 13–14.

¹⁵¹⁹ 4D163 (Kartelë Ushtarake e Nebojsa Pavkoviqit), f. 6; Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 14.

¹⁵²⁰ Aktakuza, para. 16–22, 50–54.

¹⁵²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 18.

¹⁵²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 91–94.

3. Roli i Pavkoviçit si komandant i Korpusit të Prishtinës

a. Emërimi dhe kompetencat

640. Korpusi i Prishtinës pati komandant Pavkoviçin nga data 5 janar 1998 deri më 13 janar 1999, kur ai mori detyrën e komandantit të Armatës së Tretë dhe u zëvendësua nga Llazareviçi si komandant i Korpusit.¹⁵²³ Gjatë gjithë vitit 1998, komandant i Armatës së Tretë ishte gjeneral Dushan Samarxhiçi, i cili, ishte logjikisht edhe eprori i drejtpërdrejtë i Pavkoviçit.¹⁵²⁴

641. Komandanti i Korpusit të Prishtinës kishte detyrë ta komandonte Korpusin në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore për UJ-në.¹⁵²⁵ Gjatë mandatit si komandant i Korpusit të Prishtinës, Pavkoviçi mund ta kryente këtë detyrë drejtpërsëdrejti ose “përmes shefit të Shtabit të tij, ndihmësit të tij ose krerëve të degëve”.¹⁵²⁶ Në detyrat e tij përfshiheshin mbajtja nën kontroll e punës së Komandës së Korpusit, caktimi i detyrave vartësve dhe garantimi i realizimit të këtyre detyrave, si edhe mbikëqyrja dhe analizimi i rezultateve, rendit dhe disiplinës së Korpusit të Prishtinës.¹⁵²⁷ Ai kishte detyrimin t’i raportonte drejtpërsëdrejti Komandës së Armatës së Tretë, ndër të tjera, edhe për krimet dhe incidentet e paligjshme.¹⁵²⁸

b. Roli i Pavkoviçit si komandant i Korpusit të Prishtinës

i. Kontaktet me Millosheviçin dhe pjesëmarrja në Komandën e Përbashkët në vitin 1998

642. Prokuroria argumenton se në vitin 1998, kur ishte komandant i Korpusit të Prishtinës, Pavkoviçi ishte mbështetës i zjarrtë i përdorimit të UJ-së brenda Kosovës dhe se anashkaloi hierarkinë komanduese përkatëse brenda UJ-së, përfshirë edhe përmes pjesëmarrjes së tij në

¹⁵²³ P801 (Raport mbi marrjen e detyrës së komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviçi, 9 janar 1999); Vladimir Llazareviçi, T. 17744–17745 (6 nëntor 2007); *shih edhe* Nikë Peraj, P2248 (deklaratë e dëshmitarit, datë 18 prill 2000), f. 2, P2253 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 gusht 2006), para. 6, f. 2; 4D36 (Raport mbi marrjen e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsha Pavkoviçi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin P800.

¹⁵²⁴ 4D36 (Raport mbi marrjen e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsha Pavkoviçi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin P800. P800 (Raport mbi dorëzimin e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiçi, 13 janar 1999).

¹⁵²⁵ P987 (Rregullore për përgjegjësitë e komandës së trupave tokësore të ushtrisë në kohë paqeje, 1990), nenet 4, 5, 9; *shih edhe* P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt), P987 (Rregullore për përgjegjësitë e komandës së trupave tokësore të ushtrisë në kohë paqeje, 1990).

¹⁵²⁶ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt), f. 14.

¹⁵²⁷ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt), f. 14; P1078 (Analizë vjetore e rezultateve, rendit, disiplinës brenda Korpusit të Prishtinës, 28 dhjetor 1998), f. 1.

¹⁵²⁸ Geza Farkash, T. 16362–16363 (25 shtator 2007); Lubisha Stojimiroviçi, T. 17681 (26 tetor 2007); Radojko Stefanoviçi, T. 21728 (6 shkurt 2008); *Shih edhe* Millosh Mandiçi, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviçi, T. 8666 (18 janar 2007). *shih* Radomir Gojoviçi, T. 16706 (2 tetor 2007); 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999), f. 1–2.

Komandën e Përbashkët.¹⁵²⁹ Mbrojtja e Pavkoviqit i mohon pretendimet e Prokurorisë dhe parashtron se në vitin 1998 ai nuk ka veproi jashtë hierarkisë komanduese dhe se në të gjitha rastet përdorimi i UJ-së nga ana e tij u miratua brenda hierarkisë komanduese përkatëse.¹⁵³⁰

643. Nga data 21 prill deri më 12 maj 1998, Pavkoviqi angazhoi njësi të ndryshme të UJ-së në operacione luftimi në Kosovë. Mirëpo këto përpjekje nuk ia dolën mbanë ta shkatërronin UÇK-në.¹⁵³¹ Për pasojë, në maj dhe qershor 1998, Pavkoviqi mori pjesë në një varg mbledhjesh lidhur me shtimin e angazhimit të UJ-së në Kosovë kundër UÇK-në. Në maj, Pavkoviqi paraqiti një plan veprimi kundër UÇK-së në Kosovë, së pari Samarxhiqit dhe më pas Perishiqt.¹⁵³² Më tej, më 30 maj 1998, ai mori pjesë në një mbledhje me Millosheviqin në Beograd dhe diskutoi për miratimin e një plani për luftën kundër terrorizmit.¹⁵³³ Personat e pranishëm, ndër të tjerë, qenë Perishiqi, Aleksandar Dimitrijeviqi dhe Samarxhiqi nga UJ-ja, së bashku me Stojilkoviqin, Obrad Stevanoviqin dhe Sreten Llukiqin nga MPB-ja.¹⁵³⁴ Edhe në një raport të dorëzuar nga Samarxhiqi thuhej se Planin për Luftën kundër Terrorizmit e kishte propozuar Pavkoviqi.¹⁵³⁵ Sikurse është përshkruar në Pjesën VI.B, Planin Kundër Terrorizmit përbëhej nga pesë faza mbi të cilin do të bazoheshin UJ-ja dhe MPB-ja në operacionet e bashkërenduara në Kosovë, plan i cili më vonë u zëvendësua me planin “Grom 98” i cili do të përdorej nga UJ-ja.¹⁵³⁶ Në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviqi dha shpjegimin e tij për këtë temë dhe deklaroi se UJ-ja ishte e angazhuar në territorin e Kosovës dhe ishte shpërndarë në garnizone në të gjithë Kosovën, që prej 4 qershorit 1998, në bazë të një vendimit të marrë në mbledhjen e datës 30 maj 1998 midis Millosheviqit dhe zyrtarëve të lartë të shtetit dhe UJ-së.¹⁵³⁷

644. Sipas Dimitrijeviqit, Pavkoviqi ishte personi të cilit iu kërkua të hartonte Planin për Luftën Kundër Terrorizmit sepse Millosheviqi donte që Pavkoviqi të kishte komandën e “të gjitha forcave në Kosovë”. Gjithashtu, në qershor 1998 dhe pas propozimit të Pavkoviqit për Planin për Luftën Kundër Terrorizmit, Millosheviqi u sugjeroi Dimitrijeviqit dhe Perishiqt që Pavkoviqi të emërohej komandant i të gjitha forcave në Kosovë, përfshirë edhe forcat e MPB-së. Këtë ide e kundërshtuan përfaqësuesit e UJ-së të cilët i thanë Millosheviqit se MPB-ja nuk do të ishte dakord për një

¹⁵²⁹ Aktakuza, para. 50–54; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 853, 855, 860.

¹⁵³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 127, 242.

¹⁵³¹ P1401 (Përfundime për angazhimin e forcave të Korpusit të Prishtinës, 13 maj 1998), f. 1–3 .

¹⁵³² Millan Gjakoviq, T. 26409–26411 (19 maj 2008); *shih* P1401 (Përfundime për angazhimin e forcave të Korpusit të Prishtinës, 13 maj 1998).

¹⁵³³ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 321–325; Millan Gjakoviq, T. 26411 (19 maj 2008).

¹⁵³⁴ Millan Gjakoviq, T. 26409–26411 (19 maj 2008).

¹⁵³⁵ 4D119 (Raport i Armatës së Tretë për Korpusin e Prishtinës, 22 korrik 1998).

¹⁵³⁶ Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

organizim të tillë, kështu që kjo ide nuk u vu në jetë.¹⁵³⁸ Dimitrijeviqi dëshmoi gjithashtu se, duke filluar në vitin 1998, Pavkoviqi e anashkalonte hierarkinë komanduese, duke shfrytëzuar komunikimet e drejtpërdrejta me Millosheviqin të cilat i dhanë mundësi të vepronte pa kërkuar miratimin e Shtabit të Përgjithshëm.¹⁵³⁹ Më tej, Dimitrijeviqi dëshmoi se Pavkoviqi ishte bërë “favorit i Presidentit” dhe se Pavkoviqi shpesh pretendonte se ishte i vetmi që i kuptonte problemet e Kosovës dhe që kujdesej për “popullin serb” atje.¹⁵⁴⁰ Dhoma vëren se ai dëshmoi se Pavkoviqi ishte pjesërisht përgjegjës për shkarkimin e tij në vitin 1999.¹⁵⁴¹ Sidoqoftë, Dhoma arriti në përfundimin se Dimitrijeviqi është në përgjithësi i besueshëm dhe nuk mendon që dëshmia e tij të jetë kompromentuar në lidhje me Pavkoviqin.

645. Edhe Aleksandar Vasileviqi dëshmoi se dy gjeneralë, emrat e të cilëve i dha në seancë të mbyllur, i kishin thënë se dihej që Pavkoviqi i anashkalonte dy nivelet e komandës në vitin 1998 kur ishte komandant i Korpusit të Prishtinës në Kosovë.¹⁵⁴²

646. Në kundërshtim me këto dëshmi, në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviqi pretendoi se “parimi i komandës” nuk ishte shkelur asnjëherë në UJ dhe se Millosheviqi nuk i kishte dhënë asnjë urdhër dhe nuk e kishte kontaktuar asnjëherë jashtë hierarkisë së rregullt komanduese.¹⁵⁴³ Ai tha se u takua për herë të parë zyrtarisht me Millosheviqin në qershor 1998 dhe se nuk e njohte më parë Millosheviqin apo familjen e tij.¹⁵⁴⁴ Gjithashtu, ai deklaroi se nuk ishte takuar asnjëherë vetëm për vetëm me Millosheviqin dhe se Millosheviqi nuk i kishte telefonuar asnjëherë drejtpërsëdrejti gjatë vitit 1998. Madje, sipas Pavkoviqit, kur marrëdhënia midis Perishiqit dhe Millosheviqit u ftoh gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998, Perishiqi filloi të kishte dyshime për marrëdhëniet e Pavkoviqit me Millosheviqin dhe mundësoi që të ishte gjithmonë i pranishëm në takimet mes atyre të dyve.¹⁵⁴⁵

647. Në maj 1998, u krijua një organ i njohur me emrin “Komanda e Përbashkët” për të mundësuar bashkërendimin e veprimeve të forcave të sigurimit me ato ushtarake në Kosovë për realizimin e objektivave të përbashkët, sikurse është përmendur në Pjesën VI.E. Pavkoviqi mori

¹⁵³⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 34–35, 39, 48–49; 321–324.

¹⁵³⁸ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26592–26593 (8 korrik 2008).

¹⁵³⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26592–26595, T. 26624–26624, T. 26642 (8 korrik 2008).

¹⁵⁴⁰ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26625 (8 korrik 2008).

¹⁵⁴¹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26673 (9 korrik 2008).

¹⁵⁴² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 21; Aleksandar Vasileviq, T. 8671–8672 (seancë e hapur), 8673 (seancë private) (18 janar 2007).

¹⁵⁴³ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 1–2.

¹⁵⁴⁴ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 10, 298.

¹⁵⁴⁵ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 10–11, 120.

pjesë në Komandën e Përbashkët që prej krijimit të saj, gjatë gjithë vitit 1998.¹⁵⁴⁶ Sipas Pavkoviqit, detyra parësore e këtij organi në krijimin e tij ishte miratimi dhe vënia në zbatim e një plani për të luftuar “terrorizmin” në Kosovë përmes veprimtarive të ndërthurura politike dhe ushtarake.¹⁵⁴⁷ Pavkoviqi tha se Komanda e Përbashkët nuk nxirrte asnjëherë urdhra, por miratonte “qëndrime të përbashkëta”.¹⁵⁴⁸ Millan Gjakoviqi shërbeu si shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në Korpusin e Prishtinës dhe si shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në Armatën e Tretë kur Pavkoviqi u bë komandant i atij formacioni. Ai dëshmoi se në vitin 1998, Millosheviqi e autorizoi Pavkoviqit të bashkërendonte veprimtaritë me MPB-në në të gjithë territorin e Kosovës.¹⁵⁴⁹ Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët nga data 22 korrik deri më 30 tetor 1998, të mbajtura nga Gjakoviqi dhe, pas tij, nga Tesheviqi, tregojnë se Pavkoviqi luajti një rol kryesor në këto mbledhje, ai mori pjesë thujse në çdo mbledhje, raportonte për veprimtaritë e UJ-së në Kosovë, e thoshte se do të ishin të nevojshme veprime të mëtejshme me përfshirjen e elementeve të MPB-së dhe UJ-së dhe bënte sugjerime për veprime të mëtejshme.¹⁵⁵⁰ Këto Shënime tregojnë se Pavkoviqi ishte i informuar mirë për faktet në terren në Kosovë deri në fund të muajit tetor 1998.¹⁵⁵¹

648. Ligjshmëria e angazhimit të UJ-së në Kosovë në vitin 1998 ka qenë temë debati gjatë procesit gjyqësor dhe është analizuar në Pjesën VI.A. Lidhja e këtij aspekti me akuzat kundër Pavkoviqit konsiston në qëndrimin e tij të ndryshëm nga qëndrimi i adoptuar nga ushtarakë të UJ-së në poste më të larta se ai që çoi në konflikte midis tyre. Perishiqi, i cili ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm në vitin 1998, ishte kundër Planit të Luftës Kundër Terrorizmit, idenë e të cilit e mbronte Pavkoviqi, duke qenë se ky plan kërkonte angazhimin e UJ-së në brendësi të Kosovës, pa shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, rrezikun e luftës së afërt apo gjendje lufte. Në një mbledhje të KLM-së të datës 9 qershor 1998, Perishiqi i paraqiti KLM-së mundësinë e shtimit të veprimtarive të UJ-së në Kosovë, por në të njëjtën kohë shprehu hezitimin e tij për shtimin e pranisë së UJ-së në Kosovë përtej pozicionit që kishte në brezin kufitar, pozicion të cilin ai e cilësoi “legjitim”. Përmes një deklaratë KLM-ja shprehu mbështetjen për angazhimin e UJ-së kundër

¹⁵⁴⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 321–322; P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët); Aleksandar Vasileviq, T. 8726 (19 janar 2007); Lubinko Cvetiq, T. 8051–8052, 8077–8078 (7 dhjetor 2006), 8194 (8 dhjetor 2006); Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 janar 2004), para. 32, P2515 (letinformacion plotësues, 21 nëntor 2006), f. 2, T. 7215–7217 (23 nëntor 2006), T. 7297–7298 (24 nëntor 2006).

¹⁵⁴⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 14–15, 62, 94, 253, 361.

¹⁵⁴⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 229, 244–245, 381, 387.

¹⁵⁴⁹ Millan Gjakoviq, T. 26381–26382, 26387 (19 maj 2008), T. 26473–26474 (20 maj 2008).

¹⁵⁵⁰ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 2, 4, 6, 15, 17–20, 22–26, 29–30, 34, 36, 39–43, 46–47, 49, 51, 54–56, 59, 62, 64–72, 75–77, 79–86, 88, 92–95, 97–100, 102–120, 121–126, 128–145, 146–149, 151–152, 155–156, 158, 160–164.

¹⁵⁵¹ *Shih edhe* P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 109–110.

UÇK-së, duke pohuar se “nëse veprimtaritë terroriste të lëvizjes separatiste shqiptare përshkallëzoheshin, ushtria e Jugosllavisë do të ndërhyjë si duhet”.¹⁵⁵²

649. Më 20 korrik 1998, në një mbledhje të Kolegjiumit të UJ-së, Perishiçi u ankua për rreziqet e angazhimit të UJ-së në Kosovë dhe, më tej e ndaloi këtë shprehimisht, me përjashtim të zonave kufitare dhe të mbrojtjes së objekteve të UJ-së.¹⁵⁵³ Dimitrijeviçi dëshmoi se Samarxhiçi u përpoq të niste procedim disiplinor kundër Pavkoviçit për shkelje të urdhrave në lidhje me përdorimin e UJ-së në Kosovë.¹⁵⁵⁴ Kur Pavkoviçi u informua për këtë ai takoi Millosheviçin, pas së cilës Millosheviçi e informoi Shtabin e Përgjithshëm se Pavkoviçi do të ngrihej në detyrë.¹⁵⁵⁵ Edhe Aleksandar Vasileviçi dëshmoi se ngritja në detyrë e Pavkoviçit nuk kaloi përmes procedurës normale dhe se anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm thjesht u informuan se Pavkoviçi po ngrihej në detyrë.¹⁵⁵⁶

650. Më 21 korrik 1998, Pavkoviçi mori pjesë në një mbledhje tjetër me Millosheviçin në Beograd, duke diskutoi për sa më lart,¹⁵⁵⁷ së bashku me Dimitrijeviçin, Samarxhiçin, Pavkoviçin, Perishiçin, Stojilkoviçin, Gjorgjeviçin, Lluqiçin, Millutinoviçin, Miniçin, Matkoviçin, Angjelkoviçin dhe Shainoviçin.¹⁵⁵⁸ Në këtë mbledhje, krahas Lluqiçit, Pavkoviçi propozoi disa faza të operacioneve në të cilat do të merrnin pjesë si ushtria, po ashtu edhe policia, në përpjekje për të hequr postblloqet, çarmatosur “terroristët” dhe vendosur sigurinë në Kosovë.¹⁵⁵⁹ Millosheviçi dhe Pavkoviçi bënë të ditur se disa operacione kishin filluar që më parë, në përputhje me një vendim të KLM-së më 9 qershor 1998.¹⁵⁶⁰ Plani për Luftën Kundër Terrorizmit, i cili përbëhej nga masa ushtarake, policore dhe politike, u miratua zyrtarisht në këtë mbledhje. Perishiçi mori urdhër të përgatiste një plan paralel tërësisht ushtarak për përdorimin e UJ-së në Kosovë (plani

¹⁵⁵² ID760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 3–10.

¹⁵⁵³ P922 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 3. Perishiçi tha gjithashtu se UJ-ja ishte përdorur në mbështetje të MPB-së në Rahovec dhe se ky operacion nuk ishte i planifikuar dhe ishte jo i mençur. Ai tha se përgjegjësia për këtë i binte Samarxhiçit, por tha se nuk ishte tërësisht i sigurt për këtë. Më pas, në një letër drejtuar Presidentit të RFJ-së, Perishiçi sqaroi se ishte Komandanti i Korpusit të Prishtinës, asokohe Pavkoviçi, ai që kishte dhënë urdhrin për këto operacione të UJ-së në Kosovë. P717 (Letër e Momçillo Perishiçit, drejtuar Sllobodan Millosheviçit, datë 23 korrik 1998), f. 2–3.

¹⁵⁵⁴ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26622–26623 (8 korrik 2008), T. 26682–26683 (9 korrik 2008).

¹⁵⁵⁵ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26622–26624 (8 korrik 2008), T. 26682 (9 korrik 2008). *Shih edhe* P1510 (“Millosheviçi gradon shefin e Korpusit të Prishtinës gjenerallejtënant”, *Tanjug*, 21 korrik 1998).

¹⁵⁵⁶ Aleksandar Vasileviçi, T. 8676 (18 janar 2007).

¹⁵⁵⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 331, 339; *Shih edhe* Millan Gjakoviçi, T. 26523 (20 maj 2008); 4D100 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, lidhur me angazhimin e njësave, 22 korrik 1998); Dushko Matkoviçi, T. 14634–14635 (30 gusht 2007).

¹⁵⁵⁸ Dushko Matkoviçi, T. 14634–14638 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9. *Shih edhe* Millan Gjakoviçi, T. 26410 (19 maj 2008); Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 46588 (8 korrik 2008); 4D100 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, lidhur me angazhimin e njësave, 22 korrik 1998); 4D101 (Plani i Korpusit të Prishtinës për angazhimin e njësave në Kosovë, 23 korrik 1998).

¹⁵⁵⁹ Dushko Matkoviçi, P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9.

“Grom 98”) për arritjen e zgjidhjes “përfundimtare” të problemit të UÇK-së.¹⁵⁶¹ Po atë ditë, Pavkoviqi u gradua gjenerallejtënant.¹⁵⁶²

651. Në një letër të datës 22 korrik 1998, Pavkoviqi i kujtoi Samarxhiqit se Plani për Luftën Kundër Terrorizmit ishte miratuar në një mbledhje me Presidentin e RFJ-së dhe pastaj e udhëzoi Samarxhiqin të përpilonte hollësitë e operacioneve të Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁶³ Samarxhiqi u përgjigj se, ngaqë Presidenti i RFJ-së e kishte pranuar planin si të prezantuar “personalisht” nga Pavkoviqi, komanda e Korpusit të Prishtinës duhej të përgatiste një plan për përfshirjen e UJ-së në vënien në zbatim të fazës së dytë të Planit.¹⁵⁶⁴ Të nesërmen, më 23 korrik 1998, Pavkoviqi i shkroi Samarxhiqit në lidhje me vënien në zbatim të fazës së dytë të Planit, i cili kërkonte angazhimin e përbashkët të njësive të MPB-së dhe UJ-së në operacionet në Deçan, në zonën e Drenicës dhe në Suharekë. Ai tha se disa njësi të mekanizuara të Korpusit të Prishtinës dhe toga tankesh qenë angazhuar drejtpërsëdrejti në “mbështetjen e njësive të MPB-së”.¹⁵⁶⁵ Pavkoviqi theksoi se Samarxhiqi ishte informuar për planin në tërësi “disa herë” dhe se plani qe pranuar nga Presidenti i RFJ-së dhe udhëheqja më e lartë e UJ-së dhe MPB-së pa ndonjë kundërshtim serioz.¹⁵⁶⁶ Samarxhiqi u përgjigj se, për arsye se Presidenti i RFJ-së nuk ishte informuar shprehimisht për planin e heqjes së postbllloqeve, njësitë e Korpusit të Prishtinës nuk ishin të autorizuar të përdreshin në këtë mënyrë dhe ai konfirmoi detyrimin për respektimin e hierarkisë komanduese të UJ-së.¹⁵⁶⁷

652. Po më 23 korrik, Pavkoviqi i shkroi “Kolegjiumit të komandantëve të Armatës së Tretë” për duke u ankuar se forcat e MPB-së në Kosovë nuk i kishin kryer me profesionalizëm dhe tërësisht detyrat e ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë dhe se “niveli i tyre i organizimit dhe pajisjeve, motivimi dhe gatishmëria e përgjithshme luftarake nuk mund t’i bënin ballë terrorizmit në rritje”.¹⁵⁶⁸ Ai shtonte se, “me gjithë armatosjen e popullsisë, ky faktor nuk ishte përfshirë tërësisht në sistemin kundër terrorizmit” dhe vijonte se komandantët e Armatës së Tretë “mbanin përgjegjësi të madhe për situatën” dhe se kishin “për detyrë të merrnin çdo masë brenda

¹⁵⁶⁰ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 61; Dushko Matkoviq, P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9, T. 14636–14637 (30 gusht 2007).

¹⁵⁶¹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 332–335. *Shih edhe* Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

¹⁵⁶² P1510 (“Millosheviqi gradon shefin e Korpusit të Prishtinës gjenerallejtënant”, *Tanjug*, 21 korrik 1998).

¹⁵⁶³ 4D100 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, lidhur me angazhimin e njësive, 22 korrik 1998).

¹⁵⁶⁴ 4D119 (Raport i Armatës së Tretë për Korpusin e Prishtinës, 22 korrik 1998).

¹⁵⁶⁵ 4D101 (Plan i Korpusit të Prishtinës për angazhimin e njësive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1. *Shih edhe* 3D702 (Urdhër i Perishiqit për Armatën e Tretë, 28 korrik 1998).

¹⁵⁶⁶ 4D101 (Plani i Korpusit të Prishtinës për angazhimin e njësive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1–2.

¹⁵⁶⁷ 4D102 (Përgjigje për Planin e Korpusit të Prishtinës për angazhimin e njësive, 23 korrik 1998).

¹⁵⁶⁸ P1011 (Ivan Markoviq, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 57–58.

kompetencave të tyre për të mundësuar kushtet e nevojshme, për të shtypur terrorizmin në [Kosovë] dhe për të mbrojtur popullin, anëtarët e [Korpusit të Prishtinës] dhe ato objekte që ishin jetike për këtë shtet”.¹⁵⁶⁹ Pavkoviqi bënte të ditur përkushtimin e tij për ta mbajtur Kosovën brenda Serbisë, duke paralajmëruar se “nëse nuk merreshin masa urgjente, Kosovën do ta humbitnin përgjithmonë, dhe bashkë me të do të humbiste edhe Serbia dhe UJ-ja”. Ai shtonte se nuk mund “të dorëzohej përpara faktit që ai, si ushtarak, nuk kishte bërë gjithçka që i kërkohej të bënte për ta shmangur një situatë të tillë”.¹⁵⁷⁰

653. Po atë ditë, Perishiqi i dërgoi letër Millosheviqit ku i ankohej për përdorimin e UJ-së në Kosovë, sikurse u diskutua më lart.¹⁵⁷¹ Në letër Perishiqi shpjegonte se, pas mbledhjes së KLM-së më 9 qershor, qeverisë së RFJ-së i ishte paraqitur kërkesa për shpalljen e gjendjes së luftës, rrezikut të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, por kjo nuk kishte ndodhur dhe, kështu, “çdo angazhim i UJ-së në operacione luftimi jashtë zonave kufitare dhe përtej tyre vazhdon të jetë i paligjshëm”. Ai përshkruante ndërhyrjet në hierarkinë komanduese të UJ-së, duke u ankuar për:

Përpyqjen nga anëtarët civilë të Shtabit për të komanduar Korpusin. Komandanti i Korpusit është përgjegjës për vlerësimin e situatës dhe për planifikimin e operacioneve të UJ-së dhe MPB-së, në bashkëpunim me anën civile të shtabit dhe të MPB-së, për t’ia përcjellë ato Shainoviqit dhe Miniqit, në mënyrë që këta t’u shpërndajnë detyra të gjithëve përveç Korpusit të Prishtinës. Në praktikë, komandanti i Korpusit të Prishtinës planifikon për çfarë është urdhëruar dhe kjo bëhet me kërkesën e Shainoviqit dhe Miniqit dhe të MPB-së dhe, kështu, shndërrohet në njëfarë shërbimi të tyre, për planifikim dhe ekzekutim.¹⁵⁷²

Më tej ai sugjeronte që Millosheviqi të mos lejonte që UJ-ja të komandohej “jashtë sistemit të vartësisë ushtarake dhe parimit të një komande të vetme”.¹⁵⁷³ Në këtë letër, Perishiqi ankohej edhe për anashkalimin e hierarkisë komanduese nga ana e Millosheviqit dhe për ngritjen në gradën e gjeneralit të personave pa ndjekur procedurën e duhur.¹⁵⁷⁴

654. Si Dimitrijeviqi, po ashtu edhe Momir Bullatoviqi vërejtën se kjo pjesë e letrës përdorte termin “përpyqje” dhe, kështu, dëshmuar se kjo nuk nënkuptonte automatikisht se ekzistonin kanale alternative të drejtimit të UJ-në.¹⁵⁷⁵ Mirëpo, letra ngrinte në mënyrë të qartë pretendimin se

¹⁵⁶⁹ P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 58.

¹⁵⁷⁰ P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 58–59.

¹⁵⁷¹ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998).

¹⁵⁷² P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998), f. 2–3. Perishiqi përdori termin “Shtab” por është e qartë që e kishte fjalën për Komandën e Përbashkët.

¹⁵⁷³ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998), f. 3.

¹⁵⁷⁴ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998), f. 2–4.

¹⁵⁷⁵ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26723 (9 korrik 2008); Momir Bullatoviç, T. 13920–13921 (17 gusht 2007).

ishte në funksionim një hierarki komanduese paralele, jo thjesht një përpjekje, duke qenë se në letër përmendeshin ato që ndodhnin “në praktikë”.¹⁵⁷⁶

655. Mbrojtja e Pavkoviqit mohon se zbatimi i Planit për Luftën Kundër Terrorizmit u ndërmor me nismë vetjake të Pavkoviqit jashtë hierarkisë komanduese, duke argumentuar se, përkundrazi, ai kishte vepruar në përputhje me urdhrat e eprorëve të tij, komandantit të Armatës së Tretë dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.¹⁵⁷⁷ Gjakoviqi tha se gjatë mbledhjeve Pavkoviqit i paraqiteshin kërkesa, kryesisht nga MPB-ja, “që ai t’i raportonte komandantit të Armatës dhe që komandanti i Armatës ta korrigjonte apo zgjeronte vendimin e tij”.¹⁵⁷⁸ Pas diskutimit të urdhrave të tillë, Pavkoviqi shkante te Samarxhiqi ose te shefi i Shtabit të Armatës së Tretë, Miodrag Simiqi, për të marrë miratimin e tyre, por vendimi merrej gjithmonë jashtë mbledhjes.¹⁵⁷⁹ Në intervistën e tij me Prokurorinë, Pavkoviqi tha se operacioni kryesor i UJ-së në Kosovë në vitin 1998 u krye në përputhje me një urdhër të nxjerrë nga Perishiqi më 28 korrik 1998, i ashtuquajtur “Plani Grom”, i cili parashikonte përdorimin e UJ-së për të siguruar kufirin me Shqipërinë, si edhe njësitë dhe objektet në territorin e Kosovës, dhe për të shtypur “forcat e armatosura rebele”.¹⁵⁸⁰ Dhoma vëren se, në këtë urdhër, Perishiqi autorizonte përdorimin e UJ-së për të siguruar kufirin “në thellësi” në mënyrë që të mbroheshin objektet e UJ-së dhe të siguroheshin rrugët e furnizimit. Urdhri parashikonte edhe veprime të UJ-së në bashkërendim me MPB-në për të sulmuar UÇK-në në brendësi të Kosovës, sipas një “urdhri të posaçëm” të Shtabit të Përgjithshëm.¹⁵⁸¹ Urdhri i Perishiqit, i datës 28 korrik 1998, u vu në zbatim të nesërmen, përmes një urdhri të nxjerrë nga Samarxhiqi.¹⁵⁸² Në urdhrin e Armatës së Tretë përsëriteshin udhëzimet për sigurimin e kufirit “në thellësi”, për mbrojtjen e objekteve të UJ-së dhe për sigurimin e rrugëve të furnizimit, dhe thuhej se Korpusi i Prishtinës duhej të qëndronte në gatishmëri për mësymje të shpejta kundër UÇK-së në Kosovë në bazë të një “urdhri të posaçëm” të Shtabit të Përgjithshëm.¹⁵⁸³

656. Mirëpo, procesverbalet e kolegjiemeve të Shtabit të Përgjithshëm dhe shënimet e mbajtura në mbledhjet e Komandës së Përbashkët tregojnë se operacionet e UJ-së në brendësi të Kosovës

¹⁵⁷⁶ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998), f. 2.

¹⁵⁷⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 127, 245.

¹⁵⁷⁸ Millan Gjakoviqi, T. 26485 (20 maj 2008).

¹⁵⁷⁹ Millan Gjakoviqi, T. 26485 (20 maj 2008); Tomislav Mlladenoviq, T. 17602, 17606–17607, 17620–17621 (25 tetor 2007); Velimir Obradoviq, T. 17402–17409 (22 tetor 2007); Miodrag Simiq, T. 15532 (13 shtator 2007).

¹⁵⁸⁰ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 60–64; 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për angazhimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998). *Shih edhe* 3D703 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për Armatën e Tretë, 28 korrik 1998).

¹⁵⁸¹ 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për angazhimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998), f. 2–3.

¹⁵⁸² 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për angazhimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998); 4D140 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, 29 korrik 1998).

¹⁵⁸³ 4D140 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, 29 korrik 1998), f. 7. *Shih edhe* John Crosland, T. 9985–9987 (8 shkurt 2007).

ishin zhvilluar përpara nxjerrjes së urdhrat të Perishiqit për fillimin e planit “Grom” më 28 korrik.¹⁵⁸⁴ Dushan Matkoviqi tha se në mbledhjen e datës 21 korrik, Pavkoviqi u shpreh se UJ-ja kishte kryer disa operacione në kuadër të Planit për Luftën Kundër Terrorizmit.¹⁵⁸⁵ Më 26 korrik, dy ditë përpara urdhrat të Perishiqit, Pavkoviqi i raportoi Komandës së Përbashkët, ku i pranishëm ishte edhe Samarxhiqi, se ishin realizuar me sukses operacionet e grupit luftarak të UJ-së në Duhël, Shtime dhe Bllacë, përkundër humbjes së një tanku.¹⁵⁸⁶ Pavkoviqi i quajti këto operacione si përgatitje të zonës për fazën e dytë, duke bërë të ditur se operacionet qenë pjesë e Planit me pesë faza për Luftën Kundër Terrorizmit.¹⁵⁸⁷ Rrjedhimisht, megjithëse provat tregojnë se Samarxhiqi dhe Perishiqi dhanë urdhra për angazhimin e UJ-së në Kosovë, ato tregojnë edhe se Pavkoviqi e vuri në jetë angazhimin e UJ-së në brendësi të Kosovës përpara miratimit zyrtar të këtyre urdhrave, në bazë të miratimit prej “Kryekomandantit” të Planit për Luftën Kundër Terrorizmit të cilin ia kishte paraqitur Pavkoviqi, me gjithë faktin se Perishiqi e kishte ndaluar përdorimin e UJ-së në Kosovë jashtë udhëzimeve që kishte dhënë shprehimisht më datë 20 korrik.

657. Dhoma analizoi edhe një urdhër të Samarxhiqit, të datës 30 korrik 1998, përmes të cilit ai udhëzonte Pavkoviqin “si anëtar të Komandës së Përbashkët” të merrte pjesë në të gjitha mbledhjet e Komandës së Përbashkët. Në bazë të këtij urdhri, përpara se të merrte pjesë në këto mbledhje Pavkoviqi duhej t’i raportonte shefit të Shtabit të Armatës së Tretë dhe ta informonte për kërkesat dhe propozimet e mundshme për angazhimin e forcave me përforsime. Pas mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, Pavkoviqi duhej t’i raportonte përsëri shefit të Shtabit, për t’i bërë të ditur propozimet apo kërkesat e mëtejshme të bëra në mbledhje dhe duhej t’i kërkonte leje në lidhje me këto kërkesa. Më tej Pavkoviqi u urdhërua ta informonte Komandën e Përbashkët për çdo vendim në lidhje me këto kërkesa.¹⁵⁸⁸ Në provat përfshihen edhe një sërë urdhrash të tjerë nga Armata e Tretë të cilët Pavkoviqi i përmend si urdhra që përbënin bazën për urdhrat që ai vetë i ka dhënë Korpusit të Prishtinës në vitin 1998.¹⁵⁸⁹ Duke pasur parasysh provat që kanë të bëjnë me funksionimin e Komandës së Përbashkët në vitin 1998 dhe anashkalimin e hierarkisë komanduese nga ana e Pavkoviqit duke komunikuar drejtpërsëdrejti me Millosheviqin, Dhoma gjykon se këto urdhra tregojnë përpjekjet e Samarxhiqit për të ruajtur njëfarë kontrolli mbi pjesëmarrjen e

¹⁵⁸⁴ P922 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 3, 12–13; P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 13.

¹⁵⁸⁵ Dushko Matkoviqi, P2913 (deklarate e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9.

¹⁵⁸⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 13. Këto fshatra nuk përfshihen as në brezin më të zgjeruar kufitar, 3D739 (Harta e Brezitet të Zgjeruar Kufitar).

¹⁵⁸⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 13. *Shih edhe* Aleksandar Vasileviq, T. 8924–8926 (23 janar 2007).

¹⁵⁸⁸ 4D91 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, 30 korrik 1998); Miodrag Simiq, T. 15532 (13 shtator 2007).

¹⁵⁸⁹ *Shih, p.sh.*, P1427 (Vendim i Korpusit të Prishtinës, 10 gusht 1998); Millan Kotur, T. 20724–20727 (21 janar 2008); 3D697 (Dokument i Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë, “Analizë e realizimit të detyrave në Kosovë”, 2 tetor 1998).

Pavkoviqit në Komandën e Përbashkët, në përputhje me pretendimin se Pavkoviqi e anashkaloi hierarkinë komanduese të UJ-së duke planifikuar operacionet në Kosovë me Millosheviqin.

658. Në vitin 1998, pati përplasje të tjera midis Pavkoviqit dhe Samarxhiqit. Më 1 gusht, Pavkoviqi i dërgoi një kërkesë Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë për marrjen e autorizimit për nisjen e fazës së tretë të Planit për Luftën Kundër Terrorizmit. Në kërkesë, ai përcaktonte se në një mbledhje të Komandës së Përbashkët të zhvilluar më 31 korrik 1998 ishte marrë vendim për nisjen e fazës së tretë të Planit më 2 gusht 1998.¹⁵⁹⁰ Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët në vitin 1998 tregojnë qartë se ky vendim, në të vërtetë, qe marrë më 30 korrik, kur u vendos që faza e tretë e Planit do të realizohej përmes operacioneve në Drenicë dhe Jabllanicë.¹⁵⁹¹ Mirëpo, Samarxhiqi nuk e pranoi kërkesën e Pavkoviqit, dhe nxori një urdhër në përgjigje të kërkesës po atë ditë, duke ndaluar angazhimin e njësive të Korpusit të Prishtinës në fazën e tretë të operacionit, deri në marrjen e autorizimit nga zyra e Presidentit të RFJ-së, gjë që sipas tij, do të bëhej më 3 gusht.¹⁵⁹² Përkundër këtij urdhri, më 2 gusht Pavkoviqi i raportoi Komandës së Përbashkët se “njësitë e UJ-së po shkonin drejt tri pikave kryesore: Drenicës, Jabllanicës dhe Smonicës”.¹⁵⁹³ Dhoma ka konkluduar më lart se gjatë operacionit në Drenicë në 1998, UJ-ja përdori forcë të tepruar, sikurse është përmendur në Pjesën VI.C.

659. Pas një jave, Samarxhiqi nxori një urdhër në të cilin sanksionohej mbështetja e UJ-së për operacionet e MPB-së dhe sigurimin e vazhdueshëm të brezit kufitar dhe objekteve të UJ-së. Dukej qartë që kjo bëhej për Pavkoviqin. Samarxhiqi theksonte se njësitë nuk duhej të përdroreshin kundër këtij urdhri dhe se, nëse do të përdroreshin në kundërshtim me urdhrin, atëherë komandantët e njësive të cilët do të merrnin urdhra të tillë të ndryshëm duhej të informonin menjëherë eprorin e dytë dhe të vepronin sipas urdhrave të tij.¹⁵⁹⁴ Më 6 shtator 1998, Samarxhiqi dhe Pavkoviqi patën një përplasje edhe për një kërkesë që kishte bërë Pavkoviqi për të vendosur një helikopter në dispozicion të Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁹⁵

660. Më 5 tetor 1998, Pavkoviqi i dërgoi një letër Samarxhiqit në të cilën e informonte se, përkundër urdhrave të ndryshëm të Komandës së Armatës së Tretë, Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk kishte formuar grupe të reja luftimi por kishte formuar forca të ndërhyrjes së shpejtë

¹⁵⁹⁰ P1419 (Kërkesë e Pavkoviqit drejtuar Armatës së Tretë, 1 gusht 1998).

¹⁵⁹¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 33, 36.

¹⁵⁹² 4D125 (Urdhër i Armatës së Tretë, 1 gusht 1998).

¹⁵⁹³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 36.

¹⁵⁹⁴ P1421 (Urdhër i Armatës së Tretë lidhur me angazhimin e njësive në mbështetje të MPB-së, 7 gusht 1998), f. 2. *Shih edhe* Dragan Zhivanoviq, T. 20534–20536 (18 janar 2008).

¹⁵⁹⁵ P1011 (Ivan Markoviq, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 64; 4D230 (Komanda e Armatës së Tretë për Korpusin e Prishtinës, 12 shtator 1998); P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 94, 109.

sipas një vendimi të Komandës së Përbashkët të marrë në mbledhjet e zhvilluara më 19 dhe 20 shtator 1998. Në këtë letër, Pavkoviqi i rikujtonte Samarxhiqit se ai e kishte informuar me telefon për këtë vendim dhe se i kishte dërguar vendimin e Komandës së Përbashkët.¹⁵⁹⁶ Radovan Radinoviqi shpjegoi se kjo nuk përbente automatikisht shkelje të parimit të vartësisë, duke qenë se Pavkoviqi nuk e anuloi vendimin e Samarxhiqit, por në fakt ishte një shtjellim i situatës dhe rikthim i çështjes për shqyrtim të Samarxhiqi.¹⁵⁹⁷ Mirëpo, Dhoma nuk e pranon interpretimin e Radinoviqit për këtë letër, duke qenë se bie ndesh me gjuhën e përdorur në të.¹⁵⁹⁸ Vasileviqi komentoi për letrën dhe tha se nuk përbente shkelje të hierarkisë komanduese. Mirëpo, ai nxori përfundimin e gabuar se grupet e luftimit idenë për të cilat e mbështeste Samarxhiqi ishin e njëjta gjë me forcën e ndërhyrjes së shpejtë pro të cilës që Pavkoviqi.¹⁵⁹⁹ Gjithashtu, ai dëshmoi se ishte në dijeni të përplasjes midis Perishiqit dhe Samarxhiqit, nga njëra anë, dhe Pavkoviqit, nga ana tjetër, lidhur me angazhimin e UJ-së në Kosovë në vitin 1998.¹⁶⁰⁰ Duke marrë parasysh gjuhën e përdorur në letër dhe të provave të tjera lidhur me marrëdhënien midis Pavkoviqit dhe eprorëve të tij, Perishiqit dhe Samarxhiqit, Dhoma është e mendimit se kjo letër dëshmon shkeljen e parimit të varësisë brenda UJ-së, në bazë të të cilit urdhrat e komandave eprorë duhej të “zbatoheshin nga vartësit pa kundërshtim, pa vonesë dhe përpikmërisht”.¹⁶⁰¹

661. Në mbështetje të argumentimit se Pavkoviqi nuk e mbështeti fuqizimin e rolit të UJ-së në Kosovë në vitin 1998, Mbrojtja e Pavkoviqit i referohet mbledhjes së Presidentit të RFJ-së, Millosheviqit, dhe zyrtarëve të lartë të shtetit dhe UJ-së më 29 tetor 1998, në të cilën Pavkoviqi theksoi se arsyeja e mosshpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme lidhur me ngjarjet në Kosovë ishte se një gjë e tillë do të tërhiqte vëmendjen ndërkombëtare te kjo çështje dhe te përshtetëzimi i përfshirjes së UJ-së që pashmangshmërisht do të çonte në rritje të numrit të viktimave mes civilëve.¹⁶⁰² Dhoma thekson rezervat e saj lidhur me saktësinë e procesverbalit mbi çfarë është diskutuar në këtë mbledhje, por pranon se mbledhja është zhvilluar dhe se në të u diskutuar çështje të përgjithshme të përmendura në procesverbal.¹⁶⁰³ Gjithsesi, mbledhja u zhvillua pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të Tetorit, të cilat vendosën kufizime konkrete mbi UJ-në nën kërcënimin e

¹⁵⁹⁶ P1439 (Përgjigje e Korpusit të Prishtinës për Komandën e Armatës së Tretë, 5 tetor 1998). Megjithëse në përkthimin e këtij dokumenti thuhet “Komisioni i Përbashkët”, kur iu kërkua ta lexonte, Radovan Radinoviqi tha se ishte “Komanda e Përbashkët”. Radovan Radinoviqi, T. 17340 (19 tetor 2007).

¹⁵⁹⁷ Radovan Radinoviqi, T. 17338–17342 (19 tetor 2007); *Shih edhe* Aleksandar Vasileviqi, T. 9094 (24 janar 2007).

¹⁵⁹⁸ *Shih, p.sh.*, P717 (Letër e Momçillo Perishiqit, për Sllobodan Millosheviqin, datë 23 korrik 1998), f. 1–3; John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 54, T. 9789, 9819–9822 (7 shkurt 2007).

¹⁵⁹⁹ Aleksandar Vasileviqi, T. 9094 (24 janar 2007).

¹⁶⁰⁰ Aleksandar Vasileviqi, T. 9092–9093 (24 janar 2007).

¹⁶⁰¹ *Shih, p.sh.*, P984 (Ligj i RFJ-së “Për UJ-në”), f. 2; P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll), f. 62, 96.

¹⁶⁰² P2166 (Procesverbal i mbledhjes së Beli Dvorit, zhvilluar më 29 tetor 1998), f. 3. Edhe pse dokumenti mban datën 2 nëntor 1998, në të thuhet se mbledhja u zhvillua më 29 tetor 1998.

¹⁶⁰³ P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Beli Dvor më 29 tetor 1998), f. 3.

bombardimit, për të mos vepruar në Kosovë, me përjashtim të brezit kufitar dhe vetëm tri kompani të vendosura përgjatë tri linjave të përcaktuara të komunikimit. Komentet e Pavkoviqit në këtë mbledhje nuk kanë rëndësi për qëndrimin e tij lidhur me angazhimin e UJ-së në Kosovë përpara nënshkrimit të Marrëveshjeve të Tetorit më 1998.

662. Atasheu i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar, John Crosland, dëshmoi se, së bashku me ambasadorin britanik, Robert Donnelly-in, u takua me Dimitrijeviqin më 3 tetor 1998, për të diskutuar mbi “keqpërdorimin e armëve të artillerisë kundërajrore për granatimin e fshatrave”, që ai e konsideronte si forcë të tepruar. Kur Crosland-i, ngriti këtë çështje, Dimitrijeviqi u përgjigj se Pavkoviqi “po përpiquej të bënte emër”. Sipas Crosland-it, kjo deklaratë nënkuptonte “synimin për të shtypur UÇK-në dhe popullatën shqiptare kosovare”.¹⁶⁰⁴ Vetë Dimitrijeviqi dëshmoi se i kujtohej që Crosland-i t’i kishte folur për përdorimin e forcës së tepruar nga UJ-ja.¹⁶⁰⁵ Kur i treguan shënimet e mbajtura nga përfaqësuesit britanikë gjatë kësaj bisede, ai tha se kishte të ngjarë t’i ketë bërë komentet e përmendura nga Crosland-i.¹⁶⁰⁶

663. Crosland-i shtoi se, kur u takua përsëri me Dimitrijeviqin, më 5 nëntor 1998, ai i tha se ishte tejet i shqetësuar për situatën brenda Kosovës dhe se Pavkoviqi po punonte “jashtë kornizës së komandës”, duke e pasur fjalën për hierarkinë komanduese zyrtare të UJ-së.¹⁶⁰⁷ Sipas Crosland-it, ishte e qartë që Perishiqi dhe Dimitrijeviqi nuk qenë plotësisht të informuar lidhur me çfarë ndodhte në Kosovë dhe se “ata po lireshin jashtë hierarkisë komanduese operative që shkonte drejtpërdrejtë nga Pavkoviqi te Millosheviqi dhe te Shainoviqi i cili ishte njeriu operativ i Millosheviqit për punët e përditshme”.¹⁶⁰⁸ Më tej, Crosland-i dëshmoi për një bisedë tjetër që kishte bërë me Dimitrijeviqin më 6 nëntor 1998, të cilën, asokohe, e ka përshkruar në një raport për qeverinë britanike.¹⁶⁰⁹ Gjatë bisedës në fjalë, dhe gjatë diskutimeve për reagimin e UJ-së dhe MPB-së kundrejt provokimeve të UÇK-së, Dimitrijeviqi tha se “Pavkoviqi mund të reagojë pa lejen e Shtabit të Përgjithshëm dhe jashtë hierarkisë komanduese ushtarake” dhe aludoi se Pavkoviqi “ishte i vendosur të zbatonte urdhrat e Millosheviqit, të cilat i vinin përmes Shainoviqit, për ta trajtuar situatën me dorë të fortë”.¹⁶¹⁰ Kur i paraqitën raportin e datës 6 nëntor 1998, Dimitrijeviqi vërejt se përshtypjet dhe konkluzionet e Crosland-it mund të kenë qenë të gabuara dhe se ai e kishte

¹⁶⁰⁴ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 53; P683 (Raport konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 3 tetor 1998).

¹⁶⁰⁵ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627 (8 korrik 2008), T. 26667 (9 korrik 2008).

¹⁶⁰⁶ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26668 (9 korrik 2008).

¹⁶⁰⁷ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 48, 54, T. 9789, 9819–9822 (7 shkurt 2007). Crosland-i sqaroi se data 5 tetor në P2645 ishte gabim dhe se, në fakt, ishte 5 nëntor.

¹⁶⁰⁸ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 54.

¹⁶⁰⁹ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 56; P684 (Raport konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 6 nëntor 1998).

¹⁶¹⁰ John Crosland, P2645 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 tetor 2006), para. 56; T. 9965 (8 shkurt 2007).

quajtur gabimisht Pavkoviçin komandant i Armatës së Tretë në tetor 1998.¹⁶¹¹ Mirëpo, Crosland-i konfirmoi se ai e kishte, pa dyshim, fjalën për Pavkoviçin.¹⁶¹² Dhoma e pranon këtë shpjegim dhe nuk pranon që komenti i Dimitrijeviçit e komprometon vlerën provuese të shënimeve të mbajtura nga Crosland-i, i cili është konsideruar dëshmitar i besueshëm, siç është theksuar më lart.

664. Në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 në mbledhjet e kolegjiut të UJ-së Dimitrijeviç u ankua disa herë për mënyrën me të cilën e përdorte UJ-në në Kosovë Pavkoviç dhe për raportimin e pamjaftueshëm që vinte nga ky sektor. Në tetor 1998, Dimitrijeviç u ankua se njësitë e UJ-së duhej të përdreshin në Kosovë vetëm nëse kërcënoheshin.¹⁶¹³ Ai dëshmoi se shqetësimi i tij lindi sepse më parë qenë përdorur njësi të ushtrisë në Kosovë pa miratimin e Shtabit të Përgjithshëm.¹⁶¹⁴ Ai shtoi se sjellja jo e rregullt e Pavkoviçit vazhdoi gjatë gjithë vitit 1998. Në një mbledhje të kolegjiut të UJ-së, më 10 dhjetor 1998, Dimitrijeviç u ankua për “kaq shumë incidente të pazakonta dhe shumë prej atyre që po ndodhin në Korpusin e Prishtinës janë pikërisht pasojë e ... distancimit të Komandantit të Korpusit dhe, bashkë me të, të gjithë komandës nga UJ-ja”.¹⁶¹⁵ Gjatë dhënies së dëshmisë ai sqaroi se këto “incidente të pazakonta” konsistonin në dezertime, plagosje dhe vetëvrasje, dhe jo akte të Pavkoviçit, por shtoi se këto akte qenë ndihmuar nga mungesa e Pavkoviçit nga vendkomanda e tij ndërkohë që qëndronte në Beograd për periudha të gjata.¹⁶¹⁶ Në janar 1999, Dimitrijeviç u ankua se raportet nuk përmbanin të dhëna për incidentet e pazakonta në Kosovë dhe se nuk bëhej e ditur se çfarë masash kishin marrë komandantët e Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë për këto incidente.¹⁶¹⁷ Më vonë, në mars 1999, Dimitrijeviç ia përsëriti paralajmërimet e tij Shtabit të Përgjithshëm dhe në veçanti Ojdaniçit, dhe këshilloi që të merreshin masa për të mundësuar informacion të saktë nga Armata e Tretë.¹⁶¹⁸

665. Sikurse është konkluduar më lart, ngjarjet që i paraprinë zbatimit të Planit për Luftën Kundër Terrorizmit tregojnë se Pavkoviç ishte një prej mbështetësve kryesorë të shtimit të angazhimit të UJ-së në brendësi të Kosovës. Pavkoviç ishte anëtar i Komandës së Përbashkët, ai mori pjesë thujse në të gjitha mbledhjet e saj dhe përdori ndikimin e këtij organi dhe lidhjen e drejtpërdrejtë që kishte me Millosheviçin për realizimin e strategjinë së tij agresive për përdorimin e përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, përfshirë edhe anashkalimin e hierarkisë së rregullt

¹⁶¹¹ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26672 (9 korrik 2008), lidhur me P2645 (deklaratë e dëshmitarit e John Crosland-it, datë 31 tetor 2006), para. 54.

¹⁶¹² John Crosland, T. 9965 (8 shkurt 2007).

¹⁶¹³ 3D646 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 26 tetor 1998), f. 9.

¹⁶¹⁴ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26693 (9 korrik 2008).

¹⁶¹⁵ 3D484 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14.

¹⁶¹⁶ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26624 (8 korrik 2008).

¹⁶¹⁷ 3D559 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 janar 1999), f. 20.

¹⁶¹⁸ P933 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 9, 15.

komanduese të UJ-së. Kjo i solli edhe përfitime vetjake. Miratimi i Planit për Luftën Kundër Terrorizmit në mbledhjen e datës 21 korrik 1998 përkoi me ngritjen e tij në gradën e gjenerallejtënantit. Pavkoviqi pati përplasje me Perishiqin dhe Samarxhiqin dhe e shfrytëzoi UJ-në Kosovë në fillim të muajit gusht 1998, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me urdhrat e Samarxhiqit. Fakti që Pavkoviqi e ndjente nevojën për të dalë jashtë detyrave të tij normale dhe aktivisht përpiquej për shtimin e angazhimit të UJ-së në Kosovë përputhet me qëndrimin e tij mbi rolin e UJ-së, të cilën ai donte ta shfrytëzonte përkundër ankesave se përdorimi i saj binte ndesh me kufizimet kushtetuese, të dy këto qëndrime përbënin hapur një përkushtim të thellë për mbajtjen e Kosovës brenda Republikës së Serbisë, sikurse shprehet ai në letrën që i drejtonte Komandës së Armatës së Tretë më 23 korrik. Dhoma konstaton se, pas përplasjeve midis Pavkoviqit dhe eprorëve të tij, Perishiqi dhe Samarxhiqi u larguan që të dy nga postet e tyre komanduese dhe Pavkoviqi mori drejtimin e Armatës së Tretë si komandant i saj.

ii. Armatosja e popullatës joshqiptare në Kosovë

666. Prokuroria parashtroi se, gjatë vënies në zbatim të Planit të vitit 1998 të Luftës Kundër Terrorizmit në Kosovë, anëtarët e UJ-së, MPB-së dhe autoritetet civile armatosën popullatën joshqiptare dhe çarmatosën shqiptarët kosovarë, për realizimin e synimeve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe se Pavkoviqi dha kontributin e tij të vullnetshëm në këtë aspekt.¹⁶¹⁹ Mbrojtja e Pavkoviqit kundërpërgjigjet se armatosja ishte një politikë legjitime mbrojtjeje e RFJ-së dhe se Pavkoviqi nuk komandoi asnjëherë grupe që nuk bënin pjesë në UJ.¹⁶²⁰

667. Natyra e popullatës së armatosur joshqiptare dhe procesi i armatosjes së këtij grupi u diskutuan në Pjesët VI.A dhe VIII.B. Në të përfshiheshin rezervistë të UJ-së, rezervistë të MPB-së, anëtarë të mbrojtjes civile dhe territoriale dhe të tjerë jashtë të gjitha këtyre strukturave. Kur i treguan urdhrin e datës 26 qershor 1998 të Korpusit të Prishtinës për shpërndarjen e armëve serbëve në Kosovë, Momir Stojanoviqi, i cili ishte shef i Degës së Sigurimit në Korpusin e Prishtinës, dëshmoi se ky urdhër u lëshua në përgjigje të kërkesave të përfaqësuesve të vendbanimeve serbe. Këta përfaqësues kishin thënë se qenë djegur dhe plaçkitur enklavat serbe dhe, pasi Pavkoviqi u takua me serbë të Prelluzhës dhe Obiliqit, u organizua armatosja e popullsisë serbe për t'u dhënë mundësi të mbroheshin në fshatrat e tyre.¹⁶²¹ Pavkoviqi tregoi mbështetjen e tij për armatosjen e popullsisë joshqiptare në Kosovë, si pjesë e strategjisë së Komandës së Përbashkët. Në letrën e tij

¹⁶¹⁹ Aktakuza, para. 51; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 871–872.

¹⁶²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 90, 156.

¹⁶²¹ Momir Stojanoviqi, T. 20072–20074 (12 dhjetor 2007). *Shih edhe* Zllatomir Peshiq, T. 7190 (23 nëntor 2006); P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës për vënien në zbatim të masave për sigurinë dhe mbrojtjen e

të datës 23 korrik 1998, ai shkruante se “me gjithë armatosjen e popullsisë, ky faktor nuk ishte përfshirë tërësisht në sistemin kundër terrorizmit”.¹⁶²² Mbështetja dhe faktori udhëheqës i Pavkoviçit në procesin e armatosjes së popullsisë së armatosur joshqiptare dëshmohej edhe nga diskutimet e Komandës së Përbashkët për këtë çështje gjatë gjithë vitit 1998.¹⁶²³ Më 28 tetor 1998, Pavkoviç i ngriti përsëri çështjen se si mund të përdorej “popullsia e armatosur” dhe si mund të përfshihej ajo në “mbrojtjen e linjave të komunikimit”.¹⁶²⁴

668. Ndërkohë që MPB-ja mori detyrën e çarmatosjes së shqiptarëve kosovarë në brendësi të krahinës, Pavkoviç i urdhëroi që Korpusi i Prishtinës ta zbatonte këtë urdhër në brezin kufitar, duke i udhëzuar njësitë në vartësi të tij “të monitoronin sjelljen e popullsisë shqiptare në sektorët që mbulonin” dhe “të planifikonin dhe të zbatonin çarmatosjen e planifikuar të popullsisë shqiptare”.¹⁶²⁵ Më vonë, ai që i pranishëm në mbledhjen e datës 29 tetor në Beli Dvor në Beograd, në të cilën u diskutuan çështjet e armatosjes së popullsisë joshqiptare dhe çarmatosjes së fshatrave shqiptare kosovare, si pjesë e Planit të Luftës Kundër Terrorizmit.¹⁶²⁶ Veprimtaria e çarmatosjes vazhdoi edhe gjatë muajit tetor dhe nëntor 1998.¹⁶²⁷

669. Këto procese paralele kanë rëndësi të veçantë, parë në atmosferën tejet të ngarkuar të tensionit etnik që mbizotëronte në vitin 1998 dhe 1999. Në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviç pranoi se në atë kohë ekzistonte një konflikt midis shqiptarëve kosovarë dhe joshqiptarëve. Ai tha se “nga e kaluara dihet se [konflikti midis popullsisë shqiptare dhe joshqiptare] është shfaqur çdo herë që kanë ndodhur ngjarje të këtij lloji në Kosovë” dhe se në konflikte të tilla dhe kur njerëzit kanë mbrojtur fshatrat e tyre, kanë ndodhur “krime”.¹⁶²⁸ Dhoma vëren se, me gjithë këtë situatë shpërthyes, Pavkoviçi armatosi popullatën joshqiptare, ndërkohë që paralelisht çarmatosi popullatën shqiptare kosovare.

iii. Dijenia dhe veprimet si komandant i Korpusit të Prishtinës

popullatës, 21 maj 1998); Radovan Radinoviç, 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 37; *shih edhe* Momir Stojanoviç, T. 19747 (7 dhjetor 2007); 5D1378 (Video e Pavkoviçit dhe Llazareviçit në Gjakovë).

¹⁶²² P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 58 (para. 3).

¹⁶²³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 2, 4–6, 24–26.

¹⁶²⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 163.

¹⁶²⁵ P1433 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 15 shtator 1998). *Shih edhe* P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 97.

¹⁶²⁶ P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Beli Dvor më 29 tetor 1998), f. 3–4.

¹⁶²⁷ P1203 (Raport operativ i Komandës së Përbashkët lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë, 15 tetor 1998), f. 5; P1197 (Raporte për situatën të Komandës së Përbashkët me zarf shoqëruar për Millomir Miniçin), f. 6.

¹⁶²⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 1–2, 88, 205, 213, 347.

670. Prokuroria pretendon se në vitin 1998, Pavkoviqi i dha urdhër UJ-së të angazhohej në operacione në Kosovë dhe se ishte i vetëdijshëm se ky angazhim shkaktoi përdorim të forcës së tepruar dhe joproportionale.¹⁶²⁹ Mbrojtja e Pavkoviqit kundërpërgjigjet se të gjitha angazhimet e UJ-së në vitin 1998 ishin zbatim i ligjshëm i forcës në përgjigje të rrezikut që vinte nga UÇK-ja.¹⁶³⁰

671. Dhoma ka konkluduar se forcat e MPB-së dhe UJ-së përdorën forcë të tepruar dhe joproportionale në disa raste në Kosovë.¹⁶³¹ Dhoma ka konkluduar edhe se dhjetëra mijëra shqiptarë kosovarë u shpërngulën nga konflikti i atëhershëm midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë, deri në fund të vitit 1998, dhe se kjo shpërngulje u shkaktua pjesërisht nga përdorimi i forcës së tepruar ose joproportionale nga UJ-ja dhe MPB-ja në vitin 1998.

672. Në vitin 1998, Pavkoviqi mori pjesë në diskutimet e Komandës së Përbashkët lidhur me numrin e madh të civilëve të shpërngulur në Kosovë.¹⁶³² Në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, ai u informua edhe për praktikën e djegies së shtëpive të shqiptarëve kosovarë. Më 7 gusht, Shainoviqi i tha Komandës së Përbashkët se “dëmi më i madh na bëhet nga djegia e shtëpive pa pasur asnjë nevojë”.¹⁶³³ Po atë ditë, Samarxhiqi i tha vetë Pavkoviqit se ishte “turp” ta “luftohej terrorizmi përmes zjarrvënies”.¹⁶³⁴ Më 12 gusht, Miniqi përsëri tha se i duhej dhënë fund djegies së shtëpive.¹⁶³⁵ Në shtator, Shainoviqi udhëzoi që njësitë të përgatiteshin për “ndërhyrje më të shpejtë” dhe shtoi që detyrat të kryheshin në mënyrë të disiplinuar për të evituar zjarrvënien.¹⁶³⁶ Në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviqi tha se zjarrvënja u bë nga serbët vendas të armatosur dhe nga disa “persona të papërgjegjshëm të njësive”.¹⁶³⁷ Rrjedhimisht, Dhoma bindet se Pavkoviqi ishte në dijeni se efektivë të njësive të UJ-së morën pjesë në djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë në vitin 1998.

673. Në vitin 1998, Pavkoviqi lëshoi një sërë urdhrash me shkrim, përmes të cilëve i udhëzonte forcat në vartësi të tij që të respektonin të drejtën humanitare ndërkombëtare.¹⁶³⁸ Disa prej këtyre

¹⁶²⁹ Aktakuza, para. 95–96; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 864.

¹⁶³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 124.

¹⁶³¹ *Shih* Pjesën VI.C.

¹⁶³² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 36, 40–41, 121.

¹⁶³³ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 46. *Shih edhe* 4D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës që ndalon shkatërrimet, 7 gusht 1998), f. 1.

¹⁶³⁴ 4D97 (Procesverbal i mbledhjes informuese të komandantëve të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, 7 gusht 1998), f. 3.

¹⁶³⁵ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52.

¹⁶³⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 124–125.

¹⁶³⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 358.

¹⁶³⁸ *Shih* P1535 (Urdhër për komandantët e njësive për t’u angazhuar në sigurimin e kufirit shtetëror, 29 prill 1998), f. 2; 4D183 (Korpusi i Prishtinës, Urdhër i Pavkoviqit, 16 maj 1998); 4D428 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 27 maj 1998); 4D231 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me mbështetjen e MPB-së, 20 korrik 1998), pranuar edhe me numrin 5D1172; 4D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për ndalimin e shkatërrimeve, 7 gusht 1998); P1422 (Urdhër i

urdhrave dëshmojnë se në vitin 1998, pati shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare nga forcat e UJ-së. Këtu përfshihej keqtrajtimi i robërve të luftës pranë Brestocit, lidhur me të cilën theksohej ndalimi i represionit, torturës dhe sjelljes çnjerëzore dhe konstatohet se kishte pasur shkelje të ligjeve të luftës.¹⁶³⁹ Gjithashtu ai përmendte hapjen e zjarrit të tepruar nga artilleria në zonat e banuara,¹⁶⁴⁰ dhe shkatërrimin dhe plaçkitjen e pronave të civilëve shqiptarë kosovarë.¹⁶⁴¹ Pavkoviqi nxori dy urdhra më 26 maj dhe 5 qershor 1998, përmes të cilëve i udhëzonte komandantët e njësisive të mos i lejonin personat dhe njësitë të hynin në zonat e populluara dhe të dëmtonin pasuritë e qytetarëve dhe të mos lejonin vjedhjen e pasurive të qytetarëve me kombësi shqiptare. Më tej, në to jepej udhëzimi që të gjitha pasuritë e vjedhura deri atëherë të ktheheshin menjëherë.¹⁶⁴² Në korrik 1998, Pavkoviqi përcolli një urdhër të nxjerrë nga Shtabi i Përgjithshëm, për moshapjen e zjarrit në zonat ku dyshohej se mund të kishte të pranishëm vëzhgues ndërkombëtarë, i cili u zbatua nga Llazareviqi.¹⁶⁴³ Miodrag Simiqi dëshmoi se edhe ky urdhër kishte synim parandalimin e dëmit ndaj civilëve.¹⁶⁴⁴ Më 3 tetor, ai nxori një urdhër përmes të cilit ndalonte të gjithë përdorimin e paprovokuar të artillerisë dhe të armëve të rënda në Kosovë, duke thënë se kjo ishte për të eliminuar imazhin e forcës së tepruar që po përhapej në mediat perëndimore.¹⁶⁴⁵

674. Në shtator 1998, Pavkoviqi nxori urdhra, ku thoshte se pretendimet në mediat ndërkombëtare lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve kosovarë nga UJ-ja dhe MPB-ja qenë të rreme dhe për këtë ia hidhte fajin UÇK-së.¹⁶⁴⁶ Ai i bëri thirrje UJ-së të kujdesej për refugjatët dhe t'i lejonte ata të ktheheshin në shtëpi.¹⁶⁴⁷ Mirëpo duke pasur parasysh komentet e Pavkoviqit gjatë javëve të mëparshme lidhur me përfshirjen e forcave të tij në djegien e fshatrave në Kosovë,

Korpusit të Prishtinës lidhur me “tejpërdorimin” e pajisjeve, 7 gusht 1998); 4D375 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me parandalimin e vjedhjeve, 18 gusht 1998); 6D698 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 5 shtator 1998), pranuar edhe me numrin P1101; P1430 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 9 shtator 1998); P626 (Përkujtesë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për efektivin e UJ-së që luftonin UÇK-në, qershor 1998).

¹⁶³⁹ 4D428 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 27 maj 1998), f. 1.

¹⁶⁴⁰ 4D231 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me mbështetjen e MPB-së, 20 korrik 1998), pranuar edhe me numrin 5D1172.

¹⁶⁴¹ 4D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për ndalimin e shkatërrimeve, 7 gusht 1998); P1422 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me “tejpërdorimin” e pajisjeve, 7 gusht 1998); 4D375 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me parandalimin e vjedhjeve, 18 gusht 1998).

¹⁶⁴² P1011 (Ivan Markoviq, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 47; P2098 (Urdhër i Postëkomandës Pararojë të Korpusit të Prishtinës, 5 qershor 1998).

¹⁶⁴³ Miodrag Simiq, T. 15562–15564 (13 shtator 2007); 4D177 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 7 korrik 1998); P969 (Urdhër i nxjerrë nga Vladimir Llazareviqi, 10 korrik 1998).

¹⁶⁴⁴ Miodrag Simiq, T. 15562–15564 (13 shtator 2007).

¹⁶⁴⁵ 4D150 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për ndalimin e përdorimit të armëve, 3 tetor 1998).

¹⁶⁴⁶ P1430 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 9 shtator 1998); P1434 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 19 shtator 1998), f. 2, 5.

¹⁶⁴⁷ P1434 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 19 shtator 1998), f. 2, 5.

Dhoma është e mendimit se këto udhëzime shërbyen vetëm për të larguar fajin nga forcat e UJ-së, dhe jo si masa të efektshme për pakësimin e incidenteve të tilla.

675. Më 24 shtator 1998, Pavkoviqi i dha urdhër Brigadës së 125-të të Motorizuar që të kryente operacione luftimi, ndër të tjera, në Abrinë e Epërme.¹⁶⁴⁸ Më 26 shtator, ai raportoi se rezistenca kishte qenë e fuqishme, por se “grupi” ishte detyruar të tërhiqej në një zonë shumë më të vogël. Më pas, Shtabi i Përgjithshëm vërente se, sipas raporteve nga Armata e Tretë, më 26 dhe 27 shtator njësitë e Korpusit të Prishtinës dhanë mbështetje me zjarr për njësitë e MPB-së që po kryenin operacione luftimi në këtë fshat, ndërsa mediat e huaja, organizatat humanitare dhe përfaqësuesit e shteteve të huaja kishin raportuar për një masakrim të civilëve dhe kishin kërkuar informacione të tjera.¹⁶⁴⁹ Në raportin e tij, Pavkoviqi thoshte se komanda e tij nuk kishte informacion për “masakrimin e pretenduar të popullatës civile”. Ai pranonte se kishte informacion të pakonfirmuar sipas të cilit anëtarët e MPB-së kishin ekzekutuar individë të ndaluar, por thoshte se ky informacion “nuk ishte për masakrimin e popullatës civile, sikurse përmendet në media”.¹⁶⁵⁰ Në raport ai nuk përmendte hollësitë që kishte marrë po atë ditë nga Brigada e 125-të e Motorizuar. Në raportin e tyre thuhej se forcat e pranishme të UJ-së kishin gjetur kufomën e një femre në fshat dhe i kishin dorëzuar MPB-së tri fëmijë të moshave nga dy deri në katër vjeç të cilët i lanë në një shtëpi me furnizime për të pritur derisa të ktheheshin fshatarët.¹⁶⁵¹

676. Në fund të vitit 1998, gjatë mbledhjeve të Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së u shpreh shqetësim lidhur me saktësinë e raportimit nga njësitë në vartësi.¹⁶⁵² Dimitrijeviqi dëshmoi në lidhje me deklaratën e tij gjatë kolegjiut të datës 10 dhjetor 1998 se “incidentet e pazakonshme” qenë rezultat i “distancimit” të Pavkoviqit nga Armata e Tretë dhe Shtabi i Përgjithshëm. Ai shpjegoi se, kur vuri në dyshim saktësinë e raporteve që kalonin përmes hierarkisë komanduese, përgjigjja që mori nga ndihmësi i Shtabit të Përgjithshëm për Operacionet, Obradoviqi, ishte thjesht se raportet e Korpusit të Prishtinës vinin përmes kanaleve të rregullta. Ai

¹⁶⁴⁸ 6D700 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 24 shtator 1998), f. 1–3.

¹⁶⁴⁹ 4D403 (Kërkesë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për deklaratë me shkrim, 2 tetor 1998). Ka prova se në Abrinë e Epërme u ekzekutuan 21 civilë. Frederick Abrahams, T. 806–814 (13 korrik 2006), P2227 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 maj 2002), para. 19; P441 (Raport i organizatës “Human Rights Watch” me titull *A Week of Terror in Drenica - Humanitarian Law Violations in Kosovo* “Një javë terror në Drenicë, shkelje të së drejtës ndërkombëtare në Kosovë”, 1 shkurt 1999), f. 16–47. KDOM-i konstatoi se, gjatë këtij incidenti, u vranë 21 civilë, përfshirë edhe gra dhe fëmijë. P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 129; 4D402 (Raport i Armatës së Tretë mbi incidentet vdekjeprurëse dhe me përdorimin e municioneve kritike, 3 tetor 1998).

¹⁶⁵⁰ P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse 5 tetor 1998), f. 4.

¹⁶⁵¹ P1011 (Ivan Markoviq, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 70–71.

¹⁶⁵² 3D484 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14–15; P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, 30 dhjetor 1998), f. 14; P933 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15; P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627, 26653 (8 korrik 2008).

dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm (fillimisht Perishiçi, e më pas Ojdaniçi) ishin të pakënaqur nga këto përgjigje. Perishiçi kërkoi raporte ditore për municionet e përdorura nga Korpusi i Prishtinës, duke qenë se raportet nuk informonin për kryerje operacionesh edhe kur kishte pakësim të municioneve, dhe Ojdaniçi bëri të njëjtën gjë kur e mori këtë detyrë në dhjetor.¹⁶⁵³

677. Krahas raporteve të ndryshme të brendshme nga njësitë dhe organet e UJ-së të cilat informonin për akte kriminale nga anëtarët e UJ-së në vitin 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së nxori rezoluta në të cilat përcillte informacion të ngjashëm. Më 31 mars 1998, Këshilli i Sigurimi miratoi Rezolutën nr 1160, e cila e dënonte “përdorimin e forcës së tepruar nga forcat policore serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë në Kosovë”,¹⁶⁵⁴ si edhe aktet e dhunshme të UÇK-së. Më pas, më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1199 në të cilën theksonte shprehimisht se ishte “shumë i shqetësuar” nga konflikti në Kosovë dhe sidomos për “përdorimin e tepruar dhe pa dallim të dhunës” nga MPB-ja dhe UJ-ja, e cila, sipas mendimit të Këshillit, kishte shkakuar “humbje të shumta në civilë dhe ... shpërnguljen e mbi 230 mijë personave nga shtëpitë e tyre”.¹⁶⁵⁵ Pavkoviçi përmendi “parimet e përcaktuara në Rezolutën e OKB-së” në mbledhjen e Komandës së Përbashkët më 28 tetor 1998, duke treguar kështu se ishte në dijeni të përmbajtjes së rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.¹⁶⁵⁶

678. Dhoma është e mendimit se urdhrat dhe raportet e UJ-së tregojnë se Pavkoviçi e angazhoi UJ-në në operacione të përbashkëta me forcat e MPB-së në vitin 1998, gjatë të cilave u ushtrua forcë e tepruar dhe joproporcionale. Ndërkohë që Pavkoviçi nxori një sërë urdhrash me të cilat u bënte thirrje vartësve të tij për garantimin e disiplinës në Korpusin e Prishtinës dhe për respektimin e së drejtën humanitare ndërkombëtare, ai gjithashtu u informua për pretendimet lidhur me përdorimin e forcës së tepruar apo joproporcionale në operacionet e përbashkëta, sidomos në Abrinë e Epërme.¹⁶⁵⁷ Në raportin e tij të mëposhëm për këtë incident ai përpiqej ta minimizonte incidentin e rëndë dhe të mos përcillte informacionet që dinte.¹⁶⁵⁸ Gjithashtu atë e vunë në dijeni disa herë për djegien e shtëpive në Kosovë nga njësitë vartëse. Me gjithë dijeninë e tij për aktivitetet kriminale të forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, Pavkoviçi vijoi me dhënien e urdhrave për angazhimin e UJ-së në operacionet e përbashkëta në Kosovë dhe vijoi pjesëmarrjen në

¹⁶⁵³ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26622–26628 (8 korrik 2008); 3D484 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14.

¹⁶⁵⁴ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998), f. 1.

¹⁶⁵⁵ P456 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199, 23 shtator 1998), f. 1.

¹⁶⁵⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 161.

¹⁶⁵⁷ P441 (Raport i organizatës “Human Rights Watch”, 1 shkurt 1999), f. 16–47; Frederick Abrahams, T. 806–812 (13 korrik 2006); P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 70–71; P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës për incidentet që kanë për pasojë vdekjen, 5 tetor 1998), f. 4.

¹⁶⁵⁸ P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse, 5 tetor 1998), f. 4.

Komandën e Përbashkët. Dhoma konstaton se, gjatë një diskutimi për situatën e sigurisë në Kosovë në një mbledhje të Komandës së Përbashkët më 13 gusht 1998, Millomir Miniqi u tha të pranishmëve, përfshirë edhe Pavkoviqin, se u duhej “t’i përgatisim këto aksione dhe t’i maskojmë aksionet tona me masa për civilët”.¹⁶⁵⁹ Duke marrë parasysh këtë dëshmi dhe minimizimin prej Pavkoviqit të aktivitetit kriminal të vartësve të tij, Dhoma nuk është e mendimit se urdhrat me shkrim ku kërkohet respektimi i së drejtës humanitare ndërkombëtare qenë përpjekje të sinqerta për marrjen e masave të efektshme për parandalimin e kryerjes së krimeve kundër shqiptarëve kosovarë. Për më tepër, Dhoma nuk e pranon shpjegimin se urdhri për moshapjen e zjarrit në zonat ku mund të qenë të pranishëm vëzhguesit e huaj kërkonte të mbronte vëzhguesit e huaj, por, përkundrazi, mendon se kushtet e tij dëshmojnë se ishte një përpjekje që të tjerët të mos zbulonin se UJ-ja po kryente krime.¹⁶⁶⁰

4. Roli i Pavkoviqit si komandant i Armatës së Tretë

a. Emërimi dhe kompetencat

679. Prokuroria argumenton se Pavkoviqi u emërua komandant i Armatës së Tretë pas një sërë mosmarrëveshjes midis Millosheviqit dhe Perishiqit (me mbështetjen e Samarxhiqit) lidhur me përdorimin e UJ-së në Kosovë. Më tej, Prokuroria argumenton se, pas ngritjes së tij në detyrë si Komandant i Armatës së Tretë, Pavkoviqi kishte kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi Armatën e Tretë dhe se, si epror i të gjitha forcave të UJ-së në Kosovë, ishte në gjendje ta përdorte UJ-në për të mundësuar dëbimin e popullatës shqiptare kosovare.¹⁶⁶¹ Mirëpo, Mbrojtja e Pavkoviqit i mohon këto pretendime dhe pohon se ai as nuk urdhëroi, e as nuk organizoi kurrë kryerjen e asnjë krimi gjatë kohës si komandant i Armatës së Tretë.¹⁶⁶²

i. Emërimi

680. Më 28 dhjetor 1998, Pavkoviqi zëvendësoi Dushan Samarxhiqin si komandant i Armatës së Tretë.¹⁶⁶³ Tensioni mes dy oficerëve lidhur me përdorimin e UJ-së në Kosovë është analizuar më

¹⁶⁵⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 53; P949 (intervistë e Nebojsja Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 364.

¹⁶⁶⁰ Miodrag Simiq, T. 15562–15565 (13 shtator 2007); 4D177 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 7 korrik 1998); P969 (Urdhër i nxjerrë nga Vladimir Llazareviqi, 10 korrik 1998).

¹⁶⁶¹ Aktakuza, para. 50–54; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 847–848.

¹⁶⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 18.

¹⁶⁶³ P800 (Raport për marrjen në dorëzim të detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsja Pavkoviqi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin 4D36 (Raport për marrjen në dorëzim të detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsja Pavkoviqi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin P800; P800 (Raport për dorëzimin e detyrës së

lart, ku është arritur në përfundimin se ata patën divergjenca lidhur me shtimin e pranisë së UJ-së në Kosovë nga Pavkoviqi, pa respektuar hierarkinë komanduese të UJ-së.

681. Propozimi për emërimin e Pavkoviqit si Komandant i Armatës së Tretë në vend të Samarxhiqit u diskutua në sesionin e tetë të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes më 25 dhjetor 1998.¹⁶⁶⁴ Në mbledhje emërimin e Pavkoviqit e kundërshtoi Presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanoviqi, i cili tha se operacionet e Korpusit të Prishtinës nuk ishin gjithmonë në përputhje me rolin kushtetues të UJ-së.¹⁶⁶⁵ Pavarësisht këtyre kundërshtimeve, më 28 dhjetor 1998 Millosheviqi dekretoi emërimin e Pavkoviqit si komandant të Armatës së Tretë dhe të Llazareviqit si komandant të Korpusit të Prishtinës.¹⁶⁶⁶

682. Emërimet në poste të larta ishin kompetencë e Presidentit të RFJ-së dhe përcaktoheshin shprehimisht nga neni 136 i Kushtetutës së RFJ-së dhe neni 151 i Ligjit për UJ-në.¹⁶⁶⁷ Branko Fezeri, i cili punonte si shef i Administratës së Personelit për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së,¹⁶⁶⁸ shpjegoi procesin e emërimit dhe ngritjes në detyrë të oficerëve të UJ-së, që sipas tij u respektua në rastin e ngritjes në detyrë të Pavkoviqit.¹⁶⁶⁹ Duke u mbështetur në vlerësimet e marra gjatë gjithë karrierës së tij, Mbrojtja e Pavkoviqit pretendon se Pavkoviqi ishte ushtarak profesionist dhe i nderuar, i cili së bashku me njësitë që kishte nën urdhra, vepronte në përputhje me aktet normative ushtarake dhe me parimet e së drejtës humanitare ndërkombëtare. Në veçanti, Dhoma vëren se në vlerësimin që i është bërë Pavkoviqit në janar 1999, i nënshkruar nga Samarxhiqi, ai është vlerësuar si “i shkëlqyer” dhe “i jashtëzakonshëm”.¹⁶⁷⁰

Komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiqi, 13 janar 1999); 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998).

¹⁶⁶⁴ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1, 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3, 13–21.

¹⁶⁶⁵ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 9–10; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 21–22; *Shih edhe* Ratko Marković, T. 13407–13409 (13 gusht 2007).

¹⁶⁶⁶ 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998); P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Llazareviqi, 9 janar 1999).

¹⁶⁶⁷ Branko Fezer, T. 16482 (27 shtator 2007), 3D1118 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 shtator 2007), para. 5. *Shih edhe* Branko Kërça, T. 16901–16902 (4 tetor 2007).

¹⁶⁶⁸ Branko Fezer, 3D1118 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 shtator 2007), para. 1–2.

¹⁶⁶⁹ Branko Fezer, T. 16483–16485, 16489–16490 (27 shtator 2007), 3D1118 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 shtator 2007), para. 5.

¹⁶⁷⁰ *Shih* 4D136 (Vlerësimi i karrierës së Nebojsa Pavkoviqit nënshkruar nga Dushan Samarxhiqi, 10 janar 1999). Dhoma ka analizuar edhe vlerësimet e mëparshme për Pavkoviqin gjatë karrierës së tij ushtarake. *Shih* 4D178 (Vlerësim i karrierës së Nebojsa Pavkoviqit, 16 mars 1973), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 3 (ku puna e tij vlerësohet si “e shkëlqyer”); 4D180 (Vlerësim i karrierës së Nebojsa Pavkoviqit, 10 mars 1979), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 3 (ku puna e tij vlerësohet si “jashtëzakonisht e dalluar”); 4D181 (Vlerësim i karrierës së Nebojsa Pavkoviqit, 10 tetor 1989) (ku puna e tij vlerësohet si “veçanërisht e jashtëzakonshme”); 4D182 (Vlerësim i karrierës së Nebojsa Pavkoviqit, 30 qershor 1997), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2 (ku puna e tij vlerësohet si “e shkëlqyer”).

683. Më 9 janar 1999 Llazareviqi u ngrit në detyrë, në postin e komandantit të Korpusit të Prishtinës,¹⁶⁷¹ dhe më 13 janar 1999 Pavkoviqi mori në dorëzim detyrën e Komandantit të Armatës së Tretë, duke zëvendësuar Samarxhiqin.¹⁶⁷² Në një intervistë në media, në vitin 2000, Pavkoviqi tha se kishte marrë ngritje në detyrë përpara kohe pesë herë gjatë karrierës së tij në UJ, përfshirë një herë në vitin 1998 dhe një herë në vitin 1999, përkundër faktit që normat lejonin vetëm tre ngritje në detyrë përpara kohe.¹⁶⁷³

ii. Kompetencat dhe përgjegjësitë

684. Komandanti i Armatës së Tretë ishte në vartësi të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, i cili ishte ushtaraku me gradën më të lartë në UJ. Nga ana tjetër, komandanti i Armatës së Tretë kishte pushtet mbi të gjitha forcat e tjera në vartësi të tij, përfshirë Korpusin e Prishtinës, Korpusin e Nishit dhe Qarqet Ushtarake të Prishtinës dhe Nishit, së bashku me Degët Ushtarake të tyre.¹⁶⁷⁴ Pavkoviqi kishte mundësinë t'i komandonte forcat e UJ-së në Kosovë gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-së, me gjithë bombardimet.¹⁶⁷⁵ Në kompetencat disiplinore dhe parandaluese të tij përfshihej kompetenca për lirim nga detyra të komandantëve të brigadave, si edhe oficerë të tjerë, për moszbatimin e urdhrave,¹⁶⁷⁶ dhe kompetenca për largimin e vullnetarëve nga njësitë e UJ-së.¹⁶⁷⁷ Ai kishte detyrimin për të disiplinuar çdo vartës që nuk zbatonte një urdhër për shkak të mungesës së disiplinës,¹⁶⁷⁸ dhe Komanda e Armatës së Tretë kishte detyrimin t'i raportonte drejtpërsëdrejti Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, ndër të tjera, edhe për krimet dhe incidentet e paligjshme.¹⁶⁷⁹

¹⁶⁷¹ P801 (Raport për marrjen e detyrës së komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviqi, 9 janar 1999).

¹⁶⁷² P800 (Raport për marrjen e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsa Pavkoviqi, 13 janar 1999), pranuar edhe me numrin 4D36. P802 (Raport për dorëzimin e detyrës së komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiqi, 13 janar 1999). Pavkoviqi ishte emëruar me anë të një dekreti në postin e Komandantit të Armatës së Tretë më 28 dhjetor, sikurse u përmend më lart. *Shih* 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998).

¹⁶⁷³ P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit ndaj pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 9.

¹⁶⁷⁴ *Shih* P984 (Ligj i RFJ-së për UJ-në), nenet 5, 6. *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviq, T. 17646 (26 tetor 2007); Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 janar 2004), para. 6–9; P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 144; 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 1.

¹⁶⁷⁵ *Shih, p.sh.*, P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit ndaj pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17.

¹⁶⁷⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 271; *shih edhe* 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me listën e udhëzimeve, 7 maj 1999), para. 7; Mirko Starçeviq, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 24.

¹⁶⁷⁷ 4D198 (Lista e Plotë e Udhëzimeve e Armatës së Tretë, 7 maj 1998), para. 11.

¹⁶⁷⁸ 4D532 (Rregullore e Shërbimit e UJ-së, 1 janar 1996), rregulla 36.

¹⁶⁷⁹ Geza Farkash, T. 16362–16363 (25 shtator 2007); Lubisha Stojimiroviq, T. 17681 (26 tetor 2007); Radojko Stefanoviq, T. 21728 (6 shkurt 2008). *Shih edhe* Millosh Mandiq, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviq, T.

b. Sjellja e Pavkoviçit si komandant i Armatës së Tretë

i. Shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit

685. Prokuroria parashton se Pavkoviçiqi mori pjesë në përpjekjet e udhëheqjes së RFJ-së dhe Serbisë për të anashkaluar dhe kompromentuar detyrimet që rridhnin nga Marrëveshjet e Tetorit të vitit 1998.¹⁶⁸⁰ Mbrojtja e Pavkoviçiqit argumenton se, që nga fillimi i nismës për Marrëveshjet e Tetorit, bashkëpunimi midis UJ-së dhe Misionit të OSBE-së ishte shembullor, me shumë pak mosmarrëveshje.¹⁶⁸¹

686. Çështja e respektimit të Marrëveshjeve të Tetorit është diskutuar më lart në Pjesën VI.D, ku Dhoma konkludoi se UJ-ja i shkeli qëllimisht Marrëveshjet e Tetorit përmes angazhimit të forcave në incidentin e Podujevës, se shtimi i efektivit të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 binte ndesh me Marrëveshjet e Tetorit, dhe se MPB-ja mbajti armë dhe pajisje të rënda, të cilat ishte e detyruar t'ia kthente UJ-së. Këtu do të analizohet qëndrimi i Pavkoviçiqit në lidhje me këto shkelje.

687. Shaun Byrnes, i cili ishte anëtar i misionit diplomatik të vëzhguesve të SHBA-së në Kosovë (KDOM) në vitin 1998 dhe 1999, dëshmoi se ishte takuar një herë me Pavkoviçiqin, shumë pak kohë pas Marrëveshjeve të Tetorit, kur Pavkoviçiqi i thirri zyrtarët e KDOM-it në një mbledhje në zyrat e tij në Komandën e Korpusit të Prishtinës, për të shqyrtuar “rregullat e lojës”, Marrëveshjet e Tetorit, detyrimet e Pavkoviçiqit që rridhnin nga marrëveshjet dhe detyrimet e KDOM-it. Sipas Byrnes-it, Pavkoviçiqi ishte profesional dhe i drejtpërdrejtë.¹⁶⁸² Më 28 tetor 1998, gjatë një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët, Pavkoviçiqi kërkoi që t'i konfirmonin ose t'i raportonin me shkrim se verifikuesit e OSBE-së/KVM-së mund të hynin në garnizone për të numëruar armët. Në lidhje me këtë, ai tha se “duhen respektuar parimet ... e sanksionuara në Rezolutën e OKB-së”.¹⁶⁸³

688. Mirëpo, në lidhje me incidentin e Podujevës në dhjetor 1998, Aleksandar Dimitrijeviçiqi dha dëshmi e cila e vë në dyshim pretendimin e Pavkoviçiqit se veprimet e Korpusit të Prishtinës qenë kundërpërgjigje e nevojshme ndaj provokimeve të UÇK-së.¹⁶⁸⁴ Në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Dimitrijeviçiqi i raportoi Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së se cilësimi nga Armata e

8666 (18 janar 2007), Aleksandar Vasileviçiq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 52. *Shih* Radomir Gojoviçiq, T. 16706 (2 tetor 2007); 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999), f. 1–2; P1469 (paralajmërim për dorëzimin e raporteve të sakta dhe të konfirmuara, 25 mars 1999).

¹⁶⁸⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 876.

¹⁶⁸¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçiqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 123.

¹⁶⁸² Shaun Byrnes, T. 12143, 12198 (16 prill 2007).

¹⁶⁸³ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 161.

¹⁶⁸⁴ Aleksandar Dimitrijeviçiq, T. 26627 (8 korrik 2008), T. 26653 (8 korrik 2008).

Tretë dhe Korpusi i Prishtinës i të gjitha operacioneve të UJ-së në Kosovë si reagime mbrojtëse ishte çorientues.¹⁶⁸⁵ Dimitrijeviqi shpjegonte se ishte shqetësuar nga fakti se të gjitha raportet pohonin se njësitë kishin vepruar vetëm në kundërpërgjigje ndaj sulmeve të UÇK-së, kur e dinin se shumë aksione qenë planifikuar paraprakisht nga UJ-ja.¹⁶⁸⁶ Gjatë muajve të tij të fundit në UJ, përpara se ta largonin nga posti i tij më 23 mars 1999, ai mendonte se ky problem ende ekzistonte.¹⁶⁸⁷

689. Në fillim të vitit 1999, Pavkoviqi pruri një sërë njësisish në Kosovë për shtimin e forcave të UJ-së. Pavkoviqi dislokoj Brigadën e 72-të Speciale në Kosovë përpara datës 25 shkurt 1999, përkundër një udhëzimi të Ojdaniqit për ta mbajtur në brezin kufitar.¹⁶⁸⁸ Në intervistën e tij në media në vitin 2000, vetë Pavkoviqi tha se, pas Marrëveshjeve të Tetorit, UJ-ja “realizoi mobilizim shtesë në kohë, i pruri trupat e mobilizuara në Kosovë në fshehtësinë më të madhe, shpërndau rezervat e luftës dhe i bllokoi këto forcat (UÇK-në) ndërsa këto të fundit nuk ishin fare në dijeni. Shenja për bllokadën totale ishte raketa e parë që u hodh”.¹⁶⁸⁹ Pavkoviqi shtoi se kjo ishte kundërpërgjigje ndaj aktiviteteve të KVM-së, që sipas tij, ndihmonte UÇK-në.¹⁶⁹⁰

690. Njësitë shtesë të ardhura në Kosovë përbënin shkelje të kufizimeve të vendosura në bazë të Marrëveshjeve të Tetorit, sikurse është përmendur në Pjesën VI.D. Urdhri për dislokimin e Brigadës së 72-të Speciale në brendësi të Kosovës binte në sy duke qenë se ishte në kundërshtim me urdhrat e Ojdaniqit për mbajtjen e njësisë në kufi. Mirëpo Mbrojtja e Pavkoviqit argumenton se, edhe pse dislokimi i njësisë shtesë të UJ-së konsiderohej si shkelje e Marrëveshjeve të Tetorit, kjo ishte thjesht përgjigje ndaj kërcënimit të një sulmi nga NATO-ja dhe rritjes së ndjeshme të aktivitetit të UÇK-së në fund të muajit mars 1999 pas largimit të misionit të KVM-së.¹⁶⁹¹ Dhoma arrin në përfundimin se njësitë e Korpusit të Prishtinës nën kontrollin e Pavkoviqit u angazhuan në

¹⁶⁸⁵ P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14; P933 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 15; P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627, 26653 (8 korrik 2008).

¹⁶⁸⁶ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627, 26654 (8 korrik 2008). *Shih edhe* P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 18 mars 1999), f. 21.

¹⁶⁸⁷ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26654 (8 korrik 2008).

¹⁶⁸⁸ P941 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 16, 24; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26708 (9 korrik 2008); P1948 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për ndërrim varësie, 19 shkurt 1999); Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 54, 65, T. 17656–17657 (26 tetor 2007).

¹⁶⁸⁹ P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit ndaj pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17; P912 (Video e titulluar “JNA-Srpska Verzija Sloma” nga organizata “Helsinki Human Rights Watch” e Serbisë, 1 janar 2004).

¹⁶⁹⁰ P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit ndaj pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17; P912 (Video e titulluar “JNA-Srpska Verzija Sloma” nga organizata “Helsinki Human Rights Watch” e Serbisë, 1 janar 2004); 3D1048 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së Tretë, 2 mars 1999).

¹⁶⁹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 105, 109, 119; Vladimir Llazareviq, T. 17944 (8 nëntor 2007); Kërsman Jelliq, T. 18846 (22 nëntor 2007).

aksion provokues në Podujevë. Për më tepër, Pavkoviqi dislokoi trupa shtesë në Kosovë, pa informuar KVM-së, në mënyrë që të ishte në gjendje të angazhohej në operacione të gjithandeshme në Kosovë në muajin mars 1999. Për pasojë, Pavkoviqi i shkeli Marrëveshjet e Tetorit. Ky përfundim nuk komprometohet nga fakti se një prej qëllimeve të deklaruara të dislokimit të këtyre trupave dhe marrjes së këtyre masave ishte veprimi kundër kërcënimit që vinte nga UÇK-ja dhe ndërhyrja e mundshme e NATO-s.

ii. Urdhrat ushtarakë

691. Prokuroria parashtron se vijimësia nga ana e Pavkoviqit gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s në vitin 1999, e të njëjtës taktikë “të dorës së fortë” që rezultoi në shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare në vitin 1998, tregon miratimin nga ana e tij e krimeve që po kryheshin në Kosovë dhe të synimit të tij për kryerjen e tyre.¹⁶⁹² Mbrojtja e Pavkoviqit i mohon pretendimet e Prokurorisë dhe parashtron se gjatë kohës si komandant i Armatës së Tretë, ai as nuk urdhëroi, as nuk organizoi kurrë kryerjen e asnjë krimi.¹⁶⁹³

692. Sipas Ligjit për UJ-në, Komandanti i Armatës së Tretë ishte përgjegjës për komandimin e njësisve dhe institucioneve në vartësi të tij, në përputhje me dokumentet e nxjerra nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm.¹⁶⁹⁴ Pavkoviqi e konfirmoi këtë procedurë në intervistën e tij me Prokurorinë dhe tha se të gjitha veprimet ushtarake të Armatës së Tretë gjatë fushatës ajrore të NATO-s u bënë sipas urdhrave që vinin nga Ojdaniqi.¹⁶⁹⁵ Ai pretendoi gjithashtu se Armata e Tretë as nuk mori, as nuk dha urdhra për të kryer vrasjen e organizuar të civilëve, të personave të burgosur apo të kategorive të tjera të popullsisë shqiptare kosovare.¹⁶⁹⁶

693. Më 16 janar 1999, Ojdaniqi nxori një plan për mbrojtjen e vendit në rast të një sulmi nga jashtë, i njohur si plani “Grom 3”.¹⁶⁹⁷ Faza e parë e operacionit ishte marrja e masave për të penguar hyrjen e NATO-s në Kosovë dhe, në bashkërendim me MPB-në, për “bllokimin” e UÇK-në në Kosovë. Objektivi i fazës së dytë ishte “dërrmimi dhe shkatërrimi” i forcave të NATO-së dhe UÇK-së, në bashkërendim me MPB-në.¹⁶⁹⁸ Më 27 janar 1999, Pavkoviqi nxori urdhrin e Komandës së Armatës së Tretë, ku përfshihej plani “Grom 3”. Ky ishte një urdhër për angazhimin e trupave të UJ-së, me mbështetjen e forcave të MPB-së, në Kosovë në kundërpërgjigje të rrezikut

¹⁶⁹² Aktakuza, para. 50–54; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 881.

¹⁶⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 18.

¹⁶⁹⁴ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 6.

¹⁶⁹⁵ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 277–280.

¹⁶⁹⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 1, 409.

¹⁶⁹⁷ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva “Grom 3”, 16 janar 1999).

të NATO-s dhe forcave të UÇK-së.¹⁶⁹⁹ Ndër të tjera, ky urdhër u kërkonte komandantëve të njëjësive të “angazhonin popullatën e armatosur joshqiptare” për sigurimin e objekteve dhe mbrojtjen e zonave të populluara. Më 1 shkurt 1999, Pavkoviqi i dha urdhër Llazareviqit të hartonte një plan për operacionet në zonat e Drenicës, Llapit dhe Malishevës në Kosovë, në bashkëpunim me MPB-në.¹⁷⁰⁰ Në përputhje me këto urdhra, Llazareviqi përpiloi një urdhër në Korpusin e Prishtinës, i cili udhëzonte që më 20 mars 1999 të fillonin operacionet në Kosovë, si edhe 16 urdhra të Komandës së Përbashkët për përdorimin e UJ-së së bashku me MPB-në në Kosovë në mars 1999, që janë diskutuar në Pjesën VI.E.¹⁷⁰¹

694. Një urdhër i nxjerrë nga Pavkoviqi më 23 mars 1999 udhëzonte që UJ-ja të angazhohej menjëherë kundër të gjitha forcave armike. Më tej, në të thuhej se, në vendet apo sektorët ku qe konstatuar prania e UÇK-së, njësitë duhej të krijonin një mburojë parandaluese në mënyrë që të parandalonin sulmet mbi komandat dhe njësitë e Armatës së Tretë, të përqendroheshin në vendet me “popullsi besnike” dhe të parandalonin koordinimin midis sulmeve të UÇK-së dhe goditjeve ajrore të NATO-s.¹⁷⁰² Po kështu, më 23 mars 1999, në përgjigje të një kërkesë të Pavkoviqit,¹⁷⁰³ Ojdaniqi dha urdhër për mobilizimin e detashmenteve territoriale-ushtarake në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren.¹⁷⁰⁴ Këtyre detashmenteve territoriale iu ngarkua detyra parësore e sigurimit të rrugëve, por, herë pas here u angazhuan edhe në operacione luftimi.¹⁷⁰⁵ Një tjetër urdhër i lëshuar nga Pavkoviqi më 26 mars kërkonte që komandantët e njëjësive të UJ-së të vazhdonin operacione luftimi për “dërrmimin dhe shkatërrimin” e UÇK-së, të “siguronin mbajtjen e pikave dhe territorit të favorshëm” dhe të “bënin përgatitje të plota dhe intensive për mbrojtjen [e territorit] dhe [për] parandalimin e depërtimit të forcave të armikut në [Kosovë]”.¹⁷⁰⁶

695. Gjithashtu, në këtë kohë, përmes urdhrave të dhënë në emër të Komandës së Përbashkët, u kryen një sërë operacionesh të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së, të cilët përkonin me periudhat kohore dhe vendet e krimeve për të cilët është vërtetuar se janë kryer nga forcat e UJ-së dhe/ose MPB-së.¹⁷⁰⁷ Për shembull, më 28 mars 1999, njësitë e Korpusit të Prishtinës, përfshirë Brigadën e

¹⁶⁹⁸ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva “Grom 3”, 16 janar 1999), f. 4; Vladimir Llazareviq, T. 17894 (8 nëntor 2007).

¹⁶⁹⁹ 5D245 (Urdhër “Grom 3” i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), f. 5.

¹⁷⁰⁰ 5D249 (Urdhër i Armatës së Tretë, 1 shkurt 1999), f. 2.

¹⁷⁰¹ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999); Vladimir Llazareviq, T. 17894 (8 nëntor 2007).

¹⁷⁰² 4D103 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, 23 mars 1999), para. 1.6; Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 38.

¹⁷⁰³ P1924 (Kërkesë nga Pavkoviqi për mobilizim, 23 mars 1999).

¹⁷⁰⁴ P1925 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 mars 1999).

¹⁷⁰⁵ Millosh Mandiq, T. 20946 (24 janar 2008); 5D1074 (Raport luftimi i Komandës së Qarkut Ushtarak, 15 prill 1999).

¹⁷⁰⁶ 4D133 (Urdhër i Armatës së Tretë për marrjen e masave për operacionet e ardhshme, 26 mars 1999), para. 3.

¹⁷⁰⁷ *Shih, p.sh.*, P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999); P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të

549-të të Motorizuar, morën urdhër të jepnin mbështetje për operacionet e MPB-së për shkatërrimin e UÇK-së në zonën e Malishevës.¹⁷⁰⁸ Gjatë ditëve në vijim, njësi të ndryshme të UJ-së të cilat përmendeshin në urdhër konfirmuan marrjen dhe zbatimin e këtij urdhri.¹⁷⁰⁹ Më 30 mars, Komanda e Armatës së Tretë i dërgoi një telegram Shtabit të Komandës së Lartë, ku thuhej se kishte nisur operacionet në zonën e Malishevës, më konkretisht në fshatin Arlat, fshatin Gillarevë, fshatin Volljakë, zonat e Rahovecit, Suharekës, fshatit Duhël dhe fshatit Ngucat.¹⁷¹⁰

696. Sikurse është diskutuar me më shumë hollësi më lart, K90, i cili ishte anëtar i Brigadës së 549-të të Motorizuar, dëshmoi se shpërngulja e fshatarëve nuk urdhërohej me shkrim, por me gojë. Ai dëshmoi se, në përputhje me urdhrat e tij, ai u drejtohej në serbisht fshatarëve dhe u thoshte të shkonin në drejtim të qytetit të Gjakovës dhe fshatrave përreth saj.¹⁷¹¹ Urdhrrat që merrte njësia e tij për dëbimin e njerëzve nuk ishin asnjëherë me shkrim, por kaloheshin me gojë.¹⁷¹² Për më tepër, këto urdhra kishin të bënin gjithmonë vetëm me fshatrat shqiptare kosovare. Edhe pse përbënte përjashtim që komandantët vendorë të urdhëronin zhvendosjen e fshatarëve për t'i mbrojtur, rast në të cilin urdhri jepej me shkrim, sipas mendimit të K90-s nuk kishte asnjë arsye legjitime ushtarake për zhvendosjen e civilëve.¹⁷¹³

697. Në prill 1999, u hartua një plan tjetër i gjerë për përdorimin e UJ-së në Kosovë. Më 6 prill, Komanda e Korpusit të Prishtinës nxori një urdhër për vënien në zbatim të “Grom 4”. Tri ditë më vonë, Shtabi i Komandës së Lartë nxori versionin e tij të direktivës “Grom 4” “për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen nga agresioni i NATO-s” dhe, më pas, më 10 prill 1999, Komanda e Armatës së Tretë nxori urdhrin e saj për “Grom 4”.¹⁷¹⁴ Në mes të muajit prill 1999, në përputhje me urdhrat e Komandës së Përbashkët, u kryen disa operacione të përbashkëta në zonën e Kosmaçit,¹⁷¹⁵ sektorin

Motorizuar, 29 mars 1999); P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

¹⁷⁰⁸ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 7–8.

¹⁷⁰⁹ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999); P2035 (Raport Luftimi i Komandës së Brigadës së 125-të të Motorizuar, 30 mars 1999); P2802 (Ditar lufte i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar); P2047 (Raport i Operacioneve i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 29 mars 1999).

¹⁷¹⁰ P1446 (Dokument i Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999). *Shih edhe* 4D307 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë i Pavkoviçit dërguar Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999).

¹⁷¹¹ K90, T. 9302 (29 janar 2007).

¹⁷¹² K90, P2652 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 8 dhjetor 2002), para. 41; K90, T. 9303 (29 janar 2007).

¹⁷¹³ K90, P2652 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 8 dhjetor 2002), para. 41.

¹⁷¹⁴ P1481 (Direktivë e Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999); 4D308 (Urdhër i Armatës së Tretë për mbrojtjen nga NATO-ja, 10 prill 1999); 5D175 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1999). *Shih edhe* P1480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë për përgatitjen e planeve për mbrojtje, 9 prill 1999).

¹⁷¹⁵ P1970 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 9 prill 1999).

e Zhegocit,¹⁷¹⁶ e Drenicës,¹⁷¹⁷ Orllan-Zllashit,¹⁷¹⁸ Çiçavicës,¹⁷¹⁹ Jezercës,¹⁷²⁰ Rugovës,¹⁷²¹ zonën Bajgorë-Barë¹⁷²² dhe sektorin Zatriq.¹⁷²³

698. Bazuar në sa më sipër, Dhoma arrin në përfundimin se si komandant i Armatës së Tretë, Pavkoviqi, i urdhëroi njësitë e UJ-së të angazhoheshin në operacione brenda Kosovës, përmes hierarkisë së rregullt të komandimit dhe përmes Komandës së Përbashkët, çka në disa raste përkoi me kohën dhe vendin e krimeve të kryera nga forcat e UJ-së.

iii. Deklarata në kazermën “Kosovski Junaci”

699. Dëshmi e drejtpërdrejtë, ofruar nga Prokuroria lidhur me synimin e Pavkoviqit për kryerjen e krimeve të pretenduara në Aktakuzë, është një deklaratë që i vishet Pavkoviqit nga K73, anëtar i UJ-së i dislokuar në Kosovë, i cili dëshmoi se Pavkoviqi dhe Llazareviqi e vizituan kazermën “Kosovski Junaci” në Prishtinë, dikur nga muaji shkurt ose mars 1999. Gjatë vizitës në kazermë, Pavkoviqi iu drejtua anëtarëve të UJ-së dhe u tha se me të rënë bomba e parë në Kosovë, ata do të duhej “të na heqin qafe shqiptarët”. Mirëpo, K73-shi pranoi se nuk ishte i sigurt nëse kjo do të thoshte të hiqnin qafe popullsinë shqiptare kosovare apo forcat e UÇK-së.¹⁷²⁴

700. Mbrojtja e Pavkoviqit pyeti Sasha Antiqin, komandant në Batalionin e 52-të të Policisë Ushtrake të UJ-së, në lidhje me videon ku shfaqej Pavkoviqi gjatë një vizite në kazermën “Kosovski Junaci” më 18 mars 1999.¹⁷²⁵ Antiqi tha se ai qe i pranishëm gjatë kësaj vizite të Pavkoviqit dhe se nuk e kishte dëgjuar asnjëherë Pavkoviqin të thoshte ndonjë gjë të tillë si “na duhet t’i heqim qafe shqiptarët” atë ditë apo në ndonjë vizitë tjetër të mëparshme.¹⁷²⁶ Dhoma vëren se, ndërkohë që K73-shi foli për një fjalim në një sallë me shumë oficerë të pranishëm, videoja që

¹⁷¹⁶ P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999).

¹⁷¹⁷ P1972 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

¹⁷¹⁸ P1973 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

¹⁷¹⁹ P1974 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D1023 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 19 prill 1999).

¹⁷²⁰ P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

¹⁷²¹ P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D194 (Informacion i Komandës së Korpusit të Prishtinës për Komandën e Armatës së Tretë, 15 prill 1999); 5D1411 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999); P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999).

¹⁷²² P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P2619 (Pjesë nga Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 10, 13–15; P2572 (Ditar Luftë i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 57, 61–62; 5D220 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 1 maj 1999); P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

¹⁷²³ P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

¹⁷²⁴ K73, P2440 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 dhjetor 2005), para. 34; T. 3317–3319 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), T. 3403 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷²⁵ 4D18 (Intervistë e Nebojsa Pavkoviqit, Prishtinë, 18 mars 1999); Momir Stojanoviqi konfirmoi se kjo video paraqet fjalimin e mbajtur nga Pavkoviqi. Momir Stojanoviqi, T. 19822–19823 (7 dhjetor 2007).

lidhet me dëshminë e Antiqit dhe me atë të Stojanoviçit tregon një pamje në mjedis të hapur, ku ka të pranishëm vetëm disa anëtarë të UJ-së.¹⁷²⁷

701. Duke marrë parasysh pasigurinë e K73-it lidhur me kuptimin e kësaj deklarate, Dhoma nuk është e gatshme të mbështetet në të në lidhje me synimin kriminal të Pavkoviçit.

iv. Kontaktet me Millosheviçin dhe pjesëmarrja në Komandën e Përbashkët në vitin 1999

702. Prokuroria pretendon se gjatë vitit 1999, Pavkoviçiqi e ruajti ndikimin e tij mbi ngjarjet në Kosovë dhe vijoi pjesëmarrjen e tij në Komandën e Përbashkët.¹⁷²⁸ Mbrojtja e Pavkoviçit parashtron se Komanda e Përbashkët ishte thjesht një organ bashkërendues.¹⁷²⁹ Mbrojtja e Pavkoviçit pretendon se përmendja e togfjalëshit “Komandë e Përbashkët” në 1999 është gabim dhe karakteristikat e pazakonta të urdhrave dhe vendimeve të Komandës së Përbashkët të nxjerra në vitin 1999 e komprometojnë besueshmërinë e këtij emërtimi. Mbrojtja argumenton edhe se ato pak kontakte që Pavkoviçiqi pati me Millosheviçin në vitin 1999 nuk kishin të bënin me kryerjen e krimeve në Kosovë.¹⁷³⁰

703. Vetë Pavkoviçiqi konfirmoi se ka marrë pjesë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët në vitin 1998, por se Komanda e Përbashkët praktikisht pushoi së ekzistuari përpara fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s.¹⁷³¹ Në Pjesën VI.E, në lidhje me funksionimin e Komandës së Përbashkët, Dhoma ka arritur në përfundimin se ekzistenca e Komandës së Përbashkët gjatë periudhës së Aktakuzës është më pak e dukshme se në vitin 1998, megjithëse në vitin 1999 u lëshuan urdhra në emër të Komandës së Përbashkët për operacione të bashkërenduara të UJ-së dhe MPB-së.

704. Pasi u bë komandant i Armatës së Tretë në janar 1999, kompetencat e Pavkoviçiqit u zgjeruan përtej Kosovës. Mirëpo, ka prova se pjesëmarrja e Pavkoviçiqit në Komandën e Përbashkët vazhdoi gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s në vitin 1999. Më 27 janar 1999, Pavkoviçiqi dha urdhër për përdorimin e UJ-së dhe “popullatës së armatosur joshqiptare” në Kosovë në planin “Grom 3”.¹⁷³² Më pas, më 23 mars 1999, ai dha urdhër që njësitë të angazhoheshin menjëherë kundër të gjitha forcave armike, sidomos kundër “grupeve apo njësive terroriste shqiptare”.¹⁷³³ Këto urdhra

¹⁷²⁶ Sasha Antiq, T. 21150–21152 (28 janar 2008).

¹⁷²⁷ 4D18 (Intervistë e Nebojsa Pavkoviçiqit, Prishtinë, 18 mars 1999).

¹⁷²⁸ Aktakuza, para. 50–54; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 866.

¹⁷²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçiqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 243.

¹⁷³⁰ Dosje Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçiqit, 28 korrik 2008, (version publik), para. 263; P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçiqit me Prokurorinë), f. 2, 201, 244, 282, 299.

¹⁷³¹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçiqit me Prokurorinë), f. 96–97, 113, 116–117, 321–322.

¹⁷³² 5D245 (Urdhër “Grom 3” i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), f. 5.

¹⁷³³ 4D103 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë për Mbrojtjen nga sulmet e NATO-s, 23 mars 1999), para. 1.6; Lubisha Stojimiroviç, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 38.

përbënin bazën për urdhrat e Komandës së Përbashkët për UJ-në dhe MPB-në për t'u angazhuar në operacione të përbashkëta të gjithandejme në fund të muajit mars 1999, sikurse është diskutuar më lart.

705. Dhoma ka dëgjuar dëshmi për rrethanat që lidhen me hartimin e një dokumenti të nxjerrë më 17 prill 1999 nga Ojdaniqi, drejtuar Komandës së Armatës së Tretë dhe i cili përmban një varg “sugjerimesh” lidhur me përgatitjet e plota dhe dislokimin e forcave, sipas urdhrat të Komandës së Përbashkët të datës 15 prill 1999.¹⁷³⁴ Gjorgje Qurçini dëshmoi se ai e transkriptoi këtë dokument dhe shtoi se sugjerimet qenë shkruar me ngut nga Ojdaniqi në bazë të një harte të treguar Pavkoviçi, e cila pasqyronte situatën në zonën e madhe të Rogovës në Kosovën Perëndimore pranë Pejës.¹⁷³⁵ Qurçini më tej dëshmoi se Pavkoviçi erdhi të takohej me Ojdaniqin pas takimit me Millosheviqin, duke e anashkaluar në këtë mënyrë eprorin e drejtpërdrejt të tij.¹⁷³⁶ Vihet re se këto sugjerime që lidhen me urdhrin e Komandës së Përbashkët të paraqitura nga Pavkoviçi qenë hartuar në mënyrë të tillë që ti përcillnin Pavkoviçit mesazhin që “të mendonte për mundësinë e përdorimit të forcave...” përkundër faktit se zyrtarisht kompetencën për t'i dhënë urdhra Komandës së Armatës së Tretë e kishte Ojdaniqi, si shef i Shtabit të Përgjithshëm.¹⁷³⁷

706. Dijenia dhe mbështetja e vazhdueshme e Pavkoviçit për Komandën e Përbashkët dëshmohej edhe nga letra që i dërgoi shefit të Shtabit të Komandës së Lartë më 25 maj 1999. Në letër ai vërente se kishte pasur një urdhër për kalimin zyrtar të MPB-së në vartësinë e UJ-së në të gjithë Kosovën dhe kërkonte që “Komanda e Lartë” ose ta vinte në zbatim urdhrin për vënien në vartësi, ose ta shfuqizonte urdhrin dhe ta linte komandimin e njërive të MPB-së në duar të Ministrisë së Brendshme “përmes Komandës së Përbashkët, siç është vepruar deri tani.”¹⁷³⁸

707. Vasileviçi dëshmoi se Pavkoviçi e kishte thirrur në mbledhjen e një grupi të quajtur “Komanda e Përbashkët”, zhvilluar më 1 qershor 1999 në bodrumin e Hotelit “Grand” në Prishtinë. Në të u mbajtën prezantime nga Llukiqi, Llazareviçi dhe Pavkoviçi, ku përfshiheshin hollësi teknike për aktivitetet e UJ-së dhe MPB-së. Të pranishmëve iu drejtua edhe Shainoviçi, duke thënë se ishte dakord që gjërat të bëheshin sikurse ishin planifikuar nga gjeneralët e UJ-së dhe MPB-së. Vasileviçi pati përshtypjen se kjo ishte një mbledhje e përditshme, duke qenë se diskutimet u

¹⁷³⁴ 4D420 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999); Gjorgje Qurçin, T. 16966–16968 (5 tetor 2007).

¹⁷³⁵ Gjorgje Qurçin, T. 16966–16969 (5 tetor 2007).

¹⁷³⁶ Gjorgje Qurçin, T. 17025–17027 (16 tetor 2007).

¹⁷³⁷ 4D420 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999).

¹⁷³⁸ P1459 (Raport i Armatës së Tretë mbi moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999). Kundërshtimet lidhur me vërtetësinë dhe marrjen e kësaj letrë nga Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë i UJ-së diskutohen më poshtë.

kufizuan në ngjarjet e 24 orëve të fundit.¹⁷³⁹ Zoran Angjelkoviqi dëshmoi se ai ishte në të njëjtën mbledhje.¹⁷⁴⁰ Llazareviqi konfirmoi se mori pjesë në mbledhje dhe, ndër të tjerë, të pranishëm qenë edhe Vasileviqi, Pavkoviqi, Gajiqi dhe Stojanoviqi nga UJ-ja, së bashku me zyrtarët shtetërorë Angjelkoviqin dhe Shainoviqin.¹⁷⁴¹ Stojanoviqi dha një version i cili përputhet me këtë, duke dëshmuar se në qershor 1999 ai mori pjesë në një mbledhje në Hotelin “Grand” me Vasileviqin, me ftesën e Pavkoviqit.¹⁷⁴² Të pranishëm në mbledhje qenë edhe Angjelkoviqi, Kovaçeviqi, Llazareviqi, Llukiqi, Shainoviqi dhe Villotiçi.¹⁷⁴³

708. Vasileviqi dëshmoi se ai mendonte se në vitin 1999 Pavkoviqi shpesh e anashkaloi hierarkinë komanduese, duke shkuar drejtpërdrejtë te Millosheviqi dhe Shainoviqi, pa dijeninë apo lejen e Ojdaniqit.¹⁷⁴⁴ Ai tregoi për përvojën e tij lidhur me këtë anashkalim, duke thënë se kur në mes të qershorit 1999, Vasileviqi dhe Ojdaniqi shkuan të takoheshin me Millosheviqin në Beli Dvor në Beograd, ata panë Pavkoviqin duke dalë nga ndërtesa. Sipas Vasileviqit, vetë Ojdaniqi i tha se Pavkoviqi takohej privatisht me Millosheviqin pa dijeninë e Ojdaniqit dhe nuk i raportonte atij si oficer epror që ishte.¹⁷⁴⁵ Ojdaniqi iu ankua Millosheviqit, i cili iu përgjigj se nuk ishte takim zyrtar.¹⁷⁴⁶

709. Nga ana tjetër, në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviqi tha se, pasi u emërua komandant i Armatës së Tretë, Ojdaniqi e shoqëronte gjithmonë në mbledhjet me Millosheviqin.¹⁷⁴⁷ Ai përmendi një mbledhje me Millosheviqin më 5 janar 1999, por nuk dha hollësi të tjera.¹⁷⁴⁸ Pavkoviqi tha se Millosheviqi i telefonoi në fillim të bombardimit të NATO-s dhe i urdhëroi atë dhe Llazareviqin ta evitonin sa më shumë Kosovën në mënyrë që të mos kishin telashe. Pavkoviqi tha gjithashtu se i telefonoi dy herë Millosheviqit gjatë “armëpushimit” për ta informuar lidhur me problemet e furnizimeve me ushtrinë dhe për një incident pas bombardimit të NATO-s, në të cilin

¹⁷³⁹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 80–82; T. 8784–8785 (22 janar 2007), T. 8954 (23 janar 2007); 2D387 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2007), para. 4.

¹⁷⁴⁰ Zoran Angjelkoviq, T. 14663 (30 gusht 2007).

¹⁷⁴¹ Vladimir Llazareviq, T. 18122–18123 (12 nëntor 2007).

¹⁷⁴² Momir Stojanoviq, T. 19773 (7 dhjetor 2007).

¹⁷⁴³ Momir Stojanoviq, T. 19774 (7 dhjetor 2007).

¹⁷⁴⁴ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 19; T. 8669 (18 janar 2007).

¹⁷⁴⁵ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 20; T. 8670 (18 janar 2007), T. 8932 (23 janar 2007).

¹⁷⁴⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 20.

¹⁷⁴⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 11–12, 123.

¹⁷⁴⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 396.

KFOR-i kishte çarmatosur anëtarë të UJ-së.¹⁷⁴⁹ Ai tha se nuk kishte marrë asnjëherë urdhra me gojë nga Millosheviqi gjatë bombardimit të NATO-s.¹⁷⁵⁰

710. Lidhur me pretendimin se në vitin 1999 Pavkoviqi mori pjesë në urdhërimin e operacioneve të UJ-së në bashkërendim me forcat e MPB-së përmes Komandës së Përbashkët, dhe përmes kontakteve të tij të drejtpërdrejta me Presidentin e RFJ-së, Dhoma ka analizuar dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm dhe prova dokumentare. Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s u lëshuan një numër urdhrash të Komandës së Përbashkët të cilët përkojnë me kohën dhe vendin e kryerjes së krimeve të parashtruara në Aktakuzë, sikurse u përmend më lart. Njësitë e UJ-së u angazhuan në operacione në bazë të këtyre urdhrave dhe përmes sistemit të zakonshëm të raportimit të UJ-së, Komanda e Armatës së Tretë mori raporte për kryerjen e këtyre operacioneve, sikurse është shpjeguar me hollësi në Pjesën VI.E. Rrethanat që kanë të bëjnë me “sugjerimet” e Ojdaniqit për Komandën e Armatës së Tretë tregojnë se hierarkia komanduese e UJ-së funksiononte me një farë elasticiteti dhe se Pavkoviqi ushtronte ndikim të madh në planifikimin e operacioneve. Megjithëse pjesëmarrja e Pavkoviqit në Komandën e Përbashkët nuk është aq e dukshme sa në vitin 1998, ka prova se në vitin 1999 ai vijoi t’i mbështeste funksionimin dhe aktivitetet e saj. Për më tepër, Dhoma nuk e pranon dëshminë e Pavkoviqit se në vitin 1999, ai pati vetëm kontakt minimal me Millosheviqin,¹⁷⁵¹ duke qenë se provat e diskutuara më lart tregojnë se Pavkoviqi vijoi të punonte nga afër me Millosheviqin për çështjen e Kosovës në vitin 1999.

v. Përgjegjësia për operacionet e forcave të MPB-së

711. Prokuroria argumenton se, pas kalimit të MPB-së në varësi të UJ-së në prill 1999, Pavkoviqi u bë epror i forcave të MPB-së që vepronin në Kosovë. Në veçanti, Prokuroria pretendon se, pas kalimit në varësi, Pavkoviqi kishte komandën e drejtpërdrejtë të forcave të MPB-së deri në të njëjtat hollësi që përfshinte në urdhrat që u jepte forcave të UJ-së, përfshirë edhe urdhërimin e të akuzuarit Llukiq për të përdorur njësi konkrete në operacione përkatëse.¹⁷⁵² Nga ana e saj, Mbrojtja e Pavkoviqit argumenton, se kalimi në vartësi nuk ndodhi asnjëherë në realitet, por pati vetëm një bashkëpunim dhe bashkërendim midis UJ-së dhe MPB-së gjatë disa operacioneve në Kosovë dhe se Pavkoviqi nuk pati asnjëherë kontroll të efektshëm mbi forcat e MPB-së në Kosovë.¹⁷⁵³

¹⁷⁴⁹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 2, 203.

¹⁷⁵⁰ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 282, 299; *Shih edhe* Tomislav Milladenoviq, T. 17622 (25 tetor 2007); Lubisha Stojimiroviq, T. 17656–17662 (26 tetor 2007).

¹⁷⁵¹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 2, 203, 282, 299.

¹⁷⁵² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 845.

¹⁷⁵³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 90, 177.

712. Kjo çështje është diskutuar më lart, në Pjesën VI.E. Më 20 prill 1999 Pavkoviqi, si komandant i Armatës së Tretë, dha urdhrin për kalimin e të gjitha njësive dhe reparteve të MPB-së në vartësinë e Korpusit të Prishtinës dhe Korpusit të Nishit për realizimin e misionëve të luftimit, në përputhje me urdhrin e Presidentit të RFJ-së për ndërrimin e varësisë të datës 18 prill, dhe urdhrin për ndërrimin e varësisë të nxjerrë po atë ditë nga Ojdaniqi.¹⁷⁵⁴ Bashkëpunimi i gjerë midis forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe pas këtij viti është pranuar nga dëshmitarë të ndryshëm. Vetë Pavkoviqi tha se brenda Kosovës kishte një “bashkëpunim absolut” midis UJ-së dhe MPB-së,¹⁷⁵⁵ por se nuk ka pati kalim të MPB-së në varësi të UJ-së.¹⁷⁵⁶ Sipas tij, UJ-ja dhe MPB-ja “nuk ndërmorën operacione të përbashkëta”, por operacione “të veçanta dhe individuale” të cilat u bashkërenduan në nivel vendor nga komandantët e njësive të përfshira në to.¹⁷⁵⁷ Pavkoviqi pranoi se “në fazat e fundit u planifikuan disa operacione të përbashkëta, ku [UJ-ja] dha mbështetje logjistike” për MPB-në.¹⁷⁵⁸

713. Pavarësisht nga provat për bashkërendimin e gjerë midis MPB-së dhe UJ-së dhe urdhrave të ndryshëm të nxjerrë në zbatim të urdhrin të Presidentit të RFJ-së për kalimin e MPB-së në varësi të UJ-së në Kosovë, provat tregojnë se marrëdhënia midis UJ-së dhe MPB-së nuk u shndërruar në varësinë e njëjës ndaj tjetrës. Për këtë kanë dëshmuar disa dëshmitarë.¹⁷⁵⁹ Për shkak të faktit se kalimi i MPB-së në varësi të UJ-së nuk u bë në vitin 1999, nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorisë se Pavkoviqi kishte kontroll mbi njësitë e MPB-së të angazhuara në operacione luftimi në Kosovë.

c. Dijenia për krimet në Kosovë dhe reagimi i Pavkoviqit

714. Prokuroria argumenton se Pavkoviqi ishte në dijeni se në Kosovë po kryheshin krime dhe i vetëdijshëm për rrezikun se mund të kryheshin krime të tjera nga forcat që kishte nën kontroll, mirëpo, gjithsesi, nuk mori masa të efektshme për t’iu përgjigjur kësaj situatë.¹⁷⁶⁰ Mbrojtja e Pavkoviqit përgjigjet se dijenia e Pavkoviqit që e kufizuar, sepse ai ndodhej gjashtë nivele hierarkike larg luftimeve në terren dhe se informacioni që i shkonte ishte i komprometuar dhe

¹⁷⁵⁴ P1457 (Urdhër i Postëkomandës së Armatës së Tretë, 20 prill 1999); 3D670 (Urdhër për kalimin e forcave të MPB-së në vartësi të Ushtrisë, nga Presidenti Slllobodan Millosheviq, 18 prill 1999); P1488 (Urdhër lidhur me kalimin e njësive dhe organeve të MPB-së në vartësi të UJ-së, 18 prill 1999).

¹⁷⁵⁵ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 39.

¹⁷⁵⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 112, 222, 399–400.

¹⁷⁵⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 216–218, 352–353. Në Prilep dhe Gillogjan, Pavkoviqi tha se UJ-ja i mbështeti operacionet e MPB-së duke dhënë një tank.

¹⁷⁵⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 39, 216.

¹⁷⁵⁹ *Shih* Pjesën VI.E.

¹⁷⁶⁰ Aktakuza, para. 50–54; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 851, 884–906, 918, 920.

shpesh i paplotë.¹⁷⁶¹ Për më tepër, Mbrojtja pretendon se Pavkoviqi nuk ishte në dijeni të krimeve të kryera nga vartësit e tij në vitin 1998 dhe se, edhe sikur të dëgjonte për akuza të tilla, efektiv i UJ-së kishte ndryshuar deri në fushatën ajrore të NATO-s në vitin 1999.¹⁷⁶² Argumentohet se, në rastet kur Pavkoviqi është vënë në dijeni të kryerjes së krimeve nga vartësit e tij brenda UJ-së, ai mori masa për mundësimin e hetimeve dhe procedimit penal të autorëve në përputhje me procedurën e pranuar të drejtësisë ushtarake.¹⁷⁶³

i. Prania në Kosovë

715. Gjatë vitit 1998 dhe 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në Prishtinë në një ndërtesë rreth 500 metra nga ndërtesa e Shtabit të MPB-së.¹⁷⁶⁴ Andreja Millosavleviqi, i cili ishte koordinator i aktiviteteve të organeve shtetërore në vitin 1998, dëshmoi se, kur ishte në Prishtinë gjatë vitit 1998, jetonte në një ndërtesë ku qenë vendosur disa pjesë të Korpusit të Prishtinës dhe se në të jetonte edhe Pavkoviqi.¹⁷⁶⁵ Më 27 korrik 1998, Armata e Tretë ngriti një Postëkomandë Pararojë në Prishtinë.¹⁷⁶⁶ Pavkoviqi e vizitonte çdo ditë Postëkomandën Pararojë të Armatës së Tretë duke filluar nga fundi i muajit korrik deri në fund të muajit gusht 1998 dhe i raportonte Samarxhiqit për ngjarjet në Kosovë.¹⁷⁶⁷

716. Në intervistën me Prokurorinë, Pavkoviqi tha se me situatën në Kosovë u njoh nga raportet që merrte dhe nga prania e tij në krahinë.¹⁷⁶⁸ Ai shtoi se gjatë periudhës mars-qershor 1999, ai ishte në Kosovë më shumë se 95% të kohës sepse këtë ia kërkonte detyra si komandant i Armatës së Tretë.¹⁷⁶⁹ Llazareviqi dëshmoi se, gjatë gjithë konfliktit, “nuk kishte ditë që komandanti i Armatës të mos ndodhej në Postëkomandën Pararojë të Korpusit të Prishtinës”.¹⁷⁷⁰ Ai shtoi se kjo i jepte Pavkoviqit një “pamje nga afër” të aktiviteteve të njësisë të Korpusit të Prishtinës.¹⁷⁷¹ Millan Gjakoviqi dëshmoi se gjatë fushatës ajrore të NATO-s, kur Pavkoviqi ndodhej në Nish, ai merrte

¹⁷⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 92.

¹⁷⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 94.

¹⁷⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 268–298, 314.

¹⁷⁶⁴ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 109.

¹⁷⁶⁵ Andreja Millosavleviq, T. 14294–14296 (23 gusht 2007).

¹⁷⁶⁶ 3D697 (Dokument i Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë, “Analizë e realizimit të detyrave në Kosovë”, 2 tetor 1998), f. 2; *Shih edhe* Zharko Kostiq, T. 17524 (23 tetor 2007); Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 tetor 2007), para. 16, 21; Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007), para. 24; Tomislav Mlladenoviq, 4D505 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007), para. 8; T. 17598 (25 tetor 2007).

¹⁷⁶⁷ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 21. Nikë Peraj, P2253 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 gusht 2006), f. 5, 15; T. 1663 (15 gusht 2006).

¹⁷⁶⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 73.

¹⁷⁶⁹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 82.

¹⁷⁷⁰ Vladimir Llazareviq, T. 18080 (12 nëntor 2007); *shih edhe* Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 21, T. 7578 (30 nëntor 2006).

¹⁷⁷¹ Vladimir Llazareviq, T. 18104–18105 (12 nëntor 2007).

drejtpërdrejtë raporte nga Korpusi i Prishtinës. Kur ndodhej në Prishtinë, kishte kontakte të drejtpërdrejta me komandantin ose merrte raporte luftimi përmes postëkomandës pararojë.¹⁷⁷²

717. Mirko Starçeviqi, i cili ishte Ndhimëskomandant për Informacionin dhe Moralin për Armatën e Tretë, dëshmoi se në vitin 1999, Pavkoviçiqi dhe Llazareviçiqi vizitonin njësitë e UJ-së në vartësi gjatë gjithë orarit të punës dhe pasditeve takoheshin për të shkëmbyer pikëpamje në lidhje me zhvillimet në terren.¹⁷⁷³ K73-shi dëshmoi se Pavkoviçiqi dhe Llazareviçiqi shkuan për kontroll të trupave në Kazermën “Kosovski Junaci” në Prishtinë rreth muajit shkurt 1999.¹⁷⁷⁴ Sipas Goran Jevtoviçiqit, më 10 prill 1999, Llazareviçiqi dhe Pavkoviçiqi erdhën të inspektonin zonën e përgjegjësisë të Postëkomandës Pararojë.¹⁷⁷⁵ Millan Koturi përshkroi se më 10 prill 1999 i kishte raportuar Postëkomandës së Korpusit të Prishtinës, e cila asokohe që vendosur në një zonë pranë Prishtinës të quajtur “Gërmi” dhe se ishte takuar atje me Pavkoviçiqin, i cili e informoi për problemet në kufirin me Shqipërinë, në zonën e Koshares.¹⁷⁷⁶ Llazareviçiqi foli edhe për një mbledhje më 19 prill 1999 në Prishtinë me Pavkoviçiqin dhe Gjakoviçiqin nga UJ-ja, së bashku me Obrad Stevanoviçiqin dhe Gjorgjeviçiqin nga MPB-ja.¹⁷⁷⁷ Sikurse është diskutuar më lart, në Pjesën VII.J për komunën e Prishtinës, në fund të muajit mars dhe fillim të muajit prill, forcat e UJ-së dhe MPB-së po shpërngulnin me dhunë shqiptarët kosovarë nga qyteti i Prishtinës në mënyrë të organizuar. Rrjedhimisht, provat mbi praninë e rregullt të Pavkoviçiqit në terren në Kosovë mbështet pretendimin se ai ishte në dijeni të aktiviteteve kriminale që po ndodhnin në atë territor.

ii. Dijenia për krimet përmes raporteve dhe mbledhjeve

718. Sikurse është përmendur më lart, në vitin 1998, Pavkoviçiqi mori pjesë në diskutime për numrin e madh të civilëve të shpërngulur në Kosovë dhe ishte në dijeni të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të cilat ua ngarkonin përgjegjësinë, të paktën pjesërisht, MPB-së dhe UJ-së.¹⁷⁷⁸ Ai u informua për praktikën e djegies së shtëpive të shqiptarëve kosovarë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, nga eprori i tij Samarxhiqi, dhe, më vonë, nga Miniqi, i cili përsëriti edhe një herë se duhej ndaluar djegia e shtëpive.¹⁷⁷⁹

¹⁷⁷² Millan Gjakoviçiq, T. 26401–26403 (19 maj 2008).

¹⁷⁷³ Mirko Starçeviq, T. 17436 (22 tetor 2007).

¹⁷⁷⁴ K73, P2440 (deklaratë e dëshmitarit), para. 34; T. 3317–3318 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷⁷⁵ Goran Jevtoviçiq, T. 20354–20355 (16 janar 2008).

¹⁷⁷⁶ Millan Kotur, T. 20676–20678 (21 janar 2008).

¹⁷⁷⁷ Vladimir Llazareviçiq, T. 18260 (14 nëntor 2007).

¹⁷⁷⁸ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 36, 40, 41, 121.

¹⁷⁷⁹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 46, 52, 124–125; 4D97 (Procesverbal i mbledhjes informuese të komandantëve të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, 7 gusht 1998).

719. Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s, komunikimet brenda Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës vijuan duke mundësuar funksionimin pa ndërprerje të sistemit të komandimit të Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës.¹⁷⁸⁰ Pavkoviqi deklaroi se sistemi i komandimit i UJ-së funksionoi gjatë gjithë fushatës së NATO-s dhe se ai u njoh me situatën në Kosovë nga raportet që merrte.¹⁷⁸¹ Në atë kohë Pavkoviqi nxori urdhra të tjerë për respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare.¹⁷⁸² Ai ndryshoi edhe strukturën e gjykatave ushtarake për t'i kthyer në organe për kohë lufte, në përputhje me direktivat e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁷⁸³ Mirëpo, disa ditë pas fillimit të bombardimit nga NATO, Pavkoviqi mori informacion se anëtarët e UJ-së po kryenin krime kundër civilëve në Kosovë. Më 27 mars 1999 ai paralajmëroi Korpusin e Prishtinës dhe Komandat Territoriale-Ushtarake në lidhje me rrezikun konkret të mungesës së disiplinës në Njësitë Territoriale-Ushtarake, sidomos në lidhje me civilët shqiptarë kosovarë dhe pronat e tyre, duke theksuar se gjatë ditëve të fundit kishte pasur shtim të indisciplinimeve dhe të shkeljeve.¹⁷⁸⁴ Deri më 31 mars Pavkoviqi kishte marrë informacion që bënte të ditur se Njësitë Territoriale-Ushtarake të UJ-së dhe forcat e MPB-së po “kanalizonin” shqiptarët kosovarë të shpërngulur për në Shqipëri.¹⁷⁸⁵

720. Në intervistën e tij, Pavkoviqi tha se ishte në dijeni të faktit se shqiptarëve kosovarë të cilët po largoheshin nga vendi përmes pikës kufitare Hani i Elezit, po u merreshin dokumentet e identitetit por se ai vërtetoi se nuk ishte përfshirë asnjë efektiv i UJ-së dhe se për këtë problem i kishte dërguar një raport Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë. Ai saktësoi se UJ-ja nuk kishte kontroll mbi pikat kufitare, ku merreshin dokumentet e identitetit.¹⁷⁸⁶ Ai informoi Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë për lëvizjen e popullsisë dhe se UJ-ja nuk ishte përfshirë në largimin e civilëve nga Kosova. Me zhvillimin e konfliktit, ai kuptoi se nuk ishte

¹⁷⁸⁰ Miodrag Jankoviç, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 tetor 2007), para. 8, 12–13; 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 10–11.

¹⁷⁸¹ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 73.

¹⁷⁸² *Shih* 5D249 (Urdhër i Armatës së Tretë, 1 shkurt 1999), f. 5. 4D103 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë, 23 mars 1999); 4D407 (Raport Luftimi i Komandës së Armatës së Tretë, 5 prill 1999), f. 3, në të cilin Pavkoviçi raportonte se “për të mbajtur nën kontroll kriminalitetin dhe plaçkitjet në operacionet e luftimit, janë ngritur pika të përziera kontrolli me përbërjen e organeve të policisë ushtarake dhe civile në të gjitha rrugët me rëndësi që dalin nga [Kosova]”.

¹⁷⁸³ 4D153 (Njoftim lidhur me Nëpunësit e Gjykatave të Kohës së Luftës, 28 mars 1999); 4D160 (Urdhër drejtuar Gjykatave të Larta Ushtarake për informimin e përditshëm të Armatën e Tretë mbi veprimtaritë e tyre, 29 mars 1999).

¹⁷⁸⁴ Pavkoviçi dha urdhër që “komandat në varësi të marrin të gjitha masat e përcaktuara për të eliminuar vjedhjet, plaçkitjen dhe të gjitha format e tjera të kriminalitetit dhe sjelljes joushtarake”, përfshirë “masat disiplinore dhe të ndjekjes ligjore kundër të gjithë autorëve të shkeljeve”. Komanda e Korpusit të Prishtinës dhe Komanda e Qarkut Ushtarak të Prishtinës duhej të paraqisnin informacion për sjelljen e anëtarëve të Njësiave Territoriale Ushtarake dhe për dobinë e masave të marra, në raportet e rregullta. 4D154 (Paralajmërim i Armatës së Tretë për komandat vartëse, 27 mars 1999).

¹⁷⁸⁵ P2930 (Raport Luftimi i Grupit të Komandës së Korpusit të Prishtinës për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 2.

¹⁷⁸⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 91–92.

mirë për UJ-në që njerëzit po largoheshin nga vendi dhe, për këtë arsye i dha urdhër UJ-së të mos e lejonte këtë dukuri.¹⁷⁸⁷ Branko Kërگا dëshmoi se në fillim të prillit 1999, Pavkoviqi i telefoni dhe i tha se duheshin marrë masat organizative për veshjen, strehimin dhe ushqimin e personave të shpërngulur në Kosovë.¹⁷⁸⁸ Dhoma vëren se, përkundër këtij informacioni, Pavkoviqi vijoi t'i miratonte operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, si ai në zonën e Rugovës më 15 prill.¹⁷⁸⁹

721. Në prill 1999 Pavkoviqi pranoi sërish kryerjen e krimeve nga forcat e UJ-së dhe nxori urdhra të tjerë me shkrim në të cilët kërkohej respektimi i së drejtës humanitare ndërkombëtare.¹⁷⁹⁰ Kur mësoi për akuzat mbi ekzistencën e një kampi burgimi për “refugjatët” shqiptarë kosovarë në komunën e Istogut, Pavkoviqi dha urdhër për krijimin e një komisioni të kryesuar nga Millan Gjakoviqi, me pjesëmarrjen e punonjësve të MPB-së, për hetimin e veprimeve të organeve përgjegjëse në këtë komunë, më 13 prill 1999.¹⁷⁹¹ Komisioni u krijua dhe i raportoi të nesërmen Pavkoviqit se në Istog nuk kishte asnjë kamp për refugjatë shqiptarë kosovarë. Ishte një grup prej 544 “refugjatësh” të strehuar në një shkollë në Llukafc të Thatë dhe një grup tjetër me 221 “refugjatë” në rrethinat e Istogut. Sipas raportit, grupi i dytë ishte nisur për në Shqipëri dhe ishte diktuar gjatë rrugës nga anëtarë të JSO-së të cilët u kishin marrë sendet personale. Më pas ata u ndaluan në kufi anëtarët e UJ-së, të cilët i udhëzuan të ktheheshin në Istog.¹⁷⁹² Në lidhje me funksionimin e forcave të ndryshme të armatosura në komunë, raporti theksonte se kishte një problem me bashkërendimin dhe se kriminaliteti ishte rezultat i këtij problemi. Në të propozohej krijimi i një komisioni të përzierë me anëtarë të UJ-së, MPB-së dhe komunës vendore për të zbuluar shkaqet e “gabimeve të bëra” dhe masat e duhura që duheshin marrë.¹⁷⁹³ Kur ky raport iu tregua Momir Paniqit i cili ishte shefi i OUP-së në Istog, ai dëshmoi se një grup me 544 shqiptarë kosovarë të shpërngulur ndodhej në shkollën e Llukafcit të Thatë dhe një grup tjetër me 221 vetë në rrethinat e Istogut, ku përfshiheshin edhe disa familje të cilat ai i njihet personalisht. Ai tha se kishte folur me Gjakoviqin për personat e shpërngulur.¹⁷⁹⁴ Paniqi tha se përfundimet e raportit të

¹⁷⁸⁷ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 76–80.

¹⁷⁸⁸ Branko Kërگا, T. 16916–16917 (4 tetor 2007).

¹⁷⁸⁹ P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D194 (Informacion i Komandës së Korpusit të Prishtinës për Komandën e Armatës së Tretë, 15 prill 1999); 5D1411 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999); P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999). *Shih edhe* P1487 (Sugjerime të Shtabit të Komandës së Lartë për Armatën e Tretë, 17 prill 1999); Gjorgje Qurçin, T. 16966–16968 (5 tetor 2007).

¹⁷⁹⁰ 4D191 (Urdhër i Armatës së Tretë, 15 prill 1999); *shih edhe* Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 5; Vladimir Llazareviq, T. 18091 (12 nëntor 2007).

¹⁷⁹¹ 4D86 (Urdhër i Nebojsa Pavkoviqit për krijimin e një komisioni, 13 prill 1999), pranuar edhe me numrin P1720; Millan Gjakoviqi, T. 26403–26408 (19 maj 2008).

¹⁷⁹² P1721 (Raport i Komisionit për Istogun, 14 prill 1999).

¹⁷⁹³ P1721 (Raport i Komisionit për Istogun, 14 prill 1999), f. 2.

¹⁷⁹⁴ Momir Paniq, T. 24760–24765, 24779–24795 (2 prill 2008), 24805–24806 (3 prill 1999).

komisionit nuk qenë të sakta dhe se ai shkruar me qëllim që të tregonte se MPB-ja nuk po bashkëpunonte me urdhrat e kalimit në vartësi të UJ-së.¹⁷⁹⁵ Ai nuk kishte dëgjuar asnjë histori që ata të qenë ndaluar dhe plaçkitur nga anëtarët e JSO-së. Grupi i të shpërngulurve në rrethinat e Istogut qëndroi atje gjatë fushatës ajrore të NATO-s dhe, faktikisht u shtua dhe u bë me 250 vetë.¹⁷⁹⁶ Ai tha se, në zbatim të rekomandimit të raportit, nuk u bë asnjë hetim tjetër për aktivitetin kriminal të diskutuar në raport.¹⁷⁹⁷ Megjithëse këto ngjarje tregojnë se Pavkoviçi mund të krijonte komisione për hetim të shpejtë të pretendimeve për veprimtari kriminale, duke marrë parasysh dëshminë e Paniqit lidhur me saktësinë dhe motivin e raportit të komisionit, Dhoma nuk mbështetet në përmbajtjen e këtij raporti.

722. Gjithashtu, në prill Pavkoviçi mësoi për krimet e kryera nga vullnetarët e UJ-së.¹⁷⁹⁸ Sipas Zharko Kostiqit, i cili ishte shefi i Zyrës së Pranimit, Përzgjedhjes dhe Stërvitjes së Vullnetarëve në Armatën e Tretë, kishte rekrutë të dërguar nga Armata e Parë. Situata në Qendrën e Pranimit të Armatës së Tretë ishte më e mirë duke qenë se atje theksi vihej te disiplina dhe stërvitja e gjerë, çka ndihmonte në mundësimin e një përzgjedhjeje të duhur të vullnetarëve.¹⁷⁹⁹ Pas këtyre konstatimeve, Pavkoviçi nxori urdhra të cilët bënin fjalë për vullnetarët dhe në të cilët thuhej se ata duhej të pranoheshin vetëm nëse ekzistonte nevoja për ta dhe se duhej të nxirreshin nga Kosova nëse nuk i zbatonin urdhrat e komandantëve të tyre.¹⁸⁰⁰

723. Branko Gajiqi dëshmoi se Administrata e Sigurimit kishte mësuar për një grup të quajtur “Pauk” (“Merimanga”) në Kosovë që urdhërohej nga një person me emrin Jugosllav Petrushiç dhe se, pas hetimit përkatës u konstatua se në Brigadën e 125-të të Këmbësorisë ishte përfshirë një grup me 23 vullnetarë paraushtarakë.¹⁸⁰¹ Sipas Vasileviqit, Millosheviçi dha urdhër të arrestohej

¹⁷⁹⁵ Momir Paniq 6D1604 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 mars 2008), para. 54–55.

¹⁷⁹⁶ Momir Paniq, T. 24782–24783 (2 prill 2008).

¹⁷⁹⁷ Momir Paniq, T. 24793 (2 prill 2008).

¹⁷⁹⁸ P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 1–2. Sipas një dokumenti të tillë, nga 1.517 vullnetarë të pranuar, qenë përdorur 849; mirëpo, për shkak të kufizimit të personelit që bënin kontrollat e sigurisë, mes tyre kishte edhe disa vullnetarë me të shkuar penale. Njëzetepesë vullnetarë të angazhuar u kthyen ndërsa shtatë u arrestuan për aktivitet kriminal. Sipas raporteve, pesëdhjetë për qind e vullnetarëve në qendrat e pranimit kishin hequr dorë dhe ishin larguar për arsye të ndryshme, si për shembull “informim i dobët, veshje jo të plota [dhe] kritere të dobëta kontrolli rutinë”.

¹⁷⁹⁹ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 35–36; T. 17504–17505 (23 tetor 2007). *Shih edhe* Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 39, T. 17505 (23 tetor 2007).

¹⁸⁰⁰ 4D353 (Urdhër i Komandës së Tretë për pranimin e vullnetarëve, 6 maj 1999); 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me listën e udhëzimeve, 7 maj 1999), para. 11.

¹⁸⁰¹ Branko Gajiq, T. 15288–15290 (7 shtator 2007).

Petrushiqi dhe një person tjetër.¹⁸⁰² Ai tha se arrestimi u bë, por se prokuroria ushtarake gjykoj se nuk kishte prova të mjaftueshme për të ngritur akuza kundër tyre.¹⁸⁰³

724. Dragisha Marinkoviçit u pyet konkretisht se çfarë pa kur kishte shkuar për kontroll në Brigadën e 175-të Këmbëtorisë në mes të muajit prill 1999. Ai tha se disa ushtarë nuk “i plotësonin standardet” sepse “nuk kishin pamjen e ushtarit” dhe “nuk e mbanin veten mirë dhe në rregull”.¹⁸⁰⁴ Kur u pyet për vullnetarët, ai tha se kishte hasur në një grup në Brigadën e 175-të të Këmbëtorisë i cili përbëhej tërësisht nga vullnetarë.¹⁸⁰⁵ Pas një muaji, u raportuan probleme të ngjashme në këtë njësi.¹⁸⁰⁶

725. Pavkoviçit tha se gjatë fushatës së NATO-s ai vetë kishte liruar nga detyra tre komandantë brigadash, si edhe oficerë të tjerë për moszbatim të urdhrave, përfshirë edhe komandant Kuzmanoviçin në Gjilan, Nikolla Petroviçin e Brigadës së 175-të të Këmbëtorisë dhe Dragomir Millentijeviçin e Brigadës së 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë. Ai shtoi se ishte ndëshkuar në formë disiplinore Miodrag Jovanoviçit i Grupit të Luftimit të 252-të.¹⁸⁰⁷ Starçeviçit dëshmoi se, pas vrasjeve të civilëve, të kryera në fund të muajit mars dhe fillim të prillit 1999 në Zhegër, Gjilan,¹⁸⁰⁸ Pavkoviçit bëri që Petroviçit të lirohej nga detyra, duke qenë se kjo njësi nuk vepronte në përputhje me imazhin dhe idenë e Ushtrisë Jugosllave.¹⁸⁰⁹ Mirëpo, sipas vetë Pavkoviçit, ai i largoi këta njerëz nga detyra “kryesisht ngaqë ata nuk ndërmorën disa masa për mbrojtjen dhe maskimin e njësisë”.¹⁸¹⁰ Stojanoviçit dëshmoi se asnjë prej këtyre komandantëve nuk u ndoq penalisht, me

¹⁸⁰² Aleksandar Vasileviç, T. 8780 (22 janar 2007).

¹⁸⁰³ Aleksandar Vasileviç, T. 8780–8781 (22 janar 2007).

¹⁸⁰⁴ Dragisha Marinkoviç, T. 20148–20150 (12 dhjetor 2007).

¹⁸⁰⁵ Dragisha Marinkoviç, T. 20149 (12 dhjetor 2007).

¹⁸⁰⁶ 5D563 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-së të Këmbëtorisë për Korpusin e Prishtinës, 19 maj 1999), f. 1. Në raportin e luftimit thuhet se, edhe pse qenë përmirësuar rendi dhe disiplina, “ende kishte incidente të izoluara, largim pa leje nga njësitë, tentativa për vjedhje, uniforma të çrregullta, etj., të cilat e prishnin imazhin e njësisë”.

¹⁸⁰⁷ P949 (intervistë e Nebojshe Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 270–271, 394; *shih* edhe 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me listën e udhëzimeve, 7 maj 1999), para. 7. Pavkoviçit e quajti komandantin e Batalionit të 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë me mbiemrin Millosavleviç, por Dhoma është e bindur se Pavkoviçit e kishte fjalën për Millentijeviçin. Momir Stojanoviç, T. 19738–19740 (6 dhjetor 2007); Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 24–25.

¹⁸⁰⁸ Sipas raporteve të UJ-së, këto incidente përfshinin vrasjen e shqiptarëve kosovarë më të njëjtën ditë nga rezervistë të UJ-së të cilët vepronin në bazë të një marrëveshjeje paraprake. Një rezervist i UJ-së ishte kryesi fizik i vrasjeve, ndërsa të tjerët e shoqëronin. P954 (Raport për dosjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), f. 57–58; P955 (Shqyrtim i Përmbledhur i Raportit për dosjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 19. Kryeautorit fizik u dënua me 20 vjet burgim, ndërsa të tjerët me nga një vit “ose më shumë”. Branko Gajiç, T. 15332–15333, 15350 (11 shtator 2007); Mirko Starçeviç, T. 17442–17444 (22 tetor 2007).

¹⁸⁰⁹ Mirko Starçeviç, T. 17442–17444 (22 tetor 2007). *Shih edhe* Momir Stojanoviç, T. 19794–19795 (7 dhjetor 2007); 3D721 (Seancë informuese e Shtabit të Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 5; Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 24; *shih edhe* 4D174 (Raport për sjelljet e parregullta të pretenduara të Brigadës së 175-të, 27 prill 1999); Branko Gajiç, T. 15333 (11 shtator 2007).

¹⁸¹⁰ P949 (intervistë e Nebojshe Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 270–272, 394–395. Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 24; 4D175 (Brigada e 175-të e Këmbëtorisë Petroviç për Korpusin e Prishtinës, 28 prill 1999).

përrjashtim të Millentijeveqit, i cili u ndoq penalisht për mosmarrje të masave mbrojtëse me pasojë vdekjen e një anëtarit të njësisë.¹⁸¹¹

726. Më 17 prill 1999, Pavkoviqi nxori një paralajmërim që “të zbatohen të gjitha dispozitat e së drejtës ndërkombëtare të luftës”.¹⁸¹² Në këtë urdhër, ai theksonte se disa individë nuk i kishin respektuar tërësisht dispozitat e “Udhëzimit për sjelljen në luftim apo ato të së Drejtës Ndërkombëtare të Luftës” dhe se “disa komanda dhe njësi nuk i kishin kushtuar vëmendjen e nevojshme uljes së numrit të incidenteve të lidhura me plaçkitjen dhe krimin”.¹⁸¹³ Të nesërmen Dega e Sigurimit e Armatës së Tretë raportoi se katër anëtarë të UJ-së kishin përdhunuar dy gra shqiptare kosovare në Gjakovë.¹⁸¹⁴

727. Më 19 prill, Pavkoviqi nxori një urdhër për komandat në vartësi të Armatës së Tretë për t’u kujdesur për civilët e shpërngulur, për të gjetur fshatra të përshtatshme për t’i strehuar ata jashtë zonës së operacioneve të luftimit ose për t’i kthyer në fshatrat e tyre.¹⁸¹⁵ Në urdhër u bëhej thirrje komandave të parandalonin plaçkitjen e zotërimeve personale të civilëve apo djegien e shtëpive të tyre dhe t’i jepnin Armatës së Tretë informacion lidhur me vendndodhjen e të shpërngulurve.¹⁸¹⁶ Lidhur me këto urdhra dhe me provat që kanë të bëjnë me dijeninë e Pavkoviqit mbi marrjen e dokumenteve identifikuese të shqiptarëve kosovarë të shpërngulur në kufi, Dhoma vëren se K90-a dëshmoi se në disa raste shqiptarë kosovarë nuk u shpërngulën nga zonat në të cilat vepronte UJ-ja duke qenë se kjo do ta linte UJ-në pa mbrojtjen e civilëve përreth saj, duke e nxjerrë kështu të zbuluar ndaj sulmeve të NATO-s.¹⁸¹⁷ Vetë Pavkoviqi tha se i kishte raportuar Shtabit të Komandës së Lartë një numër të madh të shpërngulurish në Kosovë dhe se kishte propozuar marrjen e masave për parandalimin e shpërnguljes duke qenë se nuk ishte një gjë e dëshirueshme që të largohej popullsia civile nga Kosova dhe atje të mbetej vetëm UJ-ja.¹⁸¹⁸ Për më tepër, përkundër urdhrin të datës 19 prill, Pavkoviqi vijoi miratimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në

¹⁸¹¹ Momir Stojanoviç, T. 19736–19740 (6 dhjetor 2007).

¹⁸¹² P1011 (Ivan Markoviç, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 80–81, 90.

¹⁸¹³ P1454 (Paralajmërim nga Komandanti i Armatës së Tretë kundër shkeljeve apo moszbatimit të ligjeve ose zakoneve ndërkombëtare të luftës, 17 prill 1999), f. 1. *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviç, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 60–61.

¹⁸¹⁴ 4D513 (Raport Sigurie i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 18 prill 1999), f. 1.

¹⁸¹⁵ P1766 (Urdhër i Armatës së Tretë për strehimin dhe ndihmën për “refugjatët”, 19 prill 1999), pranuar në provat gjyqësore edhe me numrin 4D350

¹⁸¹⁶ P1766 (Urdhër i Armatës së Tretë për strehimin dhe ndihmën për “refugjatët”, 19 prill 1999), pranuar në provat gjyqësore edhe me numrin 4D350; *shih edhe* 5D1101 (Urdhër i Brigadës së 52-të të Motorizuar, 22 prill 1999).

¹⁸¹⁷ K90, T. 9408 (30 janar 2007). *Shih edhe* Momir Stojanoviç, T. 19732 (6 dhjetor 2007); Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 4.

¹⁸¹⁸ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 1, 77–78.

Kosovë,¹⁸¹⁹ dhe njësitë e UJ-së vijuan angazhimin në lëvizje të mëdha të personave të shpërngulur për të dalë nga Kosova, si për shembull gjatë operacioneve në luginën e Caragojt në Gjakovë më 27 dhe 28 prill 1999 dhe në Lisnajë në komunën e Kaçanikut më 25 maj 1999, sikurse është përshkruar, përkatësisht, në Pjesët VII.C dhe VII.M.

728. Mbrojtja e Pavkoviçit citon raporte të shumta nga Korpusi i Prishtinës drejtuar Komandës së Armatës së Tretë, gjatë periudhës 3 prill-12 maj 1999, në mbështetje të pretendimit se gjatë asaj kohe ishte në funksionim një sistem i duhur raportimi dhe se Llazareviçi e siguroi Pavkoviçin se ato pak krime të kryera nga forcat e UJ-së po procedoheshin si duhej.¹⁸²⁰ Konkretisht, në një raport të Komandës së Korpusit të Prishtinës drejtuar Komandës së Armatës së Tretë, i cili mban datën 3 prill 1999, theksohej se qenë marrë “masa ligjore” kundër anëtarëve të UJ-së që kishin kryer krime.¹⁸²¹ Korpusi i Prishtinës nxori raporte të ngjashme më 4 prill, 13 prill, 14 prill, 25 prill, 9 maj dhe 12 maj 1999.¹⁸²²

729. Raportet nga Komanda e Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë në fillim të muajit prill 1999 bëjnë të ditur se qenë filluar shumë procese penale dhe disiplinore për krimet kundër UJ-së, por në to nuk përmendet asnjë hetim konkret i krimeve të luftës apo i krimeve të

¹⁸¹⁹ *Shih edhe* P1459 (Raport i Armatës së Tretë mbi moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999), f. 2 (ku kërkohet ose kalimi në vartësi i MPB-së ose vazhdimi i funksionimit të Komandës së Përbashkët për bashkërendimin e operacioneve të përbashkëta).

¹⁸²⁰ *Shih* 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999); 5D85 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999); P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999); P2004 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 13 prill 1999); 4D172 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 14 prill 1999); P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999); P2006 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 9 maj 1999); P2007 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 12 maj 1999).

¹⁸²¹ Në raport thuhet, më tej, se një ditë më parë, qenë dorëzuar 32 kallëzime penale kundër autorëve të krimeve (tetë për vrasje, një për keqtrajtim, tre për tentativë për vrasje, dy për marrje automjeti, gjashtë për vjedhje dhe 12 për braktisje të qëllimshme). 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2.

¹⁸²² Raporti i luftimit i datës 4 prill të cilin Llazareviçi ia dërgonte Komandës së Armatës së Tretë thotë se një ditë më parë qenë depozituar gjashtë kallëzime penale kundër dy ushtarëve, tre rekrutëve dhe një ushtari me pagesë, megjithëse në të nuk thuhet se për çfarë qenë bërë këto kallëzime. P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999), f. 2. Raporti i datës 13 prill thotë se një ditë më parë tetë kallëzime penale i qenë dërguar gjykatësit hetues të gjykatës ushtarake në Prishtinë. P2004 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 13 prill 1999), f. 3. Raporti i datës 14 prill thotë se gjatë 24 orëve të fundit organet e sigurimit dhe Policia Ushtarake dorëzuan tetë kallëzime penale për aktivitet kriminal, dy kundër “terroristëve shqiptarë” për terrorizëm dhe vrasje të shumëfishta, dy kundër nënoficerëve për përvetësim automjetesh dhe tre kundër ushtarëve për vjedhje. 4D172 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 14 prill 1999), f. 3. Në raportin e tij të datës 25 prill, Llazareviçi vërente se “kishte raste krimesh” dhe se organet e sigurimit janë përfshirë në përpjekjet për “të hedhur dritë mbi to”. P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999), f. 2. Në raportin e tij të datës 9 maj, Llazareviçi nuk përmend asnjë krim, por thotë se popullsia vendase po trajtohej “me korrektesë dhe njerëzi” nga forcat e UJ-së. P2006 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 9 maj 1999), f. 4. Së fundi, as në raportin e datës 12 maj nuk përmendet ndonjë proces penal apo sjellje kriminale nga ana e trupave të UJ-së. P2007 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 12 maj 1999).

rënda e të dhunshme.¹⁸²³ Për më tepër, raporti i luftimit i Armatës së Tretë i datës 31 mars 1999 bënte të ditur se prokuroria ushtarake e Armatës së Tretë kishte marrë 62 kallëzime penale dhe kishte kërkuar nisjen e 31 hetimeve.¹⁸²⁴ Mirëpo, shumica e madhe e krimeve të kallëzuara kishin të bënin me mosbindje dhe krime kundër pronës dhe nuk duket se ishte ngritur ndonjë akuzë për vrasje apo për lëndime të rënda.¹⁸²⁵ Raportet e Armata së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm më 1 dhe 2 prill informonin mbi kryerjen e krimeve të plaçkitjes së shtëpive të braktisura të shqiptarëve kosovarë.¹⁸²⁶

730. Ashtu sikurse u përmend më lart, më 30 mars 1999, Komanda e Armatës së Tretë i dërgoi një telegram Shtabit të Komandës së Lartë, drejtuar personalisht Ojdaniqit, ku thuhet se kishin nisur operacionet në zonën e Malishevës, më konkretisht në fshatin Arlat, fshatin Gllarevë, fshatin Volljakë, zonat e Rahovecit e të Suharekës, fshatin Duhël dhe fshatin Guncat.¹⁸²⁷ Këto vendndodhje përfshijnë disa prej atyre që përmenden në Aktakuzë dhe në lidhje me të cilat Dhoma ka arritur në përfundimin se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kanë kryer krime. Telegrami i Komandës së Armatës së Tretë ishte përgjigje ndaj një kërkesë që Ojdaniqi ia kishte drejtuar Pavkoviqit për të bërë një vlerësim se sa kohë do të duhej për ta eliminuar UÇK-në, për shkak të vizitës së ardhshme të një delegacioni rus.¹⁸²⁸ Gjithashtu, më 30 mars, Pavkoviqi i përmendte operacionet në raportin e tij të përditshëm të luftimeve për Shtabin e Komandës së Lartë, duke thënë shkurtimisht se kishte filluar një operacion për shpartallimin e UÇK-së në sektorin e Malishevës.¹⁸²⁹ Pra, Pavkoviqi ishte në dijeni se njësitë nën urdhrat e tij po vepronin në këto zona, të cilat u përmenden më vonë në aktakuzën kundër Pavkoviqit si vendndodhjet ku anëtarët e UJ-së ishin implikuar në kryerjen e krimeve, sikurse diskutohet më poshtë.

731. Më 26 prill 1999, Pavkoviqi urdhëroi shpërndarjen e një libri për të drejtën humanitare ndërkombëtare tek komandantët që kishte në vartësi.¹⁸³⁰ Dhoma ka shqyrtuar edhe udhëzimet që u janë dhënë psikologëve ushtarakë. Këto udhëzime për rekrutët ushtarakë nuk përmendin respektimin e ligjeve të luftës, por theksojnë që ushtarëve t'u thuhet që t'i përmbushin të gjitha

¹⁸²³ 3D1128 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 4 prill 1999), f. 2; 3D1129 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 7 prill 1999).

¹⁸²⁴ 4D273 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 31 mars 1999), f. 2.

¹⁸²⁵ *Shih* P1736 (Kodi Penal i RSFJ-së).

¹⁸²⁶ 4D274 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 1 prill 1999), f. 2; 4D275 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 2 prill 1999), f. 3.

¹⁸²⁷ P1446 (Dokument i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së lartë, 30 mars 1999).

¹⁸²⁸ P1951 (Urdhër lidhur me vizitën e delegacionit rus, 30 mars 1999).

¹⁸²⁹ 4D307 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 30 mars 1999).

¹⁸³⁰ 4D372 (*Basics of the Laws of War—A Handbook* (“Bazat e ligjeve të luftës—Manual”, 26 prill 1999); 4D203 (Urdhër i Pavkoviqit lidhur me paraushtarakët dhe ligjet e luftës, 27 prill 1999); Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 5; Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007),

detyrat e luftimit ose, përndryshe, do të dënohen me burg.¹⁸³¹ Velimir Obradoviç, i cili ishte shef i Qendrës Operative të Komandës së Armatës së Tretë në vitin 1999, dëshmoi se ai ishte njohur me urdhrat e ndryshme të Armatës së Tretë dhe se ato kishin si synim parandalimin e kryerjes së krimeve nga anëtarët e UJ-së.¹⁸³² Mirko Starçeviç, i cili ishte Ndihmëskomandant për Informimin dhe Moralën në Armatën e Tretë, shtoi se ai i kishte vizituar njësitë e UJ-së në Kosovë “një javë apo disa ditë” pasi qenë kontrolluar nga Llazareviç dhe Pavkoviç dhe se, kur kishte folur me ushtarët, ata i kishin thënë se “i njihnin urdhrat e nxjerrë nga gjeneral Pavkoviç dhe gjeneral Llazareviç për respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare ... dhe rëndësinë e këtyre urdhrave”.¹⁸³³

732. Në prill 1999, Pavkoviç mësoi për varret e përbashkëta në Izbicë. Kur dëgjoji se asnjë pjesëtar i UJ-së nuk ishte implikuar në vrasjet e shqiptarëve kosovarë në këtë fshat, ai ia kaloi këtë informacion Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁸³⁴ Gjithashtu, u dha një raport për vrasjen e 20 civilëve shqiptarë kosovarë në Hallac të Vogël, në komunën e Lipjanit, që dyshohej se ishte kryer nga pjesëtarë të Korpusit të Prishtinës.¹⁸³⁵ Për këtë incident u fol në mbledhjen me Millosheviçin më 17 maj 1999. Mirëpo, sipas Gajiqit, kjo çështje u mbyll sepse u konstatua se mbi pjesëtarët e UJ-së, të përzierë në këtë incident, ishte hapur zjarr nga persona të paidentifikuar.¹⁸³⁶ Llazareviç i dërgoi një kërkesë Armatës së Tretë dhe Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë për angazhimin e një mjeku ligjor. Në kërkesë thuhej se kishte një nevojë të ngutshme për ekzaminim profesional të kufomave të gjetura në varret në Kosovë, sepse nuk dihej se kush i kishte vendosur kufomat në varrin e përbashkët dhe se kishte “të dhëna” se përgjegjësi mbanin efektivat e UJ-së.¹⁸³⁷ Llazareviç dëshmoi se informacioni në lidhje me kufomat, kishte ardhur nga banorët vendas të Lipjanit, por ngaqë këta banorë nuk kishin qenë në gjendje t’i identifikonin si duhet uniformat që mbanin autorët e krimit, ai dëshironte marrjen e informacioneve të tjera.¹⁸³⁸ Kërkesa u pranua dhe në Korpusin e Prishtinës u dërgua një mjek ligjor (njëfarë major Millosavleviq) nga Akademia

para. 27; Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 19; Mirko Starçeviç, T. 17432 (22 tetor 2007); Lubisha Stojimiroviç, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 62.

¹⁸³¹ 3D732 (Udhëzime për psikologët në kohë lufte, 29 maj 1999).

¹⁸³² Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007); para. 27; Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 43; Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 29.

¹⁸³³ Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 19; T. 17432 (22 tetor 2007).

¹⁸³⁴ 3D586 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999), f. 1. Shënimet e kësaj mbledhjeje bëjnë të ditur se Ojdaniç nuk ishte i pranishëm dhe se ajo kryesohej nga Ndihmëshefi për Çështje Operative dhe të Shtabit, Kovaçeviç; P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviçit me Prokurorinë), f. 169–176.

¹⁸³⁵ 3D1061 (Raport Shtesë i Armatës së Tretë, 14 korrik 1999); Aleksandar Vasileviç, P2594 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 tetor 2006), para. 57 (i mbyllur me vulë); Branko Gajiq, T. 15304–15305 (10 shtator 2007).

¹⁸³⁶ Branko Gajiq, T. 15304–15306 (10 shtator 2007).

¹⁸³⁷ 5D379 (Kërkesë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 26 prill 1999).

¹⁸³⁸ Vladimir Llazareviç, T. 18645–18647 (20 nëntor 2007).

Mjekësore Ushtarake (AMU) e Beogradit.¹⁸³⁹ Llazareviqi dëshmoi se në këtë vend qenë gjetur 36 kufoma dhe se kishte kërkesa për zhvarrime në gjithsej gjashtë pika në Kosovë, të cilat u bënë nga ekspertët ushtarakë. Kërkesat për zhvarrimet e kryera nga autoritetet civile qenë një çështje më vete.¹⁸⁴⁰

733. Dr. Gordana Tomasheviq, specialiste e mjekësisë ligjore e punësuar nga AMU dëshmoi për ekzaminimet mjeko-ligjore që u bëri kufomave nga Izbica, sikurse është përshkruar në Pjesën VII.G. Ajo dëshmoi se më 12 maj 1999 shkoi me një ekip ekspertësh në Prishtinë për një mbledhje me Pavkoviqin dhe Llazareviqin, në të cilën nuk u diskutua shumë. Pas dhjetë ditësh, më 22 maj 1999, ky grup pati një mbledhje tjetër me Pavkoviqin dhe Llazareviqin, në të cilën Pavkoviqi i informoi se duhej t'i përdornin njohuritë e tyre prej eksperti për qëllimet e “*asanacija-s*” apo, siç e shpjegoi Pavkoviqi, për marrjen e masave higjienike, sanitare dhe teknike në lidhje me kufomat e kafshëve dhe njerëzve për të siguruar mospërhapjen e sëmundjeve dhe marrjen e hapave të nevojshëm për identifikimin dhe shkaqet e vdekjes së kufomave të gjetura.¹⁸⁴¹ Sipas Tomasheviqit, Pavkoviqi e udhëzoi që të shkonte në një shtëpi të braktisur në Çikatovë të Vjetër, në Gllogoc, ku qenë gjetur kufomat. Pas këqyrjes së kufomave, ajo përgatiti një aktekspertizë me konstatimet e veta,. Duke qenë se Pavkoviqi nuk i kërkoi të përgatiste raport, ajo nuk ia dorëzoi aktekspertizën.¹⁸⁴² Një raport lidhur me varret e përbashkëta në Izbicë iu paraqit Komandës së Lartë, por Pavkoviqi pretendonte se nuk ishte në dijeni se çfarë hapash të tjerë qenë marrë në lidhje me kufomat.¹⁸⁴³ Dhoma arrin në përfundimin se kjo dëshmi tregon dijeninë e Pavkoviqit për mundësinë e kryerjes së vrasjeve nga forcat e MPB-së që vepronin në Kosovë.

734. Prokuroria paraqiti prova përmes të cilave synonte të tregonte se Pavkoviqi kishte dijeni për krimet e kryera nga pjesëtarët e UJ-së dhe për moskallëzimin e këtyre krimeve, sepse ai mori pjesë në mbledhje ku u diskutuan këto tema. Një mbledhje e tillë u zhvillua më 4 maj 1999, për të diskutuar për ngjarjet në Kosovë, përfshirë krimet që pretendohesh se po kryeshin atje dhe reagimin e gjykatave ushtarake.¹⁸⁴⁴ Kjo mbledhje u zhvillua pas marrjes së komunikimeve nga Prokurorja e

¹⁸³⁹ 4D293 (Telegram i Armatës së Tretë për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999); 5D383 (Përgjigje e Komandës së Armatës së Tretë, 27 prill 1999).

¹⁸⁴⁰ Vladimir Llazareviq, T. 18645–18648 (20 nëntor 2007).

¹⁸⁴¹ Gordana Tomasheviq, T. 7022–7026, 7044 (21 nëntor 2006), P2490 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 mars 2003), f. 3–4, P2507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2006), f. 2–3. *Shih edhe* Stanimir Radosavleviq, T. 17496 (23 tetor 2007).

¹⁸⁴² Gordana Tomasheviq, T. 7025–7026 (21 nëntor 2006).

¹⁸⁴³ 3D586 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 15 prill 1999), f. 1; P949 (intervistë e Nebojshta Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 172–175.

¹⁸⁴⁴ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 4 maj 1999). 4D406 (Situata e sigurisë në Kosovë, reportazh në *Politika*, 5 maj 1999). Këto dokumente u kundërshtuan në gjyq. T. 16105–16106 (21 shtator 2007); Millosh Deretiç, T. 22547 (15 shkurt 2008). Megjithatë, ato mbështeten nga 5D1289 (Raport i Sreten Llukiçit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999); *shih edhe* Dushan Gavranic, T. 22722 (19 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24188 (12 mars 2008).

atëherëshme Tribunalit, Louise Arbour, në të cilat ajo shprehte shqetësimin e saj lidhur me shkeljet e vazhdueshme të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë.¹⁸⁴⁵ Në të u paraqit informacion se “forcat e sigurimit” kishin trajtuar raste të shumta dhune, vrasjesh, plaçkitjesh dhe krimesh të tjera dhe se kishin arrestuar disa qindra kriminelë, krimet e të cilëve e kishin vënë në rrezik të madh popullatën civile. Nga ajo mbledhje doli një deklaratë në të cilën përmendeshin dënimet e shumta me burgim nga pesë derë në 20 vjet të dhëna nga gjykatat ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s, çka nuk përputhet me raportet e ndryshme të UJ-së për punën e gjykatave ushtarake gjatë fushatës ajrore të NATO-s deri më datë 4 maj 1999.¹⁸⁴⁶

735. Të nesërmen e mbledhjes së datës 4 maj, Pavkoviqi theksoi se anëtarë të armatosur të UJ-së që vepronin jashtë zonave të luftimit ishin sjellë “jo si duhet” dhe kishin komprometuar reputacionin e UJ-së. Ai u dha urdhër komandave në vartësi që të mbikëqyreshin veprimet e pjesëtarëve të UJ-së jashtë zonave të luftimit.¹⁸⁴⁷ Në një mbledhje të Shtabit të MPB-së për Kosovën më 7 maj 1999 u tha se pjesëtarët e UJ-së po kryenin krime, por se këto krime nuk po procedoheshin sa duhet nga sistemi i drejtësisë ushtarake. Në këtë mbledhje, shefi i SPB-së në Prishtinë tha se UJ nuk po merrte masa të mjaftueshme dhe se “shumica e krimeve” po bëhej nga anëtarët e UJ-së. Shefa të ndryshëm të MPB-së raportuan se anëtarët e UJ-së po kryenin krime, përfshirë vrasje, plaçkitje dhe djegie shtëpish.¹⁸⁴⁸ Bozhidar Filiqi dëshmoi se, pas mbledhjes, ai hetoi më tej dhe zbuloi se anëtarët e UJ-së që kryenin krime qenë hetuar por ishin kthyer në njësitë e tyre brenda UJ-së në pritje të fundit të fushatës së NATO-s.¹⁸⁴⁹ Ky informacion përputhet me versionet për mbledhjen e datës 4 maj, të cilat bëjnë të ditur se kundër civilëve në Kosovë ishin kryer gjatë javëve të fundit krime të shumta, ndër të cilat kishte edhe krime të kryera nga anëtarët e UJ-së dhe MPB-së, dhe se Pavkoviqi ishte në dijeni të kësaj.

736. Nga intervista me Prokurorinë, është e qartë se Pavkoviqi ishte vënë në dijeni të lëvizjeve të mëdha të popullsisë në vitin 1998 dhe 1999. Sipas tij kjo kishte të bënte me personat që largoheshin nga zonat ku kishte përleshje midis forcave të sigurisë dhe “terroristëve” dhe, më vonë, nga frika e bombardimit të NATO-s.¹⁸⁵⁰ Velimir Obradoviqi dëshmoi se vetëm disa raporte luftimi të UJ-së i përmendnin lëvizjet e popullsisë civile, sepse këto lëvizje nuk binin në sferën e

¹⁸⁴⁵ P401 (Letër e Louise Arbour-it drejtuar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999); 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046 (20 shtator 2007); 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

¹⁸⁴⁶ P1696 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 4 maj 1999), f. 1–2.

¹⁸⁴⁷ P1672 (Urdhër i Armatës së Tretë, 5 maj 1999), f. 1. Në veçanti, Pavkoviqi urdhëroi marrjen e “e masave të duhura të parashkruara në ligj, kundër të gjithë personave përgjegjës për shkeljet e këtij urdhri”.

¹⁸⁴⁸ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 4–5.

¹⁸⁴⁹ Bozhidar Filiq, T. 23976 (10 mars 2008).

¹⁸⁵⁰ P949 (intervistë e Nebojshta Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 171–72, 220, 353–355.

kompetencës së UJ-së, me përjashtim të rasteve kur këto lëvizje ndikonin në lëvizjen e trupave ose nëse në to ishte e përfshirë UÇK-ja.¹⁸⁵¹ Një listë direktivash drejtuar komandave në vartësi, të nxjerra nga Pavkoviqi më 7 maj 1999, u kërkonte të “siguronin kontroll të plotë të territorit dhe të lëvizjes së civilëve shqiptarë”.¹⁸⁵² Lubisha Stojimiroviqi shpjegoi se kjo direktivë kërkonte që të merreshin masa që njësitë të ishin të sigurta në pozicionet e tyre dhe që të shmangeshin aksidentet e civilëve në lëvizje.¹⁸⁵³ Mirëpo, ai nuk shpjegoi përse bëhej dallim lidhur me kombësinë, në urdhër.¹⁸⁵⁴ Më pas, më 10 maj, Armata e Tretë raportonte se 10 mijë civilë nga fshatrat e komunës së Pejës qenë “dërguar” në Klinë dhe Pejë, pas një operacioni të Brigadës së 7-të të Këmbëtorisë dhe të Detashmentit Ushtarak të Pejës gjatë të cilit qenë kapur 600 anëtarë të UÇK-së.¹⁸⁵⁵ Raporti nuk përmend asnjë bombardim të NATO-së në sektorin e Pejës në atë kohë.

737. Në maj 1999, kreu i Administratës së Sigurimit të UJ-së, Geza Farkashi, u nis me mision për në Kosovë. Farkash zbuloi se kishte probleme të mëdha nga aktiviteti kriminal në Kosovë, ku përfshiheshin përdhunime, plaçkitje, vjedhje dhe angazhim jokorrekt i njësive të Policisë Ushtarake.¹⁸⁵⁶ Më 8 maj Aleksandar Vasileviqi u takua me shefin e Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës, i cili e informoi për krimet e kryera nga anëtarët e UJ-së kundër civilëve në Kosovë. Në këto krime kishte një përdhunim në të cilin ishte implikuar një rezervist, një vrasje e një shqiptari kosovar në një fshat të Skënderajt dhe vrasja e një burri në Shipovë.¹⁸⁵⁷ Vasileviqi dëshmoi se, më vonë, zbuloi se Komanda e Armatës së Tretë në Prishtinë kishte marrë një vendim për të mos raportuar kryerjen e disa krimeve të caktuara në raportet e rregullta të luftimit, duke qenë se me to po merreshin organet gjyqësore ushtarake.¹⁸⁵⁸ Ai shprehu mendimin se kjo nuk përbënte një përpjekje për të mbuluar krimet e shërbimit të sigurimit, por thjesht një mendim të gabuar se nuk kishte nevojë për raportim nëse autorët e krimeve qenë ndjekur më parë penalisht.¹⁸⁵⁹ Mirëpo, Dhoma vëren se justifikimi se mendohej që raportimi i krimeve të rënda nuk ishte i nevojshëm pas kallëzimit të tyre penal në organet e drejtësisë ushtarake, nuk përputhet me faktin se krimet më pak të rënda vazhdonin t’u raportoheshin komandave eprorë edhe pasi që bërë kallëzimi në sistemin e drejtësisë ushtarake, sikurse diskutohet këtu.

¹⁸⁵¹ Velimir Obradović, T. 17377 (22 tetor 2007).

¹⁸⁵² 4D198 (Lista e Plotë e Udhëzimeve e Armatës së Tretë, 7 maj 1999), p. 2.

¹⁸⁵³ Lubisha Stojimiroviqi, T. 17693–17694 (26 tetor 2007).

¹⁸⁵⁴ Lubisha Stojimiroviqi, T. 17694–17695 (26 tetor 2007).

¹⁸⁵⁵ 4D315 (Raport Luftimi i Komandës së Armatës së Tretë, 10 maj 1999), f. 1.

¹⁸⁵⁶ Geza Farkash, T. 16293–16294 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15280–15282 (7 shtator 2007).

¹⁸⁵⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 59.

¹⁸⁵⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8750–8751 (19 janar 2007).

¹⁸⁵⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8749–8751 (19 janar 2007).

738. Pas marrjes së këtij informacioni në Shtabin e Komandës së Lartë, Pavkoviqi mori pjesë në një mbledhje me Ojdaniqin më 16 maj 1999, në Postëkomandën e Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁸⁶⁰ Farkashi tha se Pavkoviqi e informoi Ojdaniqi për hollësitë e krimeve që po kryenin në Kosovë anëtarët e UJ-së dhe për rezultatet e hetimeve të këtyre krimeve.¹⁸⁶¹ Vasileviqi dëshmoi se Pavkoviqi diskutoi akuzat për krimet e kryera nga UJ-ja, ku bënte pjesë edhe zbulimi i 800 kufomave në Kosovë.¹⁸⁶² Përpara kësaj mbledhjeje, Pavkoviqi ishte përpjekur të verifikonte nëse numri i kufomave ishte i saktë, por nuk kishte nisur ndonjë hetim zyrtar.¹⁸⁶³ Në mbledhje, ai tha se hetimet kishin zbuluar se 271 prej këtyre vdekjeve kishin ndodhur në zonat e mbuluara nga UJ-ja, ndërsa 326 në zonat e mbuluara nga forcat e MPB-së.¹⁸⁶⁴ Vasileviqi tha se në mbledhje u diskutua fakti se këto shifra nuk rezultonin në shumën 800.¹⁸⁶⁵ Gjithashtu, në mbledhje u tha se disa prej vdekjeve mund të ishin shkaktuar nga sulmet e NATO-s.¹⁸⁶⁶ U fol edhe për krimet e kryera nga grupet paraushtarake.¹⁸⁶⁷ Pavkoviqi tha se kishte pasur kontakt me udhëheqësin e grupit të armatosur të organizuar nga MPB-ja, të njohur me emrin “Akrepas”, Sllobodan Mediqin (i njohur edhe si Boca), i cili, sipas mendimit të tij, e kishte gënjyer Pavkoviqin duke i thënë se nuk kishte qenë i pranishëm në Kosovë.¹⁸⁶⁸ Mirëpo, Pavkoviqi tha se këto grupe ishin parë të mbanin emblemën e SAJ-së dhe se ishte e vështirë t’i mbaje nën kontroll lëvizjet e tyre sepse ata nuk qenë në kontrollin e tij.¹⁸⁶⁹

739. Pas kësaj mbledhjeje, më 17 maj 1999 u mbajt një mbledhje e dytë, me Millosheviqin.¹⁸⁷⁰ Pavkoviqi përsëriti informacionin lidhur me krimet që po kryenin anëtarët e UJ-së në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Tretë brenda Kosovës.¹⁸⁷¹ Vasileviqi paraqiti edhe një raport për krimet e rënda të kryera nga forcat dhe vullnetarët e UJ-së kundër civilëve, përfshirë edhe vrasjet dhe përdhunimet.¹⁸⁷² M1 tej ai i informoi të pranishmit për krimet e kryera nga “Akrepas” dhe nga

¹⁸⁶⁰ Geza Farkash, T. 16296–16299 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15284–15287 (7 shtator 2007).

¹⁸⁶¹ Geza Farkash, T. 16295 (25 shtator 2007).

¹⁸⁶² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62.

¹⁸⁶³ Aleksandar Vasileviq, T. 8760–8762 (19 janar 2007).

¹⁸⁶⁴ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62.

¹⁸⁶⁵ Aleksandar Vasileviq, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr No. IT-02-54-T), T. 15999.

¹⁸⁶⁶ Aleksandar Vasileviq, T. 8763 (19 janar 2007), T. 9041 (24 janar 2007).

¹⁸⁶⁷ Branko Gajiq, T. 15290 (7 shtator 2007).

¹⁸⁶⁸ Branko Gajiq, T.15285–15286 (7 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8755–8756 (19 janar 2007).

¹⁸⁶⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8756 (19 janar 2007).

¹⁸⁷⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8772–8773 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 62–63; Branko Gajiq, T. 15290–15291 (7 shtator 2007); *Shih edhe* Geza Farkash, T. 16296 (25 shtator 2007).

¹⁸⁷¹ Geza Farkash, T. 16296–16297 (25 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, 14 janar 2007), para. 67.

¹⁸⁷² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65. Vasileviqit dhe Farkashit u kujtohej ndryshe renditja e prezantimeve në këtë mbledhje. Vasileviqi tha se ai raportoi i pari. Farkashi tha se Pavkoviqi dha raportin e parë. Sidoqoftë, të dy pajtohen lidhur me faktin se u mbajtën të dy prezantimet.

paraushtaraku Sllobodan Mediq (i njohur gjithashtu si Boca).¹⁸⁷³ Shënimet e Vasileviqit për këtë mbledhje bëjnë të ditur se të pranishmit diskutuan për aktivitetet kriminale të paraushtarakëve brenda Kosovës të cilët vepronin në bashkëpunim me forcat e MPB-së të vendosura në atë zonë.¹⁸⁷⁴ Këtu përfshiheshin edhe njerëzit e Arkanit, numri i të cilëve ishte 30 dhe të cilët qenë implikuar në vrasjen e një çifti pleqsh.¹⁸⁷⁵ Sipas Vasileviqit, Pavkoviqi tha se disa prej vrasjeve kishin ndodhur në Jezercë, çka Markoviqi e pranoi se ishte një fshat në zonën e kontrollit të JSO-së. Dhoma vëren se, edhe pse Markoviqi tha se fshati i Jezercës kontrollohej nga JSO-ja, me urdhër të Komandës së Përbashkët të datës 15 prill në fshat dhe në zonat rreth tij u dërguan forca të UJ-së dhe MPB-së për të kryer operacione.¹⁸⁷⁶ Në mbledhje, Pavkoviqi raportoi përsëri për 800 kufomat që qenë gjetur në Kosovë.¹⁸⁷⁷ Ai shtoi se ky problem ishte shfaqur nga përpjekjet e MPB-së dhe UJ-së për t'ia kaluar fajin njëra-tjetrës.¹⁸⁷⁸ Vasileviqi dëshmoi se Ojdaniqi dhe Pavkoviqi propozuan krijimin e një “komisioni të përbashkët shtetëror” për të hetuar çfarë po ndodhte në Kosovë, por se Millosheviqi nuk kishte interes për krijimin e këtij komisioni.¹⁸⁷⁹ Përgjigja e Millosheviqit ndaj këtyre problemeve ishte “t’i kthente kokëposhtë të gjitha propozimet” dhe t’i shmangej ballafaqimit të krimeve që po ndodhnin në Kosovë, duke thënë se nuk kishte “komunikim të duhur midis autoriteteve civile dhe ushtarake”.¹⁸⁸⁰

740. Lidhur me sugjerimin e Pavkoviqit mbi krijimin e një komisioni për hetimin e rreth 800 kufomave, për të cilin u diskutua në mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj, dhe i cili nuk u realizua kurrë, Dhoma vëren se vetë mbledhjet u bënë, pjesërisht, për shkak të zbulimit të moskallëzimit të krimeve nga Armata e Tretë. Komisioni i propozuar, në fakt, nuk u krijua dhe Pavkoviqi nuk zbatoi asnjë masë tjetër lidhur me 800 kufomat, me gjithë kompetencat e shumta që kishte në dispozicion. Dhoma nxjerr përfundimin se këto mbledhje janë një tjetër dëshmi se anëtarët e UJ-së dhe MPB-së po kryenin krime në Kosovë dhe nuk e konsideron sugjerimin e dështuar të Pavkoviqit lidhur me komisionin, për të cilin ai nuk ndërmori asnjë masë tjetër, si provë të vullnetit të singertë për marrjen e masave të efektshme kundër veprimtarisë kriminale në Kosovë.

¹⁸⁷³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 65; Branko Gajiq, T. 15269, 15273 (7 shtator 2007).

¹⁸⁷⁴ P2592 (pjesë e nxjerrë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999).

¹⁸⁷⁵ P2592 (pjesë e nxjerrë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999), f. 1; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 67.

¹⁸⁷⁶ P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 1, 4.

¹⁸⁷⁷ Aleksandar Vasileviq, P2589 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda IT-02-54-T), T. 15999, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 64.

¹⁸⁷⁸ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 68; P2592 (pjesë e nxjerrë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999), f. 1.

¹⁸⁷⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8783, 8826–8827 (22 janar 2007). Vasileviqi përmendi edhe një “komision shtetëror të pavarur”.

¹⁸⁸⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8783 (22 janar 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 71.

741. Më 25 maj 1999, Pavkoviqi i dërgoi një raport Shtabit të Komandës së Lartë (drejtuar Ojdaniqit, personalisht), ku thuhej se situata e sigurisë në Kosovë ishte e paqëndrueshme për shkak të krimeve të shpeshta të kryera nga MPB-ja.¹⁸⁸¹ Pavkoviqi pohonte se kjo ishte më e dukshme në pikat kufitare, ku anëtarët e MPB-së e toleronin veprimtarinë kriminale dhe e kryenin vetë atë, kryesisht duke përvetësuar automjete dhe mallra. Ai thoshte edhe se anëtarët dhe njësitë e MPB-së po kryenin krime të rënda kundër popullsisë shqiptare kosovare në vendbanime dhe strehimore “të refugjatëve” në Kosovë, ku përfshiheshin “vrasje, përdhunime, plaçkitje, vjedhje në rrethana rënduese, etj.”. Pavkoviqi përmendte se pjesëtarët e MPB-së të cilët i kryenin këto krime më pas “ua ngarkonin qëllimisht këto krime njësisive dhe anëtarëve të UJ-së”.¹⁸⁸² Në fund, ai raportonte se marrja e informacionit të sigurimit nga RDB-ja nuk kishte qenë e kënaqshme dhe se i vetmi aspekt pozitiv i veprimeve të përbashkëta me MPB-në kishte qenë lokalizimi dhe ndalimi i rekrutëve ushtarakë të cilët nuk paraqiteshin në detyrë.¹⁸⁸³ Më 24 maj 1999 Pavkoviqi kishte marrë informacion nga Llazareviqi për moskalimin e MPB-së në vartësi në UJ-së. Në këtë raport, Llazareviqi përshkruante me hollësi krimet që po kryenin anëtarët e MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë.¹⁸⁸⁴

742. Më pas, më 4 qershor 1999, Pavkoviqi i dërgoi një telegram tjetër Shtabit të Komandës së Lartë, ku përshkruante të njëjtat ankesa që kishin të bënin me forcat e MPB-së: “mosrespektimi i marrëveshjeve, plaçkitje, etj.”. Në këtë raport, Pavkoviqi kërkonte që një numër problemesh, të cilët qenë vënë re gjatë vizitave në disa prej njësisive gjatë periudhës 23-26 maj 1999, të zgjidheshin në nivel të Shtabit të Komandës së Lartë. Ai rendiste problemet që duheshin zgjidhur, duke përfshirë faktin se forcat e MPB-së nuk kishin kaluar në varësi të komandave përkatëse të UJ-së sepse nuk kishin marrë urdhra nga komandat e tyre eprorë.¹⁸⁸⁵ Qurçini dëshmoi për raportin e datës 4 qershor 1999, ku shpjegoheshin problemet e hasura nga Pavkoviqi lidhur me MPB-në. Kur u pyet nëse dinte nëse ishte bërë diçka për të ndrequr problemet që përmbante raporti i Pavkoviqit, Qurçini u përgjigj se Millosheviqi dhe Ojdaniqi u takuan për ta diskutuar këtë çështje, por se në fund MPB-ja nuk kaloi asnjëherë në vartësi të UJ-së dhe, për pasojë këto shqetësime nuk gjetën zgjidhje.¹⁸⁸⁶

¹⁸⁸¹ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999). Kundërshtimet për këtë dokument dhe P1725 trajtohen në Pjesën VIII.E. *Shih edhe* 3D1078 (Letër drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, 1 mars 2002); 3D1077 (Letër e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar Ojdaniqit, 13 mars 2002).

¹⁸⁸² P1459 (Raport i Armatës së Tretë mbi moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999), para. 4.

¹⁸⁸³ P1459 (Raport i Armatës së Tretë mbi moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999), para. 6–7.

¹⁸⁸⁴ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi moszbatimin e Urdhrit për Ndërrimin e Varësisë, 24 maj 1999), pranuar edhe me numrat 4D192 dhe P1723.

¹⁸⁸⁵ P1725 (Kërkesë e Armatës së Tretë drejtuar Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999), para. 1.

¹⁸⁸⁶ Gjorgje Qurçin, T. 17019–17021 (16 tetor 2007).

743. Branko Gajiqi dëshmoi se pas ndërprerjes së luftimeve më 10 qershor 1999, UJ-ja vijoi me masat për hetimin e krimeve të luftës të kryera gjatë fushatës së NATO-s dhe citoi çështjet e veçanta që i kishin kaluar atij dhe që u ishin kaluar gjykatave civile.¹⁸⁸⁷ Një prej këtyre çështjeve kishte të bënte me vrasjen e 20 civilëve shqiptarë kosovarë në Hallaç të Vogël, në komunën e Lipjanit, nga anëtarë të Grupit të 252-të Taktik të Korpusit të Prishtinës,¹⁸⁸⁸ për të cilin u diskutua në mbledhjen me Millosheviqin më 17 maj 1999.¹⁸⁸⁹

iii. Raportimi nga Armata e Tretë

744. Prokuroria parashtron se në disa raste Pavkoviqi qëllimisht thajse nuk raportoi apo dha informacion të shtrembër mbi krimet e kryera nga efektivi i UJ-së në Kosovë dhe se kjo pati për pasojë inkurajimin e aktivitetit të mëtejshëm kriminal.¹⁸⁹⁰ Mbrojtja e Pavkoviqit përgjigjet se ai mbështetej në informacionin e marrë nga njësitë në vartësi dhe se, kur e merrte këtë informacion, ai ia përcillte Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë për shqyrtim dhe se njërive në vartësi në UJ u kërkohesh vetëm t'ia kallëzonin krimet policisë ushtarake apo prokurorëve ushtarakë dhe jo eprorëve.¹⁸⁹¹

745. Sipas Geza Farkashit, Komanda e Armatës së Tretë i raportonte drejtpërdrejtë Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁸⁹² Lubisha Stojimiroviqi, i cili ishte shefi i Shtabit të Armatës së Tretë, dëshmoi se komandantët e UJ-së duhej të raportonin për krimet dhe incidentet e paligjshme që ndodhnin në zonën e tyre të përgjegjësisë.¹⁸⁹³ Në mënyrë të ngjashme, Radojko Stefanoviqi, i cili ishte shef i Sektorit të Operacioneve dhe Stërvitjes në Komandën e Korpusit të Prishtinës, dëshmoi se çdo anëtar i UJ-së kishte detyrimin për t'i raportuar eprorit dhe organit përkatës së sigurimit nëse po kryej ndonjë krim.¹⁸⁹⁴ Ojdaniqi e konfirmoi këtë detyrim në urdhrin e tij të datës 2 prill 1999.¹⁸⁹⁵

¹⁸⁸⁷ Branko Gajiq, T. 15301–15307 (10 shtator 2007); 3D1057 (Raport Shtesë i Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së Tretë, 25 qershor 1999); 3D1058 (Raport Shtesë i Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së Tretë, 25 qershor 1999); 3D1059 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 25 qershor 1999).

¹⁸⁸⁸ 3D1061 (Raport Shtesë i Armatës së Tretë, 14 korrik 1999); Aleksandar Vasileviq, P2594 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 57 (mbyllur me vulë); Branko Gajiq, T. 15304–15306 (10 shtator 2007).

¹⁸⁸⁹ Branko Gajiq, T. 15304–15306 (10 shtator 2007).

¹⁸⁹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë (version publik), 29 korrik 2008, para. 895.

¹⁸⁹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit (version publik), 28 korrik 2008, para. 216.

¹⁸⁹² Geza Farkash, T. 16362–16363 (25 shtator 2007); Lubisha Stojimiroviq, T. 17681 (26 tetor 2007).

¹⁸⁹³ Lubisha Stojimiroviq, T. 17681 (26 tetor 2007).

¹⁸⁹⁴ Radojko Stefanoviq, T. 21728 (6 shkurt 2008). *Shih edhe* Millosh Mandiq, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviq, T. 8666 (18 janar 2007). *shih Radomir Gojoviq*, T. 16706 (2 tetor 2007).

¹⁸⁹⁵ 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999), f. 1–2. Dhoma vëren se normat që rregullonin UJ-në parashikonin një sistem uniteti dhe njëjësie të komandës i cili kërkonte që urdhrat të zbatoheshin nga vartësitë “pa kushte, përpikmërisht dhe menjëherë”. *Shih, p.sh.*, P984 (Ligj i RFJ-së “Për UJ-në”), f. 2; P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll), f. 61–63, 96.

746. Gjatë bombardimit të NATO-s, pati probleme në linjën e komunikimit me nivelet e ulëta të komandimit, çka do të thoshte se në disa raste Armata e Tretë i dërgonte Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë raporte luftimi pa të dhëna nga Korpusi i Prishtinës dhe Korpusi i Nishit.¹⁸⁹⁶ Mirëpo, sipas Pavkoviçit, gjatë fushatës ajrore të NATO-s sistemi i komandimit nuk u bllokua asnjëherë, edhe pas shkatërrimit të qendrave të komunikimit dhe të ritransmetimit.¹⁸⁹⁷

747. Një krahasim i raporteve të luftimit të marra nga Komanda e Armatës së Tretë dhe i atyre dërguar Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë tregon se Pavkoviçi nuk raportonte në masë të mjaftueshme disa aktivitete kriminale në brendësi të UJ-së. Më 29 mars 1999, Brigada e 175-të e Këmbëorisë i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës se qenë arrestuar tetë vullnetarë, për të cilët ekzistonin arsye për të dyshuar se kishin kryer “krimin në fshatin e Zhegrës”. Në raport thuhej gjithashtu se komandanti i Korpusit të Prishtinës kishte miratuar dërgimin e vullnetarëve në Brigadën e 243-të të Mekanizuar, por se 32 syresh kishin thënë se dëshironin të largoheshin, kështu që qenë çarmatosur dhe qenë kthyer mbrapsht.¹⁸⁹⁸ Raporti që Armata e Tretë i dërgonte Shtabit të Përgjithshëm më 1 prill bënte të ditur se Korpusi i Prishtinës kishte nxjerrë nga shërbimi një grup vullnetarësh “që ishte një togë e tërë” për “mungesë discipline”.¹⁸⁹⁹ Në të përmendej edhe se kallëzimet penale po procedoheshin nga prokuroritë ushtarake, por se këto çështje kishin të bënin me mosbindjen ndaj thirrjes në detyrë dhe “mospërbushjes së kërkesave materiale”.¹⁹⁰⁰ Raporti i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë më 2 prill përmendte plaçkitjen nga pjesëtarët e UJ-së të shtëpive shqiptare kosovare dhe ndjekjet penale të anëtarëve të UJ-së, përfshirë edhe rastet për vjedhje dhe braktisje të pozicionit.¹⁹⁰¹

748. Raporti ditore i luftimit i datës 3 prill 1999 nga Komanda e Korpusit të Prishtinës për Komandën e Armatës së Tretë bënte të ditur se po merreshin masa ligjore kundër anëtarëve të UJ-së të cilën kryenin krime dhe se një ditë më parë qenë depozituar 32 kallëzime penale në prokurorinë ushtarake, përfshirë tetë kallëzime për vrasje dhe tre për tentativë për vrasje.¹⁹⁰² Por, raporti i luftimit që Armata e Tretë i dërgonte po atë ditë Shtabit të Komandës së Lartë, në të cilin

¹⁸⁹⁶ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007), para. 14. *Shih edhe* 4D274 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 1 prill 1999), f. 3; 4D275 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 2 prill 1999), f. 3. 4D276 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 3 prill 1999), f. 3.

¹⁸⁹⁷ P1319 (Përgjigje të Pavkoviçit ndaj pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17.

¹⁸⁹⁸ 5D825 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbëorisë për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 1.

¹⁸⁹⁹ 4D274 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 1 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁰⁰ 4D274 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 1 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁰¹ 4D278 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 2 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁰² 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2.

përmendeshin 32 kallëzimet penale që qenë depozituar në prokurorinë ushtarake, nuk i përfshinte hollësitë për nivelin e këtyre krimeve, duke përmendur shkeljet disiplinore kundër UJ-së dhe, më tej, thjesht, duke përmendur “incidente të izoluara të tentativave për plaçkitje dhe vepra të tjera penale”, pa përmendur fare vrasjet apo tentativat për vrasje.¹⁹⁰³ Raporti i luftimit që Armata e Tretë i dërgonte Shtabit të Komandës së Lartë të nesërmen gjithashtu nuk i përmendte këto krime të dhunshme.¹⁹⁰⁴ Një fshehje e tillë e hollësive të krimeve që po kryheshin në Kosovë nuk përputhej me urdhrin e Ojdaniqit një ditë më parë, që krimet t’u raportoheshin si organeve të sigurimit, po ashtu edhe Shtabit të Komandës së Lartë dhe nuk përputhej as me parimin e komandimit të UJ-së sipas të cilit urdhrat duhej të zbatoheshin menjëherë dhe përpikmërisht.¹⁹⁰⁵ Më 10 prill 1999, pasi Shtabi i Komandës së Lartë i kërkoi informacion konkret për këtë incident, Pavkoviçi raportoi se 25 vullnetarë qenë tërhequr nga Korpusi i Prishtinës, shtatë prej të cilëve të akuzuar për aktivitet kriminal, ku përfshiheshin vrasja dhe përdhunimi. Në raport thuhej edhe se mes vullnetarëve kishte edhe paraushtarakë.¹⁹⁰⁶ Në raport bëhej e ditur se, në Qarkun Ushtarak të Nishit ishin pranuar 1.517 vullnetarë, 360 ishin liruar për arsye të ndryshme, 849 ishin dislokuar në njësitë luftarake të Armatës së Tretë (500 në njësitë e Korpusit të Prishtinës dhe 349 në njësitë e Korpusit të Nishit) ndërsa 308 po stërviteshin në qendrën e pranimit. Pavkoviçi theksonte edhe disa çështje të hasura gjatë procesit të pranimit. Në veçanti, ai vërente se “kontrolli i sigurisë në qendrën e pranimit të Armatës së Tretë nuk mund të kryhej për shkak të mungesës së informacionit, kështu që një sërë vullnetarësh me të shkuar penale qenë dislokuar në njësitë luftarake (persona të dënuar më parë ose në pritje të dënimit)”. Ndër të tjera, ai thoshte se stërvitja e vullnetarëve kryhej për pesë deri në shtatë ditë, kohë e cila “mjafton për përzgjedhjen cilësore dhe kontrollin përfundimtar”.¹⁹⁰⁷

749. Mbrojtja e Pavkoviçit pretendon se, që prej 30 marsit 1999, Pavkoviçi i kishte dërguar raporte të shpeshta luftimi Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, me informacion për aktivitetin e prokurorive dhe gjykatave ushtarake. Ajo argumenton se, megjithëse ky informacion raportohet në terma të përgjithshme, Ojdaniçi mund të kishte kërkuar informacion shtesë, sidomos për shkak të faktit që raportet e përditshme bënin të ditur se kishte një numër të madh çështjesh penale.¹⁹⁰⁸ Stojimiroviçi dëshmoi se nuk kishte dëgjuar që Shtabi i Komandës së Lartë të kishte qenë i pakënaqur me raportimin nga Armata e Tretë.¹⁹⁰⁹ Mbrojtja e Pavkoviçit

¹⁹⁰³ 4D276 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 3 prill 1999), f. 2–3.

¹⁹⁰⁴ 3D1128 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 4 prill 1999).

¹⁹⁰⁵ Gjorgje Qurçin, T. 16961 (5 tetor 2007); 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999); P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), f. 2; P1041 (Udhëzues i UJ-së për Komandë dhe Kontroll, f. 61–63, 96).

¹⁹⁰⁶ P1938 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁰⁷ P1938 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 1–2.

¹⁹⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit (version publik), 28 korrik 2008, para. 216–217.

¹⁹⁰⁹ Lubisha Stojimiroviçi, T. 17669–17670 (26 tetor 2007); *shih edhe* Velimir Obradoviçi, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007), para. 19.

përmend raportet e tjera të ndryshme të luftimit që Komanda e Armatës së Tretë i dërgoi Shtabit të Komandës së Lartë gjatë bombardimit të NATO-s, në të cilët bëhej i ditur aktiviteti kriminal i forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe nënkupton se, duke vepruar kështu ai ia kishte kaluar përgjegjësinë për të vepruar për këto raste eprorit të tij, Ojdaniqit, i cili mund të kishte kërkuar informacion shtesë apo të kishte marrë masa të tjera shtesë.¹⁹¹⁰

750. Shkeljet penale të pjesëtarëve të UJ-së janë përmendur në një sërë raportesh që iu paraqitën Shtabit të Komandës së Lartë gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Raportet e luftimit të Armatës së Tretë të datave 30 dhe 31 mars 1999 bënin të ditur se prokuroria ushtarake kishte marrë një numër kallëzimesh penale.¹⁹¹¹ Mirëpo, shumica e madhe e krimeve të kallëzuara kishin të bënin me mosbindje dhe krime kundër pronës dhe nuk kishte asnjë akuzë konkrete për vrasje apo lëndime të rënda. Dhoma ka analizuar edhe disa raporte luftimi të Armatës së Tretë për muajt prill dhe maj 1999, dhe vëren se në shumicën e tyre nuk ka asnjë informacion për krimet e kryera dhe, edhe kur përmbajnë informacion të tillë, shumica e çështjeve të trajtuara qenë për mosparaqitje në bazë të fletëthirrjes apo për mospërmbushje të kërkesave materiale të shërbimit.¹⁹¹² Raporti i luftimit për datën 24 prill përmendte përpjekjet për plaçkitjen e pasurive të civilëve.¹⁹¹³ Raporti i luftimi për datën 30 prill bënte të ditur se siguria e njësisë ishte vënë në rrezik nga incidente negative (krime

¹⁹¹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit (version publik), 28 korrik 2008, para. 217.

¹⁹¹¹ 4D307 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 30 mars 1999), f. 3; *shih edhe* 4D273 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 31 mars 1999), f. 2.

¹⁹¹² 4D275 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 2 prill 1999), f. 2; 4D278 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 2 prill 1999), f. 2-3; 4D276 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 3 prill 1999), f. 2; P1997 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 13 prill 1999), f. 3-4; 4D280 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 20 prill 1999); f. 3; 4D281 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 24 prill 1999), f. 2; 4D282 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 25 prill 1999), f. 2; 4D283 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 26 prill 1999), f. 2; P2005 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 27 prill 1999), f. 2, pranuar edhe me numrin 4D284; P2017 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 29 maj 1999), f. 2, pranuar edhe me numrin 4D122; 4D285 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 30 prill 1999), f. 2; 4D286 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 1 maj 1999), f. 2; 4D123 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 2 maj 1999), f. 2; 4D422 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 3 maj 1999), f. 2; 4D287 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 4 maj 1999), f. 2; 4D288 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 5 maj 1999), f. 3; 4D356 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 7 maj 1999), f. 2; 4D315 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 10 maj 1999), f. 3; 4D290 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 12 maj 1999), f. 3; 4D316 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 13 maj 1999), f. 2-3; 4D291 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 14 maj 1999), f. 3; 4D358 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 15 maj 1999), f. 3; 4D317 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 16 maj 1999), f. 3; 4D292 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 17 maj 1999), f. 3; 4D336 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 19 maj 1999), f. 3; P2008 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 20 maj 1999), f. 4; 4D270 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 22 maj 1999), f. 3; 4D271 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 23 maj 1999), f. 3.

¹⁹¹³ 4D281 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 24 prill 1999), f. 2.

dhe konsumim i tepruar i alkoolit).¹⁹¹⁴ Raporti i luftimit për datën 12 maj informonte se kishte raste krime, sidomos ndërmjet vullnetarëve dhe rekrutëve, të cilat po gjenin përgjigje nga dega e sigurimit dhe masat e komandës.¹⁹¹⁵ Mirëpo, në asnjë prej këtyre raporteve nuk jepeshin hollësi për këto krime.

751. Dhoma dëgjoi argumente se raportet e luftimit të Komandës së Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë mund të jenë ndryshuar. Në këtë aspekt, Velimir Obradoviç dëshmoi se Pavkoviç nuk ishte asnjëherë i pranishëm në Qendrën Operative gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s dhe nuk e udhëzoi asnjëherë të mos përfshinte informacione të caktuara në raportet e luftimit që përgatiteshin në qendër.¹⁹¹⁶ Obradoviç dëshmoi, më tej, se Pavkoviç nuk kishte asnjë mundësi për të ndikuar në hartimin e raporteve të luftimit sepse këto raporte hartoheshin përditë nga oficerë roje të ndryshëm, çka, sipas Obradoviçit, e bënte thuajse të pamundur që ai “të bindte gjithë ata njerëz për këtë lloj gjëje”.¹⁹¹⁷ Mirëpo, Dhoma vëren se këto raporte u dërguan në emër të Pavkoviçit dhe Vasileviçit ia ngarkon faktin e raportimit të pamjaftueshëm Komandës së Armatës së Tretë.¹⁹¹⁸

752. Pas zbulimit të raportimit të pamjaftueshëm nga Armata e Tretë në prill dhe maj 1999, ky problem vijoi. Në raportimin për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, të datës 2 qershor 1999, Geza Farkashi i informoi të pranishmit se pjesëtarë të UJ-së në Kosovë po kryenin krime dhe se raportimet për këto krime nuk “po kalonin përmes kanaleve të rregullta dhe linjave të komandimit”.¹⁹¹⁹

753. Pas analizimit të këtyre raporteve të luftimit, Dhoma është e mendimit se, megjithëse përmendeshin aktivitete kriminale në Kosovë, në disa raste Armata e Tretë i minimizoi raportimet e veprave të rënda penale, siç duket qartë në mospërputhjet midis raporteve të luftimit të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë të datës 3 prill 1999. Një problem të ngjashëm zbuloi edhe Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë, kur doli në dritë çështja e krimeve të kryera nga UJ-ja, MPB-ja dhe grupet parashtarake në Kosovë dhe kur raportimi i pamjaftueshëm i krimeve çoi në

¹⁹¹⁴ 4D285 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 30 prill 1999), f. 3.

¹⁹¹⁵ 4D290 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 12 maj 1999), f. 3–4.

¹⁹¹⁶ Velimir Obradoviç, T. 17365 (22 tetor 2007). Prokuroria parashtroi se, për shkak të ndërrimit të turneve, Obradoviç nuk mundi të thoshte me siguri se Pavkoviç nuk i udhëzoi asnjëherë oficerët që përpilonin raportet e luftimit, së cilës Obradoviçiu iu përgjigj se ai kujdesej gjithmonë që të informohej për ato që ndodhnin në qendër gjatë mungesës së tij. Velimir Obradoviç, T. 17400 (22 tetor 2007).

¹⁹¹⁷ Velimir Obradoviç, T. 17366 (22 tetor 2007); Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 shtator 2007), para. 16.

¹⁹¹⁸ *Shih, p.sh.*, 3D1128 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 prill 1999).

¹⁹¹⁹ 3D633 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 1. Farkashi shpjegoi se, pas raportimit për Milloseviçin më 17 maj 1999, “gjërat morën zgjidhje ... dhe për njëfarë kohe vinin raporte të rregullta, mirëpo më pas

një sërë mbledhjesh me pjesëmarrjen e Ojdaniqit, Pavkoviqit, Millosheviqit dhe zyrtarëve të tjerë të UJ-së dhe MPB-së. Për më tepër, megjithëse raportet e luftimit përmendnin faktin se organet e drejtësisë ushtarake po hetonin dhe ndiqnin penalisht krime të ndryshme dhe po merreshin me shumë dosje, shumica e çështjeve lidheshin me krime të kryera kundër UJ-së, si mosparaqitja pas thirrjes për mobilizim dhe shmangia e shërbimit ushtarak dhe nuk i përmendnin veprat e tjera penale (më të rënda) të kryera kundër popullsisë civile përkundër kryerjes së përhapur të shpërnguljes së dhunshme, sikurse u përshkrua më lart në Kapitullin VII. Për rrjedhojë, Dhoma arrin në përfundimin se Pavkoviqi raportoi në masë të pamjaftueshme dhe u orvat të minimizonte implikimin e forcave në vartësi të tij në kryerjen e krimeve në Kosovë.

iv. Informacioni i dhënë nga bashkësia ndërkombëtare

754. Krahas raporteve të ndryshme të brendshme nga njësitë dhe organet e UJ-së të cilat informonin për aktivitet kriminal të pjesëtarëve të UJ-së në vitin 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së nxori rezoluta në të cilat përcillte informacion të ngjashëm.¹⁹²⁰ Më 3 shkurt 1999, Drewienkiewicz-i e informoi Llonçarin për plaçkitjen e shtëpive të civilëve në fund të muajit janar 1999 nga anëtarë të UJ-së dhe MPB-së.¹⁹²¹ Mirëpo, Llonçari dëshmoi vetëm për raportimin prej tij të këtyre incidenteve tek Shainoviqi.¹⁹²² Më pas, Drewienkiewicz-i nxori një deklaratë për shtyp jo më vonë se 2 prill 1999, në të cilën ai informonte për një numër të madh shqiptarësh kosovarë të shpërngulur të cilët mbërrinin në kufi, dhe përcillte raporte për mizori të përhapura të kryera nga UJ-ja dhe MPB-ja, përfshirë edhe dëbimin nga Kosova. Në deklaratën për shtyp të Drewienkiewicz-it thuhej se me mijëra shqiptarë kosovarë të shpërngulur ishin larguar për në Maqedoni një ditë më parë, ndërsa shumë të tjerë ishin parë të largoheshin me tren atë ditë, krahas 50.000 të tjerëve që prisnin të kalonin kufirin.¹⁹²³ Ai përmendi konkretisht “plaçkitjen sistematike” dhe largimin e dhunshëm të shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, ku, sipas Llazareviqit, Pavkoviqi shkonte “çdo ditë” gjatë konfliktit.¹⁹²⁴ Komanda e Armatës së Tretë kishte një degë për informatat nga zbulimi dhe shefit të Shtabit të Armatës së Tretë i ishte ngarkuar detyra konkrete e transmetimit

përsëri doli ky problem kur erdhi puna te tërheqja e trupave nga Kosova”. Ai shtoi se kishte informacion se “informacioni që merrnin nuk ishte i mjaftueshëm”. Geza Farkash, T. 16364–16365 (25 shtator 2007).

¹⁹²⁰ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998), f. 1; P456 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199, 23 shtator 1998), f. 1.

¹⁹²¹ P621 (Letër e OSBE-së drejtuar Komisionit të RFJ-së për Bashkëpunim me KVM-në), f. 1; *shih edhe* Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë e dëshmitarit, datë 23 qershor 2000), f. 31–32.

¹⁹²² Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 28, T. 7576–7578 (30 nëntor 2006). Llonçari dëshmoi se kishte pasur kontakte telefonike me Pavkoviqin dhe Lluqiun dhe se ata ishin në komunikim të rregullt me njëri-tjetrin, kështu që ai mund ta informonte Pavkoviqin për çdo zhvillim të rëndësishëm në terren, por nuk përmendi nëse e kishte informuar apo jo Pavkoviqin për këto incidente. Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit, datë 3 mars 2004), para. 47; Dushan Llonçar, T. 7652–7654 (1 dhjetor 2006).

¹⁹²³ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999); Karol John Drewienkiewicz, T. 7815 (4 dhjetor 2006).

të të dhënave të zbulimit, komandantit.¹⁹²⁵ Duke pasur parasysh përmbajtjen e deklaratës për shtyp të Drewienkiewicz-it dhe namin e keq që kishte në sytë e autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë, Dhoma bindet se Pavkoviqi u vu në dijeni të këtij raporti në fillim të muajit prill 1999.

755. Krahas të gjitha raporteve nga njësitë dhe organet e UJ-së, Pavkoviqi ishte vënë në dijeni të pretendimeve për krime të kryera në masë nga efektivi i UJ-së përmes komunikimeve nga Prokurorja e Tribunalit, Louise Arbour. Pavkoviqi mori brenda datës 29 prill 1999, një letër nga Arbour ku ngriheshin pretendime për aktet kriminale të vartësve të tij.¹⁹²⁶ Për më tepër, më 27 maj 1999 u bë publike aktakuza e parë kundër Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit dhe Stojilkoviqit, e cila ishte depozituar më 23 maj 1999.¹⁹²⁷ Aktakuza u diskutua në mbledhjen e Shtabit të Komandës së Lartë të datës 28 maj, ku Branko Kërگا tha se një prej qëllimeve të ngritjes së aktakuzës kundër zyrtarëve të lartë të RFJ-së/Serbisë ishte pengimi i nismave për paqen.¹⁹²⁸ Duke pasur parasysh këtë dijeni brenda UJ-së, Pavkoviqi duhet të ketë qenë i informuar për ekzistencën e aktakuzës më 27 maj, ose rreth kësaj date.

756. Në këtë aktakuzë kishte akuza konkrete për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në të gjithë Kosovën nga forcat që ndodheshin nën kontrollin e Pavkoviqit, të cilat përbëjnë edhe aktakuzën e kësaj çështjeje dhe në të renditen emrat e viktimave të vrasjeve të pretenduara, për shumë prej të cilave është vërtetuar se janë vrarë nga forcat e RFJ-së/Serbisë, sikurse është shpjeguar me hollësi në Kapitullin VII. Në aktakuzën e parë parashtrohej se pjesëtarë të UJ-së dhe MPB-së po kryenin krime, përfshirë dëbimin e popullatës në Mitrovicë, dëbim dhe dhunë seksuale në Deçan, dëbim në Pejë, dëbim në Prishtinë, dëbim në Prizren, dëbim dhe vrasje në Gjakovë, dëbim në Gjilan, Kaçanik, Rahovec dhe Skënderaj, dhe dëbim në Ferizaj—të gjitha këto figurojnë edhe në Aktakuzën e tanishme dhe për të cilat është vërtetuar implikimi i ushtarëve të UJ-së. Këto forca të UJ-së qenë të Armatës së Tretë në periudhën përkatëse dhe, rrjedhimisht ishin nën urdhrat e Pavkoviqit.

757. Më 17 maj Pavkoviqi i dërgoi letër Ojdaniqit në të cilën u përgjigjej akuzave të ngritura nga Arbour në mars 1999.¹⁹²⁹ Në letër ai thoshte se të gjitha veprimet e tij në cilësinë e komandantit të

¹⁹²⁴ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999), f. 3; Vladimir Llazareviq, T. 18080 (12 nëntor 2007).

¹⁹²⁵ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 9.

¹⁹²⁶ P401 (Letër e Louise Arbour-it drejtuar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999); 3D788 (Letër përcjellëse e Zoran Knezheviqit për Louise Arbour-in, 29 prill 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046 (20 shtator 2007).

¹⁹²⁷ Aktakuza e parë ishte kundër Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit dhe Stojilkoviqit. P968 (Prokurori kundër *Millosheviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IC-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999).

¹⁹²⁸ 3D628 (Raportim për Shefin e Shtabit, 28 maj 1999), f. 1.

¹⁹²⁹ 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046 (20 shtator 2007). Kjo letër bënte të ditur se ishte përgjigje ndaj një urdhri të Drejtorisë Juridike të Shtabit të Komandës së Lartë të datës 10 maj 1999 drejtuar të gjithë komandantëve të UJ-së për respektimin e ligjeve të luftës. *Shih* 3D483 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 10 maj 1999).

Korpusit të Prishtinës dhe, më vonë, në cilësinë e komandantit të Armatës së Tretë, kishin qenë në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për UJ-në. Më tej ai vijonte se i kishte informuar gjithmonë eprorët e tij për veprimtaritë e njësisë së tij dhe se kishte shpërndarë informacion lidhur me detyrimet e vartësve të tij për të zbatuar të drejtën humanitare ndërkombëtare. Në mbyllje, ai shprehej se nuk kishte kompetencë për të lejuar kryerjen e hetimeve për krimet e luftës dhe se kjo kompetencë i takonte qeverisë federale.¹⁹³⁰ Mirëpo Dhoma vëren se Pavkoviqi ishte në gjendje të niste hetime për krimet e pretenduara të luftës dhe se ai krijoi një komision pasi u vu në dijeni të akuzave lidhur me një kamp burgimi në komunën e Istogut, sikurse është diskutuar më lart. Për më tepër, shpjegimi se në rrëmujën e fundit të bombardimit nga NATO-ja nuk kishte kohë për marrje masash, nuk përputhet me ngritjen e menjëhershme të këtij komisioni nga ana e tij.¹⁹³¹ Përgjigja e Pavkoviqit lidhur me aktakuzën, se ai nuk ishte në gjendje të merrte masa të mëtejshme kundër autorëve të krimeve në Kosovë, nuk përmendte masat që ai mund të merrte, siç qenë masat disiplinore, krijimi i një komisioni mbi dëbimet në masë, përdorimi i Degës së Sigurimit të Armatës së Tretë, në detyrat e së cilës përfshihej edhe hetimi i krimeve të pretenduara të kryera nga anëtarët e UJ-së, apo angazhimi i ekspertëve kriminalistë.¹⁹³²

v. Pavkoviqi dhe sistemi i drejtësisë ushtarake

758. Llakiq Gjoroviqi, prokurori ushtarak dëshmia e të cilit është analizuar me hollësi në Ndarjen VI.A.1.e, dëshmoi se ndjekja penale e anëtarëve të UJ-së për krimet e kryera gjatë konfliktit ishte jo e plotë, kryesisht si pasojë e moskallëzimit dhe e fshehjes së provave nga administrata e sigurimit e UJ-së.¹⁹³³ Versioni i tij i përgjithshëm për ndërhyrjet lidhur me ndjekjet penale të krimeve të rënda në Kosovë përputhet me informacionin e paraqitur në raportet nga gjykatat ushtarake.¹⁹³⁴

¹⁹³⁰ 3D790 (Letër e Pavkoviqit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999). *Shih edhe* Stanimir Radosavleviq, T. 17499–17500 (23 tetor 2007).

¹⁹³¹ 4D86 (Urdhër i Nebojsa Pavkoviqi për krijimin e një komisioni, 13 prill 1999). Këtij komisioni iu dhanë dy ditë për kryerjen e hetimeve paraprake dhe për të raportuar.

¹⁹³² 4D86 (Urdhër i Nebojsa Pavkoviqi për krijimin e një komisioni, 13 prill 1999); Gordana Tomasheviq, T. 7022–7025, 7044 (21 nëntor 2006), P2490 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 mars 2003), f. 3–4, P2507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2006), f. 2–3.

¹⁹³³ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 6, 9.

¹⁹³⁴ P1912 (Raport i Armatës së Tretë mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raport mbi Ecurinë e Punës për Prokuroritë dhe Gjykatat Ushtarake në Kohë Luftë, 30 prill 1999); P1182 (Informacion dërguar Brigadës 52 Artilerike të Raketave nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999); 3D986 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbi çështjet penale, 6 shtator 1999), f. 7–10. P962 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, maj 1998–korrik 1999); P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002); P954 (Raport mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001); P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake); P845 (Raport mbi çështjet penale në gjykatat ushtarake për dhunë seksuale, 10 shtator 2002); 4D171 (Raport i Prokurorit Ushtarak, 6 prill 2001).

759. Gjoroviqi dha dëshmi konkrete se punonjësit e tij si edhe UJ-ja në përgjithësi, përdornin vetura “të konfiskuara” në Kosovë gjatë periudhës që lidhet me Aktakuzën dhe se Pavkoviqi u implikua në këto aktivitete.¹⁹³⁵ Dhoma dëgjoi edhe Millan Uzelacin, shefi i Administratës së Transportit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, dhe Millosh Spasojeviqin, Prokurori Ushtarak i Korpusit të Prishtinës, të cilët Dhoma i konsideroi jo të besueshëm.

760. Nga dokumentet që i janë dhënë, Gjoroviqi arriti në përfundimin se Pavkoviqi urdhëroi mbajtjen e një mbledhjeje të parë për mënyrën e ndarjes së mallrave të sekuestruara midis UJ-së dhe MPB-së dhe fshehjen e vjedhjes së tyre.¹⁹³⁶ Gjoroviqi dëshmoi më tej se në procesverbalin e një mbledhjeje të dytë të të njëjtëve persona shënoj se mbledhja u bë në zyrat e Kryetarit të Gjykatës së Lartë Ushtarake në fund të tetorit ose në fillim të nëntorit 1999 dhe se në të qenë të pranishëm po ata persona që kishin qenë të pranishëm edhe në mbledhjen e parë.¹⁹³⁷ Pjesëmarrësit diskutuan për faktin se Pavkoviqi ishte inatosur me ta kur qe informuar për përmbajtjen e mbledhjes së parë, sepse ai mendonte se nuk u duhej kërkuar mendim juristëve lidhur me këtë çështje dhe se automjetet e sekuestruara thjesht u duheshin shpërndarë MPB-së, Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes.¹⁹³⁸ Në një mbledhje të tretë, me pjesëmarrjen e të paktën 30 oficerëve nga Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, në të cilin mori pjesë edhe Gjoroviqi, Uzelaci dhe oficerë të tjerë diskutuan faktin se Pavkoviqi dhe Ojdaniqi ishin inatosur se automjetet ende nuk qenë shpërndarë.¹⁹³⁹

761. Pas mbledhjes, Gjoroviqi, së bashku me Grigoriye Spasojeviqin nga Shtabi i Përgjithshëm, u udhëzua që të hartonte një urdhër për t’u nënshkruar nga Pavkoviqi dhe Ojdaniqi. Udhëzimi ishte që urdhri të hartohej në mënyrë të tillë që të gjitha mallrat në zotërim të UJ-së pas tërheqjes së forcave nga Kosova të trajtoheshin si plaçkë lufte dhe të mbeteshin në zotërim të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe të MPB-së. Kur Gjoroviqi e hartoi ndryshe vendimin, Radomir Gojoviqi (shefi i atëhershëm i Drejtorisë Juridike të Shtabit të Përgjithshëm) “u çmend”.¹⁹⁴⁰ Atëherë, Pavkoviqi dhe Ojdaniqi vendosën të mos e lëshonin urdhrin fare dhe thjesht t’i mbanin automjetet

¹⁹³⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 40–41; Llakiq Gjoroviq, T. 11470–11481 (12 mars 2007). *Shih* Millan Uzelac, T. 16157–16158 (21 shtator 2007); Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë e dëshmitarit, datë 9 janar 2007), para. 7.

¹⁹³⁶ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 41. *Shih* Millan Uzelac, T. 16162, 16172–16174 (21 shtator 2007).

¹⁹³⁷ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 42.

¹⁹³⁸ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 42. *Shih* Millan Uzelac, T. 16164 (21 shtator 2007).

¹⁹³⁹ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 43; T. 11476–11478 (12 mars 2007). *Shih* P2752 (Evidencë e veturave të sekuestruara përkohësisht, 23 nëntor 1999); *Shih* Millan Uzelac, T. 16164 (21 shtator 2007).

¹⁹⁴⁰ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 45.

dhe mallrat.¹⁹⁴¹ Nga ana tjetër, Uzelaci dëshmoi se administrata e transportit dhe Shtabi i Përgjithshëm bënë përpjekje të menjëhershme për t'i kthyer automjetet pas luftës. Kur pronarët u paraqitën për t'i marrë automjetet e tyre, atyre që kishin vërtetim pronësie iu kthyen automjetet. Gjithsesi Uzelaci pranoi se nuk u bë asnjë njoftim publik në mënyrë që pronarët e automjeteve të dinin si të bënin kërkesën për kthimin e tyre.¹⁹⁴²

762. Gjoroviqi dëshmoi edhe se gjatë kohës së tij në Beograd ai nisi një hetim kundër Millovan Tijaniqit, një oficer rezervist në degën e prokurimeve teknike në Korpusin e Prishtinës, i cili sekuestroi mallra në mënyrë të paligjshme gjatë bombardimit të NATO-s dhe i transportoi ato me kamion për në Beograd, në shoqërimin e organeve të sigurimit dhe organeve të policisë ushtarake.¹⁹⁴³ Megjithëse, Gjoroviqi pretendoi se sekuestrimi i paligjshëm i sendeve që bërë sipas urdhrave të Pavkoviqit dhe Ojdaniqit,¹⁹⁴⁴ të cilët si pasojë kishin kryer “shpërdorim pushteti”, ai pranoi se nuk kishte parë asnjëherë asnjë urdhër të nënshkruar nga Pavkoviqi apo nga Ojdaniqi.¹⁹⁴⁵ Ai shtoi se këtë informacion e mori nga një sërë personash, si Mihal Kertesi (shefi i administratës doganore), ministri i Shëndetësisë dhe komisioneri për refugjatët, si edhe nga administratorë të dyqaneve dhe firmave të ndryshme. Më tej, Gjoroviqi sqaroi se vetë Tijaniqi i kishte thënë se kishte lejen e udhëheqjes ushtarake, që nga ministri i Mbrojtjes e deri te Ojdaniqi dhe Pavkoviqi.¹⁹⁴⁶

763. Krahas dijenisë që kishte se anëtarët e sistemit të drejtësisë ushtarake qenë implikuar në aktet kriminale që kishin të bënin me pasuritë e shqiptarëve kosovarë, Pavkoviqi ishte në dijeni për funksionimin në përgjithësi jo të duhur të sistemit të drejtësisë ushtarake të UJ-së. Mospërputhja midis numrit të madh të incidenteve të shpërnguljes së dhunshme dhe krimeve të tjera të rënda në lidhje me të cilat merrte informacion, sikurse diskutohet më poshtë dhe numrit të vogël të hetimeve dhe ndjekjeve penale për krime të tilla të ndërmarra nga sistemi i drejtësisë ushtarake, duhet ta kishte ndërgjegjësuar Pavkoviqin se ky sistem nuk po funksiononte si duhej.¹⁹⁴⁷ Madje, pasi i

¹⁹⁴¹ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 45.

¹⁹⁴² Millan Uzelac, T. 16177–16179 (21 shtator 2007).

¹⁹⁴³ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 18; T. 11421 (12 mars 2007). *Shih* Millutin Fillipoviq, T. 19154–19155 (27 nëntor 2007); Novica Stamenkoviq, T. 20115–20118 (12 dhjetor 2007); Branko Zhigiq, 3D528 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 janar 2007), para. 5–6, T. 15949–15951 (19 shtator 2007).

¹⁹⁴⁴ Dhoma vëren se, megjithëse në deklaratën e tij me shkrim, Gjoroviqi pohonte se “Pavkoviqi dhe Llazareviqi i dhanë ... Tijaniqit ... leje për të mbledhur sende ... që mund të kishin vlerë për Korpusin e Prishtinës”, ai nuk iu mbajti këtij qëndrimi përpara gjykatës dhe dëshmoi se Pavkoviqi dhe Ojdaniqi qenë ata që i dhanë leje Tijaniqit. Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 17; T. 11625–11628 (13 mars 2007).

¹⁹⁴⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 shtator 2006), para. 17–18, T. 11421 (12 mars 2007). *Shih* Arsenije Kataniq, T. 15961–15969 (19 shtator 2007); *shih edhe* 3D530 (deklaratë e dëshmitarit, datë 18 janar 2007), para. 5–6.

¹⁹⁴⁶ Llakiq Gjoroviq, T. 11625–11627 (13 mars 2007), T. 11718–11723 (14 mars 2007).

¹⁹⁴⁷ P1912 (Raport i Armatës së Tretë mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raport mbi Ecurinë e Punës për Prokuroritë dhe Gjykatat Ushtarake në Kohë Luftë, 30 prill 1999); P1182

treguan raporte të tilla, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi, ia vuri në dukje këtë mospërputhje Gojoviqit, sikurse është përmendur në Pjesën VIII.E.¹⁹⁴⁸

764. Sa i takon sekuestrimit të pasurive shqiptare kosovare, Dhoma konkludon se dëshmia e Llakiq Gjoroviqit është e besueshme dhe e saktë dhe nuk gjykon se dëshmitarët e thirrur për ta përgënjeshtuar këtë dëshmi, kanë arritur të vënë në dyshim vërtetësinë e tij. Megjithatë dëshmia e tij për rolin e Pavkoviçit në këtë aspekt bazohet në dijeni të tërthortë, implikimi i më shumë se 30 oficerëve të UJ-së, përfshirë edhe anëtarë të sistemit të drejtësisë ushtarake, dhe fakti se kishte të bënte me pasuri të sekuestruara nga Kosova, e mbështesin dëshminë e tij se Pavkoviçiq ishte në dijeni të konfiskimit të paligjshëm dhe shpërndarjes së pasurive shqiptare kosovare nga forcat e UJ-së dhe të implikimit të anëtarëve të sistemit të drejtësisë ushtarake në këtë praktikë.

vi. Përfundim

765. Në mbledhjet e organizuara mbi raportimin të pamjaftueshëm nga ana e Pavkoviçit, të krimeve të kryera në Kosovë nga UJ-ja, MPB-së dhe forcat paraushtarake, ai sugjeroi një komision, por ky komision nuk u formua, dhe ai nuk mori asnjë masë të efektshme për zgjidhjen e këtij problemi.¹⁹⁴⁹ Pas fushatës ajrore të NATO-s, ai u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm në vitin 2000 dhe, si rrjedhojë kishte pushtetin për të kryer hetime mbi sjelljen e çdo anëtari të UJ-së, por nuk ngriti asnjë komision të posaçëm për të hetuar implikimin e UJ-së në këto krime. Mosveprimi i mëpasshëm nga ana e tij lidhet me synimin e tij të atëhershëm. Dhoma vëren se përgjigjja e Pavkoviçit lidhur me aktakuzën, *d.m.th.* se ai nuk ishte në gjendje të merrte masa të mëtijshme kundër autorëve të krimeve në Kosovë, nuk përmendte masat që ai mund të merrte, si masat disiplinore, krijimi i një komisioni mbi dëbimet në masë, apo angazhimi i ekspertëve të kriminalistikës.¹⁹⁵⁰ Dhoma ka shqyrtuar provat lidhur me urdhrat e dhënë nga Pavkoviçiq për respektimin e së drejtën humanitare ndërkombëtare dhe për parandalimin e largimit të shqiptarëve

(Informacion dërguar Brigadës 52 Artilerike të Raketave nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999); 3D986 (Raport i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbi çështjet penale, 6 shtator 1999); P962 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, maj 1998–korrik 1999); P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002); P954 (Raport mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001); P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake); P845 (Raport mbi çështjet penale në gjykatat ushtarake për dhunë seksuale, 10 shtator 2002); 4D171 (Raport i Prokurorit Ushtarak, 6 prill 2001).

¹⁹⁴⁸ Radomir Gojoviq, T. 16679, 16685 (2 tetor 2007).

¹⁹⁴⁹ 3D1061 (Raport Shtesë i Armatës së Tretë, 14 korrik 1999); Aleksandar Vasileviq, P2594 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 tetor 2006), para. 57 (nën vulë); Branko Gajiq, T. 15304–15305 (10 shtator 2007).

¹⁹⁵⁰ 3D790 (Letër e Pavkoviçit në përgjigje të akuzave të Louise Arbour-it, 17 maj 1999); 4D86 (Urdhër i Nebojsa Pavkoviçiq për krijimin e një komisioni, 13 prill 1999); Gordana Tomasheviq, T. 7022–7025, 7044 (21 nëntor 2006), P2490 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 mars 2003), f. 3–4, P2507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2006), f. 2–3.

kosovarë nga Kosova.¹⁹⁵¹ Pasi thekson deklaratën lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë që “t’i përgatisim këto aksione dhe t’i maskojmë aksionet tona me masa për civilët”, të cilën Miniqi e bëri në prani të Pavkoviqit në një mbledhje të Komandës së Përbashkët në gusht 1998,¹⁹⁵² dhe duke marrë parasysh dëshminë e K90-s se shqiptarët kosovarë u penguan që të largoheshin nga zonat ku vepronte UJ-ja sepse kjo do ta kishte lënë UJ-në pa mbrojtjen e popullsisë civile dhe të zbuluar ndaj sulmeve të NATO-s, Dhoma nuk gjykon se këto qenë masa të sigërtë për kufizimin e aktivitetit kriminal që po ndodhte në Kosovë.¹⁹⁵³ Së fundmi, Mbrojtja e Pavkoviqit thekson lirimin nga detyra të tre komandantëve të brigadave gjatë fushatës së NATO-s prej Pavkoviqit, si një shembull të një mase të efektshme të marrë në përgjigje të kryerjes së krimeve në Kosovë.¹⁹⁵⁴ Mirëpo në lidhje me këtë shembull, Dhoma vëren se Pavkoviqi deklaroi se motivi i tij për lirimin nga detyra të komandantëve të brigadave lidhej me rritjen e gatishmërisë luftarake dhe, rrjedhimisht Dhoma nuk e konsideron masë të sigërtë apo të efektshme për kufizimin e aktivitetit kriminal të UJ-së në Kosovë.

766. Për rrjedhojë, Dhoma arrin në përfundimin se Pavkoviqi ishte në dijeni të akuzave konkrete për krimet e kryera gjithandej, përfshirë shpërnguljet e dhunshme brenda dhe jashtë Kosovës, vrasje, dhunë seksuale, që po kryheshin kundër popullsisë civile shqiptare kosovare nga anëtarët e UJ-së dhe MPB-së gjatë fushatës së NATO-s.¹⁹⁵⁵

5. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Nebojsa Pavkoviqit

767. Tani, Dhoma i kthehet çështjes së përgjegjësisë penale individuale të Pavkoviqit për krimet e kryera nga UJ-ja dhe MPB-së në Kosovë nga muaji mars deri në muajin qershor 1999.

768. Prokuroria pretendon se Pavkoviqi është përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) apo për ndihmë dhe inkurajim të krimeve në Aktakuzë.¹⁹⁵⁶ Ai akuzohet me përgjegjësinë si epror për mosparandalimin

¹⁹⁵¹ P1766 (Urdhër i Armatës së Tretë për strehimin dhe ndihmën për “refugjatët”, 19 prill 1999), pranuar edhe me numrin 4D350.

¹⁹⁵² P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 52–53; P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 364.

¹⁹⁵³ K90, T. 9408 (30 janar 2007).

¹⁹⁵⁴ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 270–271, 394 (deklarohet se u liruan nga detyra tre dhe më tej sqarohet se dy u liruan nga detyra dhe ndaj njërit u morën masa disiplinore). *Shih edhe* 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me listën e udhëzimeve, 7 maj 1999), para. 7.

¹⁹⁵⁵ Aktakuza e parë ishte kundër Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit dhe Stojilkoviqit; P968 (*Prokurori kundër Millosheviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr IC-99-37, Aktakuza e Parë, 23 maj 1999), f. 2–29; P401 (Letër e Louise Arbour-it drejtuar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999); 3D788 (Letër përcjellëse e Zoran Knezheviqit për Louise Arbour, 29 prill 1999); Millovan Vllajkoviq, T. 16046 (20 shtator 2007).

¹⁹⁵⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 843, 909.

apo mosndëshkimin e krimeve të kryera nga vartësit e tij.¹⁹⁵⁷ Mbrojtja e Pavkoviçit përgjigjet se Prokuroria nuk ka vërtetuar asnjë prej këtyre formave të përgjegjësisë.¹⁹⁵⁸

769. Sipas Prokurorisë, provat tregojnë se Pavkoviç ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe se kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e kësaj ndërmarrjeje. Prokuroria parashtron se Pavkoviç kishte synimin e përbashkët me të tjerë për zbatimin e planit të përbashkët dhe veprimet e tij—përfshirë edhe komandimin, urdhërimin dhe udhëzimin nga ana e tij e operacioneve të UJ-së në Kosovë, përfshirë edhe operacionet e përbashkëta me MPB-në—tregojnë se ai synonte realizimin e këtij plani përmes mjeteve kriminale.¹⁹⁵⁹ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Pavkoviçit argumenton se ai nuk mori pjesë në ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe se nuk është vërtetuar që ai të ketë pasur synimin për të marrë pjesë në një ndërmarrje të tillë.¹⁹⁶⁰

770. Që Pavkoviç të ngarkohet me fajësi në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të dëshmojnë se ai ka marrë pjesë së paku në një aspekt të qëllimit të përbashkët për mundësimin e vijimësisë së kontrollit të Kosovës nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë, përmes krimeve të shpërnguljes me dhunë, që Dhoma tashmë ka konkluduar se ekzistonte.¹⁹⁶¹ Për vërtetimin e këtij elementi, nuk është e domosdoshme që Pavkoviç t'i ketë kryer fizikisht krimet përmes të cilave është arritur qëllimi, apo edhe krime të tjera.¹⁹⁶² Madje, nuk as është e domosdoshme që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të këtyre krimeve.¹⁹⁶³ Mirëpo, duhet që kontributi i tij në këtë plan të ketë qenë i konsiderueshëm.¹⁹⁶⁴ Sa i synimit kriminal, duhet vërtetuar që Pavkoviç mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte synimin e përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë që përbën objektivin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, e cila në këtë rast është shpërngulja me dhunë.

771. Çështjet e trajtuara janë ilustruar me shembuj konkretë, mirëpo Dhoma thekson se përfundimet bazohen në të gjitha provat përkatëse.

772. Fillimisht, lidhur me elementin mendor, Dhoma gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjitha veprimet e Pavkoviçit, të përshkruara më lart, janë kryer me

¹⁹⁵⁷ Aktakuza, para. 16–22, 50–54.

¹⁹⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit (version publik), 28 korrik 2008, para. 18.

¹⁹⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 8, 843–846.

¹⁹⁶⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit (version publik), 28 korrik 2008, para. 18.

¹⁹⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁹⁶² Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁹⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

¹⁹⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

vullnet të lirë dhe jo me detyrim. Dhoma është gjithashtu e bindur se Pavkoviçi kishte synimin për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi Kosovën përmes krimeve të shpërnguljes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare.

773. Së pari Dhoma vëren se, si komandant i Korpusit të Prishtinës në vitin 1998, dhe më pas si komandant i Armatës së Tretë, Pavkoviçi kishte kompetenca të gjera *de jure* dhe kishte pushtet komandues mbi forcat e UJ-së në Kosovë gjatë gjithë periudhës në të cilën janë kryer krimet. Për më tepër, ndikimi i Pavkoviçit rritej edhe nga pushteti i tij i konsiderueshëm *de facto*. Si anëtar i Komandës së Përbashkët në vitin 1998, ai punoi bashkëpunoi ngushtësisht me drejtuesit e MPB-së, sidomos me Sreten Llukiqin. Ai kishte lidhje të ngushtë me “Kryekomandantin”, sidomos përsa i përket veprimtarisë së MPB-së dhe UJ-së në Kosovë, e cila ekzistoi viti 1998 më 1999.

774. Informacioni i marrë nga Pavkoviçi përpara dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s është provë e rëndësishme për përcaktimin e përgjegjësisë së tij, sepse dijenia e tij për kryerjen e krimeve nga vartësit e UJ-së dhe pjesëtarët e MPB-së, e ndërthurur me urdhrat e vazhdueshëm të tij për pjesëmarrjen në operacionet e përbashkëta me këta autorë të krimeve, tregon synimin e tij për kryerjen e këtyre krimeve. Pavkoviçi ishte në dijeni se në vitin 1998 po kryheshin krime dhe se forcat që kishte nën kontroll mbanin përgjegjësi për këto krime.¹⁹⁶⁵ Për shembull, atij iu tha disa herë se duhej ndaluar djegia e fshatrave në Kosovë.¹⁹⁶⁶ Ai dha urdhër për dislokimin e UJ-së në Drenicë në fillim të muajit gusht 1998, në kundërshtim me urdhrat e eprorit të tij, Samarxhiqit, dhe gjatë këtij operacioni u përdor forcë e tepruar. Ai u informua për krimet e dhunshme të kryera gjatë operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Abri të Epërme dhe për pretendimet se UJ-ja dhe MPB-ja qenë përgjegjëse për këto krime.¹⁹⁶⁷ Në raportin e tij të mëpasshëm ai orvatej ta minimizonte incidentin e rëndë dhe të mos jepte informacionet që dinte.¹⁹⁶⁸ Pavkoviçi ishte gjithashtu në dijeni të pretendimeve të ngritura nga bashkësia ndërkombëtare se përdorimi i tepruar dhe pa dallim i forcës nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në vitin 1998 kishte shkaktuar shpërngulje të dhunshme të mbi 230 mijë shqiptarëve kosovarë.¹⁹⁶⁹ E megjithatë, ndonëse kishte dijeni për aktivitetin e mëparshëm kriminal të forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe për akuzat mbi aktivitetin kriminal të përhapur të forcave të UJ-së dhe MPB-së kundër shqiptarëve kosovarë,

¹⁹⁶⁵ *Shih, p.sh.* 4D428 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 27 maj 1998); P1422 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me “tejpërdorimin” e pajisjeve, 7 gusht 1998).

¹⁹⁶⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 46; 4D97 (Procesverbal i mbledhjes informuese të komandantëve të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, 7 gusht 1998), f. 3.

¹⁹⁶⁷ P441 (Raport i organizatës “Human Rights Watch”, 1 shkurt 1999), f. 16–48; Frederick Abrahams, T. 806–811 (13 korrik 2006); P1011 (Ivan Marković, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 70–72; P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse, 5 tetor 1998), f. 4.

¹⁹⁶⁸ P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse, 5 tetor 1998), f. 4.

Pavkoviqi urdhëroi operacionet e UJ-së në bashkëpunim me MPB-në në Kosovë në mars 1999 dhe më pas.¹⁹⁷⁰

775. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Pavkoviqi vazhdoi të merrte informacion se anëtarët e UJ-së po kryenin krime kundër civilëve në Kosovë. Sistemi i komandimit dhe komunikimit në UJ funksionoi gjatë gjithë sulmeve ajrore dhe Pavkoviqi ishte i pranishëm në postëkomandën e Korpusit të Prishtinës në Prishtinë rregullisht gjatë konfliktit dhe mori pjesë në një mbledhje atje me Stevanoviqin dhe Gjorgjeviqin nga MPB-ja ndërkohë që shqiptarët kosovarë po shpërnguleshin me dhunë nga ky qytet nga forcat e UJ-së dhe MPB-së të cilat bashkëvepronin.¹⁹⁷¹ Prania e tij e shpeshtë në terren në Kosovë,¹⁹⁷² së bashku me praktikën e përhapur të shpërnguljes së shqiptarëve kosovarë, vërtetojnë pretendimin se ai ishte në dijeni të veprave penale të kryera në Kosovë nga MPB-ja dhe UJ-ja. Raporte nga burime ndërkombëtare e vunë në dijeni të implikimit të MPB-së dhe UJ-së në shpërnguljen e dhunshme dhe kryerjen e krimeve kundër shqiptarëve kosovarë, përfshirë edhe qytetin e Prishtinës ku ai ndodhej rregullisht.¹⁹⁷³ Në ditët e para të sulmeve ajrore, ai përmendi shtimin e rasteve të indisiplinimit dhe të shkeljeve nga anëtarët e UJ-së në lidhje me civilët shqiptarë kosovarë dhe pasuritë e tyre.¹⁹⁷⁴ Më pas, ai mori informacione të tjera të cilat bënë ditur për veprat penale të kryera nga vartësit e tij që vepronin në Kosovë, përfshirë edhe krime të dhunshme të rënda.¹⁹⁷⁵ Krahas këtyre, ai pranoi se anëtarët e MPB-së u kishin marrë dokumentet e identitetit shqiptarëve kosovarë dhe se MPB-ja po kryente krime të tjera të rënda, por vijoi me urdhra për kryerjen e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së.¹⁹⁷⁶ Përveçse ishte i pranishëm në terren në Kosovë gjatë zhvillimit të fushatës së shpërnguljeve të dhunshme, ai ishte i pranishëm rregullisht edhe në Beograd dhe mori pjesë në mbledhje e takime me udhëheqjen ushtarake dhe civile të RFJ-së dhe Serbisë. Tema e krimeve të rënda të kryera nga anëtarët e UJ-së dhe MPB-së u diskutua në mbledhjet e datave 4 maj, 16 maj dhe 17 maj, në të cilat mori pjesë edhe Pavkoviqi.

¹⁹⁶⁹ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998), f. 1; P456 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199, 23 shtator 1998), f. 1.

¹⁹⁷⁰ 5D245 (Urdhër "Grom 3" i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), f. 5; 4D103 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë për Mbrojtjen nga sulmet e NATO-s, 23 mars 1999), para. 1.6; Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 38.

¹⁹⁷¹ Vladimir Llazareviq, T. 18260 (14 nëntor 2007).

¹⁹⁷² P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 92; Vladimir Llazareviq, T. 18080 (12 nëntor 2007); Mirko Starçeviq, T. 17436 (22 tetor 2007).

¹⁹⁷³ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999); Karol John Drewienkiewicz, T. 7815 (4 dhjetor 2006).

¹⁹⁷⁴ 4D154 (Paralajmërim i Armatës së Tretë për komandat në vartësi, 27 mars 1999).

¹⁹⁷⁵ *Shih, p.sh.*, P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁷⁶ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 91-92; P1459 (Raport i Armatës së Tretë për moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999).

776. Pavkoviqi raportoi pamjaftueshmërisht mbi krimet në vitin 1999, ku përfshiheshin vrasjet dhe tentativat për vrasje nga ana e vartësve të tij në UJ, çka përbën shkelje të detyrimit të qartë për t'ia raportuar këto incidente Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁹⁷⁷ Dhoma vëren se shpjegimi i dhënë për këtë raportim të pamjaftueshëm, d.m.th. që ishte një pakujdesi e parëndësishme dhe se po bëheshin ndjekje penale të efektshme kundër autorëve të krimeve, nuk e cenon përfundimin se Pavkoviqi u përpoq ta minimizonte implikimin e UJ-së në aktivitetin kriminal dhe nuk përputhet me faktin se ai vijoi të raportonte për krimet më pak të rënda në këto raporte edhe atëherë kur këto çështje qenë në duart e organeve të drejtësisë ushtarake.¹⁹⁷⁸

777. Dhoma ka analizuar provat që lidhen me përpjekjet e Pavkoviqit për kufizimin dhe hetimin e krimeve të kryera në Kosovë, përfshirë edhe sugjerimin për krijimin e një komisioni të përbashkët shtetëror, lirim nga detyra të tre komandantëve të brigadave dhe urdhrat e tij për respektimin e së drejtën humanitare ndërkombëtare dhe për parandalimin e largimit të shqiptarëve kosovarë nga Kosova. Këto masa të paefektshme ishin natyrisht shumë kundrejt krimeve të përhapura të kryera nga forcat e UJ-së dhe MPB-së kundër shqiptarëve kosovarë, për të cilat Pavkoviqi ishte në dijeni.

778. Nga sa më lart mund të deduktohet synimi i përbashkët i Pavkoviqit për kryerjen e krimeve apo të shkeljeve që përbënin objektivin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Synimi i Pavkoviqit për të marrë pjesë në qëllimin e përbashkët mund të deduktohet edhe nga mënyra e bashkëpunimit të tij të ngushtë me Millosheviqin për çështjen e Kosovës në vitin 1998 dhe 1999.¹⁹⁷⁹ Provë që tregon ndikimin e tij si rezultat i lidhjes me Millosheviqin, përbën fakti si ai i dislokoj trupat në brendësi të Kosovës në kundërshtim me urdhrat e eprorit të tij, Ojdaniqit, pa u ndëshkuar.¹⁹⁸⁰ Miratimi nga Millosheviqi i qëndrimit të Pavkoviqit ndaj problemit në Kosovë evidentohet edhe nga ngritja e shpejtë e Pavkoviqit në hierarkinë komanduese të UJ-së. Pavkoviqi u ngrit nga shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës në vitin 1997, në komandant të Korpusit të Prishtinës në janar 1998, komandant i Armatës së Tretë në janar 1999 dhe, më në fund shef i Shtabit të Përgjithshëm në shkurt 2000.¹⁹⁸¹ Ngritjet në detyrë si komandant i Armatës së Tretë dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm qenë shpërblime të Millosheviqit për Pavkoviqin për pjesëmarrjen e tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

¹⁹⁷⁷ 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2; 4D276 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm, 3 prill 1999); 3D480 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 prill 1999), f. 2; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007) (version publik), para. 55–56, T. 8748–8750 (19 janar 2007).

¹⁹⁷⁸ Geza Farkash, T. 16359–16361 (25 shtator 2007).

¹⁹⁷⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26595–26597, 26624 (8 korrik 2008); 3D484 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 14.

¹⁹⁸⁰ P941 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 16, 24–25; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26708 (9 korrik 2008).

779. Në vitin 1998, Pavkoviqi u implikua në procesin e armatosjes së popullatës shqiptare dhe në çarmatosjen e popullatës shqiptare kosovare në fshatrat dhe qytetet e krahinës së Kosovës. Ai mori pjesë në përpjekjet e udhëheqjes së RFJ-së dhe Serbisë për kryerjen e këtyre proceseve, përkundër dijenisë që kishte për kryerjen e akteve kriminale gjatë përplasjeve ndëretnike.¹⁹⁸² Entuziazmi dhe pjesëmarrja e tij në këto procese vërtetojnë akuzën e Prokurorisë se Pavkoviqi veprroi në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për realizimin e qëllimit të përbashkët të mbajtjes së kontrollit mbi Kosovë përmes mjeteve të ndryshme kriminale.

780. Për më tepër, Pavkoviqi ishte i vetëdijshëm se, në rolin e tij si komandant i Armatës së Tretë, pjesëmarrja e tij aktive ishte e rëndësishme në përmbushjen e objektivave të përbashkëta të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Ai dinte se mund ta pengonte, madje ta parandalonte, shpërnguljen e dhunshme të popullsisë shqiptare kosovare, nëse ushtronte pushtetin e tij *de jure* dhe *de facto* për t'i nxjerrë para përgjegjësisë autorët e krimeve nëse nuk pranonte të urdhëronte bashkëpunimin e UJ-së me MPB-në në Kosovë. Mirëpo, në vitin 1999 ai vijoi të jepte urdhra nga komanda e Armatës së Tretë për përdorimin e UJ-së në Kosovë dhe vijoi të ishte në dijeni dhe të jepte miratimin e tij për bashkërendimin e veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së përmes Komandës së Përbashkët.¹⁹⁸³

781. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat përkatëse, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim i arsyeshëm në të cilin mund të arrihet është se Pavkoviqi kishte synimin për shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare, si brenda Kosovës, po ashtu edhe jashtë saj, duke mundësuar në këtë mënyrë vijimësinë e kontrollit të krahinës nga autoritetet e RFJ-së dhe autoritetet serbe. Dhoma bindet gjithashtu se synimi i tij ishte i përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, si Millosheviqi, Llukiqi dhe Shainoviqi.

782. Lidhur me kontributin e Pavkoviqit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, Dhoma është e mendimit se nga paragrafët e mësipërm del qartë se ai ka kontribuar dhe se ky kontribut ka qenë i ndjeshëm. Përkundër dijenisë që kishte për krimet e kryera nga forcat e UJ-së dhe MPB-së, ai dha urdhër dhe mbështetje për operacionet e UJ-së në Kosovë në vitin 1999, përfshirë edhe operacionet e përbashkëta me MPB-në, të bashkërenduara përmes Komandës së Përbashkët, gjatë gjithë

¹⁹⁸¹ 4D163 (Kartelë Ushtarake e Nebojsa Pavkoviqit), f. 5–6; P1319 (Përgjigje të Pavkoviqit drejtuar pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 9.

¹⁹⁸² Momir Stojanović, T. 20072–20074 (12 dhjetor 2007); P1011 (Ivan Marković, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 58; P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 163; P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 1–2, 205, 213–216, 347–348.

¹⁹⁸³ Gjorgje Qurçin, T. 17025–17027 (16 tetor 2007); P1459 (Raport i Armatës së Tretë për moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999).

periudhës kur u kryen krimet.¹⁹⁸⁴ Ai i mobilizoi trupat dhe i komandoi gjatë operacioneve, përfshirë edhe përmes pranisë së tij në terren në Kosovë. Dislokimi i forcave të tjera shtesë të UJ-së në Kosovë në fillim të vitit 1999, në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit, i dha mundësi UJ-në që të angazhohej në operacione të përhapura në të gjithë Kosovën në mars 1999, si më vete, po ashtu edhe me mbështetjen e MPB-së. Ai mbështeti armatosjen e popullatës joshqiptare dhe çarmatosjen e popullatës shqiptare kosovare në vitin 1998, çka ndihmoi punën e anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për arritjen e qëllimeve të tyre. Për më tepër, përmes minimizimit të krimeve të kryera nga forcat që kishte nën kontroll dhe përmes mosmarrjes së masave të efektshme në përgjigje të informacioneve që bënin të ditur kryerjen e përhapur të krimeve nga këto forca në Kosovë, Pavkoviqi kontribuoi në krijimin dhe vijimësinë e një atmosfere mosndëshkimi, që inkurajoi kryerjen e krimeve nga forcat nën kontrollin e anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

783. Siç mund të shihet nga përfundimet lidhur me komuna të ndryshme të Kosovës të diskutuara më lart, anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale i përdorën forcat e UJ-së dhe MPB-së që kishin në kontroll për kryerjen e krimeve të përmendura në Aktakuzë. Dhoma është e ndërgjegjshme se nuk është e nevojshme që të gjithë efektivet e këtyre forcave të kenë qenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Sidoqoftë, veprimet e efektivëve të UJ-së dhe MPB-së u ngarkohen anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në lidhje me këtë, Dhoma përfundimet e saj se Shainoviqi dhe Llukiqi ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Shainoviqi ishte koordinator politik i forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Homologu i Pavkoviqit në MPB ishte Llukiqi i cili, gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s, kishte përgjegjësinë *de jure* dhe *de facto* për forcat e MPB-së që kryen krime në masë. Pavkoviqi, si komandant i Armatës së Tretë të UJ-së, kishte nën urdhrat dhe kontrollin e vet të gjitha forcat e UJ-së në Kosovë gjatë gjithë periudhës kur janë kryer krimet dhe dha urdhra për operacionet e UJ-së në Kosovë gjatë asaj kohe. Të tre ata morën pjesë në bashkërendimin e veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së. Sllobodan Millosheviqi, një tjetër anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ishte “Kryekomandanti” i UJ-së dhe kishte kompetenca të rëndësishme *de facto* mbi MPB-në. Për të gjitha këto arsye, krimet e UJ-së dhe të MPB-së i ngarkohen Pavkoviqit.

784. Duke qenë se Dhoma ka konkluduar se qëllimi i përbashkët do të arrihej vetëm përmes shpërnguljes me dhunë, rezulton se krimet e tjera për të cilat akuzohet Pavkoviqi, përkatësisht vrasje dhe përndjekje, përmes, ndër të tjera, vrasjes, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve

¹⁹⁸⁴ *Shih, p.sh.*, 5D245 (Urdhër “Grom 3” i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), f. 5–7, 11–12; 4D103 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë për Mbrojtjen nga Sulmet e NATO-s, 23 mars 1999), para. 1.6; Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 38.

kulturore, duhet të analizohen në kuadër të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Duhet provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kryerja e këtyre krimeve, edhe pse bie jashtë objektit të qëllimit të përbashkët, ishte, logjikisht e parashikueshme nga Pavkoviqi dhe se ai e mori me vullnet të plotë rrezikun se mund të kryheshin këto krime.

785. *Vrasjet dhe dhuna seksuale.* Sikurse u përshkrua më lart, Pavkoviqi synonte të shpërngulte me dhunë një pjesë të popullsisë shqiptare kosovare dhe këtë synim e kishte të përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, objektivi i së cilës ishte shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë brenda Kosovës dhe dëbimi i tyre jashtë Kosovës në mënyrë që të ruhej kontrolli mbi këtë krahinë. Pavkoviqi ishte i vetëdijshëm për armiqtësinë e fortë midis serbëve etnikë dhe shqiptarëve kosovarë në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe vitit 1999. Ai ishte i vetëdijshëm për rrethanat e shpërnguljes me dhunë të popullsisë. Si rrjedhojë ishte logjikisht e parashikueshme kryerja e krimeve të tjera, përfshirë vrasjet, nga autorët fizikë dhe t1 ndërmjetëm të krimeve me synimin për të diskriminuar shqiptarët kosovarë.¹⁹⁸⁵ Dhoma është e mendimit se dijenia e hollësishme e Pavkoviqit për ngjarjet në terren në Kosovë në vitin 1998 dhe vitin 1999 e bëri të kuptonte se UJ-ja dhe MPB-ja do të kryen vrasje të paligjshme dhe krime seksuale si rezultat i shpërnguljeve që po ndodhnin në vitin 1999. Krahas kësaj, ka prova konkrete në mbështetje të këtij përfundimi. Për shembull, incidenti në Abrinë e Epërme në tetor 1998 e bëri normalisht të parashikueshme për Pavkoviqin se forcat e MPB-së dhe UJ-së do të implikoheshin në krime, përfshirë edhe në vrasje, në rast se do të angazhoheshin në Kosovë. Një urdhër i datës 4 prill 1999, i nxjerrë nga Pavkoviqi, e urdhëronte Korpusin e Nishit të parandalonte plaçkitjen, përdhunimin apo keqtrajtimin e popullsisë, duke kryer kontrole të përditshme në zonat e banuara dhe ndërtesat e braktisura.¹⁹⁸⁶ Në një urdhër të datës 6 prill 1999, të nxjerrë nga Pavkoviqi, Korpusi i Prishtinës dhe Korpusi i Nishit urdhëroheshin të përmirësonin disiplinën dhe të parandalonin shkeljet, përfshirë edhe plaçkitjet dhe vrasjet.¹⁹⁸⁷ Një raport i datës 10 prill 1999 nga Pavkoviqi bënte të ditur se vullnetarët të cilët qenë dënuar ose qenë në pritje të dënimit, ishin dislokuar në Kosovë dhe se shtatë vullnetarë ishin arrestuar, ndër të tjera, për vrasje dhe përdhunim.¹⁹⁸⁸ Më 25 maj 1999, Pavkoviqi i dërgoi Shtabit të Komandës së Lartë një raport në të cilin përmendeshin, ndër të tjera, vrasjet dhe përdhunimet e kryera nga forcat e MPB-së kundër popullsisë shqiptare kosovare.¹⁹⁸⁹ Për rrjedhojë, Pavkoviqi mund të parashikonte normalisht se forcat e UJ-së dhe MPB-së do të

¹⁹⁸⁵ P949 (intervistë e Nebojsa Pavkoviqit me Prokurorinë), f. 1–2, 88, 219, 264.

¹⁹⁸⁶ P1448 (Urdhër i Armatës së Tretë për udhëzimet lidhur me masat organizative për sigurinë, 4 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁸⁷ 4D224 (Urdhër i Armatës së Tretë për masat mbrojtëse, 6 prill 1999), f. 3; *shih edhe* Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit, datë 14 janar 2007), para. 59, 62, 65–67 (raportohet mbi diskutimet për vrasjet në Kosovë në mbledhjen e datës 17 maj 1999 në të cilën ishte i pranishëm Pavkoviqi).

¹⁹⁸⁸ P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁸⁹ P1459 (Raport i Armatës së Tretë për moszbatimin e urdhrave nga organet e MPB-së, 25 maj 1999), para. 3–4.

kryenin vrasje dhe krime seksuale kundër shqiptarëve kosovarë gjatë shpërnguljes së dhunshme të tyre.

786. *Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve fetare.* Dhoma ka konkluduar më herët se forcat e RFJ-së dhe Serbisë shkatërruan katër xhami dhe se këto vepra penale i përkasin kategorisë së përndjekjes. Dhoma gjykon se Pavkoviqi mund të parashikonte logjikisht që forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin shkatërrim ose dëmtim pa shkak të objekteve fetare shqiptare kosovare, të monumenteve të kulturës dhe të vendeve të shenjta myslimane gjatë shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare kosovare. Konflikti kishte të bënte me dasinë etnike. Për më tepër, qëllimi i përbashkët do të arrihej përmes një fushate terrori dhe dhune kundër popullsisë civile shqiptare kosovare. Në këto rrethana, dhe duke mbajtur parasysh dijeninë e hollësishme të Pavkoviqit për ngjarjet në terren në Kosovë gjatë konfliktit, konkluzioni i pashmangshëm është se ishte normalisht e parashikueshme për Pavkoviqin që, ndërkohë që forcat e RFJ-së dhe Serbisë po zhvendosnin dhe dëbonin me dhunë popullsinë shqiptare kosovare, në të njëjtën kohë ato po shkatërronin apo dëmtonin pa shkak edhe objektet e tyre fetare, monumentet e kulturës dhe vendet e shenjta të kësaj popullsie.

787. Pas nxjerrjes së përfundimeve të mësipërme, nuk është e nevojshme që Dhoma të nxjerrë përfundime për format e tjera të përgjegjësisë të pretenduara në Aktakuzë.

788. Për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm përgjegjësia e Nebojsa Pavkoviqit në kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e krimeve të mëposhtme në vendndodhjet e mëposhtme:

- Pejë
 - Qyteti i Pejës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Deçan
 - Beleg— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (dhunë seksuale) si krim kundër njerëzimit;
- Gjakovë
 - Qyteti i Gjakovës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Korenicë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si

- shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Dobrosh—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Ramoc— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Mejë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Fshatra të tjerë në zonën e Caragojit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Piranë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Dushanovë, pjesë e qytetit të Prizrenit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Rahovec
 - Celinë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Bellacërkë—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Krushë e Vogël—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Suharekë
 - Qyteti i Suharekës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
- Skënderaj
 - Turiçec—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Izbicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Tushilë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Qirez— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (dhunë seksuale) si krim kundër njerëzimit
- Mitrovicë

- Qyteti i Mitrovicës— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Zhabar— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Vushtrri
 - Qyteti i Vushtrrisë—veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Kolonë pranë Studimes së Epërme—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Prishtinë
 - Qyteti i Prishtinës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjilan
 - Zhegër— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lladovë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Llashticë—përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Përlepnicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Ferizaj
 - Sojevë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mirosalë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Staro Sello— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Kaçanik
 - Kotlinë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Kaçanik— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lisnajë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit.

789. Pavkoviqi nuk është përgjegjës për asnjë prej akuzave të tjera të ngritura në Aktakuzë, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

790. Rrjedhimisht, Nebojsa Pavkoviqi është fajtor për pikat 1 deri në 5 të Aktakuzës, përcaktuar si më sipër.

G. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E VLADIMIR LLAZAREVIQIT

1. I akuzuari

791. I akuzuari Vladimir Llazareviq u lind më 23 mars 1949 në qytetin Gërçar të komunës Babushnicë, në Serbi.¹⁹⁹⁰ Pas mbajtjes së posteve të ndryshme në APJ dhe UJ, në janar 1998 ai u emërua shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës.¹⁹⁹¹ Më 25 dhjetor 1998, Llazareviqi u emërua komandant i Korpusit të Prishtinës dhe qëndroi në këtë post deri më 28 dhjetor 1999, kur u emërua shef i Shtabit të Armatës së Tretë.¹⁹⁹² Më pas, më 13 mars, 2000, u emërua komandant i Armatës së Tretë dhe, në fillim të vitit 2002, u bë Ndhimësshef për Forcat Tokësore në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së.¹⁹⁹³ Karrierën ushtarake e përfundoi më 5 tetor 2004, me kërkesë të tij.¹⁹⁹⁴ Në qershor 1999 Llazareviqi u gradua gjenerallejtënant dhe më 30 dhjetor 2000 gjeneralkolonel.¹⁹⁹⁵

2. Akuzat në Aktakuzë

792. Sipas Aktakuzës, që prej 6 janarit 1999, Vladimir Llazareviqi, si komandant i Korpusit të Prishtinës, mbante përgjegjësi të plotë për operacionet e kryera nga njësitë e Korpusit të Prishtinës dhe njësitë vartëse dhe ushtronte pushtet komandues ose kontroll mbi njësitë e MPB-së të vëna në vartësi të Korpusit të Prishtinës apo që vepronin në bashkëpunim ose bashkërendim me Korpusin e Prishtinës, si edhe mbi struktura të tjera.¹⁹⁹⁶ Prokuroria pretendon se synimi i Llazareviqit për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale mund të deduktohet nga veprimet e tij, ku përfshihen urdhrat dhe pjesëmarrja e tij në organet bashkërenduese, si Komanda e Përbashkëta, dhe parashtron se Llazareviqi ishte në dijeni se taktika e dorës së fortë përdorur nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në operacionet e vitit 1998 rezultoi në kryerjen e krimeve kundër popullatës civile me kombësi shqiptare. Gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza, ai vijoi angazhimin e të njëjtave

¹⁹⁹⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17735–17736, 17739–17745 (6 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 7.

¹⁹⁹¹ Vladimir Llazareviq, T. 17740–17741 (6 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15. *Shih edhe* 5D1324 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për emërimin e Llazareviqit si Shef Shtabi të Korpusit të Prishtinës, 12 janar 1998); P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviqi, 28 dhjetor 1998). Nikë Peraj, P2248 (deklaratë e dëshmitarit, datë 18 prill 2000), para. 5–6.

¹⁹⁹² Vladimir Llazareviq, T. 17735–17736, 17739–17745 (6 nëntor 2007); P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviqi, 28 dhjetor 1998).

¹⁹⁹³ Vladimir Llazareviq, T. 17735–17736, 17739–17745 (6 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15.

¹⁹⁹⁴ Vladimir Llazareviq, T. 17745 (6 nëntor 2007).

¹⁹⁹⁵ Vladimir Llazareviq, T. 17735–17736, 17739–17745 (6 nëntor 2007).

¹⁹⁹⁶ Aktakuza, para. 13, 58.

njësi dhe përdorimin e të njëjtave taktika, çka tregon se ai i miratonte krimet dhe se synonte kryerjen e tyre. Prokuroria argumenton gjithashtu se, megjithëse kishte kompetenca, Llazareviqi qëllimisht nuk ndërmoi asnjë masë kundër autorëve të krimeve sepse ai kishte synimin që këto krime të ndodhnin.¹⁹⁹⁷ Së fundi, sipas Prokurorisë, Llazareviqi kontribuoi ndjeshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale duke marrë pjesë në inkuadrimin e vullnetarëve në Korpusin e Prishtinës.¹⁹⁹⁸

793. Bazuar në sa më sipër, ai akuzohet për planifikimin, nxitjen, urdhërimin ose, përndryshe, ndihmë dhe inkurajim për planifikimin, përgatitjen ose zbatimin e krimeve të pretenduara në Aktakuzë dhe për pjesëmarrjen në ndërmarrjen e përbashkët kriminale të diskutuar më lart. Më tej, Llazareviqi ngarkohet me përgjegjësinë si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.¹⁹⁹⁹

794. Mbrojtja e Llazareviqit i hedh poshtë këto akuza dhe argumenton se Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë se Llazareviqi kishte synim për të kontribuar në realizimin e planit përmes veprimeve apo mosveprimeve të tij dhe se nuk ka provuar se ai ishte në dijeni të një plani kriminal kundër popullatës civile.²⁰⁰⁰

795. Në Kapitullin VII, më lart, Dhoma ka arritur në përfundimin se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen krime kundër popullatës civile shqiptare kosovare në shumë prej komunave të Kosovës, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999. Si pasojë, më poshtë analizohet përgjegjësia e Llazareviqit për këto krime, sipas kategorive të ndryshme të përgjegjësisë penale të pretenduar në Aktakuzë.

3. Emërimi i Llazareviqit si shef i Shtabit dhe komandant i Korpusit të Prishtinës

796. Prokuroria parashton se në vitin 1998, disa oficerë të UJ-së të cilët denoncuan përdorimin e UJ-së jashtë hierarkisë komanduese të përcaktuar në operacionet e luftimit në Kosovë u liruan nga detyra prej Millosheviqit dhe Millutinoviqit dhe u zëvendësuan me persona të cilët treguan më shumë bindje. Prokuroria shton se përmes emërimit si komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi u vendos në një pozicion kyç nga i cili ai mund të kontribuonte në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.²⁰⁰¹ Sipas Mbrojtjes së Llazareviqit, fakti se Perishiqi, i cili u bë një prej kundërshtarëve të Millosheviqit në vitin 1998, e emëroi Llazareviqin si shef Shtabi të Korpusit të

¹⁹⁹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 953–956.

¹⁹⁹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 924.

¹⁹⁹⁹ Aktakuza, para. 21.

²⁰⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 849–851, 951.

²⁰⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 80.

Prishtinës në fund të vitit 1997 dhe i sugjeroi Millosheviqit në qershor 1998 që Llazareviqi të gradohej gjeneral, nga kolonel që ishte, tregon se argumenti i Prokurorisë është i pabazë.²⁰⁰²

797. Llazareviqi u emërua shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës në fund të vitit 1997 nga shefi i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm, Perishiqi.²⁰⁰³ Më 9 qershor 1998, gjatë një mbledhjeje të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes Perishiqi deklaroi se Llazareviqi ishte “një oficer i lartë shumë i aftë i cili kishte treguar cilësi të larta në situatat më të vështira” dhe, rrjedhimisht, i sugjeroi Millosheviqit që ai të gradohej gjeneral. Askush nuk e kundërshtoi sugjerimin e Perishiqit, që si rezultat u miratua.²⁰⁰⁴ Në sesionin e tetë të KLM-së, më 25 dhjetor 1998, Ojdaniqi, si shef i Shtabit të Përgjithshëm, propozoi që Llazareviqi të emërohej komandant i Korpusit të Prishtinës.²⁰⁰⁵ Në lidhje me ngritjen e propozuar në detyrë të Llazareviqit nuk pati asnjë kundërshtim.²⁰⁰⁶ Megjithëse në këtë mbledhje u shprehën kritika për aktivitetet e Korpusit të Prishtinës në Kosovë, ato u shprehën gjatë diskutimit për emërimin e Pavkoviqit. Pas sesionit të KLM-së, Millosheviqi nxori një dekret presidencial përmes të cilit e emëronte Llazareviqin komandant të Korpusit të Prishtinës më 28 dhjetor 1998.²⁰⁰⁷ Më 9 janar 1999 Llazareviqi mori në dorëzim postin e komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Pavkoviqi, ndërsa Pavkoviqi mori në dorëzim detyrën e komandantit të Armatës së Tretë, duke zëvendësuar Dushan Samarxhiqin.²⁰⁰⁸ Në dëshminë e tij, Llazareviqi theksoi se procedura e ndjekur për emërimin e tij si komandant i Korpusit të Prishtinës në dhjetor 1998 ishte procedura normale që ndiqej për emërimet në poste të tilla.²⁰⁰⁹

798. Dhoma Gjyqësore bindet se emërimi i Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës u krye në përputhje me procedurën zyrtare. Duke marrë parasysh re se profesionalizmi i Llazareviqit u lëvdua nga Perishiqi në qershor 1998 dhe se, ndryshe nga emërimet e Ojdaniqit dhe Pavkoviqit, të cilët zëvendësuan, përkatësisht, Perishiqin dhe Samarxhiqin, nuk pati asnjë debat lidhur me

²⁰⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 598–599. *Shih edhe* para. 600–604.

²⁰⁰³ Vladimir Llazareviq, T. 17736 (6 nëntor 2007); 5D1324 (Urdhër i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, 12 janar 1998). *Shih edhe* 5D1323 (Urdhër i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, 30 dhjetor 1997).

²⁰⁰⁴ 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të pestë të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 14–15. *Shih edhe* Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26743–26444 (9 korrik 2008); 5D1325 (Raport i Llazareviqit për dorëzimin e detyrës, 26 qershor 1998).

²⁰⁰⁵ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 5–7.

²⁰⁰⁶ P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 1, 5–9; 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të tetë të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 3, 13–21. Ndryshe nga ngritja në detyrë e propozuar për Pavkoviqin, Milo Gjukanoviqi nuk shprehu asnjë mendim për ngritjen në detyrë të Llazareviqit.

²⁰⁰⁷ 4D35 (Dekret i Presidentit të RFJ-së për emërimin e Nebojsa Pavkoviqit, 28 dhjetor 1998); P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Llazareviqi, 9 janar 1999). *Shih* Urdhër mbi Fakte të Pranuara, 11 korrik 2006, f. 14.

²⁰⁰⁸ P801 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës nga Vladimir Llazareviqi, 9 janar 1999). P800 (Raport për marrjen e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Nebojsa Pavkoviqi, 13 janar 1999); P802 (Raport për dorëzimin e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë nga Dushan Samarxhiqi, 13 janar 1999).

²⁰⁰⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17744–17745 (6 nëntor 2007).

emërimin e Llazareviqit, Dhoma arrin në përfundimin se provat nuk e vërtetojnë argumentimin e Prokurorisë se Llazareviqi u emërua komandant i Korpusit të Prishtinës ngaqë ishte “më i bindur” se oficerët e tjerë të UJ-së. Arsyet për emërimin e Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës qenë përvoja e tij, sidomos si shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës, dhe cilësitë e tij si oficer.

4. Llazareviqi si shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës në vitin 1998

a. Llazareviqi dhe operacionet e përbashkëta

799. Prokuroria argumenton se Llazareviqi mori pjesë në Komandën e Përbashkët dhe kontribuoi në punën e saj. Theksohet se ai mori pjesë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët në vitin 1998 dhe parashtroi se operacioni i kryer në Sllup dhe Voksh në gusht 1998 ilustron kontributin e Llazareviqit në operacionet e Komandës së Përbashkët.²⁰¹⁰ Mbrojtja e Llazareviqit parashtroi se Llazareviqi e nënshkroi vendimin për këtë operacion vetëm sepse asokohe Pavkoviqi nuk ndodhej aty dhe thekson se urdhri kishte marrë miratimin paraprak të Samarxhiqit dhe Perishiqit.²⁰¹¹

i. Pjesëmarrja e Llazareviqit në operacionet e përbashkëta

800. Si shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës, në vartësi të Pavkoviqit, Llazareviqi shërbeu si hallkë lidhëse midis drejtuesve të Korpusit të Prishtinës dhe komandantit të Korpusit, dhe shërbeu si zëvendëskomandant.²⁰¹² Të dy ishin në kontakt të rregullt gjatë gjithë vitit 1998, sikurse është përmendur në Pjesën VI.A. Gjatë asaj kohe, Llazareviqi ishte vazhdimisht i pranishëm në Postëkomandën Pararojë dhe qëndroi atje deri në tetor 1998.²⁰¹³ Ai ishte në kontakt edhe me Samarxhiqin, duke qenë se Postëkomanda Pararojë kishte lidhje telefonike të drejtpërdrejtë me Komandën e Armatës së Tretë. Postëkomanda Pararojë kishte lidhje telefonike të drejtpërdrejtë edhe me Perishiqin, shefin e atëhershëm të Shtabit të Përgjithshëm.²⁰¹⁴ Perishiqi i telefononte shpesh Llazareviqit në Postëkomandën Pararojë, për t’u informuar personalisht për situatën në kufi.²⁰¹⁵ Gjithashtu, Llazareviqi u takua me Perishiqin kur ky erdhi për tri ditë në kufi me një ekip

²⁰¹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 933.

²⁰¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 555.

²⁰¹² P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 20–21; P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt), f. 16.

²⁰¹³ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 92; *shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 17809 (6 nëntor 2007), T. 17823 (7 nëntor 2007); Millorad Obradoviç, T. 15044 (5 shtator 2007); Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 4; Dragan Zhivanoviç, T. 20617–20618 (18 janar 2008); Millan Kotur, T. 20629 (18 janar 2008).

²⁰¹⁴ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 6.

²⁰¹⁵ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 6. *Shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 17809 (6 nëntor 2007).

të përbërë nga një duzinë oficerësh, për të verifikuar gjendjen e gatishmërisë luftarake në gusht 1998.²⁰¹⁶

801. Llazareviqi dëshmoi se në prill 1998 ai mori urdhër personalisht nga komandanti i Armatës së Tretë, Samarxhiqi, për të çuar një grup oficerësh nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në Postëkomandën Pararojë në Gjakovë dhe për të bashkërenduar prej atje operacionet e forcave të Korpusit të Prishtinës për sigurimin dhe mbrojtjen e kufirit shtetëror.²⁰¹⁷ Samarxhiqi gjykoj se, për shkak të situatës së ndërlikuar në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës, ishte e nevojshme që një grup oficerësh nga Komanda e Korpusit të Prishtinës të shkonte në Postëkomandën Pararojë “për të vëzhguar situatën dhe për të komanduar në mënyrë më të efektshme njësitë në sektorin e përgjithshëm të Gjakovës”.²⁰¹⁸

802. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998 në Kosovë u kryen disa operacione të përbashkëta.²⁰¹⁹ Sikurse është shpjeguar më lart, sipas urdhrit të Samarxhiqit të datës 20 prill 1998, Llazareviqi, si shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës, kishte përgjegjësinë për vëzhgimin e situatës në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës.²⁰²⁰ Provat që lidhen me pjesëmarrjen e Llazareviqit në operacionet e përbashkëta të kryera në zonën kufitare kur ndodhej në Postëkomandën Pararojë në vitin 1998 kufizohen me ato që kanë të bëjnë me operacionin në Sllup dhe Voksh. Dhoma tashmë ka konkluduar se për këtë operacion u diskutua gjatë një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët më 13 prill 1998 dhe se plani për të u përgatit nga Komanda e Korpusit të Prishtinës përpara zhvillimit të mbledhjes së Komandës së Përbashkët.²⁰²¹ Urdhri i Llazareviqit i datës 14 gusht 1998 përmban një klauzolë ku thuhet se njësitë e angazhuara në sektorin e fshatrave Sllup dhe Voksh duhej të “komandoheshin nga Komanda e Përbashkët për Kosovën”. Hierarkitë komanduese të UJ-së dhe MPB-së mbetën të ndara në terren. Llazareviqi dëshmoi se ai ndodhej në Postëkomandën Pararojë prej nga monitoronte operacionin.²⁰²²

803. Në bazë të këtyre provave, Dhoma arrin në përfundimin se Llazareviqi kontribuoi në zbatimin e operacioneve të përbashkëta të kryera në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998. Më poshtë analizohet përgjegjësia e Llazareviqit për nxjerrjen e urdhrave të Komandës së Përbashkët në vitin 1999.

²⁰¹⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18297 (14 nëntor 2007).

²⁰¹⁷ Vladimir Llazareviq, T. 17808 (6 nëntor 2007).

²⁰¹⁸ 4D380 (Urdhër i Postëkomandës së Armatës së Tretë, 20 prill 1998).

²⁰¹⁹ *Shih* Pjesën VI.C.

²⁰²⁰ 4D380 (Urdhër i Postëkomandës së Armatës së Tretë, 20 prill 1998).

²⁰²¹ *Shih* Pjesën VI.E.

²⁰²² Vladimir Llazareviq, T. 18297 (14 nëntor 2007).

ii. *Pjesëmarrja e Llazareviqit në mbledhjet e Komandës së Përbashkët*

804. Provat tregojnë se në vitin 1998 Llazareviqi mori pjesë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët vetëm pesë herë,²⁰²³ nga të cilat një herë në gusht dhe katër herë në shtator 1998.²⁰²⁴ Në gjyq Llazareviqi konfirmoi se ishte i pranishëm në këto mbledhje.²⁰²⁵ Ai shtoi se, megjithëse në fund të muajit tetor 1998 ai ndodhej në Prishtinë, nuk mori pjesë në asnjë mbledhje në atë kohë.²⁰²⁶ Sipas Shënimeve, Llazareviqi ka folur vetëm në tri prej këtyre mbledhjeve.²⁰²⁷ Gjatë dëshmisë së tij, Llazareviqi shpjegoi se gjatë mbledhjes së datës 18 shtator 1998, të gjithë pjesëmarrësit kishin interes të “dëgjonin [prej tij] drejtpërdrejt se çfarë po ndodhte në kufi”. Ai i informoi për “situatën dramatike” atje.²⁰²⁸ Temat e diskutuara gjatë mbledhjeve në të cilat mori pjesë Llazareviqi do të trajtohen më poshtë.

805. Megjithëse Llazareviqi mori pjesë në disa prej mbledhjeve të Komandës së Përbashkët të zhvilluara në Prishtinë në korrik-tetor 1998, Dhoma nuk arrin në përfundimin se, përmes pranisë së tij në këto mbledhje, ai u informua tërësisht mbi çfarë po ndodhte në Beograd asokohe, apo se gjatë këtyre mbledhjeve ishte në gjendje të vlerësonte ndikimin që ushtronte Komanda e Përbashkët mbi MPB-në dhe UJ-në në lidhje me vënien në zbatim të fazave të ndryshme të Planit kundër Terrorizmit. Dhoma vëren se Llazareviqi nuk shkoi në Beograd në vitin 1998 dhe se ai nuk mori pjesë në mbledhjet e zhvilluara në kryeqytet.²⁰²⁹ Duke pasur parasysh largësinë e Llazareviqit si nga Prishtina, po ashtu edhe nga Beogradi në vitin 1998, faktin se ai nuk bënte pjesë në Kolegjiumin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe mungesën e provave që tregojnë dijeninë e tij, Dhoma nuk gjykon se është vërtetuar që Llazareviqi të ketë qenë në dijeni të mosmarrëveshjeve që ekzistonin në atë kohë midis Pavkoviqit, Samarxhiqit dhe Perishiqit.

b. *Dijenia e Llazareviqit për krimet e kryera më 1998 nga UJ-ja dhe MPB-ja*

806. Prokuroria argumenton se Llazareviqi ishte në dijeni se taktika e dorës së fortë zbatuar nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në operacionet e vitit 1998 rezultoi në kryerjen e krimeve kundër popullsisë civile shqiptare kosovare. Gjithashtu, sipas Prokurorisë, Llazareviqi ishte në dijeni të shpërnguljes në masë të popullsisë civile përmes sistemit të raportimit të UJ-së, rezolutave

²⁰²³ *Shih* Pjesën VI.E.

²⁰²⁴ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 68–70 (23 gusht 1998); f. 117–119 (17 shtator 1998); f. 119–120 (18 shtator 1998); f. 121–122 (19 shtator 1998); f. 124–125 (21 shtator 1998); *shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 18455–18467 (16 nëntor 2007).

²⁰²⁵ Vladimir Llazareviq, T. 18455–18467 (16 nëntor 2007).

²⁰²⁶ Vladimir Llazareviq, T. 17819 (7 nëntor 2007).

²⁰²⁷ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 68 (23 gusht 1998), f. 121 (19 shtator 1998), f. 124–125 (21 shtator 1998).

²⁰²⁸ Vladimir Llazareviq, T. 17817–17819 (7 nëntor 2007).

²⁰²⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18134 (12 nëntor 2007).

përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, raporteve të organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kontakteve të shpeshta tij me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë.²⁰³⁰ Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se ai nuk kishte dijeni që pjesëtarët e UJ-së kishin kryer krime në vitin 1998.²⁰³¹

807. Në kohën kur Llazareviqi ndodhej në Postëkomandën Pararojë, në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës u kryen disa operacione të përbashkëta. Duke shqyrtuar shembujt nga zonat ku pretendohet forcat e UJ-së kryen krime në vitin 1998, Dhoma ka konkluduar se forcat e MPB-së dhe UJ-së përdorën forcë të tepruar ose joproporcionale disa herë në Kosovë. Forcat e UJ-së shkaktuan shkatërrim të tepruar pranë Glogjanit në fund të muajit gusht 1998 dhe tetor 1998. Forcat e UJ-së dhe MPB-së përdorën forcë të tepruar në Malishevë në fund të muajit korrik 1998 dhe përsëri në Drenicë në fund të korrikut dhe fillim të muajit gusht 1998. Dhoma ka konkluduar se deri në fund të vitit 1998 u shpërngulën një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kosovarë nga konflikti që po zhvillohej midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë dhe pjesërisht u shkaktua nga përdorimi i tepruar ose joproporcional i forcës nga UJ-ja dhe MPB-ja në vitin 1998.²⁰³²

808. Gjatë kohës që ndodhën këto incidente, Llazareviqi i ndiqte nga afër ngjarjet në terren në Kosovë. Ai shpjegoi se detyrat kryesore të Postëkomandës Pararojë ku ndodhej gjatë pjesës më të madhe të vitit 1998, ishin monitorimi i situatës në kufirin shtetëror dhe raportimi në Komandën e Korpusit, propozimi i masave për sigurimin e kufirit dhe parandalimin e përshkallëzimit të aktiviteteve “terroriste” me burim nga Shqipëria, vizitimi dhe kontrollimi i njësisë të Korpusit të Prishtinës në mënyrë të përditshme dhe bashkërendimi i aktiviteteve të tyre.²⁰³³ Llazareviqi ishte i pranishëm në një mbledhje të udhëheqjes së UJ-së më 7 gusht, kur Samarxhiqi tha konkretisht se lufta kundër terrorizmit përmes zjarrvënies ishte “turp”.²⁰³⁴ Më pas, gjatë një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët të zhvilluar më 21 shtator 1998, ku merrte pjesë edhe Llazareviqi, Shainoviqi pranoi “katastrofën humanitare” në Kosovë. Për të zgjidhur problemin e Kosovës, ai theksoi se operacionet duhej të realizoheshin “në mënyrë të disiplinuar, për të evituar zjarrvënien” dhe ai tha se duhej “të shkatërronin vendosmërinë e tyre për të luftuar”.²⁰³⁵

²⁰³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 954, 957–959.

²⁰³¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 642.

²⁰³² *Shih* Pjesën VI.C.

²⁰³³ *Shih* Pjesën VI.A.

²⁰³⁴ 4D97 (Procesverbal i mbledhjes informuese të komandantëve të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, 7 gusht 1998), f. 3.

²⁰³⁵ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 119 (18 shtator 1998), f. 125 (22 shtator 1998).

809. Pas dy ditësh, në Rezolutën nr 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së shprehej shqetësim serioz “për luftimet e ashpra të kohëve të fundit në Kosovë, sidomos për përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës nga forcat e sigurimit serb dhe ushtria jugosllave çka kishte rezultuar në viktima të shumta civile dhe, sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, shpërnguljen e mbi 230 mijë personave nga shtëpitë e tyre”.²⁰³⁶ Mbështetur në faktin se më vonë Llazareviqi mori pjesë në zbatimin e detyrimeve të vendosura mbi UJ-në nga Marrëveshjet e Tetorit dhe faktin se këto marrëveshje bazoheshin shprehimisht në Rezolutën nr 1199, Dhoma bindet se ai ishte në dijeni të kësaj rezolute dhe të përmbajtjes së saj.

810. Llazareviqi diskutoi për numrin e madh të shqiptarëve kosovarë të shpërngulur dhe për kthimin e tyre, gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët. Më 17 shtator 1998 u shpjegua se 10 mijë civilë ishin gjetur pranë kufirit dhe se disa prej tyre po planifikonin të kalonin kufirin.²⁰³⁷ Rendi i ditës i mbledhjes së zhvilluar më 18 shtator 1998 bën të ditur se personat e pranishëm diskutuan për çështjet e “refugjatëve”. Llazareviqi tha se kishte raporte nga Mali i Zi për kthimin e “refugjatëve”. Radoviqi tha se në zonën e Jezercës priteshin 3 mijë persona. Matkoviqi i informoi të pranishmit se në tri fshatra të tjera duhej të kujdeseshin për rreth 10 mijë “refugjatë”.²⁰³⁸ Më 19 shtator 1998, Shainoviqi tha se ishte nevoja për raporte të përditshme për vendndodhjen e “refugjatëve” dhe dha udhëzim se dy persona duhej të raportonin në mënyrë të përditshme për kthimin e “refugjatëve”.²⁰³⁹

811. Edhe një numër dokumentesh të Korpusit të Prishtinës flasin për dijeninë e Llazareviqit lidhur me kryerjen e krimeve. Më 5 qershor 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi Komandës në Postëkomandën Pararojë në Gjakovë një urdhër me “masat për rritjen e nivelit të gatishmërisë luftarake”. Në urdhër thuhej se komandantët e njësisve duhej të mos lejonin hyrjen e individëve dhe njësisve në vendet e populluara dhe të mos lejonin dëmtimin e pasurive të qytetarëve

²⁰³⁶ P456 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199, 23 shtator 1998); *shih edhe* P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998); P433 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1244, 10 qershor 1999).

²⁰³⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 117. Në mbledhje ishin të pranishëm Pavkoviqi, Llazareviqi, Shainoviqi, Llukiqi, Radoviqi dhe Davidoviqi. Në Shënime thuhet se Matkoviqi mungonte.

²⁰³⁸ Vladimir Llazareviq, T. 18463–18464 (16 nëntor 2007); P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 119–121. Në mbledhje ishin të pranishëm Llazareviqi, Gjorgjeviqi, Radoviqi, Angjelkoviqi dhe Matkoviqi. Në Shënime thuhet se mungonin Shainoviqi, Mijaqi dhe Llukiqi.

²⁰³⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18455–18457 (16 nëntor 2007); P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 121–123. Miniqi dhe Matkoviqi mungonin. Në mbledhje ishin të pranishëm Pavkoviqi, Llazareviqi, Shainoviqi, Gjorgjeviqi dhe Radoviqi.

dhe vjedhjen e pasurive të qytetarëve “me kombësi shqiptare”. Më tej, udhëzohej që të gjitha sendet e vjedhura deri atëherë të ktheheshin menjëherë.²⁰⁴⁰

812. Më 10 korrik 1998, Llazareviqi nxori një urdhër për mbrojtjen e përfaqësuesve të misioneve monitoruese dhe organizatave humanitare në Kosovë.²⁰⁴¹ Ai i informoi njësitë lidhur me faktin se, për shkak të vizitës së vëzhguesve ndërkombëtarë në zonën e përgjegjësisë së Korpusit të Prishtinës, forcat “terroriste” shqiptare “po përfitonin nga rrethanat dhe po përpiqeshin t’i provokonin njësitë e UJ-së”. Ai urdhëronte që njësitë e UJ-së të mos hapnin zjarr nëse vëzhguesit ndërkombëtarë ishin të pranishëm, por nëse hapja e zjarrit ishte e domosdoshme, UJ-ja të mos përdorte forcë të tepruar dhe të hapte zjarr vetëm “me të njëjtin lloj armësh”.²⁰⁴² Llazareviqi dëshmoi se ky urdhër synonte të mbronte vëzhguesit e huaj.²⁰⁴³

813. Disa prej provave të paraqitura gjatë procesit gjyqësor tregojnë se UÇK-ja i provokoi njësitë e UJ-së. Për shembull, KVM-ja e evidentonte këtë problem në një raport të vitit 1999, ku thuhej: “Reagimi i tepruar i forcave serbe është edhe synimi i UÇK-së – duke shfrytëzuar përsëri fuqinë e informimit prej mediave”.²⁰⁴⁴ Dhoma është e mendimit se urdhri i Llazareviqit, i datës 10 korrik 1998, tregon se ai ishte në dijeni të rrezikut se njësitë e Korpusit të Prishtinës do të “mbireagonin” ndaj provokimeve të UÇK-së dhe, si pasojë do të kryenin krime. Rrjedhimisht, Dhoma nuk pranon shpjegimin se urdhri për të mos hapur zjarr në zonat ku ishin të pranishëm vëzhguesit e huaj kërkonte të mbronte vëzhguesit e huaj, por, përkundrazi, mendon se ishte një përpjekje që të mos zbulohet se UJ-ja po kryente krime.

814. Më 20 korrik 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës u dërgoi një urdhër tjetër njësive në vartësi, përmes të cilit shpjegonte se kohët e fundit kishte pasur “disa raste” në të cilat njësitë e Korpusit të Prishtinës qenë angazhuar në mbështetjen e njësive të MPB-së në operacione luftimi kundër forcave “terroriste” shqiptare, “pa miratimin e Komandës së Korpusit”. Korpusi i Prishtinës theksonte se këto veprime mund të çonin në “të shtëna me armë zjarri të pakontrolluara drejt

²⁰⁴⁰ P1011 (Ivan Marković, redaktor, The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 47; P2098 (Urdhër i Postëkomandës Pararojë të Korpusit të Prishtinës mbi masat për rritjen e gatishmërisë luftarake, 5 qershor 1998).

²⁰⁴¹ P969 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për vizitën e përfaqësuesve të misionit diplomatik dhe monitorues në Kosovë, 10 korrik 1998). *Shih edhe* Miodrag Simiq, T. 15562 (13 shtator 2007); 4D231 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me mbështetjen e MPB-së, 20 korrik 1998), f. 1; 4D177 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 7 korrik 1998).

²⁰⁴² P969 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për vizitën e përfaqësuesve të misionit diplomatik dhe monitorues në Kosovë, 10 korrik 1998), f. 1.

²⁰⁴³ Vladimir Llazareviq, T. 17841–17842 (7 nëntor 2007). *Shih edhe* Goran Jevtović, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 16–18.

²⁰⁴⁴ P680 (Dokumentet Operative të Bashkimit OSBE/KVM). Dhoma vëren gjithashtu se, gjatë mbledhjes së datës 29 tetor 1998 në Beli Dvor në Beograd, Perishiçi rekomandoi fuqimisht që UJ-ja të bënte “gjihtëçka të mundur për të

ndërtesave që strehonin civilë apo drejt personave jo të përfshirë në operacione luftimi”.²⁰⁴⁵ Një urdhër i datës 7 gusht 1998, i nënshkruar nga Pavkoviçi dhe që, ndër të tjerë, iu dërgua edhe Postëkomandës Pararojë, vërteton se Llazareviçi ishte në dijeni të rasteve të përdorimit të forcës së tepruar në vitin 1998 si edhe të akteve të plaçkitjes që po kryheshin anëtarët e njësive të Korpusit të Prishtinës. Në këtë urdhër, Korpusi i Prishtinës dënonte faktin se disa njësi i kishin përdorur me tepri pajimet luftarake gjatë operacioneve të fundit, “dhe për pasojë kishte dëmtim më të madh shkaktuar ndërtesave në zonat e operacioneve luftarake”. Aty theksohej konkretisht se ishin shkatërruar dhe djegur një numër i madh shtëpish. Komanda e Korpusit i konsideronte këto veprime si “veprime të rrezikshme të personave dhe grupeve të papërgjegjshëm”. Rrjedhimisht, Komanda e Korpusit të Prishtinës jepte urdhër që pajisjet luftarake të përdoreshin në mënyrë shumë racionale gjatë operacioneve kundër forcave “terroriste” shqiptare, që të ndalohej djegia e shtëpive dhe e ndërtesave të tjera ndihmëse dhe ekonomike, që të ktheheshin mallrat e vjedhura dhe që të merreshin masa disiplinore dhe penale kundër personave që e thyenin urdhrin.²⁰⁴⁶

815. Lidhur me vrasjen e civilëve në fshatin Abri e Epërme të komunës së Glllogocit në muajin tetor 1998, Llazareviçi tha se në fund të vitit 1998 ai kishte dëgjuar nga mediat se kundër civilëve atje qenë përdorur armët e rënda.²⁰⁴⁷ Ai ishte gjithashtu në dijeni të një urdhri të dhënë të gjitha njësive nga Pavkoviçi për të raportuar për çdo akuzë në media lidhur me këtë incident.²⁰⁴⁸ Më 5 tetor 1998, Llazareviçi i dërgoi një raport Pavkoviçit, ku i bënte një përmbledhje të këtyre raporteve dhe informonte se njësitë e UJ-së nuk kishin kryer masakër, por se nuk kishte asnjë informacion të besueshëm për MPB-në.²⁰⁴⁹ Në një dokument të datës 5 tetor 1998, bëhet e ditur se Pavkoviçi ishte informuar për informacionin e dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së nga Dega e Sigurimit e Korpusit të Prishtinës, sipas të cilit anëtarë të paidentifikuar të njësive të MPB-së kishin kryer një operacion në Abrinë e Epërme dhe kishin ekzekutuar civilët e ndaluar.²⁰⁵⁰ Më tej, Llazareviçi shpjegoi se ai kishte dëgjuar në media se gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998 ishte përdorur forcë joproporcionale në Abrinë e Epërme. Sipas tij, në ditët në vijim Komanda e Korpusit të Prishtinës dha urdhër që të hetohej kjo çështje për të parë nëse kishte implikim të UJ-së.²⁰⁵¹ Edhe pse Llazareviçi ishte në dijeni të vrasjeve të civilëve

evituar provokimin nga terroristët të cilët do të inskenojnë incidente të ndryshme për vëzhguesit e huaj në mënyrë që UJ-ja t’u nënshtrohet presioneve të reja”. P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Beli Dvor më 29 tetor 1998), f. 11.

²⁰⁴⁵ 4D231 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me mbështetjen e MPB-së, 20 korrik 1998), f. 1.

²⁰⁴⁶ 4D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për ndalimin e shkatërrimit, 7 gusht 1998), f. 1. *Shish edhe* 4D375 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me parandalimin e vjedhjeve, 18 gusht 1998).

²⁰⁴⁷ Vladimir Llazareviç, T. 18561 (19 nëntor 2007).

²⁰⁴⁸ Vladimir Llazareviç, T. 18489 (16 nëntor 2007). *Shih* P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse, 5 tetor 1998).

²⁰⁴⁹ 4D401 (Raport i Shefit të Shtabit të Korpusit të Prishtinës për Komandantin e Korpusit të Prishtinës, 5 tetor 1998).

²⁰⁵⁰ P1440 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi incidentet vdekjeprurëse, 5 tetor 1998), f. 4.

²⁰⁵¹ Vladimir Llazareviç, T. 18562 (19 nëntor 2007).

dhe të përfshirjes së pretenduar të MPB-së dhe UJ-së në këtë incident, provat nuk tregojnë që ai të ketë qenë në dijeni të përgjegjësive të UJ-së për këto vrasje.

816. Dhoma citon dëshminë e Llazareviqit në sallën e gjyqit, se gjatë një takimi zyrtar midis KVM-së dhe ekipit të ndërlidhjes të RFJ-së/Serbisë u tha se UJ-ja kishte përdorur forcë joproporcionale më 8 janar 1999 në fshatin Slapuzhan, ku ishte gjuajtur një predhë tanku. Ai shpjegoi se, përveç informacionit që mori gjatë këtij takimi, ai nuk mori asnjë informacion tjetër nga KVM-ja për përdorimin e tepruar të forcës.²⁰⁵² Lidhur çfarë kishte ndodhur në fshatin Slapuzhan, Llazareviqi ishte i mendimit se një ekip i Komandës së Korpusit të Prishtinës kishte kryer një hetim.²⁰⁵³

817. Provat e mësipërme tregojnë se Llazareviqi ishte në dijeni të faktit se gjatë operacioneve të zhvilluara nga UJ-ja dhe MPB-ja në vitin 1998 u kryen krime kundër civilëve dhe pronave të civilëve. Ai ishte gjithashtu në dijeni se kjo kishte shkaktuar shpërnguljen e një numri të konsiderueshëm civilësh. Këto prova tregojnë gjithashtu se në vitin 1998, Llazareviqi nxori urdhra me shkrim përmes të cilëve e udhëzonte UJ-në të parandalonte kryerjen e krimeve kundër civilëve dhe të kujdesej që civilët të ktheheshin në fshatrat e tyre.

5. Llazareviqi si komandant i Korpusit të Prishtinës në vitin 1999

a. Detyrat dhe kompetencat e Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës

818. Detyra e komandantit të Korpusit të Prishtinës ishte të komandonte Korpusin, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore, me autorizim nga eprori dhe në përputhje me Udhëzimet për Organizimin e Brendshëm të Korpusit.²⁰⁵⁴ Gjithashtu ai kishte detyrë që të mbante në kontroll punën e Komandës së Korpusit, t'u ngarkonte detyra vartësve dhe të verifikonte realizimin e detyrave.²⁰⁵⁵ Krahas këtyre, komandanti i Korpusit të Prishtinës duhej të mbikëqyrte dhe analizonte ecurinë, rendin dhe disiplinën e Korpusit të Prishtinës.²⁰⁵⁶ Ai kishte detyrimin që të disiplinonte çdo vartës që nuk zbatonte një urdhër për shkak të indisiplinimit.²⁰⁵⁷ Sikurse është theksuar në Pjesën VI.A, Llazareviqi kishte personel komande në dispozicion, me informacion të plotë lidhur me vendndodhjen e njësive të ndryshme të Korpusit të Prishtinës në Kosovë. Personeli përfshinte degët e operacioneve dhe stërvitjes, shërbimit të fshehtë dhe sigurimit, dhe gjatë gjithë

²⁰⁵² Vladimir Llazareviq, T. 18561 (19 nëntor 2007).

²⁰⁵³ Vladimir Llazareviq, T. 18844–18845 (22 nëntor 2007).

²⁰⁵⁴ P987 (Rregullore për përgjegjësitë e komandës së trupave tokësore të ushtrisë në kohë paqeje, 1990), neni 9; *shih edhe* P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt).

²⁰⁵⁵ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt), f. 14.

²⁰⁵⁶ P1078 (Analizë vjetore e punës, rendit, disiplinës brenda Korpusit të Prishtinës, 28 dhjetor 1998), f. 1.

bombardimit të NATO-s, edhe pse pati disa ndërprerje të funksionimit të sistemit të komunikimit, Komanda e Korpusit të Prishtinës funksionoi në vazhdimësi.²⁰⁵⁸

819. Është vërtetuar se pas emërimit të tij si komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi kishte pushtet *de jure* dhe *de facto* mbi anëtarët e Korpusit të Prishtinës gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s. Nga data 8 prill 1999, Qarku Ushtarak i Prishtinës ishte në vartësi të Korpusit të Prishtinës, duke i vendosur të gjitha detashmentet territoriale-ushtarake nën urdhrat e Llazareviqit.²⁰⁵⁹ Megjithëse njësitë e MPB-së nuk kaluan në vartësi të UJ-së, gjithsesi ekzistonte një nivel i lartë bashkëpunimi apo bashkërendimi midis forcave të RFJ-së dhe Serbisë, çka u mundësoi të kryenin operacione të përbashkëta në Kosovë gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.²⁰⁶⁰

b. Llazareviqi dhe operacionet e përbashkëta në vitin 1999

820. Prokuroria parashton se, në pamje të parë, ofensiva e pranverës në mars 1999 ishte një operacion legjitim kundër UÇK-së, por qëllimi i vërtetë ishte kryerja e krimeve kundër shqiptarëve kosovarë, përfshirë edhe shpërnguljen e dhunshme në masë.²⁰⁶¹ Me të filluar bombardimi i NATO-s, ofensiva e pranverës u zbatua hierarkive komanduese të UJ-së dhe MPB-së me anë të një sërë urdhrash të Komandës së Përbashkët.²⁰⁶² Nga prilli 1999 njësitë e UJ-së dhe MPB-së ishin angazhuar në operacione të gjera luftimi në mbarë Kosovën.²⁰⁶³ Gjatë disa prej këtyre operacioneve u kryen krimet e pretenduara në Aktakuzë, përfshirë edhe shpërnguljen në masë të civilëve shqiptarë kosovarë.²⁰⁶⁴ Prokuroria shton se Llazareviqi komandoi, planifikoi dhe urdhëroi veprimtaritë e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe të njëjse vartëse gjatë operacioneve të kryera në Kosovë në periudhën që mbulon Aktakuza. Gjithashtu më 1999, Llazareviqi bashkërendoi operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së.²⁰⁶⁵

821. Mirëpo, sipas Mbrojtjes së Llazareviqit, urdhrat për operacionet e përbashkëta të kryera në fund të muajit mars dhe mes të muajit prill 1999 qenë tërësisht legjitimë.²⁰⁶⁶ Në veçanti, Mbrojtja e Llazareviqit thekson se, në fillim të vitit 1999, ishte e qartë për organet e sigurimit të UJ-së se UÇK-ja po mobilizonte forcat dhe se po përgatitej për një ofensivë. Rrjedhimisht, marrja e masave

²⁰⁵⁷ 4D532 (Rregullore e Shërbimit të UJ-së, 1 janar 1996), f. 11, rregulla 36.

²⁰⁵⁸ Momir Stojanović, T. 19733–19734 (6 dhjetor 2007); Dragisha Marinković, 5D1379 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 dhjetor 2007), para. 9; Millutin Filipović, T. 19232–19233 (28 nëntor 2007).

²⁰⁵⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18780 (22 nëntor 2007).

²⁰⁶⁰ *Shih* Pjesën VI.E.

²⁰⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 267, 954.

²⁰⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 265.

²⁰⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 266.

²⁰⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 262.

²⁰⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 924.

²⁰⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 640–648.

nga UJ-ja ishte e nevojshme.²⁰⁶⁷ Mbrojtja e Llazareviqit arrin në përfundimin se Llazareviqi “mori pjesë vetëm në planifikimin e përdorimit të njësive të tij në mbrojtjen nga agresioni i NATO-s dhe në planifikimin e operacioneve legjitime kundër UÇK-së, në përputhje me ligjin dhe doktrinën ushtarake”.²⁰⁶⁸

822. Në Kapitullin VII, Dhoma ka arritur në përfundimin se, duke filluar nga muaji mars 1999, kur UJ dhe MPB nisën ofensivën kundër UÇK-së dhe NATO-s, forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë nisën edhe një fushatë të gjerë dhe sistematike shpërnguljesh të dhunshme kundër popullsisë civile, e cila vazhdoi deri kur UJ-ja dhe MPB-ja u detyruan të tërhiqeshin nga Kosova në qershor 1999.

823. Në janar dhe më pas në prill 1999 brenda UJ-së u përgatitën dy plane të mëdha (planet *Grom 3* dhe *Grom 4*). Më 16 janar 1999, Shtabi i Përgjithshëm nxori planin “Grom 3”, në të cilin skicoheshin planet e mbrojtjes nga NATO-ja si edhe planet e ofensivave kundër UÇK-së në brendësi të Kosovës.²⁰⁶⁹ Më 27 janar 1999, Pavkoviqi, komandanti i atëhershëm i Armatës së Tretë, nxori urdhrin për planin *Grom 3*, për angazhimin e Armatës së Tretë në Kosovë në bashkërendim me MPB-në,²⁰⁷⁰ ndërsa më 1 shkurt 1999 Pavkoviqi nxori një urdhër për hartimin e një plani për bllokimin dhe shkatërrimin e forcave terroriste shqiptare në sektorët e Drenicës, Llapit dhe Malishevës, përsëri në bashkërendim me MPB-në.²⁰⁷¹

824. Komanda e Korpusit të Prishtinës nxori urdhrin e saj *Grom 3* drejtuar të gjitha njësive të Korpusit më 7 shkurt 1999.²⁰⁷² Më 16 shkurt 1999, kjo Komandë nxori edhe një urdhër për eliminimin e forcave “terroriste” shqiptare në sektorin e Kosovës së Vogël, Drenicës dhe Malishevës.²⁰⁷³ Llazareviqi dëshmoi se ky urdhër u planifikua në bashkërendim me MPB-në.²⁰⁷⁴ Në këtë aspekt, Dhoma vëren se më 17 shkurt 1999, një ditë pas nxjerrjes së urdhrin *Grom 3* nga

²⁰⁶⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 605–618.

²⁰⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 885; *shih edhe* para. 859, 870.

²⁰⁶⁹ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Direktiva *Grom 3*, 16 janar 1999).

²⁰⁷⁰ 5D245 (Urdhër *Grom 3* i Komandës së Armatës së Tretë, 27 janar 1999), f. 3, 5–7. Në urdhër përfshiheshin detyrat për Korpusin e Prishtinës, duke përcaktuar, ndër të tjera, se, në fazën e parë, Korpusi i Prishtinës duhej të “vijonte fuqizimin e sigurisë në thellësi të kufirit shtetëror në drejtim të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, të parandalonte zbarkimin nga ajri dhe dislokimin me forcë të brigadës së NATO-së nga sektorët e Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës në sektorët e Duhllës, Drenicës dhe Llapit”, dhe në një fazë të dytë, duhej të “parandalonte infiltrimin e forcave sabotatore dhe terroriste nga Republika e Shqipërisë, të shpartallonte dhe shkatërronte brigadën e NATO-s dhe FTSH-në në Kosovë dhe Metohi” në bashkëpunim me forcat e MPB-së.

²⁰⁷¹ 5D249 (Urdhër i Armatës së Tretë, 1 shkurt 1999), f. 2. *Shih edhe* Vladimir Llazareviqi, T. 17900–17902, 17905–17906 (8 nëntor 2007).

²⁰⁷² Vladimir Llazareviq, T. 17905 (8 nëntor 2007).

²⁰⁷³ P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999).

²⁰⁷⁴ Vladimir Llazareviq, T. 17917–17918 (8 nëntor 2007). Sipas Llazareviqit, kishte pasur “bashkërendim në përgatitjen për kryerjen e [detyrës së shkatërrimit të forcave rebele të armatosura në tri vendndodhje të përmendura në urdhrin *Grom 3*].” T. 17918–17919 (8 nëntor 2007).

Komanda e Korpusit të Prishtinës, gjatë një mbledhjeje në Shtabin e MPB-së Llukiqi informoi se Shtabi i MPB-së “planifikonte ... të kryente tri operacione spastruese në zonat e Podujevës, Dragobilës dhe Drenicës”, por ishte në pritje të urdhrimit për të vepruar.²⁰⁷⁵ Tri zonat e përmendura nga Llukiqi ishin pak a shumë ato që përmenden në urdhrin *Grom 3* të Korpusit të Prishtinës. Për më tepër, Dhoma vëren se në urdhrin *Grom 3* Korpusi i Prishtinës i udhëzonte njësitë vartëse të vepronin në bashkërendim me njësi të posaçme të MPB-së, që ishin PJP e 22-të, PJP e 35-të, PJP e 37-të, SAJ dhe JSO.²⁰⁷⁶ Kjo provë dëshmon se, sipas urdhrave të Armatës së Tretë, Llazareviqi dhe Komanda e Korpusit të Prishtinës planifikonin operacione të përbashkëta që duhej të realizoheshin në fund të muajit mars 1999 në bashkëpunim me MPB-në. UJ-ja dhe MPB-ja komunikuan dhe shkëmbyen informacion gjatë shqyrtimit të planit, sipas të cilit duhej të kryheshin tri operacione të mëdha në zonat e Kosovës së Vogël, Drenicës dhe Malishevës.²⁰⁷⁷

825. Në fund të muajit mars 1999 u ndërmorën operacione të mëdha të përbashkëta në përputhje me urdhrat e Komandës së Përbashkët në zonat e Podujevës,²⁰⁷⁸ Kosovës së Vogël,²⁰⁷⁹ Drenicës së Poshtme,²⁰⁸⁰ Rahovecit, Suharekës dhe Krushës së Vogël,²⁰⁸¹ të Drenicës,²⁰⁸² dhe në zonën e përgjithshme të Malishevës.²⁰⁸³ Më 2 prill 1999, edhe njësitë e Korpusit të Prishtinës morën urdhër t’u jepnin mbështetje forcave të MPB-së për të dërrmuar dhe shkatërruar forcat “terroriste”

²⁰⁷⁵ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1. Ndër të tjerë, në këtë mbledhje merrnin pjesë Llukiqi, Vllajko Stojilkoviqi, Vllastimir Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, anëtarë të Shtabit të MPB-së së Prishtinës, Millosav Villotiqi, të gjithë shefat e SPB-ve, si edhe komandantë të PJP-së dhe SAJ-së.

²⁰⁷⁶ P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999).

²⁰⁷⁷ *Shih* Pjesën VI.E.

²⁰⁷⁸ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999); 5D1357 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 25 mars 1999).

²⁰⁷⁹ P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

²⁰⁸⁰ P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999); P2042 (Raport operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 23 mars 1999), f. 1.

²⁰⁸¹ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999); P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999); 5D1357 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 25 mars 1999).

²⁰⁸² P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999); P2043 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 25 mars 1999). *Shih edhe* P2045 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 27 mars 1999); P2046 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 28 mars 1999); P2616 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 1–9; P2042 (Raport operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 23 mars 1999); 5D343 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, në të cilin kërkohen raporte luftimi nga njësitë e UJ-së, 29 mars 1999), f. 1; 5D1357 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 25 mars 1999); 5D1358 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 26 mars 1999).

²⁰⁸³ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999); *Shih* P1446 (Dokument dërguar Shtabit të Komandës së Lartë nga Armata e Tretë, 30 mars 1999); P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999); P2035 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 30 mars 1999); 4D371 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 1 prill 1999); P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999).

shqiptare në sektorin e Jabllanicës.²⁰⁸⁴ Zonat ku u kryen këto operacione të përbashkëta përkohë me tre sektorët e mëdhenj të përmendur në urdhrin e Komandës së Korpusit të Prishtinës, të datës 16 shkurt 1999.²⁰⁸⁵ Në këtë urdhër, Komanda e Korpusit të Prishtinës i informoi njësitë vartëse se “terroristët” qenë riorganizuar: “ata janë pajisur me armë moderne dhe pajime luftimi dhe janë stërvitur që të vijnë në luftën e tyre të armatosur kundër forcave mbrojtëse të RFJ-së”. Në urdhër thuhej gjithashtu se bazat më të mëdha “terroriste” qenë zonat e Kosovës së Vogël, Drenicës, Malishevës dhe Shalës së Bajgorës dhe se në këto zona kishte përafërsisht 6.800 “terroristë”.²⁰⁸⁶ Njësitë në vartësi udhëzoheshin që t’i eliminonin forcat “terroriste” shqiptare dhe të mos i lejonin të hynin nga Shqipëria dhe Maqedonia. Urdhri i Komandës së Përbashkët i nxjerrë më 23 mars 1999 për operacione të përbashkëta në komunat Prizren, Suharekë dhe Rahovec bënte të ditur se gjatë 15-20 ditëve të fundit UÇK-ja e kishte intensifikuar veprimtarinë luftarake dhe sulmet kundër anëtarëve të UJ-së dhe MPB-së.²⁰⁸⁷

826. Sikurse është përmendur në Pjesën VI.E, në muajin prill 1999 u hartua një plan tjetër për angazhimin e UJ-së në Kosovë (Grom 4) i cili më pas u zbatua nga Korpusi i Prishtinës.²⁰⁸⁸ Në mes të muajit prill 1999, u kryen disa operacione të përbashkëta në përputhje me urdhrat e Komandës së Përbashkët në zonën e Kosmaçit,²⁰⁸⁹ sektorin e Zhegocit,²⁰⁹⁰ Drenicë,²⁰⁹¹ Orllan-Zllash,²⁰⁹² Çiçavicë,²⁰⁹³ Jezercë,²⁰⁹⁴ Rugovë,²⁰⁹⁵ zonën Bajgorë-Barë²⁰⁹⁶ dhe sektorin Zatriq.²⁰⁹⁷

²⁰⁸⁴ P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999), f. 1; 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999); 5D85 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999).

²⁰⁸⁵ Dhoma vëren se Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se ishte “e qartë” se urdhrat e Komandës së Përbashkët në fund të muajit mars 1999 ishin urdhra të veçantë që bazoheshin në urdhrin e Komandës së Korpusit të Prishtinës i datës 16 shkurt 1999. Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 829.

²⁰⁸⁶ P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999).

²⁰⁸⁷ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); *shih edhe* P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999); 3D1048 (Raport i Sigurimit i Armatës së Tretë, 2 mars 1999), f. 2.

²⁰⁸⁸ *Shih* P1481 (Direktivë e Shtabit të Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999); 4D308 (Urdhër i Armatës së Tretë për mbrojtjen nga NATO-ja, 10 prill 1999); 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1999).

²⁰⁸⁹ P1970 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 9 prill 1999).

²⁰⁹⁰ P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999).

²⁰⁹¹ P1972 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

²⁰⁹² P1973 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

²⁰⁹³ P1974 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D1023 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 19 prill 1999).

²⁰⁹⁴ P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

²⁰⁹⁵ P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D194 (Informacion i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 15 prill 1999); 5D1411 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 19 prill 1999); P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999).

²⁰⁹⁶ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P2619 (Pjesë nga Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 10, 13–15; P2572 (Ditar Luftë i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 57, 61–62; 5D220 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 1 maj 1999); P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

²⁰⁹⁷ P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

827. Në Pjesën VI.E, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se Komanda e Korpusit të Prishtinës ishte burimi i urdhrave të Komandës së Përbashkët. Në veçanti, Dhoma Gjyqësore vëren se Llazareviqi ka marrë përgjegjësinë për nxjerrjen e këtyre urdhrave. Operacionet e përbashkëta u planifikuan nga UJ-ja në bashkëpunim me MPB-në. Varësisht prej operacionit, i jepej përparësi ose planit të MPB-së, ose planit të UJ-së. Me të përfunduar faza e bashkërendimit, mbetej që operacionet të planifikoheshin në nivel taktik.

828. Sikurse u shpjegua në Pjesën VI.E, edhe në maj 1999 u kryen operacione të përbashkëta në përputhje me urdhrat e Komandës së Korpusit të Prishtinës. Më 4 maj, u dha urdhri për një operacion të dytë në zonën e Bajgorës.²⁰⁹⁸ Më 20 maj, Komanda e Korpusit të Prishtinës dha urdhër për një operacion të përbashkët të MPB-së/UJ-së në sektorin e Liqenit të Radoniqit, i cili njihet edhe si “Operacioni Sekaç”.²⁰⁹⁹ Më 22 maj, Komanda e Korpusit të Prishtinës dha urdhër për një operacion të përbashkët në sektorin e Pollatës.²¹⁰⁰ Më 25 maj 1999, u urdhërua një operacion tjetër i përbashkët “në sektorin e Malit të Drenicës”.²¹⁰¹ Më 28 maj, Komanda e Korpusit të Prishtinës dha një urdhër tjetër për shkatërrimin e forcave “terroriste” në sektorin e Malit Drenica-1”.²¹⁰² Më 27 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi një urdhër tjetër MPB-së. Objektivi i këtij urdhri ishte dërrmimi dhe shkatërrimi i forcave “terroriste” shqiptare në zonën e Prekazit.²¹⁰³

829. Këto prova tregojnë se Llazareviqi dhe Komanda e Korpusit të Prishtinës morën pjesë në masë të konsiderueshme në planifikimin dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta të kryera në mars-qershor 1999. Komanda e Korpusit të Prishtinës i bashkërendoi këto operacione me MPB-në. Gjashtëmbëdhjetë urdhrat e Komandës së Përbashkët përshkruanin brigadat e UÇK-së që duhej të eliminoreshin nga njësitë e Korpusit të Prishtinës gjatë këtyre operacioneve. Dhoma vëren se gjatë fushatës ajrore të NATO-së, UJ-ja u angazhua në operacione ushtarake kundër UÇK-në, por në të njëjtën kohë kreu edhe një fushatë të gjerë dhe sistematike për dëbimin me dhunë të shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre, sikurse është përmendur edhe në Kapitullin VII. Në një sërë rastesh, të cilat specifikohen më poshtë, urdhrat e Korpusit të Prishtinës bënë që trupat e UJ-së të kryenin dëbimet. Më poshtë, diskutohet më tej dijenia e Llazareviqit lidhur me këtë fushatë shpërnguljesh të dhunshme dhe dijenia e tij për pjesëmarrjen e UJ-së në këtë fushatë në fshatra konkrete në Kosovë.

²⁰⁹⁸ 6D704 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 4 maj 1999), f. 1, 5.

²⁰⁹⁹ P2011 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, “Operacioni Sekaç,” 20 maj 1999); 5D230 (Raport Luftimi i Postëkomandës Pararojë të Korpusit të Prishtinës për Korpusin e Prishtinës, 26 mars 1999).

²¹⁰⁰ 6D709 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 22 maj 1999).

²¹⁰¹ P2014 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 25 maj 1999).

²¹⁰² 6D712 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 28 maj 1999).

²¹⁰³ P1503 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 27 maj 1999).

c. Implikimi i Llazareviqit në inkuadrimin e vullnetarëve në njësitë e Korpusit të Prishtinës

830. Prokuroria parashtron se Llazareviqi u përfshi drejtpërsëdrejti në pranimin, pritjen dhe inkuadrimin e vullnetarëve në forcat e Korpusit të Prishtinës dhe caktimin e tyre të mëposhëm në njësitë vartëse disa prej të cilëve më vonë u liruan nga shërbimi për shkak të sjelljes së papërshtatshme dhe mosrespektimit të disiplinës dhe rregullave ushtarake.²¹⁰⁴ Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se pranimi i vullnetarëve në ushtri ishte “i rregulluar me ligj” dhe, në përgjithësi, nuk u bë në nivelin e Korpusit të Prishtinës, por në një nivel më të lartë.²¹⁰⁵ Ajo shton se Llazareviqi, “edhe pse nuk ishte i ngarkuar me detyrën e përzgjedhjes dhe pranimi të vullnetarëve”, bëri një kontroll të rreptë të personave që u pranuan në njësitë e Korpusit të Prishtinës.²¹⁰⁶

831. Pranimi i vullnetarëve në njësitë e UJ-së, përfshirë edhe njësitë e Korpusit të Prishtinës, është diskutuar në Pjesën VI.A. Në këtë pjesë, Dhoma do të analizojë vetëm provat që lidhen me implikimin e Llazareviqit në inkuadrimin e vullnetarëve në njësitë e Korpusit të Prishtinës.

832. Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s Llazareviqi nxori urdhra që kishin të bënin me përfshirjen e vullnetarëve.²¹⁰⁷ Më 16 prill 1999, Llazareviqi dha urdhër për kryerjen e “një kontrolli të imët” të çdo vullnetari para pranimi. Për shembull, vullnetari duhej pyetur nëse dëshironte të bënte stërvitje në qendrën stërvitore në Nish. Urdhri bënte të ditur se, nëse ky person nuk dëshironte ta kryente këtë stërvitje, atëherë nuk duhej pranuar.²¹⁰⁸ Llazareviqi shpjegoi se, në nivelin e Korpusit të Prishtinës, u morën masa të tjera shtesë: vullnetarët duhej të kalonin kontrollet e sigurisë, psikologjike dhe mjekësore, dhe gjithashtu kontrollohej niveli stërvitor si edhe aftësia e tyre në përdorimin e armëve.²¹⁰⁹ Llazareviqi dëshmoi se Korpusi i Prishtinës pranoi rreth 1.400 vullnetarë si ushtarë, rreth një e treta e të cilëve u liruan shumë shpejt sepse nuk mund të luftonin, u sëmurën ose nuk respektonin disiplinën ushtarake.²¹¹⁰

833. Llazareviqi dëshmoi se disa vullnetarë “të cilët nuk e respektonin regjimin e disiplinës ushtarake dhe Normat e Sjelljes në Kohë Luftë” u arrestuan, iu dorëzuan organeve hetimore

²¹⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 950–951.

²¹⁰⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 717, 721.

²¹⁰⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 722.

²¹⁰⁷ Vladimir Llazareviq, T. 17977–17978 (9 nëntor 2007); 5D338 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 27 mars 1999).

²¹⁰⁸ 5D197 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 prill 1999), f. 2.

²¹⁰⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17978–17979 (9 nëntor 2007).

²¹¹⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17980 (9 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–46; P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999); 5D215 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 18 prill 1999);

ushtarake dhe u liruan nga detyra.²¹¹¹ Këtë dëshmi e mbështesin disa prova.²¹¹² Një sërë dokumentesh bëjnë të ditur se masat e marra kundër vullnetarëve për të cilët ishte vërtetuar se patën kryer krime nuk ndryshojnë nga masat e marra kundër ushtarëve të rregullt.²¹¹³ Më 29 mars 1999, Brigada e 175-të e Këmbëtorisë raportonte se Llazareviqi kishte miratuar dërgimin e vullnetarëve në Brigadën e 243-të të Mekanizuar, por se 32 syresh kishin thënë se dëshironin të largoheshin, kështu që qenë çarmatosur dhe qenë kthyer mbrapsht.²¹¹⁴

834. Dragisha Marinkoviqi dëshmoi se hasi në një grup të Brigadës së 175-të të Këmbëtorisë e cila përbëhej tërësisht me vullnetarë, kur e inspektoi këtë njësi në mes të muajit prill 1999.²¹¹⁵ Kjo njësi kishte pasur më parë probleme të rënda të disiplinës, ku përfshihej edhe vrasja e gjashtë shqiptarëve kosovarë nga vullnetarët e radhëve të saj.²¹¹⁶ Pas një muaji, Korpusit të Prishtinës iu raportuan probleme të ngjashme lidhur me këtë njësi.²¹¹⁷ Gjithsesi Llazareviqi ishte në dijeni se kompani të tëra vullnetarësh vazhduan të vepronin edhe gjatë fazave të mëvonshme të konfliktit, me gjithë urdhrat që ndalonin shprehimisht grupimin e vullnetarëve në një njësi,²¹¹⁸ ashtu siç ishte i informuar se një kompani vullnetarësh kishte vepruar si pjesë e Brigadës së 125-të të Motorizuar gjatë operacionit në Caragoj në fund të muajit prill 1999.²¹¹⁹

835. Sikurse është shpjeguar në Pjesën VI.A, një pjesë e provave tregojnë se disa vullnetarë i anashkaluan procedurat e rregullta të pritjes dhe pranimit të vullnetarëve dhe se në njësitë e UJ-së u inkuadruan “vullnetarë të pakontrolluar”. Gjithsesi Dhoma konkludon se Prokuroria nuk ka arritur të tregojë se Llazareviqi i ndihmoi vullnetarët të anashkalonin procedurën dhe faktikisht më 27 mars dhe 16 prill 1999 ai lëshoi urdhra të cilët krijojnë sistemin për përmirësimin e përzgjedhjes dhe disiplinës së vullnetarëve. Për më tepër, fakti se stërvitja që kryenin vullnetarët mund të ketë

²¹¹¹ Vladimir Llazareviq, T. 17980 (9 nëntor 2007). *Shih edhe* P1943 (Dokument i Shtabit të Komandës së Lartë për problemet lidhur me vullnetarët, 20 prill 1999) (“Disa ditë pas pranimit të vullnetarëve, 25 syresh u kthyen nga Korpusi i Prishtinës ndërsa 7 syresh u ndaluan për veprime të jashtëligjshme, vrasje, përdhunim, mosbindje ndaj urdhrave dhe dezertim”).

²¹¹² Vladimir Marinkoviq, T. 20272–20273, 20327–20328 (14 dhjetor 2007); Branko Gajiq, T. 15310–15311 (10 shtator 2007); Zharko Kostiq, T. 17543 (23 tetor 2007); P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 2; P1943 (Dokument i Shtabit të Komandës së Lartë për problemet lidhur me vullnetarët, 20 prill 1999), f. 2; 3D1059 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 25 qershor 1999); Vllatko Vukoviq, 5D1401 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 janar 2008), para. 83 (mbyllur me vulë); Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë e dëshmitarit, datë 28 shtator 2007), para. 34.

²¹¹³ 5D315 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për parandalimin e shpërdorimit të armëve, 10 maj 1999); P2082 (Urdhër i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar për parandalimin e shpërdorimit të armëve, 11 maj 1999); 5D1351 (Informacion për krimet dhe incidentet, dërguar nga Brigada e 549-të e Motorizuar, 27 maj 1999), f. 2.

²¹¹⁴ 5D825 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbëtorisë për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 1.

²¹¹⁵ Dragisha Marinkoviq, T. 20148–20149 (12 dhjetor 2007).

²¹¹⁶ 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999); 5D85 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999).

²¹¹⁷ 5D563 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbëtorisë për Korpusin e Prishtinës, 19 maj 1999).

²¹¹⁸ P1479 (Urdhër lidhur me vullnetarët, 7 prill 1999).

qenë e pamjaftueshme nuk ka lidhje me Llazareviqin, duke qenë se kohëzgjatja e kësaj stërvitjeje vendosej në Shtabin e Komandës së Lartë. Dhoma vëren se Llazareviqi ishte në dijëni të shkeljes së urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë i cili ndalonte grupimet e vullnetarëve në UJ dhe të angazhimit të këtyre grupeve në aktivitetet e luftimit, përkundër kryerjes së krimeve të rënda prej tyre kundër shqiptarëve kosovarë më parë.

d. Dijënia dhe reagimi i Llazareviqit ndaj krimeve të kryera në vitin 1999

i. *Prania e Llazareviqit në terren*

836. Prokuroria pretendon se Llazareviqi kishte dijëni të drejtpërdrejtë për operacionet duke qenë se ai i vizitonte përditë njësitë e Korpusit të Prishtinës.²¹²⁰ Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se si komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi, ndodhej larg aktiviteteve të njësive që kishte në vartësi dhe operacioneve të kryera në terren.²¹²¹

837. Sipas Urdhrit mbi organizimin e punës së Komandës së Korpusit të Prishtinës, të datës 29 mars 1999, Komanda e Korpusit ndahej në katër sektorë. Llazareviqi shpjegoi se këta sektorë ndodheshin “në të gjithë Kosovën”.²¹²² Si komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi, ndodhej në përgjithësi në njërin prej këtyre sektorëve.

838. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Llazareviqi ndodhej kryesisht në Prishtinë dhe rreth saj. Sikurse është përmendur në Pjesën VI.A, gjatë muajve mars, prill dhe maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në Prishtinë dhe Llazareviqi ndodhej rregullisht atje, shpesh me Momir Stojanoviçin.²¹²³ Edhe Pavkoviçi ishte i pranishëm rregullisht në postëkomandën e Korpusit të Prishtinës në Prishtinë, gjatë konfliktit.²¹²⁴ Llazareviqi shpjegoi se Pavkoviçi ishte me të “shumicën e kohës” dhe se Postëkomanda Pararojë e Armatës së Tretë ishte në Komandën e Korpusit të Prishtinës.²¹²⁵ Gjithashtu, Llazareviqi mori pjesë në të paktën një mbledhje në qytetin e Prishtinës me Stevanoviçin dhe Gjorgjeviçin nga MPB-ja ndërsa shqiptarët kosovarë po

²¹¹⁹ P2026 (Raport Luftimi i Brigadës 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2 (ku thuhet se në operacionin në luginën e Çaragojt u angazhuan kompani vullnetarësh).

²¹²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 964, 927.

²¹²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 929.

²¹²² Vladimir Llazareviq, T. 18070–18071 (12 nëntor 2007); 5D342 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës mbi organizimin e punës së Komandës së Korpusit të Prishtinës, 29 mars 1999). *Shih edhe* 5D348 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 30 mars 1999).

²¹²³ K73, T. 3336 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur); P2440 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 dhjetor 2005), para. 50.

²¹²⁴ Vladimir Llazareviq, T. 18080 (12 nëntor 2007); Mirko Starçeviq, T. 17436 (22 tetor 2007).

²¹²⁵ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 84.

shpërnguleshin me dhunë nga qyteti nga forcat e UJ-së dhe MPB-së të cilat bashkëvepronin në mënyrë të organizuar, sikurse është përmendur në Pjesën VII.J.²¹²⁶

839. Llazareviqi ishte i pranishëm edhe më 1 qershor 1999 në mbledhjen e Komandës së Përbashkët në Prishtinë, për të cilën dëshmoi Vasileviqi.²¹²⁷ Kur Shainoviqi informoi të pranishmit se së shpejti do të fillonte tërheqja e MPB-së dhe UJ-së dhe se të gjitha veprimet duhej të përfundonin sa më shpejt, Llazareviqi pyeti se çfarë duhej të bënte duke qenë se ai kishte filluar aktivitet “antiterroriste” në disa sektorë.²¹²⁸

840. Ka prova të konsiderueshme se Llazareviqi shkonte shpesh në terren për të inspektuar njësitë që kishte në vartësi.²¹²⁹ Gjatë këtyre udhëtimeve inspektuese, ai bisedonte me komandantë të ndryshëm të Korpusit të Prishtinës lidhur me moralin, gatishmërinë luftarake dhe situatën në terren.²¹³⁰ Më 3 dhe 4 mars 1999, Ojdaniqi, Pavkoviqi dhe Llazareviqi inspektuan disa prej njërive të Korpusit të Prishtinës të angazhuara kryesisht në ruajtjen e sigurisë në kufirin shtetëror. Objektivi i inspektimit ishte vlerësimi i “gatishmërisë luftarake dhe, sidomos, i moralit, aftësisë dhe efektivitetit të komandimit në këto njësi”.²¹³¹ Mirko Starçeviqi dëshmoi gjithashtu se në vitin 1999 Pavkoviqi dhe Llazareviqi bënë një vizitë në njësitë vartëse “për të folur me trupat, për t’i informuar, për të zhvilluar seanca informative” dhe pasditeve Pavkoviqi dhe Llazareviqi takoheshin me Mirko Starçeviqin për të shkëmbyer mendime “për zhvillimet në terren”.²¹³² Gjithashtu, dy raporte nga Korpusi i Prishtinës drejtuar Komandës së Armatës së Tretë, që mbajnë datat 4 dhe 5 prill 1999, bëjnë të ditur se Llazareviqi më 3 dhe 4 prill 1999 vizitoi “një pjesë të njërive të Korpusit të Prishtinës”, ku “u shqyrtua gjendja e moralit luftarak dhe u bë një informim i njërive në vartësi”.²¹³³ Dhoma vëren se inspektimi i njërive të Korpusit të Prishtinës nga Llazareviqi përmendet në këto dy raporte në rubrikat me titull “gjendja e moralit” dhe “morali i Ushtrisë”. Aty

²¹²⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18260 (14 nëntor 2007).

²¹²⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18121–18123 (12 nëntor 2007).

²¹²⁸ Momir Stojanoviq, T. 19773–19777 (7 dhjetor 2007).

²¹²⁹ Goran Jevtoviq, T. 20355 (16 janar 2008); Kërsman Jelliq, T. 19038–19039 (26 nëntor 2007); K73, T. 3317–3318 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur); Dragan Zhivanoviq, T. 20591 (18 janar 2008); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 84; P633 (Dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës lidhur me lëvdimin për rezultatet e arritura, 5 mars 1999); K73, P2307 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 dhjetor 2005), para. 34 (nën vulë); IC167 (Shënim i bërë në faqen 21 të provës numër P615 nga dëshmitari Zhivanoviq në gjykatë); P2026 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës dhe Postëkomandën Pararojë të Gjakovës, 29 prill 1999); 5D230 (Raport Luftimi i Postëkomandës Pararojë të Korpusit të Prishtinës për Korpusin e Prishtinës, 26 mars 1999); *shih edhe* 5D1378 (Video e Pavkoviqit dhe Llazareviqit në Gjakovë).

²¹³⁰ P1355 (Transkript i raportit të Millan Drecunit, televizioni RTS SAT i Beogradit, 8 prill 1999), f. 2.

²¹³¹ P633 (Dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës lidhur me lëvdimin për rezultatet e arritura, 5 mars 1999), f. 1.

²¹³² Mirko Starçeviq, T. 17432, 17436 (22 tetor 2007), 4D500 (deklaratë e dëshmitarit, datë 29 shtator 2007), para. 19. *Shih edhe* Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 dhjetor 2007), para. 14.

²¹³³ P1903 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 5 prill 1999), f. 3.

specifikohet se “rezultatet e arritura në operacionet e luftimit” kanë kontribuar në “fuqizimin e moralit luftarak të anëtarëve të Korpusit të Prishtinës”.²¹³⁴

841. Në një intervistë të publikuar në gazetën “Glas Javnosti” në korrik 1999, Llazareviqi deklaroi se ai qëndroi për ca kohë në terren në Kosovë në vitin 1999. Pyetjes nëse kishte qenë në kontakt të ngushtë me ushtarë të zakonshëm, ai iu përgjigj, “Të gjithë komandantët, Komandanti i Armatës i pari, pastaj Komandanti i Korpusit, si edhe komandantët dhe ushtarët e tyre, ndodheshin praktikisht në vijën e parë të frontit.”²¹³⁵

842. Sikurse shpjegohet më poshtë, më 1 maj 1999, Llazareviqi dhe Pavkoviqi shkuan të inspektonin njësitë në vartësi të Brigadës së 175-të të Këmbësorisë.²¹³⁶ Llazareviqi vërejti se kishte mungesë disipline dhe se ushtarët konsumonin alkool. Më 29 prill 1999, Llazareviqi inspektoi edhe Brigadën e 125-të të Motorizuar.²¹³⁷ Dragan Zhivanoviqi, komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar, konfirmoi se Llazareviqi ndodhej në Deçan me të më 29 prill 1999.²¹³⁸

843. Dhoma gjykon se edhe këto prova dëshmojnë rolin e Llazareviqit si komandant i njësisë të UJ-së në terren në Kosovë dhe dijeninë e tij për situatën e atjeshme. Mirëpo, habia e dukshme e Llazareviqit në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 1 qershor 1999, kur i thanë t’i tërhiqte trupat e tij, bie ndesh me pohimin se ai “mbahej i informuar” lidhur me ngjarjet në Beograd dhe se ishte i përfshirë në procesin e vendimmarrjes atje. Në veçanti, Dhoma vëren se Llazareviqi nuk ishte në Beograd në vitin 1999 dhe se nuk mori pjesë në mbledhjet në kryeqytet.²¹³⁹ Për më tepër, Llazareviqi nuk mori pjesë në mbledhjet e zhvilluara në Beograd më 4, 16 dhe 17 maj 1999.²¹⁴⁰

ii. Dijenia për krimet e kryera nga anëtarët e njësisë të Korpusit të Prishtinës

844. Disa prova tregojnë se sistemi i raportimit brenda Korpusit të Prishtinës nuk funksionoi gjithmonë si duhej në vitin 1999 dhe se Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk i merrte raportet në shpeshësinë e duhur.²¹⁴¹ Megjithatë, provat—përfshirë edhe raportet e përshkruara në pjesët më

²¹³⁴ P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999), f. 2.

²¹³⁵ P1523 (Transkripti i një bisede televizive të zhvilluar më 18 korrik 1999, publikuar më 21 korrik 1999), f. 2.

²¹³⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18110–18112 (12 nëntor 2007); 5D388 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1–2.

²¹³⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18105 (12 nëntor 2007); P2026 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 29 prill 1999), f. 2.

²¹³⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 20592–20593 (18 janar 2008).

²¹³⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18134 (12 nëntor 2007).

²¹⁴⁰ Vladimir Llazareviq, T. 18657 (20 nëntor 2007). Llazareviqi dëshmoi se nuk kishte asnjë dijeni në vitin 1999 për letrën e Prokurores Louise Arbour.

²¹⁴¹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokuroresin), f. 81–82; Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë e dëshmitarit, datë 8 janar 2008), para. 23, 25; Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë e dëshmitarit, datë 27 dhjetor 2007),

poshtë për masat ndëshkuese dhe parandaluese të marra nga Korpusi i Prishtinës—tregojnë se komunikimi u mbajt dhe se Komanda e Korpusit të Prishtinës mori një numër të konsiderueshëm raportesh mbi angazhimin e njësisve vartëse në aktivitetet e luftimit në vitin 1999.²¹⁴² Faktikisht ashtu sikurse është diskutuar në Pjesën VI.A, gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s, pavarësisht nga disa çrregullime, komunikimi brenda Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës vijoi duke mundësuar funksionimin pa ndërprerje të sistemit të komandimit të Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës.²¹⁴³

845. Llazareviqi mësoi për krimet e kryera nga anëtarët e njësisve të Korpusit të Prishtinës nga burime të ndryshme, përfshirë organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës. Si shef i Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës, Stojanoviqi e informonte rregullisht Llazareviqin për çështjet e sigurisë nëpër njësi dhe për çështjet e sigurisë ndikonin në këto njësi. Ai e informonte edhe për numrin, vendndodhjen, planet, synimet, armatimin dhe aktivitetet e UÇK-së dhe për informatat e zbulimit të cilat qenë me interes nga ana e sigurisë për Korpusin e Prishtinës.²¹⁴⁴

846. Gjithashtu, disa dokumente të nxjerra nga Komanda e Korpusit të Prishtinës gjatë sulmeve ajrore të NATO-s bëjnë të ditur se Llazareviqi ishte në dijeni të krimeve konkrete të kryera nga vartësit e tij.²¹⁴⁵ Për shembull, dy raporte luftimi të Komandës së Korpusit të Prishtinës dëshmojnë se në fillim të muajit prill 1999 Korpusi i Prishtinës i raportoi disa krime Komandës së Armatës së

para. 12; Goran Jevtović, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 27. *Shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 18074 (12 nëntor 2007); Aleksandar Vasileviq, T. 8659 (18 janar 2007). 5D473 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 8 maj 1999); 5D955 (Raport luftimi i Brigadës së 15-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 20 prill 1999); 5D942 (Raport luftimi i Brigadës së 15-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 7 prill 1999); 5D1099 (Raport luftimi i Qendrës së 52-të të Komunikimit KCSV të UJ-së për Korpusin e Prishtinës, 24 maj 1999); P2591 (Analizë pas operacionit e Brigadës së 37-të, 25 prill 1999); 5D362 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 4 prill 1999) (ku thuhej se, “megjithëse është përcaktuar që raportet e luftimit [nga njësitë vartëse] duhen dorëzuar brenda orës 1600 çdo ditë ... gjatë pesë ditëve të fundit, me përjashtim të Brigadës së 15-të të Blinduar dhe Brigadës së 125-të të Motorizuar, asnjë njësi tjetër nuk e ka dorëzuar raportin në kohë.”); 5D608 (Raport luftimi i Brigadës së 211-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 7 prill 1999); 5D550 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 28 prill 1999); 5D473 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 8 maj 1999); 5D1109 (Raport luftimi i Batalionit të 52-të Mjekësor për Korpusin e Prishtinës, 22 maj 1999); 5D1072 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 20 prill 1999); 5D1354 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të të Lehtë të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 12 prill 1999); 4D251 (Raport Luftimi i PBR-së për Korpusin e Prishtinës, 5 maj 1999); 5D545 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 21 prill 1999); 5D546 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 24 prill 1999); 5D549 (Raport luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999); 5D554 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 2 maj 1999); 5D570 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 31 maj 1999).

²¹⁴² Miodrag Janković, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 tetor 2007), para. 8, 12–13; 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 8, 11; P1319 (Përgjigje të Pavkoviçit drejtuar pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17.

²¹⁴³ Miodrag Janković, 4D504 (deklaratë e dëshmitarit, datë 1 tetor 2007), para. 8, 12–13; 3D865 (Raport i Shtabit të Komandës së lartë, 30 maj 1999), f. 8, 11; P1319 (Përgjigje të Pavkoviçit drejtuar pyetjeve të telespektatorëve, Programi i Parë i Televizionit RTS në Beograd, 20 tetor 2000), f. 17.

²¹⁴⁴ Momir Stojanović, T. 19734 (6 dhjetor 2007).

²¹⁴⁵ *shih* P1182 (Informacion i Korpusit të Prishtinës për Brigadën e 52-të të Raketave Artilerike, 15 maj 1999).

Tretë.²¹⁴⁶ Një urdhër i nxjerrë nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 18 prill 1999 tregon gjithashtu se Llazareviqi mori informacion lidhur me “raste konkrete sjelljesh [gjatë] operacioneve të luftimit” jo plotësisht në përputhje me udhëzimet për sjelljen gjatë luftimit dhe me të drejtën humanitare ndërkombëtare, me fjalë të tjera lidhur me “raste plaçkitjesh dhe krimesh”.²¹⁴⁷ Urdhrat e nxjerrë nga Komanda e Korpusit të Prishtinës që ndalonin aktet e plaçkitjeve dhe format e tjera e krimit përbëjnë provë të mëtijshme se Llazareviqi ishte në dijeni të kryerjes së këtyre krimeve gjatë operacioneve të luftimit.²¹⁴⁸

847. Sikurse u shpjegua në Ndarjen VI.A.1.e, disa dokumente të dërguara nga njësitë vartëse të Komandën e Korpusit të Prishtinës e informonin Llazareviqin për krimet e kryera nga anëtarët e njësisë të Korpusit të Prishtinës.²¹⁴⁹ Në një raport të datës 31 mars 1999, Llazareviqi informohej për krimet e kryera nga anëtarët e Brigadës së 175-të të Këmbësisë.²¹⁵⁰ Në një raport luftimi të datës 3 prill 1999, Komanda e Brigadës së 549-të të Motorizuar theksonte se disa rekrutë të UJ-së kishin tentuar të merrnin sende të “refugjatëve”.²¹⁵¹ Më 18 prill 1999, një raport i një “poste ushtarake” në zonën e Gjakovës e informonte Komandën e Korpusit të Prishtinës se katër ushtarë kishin kryer krimin e përdhunimit kundër një personi civil.²¹⁵² Më 25 prill 1999, Komanda e Brigadës së 37-të të Motorizuar raportonte për pesë anëtarë të brigadës për të cilët dyshohej se kishin kryer krime kundër popullsisë civile në Gllogoc.²¹⁵³ Më 1 maj 1999 Komanda e Brigadës së 354-të të Këmbësisë i raportonte Komandës së Korpusit të Prishtinës për një akt të kryer nga një rekrut i UJ-së kundër një personi civil.²¹⁵⁴ Më 10 maj 1999, Saviqi raportonte se dy ushtarë kishin kryer akte plaçkitjeje gjatë zhvillimit të operacionit të dytë në zonën e Bajgorës.²¹⁵⁵ Këto dokumente bëjnë të ditur se kundër autorëve të krimeve u morën masa, por nuk japin hollësi për këto masa.

²¹⁴⁶ 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999); P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999).

²¹⁴⁷ 5D198 (Paralajmërim i Komandës së Korpusit të Prishtinës, 18 prill 1999).

²¹⁴⁸ *Shih edhe* P2029 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 1 prill 1999); 5D32 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 20 prill 1999); 5D35 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 24 prill 1999), f. 1; 5D396 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 maj 1999); 5D372 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1999); 5D398 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 7 maj 1999); 5D385 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 29 prill 1999).

²¹⁴⁹ 5D1061 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 20 maj 1999), f. 2.

²¹⁵⁰ Momir Stojanović, T. 19739 (6 dhjetor 2007); 5D825 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbësisë për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999).

²¹⁵¹ 5D885 (Dokument i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 3 prill 1999), f. 2.

²¹⁵² 5D1148 (Raport i postës ushtarake nr 1936, 18 prill 1999).

²¹⁵³ 5D1057 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999), f. 2.

²¹⁵⁴ 5D509 (Raport i rregullt luftimi i Komandës së Brigadës së 354-të të Këmbësisë, 1 maj 1999), f. 1.

²¹⁵⁵ Lubomir Saviq, T. 20972–20973 (24 janar 2008); 5D1132 (Raport Luftimi i Brigadës së 58-të të Këmbësisë së Lehtë për Korpusin e Prishtinës, 10 maj 1999), f. 2.

848. Lidhur me krimet e kryera nga anëtarët e MPB-së, raporti që Llazareviqi i dërgoi Komandës së Armatës së Tretë më 24 maj 1999 bën të ditur se ai ishte në dijeni të problemeve në pikat e kontrollit dhe në angazhimin e forcave të MPB-së në spastrimin e fushëbetejave pas operacioneve të luftimit. Llazareviqi vuri në dukje se “puna e pikave të kontrollit me përbërje të përbashkët të MPB-së dhe Policisë Ushtarake [ishte] karakterizohej nga probleme dhe çështje të mprehta duke qenë se MPB-ja i toleronte aktivitetet kriminale të anëtarëve të saj kundër popullsisë civile [shqiptare], vrasje, përdhunime, plaçkitje, vjedhje në rrethana rënduese”. Ai kërkoi gjithashtu “marrjen e masave të forta dhe konkrete për t’i vendosur njësitë dhe organet e MPB-së në varësi të Komandës së Korpusit të Prishtinës”, duke theksuar se ai nuk donte “të mbante përgjegjësi për pasojat që kishin ndodhur më parë dhe që mund të ndodhnin në të ardhmen për shkak të angazhimit të tyre jokushtetues dhe të paligjshëm”.²¹⁵⁶ Nga dëshmia e Stefanoviqit duket se raporti i Llazareviqit mbështetej në një raport që Stefanoviqi i kishte dërguar më parë Komandës së Korpusit të Prishtinës. Stefanoviqi shpjegoi se Dikoviqi, komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar, i kishte raportuar disa herë gjatë muajit maj 1999 se në zonën e përgjegjësisë së tij kishte probleme me anëtarët e MPB-së. Më tej, ai dëshmoi se me të marrë këtë informacion “komandanti i korpusit”, krijoi tre ekipe: një prej këtyre ekipeve “drejtohej nga organet e sigurimit për të shqyrtuar informacionin e dhënë për krimet e mundshme të policisë”.²¹⁵⁷ Megjithëse mori këtë informacion, Llazareviqi vijoi me miratimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së, si sulmi kundër fshatit Lisnajë më 25 maj 1999,²¹⁵⁸ ku u dëbuan me dhunë shqiptarët kosovarë.²¹⁵⁹

849. Krahas këtyre rasteve të raportuara të krimeve konkrete të anëtarëve të UJ-së, ekzistojnë disa dokumente që tregojnë se Komanda e Korpusit të Prishtinës ishte në dijeni të shpërnguljes në masë të popullsisë shqiptare kosovare në vitin 1999 dhe se kjo shpërngulje, të paktën pjesërisht, ishte pasojë e veprimeve të UJ-së dhe MPB-së.²¹⁶⁰ Në një raport luftimi të datës 3 prill 1999, Komanda e Brigadës së 549-të të Motorizuar i raportonte Komandës së Korpusit të Prishtinës për

²¹⁵⁶ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës për moszbatimin e Urdhrit të Ndërrimit të Varësisë, 24 maj 1999), f. 2, pranuar edhe me numrat 4D192 dhe P1723.

²¹⁵⁷ Radojko Stafanoviq, T. 21727–21729 (6 shkurt 2008).

²¹⁵⁸ Fadil Vishi, T. 3555–3557 (19 shtator 2006); P2284 (deklaratë e dëshmitarit, datë 18 tetor 1999), f. 3–4; P2285 (transkripti i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr IT-02-54-T), T. 4461.

²¹⁵⁹ Kërsmann Jelliq, T. 19015–19016 (26 nëntor 2007); 5D666 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 4 maj 1999); 4D309 (Raport luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 24 maj 1999), f. 2; 4D335 (Raport luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 26 maj 1999).

²¹⁶⁰ *Shih, p.sh.*, Vllatko Vukoviq, 5D1401 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 janar 2008), para. 44 (mbyllur me vulë); Nikë Peraj, T. 1574 (14 gusht 2006); P326 (hartë e operacionit në luginën e Caragojt); Mahmut Halimi, T. 4457 (9 tetor 2006); Lizane Malaj, T. 1384, 1391 (10 gusht 2006). Lizane Malaj dëshmoi se e kaloi kufirin në Vërbnicë më 28 prill 1999 dhe se pika kufitare quhet “Vrbnica” nga serbët dhe “Qafa e Morinës” nga shqiptarët. Sipas P615 (Atlas i Kosovës, i vitit 2000, f. 14), kufiri quhet “Vrbnica/Vërmicë” në anën serbe dhe “Morinë” në anën shqiptare.

sjelljen e personelit dhe rekrutëve të UJ-së ndaj kolonave të civilëve të cilët prisnin të kalonin kufirin. Në raport thuhej se nga data 24 mars deri më 2 prill, 290 mijë shqiptarë kosovarë kishin kaluar kufirin për në Shqipëri në pikën kufitare të Morinës (Vërbnicës) ndërsa 20 deri në 25 mijë të tjerë kishin kaluar kufirin në pikën kufitare të Qafës së Prushit. Në të thuhej se këtë e kishin bërë, të paktën pjesërisht, nga frika që kishin nga UJ-ja dhe MPB-ja. Por, në raport shënohej edhe se shqiptarët kosovarë nuk kishin frikë nga UJ-ja kur vepronte më vete. Në raport pohohej se sjellja e UJ-së ishte “në përgjithësi e mirë”, por theksohej se disa rekrutë të UJ-së kishin tentuar të merrnin zotërime personale nga refugjatët. Në raport specifikohet se të gjitha këto raste qenë trajtuar me “efikasitet”; ndaj autorëve ishin marrë masa disiplinore dhe ishin depozituar kallëzime penale ndaj gjashtë rekrutëve të tjerë që qenë arrestuar.²¹⁶¹

850. Dhoma citon edhe raportin e luftimit të dërguar nga Peshiqi më 31 mars 1999, ku Komanda e Korpusit të Prishtinës informohej se MPB-ja dhe njësitë territoriale ushtarake po “i kanalizojnë refugjatët” shqiptarë kosovarë për në Shqipëri dhe se nuk kishte asnjë incident të veçantë.²¹⁶² Goran Jevtoviç shpjegoi se lëvizja në masë e civilëve shqiptarë kosovarë në drejtim të Shqipërisë ishte problemi që kërkonte më shumë për vëmendje në atë kohë. Ai tha se një pjesë e zonës ku ndodheshin “refugjatët” ishte e rrethuar me mina dhe pengesa. Krahas kësaj, disa njësi ishin dislokuar që më parë në pozicione luftimi në këtë zonë. Sipas tij, rrjedhimisht ishte e nevojshme për sigurinë e këtyre personave, që të “kanalizoheshin apo të drejtoheshin në drejtime jo të rrezikshme për të mos lejuar që të vriteshin”.²¹⁶³ Ai shpjegoi më tej se UJ-ja nuk kishte “të drejtën ligjore t’i ndalonte [refugjatët] apo të mos i lejonte të largoheshin nga vendi, megjithëse migrimi nuk i pëlqente [UJ-së]”. Fakti që civilët po largoheshin nga Kosova e linte të zbuluar UJ-në ndaj bombardimeve të NATO-s.²¹⁶⁴

851. Dokumentet e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe të njëjësive vartëse të cilat janë diskutuar më lart dhe që u përkasin masave të marra lidhur me civilët, tregojnë se Llazareviç ishte në dijeni të shpërnguljes në masë të popullsisë civile,²¹⁶⁵ në lidhje me të cilën Dhoma ka

²¹⁶¹ 5D885 (Dokument i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 3 prill 1999), f. 1–2.

²¹⁶² P2930 (Raport Luftimi i Grupit të Komandës së Korpusit të Prishtinës për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 2.

²¹⁶³ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 21.

²¹⁶⁴ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë e dëshmitarit, datë 24 dhjetor 2007), para. 23.

²¹⁶⁵ *Shih* Vladimir Llazareviç, T. 18687–18688 (21 nëntor 2007); P2046 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 28 mars 1999); P1306 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 prill 1999); 5D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 19 prill 1999); 5D372 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1999); 5D897 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 prill 1999); 5D35 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak, 24 prill 1999); 5D389 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 2 maj 1999); 5D1072 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 20 prill 1999); 5D973 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999); 5D615 (Raport luftimi i Brigadës së 211-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 26 prill 1999); 5D1103 (Raport luftimi i Brigadës së 52-të të Artilerisë së Përzierë për Korpusin e Prishtinës, 4 maj 1999); 5D486 (Raport

konkluduar implikimin e UJ-së. Në një raport të datës 27 prill 1999, dërguar nga Zhivanoviçi, komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar, në të cilën ai përshkruan një kolonë civilësh shqiptarë kosovarë, bëhet e ditur se, sipas mendimit të tij, civilët po largoheshin sepse dëshironin “të tërhiqeshin nga sektori i operacioneve të forcave [të tij] në zonën e përgjithshme të objektit të Ramoçit”.²¹⁶⁶ Për më tepër, më 23 prill 1999 Llazareviçi bëri të ditur se ishte në dijeni të shpërnguljes së mëparshme me dhunë të shqiptarëve kosovarë nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës.²¹⁶⁷

852. Më 25 prill 1999, Dikoviçi e paralajmëroi Llazareviçin se Korpusi i Prishtinës po përdorte taktika të tepruara të cilat nuk ishin ushtarakisht të nevojshme në operacionet në Kosmaç dhe Çiçavicë dhe rrethinat. Ai i tha se po përdorej një numër i tepruar trupash, po të kiheshin parasysh “rezultatet e arritura” dhe se “operacionet shtriheshin në një sipërfaqe të madhe, por rezultatet e operacioneve që synonin shkatërrimin [e UÇK-së] ishin relativisht të kufizuara”. Ai u ankua për “mungesën e stërvitjes nga ana e forcave rezerviste të UJ-së në kryerjen e operacioneve” dhe përmendi spastrimin e vendeve të populluara, pyjeve, bllokadat dhe kontrollet. Ai u ankua se “operacionet e spastrimit në shkallë të gjerë” nuk ishin të efektshme dhe konsistonin “thjesht në një shëtitje nëpër zonë”. Ai shtoi se për shkak të mungesës së informatave të zbulimit për UÇK-në, kishte pasur përdorim jo të përshtatshëm të mbështetjes me zjarr.²¹⁶⁸

853. Më 27 dhe 28 mars 1999 në qytetin e Pejës u dëbuan nga shtëpitë e tyre shumë shqiptarë kosovarë. Forcat e UJ-së dhe të policisë bashkëpunuan për të mundur largimin dhe kontrolluar drejtimin e lëvizjes së banorëve shqiptarë kosovarë në Shqipëri dhe Malin e Zi. Zhvendosja e dhunshme dhe dëbimi i popullsisë shqiptare kosovare të këtij qyteti u krye në mënyrë të organizuar dhe Llazareviçi u informua për këtë fakt nga bashkësia ndërkombëtare.²¹⁶⁹ Llazareviçi e dinte se Brigada e 125-të e Motorizuar e kishte selinë në qendër të fshatit Raushiq, në komunën e Pejës.²¹⁷⁰ Për më tepër, numri i madh i shqiptarëve kosovarë që largoheshin nga ky qytet në kolona dihej nga të gjithë.²¹⁷¹

Luftimi i Brigadës së 354-të të Këmbëorisë për Korpusin e Prishtinës, 4 maj 1999); 5D499 (Raport luftimi i Brigadës së 354-të të Këmbëorisë për Korpusin e Prishtinës, 18 prill 1999).

²¹⁶⁶ P2024 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999), f. 2.

²¹⁶⁷ 5D374 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 23 prill 1999).

²¹⁶⁸ P2591 (Analizë pas operacionit e Brigadës së 37-të, 25 prill 1999), f. 2.

²¹⁶⁹ Ndrec Konaj, P2372 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 qershor 2001), f. 4, T. 4894, 4912–4913 (16 tetor 2006); P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999); Karol John Drewienkiewicz, T. 7815 (4 dhjetor 2006). *Shih edhe* P2802 (Ditar lufte i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Blinduar), f. 3 (ku shkruhet se UJ-ja ishte përfshirë në “pastrimin” e zonave të qytetit më 28 mars).

²¹⁷⁰ P2802 (Ditar lufte i Batalionit të Blinduar të Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 1–2.

²¹⁷¹ Radovan Paponjak, 6D1603 (deklaratë e dëshmitari, datë 14 mars 2008), para. 46.

854. Forcat e UJ-së dhe MPB-së u angazhuan në operacione që kishin të bënin me zhvendosjen e dhunshme dhe dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga Pirana në Prizren gjatë një operacioni të përbashkët më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date. Ky operacion u krye në përputhje me urdhrat e Komandës së Përbashkët dhe për të u raportua përmes hallkave të hierarkisë komanduese të UJ-së.²¹⁷² Operacioni i lartpërmendur ishte pjesë e një operacioni më të madh, në të cilin qenë përfshirë mbi një mijë ushtarë të UJ-së, 21 tanke, disa obusë dhe armë kundërajrore dhe për të cilin Llazareviqi përgatiti urdhrat.²¹⁷³ Gjithashtu, Llazareviqi e dinte se UJ-ja ndodhej në Zhegër, në komunën e Gjilanit, dhe se anëtarët e UJ-së kishin kryer krime atje në fund të muajit mars 1999.²¹⁷⁴

855. Drewienkiewicz-i dha një deklaratë për shtyp ku bënte të ditur se UJ-ja dhe MPB-ja ishin përgjegjëse për këto dëbime në fillim të muajit prill 1999. Në deklaratën për shtyp të Drewienkiewicz-it thuhej se në kufi po mbërrinin shumë shqiptarë kosovarë dhe citoreshin raporte për mizori të përhapura të kryera nga UJ-ja dhe MPB-ja, përfshirë edhe dëbimin.²¹⁷⁵ Sikurse është përshkruar në Pjesën VI.A, Korpusi i Prishtinës kishte një degë të shërbimit sekret, e cila ishte përgjegjëse për t'ia kaluar këtë informacion komandantit.²¹⁷⁶ Për më tepër, deklarata për shtyp përmendte në mënyrë konkrete plaçkitjen sistematike dhe largimin e dhunshëm të shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, ku ndodhej Llazareviqi gjatë konfliktit.²¹⁷⁷ Duke pasur parasysh përmbajtjen e njoftimit për shtyp të Drewienkiewicz-it dhe faktin se nuk shihej me sy të mirë nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë, Dhoma është e bindur se Llazareviqi ishte në dijeni të këtij raporti në fillim të muajit prill 1999. Dhoma ka analizuar dijeninë e Llazareviqit mbi veprimet e UJ-së dhe MPB-së në lidhje me shpërnguljet e dhunshme në Kosovë, që përshkruhet me hollësi në Pjesën VII. Llazareviqi u informua për plaçkitjet sistematike dhe eksodin e shqiptarëve kosovarë nga Prishtina, për të cilin Dhoma ka konkluduar se ishte një proces i organizuar, i kryer nga forcat e UJ-së dhe MPB-së ndaj mijëra shqiptarëve kosovarë.²¹⁷⁸ Ai ndodhej në këtë qytet ndërkohë që po kryheshin shpërnguljet e dhunshme dhe Dhoma është bindur se ai duhet të ketë qenë në dijeni të klimës së frikës të krijuar nga forcat e atjeshme të UJ-së dhe MPB-së.

²¹⁷² P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 2–3. P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999), f. 4–5.

²¹⁷³ P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 3.

²¹⁷⁴ 5D825 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbëorisë për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999), f. 1; 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999).

²¹⁷⁵ John Drewienkiewicz, T. 7815–7816 (4 dhjetor 2006); P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999).

²¹⁷⁶ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 tetor 2007), para. 9.

²¹⁷⁷ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999), f. 2.

²¹⁷⁸ P2542 (Deklaratë për Shtyp e Drewienkiewicz-it, prill 1999), f. 2.

856. Operacioni i luginës së Caragojt më 27 dhe 28 prill ishte një operacion i organizuar me synim parësor shpërnguljen e popullsisë civile shqiptare kosovare përgjatë luginës.²¹⁷⁹ Llazareviqi ishte në dijeni se UJ-ja bashkëveproi me MPB-në në këtë operacion dhe se disa njësi të Detashmentit Territorial të 73-të të MPB-së i qenë atashuar Brigadës së 125-të të Motorizuar dhe qenë dërguar në Korenicë, ku më 25 prill 1999 u kryen shumë krime.²¹⁸⁰ Zhivanoviqi, i cili u përfshi në dhënien e urdhrat për këtë operacion, konfirmoi se Llazareviqi ishte me të në Deçan ditën pas operacionit dhe se ai i raportoi Llazareviqit atë ditë për operacionin.²¹⁸¹ Për këtë operacion iu raportua edhe Shtabit të Komandës së Lartë.²¹⁸² K73-shi dëshmoi se dëbimi i shqiptarëve kosovarë gjatë këtij operacioni u bë në përputhje me urdhrat dhe se sugjerimi se ishte një operacion ushtarak i cili kishte objektiv UÇK-në nuk shpjegonte dëbimin e grave, fëmijëve dhe pleqve nga fshatrat e tyre.²¹⁸³ K90-a tha se nuk kishte asnjë qëllim operativ për urdhrat që kishte marrë njësia e tij për të dëbuar shqiptarët kosovarë nga fshatrat e tyre në luginën e Caragojt dhe përcaktoi se urdhra të tillë duhej të miratoheshin në një nivel më të lartë se ai i komandantit të brigadës, siç ishte Bozhdar Deliqi.²¹⁸⁴ Dhoma vëren se eprori i drejtpërdrejtë i Deliqit ishte Llazareviqi. Dhoma citon gjithashtu dëshminë e Sasha Antiqit për një operacion ushtarak që nuk kishte lidhje me sa më sipër se “do të ishte çmenduri të mendoje se edhe një shef sigurimi do t’i jepte urdhër një njësie pa miratimin dhe dijeninë e komandantit të korpusit”.²¹⁸⁵ Kjo tregon se Llazareviqi ishte në dijeni se ky operacion përfshinte shpërnguljen e dhunshme të popullsisë civile të luginës së Caragojt në fund të muajit prill 1999.

857. Llazareviqi ishte në dijeni edhe se forcat e UJ-së ishin të pranishme në një sërë fshatrash në Kosovë më datat për të cilat Dhoma ka arritur në përfundimin se është vërtetuar se këto forca të UJ-së po kryenin fushatën e shpërnguljes së dhunshme. Krimet, të cilat shpesh qenë në shkallë të gjerë dhe sistematike, përfshijnë granatimin e Turiçecit dhe dëbimin e civilëve nga Qirezi dhe Tushilla në fund të muajit mars dhe në prill 1999, të kryera gjatë operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së,²¹⁸⁶ sulmin kundër fshatit Lisnajë më 25 maj, i cili u krye gjatë një operacioni të organizuar, dhe për të cilin raportimi u bë përmes hierarkisë komanduese të UJ-së,²¹⁸⁷ dhe

²¹⁷⁹ *Shih* Nën pjesën VII.C.8.

²¹⁸⁰ P2026 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999), f. 2.

²¹⁸¹ P2026 (Raport Luftimi i Brigadës 125-të të Motorizuar, 29 prill 1999), f. 2 (ku thuhet se në operacionin në luginën e Caragojt u angazhuan kompani vullnetarësh). Dragan Zhivanoviqi, T. 20592–20593 (18 janar 2008).

²¹⁸² 6D1468 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 30 prill 1999), f. 1.

²¹⁸³ K73, T. 3385 (14 shtator 2006).

²¹⁸⁴ K90, P2652 (deklaratë e dëshmitarit, datë 31 janar 2007).

²¹⁸⁵ Sasha Antiq, T. 21163 (28 janar 2008).

²¹⁸⁶ P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999); P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 4; 6D1416 (Plan Veprimi i Korpusit të Prishtinës, 18 mars 1999), f. 1.

²¹⁸⁷ Kërsmen Jelliq, T. 19015–19016 (26 nëntor 2007); 5D666 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 4 maj 1999); 4D309 (Raport luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 24 maj

shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga Celina më 25 mars 1999 gjatë një operacioni të kryer në përputhje me urdhrat e Komandës së Përbashkët dhe për të cilin raportimi u bë përmes hierarkisë komanduese të UJ-së.²¹⁸⁸ Ky ishte një operacion i madh, në të cilin morën pjesë mbi 1.000 ushtarë të UJ-së, 21 tanke, disa obusë dhe armë kundërajrore.²¹⁸⁹

858. Dhoma u referohet provave se urdhrat për dëbimin e shqiptarëve kosovarë apo raportimet për këto operacione nuk jepeshin me shkrim, por me gojë.²¹⁹⁰ Me këtë përputhet fakti se një pasqyrë e disa raporteve të luftimit nga njësitë vartëse nuk përfshinin informacionin lidhur me krimet dhe me shpërnguljen e dhunshme në masë të shqiptarëve kosovarë, për të cilat Dhoma ka konkluduar se janë provuar. Për shembull, në raportin e datës 30 mars 1999 për Komandën e Korpusit të Prishtinës në lidhje me operacionet e kryera në komunën e Rahovecit dhe Suharekës, Deliqi e informonte Llazareviqin për madhësinë numerike të “terroristëve”, për rezistencën e hasur nga trupat e tij, për dëmet në njerëz të “terroristëve”, për njësitë e Korpusit të Prishtinës dhe të MPB-së që morën pjesë në operacione, për sulmet konkrete të kryera, për ushtarët e plagosur dhe për sulmet e NATO-s. Mirëpo, nuk ka raportim për asnjë krim.²¹⁹¹

859. Po kështu, raportet që Brigada e 125-të e Motorizuar i dërgoi Komandës së Korpusit të Prishtinës midis datave 27 dhe 29 prill 1999 në lidhje me operacionin që po kryhej në atë kohë në luginën e Caragojt nuk bënë fjalë për asnjë krim, edhe pse provat dëshmojnë për shpërnguljen e dhunshme në masë të shqiptarëve kosovarë nga një sërë njësish të UJ-së dhe MPB-së që bashkëvepronin në mënyrë të organizuar.²¹⁹² Më 29 prill, Zhivanoviqi, komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar, shpjegonte se “Operacioni *Reka...* përfundoi me sukses” dhe më tej përmendte sulmet e bëra nga UÇK-ja, humbjet e pësuar nga njësitë e Korpusit të Prishtinës, aksionet e ndryshme të kryera, sulmet e NATO-s dhe moralin e trupave.²¹⁹³

860. Dhoma mendon se këto prova tregojnë se Llazareviqi ishte në dijeni të një numri aktesh kriminale konkrete të kryera nga vartësit e tij në UJ, si edhe për aktet e dhunshme të rënda të kryera nga anëtarët e MPB-së kundër shqiptarëve kosovarë. Ai ishte në dijeni të shpërnguljes së dhunshme në masë të shqiptarëve kosovarë dhe se kjo shpërngulje, të paktën pjesërisht, ishte rezultat i

1999), f. 2; 4D335 (Raport luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë, 26 maj 1999).

²¹⁸⁸ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 2–3. P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999), f. 3, 5; P2019 (Ditar luftime i Batalionit të 2-të të Motorizuar) (nën vulë), f. 3.

²¹⁸⁹ P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999).

²¹⁹⁰ K90, T. 9302–9303 (29 janar 2007); K90, P2652 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 8 dhjetor 2002), para. 40, 41.

²¹⁹¹ P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999). *Shih edhe* Bozhidar Deliq, T. 19349–19350 (29 tetor 2007); P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999).

²¹⁹² P2024 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999); P2025 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 28 prill 1999).

²¹⁹³ P2026 (Raport Luftimi i Brigadës së 125-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 29 prill 1999), f. 2.

veprimeve të UJ-së. Fakti se shpërnguljet e dhunshme në disa prej vendngjarjeve të krimeve në Kosovë nuk përmendeshin shprehimisht në raportet e luftimit të UJ-së pas operacioneve në disa prej këtyre vendndodhjeve, nuk krijon asnjë dyshim lidhur me dijeninë e Llazareviqit për fushatën e shpërnguljeve të dhunshme.

861. Mbrojtja e Llazareviqit parashtron se, duke pasur parasysh taktikën e “terroristëve” shqiptarë ku popullsia civile përdorej si mburojë dhe duke pasur parasysh fillimin e bombardimeve intensive nga NATO-ja, lëvizjet e popullsisë civile nuk ishin domosdoshmërisht tregues Llazareviqin se ishte hartuar një plan për dëbimin e civilëve shqiptarë nga Kosova.²¹⁹⁴ Mirëpo, Dhoma citon provat e mësipërme që lidhen me këto shkaqe të tjera të sugjeruara për lëvizjen e popullsisë²¹⁹⁵ dhe arrin në përfundimin se, megjithëse këto shkaqe kanë ekzistuar në disa situata, shkaku kryesor i zhvendosjes së popullsisë shqiptare kosovare qenë operacionet e përhapura dhe sistematike të UJ-së dhe MPB-së që vepronin së bashku.²¹⁹⁶ Dhoma gjykon se provat e mësipërme, përfshirë edhe përpjekjen e Llazareviqit për të parandaluar keqtrajtimin e shqiptarëve kosovarë nga efektivat e UJ-së, tregojnë se ai ishte në dijeni të shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga efektivat e UJ-së dhe se ai ishte edhe në dijeni të faktit se pati raste që kjo ndodhi gjatë operacioneve të UJ-së kundër UÇK-së dhe në vende ku NATO-ja bombardonte objektiva të UJ-së dhe MPB-së.

e. Reagimet ndaj krimeve të kryera nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës

862. Prokuroria argumenton se krimet e kryera nga anëtarët e UJ-së nuk u ndëshkuan²¹⁹⁷ dhe se proceset penale të nisura kundër autorëve të krimeve nga radhët e UJ-së qenë të pamjaftueshme në përmbushjen e detyrimit prej Llazareviqit për procedimin penal të vartësve të tij.²¹⁹⁸ Masat e përshtatshme duhej të kishin përfshirë masa të menjëhershme kundër vartësve përgjegjës për krimet dhe hetimin e efektshëm të akuzave për krime që kishin të bënin me vartësit e tij.²¹⁹⁹ Sipas Prokurorisë, Llazareviqi “qëllimisht nuk veproi” për të ndëshkuar anëtarët e njësive të Korpusit të Prishtinës të cilët kishin kryer krime kundër popullsisë civile shqiptare kosovare.²²⁰⁰

863. Mbrojtja e Llazareviqit parashtron se Prokuroria nuk ka vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Llazareviqi nuk arriti të marrë masa të arsyeshme për parandalimin e kryerjes së

²¹⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 860.

²¹⁹⁵ P680 (OSCE/KVM Fusion Working Papers/ Dokumentet Operative të Bashkimit të OSBE/KVM-së); John Drewienkiewicz, T. 7933 (5 dhjetor 2006).

²¹⁹⁶ *Shih* Pjesën VII.N dhe VIII.B.

²¹⁹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 989.

²¹⁹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 990.

²¹⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 991.

²²⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 977.

veprave penale dhe për ndëshkimin e autorëve të këtyre veprave. Mbrojtja argumenton se, në bazë të Kushtetutës së RFJ-së, oficerët i ushtrisë i përmbushnin detyrimet e tyre me depozitim të kallëzimeve penale kundër çdo anëtar të UJ-së që ishte kapur duke kryer një krim. Ata nuk mbanin përgjegjësi për asnjë hap të mëtejshëm të bërë më pas në çështjet në fjalë.²²⁰¹ Mbrojtja e Llazareviqit parashtron se, që Komanda e Korpusit të Prishtinës të mund të merrte masa, ajo duhej të merrte informacion nga komandantët e brigadave, batalioneve, skuadrave dhe trupave. Rrjedhimisht, “marrja e masave varej drejtpërsëdrejti nga shkalla dhe sasia e informacionit që vinte nga njësitë vartëse”.²²⁰²

i. Masat e marra lidhur me krimet e kryera nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës

864. Dhoma vëren përfundimin e saj në Ndarjen VI.A.1.e, dhe në veçanti dëshminë e Llakiq Gjoroviqit, se sistemi i drejtësisë ushtarake funksionoi gjatë gjithë fushatës së NATO-s, mirëpo në një mënyrë të tillë që vetëm një përqindje e vogël e krimeve të dhunshme kundër shqiptarëve kosovarë u proceduan penalisht, ndërsa krimet kundër UJ-së apo viktimave serbe u proceduan me më shumë efikasitet. Çdo anëtar i UJ-së kishte detyrimin për t’i raportuar eprorit dhe organit përkatës së sigurimit në rast se kryhej krim.²²⁰³

865. Dy raporte të Komandës së Korpusit të Prishtinës dëshmojnë se Korpusi i Prishtinës i raportoi për disa krime Komandës së Armatës së Tretë në fillim të muajit prill 1999. Më 3 prill, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi një raport luftimi Komandës së Armatës së Tretë, në të cilin Llazareviqi vërente se, një ditë më parë, qenë depozituar 32 kallëzime penale kundër autorëve të krimeve, ku përfshiheshin tetë vrasje, një keqtrajtim, tri orvatje për vrasje, dy marrje automjeti dhe gjashtë vjedhje.²²⁰⁴ Në një raport tjetër luftimi paraqitur Komandës së Armatës së Tretë më 4 prill, shënohej se një ditë më parë qenë depozituar katër kallëzime penale kundër tre rekrutëve dhe një ushtari, megjithëse në të nuk jepej asnjë hollësi për veprat penale.²²⁰⁵

866. Gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, Llazareviqi lëshoi urdhra me shkrim ku bëhej thirrje për ndjekjen ligjore apo disiplinimin e anëtarëve të UJ-së që kapeshin duke kryer krime. Pas njoftimit të vendimit të RFJ-së për shpalljen e gjendjes së luftës më 25 mars 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës u dërgoi njësitë vartëse udhëzime në lidhje me procedurat për procese disiplinore që

²²⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 669.

²²⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 929.

²²⁰³ Radojko Stefanoviç, T. 21728 (6 shkurt 2008); *Shih edhe* Millosh Mandiq, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviç, T. 8666 (18 janar 2007). *shih* Radomir Gojoviç, T. 16706 (2 tetor 2007).

²²⁰⁴ 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2.

²²⁰⁵ P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999), f. 2.

duheshin zbatuar gjatë kohës së luftës si edhe për proceset penale që duheshin ndjekur.²²⁰⁶ Më 8 prill 1999, me objektivin e deklaruar për parandalimin, ndër të tjera, të përdorimit të paligjshëm të armëve dhe të gjitha formave të tjera të krimit nga anëtarët e UJ-së, Komanda e Korpusit të Prishtinës u dha urdhër të gjithë anëtarëve të njësisë të Korpusit të Prishtinës të nxirrnin menjëherë përpara organeve të drejtësisë autorët e veprave penale, pas depozitimit të kallëzimeve penale. Në urdhër thuhej se masat e mësipërme duhej të zbatoheshin për rekrutët ushtarakë vullnetarë. Për këtë urdhër duheshin informuar të gjithë anëtarët e njësisë të Korpusit të Prishtinës.²²⁰⁷

867. Krahas këtyre, pas marrjes së informacionit lidhur me rastet e veçanta të sjelljes gjatë operacioneve të luftimit të cilat nuk përputheshin tërësisht me udhëzimet për sjelljen gjatë luftimit dhe me të drejtën humanitare ndërkombëtare, më 18 prill 1999, Llazareviqi nxori një urdhër për komandantët në vartësi të tij, në të cilin kërkonte respektimin e plotë të dispozitave të tilla nga të gjitha njësitë vartëse gjatë përgatitjes dhe realizimit të detyrave në Kosovë. Llazareviqi e dënoi faktin se disa komandantë dhe njësi të caktuara “nuk po tregonin vëmendjen e nevojshme ndaj luftës kundër rasteve të veçanta të plaçkitjeve dhe krimeve”. Komandave dhe organeve të specializuara iu ngarkua detyra për të marrë masa të efektshme për parandalimin e çdo lloj aktiviteti kriminal. Në urdhër thuhej se Komandës së Korpusit të Prishtinës i duheshin paraqitur raporte lidhur me masat e marra në kuadër të raporteve të rregullta të luftimit.²²⁰⁸ Më 23 prill, Llazareviqi u dërgoi një urdhër komandantëve të të gjitha njësisë ku autorizonte përdorimin e të gjitha mjeteve për të parandaluar “çdo tentativë apo kryerje krimi në zonat e përgjegjësisë” dhe për marrjen e “masave më të rrepta kundër çdo autori krimi”.²²⁰⁹

868. Më 15 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi Komandës së Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike një dokument të titulluar “Informacion për situatën dhe lëvizjen e kriminelëve mes personelit ushtarak profesional”. Në këtë raport thuhej se, gjatë fushatës ajrore të NATO-s dhe deri më 15 maj 1999, shumica e ndjekjeve penale qenë për krime kundër UJ-së, si, për shembull, dezertim, dhe se, përveç disa ndjekjeve penale për vjedhje në rrethana rënduese, të cilat qenë dënuar me burgim me më pak se pesë vjet, vetëm një oficer i Korpusit të Prishtinës ishte akuzuar për një krim të dhunshëm më të rëndë.²²¹⁰ Ky oficer u ndoq penalisht sepse akuzohej se u kishte dhënë urdhër dy vartësve për të vrarë dy shqiptarë kosovarë të moshuar që nuk kishin

²²⁰⁶ 5D332 (Udhëzime nga Korpusi i Prishtinës, 25 mars 1999).

²²⁰⁷ 5D176 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 8 prill 1999).

²²⁰⁸ 5D198 (Paralajmërim i Komandës së Korpusit të Prishtinës, 18 prill 1999).

²²⁰⁹ 5D374 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 23 prill 1999). *Shih edhe* P1268 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 30 prill 1999), para. 2–3.

²²¹⁰ P1182 (Informacion dërguar Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999), f. 4. *Shih edhe* P1210 (Raport i Brigadës së Raketave Artilerike lidhur me situatën dhe prirjet e kriminalitetit tek personeli ushtarak profesionist, 1999).

pranuar të largoheshin nga fshati i tyre. Oficeri u dënua me nëntë vjet burg, ndërsa dy vartësit e tij me nga shatë vjet.²²¹¹

869. Raportet që njësitë në vartësi të Korpusit të Prishtinës i dërgonin Komandës së Korpusit të Prishtinës bënin të ditur se qenë depozituar disa kallëzime penale në organet kompetente në nivel të tyre.²²¹² Në një urdhër të datës 7 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës i informonte komandantët e njërive vartëse se, që nga shpallja e gjendjes së luftës deri më 5 maj 1999, kishin nisur ndjekur penale në gjykatat ushtarake të kohës së luftës në territorin e Armatës së Tretë kundër disa oficerëve të UJ-së si edhe kundër disa civilëve, “në të gjitha rastet për krime të rënda”. Mirëpo, vërehet se, përkundër këtij fakti, komandat dhe institucionet nuk kishin bërë hetime për këta persona për t’i nxjerrë ata përpara një gjykate disiplinore ushtarake. Për rrjedhojë, Komanda e Korpusit të Prishtinës i udhëzonte njësitë në vartësi (a) “të kryenin menjëherë një hetim për të gjithë këta persona – efektivë profesionistë të UJ-së të cilët kishin kryer krime kundër UJ-së apo krime kundër pronës, pavarësisht nga fakti se kundër tyre qenë çelur dosje penale”, (b) “të nisnin një hetim disiplinor në të gjitha rastet e tjera [ku] qenë kryer shkelje të rënda disiplinore nëpër komanda dhe njësi”, dhe (c) “të paraqisnin menjëherë propozime për nxjerrjen e autorëve përpara një gjykate disiplinore ushtarake, së bashku me provat dhe dosjet e tjera, në Komandën e Korpusit të Prishtinës për shqyrtim të mëtejshëm brenda juridiksionit të saj”.²²¹³ Ky urdhër konfirmon se Llazareviqi mund të niste hetime të tjera shtesë dhe procese të tjera disiplinore brenda UJ-së, edhe atëherë kur qenë çelur hetime penale.

870. Dokumente nga Komanda e Korpusit të Prishtinës dhe nga njësitë në vartësi të saj tregojnë se në nivele të ndryshme u morën disa masa kundër anëtarëve të njërive të Korpusit të Prishtinës për të cilët ishte provuar se kishin kryer vrasje, përdhunime dhe plaçkitje. Edhe pse më lart është arritur në përfundimin se ato pak ndjekje penale kundër anëtarëve të UJ-së në Kosovë qenë të pamjaftueshme po të kihet parasysh numri i veprave penale të kryera atje, Dhoma gjykon se kjo provë dëshmon se Llazareviqi mori disa masa ndëshkuese kundër vartësve përgjegjës për vrasje dhe përdhunime, krahas krimeve kundër pronës. Mirëpo, Dhoma vëren se këto prova nuk dëshmojnë se u kryen ndjekje penale apo u dhanë dënime lidhur me dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve kosovarë nga anëtarët e UJ-së. Dhoma është e mendimit se kryerja në masë e shpërnguljes së dhunshme,

²²¹¹ Radomir Gojoviq, T. 16694–16695 (2 tetor 2007), T. 16756 (3 tetor 2007); P1011 (Ivan Markoviq, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 166.

²²¹² *Shih, p.sh.*, 5D1148 (Raport i postës ushtarake nr 1936, 18 prill 1999); 5D889 (Kallëzim penal i depozituar nga Prokurori Ushtarak, 17 prill 1999); 5D1057 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999), f. 2; 5D509 (Raport Luftimi i Brigadës së 354-të të Këmbëorisë për Korpusin e Prishtinës, 1 maj 1999); 5D1351 (Informacion për krimet dhe incidentet, dërguar nga Brigada e 549-të e Motorizuar, 27 maj 1999), f. 2.

²²¹³ 4D237 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për hetimin e krimeve, 7 maj 1999), f. 1.

sikurse është përshkruar me hollësi në Kapitullin VII, dhe mungesa e ndjekjeve penale për akte të tilla, mbështesin pretendimin e Prokurorisë se Llazareviqi qëllimisht nuk mundësoi ndjekjen penale të vartësve të tij të cilët qenë përgjegjës për shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë.

ii. Llazareviqi dhe gjykata ushtarake e Komandës së Korpusit të Prishtinës

871. Radomir Mlladenoviqi dëshmoi se komandanti i Korpusit, Llazareviqi, u kujdes që gjatë luftës të siguroheshin të gjitha burimet e nevojshme për funksionimin normal të gjyqësorit. Sipas tij, gjyqësori do të kishte funksionuar me më pak efikasitet nëse Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk do të kishte bërë përpjekje për sigurimin e të gjitha burimeve të nevojshme.²²¹⁴ Ai ofroi si shembull rastin kur Llazareviqi i kërkoi atij, si kryetar i gjykatës, të mundësonte që gjatë pastrimit të terrenit të ishte i pranishëm një gjykatës hetues. Mlladenoviqi e gjykonte këtë kërkesë si shembull të kujdesit të tepruar nga ana e Llazareviqit, duke qenë se Ligji për Procedurën Penale nuk kërkonte praninë e një gjykatësi hetues gjatë veprimeve të tilla dhe sepse gjykatësit hetues mund të lëndoheshin rëndë gjatë këtyre veprimeve, si nga snajperët, po ashtu edhe nga bombardimet e NATO-s. Mirëpo, Mlladenoviqi tha se kërkesa e Llazareviqit ishte “e dobishme sepse prania e një gjykatësi hetues në raste të tilla mbartte një vlerë provuese më vonë, gjatë proceseve penale, pas zbulimit të një autori”. Gjykatësi hetues siguronte që çdo gjë të dokumentohej si duhej gjatë këtyre veprimtarive.²²¹⁵

iii. Llazareviqi dhe ekzaminimet mjeko-ligjore në Kosovë

872. Sikurse u shpjegua në Pjesën VII.P, më 26 prill 1999, Llazareviqi i dërgoi një kërkesë Armatës së Tretë dhe Kryekomandantit në të cilën u kërkonte një mjek ligjor ushtarak, duke qenë se kishte të dhëna se UJ mund të ishte përgjegjëse për vdekjen e personave në varret në zonën e përgjegjësisë së Korpusit të Prishtinës.²²¹⁶ Të nesërmen, Komanda e Armatës së Tretë u përgjigj me telegram, ku informonte se major Millosavleviqi, mjek ligjor i AMU-së, ishte dërguar të merrte pjesë në zhvarrosjen dhe ekzaminimin e kufomave në Kosovë.²²¹⁷ Prokuroria i bëri pyetje Llazareviqit për këtë telegram dhe konkretisht se çfarë e kishte shtyrë ta dërgonte. Ai u përgjigj se ky telegram ishte nisma e dytë e tij e këtij lloji dhe se e kishte bërë telegramin për ta përgatitur UJ-të të kryente hetimet në vend edhe gjatë luftës, për të parandaluar kështu fshehje të fakteve për

²²¹⁴ Radomir Mlladenoviç, T. 21269–21270 (29 janar 2008).

²²¹⁵ Radomir Mlladenoviç, T. 21270–21271 (29 janar 2008). Mlladenoviçi shpjegoi se personat e angazhuar në operacionet e spastrimit mbanin të gjithë uniforma dhe, për rrjedhojë, qenë objektiva për t'u sulmuar.

²²¹⁶ 5D379 (Kërkesë e Vladimir Llazareviqit për Komandën e Korpusit të Prishtinës, 26 prill 1999).

²²¹⁷ 5D383 (Përgjigje e Armatës së Tretë për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999).

krime.²²¹⁸ Ai sqaroi më tej se përmendja nga ana e tij e të dhënave për implikimin e UJ-së në krime mbështetej në disa burime, përfshirë edhe banorët vendas, persona të pidentifikuar dhe MPB-në, mirëpo tha se shpesh këto të dhëna qenë të gabuara duke qenë se banorët vendas nuk qenë në gjendje të bënin dallimin midis uniformave dhe pajisjeve të përdorura nga UJ-ja dhe MPB-ja. Më pas, Llazareviqi përmendi dy pika në komunën e Lipjanit, nga të cilat specialistët e AMU-së zhvarrosën 36 kufoma. Ai tha edhe se ishte në dijeni të dy kërkesave për pjesëmarrjen e këtyre specialistëve të AMU-së dhe tha se ata kishin marrë pjesë në gjashtë pika gjithsej në Kosovë.²²¹⁹ Aktekspertiza mjeko-ligjore për këqyrjen e kufomave në vendin e ngjarjes në fshatin Hallaç i Vogël, e cila mban datën 4 maj 1999, konfirmon se, më 2 maj 1999, një ekip mjeko-ligjor i kryesuar nga Millosavleviqi, bëri zhvarrosjen e 20 kufomave të gjetura në Hallaç të Vogël.²²²⁰

iv. Masat e marra lidhur me masakrën në Hallaç të Vogël

873. Prokuroria argumenton se, megjithëse Llazareviqi ishte në dijeni të ekzekutimit të 20 civilëve në fshatin Hallaç të Vogël më 19 prill 1999 dhe të implikimit të mundshëm të Brigadës së 252-të të Blinduar në këto vrasje, Llazareviqi e vijoi angazhimin e kësaj brigadë në operacione luftimi në prill dhe maj 1999.²²²¹

874. Në prill 1999, organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës morën një raport nga MPB-ja, në të cilin përfshiheshin “hollësi të një krimi të kryer në Hallaç të Vogël”: ishin ekzekutuar përafërsisht 20 civilë dhe “mendohej se fajin e kishin anëtarë të Brigadës së 252-të të Blinduar”.²²²² Llazareviqi dëshmoi se ishte në dijeni të këtyre akuzave kur i dërgoi një kërkesë Armatës së Tretë me të cilën kërkonte një mjek ligjor ushtarak më 26 prill 1999. Ai shpjegoi se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte dëgjuar mbi krimet për të cilat akuzoheshin anëtarë të njësisive të Korpusit të Prishtinës në komunën Lipjan nga disa burime, përfshirë edhe banorët vendas dhe anëtarët e MPB-së.²²²³

875. Radomir Mlladenoviqi, i cili ishte Kryetari i Gjykatës Ushtarake në Komandën e Korpusit të Prishtinës gjatë luftës, shpjegoi se Gjykata Ushtarake e Korpusit të Prishtinës fillimisht kishte nisur procedime penale kundër autorëve të panjohur, dhe se një gjykatës hetues kishte kryer një hetim për të parë nëse ishte e mundshme të zbulohej identiteti i autorëve të vrasjes. Më pas,

²²¹⁸ Vladimir Llazareviq, T. 18127–18128 (12 nëntor 2007). Llazareviqi dëshmoi se kishte kërkuar një herë më parë ekspertë mjekoligjorë dhe se një person i tillë kishte ardhur në Kosovë më 20 prill 1999.

²²¹⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18645–18647 (20 nëntor 2007).

²²²⁰ 5D1313 (Aktekspertizë e Institutit të Mjekësisë Ligjore të AMU-së për vendin e ngjarjes në Hallaç të Vogël, 4 maj 1999); 5D1315 (Procesverbal i analizës mjeko-ligjore, 10 maj 1999), f. 2.

²²²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 988.

²²²² Aleksandar Vasileviq, P2594 (deklaratë e dëshmitarit, datë 26 tetor 2006), para. 57 (nën vulë).

²²²³ Vladimir Llazareviq, 18645–18648 (20 nëntor 2007).

gjykatësi hetues i paraqiti prokurorit ushtarak të Korpusit të Prishtinës një raport për vrasjet, në të cilin i kërkonte marrjen e masave të mëtejshme. Prokurori ushtarak shkoi në zonë për të kryer një hetim në vend dhe i kërkoi gjykatës nisjen e një hetimi për të hedhur dritë mbi rrethanat në të cilat ishin vrarë këta civilë. Në vend u dërgua një ekip specialistësh nga AMU-ja.²²²⁴ Aktekspertiza mjeko-ligjore për këqyrjen e kufomave në vendin e ngjarjes, e cila mban datën 4 maj 1999, konfirmon se, më 2 maj 1999, një ekip mjeko-ligjor i kryesuar nga Millosavleviqi, bëri zhvarrosjen e 20 kufomave të gjetura në Hallaç të Vogël.²²²⁵ Sipas Mlladenoviqit, gjykatësit hetues të Gjykatës Ushtarake në Nish, së bashku me prokurorin ushtarak, ata morën në intervistë një numër rezervistësh të cilët kishin qenë në zonë. Në fund, “dosja iu kalua një gjykate civile sepse, pasi prokurori ushtarak kishte bërë gjithçka që duhej të bënte, dosja iu përcoll një prokurori dhe, pastaj, mbështetur në gjithçka që ishte mbledhur, ai arriti në përfundimin se në këtë ngjarje nuk ishte implikuar asnjë efektiv i UJ-së”.²²²⁶

876. Raporti që Dega e Sigurimit e Komandës së Armatës së Tretë i dërgoi më 14 korrik 1999 Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm konfirmon se Gjykata Ushtarake e Komandës së Korpusit të Prishtinës kreu një hetim.²²²⁷ Komentet e shkruara nga Branko Gajiqi për këtë raport bëjnë të ditur se gjykatësi hetues kishte bërë një punë të dobët sa i takonte marrjes në intervistë të dëshmitarëve dhe se ai nuk i kishte trajtuar hollësitë. Një raport i datës 20 gusht 2001 bën të ditur se procesi penal lidhur me vrasjen e civilëve shqiptarë kosovarë në fshatin Hallaç i Vogël nisi më 21 prill 1999.²²²⁸

877. Branko Gajiqi e trajtoi personalisht incidentin pas udhëzimeve të marra nga Millosheviqi në mbledhjen e datës 17 maj 1999. Ai dëshmoi se çështja u pushua sepse u konstatua se kundër anëtarëve të UJ-së të përfshirë në këtë ngjarje kishin hapur zjarr disa persona të paidentifikuar, çka konfirmon se vrasësit ishin anëtarë të UJ-së, por tha se viktimat ishin anëtarë të UÇK-së dhe, rrjedhimisht kjo vrasje nuk ishte krim.²²²⁹

878. Provat tregojnë se organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës ishin në dijeni të akuzave të ngritura nga MPB-ja se më 19 prill 1999, në Hallaç të Vogël ishin ekzekutuar 20 civilë dhe të implikimit të mundshëm të Brigadës së 252-të të Blinduar në këtë ngjarje. Llazareviqi u informua për procesin e nisur në fund të muajit prill 1999 nga gjykata ushtarake e kohës së luftës e Korpusit

²²²⁴ Radomir Mlladenoviq, T. 21254 (28 janar 2008), T. 21260–21261 (29 janar 2008).

²²²⁵ 5D1313 (Aktekspertizë e Institutit të Mjekësisë Ligjore të AMU-së për vendin e ngjarjes në Hallaç të Vogël, 4 maj 1999); 5D1315 (Procesverbal i analizës mjeko-ligjore, 10 maj 1999).

²²²⁶ Radomir Mlladenoviq, T. 21260–21261 (29 janar 2008).

²²²⁷ 3D1061 (Raport Shtesë i Armatës së Tretë, 14 korrik 1999), f. 1.

²²²⁸ P954 (Raport mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), f. 64–65.

²²²⁹ Branko Gajiq, T. 15304–15305 (10 shtator 2007).

të Prishtinës për identifikimin e autorëve të incidentit në Hallaç të Vogël. Mirëpo, duke pasur parasysh versionet e ndryshme lidhur me arsyen e mosndjekjes penale të ndonjë anëtari të UJ-së për këtë krim, Dhoma nuk arrin në asnjë përfundim për sjelljen e Llazareviqit lidhur me këtë incident, me përjashtim të faktit se kundër autorëve nuk u mor asnjë masë ndëshkuese.

v. Masat e marra lidhur me masakrën e Izbicës

879. Prokuroria argumenton se Llazareviqi nuk mori masa të mjaftueshme për hetimin e masakrës së Izbicës, që ndodhi më 28 mars 1999, pasi mësoi për të në mars ose prill 1999. Ajo thekson se Dikoviqi, njësitë e të cilit morën pjesë në një operacion të përbashkët UJ-MPB në Izbicë gjatë kohës së masakrës, nuk bëri asnjë hetim të akuzave mbi vrasjet në Izbicë, duke qenë se ai nuk u autorizua për një gjë të tillë.²²³⁰

880. Llazareviqi i përshkruan si më poshtë masat e marra nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në lidhje me masakrën e Izbicës:

Izbica u përmend për herë të parë si problem ... ditët e para të muajit prill dhe u përmend për herë të parë ... nga mjetet e huaja të komunikimit. ... Pamjet e fotografuara me satelit tregonin se kishte një varr të përbashkët në Izbicë... Gjatë ditëve në fund të muajit mars, fillim të muajit prill, ... i dhamë urdhër Brigadës së 125-të të Motorizuar, e cila ishte njësi që ndodhej më pranë zonës, që të gjente fshatin Izbicë dhe, më pas të bënte një hetim në vend dhe të shikonte se çfarë kishte ndodhur, së bashku me autoritetet hetimore civile dhe të MPB-së. Kjo njësi i realizoi detyrat dhe e gjeti fshatin Izbicë diku në zonën e Drenicës dhe raportoi se nuk kishte asnjë informacion që të çonte në përfundimin se në këtë fshat ishte zbuluar diçka e ngjashme me një varr të përbashkët. Komanda e Korpusit i raportoi Komandës së Armatës se ... nuk kishte asnjë varr të përbashkët. Mirëpo, pas disa ditësh, [Komandës së Korpusit të Prishtinës] iu ngarkua përsëri detyra, por kësaj here me informacion më konkret sa i takon vendndodhjes së saktë dhe neve na u ngarkua detyra që të përpiqeshim ... ta gjenim këtë vendndodhje së bashku me MPB-në. Duke qenë se kishte pasur operacione luftimi dhe përlëshje intensive me terroristët në zonën e gjerë të Drenicës dhe se NATO-ja kishte bërë një numër të madh sulmesh në këtë zonë asokohe ... njësitë që ndodheshin më pranë fshatit të Izbicës iu ngarkua detyra e sigurimit të zonës së fshatit. Këtyre njësitë iu dha detyra e bllokimit të kësaj zone, si edhe detyra për t'u mundësuar autoriteteve hetimore civile dhe MPB-së të bënin një hetim në vend. Sipas gjykatësit hetues, kufomat u zhvarrosën me urdhër të gjykatësit hetues civil, por ... pati një incident dhe një sulm terrorist kundër këtyre organeve hetimore dhe hetimi [u shty] ... Hetimi në këtë vend u krye nga organet e MPB-së dhe organet hetimore civile. Njësitë e Korpusit nuk morën pjesë në procedurën hetimore.²²³¹

881. Gvozden Gagiqi dëshmoi se fotografitë satelitore të shfaqura në televizion nga BBC-ja tregonin se në fshatin e Izbicës ishte një varr i përbashkët diku nga fundi i muajit maj 1999. Dragan Iliqi, eprori i tij, i dha urdhër të ndriçonte rrethanat e masakrës.²²³² Nebojsa Bogunoviqi, zëvendës-shef i SPB-së së Mitrovicës, tha se më 27 maj 1999 u dërgua në vendngjarje një ekip i

²²³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 986.

²²³¹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 486–487.

²²³² Gvozden Gagiq, T. 24447–24450, 24483–24484 (18 mars 2008).

përbërë nga anëtarë të SPB-së që drejtonte ai.²²³³ Kur ekipi arriti, ata takuan ushtarë të UJ-së të cilët u dhanë informacion për vendndodhjen e një numri varresh të reja. Ekipi nuk pati mundësi të vijonte punën për shkak të disa të shtënave të gjuajtura në afërsi të tyre.²²³⁴ Një dokument i datës 27 maj 1999, i dërguar nga SPB-ja e Mitrovicës, konfirmon se më 27 maj 1999 një ekip shkoi në Izbicë për të gjetur varrin e përbashkët dhe se ky ekip u largua me shpejtësi nga fshati duke qenë se pranë tyre pati të shtëna me armë zjarri.²²³⁵ Sipas Bogunoviqit, “lidhur me këtë u informuan prokurori publik dhe gjykatësi hetues, të cilët nisën procedurën dhe urdhëruan zhvarrosjen e kufomave”. Ai shpjegoi se punonjës të SPB-së së Mitrovicës kryen hetimin kriminalistik, me urdhër të gjykatësit hetues të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.²²³⁶ Aktekspertiza e MPB-së për këqyrjen e vendit në Izbicë, e datës 2 qershor 1999, tregon se atë ditë disa kriminalistë të SPB-së së Mitrovicës kryen “veprime kriminalistike”.²²³⁷

882. Gordana Tomasheviq, specialiste e mjekësisë ligjore e punësuar nga Akademia Mjekësore Ushtarake në Beograd, konfirmoi se në hetimin në vendngjarje morën pjesë autoritetet civile. Ekipi i Tomasheviqit mori urdhër zyrtar nga një gjykatë civile, nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, më datë 31 maj 1999.²²³⁸ Ky urdhër parashikonte zhvarrosjen e kufomave të zbuluara në Izbicë për ekzaminimin mjeko-ligjor të tyre, për të përcaktuar kohën dhe shkakun e vdekjes.²²³⁹ Ajo nuk dinte pse iu ngarkua detyra nga një gjykatë civile, por Gagiq dëshmoi se një gjykatës hetues kishte kompetencë për të zgjedhur institucionin që do të kryente ekzaminimin mjeko-ligjor.²²⁴⁰ Tomasheviq nuk ishte e pranishme në zhvarrosjen e kufomave, kështu që ajo vetëm sa dëgjoi se kufomat ishin zhvarrosur nga varre individuale në Izbicë.²²⁴¹ Ajo dëshmoi se, edhe pse shumica e kufomave qenë veshur me tesha civile, disa mbanin uniforma të zeza të UÇK-së.²²⁴²

883. Dikoviq dëshmoi se arsyeja përse njësia e tij nuk bëri hetime për vrasjet e pretenduara në Izbicë nuk ishte se ia kishte ndaluar Komanda e Korpusit të Prishtinës, por se brigada e tij, në

²²³³ Lubisha Dikoviq, T. 19985–19988 (11 dhjetor 2007).

²²³⁴ Nebojsa Bogunoviq, T. 25128–25130 (10 prill 2008); Nebojsa Bogunoviq 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 prill 2008), para. 83.

²²³⁵ 6D613 (dokument i SPB-së së Mitrovicës lidhur me Izbicën, 27 maj 1999), f. 1, pranuar edhe me numër 6D115. Ky dokument bënte të ditur se ekipi hasi në dhjetë anëtarë të UJ-së të cilët nuk dinin gjë për varret e përbashkëta por i treguan ekipit për ekzistencën e një varreze të re diku poshtë fshatit.

²²³⁶ Nebojsa Bogunoviq, T. 25128–25130 (10 prill 2008); Nebojsa Bogunoviq 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 2 prill 2008).

²²³⁷ 6D116 (Raport i MPB-së për këqyrjen e vendngjarjes në Izbicë, 2 qershor 1999), f. 1.

²²³⁸ P2496 (urdhër i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës lidhur me varret në Izbicë).

²²³⁹ Gordana Tomasheviq, T. 7028–7029 (21 nëntor 2006); P2496 (urdhër i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës lidhur me varret në Izbicë).

²²⁴⁰ Gvozden Gagiq, T. 24483–24484 (18 mars 2008); Gordana Tomasheviq, P2490 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 mars 2003), f. 8–9; P2507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2.

²²⁴¹ Gordana Tomasheviq, P2490 (deklaratë e dëshmitarit, datë 5 mars 2003), f. 8–9; P2507 (deklaratë e dëshmitarit, datë 25 korrik 2006), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 2.

²²⁴² Gordana Tomasheviq, T. 7032 (21 nëntor 2006).

përgjithësi, nuk e kishte kompetencën për t'u përfshirë në veprime hetimore.²²⁴³ Dhoma vëren se, megjithëse Llazareviqi tha se ai mësoi për herë të parë për raportet dhe fotografitë satelitore të varreve kolektive në Izbicë në fillim të muajit prill 1999, dhe megjithëse dinte se Brigada e 37-të e Motorizuar, e cila ishte në vartësi të Korpusit të Prishtinës asokohe,²²⁴⁴ kishte raportuar për operacione kundër UÇK-së në zonën e fshatit Vojnikë (ky fshat ndodhet jo më larg se dy kilometra larg Izbicës)²²⁴⁵ duke filluar nga data 28 mars 1999, Dikoviqi pranoi se Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk i kishte bërë asnjë pyetje për varrin e përbashkët në Izbicë.²²⁴⁶

884. Raportet e përgatitura nga sistemi i drejtësisë ushtarake bëjnë të ditur se më 29 maj 1999 nisi një proces në gjykatat ushtarake në lidhje me zbulimin e varreve të përbashkëta në Izbicë. Kjo ndodhi pas zbulimit të varreve nga MPB-ja më 27 maj 1999.²²⁴⁷ Stanimir Radosavleviqi, prokuror ushtarak në Prokurorinë e Lartë Ushtarake të Armatës së Tretë dëshmoi se dosja e Izbicës u kalua nga Gjykata Ushtarake e Nishit te një prokuror civil diku pas vitit 2001, sepse nuk kishte asnjë provë se përgjegjësit e masakrës kishin qenë ushtarakë. Ai shprehu mendimin se kjo mund të ketë ndodhur në vitin 2003 ose 2004.²²⁴⁸

885. Dhoma vëren se Llazareviqi nuk e pyeti Brigadën e 37-të të Motorizuar lidhur me varrin e përbashkët apo me vrasjet, me gjithë faktin se kjo brigadë ishte angazhuar në operacione shumë pranë Izbicës shumë pak kohë para lajmeve të mediave për këtë varr të përbashkët. Mirëpo, dëshmia e Llazareviqit për përpjekjet e muajit maj 1999 në lidhje me varrin e përbashkët të Izbicës përputhet me dëshminë e Gagiqit, Bogunoviqit dhe Tomasheviqit. Fakti se ekipi i SPB-së së Mitrovicës takoi ushtarë të UJ-së në Izbicë më 27 maj 1999 të cilët i dhanë informacion për vendndodhjen e varrit të përbashkët mbështet dëshminë e Llazareviqit se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte marrë masat për gjetjen e varrit të përbashkët përpara datës 27 maj 1999. Mungesa e hetimit nga Komanda e Korpusit të Prishtinës mund të shpjegohet nga fakti se, megjithëse ushtarët e UJ-së ndodheshin në zonë dhe akuzoheshin se qenë përgjegjës për krimet, Llazareviqi ishte i bindur se detyrën e këqyrjes së vendngjarjes e kishte Gjykata e Qarkut të

²²⁴³ Lubisha Dikoviq, T. 19985–19986 (11 dhjetor 2007).

²²⁴⁴ P2046 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 28 mars 1999) (Dikoviqi i raportoi Korpusit të Prishtinës dhe i dërgoi kopje Armatës së Dytë dhe Korpusit të Uzhicës për dijëni), f. 1; P2048 (Raport Luftimi i Përkohshëm i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 29 mars 1999).

²²⁴⁵ P615 (Atlasi i Kosovës), f. 17.

²²⁴⁶ Lubisha Dikoviq, T. 19985–19986 (11 dhjetor 2007). Brigada e 37-të e Motorizuar u vendos për herë të parë në vartësi të Korpusit të Prishtinës në fillim të muajit mars dhe e gjithë njësia hyri në Kosovë para datës 3 prill. Lubisha Dikoviq, T. 19870, 19872 (10 dhjetor 2007). *Shih* 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999); 3D680 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për ndërrim varësie të Brigadës së 37-të të Motorizuar/Armata e Dytë, 6 mars 1999).

²²⁴⁷ P955 (Pasqyrë përmbledhëse e proceseve penale kundër personave që kryen krime në zonën e Kosovës gjatë agresionit të NATO-s në Jugosllavi nga data 24 mars 1999 deri më 10 qershor 1999), f. 76; 4D171 (Informacion mbi proceset penale për shkeljet e kryera në Kosovë, paraqitur nga Prokurori Ushtarak në Nish, 6 prill 2001), f. 8.

²²⁴⁸ Stanimir Radosavleviq, T. 17495–17496 (23 tetor 2007); *shih edhe* Gjura Bllagojeviq, T. 21559 (1 shkurt 2008).

Mitrovicës. Duke theksuar përfundimin e vet të mëparshëm se anëtarët e MPB-së ishin përgjegjës për vrasjen e shqiptarëve kosovarë në Izbicë dhe se UJ-ja nuk mori pjesë në vrasje, Dhoma nuk është e mendimit se mosnjsja e hetimeve nga ana e Korpusit të Prishtinës lidhur me varret e përbashkëta përbën përgjegjësi penale të Llazareviqit.

vi. Reagimi ndaj krimeve të kryera nga anëtarët e MPB-së

886. Sa u takon krimeve të kryera nga anëtarët e MPB-së, Dhoma kujton se Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk kishte kompetencën për marrjen e masave ndëshkuese kundër anëtarëve të MPB-së, duke qenë se hierarkitë komanduese të UJ-së dhe MPB-së mbetën të veçuara gjatë konfliktit. Megjithatë, Radojko Stefanoviqi dëshmoi se, kur Llazareviqi u informua për problemet e shkaktuara nga oficerët e MPB-së në fund të muajit maj 1999, ai krijoi një ekip të udhëhequr nga organet e sigurimit “për të hetuar informacionin e dhënë lidhur me krimet e mundshme të kryera nga policia”.²²⁴⁹

f. Masat parandaluese të marra brenda Korpusit të Prishtinës

i. Masat e përgjithshme parandaluese

887. Prokuroria parashtron se, edhe pse Llazareviqi u dha urdhra dhe udhëzime vartësve të tij mbi nevojën për të respektuar të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe rregulloret e UJ-së për mbrojtjen e popullsisë civile, këto urdhra dhe udhëzime ishin jo të mjaftueshme. Prokuroria parashtron se vetëm dhënia e urdhrave pa konkretizuar zbatimin e tyre nuk përbën përmbushje të përgjegjësisë së një komandanti korpusi.²²⁵⁰

888. Llazareviqi dha një sërë urdhrash duke u bërë thirrje vartësve të merrnin masa për parandalimin e kryerjes së krimeve. Në një urdhër të dhënë më 1 prill 1999, Llazareviqi i udhëzonte brigadat e angazhuara në operacion luftimi në sektorin e Jabllanicës të “parandalonin plaçkitjet, vjedhjet dhe format e tjera të krimeve dhe nxjerrjen e përfitimeve nga lufta, të mbronin civilët nga plaçkitjet dhe të vendosnin rendin”, dhe shtonte se “të identifikoheshin dhe të kapeshin shpejt dhe me efikasitet autorët e krimeve dhe personat përgjegjës për zhvillimet negative dhe Gjykata Ushtarake të merrte masat më të rënda që parashikonte ligji kundër këtyre personave”.²²⁵¹ Urdhra të ngjashëm me këtë të Llazareviqit u pasuan prej urdhrave me shkrim nga njësitë vartëse

²²⁴⁹ Radojko Stefanoviq, T. 21727–21728 (6 shkurt 2008).

²²⁵⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 986.

²²⁵¹ P2029 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 1 prill 1999), f. 5.

përmes hierarkisë komanduese.²²⁵² Në fillim të muajit maj 1999, Llazareviqi i dha urdhër Brigadës së 354-të të Këmbësores në lidhje me kryerjen e operacioneve. Në urdhër, kjo brigadë udhëzohej mes të tjerash, të parandalonte djegien dhe shkatërrimin e ndërtesave, të hapte zjarr vetëm nëse haste rezistencë dhe nëse njësi u kanosej rrezik dhe të parandalonte keqtrajtimin dhe përndjekjen e civilëve.²²⁵³

889. U morën edhe disa masa për fuqizimin e disiplinës në Detashmentet Ushtarake-Territoriale. Më 22 prill 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës urdhëroi që të gjitha Detashmentet Ushtarake-Territoriale të zhvendoseshin nga vendet e banuara në sektorë të rinj për të eliminuar dobësitë e konstatuara.²²⁵⁴ Për më tepër, sipas një urdhri të dhënë nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 21 maj 1999, Komanda e Korpusit kishte zbuluar “një sërë mosveprimesh dhe dobësish” gjatë kontrollit që u kishte bërë Detashmenteve Ushtarake-Territoriale që qenë vendosur në vartësi të komandave të brigadave. Dobësitë përfshinin sjelljen e pahijshme dhe konsumimin e sasive të mëdha të alkoolit nga disa anëtarë të këtyre detashmenteve. Komandat e brigadave në fjalë morën urdhër të bënin kontrole të përditshme brenda Detashmenteve Ushtarake Territoriale, të siguronin një rend dhe disiplinë më të mirë dhe të merrnin masa disiplinore dhe penale ndaj personave që shkelnin rendin dhe disiplinën. Ky urdhër udhëzonte edhe që të bëhej raportim për zbatimin e këtyre masave në raportet e përditshme të luftimit.²²⁵⁵

890. Komanda e Korpusit të Prishtinës insistonte në kufizimin e “lëvizjes së pakontrolluar” të anëtarëve të njësi të Korpusit të Prishtinës. Pas marrjes së një sërë raportesh në të cilat bëhej e ditur një “lëvizje e pakontrolluar e trupave në mënyrë të pakuptimtë dhe joushtarake”, më 29 prill 1999 Llazareviqi ritheksoi udhëzimet e dhëna më parë të cilat synonin parandalimin e çdo shkeljeje nga ana e ushtarëve, duke dhënë një urdhër për të përdorur të gjitha mjetet në dispozicion në nivel brigade dhe në nivel të njësi më të vogla dhe për të siguruar “një sistem tërësisht funksional dhe një sistem të pandërprerë komandimi deri në ushtarin më të fundit”. Komandantët duhej të garantonin që asnjë ushtar në vartësi të tyre të mos largohej nga zona e përgjegjësisë pa dijeninë

²²⁵² 5D86 (Urdhër i Batalionit të Dytë të Motorizuar, 8 prill 1999), f. 8 (nën vulë); 5D87 (Urdhër i Komandës së Grupit Luftarak të Dytë, 3 prill 1999), f. 6 (nën vulë); 5D32 (Urdhër i Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 20 prill 1999); 5D35 (Urdhër i Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 24 prill 1999), f. 1.

²²⁵³ 5D396 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 maj 1999); *shih edhe* 5D86 (Urdhër i Komandës së Batalionit të Dytë të Motorizuar, 8 prill 1999), f. 8 (nën vulë); 5D87 (Urdhër i Komandës së Grupit Luftarak të Dytë, 3 prill 1999), f. 6 (nën vulë); 5D32 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 20 prill 1999); 5D35 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 24 prill 1999), f. 1; 5D1101 (Urdhër i Brigadës së 52-të të Artilerisë së Përzierë, 22 prill 1999); 5D1041 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar për parandalimin e çdo shkeljeje gjatë veprimtarive luftarake, 22 maj 1999), f. 1.

²²⁵⁴ 5D372 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me zhvendosjen e Detashmenteve Territoriale-Ushtarake jashtë qendrave të banuara, 22 prill 1999); *shih edhe* 5D816 (Urdhër i Brigadës së 7-të të Këmbësores, 23 korrik 1999).

²²⁵⁵ 5D417 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 21 maj 1999).

dhe pëlqimin e një oficeri epror. Urdhri theksonte se komandantët do t'i jepnin llogari personalisht Llazareviqit për vënien në zbatim të tij.²²⁵⁶

891. Më 7 maj 1999 doli një dokument tjetër që mban nënshkrimin e Llazareviqit ku (a) theksohej se sjellja e anëtarëve të UJ-së jashtë zonës së luftimit po komprometonte reputacionin e UJ-së, (b) u ndalohej ushtarëve me armë të dilnin jashtë zonës së tyre të luftimit, (c) ndalohej hyrja në vende të tilla si hotele dhe institucione të tjera publike, ku kishte të pranishëm shtetas të huaj dhe (d) kërkohet marrja e masave adekuate kundër atyre që i shkelnin këto urdhra. Sikurse përcaktohej në dokument, zbatimi i masave të tilla duhej të raportohet përmes raporteve të rregullta të luftimit dhe komandantët e njësisë në vartësi do të quheshin përgjegjës në rast të moszbatimit të urdhrave.²²⁵⁷

ii. Shkarkimi nga detyra i komandantëve

892. Prokuroria parashtron se u morën disa masa për shkarkimin nga detyra të komandantëve përgjegjës për mosveprime apo mangësi në punën e tyre, siç ishte rasti i komandantit të Brigadës së 175-të të Këmbësisë dhe i komandantit të Brigadës së 58-të të Këmbësisë së Lehtë, të cilët u shkarkuan që të dy nga postet e tyre. Mirëpo, sipas Prokurorisë, ata ishin përgjegjës vetëm për episode sporadike dhe të palidhura me krimet e kryera nga trupat.²²⁵⁸

893. Llazareviqi dëshmoi se, që në fillim të muajit prill 1999, ai shkarkoi nga posti komandantin e Brigadës së 58-të të Këmbësisë së Lehtë. Sipas Llazareviqit, ky komandant u procedua penalisht gjatë konfliktit për akte të kryera prej tij dhe kundër tij u morën edhe masa disiplinore.²²⁵⁹ Dragisha Marinkoviqi shpjegoi se në mes të muajit prill 1999, Llazareviqi e dërgoi në rajonin e Stari Tërgut, së bashku me një ekip nga Komanda e Korpusit të Prishtinës, për të inspektuar formacionin e njësisë dhe përgatitjen e saj për realizmin e detyrave të dhëna. Vlerësimi i Marinkoviqit, si edhe ai i ekipit nga Komanda e Korpusit të Prishtinës, ishte negativ dhe, për rrjedhojë, ai i sugjeroi Llazareviqit pezullimin e komandantit. Llazareviqi e udhëzoi Marinkoviqin ta informonte menjëherë komandantin se ishte pezulluar dhe atë, më pas, e arrestoi Policia Ushtarake dhe ia kaluan gjykatave ushtarake.²²⁶⁰ Dhoma vëren se asnjë komandant nga Korpusi i

²²⁵⁶ 5D385 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 29 prill 1999). *Shih edhe* 5D1020 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 1 maj 1999).

²²⁵⁷ 5D398 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 7 maj 1999).

²²⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 986.

²²⁵⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18109–18112 (12 nëntor 2007).

²²⁶⁰ Dragisha Marinkoviq, 5D1379 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 dhjetor 2007), para. 21.

Prishtinës nuk është ndjekur penalisht, me përjashtim të këtij personi, i cili u procedua penalisht vetëm sepse nuk mori masa mbrojtëse që shkaktoi vdekjen e një anëtari të njësisë së tij.²²⁶¹

894. Llazareviqi dëshmoi se, gjatë konfliktit, ai mori “të dhëna të papërpunuara” nga Dega e Sigurimit e Korpusit të Prishtinës për “disa mosveprime apo mangësi në punën e komandantit të Brigadës së 175-të të Këmbërorisë”. Kjo brigadë kishte kaluar nga Korpusi i Nishit në varësinë e Korpusit të Prishtinës.²²⁶² Në veçanti, Dhoma vëren se, në një raport luftimi të datës 31 mars 1999 për Komandën e Korpusit të Prishtinës, Nikolla Petroviqi, komandant i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë, shpjegonte se “disa vullnetarë shfaqnin mungesë disipline dhe kryenin aktivitete të tjera kriminale”. U arrestuan tetë vullnetarë, për të cilët ekzistonin dyshime të arsyeshme se kishin kryer “krimin në fshatin Zhegër”. Ai shtonte se situata po bëhej më e qëndrueshme.²²⁶³

895. Pasi dërgoi Marinkoviçin për të inspektuar njësinë, sikurse u përshkrua më lart, Llazareviqi kërkoi që Petroviqi t’i dërgonte një raport ku të bëhej e ditur se cila prej këtyre akuzave ishte e vërtetë.²²⁶⁴ Në raportin e tij të datës 28 prill 1999, Petroviqi i mohoi këto akuza.²²⁶⁵ Më 1 maj 1999, Llazareviqi dhe Pavkoviqi shkuan të inspektonin njësitë në vartësi të Brigadës së 175-të të Këmbërorisë.²²⁶⁶ Në një urdhër të nxjerrë më 2 maj, Llazareviqi e përshkroi situatën në këto njësi “situatë tejet të pafavorshme, kaotike dhe të patolerueshme”, sidomos në lidhje me sjelljen e anëtarëve të këtyre njësisve. Ai urdhëronte më tej një analizë të situatës në mënyrë që të identifikoheshin shkaqet e kësaj situatë dhe personat përgjegjës për të. Në ditët në vijim Komandës së Korpusit të Prishtinës i duhej dorëzuar një plan konkret masash për përmirësimin e situatës.²²⁶⁷ Po atë ditë Komanda e Brigadës së 175-të të Këmbërorisë i dërgoi një raport luftimi Komandës së Korpusit të Prishtinës, në të cilin Petroviqi shpjegonte se, në përputhje me urdhrin e Komandës së Korpusit të Prishtinës, komandanti i brigadës “mbajti një mbledhje informative” dhe komandantët dorëzuan raporte. Po kështu, Petroviqi informonte se “ishin zbatuar një varg masash disiplinore dhe ishin nisur ndjekje penale për shkelje të ndryshme”. Ai theksonte se “vendimet e para patën një efekt mjaft pozitiv” dhe se detyrat do të “vazhdonin të zbatoheshin me këmbëngulje dhe plotësisht”. Ai arriti në përfundimin se “fokusi ishte te korrigjimi i të metave të identifikuara”.²²⁶⁸ Dhoma vëren se përmendja nga ana e Petroviqit e vendimeve duhet të ketë pasur të bëjë me masat

²²⁶¹ Momir Stojanović, T. 19736–19740 (6 dhjetor 2007).

²²⁶² Vladimir Llazareviq, T. 18110 (12 nëntor 2007).

²²⁶³ 5D825 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 31 mars 1999).

²²⁶⁴ Vladimir Llazareviq, T. 18110 (12 nëntor 2007).

²²⁶⁵ 5D533 (Raport i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë lidhur me akuzat për aktivitet të parregullt në Brigadë, 28 prill 1999), f. 1, pranuar edhe me numrin 4D175.

²²⁶⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18110 (12 nëntor 2007).

²²⁶⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18111 (12 nëntor 2007); 5D388 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1–2.

²²⁶⁸ 5D554 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbërorisë, 2 maj 1999).

disiplinore brendapërbrenda njësisë, duke qenë se deri në vitin 2001, nuk ishte dhënë asnjë ndëshkim penal kundër anëtarëve të Brigadës së 175-të të Këmbësorisë.²²⁶⁹

896. Më 2 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës nxori edhe një urdhër për komandantët e të gjitha njësiteve vartëse, në të cilin Llazareviqi e dënonte situatën që kishte konstatuar në njësitë në vartësi të Brigadës së 175-të dhe i paralajmëronte komandantët “të merrnin masa tejet energjike për vënien në jetë të urdhrave të nxjerra nga Komanda e Korpusit të Prishtinës dhe aktivitetet të përqendroheshin në organizimin e mbrojtjes në përputhje me regjimin efektiv të sigurisë, organizimin e përsosur të jetës dhe punës në njësi ... dhe, në veçanti, për të siguruar një pamje të rregullt ushtarake të anëtarëve të njësisë”. Llazareviqi urdhëroi që komandantët t’i vizitonin personalisht të gjitha njësitë në vartësi dhe t’i paraqisnin një raport brenda datës 4 maj 1999.²²⁷⁰

897. Sipas Llazareviqit, rreth datës 2 maj 1999, Pavkoviqi i dha urdhër komandantit të Korpusit të Nishit të dërgonte një ekip në ndihmë të Komandës së Korpusit të Prishtinës për të krijuar një pamje shumë më të hollësishme të situatës në Brigadën e 175-të të Këmbësorisë të Korpusit të Nishit, e cila kishte kaluar në varësi të Korpusit të Prishtinës. Pas disa ditësh, Llazareviqi dhe Pavkoviqi shkuan përsëri të vizitonin Brigadën. Situata ishte përmirësuar në lidhje me disa elementë, por ata, përsëri, qenë të pakënaqur me masat e marra. Për rrjedhojë, Pavkoviqi vendosi shkarkimin nga posti të Petroviqit dhe të 17 oficerëve të tjerë nga kjo brigadë, përfshirë edhe oficerë të organeve të sigurimit, shefin e shtabit dhe disa prej komandantëve të batalioneve. Korpusi i Nishit emëroi më vonë oficerë të tjerë në këto poste.²²⁷¹ Kjo u konfirmua nga Marinkoviqi.²²⁷²

898. Më 19 maj 1999, Millorad Stanojeviqi, komandanti i ri i Brigadës së 175-të të Këmbësorisë, i dërgoi një raport luftimi Komandës së Korpusit të Prishtinës, në të cilin informonte, ndër të tjera, se “rendi dhe disiplina qenë përmirësuar”, por se kishte “ende incidente të izoluara lejeje të paautorizuar nga njësitë, tentativa për vjedhje, uniforma të çrregullta, etj.”. Ai vërente gjithashtu se një ditë më parë tre ushtarë të brigadës qenë kapur duke plaçkitur. Ata ishin ndaluar menjëherë dhe kundër tyre ishte bërë kallëzim penal.²²⁷³

²²⁶⁹ P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), f. 57; P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raportit mbi çështjet penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 6.

²²⁷⁰ 5D387 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1–2. *Shih edhe* Dragisha Marinkoviq, 5D1379 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 dhjetor 2007), para. 23 (“Të gjitha pjesët e formacionit të Korpusit të Prishtinës u informuan për këtë çështje, duke qenë se komandanti i Korpusit të Prishtinës ua dërgoi këtë informacion si paralajmërim komandantëve të njësiteve personalisht, duke u kërkuar marrjen e masave energjike për parandalimin e çrregullimeve të ngjashme”).

²²⁷¹ Vladimir Llazareviq, T. 18111–18112 (12 nëntor 2007).

²²⁷² Dragisha Marinkoviq, 5D1379 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 dhjetor 2007), para. 21.

²²⁷³ 5D563 (Raport Luftimi i Brigadës së 175-të të Këmbësorisë për Korpusin e Prishtinës, 19 maj 1999).

899. Gjithashtu, sipas Stojanoviqit, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999 u shkarkuan nga detyra përafërsisht 40 komandantë batalioni dhe disa dolën përpara gjykatës disiplinore ushtarake. Mirëpo, ai nuk dha asnjë hollësi lidhur me arsyen e procedimit të tyre disiplinor dhe, pyetjes nëse ishte ndjekur penalisht ndonjë syresh, iu përgjigj se ishte vetëm në dijeni për komandantin e Brigadës së 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë, i cili ishte proceduar penalisht për mosmarrje të masave mbrojtëse çka kishte shkaktuar vdekjen e një anëtari të njësisë së tij dhe jo për vrasjet e shqiptarëve kosovarë që qenë kryer nga anëtarë të njësisë së tij.²²⁷⁴

900. Dhoma gjykon se masat e marra nga Komanda e Korpusit të Prishtinës lidhur me komandantin e Brigadës së 58-të të Këmbëtorisë së Lehtë dhe komandantin e Brigadës së 175-të të Këmbëtorisë synonin përmirësimin e disiplinës në njësitë e Korpusit të Prishtinës. Mirëpo, fakti se u ndoq penalisht vetëm njëri prej këtyre komandantëve, dhe, edhe në këtë rast, vetëm për mosmarrje të masave çka kishte shkaktuar vdekjen e një anëtari të UJ-së, dhe jo për krimet e kryera kundër shqiptarëve kosovarë, tregon se këto masa nuk u morën në përgjigje të fushatës së shpërnguljes së dhunshme në Kosovë kundër shqiptarëve kosovarë dhe as për krimet e kryera në kuadër të kësaj fushate.

iii. Masat e marra në lidhje me civilët

901. Në procesin gjyqësor janë paraqitur një sërë urdhrash të shkruar që kanë të bëjnë me zhvendosjen si edhe me mbrojtjen dhe kthimin e civilëve.

902. Më 16 prill 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës u dha një urdhër të gjithë komandantëve në vartësi, në të cilin u shpjegonte se “për shkak të operacioneve të agresorit” popullsia civile në zonën e përgjegjësisë së Korpusit ishte çdo ditë e zbuluar ndaj “sulmeve të drejtpërdrejta të cilat përbënin rrezik serioz për sigurinë e kësaj popullsie”. Me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e humbjeve të popullsisë civile, Komanda e Korpusit të Prishtinës u jepte urdhër të gjithë komandantëve në vartësi: (a) të formonin “forca të posaçme – elementë me gatishmëri luftarake për evakuimin e popullsisë civile”; (b) “të ndihmonin në strehimin dhe evakuimin e civilëve, të siguronin kushtet më të mira të mundshme për strehimin e tyre, të ndihmonin në sigurimin e furnizimeve ... sidomos të jepnin mbështetje mjekësore, të siguronin ... mbrojtjen e pasurive dhe sigurisë vetjake, të parandalonin çdo kufizim të lirisë dhe të drejtave të qytetarëve, nëse kjo nuk kërcënonte sigurinë e tyre apo atë të njësisë”; (c) “të evidentonin numrin e civilëve në zonat ku qenë dislokuar njësitë dhe të bënin inventarët e nevojshëm të ushqimeve për ushqimin e popullsisë dhe të nevojave të tjera elementare”. Në fund të urdhrit Llazareviqi

²²⁷⁴ Momir Stojanoviq, T. 19736–19737, 19739–19740 (6 dhjetor 2007).

shkruante se do të “merrte personalisht masat më të rrepta që personave që e shkelin këtë urdhër të ballafaqohen me përgjegjësinë”.²²⁷⁵ Njësitë në vartësi dhanë urdhra të njëjta në ditët në vijim.²²⁷⁶

903. Më 19 prill 1999, Komanda e Korpusit miratoi një urdhër tjetër në të cilin i udhëzonte komandantët në vartësi të “vlerësonin situatën e përgjithshme në lidhje me strehimin dhe lëvizjet e popullsisë civile”. Në urdhër thuhej se “sa herë që është e mundur” njësitë vartëse duhej të “mbronin popullsinë civile dhe parandalonin çdo lëvizje dhe përhapje” dhe se, nëse rastiste që në zonën e një operacioni luftimi ndodheshin civilë, njësitë në vartësi duhej t’i “evakuonin në sektorë më të përshtatshëm dhe t’i mbronin nga zjarri i armëve”. Vendndodhjet më të përshtatshme qenë “fshatrat, ndërtesat e banimit dhe ndërtesat e tjera” të cilat qenë “më të përshtatshme për evakuimin dhe strehimin e përkohshëm e popullsisë civile”.²²⁷⁷ Njësitë në vartësi nxorën më pas urdhra të ngjashëm.²²⁷⁸ Komanda e Korpusit të Prishtinës e përsëriti këtë urdhër më 23 prill 1999. Ky urdhër përcaktonte se komandantët duhej të parandalonin “çdo sjellje të papërshtatshme, sidomos në strukturën e ulët të komandimit, kundrejt popullsisë civile”. Moslejimi i civilëve që të ktheheshin në shtëpitë e tyre përmendej si një shembull i sjelljes së papërshtatshme që duhej parandaluar.²²⁷⁹ Komandanti i Brigadës së 549-të të Motorizuar dhe Komanda e Qarkut Ushtarak të Prishtinës miratuan urdhra të ngjashëm për njësitë në vartësi të tyre.²²⁸⁰ Gjatë kësaj periudhe kohe, Komanda e Korpusit të Prishtinës nxori një urdhër në të cilën i udhëzonte brigadat të “përshpejtonin kthimin e civilëve që po ktheheshin në fshatrat dhe qytetet nga ku qenë zhvendosur”. Në urdhër theksohej se civilët nuk duhej të qëndronin në zonat e mbrojtjes së brigadave.²²⁸¹

904. Më 2 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës ritheksoi se të gjitha njësitë e Korpusit duhej të “vazhdonin të siguronin strehim për popullsinë civile në zonat e përgjegjësisë së tyre, në vendbanime, në përputhje me vendimet e komandantëve të brigadave dhe në bashkërendim me organet e autoriteteve civile dhe mbrojtjen civile”. Ajo i udhëzonte të gjitha njësitë t’i vendosnin

²²⁷⁵ P1306 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës për mbrojtjen e popullsisë civile, 16 prill 1999).

²²⁷⁶ 5D888 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 17 prill 1999); 5D963 (Urdhër i Brigadës së 252-të të Blinduar, 17 prill 1999).

²²⁷⁷ 5D201 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës lidhur me mbrojtjen e popullsisë civile, 19 prill 1999).

²²⁷⁸ 5D1033 (Urdhër i Brigadës së 37-të të Motorizuar, 20 prill 1999); 5D1004 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak, 20 prill 1999), pranuar edhe me numrin 5D32; 5D1101 (Urdhër i Komandës së Brigadës së 52-të të Artilerisë së Përzierë, 22 prill 1999); 5D964 (Urdhër i Brigadës së 252-të të Blinduar për strehimin e civilëve, 20 prill 1999).

²²⁷⁹ 5D374 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës mbi masat për stabilizimin e mbrojtjes, 23 prill 1999).

²²⁸⁰ 5D897 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 prill 1999) (“Të parandalohet çdo sjellje e padisiplinuar nga ana e komandantëve në lidhje me popullsinë civile (të mos ndalohen që të kthehen në vendet e populluara, e kështu me radhë)”, para. 2); 5D35 (Urdhër i Komandës së Qarkut Ushtarak, 24 prill 1999) (“Të parandalohet çdo formë sjelljeje të papërshtatshme kundrejt civilëve (për shembull, të mos ndalohen që të kthehen në vendet e populluara) sidomos nga ana e individëve (komandantët e skuadrave, komandantët e togave, etj.)”, para. 2).

²²⁸¹ 5D372 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1999).

civilët në “objekte adekuate” për të mos lejuar që ata të qëndronin “në qiell të hapur” dhe të “krijonin kushtet për përmbushjen e nevojave të tyre bazë”.²²⁸²

905. Krahas kësaj, më 28 mars 1999, komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se pritej që disa mijëra refugjatë civilë të gjendeshin në vendstrehime rreth fshatit Vojnikë, ku do të kryente operacionin e ardhshëm brigada e tij. Ai shtoi se njësia e tij “nuk kishte as fuqinë, as mjetet për t’i mbyllur vendstrehimet dhe për t’i shoqëruar refugjatët për të dalë nga zona e operacionit të luftimit”, dhe, rrjedhimisht, kërkoi “udhëzime dhe urdhra” nga Komanda e Korpusit të Prishtinës.²²⁸³ Dikoviqi dëshmoi se, në përgjigje të kërkesës së tij, një oficer nga Korpusi i Prishtinës e vizitoi dhe konfirmoi se në qoftë se në zonën ku zhvilloheshin operacione luftimi do të shfaqeshin persona civilë, njësitë e Korpusit të Prishtinës të angazhuara në këto operacionet duhej t’i ndërprisnin aktivitetet e tyre dhe t’i nisnin civilët përgjatë një aksi të sigurt, drejt një zone të sigurtë. Njësitë duhej t’u jepnin ndihmë civilëve sipas nevojës.²²⁸⁴

906. Dhoma vëren se, megjithëse këto masa tregojnë se Llazareviqi ishte në dijeni të zhvendosjes së përhapur të popullsisë shqiptare kosovare nga forcat e UJ-së, ato tregojnë gjithashtu se ai bëri përpjekje që kjo zhvendosje të bëhej në mënyrë jo të dhunshme dhe pa i keqtrajtuar personat e zhvendosur.

907. Raportet nga disa njësi vartëse tregojnë se ato i zbatuan urdhrat e Komandës së Korpusit të Prishtinës në disa zona të caktuara në Kosovë. Më 18 prill 1999, komandanti i Brigadës 354 të Këmbëtorisë e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se në territorin e komunës Podujevë “kishin mbërritur rreth 15 mijë refugjatë të kombësisë shqiptare (persona të kthyer)” dhe se ishin strehuar në fshatrat Lladofc dhe Shajkofc. Ai shtoi se brigada e tij ishte në proces të “evidentimit të numrit të refugjatëve (personave të kthyer) dhe të mbrojtjes së territorit ku qenë vendosur”.²²⁸⁵ Më 4 maj 1999, ai i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës se, në lidhje me urdhrin e saj të datës 2 maj 1999 për zhvendosjen e popullsisë civile nga zona ku qenë vendosur, qenë zhvendosur afërsisht 10 mijë civilë të shpërngulur nga komuna Podujevë në fshatrat në lindje të qytetit të Podujevës. Në raport shpjegohej se procesi i regjistrimit ishte i ngadalshëm për shkak të “vëllimit të madh të

²²⁸² 5D389 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 2 maj 1999).

²²⁸³ P2046 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar, për Korpusin e Prishtinës, 28 mars 1999); Vladimir Llazareviq, T. 18687–18688 (21 nëntor 2007).

²²⁸⁴ Lubisha Dikoviq, T. 19984–19985 (11 dhjetor 2007).

²²⁸⁵ 5D499 (Raport luftimi i Brigadës 354 të Këmbëtorisë, 18 prill 1999). f. 3.

punës”. Në të jepeshin edhe emrat e disa fshatrave si “vendndodhje të mundshme për vendosje/zhvendosje”.²²⁸⁶

908. Më 20 prill 1999, Brigada e 252-të e Blinduar e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se kishte filluar “pritja e refugjatëve”: “ata ishin transportuar në dy automjete dhe një autobus, duke bërë disa rrugë”; “u kishin dhënë ushqim”; “i kishin shoqëruar në fshatin Dragobilë, nga ku kishin shkuar në fshatin Joviq”.²²⁸⁷ Më 25 prill 1999, komandanti i Brigadës së 252-të të Blinduar e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se në zonën e saj të përgjegjësisë ndodheshin dy grupe “refugjatësh” me nga 2.000 dhe 3.000 burra, gra dhe fëmijë. Ai mësoi prej njërit prej tyre se një grup “terroristësh” po i ndalonte të largoheshin dhe po i përdorte si mburojë njerëzore.²²⁸⁸ Pas dy ditësh, ai raportoi se brigada e tij po i mbronte civilët në sektorin e tij.²²⁸⁹ Në një raport të datës 26 prill 1999 drejtuar Komandës së Korpusit të Prishtinës, komandanti i Brigadës së 211-të të Blinduar kërkonte dhënien urgjente të ndihmës humanitare, kryesisht ushqime, për “refugjatët” shqiptarë kosovarë.²²⁹⁰

909. Më 20 prill 1999, Komanda e Brigadës së 37-të të Motorizuar i dërgoi një kërkesë Komandës së Korpusit të Prishtinës për “shpërndarjen e ndihmës humanitare popullsisë vendase në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Skënderajt dhe Gllogocit”. Kërkesa dërgohej në përputhje me urdhrin e datës 16 prill 1999 të Komandës së Korpusit të Prishtinës.²²⁹¹ Më 25 prill, Dikoviqi, komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar, e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se, në përputhje me urdhrin e saj të datës 23 prill, qenë marrë masat kundër anëtarëve të brigadës së tij të cilët dyshoheshin se kishin kryer krime kundër popullsisë civile në Gllogoc.²²⁹² Më 3 maj 1999, Komanda e Brigadës së 37-të të Motorizuar i dërgoi një raport Komandës së Korpusit të Prishtinës në lidhje me situatën në Gllogoc. Në të shpjegohej se, kur kishin filluar operacionet e luftimit, një numër i madh civilësh nga fshatrat përreth kishin gjetur strehim në qytetin Gllogoc, në të cilin nuk kishte energji elektrike apo ujë. Dikoviqi propozonte t’u kërkohej përfaqësuesve të Kryqit të Kuq t’i vizitonin civilët në Gllogoc, të vlerësonin situatën dhe të jepnin ndihmën më të rëndësishme me ushqime, ujë dhe kujdes shëndetësor. Ai sugjeronte edhe marrjen e masave për ardhjen e autoriteteve civile nga Fushë-Kosova në Gllogoc. Në fund, ai theksonte se, “nëse nuk ekzistonte asnjë prej mundësive për t’i ndihmuar, atëherë duhej organizuar evakuimi i popullsisë”.²²⁹³ Më 4

²²⁸⁶ 5D486 (Raport luftimi i Brigadës 354 të Këmbësisë, 4 maj 1999).

²²⁸⁷ 5D1072 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 20 prill 1999).

²²⁸⁸ 5D973 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999).

²²⁸⁹ 5D974 (Raport luftimi i Brigadës së 252-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 27 prill 1999).

²²⁹⁰ 5D615 (Raport luftimi i Brigadës së 211-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 26 prill 1999), f. 2.

²²⁹¹ 5D1034 (Kërkesë për dhënien e ndihmës humanitare drejtuar Kryqit të Kuq, 20 prill 1999).

²²⁹² 5D1057 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999).

²²⁹³ 5D1037 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 3 maj 1999).

maj, ai i raportoi Llazareviqit se të gjithë civilëve në zonën e përgjegjesisë së brigadës u ishte “siguruar strehim në ndërtesa të përshtatshme” dhe se “askush nuk ishte në qiell të hapur”; “civilët ishin nën kontrollin e njësisë, ishin regjistruar” dhe ishin “trajtuar në mënyrë njerëzore”. Në raport thuhej se në zonën e përgjegjesisë së brigadës ndodheshin 23 mijë civilë dhe se po mbaronin rezervat ushqimore.²²⁹⁴ Më 13 maj 1999, Llazareviqi i dërgoi Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm një raport për situatën në Gllogoc, në të cilin kërkonte marrjen e masave urgjente nga autoritetet krahinore për t’u siguruar civilëve të kësaj zone ushqime dhe kujdes shëndetësor.²²⁹⁵

910. Më 4 maj 1999, Komanda e Brigadës së 52-të të Raketave të Artilerisë së Mbrojtjes Kundërajrore e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se “popullsisë civile i ishte dhënë strehim” në sektorë të ndryshëm.²²⁹⁶ Edhe Komanda e Brigadës së 7-të të Këmbëorisë e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës për sektorët ku mund të rivendoseshin “refugjatët”.²²⁹⁷ Po ashtu, Brigada e 252-të e Blinduar i dërgoi një raport Komandës së Korpusit të Prishtinës për këtë çështje po atë ditë.²²⁹⁸ Në një raport tjetër të datës 2 maj 1999, Gergari, komandanti i Brigadës së 211-të të Blinduar, e informonte Komandën e Korpusit të Prishtinës se një kolonë me “refugjatë” shqiptarë kosovarë e cila kishte ardhur nga drejtimi i Prishtinës, ishte “dërguar në fshatin Sibofc”.²²⁹⁹

911. Më 22 maj 1999, Komanda e Batalionit të 52-të Mjekësor i dërgoi një raport luftimi Komandës së Korpusit të Prishtinës në të cilin i kërkonte Komandës së Korpusit të Prishtinës rivlerësimin e sektorit të dislokimit të batalionit për shkak të “rritjes së numrit të refugjatëve të kthyer, mundësisë së sulmeve të individëve dhe grupeve terroriste të armatosura dhe mungesës së stërvitjes së njësisë për mbrojtjen e organizuar në zonat e banuara”.²³⁰⁰ Pas disa ditësh, ajo e informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës se kishte vizituar “kampin e refugjatëve” në Stanica Metohija dhe se i kishte propozuar disa masa Shtabit të Krizës për parandalimin e epidemive dhe për kujdesin për “refugjatët”.²³⁰¹

912. Dhoma vëren se asnjë prej këtyre raporteve të njësisë vartëse mbi numrin e madh të shqiptarëve kosovarë të shpërngulur dhe për përfshirjen e UJ-së në lëvizjen e tyre dhe kujdesin për

²²⁹⁴ 4D303 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 4 maj 1999); *shih edhe* P2045 (Raport Luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 5 maj 1999).

²²⁹⁵ 5D412 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm, lidhur me situatën në Gllogoc, 13 maj 1999).

²²⁹⁶ 5D390 (Raport luftimi i Brigadës së 52-të të Raketave Artilerike të Mbrojtjes Kundërajrore për Korpusin e Prishtinës, 4 maj 1999).

²²⁹⁷ 5D793 (Raport luftimi i Brigadës së 7-të të Këmbëorisë, 4 maj 1999).

²²⁹⁸ 5D793 (Raport i Brigadës së 252-të të Blinduar, 4 maj 1999).

²²⁹⁹ 5D618 (Raport luftimi i Brigadës së 211-të të Blinduar për Korpusin e Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1.

²³⁰⁰ 5D1109 (Raport luftimi i Batalionit të 52-të Mjekësor për Korpusin e Prishtinës, 22 maj 1999).

ta, nuk ka lidhje me vendndodhjet ku është vërtetuar se UJ-ja kreu shpërngulje të dhunshme. Po kështu, K90-a, anëtar i UJ-së, dëshmoi se, në dallim nga këto urdhra me shkrim që kanë të bëjnë me kujdesin për civilët në zonat e luftimit, urdhrat për shpërnguljen e dhunshme të tyre nuk jepeshin me shkrim, por me gojë.²³⁰² Ai dëshmoi se, në disa raste, shqiptarët kosovarë nuk largoheshin nga zonat në të cilat vepronte UJ-ja, duke qenë se largimi i tyre do ta linte UJ-në pa mbrojtjen e civilëve përreth saj, duke e nxjerrë kështu në pozita të cenueshme nga sulmet e NATO-s.²³⁰³ Për më tepër, përkundër urdhrat të datës 19 prill 1999, Llazareviqi vijoi të jepte urdhra për operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë dhe njësitë e UJ-së vijuan përfshirjen në lëvizje të mëdha të personave të shpërngulur për të dalë nga Kosova, si për shembull gjatë operacioneve të planifikuara në luginën e Caragojt në Gjakovë më 27 dhe 28 prill 1999, ku K73-shi i cili ishte anëtar i UJ-së, tregonte për lëvizjen sistematike nga një fshat në tjetrin për ta dëbuar popullsinë, dhe në Lisnajë në komunën e Kaçanikut më 25 maj 1999, sikurse është përmendur në Pjesën VII.M.

6. Përfundime lidhur me përgjegjësinë e Vladimir Llazareviqit

913. Prokuroria pretendon se Llazareviqi është përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) apo për ndihmë dhe inkurajim të krimeve që përmban Aktakuza.²³⁰⁴ Më tej, Llazareviqi akuzohet me përgjegjësinë si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.²³⁰⁵ Mbrojtja e Llazareviqit përgjigjet se Prokuroria nuk ka vërtetuar se ai ka marrë pjesë në krimet e pretenduara në Aktakuzë, dhe as se ka pasur dijeni se këto krime kishin ndodhur apo do të ndodhnin.²³⁰⁶

914. Sipas Prokurorisë, Llazareviqi ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe ka kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e kësaj ndërmarrjeje. Prokuroria parashtron se Llazareviqi kishte synimin për ta realizuar këtë plan të përbashkët dhe veprimet e tij—përfshirë edhe komandimin, urdhërimin dhe udhëzimin nga ana e tij të operacioneve të UJ-së në Kosovë, përfshirë edhe operacionet e përbashkëta me MPB-në—tregojnë se ai synonte realizimin e këtij plani përmes mjeteve kriminale.²³⁰⁷ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se ai nuk mori pjesë në

²³⁰¹ 5D1037 (Raport luftimi i Brigadës së 37-të të Motorizuar për Korpusin e Prishtinës, 3 maj 1999).

²³⁰² K90, T. 9302–9304 (29 janar 2007), P2652 (deklaratë e dëshmitarit, e datës 8 dhjetor 2002), para. 40–41.

²³⁰³ K90, T. 9408 (30 janar 2007); *shih edhe Momir Stojanoviq, T. 19732* (6 dhjetor 2007).

²³⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 922, 975.

²³⁰⁵ Aktakuza, para. 13, 55–59.

²³⁰⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 850–851, 867–868, 888, 905, 924.

²³⁰⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 8, 922.

ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe se nuk është vërtetuar që ai të ketë pasur synimin e përbashkët për të marrë pjesë në një ndërmarrje të tillë.²³⁰⁸

915. Dhoma vëren se nuk është e detyruar të nxjerrë përfundime faktike tërësore për secilën formë të përgjegjësisë së akuzuar, por vetëm të analizojë vetëm ato që përshkruajnë më me saktësi sjelljen e të akuzuarit.²³⁰⁹ Në përgjigje të pretendimit të Prokurorisë se Llazareviqi ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, Dhoma do të analizojë fillimisht përgjegjësinë e tij ligjore në kuadër të kësaj forme përgjegjësie. Çështjet e trajtuara janë ilustruar me shembujt përkatës, mirëpo Dhoma thekson se përfundimet bazohen në të gjitha provat përkatëse

a. Kryerja e krimeve përmes pjesëmarrjes në ndërmarrje të përbashkët kriminale

916. Që Llazareviqi të ngarkohet me përgjegjësi në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të dëshmojnë se ai mori pjesë të paktën në një aspekt të qëllimit të përbashkët për të mundësuar vijimësinë e kontroll të Kosovës nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë, përmes krimeve të shpërnguljes me dhunë, për të cilin Dhoma tashmë ka konkluduar se ekzistonte.²³¹⁰ Për vërtetimin e këtij elementi, nuk është e domosdoshme që Llazareviqi t'i ketë kryer fizikisht krimet përmes të cilave është arritur qëllimi apo edhe krime të tjera.²³¹¹ Madje, nuk është e domosdoshme që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të këtyre krimeve.²³¹² Mirëpo, duhet që kontributi i tij në këtë plan të ketë qenë i konsiderueshëm.²³¹³ Sa i përket ekzistencës së synimit kriminal, duhet vërtetuar se Llazareviqi mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte synimin e përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, që në këtë rast është shpërngulja me dhunë.

917. Dhoma gjykon se, megjithëse ka prova të konsiderueshme në mbështetje të pretendimit të Prokurorisë se Llazareviqi mbështeti kryerjen e krimeve në gjithë Kosovën nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në një fushatë të gjerë dhe sistematike kundër shqiptarëve kosovarë, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai kishte synim të përbashkët me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Provat në mbështetje të pretendimit të Prokurorisë përfshijnë raporte konkrete për aktivitetin kriminal të vartësve të Llazareviqit në Korpusin e Prishtinës, dijeninë e tij

²³⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (version publik), para. 849–851.

²³⁰⁹ *Shih* Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 602; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 388–389.

²³¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

²³¹¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

²³¹² Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

²³¹³ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

për situatën e përgjithshme në Kosovë bazuar në postin që kishte si Komandant i forcave të UJ-së në Kosovë dhe praninë e tij në Kosovë gjatë zhvillimit të fushatës së shpërnguljes së dhunshme, sidomos në Prishtinë, ku ndodhej gjatë kohës që forcat e UJ-së po i shpërngulnin me dhunë shqiptarët kosovarë.²³¹⁴ Ka prova se shpërngulja e dhunshme u urdhërua gojarisht brendapërbrenda hierarkisë komanduese të UJ-së. Edhe mbledhja në prill 1999 në qytetin e Prishtinës midis Llazareviqit dhe drejtuesve të MPB-së, Stevanoviqi dhe Gjorgjeviqi ndërsa forcat e UJ-së dhe MPB-së të cilat bashkëvepronin në mënyrë të organizuar po shpërngulnin shqiptarët kosovarë me dhunë nga qyteti, tregon implikimin e tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.²³¹⁵ Fakti se ai vijoi me dhënien e urdhrave për përdorimin e UJ-së në Kosovë në vitin 1999, përkundër dijenisë që kishte për krimet e kryera nga forcat e UJ-së dhe MPB-së atje, e mbështet edhe më shumë këtë pretendim.

918. Mirëpo, ka prova që rrëzojnë pretendimin se ai kishte synimin e përbashkët për kryerjen e krimeve brenda kornizës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në lidhje me emërimin e Llazareviqit si komandant i Korpusit të Prishtinës, Dhoma rithekson përfundimin e saj se nuk duket që ai të ketë qenë një ndër “lakenjtë” e Millosheviqit në kohën e emërimit të tij në fund të vitit 1998. Dhoma ka theksuar se Llazareviqi nuk shkoi në Beograd në vitin 1998 dhe se nuk mori pjesë në mbledhjet në kryeqytet dhe se nuk bënte pjesë në Kolegjiumin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Për më tepër, pjesëmarrja e Llazareviqit në mbledhjet e Komandës së Përbashkët ishte e kufizuar. Ai mori pjesë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët vetëm disa herë dhe, si rrjedhojë, gjatë këtyre mbledhjeve ai nuk mund të formonte një ide të qartë mbi ndikimin që ushtronte mbi MPB-në dhe UJ-në Komanda e Përbashkët lidhur me vënien në zbatim të fazave të ndryshme të Planit kundër Terrorizmit. Në vitin 1999, ai nuk mori pjesë në mbledhjet e zhvilluara në Beograd më 4, 16 apo 17 maj, ndër të tjera, midis Millosheviqit, Millutinoviqit, Pavkoviqit, Ojdaniqit dhe Llukiqit.²³¹⁶ Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se ai ishte i distancuar nga vendimmarrësit në Beograd dhe se ky faktor rrëzon pretendimin mbi anëtarësinë e tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Llazareviqi mori edhe një sërë hapash në lidhje me veprat penale të anëtarëve të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, përfshirë edhe nxjerrjen e urdhrave me shkrim, në disa raste, duke mos lejuar shpërnguljen e popullsisë civile dhe duke kërkuar ndëshkimin e rëndë të sjelljes së papërshtatshme kundër civilëve. Këto urdhra tregojnë se, edhe pse dinte se UJ-ja ishte e implikuar në shpërnguljen gjerësisht të përhapur të popullsisë shqiptare kosovare, ai ndërmori disa masa për përmirësimin e rrethanave në të cilat ndodhi kjo shpërngulje.

²³¹⁴ Provat e tjera që lidhen me dijeninë e Llazareviqit për fushatën diskutohen më poshtë.

²³¹⁵ Vladimir Llazareviq, T. 18260 (14 nëntor 2007).

²³¹⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18134 (12 nëntor 2007), T. 18657 (20 nëntor 2007). Dhoma vëren se Llukiqi nuk mori pjesë në mbledhjet e datave 16 dhe 17 maj, por ai mori pjesë në mbledhjen e datës 4 maj.

919. Bazuar në këto prova, Dhoma konkludon se Prokuroria nuk ka vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Llazareviqi kishte synimin e përbashkët me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale për ruajtjen e kontrollit në Kosovë përmes shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve kosovarë. Për shkak të këtij përfundimi, Dhoma nuk analizon aspektin e kontributit të tij të konsiderueshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

920. Duke kujtuar se Dhoma duhet të analizojë vetëm ato forma përgjegjësie në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të cilat përshkruajnë më me saktësi sjelljen e të akuzuarit, Dhoma bën një konstatim të përgjithshëm të elementëve fizikë të formave të tjera të përgjegjesisë në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 se planifikimi kryesisht ka të bëjë me ata të cilët i planifikojnë krimet, se nxitja kryesisht ka të bëjë me ata të cilët i nxisin të tjerët të kryejnë krime dhe se urdhërimi kryesisht ka të bëjë me ata të cilët i udhëzojnë të tjerët të kryejnë krime; ndërsa ndihma dhe inkurajimi kanë të bëjnë me ata të cilët japin ndihmë praktike, inkurajim ose mbështetje morale për kryerjen e krimeve.²³¹⁷ Bazuar në sa më sipër, Dhoma nuk është e mendimit se planifikimi, nxitja ose urdhërimi përafrohen me sjelljen e Llazareviqit dhe nuk pranon ta përkufizojë përgjegjësinë e tij individuale penale brenda këtyre formave. Për rrjedhojë, Dhoma do të analizojë përgjegjësinë e tij për ndihmën dhe inkurajimin e dhënë në kryerjen e krimeve për të cilët është vërtetuar se kanë ndodhur.

b. Ndihma dhe inkurajimi

921. Që Llazareviqi të ngarkohet me përgjegjësi për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit për krimet që janë vërtetuar, duhet provuar se ai dha ndihmë praktike, inkurajim ose mbështetje morale për autorin e krimit apo shkeljes bazë, si edhe se kjo ndihmë praktike, inkurajim apo mbështetje morale pati efekt thelbësor në kryerjen e krimit apo shkeljes bazë.²³¹⁸ Për më tepër, duhet provuar se ai e dha qëllimisht ndihmën dhe ishte i vetëdijshëm për elementët thelbësorë të krimit apo shkeljeje bazë, përfshirë edhe synimin kriminal të autorit fizik apo të ndërmjetëm.²³¹⁹ Dhënia e ndihmës praktike, inkurajimit apo mbështetjes morale mund të ndodhë përpara, gjatë ose pas kryerjes së krimit.²³²⁰ I akuzuari mund të ndihmojë dhe inkurajojë përmes mosveprimit, kur (a) ka detyrimin ligjor për të vepruar, (b) i akuzuari ka mundësinë për të vepruar, (c) nuk vepron me synimin që të ndodhin pasoja kriminale ose me dijeninë dhe pëlqimin që të ndodhin këto pasoja, dhe (d) mosveprimi sjell kryerjen e krimit.

²³¹⁷ Për përshkrimet e plota të elementeve të këtyre formave të përgjegjesisë, shih Kapitullin II.

²³¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 45, 46; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

²³¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 49; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162; *Simiq dhe të tjerë*, Aktgjykimi i Apelit, para. 86.

²³²⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48.

922. Dhoma ka konkluduar se, nga muaji mars deri në muajin qershor 1999, forcat e UJ-së dhe të MPB-së kryen shpërngulje gjerësisht të përhapura dhe sistematike në shumë fshatra në 13 komunat e Kosovës, ku përfshihet edhe kryerja e krimeve kundër qindra mijëra shqiptarëve kosovarë.

923. Llazareviqi ishte në dijeni të kësaj fushate shpërnguljesh të dhunshme që u realizua nga UJ-ja dhe MPB-ja në mbarë Kosovën gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Gjatë vitit 1998 dhe gjatë periudhës deri në fillimin e fushatës, Llazareviqi i vinte informacion që bënte të ditur se efektivë të UJ-së dhe MPB-së ishin përgjegjës për vepra të rënda penale të kryera kundër shqiptarëve etnikë në Kosovë. Provat e mësipërme, përfshirë shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, disa urdhra të Komandës së Korpusit të Prishtinës, provat që kanë të bëjnë me praninë e Llazareviqit në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës në kohën kur u kryen operacionet e përbashkëta atje dhe provat mbi dijeninë e tij për krimet e kryera në fshatin Abri e Epërme në komunën Glllogoc në tetor 1998, si edhe në fshatin Sllapuzhan më 8 janar 1999, dëshmojnë se Llazareviqi ishte në dijeni të faktit se gjatë operacioneve të kryera nga UJ-ja dhe MPB-ja në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999 u kryen krime kundër civilëve dhe pronave të civilëve. Ai ishte në dijeni të katastrofës humanitare në Kosovë, sikurse përshkruhet në Rezolutën nr 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilën deklarohet se kjo ishte shkaktuar, pjesërisht, nga përdorimi i tepruar i forcës nga ana e UJ-së dhe MPB-së,²³²¹ dhe ishte i vetëdijshëm për implikimin e UJ-së në djegien e shtëpive të shqiptarëve kosovarë. Faktikisht ai ishte i pranishëm në një mbledhje të udhëheqjes së UJ-së, kur Samarxhiqi tha konkretisht se lufta kundër terrorizmit përmes zjarrvënies ishte “turp”.²³²² Rrjedhimisht, Llazareviqi ishte i vetëdijshëm për gjasën e një përdorimi të ngjashëm të tepruar të forcës dhe shpërnguljes së dhunshme, nëse do të jepte urdhër që UJ-ja të vepronte në Kosovë në vitin 1999.

924. Nga fundi i marsit 1999 dhe gjatë gjithë fushatës së shpërnguljeve të dhunshme, Llazareviqi, si komandant i Korpusit të Prishtinës, ishte i pranishëm në Kosovë, ku po zhvillohej fushata nga vartësit e tij, të cilët bashkëvepronin me MPB-në, dhe, sipas raporteve, ai vetë u shpreh se ishte në “vijën e parë” të veprimit.²³²³ Që prej datës 24 mars 1999, e duke vazhduar për disa javë, UJ-ja dhe MPB-ja, në bashkëveprim shpërngulën me dhunë në mënyrë të organizuar një numër të madh civilësh shqiptarë kosovarë nga Prishtina, gjë që kërkonte planifikim dhe bashkërendim të konsiderueshëm. Llazareviqi ishte i pranishëm në Prishtinë më të shumtën e kësaj periudhe dhe ishte në dijeni të këtyre shpërnguljeve dhe të atmosferës së terrorit të krijuar në qytet nga UJ-ja dhe MPB-ja. Llazareviqi bëri të ditur se ishte në dijeni të shpërnguljes së mëparshme të

²³²¹ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 124–125.

²³²² 4D97 (Procesverbal i mbledhjes informuese të komandantëve të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, 7 gusht 1998), f. 3.

dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga anëtarë të Korpusit të Prishtinës kur u bëri thirrje vartësve të tij të mos lejonin keqtrajtimin e popullsisë civile, përmes praktikave të tilla si moslejimi i kthimit të civilëve në vende të banuara.²³²⁴ Për më tepër, Llazareviqi u informua për shkallën masive të shpërnguljes së popullsisë civile në raportet që i dërgonin njësitet në vartësi. Për shembull, ai u vu në dijeni se nga data 24 mars deri më 2 prill, mbi 300 mijë shqiptarë kosovarë qenë larguar për në Shqipëri.²³²⁵ Ndërthurja e dijenisë së përgjithshme të Llazareviqit për shpërnguljen e përhapur të shqiptarëve kosovarë gjatë operacioneve të UJ-së me dijeninë e tij konkrete për vendndodhjet e këtyre operacioneve, përfshirë edhe shumicën e vendndodhjeve të përmendura në Aktakuzë, bën që Dhoma të arrijë në përfundimin se i vetmi konkluzion logjik është se ai ishte në dijeni të fushatës së terrorit, dhunës dhe shpërnguljes së dhunshme që forcat e UJ-së dhe të MPB-së kryen kundër shqiptarëve kosovarë.

925. Llazareviqi dha ndihmë praktike, inkurajim dhe mbështetje morale për forcat e UJ-së që u angazhuan në shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë, në bashkërendim me MPB-në. Gjatë gjithë fushatës së shpërnguljeve të dhunshme, Llazareviqi ishte komandant i Korpusit të Prishtinës, me pushtet *de jure* dhe *de facto* mbi të gjithë anëtarët e tij dhe me kompetencë për të planifikuar veprimtaritë dhe operacionet e UJ-së në Kosovë.²³²⁶ Pjesëmarrja e Llazareviqit në planifikimin dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta të kryera nga UJ-ja, vetëm ose në bashkërendim me MPB-në, në terren në Kosovë nga muaji mars deri në qershor 1999, ishte e konsiderueshme. Urdhrat e tij *Grom* 3 dhe 4 dhe urdhrat e Komandës së Përbashkët (të hartuara nga Korpusi i Prishtinës) e bënë UJ-në të vepronte në Kosovë dhe shërbyen si autorizim brenda hierarkisë komanduese të UJ-së që UJ-ja të vepronte në vendngjarjet ku ndodhën krimet, në vendet ku u kryen shumë shpërngulje të dhunshme të shqiptarëve kosovarë. Prania në terren e Llazareviqit, i cili inspektoi trupat e UJ-së të implikuara në kryerjen e krimeve kundër shqiptarëve kosovarë, u bë me qëllimin e shprehur për t'u ngritur moralin ushtarëve.²³²⁷ Llazareviqi ishte në dijeni se gjykatat ushtarake nuk po bënin ndjekje penale të efektshme kundër anëtarëve të UJ-së, lidhur me dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre. Përkundër dijenisë që kishte për fushatën e shpërnguljes së dhunshme që po zhvillohej në Kosovë, më 15 maj 1999 ai raportoi se vetëm një oficer i Korpusit

²³²³ P1523 (Transkripti i një bisede televizive të zhvilluar më 18 korrik 1999, botuar më 21 korrik 1999), f. 2.

²³²⁴ 5D374 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 23 prill 1999), f. 1.

²³²⁵ 5D885 (Dokument i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 3 prill 1999), f. 1.

²³²⁶ Dhoma vëren se detashmentet territoriale ushtarake në Kosovë kaluan në vartësi Llazareviqit jo më vonë se 8 prill. Në lidhje me krimet e renditura më poshtë, për të cilat po dënohet Llazareviqi, Dhoma bindet se në kryerjen e tyre ishin përfshirë anëtarë të Korpusit të Prishtinës ose të njësive të UJ-së që kishin kaluar në vartësi të Korpusit të Prishtinës në kohën e ndodhjes së tyre. Në lidhje Staro Sellon në Ferizaj, Dhoma vëren se qenë implikuar vullnetarë të UJ-së. Dhoma kujton këtu provat e diskutuara në Nënndarjen VI.A.2.c.iv, ku theksohet se vullnetarët u dërguan në qendrat stërvitore në Serbi dhe pastaj u inkuadruan në njësitet e Korpusit të Prishtinës në Kosovë. Për këtë arsye, Dhoma bindet se vullnetarët në Staro Sello ishin nën juridiksionin e Korpusit të Prishtinës në kohën që ka lidhje me Aktakuzën.

të Prishtinës ishte akuzuar për vrasje.²³²⁸ Gjithashtu, vetëm një komandant i një njësie të Korpusit të Prishtinës u ndoq penalisht në lidhje me ngjarjet në Kosovë dhe edhe kjo u bë për mosmarrje të masave çka solli vdekjen e një anëtarit të UJ-së. Llazareviqi dinte se mosmarrja e masave të mjaftueshme nga ana e tij për të mundësuar hetimin e duhur të krimeve të rënda të kryera nga UJ-ja i lejoi forcat ta vazhdonin fushatën e tyre të terrorit, dhunës dhe shpërnguljeve.

926. Këto veprime dhe mosveprime përbënin një kontribut thelbësor për kryerjen e krimeve për të cilat Dhoma ka arritur në përfundimin se janë kryer nga anëtarët e UJ-së, sikurse përcaktohet më poshtë, duke qenë se ato ndihmuan përmes pranisë së ushtarëve në terren për kryerjen e këtyre akteve, përmes organizimit dhe pajisjes së njërive të UJ-së dhe përmes furnizimit me armë, përfshirë edhe tanke, për të ndihmuar në këto akte. Për më tepër, veprimet dhe mosveprimet e Llazareviqit ofruan inkurajim dhe mbështetje morale përmes autorizimit brenda hierarkisë komanduese të UJ-së që UJ-ja të vijonte operacionet në Kosovë, megjithëse pjesëtarë të UJ-së kishin kryer krime. Si komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi dinte se sjellja e tij do të ndihmonte në vënien në zbatim të fushatës për shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë.

927. Dhoma konkludon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjitha veprimet e Llazareviqit, të përshkruara më lart, u kryen në mënyrë të vullnetshme. Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se, përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tij, Llazareviqi dha ndihmë praktike, inkurajim dhe mbështetje morale për anëtarët e UJ-së të përfshirë në kryerjen e zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit në vendet konkrete të krimeve të përshkruara më lart, që ndikuan thelbësisht në kryerjen e këtyre krimeve, se ai ishte në dijeni të kryerjes së qëllimshme të këtyre krimeve nga UJ-ja në bashkërendim me MPB-në dhe se ai ishte në dijeni se sjellja e tij ndihmoi në kryerjen e këtyre krimeve.

928. Edhe pse shpërnguljet e dhunshme qenë pjesë e fushatës së organizuar të UJ-së dhe MPB-së, Dhoma nuk bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasjet, dhuna seksuale apo shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore ishin synime të paramenduara të kësaj fushate. Për rrjedhojë, megjithëse ai ishte në dijeni se pjesëtarë të UJ-së kishin vrarë shqiptarë kosovarë në disa raste, nuk është vërtetuar që Llazareviqi të ketë qenë në dijeni se forcat e UJ-së dhe MPB-së po hynin në vendet e krimeve të përmendura më lart për të kryer vrasje, dhunë seksuale apo shkatërrim të

²³²⁷ P1903 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 5 prill 1999), f. 3; P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999), f. 2.

²³²⁸ P1182 (Informacion dërguar Brigadës së 52-të të Raketave të Artilerisë nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999), f. 4; Radomir Gojoviq, T. 16694–16695 (2 tetor 2007), T. 16756 (3 tetor 2007); P1011 (Ivan Markoviq, redaktor, *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* “Zbatimi i normave të së drejtës ndërkombëtare të konflikteve të armatosura” (2001)), f. 166.

objekteve fetare dhe kulturore. Rrjedhimisht, në rastin e Llazareviqit, nuk është vërtetuar synimi kriminal i ndihmës dhe inkurajimit në lidhje me pikat 3, 4 dhe 5 të Aktakuzës.

929. Dhoma thekson se, në nxjerrjen e përfundimeve lidhur me përgjegjësinë e Llazareviqit, ka marrë në konsideratë të gjitha provat përkatëse që lidhen me Llazareviqin, përfshirë edhe ato që mbështesin deklarin e tij të pafajësisë dhe vetë dëshminë e tij në të cilën ai mohon çdo përgjegjësi për ngjarjet që janë objekt i Aktakuzës. Mirëpo, Dhoma konkludon se në disa raste këto mohime rrëzohen nga provat e pranura të përmendura më lart, të cilat japin një pamje të qartë të ndihmës praktike, inkurajimit dhe mbështetjes morale të dhënë nga Llazareviqi autorëve të disa prej shkeljeve bazë.

930. Për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore konkludon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Vladimir Llazareviqi mban përgjegjësi për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit, në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit, për krimet në vendndodhjet e mëposhtme:

- Pejë
 - Qyteti i Pejës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Deçan
 - Beleg— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjakovë
 - Qyteti i Gjakovës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Korenicë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Dobrosh—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Ramoc— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mejë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Fshatra të tjerë në zonën e Caragojit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Piranë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Rahovec
 - Celinë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

- Skënderaj
 - Turiçec—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Izbicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Tushilë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Qirez— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prishtinë
 - Qyteti i Prishtinës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjilan
 - Zhegër— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lladovë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Përlepticë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Kaçanik
 - Kotlinë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Kaçanik— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lisnajë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

931. Në lidhje me krimet që janë vërtetuar se janë kryer dhe për të cilat Llazareviqi nuk është konsideruar përgjegjës për dhënien e ndihmës dhe të inkurajimit, Dhoma gjithashtu konkludon se ai nuk i planifikoi, nxiti apo urdhëroi këto krime.

c. Përgjegjësia si epror

932. Në lidhje me përgjegjësinë e Llazareviqit në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, Dhoma thekson se lidhur me krime konkrete të zhvendosjes së dhunshme nuk është vërtetuar përgjegjësia e tij si ndihmës dhe inkurajues. Këto krime konkrete konsistojnë në shpërngulje të dhunshme të kryer nga MPB-ja, pa pjesëmarrjen e UJ-së. Sikurse është konkluduar më lart, nuk është vërtetuar që Llazareviqi të ketë pasur kontroll të efektshëm mbi forcat e MPB-së të cilat vepronin në Kosovë. Rrjedhimisht, ai nuk është përgjegjës sipas paragrafit 3 të Nenit 7 për krimet e tjera në pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës që janë provuar, dhe të cilat janë:

- Prizren
 - Dushanovë, pjesë e qytetit të Prizrenit— dëbim, krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme; veprime të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit;
- Suharekë
 - Qyteti i Suharekës— dëbim, krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme; veprime të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit;
- Mitrovicë
 - Qyteti i Mitrovicës— dëbim, krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme; veprime të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit;
 - Zhabar— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Vushtrri
 - Qyteti i Vushtrrisë—zhvendosje e dhunshme veprime të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit;
 - Kolonë pranë Studimes së Epërme— dëbim, krim kundër njerëzimit; zhvendosje e dhunshme; veprime të tjera çnjerëzore, krim kundër njerëzimit;
- Ferizaj
 - Sojevë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mirosalë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Staro Sello— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

933. Në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit Llazareviqi ngarkohet me përgjegjësi edhe për pikat 3, 4 dhe 5 të Aktakuzës. Dhoma vëren se nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasjet, dhuna seksuale apo shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore ishin synime të paramenduara të fushatës së shpërnguljes së dhunshme. Rrjedhimisht, Llazareviqi do të kishte qenë në dijeni se forcat e tij po kryenin krime vetëm po të ekzistonte informacion i disponueshëm në lidhje me krimet konkrete të vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve fetare dhe kulturore të kryera nga forcat e UJ-së. Llazareviqi mori informacion që bënte të ditur se forcat e MPB-së ose të UJ-së ishin përgjegjëse për vrasjet e shqiptarëve kosovarë në Izbicë. Mirëpo, Dhoma ka arritur në përfundimin se këto krime u kryen nga forcat e MPB-së dhe se, megjithëse UJ-ja ndodhej në afërsi, ajo nuk ishte përgjegjëse për vrasjet. Rrjedhimisht, Llazareviqi nuk kishte kontroll të efektshëm mbi autorët e krimit. Përveç vrasjeve në Izbicë, Dhoma nuk është e mendimit se ai dispononte informacion në lidhje me vrasjet, dhunën seksuale apo shkatërrimin e objekteve

fetare dhe kulturore, për të cilat është vërtetuar përgjegjësia e UJ-së, apo se ai kishte arsye të dinte për to.

934. Llazareviqi nuk është përgjegjës për asnjë prej akuzave të tjera të ngritura në Aktakuzë, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

935. Rrjedhimisht, Vladimir Llazareviqi është fajtor për pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës. Mirëpo, ai nuk është fajtor për pikat 3, 4 dhe 5 të Aktakuzës, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

H. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E SRETEN LLUKIQIT

1. I Akuzuari

936. Sreten Llukiqi u lind në Vishegrad më 28 mars 1955. Më 1974 kreu shkollën e mesme policore në Sremska Kamenica.²³²⁹ Më pas i vijoi studimet në akademinë ushtarake në Beograd, e cila në të njëjtën kohë i shërbente UJ-së dhe MPB-së.²³³⁰ Pas diplomimit nga akademia dhe gjatë gjithë karrierës së tij, Llukiqi shërbeu në detyra të ndryshme në MPB, si inspektor i Policisë, shef i Departamentit të Rendit dhe Qetësisë Publike, zëvendës-shef i SPB-së së Uzhicës, shef i departamentit të rendit publik dhe qarkullimit rrugor në Shtabin e MPB-së në Beograd.²³³¹

937. Në vitin 1991, Llukiqi u emëruar zëvendës-shef i SPB-së së qytetit të Beogradit dhe më pas, në maj 1998, u transferua në Shtabin e MPB-së për Kosovën.²³³² Pas kryerjes së detyrës së tij në Kosovë, Llukiqi u emërua shef i Administratës së Policisë Kufitare. Më 2001 ai u ngrit në detyrën e shefit të RJB-së.

2. Akuzat e Aktakuzës

938. Sipas Aktakuzës, Llukiqi planifikoi, organizoi, drejtoi, koordinoi dhe kontrolloi punën e MPB-së në Kosovë. Si shef i Shtabit të MPB-së për Kosovën, pretendohet se ai komandoi operacionet e MPB-së dhe ishte përgjegjës për njësitë e MPB-së në Kosovë gjatë periudhës 1 janar - 20 qershor 1999. Ai akuzohet për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen apo ndryshe për ndihmë dhe inkurajim në planifikimin, përgatitjen, dhe kryerjen e krimeve të pretenduara në

²³²⁹ ID680 (Rekomandim për gradimin e Sreten Llukiqit si gjenerallejtënant, 11 maj 1999); P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 4.

²³³⁰ ID680 (Rekomandim për gradimin e Sreten Llukiqit si gjenerallejtënant, 11 maj 1999); P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 4.

²³³¹ ID680 (Rekomandim për gradimin e Sreten Llukiqit si gjenerallejtënant, 11 maj 1999); 6D1360 (Libreza e Punës e Sreten Llukiqit).

aktakuzë, dhe për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për ndryshimin e përbërjes etnike në Kosovë. Ai akuzohet edhe për përgjegjësinë e tij si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.²³³³

939. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza dhe më pas, Llukiqi punoi në mënyrë të ligjshme dhe profesionale, dhe në asnjë mënyrë nuk planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu apo ndryshe ndihmoi dhe inkurajoi planifikimin ose kryerjen e ndonjë krimi brenda juridiksionit të paragrafit 1 ose 3 të Nenit 7.²³³⁴ Ajo veçanërisht kundërshton pretendimet e Prokurorisë lidhur me natyrën dhe kompetencat e Shtabit të MPB-së dhe rolin e Llukiqit në këtë shtab.²³³⁵

940. Në Kapitullin VII, Dhoma përfundoi se midis marsit dhe qershorit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen krime kundër popullatës civile shqiptare kosovare në shumë komuna të Kosovës. Në këtë pjesë do të analizohet përgjegjësia e Llukiqit për këto krime në bazë të cilësdo forme përgjegjësie të pretenduar në Aktakuzë.

3. Grada e Llukiqit

941. Prokuroria pretendon se gjatë periudhës në fjalë, Llukiqi ishte oficeri më gradë më të lartë i MPB-së në Kosovë.²³³⁶ Mbrojtja e Llukiqit e mohon këtë dhe thekson se, në dallim nga struktura komanduese e UJ-së, në strukturën komanduese të MPB-së grada në vetvete nuk përcaktonte eproritetin e zyrtarit përkatës të policisë; faktor vendimtar për këtë ishte posti.²³³⁷ Sipas Mbrojtjes së Llukiqit, në vitin 1998 dhe 1999, në terren në Kosovë ishin të pranishëm disa zyrtarë të lartë të MPB-së që ishin eprorë të Llukiqit.²³³⁸ Ajo gjithashtu pohon se “shpeshherë, mesazhet i nënshkruanin persona të tjerë, në bazë të postit dhe detyrës që kishin në kuadrin e Administratës, dhe në këtë drejtim ata mbanin poste më të larta dhe ishin eprorë të Llukiqit.”²³³⁹

942. Gjatë dëshmisë së tij gojore, Branisllav Simonoviçi e pati të vështirë të përcaktonte se cilat grada të policisë ishin më të larta se ajo e Llukiqit, dhe vetëm tha se nuk kishte gradë më të lartë se

²³³² Dushko Adamoviçi, 6D1613 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 51; P1252 (Vendim mbi Përbërjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën dhe Metohinë), para. 1.

²³³³ Aktakuza, para. 15, 65–69.

²³³⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 7.

²³³⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 7.

²³³⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 994.

²³³⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 620–627, 629–638.

²³³⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 620–627, 629–638; Argumentet Përmbyllëse të Mbrojtjes së Llukiqit, T. 27309 (26 gusht 2008).

²³³⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 638.

ajo e gjeneralkolonelit.²³⁴⁰ Në raportin e tij, ai theksoi se ndonëse emrat e gradave ishin të njëjtë, sistemi i gradimit në MPB dallonte plotësisht nga ai i UJ-së.²³⁴¹ Ai shpjegoi se përveç gradave, Ministria e Punëve të Brendshme përdorte edhe tituj, dhe se sistemi i gradimit të punonjësve me grada dhe atyre me titull ishte “thujse i njëjtë”.²³⁴² Simonoviçi gjithashtu shpjegoi se pozita dhe funksioni i një zyrtari në Ministrinë e Brendshme ishin më të rëndësishme se grada e tij në kuptim të ndikimit dhe kompetencave, standard ky që ishte e nevojshëm për shkak të natyrës së detyrave dhe përgjegjësive në ministritë.²³⁴³ Edhe pse Dhoma shprehu rezerva në lidhje me natyrën e saktë të ekspertizës së Simonoviçit²³⁴⁴, dëshmia e tij në lidhje me këtë çështje u konfirmua edhe nga dëshmitarë të tjerë, përfshirë Çasllav Golluboviçin, i cili ishte shefi i SPB-së së Borit në Serbinë lindore. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Golluboviçi pranoi se ishte e mundshme që një anëtar i MPB-së me gradë më të ulët të mbante post më të lartë.²³⁴⁵

943. Libreza e punës e cila dokumenton karrierën e Llukiqit në MPB evidenton se nga 1 janari 1992 e deri më 14 korrik 1999, ku përfshihet edhe periudha kur ai shërbeu si shef i Shtabit të MPB-së, ai konsiderohej si punonjës i SPB-së së Beogradit.²³⁴⁶ Në korrik të 1997, ministri i Punëve të Brendshme emëroi nënkolonel Branko Gjuriçin në detyrën e shefit të SPB-së së Beogradit, që faktikisht e bëri Gjuriçin epror dhe përgjegjës të Llukiqit, ndonëse Llukiqi kishte gradë më të lartë se ai.²³⁴⁷

944. Dhoma pranon që në MPB ndiqej një praktikë sipas të cilës personat me gradë më të ulët mund të shërbenin si eprorë të oficerëve me gradë më të lartë se ata, dhe se natyra e postit dhe përgjegjësive ishte shumë më e rëndësishme se grada. Për këtë arsye, Dhoma nuk e sheh të nevojshme që të përcaktojë se kush ishte zyrtari i policisë me gradë më të lartë në Kosovë, dhe më poshtë do të shqyrtojë kuadrin e detyrave dhe përgjegjësive të Llukiqit.

4. Pozita e Llukiqit në kuadër të Shtabit të MPB-së

945. Më 11 qershor 1998, shefi i RJB-së, Vllastimir Gjorgjeviçi, nxori vendimin për emërimin e Llukiqit, i cili në atë kohë kishte gradën gjeneralmajor, në detyrën e shefit të Shtabit të MPB-së në

²³⁴⁰ Branislav Simonoviçi, T. 25627 (17 prill 2008).

²³⁴¹ 6D668 (Aktekspertiza e Branislav Simonoviçit), f. 46.

²³⁴² 6D668 (Aktekspertiza e Branislav Simonoviçit), f. 46–48.

²³⁴³ 6D668 (Aktekspertiza e Branislav Simonoviçit), f. 46–48.

²³⁴⁴ *Shih* Nënpyesën VI.A.3.

²³⁴⁵ Çasllav Golluboviçi, T. 7425–7426 (27 nëntor 2006); K84, T. 5212 (19 tetor 2006), T. 5237 (25 tetor 2006) (konfirmoi se ishte e mundur që një zyrtar të kishte gradë më të lartë se eprori i tij, ndonëse kjo praktikë nuk ishte e zakonshme).

²³⁴⁶ 6D1360 (Libreza e Punës e Sreten Llukiqit).

²³⁴⁷ 6D1458 (Vendim mbi Emërimin e Branko Gjuriçit si shef i SPB-së së Beogradit, 4 qershor 1997).

Prishtinë.²³⁴⁸ Më 16 qershor 1998, ministri i Brendshëm i Serbisë, Vllajko Stojilkoviqi konfirmoi emërimin e Llukiqit në Shtabin e MPB-së.²³⁴⁹ Më 31 maj 1999, Stojilkoviqi e përtëriu mandatin e Llukiqit²³⁵⁰ dhe më 11 maj 1999, rekomandoi gradimin e Llukiqit si gjenerallejtënant.²³⁵¹

946. Pozita dhe kompetencat e Llukiqit në kuadër të Shtabit të MPB-së janë objekt i kundërshtimeve të shumta midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Llukiqit, që lidhen ngushtë edhe me çështjen e diskutueshme të natyrës së Shtabit të MPB-së. Për këtë arsye, përpara se të trajtojë rolin e Llukiqit, e në veçanti rolin e tij në Shtab, Dhoma do të shqyrtojë provat në lidhje me qëllimin dhe detyrat e Shtabit të MPB-së dhe argumentet e palëve në lidhje me to. Mirëpo, duhet vënë në dukje se një pjesë e madhe e provave lidhur me Shtabin e MPB-së në përgjithësi janë të rëndësishme edhe për çështjen e kompetencave dhe detyrave të Llukiqit si shef.

a. Funksionet e Shtabit të MPB-së për Kosovën

947. Karakteristikë e kësaj çështjeje është fakti se dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes së Llukiqit shpesh bien në kundërshtim me provat dokumentare të marra në këtë çështje. Ndonëse dëshmitarët, shumica e të cilëve ishin ish-kolegë ose vartës të Llukiqit, në përgjithësi e përshkruan Shtabin e MPB-së si organ që nuk kishte kompetenca komandimi ose kontrolli mbi forcat e MPB-së në Kosovë, dokumentet e marra si prova sugjerojnë që Shtabi luajti rol qendror në procesin e planifikimit të operacioneve “antiterroriste” dhe në mundësimin e koordinimit mes forcave të ndryshme, me qëllim zbatimin e objektivave të përbashkëta të këtyre operacioneve. Gjatë shqyrtimit, Dhoma analizoi provat dokumentare së bashku me dëshmitë e dëshmitarëve dhe në nxjerrjen e përfundimeve të saj lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve dhe natyrën e vetë Shtabit të MPB-së, ajo mori posaçërisht parasysh mospërputhjet midis dokumenteve dhe dëshmimeve gojore.

i. Argumentet e palëve dhe dëshmitë e dëshmitarëve

(A) Kompetencat e Shtabit të MPB-së mbi njësitë e RJB-së

948. Siç u parashtrua në Nënpjesën VI.A.3, dokumente të ndryshme të marra si provë kanë të bëjnë me ngritjen, përbërjen, funksionet dhe përtëritjen e mandatit të Shtabit të MPB-së.²³⁵²

²³⁴⁸ P1252 (Vendim mbi përbërjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën dhe Metohinë), para. 1; P1505 (Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998). Dhoma vëren se ndonëse data në provën P1252 nuk lexohet, P1505 tregon qartë se ishte lëshuar më 11 qershor 1998; *shih gjithashtu* Lubinko Cvetiq T. 8030 (6 dhjetor 2006).

²³⁴⁹ P1505 (Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

²³⁵⁰ P1811 (Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 31 maj 1999).

²³⁵¹ 1D680 (Rekomandim për gradimin e Sreten Llukiqit si gjenerallejtënant, 11 maj 1999).

Prokuroria argumenton se roli i shtabit të MPB-së ishte të planifikonte, organizonte dhe kontrollonte veprimtaritë e SPB-ve dhe të gjitha njësite të MPB-së të angazhuara në veprimtari luftarake në Kosovë.²³⁵³ Prokuroria pretendon se Shtabi i MPB-së kishte kompetenca mbi njësitë speciale të MPB-së në Kosovë (PJP, SAJ, dhe JSO) gjatë angazhimit të tyre në operacione luftarake”,²³⁵⁴ dhe gjithashtu parashton se “pas vendosjes në Kosovë, Shtabi i MPB-së kishte për detyrë të drejtonte dhe organizonte operacionet e tyre”.²³⁵⁵ Në lidhje me operacionet që forcat e MPB-së dhe UJ-së duhej të kryenin së bashku, Prokuroria argumenton se, pasi morën autorizim për veprim nga Komanda e Përbashkët, [Llukiqi dhe Pavkoviqi], u kërkuan vartësve të tyre përkatës që të vinin në dispozicion njësitë e nevojshme dhe të vendosnin kontakt me homologët përkatës në UJ dhe MPB në nivel brigade të UJ-së ose detashmenti të PJP-së, ku finalizoheshin hollësitë e planit.”²³⁵⁶

949. Në mbështetje të argumenteve të veta, Prokuroria iu referua mandatit të Shtabit të MPB-së, të përcaktuar në “Vendimin mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit” të datës 16 qershor 1998, riafirmuar në Vendimin e datës 31 maj 1999, ku thuhet se Shtabi i MPB-së kishte për detyrë të kontrollonte punën dhe angazhimin e “njësive organizative të ministrisë dhe njësite të dërguara dhe të atashuara, për shtypjen e terrorizmit në Kosovë”.²³⁵⁷ Miroslav Mijatoviqi, i cili nga korriku 1998 e deri në fund të majit 1999 ishte zëvendësi i Llukiqit në Shtab, dëshmoi se njësitë e “dërguara” ishin detashmentet e PJP-së, por se ai nuk kishte dijeni se cilat ishin njësitë e “atashuara”.²³⁵⁸

950. Prokuroria mbështetet edhe në dëshminë e Lubinko Cvetiqit, i cili ishte shefi i SPB-së në Mitrovicë. Cvetiqi dëshmoi se detyrat e Shtabit të MPB-së ishin përcaktuar në urdhrin për ngritjen e këtij shtabi, dhe këto respektivisht përfshinin “planifikimin, organizimin, koordinimin dhe udhëzimet për punën e sekretariatit/sekretariateve të brendshme dhe pikave kufitare të policisë në Kosovë dhe Metohi, veçanërisht për shkelje të rënda të sigurisë, si për shembull, parandalimin e

²³⁵² 6D1368 (Vendim për Ngritjen e Shtabit të MPB-së në Kosovë, 11 qershor 1997); 6D1370 (Vendim mbi përcaktimin e detyrave të Shtabit të Ministrisë në Prishtinë, 15 janar 1998); P1251 (Vendim mbi Formimin e Shtabit të Ministrisë në Prishtinë, 15 maj 1998); P1252 (Vendim mbi përbërjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën dhe Metohinë, 11 qershor 1998); P1505 (Vendimi mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998); P1811 (Vendimi mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 31 maj 1999).

²³⁵³ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 210–227, 998–1002.

²³⁵⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 210.

²³⁵⁵ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 210.

²³⁵⁶ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 228.

²³⁵⁷ P1505 (Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998); P1811 (Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 31 maj 1999).

²³⁵⁸ Miroslav Mijatoviqi, T. 22430 (14 shkurt 2008).

trazirave, rezistencës ose kryengritjes së armatosur, si dhe terrorizmit.”²³⁵⁹ Shefi i Shtabit të MPB-së kishte për detyrë t’i raportonte shefit të RJB-së.²³⁶⁰

951. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se pavarësisht nga formulimi i vendimeve për ngritjen e Shtabit të MPB-së, ky shtab u krijua si “organ ndihmës” dhe jo si “njësi organizative” e MPB-së, dhe si i tillë nuk e ndryshoi hierarkinë ekzistuese dhe të ligjshme të komandimit, sipas të cilës SPB-të i raportonin vetëm shefit të RJB-së dhe ministrit të Brendshëm.²³⁶¹ Ajo argumenton se “struktura dhe detyrat e Shtabit të MPB-së për Kosovën dhe Metohinë tregojnë qartë se ai ishte vetëm një simbol, një organ ndihmës *ad hoc* që nuk kishte kompetenca ose pushtet mbi strukturat ekzistuese të MPB-së.”²³⁶² Rrjedhimisht, Shtabi i MPB-së nuk mund të kontrollonte dhe nuk kontrolloi punën e SPB-ve dhe as që mund t’u jepte urdhra. Në lidhje me njësitë luftarake, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se Shtabi i MPB-së nuk mund t’u jepte urdhra detyruese; megjithatë, ai mund t’i inkurajonte që të respektonin ligjin.²³⁶³ Argumentohet se vendimi për ngritjen e Shtabit të MPB-së i datës 16 qershor 1998 “i dha Shtabit kompetenca të cilat ishin të pazbatueshme në praktikë.”²³⁶⁴ Në veçanti, parashtrohet se “rrethanat e [nxjerrjes së vendimit] bënë që përparësia e këtij dokumenti të uzurpohej dhe të tejkalohet duke qenë se të gjitha veprimtaritë antiterroriste do të zhvilloheshin siç ishte paraparë në planin pesëfazësh.”²³⁶⁵

952. Miroslav Mijatoviçiqi e quajti Shtabin e MPB-së organ të përkohshëm ndihmës që nuk ishte në pozitë eprore ndaj SPB-ve dhe njësive të tjera organizative të MPB-së,²³⁶⁶ faktor që i pamundësonte Shtabit të MPB-së zbatimin e detyrave që i ishin besuar sipas vendimit për ngritjen e tij, respektivisht planifikimin dhe organizimin e veprimtarive të njësive organizative dhe atyre policore të dërguara në Kosovë.²³⁶⁷ Branisllav Simonoviçiqi e përshkroi në mënyrë të ngjashme rolin e Shtabit të MPB-së.²³⁶⁸ Dushko Adamoviçiqi, i cili më 1998 dhe në fillim të vitit 1999 shërbeu si ndihmës në Shtabin e MPB-së dhe përgjegjës për çështje operative, gjithashtu tha se Shtabi i MPB-së ishte një organ ndihmës i MPB-së dhe pohoi se, ndonëse ekzistonte Shtabi i MPB-së, kjo nuk

²³⁵⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8067 (7 dhjetor 2006).

²³⁶⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8067 (7 dhjetor 2006).

²³⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 416–435.

²³⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), p. 135.

²³⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 381.

²³⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 723.

²³⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 769.

²³⁶⁶ Miroslav Mijatoviçiq, T. 22210, 22216 (12 shkurt 2008) (“Hierarkia drejtuese nuk u ndryshua për një arsye të thjeshtë. Shtabi nuk ishte njësi organizative e ministrisë dhe ekzistenca e shtabit nuk ndikoi në hierarkinë drejtuese. Pra, shtabi nuk përbën njësi organizative dhe si i tillë nuk është mbi apo në varësinë e ndonjë njësie tjetër përveç ministrisë.”).

²³⁶⁷ Miroslav Mijatoviçiq, T. 22204–22205, 22210–22212 (12 shkurt 2008).

²³⁶⁸ Branisllav Simonoviçiq, T. 25520–25521 (16 prill 2008), T. 25534–25536, 25545 (17 prill 2008).

ndryshoi procedurat ose rregullat që ndiqnin njësitë organizative të MPB-së në Kosovë.²³⁶⁹ Gjithashtu, kur u pyet nëse u bënë ndryshime në punën e SPB-së në Mitrovicë si rezultat i emërimit të Llukiqit si shef i Shtabit të MPB-së, Cvetiqi u përgjigj me “Jo”.²³⁷⁰

953. Mijatoviqi dhe Adamoviqi dëshmuar se SPB-të e Kosovës i merrnin urdhrat drejtpërsëdrejti nga selia e MPB-së në Beograd, që i dërgonte të njëjtat urdhra edhe Shtabit të MPB-së për ta informuar.²³⁷¹ Dushan Gavraniqi, shefi i SPB-së së Gjilanit, dëshmoi se pavarësisht nga formulimi i urdhrat të datës 16 qershor, ku sugjerohet se Shtabi i MPB-së drejtonte disa nga veprimtaritë e SPB-ve, ai vazhdoi të “punonte në bazë të dokumenteve që merrte nga shefat e administratave në selinë e ministrisë në Beograd.”²³⁷² Sipas tij, Shtabi i MPB-së “ndihmonte SPB-të”.²³⁷³ Ai e konsideronte Shtabin si një organ i cili “ndihmonte....sekretariatet në punën [e tyre] të përditshme”: kur SPB-ja «kishte nevojë për këshillime ... [ishte] më e lehtë të kontaktohej Prishtina se sa Beogradi.”²³⁷⁴ Si shembull për ndihmën që Shtabi i MPB-së u ofronte SPB-ve, Gavraniqi tha se në rast të mungesës së burimeve materiale-teknike, SPB-ja i dërgonte Shtabit të MPB-së kërkesa urgjente, dhe më pas Shtabi ua kalonte kërkesën administratave në Beograd.²³⁷⁵

954. Dhoma Gjyqësore citon dëshminë e Gavranoviqit se SPB-të “shpeshherë” merrnin nga Shtabi i MPB-së (a) “raporte përsëritëse lidhur me sigurinë shtetërore në përgjithësi”, (b) “telegrame dhe informacione të llojeve të ndryshme” në të cilat Shtabi i MPB-së u tërhiqte vëmendjen SPB-ve që të vepronin me profesionalizëm “sa i takon ndjekjes ligjore të krimeve” dhe (c) “raporte analitike” për mënyrën si po punonin SPB-të e tjera dhe për mënyrën se si duhej të vepronin SPB-të për “të punuar me efikasitet”.²³⁷⁶ Ai shtoi se SPB-ja e tij kishte marrë “shumë telegrame nga Shtabi përmes korrierëve, ku jepeshin edhe detyrat në lidhje me mënyrën si duheshin trajtuar civilët”.²³⁷⁷

955. Krahas kësaj, Adamoviqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së lëshoi urdhra konkretë drejtuar njësitë organizative “për t’i orientuar me një procedurë konkrete apo për të marrë masa parandaluese dhe për të parandaluar llojet e ndryshme të abuzimit”.²³⁷⁸ Sipas tij, objektivi i këtyre

²³⁶⁹ Dushko Adamoviç, T. 25087–25088 (9 prill 2008), 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 29.

²³⁷⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8145 (8 dhjetor 2006).

²³⁷¹ Miroslav Mijatoviç, T. 22210–22213 (12 shkurt 2008); Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 39.

²³⁷² Dushan Gavraniç, T. 22747 (19 shkurt 2008).

²³⁷³ Dushan Gavraniç, T. 22747 (19 shkurt 2008).

²³⁷⁴ Dushan Gavraniç, T. 22655 (18 shkurt 2008).

²³⁷⁵ Dushan Gavraniç, T. 22655 (18 shkurt 2008).

²³⁷⁶ Dushan Gavraniç, T. 22755 (19 shkurt 2008).

²³⁷⁷ Dushan Gavraniç, T. 22755–22756 (19 shkurt 2008).

²³⁷⁸ Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 46.

urdhrave ishte zvogëlimi i numrit të incidenteve dhe i veprimtarive të paautorizuara në terren.²³⁷⁹

Ai theksoi se telegramet nga Shtabi i MPB-së “nuk përmbanin urdhra lidhur me operacione apo urdhra se si duhej të vepronte [një njësi e MPB-së]”. Shtabi i MPB-së thjesht “theksonte se i duhej kushtuar vëmendje e veçantë një elementi të caktuar të detyrës”.²³⁸⁰

956. Bozhidar Filiqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së ishte “një lloj organi pune pararojë i ministrisë, i cili duhej t’i ndihmonte SPB-të në Kosovë në disa situata që qenë të ndërlikuara nga ana e sigurisë”.²³⁸¹

957. Gjithashtu Mbrojtja e Llukiqit argumenton se Shtabi i MPB-së nuk kishte kompetencë urdhëruese mbi njësitë e PJP-së të angazhuara në Kosovë, duke qenë se PJP-ja kishte një hierarki komanduese të veçantë, që kalonte nga ministri i Brendshëm te komandanti i njësive të PJP-së, Obrad Stevanoviqi dhe, më tej, te vetë njësitë e PJP-së.²³⁸² Për më tepër, SAJ-ja ishte një njësi e mëvetshme, e cila përbënte një njësi të veçantë organizative e MPB-së që kishte lidhje të drejtpërdrejta me RJB-në. Kjo njësi ishte në vartësi të komandantit të SAJ-së në Beograd, Zhivko Trajkoviqit.²³⁸³ Më tej, Mbrojtja parashtron se, pavarësisht nga fakti që vendimi i datës 16 qershor 1998 për krijimin e Shtabit të MPB-të e cilëson Trajkoviqin si anëtar, ai nuk punoi kurrë si i tillë.²³⁸⁴

958. Adamoviqi pretendoi se roli i Shtabit të MPB-së në drejtim të njësive të luftimit të dislokuara në Kosovë ishte kryesisht logjistik. Ai shpjegoi se Shtabi i MPB-së mbikëqyrte mbërritjen, largimin dhe vendosjen e njësive të PJP-së në Kosovë dhe u jepte atyre mbështetje logjistike, si, për shembull, armë, municione, lëndë djegëse dhe automjete.²³⁸⁵ Ai bëri edhe një përmbledhje të detyrave të Shtabit të MPB-së, duke thënë se ky shtab ishte përgjegjës për përpilimin e informacionit për situatën e sigurisë së Kosovë, mbi bazën e raporteve të marra nga SPB-të, dhënien e mbështetjes logjistike njësive të dërguara në Kosovë, dhënien e ndihmës në stërvitjen e njësive të PJP-së, organizimin e mbledhjeve kur në Kosovë vinte ministri i Brendshëm, mbajtjen e kontakteve me organizatat ndërkombëtare me qendër në Prishtinë, për të siguruar vënien në jetë të marrëveshjeve ndërkombëtare, dhënien e urdhrave njësive organizative, vetëm për t’i orientuar për procedura të caktuara apo për të parandaluar abuzimet dhe përcjelljen e pjesëve të hartave të Korpusit të Prishtinës për kryerjen e “operacioneve antiterroriste” të përbashkëta UJ-

²³⁷⁹ Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 46.

²³⁸⁰ Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 46.

²³⁸¹ Bozhidar Filiq, T. 23986 (10 mars 2008).

²³⁸² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 391–409.

²³⁸³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 410–415.

²³⁸⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 753–755.

²³⁸⁵ Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 28.

MPB.²³⁸⁶ Lubivoje Joksiqi, i cili ishte ndihmëskoordinator i qendrave të RDB-së në Kosovë, e mbështeti pohimin e Adamoviqit se Shtabi ishte përfshirë në stërvitjen e PJP-së, kur dëshmoi se në vitin 1999 Goran Radosavleviqi (ndryshe i njohur me emrin Guri) ishte anëtar i Shtabit të MPB-së, i ngarkuar me detyrën e stërvitjes së njësive të MPB-së.²³⁸⁷

959. Detashmenti i 35-të dhe 85-të i PJP-së iu atashuan SPB-së së Mitrovicës gjatë fushatës së NATO-s dhe Cvetiqi, ish-shefi i SPB-së, dëshmoi për angazhimin e tyre në Kosovë.²³⁸⁸ Cvetiqi u pajtua me sugjerimin që iu bë se PJP-ja kishte hierarkinë e vet komanduese.²³⁸⁹ Mirëpo, sipas Cvetiqit, edhe pse asnjë prej rregulloreve që orientonte punën e MPB-së nuk u ndryshua pas krijimit të Shtabit të MPB-së,²³⁹⁰ në praktikë detashmentet e PJP-së të angazhuara në Kosovë “manovronin forcat dhe qenë nën urdhrat e Shtabit të MPB-së”.²³⁹¹ Pyetjes nëse Shtabi i MPB-së i jepte apo nuk i jepte direktiva PJP-së pas angazhimit të tyre në operacione luftimi, Cvetiqi iu përgjigj se “angazhimi i PJP-së bëhej në nivel ministrie ... dhe urdhrat i jepeshin njësisë përmes shtabit të MPB-së në Prishtinë,”²³⁹² dhe vijoi se Shtabi i MPB-së nuk bënte thjesht një përcjellje të urdhrave nga Ministria, por merrte pjesë në planifikimin e mënyrës së përdorimit të PJP-së në operacionet “antiterroriste”.

960. Cvetiqi dëshmoi më tej për rolin e Shtabit të MPB-së në hierarkinë komanduese të SAJ-së. Ai shpjegoi se Shtabi i MPB-së “nuk kishte kompetencë për të marrë vendime lidhur me përdorimin e njësive antiterroriste, por nëse merrej një vendim i tillë, shtabi i MPB-së mund t’u jepte urdhra këtyre njësive”.²³⁹³ Mirëpo, ai theksoi se “komandanti i kësaj njësie komandonte drejtpërsëdrejti në terren”.²³⁹⁴ Filiqi shpjegoi se “SAJ ishte një njësi organizative e veçantë e ministrisë”, e cila “për vite të tëra ... kishte qenë në vartësi të drejtpërdrejtë të komandës së SAJ-së në Beograd”.²³⁹⁵ Radovan Vuçureviqi dhe Millosh Vojnoviqi dëshmuar se Zhivko Trajkoviqi, komandanti i njësive të SAJ-së, nuk ishte anëtar i Shtabit të MPB-së, megjithëse përmendej si i tillë në vendimin e datës 16 qershor 1998.²³⁹⁶ Dhoma nuk e pranon dëshminë e Vuçureviqit dhe Vojnoviqit për këtë çështje. Ajo arrin në përfundimin se Vuçureviqi ishte dëshmitar i pabesueshëm,

²³⁸⁶ Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 25, 46.

²³⁸⁷ Lubivoje Joksiq, T. 21949 (8 shkurt 2008), T. 22025 (11 shkurt 2008); *shih* 6D1045 (Vendim mbi caktimin e Goran Radosavleviqit në Shtabin e MPB-së, 30 maj 1999).

²³⁸⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8158–8159 (8 dhjetor 2006).

²³⁸⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8158 (8 dhjetor 2006).

²³⁹⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8145 (8 dhjetor 2006).

²³⁹¹ Lubinko Cvetiq, T. 8034 (7 dhjetor 2006).

²³⁹² Lubinko Cvetiq, T. 8074–8075 (7 dhjetor 2006).

²³⁹³ Lubinko Cvetiq, T. 8073 (7 dhjetor 2006).

²³⁹⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8074 (7 dhjetor 2006).

²³⁹⁵ Bozhidar Fliq, T. 23929 (10 mars 2008); *shih edhe* 6D1355 (Vendim për krijimin e Njësive Speciale Antiterroriste, 5 prill 1999).

²³⁹⁶ Radovan Vuçureviqi, T. 23056 (22 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24148 (12 mars 2008).

i cili, gjatë dëshmisë së tij, nuk iu përgjigj pyetjeve në mënyrë të sigurtë dhe të hapur dhe nuk i përmbushi kushtet e betimit solemn që bëri për të thënë të vërtetën. Gjithashtu Dhoma konkludon se Vojnoviqi e teproi duke u shtirur naiv disa herë gjatë dëshmisë së tij, për shembull kur tha se për vrasjet brenda familjes Berisha kishte dëgjuar vetëm disa vjet pas incidentit, edhe pse ai ishte shefi i SPB-së në Prizren. Sikurse është theksuar në Kapitullin VII, Dhoma është e bindur se shefi i SPB-së së Prizrenit ishte në dijeni të këtyre vrasjeve në kohën kur ndodhën, ose menjëherë më pas.

961. Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi shpjegoi se “detyra e Shtabit ishte bashkërendimi i punës së njërive [policore] dhe në këtë pjesë ... njësitë e posaçme policore kishin përgjegjësi të dyfishtë: para komandantit dhe, në të njëjtën kohë, para ... vetë Shtabit.”²³⁹⁷ Më pas, pyetjes se kush u jepte udhëzime njërive të PJP-së, Llukiqi iu përgjigj se “nga mesi i muajit korrik deri në fund të muajit shtator ose fillim të muajit tetor [1998], kreu i Drejtorisë, zoti Gjorgjeviq dhe Obrad Stevanoviqi, ndihmësministër dhe komandant i njërive të posaçme, ishin me të vazhdimisht në Prishtinë”.²³⁹⁸ Ai theksoi se Gjorgjeviq dhe Stevanoviqi ishin “padyshim mbi kreun e Shtabit”.²³⁹⁹ Adamoviqi konfirmoi se Gjorgjeviq dhe Stevanoviqi ishin të pranishëm në Kosovë në vitin 1998: ai përcaktoi se ata shpesh shkonin në pikat ku ndodheshin njësitë, ndërsa personeli i Shtabit të MPB-së rrallë shkonte në terren.²⁴⁰⁰

962. K25, ish-anëtar i PJP-së, dëshmoi se dihej “nga të gjithë” se “të gjitha njësitë e MPB-së në Kosovë ishin nën urdhrat e zyrës së MPB-së në Prishtinë”, dhe se Llukiqi ishte komandanti i të gjitha forcave të MPB-së në Kosovë.²⁴⁰¹ K25 tha më tej se kur zhvilloheshin operacione në Kosovë “shpërndarja e njërive dhe inventarit të MPB-së vendosej nga [Llukiqi] dhe zyra e tij”. Përdorimi i termit “zyrë e MPB-së” për Shtabin e MPB-së tregon se ai kishte rol të përgjithshëm komandues në Kosovë, por gjatë pyetjeve nga Mbrotjtja, K25 pranoi se ai vetë nuk kishte dijeni të drejtpërdrejtë të funksionimit të Shtabit të MPB-së dhe se nuk e kishte takuar asnjëherë Llukiqin.²⁴⁰²

(B) Pushteti i Shtabit të MPB-së mbi njësitë e RDB-së

963. Krahas pretendimit për kompetencës urdhëruese mbi njësitë e MPB-së që ishin pjesë e RJB-së, Prokuroria parashtron se, prej 16 qershorit 1998, Shtabi i MPB-së “u zgjerua për t’i përfshirë të dyja drejtoritë e MPB-së në Kosovë”, pra RJB-në dhe RDB-në, dhe prej asaj kohe ky Shtab kishte

²³⁹⁷ P948 (intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 41.

²³⁹⁸ P948 intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 41; *shih edhe* Dushko Adamoviç, T. 25069 (10 prill 2008).

²³⁹⁹ P948 (intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 42.

²⁴⁰⁰ Dushko Adamoviç, T. 25081 (10 prill 2008).

²⁴⁰¹ K25, P2439 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 shtator 2001), f. 20.

²⁴⁰² K25, T. 4729–4730 (12 tetor 2006).

“pushtet mbi të dyja drejtoritë e MPB-së në Kosovë”.²⁴⁰³ Sipas Prokurorisë, ky pushtet i mundësoi Shtabit të MPB-së të bashkërendonte punën e të gjitha njësive speciale, përfshirë edhe JSO-në.²⁴⁰⁴

964. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se RDB-ja ishte një njësi e mëvetshme brenda MPB-së, që kishte një strukturë të plotë dhe të pandërprerë komandimi, në të cilën nuk bënte pjesë Shtabi i MPB-së.²⁴⁰⁵ Më tej, Mbrojtja argumenton se JSO-ja u krijua dhe ekzistonte në bazë të Rregullores së Organizimit të Brendshëm të RDB-së, si një organ i veçantë brenda RDB-së.²⁴⁰⁶ Baza e JSO-së në Kosovë ndodhej pranë Mitrovicës dhe kishte një komandant njësie i cili varej drejtpërsëdrejti nga shefi i RDB-së, që ishte i vetmi person i cili mund t'i jepte urdhra kësaj njësie. Mbrojtja e Llukiqit mbështetet në dëshmitë e dëshmitarëve se përbërja e Shtabit të MPB-së, sikurse jepet në vendimin e datës 16 qershor 1998, nuk e pasqyronte me saktësi realitetin në Kosovë gjatë periudhës që mbulon Aktakuza. Ajo argumenton se “provat nuk e mbështesin përfundimin se [vendimi i datës 16 qershor 1998 për krijimin e Shtabit të MPB-së] u zbatua zyrtarisht në terren, sa i takon personelit”.²⁴⁰⁷

965. Sipas vendimit të datës 16 qershor 1998, Shtabi i MPB-së përfshinte anëtarë të RDB-së, krahas anëtarëve të RJB-së. David Gajiqi, koordinatori i qendrës së RDB-së në Prishtinë, përmendej si zëvendësshef i Shtabit, ndërsa Millorad Ullemek Llukoviqi (i njohur ndryshe si Legjia), komandanti i JSO-së, ishte përcaktuar si Ndihmësshef i Shtabit për Operacionet.²⁴⁰⁸ Gjithashtu, në paragrafin 1 të vendimit shkruhej se “Shtabi i zgjeruar” do të përfshinte edhe “shëfat e sekretariateve të punëve të brendshme, qendrave dhe degëve të RDB-së në Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë”.²⁴⁰⁹

966. Lubivoje Joksiqi dëshmoi se RDB-ja ishte një organ tërësisht autonom dhe askush prej anëtarëve të saj në Kosovë nuk ishte në vartësi të Shtabit të MPB-së.²⁴¹⁰ Mirëpo, organet e RDB-së në Kosovë bashkëpunonin me SPB-të e Kosovës në punën e tyre për të luftuar “terrorizmin” dhe shkëmbenin informata.²⁴¹¹ Në veçanti, Joksiqi theksoi se

²⁴⁰³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 209.

²⁴⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 209.

²⁴⁰⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 436–448, 736–741.

²⁴⁰⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 445–448.

²⁴⁰⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 755.

²⁴⁰⁸ P1505 (Vendim mbi krijimin e një Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

²⁴⁰⁹ P1505 (Vendim mbi krijimin e një Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

²⁴¹⁰ Lubivoje Joksiq, T. 21945–21946 (8 shkurt 2008). Ai shtoi se askush nga RDB-ja nuk ishte në varësi të Shtabit të MPB-së në Prishtinë, apo t'i ketë raportuar këtij Shtabi. Lubivoje Joksiq, T. 21945–21946 (8 shkurt 2008), T. 22019–22023, 22025–22026 (11 shkurt 2008).

²⁴¹¹ Lubivoje Joksiq, T. 21946 (8 shkurt 2008).

në tërësinë e vet, administrimi i [RDB-së] dhe raportimi bëhej vetëm brendapërbrenda vetë [RDB-së]... Askush prej [RJB-së] nuk ishte i ngarkuar me detyrën për të bërë diçka apo për të dhënë urdhra në [RDB]. Çdo gjë kalonte nga shefi te personat me grada më të ulëta brenda [RDB-së] dhe jo jashtë saj.²⁴¹²

Ai tha gjithashtu se David Gajiqi dhe Millorad Ullemek Llukoviqi (i njohur ndryshe si Legija) nuk qenë asnjëherë anëtarë të Shtabit të MPB-së.²⁴¹³ Joksiqi dëshmoi më tej se në vitin 1998 dhe 1999 JSO ishte në varësi të drejtpërdrejtë të shefit të RDB-së. Vetëm shefi i RDB-së mund ta përdorte këtë njësi dhe t'i jepte urdhra.²⁴¹⁴

967. Edhe Cvetiqi deklaroi se, mesa dinte ai, Shtabi i MPB-së nuk kishte kompetencë urdhëruese mbi JSO-në dhe se ai nuk kishte asnjë dijeni nëse pas dislokimit në Kosovë, JSO-ja merrte apo nuk merrte detyra ose udhëzime nga Shtabi i MPB-së.²⁴¹⁵

968. Si Mijatoviqi, po ashtu dhe Adamoviqi mohuan që David Gajiqi dhe Millorad Ullemek Llukoviqi (i njohur ndryshe si Legija) kishin qenë anëtarë të Shtabit të MPB-së.²⁴¹⁶ Mijatoviqi tha se shefat e qendrave të RDB-së në Kosovë, edhe pse të përmendur si anëtarë të Shtabit të zgjeruar të MPB-së, nuk kishin kryer asnjëherë asnjë detyrë për Shtabin. Gjithsesi, ai pranoi se ata vinin në mbledhjet e Shtabit të MPB-së kur Prishtinën e vizitonte ministri i Brendshëm ose ndihmësit e tij.²⁴¹⁷

969. Pyetjes se çfarë posti kishte David Gajiqi, Millan Gjakoviqi iu përgjigj se, mesa dinte, ai ishte “njëri prej ndihmëshefave” të RDB-së.²⁴¹⁸ Gjakoviqi nuk e cilësoi Gajiqin si zëvendës shef të Shtabit të MPB-së dhe dëshmoi se UJ-ja merrte informacion drejtpërsëdrejti nga RDB-ja, dhe jo përmes Shtabit të MPB-së.²⁴¹⁹

(C) Roli i Shtabit të MPB-së në planifikimin e operacioneve

970. Në mbështetje të pretendimit të Prokurorisë se Shtabi i MPB-së ishte përgjegjës për planifikimin dhe organizimin e operacioneve të njësisve të MPB-së në Kosovë, Cvetiqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së miratonte planet për përdorimin e njësisve të PJP-së dhe njësisve të tjera të MPB-së

²⁴¹² Lubivoje Joksiq, T. 21941–21942 (8 shkurt 2008).

²⁴¹³ Lubivoje Joksiq, T. 21945–21946 (8 shkurt 2008).

²⁴¹⁴ Lubivoje Joksiq, T. 21950–21951 (8 shkurt 2008).

²⁴¹⁵ Lubinko Cvetiq, T. 8034, 8037 (6 dhjetor 2006).

²⁴¹⁶ Miroslav Mijatoviqi, T. 22167–22172, 22176, 22177–22180 (12 shkurt 2008); Dushko Adamoviqi, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 7–9, 13.

²⁴¹⁷ Miroslav Mijatoviqi, T. 22179–22180 (12 shkurt 2008).

²⁴¹⁸ Millan Gjakoviqi, T. 26370 (19 maj 2008).

²⁴¹⁹ Millan Gjakoviqi, T. 26428, 26430 (19 maj 2008) (ku dëshmon se Stojanoviqi “mund t’i kontaktonte lirisht organet e sigurimit të shtetit dhe organet e MPB-së në lidhje me probleme konkrete që kishin të bënin me sigurinë”, dhe ku vijon se ai “merrte raporte nga MPB-ja dhe sigurimi i shtetit.”).

në luftën kundër terrorizmit.²⁴²⁰ Ai shtoi se këto plane përcaktonin “detyrat bazë dhe vendet në të cilat do të angazhoheshin këto njësi”.²⁴²¹ Rrjedhimisht, sipas Cvetiqit Shtabi i MPB-së kishte një rol qendror në planifikimin e përdorimit të njësive konkrete të MPB-së në Kosovë për vënien në zbatim të planit të përgjithshëm “kundër terrorizmit”, pas marrjes së vendimeve në Beograd për përdorimin e këtyre njësive në Kosovë.

971. Mbrojtja e Llukiqit përpiqet ta rrëzojë pretendimin e Prokurorisë duke u mbështetur në dëshmitë në sallë të gjyqit të disa dëshmitarëve të cilët thanë se SPB-të miratonin planet e tyre vjetore të punës, të cilat as nuk shqyrtoheshin, e as nuk miratoheshin nga Shtabi i MPB-së.²⁴²² Më tej, Mbrojtja argumenton se Korpusi i Prishtinës përgatiste “urdhra dhe hartat e vendimeve për operacione të veçanta të cilat përfshinin edhe detyrat për njësitë e përcaktuara të UJ-së dhe MPB-së” dhe se “Shtabi i MPB-së nuk përgatiste harta dhe as nuk jepte urdhra”.²⁴²³ Mbrojtja parashtron, gjithashtu, se në vitin 1998, Shtabi i MPB-së luajti një “rol minimal ... në përgatitjen e planit me pesë faza të UJ-së”.²⁴²⁴ Roli i Shtabit ishte “thjesht të jepte informacion se cilat njësi të PJP-së ishin në dispozicion për një operacion konkret” si edhe të vepronte “si korrier për dërgimin e ekstrakteve të hartave nga Korpusi i Prishtinës komandantëve të detashmenteve të PJP-së”.²⁴²⁵ Me fjalë të tjera, Shtabi i MPB-së ishte një “kuti postare për komunikimet”.²⁴²⁶

972. Dhoma konkludon se, edhe pse ka të ngjarë që SPB-të të kenë miratuar planet e tyre të punës, këto plane kishin të bënin me veprimtari të rregullta të SPB-ve, dhe jo me veprimtaritë e luftës kundër “terrorizmit”. Faktikisht, Mijatoviçi shpjegoi se plane të tilla kishin të bënin me çështjet e përditshme administrative të të gjitha SPB-ve anembanë Serbisë, dhe jo vetëm në Kosovë,²⁴²⁷ çka nuk bie ndesh me faktin se Shtabi i MPB-së ishte përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe miratimin e veprimtarive “antiterroriste” në Kosovë.

973. Lidhur me rolin e Shtabit të MPB-së në planifikimin e veprimeve të përbashkëta me UJ-në, Gjakoviçi dëshmoi se në vitin 1998 Adamoviçi i jepte informacion për numrin e efektivave dhe vendndodhjen e njësive të MPB-së në Kosovë dhe se ata bashkëpunuan në hartimin e planeve për operacionet “antiterroriste”. Pas nxjerrjes së urdhrave nga Komanda e Korpusit të Prishtinës,

²⁴²⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8074–8075 (7 dhjetor 2006).

²⁴²¹ Lubinko Cvetiq, T. 8075 (7 dhjetor 2006).

²⁴²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 425–426; Miroslav Mijatoviçi, T. 22204–22205 (12 shkurt 2008); Dushan Gavranici, T. 22652–22655 (18 shkurt 2008); Bozhidar Filiq, T. 23922–23923 (7 mars 2008).

²⁴²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 508, 510.

²⁴²⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 770.

²⁴²⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 509.

²⁴²⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 773.

²⁴²⁷ Miroslav Mijatoviçi, T. 2203–22204 (12 shkurt 2008).

ekstrakte të këtyre vendimeve dhe hartave shoqëruese që lidheshin me MPB-në i jepeshin Shtabit të MPB-së “në mënyrë që ky të mund të bashkërendonte gjërat brenda kompetencës së vet”.²⁴²⁸ Ekstraktet e hartave që kishin të bënin me njësitë e MPB-së, përdorshin nga komandantët e PJP-së për “të bërë vlerësimet e tyre dhe për të marrë vendimet e tyre në përputhje me situatën faktike.”²⁴²⁹

974. Adamoviqi konfirmoi se urdhrat me shkrim ku njësitë e MPB-së orientoheshin për kryerjen e një operacioni të caktuar, përpiloheshin nga Korpusi i Prishtinës.²⁴³⁰ Ai u pajtua me sugjerimin se urdhrat përgatiteshin duke u bazuar në informacionin mbi gatishmërinë e njësisve të MPB-së, i cili merrej nga Shtabi i MPB-së,²⁴³¹ dhe shpjegoi se ai kishte detyrë që këtë informacion t’ia kalonte Korpusit të Prishtinës përmes Gjakoviqit.²⁴³² Ai shtoi se, nëse Korpusi i Prishtinës “kishte planifikuar më shumë forca, atëherë [ai dhe Gjakoviqi] shqyrtonin se kush tjetër mund të përfshihej”.²⁴³³ Mirëpo, Adamoviqi nuk pranoi që ai apo Shtabi i MPB-së të kishte luajtur rol në formulimin e planeve të cilat vinin në jetë këto urdhra apo që ai të kishte dhënë ndonjë kontribut në përgatitjen e hartave të operacioneve.²⁴³⁴ Nga ana tjetër, Gjakoviqi dëshmoi se ai nuk mund t’i planifikonte operacionet e përbashkëta MPB-UJ dhe nuk mund t’i përgatiste hartat përkatëse pa ndihmën e Adamoviqit.²⁴³⁵ Dhoma e konsideron dëshminë e Gjakoviqit më të besueshme në lidhje me këtë çështje, duke qenë se në disa raste ka konstatuar se Adamoviqi u bëri bisht pyetjeve. Megjithatë, në ato pika ku dëshmia e tij nuk është e debatueshme apo kur kjo dëshmi mbështetet nga prova të tjera të besueshme, Dhoma e ka pranuar versionin e Adamoviqit.

975. Adamoviqi shpjegoi më tej se ai “i mernte ekstraktet e hartave dhe ua shpërndante oficerëve në terren”.²⁴³⁶ Sipas tij, përpara shpërndarjes së ekstrakteve të hartave komandantëve të PJP-së dhe përpara kryerjes së operacioneve “antiterroriste”, zhvilloheshin mbledhje në Shtabin e MPB-së, gjatë të cilave “diskutohej plani për kryerjen e operacioneve antiterroriste me UJ-në dhe policinë. Kjo përbënte bazën për veprim të mëtejshëm nga ana e të gjithë oficerëve që qenë shpërndarë më parë në terren dhe që qenë angazhuar për këtë”.²⁴³⁷ Ai shtoi se këto mbledhje zakonisht zhvilloheshin në Shtabin e MPB-së dhe në to merrnin pjesë komandantët e detashmenteve të PJP-së

²⁴²⁸ Millan Gjakoviq, T. 26393–26394 (19 maj 2008).

²⁴²⁹ Millan Gjakoviq, T. 26397–26398 (19 maj 2008).

²⁴³⁰ Dushko Adamoviq, T. 24973–24979 (8 prill 2008); *shih* P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999) (ku njësitë e UJ-së urdhërohen që “të bashkërendojnë veprimet me forcat e MPB-së”).

²⁴³¹ Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 28; *shih edhe Dushko Adamoviq, T. 24978* (8 prill 2008) (ku dëshmon se “ishite në kontakt me përfaqësuesit e Korpusit të Prishtinës”).

²⁴³² Dushko Adamoviq, T. 25067, 25071 (9 prill 2008).

²⁴³³ Dushko Adamoviq, T. 25067 (9 prill 2008).

²⁴³⁴ Dushko Adamoviq, T. 25097 (10 prill 2008).

²⁴³⁵ Millan Gjakoviq, T. 26397 (19 maj 2008).

²⁴³⁶ Dushko Adamoviq, T. 24978 (8 prill 2008); *shih edhe Dushko Adamoviq, T. 24971* (8 prill 2008) (“I merrja këto ekstrakte dhe ua jepja komandantëve.”), 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 25.

²⁴³⁷ Dushko Adamoviq, T. 24975 (8 prill 2008).

dhe shefat e sekretariateve. Gjatë këtyre mbledhjeve “të gjithë pjesëmarrësit njiheshin me planin për kryerjen e operacioneve antiterroriste”.²⁴³⁸ Ai përfundoi duke thënë se “bëhej një mbledhje me komandantët e detashmenteve dhe shefave të SPB-ve ku ndihmësministrat, gjeneralët—domethënë, gjeneral Gjorgjeviqi dhe gjeneral Obrad Stevanoviqi—i udhëzonin oficerët për detyrat e ardhshme”.²⁴³⁹ Pas përfundimit të një operacioni, komandantët e PJP-së, ose SPB-të përkatëse të tyre informonin Shtabin e MPB-së.²⁴⁴⁰ Mijatoviqi dëshmoi se “Shtabi u dërgonte njësitë të përfshira në këto veprimtari [hartën për operacionet “antiterroriste” që Korpusi i Prishtinës ia kishte dërguar Shtabit të MPB-së]”.²⁴⁴¹

(D) Raportimi në Shtabin e MPB-së

976. Disa dëshmitarë dëshmuar se SPB-të i raportonin rregullisht Shtabit të MPB-së.²⁴⁴² Për shembull, Cvetiqi dëshmoi se “çdo mëngjes, secili prej shefave të SPB-së duhej t’i telefononte shefit të Shtabit të MPB-së në Prishtinë” dhe t’i raportonte “për ngjarjet më të fundit”.²⁴⁴³ Ai tha edhe se një urdhër i Shtabit të MPB-së për SPB-të e Kosovës, i datës 21 tetor 1998, “përcaktonte metodikën e njëtrajtshme që duhej përdorur nga të gjithë sekretariatet” për informimin e Shtabit të MPB-së.²⁴⁴⁴ Sipas kësaj metode, raportet duhej të përmbanin informacion të hollësishëm, ndër të tjera, lidhur me “aksionet terroriste”; “operacionet policore të realizuara”; “lëvizjen e njësitë policore drejt Kosovës, nga Kosova dhe brenda Kosovës”.²⁴⁴⁵ Bogunoviqi tha se SPB-të në të cilat kishte punuar i raportonin Shtabit të MPB-së për incidentet e përditshme që kishin të bënin me sigurinë në zonën e tyre të përgjegjësisë. Mirëpo, duke rënë disi në kundërshti me çfarë kishte deklaruar vetë, ai shtoi se Shtabit të MPB-së nuk i kaloheshin raportet periodike të SPB-ve, por vetëm raportet urgjente.²⁴⁴⁶ Bogunoviqi tha gjithashtu se ai nuk dinte për çfarë qëllimi ekzistonte Shtabi i MPB-së dhe se nuk kishte asnjë informacion për këtë.²⁴⁴⁷ Dhoma arrin në përfundimin se ky pretendim nuk është i besueshëm dhe gjykon se kjo e komprometon dëshminë e këtij dëshmitari në lidhje me Shtabin e MPB-së, të cilën Dhoma nuk e pranon.

²⁴³⁸ Dushko Adamoviç, T. 24977 (8 prill 2008).

²⁴³⁹ Dushko Adamoviç, T. 24977 (8 prill 2008).

²⁴⁴⁰ Dushko Adamoviç, T. 25074–25078 (9 prill 2008).

²⁴⁴¹ Miroslav Mijatoviç, T. 22443–22444 (14 shkurt 2008).

²⁴⁴² Lubinko Cvetiq, T. 8045 (7 dhjetor 2006); Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 21. Dushan Gavranic, T. 22640–22641 (18 shkurt 2008); Nebojsa Bogunoviç 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 prill 2008), para. 4; Miroslav Mijatoviç, T. 22328–22329 (12 shkurt 2008);

²⁴⁴³ Lubinko Cvetiq, T. 8083–8084 (7 dhjetor 2006).

²⁴⁴⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8097–8098 (7 dhjetor 2006); *shih* P2528 (Urdhër për Shefat e SPB-ve të Kosovës, dhënë nga Sreten Llukiqi, 21 tetor 1998).

²⁴⁴⁵ Lubinko Cvetiq, T. 8097–8098 (7 dhjetor 2006); P2528 (Urdhër për Shefat e SPB-ve të Kosovës, dhënë nga Sreten Llukiqi, 21 tetor 1998).

²⁴⁴⁶ Nebojsa Bogunoviç 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 prill 2008), para. 4.

²⁴⁴⁷ Nebojsa Bogunoviç, T. 25153–25158 (10 prill 2008).

977. Adamoviqi shpjegoi se SPB-të i raportonin Shtabit të MPB-së krahas selisë qendrore të MPB-së në Beograd, duke qenë se Shtabi i MPB-së nuk kishte përfaqësues në terren dhe duhej të mbështetej te SPB-të për informacion.²⁴⁴⁸ Shtabi i MPB-së ishte përgjegjës për përpilimin e informacionit mbi situatën e sigurisë së Kosovës, duke u bazuar e raporteve të marra nga SPB-të.²⁴⁴⁹ Gavraniqi shpjegoi se Shtabi i MPB-së kishte një “informacion më të mirë për situatën e përgjithshme në lidhje me të gjitha ato zona për të cilat ka sekretariate”.²⁴⁵⁰

978. Nebojshta Ognjenoviqi konfirmoi se çdo stacion i policisë kufitare përpilonte nota zyrtare për çdo aksion të kryer nga punonjësit e saj dhe për veprimtaritë e pazakonta. Më tej, këto nota zyrtare i dërgoheshin Administratës së Policisë Kufitare në Beograd, si edhe Shtabit të MPB-së.²⁴⁵¹ Gjithashtu, pyetjes nëse stacionet e policisë kufitare merrnin njoftime nga Shtabi i MPB-së në vitin 1999, Ognjenoviqi iu përgjigj se merrnin.²⁴⁵²

979. Sipas 6D2-shit dhe Debelkoviqit, Dega e Policisë për Krime (OKP) i raportonte Administratës së Policisë për Krime (UKP) në Beograd për “incidentet” dhe masat e marra më pas. Raporte të tilla, ndër të tjerë, i dërgoheshin edhe Shtabit të MPB-së dhe shefit të SPB-së përkatëse.²⁴⁵³ Radovan Zllatkoviqi e konfirmoi pohimin e 6D2-shit.²⁴⁵⁴

980. Filiqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së

duhej të monitoronte situatën në territorin e krahinës, të bënte një përmbledhje të rezultateve të këtyre ngjarjeve dhe incidenteve ... ministrit i leverdiste të kishte një organ të tillë dhe të kishte mbi tryezë çdo mëngjes informacion të përmbledhur të incidenteve që kishin të bënin me sigurinë në këtë zonë të krizës dhe jo të merrte shtatë dokumente të ndryshme nga sekretariatet në Kosovë.²⁴⁵⁵

981. Në intervistën me Prokurorinë, Llukiqi tha se në operacionet që përfshinin më shumë sesa njësitë që i përkisnin një SPB-je, komandantët e njërive përkatëse i raportonin Shtabit të MPB-së.²⁴⁵⁶ Edhe Cvetiqi tha se komandantët e njërive që merrnin pjesë në operacione i raportonin Shtabit të MPB-së për aktivitetin e kryer.²⁴⁵⁷ Më tej, ai dëshmoi se “njësitë e manovrave dhe të

²⁴⁴⁸ Dushko Adamoviqi, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 25, 49–50. *Shih edhe* Nebojshta Bogunoviqi 6D1614 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 prill 2008), para. 4.

²⁴⁴⁹ Dushko Adamoviqi, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 25.

²⁴⁵⁰ Dushan Gavraniqi, T. 22656 (18 shkurt 2008).

²⁴⁵¹ Nebojshta Ognjenoviqi, T. 22857 (20 shkurt 2008).

²⁴⁵² Nebojshta Ognjenoviqi, T. 22874–22875 (20 shkurt 2008).

²⁴⁵³ Branislav Debelkoviqi, T. 24258–24262, 24266–24267 (13 mars 2008), 6D1533 (deklaratë e dëshmitarit, datë 11 mars 2008), para. 17; *shih edhe* 6D2, 6D1631 (deklaratë e dëshmitarit, datë 12 prill 2008), para. 20 (nën vulë).

²⁴⁵⁴ Radovan Zllatkoviqi, 6D1627 (deklaratë e dëshmitarit, datë 13 prill 2008), para. 3.

²⁴⁵⁵ Bozhidar Filiqi, T. 23986 (10 mars 2008).

²⁴⁵⁶ P948 (intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 57.

²⁴⁵⁷ Lubinko Cvetiq, T. 8193–8194 (8 dhjetor 2006).

luftimit në terren” kishin detyrimin për të informuar shefin e Shtabit të MPB-së.²⁴⁵⁸ Mirëpo, asnjë raport i tillë nuk u paraqit si provë.

982. Adamoviqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së merrte informacion në lidhje me njësitë e SAJ-së. Mirëpo, dëshmia e tij nuk qartësoi se në çfarë mënyre bëhej. Sipas tij, sekretariatet e informonin Shtabin me të mbaruar aktivitetin.²⁴⁵⁹ Dhoma vëren se dëshmia e Adamoviqit në lidhje me përfshirjen e Shtabit të MPB-së në bashkërendimin midis njësive të MPB-së në terren dhe Shtabit të MPB-së ishte tejet bishtnuese dhe ai nuk pranoi të jepte përgjigje të arsyeshme dhe të logjikshme në lidhje me këtë aspekt. Për shembull, pyetjes së Prokurorisë se nga e dinte ai se cilat njësi të MPB-së qenë të gatshme për operacione të mëtejshme, sidomos duke përmendur një vendim të nxjerrë nga Korpusi i Prishtinës për angazhimin e përbashkët të njësive të UJ-së dhe MPB-së më datë 10 gusht 1998,²⁴⁶⁰ në të cilin duhej të merrnin pjesë edhe forcat e SAJ-së, Adamoviqi la përshtypjen se nuk kishte dëshirë t’i përgjigjej drejtpërsëdrejti. Ai tha: “Nuk kishte asnjë informacion konkret dhe nuk kisha nevojë për një informacion të tillë”; “nuk ishte nevoja për informacion të përditësuar”; “ata [njësia e SAJ-së] mund të kishin qenë ose në bazën e tyre ose në terren duke kryer një aksion”.²⁴⁶¹ Më në fund, ai shpjegoi se, me përfundimin e një veprimtarie në një zonë të caktuar, SPB-të ose oficerët e njësive përkatëse njoftonin për këtë Shtabin.²⁴⁶²

ii. Prova shkresore

(A) 1998

983. Në dallim nga dëshmitë e shumicës së dëshmitarëve, vendimi i datës 16 qershor 1998, i nxjerrë nga Stojilkoviqi, dhe vendimi që ai nxori thuajse pas një viti, në mes të fushatës ajrore të NATO-s (vendim që rikonfirmoi mandatin e Shtabit të MPB-së dhe e ndryshoi paksa përbërjen e tij) tregon se ky shtab përbëhej nga zyrtarë të RJB-së dhe RDB-së dhe se detyra e tij ishte “planifikimi, organizimi dhe administrimi” i punës së “njësive organizative” të MPB-së dhe i çdo njësie tjetër të MPB-së të dërguar në Kosovë, pa u kufizuar vetëm te njësitë që i përkisnin RJB-së.²⁴⁶³ Dokumente të tjera që janë pjesë e provave bëjnë të ditur se Shtabi i MPB-së e përmbushi rolin e tij në praktikë në lidhje me njësitë e RJB-së, pa ndërhyrë në funksionet komanduese të komandantëve të njësive të veçanta dhe pa e ndërprerë hierarkinë normale të raportimit të tyre.

²⁴⁵⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8195 (8 dhjetor 2006).

²⁴⁵⁹ Dushko Adamoviq, T. 25078 (9 prill 2008).

²⁴⁶⁰ *Shih, në përgjithësi*, P1427 (Vendim i Korpusit të Prishtinës, 10 gusht 1998).

²⁴⁶¹ Dushko Adamoviq, T. 25074–25077 (8 prill 2008).

²⁴⁶² Dushko Adamoviq, T. 25076–25078 (8 prill 2008).

²⁴⁶³ P1505 (Vendim mbi krijimin e një Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998); P1811 (Vendim për krijimin e Shtabit të Ministrisë për Shtypjen e Terrorizmit, i datës 31 maj 1999).

984. Për shembull, më 10 korrik 1998, Llukiqi, si shef i Shtabit të MPB-së, i dërgoi një telegram shefit të SPB-së së Mitrovicës, si edhe komandantëve të DPB-ve të Mitrovicës, duke i udhëzuar, ndër të tjera, “të organizonin mbrojtjen e fshatrave me [RPO] të formuara rishtazi dhe për këtë qëllim të ndërtonin fortifikime mbrojtëse”.²⁴⁶⁴ Më 16 korrik 1998, Llukiqi u dërgoi një telegram shefave të gjithë SPB-ve të Kosovës dhe komandantëve të detashmenteve të PJP-së në Kosovë, duke përmendur “neglizhimet e konstatuara në kryerjen e detyrave” dhe jepte udhëzime për kontaktet e MPB-së me përfaqësuesit diplomatikë të huaj dhe anëtarët e organizatave ndërkombëtare. Një prej udhëzimeve të dhëna përmes telegramit ishte se çdo kontakt me diplomatët e huaj apo përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare duhej t’i raportohej Shtabit të MPB-së.²⁴⁶⁵

985. Më 22 korrik 1998, në Prishtinë, u zhvillua një mbledhje ku merrnin pjesë Llukiqi dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të MPB-së dhe Gjorgjeviqi, Stevanoviqi, shefa të SPB-ve dhe të gjithë komandantët e PJP-së.²⁴⁶⁶ Procesverbali i kësaj mbledhjeje bën të ditur se një prej objektivave ishte “përcaktimi i detyrave për zbatimin e Planit Global”, ku duket qartë se bëhet fjalë për Planin kundër Terrorizmit.²⁴⁶⁷

986. Më 28 korrik 1998, Llukiqi drejtoi një mbledhje të Shtabit të MPB-së, ku, ndër të tjerë, merrnin pjesë ministri i Brendshëm, shefi i RDB-së Rade Markoviqi dhe shefat e SPB-ve të Kosovës. Llukiqi u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe u dha një informacion “për masat dhe veprimtaritë e njësisve policore në përputhje me Planin” dhe përshkroi se çfarë aksionesh qenë kryer dhe se cilat detashmente i kishin kryer ato në bashkërendim me UJ-në.²⁴⁶⁸ Llukiqi tha se disa njësi policore nuk kishin dëshirë të angazhoheshin dhe, madje, nuk pranonin t’i kryenin detyrat dhe shtoi se “policët dhe njësitë policore që nuk pranojnë të shkojnë atje ku u ngarkohet si detyrë të shkojnë, nuk do të kthehen në shtëpi edhe sikur të duhet të qëndrojnë [në Kosovë] një muaj. Nuk ka kthim në shtëpi, por në vijën e frontit”.²⁴⁶⁹ Llukiqi shprehu mendimin se policia kishte forca të pamjaftueshme për ta mbajtur territorin e zënë, çka e bënte më të vështirë angazhimin e njësisve operative, dhe shtoi se duheshin edhe dy mijë policë të tjerë, sidomos rezervistë policorë.²⁴⁷⁰

²⁴⁶⁴ P2804 (Telegram i Shtabit të MPB-së drejtuar komandantëve të njësisve organizative të MPB-së në Kosovë, 10 korrik 1998).

²⁴⁶⁵ 6D968 (Telegram i Sreten Llukiqit, 16 korrik 1998).

²⁴⁶⁶ 6D798 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998), f. 1.

²⁴⁶⁷ 6D798 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998). Llukiqi raportoi për vënien në zbatim të Planit Global në mbledhjen e datës 28 korrik 1998, ku merrnin pjesë ministri Stojilkoviç dhe Rade Markoviqi. P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3; *shih edhe* Dushko Adamoviç, T. 25019 (9 prill 2008) (ku e karakterizon si një plan që “ishte miratuar për realizimin e operacioneve antiterroriste në zbatimin e të cilave duhej të merrnin pjesë ushtria dhe policia”).

²⁴⁶⁸ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3.

²⁴⁶⁹ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3.

²⁴⁷⁰ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3.

Stojilkoviqi vërejti se kjo përbënte ndryshim të “Planit kryesor”, gjë të cilën e konfirmoi Llukiqi. Pyetjes së Stojilkoviqit nëse çdo gjë kishte shkuar sipas Planit sa i takon bashkëpunimit me UJ-në, Llukiqi iu përgjigj “jo plotësisht”.²⁴⁷¹

987. Më 7 gusht 1998, Llukiqi u dha urdhër shefave të të gjitha SPB-ve të Kosovës, si edhe komandantëve të PJP-së, të merrnin masa disiplinore kundër oficerëve të policisë të përfshirë në plaçkitje. Ai tha gjithashtu se shefat e SPB-së dhe komandantët e PJP-së qenë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave dhe për parandalimin e ngjarjeve të tilla”.²⁴⁷² Në një telegram të datës 9 gusht 1998, Llukiqi i udhëzonte shefat e SPB-ve të Kosovës që, ndër të tjera, të merrnin në pyetje shqiptarët kosovarë që kërkonin kopje të dokumenteve të tyre të identitetit dhe “të merrnin masa të tjera për t’u siguruar nëse qenë ose nuk qenë përfshirë në aktivitete terroriste”.²⁴⁷³

988. Më 18 tetor 1998 Llukiqi u dërgoi SPB-ve të Kosovës tekstin e marrëveshjes për krijimin e KVM-së dhe u dha udhëzime për masat e nevojshme për të mundësuar zbatimin e saj.²⁴⁷⁴ Më 21 tetor ai u dha udhëzime shefave të SPB-ve të Kosovës në lidhje me trajtimin e verifikuesve të KVM-së dhe u dha urdhër të jepnin raporte të hollësishme të përditshme lidhur me aktivitetet policore, aksionet e realizuara dhe kontaktet me KVM-në. Llukiqi theksoi se urdhrat qenë të nevojshëm, po të kihej parasysh “objektivi i zbatimit të njëtrajtshëm të detyrave që rridhnin nga Marrëveshja e Misionit të Verifikimit të OSBE-së për Kosmetin”.²⁴⁷⁵

989. Më 3 nëntor 1998 u zhvillua një mbledhje, e drejtuar nga Llukiqi, me pjesëmarrjen e të gjithë shefave të SPB-së dhe komandantëve të PJP-së. Në të u fol për “situatën aktuale të sigurisë në territorin e çdo sekretariati pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Misionit të Verifikimit të OSBE-së në Kosmet dhe nivelin e gatishmërisë dhe organizimit në lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve në dimër”. Një prej përfundimeve të kësaj mbledhjeje ishte se “automjetet e blinduara dhe armët [e kalibrit të madh] ... nuk duhen lëvizur, angazhuar apo përdorur pa miratimin dhe lejen e Shtabit”. Gjithashtu, SPB-të duhej të informonin “shtabin e MPB-së në Prishtinë për çdo gjë të lidhur me terrorizmin”. Konkluzioni i fundit ishte se “Që këtej e tutje, Shtabi i MPB-së në Prishtinë do të marrë rolin e planifikimit dhe Sekretariatet do të kenë një pavarësi më të madhe në realizimin e

²⁴⁷¹ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3–4.

²⁴⁷² 6D768 (Urdhër për shefat e SPB-ve të Kosovës dhe komandantëve të PJP-ve, dhënë nga Sreten Llukiqi, 7 gusht 1998), f. 2.

²⁴⁷³ 6D665 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 9 gusht 1998).

²⁴⁷⁴ 6D690 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 18 tetor 1998).

²⁴⁷⁵ P2528 (Urdhër për shefat e SPB-ve të Kosovës, dhënë nga Sreten Llukiqi, 21 tetor 1998), f. 1.

detyrave dhe detyrimeve të tyre të rregullta nga marrëveshjet e mësipërme, domethënë, Sekretariatet do t'u kthehen kushteve të punës si në kohë paqeje”.²⁴⁷⁶

990. Më 2 dhjetor 1998, Shtabi i MPB-së mbajti një mbledhje më Prishtinë, në të cilën morën pjesë Dushko Adamoviqi, Miroslav Mijatoviqi, Goran Radosavleviqi, anëtarë të tjerë të Shtabit të MPB-së, të gjithë shefat e SPB-ve dhe komandantë të detashmenteve policore speciale. Në rendin e ditës së mbledhjes ishte situata e sigurisë në Kosovë, caktimi i detyrave dhe angazhimit të efektivave policore, vijimi i kryerjes së “operacioneve antiterroriste”, dhe ndërmarrja e “veprimeve më agresive” nga efektivat policorë në përgjigje të situatës të lindur rishtazi.²⁴⁷⁷ Llukiqi i informoi të pranishmit për një mbledhje të mëparshme në të cilën kishte marrë pjesë, në Beograd, më 27 nëntor 1998. Këtë mbledhje të mëparshme e pat drejtuar Vllajko Stojilkoviqi dhe në të kishin marrë pjesë krerët e RJB-së dhe RDB-së, ndihmësministrat dhe Shainoviqi. Llukiqi raportoi se “u bë një vlerësim i situatës në Kosovë” dhe “u përcaktuan detyrat dhe angazhimet e mëtejshme të forcave policore në Kosovë”. Ai shpjegoi se “thelbi i mbledhjes [në Beograd] ishte vijimi i kryerjes së operacioneve antiterroriste me synim shtypjen e terrorizmit në Kosovë dhe se, në këtë aspekt, policia do të jetë më agresive gjatë marrjes së masave në situatën e lindur rishtazi”.²⁴⁷⁸ Pas këtij informimi dhe pasi u dëgjuan raportimet e shefave të SPB-ve për “situatën aktuale të sigurisë”, Llukiqi renditi detyrat e ardhshme.²⁴⁷⁹ Gjithashtu, ai i udhëzoi të pranishmit që brenda datës 7 dhjetor 1998, të dorëzonin “një plan për parandalimin e terrorizmit”.²⁴⁸⁰ Ai kërkoi që informacioni dhe raportet t'i paraqiteshin Shtabit të MPB-së në kohë dhe që këto informacione dhe raporte të ishin “realiste, përmes raportimit të menjëhershëm me telefon të ngjarjeve më të rëndësishme dhe më pas përmes dërgimit të një raporti të shkurtër për incidentin”.²⁴⁸¹

991. Dhoma vëren se, në mbledhjen e datës 2 dhjetor 1998, Llukiqi dha udhëzime të përgjithësuara, çka pritet nga një person i cili ka komandën tërësore dhe urdhëroi dorëzimin e një plani për parandalimin e terrorizmit. Ndër të tjera, ai tha se ishte i nevojshëm “parandalimi i armatosjes, stërvitjes dhe organizimit të mëtejshëm të ... terroristëve” dhe “rritja e agresivitetit në punë”. Më tej, për arsye sigurie ai udhëzoi që të dërgoheshin dy automjete për operacione kontrolli në terren.²⁴⁸² Vlen të përmendet, gjithashtu, se edhe pse Llukiqi i udhëzoi personat e pranishëm të merrnin masa të ndryshme, ai nuk i përcaktoi këto masa. Për shembull, ai i udhëzoi të pranishmit të merrnin “masa për praninë e një numri të madh policësh në të gjitha sekretariatet dhe pajisjen dhe

²⁴⁷⁶ P3130 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 3 nëntor 1998), f. 3.

²⁴⁷⁷ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 2–3.

²⁴⁷⁸ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 3.

²⁴⁷⁹ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7–8.

²⁴⁸⁰ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 8.

²⁴⁸¹ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7.

armatosjen e tyre” dhe theksoi se “MPB-ja ishte përgjegjëse për këtë pjesë të punës”.²⁴⁸³ Më pas, ai i udhëzoi të pranishmit të merrnin “të gjitha masat për parandalimin e futjes së armëve nga Republika e Shqipërisë dhe Maqedonia, si edhe për mbajtjen në kontroll të rrugëve nga Republika e Serbisë”. Gjithsesi, ai theksoi se këto masa duheshin marrë “në marrëveshje me Ushtrinë Jugosllave dhe RDB-në”.²⁴⁸⁴ Gjithashtu Llukiqi kujtoi se komandantët e detashmenteve qenë anëtarë të “Kolegjiumit të shefit të SPB-së dhe duhej të lidheshin përditë me shefin e SPB-së për qëllime pune dhe kontrolli”.²⁴⁸⁵

992. Në të njëjtën mbledhje, Cvetiqi u ankua se ai nuk merrte informacionin e duhur nga RDB-ja “për planifikimin dhe harmonizimin e veprimeve në përputhje me këtë informacion”.²⁴⁸⁶ Më vonë, Llukiqi tha se “duhen dërguar patrulla të përbashkëta, të përbëra nga policë dhe anëtarë të RDB-së dhe RJB-së të veshur civil” për të mbajtur nën kontroll qytetet dhe rrethinat ku kishte “terroristë”.²⁴⁸⁷ Llukiqi i udhëzoi të pranishmit që “nëse ka probleme në lidhje me shkëmbimin e informacionit midis RDB-së dhe RJB-së, më njoftoni mua në mënyrë që ta tejkalojmë këtë”.²⁴⁸⁸

993. Llukiqi tha gjithashtu se “plani për parandalimin e terrorizmit” që duhej dorëzuar brenda datës 7 dhjetor 1998 duhej të përmbante, në parim: “një vlerësim të sigurisë”, “masa për parandalimin e futjes së armëve përmes kufirit”, “mbajtjen në kontroll të linjave të komunikimit”, “mbajtjen në kontroll të territorit”, “masa në qytete”, “sigurimin e objekteve”, “identifikimin e pikave dhe fshatrave ku ndodhen shtabet dhe grupet terroriste” dhe “masa për çarmatosjen”.²⁴⁸⁹

994. Në përputhje me udhëzimet e Llukiqit, më 4 dhjetor 1998 Petar Damjanaci, i cili ishte shef i DPB-së së Gillogocit, përgatiti një plan apo “propozime” për parandalimin e terrorizmit.²⁴⁹⁰ Plani i tij u miratua asokohe nga shefi i SPB-së së Prishtinës, Boshko Petriqi.²⁴⁹¹ Në një mbledhje tjetër të Shtabit të MPB-së, të zhvilluar më 21 dhjetor 1998, shefat e SPB-ve, mes tyre edhe Petriqi, shpjeguan se kishin hartuar plane kundër terrorizmit dhe se shumica e këtyre planeve po viheshin në zbatim.²⁴⁹² Gjithashtu Stevanoviqi i informoi të pranishmit për detyrat në vijim. Një prej këtyre detyrave ishte që “Shtabi i Ministrisë të planifikonte operacione më të gjera kundër bazave

²⁴⁸² P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7.

²⁴⁸³ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 8.

²⁴⁸⁴ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7.

²⁴⁸⁵ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 8.

²⁴⁸⁶ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 4.

²⁴⁸⁷ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7.

²⁴⁸⁸ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 6.

²⁴⁸⁹ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7.

²⁴⁹⁰ Petar Damjanac, T. 23791–23798 (6 mars 2008).

²⁴⁹¹ P3116 (Plani i DPB-së së Gillogocit për parandalimin e terrorizmit, 4 dhjetor 1998); Petar Damjanac, T. 23792–23795 (6 mars 2008).

²⁴⁹² P1991 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 4–8.

terroriste, por nisma duhej të vinte nga Sekretariatet, të cilët duhej të bënin përgatitjen dhe të hartonin rekomandimet e Planit të Veprimeve”.²⁴⁹³

995. Të gjitha këto procesverbale, raporte dhe udhëzime tregojnë se në vitin 1998, Shtabi i MPB-së dhe Llukiqi si shef i tij, kishin pushtet të qenësishëm mbi SPB-të dhe detashmentet e PJP-së në Kosovë, sa i takon dhënies së udhëzimeve të përgjithshme, kërkimit të informacionit prej tyre dhe garantimit që veprimet e tyre të përputheshin me politikën a planin e përgjithshëm të MPB-së. Edhe udhëzimi i Llukiqit në mbledhjen e datës 2 dhjetor që ai të njoftohej për çdo problem lidhur me shkëmbimin e informacionit midis RDB-së dhe RJB-së,²⁴⁹⁴ tregon se Shtabi i MPB-së luante një rol në shkëmbimin e informacionit midis forcave të RJB-së dhe RDB-së.

(B) 1999

996. Dokumentet e fillimit të vitit 1999 japin një pamje të ngjashme. Më 24 janar 1999, Llukiqi i udhëzoi SPB-të dhe detashmentet e PJP-së në Kosovë të tregonin sjellje korrekte kundrejt anëtarëve të KVM-së dhe u kujtoi detyrimin për të garantuar sigurinë e KVM-së.²⁴⁹⁵ Ai e përsëriti këtë udhëzim më 23 shkurt 1999, ku shprehej se “anëtarët e Ministrisë për të cilët vërtetohet se kanë shpërdorur apo tejkaluar kompetencat, të ndëshkohen përmes masave disiplinore dhe masave të tjera”.²⁴⁹⁶ Në një mbledhje të zhvilluar më 17 shkurt në Shtabin e MPB-së, ku, ndër të tjerë, merrnin pjesë Stojilkoviqi, shefi i RDB-së Rade Markoviqi dhe Obrad Stevanoviqi, Llukiqi shpjegoi situatën e atëhershme në Kosovë dhe raportoi se “MPB është ende duke marrë masat e nevojshme për të mbajtur në kontroll rrugët, për të siguruar territorin, objektet, personat dhe sigurinë e njerëzve dhe pronave”.²⁴⁹⁷ Më tej, ai tha:

Është hartuar një plan i RJB-së për parandalimin dhe pengimin e hyrjes së trupave të NATO-s në territorin tonë. Shtabi planifikon që pasi të urdhërohet, të kryejë operacione spastruese në zonat Podujevë, Dragobi dhe Drenicë dhe ka caktuar rreth 4.000 policë, rreth 70 policë të [grupit operativ të ndjekjes] dhe rreth 900 policë rezervistë.²⁴⁹⁸

Ai raportoi se pas tri ditësh do të mbahej një mbledhje e Shtabit të MPB-së, me pjesëmarrjen e të gjithë “komandantëve të detashmenteve policore”, për konsultime të mëtejshme lidhur me angazhimin e tyre. Sipas procesverbalit, Stojilkoviqi i udhëzoi të pranishmit “t’i trajtojnë dhe

²⁴⁹³ P1991 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 1, 10–11.

²⁴⁹⁴ P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 6.

²⁴⁹⁵ 6D871 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 24 janar 1999).

²⁴⁹⁶ 6D872 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 23 shkurt 1999).

²⁴⁹⁷ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1.

²⁴⁹⁸ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1.

angazhojnë vullnetarët me kujdes, duke e inkuadruar angazhimin e tyre përmes forcës rezerviste policore kur kjo të gjykohet e nevojshme”.²⁴⁹⁹

997. Në mbledhjen e datës 17 shkurt 1999 Cvetiqi tha se komentet e Stojilkoviçit vinin “ndesh me legjislacionin ekzistues”.²⁵⁰⁰ Cvetiqi shtoi se, në një mbledhje tjetër të Shtabit të MPB-së të zhvilluar më 17 mars 1999, Llukiqi

ngriti çështjen e vullnetarëve. Ai tha se nëse dalin vullnetarë në zonën e Kosovës, këta njerëz duhen mbajtur në këtë zonë. Dhe me nisjen e operacioneve luftarake, vullnetarët duhej të përfshiheshin në sistemin e MPB-së.²⁵⁰¹

Më tej, Cvetiqi shpjegoi natyrën e paligjshme të përdorimit të këtyre vullnetarëve nga MPB-së, duke thënë se

sipas ligjit për Ushtrinë e Jugosllavisë, më duket në Nenin 15, përcaktohet që në rast të një rreziku të afërt lufte apo në gjendje lufte, Ushtria e Jugosllavisë mund të pranojë në radhët e veta vullnetarë. Pra, ligjvënësi nuk e ka lejuar këtë mundësi për asnjë strukturë tjetër mbrojtëse që të përdorin vullnetarë, përfshirë këtu edhe Ministrinë e Brendshme.²⁵⁰²

Dëshmia që dha Cvetiqi u kundërshtua nga Mbrojtja e Llukiqit përmes dëshmisë së Millosh Vojnoviqit. Vojnoviqi tha se atij nuk i kujtohej ndonjë mbledhje e datës 17 mars 1999 dhe se nuk kishte dëgjuar ndonjëherë që Llukiqi të kishte thënë ndonjë gjë në lidhje me angazhimin e vullnetarëve.²⁵⁰³ Dushan Gavraniqi dëshmoi gjithashtu se Stojilkoviçi foli për vullnetarët në një mbledhje. Atij i kujtohej se kjo ndodhi në një mbledhje të zhvilluar më 17 shkurt 1999 dhe jo më 17 mars 1999. Atij nuk i kujtohej që Llukiqi të kishte thënë ndonjë gjë në lidhje me përdorimin e vullnetarëve në asnjë prej mbledhjeve. Madje, atij i kujtohej se ministri i Brendshëm i kishte thënë se më pas do të vinin udhëzime të mëtejshme, por nuk tha nëse i mori më pas këto udhëzime. Ai vërejti se SPB-ja e Gjilanit nuk përdori asnjëherë asnjë vullnetar; nëse ndonjë vullnetar paraqitej në SPB, ata i dërgoheshin UJ-së.²⁵⁰⁴ Megjithëse Mbrojtja e Llukiqit i mbahet pikëpamjes se Cvetiqi gabimisht mendonte se deklaratën e ministrit e kishte bërë Llukiqi, Cvetiqi citoi qartë përmendjen e vullnetarëve në dy mbledhje një muaj larg njëra-tjetrës.²⁵⁰⁵ Pyetjet e Mbrojtjes së Llukiqit, të cilat qenë disi të paqarta, nuk arritën ta komprometojnë dëshminë e Cvetiqit në lidhje me këtë aspekt.

²⁴⁹⁹ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 3.

²⁵⁰⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8099–8100 (7 dhjetor 2006); *shih, në përgjithësi*, P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999).

²⁵⁰¹ Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006). Edhe pse dëshmia e Cvetiqit përmend “shëfën e shtabit të MBP-së në Prishtinë”, më vonë ai sqaroi se me këtë nënkuptonte Llukiqin. Lubinko Cvetiq, T. 8103 (7 dhjetor 2006).

²⁵⁰² Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006).

²⁵⁰³ Millosh Vojnoviq, T. 24154–24155 (12 mars 2008).

²⁵⁰⁴ Dushan Gavraniq, T. 22724–22725 (12 shkurt 2008).

²⁵⁰⁵ Lubinko Cvetiq, T. 8099–8100 (7 dhjetor 2006); *shih, në përgjithësi*, P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999).

Gjithashtu, Dhoma gjykon se Vojnoviqi dhe Gavraniqi nuk janë të besueshëm kundrejt dëshmisë së Cvetiqit dhe provave shkresore.²⁵⁰⁶

998. Lidhur me çështjen e vullnetarëve, Gjorgjeviqi u dërgoi shefave të SPB-ve në Kosovë, Shtabit të MPB-së dhe organeve të tjera të MPB-së, një mesazh ku i udhëzonte të “kryejnë kontrollet e nevojshme, të përpilojnë listat dhe vendosin kontroll të plotë mbi vullnetarët dhe njësitë paraushtarake dhe anëtarët e tyre.”²⁵⁰⁷ Më 24 mars 1999, Stojilkoviqi dërgoi një telegram me udhëzime për të njëjtët marrës që, ndër të tjera, “të regjistrojnë të gjitha njësitë vullnetare dhe paraushtarake dhe anëtarët e tyre, dhe t’i mbajnë nën kontroll në rast nevojë për angazhimin e tyre.”²⁵⁰⁸

999. Më 1 prill 1999, Llukiqi u dërgoi një urdhër të gjitha SPB-ve në Kosovë, duke i udhëzuar që, për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe “me qëllim informimin efektiv dhe në kohë të Ministrisë për Punë të Brendshme të Republikës së Serbisë”, të dërgojnë raport përmbledhës ditor të ngjarjeve dhe incidenteve me rëndësi për Shtabin e MPB-së”.²⁵⁰⁹

1000. Më 4 prill 1999 “u zhvillua një mbledhje me zyrtarë të lartë të policisë në Kosovë” në të cilën, ndër të tjerë, morën pjesë Llukiqi, Stevanoviqi, Shainoviqi, shefat e SPB-ve në Kosovë, dhe komandantët e njësisë të PJP-së, SAJ-së dhe JSO-së.²⁵¹⁰ Në këtë mbledhje, shefat e SPB-ve raportuan mbi situatën në komunat e tyre.²⁵¹¹ Millorad Jankoviqi, një komandant në JSO, u raportoi të pranishmëve edhe mbi bashkëpunimin me UJ-në.²⁵¹² Mbasi dëgjuan prezantimet, Llukiqi dhe Stevanoviqi përmendën detyrat e ardhshme. Detyrat që përmendi Llukiqi përfshinin “spastrimin e fushëbetejës, marrjen e të gjitha masave dhe veprimeve të nevojshme” “[duke përdorur municionet [minat dhe lëndët shpërthyes në mënyrë të arsyeshme]; “[përdorimin sa më të vogël të radiolidhjeve, për shkak të mundësisë së zbulimit të vendndodhjeve të postëkomandave dhe njësisë]; “marrjen e masave të rrepta ndaj njësisë paraushtarake”; “konfiskimin e ...makinave pa dokumente dhe targa”; dhe “kujdes të veçantë lidhur me numrin e minave të vendosura”.²⁵¹³

²⁵⁰⁶ Dhoma nuk beson se dëshmia e Gavraniqit hedh dyshime lidhur me datat e mbledhjeve që ka përmendur Cvetiqi. Si Gavranoviqi, po ashtu edhe Cvetiqi kujtojnë një mbledhje e cila u zhvillua më 17 shkurt 1999 dhe në të cilën ministri i Brendshëm foli për çështjen e vullnetarëve. Lubinko Cvetiq, T. 8099–8100 (7 dhjetor 2006); Dushan Gavranic, T. 22724–22725 (19 shkurt 2008). Cvetiqi kujtoi edhe një mbledhje të datës 17 mars 1999, në të cilën Llukiqi foli për të njëjtën çështje. Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006). Mirëpo dëshmia e Gavraniqit kufizohej vetëm te mbledhja e datës 17 shkurt dhe nuk bënte fjalë nëse kishte pasur një mbledhje më datë 17 mars apo se çfarë kishte ndodhur në këtë mbledhje. *Shih* Dushan Gavranic, T. 22724–22725 (19 shkurt 2008).

²⁵⁰⁷ 6D269 (Telegram i RJB-së Nr. 312, 18 shkurt 1999), f. 3.

²⁵⁰⁸ 6D238 (Telegram i Vllajko Stojilkoviqit, 24 mars 1999), f. 1.

²⁵⁰⁹ 6D808 (Urdhër i Sreten Llukiqit dërguar SPB-ve të Kosovës, 1 prill 1999), f. 1, 4.

²⁵¹⁰ P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 1.

²⁵¹¹ P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 1–3.

²⁵¹² P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 3.

²⁵¹³ P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 3–4.

Llukiqi gjithashtu theksoi që “shefat e sekretariateve dhe komandantët e njërive janë të detyruar t’i raportojnë Shtabit”.²⁵¹⁴ Lidhur me detyrat e përmendura nga Llukiqi, Gavraniqi tha se “ai nuk na dha kurrfarë detyrash të posaçme që do të ishin në kundërshtim me detyrat në të cilat ne tanimë ishim përfshirë, në përputhje me planin tonë të punës.”²⁵¹⁵ Ai gjithashtu tha që Shtabi i MPB-së asnjëherë nuk i dha SPB-së së tij ndonjë urdhër lidhur me operacionet antiterroriste.²⁵¹⁶

1001. Më 5 prill 1999, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve në Kosovë dhe komandantëve të detashmenteve të 21-të deri në 87-të të PJP-së një “urdhër” në të cilin udhëzonte marrësit që të parandalonin largimin e civilëve nga shtëpitë e tyre.²⁵¹⁷ Më 15 prill, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve në Kosovë dhe komandantëve të detashmenteve 21-të deri në 87-të të PJP-së edhe një telegram, i cili i referohej “urdhrit” të datës 5 prill. Në telegram, Llukiqi vuri në dukje që kishte mësuar se urdhri nuk po respektohej plotësisht nga disa komandantë të MPB-së, dhe theksoi se komandantët që nuk i përmbushnin urdhrat, do të mbanin përgjegjësi. Ai gjithashtu urdhëroi shefat e SPB-së dhe komandantët e PJP-së që të informonin me shkrim Shtabin e MPB-së lidhur me problemet që mund të dilnin nga ky urdhër.²⁵¹⁸

1002. Më 9 prill 1999, Llazareviqi njoftoi njësitë e tij vartëse që Shtabi i MPB-së kishte urdhëruar të gjitha SPB-të që të “fillonin planifikimin e aksioneve për shtypjen e grupeve terroriste të mbetura në zonat e tyre përkatëse të përgjegjësisë.”²⁵¹⁹ Më tej Llazareviqi urdhëronte vartësit e tij që të kontaktonin menjëherë shefat e SPB-së me qëllim bashkërendimin e aksioneve për “shtypjen” e grupeve terroriste”.²⁵²⁰ Gjatë dëshmisë së tij, Llazareviqi shpjegoi se organi operativ i Korpusit të Prishtinës i tregoi se Shtabi i MPB-së i kishte informuar se “ishte angazhuar në planifikimin, duke qenë se sekretariatet e brendshme në territorin e Kosovës dhe Metohisë po planifikonin ose kishin planifikuar aksione antiterroriste.” Më pas Llazareviqi urdhëroi “komandantët e UJ-së që të vendosnin kontakte me [SPB-të], me qëllim përcaktimin e vendit dhe rolit të tyre në angazhimin e mundshëm të tyre në aksion të bashkërenditur me forcat e MPB-së, për të zbatuar detyrat e kontrollit luftarak të territorit.”²⁵²¹

²⁵¹⁴ P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4.

²⁵¹⁵ Dushan Gavraniq, T. 22754–22755 (19 shkurt 2008).

²⁵¹⁶ Dushan Gavraniq, T. 22756 (19 shkurt 2008).

²⁵¹⁷ 6D778 (Telegram i Sreten Llukiqit dërguar shefave të SPB-ve dhe komandantëve të PJP-së në Kosovë, 15 prill 1999) (referuar urdhrit të datës 5 prill 1999).

²⁵¹⁸ 6D778 (Telegram i Sreten Llukiqit dërguar shefave të SPB-ve dhe komandantëve të PJP-së në Kosovë, 15 prill 1999).

²⁵¹⁹ 5D476 (Telegram i Vladimir Llazareviqit dërguar njërive të PrK-së, 9 prill 1999), f. 1.

²⁵²⁰ 5D476 (Telegram i Vladimir Llazareviqit dërguar njërive të PrK-së, 9 prill 1999), f. 1.

²⁵²¹ Vladimir Llazareviq, T. 18006–18007 (9 nëntor 2007), 18804–18805 (22 nëntor 2007).

1003. Më pas, komandantët e njësisve të UJ-së duhej t’ia dorëzonin planet komandës së Korpusit të Prishtinës për miratim.²⁵²² Radojko Stefanoviqi, i cili ishte komandant i Brigadës së 52-të Artilerike të Përzierë të Korpusit të Prishtinës, konfirmoi se urdhri në fjalë udhëzonte komandantët e brigadave që të kontaktonin shefat e SPB-ve përkatëse në territoret e tyre, dhe të fillonin planifikimet e aksioneve në përputhje me urdhrin.²⁵²³ Megjithatë, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes së Llukiqit, Stefanoviqi qartësoi se ai vetë nuk kishte parë urdhër nga Shtabi i MPB-së për planifikimin e aksioneve “antiterroriste”dërguar SPB-ve, siç thuhej në urdhrin e Llazareviciqit.²⁵²⁴

1004. Më 13 prill 1999, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve dhe komandantëve të SAJ-së në Kosovë edhe një mesazh ku thuhej se Shtabi i MPB-së po dërgonte shirita me ngjyra dhe udhëzimet për përdorimin e tyre nga anëtarët e MPB-së. Llukiqi urdhëroi që gjatë lëvizjeve të tyre jashtë objekteve të MPB-së, të gjithë policët me uniformë duhej të mbanin shiritin e duhur në krah.²⁵²⁵

1005. Më 6 maj 1999, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve të Kosovës dhe komandantëve të PJP-së dhe SAJ-së në Kosovë kopje të një artikulli nga *Politika*, e datës 5 maj. Ai i udhëzoi ata që të informonin forcat e tyre mbi përmbajtjen e artikullit, ku flitej për një mbledhje në Beograd midis Millosheviqit dhe disa zyrtarëve të lartë, përfshirë dhe vetë Llukiqin, në të cilin ishin diskutuar situata aktuale dhe planet për mbrojtjen e vendit, si dhe “lufta kundër terrorizmit”. Kjo është mbledhja e datës 4 maj 1999, përmendur më sipër në Pjesët VIII.C–F. Më tej ai urdhëroi shefat e SPB-ve dhe komandantët e PJP-së dhe SAJ-së që “gjatë periudhës vijuese” të merrnin “të gjitha masat për parandalimin e kryerjes së akteve të dhunës nga formacionet dhe individët paraushtarakë”.²⁵²⁶ Në të njëjtën ditë, një telegram me emrin e Llukiqit të shtypur poshtë faqes iu dërgua shefave të të gjitha SPB-ve në Kosovë, ku ata udhëzoheshin që të zbatonin detyrat lidhur me autorët e krimeve në Kosovë dhe urgjentisht të fillonin ndjekje penale. Telegrami theksonte se shefat e SPB-ve ishin “përgjegjës për realizimin e veprimeve të parapara” dhe se shefat e Policisë për Krime kishin për detyrë “realizimin e tyre të drejtpërdrejtë” nën drejtimin e përgjithshëm të Shtabit të MPB-së.²⁵²⁷ Gvozden Gagiqi dëshmoi se, pavarësisht nga fakti që telegrami mbante emrin e Llukiqit, ishte vetë ai që hartoi këtë dokument, së bashku me një punonjës të MPB-së me emrin Spanoviq. Telegramin më pas e nënshkroi Dragan Iliqi. Gagiqi shpjegoi se kishte nisur telegramin nga Shtabi i MPB-së me emrin e Llukiqit sepse në atë kohë nuk kishte kushte për dërgimin e tij nëpërmjet kanaleve të OKP-së. Ai gjithashtu shpjegoi se ekzistonte një regjistër i MPB-së ku regjistrohej emri i dërguesit të telegramit; rrjedhimisht, në rast “keqkuptimi”, ishte e

²⁵²² Vladimir Llazareviq, T. 18007 (9 nëntor 2007), T. 18804–18805 (22 nëntor 2007).

²⁵²³ Radojko Stefanoviq, T. 21700–21701 (5 shkurt 2008).

²⁵²⁴ Radojko Stefanoviq, T. 21770–21771 (6 shkurt 2008).

²⁵²⁵ 6D237 (Telegrami i Shtabit të MPB-së lidhur me shiritat për policët, 13 prill 1999).

²⁵²⁶ 5D1289 (Telegram i Sreten Llukiqit, 6 maj 1999).

²⁵²⁷ 6D874 (Telegram i Sreten Llukiqit dërguar shefave të SPB-ve në Kosovë, 6 maj 1999), f. 2.

lehtë të zbulojë identitetin e dërguesit.²⁵²⁸ Lidhur me këtë, Dhoma përfundon se, ndonëse telegramin nuk e dërgoi Llukiqi, gjithsesi ai u dërgua nga Shtabi i MPB-së në emër të tij dhe nuk pati sugjerime se ishte i paautorizuar.

1006. Më 7 maj 1999, në ndërtesën e Shtabit të MPB-së u zhvillua një mbledhje e drejtuar nga Sreten Llukiqi, në të cilën morën pjesë Shainoviqi, Stevanoviqi, Dragan Iliqi, anëtarë të Shtabit të MPB-së dhe shefat e SPB-ve të Kosovës. Rendi i ditës i mbledhjes përfshinte dhe diskutime lidhur me “detyrat e ardhshme në mbrojtjen e vendit nga agresori” dhe “çështjet e rëndësishme lidhur me punën dhe kryerjen e detyrave nga ana e pjesëtarëve të MPB-së në Kosovë dhe Metohi.”²⁵²⁹ Llukiqi, i cili drejtoi mbledhjen, udhëzoi shefat e SPB-ve të merrnin masa kundër autorëve të krimeve dhe dha udhëzime lidhur me mbajtjen e uniformave. Ai gjithashtu udhëzoi SPB-në e Prishtinës që të siguronte rrugën Prishtinë-Podujevë në bashkëpunim me UJ-në.²⁵³⁰

1007. Gjatë këtij takimi, Stevanoviqi urdhëroi shefat e SPB-ve që të përqendroheshin në parandalimin e krimeve dhe të organizonin aksione “antiterroriste” dhe t’i kryenin me miratim paraprak nga Shtabi i MPB-së. Ai theksoi “mbas përfundimit të disa operacioneve më të mëdha...çdo SPB do të duhet të punojë në mënyrë të pavarur në organizimin e operacioneve antiterroriste në zonat e tyre përkatëse. Plani duhet miratuar nga Shtabi.”²⁵³¹

1008. Lidhur me këtë deklaratë, Dushan Gavraniqi u përpoq që të zvogëlonte rolin e SPB-ve në planifikimin dhe kryerjen e operacioneve antiterroriste.²⁵³² Mirëpo dëshmia e tij bie ndesh me komentin e Stevanoviqit bërë më 7 maj që “gjatë organizimit të punës, Sekretariati i Brendshëm duhet të garantojë që organizimi në Kosovë të jetë i tillë që të gjitha njësitë [PJP dhe OPG] të vihen nën varësinë e shefit të Sekretariatit.”²⁵³³ Gavraniqi tha gjithashtu se nuk kishte dijeni që planet duheshin miratuar nga Shtabi i MPB-së.²⁵³⁴

1009. Më 11 maj 1999, në Shtabin e MPB-së në Prishtinë u zhvillua edhe një mbledhje e drejtuar nga Llukiqi në të cilën morën pjesë edhe 4 anëtarë të tjerë të Shtabit të MPB-së, 13 komandantë të PJP-së, dhe Obrad Stevanoviqi. Rendi i ditës ishte i ngjashëm me atë të mbledhjes së datës 7 maj dhe përfshiu diskutime lidhur me “detyrat e ardhshme në mbrojtjen e vendit nga agresori” dhe

²⁵²⁸ Gvozden Gagiq, T. 24476–24478 (18 mars 2008), T. 24517–24524 (19 mars 2008).

²⁵²⁹ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 1–2.

²⁵³⁰ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 10–12.

²⁵³¹ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 10–11.

²⁵³² Dushan Gavraniq, T. 22758–22759, 22762–22763, 22787 (19 shkurt 2008).

²⁵³³ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 11.

²⁵³⁴ Dushan Gavraniq, T. 22764, 22793 (19 shkurt 2008).

“luftën kundër terrorizmit”.²⁵³⁵ Pasi komandantët e ndryshëm të PJP-së i raportuan grupit lidhur me veprimtaritë e tyre, Stevanoviqi tha se “çdo SPB dhe OPJP do të krijojë një listë përparësish të operacioneve antiterroriste me plane të hollësishme, që do të miratohet nga Shtabi.”²⁵³⁶ Ai gjithashtu theksoi se “njësitë e policisë janë në varësinë e shefit të SPB-së dhe se shefat e OPJP-së dhe policisë duhet të marrin pjesë në çdo mbledhje të Kolegjiumit të SPB-së”. Në fund e mori fjalën Llukiqi i cili u kujtoi të pranishmëve që duheshin marrë masa për parandalimin e eksodit nga Kosova.²⁵³⁷ Ai gjithashtu tha se meshkujt shqiptarë kosovarë të aftë për shërbim ushtarak duheshin arrestuar, kontrolluar dhe të nisnin procedimet përkatëse penale, dhe dha udhëzime lidhur me mbajtjen e uniformave policore.²⁵³⁸ Pas mbledhjeve të datës 7 dhe 11 maj, Shtabi i MPB-së nxori përfundimet në të cilat qenë përcaktuar detyrat e ardhshme.²⁵³⁹

1010. Më 13 maj 1999, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve të Prizrenit, Ferizajt dhe Prishtinës, dhe komandantit të “stacionit të policisë rrugore” në Han të Elezit, një telegram bashkëlidhur me një letër të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Llukiqi urdhëronte shefat e SPB-ve dhe komandantin e policisë rrugore të ndërmerren masa të veçanta për të ndihmuar KNKK -në, dhe në të njëjtën kohë i udhëzonte që të “largonin të gjitha makinat e braktisura dhe objektet që mund të tregonin se refugjatë [kishin] qëndruar përgjatë rrugës” që do të ndiqnin anëtarët e KNKK -së gjatë udhëtimit në Kosovë.²⁵⁴⁰ Më 15 maj, Llukiqi u dërgoi edhe një telegram të gjithë shefave të SPB-ve të Kosovës si dhe shefave të Policisë për Krime, “duke kërkuar nga ata që t’i dërgonin menjëherë Shtabit të MPB-së disa informata lidhur me ndalimet dhe procedurat penale në zonat e tyre të përgjegjësisë.²⁵⁴¹

1011. Së fundi, telegrami i datës 26 maj 1999 i Dragan Zhivaleviqit, komandantit të Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes të PJP-së, drejtuar Shtabit të MPB-së,²⁵⁴² përfshinte një raport mbi “vijat e arritura” të Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes, me kode referimi që përputheshin me një hartë.²⁵⁴³ Në telegram gjithashtu raportohej mbi një pjesëtar të plagosur të PJP-së dhe vendndodhjen e disa “refugjatëve”, dhe kërkoheshin nga Shtabi i MPB-së udhëzime se ku duheshin strehuar këta

²⁵³⁵ P1993 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 1.

²⁵³⁶ P1993 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 7.

²⁵³⁷ Deri në këtë kohë, Shtabi i MPB-së i kishte raportuar MPB-së në Beograd që mbi 700,000 shqiptarë kosovarë ishin larguar nga Kosova. *Shih* P1693 (Pasqyrë e Shtabit të MPB-së të gjendjes së sigurisë, 1 maj 1999).

²⁵³⁸ P1993 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 8–9.

²⁵³⁹ 6D802 (Përfundime të mbledhjeve të Shtabit të MPB-së të datës 7 dhe 11 maj 1999).

²⁵⁴⁰ 6D796 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 13 maj 1999).

²⁵⁴¹ 6D876 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 15 maj 1999).

²⁵⁴² 5D1418 (Telegram i Shtabit të MPB-së dhe telegram i Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes, 26 maj 1999). Ndonëse titulli i telegramit të Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes sugjeron që telegrami iu dërgua “shefit të Shtabit” të PJP-së, gjatë dëshmisë së tij Zhivaleviqi shpjegoi se ky qe një gabim i hartuesit të telegramit dhe se duhej t’i ishte adresuar Shtabit të MPB-së. Dragan Zhivaleviq, T. 24862–24863 (3 prill 2008).

²⁵⁴³ *Shih* Dragan Zhivaleviq, T. 24869–24870 (3 prill 2008).

“refugjatë.”²⁵⁴⁴ Në krye të telegramit, nga ana e djathtë, ka një shënim me shkrim dore, “Gjeneralit Llukiq, për informim dhe vendim”, nënshkruar më poshtë nga Miroslav Mijatoviqi.²⁵⁴⁵ Në përgjigjen e tij, Shtabi i MPB-së e udhëzoi Zhivaleviqin që t'i kthente civilët nëpër fshatrat e tyre, dhe në rast se kjo ishte e pamundur, t'i strehonte në vendet që kishte sugjeruar. Ai u udhëzua që t'i arrestonte të gjithë “meshkujt e aftë për shërbim ushtarak” dhe t'ia dorëzonte “Sekretariatit Rajonal.” Gjithashtu Zhivaleviqi u udhëzua që të garantonte se policia do të vepronte “në pajtim të plotë me ligjin.”²⁵⁴⁶

b. Përfundime lidhur me rolin dhe funksionet e Shtabit të MPB-së

1012. Të gjitha këto dokumente tregojnë se gjatë periudhës para dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Shtabi i MPB-së luajti rol qendror në planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe udhëheqjen e punës së njësive të ndryshme të MPB-së që vepronin në Kosovë, si dhe në bashkërendimin dhe planifikimin e operacioneve të përbashkëta me UJ-në. Shtabi i MPB-së nuk zëvendësoi strukturat ditore komanduese brenda MPB-së. Shefat e SPB-ve dhe komandantët e njësive të PJP-së dhe SAJ-së vazhduan të ushtronin kontroll të drejtpërdrejtë mbi forcat e tyre. Faktikisht, Shtabi i MPB-së luajti një rol më të gjerë duke drejtuar dhe kontrolluar veprimet e të gjithë këtyre komandantëve dhe njësive vartëse të tyre, dhe siguruar që [veprimet e tyre] të ishin në përputhje me politikat dhe planet e përgjithshme.

1013. Këtë pasqyrë e konfirmoi edhe vetë Llukiqi në intervistën e tij me Prokurorinë, gjatë të cilës shpjegoi se roli kryesor i Shtabit të MPB-së ishte bashkërendimi, planifikimi, dhe drejtimi i njësive organizative, sidomos gjatë detyrës së “shtypjes së terrorizmit”. Ai më tej shtoi, veçanërisht lidhur me PJP-në, që njësitë e PJP-së mbanin “përgjegjësi të dyfishtë”: ndaj komandantit të PJP-së (Stevanoviqit) dhe në të njëjtën kohë ndaj Shtabit të MPB-së.²⁵⁴⁷

1014. Ndonëse disa dëshmitarë të Mbrojtjes së Llukiqit u përpoqën të sugjeronin se Shtabi i MPB-së ishte një “kuti postare” për komunikimet, një organ i dobët që nuk kishte pushtet të vërtetë, Dhoma i hedh poshtë këto dëshmi për shkak të provave përputhëse dhe bindëse që janë në kundërshtim me këto dëshmi, nxjerrë nga dokumentet e lartpërmendura, shumica e të cilave të nënshkruara nga vetë Llukiqi. Ky përfundim konfirmohet edhe nga intervista e Llukiqit.

²⁵⁴⁴ 5D1418 (Telegram i Shtabit të MPB-së dhe telegram i Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes, 26 maj 1999), f. 3; Miroslav Mijatoviqi, T. 22537 (15 shkurt 2008).

²⁵⁴⁵ 5D1418 (Telegram i Shtabit të MPB-së dhe telegram i Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes, 26 maj 1999), f. 3; Miroslav Mijatoviqi, T. 22379 (14 shkurt 2008).

²⁵⁴⁶ 5D1418 (Telegram i Shtabit të MPB-së dhe telegrami i Brigadës së 122-të të Ndërhyrjes, 26 maj 1999), f. 2.

²⁵⁴⁷ P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 41.

1015. Dhoma pranon që në përputhje me vendimin e datës 16 qershor 1998, Shtabi i MPB-së formalisht përfshinte edhe anëtarë të RDB-së. Megjithatë, në mungesë të provave të mjaftueshme të drejtpërdrejta lidhur me mënyrën se si Llukiqi si shef i Shtabit të MPB-së ushtronte pushtet mbi personelin dhe njësitë e RDB-së në Kosovë, Dhoma nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nëse ai faktikisht gëzonte një pushtet të tillë. Gjithsesi, ky përfundim nuk ndikon mbi konkluzionet përmbyllëse të Dhomës lidhur me përgjegjësinë penale të Llukiqit.

5. Kompetencat e Llukiqit si shef i Shtabit të MPB-së

1016. Dhoma thekson se normalisht do të ishte logjike që roli i Shtabit të MPB-së dhe shefit të tij, Sreten Llukiqit, të analizohen së bashku. Mirëpo, për shkak të një argumenti konkret që ngrii Mbrojtja e Llukiqit lidhur me pozitën e Llukiqit në kuadër të Shtabit të MPB-së, Dhoma do t'i analizojë këto dy aspekte veç e veç.

1017. Mbrojtja e Llukiqit argumenton se pozita e Llukiqit në kuadër të shtabit të MPB-së nuk ishte ajo e shefit (*načelnik*), por e “drejtuesit” ose “administratorit” (*rukovodilac*).²⁵⁴⁸ Ajo më tej argumenton se Prokuroria e ka analizuar gabimisht strukturën e Shtabit të MPB-së, për shkak se është mbështetur në dëshmitë e të jashtëmëve, si për shembull në ato të anëtarëve të KDOM-it dhe KVM-së, dhe dëshmitarëve nga radhët e UJ-së. Mbrojtja vë në dukje se Prokuroria nuk paraqiti dëshmitarë ekspertë të policisë, dhe për këtë arsye i referohet gabimisht Llukiqit me “shef,” ose “komandant” i Shtabit të MPB-së për Kosovën.²⁵⁴⁹ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se formulimi gjuhësor i Vendimit mbi Formimin e Shtabit të Ministrisë për Shtypjen e Terrorizmit tregon qartë se ai u emërua për të shërbyer si administrator ose drejtues (*rukovodilac*) i Shtabit, që nënkupton kompetenca më të pakta se të shefit ose kreut (*načelnik*).²⁵⁵⁰

1018. Origjinali në serbisht i vendimit të datës 16 qershor 1998 faktikisht përmend se Llukiqi u emërua “*rukovodilac*” i Shtabit, sikundër thekson Mbrojtja e Llukiqit.²⁵⁵¹ Megjithatë, Dhoma mendon se titulli i saktë i postit të Llukiqit dhe përkthimi i tij në anglisht nuk janë me rëndësi. Me rëndësi janë pushteti dhe kompetencat e tij. Vetëm për lehtësi përdorimi, në këtë pjesë përdoret përkthimi “shef i Shtabit të MPB-së”.

²⁵⁴⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 692–722, 1432.

²⁵⁴⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 692–722.

²⁵⁵⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 692–722, 730.

²⁵⁵¹ P1505 Vendim për Ngritjen e një Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

a. Pjesëmarrja e Llukiqit në mbledhje të nivelit të lartë

1019. Përveç mbledhjeve të mbajtura në Shtabin e MPB-së në Prishtinë, gjatë kohës që kreu detyrën e shefit të Shtabit të MPB-së, Llukiqi mori pjesë edhe në mbledhje të tjera të zyrtarëve të lartë të MPB-së, UJ-së dhe politikanëve të RFJ-së dhe Serbisë.

1020. Më 30 maj 1998, Llukiqi mori pjesë në një mbledhje me Millosheviqin në Beograd, në të cilën qenë të pranishëm, mes të tjerëve, Perishiçi, Stanishiçi, Samarxhiçi, Dimitrijeviçi, Pavkoviçi dhe Stevanoviçi. Mbledhjen e organizoi Millosheviçi dhe në të u diskutua plani për luftën kundër terrorizmit në Kosovë, siç u përshkrua në Pjesën VI.E.²⁵⁵²

1021. Aleksandar Dimitrijeviçi dëshmoi se në korrik dhe gusht 1998 ai mori pjesë “katër ose pesë herë” në mbledhje të tilla të thirrura nga Millosheviçi në Beli Dvor në Beograd. Dimitrijeviçi mbante mend që përveç oficerëve të lartë të ushtrisë, të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Llukiqi, Stojilkoviçi, Stevanoviçi, dhe Gjorgjeviçi për MPB-në, së bashku me politikanë si Shainoviçi, Matkoviçi, Miniçi, dhe Angjelkoviçi.²⁵⁵³ Gjatë intervistës së tij, Llukiqi konfirmoi se kishte marrë pjesë në një mbledhje të thirrur nga Millosheviçi, që sipas tij u mbajt në fillim të korrikut, në të cilën morën pjesë Stojilkoviçi, Gjorgjeviçi dhe Stevanoviçi nga MPB-ja, si dhe Millutinoviçi, Shainoviçi, Pavkoviçi, Matkoviçi, Miniçi dhe Angjelkoviçi. Dhoma tashmë ka konkluduar se kjo mbledhje u mbajt më 21 korrik 1998.²⁵⁵⁴ Llukiqi tha se gjatë kësaj mbledhjeje, Pavkoviçi paraqiti situatën në Kosovë dhe propozoi kryerjen e operacioneve të përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së në tri ose katër faza. Planin që propozoi Pavkoviçi u miratua në këtë mbledhje. Llukiqi theksoi se Shtabi i MPB-së nuk mori pjesë aktive në hartimin e planit dhe se ai nuk e pranoi planin ashtu siç u propozua, për arsye se plani përfshinte një numër të madh punonjësish që nuk ishin të pranishëm në Kosovë, si dhe për shkak të problemeve tjera logjistike.²⁵⁵⁵ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se Llukiqi nuk mori pjesë në hartimin e Planit Kundër Terrorizmit.²⁵⁵⁶ Dhoma pranon se Llukiqi nuk u përfshi në formulimin e planit në nivelet më të larta; gjithsesi ai mori pjesë në mbledhjen në të cilën u miratua ky plan si dhe në zbatimin e masave për të mundësuar konkretizimin e mirëfilltë të tij.

²⁵⁵² Millan Gjakoviçi, T. 26410–26411 (19 maj 2008).

²⁵⁵³ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26587–26590 (8 korrik 2008).

²⁵⁵⁴ *Shih* Nën pjesën VI.E.1.

²⁵⁵⁵ P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 68–73; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 500–506. Dhoma vëren se, ndonëse Llukiqi tha që mbledhja u mbajt në fillim të korrikut, Dushko Matkoviçi dëshmoi se faktikisht mbledhja u mbajt më 20 korrik. Dushko Matkoviçi, T. 14634–14637 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë e dëshmitarit e datës 10 shkurt 2003), f. 9 (version publik).

²⁵⁵⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 500–506.

1022. Disa nga mbledhjet në të cilat mori pjesë Llukiqi ishin ato të Komandës së Përbashkët, të diskutuara në Pjesën VI.E. Prokuroria pretendon se Llukiqi ishte anëtar i Komandës së Përbashkët që nga krijimi i saj, dhe se ai takohej rregullisht me anëtarë të tjerë të Komandës së Përbashkët për të planifikuar operacione që duheshin kryer në Kosovë. Në këto mbledhje, Llukiqi u raportonte të tjerëve mbi çështje lidhur me MPB-në dhe merrte pjesë në diskutimet për operacionet në vijim. Sipas Prokurorisë, operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së nuk mund të realizoheshin pa përfshirjen e Llukiqit si shef i Shtabit të MPB-së i cili i kalonte përfundimet e miratuara nga Komanda e Përbashkët përmes hierarkisë komanduese të MPB-së.²⁵⁵⁷

1023. Nga ana tjetër, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se Komanda e Përbashkët ishte një përpjekje e ligjshme e MPB-së dhe UJ-së për të shkëmbyer informacione, dhe nuk ishte një organ me kompetencë komanduese mbi forcat e MPB-së dhe UJ-së. Ajo pretendon se termi “Komandë e Përbashkët” ishte thjesht një shkurtesë e UJ-së për të përshkruar bashkërendimin midis MPB-së dhe UJ-së para nxjerrjes së urdhrat për ndërrimin e varësisë; dhe, rrjedhimisht, Komanda e Përbashkët nuk gëzonte kompetenca urdhërdhënëse. Gjithashtu, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se pas vitit 1998, Komanda e Përbashkët pushoi së ekzistuari, duke lënë të kuptohet se Llukiqi nuk mund të ketë qenë anëtar i këtij organi më 1999.²⁵⁵⁸ Gjithsesi Dhoma më parë ka konkluduar se Komanda e Përbashkët luajti një rol të rëndësishëm në drejtimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, si më 1998, po ashtu edhe më 1999.

1024. Dhoma ka analizuar provat lidhur me Komandën e Përbashkët dhe në veçanti pjesëmarrjen e Llukiqit në të. Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi shpjegoi se nga 20 korriku 1998, Komanda e Përbashkët mblidhej thujtse çdo mbrëmje për të shkëmbyer informacione dhe pasqyruar situatën.²⁵⁵⁹ Analiza e hollësishme e Shënimeve të Millan Gjakoviqit marrë gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët nga korriku deri në tetor 1998, tregon se Llukiqi ishte rregullisht i pranishëm në këto mbledhje.²⁵⁶⁰ Për më tepër, Gjakoviqi identifikoi Llukiqin si personi që komandonte forcat e MPB-së në Kosovë.²⁵⁶¹ Roli i Llukiqit dhe natyra e përfshirjes së tij në mbledhjet e Komandës së Përbashkët ilustrohen me disa shembuj të diskutuar më poshtë.

1025. Sipas Shënimeve, në mbledhjen e datës 22 korrik 1998, Llukiqi raportoi se “në territorin e Kosovës dhe Metohisë janë regjistruar disa incidente, në Ferizaj dhe Nerodime të Epërme u

²⁵⁵⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 156–180, 1012.

²⁵⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 788–799.

²⁵⁵⁹ P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 77.

²⁵⁶⁰ P1468 (Shënime të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët).

²⁵⁶¹ Millan Gjakoviq, T. 26434 (19 maj 2008) (tha se kur u pyet lidhur me termin “Komandë e Përbashkët”, ai donte të thoshte “Gjenerali Llukiq dhe gjenerali Pavkoviq, askush tjetër, sepse askush tjetër nga hierarkia komanduese nuk

shpartallua një grup terrorist dhe u arrestuan shtatë persona.”²⁵⁶² Më tej ai raportoi se “u mbajt [një] mbledhje me të gjithë komandantët e togave dhe më pas me shefat e MPB-së.”²⁵⁶³ Më 23 korrik, Llukiqi informoi të pranishmit se MPB-ja kishte marrë masa kundër “sulmeve terroriste” në komunën e Pejës; se në atë zonë ishte ngritur një pikë kontrolli; se ishte rritur numri i patrullimeve; dhe se në Rahovec ishte arrestuar një grup prej 35 personash dhe ishin kontrolluar për prani të mbetjeve të barutit.²⁵⁶⁴

1026. Në një mbledhje të Komandës së Përbashkët të mbajtur më 27 korrik 1998, Llukiqi raportoi mbi ecurinë e njësisë të MPB-së në Runik.²⁵⁶⁵ Në mbledhjen e 29 korrikut ai iu referua një sulmi kundër MPB-së në Prizren, dhe informoi të pranishmit se kishte 3.000 uniforma të gatshme për t’ua shpërndarë policëve rezervë.²⁵⁶⁶ Të nesërmen, ai informoi të pranishmit në mbledhje se gjithsej 1.203 policë rezervë dhe “personel i kohës së paqes” nga Serbia kishin arritur në Kosovë, duke e rritur numrin e përgjithshëm të policëve rezervistë dhe “personelit të kohës së paqes” në Kosovë në 14.687. Sipas Shënimeve, Llukiqi me tej tha se deri të nesërmen, do të tërhiqeshin të gjitha njësitë manovruese, me përjashtim të skuadrave të 5-të dhe 8-të dhe të skuadrës në Duhël.²⁵⁶⁷ Sipas Shënimeve Llukiqi tha gjithashtu se “Plani për Mitrovicës nuk është i mirë. Duhet të hartohet përsëri, sidomos në [pjesën shqiptare], për shembull Shipol.”²⁵⁶⁸

1027. Shënimet tregojnë se në një mbledhje të mbajtur më 4 gusht 1998, Llukiqi tha se “brenda 30 ditësh, [një] gjykatës hetues [do] të lëshojë një fletarrestim për autorët e krimit”, dhe foli mbi nevojën “e respektimit të procedurave ligjore” gjatë trajtimit të të dyshuarve.²⁵⁶⁹ Me sa duket, Llukiqi e kishte fjalën për dy të dyshuar për të cilët Radoviqi, zëvendës shefi i qendrës së RDB-së në Prishtinë, raportoi se ishin ndaluar për arsye se kishin kryer krime, pa përmendur se kush ishin këta të dyshuar e as natyrën e krimeve që kishin kryer.²⁵⁷⁰

1028. Më 13 gusht 1998, Llukiqi informoi Komandën e Përbashkët se në disa zona të Kosovës ishin hapur llogore, se ishin shpërndarë “fletushka propagandistike” lidhur me kthimin e civilëve nga qytetet në fshatrat e tyre; se ai kishte biseduar me “Shefin e Misionit” lidhur me nevojën e

mund t’u jepte urdhra njësisë të MPB-së përveç gjeneralit Llukiq dhe njësisë të ushtrisë, përveç gjeneralit Pavkoviç ose gjeneralit Samarxhiq. Pra, për mendimin tim, ky term që përdor unë këtu nuk nënkupton askënd tjetër”.

²⁵⁶² P1468 (Shënime të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët), f. 3.

²⁵⁶³ P1468 (Shënime të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët), f. 3.

²⁵⁶⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 6–7.

²⁵⁶⁵ P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 17.

²⁵⁶⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 25–26, 28–29.

²⁵⁶⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 30–31.

²⁵⁶⁸ P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 33.

²⁵⁶⁹ P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 42.

²⁵⁷⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 42.

parandalimit të një katastrofe humanitare; dhe foli për nevojën e bashkëpunimit me organizatat humanitare.²⁵⁷¹ Shënimet tregojnë se në mbledhjen e datës 27 gusht 1998, gjatë diskutimeve mbi numrin e detashmenteve dhe kompanive të MPB-së në Kosovë, Llukiqi tha se “nesër mbrëma, e gjithë kjo duhet të përfundojë, Plani i MPB-së (angazhimi)”, dhe se “nesër, gazetarët do të shoqërohen deri në Duhël për të fotografuar bunkerin dhe objektet e tjera të UÇK-së”.²⁵⁷²

1029. Më 1 shtator 1998, Llukiqi përshkroi dorëzimin e armëve në fshatrat Dubovik, Beleg, Strellc i Poshtëm, Lubushë, dhe Prapaqan.²⁵⁷³ Në mbledhjen e datës 6 shtator 1998, ai raportoi se “po bëhen përgatitje të përbashkëta për aksionin ‘Ratis’”, përmendi nevojën “për të shkuar me një kompani në Ostrozub , i cili duhet marrë”, përmendi kapjen e 537 personave në Prizren, Pejë, dhe Gjakovë, dhe tha se armët ishin dorëzuar në “H. Zagrodska”.²⁵⁷⁴ Në mbledhjen e datës 12 shtator 1998, Llukiqi informoi të pranishmit se ishin gjetur 29 kufoma në rrethinën e Ratishtës, në komunën e Deçanit.²⁵⁷⁵

1030. Në mbledhjen e datës 13 shtator 1998, Llukiqi raportoi mbi “përgatitjet për operacionin ‘Bajgora’”.²⁵⁷⁶ Të nesërmen, ai i informoi të pranishmit se operacioni *Bajgora* ishte kryer.²⁵⁷⁷ Në mbledhjen e datës 15 shtator, Llukiqi edhe një herë raportoi mbi angazhimin e Detashmenteve të 5-të dhe 2-të të PJP-së në zonën e Stari Tërgut,²⁵⁷⁸ afër Mitrovicës dhe Bajgorës. Në mbledhjen e datës 16 shtator, ai vazhdoi raportimin e tij lidhur me operacionet që po kryheshin në zonën e Bajgorës, në fshatin e quajtur Bare.²⁵⁷⁹

1031. Më 26 shtator, evidentohet se Llukiqi u shpreh: “Abria e Poshtme përfundoi sot ... Tre detashmente, dy kompani dhe SAJ-ja u tërhoqën... U kap një numër i madh personash.”²⁵⁸⁰ Më 30 shtator ai tha se për të nesërmen do të hartohet tabela e dislokimit për MPB-në.²⁵⁸¹ Më 1 tetor 1998, Llukiqi u shpreh: “Pretendohet se në rajonin e Jabllanicës është një varr i përbashkët.”²⁵⁸² Më 30

²⁵⁷¹ P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52–53. Edhe pse shënimet e Komandës së Përbashkët nuk thonë se kush është “Shefi i Misionit” të cilin e përmendi Llukiqi, duke patur parasysh se shënimet përkatëse u morën më 13 gusht 1998, Dhoma konkludon se Llukiqi i referohej Shefit të Misionit të KDOM-it në Kosovë.

²⁵⁷² P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 77–78.

²⁵⁷³ P1468 Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 100–101.

²⁵⁷⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 92.

²⁵⁷⁵ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 106.

²⁵⁷⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 109.

²⁵⁷⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 111.

²⁵⁷⁸ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 113.

²⁵⁷⁹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 116.

²⁵⁸⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 129.

²⁵⁸¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 133.

²⁵⁸² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 134. Versioni në B/K/S lexohet “Jablanica”.

tetor, ai komentoi se “Ka patur disa zjarre në rreth 30 fshatra në zonën e Prizrenit, për shkaqe ende të panjohura.”²⁵⁸³

1032. Të gjithë këta shembuj tregojnë se Llukiqi kishte dijeni të hollësishme për ngjarjet në terren në Kosovë më 1998, dhe rolin e tij në raportimin para anëtarëve të tjerë të Komandës së Përbashkët për veprimtaritë e forcave të MPB-së. Pjesëmarrja e tij në pjesën më të madhe të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët evidentuar në Shënimet, shpeshherë si i vetmi përfaqësues i MPB-së, tregon se ai luajti rol të rëndësishëm dhe qendror në bashkërendimin e veprimeve të MPB-së dhe UJ-së.

1033. Duke konfirmuar rolin e Llukiqit si anëtar i rëndësishëm i Komandës së Përbashkët, i përfshirë në garantimin e zbatimit të urdhrave të saj të saj në bashkërendim midis forcave të UJ-së dhe MPB-së, Adamoviçi dëshmoi se pas mbledhjes së datës 22 korrik 1998 në Shtabin e MPB-së përmendur më lart, ai mori detyrë nga Llukiqi që njësitë të MPB-së në terren, t'u kalonte hartat e operacioneve të përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së.²⁵⁸⁴ Konkretisht, Llukiqi e udhëzoi që të “shkonte kohë pas kohe tek kolonel Gjakoviçi dhe ta informonte për njësitë që ishin në territorin e Kosovës dhe Metohisë, e gjithë kjo me qëllim planifikimin dhe zbatimin e operacioneve antiterroriste.”²⁵⁸⁵ Siç u përshkrua më lart, Gjakoviçi dëshmoi se ai nuk do të mund të planifikonte operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së dhe të hartonte hartat përkatëse pa ndihmën e Adamoviçit dhe anëtarëve të tjerë të Shtabit të MPB-së.²⁵⁸⁶

1034. Krahas mbledhjeve në Komandën e Përbashkët, Llukiqi mori pjesë edhe në shumë mbledhje të tjera me zyrtarë të lartë të UJ-së dhe MPB-së, dhe me udhëheqës politikë, në të cilat ai raportoi për situatën në Kosovë dhe mori pjesë në planifikimin e operacioneve të mëtejshme.

1035. Llukiqi mori pjesë në mbledhjen e mbajtur në Beli Dvor në Beograd më 29 tetor 1998, në të cilën u përfshinë shumica e pjesëmarrësve të njëjtë si në mbledhjen e 21 korrikut. Pas prezantimit të Pavkoviçit lidhur me zbatimin e suksesshëm të Planit, Llukiqi u raportoi të pranishmëve mbi dislokimin e forcave të MPB-së në Kosovë në kuadrin e Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviç.²⁵⁸⁷

1036. Dushan Llonçari dëshmoi se kur shkoi për herë të parë në Kosovë në nëntor 1998, mori pjesë në një mbledhje në ndërtesën e MPB-së në Prishtinë, ku ndër të pranishmit ishin Shainoviçi, Llukiqi, Pavkoviçi dhe të tjerë. Në këtë mbledhje, Shainoviçi e prezantoi Llonçarin tek të

²⁵⁸³ P1468 ((Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 164.

²⁵⁸⁴ Dushko Adamoviçi, T. 24969–24970, 24978 (8 prill 2008), T. 25063–25065 (9 prill 2008).

²⁵⁸⁵ Dushko Adamoviçi, T. 25065 (9 prill 2008).

²⁵⁸⁶ Millan Gjakoviçi, T. 26397 (19 maj 2008).

pranishmit dhe udhëzoi që të gjitha kontaktet me KVM-në të kalonin nëpërmjet Llonçarit.²⁵⁸⁸ Ndonëse është e paqartë nëse më pas Llonçari mbajti kontakte me Llukiqin, ai komunikonte me zëvendësin e Llukiqit, Mijatoviqin, i cili i raportonte për incidentet në Kosovë.²⁵⁸⁹ Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi konfirmoi se Mijatoviqi mbante mbledhje të përditshme me përfaqësuesit e KVM-së.²⁵⁹⁰ Llonçari shtoi se gjatë periudhës nëntor 1998 – mars 1999, Shainoviqi vazhdoi të vizitonte Kosovën një ose dy herë në javë, dhe se çdo herë takohej me Pavkoviqin dhe Llukiqin. Dy të sapopërmendurit gjithashtu kishin për detyrë t'a informonin Shainoviqin me telefon në rast se ndodhte diçka e rëndësishme.²⁵⁹¹

1037. Procesverbali i mbledhjes së 2 dhjetorit 1998 mbajtur në Shtabin e MPB-së evidenton se Llukiqi përshkroi një mbledhje që ishte zhvilluar më herët në Beograd, më 27 nëntor 1998. Kjo mbledhje u mbajt në Ministrinë e Brendshme dhe në të morën pjesë Llukiqi, Shainoviqi, Stojilkoviqi, ndihmësministrat e MPB-së dhe shefat e RDB-së dhe RJB-së. Ata analizuan situatën në Kosovë dhe diskutuan angazhimin e mëtejshëm të forcave të MPB-së në “operacionet antiterroriste”.²⁵⁹²

1038. Ka gjithashtu prova që roli i Llukiqit si përfaqësuesi kryesor i MPB-së për Kosovën vazhdoi edhe më 1999. Gjatë një raportimi më 11 prill 1999, Ojdaniqi u tha oficerëve të lartë të UJ-së se do të mbahej një mbledhje mes përfaqësuesve të Shtabit të Komandës së Lartë dhe “Kryekomandantit” (Millosheviqit), si dhe Millutinoviqit, Shainoviqit, Pavkoviqit dhe Llukiqit.²⁵⁹³ Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi përshkroi një mbledhje tjetër të mbajtur në maj 1999, në një vilë në Beograd. Mbledhjen e kishte thirrur Millosheviqi dhe në të morën pjesë edhe Millutinoviqi, Shainoviqi, Pavkoviqi, Ojdaniqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi dhe Stevanoviqi. Si shef i Shtabit të MPB-së, Llukiqi paraqiti një raport lidhur me situatën në Kosovë, dhe të njëjtën gjë bëri edhe Pavkoviqi si përfaqësues i UJ-së.²⁵⁹⁴ Dhoma është e bindur se mbledhja të cilës iu referua Llukiqi është ajo e datës 4 maj, diskutuar më sipër, që u zhvillua pas marrjes së një letre nga Prokurorja e atëhershme e Tribunalit, Louise Arbour, në të cilën ajo shprehte shqetësimin e saj të thellë për kryerjen e përsëritur të shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në

²⁵⁸⁷ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Beli Dvor, mbajtur më 29 tetor 1998), f. 7. Shih Pikën VI.E.2.b.i.C lidhur me mendimin e Dhomës për këtë dokument.

²⁵⁸⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 21.

²⁵⁸⁹ Shih Dushan Llonçar, T. 7594, 7596 (30 nëntor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 21, 22, 35; P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 80.

²⁵⁹⁰ P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 122.

²⁵⁹¹ Dushan Llonçar, T. 7576–7578 (30 nëntor 2006), T. 7652–7654 (1 dhjetor 2006), P2521 (deklaratë e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 38.

²⁵⁹² P3122 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 3.

²⁵⁹³ Branko Gajiq, 15414–15418 (11 shtator 2007); 3D728 (Raportim për shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3.

Kosovë.²⁵⁹⁵ Një lajm i mediave lidhur me mbledhjen e datës 4 maj thekson se në të morën pjesë Millosheviqi, Millutinoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Llukiqi dhe të tjerë. Sipas këtij lajmi, gjatë mbledhjes u paraqitën informacione se “forcat e sigurimit” kishin trajtuar raste të shumta të dhunës, vrasjeve, plaçkitjeve dhe krimeve të tjera, dhe kishin arrestuar disa qindra autorë të krimeve, krimet e të cilëve paraqitnin rrezik të madh për popullatën civile. Artikulli theksonte se gjatë mbledhjes u konkludua se krime të tilla ishin bërë “të pamundura” duke qenë se autoritetet shtetërore i kryenin pa paragjykimet detyrat e tyre në mbrojtjen e civilëve.²⁵⁹⁶

1039. Lubisha Stojimiroviqi, i cili në atë kohë ishte shef i Shtabit të Armatës së Tretë, vërtetoi se në fillim të muajit maj, Llukiqi dhe Pavkoviqi shkuan të takoheshin me Millosheviqin.²⁵⁹⁷ Dy ditë pas takimit, Llukiqi lëshoi një urdhër ku u kërkonte vartësve të tij që të lexonin artikullin në gazetën *Politika* dhe t’u përmbaheshin udhëzimeve të tij.²⁵⁹⁸ Deklaratat e Shainoviqit gjatë mbledhjes së Shtabit të MPB-së të datës 7 maj 1999 mbështesin përshkrimin e mbledhjes së datës 4 maj që bën artikulli. Shainoviqi tha se Presidenti i RFJ-së dhe ai i Serbisë kishin dëgjuar raportimin nga Pavkoviqi dhe Llukiqi, se teksti i deklaratës u bë publik, dhe se kjo deklaratë duhej t’u shpërndahej të gjithë komandantëve të policisë.²⁵⁹⁹ Miroslav Mijatoviqi dëshmoi se Shainoviqi i referohej deklaratës në gazetën *Politika* e cila informonte mbi mbledhjen e datës 4 maj 1999.²⁶⁰⁰

1040. Së fundi, Llukiqi mori gjithashtu pjesë në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 1 qershor 1999, mbajtur në bodrumin e Hotelit Grand në Prishtinë, që u diskutua me hollësi në Pjesën VI.E, gjatë të cilës, mes të tjerëve, ai bëri një prezantim të veprimtarive të MPB-së.²⁶⁰¹

b. Kontaktet e Llukiqit me vëzhguesit ndërkombëtarë

1041. Shefi i US-KDOM-it, Shaun Byrnes, dëshmoi lidhur me pjesëmarrjen e Llukiqit, së bashku me Gjorgjeviqin dhe Stevanoviqin për MPB-në, në një sërë mbledhjesh teknike që u zhvilluan pas takimit të datës 24 tetor 1998 midis Millosheviqit, Wesley Clark-ut dhe Klaus Naumann-it.²⁶⁰²

²⁵⁹⁴ P948 (Intervistë e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 142–143.

²⁵⁹⁵ *Shih në përgjithësi* P398 (Letër nga Louise Arbour dërguar Millosheviqit, 26 mars 1999); P399 (Letër nga Louise Arbour dërguar Millutinoviqit, 26 mars 1999); P400 (Letër nga Louise Arbour dërguar Nikolla Shainoviqit, 26 mars 1999); P401 (Letër nga Louise Arbour dërguar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999).

²⁵⁹⁶ P1696 (“Shefat e Ushtrisë dhe Policisë Informojnë Millosheviqin për Mbrojtjen e Suksesshme”, Reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

²⁵⁹⁷ Lubisha Stojimiroviq, T. 17684 (26 tetor 2007).

²⁵⁹⁸ 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit lidhur me Artikullin e gazetës *Politika*, 6 maj 1999), pranuar gjithashtu me numrin P2159.

²⁵⁹⁹ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 4.

²⁶⁰⁰ Miroslav Mijatoviq, T. 22286–22289 (13 shkurt 2008).

²⁶⁰¹ Aleksandar Vasileviq, T. 14505 (29 gusht 2007), P2600 (deklaratë e dëshmitarit e datës 14 janar 2007), para. 78–81; Momir Stojanoviq, T. 19774–19775 (7 dhjetor 2007).

²⁶⁰² Shaun Byrnes, T. 12156–12158 (16 prill 2007).

Diskutimet u zhvilluan rreth numrit të forcave që do të lejoheshin në Kosovë pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq.²⁶⁰³ Byrnes-i dhe Llukiqi morën pjesë në një nëngrup për diskutimin e çështjes së forcave policore në veçanti, që përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes për “Mirëkuptim midis KDOM-it dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë” nga Byrnes-i dhe Gjorgjeviqi.²⁶⁰⁴

1042. Pas vendosjes së KVM-së në Kosovë, sikundër u përmend më lart, në Prishtinë u ngrit zyra e Komisionit Federal për Bashkëpunim, për të mbikëqyrur bashkëveprimin vendor me KVM-në. Komisioni kryesohej nga Dushan Llonçari dhe në të bënin pjesë Millan Koturi që përfaqësonte UJ-në, dhe zëvendësi i Llukiqit, Miroslav Mijatoviqi, që përfaqësonte MPB-në,²⁶⁰⁵. Gjatë muajve të parë të vitit 1999, Komisioni takohej me përfaqësuesit e KVM -së thujse çdo ditë.²⁶⁰⁶ Gjatë këtyre takime shkëmbeheshin informacione lidhur me veprimtaritë e UJ-së, MPB-së dhe UÇK-së në Kosovë.²⁶⁰⁷

1043. Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi tha se pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq, Mijatoviqi takohej me përfaqësuesit e KVM-së në Kosovë çdo mëngjes.²⁶⁰⁸ Sipas Llukiqit, kur ai vetë kontaktonte KVM-në, këtë e bënte në të shumtën e rasteve nëpërmjet Richard Heaslip-it, një oficer irlandez që ishte caktuar për ndërlidhje me Shtabin e MPB-së.²⁶⁰⁹ Karol John Drewienkiewicz, i cili caktoi Heaslip-in në këtë detyrë, dhe i cili ndonjëherë takonte Llukiqin, tha se Llukiqi iu prezantua si “komandanti i policisë serbe në Kosovë”.²⁶¹⁰ Gjatë pyetjeve nga Mbrotjtja, ai shtoi se sipas tij Llukiqi ishte “shefi i policisë në Kosovë”.²⁶¹¹ Në procesverbalin e OSBE-së të takimit të datës 24 dhjetor 1998 është shënuar se Drewienkiewicz-i e informoi Llukiqin që KVM-ja kishte marrë raporte të pakonfirmuara mbi përdorimin e forcës së tepruar nga ana e policisë në fshatrat në perëndim të Fushë-Kosovës. Mirëpo Llukiqi hodhi poshtë propozimin e Drewienkiewicz-it që MPB-ja të paralajmëronte KVM-në për operacionet e MPB-së.²⁶¹²

²⁶⁰³ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 14–16, P2512 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6980–6983; Rade Çuçak, T. 14933–14934 (4 shtator 2007).

²⁶⁰⁴ Shaun Byrnes, T. 12157–12159 (16 prill 2007); *shih gjithashtu* P394 (Marrëveshje Mirëkuptimi midis KDOM-it dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë).

²⁶⁰⁵ Richard Ciaglinski, P2488 (deklaratë e dëshmitarit e datës 23 mars 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 6.

²⁶⁰⁶ Richard Ciaglinski, T. 6859 (17 nëntor 2006).

²⁶⁰⁷ Richard Ciaglinski, T. 6860 (17 nëntor 2006).

²⁶⁰⁸ P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 122–123.

²⁶⁰⁹ P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 123; Richard Ciaglinski, T. 6986–6987 (21 nëntor 2006).

²⁶¹⁰ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 56.

²⁶¹¹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7987–7988 (6 dhjetor 2006); *shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 103; P2544 (Pikat Kryesore të Takimit midis Llukiqit dhe Drewienkiewicz-it, 24 dhjetor 1998).

²⁶¹² P2544 (Pikat Kryesore të Takimit midis Llukiqit dhe Drewienkiewicz-it, 24 dhjetor 1998).

1044. Shaun Byrnes-i pati kontakte të shumta pune me Llukiqin përpara dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të Tetorit. Shpeshherë këto kontakte zhvilloheshin çdo ditë, sidomos gjatë periudhës së krijimit të KVM-së.²⁶¹³ Ai gjithashtu kontaktonte shpesh edhe me Mijatoviqin. Byrnes-i mbante mend se dikush i kishte thënë se Llukiqi kishte zëvendësuar Obrad Stevanoviqin si “shef i policisë serbe në Kosovë” dhe se Llukiqi i raportonte Stevanoviqit në Beograd.²⁶¹⁴ Ai diskutonte ngjarjet në Kosovë me Llukiqin dhe i bënte të njohura konstatimet e ekipeve të KDOM-it lidhur me sjelljen e papranueshme të policisë; Më pas, Llukiqi kontaktonte Byrnes-in për t’i rrëfyer lidhur me shkeljet e UÇK-së, dhe KDOM-i më pas përpiqej të verifikonte këtë.²⁶¹⁵ Sipas Byrnes-it, zhdukja dhe/ose vrasja e serbëve që jetonin në Kosovë çdo herë nxiste Llukiqin që të bënte kërkesë për ndihmë.²⁶¹⁶ Më vonë, megjithëse KDOM-i ia kaloi KVM-së kompetencat dhe përgjegjësinë për kontaktet me policinë serbe, Byrnes-i mbajti kontakt me Llukiqin.²⁶¹⁷

1045. Lidhur me kontaktet e punës midis Llukiqit dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë dëshmoi edhe Llonçari, i cili theksoi se Llukiqi ishte mjaft i zellshëm në kontaktet e tij me KVM-në dhe se asnjëherë nuk i refuzonte kërkesat e tyre. Llonçari tha se kur shkoi për herë të parë në Kosovë më 11 dhjetor 1998, “përgjegjës për MPB-në” ishte Llukiqi.²⁶¹⁸ Ai shtoi se nëpërmjet Mijatoviqit, Llukiqi vazhdimisht insistonte për bashkëpunim sa më të madh me KVM-në.²⁶¹⁹

1046. Gjatë dëshmisë së tij në procesin *Milloseviq*, Richard Ciaglini fillimisht tha se me sa dinte ai, Llukiqi ishte shefi i MPB-së në Kosovë.²⁶²⁰ Më vonë, ai saktësoi se këtë ia konfirmuan shumë herë gjatë mbledhjeve me Komisionin Federal për Bashkëpunim me KVM-në, dhe “rrallë herë” kur takoi vetë Llukiqin.²⁶²¹ Në deklaratën e tij me shkrim, Ciaglini e përshkroi Llukiqin si “komandanti i përgjithshëm për forcat e policisë në Kosovë”.²⁶²² Ai tha se e kishte takuar Llukiqin një ose dy herë sepse Llukiqi “thjesht nuk donte të merrej me OSBE-në, dhe se kjo punë i ishte caktuar Mijatoviqit”.²⁶²³

²⁶¹³ Shaun Byrnes, T. 12140–12142 (16 prill 2007).

²⁶¹⁴ Shaun Byrnes, T. 12146 (16 prill 2007).

²⁶¹⁵ Shaun Byrnes, T. 12141–12142 (16 prill 2007).

²⁶¹⁶ Shaun Byrnes, T. 12142 (16 prill 2007).

²⁶¹⁷ Shaun Byrnes, T. 12140–12141 (16 prill 2007).

²⁶¹⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklaratë e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 21.

²⁶¹⁹ Dushan Llonçar, T. 7659–7660 (1 dhjetor 2006).

²⁶²⁰ Richard Ciaglini, P2489 (transkript nga *Prokurori kundër Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3176. Pësha që i jepet dëshmisë së Ciaglini-it të vitit 2002 në procesin *Milloseviq* përfshin edhe saktësimet që bëri ai gjatë dëshmisë në procesin *Millutinoviqi dhe të tjerët*. Shih Richard Ciaglini, T. 6811 (17 nëntor 2006).

²⁶²¹ Richard Ciaglini, P2489 (transkript nga *Prokurori kundër Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3182.

²⁶²² Richard Ciaglini, P2488 (deklaratë e dëshmitarit e datës 23 mars 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 10.

²⁶²³ Richard Ciaglini, P2488 (deklaratë e dëshmitarit e datës 23 mars 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik, f. 11–12.

1047. Michael Phillips-i konfirmoi se takohej me Llukiqin si dhe me Shainoviqin dhe Llonçarin çdo javë, për të zgjidhur problemin e lëvizjes së vëzhguesve të KVM-së në Kosovë. Mirëpo këto takime u ndërpre në janar 1999, pas incidentit të Reçakut. Prej këtyre takime, Phillips-i nxori përfundimin se Shainoviqi kishte pushtet të konsiderueshëm mbi UJ-në dhe MPB-në, por theksoi se për disa çështje të veçanta lidhur me MPB-në, hollësitë duhej t'i merrte nga Llukiqi.²⁶²⁴ Gjithashtu Phillips-i dëshmoi se kur takoi Llukiqin për të parën herë, ai u prezantua si “shefi i MPB-së ose komandanti i MPB-së në Prishtinë.”²⁶²⁵ Llukiqi mori pjesë në takimin e tij të parë me KVM-në më 24 dhjetor 1998, por nuk foli për pjesën më të madhe të takimit.²⁶²⁶ Kur Phillips-it iu sugjerua se askund në shënimet e tjera në fletoret e tij nuk përmendeshin takime në të cilat kishte marrë pjesë Llukiqi, ai u përgjigj se ishte shumë i sigurt që Llukiqi mori pjesë në më shumë se një takim ku ishte i pranishëm edhe Shainoviqi.²⁶²⁷ Phillips-i gjithashtu dëshmoi se në dhjetor 1998, ai u paraqiti Shainoviqit, Millosheviqit dhe Llukiqit shqetësimet e KVM-së lidhur me përdorimin e forcës së tepruar nga ana e forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë: ai theksoi se UÇK-ja përdorte armë të kalibrit të vogël kurse forcat e RFJ-së përdornin armë të rënda të kalibrit të madh. Sipas Phillips-it, reagimet e Shainoviqit dhe Llukiqit ishin të natyrës mbrojtëse, duke pretenduar çdo herë se kishin detyrim të mbronin popullatën serbe, sepse OSBE-ja nuk po i mbronte.²⁶²⁸

1048. Dhoma gjykon se tërësia e provave përputhëse lidhur me çfarë u tha Llukiqi vëzhguesve ndërkombëtarë dhe përshtypja që la, çon drejt përfundimit se Llukiqi u prezantua si shefi i policisë në Kosovë.

c. Kompetencat e Llukiqit për masa disiplinore

1049. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se as Llukiqi, as Shtabi i MPB-së nuk mund të fillonin procedura disiplinore kundër pjesëtarëve të MPB-së.²⁶²⁹ Ndonëse Dhoma është e bindur se procedurat disiplinore në përgjithësi çelëshin nga eprori i drejtpërdrejtë i personit dhe kryheshin nga SPB-të përkatës, udhëzimet e Llukiqit lëshuar në gusht 1998 dhe shkurt 1999 tregojnë se ai kishte kompetenca *de facto* për t'u kërkuar shefave të SPB-ve q1 të kryenin hetime lidhur me krime, edhe kur nuk ishin ata që kishin nisur procedimin.²⁶³⁰ Për më tepër, gjatë intervistës së tij

²⁶²⁴ Michael Phillips, T. 11829–11831, 11855 (19 mars 2007).

²⁶²⁵ Michael Phillips, T. 11829–11830 (19 mars 2007).

²⁶²⁶ Michael Phillips, T. 11987–11989 (20 mars 2007); 6D198 (fragmente nga fletorja e Phillips-it).

²⁶²⁷ Michael Phillips, T. 11989 (20 mars 2007).

²⁶²⁸ Michael Phillips, T. 11845–11846 (19 mars 2007).

²⁶²⁹ Argumentet Përmbyllës të Mbrojtjes së Llukiqit, T. 27306 (26 gusht 2008).

²⁶³⁰ 6D768 (Urdhër i Sretin Llukiqit drejtuar shefave të SPB-ve dhe komandantëve të PJP-së në Kosovë, 7 gusht 1998); 6D872 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 23 shkurt 1999).

me Prokurorinë, Llukiqi përmendi veprimet e ndërmarra pas një masakre të kryer, dhe tha: “Porsa mora këtë informacion, ata u arrestuan menjëherë”.²⁶³¹

d. Përfundime

1050. Dhoma nuk ka dyshim se, pa marrë parasysh titullin e tij të saktë, Llukiqi ishte në krye të Shtabit të MPB-së, nga qershori 1998 deri në korrik 1999. Pjesa më e madhe e provave të diskutuara më lart lidhur me kompetencat dhe funksionet e Shtabit të MPB-së gjithashtu zbulojnë shkallën e pjesëmarrjes së Llukiqit në planifikimin, organizimin dhe kontrollimin e njësisve të MPB-së në Kosovë. Dokumentet e marra si provë tregojnë se Llukiqi drejtoi pjesën më të madhe të mbledhjeve të mbajtura në Shtabin e MPB-së, përfshirë dhe mbledhjet në të cilat morën pjesë personalitete të larta si Presidenti i Serbisë, ministri i Brendshëm, shefat e RJB-së dhe RDB-së, i Akuzuari Shainoviq dhe shefi i njësisve të PJP-së Obrad Stevanoviqi. Për shembull, në mbledhjen e datës 22 korrik 1998 përshkruar më lart – në të cilën morën pjesë Gjorgjeviqi dhe Stevanoviqi – Llukiqi propozoi rendin e ditës dhe drejtoi mbledhjen.²⁶³² Më 28 korrik 1998, Llukiqi drejtoi një mbledhje në Shtabin e MPB-së, në të cilën morën pjesë ministri i Brendshëm, shefi i RDB-së Rade Markoviqi dhe shefat e SPB-ve. Siç u tha më lart, Llukiqi u uroi të pranishmëve mirëseardhjen dhe bëri një raportim të shkurtër mbi “masat dhe veprimtaritë e njësisve të policisë sipas Planit”, dhe përshkroi se cilat veprime ishin ndërmarrë dhe nga cilat detashmente, në bashkërendim me UJ-në.²⁶³³ Veç kësaj, më 5 nëntor 1998, në një mbledhje tjetër që u mbajt në Shtabin e MPB-së, në të cilën morën pjesë Millutinoviqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, Markoviqi, Shainoviqi, Pavkoviqi, të gjithë shefat e SPB-ve të Kosovës dhe komandantët e PJP-së, Llukiqi si drejtues i mbledhjes “përshëndeti të pranishmit, falënderoi Presidentin Millutinoviq, ministrin Stojilkoviq dhe të tjerët që kishin ardhur për të vizituar Shtabin e MPB-së, dhe u raportoi mbi situatën aktuale të sigurisë në Kosovë dhe Metohi, si dhe i informoi për gatishmërinë e njësisve të policisë për të vazhduar me zbatimin e detyrave.”²⁶³⁴

1051. Gjithashtu, në emër të Shtabit të MPB-së Llukiqi lëshoi shumë telegrame që përmbanin detyra dhe udhëzime për SPB-të dhe njësitë e PJP-së dhe SAJ-së, siç u përshkrua më lart. Pas nxjerrjes së përfundimit se Shtabi i MPB-së luajti rol kryesor në planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe drejtimin e veprimeve të njësisve të ndryshme të MPB-së që vepronin në Kosovë, si dhe në bashkërendimin dhe planifikimin e operacioneve të përbashkëta me UJ-në, dhe duke

²⁶³¹ P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 155–156. Me sa duket, Llukiqi po diskutonte masakrën në Podujevë që kishin kryer njësitë rezerviste të SAJ-së të njohura si Akrepat, diskutuar në Ndarjen VI.A.3.f.

²⁶³² 6D798 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998).

²⁶³³ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998).

²⁶³⁴ P2805 (Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 5 nëntor 1998, në Shtabin e MPB-së, f. 3, 7–8).

marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura më lart lidhur me rolin qendror të Llukiqit në Shtabin e MPB-së si shef i këtij shtabi, Dhoma përfundon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ishte komandant *de facto* i forcave të MPB-së të dislokuara në Kosovë nga mesi i vitit 1998 deri në mes të vitit 1999. Në këto forca bënin pjesë policia e rregullt e SPB-ve dhe njësitë e PJP-së dhe SAJ-së. Ky fakt konfirmohet edhe nga letra e Stojilkoviçit dërguar Millutinoviçit me datë 11 maj 1999, ku ai rekomandon Llukiqin për ngritje në detyrë dhe shprehet Llukiqi “dallohët për komandim dhe kontroll të suksesshëm të njësive të MPB-së të angazhuara në parandalimin e terrorizmit në Kosovë dhe Metohi.”²⁶³⁵ Ndonëse në prova mungojnë urdhra luftimi me detyra konkrete për dislokimin e njësive të MPB-së, ekzistonin dallime midis organizimit dhe strukturës së MPB-së dhe të UJ-së, siç theksoi Mbrojtja e Llukiqit. Llukiqi nuk zëvendësoi Stevanoviçin, Gjorgjeviçin, ose Iliçin, shefat e SPB-ve ose komandantët e PJP-së dhe SAJ-së, por ishte hallka lidhëse midis këtyre komandantëve dhe politikave dhe planeve që përcaktonte Beogradi si edhe drejtpërsëdrejti i angazhuar në procesin e planifikimit dhe në mundësimin e kryerjes së operacioneve të përditshme të njësive të ndryshme të MPB-së në përputhje me këto plane.

6. Roli i Llukiqit në raportimin për Ministrinë e Brendshme

1052. Në bazë të vendimit për krijimin e shtabit të MPB-së të datës 16 qershor 1998, shefi i Shtabit të MPB-së kishte për detyrë t’i “raportonte ministrit për veprimet e tij, veprimet e shtabit dhe aspektet e sigurisë në territorin nën përgjegjësinë e shtabit; të informonte ministrin për zhvillimet lidhur me situatën e sigurisë, për masat e ndërmarra dhe rezultatet e këtyre masave.”²⁶³⁶ Cvetiqi konfirmoi se shefi i RJB-së Gjorgjeviçiqi ndonjëherë shkante në Kosovë për të marrë informacione dhe se Shtabi i MPB-së u dërgonte atij dhe ministrit informacion kur ata nuk ishin në Kosovë.²⁶³⁷ Adamoviçiqi tha se Shtabi i dorëzonte ministrisë së Brendshme raporte mbi “incidentet lidhur me gjendjen e sigurisë” në Kosovë.²⁶³⁸

1053. Janë marrë si prova raporte që Shtabi i MPB-së i dërgoi MPB-së në Beograd midis 1 janarit dhe 1 majit 1999.²⁶³⁹ Raportet nxjerrë para datës 29 mars 1999 iu dërguan ministrit të Brendshëm,

²⁶³⁵ 1D680 (Rekomandim për gradimin e Sreten Llukiqit si gjenerallejtënant, 11 maj 1999).

²⁶³⁶ P1505 (Vendim për ngritjen e një Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

²⁶³⁷ Lubinko Cvetiq, T. 8104–8105 (7 dhjetor 2006).

²⁶³⁸ Dushko Adamoviçiq, T. 24993 (8 prill 2008).

²⁶³⁹ 6D1156 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 janar 1999); 6D1157 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 janar 1999); 6D1158 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 janar 1999), pranuar gjithashtu me numrin P1228; 6D1151 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 janar 1999); 6D1207 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 shkurt 1999); 6D1208 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 shkurt 1999); 6D1152 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 26 shkurt 1999); 6D1153 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 27 shkurt 1999); 6D1155 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 mars 1999); 6D1221 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 13 mars 1999); 6D1222 (Raport i

shefit të RJB-së, shefit të RDB-së dhe organeve të tjera të Ministrisë, si Administratës së Policisë dhe shefave të SPB-ve në Kosovë.²⁶⁴⁰ Nga data 2 prill 1999 dhe më pas, raportet iu dërguan vetëm ministrit të Brendshëm, Vllajko Stojilkoviçit dhe shefit të RJB-së Vllastimir Gjorgjeviçit. Duke filluar nga 21 prilli 1999, në listën e marrësve u përfshi shefi i Administratës për Analiza, kurse nga data 24 prill 1999, edhe shefi i RDB-së Rade Markoviçi. Mirëpo raportet e hartuara pas datës 2

Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 14 mars 1999); 6D1223 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 15 mars 1999); 6D1224 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 mars 1999); 6D1225 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 17 mars 1999); 6D1226 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 18 mars 1999); 6D1227 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 19 mars 1999); 6D1228 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 20 mars 1999); 6D1229 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 mars 1999); 6D1230 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 22 mars 1999); 6D1231 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 mars 1999); 6D1232 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 mars 1999); 6D1233 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 25 mars 1999); 6D1234 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 26 mars 1999); 6D1235 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 27 mars 1999), pranuar gjithashtu si P1100; 6D1236 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 28 mars 1999); 6D1237 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 29 mars 1999); 6D1238 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 prill 1999); 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999); 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 4 prill 1999); 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 5 prill 1999); 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 6 prill 1999); 6D1243 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 7 prill 1999); 6D1244 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 8 prill 1999); 6D1245 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 9 prill 1999); 6D1246 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 10 prill 1999); 6D1248 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 12 prill 1999); 6D1249 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 13 prill 1999); 6D1250 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 14 prill 1999); 6D1251 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 15 prill 1999); 6D1252 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 prill 1999); 6D1254 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 18 prill 1999); 6D1255 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 19 prill 1999); 6D1256 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 20 prill 1999); 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 prill 1999); 6D1259 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 prill 1999); 6D1260 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 prill 1999); 6D1261 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 25 prill 1999); P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999).

²⁶⁴⁰ 6D1156 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 janar 1999); 6D1157 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 janar 1999); 6D1158 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 janar 1999), pranuar gjithashtu si P1228; 6D1151 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 janar 1999); 6D1207 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 shkurt 1999); 6D1208 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 shkurt 1999); 6D1152 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 26 shkurt 1999); 6D1153 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 27 shkurt 1999); 6D1155 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 mars 1999); 6D1221 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 13 mars 1999); 6D1222 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 14 mars 1999); 6D1223 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 15 mars 1999); 6D1224 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 mars 1999); 6D1225 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 17 mars 1999); 6D1226 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 18 mars 1999); 6D1227 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 19 mars 1999); 6D1228 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 20 mars 1999); 6D1229 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 mars 1999); 6D1230 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 22 mars 1999); 6D1231 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 mars 1999); 6D1232 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 mars 1999); 6D1233 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 25 mars 1999); 6D1234 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 26 mars 1999); 6D1235 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 27 mars 1999), pranuar gjithashtu si P1100; 6D1236 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 28 mars 1999); 6D1237 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 29 mars 1999).

prill 1999, nuk tregojnë nëse midis marrësve ishin edhe shefat e SPB-ve në Kosovë.²⁶⁴¹ Të gjitha këto raporte mbajnë emrin e shtypur të Sreten Llukiqit si nënshkrim.²⁶⁴²

1054. Raportet përmbanin përmbledhje të “ngjarjeve”, “ndodhive”, “dukurive”, dhe “informacione” të tjera lidhur me “sigurinë”.²⁶⁴³ Para fushatës ajrore të NATO-s, ato trajtonin kryesisht “sulme terroriste”, “provokime të terroristëve”, “persona të ndaluar për t’u marrë në pyetje lidhur me pjesëmarrje në sulme terroriste mbi pjesëtarë të policisë dhe UJ-së”, “numrin e shkeljeve të rënda”, “aksidente të rënda rrugore në të cilat ishin përfshirë makina zyrtare”, dhe “incidente zjarri, shkatërrime dhe shpërthime”. Nga data 26 mars 1999, raportet përfshinin informacion mbi “pasoja të bombardimeve të NATO-s”, kurse nga data 2 prill 1999 ato përfshinin edhe numrin e “personave të kombësisë shqiptare dhe kombësive të tjera që kishin ikur” nga Kosova. Kjo ishte rrjedhojë e urdhrat të Llukiqit të datës 1 prill 1999 dërguar SPB-ve që të evidentonin numrin e shqiptarëve që po largoheshin nga Kosova nëpërmjet vendkalimeve kufitare në zonat e tyre të përgjegjësisë.²⁶⁴⁴

1055. Asnjë raport nuk përmbante informacion mbi operacionet e kryera nga njësitë e MPB-së ose mbi punën e tyre, edhe pse në to raportohet kur pjesëtarë të MPB-së ose UJ-së u përgjigjeshin sulmeve të UÇK-së. Për shembull, më 2 prill 1999 u raportua se ishte kryer një sulm mbi personelin e MPB-së në komunën e Skenderajt dhe se “policia iu përgjigj sulmit në mënyrën e duhur.”²⁶⁴⁵ Më 3 prill, Llukiqi raportoi se një ditë më parë, në afërsi të fshatit Greben në Ferizaj, ishte kryer një sulm terrorist mbi policinë. Rrjedhimisht, gjatë një operacioni “spastrimi”, u lënduan

²⁶⁴¹ 6D1238 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 prill 1999); 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999); 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 4 prill 1999); 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 5 prill 1999); 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 6 prill 1999); 6D1243 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 7 prill 1999); 6D1244 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 8 prill 1999); 6D1245 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 9 prill 1999); 6D1246 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 10 prill 1999); 6D1248 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 12 prill 1999); 6D1249 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 13 prill 1999); 6D1250 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 14 prill 1999); 6D1251 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 15 prill 1999); 6D1252 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 16 prill 1999); 6D1254 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 18 prill 1999); 6D1255 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 19 prill 1999); 6D1256 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 20 prill 1999); 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 prill 1999); 6D1259 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 prill 1999); 6D1260 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 prill 1999); 6D1261 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 25 prill 1999); P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999).

²⁶⁴² Ndonëse përkthimi në anglisht i 6D1222 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 14 mars 1999) nuk vë në dukje që Llukiqi nënshkroi raportin, origjinali në të vërtetë është i nënshkruar me emrin e tij.

²⁶⁴³ *Shih p.sh.*, P1228 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 janar 1999); P1100 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 27 mars 1999); P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999).

²⁶⁴⁴ 6D808 (Letër e Shtabit të MPB-së dërguar shefave të SPB-ve të Kosovës, 1 prill 1999), f. 2.

²⁶⁴⁵ 6D1238 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 prill 1999), f. 2.

tre pjesëtarë të PJP-së. Operacioni i “spastrimit ” u ndërpre për shkak të rezistencës së fuqishme të luftëtarëve të UÇK-së.²⁶⁴⁶ Raporti i Shtabit të MPB-së i datës 4 prill 1999 bën të ditur se më 3 prill, pas një sulmi terrorist kundër pjesëtarëve të SPB-së së Ferizajt dhe UJ-së në Greben, “ata iu përgjigjën fuqimisht zjarrit dhe i shpartalluan bandat terroriste.”²⁶⁴⁷ Raporti gjithashtu theksonte që pas një sulmi terrorist në komunën e Vushtrrisë “sulmet kishin marrë përgjigjen e duhur.”²⁶⁴⁸

1056. Raportet gjithashtu trajtonin krime të rastit si vjedhje, marrje makinash dhe plaçkitje të kryera nga pjesëtarë të UJ-së, të SPB-ve dhe civilë.²⁶⁴⁹ Në to gjithashtu raportohej për të vrarë dhe të lënduar nga radhët e UJ-së dhe MPB-së. Për shembull, raporti i datës 21 prill 1999 përmend një “sulum terrorist” në komunën e Prishtinës, gjatë të cilit ishte vrarë një oficer i MPB-së; dhe raporti i datës 23 prill 1999 informonte se pesë pjesëtarë të UJ-së ishin vrarë dhe kufomat e tyre ishin djegur gjatë një “sulmi terrorist” në komunën e Glogocit.²⁶⁵⁰ Raportet trajtonin raste të gjetjes së kufomave të paidentifikuara të civilëve dhe masat ligjore të mëtejshme ndërmarrë nga policia ose gjykatësi hetues. Për shembull, raporti i datës 3 prill 1999 thekson se 30 kufoma të paidentifikuara ishin gjetur në Skënderaj, rreth 25 kufoma të djegura në afërsi të Krushës së Vogël, dhe 11 kufoma të paidentifikuara burrash të moshën midis 25 dhe 35 vjeç në fshatin Mamushë në komunën e Prizrenit.²⁶⁵¹

1057. Miroslav Mijatoviqi dëshmoi se raportin e datës 1 maj 1999 e kishte “hartuar Shtabi, në bazë të raporteve ditore të sekretariateve për punë të brendshme në Kosovë dhe Metohi [dhe] më pas ai iu dërgua Ministrisë së Brendshme”.²⁶⁵² Pjesa më e madhe e raporteve nuk tregojnë se mbi çfarë baze i kishte hartuar Shtabi i MPB-së. Megjithatë, raporti i datës 10 prill 1999 shpjegonte se në të nuk ishin përfshirë incidentet nga komuna e Gjilanit, prej të cilës ende nuk kishin marrë raporte, fakt që sugjeron se zakonisht raportet përgatiteshin në bazë të informacioneve marrë nga SPB-të e ndryshme.²⁶⁵³

1058. Procesverbali i mbledhjes së datës 28 korrik 1998, në të cilën mori pjesë Stojilkoviqi, gjithashtu tregon se Llukiqi si shef i Shtabit të MPB-së i raportonte Ministrisë së Brendshme. Gjatë kësaj mbledhjeje, Llukiqi “raportoi mbi masat dhe veprimet e njëjësive të policisë midis 25 dhe 28

²⁶⁴⁶ 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999), f. 4.

²⁶⁴⁷ 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 4 prill 1999), f. 3.

²⁶⁴⁸ 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 4 prill 1999), f. 2.

²⁶⁴⁹ *Shih, p.sh.*, 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 5 prill 1999), f. 3–5; 6D1245 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 9 prill 1999), f. 4.

²⁶⁵⁰ 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 prill 1999), f. 2; 6D1259 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 prill 1999), f. 2.

²⁶⁵¹ 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999), f. 2–3.

²⁶⁵² Miroslav Mijatoviqi, T. 22464 (15 shkurt 2008); *shih* P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999); *shih gjithashtu* Lubinko Cvetiq, T. 8165–8166 (8 dhjetor 2006).

²⁶⁵³ 6D1246 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 10 prill 1999), f. 4.

korrikut 1998 që kishin për qëllim zhbllokimin e rrugëve dhe disa qytezave në bazë të Planit ... si dhe mbi aksionet (konkrete) që ishin ndërmarrë dhe detashmentet që i kishin kryer ato.”²⁶⁵⁴ Ai më tej theksoi se “faza e dytë e Planit të Përgjithshëm ishte kryer në përputhje me afatin e përcaktuar, me dhjetë detashmente.”²⁶⁵⁵ Lidhur me aksionet e kryera në bashkërendim me UJ-në, ai dha një “shpjegim të hollësishëm për vendet ku ishin kryer aksionet dhe për arritjet, duke i treguar drejtimit e aksionit dhe gjëra të tjera në hartën topografike”.²⁶⁵⁶

1059. Dhoma përfundon se fakti që Shtabi i MPB-së merrte raporte të ndryshme nga SPB-të, i mblidhte ato dhe i dërgonte në Beograd, tregon edhe më tepër se Llukiqi luante rol aktiv në koordinimin e shkëmbimit të informacionit midis forcave të MPB-së në Kosovë dhe selisë së MPB-së në Beograd.²⁶⁵⁷

7. Pjesëmarrja e Llukiqit në armatosjen e civilëve joshqiptarë

1060. Prokuroria pretendon se Llukiqi mori pjesë në armatosjen e civilëve joshqiptarë nëpërmjet ngritjes së RPO-ve në Kosovë që nga korriku 1998.²⁶⁵⁸ Mirëpo Mbrojtja e Llukiqit argumenton se ai nuk kishte kontroll mbi RPO-të, pasi ato “përbëheshin kryesisht nga rekrutë të UJ-së dhe shumë pak policë rezervistë, dhe se me mobilizimin ato u shpërbënë me që rekrutët e UJ-së shkuan në detyrat e tyre luftarake.”²⁶⁵⁹ Mbrojtja e Llukiqit madje lë të kuptohet se RPO-të në thelb ishin njësi të UJ-së që ishin nën ngrehinën e njërive të mbrojtjes civile dhe ruajtjes civile.

1061. Ka prova të konsiderueshme shkresore dhe gojore lidhur me RPO-të, dhe pjesa më e madhe e tyre u diskutuan në Nënpjesën VI.A.3. Në veçanti, një raport i SPB-së së Mitrovicës i datës 1 korrik 1998, dërguar Shtabit të MPB-së, vë në dukje se në RPO-të e ndryshme që ishin ngritur në fshatrat anëmbanë Kosovës ishin përfshirë persona që ishin policë aktivë, anëtarë të forcave rezerviste të policisë, dhe rezervistë të UJ-së.²⁶⁶⁰ Mijatoviqi tha se RPO-të “përbëheshin nga rezervistë të Ministrisë së Punëve të Brendshme ose më saktë, policë dhe forca rezerviste të njërive të Mbrojtjes Territoriale.”²⁶⁶¹ Cvetiqi tha që RPO-të përbëheshin nga “qytetarë që kishin vendshërbimin e kohës së luftës madje edhe në bazë të ndonjë detyrimi tjetër. Për shembull, personat që ishin caktuar me detyrë në mbrojtjen civile ose në njësitë vendore të Ushtrisë së

²⁶⁵⁴ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3.

²⁶⁵⁵ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998).

²⁶⁵⁶ P3121 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998).

²⁶⁵⁷ Emri i Llukiqit është i shtypur në fund të çdo raporti, por ai nuk i nënshkroi me dorën e tij.

²⁶⁵⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1016–1026.

²⁶⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 465–474.

²⁶⁶⁰ P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës dërguar Shtabit të MPB-së, 1 korrik 1998) (përmban RPO-të e ndryshme që ishin formuar, emrat e komandantëve dhe zëvendëskomandantëve të tyre).

²⁶⁶¹ Miroslav Mijatoviqi, T. 22343 (13 shkurt 2008).

Jugosllavisë, dhe detyra e vetme e tyre ishte mbrojtja e fshatrave.”²⁶⁶² Cvetiqi përshkroi përkimin midis anëtarëve të RPO-ve dhe organeve ushtarake-territoriale në Kosovë, të cilat ishin përgjegjëse për rekrutimin dhe mobilizimin e rregullt dhe sipas nevojës të rezervistëve për UJ-në.²⁶⁶³ Këto organe ushtarake armatosnin “njësitë” me armë automatike dhe gjysmëautomatike. Kur këto “njësi” nuk përdoren nga organet ushtarake-territoriale, ato angazhohen si pjesë e RPO-ve.²⁶⁶⁴

1062. Këto prova konfirmohen nga një telegram i komandantit të Qarkut Ushtarak të Prishtinës Vojkan Saviqit, dërguar Llukiqit më 1 korrik 1998, ku ai informon Llukiqin se organet e MPB-së në Kosovë po caktonin “një numër gjithnjë e më të madh të [detashmenteve ushtarake] në organet dhe njësitë e policisë në detyra luftarake. Ata po e bëjnë këtë pa pëlqimin ose dijeninë e organeve përgjegjëse ushtarake-territoriale.”²⁶⁶⁵ Saviqi gjithashtu raportoi se pjesa më e madhe e organeve ushtarake-territoriale kishin marrë detyrat e tyre luftarake brenda strukturave të tjera mbrojtëse.

1063. Një raport i SPB-së së Mitrovicës i datës 1 korrik 1998, drejtuar Shtabit të MPB-së, vë në dukje se SPB-ja e Mitrovicës kishte shpërndarë 1.060 pushkë automatike dhe gjysmëautomatike, dhe bën të ditur se 735 armë tytëgjata u ishin dhënë anëtarëve të RPO-ve në zonën e përgjegjësisë së këtij sekretariati.²⁶⁶⁶ Cvetiqi tha se anëtarëve të RPO-ve u ishin dhënë edhe mitralozë të lehtë.²⁶⁶⁷ UJ-ja u kishte shpërndarë anëtarëve të RPO-ve anëmbanë Kosovës edhe 7.436 armë të tjera.²⁶⁶⁸ Cvetiqi dhe Filiqi shpjeguan se RPO-të nuk kishin ndonjë objekt ose depo të veçantë dhe për këtë arsye armët iu dhanë individëve të cilët i mbanin ato nëpër shtëpitë e tyre.²⁶⁶⁹

1064. Më 10 korrik 1998, Llukiqi u dërgoi komandantëve të njësisve të ndryshme organizative të MPB-së në Kosovë një telegram në të cilin i udhëzonte që të organizonin mbrojtjen e fshatrave duke i angazhuar RPO-të e sapokrijuara, dhe të kryenin stërvitje. Nga ata gjithashtu kërkohet që të

²⁶⁶² Lubinko Cvetiq, T. 8051, 8055 (7 dhjetor 2006).

²⁶⁶³ Lubinko Cvetiq, T. 8055 (7 dhjetor 2006). Megjithatë, Cvetiqi nuk saktësoi nëse e kishte fjalën për RPO-të, mbrojtjen civile ose ruajtjen civile.

²⁶⁶⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8055 (7 dhjetor 2006); *shih gjithashtu* P1115 (Pasqyrë e numrit të armëve të dhëna nga UJ-sipas komunave në territorin e SPB-së në Kosovë dhe Metohi).

²⁶⁶⁵ 4D521 (Paralajmërim i Komandës së Qarkut Ushtarak për Sreten Llukiqin).

²⁶⁶⁶ P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës drejtuar Shtabit të MPB-së lidhur me realizimin e detyrave). Dokumenti nuk jep numrin e përgjithshëm të pushkëve automatike dhe gjysmëautomatike që ishin shpërndarë por saktëson numrin e armëve të shpërndara në çdo DPB ose stacion të policisë. Shifrat e lartpërmendura paraqesin shumën e shifrave të raportuara. *Shih gjithashtu* P1582 (Listë e anëtarëve të RPO-së të cilëve u ishin dhënë pushkë automatike dhe gjysmëautomatike).

²⁶⁶⁷ Lubinko Cvetiq, T. 8061 (7 dhjetor 2006).

²⁶⁶⁸ P1115 (Pasqyrë e numrit të armëve dhënë nga UJ sipas komunave në territorin e SPB-së në Kosovë dhe Metohi); *shih* P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës drejtuar Shtabit të MPB-së lidhur me realizimin e detyrave) (që vë në dukje se në disa raste, UJ-ja u kishte dhënë armë anëtarëve të RPO-së).

²⁶⁶⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8061 (7 dhjetor 2006); Bozhidar Filiqi, T. 24013–24014 (10 mars 2008).

përgatisnin një dosje me vlerësimet e rreziqeve ndaj RPO-ve, detyrat e tyre, planin për stërvitje, dhe të tjera. Raportet lidhur me veprimtaritë e RPO-ve duhej t'i dërgoheshin Shtabit të MPB-së.²⁶⁷⁰

1065. Cvetiqi shpjegoi se RPO-të ishin të organizuara mbi bazën e parimit ushtarak, që donte të thoshte se ato kishin një komandant ose udhëheqës skuadre, dhe numrin e nevojshëm të policëve.²⁶⁷¹ Komandanti i çdo RPO-je i dorëzonte raporte komandantit të stacionit policor që mbulonte fshatin përkatës.²⁶⁷² Më pas, komandanti përkatës i policisë u jepte komandantëve të RPO-ve udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave. Vendimet lidhur me veprimtaritë e RPO-ve i merrte komanda e MPB-së në Beograd, Shtabi i MPB-së, SPB-të, DPB-të ose stacionet e policisë, varësisht nga situata e sigurisë.²⁶⁷³

1066. Gjatë mbledhjes së datës 4 prill 1999, të mbajtur në Shtabin e MPB-së, Llukiqi udhëzoi shefat e SPB-ve të Kosovës dhe shefat e njësisve të ndryshme speciale të policisë që t'u kushtonin vëmendje të posaçme RPO-ve gjatë përdorimit të municionit dhe minave.²⁶⁷⁴ Më 7 maj 1999, Llukiqi udhëzoi shefat e SPB-ve të Kosovës që anëtarët e RPO-ve mund të mbanin uniformat e policisë ose ushtrisë vetëm gjatë kohës që kryenin detyra si rezervistë të policisë ose UJ-së.²⁶⁷⁵ Ky udhëzim u përsërit edhe në dokumentin që nxori Shtabi i MPB-së pas mbledhjeve të datës 7 dhe 11 maj 1999 në Shtabin e MPB-së.²⁶⁷⁶

1067. Në bazë të këtyre provave, Dhoma arrin në përfundimin se Llukiqi, si shef i Shtabit të MPB-së, u përfshi në krijimin e RPO-ve dhe në armatosjen e anëtarëve të tyre. Dhoma gjithashtu konkludon se Llukiqi ushtronte pushtet mbi RPO-të, të cilat ishin nën varësinë e SPB-ve, puna e të cilave kontrollohej dhe drejtohej nga Shtabi i MPB-së së bashku me MPB-në në Beograd.

8. Implikimi i Llukiqit në shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit

1068. Siç u tha më sipër, pas nënshkrimit të Marrëveshjeve të Tetorit, MPB-ja kishte detyrimin që të pakësonte numrin e pjesëtarëve të saj në terren. Prokuroria pretendon se MPB-ja i shkeli këto marrëveshje duke mos e pakësuar numrin e policëve në Kosovë dhe duke vazhduar me përdorimin

²⁶⁷⁰ P2804 (Telegram i Shtabit të MPB-së drejtuar komandantëve të njësisve organizative të MPB-së në Kosovë).

²⁶⁷¹ Lubinko Cvetiq, T. 8051 (7 dhjetor 2006).

²⁶⁷² Lubinko Cvetiq, T. 8052–8053 (7 dhjetor 2006).

²⁶⁷³ Lubinko Cvetiq, T. 8053 (7 dhjetor 2006).

²⁶⁷⁴ P1989 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 3.

²⁶⁷⁵ P1996 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 12; 6D802 (Konkluzione të mbledhjeve të Shtabit të MPB-së të datës 7 dhe 11 maj 1999), para. 19.

²⁶⁷⁶ 6D802 (Konkluzione të mbledhjeve të Shtabit të MPB-së të datës 7 dhe 11 maj 1999), para. 19.

e armëve të rënda.²⁶⁷⁷ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se MPB-ja përmbushi detyrimet e saj që dilnin nga marrëveshjet dhe zvogëloi numrin e forcave të saj në Kosovë.²⁶⁷⁸

1069. Miroslav Mijatoviqi dhe Lubinko Cvetiqi dëshmuar se pas marrëveshjeve, MPB-ja zvogëloi numrin e përgjithshëm të policëve të pranishëm në Kosovë në 10.021 policë.²⁶⁷⁹ Klaus Naumann-i e konfirmoi këtë numër duke pohuar se MPB-ja tërhoqi 5.000 deri në 6.000 forca policore.²⁶⁸⁰ Për mendimin e tij, fillimisht Millosheviqi iu përmbajt detyrimit duke tërhequr policë nga Kosova që të mbetej një numër prej rreth 10.000 policësh.²⁶⁸¹ Mirëpo, Naumann-i shtoi se informacionet e mëvonshme të OSBE-së dhe KDOM-it vunë në dukje se në krahinë ishin rreth 500 policë më shumë se numri i lejuar.²⁶⁸² Në nëntor 1998, dolën raporte mbi përdorimin e forcës së tepruar, ngritjen e postbllloqeve të reja dhe ridislokimin e policisë.²⁶⁸³ Millosheviqi u vu në dijeni për dhjetë incidente mes dhjetorit 1998 dhe janarit 1999, të cilat sipas Naumann-it ishin shembuj të shkeljeve të qarta të Marrëveshjeve të Tetorit.²⁶⁸⁴

1070. Në një mbledhje të kolegjiut të UJ-së që u mbajt më 3 dhjetor 1998, Obradoviqi raportoi se pavarësisht nga kërkesat me shkrim të UJ-së, MPB-ja vazhdonte të refuzonte t'i kthente UJ-së 20 autoblanda dhe 23 mortaja, gjë që ishte në kundërshtim me detyrimet dalë nga Marrëveshjet e Tetorit.²⁶⁸⁵ Në mbledhjen e kolegjiut të UJ-së të datës 24 dhjetor 1998, Ojdaniqi informoi të pranishmit se gjatë takimit të tij me Clark-un, ai e kishte pyetur se “pse [UJ-ja] nuk i kishte përmbushur detyrimet e marrëveshjes [së Tetorit] për tërheqjen e të gjitha pajisjeve të rënda që i kishte dhënë MPB-së për përdorim”.²⁶⁸⁶ Dimitrijeviqi konfirmoi se Ojdaniqi e kishte fjalën për të njëjtat pajisje që i kishte përmendur edhe Obradoviqi në mbledhjen e kolegjiut të datës 3 dhjetor, dhe shtoi se MPB-ja po e “hiqte zvarrë” këtë çështje dhe se për mendimin e tij pajisjet nuk u kthyen asnjëherë.²⁶⁸⁷

1071. Prokuroria pohon se me armatosjen e popullatës vendase joshqiptare dhe anëtarëve të RPO-ve në veçanti, MPB-ja iu shmang kufizimeve imponuar nga Marrëveshjet e Tetorit, dhe pretendon

²⁶⁷⁷ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 78, 1021–1022.

²⁶⁷⁸ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 41–54.

²⁶⁷⁹ Miroslav Mijatoviq, T. 22278 (13 shkurt 2008); Lubinko Cvetiq, T. 8198 (8 dhjetor 2006); *shih gjithashtu* 6D800 (Përfundime nga mbledhja e Shtabit të MPB-së, 25 tetor 1998).

²⁶⁸⁰ Klaus Naumann, T. 8263–8264 (13 dhjetor 2006), P2512 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02–54–T), T. 6969–6970, 6994–6995, 7056–7059.

²⁶⁸¹ Klaus Naumann, T. 8277 (13 dhjetor 2006), T. 8376–8378 (14 dhjetor 2006); 3D377 (Artikull i David Morison botuar në *Labour and Trade Union review*, nëntor- dhjetor, 2000, i cili citon Gjeneralin Naumann).

²⁶⁸² Klaus Naumann, T. 8380–8382 (14 dhjetor 2006).

²⁶⁸³ Klaus Naumann, T. 8263–8265 (13 dhjetor 2006).

²⁶⁸⁴ Klaus Naumann, T. 8269–8270 (13 dhjetor 2006).

²⁶⁸⁵ 3D557 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 3 dhjetor 1998), f. 19.

²⁶⁸⁶ P924 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 25–26.

se Llukiqi u përpoq të mashtronte KVM-në lidhur me numrin e vërtetë të forcave policore.²⁶⁸⁸ Këtë argument Prokuroria e mbështet duke iu referuar procesverbalit të mbledhjes së mbajtur në Shtabin e MPB-së më 2 nëntor 1998, në të cilën morën pjesë shefat e SPB-ve të Kosovës dhe komandantët e njësisve të PJP-së. Në këtë mbledhje të drejtuar nga Llukiqi u miratua përfundimi në vijim:

Siguroni që serbët dhe anëtarët e RPO-ve të mos keqpërdorin armët, të mos shtinë me armë në dasma, festa familjare fetare *slava*, festa lamtumirëse dhe kështu me radhë, mos mbani ose shfaqni armët publikisht në prani të anëtarëve të Misionit. Gjatë shërbimit të rojës, përdorni një armë dhe mos lejoni që individët të sjellin armën që u është dhënë. U thoni që të mos tregojnë se serbët janë të armatosur dhe në rast se janë të detyruar t'a shpjegojnë këtë fakt, le të arsyetohen duke thënë se vetëm rojet janë të armatosur.²⁶⁸⁹

1072. Në Pjesën VI.D, Dhoma nxori përfundimin se numri i efektivave të UJ-së dhe MPB-së u rrit, në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit, dhe se MPB-ja mbajti armatimet dhe pajisjet e rënda që duhej t'ia kthente UJ-së. Gjithsesi duke u bazuar në provat e lartpërmendura, Dhoma nuk mund të nxjerrë përfundimin se Shtabi i MPB-së, ose Llukiqi si shef i tij, ishin përgjegjës për këto shkelje.

9. Kontrolli i Llukiqit mbi stacionet e policisë kufitare

1073. Në dosjen e vetë përfundimtare, Mbrojtja e Llukiqit parashtroi se Shtabi i MPB-së dhe Llukiqi si shef i Shtabit nuk kishin kontroll mbi stacionet e policisë kufitare në Kosovë. Pretendohet se nuk ishte e mundur që Shtabi i MPB-së të komandonte stacionet e policisë kufitare, sepse Shtabi i MPB-së nuk ishte njësi organizative e MPB-së. Gjithashtu argumentohet se stacionet e policisë kufitare ishin drejtpërsëdrejti dhe nga aspekti organizativ të lidhura me Administratën e Policisë Kufitare në Beograd, dhe rrjedhimisht nuk ishin nën varësinë e SPB-ve vendore.²⁶⁹⁰ Ndonëse Prokuroria nuk paraqiti argumente konkrete lidhur me kontrollin e Llukiqit mbi postat kufitare në Kosovë, Aktakuza pretendon se Llukiqi kishte kontroll mbi të gjitha njësitë e MPB-së në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës.²⁶⁹¹

1074. Në mbështetje të argumenteve të veta, Mbrojtja e Llukiqit mbështetet në dëshmitë e Mijatoviqit, Adamoviqit, Vuçureviqit, Dujkoviqit dhe Ognjenoviqit, të cilët thanë se stacionet e policisë kufitare i raportnin Administratës së Policisë Kufitare në Beograd dhe jo Degëve të Policisë Kufitare të SPB-ve përkatëse të Kosovës.²⁶⁹² Mbrojtja gjithashtu mbështetet në provat

²⁶⁸⁷ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26606–26610 (8 korrik 2008).

²⁶⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 15 korrik 2008 (version publik), para. 1021–1022.

²⁶⁸⁹ P3130 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 3 nëntor 1998), para. 8.

²⁶⁹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 451–463.

²⁶⁹¹ Aktakuza, para. 66.

²⁶⁹² Dushko Adamoviq, T. 25053 (9 prill 2008), 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit e datës 30 mars 2008), para. 20; Miroslav Mijatoviq, T. 22205 (12 shkurt 2008); Petar Dujkoviq, T. 23315–23316 (27 shkurt 2008); Nebojsa Ognjenoviq, T. 22848, 22855 (20 shkurt 2008); Radovan Vuçureviq, T. 23047, 23071 (22 shkurt 2008). Dhoma vëren se dëshmia që iu atribuuu Vuçureviqit ishte në fakt dëshmi e Dragan Milenkoviqit.

shkresore, si për shembull shkresat zyrtare që pjesëtarët e vendkalimit kufitar të Vërbnicës i dërguan Administratës së Policisë Kufitare në Beograd, dhe disa urdhra dërguar drejtpërsëdrejti stacioneve të policisë kufitare nga Beogradi, duke argumentuar se këto prova dëshmojnë se stacionet e policisë kufitare ishin nën kontrollin e drejtpërdrejtë të selisë në Beograd dhe jo nën kontrollin e SPB-ve përkatëse të Kosovës ose Shtabit të MPB-së.²⁶⁹³

1075. Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat përkatëse, Dhoma gjykon se nuk është provuar që Shtabi i MPB-së ose Llukiqi si shef i tij, kishte kontroll mbi stacionet e policisë kufitare në Kosovë. Gjithsesi, ky konkluzion nuk ndikon në përfundimet lidhur me përgjegjësinë e tij penale të paraqitura më poshtë.

10. Dijenia e Llukiqit për krimet

1076. Prokuroria pretendon se gjatë ofensivës së verës së vitit 1998, Llukiqi dinte se operacionet e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë shkaktuan shpërnguljen masive të shqiptarëve kosovarë dhe kryerjen e krimeve të gjerësisht të përhapura kundër tyre. Prokuroria mbështetet në faktin se në verën e vitit 1998, Llukiqi ishte rregullisht i pranishëm në mbledhjet e Komandës së Përbashkët gjatë të cilave u bë bashkërendimi i Planit pesëfazësh kundër Terrorizmit.²⁶⁹⁴ Për më tepër, Prokuroria argumenton se më 1999, ekzistonte informacion për krimet në dispozicion të Llukiqit nga kanale të ndryshme, si për shembull sistemi i raportimit në MPB, pjesëmarrja e tij në mbledhjet e Shtabit të MPB-së, pjesëmarrja e tij në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, dhe takimet e tij me eprorë të lartë të MPB-së dhe UJ-së, dhe politikanë.²⁶⁹⁵

1077. Mbrojtja e Llukiqit kundërpërgjigjet se Llukiqi nuk dinte se më 1998 ose 1999 u kryen krime, ose nuk u ndëshkuan, për arsye se Shtabi i MPB-së nuk dispononte një informacion të tillë.²⁶⁹⁶ Në mbështetje të këtij pretendimi, Mbrojtja citon dëshminë e Millosh Deretiçit, punonjës në SPB-në e Prishtinës, i cili e ndihmonte Shtabin e MPB-së në sistemin e ndërlihdjes. Mbrojtja pretendon se, së pari, Shtabi i MPB-së nuk kishte nyjën e vet të ndërlihdjes ose centralin e vet telefonik, kështu që ishte i detyruar të mbështetej në SPB-në e Prishtinës për ndërlihdje;²⁶⁹⁷ së dyti, njësitë në terren i raportonin drejtpërsëdrejti SPB-ve dhe më pas MPB-së në Beograd “duke

²⁶⁹³ 6D1497 (Notë zyrtare e stacionit të policisë kufitare të Vërbnicës, datë 27 mars 1999); 6D1498 (Notë zyrtare e stacionit të policisë kufitare të Vërbnicës, datë 6 qershor 1999); 6D266 (Telegrami Nr. 1066 i Sektorit të Sigurisë Publike, 1 korrik 1998); 6D129 (Telegram i UKP-së, datë 1 dhjetor 1998).

²⁶⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1045–1054.

²⁶⁹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1055–1067.

²⁶⁹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 539–596.

²⁶⁹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 541–558.

përdorur linja paralele në shtabin e MPB-së për të marrë informacione”;²⁶⁹⁸ së treti, për shkak të bombardimeve të NATO-s mbi ndërtesën e Shtabit të MPB-së, sistemi i ndërlidhjes u dëmtuar keqazi dhe për këtë arsye, për të marrë informacione Shtabi i MPB-së ishte i detyruar të përdorte kryesisht korrierë.²⁶⁹⁹ Rrjedhimisht, për shkak të sistemit të dobët të ndërlidhjes, ishte e pamundur për Llukiqin që të kishte dijeni të mjaftueshme për kryerjen e krimeve. Së fundi, pretendohet se informacioni që i dërgohej Shtabit të MPB-së nuk përfshinte raporte luftimi të PJP-ve.²⁷⁰⁰

1078. Më poshtë Dhoma do të analizojë provat lidhur me këtë çështje për sa u përket ngjarjeve më 1998 dhe 1999.

a. Dijeni për krimet më 1998

1079. Siç u diskutua më lart, në vitin 1998, Llukiqi mori pjesë rregullisht në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, në të cilat diskutoheshin çështje të ndryshme, si për shembull, operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së, kriza e “refugjatëve”, dhe nevoja për të disiplinuar forcat e RFJ-së dhe Serbisë.²⁷⁰¹ Llukiqi gjithashtu takohej rregullisht me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilët e informonin lidhur me veprimet e mundshme kriminale të MPB-së në Kosovë.

1080. Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët mbajtur nga Gjakoviqi treguan se shpeshherë gjatë këtyre mbledhjeve u diskutuan zjarrvëniet e qëllimshme të kryera nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë. Për shembull, në një mbledhje të datës 7 gusht 1998, Shainoviqi theksoi se “dëmin më të madh po na e shkaktojnë djegiet e panevojshme të shtëpive, të cilat mund të shkaktojnë presion mbi vendin”.²⁷⁰² Në një mbledhje të mbajtur më 12 gusht, Miniqi udhëzoi të pranishmit se u duhej dhënë fund djegieve të shtëpive.²⁷⁰³ Më vonë, në një mbledhje më 1 shtator, Shainoviqi tha se detyrat duheshin realizuar në mënyrë të disiplinuar me qëllim shmangien e zjarrvënieve.²⁷⁰⁴ Më 7 shtator 1998, edhe Gjorgjeviqi paralajmëroi lidhur me persona që po u vinin zjarrin shtëpive.²⁷⁰⁵

1081. Për më tepër, anëtarët e Komandës së Përbashkët diskutuan operacione konkrete të MPB-së dhe UJ-së dhe incidentet përkatëse. Për shembull, më 26 shtator 1998, Pavkoviqi raportoi se

²⁶⁹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 559–567.

²⁶⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 568–590.

²⁷⁰⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 591–596.

²⁷⁰¹ *Shih në përgjithësi* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët).

²⁷⁰² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 46.

²⁷⁰³ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52.

²⁷⁰⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 125. Edhe pse data e kësaj mbledhjeje mund të mos jetë shënuar saktë, kjo nuk ndryshon përfundimet e Dhomës.

“përfundoi operacioni në zonën e Abrisë së Epërme dhe Abrisë së Poshtme. Rezistenca ishte e fuqishme por [UÇK-ja] ishte kufizuar në një zonë më të vogël.”²⁷⁰⁶ Urdhrat e Pavkoviqit për këtë operacion janë marrë si prova dhe tregojnë se ky ishte një operacion i përbashkët i MPB-së dhe UJ-së.²⁷⁰⁷ Gjithsesi ai u ankua se mospjesëmarrja e JSO-së kishte ndikuar në disa humbje në radhët e MPB-së dhe tha se pas këtij operacioni ishin vërejtur “refugjatë” në afërsi të fshatit Tërdec. Po në këtë mbledhje, Llukiqi konfirmoi se ky operacion faktikisht kishte përfunduar dhe se “njësitë ishin bashkuar.”²⁷⁰⁸ Në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të datës 4 tetor 1998, në të cilën mori pjesë edhe Llukiqi, Shainoviqi tha se duhej filluar një hetim në Abrinë e Epërme.²⁷⁰⁹

1082. Për më tepër, siç u tha më sipër, Llukiqi kontaktonte vazhdimisht me përfaqësuesit e KDOM-it dhe KVM-së në Kosovë, të cilët e informonin për konstatimet e tyre. Shaun Byrnes-i dëshmoi se në gusht dhe shtator 1998, ekipi i tij thajse çdo ditë shihte se si PJP-ja dhe njësi të tjera policore digjinin fshatra, shkatërronin të lashta, vrisnin bagëtinë, frikësonin civilë shqiptarët kosovarë dhe i dëbonin ata nga shtëpitë e tyre. Byrnes-i dëshmoi se “për këtë informoi veçanërisht gjeneral Llukiqin, i cili [me sa kishte kuptuar ai] ishte në krye të policisë serbe në Kosovë.”²⁷¹⁰ Byrnes-i gjithashtu përshkroi një incident që e kishte parë vetë nga mesi ose fundi i shtatorit 1998: gjatë një vizite në Kosovën perëndimore, ai pa njësitë e PJP-së kur po largoheshin nga një fshat në jug të fshatit Kijevë. Ai pa qartë se fshati nuk kishte banorë dhe po digjej. Ai shpjegoi se askush nuk po përpiquej t'a shuante zjarrin.²⁷¹¹ Byrnes-i informoi Llukiqin për këtë ngjarje.²⁷¹² Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Byrnes-it iu sugjerua se kishte shkuar aty pas luftimeve të ashpra midis UÇK-së dhe “forcave serbe” në zonë. Byrnes-i tha se nuk dinte nëse ishte zhvilluar një betejë e tillë.²⁷¹³ Megjithatë, pyetjet e Mbrojtjes nuk e komprometuan dëshminë se njësitë e PJP-së qëndronin duarkryq gjatë kohës që po digjeshin shtëpitë nëpër fshatrat e braktisura.

1083. Sipas Byrnes-it, kur i paraqiste Llukiqit, të cilin ai e përshkroi si “person lehtësisht i disponueshëm”, informacione lidhur me krimet e MPB-së, Llukiqi përgjithësisht i mohonte këto incidente, ose pranonte që ato kishin ndodhur por si përgjigje ndaj sulmeve të UÇK-së.²⁷¹⁴ Byrnes-i gjithashtu raportoi për një ngjarje që kishte ndodhur në zonën e Pejës në shtator 1998, ku forcat e MPB-së kryen një operacion kundër fshatrave që mendonin se ishin baza të UÇK-së. Gjatë këtij

²⁷⁰⁵ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 96.

²⁷⁰⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 129.

²⁷⁰⁷ 6D700 (Urdhër i PrK-së, 24 shtator 1998).

²⁷⁰⁸ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 129.

²⁷⁰⁹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 136; IC-199 (Shtojcë e P1468), f. 7.

²⁷¹⁰ Shaun Byrnes, T. 12149–12150, 12152–12153 (16 prill 2007).

²⁷¹¹ Shaun Byrnes, T. 12148–12149 (16 prill 2007).

²⁷¹² Shaun Byrnes, T. 12148–12151 (16 prill 2007).

²⁷¹³ Shaun Byrnes, T. 12208 (16 prill 2007).

operacioni, fshatarët shqiptarë kosovarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u detyruan të qëndronin jashtë në pyll. Byrnes-i dëshmoi se, kur mediat ndërkombëtare filluan të raportonin mbi këtë incident, MPB-ja dërgoi forca në atë zonë dhe “efektivisht mblodhi [fshatarët në tufë dhe i ktheu nëpër shtëpitë e tyre] me autobusë të policisë.”²⁷¹⁵ Byrnes-i e fotografoi këtë ngjarje dhe raportoi se shqiptarët e shpërngulur kosovarë ishin të tmerruar që pjesëtarët e policisë, të cilët ndonjëherë përdorën dhunë të panevojshme, i detyruan ata kundër vullnetit të tyre të lirë të hipnin në autobusët e MPB-së. Kur Byrnes-i iu ankua Llukiqit për këtë, reagimi i tij ishte se ky ishte një “operacion humanitar.”²⁷¹⁶

1084. Siç u tha më sipër, në një mbledhje të mbajtur më 24 dhjetor 1998, Drewienkiewicz-i informoi Llukiqin se kishte marrë raporte të pakonfirmuara që MBP-ja po përdorte forcë të tepruar në rajonin e Fushë-Kosovës. Drewienkiewicz-i gjithashtu theksoi se operacioni që po vazhdonte në Podujevë, përbënte shkelje të rëndë të armëpushimit dhe i bëri thirrje Llukiqit që të merrte masat e nevojshme në këtë drejtim.²⁷¹⁷ Mirëpo Llukiqi nuk pranoi që ishte një veprim i pavend dhe refuzoi që të merrte masa në këtë drejtim.²⁷¹⁸

1085. Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare pretendonte se krimet e përhapura gjerësisht, të kryera nga UJ-ja dhe MPB-ja më 1998, kishin shkaktuar shpërnguljen e dhunshme të mbi 230.000 shqiptarëve kosovarë.²⁷¹⁹

1086. Në bazë të të gjitha provave të paraqitura lidhur me këtë aspekt, Dhoma arrin në përfundimin se Llukiqi ishte në dijeni të akuzave të rënda për veprime kriminale të forcave të MPB-së në periudhën nga mesi e deri në fund të vitit 1998, kundër popullatës civile shqiptare kosovare. Për më tepër, Dhoma ka konkluduar se disa nga këto incidente faktikisht ishin shembuj të forcës së tepruar të ushtruar forcat e RFJ-së dhe Serbisë më 1998, siç është përmendur në Pjesën VI.C.

b. Dijenia për krimet më 1999

1087. Prokuroria pretendon se vartësit e Llukiqit e informonin rregullisht për ngjarjet në terren më 1999. Sipas Prokurorisë, një nga kanalet konkrete nëpërmjet të cilave Llukiqi informohej ishin

²⁷¹⁴ Shaun Byrnes, T. 12151–12153 (16 prill 2007).

²⁷¹⁵ Shaun Byrnes, T. 12154 (16 prill 2007).

²⁷¹⁶ Shaun Byrnes, T. 12153–12155 (16 prill 2007).

²⁷¹⁷ P2544 (Pikat kryesore nga takimi midis Llukiqit dhe Drewienkiewicz-it, 24 dhjetor 1998).

²⁷¹⁸ Karol John Drewienkiewicz, T. 7785–7786 (4 dhjetor 2006).

²⁷¹⁹ P456 (Rezoluta 1199 e KSKB-së, 23 shtator 1998), f. 1; *shih gjithashtu* P455 (Rezoluta 1160 e KSKB-së, 31 mars 1998), f. 1.

mbledhjet e Shtabit të MPB-së, të cilat i drejtonte ai; në këto mbledhje, shefat e SPB-ve të Kosovës dhe komandantët e njësive speciale të MPB-së raportnin lidhur me veprimtaritë e tyre.²⁷²⁰

1088. Mbrojtja e Llukiqit përgjigjet se gjatë bombardimeve të NATO-s, Shtabi i MPB-së kishte informacion të kufizuar për shkak të vështirësive teknike, infrastrukturës fizike të ndërlidhjes në Kosovë, të kushteve të luftës dhe për arsye se njësitë e MPB-së në terren nuk ishin të detyruara t'i raportnin Shtabit të MPB-së.²⁷²¹

1089. Në kundërshtim me argumentet që paraqiti Mbrojtja e Llukiqit, Adamoviçi dëshmoi se Shtabi i MPB-së merrte raporte nga njësitë e PJP-së dhe SAJ-së në terren, si dhe SPB-të e Kosovës.²⁷²² Asnjë nga këto raporte nuk u paraqit si provë. Cvetiqi gjithashtu dëshmoi se Shtabi i MPB-së merrte informacione nga SPB-të, dhe se njësi të ndryshme luftarake të MPB-së ishin të detyruara t'i raportnin shefit të Shtabit të MPB-së.²⁷²³

1090. Në fakt, Shtabi i MPB-së dhe Llukiqi si shef i tij kishin mundësi të ndryshme raportimi. në dispozicion. Rregullorja e Brendshme e MPB-së serbe, ndryshuar më 1996, përcaktonte se shtatë SPB-të e Kosovës ishin të detyruara që t'u dërgonin mesazhe si MPB-së në Beograd, po ashtu edhe Shtabit të MPB-së në Kosovë.²⁷²⁴ Për më tepër, më 21 tetor 1998, Llukiqi udhëzoi shefat e SPB-ve të Kosovës që të dërgonin raporte ditore urgjente me informacione për “aksionet terroriste”, përkrahje të sulmeve, dhe reagimet përkatëse të policisë.²⁷²⁵ Cvetiqi tha se këto udhëzime parashkruanin metodologjinë e njëjtë që do të përdorej dhe që ishte e detyrueshme për të gjitha SPB-të.²⁷²⁶ Këtë e konfirmoi edhe Miroslav Mijatoviçi.²⁷²⁷ Më 15 shkurt 1999, zëvendës shefi për Çështje Operative në MPB, Vesko Petroviçi, urdhëroi të gjithë përgjegjësit e ndërrimeve në stacionet e policisë anembanë Kosovës që t'i raportnin Shtabit të MPB-së në Kosovë dhe MPB-së në Beograd lidhur me çdo incident në zonat e tyre të përgjegjësisë.²⁷²⁸ Për më tepër, në fillim të fushatës së NATO-s, ministri për Punë të Brendshme udhëzoi të gjitha njësitë organizative të MPB-së në Kosovë që t'i raportnin Shtabit të MPB-së në Kosovë si dhe MPB-së në Beograd për çdo

²⁷²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1006–1008.

²⁷²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 541–590.

²⁷²² Dushko Adamoviçi, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 50.

²⁷²³ Lubinko Cvetiq, T. 8166, 8195 (8 dhjetor 2006).

²⁷²⁴ P10444 (Listë ndryshimesh bërë rregullores organizative të MPB-së, 19 prill 1996), f. 3.

²⁷²⁵ P2528 (Urdhër i Sretin Llukiqit për shefat të SPB-ve të Kosovës më 21 tetor 1998), seksioni b; *shih gjithashtu* 6D808 (Letër e Shtabit të MPB-së dërguar shefave të SPB-ve të Kosovës, 1 prill 1999) (për aktualizimin e formës së raporteve me qëllim që të përfshijnë informacion lidhur me bombardimet e NATO-s dhe numrin e shqiptarëve kosovarë që po largohen nga Kosova përmes vendkalimeve kufitare).

²⁷²⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8096–8098 (7 dhjetor 2006).

²⁷²⁷ Miroslav Mijatoviçi, 6D1492 (deklaratë e dëshmitarit, datë 6 shkurt 2008), para. 11.

²⁷²⁸ P1092 (Udhëzime drejtuar DPB-ve dhe stacioneve policore të Kosovës, 15 shkurt 1999).

incident lidhur me sigurinë.²⁷²⁹ Një raport i Shtabit të MPB-së i datës 10 prill 1999 drejtuar Ministrisë së Brendshme, nënshkruar nga Llukiqi, bënte të ditur se në të nuk ishin përfshirë incidentet nga SPB-ja e Gjilanit, “raportet e të cilës ende nuk ishin marrë”.²⁷³⁰ Siç u diskutua më sipër, kjo lë të kuptohet që raportet ditore zakonisht hartoheshin në bazë të informacionit që SPB-të i dërgonin Shtabit të MPB-së, dhe rrjedhimisht, Llukiqi si shef i Shtabit të MPB-së çdo ditë merrte informacion të përditësuar lidhur me ngjarjet në gjithë Kosovën.

1091. Dijenia e Llukiqit për krimet e kryera në Kosovë mund të shihet edhe nga raporti që ai i dërgoi MPB-së në Beograd më 3 prill 1999. Në këtë raport, ai shkruan se më 1 prill, në fshatin Mamushë të Prizrenit pjesëtarë të policisë kishin gjetur 11 kufoma burrash të panjohur të moshës 25-35 vjeçare. Më pas, kufomat u shënuan me numra nga 1 deri në 11 dhe varrosur në varrezat myslimane me urdhër të gjykatësit hetues. Në raportin e tij, Llukiqi gjithashtu theksonte se më 1 prill, në zonën e përgjithshme të komunës së Skenderajt, ishin gjetur 30 kufoma të paidentifikuara “burrash të vrarë gjatë operacioneve nga bandat terroriste shqiptare”, nga të cilat gjashtë ishin identifikuan.²⁷³¹ Me urdhër të gjykatësit hetues, kufomat u varrosën në varrezat myslimane. Në fund, raporti bën të ditur se më 2 prill “25 kufoma të djegura burrash të panjohur u gjetën në disa shtëpi të pronarëve të panjohur, tek udhëkryqi për në qilarin e verës *Kosovo vino* në Krushë të Vogël”.²⁷³² Me urdhër të gjykatësit hetues, kufomat u shënuan me numra nga 1 deri 25 dhe u varrosën në varrezat myslimane.²⁷³³ Raporte të tjera ditore përmbajnë përshkrime të gjetjes së kufomave të tjera të paidentifikuara në komuna të ndryshme.

1092. Gjatë intervistës së tij, Llukiqi tha se sapo MPB-ja mori informacione lidhur me varret e përbashkëta në Izbicë dhe Pastasellë, MPB-ja veprimi në përputhje me ligjin dhe informoi gjykatat përkatëse që ishin përgjegjëse për atë zonë. Më pas, një gjykatës hetues lëshoi një urdhër dhe kufomat u ekzaminuan, identifikuan dhe varrosën. Sipas Llukiqit, ekzaminimi i kufomave konfirmoi se viktimat ishin anëtarë të UÇK-së të vrarë gjatë luftimeve, meqë shumica prej tyre kishin plagë të shkaktuara nga armë zjarri.²⁷³⁴ Dhoma citon përfundimin e vet se së paku 93 viktima të Izbicës, shumica e të cilëve ishin të moshuar, nuk ishin vrarë në luftime.

1093. Më 1 prill 1999, Llukiqi udhëzoi shefat e SPB-ve të Kosovës për njëtrajtshmëri në raportim, sipas të cilave ata detyroheshin që t’i paraqisnin Shtabit të MPB-së raporte lidhur me bombardimet

²⁷²⁹ 6D238 (Telegram i Vllajko Stojilkoviçit, 24 mars 1999), pika 9.

²⁷³⁰ 6D1246 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 10 prill 1999), f. 4.

²⁷³¹ 6D1239 ((Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999), f. 2.

²⁷³² 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999), f. 2–3.

²⁷³³ 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999), f. 3.

²⁷³⁴ P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 160–162.

e NATO-s, krimet e kryera në zonat përkatëse të përgjegjësisë dhe “veprimtaritë terroriste”.²⁷³⁵ Më 4 prill, Llukiqi udhëzoi përsëri komandantët e PJP-së, SAJ-së dhe JSO-së si dhe SPB-të e Kosovës që t'i raportnin Shtabit të MPB-së.²⁷³⁶ Më 6 maj, shefave të SPB-ve të Kosovës iu dërgua një telegram që mbante emrin e Llukiqit, ku thuhet se “që nga fillimi i agresionit të NATO-s mbi vendin tonë, për shkak të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të sigurisë, në territorin e Kosovës janë kryer krime dhe veprime të paligjshme në një mënyrë të re.”²⁷³⁷ Rrjedhimisht, shefat e SPB-ve u udhëzuan që të mblidhnin informacione lidhur me krimet më të rënda, si vrasje, përdhunime, keqtrajtime, dhe zjarrvëniet të qëllimshme dhe këto informacione t'ia dërgonin shtabit të MPB-së dy herë në muaj.²⁷³⁸ Më 15 maj 1999, Llukiqi u dërgoi shefave të SPB-ve të Kosovës dhe shefit të Degës së Policisë për Krime një telegram ku i urdhëronte që t'i dërgonin një pasqyrë të krimeve nga fillimi i bombardimeve të NATO-s.²⁷³⁹ Më 28 maj 1999, pak pasi Tribunali nxori Aktakuzë kundër Sllobodan Millosheviqit, Vllajko Stojilkoviqit dhe të tjerëve, Shtabi i MPB-së u dërgoi shefave të SPB-ve të Kosovës dhe shefit të OKP-së një telegram ku i udhëzonte që të dërgonin informacion lidhur me numrin e krimeve të kryera për të cilat ishte bërë kallëzim penal, numrin e ndërtesave të djegura si pasojë e zjarrvënies së qëllimshme, dhe numrin e kufomave të gjetura brenda periudhës 24 mars – 25 maj 1999.²⁷⁴⁰

1094. Veç kësaj, disa dokumente marrë si prova mbështesin përfundimin se faktikisht Llukiqi kishte dijeni të hollësishme për situatën në terren në Kosovë, përfshirë numrin e madh të personave të shpërngulur. Në telegramin e datës 3 prill 1999, Llukiqi udhëzoi shefat e SPB-ve të Kosovës dhe komandantët e detashmenteve të PJP-së që të parandalonin dëbimin e dhunshëm të popullatës shqiptare kosovare.²⁷⁴¹ Më 15 prill 1999, Llukiqi dërgoi edhe një telegram ku theksonte se pavarësisht nga urdhri paraprak i datës 5 prill, disa nga komandantët nuk po e respektonin urdhrin dhe po “ toleronin largime masive të popullatës civile.”²⁷⁴² Dhoma vëren se nga 24 marsi e deri më 5 prill 1999, 613.530 shqiptarë kosovarë u larguan nga krahina.²⁷⁴³ Largimet masive vazhduan edhe pas telegramit të Llukiqit, dhe nga 5 prilli deri më 30 prill 1999, gjithsej 101.628 shqiptarë

²⁷³⁵ 6D808 (Urdhër i Sreten Llukiqit dërguar SPB-ve të Kosovës, 1 prill 1999).

²⁷³⁶ P1989 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4.

²⁷³⁷ 6D874 (Udhëzime të Sreten Llukiqit dërguar shefave të SPB-ve të Kosovës, 6 maj 1999).

²⁷³⁸ 6D874 (Udhëzime të Sreten Llukiqit dërguar shefave të SPB-ve të Kosovës, 6 maj 1999).

²⁷³⁹ 6D876 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 15 maj 1999).

²⁷⁴⁰ P1188 (Telegram nga Shtabi i MPB-së, 28 gusht 1999).

²⁷⁴¹ 6D666 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 3 prill 1999).

²⁷⁴² 6D778 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 15 prill 1999).

²⁷⁴³ 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 6 prill 1999), f. 6.

kosovarë të tjerë ishin larguar duke e çuar numrin e përgjithshëm të personave të larguar nga krahina në 715.158.²⁷⁴⁴

1095. Në intervistën e tij me Prokurorinë, Llukiqi përshkroi një mbledhje të mbajtur në maj 1999 në një vilë në Beograd. Mbledhja ishte organizuar nga Millosheviqi dhe në të pranishëm ishin edhe Millutinoviqi, Shainoviqi, Pavkoviqi, Ojdaniqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi dhe Stevanoviqi.²⁷⁴⁵ Lubisha Stojimiroviqi, i cili atëherë ishte shefi i Shtabit të Armatës së Tretë, konfirmoi se në fillim të muajit maj, Llukiqi dhe Pavkoviqi shkuan për të takuar Millosheviqin.²⁷⁴⁶ Dhoma ka konkluduar më parë se mbledhja së cilës iu referua Llukiqi është e datës 4 maj, pas marrjes së një letre nga Prokurorja e atëhershme e Tribunalit, Louise Arbour, në të cilën ajo shprehu shqetësimin e saj të thellë për kryerjen e përsëritur të shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë.²⁷⁴⁷ Sipas një artikulli në media lidhur me mbledhjen, gjatë mbledhjes u paraqitën informacione se forcat e sigurimit të UJ-së kishin trajtuar raste të shumta të dhunës, vrasjeve, plaçkitjeve dhe krimeve të tjera, dhe kishin arrestuar disa qindra keqbërës, krimet e të cilëve paraqitnin rrezik të madh për popullatën civile.²⁷⁴⁸ Dy ditë pas mbledhjes, Llukiqi lëshoi një urdhër ku u kërkonte vartësve që të lexonin artikullin në gazetën *Politika* dhe t'u përmbaheshin udhëzimeve të tij.²⁷⁴⁹

1096. Më 11 maj 1999, në një mbledhje në Shtabin e MPB-së, Llukiqi iu drejtua komandantëve të detashmenteve të PJP-së dhe i urdhëroi që gjatë planifikimit të operacioneve të garantonin “parashikimin e masave dhe trajtimin e civilëve në zonën e veprimit dhe operacioneve.”²⁷⁵⁰ Dijenia e Llukiqit për lëvizjet e shqiptarëve kosovarë përtej kufijve gjithashtu konfirmohet nga raportet e nënshkruara nga Llukiqi që Shtabi i MPB-së në Kosovë i dërgonte çdo ditë Ministrisë së Brendshme në Beograd, të cilat përmbanin numrin e shqiptarëve kosovarë që kishin ikur nga krahina.²⁷⁵¹

²⁷⁴⁴ P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999), f. 8.

²⁷⁴⁵ P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 142–143.

²⁷⁴⁶ Lubisha Stojimiroviq, T. 17684 (26 tetor 2007).

²⁷⁴⁷ *Shih në përgjithësi* P398 ((Letër nga Louise Arbour dërguar Millosheviqit, 26 mars 1999); P399 (Letër nga Louise Arbour dërguar Millutinoviqit, 26 mars 1999); P400 (Letër nga Louise Arbour dërguar Nikolla Shainoviqit, 26 mars 1999); P401 (Letër nga Louise Arbour dërguar Dragolub Ojdaniqit, 26 mars 1999).

²⁷⁴⁸ P1696 (Shefat e Ushtrisë dhe Policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme, Raport i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

²⁷⁴⁹ 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit lidhur me artikullin në gazetën *Politika*, 6 maj 1999), pranuar gjithashtu si P2159.

²⁷⁵⁰ P1993 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 8.

²⁷⁵¹ 6D1232 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 mars 1999); 6D1236 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 28 mars 1999), pranuar gjithashtu si P1099; 6D1238 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 2 prill 1999); 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 3 prill 1999); 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 4 prill 1999); 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 5 prill 1999); 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 6 prill 1999); 6D1244 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme,

1097. Për këto arsye, Dhoma konkludon se Llukiqi si shef i Shtabit të MPB-së kishte informacione të hollësishme lidhur me veprimtaritë e MPB-së në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, përfshirë kryerjen e krimeve, dhe hedh poshtë argumentin e Llukiqit se ai kishte vetëm informacion të kufizuar.

c. Pjesëmarrja e Llukiqit në fshehjen e kufomave

1098. Prokuroria pretendon se Llukiqi u përpoq të fshihte vrasjet e kryera nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, duke argumentuar se gjatë konfliktit të vitit 1999, pjesëtarë të MPB-së transportuan kufomat e shqiptarëve kosovarë nga Kosova në vendvarrime të përbashkëta të ndryshme të fshehta në Serbi, gjegjësisht në Petrovo Sellë dhe Batajnicë, dhe se Llukiqi mori pjesë në këtë operacion.²⁷⁵² Në mbështetje të këtij argumenti, Prokuroria citon kryesisht dëshminë e Bozhidar Protiqit, një shofer i MPB-së, i cili dëshmoi se gjatë vitit 1999 transportoi tri herë kamionë të ngarkuar me kufoma nga Kosova për në pjesë të tjera të Serbisë sipas udhëzimeve të Llukiqit, ndër të tjerë.

1099. Ndonëse nuk e kundërshton përfshirjen e Protiqit në transportimin e kufomave, Mbrojtja e Llukiqit argumenton se dëshmia e Protiqit është kundërthënëse, e pabesueshme dhe e frymëzuar nga hakmarrja e tij personale ndaj Llukiqit, i cili nënshkroi vendimin për daljen në pension të Protiqit më 2001.²⁷⁵³ Mbrojtja citon dëshminë e Çedomir Shakiqit që shoqëroi Protiqin në disa nga udhëtimet e tij; të Dragan Furdulloviqit, i cili ishte anëtar i grupit të punës së MPB-së që ngrii Llukiqi në 2001 për të hetuar kamionin-frigorifer të mbushur me kufoma që u gjet në lumin Danub; të Aleksandar Kostiqit, i cili ishte anëtar i degës së MPB-së për hetime të krimeve të luftës, që u krijua nga grupi fillestar i punës; dhe të Gvozden Gagiqit, i cili drejtonte degën për vrasje dhe krimet seksuale në seksionin për krime të përgjithshme të administratës së policisë për krime të MPB-së. Furdulloviqi, Kostiqi dhe Gagiqi intervistuan Protiqin gjatë punës së tyre lidhur me përfshirjen e tij në transportimin e kufomave.

1100. Më 27 gusht 2002, Gagiqi intervistoi Protiqin në zyrat e MPB-së, kurse shënimet nga intervista i mbajti Kostiqi.²⁷⁵⁴ Në fund të vitit 2003, Protiqi u intervistua nga gjykatësi hetues

8 prill 1999); 6D1254 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 18 prill 1999); 6D1255 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 19 prill 1999); 6D1256 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 20 prill 1999); 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 21 prill 1999); 6D1259 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 23 prill 1999); 6D1260 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 24 prill 1999); 6D1261 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 25 prill 1999); P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së dërguar Ministrisë së Brendshme, 1 maj 1999).

²⁷⁵² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 1033–1040.

²⁷⁵³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (version publik), para. 1408–1421.

²⁷⁵⁴ P3134 (Deklaratë e Protiqit dhënë MPB-së, 27 gusht 2002).

Millan Dillpariq.²⁷⁵⁵ Në vitin 2006, Protiqi i dha një deklaratë zëvendësprokurorit për Krime të Luftës, Dragolub Stankoviçit.²⁷⁵⁶ Më 8 shkurt 2007, thujse një muaj përpara se të jepte dëshmi në këtë çështje, Protiqi dëshmoi në gjykatën e Qarkut të Beogradit lidhur me operacionin në të cilin mori pjesë si shofer i MPB-së.²⁷⁵⁷ Në vitin 2006, policia intervistoi edhe Çedomir Shakiqin.²⁷⁵⁸

1101. Gjatë dëshmisë së tij, Protiqi shpjegoi se kishte punuar si shofer i MPB-së, i punësuar në Administratën e Serbisë për Punë të Përbashkëta.²⁷⁵⁹ Në fillim të vitit 1999, ai transportoi tri herë kufoma nga Kosova për në pjesë të tjera të Serbisë, dhe një herë nga Tekija për në Serbinë lindore, për në bazën e Batajnicës në afërsi të Beogradit.²⁷⁶⁰ Gjatë udhëtimit të parë për në Kosovë, ai mori udhëzime nga shefi i Administratës për Punë të Përbashkëta, gjeneral Zekoviçi, që të shkonte në Prishtinë te një firmë me emrin *Gemaks*.²⁷⁶¹ Zekoviçi gjithashtu i dha një numër të posaçëm telefoni që për mendimin e Protiqit ishte numër Beogradit. Ai u udhëzua që pasi të arrinte në Prishtinë të telefononte në këtë numër pa kodin e hyrjes, për të marrë udhëzime të mëtejshme.²⁷⁶² Sipas Protiqit, ai veprimi sipas udhëzimeve, duke përdorur telefonin fiks në ndërtesën e MPB-së në Prishtinë, dhe foli me një person zërin e të cilit e njohu si të Sreten Llukiqit.²⁷⁶³ Protiqi shpjegoi se e njohte zërin e Llukiqit sepse gjatë vitit 1990 kishte punuar kohë pas kohe si shofer jozyrtar i tij, dhe se e njohte Llukiqin prej dhjetë vjetësh.²⁷⁶⁴ Në deklaratën dhënë Gjykatës Speciale për Krime të Luftës në Beograd në vitin 2007, ai tha se ishte “thellësisht i bindur” dhe 99.9 për qind i sigurt se kishte folur me Llukiqin.²⁷⁶⁵ Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja në këtë çështje, Protiqi dëshmoi se ishte 90 - 99 për qind i sigurt se në telefon kishte qenë Llukiqi.²⁷⁶⁶ Ai ishte kategorikisht kundër sugjerimit të Mbrojtjes se personi në telefon ishte Gjorgjeviçi.²⁷⁶⁷ Gjithashtu doli se gjatë udhëtimit të parë për në Kosovë, ai thjesht hyri në një zyrë në ndërtesën kryesore dhe përdori një

²⁷⁵⁵ P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin).

²⁷⁵⁶ P2817 (Deklaratë e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviçi).

²⁷⁵⁷ P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd); *shih gjithashtu* Bozhidar Protiq, T. 11308–11310 (9 mars 2007).

²⁷⁵⁸ Çedomir Shakiq, T. 22102–22103 (11 shkurt 2008).

²⁷⁵⁹ P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 4.

²⁷⁶⁰ P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 3, 15; Bozhidar Protiq, T. 11320–11323 (9 mars 2007).

²⁷⁶¹ P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 4; Bozhidar Protiq, T. 11324–11325, 11354 (9 mars 2007).

²⁷⁶² Bozhidar Protiq, T. 11324–11325 (9 mars 2007).

²⁷⁶³ Bozhidar Protiq, T. 11324–11326 (9 mars 2007); P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 19, 27.

²⁷⁶⁴ Bozhidar Protiq, T. 11130–11131, 11380, 11399–11402 (9 mars 2007); P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 2.

²⁷⁶⁵ P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 19, 27; Bozhidar Protiq, T. 11367 (9 mars 2007).

²⁷⁶⁶ Bozhidar Protiq, T. 11367 (9 mars 2007).

²⁷⁶⁷ Bozhidar Protiq, T. 11370 (9 mars 2007).

telefon të rastësishëm dhe jo telefonin që ishte i sigurt se kishte linjë të Beogradit. Kjo do të thotë se ai nuk mund të ishte i sigurt nëse atë ditë kishte folur me Beogradin ose Prishtinën.²⁷⁶⁸

1102. Protiqi deklaroi që personi i cili ai besonte se ishte Llukiqi, e udhëzoi që të shkonte pas një makine Golf me ngjyrë të kuqërreme dhe ai veproi dhe më në fund arriti në Janjevë të komunës së Lipjanit ku u takua me police të atjeshëm. Njerëz që ai nuk i njihte ngarkuan kufomat në kamionin e Protiqit me ndihmën e një traktori.²⁷⁶⁹ Më tej, Protiqi i transportoi këto kufoma – rreth 17-19 syresh për në Petrovo Sellë.²⁷⁷⁰ Kur arriti atje, gropat ishin hapur.²⁷⁷¹

1103. Disa ditë më vonë, Zekoviqi udhëzoi përsëri Protiqin që të shkonte në Kosovë. Me të mbërritur atje, ai mori udhëzime me anë të telefonit nga personi që besonte se ishte Llukiqi, i cili i tha që t'i transportonte kufomat në Petrovo Sellë.²⁷⁷² Këtë herë, Protiqi grumbulloi mbi 50 kufoma²⁷⁷³ dhe ishte i shoqëruar nga pjesëtarë të MPB-së, ndër të cilët njëri ishte Çedomir Shakiqi.²⁷⁷⁴ Kësaj radhe ishte një gropë tjetër në Petrovo Sellë, rreth 50-60 metra larg nga e para,²⁷⁷⁵ tre ose katër burra me uniforma të ndryshme ishin të pranishëm gjatë kohës që ai shkarkoi kufomat, por ai nuk pa shenja të gradës në uniformat e tyre.²⁷⁷⁶

1104. Disa ditë më pas, Protiqi udhëtoi për në Kosovë për të tretën herë, përsëri sipas udhëzimeve të Zekoviqit. Këtë herë, ai i mori kufomat nga qendra e Prishtinës dhe i çoi në qendrën për njësi speciale në Batajnicë afër Beogradit.²⁷⁷⁷ Ndonëse ai faktikisht nuk i pa kufomat për shkak se kamioni ishte i mbyllur, atij i thanë që kishte përafërsisht 500 kufoma.²⁷⁷⁸ Lidhur me këtë udhëtim, Protiqi tha se kur telefonoi në numrin e posaçëm, zëri në telefon që për mendimin e tij ishte i Llukiqit i tha që të shkonte te parkingu pas ndërtesës së Rilindjes në Prishtinë, ku do të takonte një njeri që kishte një kamion të cilin ai [Protiqi] mund ta merrte. Personi në telefon gjithashtu i tha që t'i çonte kufomat në bazën e Batajnicës.²⁷⁷⁹ Mirëpo, më vonë, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, ai tha se

²⁷⁶⁸ Bozhidar Protiq, T. 11361–11363 (9 mars 2007).

²⁷⁶⁹ Bozhidar Protiq, T. 11326 (9 mars 2007).

²⁷⁷⁰ Bozhidar Protiq, T. 11322 (9 mars 2007); P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 4–5.

²⁷⁷¹ P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 4.

²⁷⁷² Bozhidar Protiq, T. 11327 (9 mars 2007).

²⁷⁷³ Bozhidar Protiq, T. 11322 (9 mars 2007). I pyetur për numrin e kufomave që u transportuan gjatë këtij udhëtimi, dëshmitari tha: “Pesëdhjetë e pesë ose pesëdhjetë e gjashtë. Mbi pesëdhjetë”. P2824 (Transkripti i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 15.

²⁷⁷⁴ P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 4; Bozhidar Protiq, T. 11381–11382 (9 mars 2007) (seancë private).

²⁷⁷⁵ Bozhidar Protiq, T. 11322 (9 mars 2007); P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 11–12.

²⁷⁷⁶ P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 12.

²⁷⁷⁷ Bozhidar Protiq, T. 11323 (9 mars 2007).

²⁷⁷⁸ Bozhidar Protiq, T. 11323 (9 mars 2007); P2816 (Transkripti i intervistës së Protiqit me Dillpariqin), f. 4–5.

²⁷⁷⁹ Bozhidar Protiq, T. 11328 (9 mars 2007).

kjo nuk ishte e saktë dhe se në at udhëtim nuk kishte telefonuar në numrin e posaçëm.²⁷⁸⁰ Ai e mori me mend vendin në Prishtinë ku duhej të shkonte sepse atje kishte shumë automjete dhe policë.²⁷⁸¹ Këtë mospërputhje në dëshminë e tij, Protiqi ia atribuoi kohës së gjatë.²⁷⁸²

1105. Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja, Protiqit iu sugjerua se e vetmja arsye që ai akuzonte Llukiqin ishte se kishte një mëri personale kundër tij sepse Llukiqi nuk i kishte dhënë një apartament që kishte kërkuar ai [Protiqi] dhe për arsye se Llukiqi kishte nënshkruar dokumentet për daljen në pension të Llukiqit me kushte të pakënaqshme. Protiqi pranoi që ndjente armiqësi ndaj Llukiqit, por mohoi se kjo ishte arsyeja e dëshmisë së tij. Ai më tej konfirmoi se Llukiqi i kishte ofruar një apartament, por apartamentin e kishte zënë një polic i cili ishte lënduar në Kosovë dhe si rezultat i lëndimeve kishte mbetur invalid. Protiqi tha se më mirë do të jetonte në një tendë se sa kishte të bënte me nxjerrjen e atij polici nga apartamenti.²⁷⁸³ Për sa u përket problemeve lidhur me daljen e tij në pension, Protiqi pranoi se ishte prekur shumë që e kishin pensionuar në këtë mënyrë.²⁷⁸⁴

1106. Mbrojtja e Llukiqit paraqiti si dëshmitar Çedomir Shakiqin për të përgënjeshtuar disa aspekte të dëshmisë së Protiqit. Ai e shoqëroi Protiqin gjatë udhëtimeve për në Kosovë, edhe pse në një makinë tjetër, dhe deklaroi se gjatë udhëtimeve të tyre për në Kosovë, Protiqi asnjëherë nuk e përmendi emrin e Llukiqit.²⁷⁸⁵ Ai gjithashtu tha se Protiqi asnjëherë nuk kishte shkuar në ndërtesën e Shtabit të MPB-së në Prishtinë për të telefonuar; se asnjëherë nuk kishte përdorur telefonin fiks sepse kishte një celular; dhe të gjitha detyrat Protiqit iu dhanë në Beograd.²⁷⁸⁶ Shakiqi më tej dëshmoi se e kishte takuar Protiqin përsëri në vitin 2005, jashtë apartamentit të tij në Beograd, dhe se këtë herë Protiqi kishte sulmuar Llukiqin verbalisht duke thënë që kishte ndërmend të dëshmonte kundër tij në Tribunal për shkak të mërisë që kishte kundër tij lidhur me një zënkë për një apartament. Sipas Shakiqit, Protiqi i tha se i kishin premtuar 1.000 dollarë amerikanë në rast se do të jepte dëshmi.²⁷⁸⁷ Në vitin 2006, Shakiqi bisedoi me Protiqin në telefon dhe më pas u takua me të dy herë në shkurt të vitit 2007, në apartamentin e Protiqit. Protiqi i tha se kishte marrë ndihmë nga “administrata ose departamenti për krime të luftës” e/i MBP-së, për të dëshmuar në

²⁷⁸⁰ Bozhidar Protiq, T. 11361–11363 (9 mars 2007).

²⁷⁸¹ Bozhidar Protiq, T. 11360–11361 (9 mars 2007). Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, ai tha se kishte menduar që ata ishin policë vendorë ose rezervistë pasi kishte pare emblemat e tyre, dhe se kur kishte arritur, në vendparkim ndodheshin pesë ose gjashtë kamionë. Bozhidar Protiq, T. 11328 (9 mars 2007).

²⁷⁸² Bozhidar Protiq, T. 11363 (9 mars 2007).

²⁷⁸³ Bozhidar Protiq, T. 11344–11345, 11352–11353, 11388–11389, 11396–11398 (9 mars 2007).

²⁷⁸⁴ Bozhidar Protiq, T. 11388 (9 mars 2007).

²⁷⁸⁵ Çedomir Shakiq, T. 22100 (11 shkurt 2008).

²⁷⁸⁶ Çedomir Shakiq, T. 22080–22084 (11 shkurt 2008).

²⁷⁸⁷ Çedomir Shakiq, T. 22100–22101, 22107–22110, 22115–22116 (11 shkurt 2008).

këtë proces. Protiqi u shpreh se kishte ardhur koha e tij dhe se do t'a "varroste Llukiqin 50 metra nën tokë."²⁷⁸⁸

1107. Dhoma nuk i beson Shakiqit se dëshmia e Protiqit kundër Llukiqit motivohej nga ndjenja e armiqësisë për shkak të mërisë kundër tij. Dhoma thekson se Protiqi faktikisht nuk donte të dëshmonte në këtë proces. Më 14 dhjetor 2006, në mocionin e saj për urdhërparaqitje për të dëshmuar, Prokuroria shpjegoi që në të kaluarën Protiqi nuk u ishte përgjigjur fletëthirrjeve të shumta për intervistë me Zyrën e Prokurorisë në Beograd²⁷⁸⁹ dhe refuzoi të paraqitej vullnetarisht për të dëshmuar përpara Dhomës.²⁷⁹⁰ Më 19 janar 2007, Dhoma nxori një urdhërparaqitje për Protiqin për të dëshmuar.²⁷⁹¹ Protiqi refuzoi disa herë të merrte urdhërparaqitjen për të dëshmuar, dhe më 1 shkurt 2007, gjatë një bisede telefonike ai i tha një hetuesi të Prokurorisë se nuk kishte ndërmend të udhëtonte për në Hagë, se do të zhdukej dhe do t'a fikte telefonin që të mos mund t'a kontaktonin më.²⁷⁹² Rrjedhimisht, më 22 shkurt 2007, Dhoma lëshoi një fletarrestim *ex parte* dhe konfidencial, dhe një urdhër për dorëzimin e Bozhidar Protiqit.²⁷⁹³ Më pas, më 9 mars 2007, ky urdhër u tërhoq, pasi Prokuroria informoi Dhomën se Protiqi më në fund ishte i gatshëm të dëshmonte.²⁷⁹⁴ Dhoma konkludon se Protiqi tregoi haptazi mosgatishmëri për të dëshmuar, fakt që nuk përputhet aspak dhe është në kundërshtim të qartë me dëshminë e Shakiqit, sipas të cilës Protiqi ishte i etur të dëshmonte për shkak të dëshirës së tij për hakmarrje kundër Llukiqit.

1108. Dragan Furdulloviqi dëshmoi se në qershor 2001 u bënë së paku pesë intervista me Protiqin por se vetëm pas një interviste më 4 qershor 2001 u hartua një notë zyrtare, për arsye se Protiqi ishte shpesh i hutuar dhe jepte deklaratat jo të plota. Gjatë intervistave, Protiqi asnjëherë nuk përmendi Llukiqin lidhur me varret e përbashkëta, me transportimin e kufomave nga Kosova, dhe faktikisht nuk e përmendi aspak. Më 14 qershor 2001, vetë Furdulloviqi hapi varrin e përbashkët në Petrovo Sellë; Protiqi ishte i pranishëm por atij nuk i kujtohej vendi i saktë i gropave.²⁷⁹⁵

1109. Aleksandar Kostiqi dëshmoi lidhur me ngritjen e grupit të punës për hetimin e varreve të përbashkëta të zbuluara në Petrovo Sellë dhe Batajnicë. Me përfundimin e punës së tij më 1 tetor

²⁷⁸⁸ Çedomir Shakiq, T. 22107–22108 (11 shkurt 2008).

²⁷⁸⁹ Mocion i Prokurorisë për Lëshimin e Urdhërparaqitjeve, 14 dhjetor 2006, para. 11, Shtojca Konfidenciale C, para. 2–7.

²⁷⁹⁰ Mocion i Prokurorisë për Lëshimin e Urdhërparaqitjeve, 14 dhjetor 2006, para. 11, Shtojca Konfidenciale C.

²⁷⁹¹ Urdhërparaqitje për të dëshmuar, 19 janar 2007.

²⁷⁹² Kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për Fletarrestim për Dëshmitarin Bozhidar Protiq dhe Urdhër për Transferimin e tij në Tribunal, 8 shkurt 2007, para. 8; Raport konfidencial i Republikës së Serbisë lidhur me Dorëzimin e Urdhërparaqitjes për të dëshmuar dëshmitarit Bozhidar Protiq, 7 shkurt 2007, para. 3.

²⁷⁹³ *Prokurori kundër Protiqit*, Lënda Nr. IT-05-87-R77.1, Fletarrestim konfidencial dhe *ex parte* dhe Urdhër për dorëzimin e Bozhidar Protiqit, 22 shkurt 2007.

²⁷⁹⁴ *Prokurori kundër Protiqit*, Lënda Nr. IT-05-87-R77.1, Urdhër për Tërheqjen e Fletarrestimit dhe Urdhrit në vend të Aktakuzës, 9 mars 2007.

2001, në kuadër të MPB-së u formua një seksion i përhershëm për hetimin e krimeve të luftës dhe Kostiqi u bë anëtar i këtij seksioni.²⁷⁹⁶ Gjatë punës së tij, Kostiqi intervistoi Protiqin më shumë se 15 herë lidhur me çështjen e kamionit-frigorifer, që u diskutua në Pjesën VII.P. Ai tha se vetëm pas katër ose pesë intervistash hartohet procesverbal që në thelb ishte përmbledhje intervistash.²⁷⁹⁷ Sipas Kostiqit, Protiqi shpesh e ndryshonte tregimin e tij dhe jepte versione kundërthënëse për ngjarjet.²⁷⁹⁸ Kostiqi dëshmoi se Protiqi e përmendi Llukiqin për herë të parë në pranverë të vitit 2006, pas më shumë se shtatë intervistash.²⁷⁹⁹ Ekipi i hetuesve mbajti shënim deklaratat kundërthënëse të Protiqit gjatë intervistave. Mirëpo Kostiqi nuk i solli këto shënime për t'i paraqitur si prova në gjyq.²⁸⁰⁰ MPB-ja intervistoi të gjithë të dyshuarit për implikim në çështjen e kamionit-frigorifer, dhe askush nuk e përmendi Llukiqin.²⁸⁰¹ Hetimi i MPB-së nuk vërtetoi që Llukiqi të ishte implikuar në këtë çështje.²⁸⁰²

1110. Gvozden Gagiqi tha se ai “bëri një intervistë me Bozhidar Protiqin lidhur me dëshminë e tij, kur u thirr për të dëshmuar në Tribunalin e Hagës” në vitin 2006.²⁸⁰³ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Gagiqi qartësoi se Protiqin e kishte intervistuar në vitin 2002, përpara se të thirrej për intervistë në zyrën e Tribunalit në Beograd. Sipas Gagiqit, kjo ishte një procedurë e rregullt për arsye se pjesëtarët e MPB-së që ftoheshin nga Tribunali për intervistë, gëzonin të drejtën e ndihmës juridike dhe teknike përpara intervistave të tilla. Pa ia kërkuar askush, Gagiqi theksoi se MPB-ja “nuk u mbështet në asnjë dëshmitar; në të vërtetë, krejtësisht e kundërta.”²⁸⁰⁴ Gagiqi tha se Protiqi asnjëherë nuk kishte përmendur se zëri në anën tjetër të lidhjes telefonike ishte i Llukiqit.²⁸⁰⁵ Dhoma gjykon se është e logjikshme që intervista e Gagiqit, qëllimisht ose joqëllimisht, kishte efekt frikësues mbi Protiqin, dhe për këtë arsye kuptohet që Protiqi nuk përmendi emrin e Llukiqit si personi në anën tjetër të lidhjes telefonike.

1111. Dhoma vëren se, ndonëse Protiqi u intervistua shume herë lidhur me pjesëmarrjen e tij në transportimin e kufomave nga Kosova në Serbi,²⁸⁰⁶ ai e përmendi pjesëmarrjen e Llukiqit për herë

²⁷⁹⁵ Dragan Furdulloviq, T. 24709–24711 (1 prill 2008).

²⁷⁹⁶ Aleksandar Kostiq, T. 24097, 24099 (11 mars 2008).

²⁷⁹⁷ Aleksandar Kostiq, T. 24112, 24130–24132 (11 mars 2008).

²⁷⁹⁸ Aleksandar Kostiq, T. 24113, 24130 (11 mars 2008).

²⁷⁹⁹ Aleksandar Kostiq, T. 24113 (11 mars 2008).

²⁸⁰⁰ Aleksandar Kostiq, T. 24130–24133 (11 mars 2008).

²⁸⁰¹ Aleksandar Kostiq, T. 24117 (11 mars 2008).

²⁸⁰² Aleksandar Kostiq, T. 24119 (11 mars 2008); Dragan Furdulloviq, T. 24708 (1 prill 2008), T. 24738 (2 prill 2008).

²⁸⁰³ Gvozden Gagiq, T. 24466 (18 mars 2008).

²⁸⁰⁴ Gvozden Gagiq, T. 24528–24530 (19 mars 2008).

²⁸⁰⁵ Gvozden Gagiq, T. 24466 (18 mars 2008).

²⁸⁰⁶ P586 (Shënime të Grupit të Punës nga intervista me Bozhidar Protiqin, 4 qershor 2001); P3134 (Deklarata e dëshmitarit Bozhidar Protiq dhënë ekipit hetimor të MPB-së, 27 shtator 2002); P2816 (Transkript i intervistës së

të parë në intervistën e tij me Prokurorin e Dhomës për Krime të Luftës në Beograd në qershor të vitit 2006,²⁸⁰⁷ dhe e përsëriti këtë në shkurt të vitit 2007.²⁸⁰⁸ Gjithsesi ai shpjegoi se arsyeja pse nuk e kishte përmendur Llukiqin gjatë intervistës së parë ishte se kishte patur frikë për anëtarë të familjes së tij të ngushtë që punojnë në MPB.²⁸⁰⁹ Dhoma e gjykon këtë shpjegim të arsyeshëm dhe i beson Protiqit për këtë.

1112. Gjithashtu Dhoma thekson se në vitin 2001, kur u formua grupi hetimor i MPB-së, Llukiqi ishte shefi i RJB-së dhe ndihmësministër në MPB. Dhoma pranon shpjegimin e Protiqit se në vitin 2001 ai kishte patur frikë të përmendte emrin e Llukiqit, sidomos duke marrë parasysh faktin se në dhjetor të vitit 2001 u detyrua të dilte në pension.²⁸¹⁰

1113. Dhoma gjykon se ndonëse Protiqi sinqerisht mendonte se kishte folur me Llukiqin, mund të ketë gabuar, meqenëse në vitin 1999 nuk kishte patur rast për të biseduar me Llukiqin në telefon. Për më tepër, nën presion, duket se ai pranoi që ekzistonte dhjetë për qind mundësi që të mos ketë qenë Llukiqi. Pavarësisht nga fakti që Dhoma e çmon dëshminë e Protiqit në përgjithësi të besueshme, ajo është e mendimit se dëshmia e tij lidhur me identifikimin e Llukiqit nëpërmjet zërit, në këto rrethana, në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konkluduar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se personi në anën tjetër të linjës telefonike ishte Llukiqi. Rrjedhimisht, në mungesë të provave të tjera, Dhoma nuk mund të konkludojë se Llukiqi ishte i përfshirë drejtpërsëdrejti në fshehjen e kufomave.

11. Përfundime mbi përgjegjësinë e Sreten Llukiqit

1114. Prokuroria pretendon se Llukiqi është përgjegjës për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, si edhe për ndihmë dhe inkurajim të krimeve në Aktakuzë.²⁸¹¹ Prokuroria pretendon se Llukiqi kishte synimin për ta realizuar këtë plan të përbashkët dhe veprimet e tij—përfshirë edhe pjesëmarrjen e tij në organet komanduese, siç ishte, për shembull, Komanda e Përbashkët—tregojnë se ai synonte realizimin e

Protiqit me Dillpariqin); P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq); P2824 (Transkript i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd).

²⁸⁰⁷ P2817 (Deklarata e Protiqit dhënë Prokurorit të Beogradit Stankoviq), f. 2.

²⁸⁰⁸ P2824 (Transkript i dëshmisë së Protiqit në Gjykatën e Qarkut në Beograd), f. 19, 27.

²⁸⁰⁹ Bozhidar Protiq, T. 11342 (9 mars 2007).

²⁸¹⁰ Bozhidar Protiq, T. 11335–11340 (9 mars 2007).

²⁸¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 993, 1068–1069, 1072.

këtij plani përmes metodave dhe mjeteve kriminale.²⁸¹² Më tej, ai akuzohet me përgjegjësinë si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit.²⁸¹³

1115. Që Llukiqit të ngarkohet me përgjegjësi në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, provat duhet të dëshmojnë se ai ka marrë pjesë të paktën në një aspekt të qëllimit të përbashkët për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të Kosovës nga autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë, përmes krimeve të shpërnguljes me dhunë, që Dhoma tashmë ka konkluduar se ekzistonte.²⁸¹⁴ Për vërtetimin e këtij elementi, nuk është e domosdoshme që Llukiqi t'i ketë kryer fizikisht krimet përmes të cilave është arritur qëllimi apo edhe krime të tjera.²⁸¹⁵ Madje, nuk është e domosdoshme që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të këtyre krimeve.²⁸¹⁶ Mirëpo, duhet që kontributi i tij në këtë plan të ketë qenë i konsiderueshëm.²⁸¹⁷ Sa i përket synimit të nevojshëm kriminal, duhet vërtetuar që Llukiqi mori pjesë vullnetarisht në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se kishte synimin e përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë që ishte objektivi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, e cila në këtë rast është shpërngulja me dhunë.

1116. Çështjet e trajtuara janë ilustruar me shembuj konkretë, mirëpo Dhoma thekson se përfundimet bazohen në të gjitha provat përkatëse.

1117. Fillimisht, lidhur me synimin kriminal, Dhoma gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se të gjitha veprimet e Llukiqit, të përshkruara më lart, janë kryer me vullnet të lirë dhe jo me detyrim. Dhoma është gjithashtu e bindur se Llukiqi kishte synimin e përbashkët për të mundësuar vijimësinë e kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi Kosovën përmes krimeve të shpërnguljes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare.

1118. Si shef i Shtabit të MPB-së për Kosovën, Llukiqi kishte kompetenca *de jure* mbi SPB-të, DPB-të, stacionet e rregullta policore si edhe njësitë e RJB-së që morën pjesë në operacione luftimi, si PJP-ja dhe SAJ-ja, gjatë periudhës së kryerjes së krimeve. Krahas kësaj, Llukiqi gëzonte edhe kompetenca *de facto* të konsiderueshme. Si anëtar i Komandës së Përbashkët, Llukiqi bashkëpunoi ngushtë me udhëheqjen e UJ-së, sidomos me komandantin e Korpusit të Prishtinës dhe, më pas, të Armatës së Tretë, Nebojsa Pavkoviçin, duke bashkërenduar operacione të ndryshme të

²⁸¹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (version publik), para. 8, 993, 1068–1069.

²⁸¹³ Aktakuza, para. 15, 22.

²⁸¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227.

²⁸¹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 99.

²⁸¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

²⁸¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

përbashkëta “antiterroriste” të UJ-së dhe MPB-së. Si shef i Shtabit të MPB-së Llukiqi mori pjesë edhe në disa mbledhje të nivelit të lartë me udhëheqjen e RFJ-së dhe Serbisë, në të cilat u diskutua për Planin kundër Terrorizmit.²⁸¹⁸

1119. Informacioni i marrë nga Llukiqi përpara dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s është provë kyçe për përcaktimin e përgjegjësisë së tij, sepse dijenia e tij për kryerjen e krimeve nga vartësit e MPB-së dhe anëtarët e UJ-së nga mesi i vitit 1998 deri në fund të fushatës ajrore të NATO-s në vitin 1999, e ndërthurur me punën e vazhdueshme të tij për mundësimin e operacioneve të përbashkëta MPB/UJ përkundër dijenisë për krime të tilla, tregojnë synimin e tij për kryerjen e këtyre krimeve.

1120. Sikurse u përmend më lart, Llukiqi ishte në dijeni të kryerjes së krimeve në vitin 1998 nga forca të ndryshme, përfshirë edhe PJP-në dhe SAJ-në, të cilat qenë nën kontrollin e tij kur vepronin në Kosovë.²⁸¹⁹ Gjithashtu, Llukiqi ishte vënë në dijeni për krimet e kryera nga forcat që kishte nën kontroll, nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, me të cilët ishte në kontakt të vazhdueshëm. Llukiqi ishte gjithashtu në dijeni të akuzave të ngritura nga bashkësia ndërkombëtare se krimet gjerësisht të përhapura, të kryera nga forcat e UJ-së dhe MPB-së në vitin 1998, kishin shkaktuar shpërngulje të dhunshme të mbi 230 mijë shqiptarëve kosovarë.²⁸²⁰ Pavarësisht nga dijenitë që kishte, Llukiqi vijoi t’i përmbushte detyrat e tij si shef i Shtabit të MPB-së, në të cilat, ndër të tjera, përfshihej planifikimi i veprimtarive “antiterroriste” në bashkëpunim me UJ-në dhe dhënia e udhëzimeve dhe urdhrave përkatëse SPB-ve, PJP-së dhe SAJ-së.²⁸²¹ Për shembull, më 9 prill 1999, Llazareviqi u dha njoftim njësisive në vartësi se Shtabi i MPB-së u kishte dhënë urdhër të gjitha SPB-ve të “fillojnë planifikimin e operacioneve për shtypjen e grupeve terroriste që ndodhen në zonat përkatëse të përgjegjësisë”.²⁸²²

1121. Në vitin 1998, Llukiqi mori pjesë aktivisht në procesin e armatosjes së popullsisë joshqiptare, në kuadrin e RPO-ve, dhe në çarmatosjen e popullatës shqiptare kosovare në fshatrat dhe qytetet e krahinës së Kosovës. Ai mori pjesë në punën e udhëheqjes së RFJ-së dhe Serbisë për

²⁸¹⁸ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26587–26590 (8 korrik 2008); P948 (intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 41. 67–73, 142–144; Dushko Matkoviq, T. 14634–14635 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë e dëshmitarit, datë 10 shkurt 2003), f. 9 (version publik).

²⁸¹⁹ *Shih, p.sh.*, Dushko Adamoviq, 6D1613 (deklaratë e dëshmitarit, datë 30 mars 2008), para. 50; P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4; 6D874 (Udhëzime nga Sreten Llukiqi për shefat e SPB-ve të Kosovës, 6 maj 1999).

²⁸²⁰ P455 (Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1160, 31 mars 1998), f. 1; P456 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr 1199, 23 shtator 1998), f. 1.

²⁸²¹ P3130 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 3 nëntor 1998), f. 3; P3122 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 7–8; P1991 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 10–11.

²⁸²² 5D476 (Raport i Llazareviqit për Korpusin e Prishtinës, 9 prill 1999).

kryerjen e këtij procesi, përkundër dijenisë që kishte për kryerjen e akteve kriminale gjatë përplasjeve ndëretnike.²⁸²³ Pjesëmarrja aktive e Llukiqit në këtë proces e vërteton pretendimin e Prokurorisë se ai veprimi në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për realizimin e qëllimit të përbashkët të ruajtjes së kontrollit mbi Kosovë përmes mjeteve të ndryshme kriminale.

1122. Sikurse u përmend më lart, përpara fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s, Llukiqi i udhëzoi pjesëmarrësit në një mbledhje të Shtabit të MPB-së t'i mbanin vullnetarët, të cilët do të përfshiheshin në sistemin e MPB-së me të filluar “operacionet e luftës”. Një përdorim i tillë i vullnetarëve nga ana e MPB-së nuk parashikohej me ligj.

1123. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, Llukiqi vazhdoi të merrte informacion se anëtarët e MPB-së dhe UJ-së po kryenin krime kundër civilëve shqiptarë kosovarë në Kosovë. Shtabi i MPB-së merrte raporte të përditshme nga SPB-të e Kosovës, të cilat kishin të bënin me ngjarjet në të gjithë Kosovën. Raportet e SPB-ve përmbledheshin, më pas, në një raport të plotë, i cili nënshkruhej nga Llukiqi dhe i përcillej MPB-së në Beograd, sikurse u shpjegua në Nënpjesën VI.A.3. Raportet tregojnë se Llukiqi u informua shpesh për kryerjen e krimeve të tilla si përvetësim i automjeteve, vjedhje e mallrave teknike dhe “konfiskim” i parave të shqiptarëve kosovarë nga anëtarët e UJ-së, RPO-ve, SPB-ve dhe stacioneve të policisë.²⁸²⁴ Llukiqi ishte gjithashtu në dijeni të zbulimit të kufomave në Izbicë dhe Pastesellë, sikundër konfirmoi në intervistën e tij.²⁸²⁵

1124. Llukiqi ishte në dijeni se në vitin 1999 nga Kosova po largohej një numër i madh civilësh dhe se disa komandantë të PJP-ve “po toleronin largimin masiv të popullatës civile”.²⁸²⁶ Ai i

²⁸²³ P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 3; P2804 (Telegram i Shtabit të MPB-së drejtuar komandantëve të njëjësive organizative të MPB-së në Kosovë).

²⁸²⁴ 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 3 prill 1999), f. 5; 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 4 prill 1999), f. 4–5; 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 5 prill 1999), f. 3–4; 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 6 prill 1999), f. 3–5; 6D1248 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 12 prill 1999), f. 3; 6D1254 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 18 prill 1999), f. 3; 6D1255 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 19 prill 1999), f. 3; 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 21 prill 1999), f. 3.

²⁸²⁵ P948 (intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 160–162.

²⁸²⁶ 6D778 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 15 prill 1999). *Shih në përgjithësi* 6D1232 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 24 mars 1999); 6D1236 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 28 mars 1999), pranuar në provat gjyqësore edhe me numrin P1099; 6D1238 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 2 prill 1999); 6D1239 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 3 prill 1999); 6D1240 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 4 prill 1999); 6D1241 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 5 prill 1999); 6D1242 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 6 prill 1999); 6D1244 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 8 prill 1999); 6D1254 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 18 prill 1999); 6D1255 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 19 prill 1999); 6D1256 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 20 prill 1999); 6D1257 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 21 prill 1999); 6D1259 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 23 prill 1999); 6D1260 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 24 prill 1999); 6D1261 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 25 prill 1999); P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 1 maj 1999).

udhëzoi vartësit e tij që “të parandalohet keqtrajtimi i civilëve” dhe që “anëtarët e MPB-së të mos marrin pjesë në asnjë lloj transportimi të organizuar të civilëve që duan të largohen” nga Kosova, e megjithatë shpërngulja vazhdoi.²⁸²⁷ Kjo tregon dijeninë e Llukiqit për keqtrajtimin dhe shpërnguljen e dhunshme të civilëve.

1125. Çështja e krimeve të rënda të kryera nga anëtarët e UJ-së dhe MPB-së u diskutua edhe në një mbledhje me udhëheqjen ushtarake dhe civile të RFJ-së dhe Serbisë më 4 maj 1999, në të cilën mori pjesë Llukiqi. Kjo mbledhje u thirr nga Millosheviqi, pas marrjes së një letre nga Prokurorja e atëhershme Tribunalit, Louise Arbour, në të cilën ajo shprehte shqetësimin e saj të thellë lidhur me shkeljet e vazhdueshme të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë. Sipas një raporti mbi përmbajtjen e mbledhjes, në të u paraqit informacion se forcat e sigurisë të MPB-së dhe UJ-së ishin marrë me raste të shumta dhune, vrasjesh, plaçkitjesh dhe krimesh të tjera dhe se kishin arrestuar disa qindra kriminelë, krimet e të cilëve e kishin vënë në rrezik popullatën civile.²⁸²⁸

1126. Në mbledhjen e Shtabit të MPB-së, të zhvilluar më 7 maj 1999, u diskutua përsëri mbi masat për parandalimin e krimeve dhe mjetet për mbrojtjen e popullsisë civile. Në këtë mbledhje Shainoviqi theksoi nevojën për ruajtjen e ligjit dhe rendit, në mënyrë që të mos “lejohet stigmatizimi i serbëve si njerëz që djegin, plaçkitin dhe kapardisen fshatrave të braktisura dhe të shkretuara”. Shainoviqi theksoi se “nuk ka asnjë luftë private dhe duhen parandaluar vrasjet private. Të ndëshkohen menjëherë veprime të tilla. Të informoni gjeneral Llukiqin për çdo incident”.²⁸²⁹ Llukiqi dëshmoi se kishte dijeni për situatën në terren kur tha se numri i 27 hetimeve të vrasjeve nuk ishte “realist” dhe se ekzistonte informacion se ishte kryer një numër më i madh hetimesh dhe se numri i kallëzimeve penale ishte më i madh.²⁸³⁰ Bogunoviqi raportoi se ndërtesave u ishte vënë zjarri dhe se vrasjet qenë kryer nga prania dhe lëvizja e paraushtarakëve dhe ushtarakëve në zonë.²⁸³¹

1127. Më 11 maj 1999, në Shtabin e MPB-së u zhvillua një mbledhje tjetër me rend dite të ngjashëm me atë të mbledhjes së datës 7 maj 1999, vetëm se kësaj here të pranishëm qenë

²⁸²⁷ 6D666 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 3 prill 1999).

²⁸²⁸ P1996 (“Krerët e ushtrisë dhe policisë informojnë Millosheviqin për mbrojtjen e suksesshme”, reportazh i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

²⁸²⁹ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 2–3.

²⁸³⁰ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 prill 1999), f. 10.

²⁸³¹ P1996 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 6.

komandantët e forcave të MPB-së në Kosovë. Në këtë mbledhje, Llukiqi u rikujtoi të pranishmëve se duheshin marrë masa për parandalimin e eksodit të civilëve nga Kosova.²⁸³²

1128. Megjithëse Llukiqi kishte dijeni për krimet gjerësisht të përhapura, të kryera në territorin e Kosovës nga anëtarët e MPB-së dhe UJ-së, ai vijoi me udhëzimet që MPB-ja të angazhohej në operacione të tjera të përbashkëta me UJ-në në Kosovë.

1129. Dhoma gjykon se, edhe pse Llukiqi mund të ketë nxjerrë disa urdhra në të cilat e udhëzon policinë të parandalojë largimin e civilëve nga Kosova pas fillimit të eksodit në masë, këta urdhra qenë të ngjashëm me ata që u jepeshin forcave të UJ-së për të respektuar të drejtën humanitare ndërkombëtare humanitare, urdhra të cilat u shkelën rregullisht.²⁸³³ Fakti që Llukiqi, me gjithë dijeninë që kishte për ngjarjet në terren, vijoi t'a urdhëronte MPB-së që të angazhohej në operacione të përbashkëta me UJ-në, tregon se urdhrat e tij nuk qenë të sinqertë dhe, rrjedhimisht, nuk krijojnë asnjë dyshim lidhur me synimin e tij për realizimin e objektivave të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Për shembull, Llukiqi lejoi pjesëmarrjen e njërive të ndryshme të MPB-së në operacionin e përbashkët "Bajgora" të UJ-së dhe MPB-së, urdhri për të cilin u dha më 15 prill 1999 nga Llazareviqi dhe operacioni u krye nga data 25 prill deri më 6 maj 1999, pasi qenë kryer më parë krime të ndryshme dhe pasi qenë larguar qysh më parë nga Kosova 669.071 shqiptarë kosovarë.²⁸³⁴ Angazhimi i forcave të MPB-së në këtë operacion çoi në vdekjen e të paktën tre personave dhe shpërnguljen e mijërave të tjerëve, sikurse është përmendur në Pjesën VII.I.

1130. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat përkatëse, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim i arsyeshëm në të cilin mund të arrihet është se Llukiqi kishte synimin për të shpërngulur me dhunë popullatën shqiptare kosovare, si brenda Kosovës, po ashtu edhe jashtë saj, duke mundësuar në këtë mënyrë vijimësinë e kontrollit të kësaj krahine nga autoritetet e RFJ-së dhe autoritetet serbe. Dhoma bindet gjithashtu se ai e kishte të përbashkët këtë synim me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, si Millosheviqi, Pavkoviqi dhe Shainoviqi.

1131. Sa i takon kontributit të Llukiqit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, Dhoma është e mendimit se nga paragrafët e mësipërm del qartë se ai ka kontribuar dhe se ky kontribut ishte i konsiderueshëm. Llukiqi ishte komandanti *de facto* i forcave të MPB-së të vendosura në Kosovë nga mesi i vitit 1998 deri në mes të vitit 1999, përfshirë edhe policinë e zakonshme në njësitë e

²⁸³² P1993 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 8; *shih edhe* 6D1634 (Plani i veprimeve të SPB-së së Prizrenit për parandalimin e krimeve, datë 8 maj 1999) (ku miratohet një plan për parandalimin e krimeve në përgjigje të një telegrami nga Shtabi i MPB-së).

²⁸³³ *Shih, p.sh.*, 6D778 (Telegram i Shtabit të MPB-së, 15 prill 1999).

²⁸³⁴ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 3; 5D1329 (Hartë dhe Vendim i Brigadës së 211-të të Blinduar); 6D1261 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 25 prill 1999).

SPB-ve, PJP-së dhe SAJ-së. Llukiqi ishte gjithashtu ndërlidhësi midis vendimmarrësve në Beograd, si Millosheviqi, Stojilkoviqi dhe Gjorgjeviqi, dhe njerëzve në terren në Kosovë. Së fundi, ai mori pjesë drejtpërdrejtë në procesin e planifikimit dhe në mundësimin e zbatimit të operacioneve të përditshme nga forcat e ndryshme të MPB-së në përputhje me planet. Rrjedhimisht, Llukiqi ishte një anëtar i rëndësishëm i ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

1132. Siç mund të shihet nga përfundimet lidhur me komuna të ndryshme të Kosovës të diskutuara më lart, anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale i përdorën forcat e UJ-së dhe MPB-së që kishin në kontroll për kryerjen e krimeve të përmendura në Aktakuzë. Dhoma është e ndërgjegjshme se nuk është e nevojshme që të gjithë efektivet e këtyre forcave të jenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Sidoqoftë, veprimet e efektivëve të UJ-së dhe MPB-së u ngarkohen anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në lidhje me këtë pikë, Dhoma citon përfundimet e saj se Shainoviqi dhe Pavkoviqi ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Shainoviqi ishte koordinator politik i forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë. Pavkoviqi, si komandant i Armatës së Tretë të UJ-së, kishte nën urdhrat dhe kontrollin e vet të gjitha forcat e UJ-së në Kosovë gjatë gjithë periudhës së kryerjes së krimeve dhe urdhëroi operacionet e UJ-së në Kosovë gjatë kësaj kohe. Llukiqi ishte homologu i Pavkoviqit në lidhje me UJ-në, i cili, gjatë gjithë fushatës ajrore të NATO-s, kishte përgjegjësinë *de jure* dhe *de facto* për forcat e MPB-së që kryen krime në masë. Të tre ata morën pjesë në bashkërendimin e veprimeve të UJ-së dhe MPB-së. Sllobodan Millosheviqi, një tjetër anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ishte “Kryekomandanti” i UJ-së dhe kishte kompetenca të rëndësishme *de facto* mbi MPB-në. Për të gjitha këto arsye, Llukiqi mban përgjegjësi si për krimet e MPB-së, po ashtu edhe të UJ-së.

1133. Duke qenë se Dhoma ka konkluduar se qëllimi i përbashkët do të realizohej vetëm përmes shpërnguljes me dhunë, kjo çon në përfundimin se krimet e tjera për të cilat akuzohet Llukiqi, të cilat janë vrasje dhe përndjekje, përmes, ndër të tjera, vrasjes, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të objekteve kulturore, lipset të analizohen në kuadër të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Duhet provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se këto krime, edhe pse bien jashtë objektivit të qëllimit të përbashkët, ishin, normalisht, të parashikueshme nga Llukiqi dhe se ai e mori me vullnet të plotë rrezikun e mundësisë së kryerjes të këtyre krimeve.

1134. *Vrasjet*. Sikurse përshkruhet më lart, Llukiqi synonte të shpërngulte me dhunë një pjesë të popullatës shqiptare kosovare dhe këtë synim e kishte të përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, objektivi i të cilës ishte shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë brenda Kosovës dhe dëbimi i tyre jashtë Kosovës në mënyrë që të ruhej kontrolli mbi këtë krahinë. Llukiqi ishte në dijeni të armiqësisë së fortë midis serbëve etnikë dhe shqiptarëve

kosovarë në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe vitit 1999. Ai ishte i vetëdijshëm për kontekstin në të cilin po zhvillohej shpërngulja me dhunë e popullsisë. Për rrjedhojë ishte logjikisht e parashikueshme se do të kryheshin edhe krime të tjera, përfshirë vrasjet, nga autorët fizikë dhe të ndërmjetëm të krimeve me synimin për të diskriminuar shqiptarët kosovarë.²⁸³⁵ Dhoma është e mendimit se dijenia e hollësishme e Llukiqit për ngjarjet në terren në Kosovë në vitin 1998 dhe vitin 1999 i shërbeu si tregues se UJ-ja dhe MPB-ja do të kryenin vrasje të paligjshme si rezultat i shpërnguljeve në vitin 1999. Krahas kësaj, ka dëshmi konkrete në mbështetje të këtij përfundimi. Për shembull, incidenti në Abri të Epërme në tetor 1998 i dha të kuptojë Llukiqit se kishte të ngjarë që anëtarët e MPB-së dhe UJ-së të angazhuar në Kosovë të kryenin vrasje dhe përndjekje.²⁸³⁶ Më 6 maj 1999, Llukiqi i nxiti shefat e SPB-ve të Kosovës t'i njihnin të gjithë anëtarët e PJP-së me përmbajtjen e artikullit në "Politika", ku flitej për akuzat mbi incidentet e shumta të vrasjeve të kryera nga anëtarë të UJ-së dhe i udhëzoi të parandalonin vrasjet, përdhunimet dhe plaçkitjet.²⁸³⁷

1135. *Dhuna seksuale*. Lidhur me akuzat për dhunë seksuale që janë vërtetuar (në Beleg dhe Qirez),²⁸³⁸ Prokuroria nuk ka arritur të paraqesë prova që ta bindin Dhomën jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që dhuna seksuale ishte logjikisht e parashikueshme nga Llukiqi. Më 1 maj 1999, Llukiqi raportoi se një rezervist i MPB-së ishte ndaluar për kryerjen e një veprimi të turpshëm kundër një femre shqiptare kosovare, çka tregon se ai, në atë moment, kishte dijeni për kryerjen e krimeve të tilla.²⁸³⁹ Mirëpo, kjo provë nuk vërteton se dhuna seksuale e kryer në fund të marsit (në Beleg) dhe në mes të prillit (në Qirez) ishte logjikisht e parashikueshme prej tij. Dhoma ka analizuar përfundimet e Dhomave Gjyqësore të proceseve *Kërstiq* dhe *Kvoçka*, në lidhje me parashikueshmërinë e përdhunimeve në çështjet në fjalë. Mirëpo, faktet konkrete të atyre çështjeve lidhur me parashikueshmërinë ishin dukshëm më bindëse se faktet e kësaj çështjeje dhe, më konkretisht, lidhur me Llukiqin.²⁸⁴⁰ Mungesa e dijenisë, nga ana e Llukiqit, lidhur me dhunën seksuale çon edhe në përfundimin se ai nuk planifikoi, nxiti, urdhëroi, apo ndihmoi dhe inkurajoi këto krime. Gjithashtu, ai nuk është përgjegjës për këto krime në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7, sepse ai nuk kishte arsye të dinte për to.

²⁸³⁵ *Shih* P948 (Intervista e Sreten Llukiqit me Prokurorinë), f. 67–68, 133, 167–168.

²⁸³⁶ P1468 (Shënimet e Komandës së Përbashkët), f. 136; IC-199 (Shtojcë e P1468), f. 7.

²⁸³⁷ 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999), pranuar edhe si P2159.

²⁸³⁸ Megjithëse më parë Dhoma ka konkluduar se K14-a, K31-shi dhe K62-shi u përdhuan në Prishtinë, Prokuroria nuk arriti të paraqesë provat e kërkuara për synimin diskriminues dhe, për rrjedhojë, akuza për përndjekje përmes dhunës seksuale në Prishtinë nuk është vërtetuar. *Shih* Nën pjesën VII.O.10.

²⁸³⁹ P1693 (Raport i Shtabit të MPB-së për Ministrinë e Brendshme, 1 maj 1999), f. 7; *shih edhe* 5D1289 (Raport i Sreten Llukiqit për artikullin në *Politika*, 6 maj 1999), pranuar edhe si P2159.

²⁸⁴⁰ Aktgjykim *Kërstiq*, para. 616–618; Aktgjykim *Kvoçka*, para. 326–327. *Shih edhe* Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq*, para. 149, 151; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 330, 334.

1136. *Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve fetare.* Dhoma ka konkluduar më herët se forcat e RFJ-së dhe Serbisë shkatërruan katër xhami dhe se këto vepra penale i përkasin kategorisë së përndjekjes. Dhoma gjykon se Llukiqi mund të parashikonte logjikisht që forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin shkatërrim ose dëmtim pa shkak të objekteve fetare shqiptare kosovare, të monumenteve të kulturës dhe të vendeve të shenjta myslimane gjatë shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare kosovare. Konflikti kishte të bënte me dasinë etnike. Për më tepër, qëllimi i përbashkët do të arrihej përmes një fushate terrori dhe dhune kundër popullsisë civile shqiptare kosovare. Në këto rrethana, dhe duke mbajtur parasysh dijeninë e hollësishme të Llukiqit për ngjarjet në terren në Kosovë gjatë konfliktit, konkluzioni i pashmangshëm është se për Llukiqin ishte logjikisht e parashikueshme që, ndërkohë që forcat e RFJ-së dhe Serbisë po zhvendosnin dhe dëbonin me dhunë popullsinë shqiptare kosovare, në të njëjtën kohë ato po shkatërronin apo dëmtonin pa shkak edhe objektet e tyre fetare, monumentet e kulturës dhe vendet e shenjta të kësaj popullsie.

1137. Pas nxjerrjes së përfundimeve të mësipërme, nuk është e nevojshme që Dhoma të nxjerrë përfundime për format e tjera të përgjegjësisë të pretenduara në Aktakuzë.

1138. Për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore gjykon se është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm përgjegjësia e Sreten Llukiqit në kryerjen (përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e krimeve të mëposhtme në vendndodhjet e mëposhtme:

- Pejë
 - Qyteti i Pejës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Deçan
 - Beleg— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjakovë
 - Qyteti i Gjakovës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Korenicë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Dobrosh—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Ramoc— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;

- Mejë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Fshatra të tjerë në zonën e Caragojit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Prizren
 - Piranë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Dushanovë, pjesë e qytetit të Prizrenit— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Rahovec
 - Celinë—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Bellacërkë—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Krushë e Vogël—vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Suharekë
 - Qyteti i Suharekës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
- Skënderaj
 - Turiçec—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Izbicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
 - Tushilë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Qirez— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (dhunë seksuale) si krim kundër njerëzimit
- Mitrovicë
 - Qyteti i Mitrovicës— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Zhabar— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Vushtri

- Qyteti i Vushtrrisë—veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
- Kolonë pranë Studimes së Epërme—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit;
- Prishtinë
 - Qyteti i Prishtinës—dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Gjilan
 - Zhegër— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lladovë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Llashticë—përndjekje (shkatërrim ose dëmtim i objekteve fetare) si krim kundër njerëzimit;
 - Përlepnicë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Ferizaj
 - Sojevë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Mirosalë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Staro Sello— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
- Kaçanik
 - Kotlinë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Kaçanik— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit;
 - Lisnajë— dëbim si krim kundër njerëzimit; veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit; vrasje si krim kundër njerëzimit; vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; përndjekje (vrasje) si krim kundër njerëzimit.

1139. Llukiqi nuk është përgjegjës për asnjë prej akuzave të tjera të ngritura në Aktakuzë, përfshirë edhe akuzat për dhunë seksuale të parashtruara në pikën 5 (përndjekje), në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

1140. Rrjedhimisht, Sreten Llukiqi është fajtor për pikat 1 deri në 5 të Aktakuzës, përcaktuar si më sipër.

IX. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

A. LIGJI PËR PËRCAKTIMIN E DËNIMIT

1141. Dënimi duhet të përcaktohet në përputhje me dispozitat e Nenit 24 të Statutit, dhe Rregullave 87(C) dhe 101 të Rregullores së Procedurës dhe Provave. Në paragrafin 2 të Nenit 24 parashtrahet se “Dhomat Gjyqësore duhet të mbajnë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të fajtorit.” Përveç rrethanave individuale, Rregulla 101 detyron Dhomat Gjyqësore që gjatë përcaktimit të dënimit të marrin parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese,²⁸⁴¹ praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë,²⁸⁴² dhe masën e kryer të dënimit që i është dhënë fajtorit nga gjykata e ndonjë shteti për të njëjtën vepër penale.²⁸⁴³

1142. Në paragrafin C të Rregullës 87 përcaktohet,

Në qoftë se Dhoma Gjyqësore e shpall të akuzuarin fajtor për një ose më shumë akuza të përfshira në aktakuzë, ajo jep dënim për çdo verdikt fajësie dhe bën të ditur nëse dënimet do të kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme apo të njëkohshme, në rast se vendos të mos ushtrojë kompetencën e vet për dhënien e një dënimi të vetëm që pasqyron tërësinë e veprimeve kriminale të të akuzuarit.²⁸⁴⁴

Personi i shpallur fajtor mund të dënohet me burgim për një periudhë deri në burgim të përjetshëm.²⁸⁴⁵ Dhoma e Apelit është shprehur se Dhomave Gjyqësore u është besuar kompetencë e gjerë në përcaktimin e dënimit të duhur, për shkak të detyrimit që kanë për t'i individualizuar dënimet në përputhje me rrethanat e të akuzuarit dhe peshën e krimit.²⁸⁴⁶

1143. Vendimet mbi dënimet e dhëna në çështje të tjera të Tribunalit mund të shërbejnë vetëm si deri-diku si udhëzime në rast se kanë të bëjnë me të njëjtën vepër penale kryer në rrethana thelbësisht të ngjashme; përndryshe, Dhoma udhëhiqet vetëm nga dispozitat e Statutit dhe Rregullores.²⁸⁴⁷ Rrjedhimisht, praktika e mëparshme e dënimeve është vetëm një nga faktorët e shumtë që duhen marrë parasysh gjatë dhënies së dënimit.²⁸⁴⁸ Duke mbajtur parasysh faktin se

²⁸⁴¹ Rregulla 101(B)(ii) e Rregullores.

²⁸⁴² Neni 24(1) i Statutit; Rregulla 101(B)(iii) e Rregullores; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 301; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 126; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 679.

²⁸⁴³ Rregulla 101(B)(iv) e Rregullores.

²⁸⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 335.

²⁸⁴⁵ Neni 24(1) i Statutit; Rregulla 101(A) e Rregullores. Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë kthimin të pronarët e ligjshëm të çdo prone ose të ardhure të siguruar nëpërmjet veprimeve kriminale, ndër të tjera nëpërmjet shtrëngimit. Neni 24(3) i Statutit.

²⁸⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 336, 348; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 302; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 127, 135; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, 137; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Zelenoviq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 393; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *D. Nikoliq*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 717; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*, para. 1037; Aktgjykimi i Apelit *Nđindabahizi*, para. 132.

²⁸⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 250; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 719–721; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 381.

²⁸⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 349; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 248.

është e vështirë të zbulohet rregullsi apo udhëzime në “praktikën” e dënimeve të Tribunalit, Dhoma ushtroi gjykimin dhe kompetencat e saj në lidhje me faktet e paraqitura në këtë çështje, përfshirë rrethanat kontekstuale dhe të përgjithshme në të cilat u kryen këto krime.

1. Qëllimet e dënimit

1144. Jurisprudenca e Tribunalit përcakton se dy qëllimet kryesore të dënimit për krimet brenda juridiksionit të Tribunalit janë ndëshkimi dhe parandalimi.²⁸⁴⁹

1145. Si formë ndëshkimi, dënimi shpreh kundërvënien e shoqërisë ndërkombëtare ndaj krimeve të kryera, dhe nuk duhet interpretuar si hakmarrje.²⁸⁵⁰ Dhoma e Apelit ka shpjeguar se “ndëshkimi duhet të trajtohet si”

përcaktim objektiv, i arsyetuar dhe me masë i dënimit të duhur i cili pasqyron masën e duhur të ... fajësisë së shkelësit, duke marrë parasysh rrezikun e marrë nga shkelësi, në planin ndërkombëtar, dëmin e shkaktuar nga shkelësi si pasojë, dhe karakterin normativ të sjelljes së shkelësit. Për më tepër, në dallim nga hakmarrja, ndëshkimi në vetvete përfshin parimin e vetëpërmbytjes; ndëshkimi kërkon imponimin e dënimit të drejtë dhe të duhur, dhe asgjë më shumë.²⁸⁵¹

1146. Parandalimi si qëllim i dënimit mund të jetë i veçantë dhe i përgjithshëm. Rrjedhimisht, dënimet që cakton Tribunali duhet të shërbejnë si parandalues të mjaftueshëm që të shkurajojnë keqbërësin prej përsëritjes së shkeljeve në të ardhmen dhe të tjerët që të mos kryejnë krime të ngjashme.²⁸⁵² Gjithsesi parandalimit “nuk duhet t’i jepet rëndësi e tepruar gjatë vlerësimit të përgjithshëm të dënimeve që u jepen personave të shpallur fajtorë nga Tribunali”.²⁸⁵³ Edhe rehabilitimi është një nga qëllimet e ligjshme të ndëshkimit, ndonëse nuk duhet t’i jepet rëndësi e tepruar.²⁸⁵⁴

2. Dhënia e dënimeve

a. Pesha e shkeljes

1147. Faktori kryesor që merret parasysh në përcaktimin e dënimit është pesha e veprës penale.²⁸⁵⁵ Kur bën vlerësimin e peshës së shkeljes, ose të tërësisë së sjelljes kriminale të personit të shpallur

²⁸⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 806; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 402; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 800 (citon Vendimin mbi Juridiksionin në lidhje me Apelin e Ndërkohshëm në çështjen *Tadiq*, para. 72).

²⁸⁵⁰ *Kordiq*, para. 1075; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 185.

²⁸⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1075 (citohet *R. v. M. (C.A.)* [1996] 1 S.C.R. 500, para. 80 (theksi në origjinal)).

²⁸⁵² Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1076–1078.

²⁸⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1078; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 801.

²⁸⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 806; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 402.

fajtor, Dhoma Gjyqësore duhet të ketë parasysh peshën e vetvetishme të krimit dhe sjelljes kriminale të fajtorit, përcaktimi i të cilës kërkon shqyrtimin e rrethanave konkrete të çështjes dhe të krimeve për të cilat personi është shpallur fajtor, si dhe mënyrën dhe masën e pjesëmarrjes së fajtorit në ato krime.²⁸⁵⁶ Gjatë vlerësimit të peshës së krimit, Dhoma Gjyqësore mund të marrë parasysh pozitën e lartë të personit të shpallur fajtor,²⁸⁵⁷ numrin e viktimave, dhe pasojat e krimeve mbi grupin e gjerë, subjekt të krimit.²⁸⁵⁸ Gjithashtu, Dhoma e Apelit ka konkluduar se pasojat e krimit që i vuan viktimat e dëmtuar drejtpërsëdrejti, gjegjësisht masa e vuajtjes fizike, psikologjike dhe emocionale afatgjatë të viktimës, është përherë e rëndësishme gjatë përcaktimit të dënimit.²⁸⁵⁹ Mund të merren parasysh edhe faktorë të tjerë si ndikimi i krimit mbi familjen e viktimës së drejtpërdrejtë.²⁸⁶⁰

b. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese

1148. Gjatë përcaktimit të dënimit, Dhoma Gjyqësore gjithashtu duhet të marrë parasysh rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor si dhe të gjitha rrethanat lehtësuese ose rënduese. Statuti dhe Rregullorja nuk përcaktojnë se cilët faktorë duhet të konsiderohen si rrethana rënduese ose lehtësuese, me përjashtim të Rregullës 101(B)(ii) e cila përcakton se Dhoma Gjyqësore duhet të marrë parasysh çfarëdo “bashkëpunimi thelbësor” të personit të shpallur fajtor me Prokurorin si rrethanë lehtësuese. Nëse faktorë të caktuar në lidhje me karakterin e personit të shpallur fajtor do të përbëjnë rrethana lehtësuese ose rënduese, kjo kryesisht varet nga rrethanat konkrete të çdo çështjeje.²⁸⁶¹

1149. Rënduese mund të konsiderohen vetëm rrethanat të cilat lidhen drejtpërdrejtë me kryerjen e shkeljes që akuzohet dhe me vetë autorin e shkeljes gjatë kohës së kryerjes së shkeljes, si për shembull mënyra e kryerjes së shkeljes.²⁸⁶² Për më tepër, vetëm faktorët që provohen jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm kundër personit të shpallur fajtor mund të merren parasysh gjatë përcaktimit

²⁸⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 442; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 731; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 442; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 182.

²⁸⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 339; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 409; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 380; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *D. Nikoliq*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 241; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 731; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 182; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 182; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 249.

²⁸⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 353; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 609–613, 625–626; Aktgjykimi i Apelit *Musema*, para. 382–383.

²⁸⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Erdemoviq*, para. 15; Aktgjykimi *Galiq*, para. 758, *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 410.

²⁸⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 512; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Dënimit *Zelenoviq*, para. 38; Aktgjykimi i Dënimit *Babiq*, para. 47.

²⁸⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 260; *shih gjithashtu* Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 1226.

²⁸⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 328; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Babiq*, para. 49.

²⁸⁶² Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 82; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 850.

të dënimit ose në rëndimin e dënimit të tij.²⁸⁶³ Faktorët që merren parasysh si aspekte të peshës së krimit nuk mund të merren parasysh si rrethana të tjera dhe të veçanta rënduese, dhe anasjelltas.²⁸⁶⁴ Gjithashtu, elementët e krimit nuk mund të konsiderohen njëherazi si elementë përbërës dhe si rrethanë rënduese.²⁸⁶⁵

1150. Në ndryshim nga rrethanat rënduese, rrethanat lehtësuese duhet të provohen në bazë të tërësisë së gjasave.²⁸⁶⁶ Dhoma Gjyqësore ka kompetencë të pranojë ose jo një faktor si rrethanë lehtësuese dhe të vendosë se çfarë peshe t'u japë faktorëve lehtësues.²⁸⁶⁷ Në rrethana lehtësuese përfshihen edhe ato që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me shkeljen.²⁸⁶⁸ Mungesa e faktorëve lehtësues asnjëherë nuk mund të trajtohet si faktor rëndues.²⁸⁶⁹

i. Rrethanat rënduese

1151. Jurisprudenca e Tribunalit ka identifikuar faktorë rëndues të mundshëm, si për shembull shpërdorimi i pozitës së tij të lartë nga i Akuzuari;²⁸⁷⁰ kohëzgjatja e krimit;²⁸⁷¹ pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në krim, lidhja me pozitën e lartë komanduese;²⁸⁷² paramendimi dhe motivi;²⁸⁷³ me çfarë zelli është kryer krimi;²⁸⁷⁴ ekzistenca e synimit diskriminues ku diskriminimi nuk përbën element të shkeljes;²⁸⁷⁵ natyra e dhunshme dhe poshtëruese e akteve dhe cënueshmëria e viktimave;²⁸⁷⁶ statusi i viktimave, moshja dhe numri i tyre, dhe pasoja e krimit mbi ta;²⁸⁷⁷ karakteri i

²⁸⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 763.

²⁸⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, para. 143; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *M. Nikoliq*, para. 58; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Deronjiq*, para. 106–107.

²⁸⁶⁵ Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 707.

²⁸⁶⁶ Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Babiq*, para. 43; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 590.

²⁸⁶⁷ Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Babiq*, para. 43; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 696; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 419; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 780.

²⁸⁶⁸ Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 850; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 911, 920.

²⁸⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 687.

²⁸⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 324; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 412; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citohet Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 61–62); Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 411; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Babiq*, para. 80.

²⁸⁷¹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimin e Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 356).

²⁸⁷² Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 708).

²⁸⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 711–712); *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 258; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 847.

²⁸⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 320; Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 705.

²⁸⁷⁵ Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 278.

²⁸⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimin *Kunarac dhe të tjerë*, para. 867); Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 352; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Dënimit *Zelenoviq*, para. 39.

²⁸⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimin *Kunarac dhe të tjerë*, para. 864, 866); Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 355; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Dënimit *Zelenoviq*, para. 40.

personit të shpallur fajtor;²⁸⁷⁸ dhe rrethanat e përgjithshme të shkeljes.²⁸⁷⁹ Zgjuarsia dhe arsimimi i mirë konsiderohen si faktorë të mundshëm rëndues.²⁸⁸⁰

ii. Rrethanat lehtësuese

1152. Në faktorët lehtësues përfshihen bashkëpunimi me Prokurorinë,²⁸⁸¹ pranimi i fajit ose vetëdeklarimi i fajësisë,²⁸⁸² pendimi,²⁸⁸³ keqardhja, dhembshuria apo pikëllimi për viktimat e krimeve;²⁸⁸⁴ dorëzimi vullnetar,²⁸⁸⁵ karakteri i mirë dhe pa dënime të mëparshme penale;²⁸⁸⁶ sjellja gjatë paraburgimit;²⁸⁸⁷ rrethanat personale dhe familjare;²⁸⁸⁸ sjellja e personit të shpallur fajtor pas konfliktit;²⁸⁸⁹ shtrëngimi;²⁸⁹⁰ pjesëmarrja e tërthortë;²⁸⁹¹ përgjegjësia e zvogëluar për shkak të paaftësisë mendore;²⁸⁹² moshë;²⁸⁹³ dhe ndihma dhënë të burgosurve apo viktimave.²⁸⁹⁴ Shëndeti i dobët konsiderohet masë lehtësuese vetëm në raste të jashtëzakonshme apo të rralla.²⁸⁹⁵ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore mund të shpërblejë personin e shpallur fajtor për respektimin e plotë të detyrimeve të caktuara, si për shembull, të kushteve të lirimimit të përkohshëm,²⁸⁹⁶ apo në qoftë se lejohet, t'a shpërblejë për parandalimin e krimeve.²⁸⁹⁷

iii. Praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë

1153. Neni 24(1) i Statutit përcakton se “Dhomat Gjyqësore i referohen praktikës së përgjithshme të dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë”.²⁸⁹⁸ Në jurisprudencën e Tribunalit vazhdimisht është konkluduar se kjo nuk i detyron Dhomat Gjyqësore që t'i përshtaten praktikës së dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë, por vetëm që të marrin parasysh këtë

²⁸⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686 (citon Aktgjykimin e Apelit *Çelebiq*, para. 788).

²⁸⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 686.

²⁸⁸⁰ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1114; *krahaso*. Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 328 (“Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këta faktorë duhet të konsiderohen *vetëm* si faktorë rëndues.”).

²⁸⁸¹ Rregulla 101(B)(ii) e Rregullores; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 344; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 180; Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 95–96.

²⁸⁸² Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 122; Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 76.

²⁸⁸³ Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 89; Aktgjykimi i Dënimit *Erdemoviq*, para. 16(iii); Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 868.

²⁸⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 366.

²⁸⁸⁵ Aktgjykimi i Dënimit *Pllavshiq*, para. 84; Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 73.

²⁸⁸⁶ Aktgjykimi i Dënimit *Erdemoviq*, para. 16(i); Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 459.

²⁸⁸⁷ Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 100; Aktgjykimi i Dënimit *D. Nikoliq*, para. 268.

²⁸⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 362, 408.

²⁸⁸⁹ Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 90–91, 103.

²⁸⁹⁰ Aktgjykimi i Dënimit *Erdemoviq*, para. 17 (ku thuhet se shtrëngimi “mund të merret parasysh vetëm si faktor lehtësues”).

²⁸⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 273.

²⁸⁹² Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 590.

²⁸⁹³ Aktgjykimi i Dënimit *Jokiq*, para. 100.

²⁸⁹⁴ Aktgjykimi i Dënimit *Sikirica dhe të tjerë*, para. 195, 229.

²⁸⁹⁵ Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 98; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Babiq*, para. 43.

²⁸⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 342; *shih gjithashtu* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Jokiq*, para. 82.

²⁸⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 342; *shih gjithashtu* Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 430.

praktikë.²⁸⁹⁹ Për rrjedhojë, Dhoma mund të përcaktojë dënim më të rëndë ose më të lehtë nga ai që do të përcaktohej sipas ligjeve përkatëse në ish-Jugosllavi gjatë periudhës së Aktakuzës.²⁹⁰⁰

1154. Burimet që duhet të merren parasysh sipas këtyre dispozitave nuk kufizohen vetëm në jurisprudencën e ish-Jugosllavisë, por përfshijnë edhe dispozitat ligjore që ishin në fuqi në ish-Jugosllavi gjatë kohës kur u kryen krimet në fjalë.²⁹⁰¹ E drejta penale e Serbisë në vitin 1999 për shkeljet si ato të paraqitura në Aktakuzë përcaktohej prej Kodit Penal të RFJ-së. Kodi u miratua nga Kuvendi Federal i RSFJ-së më 28 shtator 1976 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 1977 (“Kodi Penal i RFJ-së”).²⁹⁰²

1155. Neni 142(1) i Kodit Penal të RFJ-së me titull “Krime lufte kundër popullatës civile” përcaktonte si më poshtë:

Cilido që shkel të drejtën ndërkombëtare në kohë lufte, konflikt të armatosur apo pushtim duke urdhëruar sulm mbi popullatën civile, vendbanime të civilëve, mbi civilë ose individë që nuk marrin pjesë në luftime, me pasojë vdekjen apo dëmtim fizik apo shëndetësor; sulme pa dallim që ndikojnë mbi popullatën civile; vrasje, tortura dhe trajtim çnjerëzor të popullatës civile, ... që shkaktojnë vuajtje apo dëmtim fizik ose shëndetësor të pamasë; dëbim të paligjshëm, shpërngulje, ... përdhunime; përdorim të masave për frikësim dhe terror, ... apo cilido që kryen ndonjë nga shkeljet e lartpërmendura, ndëshkohet me burgim prej jo më pak se pesë vjet apo me dënim me vdekje.²⁹⁰³

Neni 151 me titull “Shkatërrimi i monumenteve kulturore dhe historike”, nënparagrafi (1) ndalonte shkatërrimin e monumenteve dhe ndërtesave kulturore dhe historike si shkelje e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës apo konfliktit të armatosur dhe parashikonte dënim me burgim prej jo më pak se një vit. Nënparagrafi (2) parashikonte dënim me burgim prej jo më pak se pesë vjet për shkatërrimin e godinave të veçanta të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të një populli.²⁹⁰⁴

1156. Gjithashtu Dhoma ka marrë parasysh Nenin 145 me titull “Organizimi dhe nxitja e një grupi për të kryer gjenocid dhe krime lufte”, i cili parashikonte që,

²⁸⁹⁸ *Shih gjithashtu* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *D. Nikoliq*, para. 85.

²⁸⁹⁹ *Shih, p.sh.*, Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 813, 816, 820; Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Tadiq*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 377; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 116–117; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 398; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 443.

²⁹⁰⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 262; *Prokurorja k. Banoviqit*, Lënda Nr. IT-02-65, Aktgjykimi i Dënimit, 28 tetor 2003, para. 88.

²⁹⁰¹ Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *D. Nikoliq*, para. 85.

²⁹⁰² P1736 (Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë). Kodi Penal i RSFJ-së mbeti në fuqi pas vitit 1992 (me disa ndryshime) dhe u rikuajt Kodi Penal i RFJ-së. Në vitin 2003, Kodi Penal i RFJ-së u rikuajt Kodi Penal Themelor i Serbisë.

²⁹⁰³ P1736, neni 142(1) i Kodit Penal të RFJ-së.

²⁹⁰⁴ P1736, neni 151 i Kodit Penal të RFJ-së.

(1) Cilido që organizon një grup për kryerjen e veprave penale të renditura në Nenet 141-144 të këtij Kodi, dënohet me jo më pak se pesë vjet burgim.

(2) Cilido që bëhet anëtar i grupit të përshkruar në paragrafin 1 të këtij Neni, dënohet me jo më pak se një vjet burgim. ...

(4) Cilido që nxit ose shtyn kryerjen e veprave penale të renditura në Nenet 141-144 të këtij Kodi, dënohet me jo më pak se një dhe jo më shumë se dhjetë vjet burgim.

1157. Paragrafët 1 dhe 2 të Neni 38 të Kodit Penal të RFJ-së parashikonin një dënim prej më së shumti 15 vjet burgim, dhe një dënim prej 20 vjet burgim për vepra penale për të cilat parashkruhej dënim me vdekje.²⁹⁰⁵

1158. Krimet brenda vendit dhe të natyrës së shkeljeve bazë të kësaj çështjeje i nënshtroheshin Kodit Penal të Republikës së Serbisë gjatë periudhës përkatëse. Kodi parashikonte dënim me burgim prej jo më pak se pesë vjet për vrasje dhe jo më pak se dhjetë vjet burgim ose dënim me vdekje për vrasje në rrethana rënduese.²⁹⁰⁶

1159. Kushtetuta e RFJ-së e vitit 1992 shfuqizoi dënimin me vdekje për krimet që ndëshkonte Kodi Penal i RFJ-së. Në vitet 1990-të, Gjykata Kushtetuese e Serbisë shpalli jokushtetues dënimin me vdekje duke e eliminuar nga procedura penale e vendit. Pas këtij vendimi, Kodi Penal i RFJ-së u ndryshua dhe dënimi me vdekje u zëvendësua me dënimin me 40 vjet burgim. Gjithashtu, edhe në Kodin Penal të Serbisë më 200, dënimi me vdekje u zëvendësua me 40 vjet burgim. Në këtë drejtim, Dhoma vë në dukje se Dhoma e Apelit në çështjen *Kërstiq* u shpreh se krahas marrjes parasysh të ligjit përkatës në ish-Jugosllavi në fuqi gjatë kohës së kryerjes së krimeve “Dhoma Gjyqësore ka kompetencë të marrë parasysh edhe ... evoluimin e mëvonshëm të atij ligji”.²⁹⁰⁷ Mirëpo në çështjen e paradokohshme *Mërkshiq dhe të tjerë*, Dhoma Gjyqësore theksoi se gjykatat serbe zbatonin parimin *lex mitior* dhe parashikonin dënim prej më së shumti 20 vjet burgim për krimet e kryera para ndryshimit në 40 vjet burgim.²⁹⁰⁸

1160. Dhoma është e vetëdijshme se Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara krijoi Tribunalin pjesërisht për të kontribuar në rivendosjen dhe ruajtjen e paqes në ish-Jugosllavi.²⁹⁰⁹ Ndonëse nuk udhëhiqet detyrimisht nga praktikat e përcaktimit të dënimit në ish-Jugosllavi, Dhoma mendon se gjatë zbatimit të “kompetencave të gjera në përcaktimin e dënimit të duhur”,²⁹¹⁰ ajo duhet t’i respektojë këto praktika aq sa është e mundur, me kusht që të arrijë vendim të drejtë në

²⁹⁰⁵ P1736, nenet 38(1)–(2) të Kodit Penal të RFJ-së.

²⁹⁰⁶ P1020, neni 47 i Kodit Penal të Republikës së Serbisë.

²⁹⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 260–263.

²⁹⁰⁸ Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 706–708.

²⁹⁰⁹ S/Res/808 (1993), 22 shkurt 1993, f. 2.

²⁹¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 336.

këtë çështje. Për këtë arsye, Dhoma i kushtoi vëmendje të posaçme ligjeve të atëhershme në fuqi të RFJ-së dhe Serbisë në kohën e ngjarjeve të Aktakuzës, siç u përshkrua në paragrafët më lart. Lidhur me këtë aspekt, Dhoma thekson se nuk ka të ngjarë që një person i shpallur fajtor për krimet e pretenduara në Aktakuzë, të dënohej me më shumë se 20 vjet burgim në Serbi, më 1999.

iv. Përfitimi i kohës së paraburgimit

1161. Bazuar në paragrafin C të Rregullës 101, periudha të cilën personi i dënuar e ka kaluar në paraburgim në pritje të dorëzimit të tij në Tribunal ose në pritje të procesit gjyqësor, llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit.

B. LIGJI MBI FAJËSINË E SHUMËFISHTË DHE AKUZAT KONKRETE NË KËTË ÇËSHTJE²⁹¹¹

1162. Kur Dhoma shpall të akuzuarin fajtor për më shumë se një krim të ndëshkueshëm sipas Statutit në bazë të veprimeve ose mosveprime të njëjta të tij, shpallja e fajësisë për çdo krim lejohet vetëm në qoftë se krimi përmban të paktën një element juridik të ndryshëm nga krimet e tjera në fjalë.²⁹¹² Nëse dy krime për të cilat akuzohet i akuzuari në bazë të sjelljes së njëjtë kriminale nuk përmbajnë së paku një element dallues midis tyre, Dhoma mund të shpallë të akuzuarin fajtor vetëm për krimin që përmban element apo elemente më të përcaktuara.²⁹¹³ Dhoma e Apelit ka konkluduar se “kushti i fajësisë së shumëfishtë ka qëllim të dyfishtë: të garantojë që i Akuzuari shpallet fajtor vetëm për shkelje të ndryshme dhe në të njëjtën kohë të garantojë që vendimi për shpalljen e fajësisë, pasqyron plotësisht përgjegjësinë penale të të akuzuarit”.²⁹¹⁴

1163. Rrjedhimisht, gjatë zbatimit të kushtit të fajësisë së shumëfishtë, Dhoma duhet t’i krahasojë në mënyrë abstrakte të gjitha kushtet e përgjithshme të krimeve të ndëshkueshme prej Statutit si dhe elementët e veprave penale bazë që akuzohen, për të përcaktuar nëse për çdo krim, në aspektin juridik, duhet të provohet një element i ndryshëm nga krimet e tjera.²⁹¹⁵ Për shembull, meqë Neni 3

²⁹¹¹ Dhoma Gjyqësore do të ndjekë praktikën e Dhomës së Apelit dhe do të përdorë termin “fajësi e shumëfishtë” për të përshkruar fajësinë e njëkohshme për një apo më shumë krime materiale në lidhje me të njëjtën sjellje, kurse termin “fajësi përputhëse” për të përshkruar fajësinë e njëkohshme bazuar në forma të ndryshme të përgjegjësisë sanksionuar në Nenet 4(3)(e), 7(1), dhe 7(3). *Shih, p.sh.*, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 35, 1030; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 89–93; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 81. *Gjithsesi shih* Aktgjykimi *Gacumbtsi*, para. 266 (ku termi “fajësi e shumëfishtë” përdoret për fajësinë e njëkohshme bazuar në forma të ndryshme të përgjegjësisë).

²⁹¹² Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 315; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1032–1033; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë.*, para. 173; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 412; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 717; Aktgjykimi *Strugar*, para. 447; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 799.

²⁹¹³ Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 315; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1033; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 413; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 717; Aktgjykimi *Strugar*, para. 447; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 799.

²⁹¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1033.

²⁹¹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1033, 1039–1040 (anulon Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq*, para. 231–232; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 145–146; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 174, 188).

dhe Neni 5 i Statutit përmbajnë së paku një kusht të përgjithshëm dallues midis tyre – përkatësisht Neni 3 kërkon vërtetimin e lidhjes së ngushtë midis veprimeve të të akuzuarit dhe konfliktit të armatosur,²⁹¹⁶ kurse Neni 5 kërkon vërtetimin e ekzistencës së sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile,²⁹¹⁷ - i akuzuari mund të shpallet fajtor për krimet e ndëshkueshme prej Statutit bazuar në të dy Nenet, ndonëse faktet në mbështetje të secilës prej shkeljeve bazë janë të njëjta.²⁹¹⁸

1164. Në qoftë se krimet përkatëse të ndëshkueshme sipas Statutit kanë së paku një kusht të përgjithshëm dallues midis tyre, nuk është me rëndësi nëse shkeljet bazë që i ngarkohen të akuzuarit - për shembull, vrasja, e cila mund të ngarkohet si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës, ose si krim kundër njerëzimit,²⁹¹⁹ - përmbajnë elementë të ngjashëm midis tyre.²⁹²⁰ Rrjedhimisht, Dhoma gjithmonë mund të shpallë fajësi të shumëfishtë në bazë të Nenit 3 dhe 5.²⁹²¹ Gjithashtu, në qoftë se shkeljet bazë përmbajnë së paku një element dallues midis tyre – për shembull përdhunimi, i cili kërkon penetrimin seksual dhe tortura e cila duhet t'i shkaktohet dikujt për qëllime të ndaluara si shkelje bazë të Nenit 5 – nuk është me rëndësi nëse ato figurojnë si forma të të njëjtit krim të ndëshkueshëm prej Statutit bazuar në të njëjtën sjellje.²⁹²²

1165. Për sa u përket akuzave konkrete në këtë çështje, secili prej të Akuzuarve akuzohet për vrasje si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit (pika 4), dhe në të njëjtën kohë, faktet themelore mbi të cilat bazohen akuzat për vrasje u ngarkohen të Akuzuarve si krime kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5(a) të Statutit (pika 3). Meqë të Akuzuarit akuzohen për vrasje bazuar në dy nene të ndryshme të Statutit, të cilat kërkojnë ekzistencën e elementëve juridikisht dallues midis tyre, këtu nuk bëhet fjalë për fajësi të shumëfishtë të palejueshme.

1166. Të Akuzuarit gjithashtu akuzohen për dëbim si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5(d) të Statutit (pika 1) dhe për zhvendosje të dhunshme si “veprime të tjera çnjerëzore,” krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5(i) të Statutit (pika 2). Dëbimi kërkon synimin për shpërnguljen e

²⁹¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 165; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 82; Apeli i Vendimit të Juridiksionit *Tadiq*, para. 94(i)-(ii).

²⁹¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 98; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 85; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248.

²⁹¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1036; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 176; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 388.

²⁹¹⁹ *Shih* Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 382, 388; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 326.

²⁹²⁰ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1037.

²⁹²¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1036; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 176; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 388; Aktgjykimi i Apelit *Jelisiq*, para. 82; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 800; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 503; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 556-557. *Shih p. sh.*, Aktgjykimi *Furunxhija*, f. 112 (shpall fajësinë e shumëfishtë të të akuzuarit për përdhunim si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës dhe për torturim si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës bazuar në të njëjtën sjellje ndaj të njëjtave viktime).

përhershme apo të përkohshme të viktimave përtej kufirit përkatës shtetëror, kurse veprime të tjera çnjerëzore kërkojnë provë se veprimi ose mosveprimi shkaktoi vuajtje apo lëndime të rënda mendore ose fizike ose përbën sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor. Rrjedhimisht këto dy akuza nuk përbëjnë fajësi të shumëfishtë të palejueshme.²⁹²³

1167. Së fundi, në kuadër të përndjekjes, krim kundër njerëzimit sipas Nenit 5(h) (pika 5), të Akuzuarit akuzohen për vrasjet e përshkruara në pikat 3 dhe 4, për dhunë seksuale dhe për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës si forma të krimit të përndjekjes. Për rrjedhojë, të akuzuarit akuzohen për vrasje si krim kundër njerëzimit bazuar në dy nënparagrafë të ndryshëm të Nenit 5, përkatësisht (a) dhe (h). Dhoma e Apelit ka konkluduar se fajësia e shumëfishtë bazuar në dy nënparagrafë nuk është e palejueshme.²⁹²⁴ Dhuna seksuale dhe dëmtimi ose shkatërrimi i pronës si forma të krimit të përndjekjes figurojnë vetëm si përndjekje bazuar në Nenin 5(h), dhe si pasojë nuk krijojnë problem në lidhje me fajësinë e shumëfishtë në këtë çështje.

1168. Rrjedhimisht, fajësia e shumëfishtë në lidhje me të gjitha akuzat në këtë çështje nuk mund të cilësohet e palejueshme.

C. PËRCAKTIMI I DËNIMEVE NË KËTË ÇËSHTJE

1169. Prokuroria vendosi ta trajtonte aspektin e dënimeve në terma të përgjithshme dhe nuk paraqiti parashtrime për çdo të Akuzuar veç e veç. Parashtrimet përfundimtare të disa prej të Akuzuarve nuk e trajtojnë problemin e dënimit ose nuk trajtojnë faktorë qartësisht të rëndësishëm që Dhoma duhet të marrë parasysh. Në përpjekje për të arritur një vendim të bazuar sa më shumë informacion, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dokumentacionin e procesit gjyqësor për të përcaktuar nëse përkatësisht faktorët rëndues dhe lehtësues janë vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, ose mbi bazën e tërësisë së gjasave.

1170. Përdorimi i termit “i Akuzuar” në këtë pjesë nuk i referohet Millan Millutinoviçit, i cili u shpall i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat e paraqitura në Aktakuzë, në varësi të paragrafit të fundit të Aktgjykimit.

1. Pesha e Shkeljeve

²⁹²² *Shih, p.sh.*, Aktgjykimi *Furunxhija*, f. 112 (shpall fajësinë e shumëfishtë të të akuzuarit për përdhunim si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës dhe për torturë si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës bazuar në të njëjtën sjellje ndaj të njëjtave viktime).

²⁹²³ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 366.

²⁹²⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1041; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 589.

1171. Sipas Prokurorisë, fushëveprimi i krimeve justifikon burgime afatgjata.²⁹²⁵ Argumentohet se pasojat e krimeve mbi viktimat janë të përhershme dhe se duhet marrë parasysh cënueshmëria e viktimave konkrete.²⁹²⁶

1172. Krimet e provuara nga Prokuroria dhe për të cilat të Akuzuarit janë përgjegjës përfshijnë me qindra vrasje, dhunë seksuale dhe largimin dhe shpërnguljen e dëbimin e dhunshëm të qindra mijëra njerëzve.

1173. Nuk u provuan të gjitha krimet e pretenduara në Aktakuzë. Në lidhje me disa krime të renditura në Aktakuzë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se faktikisht ato u kryen, por se nuk mund t'u ngarkoheshin disa prej të Akuzuarve, apo të gjithë të Akuzuarve. Gjithsesi, të gjithë të Akuzuarit, me përjashtim të Millan Millutinoviçit, u shpallën fajtor që kryen ose ndihmuan dhe inkurajuan shpërnguljen e qindra mijëra shqiptarëve kosovarë. Këto krime nuk ishin incidente të veçuara, por pjesë e një fushate gjerësisht të përhapur dhe sistematike terrori dhe dhune, brenda një periudhe prej pak më shumë se dy muaj. Disa nga viktimat, si gratë, pleqtë dhe fëmijët, ishin veçanërisht të cenueshëm.

1174. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se krimet për të cilat u vërtetua përgjegjësia penale e secilit të Akuzuar, janë shumë të rënda.

1175. Në përcaktimin e dënimeve janë marrë parasysh format e përgjegjësisë për çdo të Akuzuar veç e veç.

1176. Dhoma nuk mori parasysh asnjë nga faktorët e lartpërmendur kur vlerësoi faktorët e mëposhtëm rëndues.

2. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese

a. Rrethanat e përgjithshme

1177. Prokuroria parashtroi se të gjithë të Akuzuarit mbanin poste të larta drejtuese dhe se ata “nuk u vetëpërmbytën” gjatë fushatës së gjerë dhe brutale të krimeve të kryera mbi bazë të përkatësisë etnike të viktimave. Madje ata nuk ushtruan vetëpërmbytje as kur e gjithë bota, përfshirë Prokuroren e Tribunalit, po shikonin dhe ndiqnin me vëmendje veprimet e tyre.²⁹²⁷ Vërtetësia e secilit prej këtyre parashtrimeve do të diskutohet më poshtë.

²⁹²⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 1100.

²⁹²⁶ Argumentet përmblyllëse të Prokurorisë, T. 26947 (20 gusht 2008).

²⁹²⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 1099–1100.

1178. Sjellja e mirë gjatë gjykimit, në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara, dhe gjatë lirimit të përkohshëm vlerësohet si faktor që Dhoma duhet të marrë parasysh në lidhje me rrethanat lehtësuese.²⁹²⁸ Dhoma pranon se sjellja e të Akuzuarve gjatë kohës së gjykimit dhe në njësinë e paraburgimit ka qenë e mirë. Kjo i mundësoi edhe më shumë Dhomës në përmbushjen e detyrës së saj sipas Nenit 20(1) të Statutit për të garantuar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit. Sjellja e tyre e mirë është mbajtur parasysh gjatë përcaktimit të dënimit që do t'u jepet.

1179. Dhoma gjithashtu mban parasysh faktin se asnjë nga të Akuzuarit nuk ka precedentë penalë dhe se para këtyre ngjarjeve duket se secili prej tyre kishte karakter të mirë.

b. Shainoviqi

1180. Mbrojtja e Shainoviqit parashtrohet se ai luajti rol të kufizuar në ngjarjet për të cilat akuzohet.²⁹²⁹ Dhoma nuk pajtohet me këtë dhe konkludoi se ai ishte anëtar i rëndësishëm i ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe se shpërdori kompetencat e tij për të kryer krime. Ndonëse pranon se Shainoviqi veprroi në rrethana të ndërlikuar, si mbrojtja e vendit nga bombardimet e NATO-s dhe disa operacione luftarake kundër UÇK-së, Dhoma gjithsesi konkludon se Shainoviqi shpërdori kompetencat e tij dhe se kjo e rëndon dënimin e tij.

1181. Mbrojtja e Shainoviqit parashtrohet se Dhoma duhet të marrë parasysh karakterin e mirë të Shainoviqit, duke cituar dëshmitë e Qosiqit dhe Millanoviqit për të treguar se Shainoviqi ishte njeri familjar me arsimim të lartë dhe afarist i shquar, i cili respektonte ligjin dhe ishte kundër korrupsionit, dhe se ishte njëri nga zyrtarët e rrallë shtetërorë që asnjëherë nuk u shoqërua me “vjedhës dhe manjatë” gjatë luftës.²⁹³⁰ Në lidhje me karakterin e Shainoviqit, Dhoma gjithashtu mori parasysh dëshmitë e Jovanoviqit, Millosavleviqit, Angjelkoviçit dhe Matkoviçit.²⁹³¹ Dhoma është e mendimit se karakteri i mirë i Shainoviqit u vërtetua vetëm në lidhje me periudhën para ngjarjeve të Aktakuzës. Prokuroria provoi se Shainoviqi mori letrën e Prokurores së Tribunalit Louise Arbour më 26 mars 1999 dhe se u informua nga të tjerë për krimet e paraqitura në Aktakuzë, por megjithatë vazhdoi me sjelljen që e çoi drejt përgjegjësisë penale. Rrjedhimisht, karakteri i mirë i Shainoviqit nuk është vërtetuar dhe si pasojë nuk do të konsiderohet rrethanë lehtësuese.

²⁹²⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 1053.

²⁹²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 891.

²⁹³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 892; Argumentet Përmblyëse të Mbrojtjes së Shainoviqit, T. 27052 (21 gusht 2008)

²⁹³¹ Zhivadin Jovanoviq, T. 14070 (20 gusht 2007), T. 14201 (22 gusht 2007); Andreja Millosavleviq, T. 14304, 14309–14310 (23 gusht 2007); Zoran Angjelkoviç, T. 14665 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviç, T. 14600–14601 (29 gusht 2007).

1182. Mbrojtja e Shainoviqit parashtroi se Dhoma duhet të mbajë parasysh rrethanat familjare të Shainoviqit, përfshirë gjendjen e vështirë shëndetësore të anëtarëve të familjes së ngushtë.²⁹³² Dhoma e ka marrë parasysh këtë faktor. Shainoviqi ka probleme shëndetësore, ndonëse jo në atë masë sa të konsiderohen faktorë lehtësues.²⁹³³

1183. Ndonëse nuk përmendet në dosjen gjyqësore përfundimtare, Dhoma mban parasysh faktin se pas ngritjes së Aktakuzës kundër tij, Shainoviqi bëri intervistë me Prokurorinë. Bashkëpunimi thelbësor me Prokurorinë konsiderohet rrethanë lehtësuese; që bashkëpunimi i një të akuzuari me Prokurorinë të cilësohet “thelbësor”, ky përcaktim varet nga cilësia dhe sasia e informacionit që ai jep gjatë intervistës.²⁹³⁴ Dhoma rishikoi intervistën e Shainoviqit me Prokurorinë dhe nuk konstatoi bashkëpunim thelbësor me Prokurorinë, por do të marrë parasysh bashkëpunimin e përgjithshëm që ofroi Shainoviqi duke pranuar t’i japë Prokurorisë intervistën.

1184. Gjatë përcaktimit të dënimit të tij, Dhoma nuk e konsideron rrethanë lehtësuese dorëzimin e Shainoviqit.²⁹³⁵

c. Ojdaniqi

1185. Ojdaniqi ishte ushtaraku më i lartë në RFJ.²⁹³⁶ Së shumti, brenda 29 prillit 1999, ai mori letrën e Prokurores së Tribunalit Arbour me pretendimet e kryerjes së krimeve nga vartësit e tij; ai mori edhe Aktakuzën e parë në të cilën akuzohej për krimet e kryera më 27 maj 1999 në Kosovë. Pas marrjes së këtyre komunikimeve, Ojdaniqi vijoi me lëshimin e urdhrave që vinin në dukje dijeninë e tij për operacionet e koordinuara të UJ-së dhe MPB-së, pavarësisht nga dijenia që kishte se gjatë operacioneve të mëparshme të përbashkëta ishin kryer krime kundër shqiptarëve kosovarë. Sjellja e Ojdaniqit si oficeri më i lartë i UJ-së, përbën shpërdorim të pozitës së tij të lartë dhe rrjedhimisht e rëndon dënimin e tij. Dhoma arriti në këtë përfundim pavarësisht nga fakti se pranon që Ojdaniqi veprroi në rrethana të ndërlikuara, si mbrojtja e vendit nga bombardimet e NATO-s dhe disa operacione luftarake kundër UÇK-së.

²⁹³² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 893.

²⁹³³ *Shih gjithashtu, p.sh.*, Vendimi pjesërisht konfidencial dhe *ex parte* në lidhje me Mocionin e Shainoviqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 9 shkurt 2009; Parashtrimet pjesërisht konfidenciale dhe *ex parte* të Sekretarisë sipas Rregullës 33(B) në Lidhje me Gjendjen Shëndetësore të Shainoviqit, 30 dhjetor 2008; Parashtrimet pjesërisht konfidenciale dhe *ex parte* të Sekretarisë sipas Rregullës 33(B) në Lidhje me Gjendjen Shëndetësore të Shainoviqit, 26 janar 2009.

²⁹³⁴ Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Bralo*, 2 prill 2007, para. 51; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 774.

²⁹³⁵ *Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendim për Lirim të Përkohshëm, 30 tetor 2002, para. 10; *Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendimi në lidhje me Kërkesat e Dyta për Lirim të Përkohshëm, 29 maj 2003, f. 7; *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm gjatë Pushimit Dimëror të Gjykatës, 5 dhjetor 2006, para. 19, shënimi 42.

²⁹³⁶ *Shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 548–551.

1186. Mbrojtja e Ojdaniqit parashtron se provat në lidhje me karakterin e mirë të Ojdaniqit duhet të konsiderohen si rrethanë lehtësuese, dhe në mbështetje të parashtrimit të saj citon dëshmitë e Vasileviqit, Peshiqit, Llonçarit, Drewienkiewicz-it, Vllajkoviqit, Panteliqit dhe Jovanoviqit.²⁹³⁷ Anëtarë të familjes së tij vënë në dukje se Ojdaniqi është njeri i respektuar i cili bën ç'është e mundur për familjen, atdheun dhe për çdo njeri që kërkon ndihmën e tij.²⁹³⁸ Ndonëse Dhoma mban parasysh këto dëshmi, e vërteta është se Ojdaniqi u shpall fajtor për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të shumta në Kosovë gjatë periudhës së paraqitur në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Dhoma u jep peshë të kufizuar dëshmive për karakterin e mirë të Ojdaniqit.

1187. Mbrojtja e Ojdaniqit parashtron se puna e Ojdaniqit gjatë vitit 1998 dhe 1999 u fokusua në rëndësinë e së drejtës humanitare ndërkombëtare, si dhe përmirësimet në sistemin e drejtësisë ushtarake për ndjekjen penale të keqbërësve. Për më tepër, Dhomës i kërkohet të marrë parasysh bashkëpunimin e Ojdaniqit me misionin e vëzhguesve ndërkombëtarë, thirrjet e tij të vazhdueshme për zgjidhje paqësore të konfliktit, përpjekjet e tij për rekrutimin e shqiptarëve në radhët e UJ-së, dhe vështirësitë reale që hasi ai në ushtrimin e kompetencave për të parandaluar dhe ndëshkuar krimet.²⁹³⁹ Ndonëse gjykon se Ojdaniqi mori disa masa për pakësimin e vuajtjeve njerëzore gjatë konfliktit, Dhoma do t'u kushtojë shumë pak rëndësi këtyre masave si faktor lehtësues.

1188. Mbrojtja e Ojdaniqit parashtron se gjatë përcaktimit të dënimit të tij, mosha relativisht e vjetër e Ojdaniqit duhet të konsiderohet rrethanë lehtësuese. Gjithashtu parashtrohet se gjendja e tij shëndetësore është mjaft e keqe dhe se Dhoma Gjyqësore “duhet të mbajë parasysh ndikimin që mund të ketë çdo dënim i mëtejshëm me burgim”.²⁹⁴⁰ Dhoma mendon se gjendja e keqe shëndetësore dhe mosha relativisht e vjetër e Ojdaniqit janë faktorë të rëndësishëm që justifikojnë njëfarë lehtësimi të dënimit.²⁹⁴¹

1189. Mbrojtja e Ojdaniqit parashtron se në prill 2002, gjeneral Ojdaniqi “ishte zyrtari i parë nga Serbia që iu dorëzua Tribunalit pas miratimit të ligjit për bashkëpunim me Tribunalin”. Për më tepër, argumentohet se fakti që dorëzimi u bë me vullnet të lirë duhet të konsiderohet “faktor i rëndësishëm lehtësues”, dhe citohet një kumtim shtypi në të cilin Departamenti i Shtetit i SHBA-së përshëndet “vendimin e guximshëm të Ojdaniqit dhe demonstrimin e aftësisë udhëheqëse të tij”.²⁹⁴² Mirëpo, në vendimin për lirim të përkohshëm të datës 30 tetor 2002, Dhoma e Apelit bëri të ditur se

²⁹³⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 566–573.

²⁹³⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 574.

²⁹³⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 553–561.

²⁹⁴⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 577–579.

²⁹⁴¹ *Shih*, p.sh., 3D1152 (Gjendja Shëndetësore e gjeneral Ojdaniqit, konfidenciale dhe *ex parte*, 29 prill 2008) (e vulosur); Vendimi pjesërisht konfidencial dhe *ex parte* në lidhje me Mocionin e Ojdaniqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 2 maj 2008, Shtojca A; Parashtrimet pjesërisht konfidenciale dhe *ex parte* të Sekretarisë sipas Rregullës 33(B) të Rregullores së Procedurës dhe Provave në lidhje me Gjendjen Shëndetësore të të Akuzuarit, 29 prill 2008.

Dhoma Gjyqësore gaboi kur përcaktoi dorëzimin e Ojdaniqit si vullnetar.²⁹⁴³ Në vendimin e saj për lirim të përkohshëm, të datës 29 maj 2003, Dhoma Gjyqësore u bazua në vendimin e Dhomës së Apelit kur deklaroi se “Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur se i është paraqitur material i ri që do ta bënte të mos bazohej në Vendimin e Dhomës së Apelit se dorëzimet nuk ishin vullnetare”.²⁹⁴⁴ Rrjedhimisht, në vendimin e datës 5 dhjetor 2006, Dhoma Gjyqësore bëri të ditur se Ojdaniqi nuk kishte të drejtë të përfitonte nga dorëzimi i tij.²⁹⁴⁵ Kuntimi i shtypit nuk ndryshon peshën e vendimeve të mëparshme të Tribunalit në lidhje me Ojdaniqin. Në përcaktimin e dënimit të tij, Dhoma nuk i konsideron lehtësuese rrethanat e dorëzimit të Ojdaniqit.

d. Pavkoviqi

1190. Më së shumti brenda datës 29 prill 1999, Pavkoviqi mori letrën e Prokurores së Tribunalit Arbour ku pretendohet kryerje a krimeve nga vartësit e tij. Për më tepër, aktakuza e parë kundër Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit dhe Stojilkoviqit u bë publike më 27 maj 1999. Pas marrjes së këtyre njoftimeve, Pavkoviqi vijoi me miratimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së, pavarësisht se kishte dijeni që gjatë operacioneve të mëparshme ishin kryer krime kundër shqiptarëve kosovarë, dhe ai nuk mori masa efektive që mund të merrte në lidhje me krimet e kryera nga vartësit e tij. Kjo sjellje e Pavkoviqit si komandant i Armatës së Tretë përbën shpërdorim të pozitës së tij të lartë dhe rrjedhimisht e rëndon dënimin e tij. Dhoma arriti në këtë përfundim pavarësisht nga fakti se ajo pranon që Pavkoviqi veprroi në rrethana të ndërlikuara, si mbrojtja e vendit nga bombardimet e NATO-s dhe disa operacione luftarake kundër UÇK-së.

1191. Mbrojtja e Pavkoviqit vë në dukje karakterin e mirë të tij dhe e përshkruan si “ushtarak profesionist të aftë dhe të zgjuar gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake”. Gjithashtu, Pavkoviqi ishte profesionist i nivelit më të lartë dhe vazhdimisht gradohej para kolegëve të tij, dhe eprorët e tij çdo herë i kanë dhënë vlerësimet më të mira.²⁹⁴⁶ Mbrojtja e Pavkoviqit i referohet dëshmisë së Shaun Byrnes-it ku ai e përshkruan Pavkoviqin si person të drejtpërdrejtë dhe profesionist, duke thënë se për mendimin e tij, UJ-ja është sjellë në mënyrë profesionale dhe të ndershme si para, po ashtu edhe

²⁹⁴² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 563.

²⁹⁴³ *Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendimi për Lirim të Përkohshëm, 30 tetor 2002, para. 10; *Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendimi në lidhje me Kërkesën e Nikolla Shainoviqit dhe Dragolub Ojdaniqit për Lirim të Përkohshëm, 26 qershor 2002, para. 12; *shih gjithashtu Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendimi për Lirim të Përkohshëm, 30 tetor 2002, para. 10.

²⁹⁴⁴ *Prokurori k. Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37, Vendim në lidhje me Kërkesat e Dyta për Lirim të Përkohshëm, 29 maj 2003, f. 7.

²⁹⁴⁵ *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm gjatë Pushimit Dimëror të Gjykatës, 5 dhjetor 2006, para. 19, shënimi 42.

²⁹⁴⁶ Argumentet Përmbyllëse të Mbrojtjes së Pavkoviqit, T. 27177 (22 gusht 2008).

gjatë konfliktit.²⁹⁴⁷ Dhoma Gjyqësore gjykon se deklaratat e mësipërme, as nuk e rëndojnë, e as nuk e lehtësojnë dënimin e Pavkoviqit.

1192. Mbrojtja e Pavkoviqit deklaroi se në mbledhjet e 16 dhe 17 majit 1999 në Beograd, Pavkoviqi diskutoi krimet që po kryheshin dhe kërkoi që të formohej komisioni hetimor për hetimin e hollësishëm të personave përgjegjës për kryerjen e krimeve.²⁹⁴⁸ Mirëpo, Dhoma konkludoi se këto mbledhje nuk paraqesin përpjekje të sinqerta të Pavkoviqit. Mbrojtja e Pavkoviqit parashtron se Pavkoviqi lëshoi 27 urdhra në të cilat kërkoi respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe se kjo vë në dukje “përpjekjet e jashtëzakonshme të tij për të parandaluar dhe ndëshkuar”.²⁹⁴⁹ Dhoma nuk pajtohet me Mbrojtjen e Pavkoviqit dhe konkludon se këto përpjekje, të cilat përsëri kanë për qëllim të vënë në dukje karakterin e tij të mirë, ishin të pafrytshme dhe sporadike në parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve.²⁹⁵⁰ Bazuar në tërësinë e gjasave, Dhoma nuk gjykon se këto parashtrime përbëjnë rrethana lehtësuese për dënimin e tij.

1193. Pavkoviqi ka probleme shëndetësore, ndonëse jo në atë masë sa të konsiderohen faktorë lehtësues.²⁹⁵¹

1194. Dhoma gjykon se bazuar në tërësinë e gjasave, intervista e Pavkoviqit me Prokurorinë dhënë para ngritjes së Aktakuzës kundër tij nuk përbën provë të bashkëpunimit thelbësor me Prokurorinë, dhe nuk i jep atij të drejtë për ulje dënimi. Gjithashtu në përcaktimin e dënimit të tij, Dhoma nuk e konsideron rrethanë lehtësuese dorëzimin e Pavkoviqit.²⁹⁵²

e. Llazareviqi

1195. Llazareviqi ishte komandanti i Korpusit të Prishtinës, pozitë e lartë në UJ. Dhoma konkludoi se Llazareviqi ishte në dijeni së paku të një Rezolutive të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ku pretendohet se vartësit e tij po kryenin krime të shumta, dhe megjithatë

²⁹⁴⁷ Argumentet Përmblyllëse të Mbrojtjes së Pavkoviqit, T. 27177–27178 (22 gusht 2008); *shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 213.

²⁹⁴⁸ Argumentet Përmblyllëse të Mbrojtjes së Pavkoviqit, T. 27178–27179 (22 gusht 2008); *shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 294.

²⁹⁴⁹ Argumentet Përmblyllëse të Mbrojtjes së Pavkoviqit, T. 27199–27200 (22 gusht 2008).

²⁹⁵⁰ *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14, Aktgjykimi, 3 mars 2000, para. 781–782; *krahaso*. Aktgjykimi i Dënimit *Obrenoviq*, para. 132–134 (ku thuhet se ndihma “e vazhdueshme” që Obrenoviqi u ofroi disa myslimanëve gjatë luftës, si dhe përfundimi se para luftës ai ishte pjesëtar tejet i respektuar i shoqërisë, përbënin faktor “të rëndësishëm” lehtësues).

²⁹⁵¹ *Shih, p.sh.*, Vendimi mbi Mocionin e Pavkoviqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 26 shtator 2008; Vendimi mbi Mocionin e Përsëritur për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 27 nëntor 2008.

²⁹⁵² *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65.1, Vendim në lidhje me Apelimin e Ndërkohshëm të Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Miratimin e Lirimit të Përkohshëm të Nebojsha Pavkoviqit, 1 nëntor 2005, para. 9; *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, Vendimi mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm gjatë Pushimeve Dimërore të Gjykatës, 5 dhjetor 2006, para. 19, shënimi 42.

vijoi me angazhimin e forcave të tij në Kosovë. Prova të tjera të shumta të paraqitura nga Prokuroria gjithashtu vërtetojnë se ai kishte dijeni për krimet. Sjellja e tij e tillë si komandanti i Korpusit të Prishtinës përbën shpërdorim të pozitës së tij të lartë dhe rrjedhimisht e rëndon dënimin e tij. Dhoma arriti në këtë përfundim pavarësisht nga fakti se ajo pranon që Llazareviqi veproi në rrethana të ndërlikuara, si mbrojtja e vendit nga bombardimet e NATO-s dhe disa operacione luftarake kundër UÇK-së.

1196. Mbrojtja e Llazareviqit parashtrohet se karakteri i mirë i Llazareviqit duhet të merret parasysh si rrethanë lehtësuese dhe në mbështetje të këtij parashtrimi citon dëshmitë e Llonçarit, Vladimir Markoviqit dhe Kosovacit.²⁹⁵³ Ndonëse Dhoma i merret parasysh këto dëshmi, e vërteta është se Llazareviqi u shpall përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të shumta në Kosovë gjatë periudhës së paraqitur në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Dhoma u kushton rëndësi të kufizuar dëshmive mbi karakterin e mirë të Llazareviqit.

1197. Duke shtrembëruar deklaratën e Dhomës dhënë gjatë konferencës para fillimit të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes, Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se vendimi i tij për të dëshmuar gjatë paraqitjes së provave prej mbrojtjes, dëshmon gatishmërinë e tij për ta ndihmuar Dhomën në zbulimin e së vërtetës.²⁹⁵⁴ Dhoma nuk gjykon se vendimi për të dëshmuar, ndonëse në fillim të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes së të Akuzuarit, i jep detyrimisht të Akuzuarit të drejtën për lehtësimin e dënimit të tij dhe konkludon se në këtë rast nuk ndikon në lehtësimin e dënimit.

1198. Mbrojtja e Llazareviqit parashtrohet se gjatë fazës paragjyqësore, Llazareviqi u intervistua nga Prokuroria vetëm disa ditë pas paraqitjes së parë të tij, madje pa patur mundësi që ta lexonte materialin mbështetës të Prokurorisë, dhe se ky fakt dëshmon “kontributin aktiv të Llazareviqit në përpjekjet për zbulimin e të vërtetës në këtë proces”.²⁹⁵⁵ Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi këtë aspekt gjatë marrjes së një vendimi të mëvonshëm për lirim të përkohshëm, në të cilin Dhoma shënoi se Llazareviqi kishte bashkëpunuar me Prokurorinë duke marrë pjesë në një “intervistë të gjatë që zgjati disa ditë dhe duke ofruar dokumente të reja”.²⁹⁵⁶ Dhoma e konsideron thelbësor bashkëpunimin e Llazareviqit me Prokurorinë dhe rrjedhimisht do të trajtojë si rrethanë lehtësuese.

1199. Parashtrohet se “rrethanat e veçanta familjare” të Llazareviqit, përfshirë sëmundjen e rëndë të pjesëtarëve të familjes dhe kushtet e vështira jetësore të tyre, duhet të trajtohen si rrethanë e

²⁹⁵³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 945–948.

²⁹⁵⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 941–942.

²⁹⁵⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 940.

²⁹⁵⁶ *Prokurori k. Llazareviqit*, Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm, 14 prill 2005, f. 4; *shih gjithashtu Prokurori k. Llazareviqit*, Lënda Nr. IT-03-70-PT, Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm, 29 mars 2005, para. 3.

rëndësishme lehtësuese.²⁹⁵⁷ Për më tepër, gjatë mbajtjes në paraburgim Llazareviqi ka pasur probleme të mëdha shëndetësore të cilat ende e mundojnë.²⁹⁵⁸ Dhoma i konsideron lehtësues këta faktorë dhe rrjedhimisht do të zvogëlojë dënimin e Llazareviqit.

1200. Për arsyet e paraqitura në vendimet e ndërkohshme të mëparshme për lirim të përkohshëm, Dhoma i gjykon lehtësuese rrethanat e dorëzimit të Llazareviqit.²⁹⁵⁹

f. Llukiqi

1201. Pasi Prokurorja e Tribunalit, Arbour, u dërgoi letër paralajmëruese Millosheviqit, Millutinoviqit, Shainoviqit dhe Ojdaniqit - për përmbajtjen e të cilës Llukiqi mësoi në mbledhjen e mbajtur në Beograd më 4 maj 1999 – Llukiqi vijoi me udhëzime për angazhimin e MPB-së udhëzime në operacione të përbashkëta me UJ-në në Kosovë, pavarësisht se kishte dijeni që gjatë operacioneve të përbashkëta të mëparshme ishin kryer krime kundër shqiptarëve kosovarë. Sjellja e Llukiqit si shef i Shtabit të MPB-së përbën shpërdorim të pozitës së tij të lartë dhe rrjedhimisht e rëndon dënimin e tij. Dhoma arriti në këtë përfundim pavarësisht nga fakti se ajo pranon që Llukiqi veproi në rrethana të ndërlikuara, si mbrojtja e vendit nga bombardimet e NATO-s dhe disa operacione luftarake kundër UÇK-së.

1202. Mbrojtja e Llukiqit parashtrohet se ai ishte polic profesionist me përvojë të gjatë në Ministrinë e Brendshme në fushën e ruajtjes së rendit publik.²⁹⁶⁰ Argumentohet se Llukiqi “kryesoi përpjekjet për eliminimin e krimit të organizuar” që lidhet me regjimin e mëparshëm politik, si dhe përpjekjet kryesore për reformat policore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.²⁹⁶¹ Këtu përfshihen përpjekjet për krijimin e forcës policore shumetnike dhe për situatë të qetë në vendbanimet shumetnike, si dhe drejtimi i operacioneve policore për kapjen e “vrasësve” të përfshirë në vrasjen e Kryeministrit, Zoran Gjingjiq.²⁹⁶² Mbrojtja e Llukiqit parashtrohet se në kohën

²⁹⁵⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 949.

²⁹⁵⁸ *Shih, p.sh.*, Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 950; Vendimi pjesërisht konfidencial dhe *ex parte* në lidhje me Mocionin e Llazareviqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 9 shkurt 2009, Shtojca; Parashtrimi konfidencial dhe *ex parte* i Sekretarisë Bazuar në Rregullën 33(B) në lidhje me Gjendjen Shëndetësore të të Akuzuarit Llazareviq, 8 janar 2009; Parashtrimi konfidencial dhe *ex parte* i Sekretarisë Bazuar në Rregullën 33(B) në lidhje me Gjendjen Shëndetësore të të Akuzuarit Llazareviq, 26 nëntor 2008; Parashtrimi konfidencial dhe *ex parte* i Sekretarisë Bazuar në Rregullën 33(B) në lidhje me Gjendjen Shëndetësore të të Akuzuarit Llazareviq, 20 janar 2009; Parashtrimi konfidencial dhe *ex parte* i Sekretarisë Bazuar në Rregullën 33(B) në lidhje me Gjendjen Shëndetësore të të Akuzuarit Llazareviq, 5 shkurt 2009.

²⁹⁵⁹ *Prokurori k. Vladimir Llazareviqit*, Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm, 14 prill 2005, f. 3. *Shih gjithashtu Prokurori k. Vladimir Llazareviqit*, Lënda Nr. IT-03-70-PT, Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm, 29 mars 2005, para. 5; *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, Vendim mbi Mocionin e Llazareviqit për Lirim të Përkohshëm, 22 maj 2007, para. 10.

²⁹⁶⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1423, 1425.

²⁹⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), f. 282–283.

²⁹⁶² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1453–1462, 1471.

e reformave demokratike kur Llukiqi ishte shef i RJB-së së MPB-së, u amnistuan me qindra shqiptarë kosovarë të cilët më parë ishin gjykuar dhe dënuar për terrorizëm si pjesëtarë të UÇK-së.²⁹⁶³ Gjithashtu thuhet se Llukiqi “kryesoi përpjekjet e MPB-së për zbulimin dhe hetimin e krimeve nga koha e luftës në Kosovë dhe për gjetjen e keqbërësve”.²⁹⁶⁴ Konkretisht, në vitin 2001 Llukiqi organizoi komisionin policor special për hetimin e çështjes së kamionit-frigorifer të ngarkuar me kufomat e qytetarëve shqiptarë kosovarë që u gjet në lumin Danub. Mbrojtja e Llukiqit parashtroi se ky ishte grupi i parë i punës që u formua për shqyrtimin e krimeve të luftës në mënyrë profesionale dhe se hetimet e hollësishme që kreu ky grup nxorën në pah “pasqyrën e plotë” të transportimit të fshehtë të kufomave nga Kosova në Serbi.²⁹⁶⁵ Sipas Mbrojtjes së Llukiqit, Llukiqi personalisht ndërmori krijimin e arkivit të veçantë të të dhënave të rëndësishme në lidhje me ngjarjet në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999, një nga qëllimet e së cilit ishte bashkëpunimi me Tribunalin, dhe se ai ishte i pari që u përpoq të përpilonte listën e personave të zhdukur në Kosovë.²⁹⁶⁶ Për më tepër, Mbrojtja e Llukiqit deklaroi se si shef i RJB-së, ai bashkëpunoi me Tribunalin përmes kryerjes së hetimeve dhe grumbullimit të informacionit deri në vitin 2004.²⁹⁶⁷ Ndonëse nuk përmendet në dosjen gjyqësore përfundimtare, para ngritjes së Aktakuzës kundër tij, Llukiqi u intervistua nga Prokuroria. Ndonëse gjithë çka u parashtroi më lart, Dhoma nuk e konsideron të vërtetuar apo si diçka që del jashtë kompetencave të një zyrtari të ruajtjes së rendit dhe ligjit gjatë kryerjes së detyrave të tij të zakonshme, në bazë të tërësisë së gjasave Dhoma gjykon se Llukiqi kontribuoi në ruajtjen e ligjit dhe rendit në disa raste që lidhen me krimet e akuzuara në Aktakuzë,²⁹⁶⁸ dhe rrjedhimisht gjatë përcaktimit të dënimit të tij, Dhoma do ta mbajë këtë parasysh si rrethanë lehtësuese.

1203. Gjatë paraqitjes të argumenteve përmbyllëse, Mbrojtja e Llukiqit ngriti problemin e shëndetit të Llukiqit dhe kërkoi që Dhoma të mbajë parasysh të gjitha parashtrimet konfidenciale në lidhje me shëndetin e Llukiqit, të paraqitura në mocionet e mëparshme për lirimin e tij të përkohshëm..²⁹⁶⁹ Dhoma shqyrtoi dokumentacionin përkatës të procesit dhe nuk mendon se gjendja shëndetësore e Llukiqit është e tillë që justifikon lehtësimin e dënimit të tij.²⁹⁷⁰

²⁹⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1453–1463.

²⁹⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), f. 284.

²⁹⁶⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1464–1467.

²⁹⁶⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 15 korrik 2008 (versioni konfidencial), para. 1500, 1502; Argumentet Përmbyllëse të Mbrojtjes së Llukiqit, T. 27374–27375 (26 gusht 2008).

²⁹⁶⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 1506.

²⁹⁶⁸ *Shih, p.sh.*, Aleksandar Kostiq, T. 24103, 24119 (11 mars 2008); 6D2, T. 25447–25448 (16 prill 2008) (seancë e mbyllur).

²⁹⁶⁹ Argumentet Përmbyllëse të Mbrojtjes së Llukiqit, T. 27374 (26 gusht 2008).

²⁹⁷⁰ *Shih, p.sh.*, Vendimi mbi Kërkesën e Llukiqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 12 dhjetor 2008; Vendimi pjesërisht konfidencial në lidhje me Kërkesën e Llukiqit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 31 tetor 2008.

1204. Mbrojtja e Llukiqit nuk paraqiti parashtrime në lidhje me dorëzimin e Llukiqit si rrethanë lehtësuese, por edhe sikur të kishte bërë parashtrime të tilla, duke marrë parasysh vendimet e mëparshme në lidhje me këtë çështje, Dhoma nuk do ta konsideronte dorëzimin e Llukiqit si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e dënimit të tij.²⁹⁷¹

1205. Siç shihet nga analiza e paraqitur më lart, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi rrethanat e çdo të Akuzuari veçazi. Mirëpo, pavarësisht nga rrethanat e ndryshme të çdo të Akuzuari, Dhoma nuk e gjykon të arsyeshme të bëjë dallim në dhënien e dënimit midis dy të Akuzuarve të shpallur fajtorë për ndihmë dhe inkurajim, dhe midis tre të Akuzuarve të shpallur fajtorë për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

²⁹⁷¹ *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, Vendimi mbi Lirimin e Përkohshëm të Sreten Llukiqit, 30 shtator 2005, f. 5; Vendimi mbi Mocionin e Llukiqit Për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 7 dhjetor 2007, para. 6.

X. VENDIM

1206. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Nenet 23, 24, dhe 27 të Statutit të Tribunalit dhe Rregullat 98 *ter*, 99, 101, 102, 103 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit, Dhoma Gjyqësore **VENDOS** (në varësi të paragrafit 1213 në vijim) si më poshtë:

1207. Në bazë të paragrafit 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit, Dhoma Gjyqësore e shpall **Millan Millutinoviçin TË PAFAJSHËM** për pikat 1-5 të Aktakuzës, në varësi të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi. Në përputhje me paragrafin A të Rregullës 99 të Rregullores, Dhoma urdhëron lirimin e menjëhershëm të Millan Millutinoviçit nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara pas përfundimit të formaliteteve të nevojshme, pa paragjykuar procesin e mëtejshëm që mund të pasojë vendimin e Dhomës Gjyqësore III në bazë të paragrafit të fundit të këtij Aktgjykimi.

1208. Në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit Dhoma Gjyqësore e shpall **Nikolla Shainoviçin FAJTOR** për pikat 1- 5 të Aktakuzës. Dhoma Gjyqësore e dënon Nikolla Shainoviçin me një dënim të vetëm me 22 vjet burgim. Nikolla Shainoviçi ndodhet në paraburgim që nga 2 maji 2002; dhe në bazë të paragrafit C të Rregullës 101 të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim deri tani, t'i llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Në bazë të paragrafit C të Rregullës 103 të Rregullores, Nikolla Shainoviçi do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

1209. Në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit Dhoma Gjyqësore e shpall **Dragolub Ojdaniçin FAJTOR** për pikën 1 dhe 2 të Aktakuzës. dhe në bazë të paragrafit 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit, **TË PAFAJSHËM** për pikat 3–5 të Aktakuzës. Dhoma Gjyqësore e dënon Dragolub Ojdaniçin me një dënim të vetëm me 15 vjet burgim. Dragolub Ojdaniçi ndodhet në paraburgim që nga 25 prilli 2002; dhe në bazë të paragrafit C të Rregullës 101 të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim deri tani, t'i llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Në bazë të paragrafit C të Rregullës 103 të Rregullores, Dragolub Ojdaniçi do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

1210. Në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit Dhoma Gjyqësore e shpall **Nebojsa Pavkoviçin FAJTOR** për pikat 1-5 të Aktakuzës. Dhoma Gjyqësore e dënon Nebojsa Pavkoviçin me një dënim të vetëm me 22 vjet burgim. Nebojsa Pavkoviçi ndodhet në paraburgim që nga 25 prilli 2005; dhe në bazë të paragrafit C të Rregullës 101 të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim deri tani, t'i llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Në bazë të paragrafit C

të Rregullës 103 të Rregullores, Nebojsa Pavkoviqi do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

1211. Në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit Dhoma Gjyqësore e shpall **Vladimir Llazareviqin FAJTOR** për pikën 1 dhe 2 të Aktakuzës. dhe në bazë të paragrafit 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit, **TË PAFAJSHËM** për pikat 3-5 të Aktakuzës. Dhoma Gjyqësore e dënon Vladimir Llazareviqin me një dënim të vetëm me 15 vjet burgim. Vladimir Llazareviqi ndodhet në paraburgim që nga 3 shkurti 2005; dhe në bazë të paragrafit C të Rregullës 101 të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim deri tani, t'i llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Në bazë të paragrafit C të Rregullës 103 të Rregullores, Vladimir Llazareviqi do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

1212. Në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit, Dhoma Gjyqësore e shpall **Sreten Llukiqin FAJTOR** për pikat 1-5 të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore e dënon Sreten Llukiqin me një dënim të vetëm me 22 vjet burgim. Sreten Llukiqi ndodhet në paraburgim që nga 4 prilli 2005; dhe në bazë të paragrafit C të Rregullës 101 të Rregullores, ai ka të drejtë që koha e kaluar në paraburgim deri tani, t'i llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Në bazë të paragrafit C të Rregullës 103 të Rregullores, Sreten Llukiqi do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

1213. Në bazë të “Vendimit mbi Zbatimin e Rregullës 73bis” të Dhomës Gjyqësore të datës 11 korrik 2006, në lidhje me vendet e krimeve në Reçak, Padalishtë dhe në burgun e Dubravës, përkatësisht nga shkronjat a, e dhe j të paragrafit 75 të Aktakuzës, brenda dy javësh nga data e këtij Aktgjykimi, palët do të paraqesin parashtrimet e duhura para Dhomës Gjyqësore III të Tribunalit se si të procedohet më tej në lidhje me këto akuza.

Gjykatësi Ali Nawaz Chowhan i bashkëngjit Aktgjykimit mendimin e tij pjesërisht mospajtues.

Përpiluar në katër vëllime në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Gjykatësi Iain Bonomy
Kryegjykatës

Gjykatësi Ali Nawaz Chowhan

Gjykatësja Tsvetana Kamenova

Sot më 26 shkurt 2009
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]

MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT CHOWHAN

Me respekt shpreh mospajtimin tim me mendimin e shumicës në lidhje me parashikueshmërinë e dhunës seksuale kundër grave shqiptare kosovare për anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në konflikte si ky që po shqyrtojmë, në të cilin morën pjesë pjesëtarë fizikisht të aftë të forcave ushtarake dhe të sigurisë, të cilët vepruan në bazë të një plani të përbashkët për përdorimin e dhunës për shpërnguljen nga vatrat e tyre të shumë civilëve shqiptarë kosovarë, përfshirë dhe gra, matura, mendimi praktik dhe historia e konflikteve të paradokohshme në rajon më bëjnë të mendoj se dhuna seksuale, po ashtu si krimi i vrasjes, ishte padyshim realitet i parashikueshëm. Rrjedhimisht, gjykoj se për të Akuzuarit për të cilët u vërtetua pjesëmarrja në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ishte e parashikueshme se, gjatë zbatimit të planit të tyre kriminal, do të përdhunoheshin gra dhe vajza shqiptare kosovare dhe ndaj tyre do të ushtrohej dhunë seksuale, dhe si pasojë ata duhej të shpallehin fajtorë në bazë të formës së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për rastet e dhunës seksuale që u provuan në këtë çështje.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Gjykatësi Ali Nawaz Chowhan

Sot më 26 shkurt 2009
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]